UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" BASHKIA E QYTETIT TË KORÇËS FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË THIMI MITKOS NË 195-VJETORIN E LINDJES

(përmbledhje materialesh)

Korçë, 25-26 mars 2015

BOTIMI I MATERIALEVE TË KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË THIMI MITKOS NË 195-VJETORIN E LINDJES, U REALIZUA NËN KUJDESIN E VEÇANTË TË Z. SOTIRAQ FILO, KRYETAR I BASHKISË SË QYTETIT TË KORÇËS

KOMITETI SHKENCOR I KONFERENCËS

1.Prof. dr. ALI JASHARI, dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti i Korçës
2.Akad. JORGO BULO, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
3.Akad. FRANCESKO ALTIMARI, Universiteti i Kalabrisë, Itali
4.Prof. dr. YMER ÇIRAKU, zëvendësdekan i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës
5.Prof. DHORI QIRJAZI, Universiteti "Aristoteli" i Selanikut, Greqi
6.Prof. dr. SHABAN SINANI, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, QSA, Tiranë
7.Prof. as. dr. DION TUSHI, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti i Korçës

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË THIMI MITKOS NË 195-VJETORIN E LINDJES
BOTIM I VEÇANTË I BULETINIT SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

ISSN: 2078-7111

Përgatiti për botim: Msc. OLGER BRAME

Shtëpia Botuese "PROMO PRINT"

Mars 2015

PROGRAMI I KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË THIMI MITKOS NË 195-VJETORIN E LINDJES

SEANCA PLENARE

- **JORGO BULO** (TIRANË), *VEPRA E THIMI MITKOS PËR RINDËRTIMIN E IDENTITETIT KOMBËTAR*
- **FRANÇESKO ALTIMARI** (ITALI), *LIDHJET MIDIS ARVANITËVE DHE ARBËRESHËVE - ROLI I MITKOS DHE DE RADËS NË KËTE KONTEKST*
- **MATTEO MANDALÁ** (ITALI), *LETRAT E PABOTUARA TË MITKOS PËR KAMARDËN: SHËNIME PARAPRAKE PËR BOTIMIN E TYRE*
- **VALTER MEMISHA** (TIRANË), *THIMI MITKO PËR SHQIPEN PËRMES DOSJEVE PËR TË, NË ARKIVIN E INSTITUTIT TË GJUHËSISË DHE TË LETËRSISË, TIRANË*
- **DHORI Q. QIRJAZI** (SELANIK, GREQI), *NJË MOTËRZIM I PANJOHUR I "BLETËS SHQIPTARE" (ATHINË, 1875) SI PIKËNISJE PËR BOTIMIN E PLOTË TË "BLETËVE" TË THIMI MITKOS*
- **ELONA BIBA-ÇEÇE** (KORÇË), *BOTIMI I VEPRËS LEKSIKOGRAFIKE TË THIMI MITKOS NGA PROF. DHORI QIRJAZI-NJË AKT SHKENCOR DHE ATDHETAR*

SESIONI I GJUHËSISË

- **ABDULLA BALLHYSA, ELONA SOLLAKU, DHURATA HANOLI** (ELBASAN), *NGJYRIMET EMOCIONUESE "TË PROFILIZUARA" TË EMËRTIMEVE PREJ FLORËS DHE FAUNËS TE LIRIKAT E "BLETËS SHQIPTARE"*
- **AIDA URUÇI-ZAMIRA SHKRELI** (SHKODËR), *FUSHA LEKSIKORE E LEMAVE (LEKSEMAVE) TË FJALORIT TË THIMI MITKOS*
- **ASLLAN HAMITI - ISMET OSMANI** (SHKUP, MAQEDONI), *NDIHMESA E THIMI MITKOS NË LEKSIKUN E SHQIPES*

- **BAHTIJAR KRYEZIU** (GJILAN, KOSOVË), *FJALA SHQIPE NË SYNORIN E THIMI MITKOS*
- **BRUNILDA SPIRO** (TIRANË), *ELEMENTE LEKSIKORE ME PREJARDHJE GREKE NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **DANIELA-CARMEN STOICA** (KORÇË), *DISA FJALË ME PREJARDHJE LATINE (TË KONSERVUARA VETËM NË SHQIP DHE RUMANISHT) NË FJALORIN SHQIP-GREQISHT TË THIMI MITKOS*
- **DHIMITRI BELLO** (TIRANË), *DIAKRONI LEKSEMASH NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **IDRIZ METANI** (TIRANË), *IDENTIFIKIMI I KRIJIMTARISË POPULLORE SIPAS LEKSIKUT VENDOR NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **JULJANA KUME** (TIRANË), *ÇËSHTJE LEKSIKORE TË GJUHËS SHQIPE NË FJALORIN TRIGJUHËSH TË THIMI MITKOS*
- **KLEDI SHEGANI** (TIRANË), *VËSHTRIME LEKSIKORE NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **LINDITA XHANARI (LATIFI)-URTIS HARRI** (TIRANË), *KORPUSI I TURQIZMAVE NË PËRMBLEDHJEN FOLKLORIKE "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS DHE RËNDËSIA E TIJ NË PËRCAKTIMIN E KRONOLOGJISË SË HYRJES SË TURQIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE*
- **MAJLINDA BUSHAJ-MANJOLA DEMIRAJ** (SHKODËR), *RRETH PËRDORIMIT TË ORIENTALIZMAVE NË VEPRËN "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS*
- **MIMOZA ZEKAJ** (GJIROKASTËR), *DISA VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË GJUHËS SË THIMI MITKOS NË POEZITË E TIJ*
- **OLGER BRAME, BLEDAR LENJA** (KORÇË), *DËSHMITË LEKSIKORE TË THIMI MITKOS NË FJALORIN ETIMOLOGJIK TË G. MAJERIT*
- **SEJDI M. GASHI** (PRISHTINË, KOSOVË), *THIMI MITKO-GJUHËTAR, LEKSIKOLOG E LEKISKOGRAF I VEÇANTË*

- **ADELINA ÇERPJA** (TIRANË), *MBIPËRDORIMI I ZANORES **Ë** NË SHKRIMET E THIMI MITKOS*
- **AIDA KURANI** (DURRËS), *FJALIA RRJEDHIMORE NË PËRMBLEDHJEN FOLKLORIKE "BLETA SHQIPTARE"TË THIMI MITKOS*
- **ALMA POGONI** (KORÇË), *MJETE ILOKUTIVE NË FJALORIN E THIMI MITKOS*
- **ANILA ÇEPANI** - **ROZANA RUSHITI** (TIRANË), *VEÇORI FONETIKO-GRAMATIKORE NË LETËRKËMBIMET E THIMI MITKOS*
- **ANISA KOSTERI**-**TEFË TOPALLI** (SHKODËR), ***BASHKIMET SINTAGMATIKE DHE NË NIVEL FJALIE NË FJALORIN BISEDIMOR TË THIMI MITKOS***
- **ANYLA SARAÇI-MAXHE** (KORÇË), *MBI DISA TIPARE DIALEKTORE TË TOSKËRISHTES VERIORE NËPËRMJET ANTROPONIMISË TE "BLETA SHQIPTARE"*
- **ARMAND OMERI** (DURRËS), *TIPARE TË TOSKËRISHTES LETRARE NË PËRRALLAT E "BLETËS SHQIPTARE"*
- **BEGZAD BALIU** (PRISHTINË, KOSOVË), *THIMI MITKO DHE FILLIMET E SHKENCËS SË ALBANOLOGJISË*
- **BERTON SULEJMANI** (USHT,TETOVË, MAQEDONI), *KONGRUENCA E KRYEGJYMTYRËVE TË FJALISË NË VEPRËN "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS*
- **FATON KRASNIQI** (GJILAN, KOSOVË), *ONOMASTIKA NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **IZMIT DURMISHI** (USHT, TETOVË, MAQEDONI), *SHQYRTIM MBI GJUHËN E FJALËVE TË MOÇME DHE PËRRALLAVE TË THIMI MITKOS*
- **MUSTAFA IBRAHIMI** (UEJL, TETOVË, MAQEDONI), *ONOMAT NË "BLETËN SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS*
- **SENAD NEZIRI** (PRISHTINË, KOSOVË), *HABITORJA E SHQIPES NË VEPRËN E THIMI MITKOS, KRAHASUAR ME GJUHË TË TJERA TË BALLKANIT*

- **SPIRIDHULLA POÇI** (GJIROKASTËR), *DUKURI MORFOLOGJIKE NË PROZËN E THIMI MITKOS*
- **TEUTA TOSKA** (ELBASAN), *PËR DISA SHPREHJE SI SHFAQJE TË LIGJËRIMIT POETIK POPULLOR TE "BLETA SHQIPTARE"*

SESIONI I ETNOFOLKLORIT, HISTORISË DHE KULTURËS

- **AGATA ROGOŚ** (POZNANJ, POLONI), *MITI I GJUHËS NË LETËRKËMBIMIN E THIMI MITKOS NË DRITËN E NDËRTIMIT TË IDENTITETIT SHQIPTAR*
- **AGRON XHAGOLLI** (TIRANË), *FJALORËT E THIMI MITKOS NË VËSHTRIM ETNOKULTUROR*
- **ALMIRA SADIKAJ** (GJIROKASTËR), *FJALËT E URTA POPULLORE SI SHPREHJE E ETNOGRAFISË SË TË FOLURIT NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **ANTON BERISHA** (ITALI), *RRETH PARATHËNIES SË "BLETËS SHQIPTARE"(1878) TË THIMI MITKOS*
- **ARJANA SEITI** (TIRANË), *ENTITET ETNIK TE "BLETA SHQIPTARE"*
- **ARTUR LAMAJ-JANI JANI** (GJIROKASTËR) *ASPEKTE ETNOLINGUISTIKE E SOCIOLINGUISTIKE NË PËRRALLAT E "BLETËS SHQIPTARE"*
- **BEXHET ASANI** (STRUGË, MAQEDONI), *NGJASHMËRITË E DISA KËNGËVE TË "BLETËS SHQIPTARE " ME KËNGËT E FSHATRAVE TOSKE TË TREVËS SË STRUGËS*
- **ERIS RUSI** (KORÇË), *GJITHÇKA ËSHTË PËRRALLË-TRASHËGIMIA E RRËFIMIT NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **ERMIRA YMERAJ** (SHKODËR), *NDIKIMI PËRMBAJTËSOR I MOTIVEVE TË "BLETËS SHQIPTARE" NË KRIJIMIN E PROFILIT ETNOLOGJIK DHE KULTUROR TË THIMI MITKOS*
- **ILIR SHYTA** (KORÇË), *KONCEPTI POPULLOR PËR DASHURINË DHE VAJZËN TE KËNGËT E DASHURISË TË "BLETËS SHQIPTARE"*

- **IZAIM MURTEZANI** (SHKUP, MAQEDONI), *ASPEKTE NARRATOLOGJIKE TË PËRRALLËS: KORDHA, YLLI DHE DETI*
- **JONELA SPAHO** (KORÇË), *KËNGËT E DASMËS DHE RITUALI I TYRE TE "BLETA SHQIPTARE" E THIMI MITKOS*
- **MYRVETE DRESHAJ-BALIU** (PRISHTINË, KOSOVË), *POEZIA E THIMI MITKOS MES FOKLORIT DHE VJERSHËRIMIT ROMANTIK*
- **ROVENA VATA** (TIRANË), *THIMI MITKO: PARIME TË NËNKUPTUARA METODOLOGJIKE DHE ESTETIKE NË PUNËN E TIJ SI MBLEDHËS FOLKLORI*
- **SHABAN SINANI** (TIRANË), *"BËLETA SHQIPËTARE" E THIMI MITKOS DHE "BLETA SHQYPËTARE"E GJERGJ PEKMEZIT(NJË KËNGJELJ I MILOSAAT NË KOLEKSIONIN E MITKOS)*
- **VALBONA SINANAJ** (ELBASAN), *VËSHTRIME FOLKLORIKE NË VEPRËN E THIMI MITKOS*
- **ADELA ISMIRLIADHU** (SELANIK, GREQI), *TË DHËNA RRETH ARSIMIT NË KORÇË NË MESIN E SHEK. XIX*
- **DION TUSHI** (KORÇË), *THIMI MITKOJA NËPËRMJET ARTOGRAFISË DHE LETËRKËMBIMEVE*
- **ELVIRA LUMI-LEDIONA LUMI** (ELBASAN), *EVOLUIMI I FIGURAVE POETIKE NË VEPREN "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS*
- **EMINE SHABANI** (USHT, TETOVË, MAQEDONI), *THIMI MITKO- ATDHETAR, STUDIUES DHE MBLEDHËS I FOLKLORIT*
- **GËZIM RREDHI-YLLKA KËNAÇI** (GJIROKASTËR), *LETËRKËMBIMI ME PERSONALITETE TË BOTËS SHQIPTARE, SHPREHJE E INTERESAVE TË LARTA KOMBËTARE TË THIMI MITKOS*
- **HAMIT XHAFERI** (UEJL, TETOVË, MAQEDONI), *KONTRIBUTI I THIMI MITKOS NË MBLEDHJEN E FOLKLORIT SHQIPTAR*

- **IRENA NIKAJ** (KORÇË), *NGA REVOLTAT E ARMATOSURA TE RRJETI KULTUROR I INTELEKTUALËVE NË SHËRBIM TË ZGJIDHJES SË ÇËSHTJES KOMBËTARE-ROLI I THIMI MITKOS NË KËTË LËVIZJE*
- **KUJTIM BEVAPI** (ELBASAN), *THIMI MITKOJA DHE KONSTANDIN KRISTOFORIDHI*
- **LABINOT BERISHA** (PRISHTINË, KOSOVË), *SA E ÇMOI DHE SI E NDIHMOI THIMI MITKOJA BOTIMIN E "FIAMURIT TË ARBËRIT"(1883-1887) TË DE RADËS*
- **LILI SULA** (TIRANË), *KRIJIMTARIA LETRARE E THIMI MITKOS*
- **MERITA GJOKUTAJ-SHEHU**, (GJIROKASTËR), *"BLETA SHQIPTARE"-TOPOGRAPHIA SACRA E HISTORISË DHE TRADITËS SHQIPTARE*
- **MIRELA SARAÇI** (GJIROKASTËR), *KONTRIBUTI I THIMI MITKOS NË KULTURËN E RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE*
- **NELI NAÇO** (KORÇË), *"BLETA SHQIPTARE" SI MEMORJE KULTURORE DHE HISTORIKE*
- **SOKOL SUPARAKU** (KORÇË), *THIMI MITKOJA SI AKTOR I EPOKËS MODERNE DHE I PËRHAPJES SË NACIONALIZMIT*
- **VEBI BEXHETI** (UEJL, TETOVË, MAQEDONI), *NGA FONDI I DORËSHKRIMEVE TË THIMI MITKOS, NË DRITËN E STUDIMEVE TË JORGO BULOS*
- **YMER ÇIRAKU** (TIRANË), *THIMI MITKOJA PËRMES LETËRKËMBIMEVE ME DE RADËN*
- **ZEQIR KADRIU** (UEJL, TETOVË, MAQEDONI), *VLERA KULTURORE E PATRIOTIKE E THIMI MITKOS NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE*
- **ZEQIRJA NEZIRI** (SHKUP, MAQEDONI), *NJË NGJARJE HISTORIKE E KËNDUAR NË TRI KËNGË*

JORGO BULO (TIRANË)

VEPRA E TH. MITKOS PËR RINDËRTIMIN E IDENTITETIT KOMBËTAR

Shqipëria, edhe pse "nja nga provincat më të paqeta të Perandorisë Osmane"[1], në shekullin e lëvizjeve të mëdha nacionale në Ballkan, u gjend e vonuar në proceset e formimit dhe të pavarësimit kombëtar të popujve të gadishullit.

Katër shekuj e ca pushtimi osman, që iu mbivunë shekujve të pushtimeve e të sundimit të perandorive romake, bizantine e sllave, kishin lënë vragë të thellë në historinë e shqiptarëve, të cilët ballafaqoheshin në situatën e re të përçarë, pa një traditë shtetërore kombëtare dhe pa një traditë unitare zhvillimi gjuhësor e kulturor, pa shkollën e tyre kombëtare dhe pa fenë e kishën e tyre kombëtare, pa një qendër të rëndësishme politike e intelektuale, me një mendësi regjionaliste e individualiste, të trashëguar nga psikologjia e bajrakut dhe e fisit, e për pasojë pa një vetëdije kombëtare të zhvilluar në nivelin e një lëvizjeje të organizuar me program kombëtar. Por sidoqoftë, populli shqiptar kishte ardhur në shek.XIX i gjallë si bashkësi etno-shoqërore e gjuhësore, me kujtimin e një shteti mesjetar dhe të një mbretërie të humbur, dmth me trashëgimin e madh historik të epokës së Skënderbeut dhe, pa dyshim, me ndjesinë e veçorisë etnike, që e dallonte prej "të tjerëve", sidomos përmes gjuhës. Por kjo ishte e pamjaftueshme për të hyrë në epokën e një rilindjeje të vërtetë kombëtare. Duhej bërë një kapërcim historik nga vetëdija e veçorisë etnike në vetëdijen e kombit, nga lëvizja mendore e një preromantizmi ideologjik e kultivuar më herët, në shek. XVIII, sidomos në mjediset intelektuale të arbëreshëve të Italisë, në epokën e romantizmit nacional dhe të një lëvizjeje të gjerë, të programuar, politike dhe kulturore që kishte në bazë idetë e nacionalizmit modern dhe të mendimit iluminist. Këtë lëvizje e përuruan dhe i dhanë forcë e jetë me idetë dhe veprën e tyre njerëzit e mëdhenj të Rilindjes, duke filluar nga De Rada, A. Mashi, Naum Veqilharxhi e Pashko Vasa te Naimi, Samiu, G.Dara, Serembja, Mjeda, Çajupi, Noli, Konica e të tjerë. Merita e tyre nuk qëndron vetëm në faktin se ata e zgjuan ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve, por në faktin se e ndryshuan botën shqiptare, duke i kthyer idetë e veta në ideologji të një lëvizjeje masive e të organizuar për çlirim kombëtar, që u njoh me emrin e Rilindjes Kombëtare dhe u shtri në gjithë trojet dhe në diasporën shqiptare. Me fjalë të tjera përpjekja, sidomos e asaj plejade mendimtarësh prekursorë arbëreshë të shek. XVIII që, siç shprehet prof. A.Guxeta, "dolën në shesh si protagonistë guximtarë të një stine kulturore që synonte rivlerësimin e një identiteti kulturor"[2] nuk mbeti thjesht një ëndërr; lëvizja e Rilindjes Kombëtare gjatë shek.XIX e ktheu atë ëndërr nga një mision në një aksion, për rindërtimin dhe jetësimin e këtij identiteti të munguar, jo vetëm përmes lëvrimit të gjuhës dhe themelimit të letërsisë kombëtare, por edhe të organizimit të një rrjeti

[1] E. Çabej, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë, 1994, f.97.
[2] A.Guxeta, *Shqyrtime letrare,* Tiranë, 2007, f.126.

shoqërish, klubesh kombiare, institucionesh arsimore, kulturore, botimesh të shtypit dhe zhvillimit të studimeve albanistike.
Idetë e një rilindjeje kombëtare do të ishin një ëndërr e mbetur në sirtar, për shkak të pamundësisë për t'i vënë në qarkullim publik, pa atë aksion që i ktheu ato gjatë shek.XIX në frymë dhe kauzë të epokës, në një forcë që lëvizi historinë.
Protagonist i këtij aksioni u bë dhe Th. Mitkoja, një nga veprimtarët e shquar aktivë të lëvizjes dhe një nga zbuluesit e përkushtuar të vlerave identitare të kombit. Ai me veprën e tij i nxori ato vlera nga harresa, u hoqi pluhurin e shekujve, duke zbritur në burimin e tyre, në thesaret e traditës folklorike, të gjuhës e të kulturës shpirtërore të kombit. Vepra e Mitkos është një dëshmi e faktit se Rilindja Kombëtare nuk ishte një akt, por një proces. Ajo nuk lindi mbi një boshllëk, por mbi një truall të përgatitur nga zhvillimet kulturore që e paraprinë dhe në një kontekst zhvillimesh politike e kulturore, jo vetëm të brendshme, por dhe të jashtme, ballkanike dhe evropiane. Mitkoja, edhe për shkak të lëvizjeve të tij të shumta, sidomos në Vjenë, po dhe në Athinë, Bukuresht, Trieste, Venedik, Manastir e përfundimisht në Egjipt, ra në kontakt me idetë e zgjimit nacional të popujve të Ballkanit dhe me punën e një vistre albanologësh të huaj dhe bashkatdhetarë, krijoi lidhje të ngushta me ta dhe me veprën e tij u bë pjesë dhe faktor i zhvillimit të studimeve për prejardhjen historike të shqiptarëve dhe të gjuhës e të kulturës së tyre, ndërtuar jo vetëm mbi mitet, por dhe mbi realitetet dhe faktorët relevantë të identitetit të tyre kombëtar. Kështu vepra e Mitkos etnolog iu kushtua jo vetëm kërkimit të burimeve folklorike të këtij identiteti, por shumë më gjerë, duke përfshirë gjuhën, historinë, etnografinë, etnogjenezën dhe kulturën materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve.
Metafora e madhe e shkollës romantike e kthimit te rrënjët dhe e rizbulimit të shpirtit të etnisë, kish nxitur veç të tjerash dhe zgjimin e interesit për kulturën tradicionale popullore, si shprehje e gjenisë krijuese dhe e individualitetit të bartësve të kësaj kulture. Shqiptarëve u mungonte një botim, si një monument madhor, që të paraqiste para vetes dhe të tjerëve këtë pasuri që jetonte në kujtesën, në këngën, baladat, përrallat, legjendat dhe eposin e tyre, e përcjellë gojarisht, por e pastudiuar, e papërmbledhur dhe e pavënë në qarkullim shkencor. Popuj të tjerë, që e kishin kaluar më herët epideminë osianike, i kishin mbledhur gjymtyrët e eposeve të tyre, ose i kishin paraqitur ato si të tilla përmes një mistifikimi mbresëlënës. Modeli i këtyre botimeve i krijuar nga De Rada pa dyshim ishte frymëzues dhe nxitës për veprimtarin e kolonisë shqiptare të Egjiptit, që ishte në lidhje të ngushtë me patriarkun e kulturës, arbëreshe. Mitkoja pat bërë gati për botim, që në vitin 1868, thuajse në një kohë me "Rapsoditë" (1866) e De Radës, një përmbledhje folklorike me titull "Këngë shqipe erotike dhe heroike"[3].

Në kohën kur Mitkoja e të tjerë iu vunë punës për mbledhjen dhe publikimin e visarit folklorik, kishte kaluar një shekull prej revolucionit që pat shkaktuar shkolla e Herderit, e frymëzuar nga emocioni romantik dhe nga ndjenja e lirisë së popujve

[3] B. Vila, *Një dorëshkrim i hershëm i Thimi Mitkos*, "Studime filologjike", 2001, nr.3-4, f.145-162.

dhe e afirmimit të tyre kombëtar. Por për inteligjencien shqiptare të Rilindjes ishte pikërisht koha e mbledhjes së këtij thesari, ishte një kërkesë që vinte si një urdhëresë historike. Botimi i "Bletës shqiptare" më 1878, mu në ditët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ishte pjesë e projektit të madh të Rilindjes për zbulimin e rrënjëve të kombit dhe afirmimin e identitetit të tij.

Me vetëdijen se kënga e popullit ishte arkivi i kujtesës së tij e se atje gjendeshin themelet e ripërtëritjes kulturore, Mitkoja me "Bletën Shqiptare", i rikthente gjininë popullit të vet dhe dëshmonte ekzistencën e shqiptarëve si komb. Botimi i një libri me thesarin shpirtëror të shqiptarëve ishte një argument që rrëzonte pretendimet e qarqeve antishqiptare sipas të cilave ky ishte një popull "pa libër", domethënë pa kulturë, pa gjuhë, pa histori dhe pa letërsi, një popull që, si thuhej, "ua kishte ngrënë librin lopa". "Bleta shqiptare" ishte një monument kulture, një provë se shqiptarët kishin librin e tyre të shkruar e të pashkruar, pasqyrë e zhvillimit të tyre historik e shpirtëror, e kulturës dhe e qytetërimit të tyre.

Larmia e madhe e lëndës folklorike të përfshirë në këtë libër: këngë rituale, balada, këngë historike dhe heroike, këngë të dëshmisë, këngë të kurbetit, gjëegjëza, fabula, anekdota dhe përralla, të mbledhura nga bartës të të gjitha arealeve rurale dhe urbane dhe të të gjitha trevave, nga Veriu e nga Jugu, nga arbëreshët e Italisë dhe nga arvanitët, plotësonin mozaikun e madh që shprehte shpirtin popullor dhe njësinë shpirtërore të kombit. Mbizotëron në këtë mozaik repertori i folklorit rural, i freskët në figuracion, me një pasuri tropesh të befta, me një peizash magjepsës rustik që shërben si sfond i idileve dashurore, dramave njerëzore ose gjesteve heroike të trimave të çartur e rebelëve kryengritës që kanë mbetur në këngë si një emër mbi një gur varri të harruar. Janë këto balada e këngë epike tronditëse dëshmi e ngjarjeve historike, janë historia e ngulitur në kujtesën popullore; ato na kujtojnë thënien e Zhorzh Sandit se "fshatari është i vetmi historian që na mbetet nga kohërat e shkruara". Këtë aspekt të rëndësisë së një dokumentacioni historik të këngëve epike, dhe jo vetëm epike, e plotëson sidomos në veprën e Mitkos një sistem i tërë shënimesh historike, komentesh e realesh, me vlerë për lokalizimin e ngjarjeve e të personazheve të tyre dhe të gjithë atmosferës së kohëve të mugëta të një historie të pashkruar.

Në faqet e këtij libri në dukje të përkorë, po të shprehemi me fjalët e Lasgushit, është "gjithë fisi, gjithë jeta", janë të gjitha elementet parësore e dytësore të identitetit tonë, duke filluar nga gjuha, historia, mentaliteti, virtytet dhe veset, zakonet dhe ritet pagane dhe fetare, etnopsikologjia e shqiptarit, peizazhi i atdheut dhe koloriti etnografik, gjithçka ka vënë vulën në individualitetin kombëtar të këtij populli vital, por gjithsesi të vonuar në histori dhe të dënuar nga vetvetja e nga të tjerët.

Do të ishte e mangët paraqitja e kontributit të Mitkos për ndërtimin e identitetit kombëtar, pa folur për konceptin e tij për gjuhën si faktor themelor në procesin e formimit të kombit dhe të kulturës së tij. Gjuha për njerëzit që vunë themelet e lëvizjes kombëtare nuk ishte vetëm tipar i qenësishëm i individualitetit

etnik dhe faktor vendimtar i mbijetesës së shqiptarëve si popull, por dhe dëshmi e lashtësisë së tyre si komb. Duke bërë të tyren tezën romantike të prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve (defiçitare për nga argumentet, por jo për nga patosi retorik me të cilin mbrohej), tezë që u përpunua në mjediset kulturore arbëreshe dhe kaptoi Adriatikun[4], veprimtarët e Rilindjes bashkonin në një argument të vetëm lashtësinë e shqipes me lashtësinë e shqiptarëve si pasardhës të pellazgëve mitikë. Mitkoja, që gjithashtu e përkrahu këtë tezë, e cila sipas tij, "i lidh ata (shqiptarët) me pellazgët e moçëm, domethënë me vetë prindërit e kombit dhe të qytetërimit grek"[5], ka meritën se iu përmbajt një vije të qartë demarkacioni, që e ndan nga spekulimet e thurura mbi bazën e kësaj "origjine të përbashkët", të supozuar, me synimin, siç shkruan prof. Buda, për t'i futur shqiptarët në gjirin e "helenizmit", jo vetëm në kuptimin e një rrethi kulturor, por dhe në kuptimin politik"[6]. "Ajo që kundërshtojnë shqiptarët, me tërë fuqinë tyre, shkruan Mitkoja, është thëthitja, nëse mund të shprehemi kështu, e individualitetit të tyre kombëtar, domethënë vdekja politike dhe shoqërore e racës së tyre, e gjuhës, dokeve e zakoneve dhe e traditave të tyre[7]. Për pasojë, ajo që i shpëton shqiptarët nga kjo vdekje, sipas Mitkos, është gjuha. Ai është për "qytetërim natyral dhe rrënjësor të Shqipërisë, që mund të bëhet, sipas tij, vetëm e vetëm nëpërmjet gjuhës amtare"[8]. Me këtë bindje, Mitkoja, njëherazi me mbledhjen e lëndës folklorike, nisi dhe qëmtimin e fjalës shqipe, të leksikut e frazeologjisë popullore, jo vetëm nga goja e subjekteve prej nga vilte këngën e popullit, por dhe nga botimet e kohës që i binin në dorë. Kurorëzimi i kësaj pune ishte hartimi prej tij i disa fjalorëve, që deri dje kishin mbetur të panjohur, e të pabotuar, i një libri bisedimor italisht-greqisht shqip, i "Fjalëtores shqip-gërqisht" dhe i "Fjalëtores gërqisht-shqip". Njohja e këtyre veprave, të zbuluara këtu e tridhjetë vjet më parë në Arkivin e Mitkos në Aleksandri, na lejon të flasim sot edhe për Mitkon leksikograf, për veprën e tij leksikografike, me po aq rëndësi për rindërtimin e identitetit kulturor të shqiptarëve, si dhe folkloristika. Puna si leksikograf e pasuron personalitetin e Mitkos me një përmasë të re, të rëndësishme, si njeri i rilindjes, në kuptimin e plotë të fjalës.

"Fjalëtorja" e Th.Mitkos është një monument i shqipes, një vepër që konservon një pasuri të rrezikuar të fondit të leksikut të saj historik, një ndërmarrje madhore e shestuar si pjesë e programit kulturor të Rilindjes, jo vetëm për të dëshmuar vlerat identitare të kombit, por dhe për të vënë themelet e kulturës kombëtare dhe të gjuhës letrare, me vepra bazale për të, siç janë alfabeti, gramatika dhe fjalori. Nuk është e rastit që kësaj ndërmarrjeje i kanë hyrë në të njëjtën kohë, në vitet 60-80 të shek.XIX, K.Kristoforidhi me fjalorin e tij shqip-greqisht, S.Frashëri

[4] Shih. M.Mandala, *Ideologjia albaniste dhe Rilindja e parë: Aktivitetet e Arbëreshëve gjatë shekullit XVIII*, në "Një Rilindje para Rilindjes", Botim i Universitetit "E. Çabej",2014, f.8
[5] Th. Mitko, *Vepra*, (Botim i Akademisë së Shkencave), Tiranë 1981, f.560.
[6] A. Buda, *Shkrime historike*, vëll. 2, Tiranë 1986, f.74.
[7] Th. Mitko, *Vepra* (Botim i Akademisë së Shkencave) Tiranë 1981, f.560
[8] Po aty, f.615.

me “Fjalëtoren” e tij të gjuhës shqipe dhe Th.Mitkoja me “Fjalëtoren shqip-greqisht dhe greqisht-shqip”, të tria të mbetura të pabotuara me gjallje të autorëve. Fjalori i Kristoforidhit u botua më 1904, “Fjalëtores” së S.Frashërit nuk i dihet fati, kurse “Fjalëtorja” e Mitkos po e sheh dritën e botimit pas 125 vjetësh nga vdekja e tij, falë punës së përkushtuar të prof. Dhori Qirjazit.[9]

Edhe në rastin e shkollës leksikografike të Rilindjes, përfaqësuar nga ky trinitet themeluesish të saj, nuk mund të mos dallojmë vazhdimin e një tradite pararendëse, por dhe një kapërcim historik në një stad cilësisht të ri, jo thjesht për nga përmasat dhe niveli i përpunimit leksikografik, por për nga funksioni, si mjet i mësimit të shqipes. Tradita pararendëse më e afërt për Mitkon duket se ka qenë shkolla leksikografike e Voskopojës e shek. XVIII. Nuk kemi të dhëna nëse ka pasur në dorë “Fjalorin greqisht-arumanisht-shqip” (1770) të T.Kavaljotit, por mund të flasim me siguri se ka pasur në tavolinën e punës “Isagogjinë” e Dh.Haxhiut (botuar më 1802 në Venedik, por që mund të ketë pasur një botim të parë më 1794). Një kopje të kësaj vepre e kopjuar me dorë (nga vetë Mitkoja ose një tjetër) e kemi gjetur në Arkivin e Mitkos dhe sot gjendet e depozituar në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë. Ky libër mësimesh fillestare shoqërohet me një fjalor katër gjuhësh: greqisht-arumanisht, bullgarisht dhe shqip. Nga ky model do të jetë nisur Mitkoja kur hartoi dhe ai një fjalor bisedimor italisht-greqisht-shqip, që u gjet po në Arkivin e Mitkos dhe u depozitua më 1984 po në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Por Mitkoja do ta braktiste shpejt këtë model me hartimin e Fjalëtores shqip-greqisht dhe greqisht-shqip. Në radhë të parë e braktisi, sepse nisej prej një qëllimi diametralisht të kundërt. Ndërsa Dh. Haxhiu, si e thotë hapur në hyrje të librit, synon t’u mësojë greqishten shqiptarëve, vllehëve e bullgarëve për të braktisur gjuhët e tyre “barbare”, pra si të thuash t’u mësonte shqiptarëve greqishten duke përdorur shqipen kundër shqipes, Th.Mitkoja, si dhe Kristoforidhi, përmes fjalorëve të tyre synojnë t’u mësojnë shqiptarëve shqipen dhe greqishtja “është hallka ndërmjetëse, metagjuha, që e ndihmon autorin për t’u nisur prej shqipes e për të mbërritur po tek ajo[10]. Këtë hap cilësisht të ri, për një fjalor për të mësuar shqipen dhe për shkollat shqipe duhet ta ketë çuar më tej S.Frashëri me “Fjalëtoren” e tij. Nga sa del prej një letre të J.Vretos e 23 nëntorit të vitit 1885, dërguar Mitkos, fjalori i Samiut, që Vretoja e ka pasur në dorë, dhe i ka numëruar “mbi 6000 fjalë rrënjë, që me të dalat të pakënë bënen dy a tri herë aqë”[11], (pra një fjalor me 12-18,000 fjalë), duhet të ketë qenë një fjalor shpjegues shqip-shqip, i destinuar, me sa kuptohet, si edhe alfabetarja, gramatika e tekstet e tjera, për shkollën kombëtare shqipe, që do të hapej në Korçë, dy vjet më pas, më 1887. Po qe kështu, kjo do të ishte vepra që do të kurorëzonte shkollën leksikografike të

[9] Shih. Th. Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht-shqip* (përgatitur nga Dhori Q. Qirjazi) Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2014, 778 faqe.
[10] Po aty, f.25
[11] Shih. J.Bulo, “*Magjia dhe magjistarët e fjalës*”, Tiranë, 1998, f.231-235.

Rilindjes, krahas veprës së Kristoforidhit e të Mitkos. Vendi i Mitkos në këtë lagje intelektualësh atdhetarë, është vendi i një prej personaliteteve të shquara të Rilindjes, që me veprën e tyre të shumanshme, zbuluan dhe afirmuan vlerat identitare të kombit, ngritën vetëdijen kombëtare të shqiptarëve në shkallën e kërkesave të kohës, duke shënuar udhën që çonte në pavarësinë e Shqipërisë.

FRANÇESKO ALTIMARI (KALABRI, ITALI)

LIDHJET MIDIS ARVANITËVE DHE ARBËRESHËVE – ROLI I MITKOS DHE DE RADËS NË KËTË KONTEKST

Përmbledhje

Në këtë kumtesë do të ndalem mbi raportet që patën midis tyre Jeronim De Rada dhe Thimi Mitkoja, duke u përqendruar mbi letërkëmbimin e tyre që ruhet në Arkivin Shtetëror të Tiranës dhe në materialin e botuar në revistën arbëreshe "Fjamuri Arbërit" (1883-1887). Në veçanti do të ndalem mbi kontributin që këta dy intelektualë dhe patriotë të mëdhenj i dhanë Rilindjes në vitet '70-'80 të shekullit XIX, duke nënvizuar lidhjet që përmes tyre u krijuan brenda kësaj lëvizjeje patriotike midis vatrave të ndryshme shqiptare të diasporës dhe të mëmëdheut. Nga këto kontakte do të shohim se si idetë që ata debatuan i dhanë një shtyrje të mëtejshme procesit të konvergjencës midis qendrave të shkëputura të një intelligjence, siç ishte ajo shqiptare asokohe, të shpërndarë në vatrat e Mesdheut, në emër të mbrojtjes së identitetit kombëtar, me qëllim që të gjente në gjuhën dhe në kulturën e përbashkët, rrugën dhe faktorin e bashkimit. Natyrisht ndikimet e ambientit politik dhe nacional të Shteteve ku këto vatra ndodheshin, i theksonin dasitë dhe grindjet midis këtyre qarqeve intelektuale, që në sajë të diferencave të këndvështrimeve të tyre arrinin të gjenin një farë konvergjence që favorizonte lindjen e një procesi më të avancuar pjekurie në debatin kulturor të kohës dhe gjetjen e një rrugëdaljeje nga nacionalizmat e shteteve fqinje të sapoformuara, që ndikonin negativisht në emancipimin e klasës intelektuale shqiptare dhe arbëreshe.

Vizioni politik realist dhe largpamës i De Radës, u përhap sidomos me revistën e tij "Fjamuri Arbërit dhe, u mbështet edhe nga ndjekësi i tij Anselmo Lorekjo me revistën tjetër arbëreshe "La Nazione Albanese". Kjo revistë përkrahte më shumë një autonomi të madhe të Arbërit (Shqipërisë) të bashkuar brenda perandorisë osmane, se sa një pavarësi të brishtë të një kombi të copëtuar, që, jashtë perandorisë mund të ishte nën rrezikun e asimilimit të politikës kanosëse të shteteve nacionaliste fqinje (Greqisë dhe sidomos Serbisë). Ajo pati meritën se u ofroi një rrugëdalje intelektualëve dhe patriotëve të tjerë të Rilindjes, sidomos arvanitëve dhe shqiptarëve që ishin nën presionin e fortë të qarqeve fetare dhe nacionale greke, për një përspektivë të ndryshme nga ajo e bashkimit nën të njëjtën çati "ortodokse" mbi baza fetare dhe jo kombëtare, që kishte një peshë të madhe në debatin e kohës. Në planin politik kjo ide shfaqej me kërkesën e një Federate shqiptaro-greke që De Rada e kundërshtoi me forcë dhe me këmbëngulje, ndryshe nga intelektualë të tjerë të Rilindjes si arbëreshi Dhimitër Kamarda dhe arvanitët Kupitori dhe Kullurjoti , që ëndërronin një "komb" të përbashkët ortodoks ku të dy popujt, të bashkuar nga i njëjti kontekst - gjeografik, kulturor dhe fetar - mund të bashkëjetonin lirisht dhe paqësisht.

MATTEO MANDALÀ (PALERMO, ITALI)

LETRAT E PABOTUARA TË MITKOS PËR KAMARDËN: SHËNIME PARAPRAKE PËR BOTIMIN E TYRE

Vendi qendror që zënë figura dhe vepra e Thimi Mitkos (1820-1890) është nënvizuar sa e sa herë.
Duke qenë folklorist e shkrimtar, leksikograf e gjuhëtar, historian e publicist, profili i tij poliedrik jo vetëm dallon nga ai i studiuesve të tjerë bashkëkohës të tij, por përmbledh në vetvete edhe tiparet e intelektualit romantik e militant.
Impenjimi për çështjen e rilindjes shpirtërore dhe politike të Shqipërisë, që hodhi rrënjë tek ai që në vitet e rinisë së hershme, qe një prej arsyeve që e shtynë Mitkon të mbulonte një rol themelor në lëvizjen e Rilindjes, një rol ky që nëse në njërën anë vuri në dukje energjinë e tij polemike, formimin e thelluar kulturor dhe prirjen e vendosur ndaj kërkimit shkencor, nga ana tjetër bëri të mundur që të bëhej mjaft i njohur në Ballkan dhe jashtë tij. Emri i Mitkos filloi të gëzonte një admirim të pamatë nga ana e intelektualëve europianë bashkëkohës me emër edhe falë botimit të një sërë artikujsh (nga viti 1859 e këtej) në revistën greke *Pandora*, mjaft e përhapur në Itali në qerthujt e ashtuquajtur filohelenistikë dhe me prirje rilindëse. Ndër këta intelektualë disa janë arbëreshë, me të cilët Mitko do të mbajë raporte të gjata dhe të frytshme bashkëpunimi dhe shkëmbimi kulturor.
Dokumentet që disponoheshin deri dje na kanë lejuar të përshkruajmë me detaje të bollshme e të mjaftueshme cilësinë e këtyre raporteve. U referohem në veçanti shkrimeve të vetë Mitkos të botuara në tribunën e njohur *Fiamuri i Arbërit,* të themeluar nga Jeronim De Rada dhe pikërisht asaj pjese të epistolarit mes këtyre korifejve që ruhet aktualisht në Arkivin e Shtetit në Shqipëri dhe që e botoi Qemal Haxhihasani në vitin 1981 në apendiks të veprës së Mitkos[12] (ky i fundit një herë e një kohë i përkiste vetë fondit në dorëshkrim deradian që ruhej pranë Bibliotekës së qytetit të Kozencës).
Nuk mund të lëmë në heshtje faktin që intelektuali korçar u shkroi letra Dora D'Istrias (1828-1888), Francesco Crispit (1808-1901), G. Skiroit (1865-1927). Bëhet fjalë për dokumente që pa dyshim kanë dhënë një ndihmesë të madhe në drejtim të përvijimit të kuadrit të raporteve mes arbëreshëve dhe intelektualëve shqiptarë të shpërndarë në zona të ndryshme të kontinentit të vjetër dhe të Lindjes së afërt. Sot, falë rekuperimit të arkivit të Mitkos në Kairo, të kryer nga një ekip studiuesish të drejtuar nga "i riu" Jorgo Bulo, disponojmë botime të freskëta të materialeve të tjera të pabotuara, por dhe të botuara e të prodhuara pothuaj të gjitha nga Thimi Mitko.

[12] Thimi Mitko, *Vepra*, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Tiranë, 1981, f. 617, 630-631, 633-635 e 638-709. Kjo pjesë e epistolarit përfshin vitet 1872-1889.

Ndër to përmendim fjalorët e përgatitur përkatësisht nga Sh. Sala[13] dhe Dhori Q. Qiriazi[14], të cilët jo vetëm na bëjnë të mundur plotësimin e informacioneve që nevojiten për të rindërtuar punën e madhe dhe të pabotuar të Thimi Mitkos, por dhe ribashkimin e fijeve që e lidhnin nga njëra anë me kontekstin historik e kulturor të epokës së tij dhe nga ana tjetër me ambientet arbëreshe.

Nuk ka asnjë dyshim që nga dy punimet leksikografike të cituara më sipër të mund të dalin në pah të dhëna gjuhësore interesante që dëshmojnë në mënyrë të padiskutueshme sa të frytshme dhe intensive kanë qenë të tilla raporte. Nëse u shtojmë këtyre të dhënave dhe ato materiale që na vijnë prej një fondi tjetër arkivistik që ruan të tjera dorëshkrime të Mitkos, jo vetëm arrihet konfirmimi i plotë mbi sinergjinë e vendosur mes Mitkos dhe arbëreshëve, por rriten mundësitë për të arritur në një vlerësim kritiko-historiografik më të përditësuar të gjendjes së studimeve të albanologjisë së gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe njëkohësisht fiton vlefshmëri më të madhe shkencore rindërtimi i një rrjeti të përforcuar që mbante në kontakt të ngushtë komunitetet dhe patriotët shqiptarë që për arsye të ndryshme ishin të vendosur jashtë atdheut të tyre të origjinës.

Përmendja dhe citimi i emrit të Dhimitër Kamardës (1821-1882) nuk është aspak e rastit, sepse fondi me të cilin do të merrem në këto faqe i përket një arkivi që një herë e një kohë përmblidhte dorëshkrime të vyera të shkruara prej tij dhe letra interesante private të tijat, si dhe materiale në dorëshkrim të dy vëllezerve të vet: Nicolò (1807-1884) dhe Giuseppe (1831-1878), duke qenë se dhe ata, sidomos Nicolò, kishin krijuar raporte miqësie dhe bashkëpunimi me Thimi Mitkon.

Ky arkiv për të cilin po bëjmë fjalë e që ka rrezikuar si shumë pasuri e thesare të tjera të kulturës arbëreshe të pësonte shpërbërje dhe humbje të paevitueshme, na ka ardhur pothuaj i plotë dhe i ndarë në dy nënndarje kryesore. Njëra nënndarje është ajo "*arbëreshe*" e Palermos e themeluar prej filologut arbëresh mons. Paolo Schirò (1866-1941), i cili arriti të merrte në zotërim pjesën më konsistente të arkivit të Kamardës, duke e lënë në dispozicion dhe në trashëgimi të nipërve të vet. Pjesa tjetër është ajo "*daneze*", që Giuseppe Gangale themeloi me emrin *Albansk Sammling*, që ruhet pranë Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagenit dhe që përmbledh materiale që bëjnë të mendosh për një prejardhje të dyfishtë të tyre: nga arkivi i mons. Schiroit dhe nga arkiva të tjera private, zotëruesit e të cilëve mburreshin se kishin lidhje farefisnie me tre vëllezërit Kamarda.

Një bërthamë e tretë arkivistike, që për të qenë koherentë na duhet ta quajmë "*skipetare*", ruan letra të tjera të Mitkos për Kamardën: bëhet fjalë për tri letra që datojnë përkatësisht më 9 janar 1868, 6 tetor 1868 e 7 maj 1869 e që Zef Schirò, nip i mons. Schiroit la në Tiranë bashkë me materiale të tjera pas kthimit të tij të ngutur

[13] Thimi Mitko, *Fjalori Italisht-Greqisht-Shqip (dorëshkrimi origjinal)*, përgatiti Shpëtim Shala, vëll. I: *Dorëshkrimi origjinal;* vëll. II: *Transliterimi dhe Fjalësi shqip*, Ëest Print, Tiranë 2013.

[14] Thimi Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht-shqip & ndihmesa të tjera leksikografike = Lexigrafia alvano-elleniki, elleno-alvaniki k alles lexikografikes symboles*, përgatiti për botim Dhori Q. Qiriazi, Akademia e Shkencave, Libraria "Kotti", Tiranë-Korçë, 2014.

në Itali menjëherë pas luftës. Këto letra që sot ruhen në fondin "Thimi Mitko" të Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH), janë botuar dhe ato prej Q. Haxhihasanit në botimin e sipërcituar të veprës së Mitkos[15].

Ajo çka kishte mbetur prej letrave të Mitkos është gjetur ndër mijëra letra të arkivit të Kamardës në Palermo. Dhe ajo, bashkë me materiale të tjera të pabotuara (mes të cilave citoj botimin e parë kritik të *Mesharit* të përgatitur prej zbuluesit të tij dhe shkëmbimet epistolare të Kamardës me personalitete të shquara të kohës së tij, ndër të cilët ai me Dora d'Istrian që numëron më shumë se 2000 letra), më është vënë në dispozicion prej F. Schiroit, biri i të sipërpërmendurit Zef, që aktualisht kujdeset për arkivin me një përkushtim të admirueshëm, duke pasë një rekomandim mjaft të thjeshtë dhe njëkohësisht mjaft impenjues: të kujdeset për botimin e tyre dhe t'i vërë në dispozicion të komunitetit shkencor.

Nuk doja të lija në heshtjen e raporteve private këtë aspekt, sepse nga mesazhi i F. Skiroit (të cilin gjej rastin të falënderoj për besimin që më ka dhënë) vjen kjo frymë e bashkëndarjes identitare që ka karakterizuar shekujt më produktivë në historinë e kulturës shqiptare, qoftë kur kjo histori është zhvilluar në territor ballkanik, qoftë kur është zhvilluar në skenare të cilat kapërcejnë dete dhe oqeane. Nëse sot (e përsëris) jemi në gjendje të studiojmë bërthamën themelore të ideologjisë albaniste të shekullit XVIII dhe XIX, kjo bëhet e mundur vetëm falë këtyre materialeve të jashtëzakonshme të dhjetëvjeçarëve të fundit që me durim po arrijmë të rizbulojmë e të nxjerrim në dritë. Dhe është meritë e pasardhësve të ligjshëm që i kanë ruajtur dhe vënë në dispozicion të vëmendjes sonë dhe të asaj të studiuesve më të mirë evropianë dhe shqiptarë.

Në rastin tonë, letrat që Mitko i ka shkruar Kamardës lënë të depërtojnë nga hapësirat e historisë private rreze drite që ndriçojnë një raport emocionues miqësie mes njerëzish që kurrë nuk ishin takuar dhe nuk do të takohen asnjëherë, një bashkëpunim të frytshëm rezultatet e të cilit i vlerësojmë në rrafshin shkencor, një dëshmi e çmuar e një veprimi militant politik e kulturor që frymëzoi lëvizjen e Rilindjes.

Referimet kronologjike që kemi në dispozicionin tonë nuk na lejojnë të rindërtojmë me saktësi origjinën e raporteve mes Dhimitri Kamardës dhe Thimi Mitkos. Duke iu përmbajur datimit në letrat që ruhen në AQSH, këto raporte shkojnë nga janari i vitit 1868, që mund ta konsiderojmë afërsisht si limit kohor *post quem*.

Përmbajtja e letrës është e tillë që lë të mendosh se është e para që duhet të ketë dërguar Mitko. E dëshmon fakti që kjo letër e gjetur në Livorno *prej një shqipëtari,*

[15] Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 610-613. Tri letrat përmbanin materiale të bashkëngjitura, edhe ato të botuara nga Qemal Haxhihasani (Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 525-528), në të cilat Mitko shtjellon disa vëzhgime gjuhësore. Një letër e katërt, botuar në Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 621-622, është rigjetur nga Haxhihasani nga kopja që i ndjeri Dhimitër S. Shuteriqi shkroi gjatë vizitës së një delegacioni shqiptar pranë familjes Schirò në Palermo në vitet '60. Origjinali gjendet në fakt në arkivin që ruhet nga trashëgimtarët e mons. Paolo Schirò-it.

mik e të dashime të shqipëtarëvet Italisë[16], përmbyllet me një frazë që dëshmon se të dy nuk ishin takuar kurrë më parë: *Muntni të më shkruani me postë dreq mbë emër tem, për Kairo*, *pa* ***recomandazione***[17].

Ka shumë mundësi që duke pasur stimujt e një kurioziteti të theksuar shkencor, Thimi Mitko i është drejtuar me guxim të mirënjohurit D. Kamarda, emri i të cilit ishte i përmendur goxha mes intelektualëve për arsye të dy vëllimeve të rëndësishme, pikërisht: *Saggio di grammatologia comparata*[18] dhe të *Appendice al Saggio*[19] të dala në dritë përkatësisht më 1864 dhe 1866.

Sigurisht Mitko ishte në dijeni të veprimtarisë shkencore dhe publicistike të gjuhëtarit arbëresh dhe me siguri duhet të ketë pasur në dorë veprat e tij, një prej të cilave, përkthimin në shqip të kryer nga Kamarda[20] të punimit të D. Istrias *Kombësia shqiptare, sipas këngëve popullore* (*La nationalité albanaise d'aprés les chants populaires*)[21], ai e kujton shprehimisht në letrën e cituar të janarit të vitit 1868[22]. Dhe është duke u nisur nga kjo datë që pasi mirëpritet nga Kamarda ftesa që i dërgohet nga Mitko[23], mes të dyve u vendos një shkëmbim i frytshëm idesh dhe informacionesh, materialesh folkloristike dhe etnotekstesh me një vlerë të padiskutueshme antropologjike dhe gjuhësore që nga njëra anë do të kulmojnë në botimin e veprës monumentale *Bleta shqipëtare* (1878), dhe nga ana tjetër, do të

[16] Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 610.

[17] Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 611.

[18] Khs. Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Egisto Vignozzi, Livorno, 1864.

[19] Khs. Demetrio Camarda, *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Tip. F. Alberghetti" e C., Livorno, 1866.

[20] Khs. Dora d'Istria, *Fylétia e Arbenoré prèj kanekate laoshima enkethyeme ne shkjipe pèrei D(himitri) C(amarda)*, P. Vannini, Në Livurnë, 1867. Të po këtij vitit janë dy përkthimet në italisht të kryera: njëra prej avokatit ebre Enrico Artom(khs.Dora d'Istria, *La nazionalità albanese secondo i canti popolari, con biografia e ritratto dell'Autrice da un disegno di Felice Schiavoni; traduzione da lei consentita, per E(nrico) Artom*, Migliaccio,Cosenza, 1867) dhe tjetra, e kryer prej vëllait të Kamardës, Nikoloit, të një eseje tjetër të njohur të Dora d'Istrias të botuar në L'*Indépendance Hellénique*: khs.Dora d'Istria, *Gli scrittori albanesi dell'Italia Meridionale*, traduzione italiana di N(icolò) C(amarda), con note del traduttore, All'ufficio delle Ore del Popolo, Palermo, 1867.

[21] Khs. Dora d'Istria, "La nationalité albanaise d'après les chants populaires" in *Revue des deux Mondes*, Paris, 1866.

[22] «Kam ndër duar të ndershimen të shkruamen tër zotënisë suaj mbë gluhënë shqipe, "Metapameja e të dy kosmet", prej zonjës Dora d'Istria, shqipëtares e lëvduarë, edhe jam fort i gëzuar ka ajo»: Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 610. Në gjendjen aktuale të njohurive tona në lidhje me këtë çështje, nuk duket e bazuar hipoteza e Qemal Haxhihasanit, sipas të cilit i duhet atribuar Thimi Mitkos oda që me titullin "*E ndë Shqypëtarëtë gjithë sa janë*" shfaqet "anonime", më parë, në faqet 84-85 të përkthimit të cituar në shqip të punimit të Dora d'Istrias e më tej, në "manifestin" politik-kulturor të Rilinjdes të ideuar dhe kujdesuar prej Kamardës (*A Dora d'Istria, gli albanesi*. Canti pubblicati per cura di D(emetrio) C(amarda), Fabbreschi, Livorno, 1867, f. 65). Stili, gjuha, përmbajtja politike-rilindëse nuk përshtaten me stilin, gjuhën dhe Ë*eltanschuung-un* e Mitkos.

[23] «Mbesoj se do të më boni nderin, të më përgigji»: Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 610-611.

përmblidhen në stezurën e punës leksikografike që për fat jo të mirë, Mitko ka lënë të papërfunduar dhe të pabotuar.
Miqësia me Kamardën do të forcohet gjatë letërkëmbimit që pa ndërprerje do të vijojë deri në 7 shtator 1879, që është dhe data e letrës së fundit të shkruar në greqisht prej Mitkos për mikun e tij arbëresh.
Në gjendjen aktuale nuk jemi në gjendje të konfirmojmë gjë të saktë në lidhje me vazhdimësinë e letërkëmbimit në tri vitet në vijim dhe nëse kanë humbur letra të tjera që mund të kenë ekzistuar përveç atyre që disponohen. Një përgjigje mund të na vijë nga fondi i Mitkos që po hulumtohet prej kolegut Dhori Q. Qiriazi me rezultate të frytshme. Duke qenë në pritje të kësaj përgjigjeje, po i kufizojmë konsideratat tona te materiali që aktualisht disponojmë.
Në tabelën që i bashkangjitet këtij shkrimi kemi sjellë në mënyrë sintetike të dhënat që lidhen me epistolarin dhe natyrisht dy llojet e të dhënave: kronike dhe topike. Nuk kam sjellë karakteristikat fizike sepse duke pasur parasysh kohën në dispozicion, më duket më e arsyeshme të vë në dukje që të gjitha letrat janë dërguar nga Kairo dhe që vitet e karakterizuara nga një intensitet më i madh epistolar koincidojnë me periudhën në të cilën ai ishte maksimalisht i impenjuar me stezurën e veprës së tij folkloristike.
Nuk është rastësi që shpesh në tufën e dendur të letrave që i përkasin periudhës para vitit 1878, shqetësimi i tij është t'i bëjë objekt të vëmendjes kritike të Kamardës zbulimet, përmbledhjet, hamendësimet në sektorë të ndryshme të studimeve albanistike që Mitko do të pasqyrojë në veprën *Bleta shqipëtare*.
Në këto letra bie në sy vlerësimi i madh që Mitko kishte për autoritetin e padiskutueshëm të personalitetit shkencor të Kamardës, por dhe kompetenca e dukshme dhe siguria metodike që karakterizonin punën e tij prej etnografi dhe gjuhëtari[24].
Te shënimet me të cilat pajisen mjaft zëra të rrallë apo që shpjegoheshin me vështirësi, me gjithë konkluzionet e guximshme që sot mund dhe të mos i pranojmë, dëshmohet mprehtësia e një intelektuali romantik të përfshirë nga dashuria për gjuhën e vet dhe për çështjen e identitetit të popullit të vet, të dyja të ekspozuara ndaj rrezikut të një rënieje të shpejtë dhe të pandalshme si rrjedhojë e procesit degjenerativ që po konsumohej para syve të tyre.
Qëndrimi ideologjik i Mitkos në lidhje me këtë çështje kushtëzohej plotësisht me atë të mbajtur nga studiuesit arbëreshë, të cilët tashmë prej dhjetëra vitesh e praktikisht

[24] Të vihet re eleganca e këtyre frazave me anë të të cilave Mitko me një modesti të skajshme i drejtohet Kamardës, qoftë dhe për t'i dëshmuar stimën e tij të sinqertë: «Më ndëleni zotënia juaj të u shënoj disa fjalë çë **pashë** ndë të ndershmen të shkruamen tuaj, cilatë na **i folasimë** ndrishe, pra, me diturinë tuaj, të i vështroni e të i sgëlidhëni. U lutemë të mos pantehini semos u (a unë) boj te diturin, të ditshmin a filologun mbi gluhën tënë, por tue klënë këjo e pashkruar gluhë, e humbur edhe e zbjere, dua t'u dëftoj vetëmë fjalët të dialektit tonë. Do të kërkoj të mbëledh ca kënëka shqipe të vendevet tona (të Korçës) e t'ua dërgoj, ndë keni pëlqim ndë m'epëni urdhërimin»: Thimi Mitko, *Vepra*, cit, f. 610.

që nga gjysma e shekullit XVIII ishin të angazhuar të hidhnin dritë mbi çështjet e historisë, gjuhës dhe zakoneve të shqiptarëve me qëllimin që të fitonin dhe në emër të atdheut amë mitik të tyre respektin dhe admirimin e popujve të tjerë[25]. Nuk është e rastit që materialet që u bashkëngjiten letrave që i dërgohen Kamardës zbulojnë interesin e madh që studiuesi korçar, si një nga intelektualët e parë shqiptarë, dëshmoi për shqiptarët e Italisë, trashëgimia gjuhësore e kulturore e të cilëve u gjykua prej tij si një visar i një rëndësie të madhe e të paçmuar për rindërtimin e imazhit (*facies*) së humbur të identitetit shqiptar.

Nuk është ky rasti për t'iu rikthyer këtij aspekti të historisë së origjinës dhe përhapjes së ideve rilindase, të impaktit të fortë që arbëreshët arritën t'i vishnin lëvizjes së Rilindjes falë kontributeve të panumërta shkencore dhe deri dhe falë zbulimit të padiskutueshëm (në kuptimin etimologjik të termit latin "inventio") të miteve që përbënin arkitekturën e ideologjisë rilindëse, nga miti i Skënderbeut në atë pellazgjik, në atë të lashtësisë së gjuhës. Por është rasti që të vëmë në dukje që qe meritë ekskluzive e rrjetit të përforcuar të intelektualëve të asaj kohe eventi i rrallë që në atë fazë historike kruciale favorizoi ozmozën e mbarsur me teori, projekte dhe veprimtari shkencore-kulturore që dëshmuan se qenë përcaktuese për rindërtimin e idesë së nacionalitetit shqiptar ose, nëse mund ta themi ndryshe, dhe të identitetit kombëtar shqiptar.

Duke përdorur mjetet e komunikimit të asaj kohe, duke shkëmbyer libra, revista, gazeta, letra, ata burra patën forcën që të krijonin një sistem ideologjik që nga njëra anë ushqeu formimin e një drejtimi shkencor që sot e përkufizojmë me termin "albanologji" dhe, që nga ana tjetër çoi drejt një pjekurie të plotë procesin politik-kulturor që pati si pjesëmarrës dhe protagonistë realitete të ndryshme intelektuale shqiptare të shek. XIX. Kundërshtimi i kësaj gjëje jo vetëm që përbën një qëndrim antishkencor, por dëshmon dhe një finalitet në thelb manipulues të realitetit historik-kulturor ashtu si na dokumentohet nga materiale të ndryshme arkivistike, qoftë nga ato që kam sjellë e cituar në mënyrë sintetike, qoftë dhe nga ato që po dalin prej heshtjes dhe pluhurit në të cilën gjinden prej shumë kohësh.

Fakti që këto materiale "ringjallen" pikërisht në këtë qytet të mrekullueshëm dhe në këtë rast është veçanërisht domethënës. Dhe për këtë arsye kam qëllim të falënderoj dy kolegët e mi të dashur dhe të çmuar, Dekanin e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, prof. Ali Jasharin, dhe Rektorin e Universitetit "Fan S. Noli", prof. Gjergji Meron, të cilët kanë promovuar dhe mbështetur organizimin e veprimtarisë së sotme. Zotit Sotiraq Filo, kryetar i Bashkisë së Korçës, i transmetoj përqafimin e ngrohtë të komunitetit arbëresh që për momentin përfaqësoj në cilësinë e presidentit të këshillit komunal të *Pianës arbëreshe*, me shpresën që në të ardhmen të vihen në udhë e të forcohen raporte institucionale miqësore mes komuniteteve

[25] «Dëshëroja të kem të tëratë libra të shkruara mbë shqip prej shqipëtarësh. Zemërën time të plagosurë per fatkeqërin'e madhe të Shqipërisë sotme, ma ngroh meaft patriotismi, dituria edhe mësimi i shqipëtarëvet Italise»: Thimi Mitko, *Vepra*, f. 610.

tona. Duke ia arritur kësaj gjëje, me siguri do të nderonim kujtimin e atyre burrave si Mitko e Kamarda, të cilët dhe duke pasur të njëjtën dëshirë të madhe, nuk arritën ta realizonin, duke u mjaftuar me çka u ofronte *facebook*-u i atyre kohëve: shkëmbimi i fotografive të secilit prej tyre[26].

Tabela kronologjike e letrave të Mitkos Kamardës

Nr.	Date topica e cronica		ff.	Note
1870				
1/22	Cairo	21 janar 1870	3	
2/38	"	11 shkurt 1870	3	*in greco*
3/39	"	17 shkurt 1870	2	
4/40	"	17 mars 1870	3	Botuar në *Mondo Albanese* 1984/39 f. 3-5
5/17	"	28 maj 1870	4	Botuar në *Mondo Albanese* 1984/41 p. 8
6/19	"	8 qershor 1870	2	Botuar në *Mondo Albanese* 1984/41 p. 11
7/21	"	5 gusht 1870	2	*in greco*
8/18	"	14 vjeshtës dytë 1870	4	
9/20	"	30 shtator 1870	3	*in greco*
1871				
10/50	"	20 janar 1871	3	Botuar në *Mondo Albanese* 1984/42 p. 8
11/13	"	23 shkurt 1871	3	*in greco*
12/48	"	(?) shkurt 1871	2	
13/45	"	17 mars 1871	2	
14/47	"	28 prill 1871	4	
15/46	"	26 maggio 1871	2	
16/49	"	22 qershor 1871	2	
17/44	"	17 korrik 1871	3	
18/11	"	11 gusht 1871	3	
19/16	"	8 vjeshtësë parë 1871	2	
20/43	"	3 vjeshtë tretë 1871	1	
21/26	"	24 shtator 1871		
22/42	"	20 tetor 1871	2	

[26] «Po ju dërgoj bashkëmbyllur fotografinë time dhe lutem të më dërgoni, po të jetë e mundur, edhe ju tuajën, për ta patur në koleksionin tim. Do të dëshiroja shumë të kisha edhe fotografinë e së respektueshmes Dora d'Istria dhe nuk di ku ta gjej»: Thimi Mitko, *Vepra*, cit., f. 610.

23/15	"	24 brumorit 1871	2	
24/41	"	22 dimërorit 1871	4	
1872				
25/37	"	14 prill 1872	2	
26/12	"	14 korrik 1872	6	
27/36	"	12 njëmbëdhjetit 1872	4	
28/35	"	21 Shën Ndreut 1872	4	
1874				
29/11	"	28 shkurt 1874	4	
30/31	"	11 prill 1874	3	
31/10	"	27 qershor 1874	4	
32/32	"	15 brumar 1874	3	
33/34	"	5-17 kalendorit 1874	4	
34/33	"	31 dimëror 1874	2	*in greco*
1875				
35/30	"	21 mars 1875	2	
36/9	"	18 vjeshtës tretë 1875	3	
37/29	"	2 vjeshtës'e dytë a Shën Mitrit 1875	2	
1877				
38/27	"	22 Shën Ndreut 1877	4	
1878				
39/23	"	15 shkurtit 1878	2	Botuar në Thimi Mitko, *Vepra*, cit, p. 621-622.
40/24	"	27 prillit 1878	18	
41/1	"	8 qershor 1878	8	
42/2	"	12 korrik 1878	4	
43/3	"	3 vjeshtës 1878	5	
44/25	"	7 vjeshtës tretë 1878	4	
45/28	"	24 kalendorit 1878	1	
46/5	"	30 Shën Andreut 1878	8	
47/4	"	30 dhjetor 1878		*in greco*. Indirizzata a Nicola Camarda
1879				
48/8	"	26 qershor 1879	7	
49/6	"	1 vjeshtës 1879	6	*in greco*
50/7	"	7 shtator 1879	2	*in greco*

VALTER MEMISHA (TIRANË)

TH. MITKO PËR SHQIPEN PËRMES DOSJEVE PËR TË, NË ARKIVIN E INSTITUTIT TË GJUHËSISË DHE TË LETËRSISË, TIRANË

Në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, gjenden mjaft materiale me interes që lidhen me veprën e veprimtarinë e Thimi Mikos apo me studimet për këtë përfaqësues të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare. Ato, përgjithësisht, janë shfrytëzuar nga studiues të ndryshëm, për qëllime vetjake a institucionale studimi, siç është rasti i shfrytëzimit për përgatitjen e vëllimit Vepra, nga Instituti i Kulturës Popullore, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1981.

Përmes një rimarrjeje informuese për atë çka gjendet në dosjet për Thimi Mitkon në këtë arkiv, punimi ynë i shkurtër ndalet te çështja e gjuhës shqipe, si një nga përbërësit kryesorë të veprës së tij. Kundruar në shumanshmërinë e vet, përmes ardhjes së njëpasnjëshme sipas secilës dosje a dokumenti në këto dosje, gjuha amtare zbulon një anë të dallueshme të personalitetit të Th. Mikos. Punimi, vetvetiu, është deskriptiv e piketues dhe mundëson një studim të mëtejshëm përfshirës, të plotë e shterues të kësaj çështjeje, duke iu referuar dokumenteve që ndodhen edhe në Arkivin Qendror të Shtetit, në atë Institutit të Antropologjisë, të Historisë, të Prishtinës e të dokumenteve që gjenden në arkiva në vende të tjera, evropiane, afrikane a më gjerë.

I. Dosja J/10-nr. 166, Fotokopje të mikrofilmit K nr. 15, Thimi Mitko, *Mjaltë nga bleta shqiptare*, mbledhur nga Dhimitër Pilika, f. 147. Materialet janë zbardhje të fotove të "Bletës", zbuluar në Pragë nga Dhimitër Pilika, kur ishte student në Çekosllovaki dhe që si material është paraqitur në Seminarin shqiptar të Universitetit të Pragës, Kabineti i Filologjisë Moderne i Akademisë çekosllovake të Shkencave. Dokumentet e kësaj dosjeje janë zemra e e gjithë dokumenteve për Mikton, sepse janë fotokopje e pasurisë folklorike të regjistruar *me shkrim dore* prej tij dhe kanë shërbyer si lëndë kryesore për përgatitjen e "Bletës shqiptare". Tërheqim vëmendjen këtu se, në një botim të ardhshëm dhe të plotë të veprës së Miktos, kjo dosje, pa nënvleftësuar rëndësinë e dosjeve të tjerave, duhet të zërë vendin kryesor në botimin anastatik të punës origjinale të autorit.

Nuk po ndalemi në rimarrje të njohura, por duke u mbështetur në botimin e "Bletës shqiptare" në Vjenë, në vitin 1924, realizuar nga konsulli i Shqipërisë, dr. Gjergj Pekmezi[27], po skicojmë disa qëndrime për shqipen e çështjen shqiptare përmes shqipes, sipas këndvështrimit të Mitkos. Mjafton vetëm referimi te Parathënia e shkruar nga ai vetë, për të parë paradigmën e gjuhës shqipe, e cila del e vështruar në disa prerje:

[27] *Bleta shqypëtare e Thimi Mitkos*, E përshkroj me shkrojla shqype, e përktheu shqip dhe e radhitit dr. dr. Gjergj Pekmezi, Konsulli i Shqypërisë, Vjen-ë 1924

a. Me "Bletën" Mitko bën *punë misionare për gjuhën shqipe*, për grumbullimin e pasurisë gojore të popullit shqiptar dhe të vetë fjalës shqipe. Kjo i mori shumë kohë e shumë mund, sepse dihen tashmë vështirësitë e regjistrimit gjuhësor në shqip të këngëve, rrëfenjave, fjalëve të urta, gjëzave etj. në fund të shekullit XIX. Megjithatë ai bëri atë punë që tashmë është vlerësuar dhe që edhe kjo veprimtari me punimet që po sjell, vazhdon të vlerësojë e të nxjerrë në pah anë të pastudiuara a pak të studiuara të punës aq madhore të birit të Korçës. Thimi Mitkoja shkruan se "Qëllimi i *Bletës shqiptare*, d.m.th. i këtyre këndimeve albanologjike, është përgjithësisht, shpëtimi edhe dhënija brezave që vinë i fjalëvet edhe tekstevet shqipe, sa para vjetësh me shumë mundim e prishje mblodha, të cilat mbesoj se do të kenë një vjeftë, sepse në këto duket fisi, karakteri, adetet e zakonet e racës shqiptare"[28].

b. Ashtu si rilindësit e tjerë iluministë, Th. Mitkoja e vlerëson shumë *rolin kulturues, emancipues e zhvillues të gjuhës amtare* për shqiptarët, që ata të bëhen e të jenë si edhe popujt e tjerë, veçanërisht si helenët, për të cilët besonte se me shqiptarët janë të një trungu dhe që në krye të herës kanë pasur edhe një atdhe të përbashkët. Për këtë rol, po te Parathënia e "Bletës shqiptare" ai shkruan se "veçanërisht, duha që t'u ipet një shkak e shtyrje bashkatdhetarëve shqiptarë për të kulturuar edhe studiuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë natyrale edhe të vetëm fitimprurëse të mundin edhe këta të civilizohen edhe të kenë njësoj vjeftë me vëllezërit e tyre ellenofonë"[29].

c. Th. Mitkoja pranon rolin ndritues të shqipes së shkruar për qytetërimin e shqiptarëve dhe daljen e tyre si komb i veçantë dhe, në linjën patriotike të krejt Rilindjes sonë kombëtare, ngrihet mbi ndasitë fetare dhe e sheh gjuhën e kultivuar si *mjet bashkues e identifikues*. Ai shkruan se "Një komp nuk munt me as një mënyrë tjetër të dalë pe barabarismës, përveç se dyke punuar gjuhën e vet – thotë Herderi. Edhe Shqiptarët, si gjenden tani të ndarë në Mohamedanë edhe të Kështerë, këta prapë në katolikë edhe Ortodoksë, do të mundin të ndriten edhe të humbasin zgjyrën e padijes së tyre barbare vetëm dyke studiuar gjuhën e tyre amtare."[30]

d. Megjithatë Mitkoja, nën kushtëzimin e kohës dhe të mjedisit ku jetoi dhe punoi, edhe pse e vlerëson lart gjuhën amtare, *e ngushton dukshëm rolin dhe funksionet e saj*. Për të, gjuha shqipe në shkolla perceptohet vetëm në funksionin shkollues për popullin e thjeshtë e të varfër. Kurse të pasurit që kanë mundësi financiare, të mësojnë edhe greqishten si gjuhë të kulturës dhe të qytetërimit. Ai shkruan se "Gjuha amtare është yshqimi i parë i përbashktë q'i jep gjallësi popullit; sa për klaset më ta lartra le të mbetet më e mbaruara edhe e provuara greqishte"[31].

[28] Th. Mitko, *Bleta shqiptare*, Vjenë, 1924, f. 11
[29] Th. Mitko, Bleta shqiptare, Vjenë, 1924, f. 11
[30] Po aty, f. 11-13
[31] Po aty, f. 13

e. Në vazhdim, po në Parathënie, Mitko pranon se *vetëm përmes kultivimit të shqipes* së në shkollë *mundësohet edhe njohja e qytetërimit botëror*, të cilin së shumti e lidh me atë grek. "Qytetërimi grek, siç gjenden sot punrat, munt të hyjë vetëm në të paktë Shqiptarë, vetëm në mest të atyre, të cilët kanë pak dituri. Po si munt të hyjë qytetërimi grek në shumicën e gjendjes shqiptare, në familjen e zanatçiut edhe të industrielit, në kasollen e bariut, në qoftë se nuk përhapen iderat greke me përdorimin e gjuhës së tyre amtare që flitet?[32]

f. Thimi Mitko ngrihet kundër politikave penguese, madje dënuese e shfarosëse të kohës, por edhe kundër veprimtarisë së qarqeve ortodokse në Stamboll e Athinë *për moslejimin e hapjes së shkollave shqipe dhe shkrimin e shqipes* në to. Ai ngre zërin fort kur thotë se "Kërkimi i cave të mbytin gjuhën shqipe edhe me përdorimin e shtrënguar të greqishtes t'a thëthinë fjesht rasën shqiptare ose t'a shuajnë edhe t'a bëjnë sikur ska qënë, është një gabim i tmerruar, shpikje e një mendje të shkurtër, politik' e kalbur edhe i çdo "idee të madhe" mosmeritonjës. Si shëmbëll le të jetë politika kishatare e Patriarhatës të Stambollit edhe e qeverrisë të Athinës kontra Bullgarisë, e cila në vent të bashkimit solli çarje, edhe në vent të thëthitjes priri mëni rase të papajtuar"[33].

g. Me bindje te gjaku i përbashkët me grekët, Mitko *njeh vetëm kërcënimin asimilues të shqiptarëve nga sllavët* dhe bën thirrje për t'i dalë së keqes përpara. Zbrazëtinë e krijuar nga shqiptarët për kultivimin gjuhës amtare, sipas tij, do të mbushte e keqja nga fqinjët e veriut, me pasoja për vetë ekzistencën e racës sonë. Ai shkruan se "Në qoftë se lihet Shqipërija në padijen e saj, pa shkronja vendi edhe pa shkolla popullore, do të rendin atëhere Sllavët me vegla më të forta e më praktike për të gëlltitur rasën shqiptare"[34].

h. Interesante janë te "Bleta" pjesët që lidhen me *dukuri gjuhësore*, që janë përveçuar nga vetë autori i saj. Këtu po sjellim në kujtesë të lexuesit tri rubrika: *Të përshëndoshura, emra vetjakë, mbiemra familjesh; Fjalorthin shqip - greqisht (me parahyrje)*, si dhe *Shënime të ndryshme gjuhësore*. Ato janë bërë objekt kumtimesh edhe në këtë konferencë, ndaj nuk po ndalem më tej. Por duhet të theksojmë se ato kanë rëndësi të madhe për të parë prurjet dhe ndihmesën e Mitkos edhe në rrafshin etno-linguistik, onomastik, historik, leksiko-semantik, dialektologjik, në rrafshin e procesit huazues të shqipes etj.

II. Dosja "Plaku Stathi", në të cilën përfshihen dy nëndosje. Në të parën gjendet dorëshkrimi origjinal "Plaku Stathi" (*Plakustathi*, e shkruar bashkë, V. M.), varianti i parë, në një fletore me 32 faqe, shkruar me bojë; në të dytën gjendet dorëshkrimi origjinal "Plaku Stathi" (*Plakustathi*, e shkruar bashkë, V. M.), varianti i dytë, në 7 fashikuj fletoresh, që fillon me faqen 5 (katër faqet e para mungojnë) e mbyllet me faqen 140, edhe ky variant i shkruar me bojë. Brenda kësaj dosjeje

[32] Po aty, f. 13
[33] Po aty, f. 13
[34] Po aty, f. 13

gjendet dhe një fletë e veçantë (që është një redaktim i faqes 5 të variantit të dytë, të cilën studiuesi Th. Gjika e merr si një variant të tretë të veprës, por që ne nuk na bind ky mëtim). Të dy variantet janë sjellë prej Egjiptit nga prof. Jorgo Bulo në mars 1984. Nuk dimë vitin e saktë kur është shkruar vepra, ndonëse studiuesi Thanas Gjika pranon se kjo duhet kërkuar midis viteve 1880 – 1885[35]. Një informacion të ndërmjetëm për kohën e shkrimit e gjejmë te fleta e veçantë (faqja 5), nga ana e mbarë e së cilës kemi të dhëna të një regjistri tregtar (ku jepen emërtimet e disa mallrave dhe vlera e tyre në franga, dhe që nuk janë shkruar nga Th. Mitko), që i përket vitit 1880, çka do të thotë se, minimalisht, varianti dytë ka filluar të shkruhet këtë vit.

Vepra nuk trajton drejtpërdrejt ndonjë problem gjuhësor, por ajo është një realizim i bukur artistik përmes gjuhës shqipe, duke treguar aftësitë e shprehjes të shqipes, por edhe talentin e Mitkos në letërsinë artistike, në një kohë kur shqipja kishte shumë vështirësi që të realizohej si gjuhë e letërsisë së mirëfilltë artistike, për shkak të shkrimit të vonët të saj. Po sjellim vetëm dy pjesë të shkurtra, nga një për secilin variant, për të parë jo Thimi Mikton për gjuhën shqipe (siç është edhe qëllimi i punimi), por *gjuhën e Miktos* në një vepër të dalë nga dora e tij, për të cilën studiuesi Th. Gjika shprehet se "si vepër letrare, dorëshkrimi *Plaku Stathi* është pjesë e një novele origjinale didaskalike. Kjo novelë... shënon fillimet e prozës së gjatë shqipe. Dhe kur themi të prozës së gjatë shqipe, kemi parasysh të prozës artistike me temë laike, e më konkretisht të novelës shqipe."[36]

Nga varianti parë:

Ndërtojti ngaj gjëri i tij mbë një vënt të bukurë, të xbavitçimë e të shëndetçimë të katundit shkollë (mësonjëtore, mjeshtërore) të gjerë edhe pru njëheriesht dy mësonjësë të zotët e sendrëqarë, për të mësuar djelmurinë. Po zembërmirësija e Plakustathitë nuku mbeti gjerë këtu. Ay me fuqiën, forcën e ëmbëlsiën e madh të gëluhës së tij, mundi në pak mot të marrë zembrën e dashuriën e gjithë dielmavet të vendit.

Nga varianti i dytë:

Ndonëse umplak ndë dhe të huajë, Plakustathi, asnjë cas nuku haroi të dashurën mëmëdheën e tij, as tëmënë, një plakë, pra, e cila që shumë vjetra po qante vdekjen e shoqit të saj, edhe mërgimin e së birit. As lakmia e arit, as kënaqiat, përgëzimet e ëmbëlsiat e Europës, mbrapsën dot Plakustathin mbë të kthyer ndë vent të tij.[37]

Mjaftojnë vetëm këto dy pjesë për të parë bukurinë e rrjedhshmërinë në të rrëfyerit artistik. Por mbi këtë novelë duhet të ndërmerren studime të shumëfishta, ato mund të bëhen për sintaksën e pastër shqipe, për qëmtimin e përzgjedhjen e

[35] Th. Gjika, *"Plaku Stathi – një dorëshkrim i Th. Mitkos dhe fillimet e prozës sonë tregimtare*, kumtesë, Arkivi i IGJL, Dosja T"H. Mitko", f. 3

[36] Po aty, f. 3

[37] "*Plaku Stathi*", varianti i dytë, në Nëndosja "Plaku Stathi", Dosja TH. Mitko, Arkivi i IGJL, f. 5

kujdesshme të fjalëve, për format e eptimit e fjalëformimin, për punën e bërë në pasurimin e pastrimin e leksiku të përdorur etj. Fjala vjen, të tërheq vëmendjen se në çdo fund faqeje Th. Mitkoja shpjegon fjalë që ai i mendon si të huaja, si të reja, apo si të panjohura për lexuesin e kohës (p.sh. fjala *shkollë* shpjegohet me fjalën shqip *mësonjëtore* dhe me fjalën tjetër shqipe me rrënjë latine *mjeshtërore;* fjalën *mjek* e shpjegon me sinonimin *shëronjës,* fjalën *qishë* me *hyjëtore, faltore* etj.). Është meritë e autorit të novelës, se në çdo fund faqe përveç shpjegimeve të fjalëve me fjalë shqipe apo edhe me fjalë greqishte etj., ai u jep përparësi fjalëve të reja të leksikut dituror, që po zinin vend hap pas hapi në ligjërimet e ngritura e sidomos në letërsinë dhe publicistikën e kohës së Rilindjes.

III. Dosja *"Plaku Stathi" - një dorëshkrim i Thimi Mitkos dhe fillimet e prozës tregimtare*, kumtesë nga Thanas Gjika. Në këtë material kemi një vështrim informativ për variantet e veprës që gjenden në arkiv, duke skicuar një studim fillestar për veprën, që mund të ndihmojë këdo në një punë më të plotë filologjike e botuese, por edhe studimore për dorëshkrimin / dorëshkrimet e novelës. I mëshojmë këtu faktit se kumtesa mbart edhe gjurmë të kohës kur është hartuar. Në ndjekje të synimit tonë për paradigmën e gjuhës shqipe në materialet që gjenden në Dosjet për "Th. Mitko" në arkiv, po japim edhe vlerësimin e studiuesi Th. Gjika për gjuhën e veprës "Plaku Stathi". Sipas tij, "Kjo novelë e Thimi Mitkos, ndonëse e pambaruar, ka vlerë të rëndësishme edhe për sa i përket gjuhës. I parë në tërësi, ky dorëshkrim tregon se Mitkoja që në gjysmën e parë të viteve '80 të shekullit XIX ishte për një gjuhë letrare të bazuar mbi toskërishten dhe të pasuruar me fjalë, shprehje e forma gramatikore të gegërishtes e të arbërishtes së arbëresheve të Italisë e të Greqisë. Një ide shumë e shëndetshme që ka gjetur sot zbatim të plotë."[38]

Vlerësimi a pohimi se *Mitkoja ishte për një gjuhën letrare të mbështetur në toskërishte*n, na duket i nxituar. Në vitet kur u shkrua vepra (sipas Gjikës, midis viteve 1880-1885), punohej e luftohej për shkollën shqipen e shkrimin e shqipes dhe akoma nuk bëhej fjalë për një gjuhë letrare me një bazë dialektore të përcaktuar a të synuar. Mitkoja ka shkruar në dialektin të cilit i përkiste, në toskërishte. Edhe nëse gjejmë gegizma dhe arbërizma në gjuhën e tij, kjo tregon se puna e tij për të mbledhur pasuri folklorike nga goja e shqiptarëve, pa gjykuar përkatësinë e tyre etno-gjeografike, ka qenë jo spontane, por e ndërgjegjshme. Njësitë leksikore etj., që i kishin tërhequr vëmendjen apo për të cilat toskërishtja e tij (vetjake) nuk kishte njësi gjegjëse, kanë zënë vend krejt natyrshëm në krijimtarinë e tij, si pasuri e mbarë shqipes. Kjo është anë tjetër që duhet vlerësuar shumë te Mitkoja. Gjithashtu, na duket tepër largvajtës pohimi se kjo gjuhë e përdorur prej Mitkos, sendërton një ide shumë të shëndetshme që ka gjetur zbatim të plotë në vitet '80 të shekullit XX, kur është bërë kumtesa dhe kur shqipja kishte mbi 10 vjet që ishte kodifikuar dhe

[38] Po aty, f. 5

normëzuar. Megjithatë, edhe ky pohim i studiuesit TH. Gjika, jep shtysë për sipërmarrje të mëtejshme studimi edhe në fushën e gjuhës së veprës *Plaku Stathi*.

III. Dosja H – 58 Letra. Në këtë dosje gjenden 5 letra[39], të ardhura për prof. Koço Bihiku, nga të cilat vetëm një lidhet me Th. Mitkon: *Një letër e TH. Mikos dërguar z. Krispi, anëtar i Parlamentit italian*. Dokumenti është fotokopjim i një letre me shkrim dore në tri faqe fletoreje (ose 3 faqe të një letre A4 e përthyer në dy pjesë). Letra nuk është origjinale, por e kopjuar nga dikush me ngut, sa shfaq edhe problem për ta sjellë nga italishtja në shqipe. Letra daton më Kairo 21 qershor 1879. Nga kjo letër po shkëpusim ato pjesë që lidhen me gjuhën shqipe e kombësinë e shqiptarëve. Thimi Mitkoja i drejtohet z. Krispi, një personalitet politik shumë i njohur dhe me shumë peshë në atë kohë dhe, siç thuhet dhe në emërtimin arkivor të letrës, edhe anëtar i Parlamentit. Në letër, në frymën e kohës si dhe në vazhdën e përpjekjeve të Mitkos me atdhetarë të tjerë për çështjen kombëtare, duke mbajtur qëndrim ndaj fqinjëve jugorë të vendit, i kërkohet z. Krispit, këtij personaliteti me peshë në vendimmarrjet politike në Itali e më gjerë, që të punojë, të luftojë e të ndihmojë që edhe shqiptarët të kenë patjetër *gjuhë, kombësi, atdhe*. Mitkoja i shkruan atij se "Grekët ndalojnë në Shqipëri dhe Greqi mësimin e gjuhës shqipe... Është koha që shqiptarët të kenë gjuhë dhe kombësi. Me kënaqësinë time kombëtare jam në dijeni (kam mësuar) se ju keni marrë iniciativën për të ngritur në Romë një komision filohelen në favor të Greqisë dhe Shqipërisë dhe vlerësoj ndjenjat tuaja patriotike fisnike e bujare. Por, më lejoni t'ju kujtoj që është e një nevoje absolute që Shqipëria të ketë gjuhën dhe kombësinë dhe t'i garantohen kufijtë natyralë të atdheut të saj."[40]

IV. Dosja Letrat e Mikos, me mbishkrim Qemal Haxhihasanit. Emërtimi i dosjes duhet riformuluar, sepse në brendësi, nuk kemi letra të Mitkos, por letra për Mitkon. Në dosje janë gjithsej 10 letra të daktilografuara në tri kopje, që shoqërohen secila me letrën ku është mbështetur daktilografimi, shkruar me dorë dhe me shpejtësi nga studiuesi Qemal Haxhihasani. Ky ka bërë ardhjen e tyre në shqipen e sotme dhe me alfabetin e sotëm. Letrat në përgjithësi trajtojnë probleme pronësie, huamarrjeje, tregtie etj. dhe në asnjërën prej tyre nuk gjetëm elemente që të lidheshin me shqipen a për shqipen.

Gjithashtu në Dosje janë edhe dy materiale të tjera:

a. *"Poemë shqipe e Apostol Papadhopullit premëtusit drejtuar shqiptaro-italianëve për të shkruar gjuhën e tyre"* (21 faqe të daktilografuara). Poema ka 80 strofa secila me nga gjashtë vargje, gjithsej 480 vargje.

---

[39] Dosja që ka dokumente për vitin 1879, përfshin 5 letra (të cilat janë përfshirë në këtë dosje, që ka lidhje me të drejtëpërdrejtë me Crispin se me Mitkon):

- *Dy letra të një grupi vorioepirotësh, dërguar Z. Krispi, anëtar i Parlamentiti Italian*
- *Një letër e Th. Mikos dërguar z. Krispi, anëtar i Parlamentit italian.*
- *Një letër anglisht*
- *Një letër e K. M. Buskalionit (C. M. Buscalioni) dërguar Z. Krispi, anëtar i Parlamentit italian.*

[40] Dosja H-58, *Një letër e TH. Mikos dërguar z. Krispi, anëtar i Parlamentit italian*, Arkivi i IGJL, Tiranë

b. *Tekste shqip të shkruara anash në këtë letër,* me nëntitullin *Transliterim.* Në këtë material, që dokumentohet në tri faqe të daktilografuara (tri kopje) gjejmë disa këngë, shumica e të cilave lidhen me Sulin. Studiuesi Q. Haxhihasani është mbështetur në materialet filmike të marra në Danimarkë dhe përmes transliterimit, i ka përgatitur këngët për vëllimin TH. Mitko, Vepra, Tiranë 1981.

V. Me interes gjuhësor në Arkiv është edhe Dosja K/2- nr. 166, Letra të Thimi Mitkos dërguar De Radës, 1881 -1887, Kopjuar në Arkivin Albanologjik të Prishtinës, fondi i Kopenhagës (Marrë nga Koço Bihiku dhe Jorgo Bulo në nëntor të viti 1978). Materiali vjen i kopjuar edhe nga Biblioteka Mbretërore e Kopenhagës (Danimarkë) nga Emil Lafe e Ali Dhrimo (material që ndodhet si fotokopje në dosjen Ç/10- 76, fq. 15-17, 28-29 dhe 32-53).

Në ballinën e dosjes K/2- nr. 166 shkruhet *26 copë letra*, por aty gjenden vetëm 13 të tilla me 23 faqe gjithsej. Nga letrat kemi qëmtuar informacionin që lidhet me gjuhën shqipe, si shenjë parësore e identifikimit të shqiptarëve, për shkrimin dhe alfabetin e saj, për pengesat dhe për penguesit e këtij procesi, për përpjekjet që bëhen për përhapjen e shkollave shqipe në Shqipëri etj. Po listojmë shkurtazi:

a. Në letrën për De Radën, 20 të kallëndorit / janar 1881 (fotokopje), Mitko shkruan se "Sepse për fatkeqësi tonë (për nostra disgrazia) librat shqypeje nuk shiten dot (non possono vendere)... kjo është e keqej, gjersa (njerësa)... të hapen shkolla shqypëje ndë vendit".[41]

b. Në letrën për De Radën, 23 prillitë 1881 BMK, F G/3, nr. 117, f. 1 (fotokopje), letërshkruesi trajton një problem të njohur për kohën, problemin se qeveria greke e qarqe të caktuara, si Patrikana e Athinës etj., nuk lejonin të shkruhej gjuha shqipe. Mitko i dërgon De Radës poemën *Mbë shqiptarët* dhe i shkruan ndër të tjera "Do gjenjësh një pun'istori brenda për grekërit, që së lënë sa të bënjën shkronjëza (letere) shqypëje shqyptarët."[42]

c. Në letrën për De Radën, mbë 18 korrikutë 1881, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 36-37 (fotokopje), që përkon me kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (që "po rron si burrat, por e keqeja është se nuk u ngrit e tëra"), Mitkoja pyet se "Pse qevernia nuk le ndë Shqypëri as së brendëshmi, as së jashtëmi të shkruanjën liruarë"[43].

d. Në letrën për De Radën, mbë 31 maitë 1882, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 39-40 (fotokopje) atdhetari ngre një problem të rëndësishëm se në vendin e tij në Shqipëri, nuk mund të hapeshin shkolla shqipe, nuk mund të shkruhej gjuha shqipe e nuk mund të shtypeshin libra shqip, nëse nuk do të kishte financim me para. Siç e tregon gjithë letërkëmbimi i tij jo vetëm me De Radën, por edhe me të tjerë mëmëdhetarë nëpër botë etj., burimi parësor i financimit për këtë, në mënyrë të vazhdueshme, ka qenë bujaria e mëmëdhetarëve shqiptarë jashtë vendit (emigrantë në ngulimet e

[41] Th. Mitko, *Vepra,* botim i Institutit të Kulturës Popullore, ASHSH, Tiranë, 1981, f. 647
[42] Po aty, f. 649
[43] Po aty, f. 652

ndryshme në Turqi, Bullgari, Rumani, Egjipt, Greqi etj.). Mitkoja shkruan në letër, ndër të tjera, edhe faktin se "sot shkoi Vretua në Kostandinopojë, pasi bëri këtu punë të mirë. U shkruajtën shumë ndihmëtarë këtu ndë Egjyptë edhe gjithë shqipëtarët kanë dëshërim të japin argjende për gjuhën..."[44]

e. Në letrën për De Radën, 18 marsitë 1883, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 41-42 (fotokopje) shkruan, Mitkoja, gjithnjë në linjën për gjuhën shqipe e shkrimin e saj anekënd vendit, shkruan se "Me gëzim të madh mora lëpushin tënd që e prita kaq moti. U gëzuash më fort për punën e bukurë që Leonardi de Martino bëri në Shkodër për të ngjallurë gjuhënë tonë. Jam i gëzuarë tepërë e dua të ble atë librë aqë të vëlejshimë. Le të nisëjë të dalë në dritë e mjera gjuhëza jonë, pa edhe tipografia jote do t'i japë krah të fortë ndë dashtë zotënë."[45] Sjellim ndër mend se në Parathënien e "Bletës" ai e sheh të kërcënuar Shkodrën nga malazezët dhe gjuha e tyre, ndaj gëzimi i tij në këtë letër për punën e bërë për shqipen në qytetin e lashtë veriperëndimor dhe në djepin e patriotizmit shumëshekullor, është më se i përligjur.

f. Në letrën për De Radën, 10 shër-mëhillit / nëntor 1883, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 43-44 (fotokopje) ndër të tjera Mitkoja trajton dhe një çështje të sistemit fonemor të toskërishtes: "Pjesa më e madhe e Shqipërisë kanë një zanore si *y* e frëngjisht a *i* grek p.sh., *sy (oeil)* që fatkeqësisht shqipëtarët e Jugut, të Çamërisë dhe Haonisë (Eperus) nuk e kanë. Unë mendoj se është tepër e nevojshme që ta kenë."[46]

g. Kurse në letrën për De Radën, 22 kallëndorit / janar 1885, BMK, D E/9, nr. 103, (fotokopje), ai shkruan se "Ndë Bukuresh të Rumanisë u bë një Sillog i bukur' për gluhënë tonë. Edhe ditaret e Europës po shkruajën mirë për Shqypërinë"[47], duke treguar se puna e shqiptarëve në ngulimet shqiptarëve jashtë vendit (Komuniteti shqiptar në Rumani ka vend të posaçëm në lëvizjen rilindëse) ka qenë përcaktuese për shkrimin e gjuhës shqipes dhe për hapjen e shkollës kombëtare shqipe.

h. Në letrën për De Radën, 20 maj 1885, BMK, D C/10, nr. 76, f. 46 (fotokopje), TH. Mitko ngrihet mbi qëndrimet personale që mbante ndaj alfabeteve të tjera që hartoheshin në atë kohë, madje edhe kundër traditës së vet të shkrimit me alfabet grek dhe mbështet alfabetin e Stambollit, të *Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip*: "Mirë është të vihi mbi një të gjithë me alfabetin e Bukureshtit, i cili, ndëgjova, doli, u shtip, po s'e kam parë akoma".

Dhe më tej në këtë letër, në komunikimin me De Radën, mban qëndrim ndaj Komitetit të Korfuzit dhe veprimtarisë antishqiptare të këtij komiteti: "Para dica ditësh të dërgova një lepush të Komitatit Korqirës sa t'i shohsh. Beso se ay i shërben Eladhës e Shqypërinë e gënjen. Unë e di fort mirë. Duhet "Flamburi" edhe të tjera ditare italishte t'i bëjnë luftën ati Komitati rremali e gënjeshtar (inganatori)."[48]

[44] Po aty, f. 656
[45] Po aty, f. 660-661
[46] Po aty, f. 662
[47] Po aty, f. 670
[48] Po aty, f. 673-674

i. Në letrën për De Radën, 16 shkurtit 1886, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 47-48; (fotokopje) del në pah një tjetër komponent i punës misionare të Mitkos për çështjen kombëtare. Ai e sheh popullsinë arbëreshe të Itali si pjesë të popullsisë mbarëshqiptare dhe dëshiron e kërkon që ajo të mos humbasë identitetin dhe lidhjen me dheun amë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë kjo duket nga letërkëmbimi i shumtë dhe i shpeshtë me De Radën, por edhe me arbëreshë të tjerë si Kamarda, Krispi etj. Në këtë letër ai dëshiron që të realizohet një ëndërr dhe një përpjekje e kryehershme për të futur gjuhën shqipe në shkollat arbëreshe. Ai i shkruan De Radës se "Dhashtë zoti të hynj gjuha shqype ndë shkollat tuaj, sa t'apë krye (per principio), siç shkruan "Flamburi".[49]

j. Në letrën për De Radën, 14 shkurtit 1887, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 52-53; (fotokopje), ndër të tjera, gjejmë mirënjohjen për Anastas Avramidhin (drejtues i shoqërisë "Dituria" të Bukureshtit), një nga figurat më kontribuuese për shqipen dhe një nga personalitetet më të respektuara nga Mitkoja. Ai shkruan se "Na shqyptarët e Egjiptit po bëjm' A. Avramidhit një kartë hirimi (una littera di ringraziamento) me ndo 50 – 60 duar (firme) të kërshterësh e myslymanësh, për të falët që bëri (25.000 napoleona, jo lira sterlinash) për gjuhën tonë edhe do t'ia dërgojmë në Bukuresh. Ndë muntni t'i bëni edh' aty zotëria juaj, është mirë, sa t'i ngrohet zembra njeriut i cili ka ndërment të falënjë edhe të tjera haroma përmbi këto".[50]

k. Në letrën për De Radën, 29 vjeshtësë së dytë / tetor 1887, BMK, D Ç/10, nr. 76, f. 50-51; (fotokopje), kemi një informacion për kërkesat që ka Mitkoja ndaj vetes, që tashmë shkruan me alfabetin e Stambollit. Ai drejtohet mikut e të tij: "Thuamë si të duket ortografia ime. Dua ta ngas pak këtë punë (causa), sa të dalin e të flasin të dishmit tanë, gjithkush idenë e mendëjen e tij mbi këtë."

Në letër vërehet, gjithashtu, interesimi i tij i vazhdueshëm për shqipen në Kolegjin e Shën Adrianit, ku ishte mësues De Rada. Mitkoja i dërgon atij që "Të më shkruash a u kall gjuha jonë në kolegjin tuaj?". Dhe nga fundi i letrës gjejmë: "Unë dëshironj e përpiqem sa të munt të dërgonj 2-3 djelma aty ndë shkollat më të mirë të kombit tonë, po passi nuk' kemi edhe shqyp; herë më thonë ëhj, herë jo. Përandaj të më ndiesh. "Arbëri ri" do të marrë alfabetin shqyp".[51]

l. Në Arkiv e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë gjendet edhe një letër e Mitkos dërguar De Radës, e datës 1 marsitë 1887, që nuk është përfshirë në vëllimin Vepra, 1981. Në letër kemi një informim për një letër përgjigjeje të A. Avramidhit për metropolitin e Korçës dhe për dhjetëra persona që Miktoja i quan *tradhëtorët corciarë* (tradhëtorët korçarë, V.M.) "kjë kishin shcrojtur pljot me ipocrizië e me dialëszië posi Judha Iscarioti". Pach nga chëto emëra janë për të hedhur ndë pasë (in pece), kjë mohojën gjuhën e tyre, se të shumitë janë të gcënjyerë prej denacut Metropoljit, e nuch i kjendronën chetij as 10 emëra të vërtetë mikj."

[49] Po aty, f. 678
[50] Po aty, f. 689 - 690
[51] Po aty, f. 701

Dhe në vazhdim të letrës kemi konstatimin se "Kjevernia e Rumuniësë ndih fort shumë Shkjypëriësë për gjuhën me anë të Naciosë, kjë të të mundojë me chëtë udhë të shpërndanjë edh'ajo gjuhën Rumune nëpër Shkjypëri."

Në këtë letër kemi edhe një informacion gjuhësor për disa fjalë që i takojnë leksikut arbëresh dhe për të cilat Mitkoja thotë se ato nuk gjenden në shqipen e këtejdetit. Ai i shkruan De Radës se "Fjalëtë t'uaja – *mosse, mbiatu, pocca* – tech na s'gjendenë fare. Ndëvend të chëtyrevet chemi *gjithënjë*, *ngaherë, gjithmonë = sempre; saacakje, ndëciast, filkal = subito; papo, prapo, adha, paspo = dunque"* [52]

VI. Dosja Ç/10- 76, Kartyty e Thimit Mitkoit (Miscellanea Euthymii Mitcoi), Mikrofilmi P/9-nr 63, (Kopjuar në Danimarkë, Theka III -2), me 52 zbardhje filmi (letër fotografike). Kjo dosje në faqet 4-5 ka një dorëshkrim të dëmtuar nga lagështia me dy kolona shqip dhe italisht (Nuk e kuptojmë se përse kjo faqe është përzgjedhur si fotografi për në vëllimin TH. Miko, Vepra, Tiranë 1981); nga faqet 6- 9, etiketuar si Tetty llipusha e Euthimity Mitkoity të shkruara me grammatiaty ty gkrikja (ty dërguara Dimitrity e Camardes?) kemi fotokopjen e dorëshkrimit origjinal të poemës *Mbë shqipëtarët* të Mitkos, botuar në vitin 1881 (shih dosjen E/1- 97, Konka e Mitkoity ty Kurtshotitu, Poiema albanou pros tous albanous. Mikrofilmi Q/3- nr. 67, marrë në Danimarkë.) Nga faqja 10-14 të dokumenteve të dosjes kemi *Ty bonuraty e shkokjerisy "Drita" ndy Bukarest*, manuscriptum Euthymi Mitconis, me shënimin Of great importance / multi interest (të një interesi shumë të madh, të jashtëzakonshëm). Ndërsa në faqet 18-19 kemi rubrikën pyetje të Mitkos për De Radën. Këto janë me rëndësi gjuhësore, sepse autori përmes rubrikës *Cë do-me-thënë (cosa significo)* pyet për fjalë e shpjegime kuptimesh, për shkrime fjalësh e elemente të paradigmave të eptimit apo për probleme të tjera gjuhësore për të paraqesin vështirësi për të etj. Po japim për ilustrim një fjalë: "*shqotë* skjottë (ndër ne) tskjottë = dborë e butë gjithë tsopaszë si pambuk (cattone) pa erë."

Në faqet në vijim jepen dy tekste të shkruara nga dora e Thimi Mitkos, njëra është një himn për Anastas Avramidhin (f. 21-22), tjetra është vjersha "Korça" e N. Frashërit, një nga vjershat më të njohura në botën shqiptare. Në vazhdimësi janë zbardhjet fotografike të 14 letrave të Mitkos dërguar De Radës (për të cilat u fol më lart).

Gjithmonë në funksion të tematikës së punimit, po ndalemi vetëm në tri strofa tek *Ymnë (Himn) për Anastas–Avramidin Cortsarin në Bucuresh*, nga të cilat dy të fundit trajtojnë çështjen e gjuhës shqipe.

Vjersha fillon me vargjet:

Ngrehu Shqipëri të thotë
sado je shtrirë mbi gjumë,
Helmjuarë shtrirë mbi botë
Me varra me plaga shumë...

[52] Sipas letrës së Th. Mitkos,1 marsitë 1887 dërguar De Radës. Arkivi i IGJL, dosja Letra për De Radën.

Dhe vazhdon (duke na kujtuar vargjet lapidar të Naim Frashërit, *Ti Shqipëri me ep nder, më ep emërin shqiptar!*):

Ti më dhe gjuhë edh'emër
Më kale afsh të dëlirë
Më çele mënt edhe zemër
Më dhe zakon të mirë.

Kurse strofa e tretë e zgjedhur prej nesh përveçon veprën e A, Avramidhit:

Ditënë që Avramidi
Hapi për gjuhën kuvendin
Ndë Skjypëri zbriti yli
Gazsi mbuljoj vendin.

Cairë, martë , 1885

VII. Dosja 7, nr. 83, me 76 fletë, nga të cilat 73 janë fotokopje të zbardhjes së mikrofilmit 0/3, nr 43 (Theka II, 13) marrë në Kopenhagë, me emërtimin *Doratyshkruara t'arbyresha e Timi Mitkoit ty shkruara me alfabetin i Gkrikjyvet*". Materiali është botuar në përmbledhjen Th. Mitko, Vepra, 1981. E rëndësishme për ne është se katër faqet e fundit (73-76) paraqesin interes gjuhësor, sepse japin një fjalorth. Vetë autori në origjinal e titullon këtë katërfaqësh *Leksegrafia.* Dhe në të mbizotërojnë çiftet e fjalëve greqisht-shqip (po ilustrojmë me fjalët shqipe *Uthull, i ahtëtë; enë; n' enë gja, resk / resku / reskun*; Gjithashtu, paraqesin interes për studime edhe shembuj ilustrues, si *ku rafsha, mos u vrafsha; thashë të bënjë, s'e bëra dot* etj.

VIII. nëndosja E/1- 97, Konka e Mitkoity ty Kurtshotitu, Poiema albanou pros tous albanous. Mikrofilmi Q/3- nr. 67, marrë në Danimarkë. Poema është në dy kolona, kolona majtas është në gjuhën shqipe, kurse tjetra, djathtas është përkthimi në greqishte i poemës *Mbi Shqipëtarët*. Botimi, dyfaqësh dhe me 72 vargje, është i vitit 1981 në Egjipt.

Në botimin e Institutit të Kulturës Popullore, Vepra, Tiranë, 1981, kemi një version më të shkurtuar të poemës, me 57 vargje (15 vargje më pak), edhe këtu titulluar *Mbë shqiptarët*, me komente lidhen me ngjarjet e vitit 1881, kur Ulqini i dorëzohet Malit të Zi nga Fuqitë e Mëdha.

Në botimin e Institutit të Kulturës Popullore kemi edhe poemë tjetër, *Mbë shqiptarët*, me një version me 151 vargje (botuar edhe kjo në Kajro të Egjiptit, më 1880). Në versionin e botuar, po shkëputim disa vargje, ku tregohet roli i gjuhës si mjet identifikimi, bashkimi dhe uniteti:

Sa flasin shqipen të tërë,
Edhe quhen shqipëtarë
Perëndia i ka bërë
Në fëmijë (familje) të pandarë.[53]

[53] Th. Mitko, *Vepra,* botim i Institutit të Kulturës Popullore, ASHSH, Tiranë, 1981, f. 597

IX. Dosja Ë / 2- nr. 108, e titulluar Artikull i De Radës botuar në *Fiamurin e Arbërit* më 2 janar 1883 për Thimi Mitkon. Materiali është zbardhje e mikrofilmit R/6- nr. 80, kopjuar në Firence. Dosja përmban 6 faqe, tri prej të cilave i përkasin shkrimit të rilindësit arbëresh. Shkrimi tregon edhe një herë bashkëpunimin e Mitkos me De Radën, si dhe vlerësimi që i bëhet nga *Fjamuri i Arbërit* botimit të *Bëljettës Shkipëtare*, në vitin 1878, në Alekasndri të Egjiptit.

***

Interesante në Arkiv janë dhe disa materiale të studiuesve shqiptarë për Th. Mitkon. Po veçojmë dy dosje:

I. Dosja Ilo Mitkë Qafëzëzi, "Thimi Kostë Mitko", një punim monografik me 23 fashikuj që ngërthejnë 422 gjysma faqesh A_4. Po ndalemi vetëm te kreu *Leksilogu apo vokabulari shqip i "Mbletës shqiptare" të Mitkos*. Në të, ndër të tjera, shkruhet se "Th. Mitko na jep te leksilogu afro 1000 fjalë pothuase të gjitha të huaja, turqishte ett., prej të cilave ne kemi eksetuar, lënë jashtë, vetëm një numër të vogël. Sipas gjykimit të shkrimtarit, që të gjitha këto fjalë të huaja u dashkan çporur prej shqipes dhe të zëvendësohen me të tilla prej gjuhës greqishte"[54]

I. M. Qafëzëzi ka bërë edhe përkthimin e Parathënies së Mitkos, që është në interes edhe të kumtimit tonë: *Parahyrja*. *"Leksilogu shqip-greqisht" i mëpasmë përkap në shumësi ato fjalë të huaja që kanë hyrë në gjuhën shqipe dhe të cilat takonen në këtë koleksion folklorik, të cilat janë të zakonëshme në të kuvënduarit shqip ndër dialektet e Shqipërisë së madhe si dhe një numur fjalësh shqipe të rralla, pranë këtyre të fundit, fjalë të përngjashme me greqishten e vjetërë.*

Prej këtyre shëmbëllavet të pakta prej krahasimit glotologjik të vogëlë, populli shqiptar do të mundnjë të kupëtonjë, pasi edhe ai që nuk e di gjuhën shqipe, se këto fjalë janë të së gjithash të huaja dhe nuk kanë lidhje me shqipen, edhe se gjuha shqipe, duke qënë farë fisje e ngushtë me helenishten e vjetër, nuk ka asndonjë lidhje me turqishten; apo me persishten apo me arabishten as edhe me sllavishten, prej të cilave gjuhëra kanë hyrë këto fjalë, që janë së gjithash të tepërta, të padobishme edhe të shëmtuara për atë.

E pra të tilla fjalë, prej origjine dhe rrënjë fare të huaj, populli Shqiptar duhet t'i flaknjë sepse përveç që janë të tepërme edhe të shëmtuara e bastardojnë gjuhën si të papërshtatme në fjalët Shqipe. Papo kur është fjala për nevojë gjuhësore reale, e do puna të marë hua fjalë prej Greqishtes si prej një mburimi të natyrshim.

Nuk e gjukova për të mirë që ti prek ato fjalë të huaja dhe ti këmbenja me Shqipe, që të mos pandehet se e cënonj origjinën e vërtetë të këngëvet edhe të veprave të tjera të popullit. Për këtë qëllim duke mbledhur këto fjalë, po i rëndit tek ky punim për tu bërë të njohurë.[55]

[54] I. M. Qafëzezi, Thimi Kostë Mitko – leksilogu shqip i tija, në "Thimi Kostë Mitko", f. 366

[55] I. M. Qafëzezi, *Thimi Kostë Mitko – leksilogu shqip i tija*, në "Thimi Kostë Mitko", f. 368-369

Nuk po ndalemi në një shqyrtim të mëtejshëm të fjalorit. Ai është pjesë e botimit "Thimi Mitko, Vepra, Tiranë, 1981 (f. 479, 522). Kurse Akademia e Shkencave dhe studiuesi Dh. Qirjazi kanë bërë një nga botimet shkencore me të mira, duke sjellë *fjalorin* e Mitkos, *Fjalëtore shqip - gërqisht, gërqisht - shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike*[56] në një format bashkëkohor dhe me një trajtesë të plotë teorike. Gjithashtu kohët e fundit ka dalë në qarkullim edhe *Thimi Mitko, Fjalor greqisht - shqip*, me dy vëllime (vëllimi i parë botim anastatik i dorëshkrimit; vëllimi i dytë, transliterimi dhe fjalësi shqip), Tiranë, 2013, përgatitur nga Shpëtim Sala.

Në Arkiv në Dosjen e I. M. Qafëzezi, janë edhe disa letra të Th. Mitkos për personalitete të kohës. Po ndalemi në ato që trajtojnë ndër të tjera problemin e gjuhës shqipes e shkrimin e saj.

a. Në Letrën për Thimo Krein, 17 maj 1877 (përkthim nga greqishtja, kopje), Mitko, pasi i shprehet se "gëzohem për zellin tuaj fisnik ndaj atdheut tonë dhe e çmoj veprën tuaj mbi përshkrimin e Shqipërisë" shkruan se "lidhur me kulturën e Shqipërisë së prapambetur, do të ishte një vepër me shumë sukses ngritja në Egjipt e një shtypshkronje me disa modifikime dhe për të shtypur vazhdimisht libra shqip dhe një gazetë... Duke punuar kështu një shoqëri e mirë do të arrijë që edhe gjuhën tonë ta shkruajë, me ngritjen e një ose dy shkollave në qendër të Shqipërisë, edhe të holla të fitojë ajo shumë, duke shitur vepra të ndryshme."[57]

b. Në Letrën për Thimo Krein, 9 dhjetor / shënëndreut maj 1877 (kopje), Mitkoja i bën kërkesë z. Th. Krei për shpjegimin e dy fjalëve shqipe. Ai i shkruan se "Të lutem të më ndëjenjësh sa të të pyes dy fjalë shqipe, mbase i di ti e munt të m'i xgjithnjësh. Për fundi të letrës sime po t'i shënonj ato dy a tri fjalë."[58] (Fjalët janë *orë, korë, kodhe*). Në letër duket puna e kujdesshme e rilindësit me pasurinë folklorike që ka mbledhur për të dhënë me saktësi çdo material dhe bie në sy thjeshtësia e modestia për të pyetur të tjerët, sidomos, për fjalë që nuk u përkasin gjuhëve që ai njeh e duke i kërkuar ato së pari te fondi leksikor i shqipes apo tek ata që e njohin më mirë se ai pasurinë gjuhës amtare.

c. Në katër letra të tjera Th. Mitkoja, me mëtimin se shumë alfabete e dëmtojnë çështjen shqiptare, ngrihet pa të drejtë, kundër punës së J. Vretos për një alfabet të shqipes, edhe pse në mënyrë konstante e justifikon këtë qëndrim. Aty ai shfaqet skajor, kundërshtues e mohues, madje duke përdorur edhe një "gjuhë", së cilës nganjëherë i mungojnë elementet e kulturës e të qytetarisë (në letrat e tij për J. Vreton gjejmë epitete të tilla, si *mëndjeshkurtër, shumë i ulët, i përciptë, i trashë* etj.).

c. 1. Në Letrën për Thimo Krein, 3/15 qershuar 1878 (përkthim nga greqishtja, kopje), ai është kundër alfabetit të hartuar nga J. Vreto dhe madje i

[56] AShSh, Dh. Q. Qiriazi, *Fjalëtore shqip - gërqisht, gërqisht - shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike,* Tiranë, 2014

[57] Th. Mikto, *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 619

[58] Po aty, f. 621

kundërvihet edhe TH. Kreit që e mbështet këtë arritje të Vretos. Në letër ai i shkruan: "Jam thellësisht i hidhëruar që ju ka pushtuar ideja krejt e gabuar për alfabetin e Vretos, sepse me këto gjëra të njëanshme dhe të shregullta po japim shkas të na vënë në lojë të huajt dhe nga ana tjetër, i heqim popullit shqiptar zellin ndaj gjuhës së vet dhe bindjen për një përfundim të kësaj çështje"[59].

Në vazhdim të letrës ai na jep edhe informacionin se "përkohësisht po shkruaj shqip me shkronja greke, siç shkruajnë edhe gegët me shkronja latine. Dhe duke qënë për një alfabet kombëtar shqiptar , kemi tek i ndjeri... (duhet ta ketë fjalën për Theodhor Haxhifilipin, V.M.), shkronjat e Elbasanit të cilat janë pronë shqiptare dhe jo ato qesharaket e Vretos..." [60]

c. 2. Në Letrën për Thimo Krein, 10 / 22 qershor 1878 (përkthim nga greqishtja) në vazhdim të letërkëmbimit me këtë figurë, Mitko shprehet me një ton të ashpër, madje edhe me ofendime ndaj J. Vretos dhe punës së tij për alfabetin e shqipes. Në letër jepen 5 argumente për të rrëzuar punën e Vretos.

c. 3. Në Letrën për Thimo Krein, 12 korrik 1878 (përkthim nga greqishtja, kopje), vazhdon i njëjti qëndrim i pajustifikuar për Alfabetin e J. Vretos. Aty shkruhet se "Përsa i përket Vretos, unë sipas mendimit tim, e respektoj dhe e duar atë vetëm për hir të ndjenjave të tij, por jo edhe për këmbënguljen e tij të kotë mbi alfabetin e tij të paarsyeshëm. Alfabetin e Vretos, siç të kujtohet, kishim mbetur dakord që t'ua parashtronim për miratim burrave kompetentë, por ai refuzoi të vinte në bisedim me Kamardën. Prandaj, si pasojë, unë vetë ia parashtrova një filologu tjetër, i cili nuk e miraton. Mendoj, i dashur, se do të besoni porsa i përket kësaj, megjithëse unë kam si fakt shfaqjen e mendimit të tij dhe për dëshmues Anastas Beratin, i cili e lexoi."

Pasi kërkon argument pas argumenti për të justifikuar qëndrimin e tij kundër Vretos, Mitko shkruan "Që të botoni diçka të mirë në gjuhën tonë, qoftë me shkronja greke (në mungesë të shkronjave tona), qoftë me latine, qoftë edhe me kineze, kjo është një vepër e mirë, por që të përdorni metodën e Vretos (alfabetin) me idenë që ajo të hyjë te populli shqiptar (prej bamirësive të Spiros) një gjë e tillë është qesharake dhe, si pasojë, një dëm të madh për atdheun, dhe po ju siguroj për fjalë të nderit, or mik, se më vjen keq që të jeni ju fajtor për këtë. Të tilla intriga e të tjera sajojnë armiqtë e shqiptarizmit dhe të atdheut dhe njerëz që, të shtyrë nga pasione të liga e dinake, sakrifikojnë, për hir të pezmatimit të tyre çdo gjë të hirshme e të shënjtë, qoftë me anë shkëputjeje e përçarjeje, qoftë me çdo mjet tjetër, vetëm e vetëm për të kënaqur pasionin e vet.[61]

c. 4. Edhe në Letrën për Thimo Krein, 2 gusht 1878 (përkthim nga greqishtja, kopje), përsëri jemi në linjën e argumentimit dhe të paraqitjes së shkaqeve se përse kundërshton J. Vreton. Ai shkruan ndër të tjera se "Ju të Shibinit (qytet në Egjipt ku

[59] Po aty, f. 623
[60] Po aty, f. 623-624
[61] Po aty, f. 627-628

jetonte e punonte Thimo Krei, V.M.), në qoftë se do ta ndihmonit me të holla për të botuar një vepër shqiptare me një alfabet krejt të ri në dukje, gaboheni dhe dëmtoni shumë rëndë atdheun, në vend që t'i sillni dobi." Kurse, më poshtë, me të drejtë thekson se "Dhe lëvrimi i gjuhës nga ana gramatikore nuk arrihet veçse me anë të një shoqate të fuqishme. Në qoftë se kjo nuk është bërë akoma për shkak pakujdesie, nuk mundemi ta plotësojmë ne me masa të tilla, të cilat i shkaktojnë më tepër konfuzion, ftohtësi dhe neveritje të kombit". Në fund të letrës ai i kujton Th. Kreit se, si e ka njoftuar një shqiptar tjetër në Athinë (është fjala për A. Kulluriotin, V.M.), ka ndërmend të botojë një tjetër alfabet shqip dhe një gazetë shqiptare" [62]

Në arkiv në gjendet edhe Dosja "Ziaudin Kodra" në të cilën përfshihen tri nëndosje / fshikuj:

a. Ziaudin Kodra, Papa Kristo Negovani – mësonjësi martir i shkollës shqipe (17 faqe);
b. Ziaudin Kodra, Dashuria për Atdhe te rilindësit (117), ku kemi shkrime të ndryshme të daktilografuara dhe dorëshkrime.
c. Ziaudin Kodra, "Bleta Shqiptare" – me rastin 70 vjetorit të vdekjes së Mitkos. Autori i shkrimit i thekson se "nga mënyra se si punoi Mikto në "Bletën" ne e kuptojmë se ai e desh me gjithë zëmër popullin dhe gjuhën shqipe", i mëshon faktit se "botimi i Bletës Shqiptare pati rëndësi të jashtëzakonshme, ndër të tjera, se ngjalli te shqiptarët sedrën kombëtare dhe dashurinë për gjuhën shqipe". Gjithashtu në shkrim theksohet se "Bleta Shqiptare e Miktos u bë mbështetje e rëndësishme për studjonjësit e huaj të shqipes; ata gjenin aty material të sakët të gjuhës shqipe (duke përmendur, ndër të tjera se Gustav Meyer ka botuar të 12 përrallat e Bletës në Archiv Für Lieteraturgeschichte).

Me interes është edhe pohimi i Z. Kodrës se "veç shqipes edhe greqishtes, siç del edhe nga disa shënime, që ka bërë në Bletën e Vogël, Eftim Mitko njeh mirë edhe italishten dhe frëngjishten. Ato shënime italisht dhe frëngjisht i shkruan me një gjuhë të sigurt edhe pa gabime ortografije."[63]

Duke e mbyllur këtë material, më shumë informues sesa analizues, i mëshoj edhe një herë asaj çka thamë në nisje, se shqipja përmes Dosjeve së Th. Mitko në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, kërkon një punë më të plotë, më shumë kohë dhe më shumë kërkime e hulumtime. Le të premtojmë se do ta realizojmë sa më shpejt.

[62] Po aty, f. 629 - 630
[63] Për citimet në këtë syth shih Dosja Ziaudin Kodra, 38, Arkivi i IGJL.

DHORI Q. QIRJAZI (SELANIK, GREQI)

NJË MOTËRZIM I PANJOHUR I "BLETËS SHQIPTARE" (ATHINË, 1875) SI PIKËNISJE PËR BOTIMIN E PLOTË TË "BLETËVE" TË TH. MITKOS

"… të mirën që po bëjmë sot, zot' i jetës do na e shpërblejë."[64]

Në këtë punim merremi me historinë e botimit të "Bletës shqiptare" dhe me anë pak të ndriçuara të saj, për të parashtruar në vazhdim disa nga kriteret që pas gjykimit tonë duhen ndjekur për botimin e plotë të "Bletës" a të "Bletëve", si pjesë e opusit ende të pabotuar integralisht dhe shkencorisht të Thimi Mitkos. Kjo do të thotë se, tanimë, pas botimit të veprës së tij leksikografike dhe pas evidentimit të pjesës më të madhe të dorëshkrimeve që pati lënë, janë pjekur kushtet që 200-vjetorin e *bletarit dhe kallëzmbëledhësit të kulturës shqiptare*, *farëhedhësit dorëmbarë e zemërbardhë*, ta kremtojmë me shtyposjen e plotë të veprës së tij të pasur[65]. Përndryshe, *"e madhe do t'ish gjëm' e mëkatit"*!

"çdo kurbetlli ... ish një llambadhë e shqipes."

Korça, *"një nga më të mbëdhenjtë, një nga më të bukurit e nga më të qytetëruarit qytete të Shqipërisë"*[66], kjo *"goor e drittēm e Shqipëriis poshtëme"*, kjo *"città splendida della bassa Albania"*[67], *Varoshi*, *kasabaja*[68] dhe *"pshatrat për qark"*, duhet t'iu ngrejnë një monument, mbase aty te Lëndina e Lotëve, kurbetllinjve dhe bijve të saj që u morën me tregti duke u endur rrugëve të Europës e deri në Misirin e largët, atyre njerëzve që pushtuan tregje në kërkim të pasurisë, por edhe u pushtuan vetë nga drit' e mbrothësisë dhe e ditурisë. Ballkani mbarë, po ashtu, u detyrohet mjaft atyre që Tr. Stoianovich-i, gjysmë shekulli më parë[69], i pati quajtur "*the Conquering Balkan Orthodox Merchant[s]"*. Në këtë paradigmë bën pjesë edhe Thimi Mitkoja, e madje portreti i tij do të mund të përfaqësonte denjësisht një shtresë të tërë shoqërore, që bëri ëndërr dhe qëllim jete përparimin e vendlindjes dhe ndriçimin e bashkatdhetarëve[70].

---

[64] Letër e Th. Mitkos për V. Dodanin, në: Thimi Mitko, *Vepra*, përg. Q. Haxhihasani, Tiranë 1981, 707.

[65] *"Përpiqi, o trima, për gjuhën tënë, sa të shtijem farën e shenjtë e të zërë rënjë, pastaj do të mbinjë e do të shtohet vetiu..."*. Letër e Th. Mitkos për V. Dodanin, ibidem.

[66] N. D. N., *Korça dhe pshatrat për qark*, Sofje 1901, 3.

[67] *Fiamuri Arbërit*, Anno I, Num. 2, p. VII, 30 Septembre 1883.

[68] Χ. Καρμίτση, *Γεωγραφία Κορυτσάς και της περιοικίδος [Gjeografi e Korçës dhe e zonës përreth]*, Selanik 1888, 9.

[69] Traian Stoianovich, "The Conquering Balkan Orthodox Merchant", *The Journal of Economic History*, Volume 20, Issue 2 (Jun., 1960), 234-313.

[70] *"...çdo kurbetlli mokrar ose korçar, devolli ose oparak, kur këthehej në vilajet ish një llambadhë e shqipes"*. M. Kuteli, *Shënime letrare*, Tiranë 2007, 216.

Siç është sqaruar tashmë, zhvillimi ekonomik[71] i një sërë vatrash ku kryqëzoheshin rrugët e transportit të lëndëve të para, që përfundonin në Europë, krijoi kushte për zgjimin kombëtar të ballkanasve, të cilit do t'i paraprinte "shekulli i dritave". Ajo që e njohura zonjë e shek. XIX, princesha Dora d' Istria, pati shkruar për Greqinë kryengritëse[72], ku pushkës i parapriu pena, do të ndodhte disa dhjetëvjeçarë më pas edhe me shqiptarët[73].

Mes figurave emblematike që çelën udhën e lëvizjes për dituri e liri të shqiptarëve, njëra me këngët e "Milosaos" dhe tjetra me këngët e "Alvaniqí Mélisa-s", d.m.th. të "Bletës Shqiptare", janë padyshim Jeronimi i Radanjve dhe Efthimi i Mitkove, hallka lidhëse mes asaj që tashmë me të drejtë është quajtur *Para-rilindje*[74], dhe *Rilindjes* vetë, që po vinte. 200-vjetorin e lindjes së të parit e kremtuam më 2014-n, ndërsa të tjetrit do ta festojmë më 2020-n. Në ngrysje të jetës së vet, Efthimi i shkruante Jeronimit: *"Edhe zotëria jote plak, edh' unë plak, e zoti na lashtë të rrojm' edhe pak e t'i shërbejm edhé Shqypërisë"*[75].

"... si prifti Ungjijtë"

Një tjetër bir i anëve ku *"Drini plak ... mburon pej Shëndaumi"*, shkrimtar si ai, i moteve të *Pas-rilindjes*, na rrëfen se *"Në kam shkruar gjësend, këtë e kam bërë nga malli i gjuhës së Nënës, nga malli i Nënës-vetë, nga malli i Tokës ku jam lindur. [...] Dikur, ... ky mall m'u pat ndezur aqë fort në shpirt sa jam mbyllur në shtëpi brenda, një muaj e një javë plot, të lëçit vetëm libra shqipe, vetëm këngë shqipe, e të flas vetëm shqip, me vetëveten. Asohere Fjalori i Kristoforidhit,* ***Bleta e Mitkos****, Valët e Dines kanë mbetur dit e natë të hapura në tryezë e në shtrat dhe të lëçitura e të rilëçitura ças për ças – si prifti Ungjijtë"*[76].

Kur ky kryemjeshtër i shqipes e quan Ungjill "Bëletën"e Shënd Efthimit, ajo që na mbetet neve të tjerëve është ta nxjerrim sa më të plotë në dritë e të marrim sa më shumë dritë prej saj, sepse *"drit' e diturisë përpara do na shpjerë"* e se drita s'njeh sinore e kufij. "Bëleta shqypëtare", ashtu si gjithë veprat e mëdha, ka një histori të vetën të frymëzimit, përgatitjes, botimit, dhe jehonës në kohë, me të cilën

[71] Për Ballkanin shih Tr. Stoianovich, *art.cit*., kurse për Korçën shih A. Ισμυρλιάδου, *Κοριτσά. Εκπαίδευση – Ευεργέτες – Οικονομία 1850-1908 [Korça. Arsimi – Bamirësit – Ekonomia 1850-1908]*, Selanik 1997.

[72] "... tout grand mouvement de régénération politique doit être nécessairement précédé d'un mouvement littéraire. En Grèce les Rhigas et les Coraïs ont été l'avantgarde des Kanaris et des Karaïskakis". *Elena Ghika a Girolamo de Rada. Lettere di una principessa*, Studio introduttivo, trascrizione e note Merita Sauku-Bruci, Tirana 2004, 89.

[73] *"Kollonija e Bukureshtit ka qënë një Organizatë idealistësh-tregëtarë që mi themelin lëndor të jetës kishin ngritur flamurin e idealit më të pastër kombëtar"*. L. Poradeci, Vepërimi kombëtar i shqiptarëve të Rumanisë me kryeqendër kolloninë e Bukureshtit, në: Lasgush Poradeci, *Vepra* 2, Onufri, Tiranë 1999, 191.

[74] Shih vëllimin *Një Rilindje para Rilindjes*, Gjirokastër 2014, me materialet e Konferencës shkencore ndërkombëtare albanologjike të organizuar nga Universiteti "E. Çabej" i Gjirokastrës në maj 2013.

[75] Letër e Mitkos për De Radën, 15.7.1887, Th. Mitko, *Vepra* 1981, 698.

[76] M. Kuteli, *Poem kosovar dhe poemi i Shëndaumit*, Tiranë 2009, 23.

histori do të merremi në kuadër të këtij punimi. Do të përpiqemi pra të shkojmë nga *Teksti* te *Para-teksti*, *Pas-teksti* e *Kon-teksti* i "Bletës", duke rindërtuar pjesë deri më sot të panjohura të historisë së saj.

Ajo çka kemi ditur deri vonë për "Bletën Shqiptare" përmblidhej në sa mund të vilej prej vetë veprës, ashtu siç është botuar në Aleksandri më 1878, si dhe nga sa ka shkruar Dr Gjergj Pekmezi me rastin e "për-shkrimit" [=trans-kriptimit] të saj me alfabetin shqip (Vjenë, 1924). Pas Çlirimit, ngjarje të shënueshme kanë qenë zbulimi dhe riatdhesimi i "Bletës së vogël", të njohur ndryshe si "Dorëshkrimi i Pragës", si dhe botimet që pasuan, kryesisht vëllimi II i serisë "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar" (1961) dhe Vepra e Mitkos, botuar më 1981 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nën kujdesin e Q. Haxhihasanit, i cili shkroi me atë rast edhe një studim të gjatë hyrës. Dy vite para këtij, më 1979, Dh. Shuteriqi botoi artikullin studimor "Mbi veprimin e Mitkos si folklorist dhe mbi botimin e 'Bletës Shqiptare'"[77]. Q. Haxhihasani botoi gjithashtu tekstet e letrave të Mitkos për G. Meyer-in, të cilat i zgjeruan njohuritë tona për 10-vjeçarin e fundit të jetës së misirlliut fisnik[78].

Ndërkaq, ngjarja më e rëndësishme, e cila krijoi kushtet për një hap cilësor në studimet rreth veprës dhe personalitetit të Th. Mitkos, ka qenë pasurimi i ndjeshëm i fondeve arkivore të tij në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar, nga mesi i viteve 1980, pasojë e sjelljes nga Egjipti të lëndës së pasur në dorëshkrime, ruajtur me përkushtim nga pasardhësit e Mitkos në Aleksandri[79]. Merita e gjetjes dhe e riatdhesimit të kësaj pasurie të çmuar kulturore të shqiptarëve i takon studiuesit të njohur të periudhës së Rilindjes kombëtare shqiptare, prof. Jorgo Bulos, i cili e nxiti autorin e këtyre radhëve të merrej me përgatitjen për botim të veprës leksikografike deri atëherë thuajse të panjohur të Th. Mitkos.

Tani që kjo detyrë mund të quhet e përmbushur[80], përvoja e grumbulluar nga kontakti pothuaj i përditshëm për mbi 5 vjet me dorëshkrimet e Mitkos, na jep mundësinë të rikapim çështje që lidhen me "Bletën Shqiptare" e të cilat nuk mund të trajtoheshin veçse *përsëshqarëthi*[81] në kuadër të studimit hyrës të një vepre që nuk kapej ballazi me ndihmesat e tij në fushë të folklorit.

"më pesëdhjet e dy senéa"

Kohën kur filloi Mitkoja të interesohej e të merrej me grumbullimin e lëndës folklorike, ne, ndryshe nga Shuteriqi *("në fund të viteve '50 të shekullit të kaluar*

[77] Dh. S. Shuteriqi, *Mbi Barletin dhe shkrime të tjera*, ShB "Naim Frashëri",Tiranë 1979, 201-215.

[78] Q. Haxhihasani, "Thimi Mitko dhe Gustav Majeri", *Kultura Popullore* 2 (1985) 139-170.

[79] Për më tepër shih kreun "Në gjurmët e rilindësve" të librit të akademik J. Bulos *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë 1988.

[80] Thimi Mitko, *Fjalëtore Shqip-Gërqisht / Gërqisht-Shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike.* Përgatitja e dorëshkrimeve për botim & studimi hyrës nga Dhori Q. Qirjazi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2014, 780 fq.

[81] Fjalë e marrë prej shkrimeve të Mitkos.

[XIX], më me siguri në fillim të viteve '60")[82], dhe në pajtim me sa paravendon Mitkë-Qafëzezi *("që më 1850-55"*)[83], do ta vendosnim në fillimet e viteve 1850. Në një fletë të dsh të Mitkos, ku janë regjistruar vargje popullore, duket i shënuar qartë, por me tjetër bojë shkrimi, viti 1852, dhe fjalët *"më pesëdhjet e dy senéa"*. Data mund të jetë reale, por edhe mund të jetë shtuar më vonë, për arsye që nuk i dimë. Nga ana tjetër, ngjarjet që përshkruan kënga kanë të bëjnë me Luftën e Krimesë dhe me rrethimin e Sevastopolit, shtator 1854 - shtator 1855, pra ato vargje nuk janë shënuar më 1852. Sido që të jetë, po të marrim parasysh pohimin e Mitkos se *"qysh në moshë të re iu vura punës dhe guxova të shpall me anë të shtypit Këngë Shqiptare"*[84], ku me "qysh në moshë të re" kuptohet mosha së paku para të tridhjetave, i bie të ketë filluar para ose rreth viteve 1850, dhe jo pas 1860-s. Le të shtojmë edhe faktin se, siç shënon vetë Mitkoja, më 1867, kur zënë e i vishen sytë, këtë ai e quan shenjë pleqërie![85]

Me të njëjtën logjikë, nisur edhe nga citimi i mësipërm i Mitkos si dhe nga pohimi i tij se *"po merrem prej shumë kohësh"*[86] me "Bletën", duhet shtyrë disi më mbrapa në kohë edhe lindja e idesë për të hartuar ai vetë një përmbledhje folklorike të shqiptarëve. Këtu nuk i duhet mëshuar edhe aq faktit që ai i dërgon kohë pas kohe lëndë folklorike Kamardës[87].

I tillë, shpirtmadh e bujar sa s'ka, pati qenë Mitkoja, dhe kjo gjë duket gjatë gjithë jetës së vet! Për të qe e rëndësishme të dilte në dritë kultura e shqiptarëve dhe pak e shqetësonte autorësia. Siç kemi vënë re edhe për rastin e Fjalëtoreve, edhe pse e pati filluar punën prej kohësh, ai priste nga Kamarda dhe nga Kristoforidhi që të botonin fjalorë të shqipes.

"Vivlia ime ndë Athinë nuk humbi, ... e lëreva."

Gjithsesi, kurdo që ta ketë filluar punën për "Bletën", dokumentet tregojnë se ai duhet ta ketë patur librin gati në fund të v. 1873 a në fillim të v. 1874[88], përderisa në mars të po atij viti, sipas zakonit të kohës, qarkullon në greqisht Njoftimin (Αγγελία)[89] për botimin së shpejti të "Bletës", pas sigurimit të pajtimtarëve që do të parapaguanin. Pikërisht këtu ka patur një vakuum në njohuritë tona për historikun e "Bletës". Nga njëra anë, njihnim përmbajtjen e Njoftimit të marsit 1874 dhe, nga ana tjetër, mbështeteshim në fjalët që Mitkoja i shkruante Kamardës më 15 shkurt 1878:

---

[82] Dh. S. Shuteriqi *art.cit.* 211.

[83] Dh. S. Shuteriqi *art.cit.* 215, shën. 24.

[84] Shih Dokumentin VII të *Shtojcës* në fund të këtij punimi.

[85] Thimi Mitko, *Fjalëtore* … 77.

[86] Njoftimi (Αγγελία) i v. 1874.

[87] *"Nga një letër e 7 majit [1869] që i dërgon Kamardës ... Kuptojmë se mbledh akoma për Kamardën dhe s' kuptojmë nëse mbledh edhe 'për vete'. Po, me sa duket, ai tani mbledhe edhe 'për vete'",* Dh. S. Shuteriqi, *art.cit.* 207.

[88] Dh. S. Shuteriqi, *art.cit.* 206.

[89] Shih Shtojcën me tekstin e plotë greqisht dhe përkthimin shqip të tij, kryer prej nesh.

Vivlia ime ndë Athinë nuk humbi, po me të panumuruarat lajthiteja të shkronjashtypësit, katandisi ajo e u bë një gjë për të mos dalë në dritë, - aq e papëlqyeshme, e prandaj e lëreva. Tani e dhashë n' Aleksandri, edhe u nis pardje të shtyposet përsëdyti pak më e shkurtër, ndonëse më qëndron shumë shtrenjt shtypësi, e i lutem zotit të dalë e pëlqyer.[90]

Por nga marsi 1874 deri në shkurtin e 1878-s kanë kaluar plot 4 mote e prandaj lind pyetja çfarë pati ndërmjetësuar që, ndryshe nga premtimi i fillimit, "Bleta" po shpallej me aq vonesë? Kur e "lëreu" Mitkoja shtyposjen "ndë Athinë" të "vivliës" së tij "me të panumuruarat lajthiteja të shkronjashtypësit"?

Lëmshin e krijuar për shkak të radhëve të cituara më sipër[91] vjen ta zgjidhë tani vetë Mitkoja me lëndën e pasur arkivore që na la, e cila as është mbledhur plotësisht dhe as është studiuar imtësisht.

Gjatë punës për botimin e Fjalëtoreve të Mitkos hasëm në disa fletë mjaft interesante, pak dorëshkrime dhe kryesisht boca tipografike, ku bëhet fjalë për "Bletën" e Athinës[92], dhe prej nga duket mjaft qartë se libri pati filluar të shtypej në muajt e parë të v. 1875. Nga ky botim i lënë në mes të udhës janë ruajtur të shtypura thuajse plotësisht *Parathënia greqisht* e Mitkos, shkruar në Kajro më 10 mars 1875, si dhe pjesa më e madhe e *Parthënmes shqip*, përkthyer prej atij vetë. Po ashtu, ruhen një numër bocash të veprës *"Filía shqiptare"* të Dora d' Istrias, që, sipas Njoftimit të v. 1874, Mitkoja kish ndërmend ta vinte në krye të librit. E theksojmë qysh këtu, se, megjithë që nuk e kemi librin të plotë, ajo çka është ruajtur na jep një pamje të qartë të strukturës së tij dhe të mënyrës si e kish konceptuar vetë autori në trajtën fillestare[93].

Parathënia/Parthënmia e marsit 1875 shtjellojnë më tej idetë e shprehura prej Mitkos qysh në Njoftimin e v. 1874, por këtu nuk do të ndalemi hollësisht në përqasjen e tyre, çka mund ta bëjë lexuesi i interesuar duke u nisur nga tekstet e paraqitura në Shtojcën e këtij studimi.

Ka interes të citohet i plotë paragrafi i parë i Parthënmes, prej nga tërthorazi kuptojmë reagimet që ka ngjallur Njoftimi i Mitkos i një viti më parë:

Kuxuarë të shpall me shtypë sendin e kësaj vivlie, nuku më ndoonjë lakëmi për fitim, as ndoonjë ligështi për të kërkuarë nam fillollogu; jo; as një nga këto më

---

[90] Th. Mitko, *Vepra*, Tiranë 1981, 622.

[91] Shuteriqi shkruan nga njëra anë se *"Bleta' duhet të ketë qenë gati për botim përpara fundit të janarit 1874, që më 1873"* dhe shton në vazhdim *se "Më 1877, me ndihmën e patriotëve dhe me kursimete e veta, Mitkoja vendosi ta botonte 'Bletën' .... [dhe] e dërgoi veprën ta botonte në Athinë në fund të vitit 1877 ose në fillim të vitit 1878. Shtypshkronja e Athinës punoi shumë keq për librin e tij"*. Art.cit. 206-207.

[92] Shih Th. Mitko, *Fjalëtore* … 20.

[93] Një fragment i Parathënies së 1875-s, ku Mitkoja shkruan se "*libri **u shtyp** larg vendit ku unë banoj, dhe për rrjedhojë jo nën mbikëqyrjen time të drejtpërdrejtë"*, nuk duhet marrë *mot à mot* dhe as duhet të na ngjallë shpresa për gjetjen e ndonjë kopjeje të rrallë të tij. Thjesht, sipas një konvencioni të atëhershëm (dhe të sotëm), në parathënie shkruajmë se libri *u shtyp* pa qenë medoemos i shtypur plotësisht.

shtyri mbë këtë kuximë, edhe ja tek' është për deshmi pazar' i vivliës sime, sagjithë mbë këto koha të sotmet: edhe këjo vetë e shkruameja, e cila më kallëzon më tepërë për një punëtuar kallës-mbë-ledhësin, sesa për një të dijtëshim bulk. Ajo që më holqi mua me-vërtetë mbë këtë, kële një njejme dëtyrë, e një mall që m' ushti që mbë vogëli e urrit bashkë me mua, sa të jem edh' unë i vëjejtëshim ndoopak për filiën time Shqypëtaren, të cilën për fatkeqëri, diemët' e saj të vërtetët, përtuarë shumë, s'i kan rën përapa aspak; e farat e saja, pa-a mentuarë mirë, e lëryen, aqë sa ajo përandaj po lëngon ndë sëmundnë të glatë e të përjetëshime të ngatëruame, e këndy e tutie gjendet ndë rrëzek të copëtohet, a të surbitet e të përpihet kryekëput.

Siç shohim, Mitkos i është dashur të përballet me thashethemnajën pas së cilës ai po e botonte "Bletën" për të bërë para e për të fituar emër!!! Këto fjalë duket se kanë qarkulluar qysh me daljen e Njoftimit, ndaj edhe misirlliu ynë, qysh në Parthënmen e marsit 1875, sqaron me një mënyrë krejt çarmatosëse arsyet që e shtynë të përgatiste e të botonte librin, për të na treguar edhe sot sa i madh e sa modest ka qenë ai, dhe sa të vegjël e cmirëzinj qenë ata që e përgojonin. Është një rrëfim prekës dhe i papërsëritshëm në letërsinë e Rilindjes, të cilin Mitkoja e ka lënë jashtë Parathënies së botimit të Aleksandrisë.

Për sa i përket strukturës së "Bletës" së vitit 1875, mund të bëhen krahasime në dy kahe: të shihet ajo në raport me Njoftim-in (premtimin) e 1874-s dhe me botimin (realizimin) e 1878-s. Sipas Mitkos, "Bleta" e Athinës do të përmbante:

A) Një pjesë të historisë së Dora d' Istrias për kombësinë shqiptare botuar në frëngjisht dhe kthyer në dialektin shqiptar të Italisë prej Dhimitër Kamardës, e mandej prej meje në të folmen dangëllishte-toskërishte.

B) Fjalë të urta shqiptare.

C) Gjëegjëza shqiptare.

Ç) Këngë popullore, heroike, erotike, dhe të dasmës, të ndara në dangëllishte-toskërishte, labërishte-çamërishte dhe gegërishte. Janë përfshirë tek tuk edhe disa [këngë] greke, heroike, bashkë me kuptimin në shqipen, ngaqë kanë lidhje me të njëjtat [këngë] shqip, si dhe disa poezi me autor, të ndryshme. Disa prej këngëve janë vetëm fragmente dhe të paplota, ashtu siç munda t'i siguroja.

D) Përralla, dhe

Dh) Fjalor fjalësh të huaja, më së shumti turke, që hasen në këngët a tjetërkund, përkthyer greqisht dhe shqip.

Kam lënë pa shtuar, ndryshe nga sa kisha dhënë fjalën, emrat dhe mbiemrat e njerëzve, për shkak se nuk m'u dërguan në kohë të dhënat më të nevojshme…

Vetë ai na thotë çfarë nuk ka përfshirë nga ato që pati premtuar në mars 1874, gjë që do ta bëjë në botimin e Aleksandrisë, por ajo që tërheq vëmendjen është fakti se ka ndër mend ta nisë "Bletën" me "Filinë Shqiptare pas këngëve të llauzit" të Dora d' Istrias. Është një lloj hyrjeje e cila vë në pah rëndësinë e krijimeve popullore për historinë dhe identitetin e bartësve të tyre, por edhe një garanci a "pasaportë" e vetë librit, ngaqë Dora d' Istria ka qenë asokohe një personalitet i njohur dhe autoritar i skenës europiane, me një rrjet të gjerë lidhjesh me

intelektualë të shquar, si dhe me njohje e reputacion në Greqi[94]. Vërejtja e dytë që mund të bëhet sa i përket strukturës së "Bletës" është se ajo nuk konceptohet thjesht si një përmbledhje materiali folklorik, por si një farë krestomacie që e jep më të plotë figurën e shqiptarëve e të kombit të tyre.

Nga këndvështrimi gjuhësor është me interes përpjekja e Mitkos për të kthyer "në dangëllishte-toskërishte" gjuhën e përdorur nga Kamarda në përkthimin arbërisht të veprës së Dora d' Istrias. Siç shënojmë në studimin hyrës të Fjalëtoreve të Mitkos[95], mbetet për t'u ftilluar arsyeja pse ai e ka hequr këtë sqarim nga botimi i Aleksandrisë, pa hequr dorë aspak nga synimi për të shkruar në një shqipe më të kuptueshme e më të kapshme nga mbarë shqiptarët[96].

Nga i njëjti këndvështrim, fakti që *Parthënmia* qe shkruar së pari në greqisht e më pas u përkthye prej tij në gjuhën shqipe (Παράφρασις εις την Αλβανικήν - *Nkëthyerë mbë Shqypen Parthënme*), tregon se Mitkoja e pati konceptuar fillimisht "Bletën" si një botim dygjuhësh dhe u përpoq ta realizonte si të tillë. Nëse në botimin e Aleksandrisë kemi vetëm versionin greqisht të parathënies, kjo tregon se autori u detyrua të hiqte dorë nga ky qëllim për arsye ekonomike. Përndryshe, qysh në ballinën e "Bëletës Shqypëtare" të Aleksandrisë lexojmë fjalët Αλβανο-Ελληνικό Σύγγραμμα, pra "Libër shqip-greqisht"!

Në rrafshin politik, si *Njoftimi* (1874), ashtu edhe *Parthënmia* (1875) apo *Prologu* (Πρόλογος) i 1878-s na japin mundësinë të ndjekim mënyrën si formohet dhe si evoluon mendimi i Mitkos. Bie në sy rëndësia që i kushton ai Kryengritjes greke të 1821-së *("E madheja frymëtoreja luftë e vitit 1821, që ndezi pe sendi të vet një fanua të madh, e shkrepi ... dritë të paa-ngrysëme ...")*[97], por edhe idesë *"Lindja nëpërmjet të Lindjes"* përkundër *"famëmadhes ide të 'nacionaliteteve'"*[98], çka do të thotë se ai besonte në nevojën e luftës së përbashkët të popujve dhe në krijimin e një *Konfederate të Orientit*[99]. Këtë ide duket se e ka përkrahur veç Mitkos[100] edhe Dora d'Istria[101], ndërsa De Rada e shihte me rezerva[102]. Ndërkaq, në Prologun e

[94] Shih morinë e shkrimeve të saj, botuar ose përkthyer në shtypin grek, por edhe librat që iu përkthyen në Greqi, gjatë viteve 60-70 të shek. XIX, në Ίρις Αυδή-Καλκάνη, *Η Ντόρα Ντ' Ίστρια και η Ελλάδα [Dora d' Istria dhe Greqia]*, Μουσείο Μπενάκη, Athinë 2009.

[95] Thimi Mitko, *Fjalëtore* … 49.

[96] Shih nënkreun "Hapa të hershëm për krijimin e një shqipeje të përbashkët" në studimin tonë hyrës të librit Thimi Mitko, *Fjalëtore* … 31-50.

[97] *Parthënme*, shih Shtojcën.

[98] *Njoftim*, shih Shtojcën.

[99] Shih Λ. Χασιώτης, *«Η Ανατολική Ομοσπονδία»: δύο ελληνικές φεντεραλιστικές κινήσεις του 19ου αιώνα ["Konfederata e Orientit": dy lëvizje federaliste të shek. XIX].* Βάνιας, Selanik 2001.

[100] Shih *Parthënmen* e "Bletës" së Athinës.

[101] Shih M. Sauku-Bruci, *Elena Ghika* ... 115: "La scrittrice propone le creazione di una confederazione balcanica fatta da rumeni, greci, serbi, albanesi e bulgari, confederazione che, seguendo l' esempio della confederazione svizzera, avrebbe rispettato le tendenze delle diverse nazionalità, come une soluzione reale per la stabilità nei Balcani". (Cfr. Dora d' Istria, *Les femmes en Orient – La Péninsule orientale*, Zurich 1859).

[102] Shih *Fiamuri Arbërit*, anno III, num. 10, pag. II-VI, 20 Febbraio 1886.

1878-s do të shohim se tashmë Mitkoja përqendrohet në raportet e shqiptarëve me grekët dhe ka "nuhatur" rreziqet që u kanosen nga "Megali Idhea". Duke vënë në përdorim shpesh argumente që i ofron historia dhe qytetërimi i fqinjëve të lashtë, ai polemizon duke pasur si busull bindjen se liria dhe gjuha janë të drejta thelbësore të qenies njerëzore e të popujve, e si të tilla nuk mund të trajtohen në mënyrë selektive.

A ndiqte Mitkoja një traditë botimesh në këtë fushë? Para tij janë botuar vepra e Hahn-it (1854) dhe më pas ajo e Kamardës (1866), prej të cilëve korçari ynë është ndikuar jo pak. Megjithatë, kemi arsye të besojmë se ai duhet ta ketë filluar grumbullimin e lëndës folklorike pa dalë ende në dritë as e para as e dyta vepër.

"...e dhashë n' Aleksandri, edhe u nis pardje të shtyposet përsëdyti pak më e shkurtër."[103]

Po ta mendosh hollë-hollë dhe të hysh në thelbin e fjalëve, "Bleta" si titull mund të quhej edhe *Antologjia Shqiptare*. Kuptimi, si në njërin si në tjetrin rast është i njëjtë. Sepse *anto-logji* (ανθο-λογία) do të thotë tufë lulesh të zgjedhura, nektarin e të cilave e *mbë-ledh* dhe e *zgë-ledh* bleta për të bërë mjaltë[104]. Të njëjtin kuptim ka edhe fjala sinonime *ap-ánthisma* (απ-άνθισμα). Me titullin "Bleta" Mitkoja vazhdon një traditë të hershme, që çelet së paku qysh me botimet e Gliqis-it (Γλύκυς) në Venedik, që, përveç se e ka bletën logo të shtypëtores së vet të famshme, boton më 1680 një përmbledhje me titullin «Μέλισσα»[105] ("Bleta"). Tradita vazhdon në vitet 1840-50 e më pas, kur në Athinë qarkullojnë një sërë "Bletësh", ndër të cilat më e njohura është "Η ιατρική Μέλισσα - Bleta mjekësore"[106]. Një vrojtues i kujdesshëm nuk e ka të vështirë të dallojë ngjashmërinë e madhe të ballinave të "Bletës mjekësore" të Athinës dhe të "Bëletës Shqypëtare" të Aleksandrisë[107].

"Bleta mjekësore" dhe "Bletë" të tjera që botoheshin asokohe në Athinë e gjetkë, kanë qenë botime periodike, dhe kështu e pati shtënë në mend "Bletën" e vet edhe Mitkoja. Vetë ai, në Njoftimin e marsit 1874, si dhe në Parthënmen e pabotuar të 1875-s, përveç atij edhe të tjerë, na thonë se pritej të dilte edhe një numër i dytë i "Bletës" e kështu me radhë. Kupitori, p.sh., shkruan më 1879 se *"Me të njëjtin qëllim [=duke dashur të plotësojë mungesën e deritashme të fjalës së shkruar shqipe]*

[103] Shih shën. 24.

[104] Është për t'u shënuar se në vitin 1840 qarkullon në Athinë një libër me titull *"Bleta : ose antologjia e artë ... Për t'u përdorur prej çdo lexuesi dijedashës. ..."*. (Titulli i origjinalit: Η Μέλισσα : ήτοι χρυσούν απάνθισμα. Περιέχουσα διάφορα αποφθέγματα και απομνημονεύματα Ηθικά, Πολιτικά και Εκκλησιαστικά, εκ της Παλαιάς Γραφής και της Νέας, και των αρχαίων Ελλήνων λογογράφων και ποιητών. … Προς χρήσιν εκάστου φιλομαθούς αναγνώστου. Ημερομηνία έκδοσης: 1840. Mitkoja duhet t'i ketë patur në duar këto libra, ngaqë, siç shënon në ato pak faqe kujtimesh që na ka lënë, në Korçë, qysh në vitet 1850, ekzistonte Bibliotekë "për ndriçimin e mbarë qytetit" (Thimi Mitko, Fjalëtore … 76).

[105] Shih Shtojcën.

[106] Shih Shtojcën.

[107] Shih Shtojcën.

publikon shqiptari Thimi Mitko 'Bletën Shqiptare', Pjesën e Parë të së cilës e botoi në Aleksandri më 1878. [...] Tani po përgatit edhe Pjesën e Dytë"[108].

Meqenëse po flasim për ballinën e "Bletës" së Aleksandrisë, mbetet për t'u ndriçuar kush ka qenë redaktori me inicialet Δ. A. [Dh. A.] i librit të Mitkos. Po kështu, duhen bërë kërkime lidhur edhe me shtypëtoren e Ksenofon N. Saltis-it, në Aleksandri.

"Del në dritë falë ndihmesës bujare të pajtimtarëve miq të muzave..."

Deri më sot nuk njohim ndonjë studim të posaçëm për sa i përket "auditorit" të "Bletës", ashtu siç përvijohet ai prej emrave të pajtimtarëve, renditur në faqet e fundit të botimit të Aleksandrisë. Ndërmarrja e një studimi të tillë, mbi bazën e lëndës që disponojmë apo edhe të të dhënave të tërthorta, do të nxirrte në dritë një sërë faktorësh ende të panjohur që ndikuan në procesin e botimit dhe të qarkullimit të librave në motet e Rilindjes kombëtare të shqiptarëve. Nga listat e "Bletës" (1878) del se Mitkoja arriti të siguronte 248 pajtimtarë, të cilët porositën 451 kopje të librit, numër jo i vogël për atë kohë (por edhe për sot!). Ndër pajtimtarët, shumica janë korçarë të kolonive të Egjiptit dhe pastaj të Rumanisë, gjë që përputhet me faktin se në këto dy vende gjendej numri më i madh i kurbetllinjve, që kishin filluar të zgjoheshin kombëtarisht. Interesante është se korçarët cilësohen herë si "korçar" herë si "Κορυτσαίος", çka mund të merret (me rezerva) edhe si një element vetëpërcaktimi identitar në atë periudhë të ngjizjes së identiteteve[109].

Në krijimin e rrjetit të pajtimtarëve luanin pas gjase rol edhe njohjet personale si dhe origjina nga i njëjti pellg apo e njëjta krahinë. Sa për Egjiptin, Mitkoja shënon se *"Korçarët zunë të venë ndë Egjyptë për tregëti mbë të dalë të tetëmbëdhjetësë qindore, tyke ndiekurë luftëtarëtë Turq Shqypëtarë"*[110]. Nga ana tjetër, njihen lidhjet tradicionale të pellgut të Korçës me viset e ultësirës së Danubit, si dhe rastet e kurbetllinjve që e nisën mërgimin në Egjipt e pastaj shkuan në Rumani (J. Banka), apo e kundërta. Nuk është e vështirë të vërehet se nga listat e pajtimtarëve mungojnë krahina të tëra të Shqipërisë, apo edhe vatra të tjera të emigracionit shqiptar. Kolonia e Stambollit, p.sh., përfaqësohet me një pakicë emrash, krahina e Gjirokastrës po ashtu, për të mos folur pastaj për ngulimet e arbëreshëve apo për arvanitasit, që mungojnë thuajse fare nga listat.

Duhet shtuar se 248 pajtimtarët janë siguruar prej Mitkos qysh pas qarkullimit të Njoftimit (mars 1874) e deri në botimin e "Bletës" së Aleksandrisë (1878), çka duket edhe nga disa dokumente që ruhen në Fondin Mitko, me emra abonentësh renditur në fund të tekstit të Njoftimit, por edhe me formularë të

[108] «Προς τον αυτόν σκοπόν [=την κει νυν έλλειψιν γραπτού αλβανικού λόγου θέλων να αναπληρώση] δημοσιεύει ο Αλβανός Ευθύμιος Μήτκος την 'Αλβανικήν Μέλισσαν', ης εξέδωκε το 'Πρώτον Μέρος' εν Αλεξανδρεία 1878, εις 4^{ον}, σελ. 233. Παρασκευάζει δε και Δεύτερον Μέρος». Π. Κουπιτώρης, *Αλβανικαί Μελέται*, Athinë 1879, 58.

[109] Mitkoja apo njerëzit që e ndihmuan për regjistrimin e pajtimtarëve, shënonin me sa duket atë çka u thonin vetë parapaguesit e librit.

[110] Thimi Mitko, dorëshkrim.

përgatitur enkas (Kajro, mars 1878), prej të cilëve tërheq vëmendjen tonë ai që ka plotësuar Jani Vretoja në Stamboll. E kemi cituar edhe
tjetërkund shënimin e Vretos[111], po e rimarrim edhe këtu[112], për të kuptuar vështirësitë e
botimit të "Bletës", e për të theksuar se ato nuk kanë qenë vetëm dhe thjesht të anës teknike.

Sepse vërtet, letra e Mitkos për Kamardën, e shkurtit 1878, me ankesat e tij për të "panumuruarat lajthiteja", tregon sa e vështirë ka qenë radhitja e teksteve të shqipes me shkronjat e greqishtes e me lloj lloj kombinimesh të tyre, gjë që duket mjaft qartë në tri faqet e Parthënmes shqip, të cilat s'kanë shumë gabime[113], por sa kohë e mund i është dashur vallë për t'i terezitur?! Dhe a mund ta bënte këtë për një libër të tërë? *"Veç këtyre, libri u shtyp larg vendit ku unë banoj, dhe për rrjedhojë jo nën mbikëqyrjen time të drejtpërdrejtë"*, shkruan ai vetë duke i kërkuar ndjesë lexuesit në mbyllje të Parthënmes[114].

Por se mos qenë vetëm problemet teknike! Po të kishin gojë e të flisnin fletët e "Bletës", kushedi çfarë do të mësonim prej tyre! Megjithatë, qëllon nganjëherë që dorëshkrimet e thyejnë heshtjen. Kemi në duar dy skicime letrash të Mitkos[115], që mezi lexohen, dërguar një korçari kurbetlli, prej nga përvijohet qartë se asokohe qenë përhapur fjalë që "Bleta" qe një libër që iu kundërvihej interesave të Helenizmës. Kjo ishte një goditje pas shpine dhe mjaft e rafinuar, dhelpërake, që synonte të tulaste guximin intelektual të Mitkos, por edhe të venitte flakën e atdhetarisë të njerëzve që e përkrahnin. Mitkoja përpiqet ta shpërndajë këtë mjegull duke shkruar se, në të vërtetë, "Bleta" u bën jehonë edhe atyre interesave e se i shërben *"mbarë atdheut"* (την καθόλου πατρίδα), e në këtë rast "atdhe", sipas tij, janë edhe Shqipëria edhe Greqia[116]. Për këtë arsye, janë të shumtë grekët që, siç shkruan, e kanë porositur librin. Ai madje bën një hap më tej, kur, si iluminist i thekur që është[117], shkruan se "Bleta" u shërben interesave të çdo njeriu në përgjithësi! Siç do të shohim, në Parathëniet e v. 1875 dhe 1878 Mitkoja shtjellon shkoqur çfarë nënkupton kur flet për atdhe të përbashkët dhe interesa të përbashkëta të grekëve dhe të shqiptarëve.

Zhurma e krijuar duket se e ka dëmtuar punën e tij. Ka patur presione jo vetëm nga krahu grek, por edhe nga krahu shqiptar, që mbase nuk i mirëpriste idetë

---

[111] Thimi Mitko, *Fjalëtore* … 87-88.

[112] Shih Shtojcën, Dok. IV.

[113] Siç duket në Shtojcë, f. 11, kemi gjetur një dokument që daton në vitin 1875 dhe përmban disa nga shenjat që përdorte Mitkoja për korrigjimin e bocave. Janë shënime të Mitkos në një fletë fletoreje të gjuhës frënge, të të birit, Dhimitrit.

[114] Shih Shtojcën.

[115] Shih Shtojcën, Dok. VII.

[116] Shih Shtojcën, Dok. VII.

[117] Në dorëshkrimet e Mitkos kemi gjetur një numër fletësh me shënime të tij nga vepra e kryeiluministit grek Adamantios Korais (1747-1833), të cilat datohen më 1844, kur Mitkoja është vetëm 24 vjeç.

e Mitkos për afinitetin dhe afrimin shqiptaro-grek. S'ka si shpjegohet ndryshe kalimi në heshtje i "Bletës" nga savantët shqiptarë të Stambollit dhe nuk është e rastit që Stambolli, me aq e aq shqiptarë, përfaqësohet kaq dobët në listat e pajtimtarëve.

Nuk përjashtohet mundësia që edhe vetë Mitkoja, sidomos pas botimit të veprës, të jetë tërhequr disi nga "skena". Kjo ka gjasa të ketë ndodhur vërtet, po të marrim parasysh se ai ka pranuar të përfshihet në veprën *"Ankime shqiptare"* të Th. Brandit (1880)[118] një pamflet i gjatë në mbrojtje të origjinës shqiptare të Skënderbeut, polemikë e Mitkos me historianin grek Paparigópoulos, tekstin e së cilës e kemi gjetur në dorëshkrimet e atdhetarit korçar[119]. Bën përshtypje gjithashtu edhe fakti se Mitkoja, më 15 janar 1883, nënshkruan në *Fjamurin e Arbërit* si "një shqiptar ngaj Toskëria"[120].

Ndër emrat e pajtimtarëve që kanë porositur shumë kopje, i pari renditet Jovan Banka (1814), i ndodhur në Rumani, dhe i cili ka parablerë 15 libra. Mitkoja, pak më i ri se ai, e adhuronte për veprën e madhe bamirëse të tij[121], por edhe ky duket se e çmonte përpjekjen e Mitkos, gjithnjë në hullinë e lidhjeve të hershme të shqiptarëve me grekët.

Një tjetër emër është ai i misirlliut Georgios Averof, me origjinë nga Mecova, dhe i vendosur në Egjipt prej kohësh, ku ka bërë pasuri të madhe dhe kryeson për vite me radhë komunitetin grek të Aleksandrisë. Fakti që ky eksponent i shquar i grekëve të Aleksandrisë ka porositur 5 kopje të "Bletës" tregon së paku vëmendje ndaj ideve dhe ndaj veprës së Mitkos, por ndoshta edhe një solidaritet krahinor, ngaqë janë të dy epirotë. (Mitkoja e konsideronte Korçën si pjesë të Epirit).

Mes emrave të pajtimtarëve, hasen edhe persona që i përkasin së njëjtës familjeje apo vëllazërie, si dhe emra njerëzish që e kanë origjinën nga një vend i caktuar. Karakteristik është rasti i ishullit Mitilini, prej nga e kanë prejardhjen një numër jo i vogël abonentësh, pas gjase me rrënjë arvanite. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ishullin Limnos, prej nga kemi edhe pajtimin e vetëm për llogari jo të një personi, por të një shkolle, e konkretisht të shkollës së atij ishulli!

Po t'i marrim pajtimtarët në pikëpamje fetare, shumica dërrmuese e tyre janë të krishterë ortodoksë dhe vetëm nje numër i vogël, gjithë-gjithë 15, janë myslimanë, njerëz jo dosido, por të veshur me pushtet, me të cilët Mitkoja duket se kishte miqësi të hershme.

---

[118] Ευθυμίου Στ. Πράντη του εκ Κορυτσάς, *Αλβανικά Παράπονα*, εν Μινίᾳ της Άνω Αιγύπτου, εν Αθήναις, εκ του τυπογραφείου του «Μέλλοντος», 1880.

[119] Edhe sikur të mos ishte gjetur teksti i origjinalit të pamfletit, një njohës i veprës dhe i mendimit të Mitkos do të nuhaste te Brandi gjurmët e ideve dhe të stilit të tij. Kësaj teme, pra lidhjeve të ndërtekstorësisë tek autorët e Rilindjes kombëtare shqiptare, do t'ia vlente t'i kushtohej një studim i veçantë.

[120] Anno I, 15 Gennaio 1883, Num. 4, Pag. II-III. Autorësia e Mitkos vërtetohet nga dsh përkatës i gjetur në Fondin Mitko.

[121] Shih edhe kumtesën tonë *"Plakustathi" apo alter ego-ja e Th. Mitkos*, që do të lexohet në Konferencën II Ndërkombëtare të Studimeve Shqiptaro-Greke / Greko-Shqiptare (Tiranë, 27 mars 2015) dhe do të botohet në vëllimin përkatës.

"...gjer sot ky thesar i bukur ishte i humbur"

Pas kësaj analize të "auditorit" të "Bletës", lind vetiu pyetja sa dhe si ndikoi ajo vepër në zgjimin kombëtar të shqiptarëve, thënë ndryshe, nëse pati një ndikim real apo virtual?

Po të nisemi nga fakti jo fort i dëshmuar i djegies publike të kopjeve të "Bletës" në Athinë[122], si dhe nga çelja e faqes së parë të numrit të parë të "Fiamurit të Arbërit" me një referencë te Mitkoja dhe "Bleta" e tij[123], mund të gjykojmë se "Bëleta" e kishte patur një jehonë në qarqet e kohës, e cila duhet gjurmuar më tej[124]. Po kështu, sipas Gj. Pekmezit (1924), *"Mitkua [veç Meyer-it] ishte i njohur edhe me të tjerë albanologë të kohës së ti, të cilët ditnë t'a çmojn bukur mirë punën e diturinë të lartë të Mitkos ashtu, që sot me të drejtë emri i ti i pavdekur e zë vëndin e merituar ndër fjaluar enciklopedik të përbotshëm"*.[125]

Nga ana tjetër, tridhjetë vjet pas botimit të saj, më 1908, kur Dr Gjergj Pekmezi e has në një librari të Mynihut, "Bleta" është pak ose aspak e njohur dhe përbën një raritet bukinistik. Fjalët e Pekmezit në "Shpjegim" të "Bletës" së transkriptuar e të botuar prej tij më 1924, janë domethënëse:

Mbasi ky libër, mjerisht, nuk gjindet më as ndëpër bibliotekat më të mëdhaja t' Evropës, përveç kësaj, sikundër thamë, është shtypur me shkrojla gërqishte, dhe gërqisht e mjaft keq, gjer sot ky thesar i bukur ishte i humbur për popullin tonë, pandajza i pamasë ishte
gëzimi jem kur e gjeta këtë librë të rallë... .[126]

"Meyeri ... kish të më shtyposnjë të mbeturat e 'Bëletës'"[127]

Siç e kemi vënë re tashmë, vetë Mitkoja kish njoftuar[128], por edhe bashkëkohës të tij[129] na bëjnë të ditur se, pas botimit të "Bletës" së Aleksandrisë[130], puna për

[122] "Nel 1878, Eutimio Mitko di Korcia, penetrato della verità 'che un popolo non puo uscire della barbarie se non coltivando la lingua a se nativa', fondava in Alessandria d' Egitto *Bëljettën Shkipëtare*". *Fiamuri Arbërit*, Anno I, S. Demetrio Corone, 2 Gennaio 1883, Num. 1

[123] "In Atene vennero bruciati gli esemplari del 1. Volume della sua Rivista, fattosi inquieto il Governo ellenico del concorso che gli Albanesi, a sè sudditi, potessero mai dare al rilevamento della propria nazionalità; dopo quello della lingua." *Fiamuri Arbërit*, ibidem.

[124] Nuk dimë, fjala vjen, si reagoi shtypi i Aleksandrisë me rastin e botimit të veprës, dhe as kemi gjetur ndonjë shkrim të atyre viteve në shtypin e Athinës, ku të merret në analizë përmbajtja apo jehona e asaj vepre. Nga ana tjetër, "Bleta" ka qenë e njohur në qarqet shkencore, siç dëshmon edhe një letër e folkloristit grek N. Politis dërguar G. Meyer-it, më 7 mars 1882. T. Jochalas, Albanologische Nachrichten von N. Politis und T. Neroutsos aus dem Nachlass G. Meyers, *Μνημοσύνη* 4 (1972-1973), 210.

[125] Shih Shtojcën, Dok. IX.

[126] Shih Shtojcën, Dok. IX.

[127] Letër e Th. Mitkos për De Radën (7.10.1884). Th. Mitko, *Vepra*, Tiranë 1981, 668..

[128] Shih fjalinë e fundit të Njoftimit të 1874-s: *Por nëse vërej që ky libër imi ka ndopak vlerë, qoftë edhe të vogël, do të përpiqem ta plotësoj e ta bëj, me sa është e mundur, më të mirë në një botim të dytë*.

[129] Kupitori shkruan se Mitkoja *"Po përgatit edhe një Pjesë të Dytë"* (Αλβανικαί Μελέται, Athinë 1879, 58), ndërsa sipas Dora d' Istrias "Je crois qu' il se décidera difficilement à transformer son *Abeille* en recueil périodique", M. Sauku Bruci, *op. cit.* 259.

grumbullimin e lëndës folklorike nuk u ndërpre, por vazhdoi me synimin e botimit të një vëllimi tjetër më të plotë, çka nuk u kurorëzua për arsye të pengesave ekonomike. Kur riaktivizohet shtypshkronja e Bukureshtit më 1886[131], Mitkoja ka dashur të shtypë Fjalorin[132], por me sa duket atëhere kryesia e kolonisë së Bukureshtit, e ndikuar mbase edhe nga Stambolli, ka patur të tjera përparësi.

Për periudhën pas 1878-s, është me vlerë një dokument i gjetur prej nesh në Fondin Mitko ku autori ynë përshkruan me hollësi lëndën që ka dërguar për botim gjatë vitit 1885. Për këtë lëndë duhet menduar se është e re (krahasuar me botimin e 1878-s) e se do të përbënte pas gjase vëllimin II të "Bletës".

Dokumenti[133]

Όσα τετράδια της αλβαν. Συλλογής μου στέλλω κατά καιρούς προς τύπωσιν. Σελίδ.

15	Μύθους αισωπείους εις σελίδας …….	16
260	Παροιμίας και φράσεις εις σελ. 26 και	
11	Αινίγματα το όλον Σελ. 2, ομού	28
8	Ανέκδοτα, διάφοροι διηγήσεις ελλ. μόνον	8
	Όρκοι, χαιρετισμοί, κύρ. ονόματα κλπ.	14
	Ήθη, έθιμα αλβανικά …….	32
80	Τετράστιχα, ποίημα, Ποστόlj-Πρίφτιτ Πηρμέτασιτ	28
47	Όμοια Ε. Σταύρ. Βράντιτ Κορτςάριτ Σελ.	70
144	Δίστιχα Ποίημα Σπύρου Νοβοσέλια	16
8	Ποιήμ. Κουπιτώρη μετά του Ευαγγελίου Πάσχα	8
26-12	Όμ. Ε. Μ. Τετράστιχα, και Ποίημ. Γ. Σ. Μήτκου	11
	Ολίγα κωμικά Χασάν Ζύκω	4
	Έστειλα την 14 Φεβρουαρ. 1885	
	…….	
	Έστειλα την 13 Απριλίου [18]85	
11	Μύθους, ήτοι 8 Τοσκικούς και 3 γεγικούς μαζύ	
	με την ελλην. μετάφρασιν εις Σελ.	153
	…….	
	Έστειλα την 23 Ιουνίου 1885	
208	Άσματα διάφορα, τοσκικά, γεγικά καί τίνα	
	ελληναλβανικά. Έτι 3 ποιήματα του Χασάν Ζύκω Καμπέρη,	

[130] *"Tani e dhashë n' Aleksandri, edhe u nis pardje të shtyposet përsëdyti pak më e shkurtër, ndonëse më qëndron shumë shtrenjt shtypësi, e i lutem zotit të dalë e pëlqyer".* Letër e Mitkos për Kamardën, shih shën. 27.

[131] Shih L. Poradeci, Vepërimi kombëtar i shqiptarëve të Rumanisë me kryeqendër kolloninë e Bukureshtit, në: Lasgush Poradeci, *Vepra* 2, Onufri, Tiranë 1999, 191.

[132] Shih sa i shkruan Mitkoja Meyer-it më 10 nëntor 1886. J. Bulo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë 1998, 214

[133] Shih foton e dsh origjinal në Shtojcë, Dok. VIII.

το όλον εις Σελίδ. – (πραγματ. σελ. 164) 166

……

Την 24 Αυγούστ. [18]85

24 Παροιμίας, 2 μύθους, και 2 άσμτ. σελ. 2

Përkthimi shqip

Fletoret e Përmbledhjes sime shqiptare, që dërgoj kohë pas kohe për shtyposje. Nr.faq.

15 Fabula të Ezopit faqe ……. 16
260 Fjalë të urta dhe shprehje faqe 26 dhe
11 Gjëegjëza të gjitha 2 faq., së bashku 28
8 Anekdota, rrëfenja të ndryshme vetëm greqisht 8
Betime, përshëndetje, emra vetjakë etj. 14
Doke, zakone shqiptare ……. 32
80 Katërvargësha, poezi, [e] Postol-Priftit Përmetasit 28
47 Po kështu, [e] E. Stavr. Brandit Korçarit Faq. 70
144 Dyvargësha, poezi e Spiro Novoselës 16
8 Poezi të Kupitorit së bashku me Ungjillin e Pashkëve 8
26-12 Po kësht. Katërvargësha të E. M., dhe Poezi e G. S. Mitkos 11
Disa [poezi] komike të Hasan Zykos 4

I dërgova më 14 shkurt 1885[134]

……

Dërgova më 13 prill [18]85[135]

11 Përralla, d.m.th. 8 toske dhe 3 gege së bashku me përkthimin greqisht faq. 153

……

Dërgova më 23 qershor 1885[136]

208 Këngë të ndryshme, toske, gege, dhe disa greko-shqiptare.

[134] Shih letrën e Mitkos për Meyer-in, të 14 shkurtit 1885, shkruar në Beni-Suef: *"Sot po ju dërgoj të lidhur me shirit të 11 fletoret e mëposhtme për t'i shtypur"*. Q. Haxhihasani, *art.cit.* 152-153.

[135] Shih letrën e Mitkos për Meyer-in, të 14 prillit 1885, shkruar në Beni-Suef: *"Dje ju dërgova fletoret të lidhura në dy pako ku janë shkruar 11 përralla shqip me përkthim greqisht deri në 153 faqe. Gjithashtu po punoj t'ju përgatis këngët popullore etj."*. Q. Haxhihasani, *vep.cit.* 153. Po ashtu, në një letër të 22 marsit 1885 Mitkoja i shkruante Meyer-it se *"Kam tani gati 11 përralla, d.m.th. 8 të Toskërisë dhe 3 të Gegërisë, dhe po të marr përgjigjen tuaj të pritshme, do t'jua dërgoj. Dhe do të vazhdoj të përpunoj historinë e Dora d' Istries dhe këngët popullore etj."* Q. Haxhihasani, *vep.cit.* 153

[136] Shih letrën e Mitkos për Meyer-in, të 23 qershorit 1885: *"Me këtë [letër] po ju dërgoj në 164 faqe, 208 këngë popullore dhe tri vjersha të Hasan Zyko Kamberit"*. Q. Haxhihasani, *vep.cit.* 154.

Edhe 3 poezi të Hasan Zyko Kamberit,
të gjitha Faq. – (faqe të vërt. 164) 166
.....
Më 24 gusht [18]85[137]
24 Fjalë të urta, 2 fabula, dhe 2 këngë faq. 24

Siç u vu re tashmë, dokumenti na ndihmon për të kryqëzuar sa shkruhen aty me korrespondencën përkatëse të së njëjtës periudhë të Mitkos me Meyer-in, nga e cila po shënojmë fillimisht se Mitkoja i drejtohet atij më 3 korrik 1884, me shpresën dhe lutjen e ndihmës për gjetjen e mundësisë së botimit të *"pjesës tjetër të koleksionit tim"*[138], ndërsa më 30 korrik 1884, pasi ka marrë me sa duket premtimin e Meyer-it, i shkruan sa më poshtë, që po i citojmë *in extenso*:

E konsideroj nder të madh të merret përsipër nga ana juaj kujdesi për shtypjen falas të përmbledhjes sime shqipe. Unë nuk pretendoj asnjë përfitim … . Ky koleksion i imi përbëhet nga: 100 ose 120 këngë popullore toskërisht dhe gegërisht, 220-250 proverba dhe shprehje, 10-15 gjëegjëza, 15 fabula të Ezopit, 13-15 përralla, 5-6 vjersha personash të ndryshëm, doke e zakone, emra të përveçëm dhe emra familjarë, betime dhe disa anekdota, Dora d' Istria "Kombësia shqiptare, 1866, pak korrigjime të librit tim të pare përsa i takon leksikografisë. Të gjitha të përkthyera në greqisht.
Madhësia e librit do të ishte e barabartë ose më e madhe se Bëleta Shqypëtare. Përveç këngëve, pothuajse që të gjitha janë gati dhe kërkojnë vetëm një rishikim…[139]

Siç u pa më lart, Mitkoja fillon t'i dërgojë Meyer-it lëndë folklorike gjatë muajve shkurt-gusht 1885, por sporadikisht edhe më pas, siç duket nga letra e 20 majit 1886. Por entuziazmi i fillimit[140] zë e davaritet[141] duke ia lënë vendin pasigurisë dhe padurimit[142], skepticizmit[143] dhe humbjes së shpresave[144]. Përfundimisht, më 2

[137] Shih letrën e Mitkos për Meyer-in, të 24 gushtit 1885: *"Sot këtu po ju dërgoj dy përralla dhe dy këngë heroike, gjithsej 14 faqe"*. Q. Haxhihasani, *vep.cit.* 155.
[138] *"Kam frikë pra se mos vdes, mbasi tani jam plakur, para se të shikoj të botuar edhe përmbledhjen në fjalë … prandaj marr guximin të kërkoj ndihmën tuaj".* Q. Haxhihasani, *art.cit.* 149.
[139] Q. Haxhihasani, *vep.cit.* 150. Në letrën e 3 korrikut Mitkoja shpjegonte se, veç sëmundjes së syve, *"që kam patur qysh prej katër vjetësh"*, dhe *"para së gjithash për humbjet e mia tregtare, nuk jam në gjendje të bëj shpenzime për botimin e pjesës tjetër të koleksionit tim, të cilin e kam përkthyer të gjithë greqisht, me këngë popullore etj., proverba, gjëegjëza, emra të përveçëm dhe emra familjare, përralla dhe historinë e Dora d' Istries Kombësia shqiptare e vitit 1866"*. Q. Haxhihasani, *art.cit.* 149.
[140] *"Besoj se tashmë ka filluar shtypja. Pas pak kohe do t'ju dërgoj historinë e Dora d' Istries, që do të jetë fundi"*, i shkruan Meyer-it më 23 qershor 1885. Q. Haxhihasani, *art.cit.*154.
[141] *"Nga letra juaj e respektuar e datës 9 korrik [1885]… vura re se nuk keni siguruar ende botuesin e koleksionit tim. Megjithëqë nuk i keni humbur krejt shpresat, siç më shkruanit, do t'ju lutem, në rast të kundërt, të m'i ktheni dorëshkrimet e mia, pasi t'i keni studiuar, ose të mbani dhe kopje të tyre, që të më kujtoni. Për shkak se vuaj nga shikimi i syve, siç e dini, nuk kam fare kopje të tyre dhe për këtë të më falni"*. Q. Haxhihasani, *art.cit.* 155.
[142] *"Shpresoj se i keni marrë këngët dhe përrallat që ju kam dërguar kohët e fundit dhe në një farë mënyre jam në pritje të marr vesh mbi botimin e dorëshkrimeve të mia. Për këtë nuk do të jem*

mars 1887, Mitkoja i shkruan Meyer-it se *"mbasi është humbur çdo shpresë e shtypjes së dorëshkrimeve të mia, që ju i keni në dorë, ju lutem të keni mirësinë të m'i ktheni përsëri të gjitha siç janë dhe shpenzimet postare bien mbi mua"*[145].

Në vazhdim, siç del nga letra e Mitkos e datës 24 qershor 1887, Meyer-i ia ka kthyer dorëshkrimet më 2 maj[146], duke i dhënë fund një odiseje që zgjati më shumë se dy vjet dhe e cila e lëndoi shpirtërisht Mitkon, gjë që duket në fjalët prekëse që ky i shkruan De Radës: *"Meyeri nuk' më shtyposi as kënëkat e mija, as istorinë [e] Dora d' Istria[s]. Jam keq i mëruar, përse më mbetnë si të vdekura gjithë këto të shkruame"*[147]. Fjalë thellësisht prekëse, shpërthim i *"mallit të shtampësë"*, që tashmë po kthehej në ankth e në makth, për një vepër jete, e cila rrezikonte të mbështillej *"në savanin e harrimit"*[148].

Ribuitja e "Bletës"

Për risjelljen në dritë të plotë të "Bletës" a "Bletëve" të Mitkos, është i një rëndësie të dorës

së parë njoftimi se dorëshkrimet iu kthyen sërish autorit, çka e vendos në një bazë të re përpjekjen për "ribuitjen" e "Bletës" dhe ringjalljen së harruarish të shënd Efthimit!

Duhen kërkuar dhe duhen gjetur fletoret e Mitkos, gjë që është e mundur të kryhet me gjurmimin sistematik të gjithë lëndës arkivore[149], dhe mbi bazën e tyre duhet botuar "Bleta", ashtu siç e pati konceptuar ai vetë, pa shtuar e pa hequr asgjë.

---

mirënjohës vetëm unë, por i gjithë kombi shqiptar". Mitkoja për Meyer-in, 26 shkurt 1886, Q. Haxhihasani, *art.cit.* 156; *"… me keqardhje për mua kam kaq kohë që nuk kam marrë letër prej jush. Mos kam gabuar gjëkafshë ndaj jush që unë nuk e di? Ju lutem të keni mirësinë të më shkruani … kur do të përfundojë shtypja e dorëshkrimeve të mia … . Me padurim jam në pritje të marr në dorë ato pak kopje"*. Mitkoja për Meyer-in, 8 prill 1886. Q. Haxhihasani, *art.cit.* 157.

[143] *"… mbasi për mua është më e preferueshme të botohet në një nga gjuhët europiane, e duke qenë se ata të Bukureshtit, sikurse më kanë shkruar kohët e fundit, nuk kanë mundësi ta botojnë atë koleksion para se të përfundojnë shtypjen e librave bazë për shkollar shqipe – për këtë ju lutemi t'i mbani në dorë edhe ca kohë akoma dorëshkrimet e mia me shpresë se ndoshta këtë punë mund ta kryeni në Shoqërinë kulturore të Londrës"*. 8.8.1886, Q. Haxhihasani, *art.cit.* 158.

[144] *"Dëshira ime e fuqishme për ta parë të botuar këtë koleksion më prek thellë në zemër, bile mbasi shoh kohët e fundit edhe te Ju shenja të humbjes së shpresave për sa i përket arritjes së këtij qëllimi"*. 10.11.1886, Q. Haxhihasani, *art.cit.* 158.

[145] Letër e 2 marsit 1887. Q. Haxhihasani, *art.cit.* 159.

[146] *"I mora dorëshkrimet e mia së bashku me shënimin tuaj të datës 2 të muajit të kaluar"*. Q. Haxhihasani, *art.cit.* 159.

[147] Thimi Mitko, *Vepra*, Tiranë 1981, 696.

[148] A. Pasko, Pak fjalë mbi jetën dhe veprën e Mitrush Kutelit, në: M.Kuteli, *Prozë dhe vargje të zgjedhura*, 1, ShB mk, Tiranë 2001, 286.

[149] E kemi thënë edhe herë të tjera sa e rëndësishme është të ngrejmë mes nesh një rrjet të *"sinjalistikës arkivore"*, aq i nevojshëm dhe aq i rëndësishëm për t'ia dalë mbanë kësaj pune të vështirë. Kjo do të thotë se, kur dikush mëson a gjen diçka, duhet të kujdeset që t'ua bëjë të njohur edhe të tjerëve, duke u respektuar, kuptohet, normat përkatëse deontologjike.

Puna ngatërrohet pakëz -dhe kërkohet një shoshitje paraprake- me ekzistencën e Dorëshkrimit të Pragës, që vijon pas atyre që Mitkoja i pati dërguar Meyer-it e që janë botuar pas Çlirimit[150].

Përse themi ka rëndësi të marrim si pikënisje "Bletën" e Athinës? Jo vetëm se kjo është një zgjidhje logjike, por edhe sepse vërejmë që "Bleta" e Pekmezit ka lënë jashtë pjesë të "Bletës" së Aleksandrisë[151] dhe se kjo e fundit i ka hyrë në "borxh" "Bletës" së Athinës[152]. Në këtë kuptim, "Bleta" e 1875-s shërben si themel për botimin e "Bletëve" që pasuan. Sa për botimin e "Bletës" II, që Mitkoja nuk arriti ta realizonte, këtu gjërat janë pleksur e duhen shpleksur, d.m.th. duhet përcaktuar çfarë është botuar e çfarë ka mbetur pa u botuar gjer më sot, e mbi të gjitha, botimi integral paravendon të përfshihen të gjitha shënimet në greqisht të Mitkos, shoqëruar me përkthimet shqip të tyre. Në përgjithësi, duhet kryer një punë sistematike për zbardhjen e të gjitha dorëshkrimeve[153] dhe përcaktimin e motërzimeve të këngëve apo krijimeve të tjera të regjistruara, të cilat ndoshta nuk janë botuar ngaqë përbënin versione më pak të njohura a me përhapje të kufizuar.

Veç kësaj, e një rëndësie parësore është edhe nxjerrja në dritë e lëndës ndihmëse, d.m.th. e korrespondencës (të përkthyer dhe në gjuhët e origjinalit), e shënimeve të Mitkos, apo edhe e jehonës që pati "Bleta" kur qarkulloi për herë të parë e më pas.

Nëse do të donim ta përfshinim botimin e ardhshëm të "Bletës" në kuadër të një projekti të botimit integral të trashëgimisë së vyer të Atdhetarit e Ndriçimtarit të shquar, misirlliut pej Korçe, ajo do të renditej krahas veprës së tij leksikografike, shoqëruar medoemos nga përkthimet në prozë të tij, *"Filisë shqypëtare nga kënkat e llauzit"* dhe *"Plakustathit"*, ku fjalët e Fjalëtoreve të Mitkos marrin jetë e na sjellin flladin e shqipes së qëmotshme. Krahas tyre, mbeten të nxirren në dritë një numër shkrimesh dhe vepërzash[154], artikujt e tij të hershëm në revistën *"Pandora"* e më pas te *"Fiamuri Arbërit"*, copa esesh a mendimesh të hedhura nëpër letra, gjithçka që mund të jetë e vlefshme për studiuesin e lexuesin, sot e mot.

Realizimi i këtij projekti kërkon të vazhdohen gjurmimet në arkivat e Kajros, Aleksandrisë, Athinës, Bukureshtit e gjetkë. Në të njëjtën kohë, duhet mbledhur e rivlerësuar lënda e hapërdarë andej-këtej dhe, si në rastin e pluhurit kozmik, prej kondensimit, që do të thotë prej sistemimit dhe studimit të imtë të saj, do të

[150] Shih letërkëmbimin e Mitkos me Jarnikun (Th. Mitko, Vepra 1981, 710-713) si dhe Dorëshkrimin e Pragës, *Mbledhës të hershëm të Folklorit Shqiptar* (1635-1912) II, Instituti i Folklorit, Tiranë 1961, 188-270.

[151] Shih Shtojcën, "Shënim" i Gj. Pekmezit te "Bleta" e Vjenës.

[152] *"… u nis pardje të shtyposet përsëdyti pak më e shkurtër",* i shkruan Mitkoja Kamardës në shkurt 1878. Shih shën. 27.

[153] Është për t'u përmendur këtu rasti i poezive të H. Z. Kamberit, që u botuan vitet e fundit mbi bazën e lëndës së vjelë nga Fondi i Mitkos, etj. Shih B. Vila, "Një dorëshkrim i hershëm i Thimi Mitkos", *Studime Filologjike*, 2001, 3-4, 145-162, si dhe "Tri tekste poetike të Hasan Zyko Kamberit (Nga arkivi i Th. Mitkos)", në J. Bulo, *Shpirti i fjalës*, Botimet Toena, Tiranë 2014, 219-251.

[154] Shih shën. 54, 56, 57 dhe 58.

konturohet më i qartë portreti i Thimi Mitkos, ashtu si përvijohet mali i Moravës sa herë davaritet mjegulla që i rri mbi krye.

Lumja ti, o Korç', o lule, ... që pate të tillë bij!

ELONA (BIBA) ÇEÇE (KORÇË)

BOTIMI I VEPRËS LEKSIKOGRAFIKE TË THIMI MITKOS NGA PROFESOR DHORI Q. QIRIAZI -NJË AKT SHKENCOR DHE ATDHETAR

Në vitin 2014 leksikografia shqipe u pasurua me një vepër të rëndësishme "Thimi Mitko Fjalëtore Shqip-Gërqisht, Gërqisht–Shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike", që dëshmon një punë të pakursyer, të kryer me seriozitet, dashuri e krenari nga profesor Dhori Qiriazi.

Struktura e veprës është realizuar në mënyrë të tillë, që nuk lidhet vetëm më aspektin kronologjik, por edhe me rëndësinë e peshën e secilës prej këtyre dorëshkrimeve të Mitkos. "Fjalëtore Shqip-Gërqisht…", "Fjalëtore Gërqisht-Shqip…", "Pasqyrë e fjalëve shqip të fjalëtores Gërqisht –Shqip të Thimi Mitkos", "Fjalori i fjalëve të huaja të "Bletës shqiptare" (Ribotim origjinal i"Bletës shqiptare" dhe i variantit të transkriptuar e të përkthyer të tij), si dhe "Plotësime të mëvonshme të Thimi Mitkos në fjalorin e "Bletës shqiptare" (botim i dorëshkrimit autograf)" paraprihen nga një studim i profesorit, ku nëpërmjet "Thimi Mitkoja në vetë të parë" na sjell të dhëna për jetën e Thimi Mitkos, të cilat janë të domosdoshme për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë veprën leksikografike të tij.

Në vlerësimin që i bën autori veprës leksikografike të Mitkos, në çështjen "Nga fjalët te fjalëtoret" ai ndalet në të dhëna të tilla, si koha kur u hartua Fjalëtorja, burimet nga të cilat Mitkoja e voli lëndën leksikore, natyra dhe teknika leksikografike e Fjalëtores për të cilat profesor Qiriazi thotë se "E vështruar në këtë prizëm, kjo vepër inkuadrohet plotësisht në mënyrën si i koncepton Mitkoja marrëdhëniet e shqipes me greqishten" dhe konkludon me "Hapat e hershëm të një shqipeje të përbashkët".[155]

Vepra është pajisur edhe me një CD me fotot e fletëve të dorëshkrimit autograf të Thimi Mitkos, gjë që vlerësohet prej nesh si një gjetje e hollë e autorit me qëllim për të vizualizuar materialin.

Duke nxjerrë në dritë kontributin e Thimi Mitkos në fushën e leksikografisë, profesor Dhori Qiriazi bën të mundur vlerësimin e plotë të figurës së tij.

Duke i bërë një rivlerësim Fjalorit të Mitkos, me bindje, mund të themi, se ai sot na vjen si një dëshmi e faktit se hartimi i tij nuk ishte thjesht një domosdoshmëri për një grup të caktuar shoqëror me qëllim zhvillimin normal të marrëdhënieve ekonomike, kulturore në kuadër të ruajtjes së një fqinjësie të mirë. Përdorimi i tij që do nxiste shkrimin e shqipes, si dhe përkthimet apo edhe mësimin e gjuhës greke (si gjuhë e huaj) dhe pashmangshmërisht do të çonte në ngulitjen e variantit letrar.

[155] Qirjazi Q. Dhori, "*Thimi Mitko Fjalëtore Shqip-Gërqisht, Gërqisht–Shqip &Ndihmesa të tjera leksikografike*", Tiranë &Shtypshkronja KOTTI ,Korçë, 2014

Po, në qoftë se Thimi Mitkoja, duke përfshirë në fjalor lëndën gjuhësore të të dy ligjërimeve, si atij libror ashtu edhe atij bisedor, si dhe lëndën e përzgjedhur nga vise të ndryshme të Shqipërisë, sjell një fjalor që synonte mbarë bashkësisë gjuhësore shqiptare, profesor Qiriazi sjell një vepër shkencore, e cila me materialin leksiko-semantik që mbart, me të dhënat për drejtshkrimin, drejtshqiptimin, etimologjinë do të shërbejë për të zbardhur më mirë dinamikën e zhvillimit të sistemit të shqipes.

Mendojmë se rëndësia e kësaj vepre nga këndvështrimin shkencor qëndron në këto fakte:

Së pari, nga ballafaqimi i shqipes me greqishten duket qartë mungesa e huazimeve të ndërsjellta, gjë që na çon te origjinaliteti ynë gjuhësor kombëtar. Në fjalor mund të evidentohen përpjekjet për pastërtinë e fjalorit shqip (huazimet turke apo ato sllave zëvendësohen me barasvlerëset e tyre shqipe), duke shprehur kështu thelbin e realitetit gjuhësor të kohës.

Së dyti, krahas fjalëve dhe kuptimeve të shtresës së përgjithshme leksikore, zënë vend të konsiderueshëm, e mund të diferencohen dialektalizmat e krahinorizmat, të cilat shpesh i janë nënshtruar përpjekjeve të vetëdijshme të Mitkos për t'i përqasur me normën leksikore të variantit letrar të toskërishtes.

Rëndësia e tyre sot është e madhe. Zhvillimi shoqëror e kulturor e ka bërë që krijimi i krahinorizmave apo dialektalizmave të reja të jetë shumë i vështirë, prandaj ato duhet të vlerësohen nga studiuesit dhe lëvruesit e shqipes:

a. si një pasuri për stilin e letërsisë, në të cilin mund të përzgjidhen si mjete stilistike.

b. këto fjalë mund të përfshihen në fjalorët shpjegues edhe sipas vlerave pasuruese që kanë për standardin. Emërtime të caktuara sendesh, dukurish, veprime specifike krahinore mund të shërbejnë në funksion informues. P.sh. "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" (1980) dhe ""Fjalori i gjuhës shqipe"(2006) kanë dhënë edhe kuptime dialektore a krahinore, herë me shënimin "krahin" e herë të çliruar nga ky shënim kufizues, kur kuptimi ka prirje të përgjithësohet. [156]

c. Gjithashtu, të dhënat leksiko-semantike mund të shfrytëzohen nga leksikografët edhe në hartimin e një fjalori krahinor, kur dihet që ky tip fjalori nuk është përfaqësuar sa duhet dhe që botimi i tyre ka një rëndësi të madhe pasi janë një burim për pasurimin e gjuhës standarde shqipe. Në këtë kuadër po citojmë nga akademiku Jani Thomai: "Detyrë e ngutshme e gjuhësisë shqiptare mbetet hulumtimi i pasurisë leksikore frazeologjike dhe semantike në të gjitha të folmet e shqipes dhe hartimi i fjalorëve krahinorë për ta shpëtuar këtë pasuri gjuhësore të pazëvendësueshme e të vlefshme për shqipen në përgjithësi, dhe për standardin në veçanti, si dhe për shkencën gjuhësore shqiptare." "Hartimi i fjalorëve krahinorë në

[156] Jani Thomai, "Ligjërata Pasuniversitare", (variant i pabotuar, dorëzuar për miratim pranë Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Universiteti"Fan Noli"), Korçë, 2015, f.120

një shkallë më të gjerë për të folmet për të cilat nuk ka ende asnjë fjalor të tillë, bëhet sot një detyrë e ngutshme përballë lëvizjeve të shpejta në leksikun e shqipes dhe largimit nga jeta e brezave më të vjetër njerëzorë. Duke ditur që koncepti i normës në leksik është shumë i ndryshëm nga ai i nënsistemeve të tjera (norma leksikore është e hapur) mund të tërhiqen jo vetëm kuptimet e përgjithshme të fjalëve, por edhe kuptimet e prejardhura, apo të figurshme, kështu në një sistem leksikografik këta fjalorë do të nxjerrin në dritë ç'ka mbetur nga pasuria e madhe leksiko-frazeologjike e semantike e ligjërimeve popullore, si dhe do ta hedhin në qarkullim këtë pasuri"[157]

d. Fjalori i Mitkos ku është zbatuar kriteri etimologjik, duke hedhur dritë mbi zhvillimet semantike, fjalëformuese ndihmon në studimin e evolucionit historik fonematik.

Veçanërisht variantet fjalëformuese dialektore mund të shërbejnë për shpjegime etimologjike, gjë që ka ndikim të padiskutueshëm edhe në evidentimin e pasurimit të leksikut të shqipes në planin diakronik**.** "Pasurimi i leksikut mund të ndiqet hap më hap në rradhë të parë përmes fjalorëve", shkruan profesor Çabej në "Studime etimologjike në fushë të shqipes".[158]

Së fundi, do të theksonim se botimi i profesor Qiriazit pasuron historinë e shkrimit të shqipes

Siç dihet nga studimet,[159] ai, në shkrimet e botuara dhe në dorëshkrimet, ka përdorur alfabetin latin në pesë variante, alfabetin grek, si dhe përzierje të të dy këtyre alfabeteve, por pavarësisht përzgjedhjeve të tij të kushtëzuara nga faktorët historikë, rëndësi kishte shkrimi dhe lëvrimi i shqipes. "Edhe shqiptarët do të mundin të ndriten dhe të humbasin ngjyrën e padijes së tyre vetëm duke studiuar gjuhën e tyre amtare. Gjuha amtare është ushqimi i përbashkët që i jep gjallëri popullit."[160] ky ishte motivi i veprës së Mitkos.

Duke e nxjerrë në dritë pasurinë e Mitkos e *"duke e ngjallur së harruarish",* siç shkruan për lexuesin, profesor Qiriazi i bashkohet vargut të gjatë të studiuesve shqiptarë, që duke kërkuar e zbuluar rrugën e shkrimit të shqipes kanë vërtetuar qëndresën e saj me gjithë trysninë e gjuhëve të tjera, si dhe rezistencën për ruajtjen e kombit shqiptar.

Prej rrugëtimit me Mitkon ai arrin madje, që në frymën e politikës bashkëkohore të paqes e bashkëpunimit në kuadër evropian, të sjellë edhe mesazhin për afrim e miqësi mes "shqiptarëve e
gërqishtarëve".[161]

---

[157] Jani Thomai , "Leksikografia shqipe- trashëgimi dhe perspektivë" në "Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f22

[158]Eqrem Çabej në "Studime etimologjikenë fushë të shqipes"[158] Tiranë, 1972, II, f.62

[159] Shih:Tomor Osmani, Udha e shkronjave shqipe, Tiranë, 2008 , f.314-317

[160] Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë, 2008 , f.306.

[161] Dhori Qirjazi, "*Thimi Mitko Fjalëtore Shqip-Gërqisht, Gërqisht–Shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike*", Tiranë & Shtypshkronja KOTTI, Korçë, 2014, f.9.

Prej rrugëtimit me Mitkon ai shkruan se mësoi shumë dhe u fisnikërua dhe e fton lexuesin që ta vlerësojë *nëse ia doli mbanë* (jo thjesht një klishe kjo).
Sot, në këtë ditë të shënuar në kujtim të Thimi Mitkos në 195- vjetorin e lindjes së tij, besojmë se i gjithë ky auditor i nderuar, të ftuar, autoritete, studiues, gjuhëtarë e pedagogë nga e gjithë hapësira shqipfolëse e më gjerë, e siguron profesor Qiriazin se *ia ka dalë mbanë* dhe e falënderon nga zemra për këtë ndihmesë të vyer.

ABDULLA BALLHYSA (ELBASAN)
ELONA SOLLAKU (ELBASAN)
DHURATA HANOLI (ELBASAN)

NGJYRIMET EMOCIONUESE "TË PROFILIZUARA" TË EMËRTIMEVE PREJ FLORËS DHE FAUNËS TE LIRIKAT E " BLETËS SHQIPTARE"

Që fjalët me ngjyrim emocionues kanë shprehësi të lartë është një gjë e njohur dhe e studiuar, mes së tjerash, edhe në leksikologji.

Kështu, kur trajton përdorimet e figurshme të fjalës në gjuhën shqipe, Prof. J. Thomaj thotë shprehimisht : - *Fjalët me ngjyrim emocionues...i përdorim për t'i dhënë ligjërimit më shumë forcë me qëllim që ta bëjmë më shumë bindës..."*[162]

Shprehja e figurshme origjinale është një eksperiment, në të cilin përfshihen sendet e dukuritë, frymorët e njerëzit me çfarëdo anë të tyre dhe marrin veti, trajta e ngjyra, lëvizje tinguj, ndjenja aftësi për të folur … duke na dhënë një njohje e përjetim më të thellë se zakonisht"[163]

Që emërtimet nga jeta blegtorale, përfshirë këtu edhe fito- zoonimet zënë vend parësor për nga përdorimi emocionues (në rastin tonë, në lirikën popullore), është gjithashtu e njohur në studimet gjuhësore dhe stilistike tonat dhe të huajat.

Me qenë se kemi si lëndë të parë të trajtesës këngët e dashurisë dhe të dasmës të mbledhura me mund e durim nga Th.Mitkoja, për të cilin jemi mbledhur sot, do të doja të citoja edhe studiuesin Prof.Q. Haxhihasani i cili i quan ato " *Si produkt kryesisht i masave fshatare dhe fryt i përvojës e i mendimit të tyre ideoartistik, figurat e lirikës sonë janë ushqyer nga ambienti dhe veprimtaria e këtyre masave, sjellin ngjyrat karakteristike të jetës së tyre*" Dhe më tej - *Tradita blegtorale... e ka lidhur atë me natyrën, ... me bimësinë, faunën, dukuritë atmosferike, të cilat ai, si blegtor, ka qenë detyruar t'i kushtojë vëmendje të vazhdueshme*"[164]

Me gjithë sa cituam më sipër, përsëri na rezulton se është hulumtuar e përmendur pak ose aspak, fakti që bimët dhe kafshët, emrat e tyre janë gati –gati " të profilizuara" në llojin e ngjyrimit që ato shprehin.

Mu për këtë shkak, në këtë kumtesë do të ndalemi e të trajtojmë, aq sa e lejon vendi, pikërisht " profilizimin" e fitonimeve dhe zoonimeve tek "Bleta".

Kështu, me emrat bimëve populli ynë, gjithnjë lavdëron, e përgjithësisht mban qëndrim pozitiv; ndërsa me perimet, ai shpreh qëndrim me konotacion pejorativ, keqësues dhe, kryesisht, me emërtimet e tyre shahet.

E njëjta gjë vërehet lehtësisht edhe tek përdorimet e emrave të kafshëve të egra Me kafshët e egra e kryesisht shpendët, lavdërohet, konotacioni pozitiv; ndërsa me

[162] J.Thomaj Leksikologjia e gjuhës shqipe, SHBLU, Tiranë 1999, f.112
[163] Xh.Lloshi"stilistika dhe pragmatika", Toena 1999, f.137
[164] Q. Haxhihasani "Disa të dhëna rreth figuracionit të lirikës popullore shqiptare", SF Nr.2 1972, 17

emrat e kafshëve të buta, shtëpiake, populli shan, mallkon; mban qëndrim mohues, negativ.

Nga vëzhgimi dhe klasifikimi i përdorimeve të vjela shterueshëm tek këngët e dashurisë e të dasmës tek "Bleta" na rezulton se ky konstatim i përgjithshëm vërtetohet tërësisht.

Le të ndjekim faktet e përdorimeve sipas shpeshtësisë:

- Fitonime, 21 emra pemësh e frutash, 11 emra lulesh dhe pak, fare pak (vetëm 2) emra perimesh;
- Zoonime: 9 emra kafshësh të egra, vetëm 2 emra kafshësh shtëpiake dhe 12 shpendësh të egra dhe 2 shtëpiake.

Cilat janë më të përdorurat? Ja renditja sipas shpeshtësisë:

Fitonimet

A. Lulet : Lule (si hiponim), Borzilok, Burbuqe, Jargavan, Karafil-e, Lule, Manushaqe, Trëndafil- e; Trëndelinë, Zambak, Zymbyl

B. **Pemët**: Mollë, Dardhë, Ftua, biskonjë (bisk), Kanellë, Kumbull, Karpuz, Li-ri Nërnxë, Pënjë

(panjë), Pjeshkë, Portokalle, Qershi, Rrush, Vllastar, Zerdeli, Xhinxhife, Ulli

Zoonimet

A. Kafshë: Qëngj-e, Bejkë, Shelege, Sorkadhe, Kunadhe, Nëpërkë, Gjarpër, Buall,

B. **Shpendë** Guguce-ja, Pëllumb, Bilbil, Fëllënzë, Gjeraqinë, Flutur, Korb, Patë, Sorrë, Zog.[165]

Në pamje të parë, shembujt e dhënë duket sikur e përligjin jo dhe aq mjaftueshëm pohimin e "profilizimit" konotativ të fitonimeve dhe zoonimeve. Kjo nga që në krijimet lirike të "Bletës " nuk gjenden raste të përdorimit të emrave të perimeve (krahasuar me bimët në përgjithësi) apo të kafshëve shtëpiake (me kafshët në përgjithësi) të përdorura me këtë "profil" a funksion.

E vërtetë, por duhet theksuar se në këtë material leksikor poetik, mungojnë krejtësisht përdorimet me konotacion negativ. Për mendimin tonë, kjo shpjegohet me vetë tematikën e poezive popullore të shqyrtuara. Afër mendsh që tek këngët e dashurisë, tek këngët e dasmës, nuk mund të ketë dhe aq vend për sharje dhe krahasime me konotacion pejorativ, pasi në to flitet për dashurinë, për vashën e trimin, për nusen e dhëndrin dhe për to flitet e këndohet, mbahet krejtësisht qëndrim pozitiv. Kaq e vërtetë është kjo sa për studiuesin Gj. Misha vasha si figurë e imagjinuar nuk ka cilësi a të meta fizike, ato nuk ekzistojnë.[166]

Dikotomia këtu del dhe shprehet: Konotacion +/ Konotacion 0 (nga njëra anë është konotacioni +, nga na tjetër ndodhet konotacioni 0, ose, thënë ndryshe, konotacioni i pashprehur)

[165] Emrat e bimëve a kafshëve janë shënuar siç janë në origjinal tek "Bleta"

[166] Gj. Misha "Çështje të folklorit shqiptar" , 4/1984, f. 202

Këtu, besoj, na vjen në ndihmë përsëri, shpjegimi që bën Q. Haxhihasani[167] i cili shkruan shprehimisht: *" Ndryshe nga sa ndodh në folklorin e ndonjë populli tjetër, termat e krahasimit nga ambienti bujqësor në lirikën tonë popullore janë të kufizuara."* Pra, sipas nesh, jo se mungon profilizimi i emërtimit, por se ai është më i pakët në këtë lloj krijimtarie. Në të kundërt, në thjeshtligjërim (siç del në Fjalor)[i] rastet jo vetëm nuk mungojnë, por janë edhe të shumta. Lidhur me këtë çështje do të flasim më gjerë pak më poshtë, kur të krahasojmë shembujt me përdorime të marra nga fjalori.

Qëndrimin tonë për një përdorim konotativ të një grupi emrash fitonime dhe zoonime e mbështesim edhe në shpjegimet që jepen në fjalorët tanë shpjegues. Le t'i krahasojmë rastet nga " Bleta" dhe nga "Fjalori"[168]:

1. Fitonime

a. Lulet

Lule (si hiponim) "Bleta" = 13 raste 1. Hajde, moj **lule**, me neve, Haj të vemi ndë fshat tonë. Fshati jyn' është i nxehëtë, Arrihenë rrushtë shpejtë: Arrihenë rrushtë e bardhë,

2. Psherëtimnë ta dëgjova, **o moj lule** /Kur të qortonte jot ëmë, **o moj lule** .....; 3. ... ti moj hëna , që ke rarë, s'më pe **lulen** ku ka shtruarë? -Nd'atë qoshk me dy tri shkallë, është shtriturë si ngjalë. U rrëzofsh, o more, qoshk! Të bjerë **luleja** përposh, të thyejë këmbën e a gjunë, heqim t'i bënesha unë. 4. Shokë, seç kam një motëmot, **me lulen** s'kam kuvenduar, asaman, se më s'duron dot, plaga ime s'ka të shuar. 5 Të lulëzonjësh si dardhë 6. Ndëpër bashtë të shkova, mollë t'ëmbla mblodha, ndë sepete t'i kyca, dhe kafenë ta poqa. Kafen'e poqa gjer u derdh, e prita **lulen** e s'më erth. (përse nuk mblodhi bamje?) **7. Po lulojshin** pjeshkatë, po na vij të zeshkatë. **Po lulojshin** dardhatë, po na vijn'të bardhatë. **Po lulojshin** kumbullat, po na vijn' të rrumbullat. **Po lulojshin** mollatë, po na vijn' meshollatë.

Fjalori:, fig. Më i miri, më trimi a më i bukuri i të gjithëve; pjesa më e mirë a më e zgjedhur e diçkaje, ajka; koha më e bukur, pjesa më e mirë e një periudhe. *Lulja e fshatit. Lulja e vajzave të krahinës. Lulja e nusërisë më e mira ndërmjet nuseve. Lulja e fisit.*

Duke analizuar hiponimin "lule" do ta ndeshim atë të përdorur kryesisht për ta thirrur (quajtur) femrën, herë për ta krahasuar e në disa raste për ta bashkëshoqëruar cilësisht (epitet)…

Në 5 vargje (2), pesë herë këndohet, *o moj lule.* Na duket se përveç detyrës së rimimit, plotësimit të

rimës në tërësi të tekstit (këngës) përsëritja përdoret edhe si mjet përforcues i asaj që këngëtari do që të theksojë më shumë. Ai edhe mund ta ndryshonte vargun duke përdorur një fjalë tjetër, ta zëmë, o moj zoge, o moj hën'e etj. Por jo, atij i duhet ta nxjerrë dufin duke qëndruar e përsëritur, deri sa të mbarojë kënga, epitetin lule.

[167] Q. Haxhihasani, vep cit.
[168] Fjalori elektronik 2006

Në një rast tjetër poeti uron jo lulen, por një pemë t'i ndodhë diçka e mirë dhe mjaft e bukur : lulëzimi i nuses që nuk është ende dardhë, por pritet të lulëzojë si ajo. Animizimi ndodh pa asnjë vështirësi dhe urimi realizohet domosdo, se kështu ia do zemra poetit, a poetes.

Duke parë dhe shpjegimin që jepet në fjalor na lind e drejta të pohojmë se përdorimi ka kaluar e është kthyer gati- gati në stilemë.[169] Derisa ka hyrë në fjalor, pavarësisht si kuptim figurativ, ndryshe nga përdorimi i papritur, individual në një poezi, ky përdorim, mendojmë, se po vjen e po leksikalizohet dita-ditës.

Trëndafil (Bleta) 1. Na mbiu **trëndafil mbë derë, se zymbyl, se trëndaffil**.Vallë, kush do t'i marrë erë? Se zymbyl se trëndafil. 2. Prilli e maj shkuan e vanë, **trëndafili** u mbarua. Kush s'ka parë **jargavanë,** të shohë faqet e tua. 3. Nem ujë, se plasa, moj cullufezezë - S'kam me se të t'ap, o trëndafil me vesë.
Fjalori: 2. përd. Në ngjyrë të çelur ndërmjet së kuqes a së bardhës. Fustan trëndafil. U bë trëndafil në fytyrë. 3. fig. përk., poet. Djalë a vajzë që ka bukuri e njomësi, djalë a vajzë në lulëzim, lule.

Trëndelinë (Bleta) = As këndojëmë një cikë, të nxjerrimë sillojitë, Kush ma vu mua qederë? Një *karafil'e kanellë, trëndafil* për të të marr erë... *Trëndafil e trëndelinë*, gjithë nga Korfuzi vinë.
Fjalori: 2. fig. përk. Vajzë e bukur dhe e këndshme. * Është bërë trëndelinë është dobësuar shumë, mezi mbahet në këmbë. Është trëndelinë (nga mendja) mospërf. është fare i lehtë nga mendja; e ka kokën bosh. Kishte mbetur trëndelinë kishte mbetur pa asnjë lek në xhep; s'kishte asgjë në shtëpi, ishte shkundur fare.

Dy fakte interesante : a. Trëndafil e zymbyl, trëndafil e trëndelinë përdoren afër e afër dhe si të njëjta, me të njëjtën vlerë, gati si sinonime kontekstuale. Pavarësisht nga hamendimi për arsyen e përdorimit, si variacion apo si vlefshmëri semantike, kryesorja për rastin tonë është se në çdo rast ato mbartin konotacion pozitiv, vlerësim, lavdërim etj.

b. Një kundërshti duket se del me fjalën (epitetin) trëndelinë, e cila në krijimet popullore

përdoret me konotacion pozitiv, ndërsa, në të kundërt, në fjalor përdoret edhe, në mos për sharje, por me konotacion përbuzës, zhvlerësues, mospërfillës.
Na duket më e drejtë që për këtë rast të mbetemi në arsyetimin e bërë në fillim të këtij punimi, i cili përdorimin e disa fitonimeve a zoonimeve në poezinë popullore e lidh me llojin e krijimeve si të tilla, në rastin tonë, me këngët e dashurisë apo të dasmës.
Le të vazhdojmë më tej.

[169] " Figura përftohet në një stilemë, që ngërthen një proces të brendshëm, një përftesë. Fjalët zhvendosen nga kuptimet e zakonshme bashkë me lidhjet dhe marrin një kuptim tjetër brenda lidhjes së re. Kur kjo zhvendosje përsëritet, ngulitet, përgjithësohet, atëherë kthehet në dukuri leksikore." Shih për më tepër Zh. Lloshi, vep cit.

Jargavan(Bleta) = 1. Seç' më rënke erë balli, si ndë verë **jargavani,** Seç të rënekë erë gusha, si ndë verë kur çel fusha, Seç të rënëke erë gjiri, si ndë verë trëndafili. Moj e vogëla xinxife mvish jelekun kadife...2. Cup' e bij 'e nënësë, Shkel mbi thonjt'e këmbësë, si zogu fëllënxësë. Djersa jot'e ballitë, er'e **jargavanitë**, djersa jot' e faqesë, er'e manushaesq. 3. Prilli e maj shkuan e vanë, **trëndafili** u mbarua. Kush s'ka parë **jargavanë,** të shohë faqet e tua. 3.

Fjalori: Shkurre a dru i vogël, me lule në ngjyrë vjollce të çelët ose të bardha dhe me erë të mirë, që mbillet në kopshte, në oborre etj. për zbukurim; lulja e kësaj bime; ngjyra vjollcë e kësaj luleje. Jargavan i bardhë. *Ngjyrë (erë) jargavani*. Kopsht me jargavanë.

Jargavani në poezi përdoret vetëm për një cilësi të tij, për aromën e veçantë që ka balli / faqet e vashës. Nga ana tjetër në fjalor përdorur me konotacion pozitiv gjithashtu, cilësohet jo vetëm aroma por edhe ngjyra (të paktën siç del nga shembujt). Në këto përdorime nuk ka asnjë mëdyshje: jargavani me cilësitë e veta është lavdërues, vlerësues i dëshiruar.

Konxhe (Bleta) = Moj syzezë, moj **sykonxhë**, bjerë tatëpjetë, poshtë... Moj qëngje

ballëxhufetë, të gënjeu a deshe vetë? Më gënjeu faqerrogozi, ra mbi cicat e m'i sosi.

Fjalori: nuk gjendet ndonjë përdorim i figurshëm me këtë emër.

Karafil (Bleta) As këndojëmë një cikë, të nxjerrimë sillojitë, Kush ma vu mua qederë? Një *karafil'e kanellë, trëndafil* për të të marr erë... *Trëndafil e trëndelinë*, gjithë nga Korfuzi vinë.

Fjalori: Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të dobët, me nyja e të degëzuar, me gjethe të holla e të gjata, që bën lule të bukura, me ngjyra të ndryshme e me erë të këndshme. Karafil i kuq (i bardhë, me pikla). Erë karafili.

3. fig. keg. Njeri mendjelehtë.

4. Përd. mb. sipas kuptimit 3 të emrit. *Është karafil nga mendja*.

Interesante, në fjalor dalin të dyja përdorimet e figurshme të fitonimit karafil. Me një tipar kuptimor të tij (aromën, njëlloj si tek jargavani) krahasohet, lavdërohet, ndërsa në kuptimin e figurshëm dhe në thjeshtligjërim me karafil emërtohet njeriu mendjelehtë.

Lind edhe këtu e njëjta pyetje: përse vërehet (sipas mendimit tonë) një shmangie e tillë? Përgjigjen e kemi dhënë , besojmë, më sipër, kur përmendëm fitonimin trëndelinë.

Po, ç'kanë të përbashkët trëndafili e trëndelina që dalin edhe me këtë lloj ngjyrimi (pejorativ) në kuptimin e figurshëm dhe në thjeshtligjërim? Hamendësimet mund të jenë të shumta. P.sh. trëndelina është nga aromat më të përdorshme prej fshatarëve, më e lehta për t'u gjendur, pa asnjë shpenzim. Nga ana tjetër, karafili qëndron "kryelartë" ndër bimët e tjera, është mospërfillës për motin e mjedisin përreth. *Rri si karafil* = rri si një njeri mospërfillës, kryelartë, ose bosh. Kalliri bosh e mban kryet përpjetë, thotë populli. Pra që të dyja lulet (trëndëlinën dhe karafilin) i bashkon një tipar, **lehtësia**; lehtësia për t'u

gjetur/mbledhur dhe, lehtësia për t'u dukur e dalë mbi lulet e tjera. Përmendja afër e afër e fitonimeve trëndafil e trëndelinë mund të ketë edhe arsye poetike. Ato janë paronime dhe krijojnë të njëjtin efekt akustik të cilin poeti popullor e përdor me finesë (si gjetje poetike individuale) në të njëjtin varg dhe pranë e pranë, pavarësisht se nga prejardhja kuptimore etimologjike ato nuk kanë asgjë të përbashkët. Paronimia gjen përdorim në gjuhë ose nga mosdija e ngatërrimi i emërtimit (krahaso: e rëndë –e rëndomtë, mëshiroj- mishëroj, ndjej –ndiej etj) ose me qëllim, siç besojmë se ndodh në rastin poetik.

Manushaqe (Bleta) = 3 raste Ç'faj të pata bënë, moj cullufezezë, që më lojte mënnë? – Fajnë ta ka balli, moj cullufezëze, q'e ke shesh mejdani. Fajnë ta ka syri, moj cullufezezë, **syri si ulliri**. Fajnë ta ka faqeja, moj...., **erëmanushaqeja.** Fajnë ta ka gusha moj... , plot lule si fusha.3. Cup' e bij 'e nënësë, shkel mbi thonjt'e këmbësë, si zogu fëllënxësë. Djersa jot'e ballitë, er'e jargavanitë, djersa jot' e faqesë, **er'e manushaqesë.**

Fjalori: Vjollcë. Era e manushaqes. Ngjyrë manushaqeje. Një tufë me manushaqe. Çelën (dolën) manushaqet.

Një tipar dallues i manushaqes, si edhe për lulet e tjera, aroma e saj te veçantë e bën të përdoret me kuptimin e parë (erë manushaqe), por gjithnjë për të lavdëruar, qoftë e përdorur si krahasim, qoftë si epitet.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fitonimet e mëposhtme. Nga përdorimi i tyre, qoftë në poezi, ashtu dhe në fjalor edhe pa ndonjë tjetërsim a shmangie kuptimore e ngjyruese. Ato në çdo rast kanë vulën e pozitives, e lavdërimit dhe të kënaqësisë që falin.

Borzilok (Bleta), *Trëndafil e borzilok*, gjir i dollomasë plot. Si fëllënxa në kuti, o babai im

Fjalori: Bimë barishtore njëvjeçare, me lule të bardha, me gjethe të vogla e **me erë të këndshme**, që mbillet në saksi ose në oborret e shtëpive... Një degë (një tufë) borzilok. *Era e borzilokut*. * E bëri borzilok e pastroi mirë, e bëri dritë (dhomën, shtëpinë).

Burbuqe (Bleta) = Ngjelino **buzëburbuqe**, ti s'm'i pate këto huqe, del pashkësh, me ve të kuqe:

Fjalori: Lule që s'ka çelur ende, sumbull luleje, gonxhe; ... Burbuqe trëndafili. *E bukur si burbuqe.* Çel (lëshon) burbuqe. Shpërthejnë burbuqet. *I ka buzët si burbuqe*.

Zambak (bleta) ... Letra asht e lagë, s'munem me këndue, moj **qafëzamake,** ti pse qesh me mue?

Fjalori: Bimë me kërcell të hollë e të drejtë, ... me lule si hinkë ... dhe me erë të mirë, ... që rritet për zbukurim. Zambak i bardh ë(i kuq, i verdhë). Lule zambaku. Erë zambakësh. *I bukur si zambak.*

Zymbyl (Bleta) = 2 raste Na mbiu trëndafil mbë derë, **se zymbyl,** se trëndaffil. Vallë, kush do t'i marrë erë? Se **zymbyl** se trëndafil.

Hajde , moj **zymbyle**, hajde, haj të vemi ndë dhe tonë. Dheu yn' është behar, atje piqen rrushtë cpejt, celin lulet me lezet, vashat dalën me jelek.

Fjalori: Bimë barishtore ... me lule të vogla si hinkë e zakonisht të grumbulluara në tufë, në ngjyrë të kaltër, të bardhë, trëndafili etj. dhe *me erë të mirë,* që lulëzon në fillim të pranverës. Zymbyl i kaltër (i bardhë). *Erë zymbylash*. Kanë çelur zymbylat.

c. Pemët

Mollë (Bleta) = 11 raste – 1. Ku m'u nise e do veç, o pullump, more pullump?- Do vete ndë asqer, moj fëllënxa gur më gur. Merrmë mua vithe kalit. O...., _ është fthohët e s'duron dot, moj .... _ Bëhem **mollë** e hynj ndë gjit. O pëllump...., _ mos harronj e të kafshonj, moj thëllëza gur më gur. 2. Ndëpër bashtë të shkova, **mollë** t'ëmbla mblodha, ndë sepete t'i kyça, dhe kafenë ta poqa. Kafen'e poqa gjer u derdh, e prita lulen e s'më erth. (përse nuk mblodhi bamje, speca etj?)

Fjalori 3. përd. ndajf. Shumë, si molla (zakonisht me mbiemrin i kuq). Ishin mollë të kuqe. *I ka faqet mollë të kuqe.* * *Si kokërr molle* (thane) shumë mirë me shëndet.

Shpjegimi për figurën e mollës e jep mjaft qartë Gj.Misha[170] kur shkruan: " Në përshkrimin që i bën portretit të vashës, poeti popullor përdor shpesh disa metafora eufemistike (ndër të cilat A. B) molla përbën një ndër simbolet që e ndeshim më dendur. Molla si dru frutor, pemët e së cilës konsiderohen si simbole të jetës, lidhen me parimin femëror jetëdhënës."

Dardhë (Bleta) 1. Syzezë, vetullhollë, leshtë tat derdhur si fqollë. O moj **dardha** rrumbulllake, merr furkën, jakë pas darke. Mos je dardh'a mos je ftua? Ndë je ftua, je për mua., të të puth e të të dua, të të shtydh posi limua. 2. Ndë dash të bënesh e hollë, shtrëngo mesinë me dorë, ndë dash të bënesh e trashë, mvish jelekun e të mëndafshtë. O moj **dardha rrumbulllake,** merr furkën e haj pas darke. 3. Hajde, moj lule, me neve, Haj të vemi ndë fshat tonë. Fshati jyn' është i nxehëtë, Arrihenë rrushtë shpejtë: Arrihenë rrushtë e bardhë,**Të lulëzonjësh si dardhë**

Duke iu referuar përsëri Gj. Mishës[ii] i cili e sheh përdorimin e fitonimeve të tjera si dardhe, ftua, kumbull, shegë etj, si zëvendësuese të figurës së mollës na duhet të theksojmë se këto fitonime " .. janë pjesë përbërëse e kodit poetik e simbolik tradicional që mbështetet në lidhjet e përhershme mes formave të trupit të njeriut dhe objekteve të botës bimore e shtazore."

Nga ana tjetër po të shohim shpjegimet dhe përdorimet në fjalor do të ndeshemi edhe me përdorime të tjera madje edhe me konotacion jo dhe aq pozitiv.

Fjalori * *Ka rënë në dardhë* dikush ka rënë ngushtë, është zënë ngushtë, është në hall. *I doli dardhë* diçka nuk i doli mirë një punë, nuk i doli ashtu siç e parashikonte, i doli më e vështirë nga ç'mendonte; nuk i eci. *Do t'i dalin dardhat dikujt* do t'i dalin në shesh dallaveret që ka bërë, do t'i dalin të palarat. *Është rrëzuar (një herë) nga dardha* dikush e ka pësuar një herë dhe ka vënë mend, është qen i rrahur; ka përvojë nga jeta, është i rrahur me jetën. *Dardha në shënëndre* gjepura, pallavra, punë boshe. *E shpunë (e çuan) dardhë* u zunë njëri me tjetrin, bënë fjalë, u grindën; i keqësuan, i ashpërsuan marrëdhëniet. *Ai është në rrëzë të dardhës* është pranë të

[170] Po aty, vep.cit

mirave e përfiton prej tyre, është si veshka në mes të dhjamit.. Kush rri nën dardhë, i ha kokrrat.

Në fjalor, ndryshe nga përdorimet e gjetura tek "Bleta", fitonimi *dardhë* përdoret me konotacion dyfish. Duhet theksuar se ky përdorim haset vetëm në shprehjet frazeologjike, që , siç dihet, e kanë të vështirë motivimin. I njëjti fenomen ndodhte, siç u përmend më sipër, edhe me fitonimet trëndelinë dhe karafil. Për këto raste, në përdorimet e ngurtësuara idiomatike, na duket se më drejt do të ishte të mos flitej për kuptim a për përdorim konotativ të vetëm fitonimit, por për kuptim të përgjithshëm të frazës, se, siç dihet kuptimi i njësisë frazeologjike nuk është shumatorja e fjalëve që e përbëjnë atë. Kjo vlen për të gjitha rastet, si për fitonimet ashtu dhe për zoonimet që do të ndeshen më poshtë.

Portokall (Bleta) 1. O moj *cicaportokalle*, ethet e gushtit më kalle. Ethet e gushtit më zunë, e më tren'e më këpunë. 2. Më ranë ca halle, *faqeja portokalle*. Më ranë qedere, ndër zemër më there. Leshtë tat si korbë, mentë m'i bëre çorbë, syri yt i zi, syri i zi jyti, ndë grykë më mbeti.

Fjalori 2. si mb. ~, ~E. Që është i verdhë në të kuq, si i verdhë, që ka ngjyrën e lëkurës së portokallit të pjekur. Ngjyrë portokalle. Fustan (dok) portokall. Dritë portokalle.

Nerënxë, (Bleta) Rëneke *nërënxa* ndë det, lëshoi degë përmbi dhetë. Ndatë degëzën e parë, mvari dyfekun e larë..

Fjalori: Dru frutor i llojit të agrumeve, që bën kokrra të ngjashme me portokallin, por të tharta dhe si të hidhura; kokrrat e këtij druri, që përdoren në mjekësi e në industrinë ushqimore. Vaj nerënxe.

Nuk haset përdorimi i figurshëm

Pënjë (Bleta) (si dega pënje) Moj xhindeja mbi shkëmbenjë, ngjaturë si degë pënje.

Rrush, * *Si rrushi e koshi* janë njësoj, si njëri edhe tjetri. *I bëri (paratë, të hollat) rrush e kumbulla* i prishi të gjitha, i shpenzoi kot e me dorë të lëshuar. *Kur të bëjë larushku rrush* iron.

Biskonjë, (Bleta) Të falem, moj, bujareshë, un'i ziu të të keshë! Të të keshë, moj biskonjë, pa më vrinje me pisqollë.

Fjalori E ka shtatin si biskonjë. 2. fig. Vajzë a grua me shtat të gjatë e të drejtë, vajzë a grua shtathedhur. 3. përd. mb. I hollë, i gjatë e i drejtë si një bisk. Grua biskonjë. Vetull biskonjë.

Xhinxhife (Bleta) , Seç' më rënke erë balli, si ndë verë jargavani, Seç të rënekë erë gusha, si ndë verë kur çel fusha, Seç të rënëke erë gjiri, si ndë verë trëndafili. Moj e vogëla ***xinxife*** mvvish jelekun kadife...

Qershi, ... syn e zi posi filxhanë, hundënë posi qirinë, gojënë posi kutinë, buzëtë posi **qershinë**, dhëmbëtë posi inxhinë, gushënë si farfurinë...

Li (Bleta) 1. Syzezë, vetullhollë, leshtë tat derdhur **si fqollë**. 2. O moj dardha rrumbulllake, merr furkën, jakë pas darke. Mos je dardh'a mos je ftua? Ndë je ftua, je për mua., të të puth e të të dua, të të shtydh posi limua. 3. Vasha me çibuk veziri, lesht e saj si fqollë liri. Shumë iu luçë fakiri, nga e keqeja, jo së miri.

Ftua (Bleta) Mos je dardh'a mos je ftua? Ndë je ftua, je për mua., të të puth e të të dua, të të shtrydh posi limua.

Fjalori: përdoret vetëm për krahasim në ngjyrë, e verdhe si ftua, si limon.

Karpuz,(Bleta) Rrumbullakeja si **karpuzi,** mb'at anë lumënë, më vjen si gjemi Korfuzi. Më prishe gjuminë.

Fjalori * Nuk mbahen dy shalqinj (dy kunguj) nën një sqetull (në një dorë) fj. u. shih te

Të ha shalqirin e të rreh me lëkura është mosmirënjohës, ha bukën dhe përmbys kupën.

Nga përdorimi i karpuz duket sikur kemi të bëjmë me një rast përjashtimi prej rregullit të përgjithshëm që me pemë lavdërohet dhe prime shahet, ironizohet, përbuzet etj. Për mendimin tonë në vargjet e mësipërme fitonimi karpuz përdoret për të lavdëruar femrën në formën e saj trupore e cila i shkon për shtat shijes popullore për një nuse të tillë e mbushur e kuqe dhe sensuale, që dallon mbi të tjerat edhe me sjelljen dhe ecjen e saj: *Rrumbullakeja si karpuzi, mb'at anë lumënë, më vjen si gjemi Korfuzi, më prishe gjuminë*. Këtë e përforcon edhe përdorimi i formës rrumbullake edhe me ndonjë frut tjetër që për mendimin tonë hyn në grupin e emërtimeve që kanë konotacion pozitiv krahaso:

Syzezë, vetullhollë, leshtë tat derdhur si fqollë. O moj dardha rrumbulllake, merr furkën, jakë pas darke. Mos je dardh'a mos je ftua? Ndë je ftua, je për mua., të të puth e të të dua, të të shtydh posi limua.

Zerdeli (Bleta) *Zerdelia nëpër bashtë, mblithte ar e sërmë bashkë, ndë një shami të mëndafshtë, lule brenda , lule jashtë, plot me lule manushaqe.*

Fakti poetik: një *zerdeli* (si frut apo si pemë) që qëndis vetëm *lule*. Përse nuk na del asnjë rast ku p.sh zë e qëndis patatja, domatja dhe bamja, të cilat janë kaq të nevojshme për ekonominë shtëpiake, madje shumë më të përdorshme në kuzhinë .krahasuar me zerdelinë a pjeshkën? Këtu besojmë se gjendet dhe arsyetimi për ta kundërshtuar mendimin e rëndësisë ekonomike të objektit. Kështu, është thënë se disa emërtime nuk ekzistojnë ose disa të tjerë përdoren kështu mbasi nga rëndësia ekonomike janë të ndryshëm, kanë jo dhe aq vlerë për jetën ekonomike të shqipfolësit. Kujto këtu: gjininë gramatikore tek dhelpër, lepur, iriq etj, apo pëemendjen e pemëve në vend të perimeve.

Qiparis (Bleta) Unju, **qiparis** me koqe, pritmëni aty, moj shoqe, Xheç t'ju them e xheç t'ju qahem, Se nga babai do t'ndahem, Tek imzot do të falem (kërkon që hallin ta qajë me natyrën , si pjesë e së cilës e ndien veten, por edhe me shoqet, gjithashtu.)

Pyetja: përse nuk përmend ndonjë perime në vend të pemës së bukur? Përse nuk thotë, të supozojmë: - *hajde, domate me koqe, apo - unju kungull, zbrit nga gardhi* etj? Jo, qiparisi, selvia e pemët qe përmendëm më sipër e kanë "profilizimin" për të shprehur të bukurën, të lakmueshmen.

" Megjithëse vashat e këngës lirike mund të kenë një emër konkret, të kenë tipare fizike të dallueshme, si sy të zes, ...janë leshverdha e mesholla, shtathedhura apo

imcake, ato nuk janë individualitete por tipa folklorikë."[iii] Kjo është për ne, arsyeja e përdorimit vetëm me konotacion pozitiv e emërtimeve që ndeshëm më sipër e do të ndeshim edhe më tej. Portreti i vashës është i idealizuar duke mos tentuar për asnjë rast për të dalë nga tërësia e tipareve fizike të kodifikuara në krijimtarinë artistike, përndryshe po të dilej nga kjo skemë, nga ky lloj standardi poetik vargjet do të përfundonin në një të folur të zakonshëm dhe disa emërtime mund të dilnin edhe ashtu siç na dalin herë-herë në fjalor. E njëjta gjë del, përgjithësisht, edhe nga përdorimet në fjalor.

2. Zoonime

a. Kafshë

Shelege & Bejkë (Bleta) Më gënjeve pas jungarit, Si **shelegeja** pas barit, Më gënjeu pas gjemenxhesë, Si djali pas fermelesë / 2. Dielli rrëzën e malit, hën' e mir' e allonarit, **shelege, bejk**' e çobanit.

Fjalori 2. fig. Fëmijë i urtë e i butë. Shelegu i babait! E ka shelege atë vajzë.

Fjalori. 1. Dele krejt e bardhë. Bejkë rudë. Bejkë mali. Bejka e stanit. Lesh bejke. 2. përk. Vajzë e re, bardhoshe dhe e hijshme.

Na duket i drejtë konstatimi se pavarësisht se e dashura është një tërësi gati hyjnore për poetin popullor[171], kjo jepet përmes pjesëve, lavdërimit të pjesëve të trupit, syrit, këmbës, belit faqes etj. Në rastin tonë kjo pjesë i takon më shumë shpirtit e jo dhe aq pamjes fizike. Shelegia është e tillë jo vetëm për pamjen fizike, por edhe për pasurinë shpirtërore, vajza e ndien melodinë e jongarit se e ka pjesë të shpirtit të vet, sa ç'ka shelega të domosdoshëm barin. Kjo pohohet më së miri edhe në kuptimin që shpjegohet në fjalor.

Qëngje & Syskë (Bleta) Ç'të humbi që po kërkon, *buzëqengjërusheja* ime. Ç'ke moj *syskë* që po trëmbe? Folëna , moj, për kokën tënde.

Fjalori 1. I vogli i deles pa mbushur vitin, shqerrë. ... *Fle si qengj. I urtë si qengj.* 2. përd. mb. fig. I butë e i urtë (kryesisht për fëmijët). E ka qengj djalin. Është bërë qengj është bërë *shumë i butë e i urtë*, nuk i ndihet më zëri.

Buall (Bleta) Humbe mëndjen e s'e gjen, ***o buall*** i Armerosë, ti u bëre për gumen, në manastir të Sparmiosë.

Fjalori, I rëndë (i ngathët) si buall. *Fle si buall* bën gjumë të thellë. *Shtrihet si bualli* në lerë. keq. I ka hapur sytë si bualli në ujë.

2. fig. keq. Burrë me trup të madh e të rëndë, por i ngathët e i trashë nga mendja.

Fjala buall në shembullin e mësipërm nuk duhet interpretuar siç duket në pamje të parë. Më bindës do të ishte interpretimi i fjalës *buall* këtu si formë të fjalës *bollë*, që konsiderohej ndër shqiptarët si "shpirti mbrojtës i shtëpisë". Kjo gjen mbështetje në studimet folklorike, kulturore, numizmatike, antropologjike etj të autorëve të ndryshëm, vendas dhe të huaj si, Q. Haxhihasani, H. Ceka, M. Tirta, G.

[171] Gj Misha vep.cit f.211

Hahn, R. Elsie etj, të cilët e shohin këtë zoonim si ndër përfaqësueset në besimin e shqiptarëve dhe paraardhësve të tyre.[172]

Edhe në mos qoftë kështu, emërtimi buall, si kafshë shtëpiake me karakteristikat e përmendura në fjalor, përsëri shkon dhe e përligj kënaqshëm hamendimin tonë për profilizim të përdorimit të emërtimeve të kafshëve dhe shpendëve të egra dhe të buta, shtëpiake.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për zoonimet *gjarpër, nëpërkë,* pse jo, mund të futet në këtë grup edhe fitonimi *ngjalë.* Ja përdorimet tek "Bleta" dhe shpjegimet në fjalor

Nëpërkë (Bleta) Seç më rri nde dera fort me të mentuarë, **nëpërk'** e shkruarë; Më të zu babaj për të martuarë, *nëpërk' e shkruarë*; të vijën shoqetë për t'uruarë, *nëpërk' e shkruarë*;

Fjalori 2. fig. Njeri shumë i keq e i pabesë; njeri shumë i djallëzuar e tinëzar; njeri që e ka gjuhën të hidhur e të mprehtë, që të ther e të helmon me fjalë. Është një nepërkë e keqe. E kishte nusen nepërkë. * *Nepërkë e shkruar* grua shumë e bukur e lozonjare.

Ngjalë (Bleta)... ti moj hëna , që ke rarë, s'më pe lulen ku ka shtruarë?
-Nd'atë qoshk me dy tri shkallë, është **shtriturë si ngjalë.** U rrëzofsh, o more, qoshk! Të bjerë luleja përposh, të thyejë këmbën e a gjunë, heqim t'i bënesha unë.

Fjalori 1. zool. Peshk që rron në det dhe në ujëra të ëmbla, me trup të gjatë e të hollë si të gjarprit… Me trup si ngjalë me trup të hollë e të shkathët; *meshollë*. 2. fig. keq. *Njeri dredharak*, që di t'u bëjë bisht e t'u shpëtojë gjendjeve të vështira. * *Shket (rrëshqet) si ngjalë* u bën bisht e u shpëton me dredhi gjendjeve të vështira. *Përzihet si bolla me ngjalën*.

Sorkadhe (Bleta) Posht' e lart ndëpër moçale, dalë, moj, Merushe, dale; qafëgjatë si *sorkadhe*, dalë, moj, Merushe, dale

Derr (Bleta)= Vogëlithë, bukuridhezë, më lëvduanë një vashë. Un' i falem pra, i thashë. Ma lëvduan e s'ma dhanë edhe " tyt more derrr" më thanë. (shqiptarët e Greqisë)

b. Shpendë

Bilbil (Bleta) 1. Tatushan, moj meslangore, pse s'na rrëfen, se nga dole,
_ ç'tju rrëfenj, o ju të mjerë, atje ku lashë çemberë, këndonin gjashtë *bilbilë*, tre të kuq e tre jeshilë. 2. Ndë majë të malit dolla, një zë *bilbili*, dëgjova. Nga *bilbili* që dëgjova, xhokene në shesht e shtrova.

Fjalori 4. përd. mb. Që këndon shumë bukur; që flet shpejt e bukur; që është i mprehtë, që e kap shpejt diçka. E ka gjuhën bilbil. Është bilbil nga goja. I ka veshët bilbil.

[172] Robert Elsie, në veprën "Leksiku i kulturës popullore shqiptare, besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore"

U bë bilbil u ndreq, u bë lule (për njerëz qe nuk kanë qenë të rregullt). Mbeti bilbil mbeti fare pa gjë ose pa njeri.

Thëllëzë (Bleta) 1. Thanë , o nëne thanë, Ata diç të dhanë Një **thëllëzë mali**, Një zok të beharit,Një degë leimonit, Ndë mes të hoborrit. 2. Tatëpjetë bregut vinje, jelekkuuqeja veshurë, **si fëllënxa** sokëllinje, jelekveshurë...3. O ujët e rrëzavet, o **misht'e thëllëzavet,** o ujët e Perivolit, tin'o florir'i Stambollit. O ujët e malitë, o yll i karvanitë. 4. Çup' e bij 'e nënësë, Shkel mbi thonjt'e këmbësë, si zogu *fëllënxësë*. Djersa jot'e ballitë, er'e jargavanitë, djersa jot' e faqesë, er'e manushaqesë.

Fjalori 1. Zog i madh sa një pëllumb,... dhe që këndon bukur. Thëllëzë mali (fushe). Mish thëllëze. Tufë thëllëzash. *E bukur si thëllëzë.* Këndojnë thëllëzat. Doli për thëllëza. Ecën si thëllëzë. 2. fig. përk. *Vajzë a nuse e bukur*. Mori një thëllëzë.

Guguçe (Bleta) Moj e vogëla Ruki, mbae Ferron në pëqi, O Nazif, o budalla, bjeri fyellit kaba, të më lozë *Guçja*, faqe kolopuçeja..

Fjalori 1. Kumri. 2. fig. përk., poet. Vajzë e pastër dhe e bukur. Ti, *guguçe,* pse s`këndon?

Pëllumb (Bleta) 1. Shtira sytë m'batë dardhë, pashë një pëllumb të bardhë, Pa i thirra, " vivido, vido" 2. Mora anënë të detit, gjeçë të bijën e mbretit; mora anënë të lumit, gjeçë **gushën e pëllumbit**.. - Ku m'u nise e do veç, *o pullump, more pullump*?- Do vete ndë asqer, moj fëllënxa gur më gur. Merrmë mua vithe kalit. O...., _ është ftohët e s'duron dot, moj .... _ Bëhem mollë e hynj ndë gjit. *O pëllump*...., _ mos harronj e të kafshonj, moj thëllëza gur më gur. Nqasu më këtej, moj shpyrto. 2. Ububu, lojte një djalë, **një djalë pëllumb i bardhë,** dyfekënë gjithë sedefe, kur e shoh më ngjethin ethe; sahatnë gjithë zinxhirë, kur e shoh, më prish fiqirë.

Fjalori 1. Shpend i butë a i egër ... dhe që mbahet si simbol i butësisë, i pastërtisë, i bukurisë dhe i paqes. *I butë* (i bukur, i urtë) si pëllumb. *Si pëllumb i shkruar* shumë i bukur. 2. fig. përk. Fëmijë a djalë i vogël, i bukur dhe i dashur. *Pëllumbi i nënës*! Fli, mor pëllumb! 3. fig. iron., shaka. Përdoret kur i drejtohemi dikujt me një qortim të lehtë etj. Ku ishe, *mor pëllumb*? Na *erdhi ky pëllumbi*.

Flutur (Bleta) Tatëpjetë malit, kur më sbret *si fluturë,/* Më more më qafë, moj Mari e bukurë,/ dilmë në penxhere, dy faqe paputhurë, më more më qafë me kaqë të luturë.

Fjalori

6. përd. mb. Shumë i shpejtë e i shkathët; shumë i lehtë. Grua (nuse, vajzë) flutur. Është flutur.

8. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat i lehtë, i shpejtë). Flutur i lehtë. Flutur e shpejtë.

Gjeraqinë (bleta) Flytyroi *një gjeraqinë,* me zilë ndëpër këmbë,/ shikonie ku do të hynjë, me zile ndëpër këmbë.

fjalori 1. zool. Shpend i madh grabitqar, me pendë të larme, me krahë të gjatë dhe me kthetra; petrit. 2. fig. *Grua e shpejtë dhe e shkathët.* 3. Përd. mb. sipas kuptimit 2 të emrit. *E ka nusen gjeraqinë.*

Patë (Bleta) 1. Në buzët të putha, të ëmblë posi mjaltë, Si lumthi jot ëmë, si lumthi yt atë, varurë gjerdani në gushët me rrathë. Kur më del te dera, e **bardhë si patë**, s'më hiqet nga mendja me dit' e me natë. Mbë gosti të thirra, për darkë një natë, moj, gostija jote vetëmë rrush të thatë.

Fjalori Shpend më i madh se rosa, me qafë të gjatë,.... Është (ecën) si patë është i ngjallur e mezi lëviz a mezi ecën, ecën duke u tundur sa andej këtej.

Përdorimi në tekst, duke marrë një cilësi pozitive të dukshme të këtij shpendi, edhe pse shtëpiak, e bën të fshihet lloji dhe të dalë në pah cilësia. Këtë mendim e përforcim edhe shembulli: *Ndë na qofsh e mira jonë. Luleja jonë / Ndër oda të të lëshojmë / Me flori të të mbulojmë / Ndë na qofsh e liga jonë, / Të të japëmë hoborrë / Me patat të të lëshojmë.* Nga shembulli duket qartë përdorimi pejorativ i zoonimit "patë" e cila merret si e tërë dhe jo më për një cilësi të saj si në rastin e mësipërm, " e bardhë si patë". Këto raste përdorimesh nuk besoj se ndikojnë në ndryshimin e "profilizimit" të disa herë përmendur në këtë material.

Korb Më ranë ca halle, *faqeja portokalle*. Më ranë qedere, ndër zemër më there. Leshtë tat *si korbë,* mentë m'i bëre çorbë, syri yt i zi, syri i zi jyti, ndë grykë më mbeti.

Cilësia e veçantë e ngjyrës së pendëve të korbit e bën më bindës e shprehës krahasimin për të cilin si gjymtyrë krahasuese mund të ishte marrë edhe ndonjë kafshë tjetër e shtëpisë, apo afër saj, sorra, të zëmë. Jo, ajo (sorra) i duhet poetit (shqiptarit në tërësi) për një tjetër krahasim me ngjyrim pejorativ.

Sorra (Bleta) Hapi ju, moj **sorra,** Se vjen *gjeraqina*, Me sheqer në gojë, Të na ëmbëlsojë

Fjalori 1. Shpend me pendë të zeza të ndritshme... . Tufë sorrash. Krakëllijnë sorrat. *Është veshur me të zeza si sorrë.*

Na duket sikur sorra, ky shpend i egër, vërtetë është familjar për shqiptaret, ai qëndron në pemët e kopshtit të shtëpisë dhe rrëmben çfarë të mundë, madje edhe sapunin në govatën ku lan teshat amvisa. A nuk duket sikur buron në një mjedis të tillë semantik përdorimi frazeologjik " s'e ha sapunin për djathë"? Prej këndej, sorra konsiderohet "si e shtëpisë" dhe këto tipare ia jep jo vetëm sjellja e saj, por edhe ngjyra që simbolizon, në mos të keqen, të paktën diçka të papëlqyer. *Hapi ju moj sorra/ Se vjen gjeraqina/ Me sheqer në gojë/ Të na ëmbëlsojë.* Vënia ballë - përballë e dy zoonimeve me ngarkesë të lartë konotative, e rrit edhe më shumë kontrastin pamor dhe e bën më të dukshëm shkëlqimin e nuses gjeraqinë. Nuk kemi ndeshur asnjë luhatje përdorimore për emërtimin sorrë, as në fjalor.

Përfundimisht, edhe pse gjendet aty – këtu ndonjë rast, rregulli i përgjithshëm i profilizimit të fitonimeve dhe zoonimeve qëndron bindës: konotacion pozitiv mbartin e përcjellin, pemët e frutat e tyre, drurët e pyllit, kafshët dhe shpendët e egra, në të kundërt: konotacionin negativ, përbuzës shfaqin e japin perimet dhe shpendët e kafshët shtëpiake.

Një mendësi e tillë na del edhe në përdorimet e popujve të tjerë fqinjë me ne, ballkanas në përgjithësi, gjë që shpjegohet jo vetëm me përkimet gjuhësore, por

me mendësinë dhe mënyrën e konceptimit të jetës në tërësi. Për këtë ia vlen të hulumtohet dhe studiohet më hollësisht, duke e shtirë analizën dhe krahasimin edhe me popuj të tjerë të Europës, në lindje dhe perëndim të saj.

AIDA URUÇI (SHKODËR)
ZAMIRA SHKRELI (SHKODËR)

FUSHA LEKSIKORE E LEMAVE (LEKSEMAVE) TË FJALORIT TË THIMI MITKOS

Thimi Mitkoja, ky veprimtar i Rilindjes Kombëtare u bë i shquar si folklorist, madje ai është vlerësuar deri më sot si "*mbledhësi më i suksesshëm i folklorit shqiptar"*, duke u quajtur gjithashtu "*babi dhe krijuesi i folkorit shqiptar*"[173]. Botimi i "Bletës shqiptare", më 1878, pati një jehonë në mbarë botën akademike (shqiptare) të kohës. Kjo vepër kishte si *qëllim dëshminë e vlerave kulturore të popullit shqiptar, të gjuhës, zakoneve, karakterit, shtrirjes gjeografike të krijimeve folkorike, të cilat ishin të panjohura dhe të pavlerësuara më parë*[174].

Albanologu G. Majer e ka vlerësuar punën e palodhur të Th. Mitkos dhe e cilëson atë si: "*Të parin toskë mbledhës të këngëve dhe përrallave popullore*", ndërsa De Rada pas botimit të kësaj vepre shprehet: "*Në Bletën Shqiptare kemi si në gjirin e nënës çdo gjë që e ka ruajtur Atdheu prej qënies së vet fisnike, nga ku mund të përtërihet e të ringjallet*".[175] Gj. Pekmezi ishte i pari studiues që realizoi transliterimin e "Bletës Shqiptare", ai ishte jashtëzakonisht i gëzuar kur shtiu në dorë kopjen origjinale të librit, e nënvizon faktin se "….*gjer sot ky thesar i bukur ishte i humbur për popullin tonë, prandajza i pamasë ishte gëzimi jem kur e gjeta këtë libër të rrallë, se dyke e përshkruar e përkthyer shqyp do të mundet të këndohet prej popullit…*".[176]

Th. Mitkoja, ky rilindës e atdhetar, ka dhënë një ndihmesë mjaft të vyer në botimin e librave e gazetave në gjuhën mëmë, në hapjen e shkollave shqipe, por edhe në krijimin e shoqërive shqiptare në: Egjipt, Aleksandri, Minia, Ajat etj., të cilat kishin si qëllim parësor përhapjen e mësimit të gjuhës amtare.

Në letërkëmbimet që kishte me De Radën, si patriot që ishte, Th. Mitkoja e ndiente nevojën e hartimit sa më shpejt të një alfabeti që "…*edhe Shqipëria të dalë ndë dritë e të pushojë më së derdhuri gjakun e saj për botën e huaj*...Ai *i mëshon idesë se përdorimi i alfabetit shqip është një faktor i domosdoshëm për të mos lejuar që të asimilohet kombi shqiptar.*"[177] Megjithatë sipas studiuesit T.Osmani: "*Th. Mitkoja paraqitet i lëkundur në bindjet e tij për sistemin alfabetik, pasi ai përdori mbi pesë variante albafetike në shkrimet e tij*."[178]

Puna e tij e palodhur për mbledhjen e leksikut të gjuhës shqipe dhe angazhimi për hartimin e fjalorëve shqip-greqisht, greqisht-shqip e më pas atë tri gjuhësh

[173] Sh. Sala, *Fjalori Italisht-greqishit-shqip i Thimi Mitkos*, (Transliterimi dhe fjalësi shqip) II, West Print, 2013, f. 25.
[174] Po aty, f. 20
[175] Sh. Sala, *Fjalori Italisht-greqishit-shqip i Thimi Mitkos*, (Transliterimi dhe fjalësi shqip) II, West Print, 2013, f. 25.
[176] Po aty, f. 24.
[177] T. Osmani, *Udha e shkronjave*, Shkodër, 1999, f. 274.
[178] Po aty, f. 276.

italisht-greqisht-shqip, është vënë më pak në dukje. Mendohet se *Th. Mitkoja e ka pasur të përfunduar dorëshkrimin e Fjalorit italisht-greqisht-shqip dhe të gatshme për ta dërguar në shtyp midis viteve 1887-1888*.[179] Ky fjalor përmban afro 5 280 (±10) fjalë të leksikut të shqipes. *Për nga sasia e fjalëve, ai renditet mbas fjalorëve të J. G. Hanit, F. Rosit, G. Jungut dhe G. Majerit*.[180]

Mitkoja e nisi punën e tij mbi një terren të përgatiur, *pasi guri i parë i themelit në lëmë të leksikografisë shqipe ishte hedhur nga Frang Bardhi, i cili më 1635 botoi të parin fjalor,"Fjalor latinisht-shqip", duke u ndjekur nga fjalorë dy a më shumë gjuhësh të hartuar*

nga F.M. Da Lecce më 1702 "Fjalor italisht-shqip", T. Kavaloiti, I. R. Von Xylander etj.[181]

Fjalori italisht-greqisht-shqip – Transliterimi dhe fjalësi shqip, doli në dritë falë punës së palodhur të studiuesit Sh. Sala në vitin 2013, prandaj studimi i këtij fjalori me një largësi kohore prej më shumë se 100 vjetësh (125), na vë përpara vështirësish e përgjegjësish që të nxjerrim në dritë
vlerat e tij e ta vendosim në vendin që i takon.

Glosari i këtij fjalori përmbledh fjalë shqipe nga të gjitha anët, ai është gjithëpërfshirës pasi aty gjenden leksema nga terminologjia fetare, kemi një pasuri mjaft të vyer nga fjalësi diturak e fjalë të ligjërimit të përditshëm. Lënda e përfshirë në këtë fjalor na jep mundësinë të njohim gjuhën shqipe të shek. XIX, pa harruar të përmendim edhe vështirësitë që kishte hasur autori për mbledhjen e këtyre fjalëve.

Fjalori italisht-greqisht-shqip - Transliterimi dhe fjalësi shqip, II, është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë e titulluar: Fjalor tematik dhe pjesa e dytë: Dialogje bisedimesh.

Objekt i këtij punimi është studimi i pjesës së parë, pikërisht fjalorit tematik. Autori aty ka përfshirë fjalë dhe shprehje të fushave të ndryshme të jetës, të kulturës, fesë e mjedisit shqiptar. Ne jemi ndalur tek terminologjia biblike, tek fjalësi diturak e tek disa leksema që pasqyrojnë ligjërimin e përditshëm. Kjo pasuri leksikore do të këndvështrohet për larminë e mjeteve fjalëformuese, për përdorimin e varianteve dialektore si edhe për përpjekjet e Mitkos për zëvendësimin e mjaft fjalëve të huaja me leksema të brumit të shqipes, që ishte qëllimi parësor i rilindasve.

Le t'i shohim më konkretisht këto fusha.

1. Terminologjia biblike

Së pari, do të ndalemi tek leksemat që pasqyrojnë terminologjinë e ***fushës biblike***. Vërejmë se leksiku biblik zë një vend të konsiderueshëm në fjalorin e Mitkos, por duhet theksuar se përmbajtja e kësaj tematike i takon më tepër besimit kristian,

[179] Sh. Sala, *Fjalori Italisht-greqishit-shqip i Thimi Mitokos*, (Transliterimi dhe fjalësi shqip) II, West Print, 2013, f. 41.
[180] Po aty, f. 62.
[181] M. Priku, *Fjalësi diturak në fjalorin e Shoqërisë "Bashkimi"* , te "Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi" në 100-vjetorin e tij", në "Studime Shqiptare "19, Shkodër, 2011, f. 64.

kryesisht atij ortodoks, megjithatë ndeshim edhe fjalë të besimit tjetër, musliman, si: *xhami, minare, agjërim, ditë të argjerisime* gjë që tregon edhe bashkekzistencën fetare në Shqipëri.

Termat fetarë i kemi ndeshur tek nëndarja: *Për qishën dhe tek të parat ditët të kremte*. Aty kemi vënë re përdorimin e çifteve sinonimike që formohen me fjalë të huaja, me fjalë të dialekteve ose me fjalë të gjuhës standarde, si: *ferri, ziarrmi*; *krishti, a ristozi*; *qishë, a kishë, tempull*. Th. Mitkoja përfshiu në këtë fjalor fjalë që janë përdorur që tek autorët e vjetër, si: *Kryjuasi, basi* që gjenden të pasqyrura që tek Budi.

Një vend të veçantë zënë shprehjet: *Ujët e bekuarë; Të lidhura-t; Kreshme e madhe, E para ditë e kreshmës,* - këto shprehje sipas studiuesit E. Çabej "J*anë përkthime nga greqishtja*, *ndikime të kishës lindore, që i ka dhe Veriu sot katolik*."[182] Pjesë e kësaj pasurie leksikore janë edhe shprehjet, si: *Kremtet e Apostojëvet*; *Kremte e gjithë shenjtërvet; Dita e shpyrtëravet; Dit' e shën Vasilit; Java e zezë; E enjët' e madhe; E prente e zezë; Dita e Shën Thomait; Dit' e kungimit trupit zotit; a e hëna e madhe; Shën Mëria, a të fjeturit e perëndillesës; Dita e pashkës, a të ngjallurit; Të lerit, a lindja e Shën Mërisë; kemi dita që jam lerë, a lindurë* – në vend të kompozitës ditëlindje, të cilat kanë strukturën e një togfjalëshi. Interesante janë fjalët e krijuara me anë të prejardhjes, të cilat krijojnë çerdhe fjalëformuese, si: *këmbona, këmbanore*-ja; *kryq-i, kryqëzuari*; *mesha, (prifti) meshatar*; *varr-i, të varruarit, a varimi*. Po ashtu edhe ndërtimet me sindajshtesën *krye-*, *që u bashkohet temave emërore e shënojnë veta sipas profesionit ose detyrave që kanë ushtruar*,[183] si: *Kryeati* (patriku, papa, Kardhinal); (peshkëve), *Kryepeshkëve*; (prift), *Kryeprift*; (dhiak, a xhakon), *Kryedhiak*-u. Mitkoja në çdo moment e ndiente nevojën e pastrimit të gjuhës shqipe nga fjalët e huaja e përpiqej t'i zëvendësonte disa prej tyre me fjalë shqipe, si*: therrore për altar, çupat për virgjirat*.

2. Fjalësi diturak

Një vend të veçantë në këtë fjalor zë fjalësi diturak me një larishmëri leksemash e termash leksikorë, në fusha të tilla, si: gjuhësisa, gjeografia, flora e fauna.

2.1 **Terminologjia shkencore**

Në fillim po ndalemi te ***terminologjia gjuhësore,*** të cilën, në fjalorin trigjuhësh, i gjejmë tek ndarja: *Se-ç' duhen për të kënduarë, a shudhasurë***.** Fusha e gjuhësisë na paraqitet më e pasur me terma gjuhësorë, pasi *Th. Mitkoja e ka njohur librin e Samiut "Shkroiëtore e gjuhës shqip"*.[184] Emërtimet e ndeshura të kësaj fushe janë: *gramatikeja, fillollogjia, fillollogë-u, a i kënduashimë, gjuhë e folurë, gjuhë shalavriqe, të shkruarit, shkronja, shkruetori* për shkrimtarin, *skolëtari* për shkollari,

[182] E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 48.

[183] E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 91.

[184] Sh. Sala, *Fjalori Italisht-greqishit-shqip i Thimi Mitokos*, (Transliterimi dhe fjalësi shqip) II, West Print, 2013, f. 53.

libri, fletorja, ditërore-ja, mbivume (për mbiemrat), numurore (për numërorët rrështorë): i dytë,i tretë, i tetë, etj.

Një grup më vete janë edhe formimet emërore me prapashtesën *-ist/-isht* të gjuhëve përkatëse si: *turqisteja, arabishteja, italishteja, frëngjishteja, latinishteja, anglishteja* etj.

Ndeshim përdorimin e çifteve sinonimike, si: *kondil-i, kalem-i, mellan; mësuas, mieshtër-i; fjalë-a, bisedi-ja, thënë-ja, ksilli.* Po ashtu, autori përpiqet të formojë çerdhe fjalëformuese, si me anë të prejardhjes edhe të kompozimit, p.sh.: *bejt-i, bejtar, bejtim, të bejtuarët*; *dijë, dijës-i, a i dijëshimë, i dijçimë*; *dora, dorëshkruem*-ja.

Bie në sy përdorimi i prapashtesave **–ar, -tar, -tor, -ës**, të cilat *formojnë emra të përgjithshëm njerëzish të karekterizuar sipas veprimit që kryejnë ose profesionit a punës që bëjnë*,[185] p.sh: *pajëtor-i, bejtar, istoriar, kaminar, këpucar, vrapëtar, poçar, diegullëtar, kthisatar, muzikëtar, peshkatar, lodërtar gjellëtar, tregëtor, ushtërtor, miekës, qepës, lypës, mullinës etj.* Disa prej këtyre leksemave, si: *fjalëtar, gojëtar,*[186] gjenden të përdorura që tek Bogdani.

Ky fjalës është i pasur edhe me ***emërtime të gjeografisë*** së përgjithshme, të cilat autori i ka vënë tek ndarja: *Për botën faresej*. Ai përdor leksemën *dheshkres* në vend të fjalës së huaj gjeografi.

Thimi Mitkoja ishte kundër përdorimit të fjalëve të huaja madje ai shprehej: "F*jalë të këtilla janë të huaja, tërësisht të tepërta, të pavlefshme dhe kakofone. Prandaj ato fjalë me origjinë dhe rrënjë të huaj duhet t'i flaki populli shqiptar*."[187] Ai u përpoq të sillte pasuri leksemash, fjalë që ishin kalke nga gjuhët që vinin, t'i zëvendësonte me fjalë të brumit të shqipes, si: *ana e diellit* (për të perënduarit); *an' e shiut* (për mesëdita); *brezi i zotit* **(**për yliberi); *rrëzë deti* (*për anë deti*); *e thata* (për tokë); *të çfryrët* (për vërshimi); *shuli* (për bosht'i i dheut*)*; *rrotëza* (për bota); zona a *brezi i përdiegurë* (*për ekuatorin*); *mal'i ziartë* (për vullkanin); *erë-shtiellsa* (për tufanin).

Mitkoja, kur flet për motin dhe stinët e vitit, bën dallimin *l'anno* për vitin e *il tempo* për motin. Kur pasqyron stinën e vjeshtës e të dimrit, autori i shoqëron ato edhe me shpjegime nga fusha biblike, si: *Viesht' e dytë, a shëm-Mitri; Viesht' e tretë, shë(r)- Mëhilli; Dimëror-i, a shën-Endreu*. Ndërsa për të treguar orën ai përdor leksemat: *or'-a, gjysmësë ore*, ndërsa për çerek e treçerek ore përdor shprehjen *një e katërtë ore, tri të katërta ore*.

Na bie në sy pasqyrimi i leksemave me anë të variante fonetike**,** si: monoftongim *q**ie**lli, a q**e**lli; d**ie**lli, a d**i**ll,*përdorimi i leksemave të toskërishtes përkrah atyre të gegërishtes: *ujë-i, a ujë-t; ziarri, a ziarm-i; dëborë,a borë, gjëmim-i, a gjëma; rëra, a rana*. Ndërsa tek ditët javës vërejmë shtimin e grupit-**jë**: e dielë, a e dielë*jë*; e hënë, e hënë*jë*; e martë, e martë*jë*, e mërkurë, mërkurë*jë*.

[185] Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 133.
[186] E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 101.
[187] Thimi Mitko, *Vepra I*, Tiranë 1981, f. 479.

Në fjalësin diturak kemi përfshirë edhe ***titujt*** apo siç i quan autori: *Ofiqe kohe.* Aty kemi vënë re përdorimin e vargjeve sinonimike, si: *kapedan, krye; kuvend, këshillë-a; perandoreshë, mbëretëresh*.

Në çdo ndarje të këtij fjalori tematik kemi ndeshur në përpjekjen Th. Mitkos për ndërtimim e çerdheve fjalëformuese, qoftë me fjalë shqipe, qoftë me ato të huaja, p.sh.: *perandor, perandori; mbëret, mbëretëri, mbëretërim-i; rigë, rigatë (pushtet).* Edhe këtu nuk mungojnë ndërtimet me sindajshtesën krye-, ku autori u mbështet tek fondi i shqipes për të dhënë ndërtimet: *kryedukë, kryeushtor, krye-mijës, krye-qindës*.

Në disa raste autori bën edhe dallimin e gjinisë me anë të ndajshtesës *-eshë*, si tek emërtimet: *dukë - dukeshë; barun - baruneshë; kont - konteshë*.

Pjesë e fjalësit diturak të këtij fjalori janë edhe pasqyrimi i leksemave që emërtojnë emra *bimësh, drurësh, kafshësh e shpendësh.*

Emrat e bimëve. Studiuesi E. Çabej nënvizon faktin që*: "Ndikimi i greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe përfshin, sidomos sferën e bimëve, veçanërisht të bimëve të kuzhinës, e atë të pemëve***."**[188] Kjo dukuri vihet re edhe tek kjo ndarje, pasi ajo është mjaft e pasur më emra bimësh, si: *lakërë, qepë, hudhërë, majdanoz, qiqërë, kungull, spanaq, patlixhan, lëpietë* etj. Ndeshim gjithashtu vargjet sinonimike: *fasule, a frashuall, grosh-a, koqe –farash; burdullak, këmbë-pule-ja, gushpullumbi*; variantet dialektore: *piepër, pepën-i; lakërë armeje, a lakërë kreçe, lakërë-lule-ja* (për lulelakër).

Emrat e drurëve i gjejmë të pasqyruara tek ndarja: *Drurë, pemësh edhe pemët e tyre*. Në disa prej këtyre emërtimeve ndeshim variantet fonetike, si me anë të monoftingimit të togut -ua në –o, p.sh.: ftua-ja, ftoji; limua-ja, limoji. Gjithashtu kemi përdorimin e vargjeve sinonimike: *trup, trung; fidan, bisk, filiz; fre-ri, veshë, kalavesh, vileja, pupë; koqe-ja, kokërë-a; misër, kollomoq; dorë, tufë, duajë*.

Emrat e shpendëve zënë një vend tjetër në këtë fjalës diturak. Mitkoja i ka përfshirë tek ndarja: *Shpena, a shpenda, a spesha*. Aty bie në sy përdorimi i vargjeve sinonimike, me anë të leksemave dialektore e ato të mbarë shqipes, apo të huaja, si: *kapua, kaposh, këndezi, gjeli; nosë, rosë a rikë; sorrë, a korbë; petrit, gjeraqinë; hulluveikë, kukumaiçkë; bilbil, fillomillë; sqypejë-a, dëllëndyshe**,** gjethëndryshe.*

Një ndarje tjetër janë edhe **emrat e kafshëve**, ose siç i quan autori: *Bagëti katërkëmbëshe*. Edhe në këto emërtime ndeshemi me variante fonetike, si: *mëz a maz; qën a qen; capi, ciapi; keci, kedhi a edhi*. Interesante janë ndërtimet e vargjeve sinonimike, p.sh.: *gomar, këre, këriç a kriç; kërmill, ligavec, kaçamill; maçe, mace, maçi, a maçok-u; der-i, a thiu i egërë*.

Tek ***emrat e insekteve*** po veçojmë çiftet sinonimike: *gjinkallë, mizë përdhesëje, a thënegëlë-a; krymb, a mizë mëndafshi; pezishkë, a cipë merimange*.

3. Terminoligjia që i përket jetës së përditshme

[188] E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 49.

Th. Mitkoja ka përfshirë në këtë fjalor edhe fjalë që i përkasin përdorimit të përditshëm. Ato janë leksema që shënojnë moshën, gatimin, veshjet, anët e mira e të këqija të njeriut etj. Po ndalemi së pari tek larishmëria e leksemave që përdor autori për të paraqitur: *Gjith anët e trupit njeriut edhe për vërsën, a, moshën*. Bie në sy dallimi i gjinisë me anë të leksemave të ndryshme ose me anë të prapashtesës femërorizuese, si: *burr-i (njeri-u), grua-ja;; nipi, mbesa; vëllai, motra; nuseja, dhëndëri; apo plak-u, plakë-a; gjysh-i, gjyshe-ja; stërgjysh-i, stërgjysheja; miku, mike-ja; stërnipi, stërmbesa; viehërri, viehërra*. Kemi ndeshur vargje sionimike të cilat ndërtohen me fjalë dialektore (a krahinore), fjalë të mbarë gjuhës standarde e me fjalë të huaja, si: *djalë i ri, a djalosh, çun- i vogëlë, a dialëthë; çupë, cucë, gocë, kaçe, vajëzë; përindët, a krerët; trashëgimtari, resmëtari, pjeshatari; bir vetëm-lindurë, a i vetëmë; nip, stërnipërit, ndiekësit; protimët, atëria, përindërit, a prinjët; të vetët, a far' e fis të afërmë-i-t.*

Një vend të veçantë zënë leksemat që shërbejnë për të treguar: *Hamëje, e të pime, a haja e pija, pirëja*. Këtu ndeshim vargjet sinonimike, p.sh.: *surbë, xama, a lëngu; dhiamë deri, ushunji; gjel deti, misorok, bibë; kupë, gotë, qeft; misurë e piata, a talure-ja, çini-ja*.

Larmi trajtash leksikore të ndërtuara me anë të togjalëshave: *mish'i piekurë, mish'i piekurë*

ndë skarët, mish i cigarisurë, mish i piekurë ndë furrët, mish kau, mish dashi, mish keci etj. Nuk mungojnë edhe variantet dialektore, si: *aikë, maza; gjalpë, të lymë*.

Interesante janë edhe ndërtimet e çerdheve fjalëformuese me anë të prapashtesimit, si: *krypësire-ja, krypësi; vajanik-u, vajas; piperoja, piperës; uthulloreja, uthullës.*

Qëllimi kryesor i rilindësve ishte pastrimi i gjuhës shqipe nga fjalët e huaja. Edhe tek Th. Mitkoja ashtu siç e kemi theksuar më lart, vihet re përpjekja e tij për të përdorur sa më pak fjalë të huaja e zëvendësimi i tyre me leksema shqipe, p.sh.: *stifato* për jahni; *mish i thatë* për pastërma; *furkulicë* për perua; *petë me mish* për byrekun.

Autori ka përdorur një larmi leksemash për të dhënë *veshjen* e burrave e të grave. Aty bie në sy më tepër përdorimi i vargjeve sinonimike, si: *këmula, kappa, festeja*; *jeleku, xhamadani*; *gunë, a tallagane*; *kallcat, tirqët, kallëzat*; *kopsa, sumbullat, toka*; *fustani, kotullë-a, rraxhë-a, këpucët, opingat; ndërsa* përdor *robe-shtëpie* për rabdëshambër; *këpucët shyte, a xvaraniket* për pantoflat.

Th. Mitkoja në një ndarje tjetër ka dhënë fjalë që tregojnë: *Ondërij, a orendij Bulkërie, ondëri*. Këtu kemi ndeshur leksemat sinonimike: *plugu, zëgjedhë-a; sëpatë, toprë-a; qerre, karrocë; litar, kanop; vrapëtorja për karro.*

"*Përdorimi i prapashtesës zvogëluese -zë është dukuri e lashtë e shqipes, ajo na del që tek*

autorët e vjetër”, [189]- shprehet gjuhëtari A. Xhuvani. Tek ky fjalor gjejmë të pasqyruara leksemat e
ndërtuara me anë të ndajshtesës –*zë*, që kanë kuptim zvogëlimi a përkëdhelie, si: *qerrëzë, qerkëzë; nëngojëza*.

Një vend të veçantë zë pasqyrimi i termave që shërbejnë për të pasqyruar: *Aretij, a të mira e të këqija e shpyrti*. Në këtë ndarje vërejmë *përdorimin e vargje sinonimike që janë disi më të përgjithshme brenda sistemit leksikor,*[190]si: *burrëria, trimëria; areti-a, dhuratë-a; të mbajturit, të duruarit; pastra, dëlirëja; pabessia, dinakëria; frikësia, trëmbësia; të dejmë, të dejturit; përitesë, mënesë, vonesë; fjalëria, kopallat; durëlitëjë-a, a bandidhëri-a; gënjeshtëra, ngënjimi, të gënjyerit, dhunë-a; cmiri, zmiri, a resë-a; pikëllimi, hidhërimi, të vrerosurit, tasaja*. Ndeshim përdorimin e fjalëve në të dy variantet dialektore, ku kemi vënë re: dukurinë e rotacizmit**:** dashu**r**ia, dashu**n**ia; më**r**i-a, më**n**ia; dukurinë e sinkopës, si: turp-i, turpëjë-a; por edhe asimilim të grupit të bashkëtingëlloreve, **nd-n**, si: *mendëja, mëndëja, mena*.

Th. Mitkoja u përpoq të shfrytëzonte pasurinë leksikore të shqipes për të dhënë trajta të larmishme që shërbejnë për të pasqyruar tipare të karakterit të njeriut. Ato i arriti së pari, me anë *të ndërtimit të çerdhes fjalëformuese*, p.sh: dashuri, dashurim, ose me kompozita këpujore si zemër-dashuri-a, a njeri-dashuri-a, zemër-dashurë, njeridashurë-i; **besa**, të mbesuarit, mbesimi.

2. Së dyti, me anë të ndërtimeve të çifteve sinonimike me anë të parashtesës *pa-,* ku si tema fjalëformuese për to shërbejnë temat mbiemërore a pjesoret, si*: i parrëfyer – i pakallëzuarë; i paluajturë – i palëvizurë; i paturpeshimë – i pamarëshimë; i panginjuë – i pangopurë; i pan(d)iejshimë – i pashpyrtëmë; i paçporrurë – i palarguarë – i pashtëmangurë; i pa-mundurë – i pamposhturë; i papiellshmë – i papemëshimë,* të pashkuarë-i-t; të pabesëmit, të pandijyerit, të pashpyrtmët.

Gjithashtu ndeshim edhe vargjet sinonimike të ndërtuara me anë të ndajshtesimit e kompozimit, si: *i çalë, i shqepur, çalamn, çalo, këmbë-shtrëmbëri; i përapë, i shtrembërë, fsatarak, i pamësuarë, i paqytetëruarë; i paujëshimë, i terurë, i terëmë, i thatë; i quajturë, i kluajturë, i dëgjua-rë, i përmendurë* etj.

3.Së treti kemi ndeshur një përdorim të larmishëm të kompozitave a shprehjeve që shërbejnë për të dhënë *këto anë të mira a të këqija të shpritit, si: të madhët e zemërës, zemër-madhëri, zemër-begati, begati-zemërë; (të hollët, a të fellët e mëndiës), a hollë-mendëje-ja; gojë-prishëjë, gojë-lëshimi, (goj'e lëshuar- togfj.); bukë-shkelëjë-a, bukë-shkelës-i; derëhapësi-a, derëhapuri-a.*

Si përfundim mund të themi që ky fjalor është fryt i një pune të palodhur, i pasionit e dashurisë për gjuhës shqipe nga Th. Mitkoja. Ai mbart mbi vete vlera leksikografike, pasi është mjaft i pasur me terminologji nga fusha biblike, nga fusha

[189] A. Xhuvani, *Vepra I*, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1980, f. 576.
[190] J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 151.

gjuhësore, gjeografike, nga flora e fauna, po ashtu edhe me leksema që i përkasin jetës së përditshme etj. Për të pasqyruar gjithë këtë pasuri leksikore të shqipes Th.Mitkoja shfrytëzoi përdorimin e çifteve apo vargjeve sinonimike, ku shfrytëzoi variantet dialektore (a krahinore) me ato të mbarë shqipes në disa raste edhe ato të huaja. Gjithashtu kemi vënë re ndërtimin e çerdheve fjalëformuese, të cilat kanë qenë të larmishme në fjalëformime në kuptime.

Së fundi, duam të theksojmë përpjekjen e Th. Mitkos për ndërtimin e formave të reja e zëvendësimin e leksemave të huaja.

Fjalori tri gjuhësh italisht-greqisht-shqip, ka një pasuri të pashtershme leksikore, prandaj ia vlen të nxjerrim në pah këto veçori që ai të radhitet përkrah fjalorëve të tjerë e të zërë vendin që e meriton.

ASLLAN HAMITI (SHKUP)
ISMET OSMANI (SHKUP)

NDIHMESA E THIMI MITKOS NË LEKSIKUN E SHQIPES

Rilindësi i shquar Thimi Mitko, autor i veprës së njohur "Bleta Shqiptare", nuk njihet vetëm si mbledhës i folklorit shqiptar, por edhe si leksikograf i shquar i shqipes me botimin e fjalorëve shqip-greqisht, ku Thimi Mitkoja pasqyron leksikun shqip me një shtrirje më të gjerë gjuhësore të trojeve shqiptare. Në këtë kumtim do të përpiqemi të trajtojmë kontributin e tij në fushën e leksikologjisë dhe leksikografisë, botimin e fjalorit tregjuhësh italisht-greqisht-shqip, në të cilin janë përfshirë shprehje të fushave të ndryshme të jetës, të kulturës, fesë, ekonomisë e të mjedisit shqiptar në shekullin XIX. Fjalori i Thimi Mitkos bashkë me atë të Pulevskit, janë të vetmit fjalorë të shekullit XIX me orientim tematik, të cilët përmbajnë fjalë dhe shprehje që përdoren në ligjërimin e shqipes.

Thimi Mitkoja rilindës i shquar, i njohur si mbledhës i folklorit shqiptar, shkrimtar, poet e gjuhëtar, i cili, pothuajse tërë veprimtarinë e vet e zhvilloi në Egjipt, bashkë me shkrimtarë e poetë të tjerë shqiptarë, si Andon Zako Çajupi, Filip Shiroka, Aleksandër Xhuvani, S. Dine, L. Ligori, M. Duçi etj. Bashkë me ta i vuri detyrë vetes për unifikimin e gjuhës dhe alfabetit të gjuhës shqipe, si një parakusht kryesor për shkollimin, përparimin dhe për qytetërimin e shqiptarëve, rrjedhimisht edhe pavarësinë e shtetit shqiptar. Por, deri në arritjen e këtij qëllimi, Thimi Mitkoja, parapëlqente që toskët të vazhdonin të përdornin alfabetin grek e gegët me alfabet latin, kurse ai vetë bëri një kombinim midis alfabetit grek e atij latin.[191] Por, një gjë e tillë nuk e lë të qetë autorin e "Bletës Shqiptare", i cili nevojën e një gjuhe standarde shqipe e shtron shumë herët, gjë që shihet qartë në shkrimet e De Radës, S. Frashërit, Veqilharxhit, Spiro Dines, L. Gurakuqit, Hilë Mosit, Asdrenit, Konicës etj. Ai thotë se: "një komb nuk mund të dalë me asnjë mënyrë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet" ("Bleta shqiptare", 1878).

Si shumë atdhetarë të tjerë, si Veqilharxhi, Elena Gjika e të tjerë, Thimi Mitkoja mendonte se nuk mund të arrihej bashkimi kombëtar pa përhapjen e arsimit e të diturisë në gjuhën shqipe dhe shtronte si detyrë më të ngutshme përhapjen e shkrimit të gjuhës shqipe në popull e lëvrimin e saj. Kjo detyrë, i nxiti bashkatdhetarët tanë në Egjipt të themelojnë disa shoqata, të botojnë gazeta, si "Toska", "Besa", "Sëpata", "Skrepëtima" etj.; pastaj, libra e broshura, të cilat do të ndihmonin në ngritjen e vetëdijes kombëtare për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe.

Ndërkaq, kur flet për historinë e gjuhës, Thimi Mitkoja, me një përkushtim të madh, përpiqet t'i bindë bashkatdhetarët se gjuha shqipe është një nga gjuhët më të

[191] M. Mufaku - Alarnaut, *Mehmet Ali Pasha në thesarin popullor shqiptar*, Monografi e Degës së Orientalistikës (1973-2013), Prishtinë, 2013, f. 226-237.

lashta të Ballkanit, duke mbështetur tezën për origjinën pellazgjike të shqiptarëve. Thimi Mitkoja shkruante se "shqiptarët janë i vetmi komb autokton i gadishullit të Ballkanit..., një komb me një gjuhë dhe histori të tijën".

Thimi Mitkoja deri vonë u konsiderua vetëm si mbledhës i folklorit. Ai shëtiti në shumë vendbanime shqiptare të Egjiptit, duke mbledhur fjalë të urta e këngë historike e të tjera që dëshmojnë kulturën origjinale që e kanë shqiptarët, me qëllim që me botimin e tyre "t'u jepet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën… që të mundin edhe këta të përparojnë".[192] Përveçse me folklor, ai u mor edhe me shkrime të tjera, ku preokupim kryesor kishte krijimin e një kulture kombëtare shqiptare, për unifikimin e gjuhës dhe të alfabetit, gjë që shihet qartë në letërkëmbimet me patriotët e kohës, me De Radën, Abdyl Frashërin e bashkëmendimtarë të tjerë, qëllim i të cilëve ishte bashkimi i të gjithë shqiptarëve. Një gjë e tillë duket qartë në veprën e tij "Bleta shqiptare", *me krahë të miqëvet, do të shërbenjë e do të punonjë për gjithë këto punëra për të bashkuarë muhametanëtë e të krishterët shqyptarë, për të helqurë me ne, shqypëtarët e Eladhës edhe për të ndërtuarë gjuhën tonë*.[193]

Dokumentet arkivore, por edhe letërkëmbimet me rilindësit shqiptarë, dëshmojnë punën e palodhur të Thimi Mitkos për mbledhjen e leksikut të shqipes dhe hartimin e fjalorëve. Thimi Mitkoja grumbulloi një fond të pasur fjalësh dhe shprehjesh shqipe të rrethit të Korçës. Kështu, kontaktet me bashkatdhetarët dhe miqtë e tij në Egjipt, udhëtimet e shpeshta në vendet ballkanike (Bullgari, Turqi, Rumani), letërkëmbimet me patriotët e kohës, rilindës të tjerë e gjuhëtarë, të cilëve vazhdimisht u kërkonte libra që botoheshin në gjuhën shqipe, bëri që Thimi Mitkoja të zgjojë interesimin për mbledhjen e leksikut të shqipes.

Bashkë me mbledhjen folklorit, ai bëri edhe mbledhjen e leksikut të gjuhës shqipe, punë kjo që e bën me një zell e përkushtim të madh edhe në Egjipt. Botimet e tij në gazetën greke "Pandora" janë një dëshmi e mirë e punës së palodhur të Mitkos në mbledhjen e materialeve gjuhësore. Ai përmes artikullit me titull "Rreth Korçës" të botuar po në këtë gazetë më 1 janar të vitit 1860, polemizon me historianin grek për shtrembërimet historike që i bën qytetit të Korçës. Përveç kësaj, në të përfshihet edhe një shkrim me titull "Leksikografi greko-shqiptare", me atë rast shpjegon kuptimin e shumë fjalëve (afro 80).

Fryt i punës së tij të palodhur në mbledhjen e leksikut shqip nga të gjitha trojet kombëtare shqiptare, është edhe fjalori, në botimin e të cilit thotë se e ka ndihmuar një shqiptar i Greqisë. Lidhur me përdorimin e disa fjalëve shqipe, si: *prift, uratë, zonë, krijues, bërës* etj., Th. Mitkoja i shkruan K. Kristoforidhit: "Por megjithatë një herë e një kohë unë e kam studiuar gjuhën tonë dhe kam mbledhur disa fjalë shqipe,

[192] Thimi Mitko, *Vepra*, parathënja e "Bletës shqiptare", Tiranë (Institut i kulturës popullore), 1981, f. 61.
[193] I. C. Fortino, *Sami Frashëri Jeronim de Radës:* Shënime rreth një letre: (rreth alfabetit të shqipes dhe gjuhës letrare), Perla nr. 2, Tiranë, 2004, f. 57-67.

të cilat do t'ua dërgoj kur të më dalë rasti. Ndoshta ato do të jenë të vlefshme për fjalorin tuaj të gjuhës shqipe". Th. Mitkoja, pothuajse punon në të njëjtën kohë me K. Kristoforidhin në hartimin e fjalorëve dhe, të dy së bashku, japin një kontribut të çmuar në lëvrimin e shqipes së kohës. Në mbledhjen e materialit gjuhësor për hartimin e fjalorëve edhe Thimi MitkoJA edhe K. Kristoforidhi, përpiqen të jenë të saktë në fjalën e shënuar. Ky i dyti niset nga Jugu e shkon në Veri të Shqipërisë, ndërsa tjetri një pjesë të mirë të leksikut e merr nga bashkatdhetarët gegë e toskë të emigruar në Egjipt.

Në fjalorin dyvëllimësh, në tri gjuhë "italisht-greqisht-shqip", Thimi Mitkoja ka regjistruar dhe na ka lënë trashëgim mjaft fjalë dhe shprehje nga fusha të ndryshme të jetës, të kulturës, fesë, të ekonomisë e të mjedisit shqiptar në shekullin XIX. Ky fond i pasur fjalësh pasqyrojnë mënyrën e jetesës së mjedisit shqiptar. Ky fjalor ka vlera të rëndësishme për njohjen e shqipes së shekullit XIX, sepse jep fjalë të rëndësishme të ligjërimit popullor dhe libror.

Thimi Mitkoja, si njohës i mirë i gjuhëve greke dhe italiane, i rreket kësaj pune të mundimshme, por mbi të gjitha kombëtare e kulturore, që ngërthen në vetvete frymën e bashkëpunimit dhe miqësisë midis këtyre tre popujve (shqiptarëve, grekëve dhe italianëve). Fjalori është botuar në dy vëllime: në vëllimin e parë kemi fjalor bisedimor italisht-greqisht-shqip, ndërsa në pjesën e dytë është botuar transliterimi i fjalëve në gjuhën shqipe. Fjalorin "Italisht-greqisht-shqip" Mitkoja e ka botuar në tri kolona, duke filluar me italishten, pastaj me greqishten dhe në kolonën e tretë ka dhënë fjalët në gjuhën shqipe. Në fjalor, Th. Mitkoja në pjesën tematike *mbi kishën* ka përfshirë mbi 55 fjalë shqipe të terminologjisë fetare, të cilat është përpjekur t'i shqipërojë, si p.sh.: *therrore për altar, shenjëtore-ja* për *il antuario, ujë të bekuar* për *aqua benedetta, kryearti* për *il patriarca, kryepeshkëvë* për *arvicesco* etj.

Fjalët e huaja (turke, arabe, greke, italiane, por edhe sllave), ndonëse të tepërta dhe të pavlefshme, siç i ka quajtur ai, janë të shumta. Në fund të përmbledhjes, Th. Mitkoja ka botuar edhe një fjalor, ku janë përfshirë shumë fjalë nga turqishtja, arabishtja dhe greqishtja, si: *adalet, dalie, allçak, byrinxhik, dylber, gairet, hajmali, heqim, karagrosh, karaull, vilaet* etj.; arabisht: *hallall (helal), sure;* greqisht: *adha* (idh), *andarë, dhimarh, faneksem, fyset, gjyftiko;* italisht: *maqel,* sllavisht: *pogonatat, prezore, porez* etj.[194]

Nga fjalori shihet qartë se huazimet turke janë të shumta edhe në këngët e botuara në përmbledhjen "Bëleta Shqypëtare":

"O vellëzer shqypëtarë, pse duroni halldupne?
Mblidhi turq e te krishterë, kërkoni leferinë
Përpiqi si tjatër herë, e përzini tyraninë".[195]

[194] *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar* (1635-1912) II, Tiranë, 1961, f. 337-349.
[195] Th. Mitko, *Vepra*, f. 284.

Në këngën kushtuar Mehmet Ali Pashës: "gjithë krajlete e dinë" se "Mehmet Aliu është nj'akran" dhe se "Ibrahim pashën e ka nj'asllan", duke theksuar se ata që bërën të dytë ishte me "urdhër të Perëndisë".[196]

Në fund të veprës, Thimi Mitkoja pasuron veprën e tij edhe me një kapitull të studimeve të antroponimisë shqiptare "të besimit muhamedan dhe të krishterë", me të cilin gjithashtu hapte fushën e kërkimeve onomastike në studimet albanologjike nga radhët e albanologëve vendorë.[197] Ai, në shumë shkrime të tij, jep shpjegime etimologjike për shumë toponime shqiptare. Mitkoja boton në gazetën "Flamuri i Arbërit" (1884) toponime nga krahina e Korçës dhe përreth saj. Po në këtë gazetë, në vitin 1886 boton disa artikuj për disa toponime të Shqipërisë Jugore dhe të Mesme, të cilat përkonin me toponimet arbëreshe.

Hartimi i fjalorëve shumëgjuhësh tematikë në shekullin XIX ka qenë praktikë e shpeshtë në Ballkan e në Evropë. Përveç Thimi Mitkos, një fjalor tematik trigjuhësh ka shkruar edhe Gjorgji Pulevski. Mendojmë se dy fjalorët trigjuhësh të shekullit XIX, ai i Mitkos dhe ai i Pulevskit, meritojnë një trajtim krahasues. Me këtë rast, meqë Pulevski është pak i njohur ndër shqiptarë, e quajmë të dobishme të japim pak të dhëna për të dhe fjalorët e tij.[198]

Gjorgji Pulevski (1822/23-1893) njihet si leksikograf dhe poliglot. Lindi në Galiçnik, katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës në Maqedoni, vdiq në Sofje. Vetëm fëmijërinë e hershme (deri në moshën kur kishte shtatë vjet) e kaloi në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesën tjetër të jetës e kaloi në kurbet, përkatësisht në Rumani (në vendin e quajtur Turno-Mogurell), Serbi (Beograd) e Bullgari (Sofje). Mori pjesë në disa luftëra e kryengritje serbe, bullgare e maqedonase kundër perandorisë osmane (në anën e rusëve në luftën ruso-turke (1877/78); mori pjesë në kryengritjen e Kresnenit në Maqedoninë Lindore (në tetor të vitit 1878); në vitin 1878 ishte prefekt i Qustendillit, në shoqërinë letrare sllavo-maqedonase me seli në Sofje. Në vitin 1888 Pulevski ushtroi detyrën e kryetarit. Vdiq dhe u varros në Sofje (1895). Ai qe autodidakt, murator, por la gjurmë si leksikograf. Botoi dy fjalorë shumëgjuhësh: a) Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe b) Fjalor bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875. Fjalori katërgjuhësh ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe. Fjalori tregjuhësh është i tipit pyetje - përgjigje, që mund të quhet fjalor bisedimor, i ndarë në 74 çerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme.

Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional (tani të serbishtes e rusishtes), ndërsa në Fjalorin trigjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit. Si vepra të shkruara në shekullin XIX, kanë rëndësi të

[196] *Th.* Mitko, *Vepra*, f. 293.
[197] Shih: *Bleta Shqiptare*, 1878.
[198] Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.

madhe dhe mund të shfrytëzohen si material burimor i kohës për të trajtuar çështje gjuhësore, kulturore e historike.[199]

Fjalori trigjuhësh dallohet shumë nga Fjalori katërgjuhësh, sidomos për nga forma. Fjalori trigjuhësh nuk është fjalor klasik ose fjalor fjalësh, por i tipit pyetje – përgjigje, që mund të quhet fjalor bisedimor. Në të kemi paralele trigjuhësore me fjali e periudha të tëra, pra me tekst të kontinuar. Ky libër i përgjigjet një enciklopedie të kohës me njohuri të llojllojshme nga besimi, filozofia e jetës, historia, gjeografia etj. Sipas Bllazhe Koneskit, Pulevski në 91 faqet e para të Fjalorit trigjuhësh ka shfrytëzuar në tërësi (me ndonjë ndryshim të vogël e përshtatje) tekstin e Kuzman Shapkarevit (1834-1909) "Mësimet fillestare për fëmijët e vegjël", botuar në Stamboll në vitin 1868.[200]

Fjalori bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht i Gjorgji Pulevskit ndahet në tema të ndryshme me sfera të veçanta leksikore. P.sh. ka një hyrje, pastaj shkruhet për vetitë psiko-fizike të njeriut, për bimët e kafshët, për xehet dhe lëgurat, për kontinentet e botës, yjet, për fenomenet natyrore, për banorët e mjakut etj.

Model për përpilimin e fjalorëve bisedimorë, si Mitkoja ashtu edhe Pulevski, kanë mundur të gjejnë edhe në bisedat dhe dialogjet e veçmas në kuvendet e popujve të Ballkanit. Për këtë është e njohur sidomos oda shqiptare e quajtur edhe si "fakultet i popullit", sidomos atëherë kur përvoja njerëzore, dija, trashëgimia mendore e kulturore është bartur vetëm përmes traditës gojore.

Krahas burimit të zbuluar për 90 faqet e para të Fjalorit trigjuhësh, është konstatuar se Pulevski ka shfrytëzuar edhe modele të tjera. Kështu, prej faqes 93 deri në faqen 128 hetohet se Pulevski ka shfrytëzuar ndonjë shkrim serb, që vërehet sidomos në modelet gjuhësore. Nga faqja 127-157 gjendet një regjistër fjalësh sipas alfabetit, të hartuar nga autori.

Fjalori trigjuhësh (Fjaltor nka tre g-juha) i Pulevskit ka gjithsej 162 faqe tekst të shkruar me pyetje-përgjigje në tri kolona: sllavisht (maqedonisht), shqip dhe turqisht me fjali e periudha të tëra. Kjo mënyrë e hartimit të fjalorit mundëson të bëhet vështrim mbi strukturën gjuhësore të këtij fjalori. Pastaj, nga ky, mund të bëhen përgjithësime për tërë gjuhën shqipe të regjistruar nga Pulevski, edhe pse fjalori katërgjuhësh nuk është i këtij tipi.

Fjalori në fjalë fillon me një bisedë (maq. razgovor, shqip kuvend dhe turq. muhabet) dhe mandej vazhdon me pyetje (maq. pitanje, shq. pjutmea e turq. suval) dhe përgjigje (maq. odgovor, shq. u prxheq e turq. xhuvab).

Në të dy fjalorthët shumëgjuhësh të Gjorgjit kolona e maqedonishtes së përzier me gjuhë të tjera sllave është bazë, e cila është përkthyer në dy-tri gjuhët e tjera. Mirëpo, në Fjalorthin trigjuhësh, autori herë-herë i është shmangur paraleles maqedonase, duke u përpjekur ta ruajë origjinalitetin e çështjeve që shtjellon,

[199] Po aty, f. 13-220.

[200] Блаже Конески, *Македонистот Ѓорѓи (Ѓорѓо) Пулевски,* Кон македонската преродба, Скопје, 1959, f. 90.

varësisht nga gjuha në të cilën shkruan. Kështu, bie fjala, në f. 49, kur bën fjalë për popujt dhe atdheun e tyre, në shtyllën e maqedonishtes thotë se: maqedonasit janë popull dhe se atdheu i tyre quhet Maqedoni, ndërkaq në paralelen e përkthyer në shqipen shkruan se shqiptarët janë popull që jetojnë edhe në Maqedoni: maqedonisht: *"Taka i makedoncive se narod i mestovo njihovno je Makedonija.* Shqip: *Ashtu ede shkipitarat jan njeraz ede vendin etijse po thijn Makedonija, cili po roin aqe."*

Nga faqja 41-48 e Fjalorit trigjuhësh të Pulevskit, trajtohen çështje për ardhjen e sllavëve në Gadishullin e Ballkanit, ndarjen e tyre në popuj, vendosjen e tyre, degëzimin dialektor të maqedonishtes etj. Teksti është shkruar vetëm në maqedonisht, pa u përkthyer fare as në shqip e as në turqisht. Gjykojmë se kjo pjesë nuk është përkthyer, sepse autorit i është dukur se kjo tematikë është e parëndësishme për shqiptarët dhe turqit.

Fjalori trigjuhësh "italisht-greqisht-shqip" i Thimi Mitkos, vështruar në retrospektivën kohore, ka rëndësi të madhe ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Konstatimin e dhënë mund ta mbështesim në disa shtylla:

- Fjalori i Mitkos paraqet një enciklopedi të mendësisë së kohës, të gjuhës e të kulturës së shekullit XIX.

- Fjalori pati karakter praktik, d.m.th. u hartua për nevojat praktike të popullatës që dinin italisht, greqisht e shqip, për të mësuar këto tri gjuhë e për komunikim të ndërsjellë, për njohjen reciproke të gjuhëve dhe kulturave, por edhe për afrimin e tyre. Komunikimi i njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme është më se i nevojshëm. Të përkujtojmë me këtë rast konstatimin e njohur të gjuhëtarëve se, njohja e disa gjuhëve ka pasoja pozitive edhe në inteligjencë. Përvoja në dy e më tepër sisteme gjuhësore ndikon që personi i tillë të ketë fleksibilitet më të madh mendor, superioritet në përpilimin e ideve si dhe shumë më tepër zgjedhje të aftësive mendore nga njeriu që di vetëm një gjuhë. Njeriu që zotëron disa gjuhë e vështron botën në disa aspekte të ndryshme. Në fund, mesi me dy e më tepër gjuhë e kultura mundëson që njohësi i këtyre gjuhëve të fitojë përvojë më të pasur e më të llojllojshme, prandaj, bashkëjetesa, kontaktet e përditshme të popullatës në tokat shqiptare, greke e italiane ndërmjet folësve të disa gjuhëve ka krijuar domosdshmërinë e hartimit të fjalorëve shumëgjuhësh.

- Nga fjalorët del konstatimi se gjuhët duhet të jenë të barabarta, d.m.th. duhet zbatuar dygjuhësia e shumëgjuhësia e jo diglosia, qëndrim ky më i drejti për mjediset shumëgjuhësore. Nuk është e rastit zgjedhja e gjuhëve: italisht, greqisht, shqip.

- Fjalori ka rëndësi leksikografike, meqë përbën një nga hallkat në vargoin e historisë së leksikografisë shqiptare.

- Fjalori tregjuhësh i Mitkos ka rëndësi gjuhësore, sepse këtu e gjejmë një variant të shkruar të shqipes së shekullit XIX. Aty na paraqiten disa forma të vjetra të shqipes, ka tipare të të folmes së qarkut të Korçës, tipare gjuhësore të të folmeve të tjera toske, një numër të vogël veçorish gjuhësore të të folmeve gege. Shqipja e Thimi Mitkos siguron një material të shkruar për të vëzhguar gjuhën dhe stilin e tij,

për të parë një variant të shkruar të shqipes së shekullit XIX e, bashkë me shkrimet e tjera të kohës, për të plotësuar rrjedhën kohore të zhvillimit të shqipes, historinë e shqipes së shkruar e historinë e gjuhës në përgjithësi. Fjalori i Mitkos gjithashtu na siguron një material të vlefshëm për të parë ndikimet ndërgjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve dhe shqipes.

- Fjalori "italisht-greqisht-shqip" i Thimi Mitkos ka jo vetëm vlerë gjuhësore e përgjithësisht kulturore, por edhe vlerë historike jo vetëm për shqipen e shqiptarët, por edhe për italishten e italianët, për greqishten e grekët.

Ndihmesa e Mitkos për leksikun e shqipes nuk mjafton të trajtohet në një shkrim të këtij tipi. Ne vetëm jemi përpjekur të përmendim shkurtimisht disa nga pikëpamjet tona për rëndësinë e fjalorëve të tij, por, mbetet që në të ardhmen, fjalësi i Mitkos të studiohet në mënyrë më të thelluar e më të zgjeruar.

BAHTIJAR KRYEZIU (PRISHTINË)

FJALA SHQIPE NË SYNORIN E THIMI MITKOS

Krahas çështjeve politike, shkencave historike, etnologjike e posaçërisht atyre folkloristike, me të cilat u mor Thimi Mitkoja, si njohës i mirë i greqishtes, frëngjishtes, gjermanishtes, italishtes e arabishtes, me zell të madh iu rrek edhe problemeve të shqipes. "Alvaniqi melisa" – "Bletën shqiptare", një manifest i kohës, përveç 490 proverbave, 80 gjëegjëzave, 359 këngëve, një morie të mirë frazash përshëndetëse, emra personash të krishterë e muhamedanë, Mitkoja e shoqëroi "Bletën" edhe me një fjalor prej 950 fjalësh të huaja, siç ishin fjalët turke, greke, sllave etj., të cilat kishin hyrë në shqipen si egjra në grurë, e të cilat studiuesi ynë, jo vetëm që u përpoq të shpjegojë etimologjinë e tyre dhe të fjalëve të tjera, të futë ndonjë fjalë shqipe, por bëri edhe studime krahasimtare fjalësh me indoevropianishten.

Me gjithë shpirtgjerësinë e tij ndaj fjalëve e shprehjeve të huaja, Mitkoja, duke shfrytëzuar pasurinë e madhe të shqipes, koloritin dhe funksionalitetin shprehës të saj, nga mbarë atdheu, në gjuhën e tij hetohet një dozë purizmi, duke u përpjekur të zëvendësojë fjalën e huaj me neologjizma që i krijoi vetë, në mbështetje të natyrës së gjuhës sonë, si fjala vjen: ditëtore (për gazetën), qindore (për shekull), etj., siç vëren me të drejtë studiuesi ynë i njohur, Qemal Haxhihasani.

Universiteti i Korçës duket se e ka bërë traditë shënimin e ngjarjeve historike e kulturore, të botimit të veprave të rëndësishme, të përvjetorëve e të figurave më të shquara të historisë e të kulturës sonë. Edhe në këtë vit, kur po mbushen 195 vjet të lindjes dhe 125 vjet të vdekjes të folkloristit më të madh shqiptar, patriotit të shquar, punëtorit të palodhur deri në vdekje për çështje të mbara e për përparimin e popullit tonë, ky universitet, ka organizuar këtë Konferencë Shkencore Ndërkombëtare për të kujtuar dhe një herë rilindësin tonë të shquar, Thimi Mitkon[201].

[201]Të shënosh përvjetorin e ndonjë ngjarjeje, vepre a të ndonjë burri e dijetari të madh, nuk është vetëm nder, por edhe detyrë jona, si dje, ashtu dhe sot e nesër. E kur është fjala për një studiues i cili gati një jetë njeriu ia kushtoi çështjeve tona: çështjeve politike, shkencave historike, etnologjike e posaçërisht atyre folkloristike e gjuhësore, borxhi është edhe më i madh. Këtë obligim kësaj here, po e përmbush Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës (siç e ka bërë edhe herëve tjera - thuaja traditë), duke organizuar edhe këtë Konferencë shkencore – me rastin e 195-vjetorit të lindjes dhe 125-vjetorit të vdekjes së Thimi Mitkos.

Të freskëta i kemi konferencat shkencore mbarëkombëtare (e ndërkombëtare) për Kongresin e Manastirit (2008), për Kongresin e Drejtshkrimit (2012), atë për profesor Selman Rizën (2009), për akademik Jani Thomain (2010) etj., aktivitete shkencore këto, të cilat janë për lakmi dhe si shembull edhe për institucionet e tjera arsimore e shkencore, të cilat po i organizon dhe përkrah kurdoherë Universiteti i Korçës, të iniciuara kryesisht nga profesori e pasionanti i palodhur i këtij tempulli të dijes, Prof. dr. Ali Jashari, për çka meriton, më së paku thënë – falënderimet dhe përgëzimet tona më të sinqerta.

Shekulli XIX mbetet ndër epokat më të bujshme të historisë së popujve evropianë e ballkanikë, e në veçanti për shqiptarët. Romantizmi në kulturë e në ideologjinë e këtyre popujve për pasojë solli lëvizjet e mëdha çlirimtare të popujve të robëruar, të cilët, në përpjekjet për mëvetësinë kombëtare, nxitonin, jo vetëm t'i vinin në pah, por edhe t'i realizonin virtytet kombëtare, ta afirmonin veten dhe historinë e tyre të lavdishme në mënyrë sa më të denjë, ndonëse ndonjëherë synimet e tilla kaluan kufijtë e arsyes, saqë disa nga popujt fqinjë edhe i mbivlerësuan veçoritë e tyre kombëtare duke i vërë ato mbi të tjerët, e sidomos mbi ne shqiptarët.

Megjithëkëtë, edhe pse në kushte e rrethana të tilla, krahas të tjerëve, edhe inteligjenca jonë, në pjesën më të madhe, diti të shfrytëzojë momentin paksa më të përshtatshëm, duke treguar një vigjilencë më të lartë në luftë për ekzistencën e popullit tonë, për shpëtimin e tij nga rrebeshet e shekullit XIX. Prandaj, përpos agjitacionit të madh që bëri për ngritjen e shtresave të gjera në luftë çlirimtare, ajo plejadë intelektualësh nxitoi dhe ia doli të kontribuojë në hapjen e shkollave shqipe brenda e jashtë atdheut, në formimin e shoqërive kulturore e patriotike, në sensibilizimin e çështjes sonë kombëtare etj.

Në këtë konglomerat veprimtarie u dallua posaçërisht Thimi Mitkoja, i cili me punë të zellshme në mbledhjen e vlerave folklorike të popullit tonë nga viset e ndryshme të shqiptarisë, me organizimin e shoqërive patriotike shqiptare në Misir, me korrespondencën shumë intensive që zhvilloi me shumë fytyra të shquara të kulturës e të politikës sonë si edhe me ato të Evropës, veçmas me albanologët më të shquar të kohës, me disa artikuj që botoi nëpër të përkohshmet shqipe dhe të huaja përkitazi me gjendjen e atdheut të robëruar, me disa poezi origjinale, dha një kontribut shumë të madh, madje edhe të rrallë, për kulturën kombëtare dhe për çështje të tjera me interes për kombin tonë.

Edhe pse nuk dimë të ketë mbaruar ndonjë shkollim të lartë, falë interesimit dhe punës së palodhur, të leximit të pareshtur e me pasion të veprave letrare e gjuhësore të Jeronim de Radës, Kristoforidhit, Naimit e Samiut, të Dora d'Istrias, Dhimitër Kamardës, të Hanit, të U. Jarnikut e të tjerëve, Mitkoja arriti të fitojë një diapazon të gjerë diturish nga më shumë fusha të jetës e të shkencës.

Qëndrimet e tij nëpër qendra të rëndësishme ballkanike e evropiane: në Athinë, pastaj në Plovdiv të Bullgarisë, në Vjenë të Austrisë (edhe për të siguruar kafshatën e gojës), deri atëherë, kur kah viti 1860 kalon në Misir, nuk qenë edhe pa rëndësi. Sidomos qëndrimi i tij në Vjenë, ngjan të ketë qenë i një rëndësie të veçantë për veprimtarinë e tij të mëtejme, sepse atje duket të ketë lexuar veprën e Hahnit "*Studime shqiptare*", të botuar më 1854 dhe "*Net pellazgjike*" të Rajnhaldit, të botuar më 1855. Po ashtu, besohet se do të ketë rënë në kontakt edhe me studimet e Boppit, veçmas ato që kishin të bënin me filologjinë krahasuese etj., probleme këto të cilat do të bëhen preokupim i vazhdueshëm i Mitkos, krahas mbledhjes dhe studimit të materialit folkloristik që i kishte vënë vetes për mision.

Një punë të mirë e të mbarë Mitkoja bëri, sigurisht, edhe për gjuhën shqipe. Botimi i përmbledhjes së tij "*Alvaniqi melisa*" ("*Bleta shqiptare*", Aleksandri, 1878), bëri bujë të madhe, jo vetëm në qarqet dhe tek intelektualët shqiptarë, por edhe në sytë e albanologëve të huaj të asaj kohe, të cilët në këtë vepër gjetën brumë të pasur për të argumentuar e mishëruar studimet e tyre gjuhësore. "Bleta", sigurisht, siç shprehet edhe Dh. S. Shuteriqi, *"shërbeu si model i një shqipeje të bukur e të pasur"*[202]. Me botimin e kësaj vepre u dëshmua dhe njëherë para botës se shqiptarët kanë gjuhën e tyre kombëtare, kulturën shpirtërore të pasur, historinë e lavdishme të përjetësuar përmes traditës popullore dhe se nuk janë as turq, as grekë, e as ndonjë soj tjetër, siç do të thoshin disa individë nga popuj e vende të caktuara.

Preokupimi i Mitokos për nxitjen e bashkatdhetarëve që të dinë të përdorin gjuhën e fjalën shqipe "për të studiuar gjuhën e tyre", shprehet qartë te *Parathënia* e vëllimit të tij "*Bleta shqiptare*", ku ai, përveç për traditën tonë në përgjithësi, pykëzohet edhe te rëndësia e studimit dhe e njohjes së gjuhës amtare. Këtë e përligj me fjalët: "*Qëllimi i "Bletës Shqyptare", d.m.th. i këtyre studimeve albanologjike, është përgjithësisht, shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë, i fjalëvet dhe tekstevet shqipe, të cilat para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime dhe besoj se do të kenë një vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare; veçanërisht dua që t'u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën dhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë t'u sjellë dobi që të mundin edhe këta të përparojnë*" [203].

Që "*Bleta shqiptare*" shquhet edhe për vlera gjuhësore, të shpërfaqura nga Mitkoja, e dëshmon edhe një vlerësim i studiuesit tonë të çmuar, Qemal Haxhihasani, i cili, në një vend vë në dukje edhe këtë komponent të rëndësishëm, duke u shprehur se "*Bleta*" qe njëkohësisht një monument kulture, dëshmi e shkëlqyer e një trashëgimie shumë të pasur mendore, morale e shoqërore, monumenti më i qartë i ekzistencës së shqiptarëve si komb. Për hapat e para që hidhte në atë kohë letërsia jonë artistike, kjo dëshmi e madhe e letërsisë popullore", zgjonte jo vetëm një frymë politike kombëtare, të lidhur me konceptin e pavarësisë, por edhe një model të përsosur të gjuhës artistike"[204].

Përpos shkrimtarëve e dijetarëve tanë, si: Dhimitër Kamarda, Konstandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Aleksandër Xhuvani,... etj., interesimi për shqipen lind edhe te studiuesit e huaj, të cilët, nga ato njohuri që kishin në kohën kur edhe jetuan e vepruan, sa për të ndriçuar probleme të shqipes, të historisë e të kulturës së popullit shqiptar, po aq edhe për interesa të tyre studimore, merreshin edhe me shqipen - studimet krahasimtare të gjuhëve indoevropiane, ku bën pjesë edhe

[202] Dhimitër S. Shuteriqi, *Histori e letërsisë shqipe* (Për shkolla të mesme), ETMM i Kosovës, Prishitnë, 1969, faqe 122.

[203] Shih: Instituti i folklorit - Sektori i folklorit letrar: Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635 – 1912), vëllimi II, Tiranë, 1961, faqe 12.

[204] Shih: Qemal Haxhihasani, Thimi Mitko (1820 – 1890), në vështrimin *Jeta dhe vepra*, te Thimi Mitko, Vepra, ASh e RPS të Shqipërisë (Instituti i Kulturës Popullore), faqe 46-47.

gjuha shqipe. Në këtë kontekst, edhe botimi i "*Bletës shqiptare*" nuk kaloi pa u vërejtur, pa jehonën e tij. "Albanologë të njohur si Gustav Majeri, J. U. Jarniku, Holger Pederseni etj., ... e bëjnë materialin e këtij vëllimi objekt të studimeve të tyre, ose e shfrytëzojnë për dokumentimin e punimeve gjuhësore dhe folklorike që botojnë"[205] – thotë me të drejtë studiuesi ynë Q. Haxhihasani.

Në *Parathënien* e veprës së tij, të "*Bletës shqiptare*", Mitkoja, duke qenë i bindur për rëndësinë e madhe që ka gjuha për një popull, ashtu si dhe bashkëkohësit e tij, nëpërmjet fjalëve të Herderit, thekson: "Një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveçse duke punuar gjuhën e vet: "Gjuha amtare është ushqimi i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit"[206]. Çështjen e gjuhës, ai e lidh ngushtë me atë të ekzistimit ose jo të popullit shqiptar. "Në qoftë se lihet Shqipëria në padijen e saj, pa shkronja vendi edhe pa shkolla të popullit, atëherë sllavët me mjete më të forta e më praktike do të shpejtojnë për të gëlltitur racën shqiptare" – thotë ai[207]. Këtë shqetësim të tij, duke e parë diturinë, gjuhën, si një armë të fortë ndaj pushtuesit, në një vjershë të gjatë: *"Nxitje mbë shqiptarët për të shkruar gjuhën e tyre*", ai shprehet:

"Shqiptarë trima jeni,
Po ju lypset dituria
shkronja të gjuhës s'keni,
ndaj ju zuri prapësira!..."

"*Bleta shqiptare*", siç dihet, përbëhet prej 490 proverbash, 80 gjëegjëzash, 359 këngësh, një morie të mirë frazash përshëndetëse në kohë të ndryshme të ditës dhe të takimit të njerëzve, emra personash të krishterë e muhamedanë, mbiemra femërorë dhe një fjalor prej afro 950 fjalësh të rralla e të panjohura.

Kjo është edhe një dëshmi më tepër se atë që sot nuk po e bëjnë për fjalësin e shqipes (qofshim gabim) dy akademitë tona, dy institutet e gjuhësisë, sa universitete publike e private, sa e sa katedra të gjuhës shqipe, në epokën e Rilindjes, në rrethana më të ngushta të dijes e në kushtet e një teknologjie e mundësie komunikimi shumë më të vogël se këto të sotme, e bënin rilindësit tanë. Nocionet e reja, fjalët e reja, togfjalëshat, terminologjitë që krijuan rilindësit tanë, si: Thimi Mitkoja, P. Vasa, e sidomos N. Veqilharxhi, J. Vretoja, K. Kristoforidhi, Sami Frashëri etj., siç thotë R. Qosja, "shënojnë fillimin e krijimit të gjuhës diturore shqipe, si pjesë përbërëse e gjuhës kombëtare letrare. Zhvillimi sasior dhe cilësor i leksikut të shqipes nga rilindësit e ka shpejtuar procesin e zhvillimit dhe të përsosjes së gjuhës shqipe[208], për të shtuar më tutje se "keqardhje edhe me të madhe për përzierjen e gjuhës shqipe me fjalë të huaja e shpreh Thimi Mitkoja, në letrën që i dërgon Dhimitër Kamardës, në të cilën përpos të tjerash shkruan: "Fjalët

[205] Shih: Qemal Haxhihasani, vepra e cituar, faqe 48.
[206] ASh e RPS të Shqipërisë (Instituti i Kulturës Popullore), Thimi Mitko, *Vepra*, Tiranë, 1981, faqe 61.
[207] Vepra e cituar, faqe 62.
[208] Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe* (Romantizmi I), Prishtinë, 1984, faqe 163-166.

turqisht, arabisht, sllavisht, etj., që kanë hyrë fshehurazi në gjuhën tonë, janë krejt të tepërta, të pavolitshme e keqtingllonjëse. Prandaj fjalë të këtilla, të një origjine të huaj populli shqiptar duhet t'i hedhë poshtë, sepse jo vetëm krejt të tepërta dhe vrasin veshin, po edhe bastardojnë gjuhën. Thimi Mitkoja ndihmoi zhvillimin e shqipes me përdorimin e fjalëve të rralla, me krijimin e fjalëve të reja, me përdorimin dhe popullarizimin e fjalëve të krijuara të autorëve të tjerë etj.[209]

Që Mitkoja e kishte në shpirt fjalën shqipe, duket edhe nga korrespondencat që kishte me bashkëpunëtorët e miqtë e vet. Në veçanti dertin ia qante dhe ndihmë i kërkonte mikut të tij, Dh. Kamardës, siç shihet, kur nga Kajroja, më 1868, i shkruante: "... Për andai, do të ishte një punë e mirë, edhe e vlefshime për shqiptarët, ndë munt të jepshe ka Italia një gazetë vetëm Shqip". Kurse, më 1877 edhe Thimi i shkruante për nevojën e ngritjes së një shtypshkronje në Misir për të"tiposur vivlla" në gjuhën amtare dhe për hapjen e shkollave shqipe në atdhe.

"Fjalori i "*Bletës*" me materialet që përmban, me shënimet etimologjike, shpjegimet e kuptimit të fjalëve, me vërejtjet e ndryshme gjuhësore, përfaqëson një punë filologjike me interes... Me fjalorin e "*Bletës*" dhe me shënimet e tjera që njohim nga shkrimet dhe letërkëmbimet e tij, mund të formohet një ide e qartë për gjerësinë dhe karakterin e veprimtarisë së zhvilluar nga studiuesi ynë në fushën e gjuhësisë"[210].

Puna e Mitkos, për të pasur një fjalës më të begatë të shqipes, mbështet te:

- zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë shqipe (*të ndezur, rëndim, ngasëje, brengë* – për *bela; ngrëjtëje, paditëje, qarëje* – për *duva*; *zell, sillë ndezë*... – për *gajret*; *luar, vështor, tuajtës, shikues* – për *karaull*;

- futja e fjalëve dhe e shprehjeve të rralla në gjuhë nga të folmet e ndryshme (*shtresë, shkorsë, plis* – për *dyshek*; pastaj fjalët: *befas, stringël, udhëtar, sulm, verore* etj.;

- funksionalizimi dhe pasurimi i gjuhës përmes fjalëve me kuptime të reja: *dije, vërvitje, dëshmoj, detyrë, ndërtesë, dhëmbje*...;

- formimi i fjalëve përmes fjalëformimit, mbështetur në rregullat e shqipes, si: *ditëtore* – për *gazetë*, *vetëdijë, vetënjohje, padije, paditje, pemëtar, gushore a rrethgushe* – për *gjerdan*, *tymës* – për *duhan*, *qethës* – për *berber, fallëtonj, parëflas, qindore-ja, qindvjete-ja, jetë-a* etj.;

- përpjekjet e tij për shpjegimin etimologjik të fjalëve: *vigje* – nga folja *vras*, *bigë* - nga *bigë; i belbër* - nga latinishtja *balbus*; *gardinë* – nga lat. *hortus*[211]*, nogiti,* të cilën me dyshim e bie nga bullgarishtja "*noxhice*" – për gërshërë; pra, duke krahasuar shumë gjuhë fqinje dhe indoevropiane etj., që është një dëshmi e fortë për të treguar elanin dhe dëshirën e madhe që kishte Mitkoja për gjuhën shqipe në përgjithësi e për fjalësin e saj në veçanti.

[209] Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe* (Romantizmi II), Prishtinë, 1984, faqe 261.
[210] Qemal Haxhihasani, vepra e cituar, faqe 51.
[211] Për më tepër shih: Qemal Haxhihasani, vepra e cituar, faqe 52-53.

Nga 950 fjalë, që ka *Fjalori* i Mitkos, rreth 530 fjalë janë të përfshira në *Fjalorin e shqipes së sotme*[212] me shpjegime të mirëfillta, çfarë i ndeshim edhe tek ai; rreth 100 të tjera, të cilat për nga forma janë të njëjta, por kanë shpjegime të ndryshme - jo të njëjta nga ato që i ka përdorur studiuesi ynë; ndërkaq nja 300 e sa fjalë të tjera, që nuk janë përfshirë në FShS, ose janë fjalë të huaja që nuk kanë gjetur vend në këtë fjalor, kurse studiuesi i ka shënuar në këtë kohë për nevojat e komunikimit, si: *allonar* (gr.) – korrik-u; *arhont-di* (gr.) – bujar, buliar; *andarë* (gr.) – mjegull; *çelengu* (turq.) – çmimi; *çipllak* (turq.) – lakuriq; *dahil* (arab.) – lutës, pëshpëritës; *elçi* (turq.) – lajmës, lajm; *gaile* (arab.) – të keqe, fatkeqësi, angështim, të dhimburi; *gjene* (turq.) – përsëri, prapë; *hazne* (arab.) – vëstar, thesar; *hynqar* (tuq.) – perandor; *ispat* (arab.) – dëftim, vërtetim; *katro* (gr.) – mjek; *kabah* (turq.) - i trashë, skulithdhi, i poshtër; karav-i (gr.) – gjemi; *naft* (gr.) – detar; *pondë* (gr.) – sikur, sikurse; *nogiti* (bullg., nga noxhice) – gërshërë; *qall* (it.) – dylbi, teleskop; rajet (arab.) – nder, kujdes; *rytbe* (turq.) – gradë, funksion, ofiq zyrtar; *tavlë* (it.) – tryezë, truverë; *vlladika* (bullg) – dhespot, ipeshkvi etj.; ose janë fjalë të arealeve tona, por që nuk kanë pasur ndonjë shtrirje më të gjerë në të folmet shqipe dhe nuk janë përfshirë në FShS. Janë fjalë e shprehje kryesisht nga të folmet arbëreshe, si: *gëxharinj* (arb. It.) – *falltonj, parëflas, fall* = *profec*i; *logori-a* (arb. It.) – *lëjigje*; *torrë* (arb. Gr) – *rreth, rrotull, përqark* etj., etj.

Në vend të përmbylljes mund të themi se i tërë ky mund e vetëmohim i Thimi Mitkos, kushtuar traditës, kulturës, gjuhës shqipe e dijes sonë, është dhe mbetet një ndihmesë e madhe edhe për çdo lakmi. Atë nuk mund ta mbulojë pluhuri i harresës e nuk mund ta shkelin as vitet e as shekujt. Edhe tani, kur po kujtojmë 195-vjetorin e lindjes dhe 125-vjetorin e vdekjes së tij, duhet ta ndjejmë veten krenarë që një burrë i tillë doli nga gjiri ynë, qe yni dhe mbetet një shembull i veçantë se si duhet punuar e sakrifikuar për të mirën e atdheut e të kombit shqiptar.

[212] Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), *Fjalor i shqipes së sotme,* "Toena", Tiranë, 2002.

BRUNILDA SPIRO (TIRANË)

ELEMENTE LEKSIKORE ME PREJARDHJE GREKE NË VEPRËN E THIMI MITKOJAS

Vepra e Thimi Mitkojas ngelet një thesar i çmuar i vlerave të trashëgimisë kulturore e morale të shprehura më së miri në folklorin e popullit tonë. Nëpërmjet kësaj vepre si dhe dokumentacioneve të ndryshme të kohës që jetoi e veproi, ai ngelet një lëvrues i madh i gjuhës shqipe duke u përpjekur për afrimin e dy dialekteve të gjuhës shqipe, si dhe pastrimin e shqipes prej fjalëve të huaja. Për këtë arsye në fund të përmbledhjes "Bëleta shqypëtare" ai ve fjalorin shqip–greqisht. Për kontributin e tij në fushën e gjuhës mund të bëhen edhe mjaft hulumtime në të gjitha rrafshet e saj.

Përzgjodha temën e sipërcituar pasi mendoj se do të ketë interes në këndvështrim diakronik, për të trajtuar elementet greke që kanë gjëlluar në atë kohë në gjuhën shqipe. Në luftën e tij për përhapjen e diturisë me "skolira dhe vivlla shqipe" dhe për pastrimin e saj nga elementet e huaj, ai në emër të origjinalitetit e vërtetësisë në këngët dhe materialet e tjera popullore, na ka transmetuar gjendjen gjuhësore të kohës.

Pavarësisht se Thimi Mitkojaja, nuk ka pasur ndonjë përgatitje filologjike, me zellin dhe përpjekjet e tij ka mundur të transmetojë shumë. Pasuria leksikore që na trashëgon janë prurje të padiskutueshme që mund t'i shërbejnë etimologut, semiologut, leksikografit dhe studiuesve të stilistikës gjuhësore.

Leksemat me prejardhje greke që hasim në veprën e Thimi Mitkojas në tërësi, i përkasin fushave të ndryshme semantike, kanë status të ndryshën të përdorimit të tyre, në varësi të stilit të tyre funksional, por edhe burimit se nga e kemi vjelë (nga gjuha e letërkëmbimit apo nga krijimet popullore).

Greqizmat që hasim në pjesët folklorike, besojmë se paraqesin gjendjen reale të përdorimit ose frekuencën e tyre në gjeografi të ndryshme të trevave shqipfolëse, pasi ato janë paqyrë e komunikimit popullor për një periudhë të caktuar.

Greqizmat në letërkëmbim janë pjesë e fjalorit të Thimi Mitkojas dhe ky eshtë një tregues i kushteve historike të kohës kur ka jetuar. Dihet që ai ka ndjekur shkollën greke në vendlindjen e tij në Korçë dhe ky formim gjuhësor e kulturor do ta kushtëzojë veprën e tij, pavarësisht përpjekjeve serioze për ta pastruar nga elementet e huaj gjuhën shqipe.

Ndërsa greqizmat në këngë, poezi dhe prozë janë huazime që kanë hyrë nga arsye të ndryshme historiko–gjuhësore të kohës.

Një nga arsyet më të rëndësishme është kontakti i vazhdueshëm i dy popujve në rrjedhë të shekujve, si një bashkëjetesë e një fqinjësie shpesh herë të ndërlikuar. Po ashtu, siç pohon dhe akademiku Jorgo Bulo:

"Shqiptarët dhe grekët, dy nga popujt më të vjetër të Evropës, që nga të parët e stërgjyshërve, në një vazhdimësi 3000-vjeçare, kanë pasur me njëri–tjetrin kontakte

të drejtpërdrejta e të gjithanshme. Këto kontakte u shtuan, por edhe u ndërlikuan sidomos kur para shqiptarëve u shtrua për zgjidhje problemi kombëtar nga mesi i shek. XIX e deri në vitin 1912”[213].

Kështu Thimi Mitkoja i vetëdijshëm për gjendjen e gjuhës shqipe dhe elmentët e huaj në trup të saj e lehtëson receptimin e veprës edhe me një fjalor të cilin e ka përfshirë në fund të përmbledhjes “Bleta shqiptare”. Vërejmë që ky fjalor shpjegues ndihmon në receptimin e veprës, por dhe tregon një erë të re në hartimin e fjalorëve ku shqipja është si gjuhë e parë dhe greqishtja gjuhe e dytë.

Po të nisemi nga fakti që pohon studiuesi Jorgo Bulo: “Shekulli i XVIII shënon fillimin e erës së hartimit të botimit të fjalorëve të mirëfilltë dy–a shumëgjuhësh, ku greqishtja dhe shqipja shfaqen si gjuhe të para e të dyta“[214], mund të dalim te mendimi që shekulli i XIX, kur jeton e punon Thimi Mitkoja, është fillim i një epoke të re në hartimin e fjalorëve dy a më shumë gjuhësh dhe më e rëndësishmja e fjalorëve me gjuhë të parë shqipen.

Në këtë fjalor vërejmë që Thimi Mitkoja u kujdes të receptonte veprën, por gjithashtu në të njëjtën kohë, të pastronte gjuhën nga fjalët e huaja, siç shprehet edhe vetë në parahyrjen e fjalorit, që ato janë për të dhe për popullin shqiptar “...tërësisht të tepërta, të pavlefshme dhe kakofone...[215]”

Duke i shpjeguar këto fjalë të nxjerra nga këngët, vjershat apo prozat e mbledhura nga populli, gjithashtu dhe duke ju vënë gjegjësen e tyre në shqip, ai shpresonte të ndihmonte me nisma të tilla serioze për një shqipe të pastër dhe të pasur, meqënëse ishte i vetëdijshëm që nuk kishte formimin e nevojshëm filologjik, siç pohon dhe studiuesi Qemal Haxhihasani në parathënien e “Veprave” të Thimi Mitkos:

”Edhe pa formimin e nevojshëm filologjik, i frymëzuar nga qëllime të tilla patriotike, nga dëshira për të dhënë kontributin e tij në zbulimin e e thesareve të gjuhës amëtare, për të ndihmuar në pasurimin dhe zhvillimin e saj, Mitkoja ju kushtua me zell kësaj veprimtarie”[216].

Huazimet greke vërej që gjenden në këngët krahinore të zonës së Korçës, Vithkuqit, Panaritit dhe arvanitasve të Greqisë. Edhe vetë Thimi Mitkoja në “Parahyrje“ e thekson faktin që ato kanë hyrë në gjuhën shqipe, por hasen kryesisht në dialekte, pra sipas krahinave dhe përkatësisht fqinjësisë që kanë këto krahina.

---

[213] Jorgo Bulo, Fjala e hapjes në Konferencën ndërkombëtare ”*Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*”, Tiranë, 2005, f, 10.

[214] Jorgo Bulo, Fjala e hapjes në Konferencën ndërkombëtare ”*Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*”, Tiranë, 2005, f, 330.

[215] kakofone. gr. *κακόφωνος*, shq. kakofonos, të dëgjuara keq, domethënë jo të këndshme në dëgjim.

[216] Qemal Haxhihasani, *Vepra,* Thimi Mitko*, Parathënie*, fq, 49, Instituti i Kulturës Populllore, Tiranë, 1981.

Të gjitha këto huazime greke, të shpjeguara nga Thimi Mitkoja në fjalorin "Bleta Shqiptare"[217] i ballafaqova në fjalorët dialektorë të Pano Tases, Niko Gazullit dhe në fjalorët e shqipes standarde të viteve: 1954, 1984, 2006 dhe vërej që këto fjalë nuk janë ngjitur në fjalorin e shqipes standarde, gjithashtu as si fjalë dialektore. Këto përpjekje serioze të nismëtarit të Rilindjes Shqiptare dhe rilindasve të tjerë, duket që kanë pasur rëndësinë e tyre për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja.

Megjithëse shumë prej tyre mendoj që gjenden sot në ligjërimin bisedor, duke e ndryshuar në disa raste kuptimin e tyre fillestar, ose duke fituar konotacione të ndryshme gjuhësore. Kjo shpjegohet me faktin, që fjalë të cilat nuk i përkasin gjuhës letrare, duke qënë pjesë e ligjerimit bisedor, shpesh ndryshohen nga individë për arsye mosnjohje mirë të fjalës apo për ngjyrime të ndryshme stilistikore, ironike apo dhe tallëse.

Por, megjithë, dëshirën për një shqipe të pastruar nga fjalët e huaja dhe midis tyre të huazimeve nga greqishtja, vërej gjithashtu, që në fjalor mungojnë shumë huazime të cilat ndodhen në vepër, por autori i përmbledhjes "Bleta shqiptare" nuk i ka përmendur. Mendoj që kjo ndodh për faktin të cilin e përmenda edhe më sipër, që edhe vetë Thimi Mitkoja, ka pasur kufizimet e tij për arsye të arsimimit në shkollën greke dhe gjendjes gjuhësore të kohës kur jetoi dhe punoi.

Kështu duke pasur parasysh gjithçka më sipër, do mundohem të depërtoj në atë moment të zhvillimit të gjuhës shqipe duke i bërë dhe analizën e duhur semantike të fjalëve, krahasuar me fjalorin e sotëm të shqipes.

Ky punim shpresoj të jete ndihmë modeste në dukuritë e ndryshme gjuhësore të vështruara nga pikepamja historike dhe gjuhësore, per të lehtësuar edhe punën e studentëve dhe studiuesve të ndryshëm, në fushën e gjuhës, duke ndarë fjalët në huazime (greqizma) të poezisë, prozës dhe letërkëmbimit.

I. "Këngë të vegjëlish"

Alfa, bega, bishtpurteka
fallagaja[218] këmbëvet
e purteka dhëmbëvet.

Kengë komike që këndonin të vegjëlit për alfabetin.

1. Këto vargje tregojnë mënyrat që përdoreshin në shkolla në atë kohë, për t'u mësuar fëmijëve alfabetin. U fusnin këmbët në një mjet torture si *fallagaja,* që mos lëviznin dhe u binin me purteka, shkopinj. Sigurisht që sot ka mbetur një fjalë historike dhe ka ngushtuar dukshëm kuptimin semantik të saj.

2. Fallaka, ~JA f. vjet. Mjet torture: Një copë dru ku i lidhnin këmbët të dënuarit që t'i binin shputave me shkopinj, e vinin në fallaka[219].

[217] *"Bleta Shqiptare"* Thimi Mitko; *Fjalorët dialektorë*: Pano Tase, Niko Gazulli; *Fjalorët e shqipes standarde të viteve: 1954, 1984, 2006.*

[218] *Vepra*, Thimi Mitko, fq, 75, kënga 18, gr. *φάλαγγα*, falaga, shq. vargan ose kolonë.

Kyrie elesion![220] *(Tri herë)*

1. Kjo fjali thirrore që përsëritet tre herë, i përket terminologjisë fetare, e përdorur në ceremonitë ortodokse të faljes apo amëshimit.

2. *"Kyrie elesion!"* Zot ki mëshirë, ki mëshirë për ne mëkatarët dhe na beko me dhimbshurinë tënde. Sot kjo shprehje po shkon drejt mospërdorimit dhe do të quhet shprehje historike e terminologjisë fetare edhe në zonat ku ka së shumti besimtarë ortodoksë, si rezultat i trysnisë që ushtron kudo shqipja letrare.

II. "Këngë për festat popullore të mot motit"

O kolendra melendra![221].

1. Vargje këngësh, që këndojnë fëmijët për festën e krishlindjeve në Greqi dhe në qytetin e Korçës, apo dhe më gjërë, e fesë ortodokse, këndohet para shtëpisë dhe shoqërohet me një vegël muzikore artizanale.

2. Ky varg këndohet edhe kur zonjat e shtëpisë bëjnë biskota me pamje të ndryshme, femijësh, bredhi të vitit të ri apo dhe kafshësh, për të sjellë mbarësi dhe begati gjatë vitit që vjen. Vazhdon të këndohet akoma me kufizim krahinor, por gjithashtu vlen të përmendet që është përshtatur sipas ligjërimit popullor, duke ndryshuar shumë nga forma fillestare të huazimit grek.

III. "Këngë dashurie"

Paç edhe *jatronj* të mijtë*,*
Të gjorin Kostandinkë,
Që ia ip vetë *jatritë.*[222].

1. Fjala *jatritë*, nuk gjendet në fjalorin e Thimi Mitkos, nuk ekziston as si fjalë në fjalorin grek, është fjalë krahinore e përshtatur për nevojat e kohës, që në këtë rast në shqipen e ka gjegjësen*, hape.*

2. Ilaç,~I m, sh~E, ~ET. 1.-Lëng, pluhur, *hape*, melhem, etj, që përgatitet posaçërisht për mjekimin a parandalimin e një sëmundjeje ose për shërimin e një plage. Ilaç i hidhur. Ilaç plakash.[223]

Rrumbullakeja si *karpuzi*[224]
mb'at anë lumënë.

1. Karpuz-i, m., me kuptimin emëror, që në këtë rast përdoret si krahasim, me ngjyrim stilistik e
letrar, me faqet e rrumbullakëta siç është karpuzi i rrumbullakët dhe brenda i kuq, krahasim i formuar ne bazë të sinonimisë së fjalëve.

---

[219] *Fjalor i Shqipes së Sotme,* Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1984, fq, 275.

[220] *Vepra*, Thimi Mitko, fq 71, kënga 7, gr. *κυρίως*, shq. kirios, zotëri, në këtë rast Zoti (Perëndia), gr. *έλεος*, shq. eleos, mëshirë, keqardhje, lëmoshë.

[221] *Vepra*, Thimi Mitko, Kënga e 47, fq95, gr. *καλανάδα*, shq. kalanda, kjo fjalë e ka burimin nga latinishtja, diçka e pamundur, por që dëshirohet të arrihet nga një kohë e re që vjen.

[222] *Vepra*, Thimi Mitko, kënga74, fq, 109, gr, *γιατρος*, shq, doktor, mjek.

[223] *Fjalor i Shqipes së Sotme,* Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1984, fq, 446.

[224] *Vepra*, Thimi Mitko, kënga 136, fq. 133, gr**.** *καρπούζι*, shq. karpuz**.**

2. Bostan, ~m, sh~E, ~ET. 1. Shalqi, imonik. Karpuz i-*fjalë em, shm-e, bot krahinore.*[225]

Shihet që kjo fjalë e ka ruajtur kuptimin e saj semantik dhe është ngritur në fjalor, por vlen të theksohet që e ka të ngushtuar përdorimin në trevat jugore të Shqipërisë.

VI. Kurbeti
Zunë yjt' e perëndojnë
Ksenetarët[226] zun'e shkojnë.

Ksenetarët, është krijuar nga fjala greke, ξένο që në këtë rast ka luajtur rolin e një fjalë–temë, që në ligjërimin krahinor ka marre konotacionin për të percjellë idenë e autorit të këngës.

1. Ksenetarët, në këtë këngë ka kuptimin edhe të njerëzve që po migrojnë, pra po ikin nga vendi i tyre dhe tashmë janë te huaj, këtu dhe kudo që do shkojnë. Është fjalë historike dhe nuk përdoret as si fjalë krahinore.

Damianeshë, damianeshë,
Je putër'edhe *fonjeshë*[227].

1. Fonjeshë, në këtë këngë ka kuptim stilistikor, duke e përdorur me ngjyrim përkëdhelës, je vrasëse, por një vrasëse e ëmbël.

2. Fonjeshë, një fjalë e përshtatur nga autori i këngës për arsye stilistikore, sipas fjalës gr. *Φονιάς*, por në gjininë femërore kjo fjalë nuk gjendet as në gjuhën greke. Fjalë historike.

II. Epika historike
Dymbëdhjetë pleq të parë
ndë Mitropoli seç vanë,
të presin *hrisogajtanë*[228].

1. Kjo fjalë kompozitë, gajtan floriri, e rrallë për nga ndërtimi, e ndërtuar nga një fjalë greke dhe një fjalë shqipe.

2. Gajtan,~i, m, sh~Ë,~ ËT. 1. shirit ose gjalmë i përdredhur prej mëndafshi, leshi a pambuku... fill i trashë dhe i përdredhur prej ari, argjendi ose mëndafshi, me të cilin qëndisen a stolisen veshjet kombëtare. *Gajtan*[229] *i zi (i kuq).* Fjala Gajtan e përmban kuptimin e plotë të kompozitës, prandaj theksojmë se fjala *hrisogajtanë,* nuk e ka humbur plotësisht kuptimin e parë, por është përshtatur sipas rregullave të shqipes.

Kush e beri *pro*[230] *fora*[231]

---

[225] *Fjalori i Gjuhës Shqipe*,1954, gjendet edhe në *Fjalorin e 2006*.
[226] *Vepra*, Thimi Mitko, kënga 291, fq. 201, vargu i dytë, gr. ξένο, shq. kseno, i huaj.
[227] *Vepra*, *Thimi Mitko*, kënga 354, fq. 236, gr. *Φονιάς*, shq. vrasës.
[228] *Vepra*, *Thimi Mitko*, kënga 399, fq. 284, gr χρυσό**,** shq. flori, metal i çmuar.
[229] *Fjalori i Shqipes së Sotme, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1984, fq. 328.*
[230] *Vepra*, *Thimi Mitko*, kënga 492, fq. 340, gr. πρώτα, shq. prota, së pari.
[231] Vepra, *Thimi Mitko*, kënga 492, fq. 340, gr. gr. φορά**,** shq. here, drejtim**.**

Ali Zoti nga Kolonja.

1. Në këtë rast është përdorur si parafjalë ose shkurtim i fjalës, gr, πρώτα që në shqipen ka gjegjësen, së pari, ndërsa gr. φορά, në shqipen ka gjegjësen, herë.

2. Së//. Pjesëz trajtëformuese në disa shprehje ndajfoljore. Së pari. Së paku, etj. Kuptimi i plotë i dy
fjalëve është: Kush së pari ja bëri fora, kush së pari e nisi sulmin.

3. Gr. φορά shq. herë, drejtim-kjo fjalë sot përdoret në ligjërimin popullor, me të njëjtin kuptim semantik dhe stilistikor që është përdorur nga autori i kengës, psh., ja bëri fora, Vlora ja bëmë fora.

Në shumë këngë ka përdorim të gjerë emërtimi: Qir, qiria, si psh., qiriakullën, qir Avramit, qir Janaqit, etj.

Ky emërtim që në shqip do të thotë zotëri, zonjë, siç duket në zonën e Korçës kishte një shtrirje të gjer, ndërsa sot përdoret vetëm si fjalë tallëse dhe e ka humbur krejt kuptimin fillestar. Gjithashtu edhe shume fjalë të tjera si *dhaskal, skolio,* të cilat i gjejmë dendur në leterkëmbimin e Thimi Mitkos, e kanë humbur kuptimin e parë dhe sot janë pjesë e krijimeve letrare me ngjyrime së shumti tallëse ose pjesë e ligjërimit popullor.

"Nga ngjyrimi stilistik-emocionues: *Mësues* e *dhaskal* shënojnë të njëjtin njeri sipas detyrës, por, ndërsa sot fjala *mësues* ka kuptim asnjëanës, *dhaskal* ka kuptim përbuzës, keqësues (mësues i keq, i prapambetur e pedant;...)[232]

Sigurisht që asnjë fjalë apo shprehje e huaj nuk duhet të shihet si e pavlefshsme, qoftë edhe ato që e kanë humbur kuptimin fillestar, qoftë edhe ato me ngjyrime tallëse, sepse gjuha standarde, ligjërimi letrar dhe popullor janë pasuri e historisë dhe e kulturës sonë në shekuj. Bukur shumë e thekson këtë studiuesi i gjuhës shqipe Ali Jashari:

"Duke studiuar këtë realitet gjuhësor, shprehjet e huazuara nuk duhet të vështrohen si "mish i huaj" në trupin e shqipes, por pjesë e saj si gjuhë kulture, si shenjë e marrëdhënieve të ndërsjellëta në kulturat e popujve të ndryshëm dhe si shprehje konkrete e përngritjes kulturore të popullit shqiptar"[233].

Natyrisht që në këtë punim nuk pretendoj se kam vjelë të gjitha greqizmat, pasi një punim i tillë do të kërkonte shumë më shumë kohë dhe kompetencë në lidhje me fjalët greke në referencën e sotme të semantikës së tyre. Kuptohet që në pjesët e shkruara prej vetë Thimi Mitkos, pra kryesisht pjesa e letërkëmbimeve, ato janë shumë më të pakta, për shkaqet që përmendëm edhe më lart, ndërsa në pjesët folklorit ato janë shumë më shumë.

Këtu nuk duhet të anashkalojmë edhe një fakt që Thimi Mitkoja greqishten e ka përdorur në fjalor më shumë si pjesë ilustruese për të dhënë semantikën e plotë të fjalës (për fjalorin), kështu që ndikimi i saj është i pashmangshëm.

---

[232] Jani Thomai, *Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, fq, 152.

[233] Ali Jashari, *Fjalor me Shprehje të Huazuara në Gjuhën Shqipe*, Botimet Dudaj, Tiranë,2007, Hyrje, VI.

Një gjë është për t'u theksuar si pjesë e historisë së shqipes letrare, se këtu janë edhe hapat e parë për një gjuhë të unifikuar dhe të pastër, për të pasur sa më pak elemente të huaja. Pra Thimi Mitkoja përveçse atributeve folklorike ka një meritë të padiskutueshme edhe në pjesën e gjuhës, në historikun e zhvillimit të saj, në formësimin e një "kojneje" të kuptueshme për mbarë trevat shqipfolëse duke u munduar me mundësitë intelektuale të kohës për ta dhënë sa më të pastër me elemente të fondit autokton.

DANIELA-CARMEN STOICA (KORÇË)

DISA FJALË ME PREJARDHJE LATINE (TË KONSERVUAR VETËM NE SHQIP DHE NË RUMANISHT) NË FJALORIN SHQIP-GREQISHT TË THIMI MITKOS

Studimet në lidhje me elementin latin në gjuhën shqipe janë të shumta dhe shpesh krahasuese. Që nga fillimi i shekullit XX, W. Meyer- Lübke (1904, 1914) e kishte vënë theksin në karakterin arkaik të latinizmave të shqipes, në raport me ato të rumanishtes. H. Mihăescu (1993) nënvizonte se paralelizmat midis latinizmave të shqipes dhe të rumanishtes janë më të vogla seç mendohej. Gjithashtu, është vënë re se në gjuhën shqipe, elementet latine e kanë prejardhjen nga format e thjeshta, ndërsa në rumanisht, por edhe në gjuhë të tjera romane, nga derivatet e tyre. Synimi i këtij punimi është të analizojë disa fjalë me prejardhje latine (të konservuara vetëm në shqipe dhe në rumanishte) në *Fjalorin shqip-greqisht* të Thimi Mitkos (2014), duke nxjerrë në pah aspektet e përmendura më lart (nga pikëpamja fonetike dhe kuptimore) dhe duke e zgjeruar këndvështrimin edhe në gjuhën rumune, gjuhë neolatine, me të cilën shqipja ka qënë vazhdimisht në kontakt.

Duke u bazuar në listën e hartuar nga kërkuesja Këtëlina Vëtëshesku (rum. Cătălina Vătășescu)[234], listë që përfshin fjalët me origjine latine të konservuara vetëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën rumune, kemi analizuar si regjistrohen disa nga këto fjalë në *Fjalorin shqip-greqisht* të Thimi Mitkos[235] në gjuhën shqipe nga pikëpamja fonetike dhe kuptimore.

- Fjala *këndoj*, nga folja latine *cantāre*, në rumanishte me formën *a cânta*, formë e cila,

krahas me atë të të shqipes, tregon mbylljen e zanores latine |a| në |ə| ne shqipe dhe në rumanishte (shih. *cănt* në arumanisht) dhe më pas në |â|, vetëm në rumanishte. Gjithashtu, forma e fjalës në shqipe nxjerr në pah sonorizimim e grupit **–nt-** në **–nd-**, fenomen i cili ndodh në shqipe, por asnjëhere në rumanishte[236]. Punimi i Këtëlina Vëtësheskut regjiston nga fjala *këndoj* edhe fjalët *këndues* (''gjeli''), dhe *me kënduem* (''psallere'') në dialektin geg[237]. Në fjalorin e Thimi Mitkos zbulojmë foljen *këndonj*, e cila shfaqet me *n*-në hundore dhe me kuptimin themelor ''këndoj'', ashtu edhe fjalën *këndes-zi* (bashkë me formën *këndées*), me zhdukjen e zanores *–u-* dhe kalimin e bashkëtingëllores *s* në *z*, me kuptimin ''gjel''. Por më tej, Fjalori i Mitkos na ofron një larmi fjalësh të cilat i përkasin fushës sematike të shpendëve dhe që kanë si bazë fjalën *këndes*: *këndesk (e egër),* e formuar me prapashtesën *–esk*, e regjistruar me kuptimin *shaptore, shapkë*; *këndezipyllit*, fjalë e përbërë, e cila

[234] K.Vëtëshesku, *Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna*, București, 1997 , f. 511.
[235] Th. Mitko, *Fjalëtore shqip-greqisht*, Tiranë, 2014.
[236] H. Mihăescu, *Remarques sur la romanité du sud de l Europe, në Mélanges de linguistique dédiés à la mémoire de Petar Skok*, Zagreb, 1985, f. 326.
[237] K. Vëtëshesku, po aty, f. 489.

shënohet edhe e ndarë, në një sintagme me trajtën fillestare të gjinores, *këndez i pyllit*, me kuptimin ''fazan''[238].

- Fjala *kaptinë* nga fjala latine *caput*+ prapashtesën *-ina,* e regjistruar nga Mihëesku[239],

Ruhet vetëm në shqip dhe në rumanisht, me formën *căpățână*. K.Vëtëshesku e regjistron me kuptimet, në shqip, ashtu edhe në rumanisht: 1. koka e prerë e kafshës 2. koka e njeriut 3. rënja e qepës/hudhrës etj. (rizomi)[240]. Prejardhja latine e kësaj fjale është kundërshtuar nga Çabeji, por pa argumente. Në fjalorin e Mitkos e gjejmë në një fjalë të përberë *kaptindullë*, me shpjegimin "rrotulla e boshtit të furkës'', ku fjala *kaptin* ruan në një farë mënyrë kuptimin e ''kokës'' si pjesë kryesore të trupit (njërëzor, të kafshes), në këtë rast të boshtit të furkës[241].

- Folja *krijoj*, nga folja latine *creare* (në rumanisht *a crea)*, shfaqet në fjalorin e Mitkos

me formën *krionj* (me ruajtjen e *n*-së hundore), duke patur kuptimet ''krijoj, ndërtoj, mbruj, nxjerr,
lind''[242] të regjistruar edhe nga K. Vëtëshesku[243]. Thimi Mitko, në fjalorin e tij, regjistron edhe disa fjalë me prejardhje nga folja *krioj* si për shembull *krietār, -i*, me prapashtesën *–tar*, (si emër, sepse shpjegimet jepen në greqisht nëpërmjet emrave κτίστης, πλάστης, γεννήτωρ) – me kuptimet që jepen në shqip, por nëpërmjet mbiemrave,''krijues, mbrujtës, lerës''. Një tjetër fjalë e prejardhur nga folja *krijoj* është mbemri *kriúes*, me variantin *kriijues* (me praninë e *j*-së për të shmangur hiatin), në shembullin *Kriijuesin e qiiellës e të dheut*, domethënë ''Perëndia, Zoti''. Kuptimet që jepen janë ''krijues, ngjizës (kryes.) ai që ndërton, që mbrun, lindës prodhues''.

Përmendim këtu fjalën *krijesë*, me prejardhje nga fjala latine *creatio, creationis,* me kuptimin në latinisht ''lindje; zgjedhje, emërtim''[244]. Në shqip *krijesë* do të thotë ''gjithçka që është krijuar''. Sipas Çabejit, mund të jetë formuar me prapashtesën *–esë* (përsëri me origjine latine <- *atio*)[245]. Në rumanisht *creatio, creationis* mendohet të ketë qënë trashëguar vetëm në formën *Crăciun* (arum. *Crâciún, Cârciún*), ''festa e lindjes së Krishtit, Krishtlindje'', ndersa fjala *kërshëndella* (emër femëror, nr. shumës), me të njëjtin kuptim në shqip, ''Krishtlindje'', është pranuar të ketë

[238] Th. Mitko, po aty, f. 288-289.
[239] H. Mihăescu, *La langue latine dans le sud-est de l Europe*, București, 1978, f. 28, *La romanite dans le sud-est de l' Europe*, București, 1993, f. 52.
[240] K. Vëtëshesku, po aty, f. 21.
[241] Th. Mitko, po aty, f. 284.
[242] Po aty, f. 297.
[243] K. Vëtëshesku, po aty, f. 305.
[244] Po aty.
[245] E. Çabej, *Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwörter im Albanischen*, në RRL VII, 1962, f. 161.

prejardhjen në shqipe nga sintagma latine *Christi natale*[246] Në fjalorin e Thimi Mitkos fjalët *krijesë* dhe *kërshëndella* nuk shfaqen.

- Fjala *orë* e ka origjinen nga *horae, horārum* (gjinia femërore, numri shumës) në

latinishte,emër i cili në këtë gjuhë kishte kuptimin themelor "vajzat e Jupiterit, perënditë e stinave, të cilat ruanin dyert e qiellit''[247]. Në mitologjinë shqiptare, fjala *orë* ka ruajtur këtë kuptim, duke iu referuar figurës së një femre, mbrojtëse e njeriut, e familjes, e një fisi. Gr. Brënkush e sinjalizon praninë e këtyre figurave femërore edhe në mitologjinë e lashtë greke (gr. ωραι- perëndi të diellit) Një sinonim i kësaj fjale në shqipe është fjala *fat*, një tjetër huazim i vjetër në shqip (< lat. *fatum*). Në fjalorin e Mitkos fjala *orë* shpjegohet nëpërmjet këtyre sintagmave *or' e mirë*, *njeri me orë*[248], ku shfaqen në fakt dy kuptime (nga i njëjti burim): në sintagmën e parë, shfaqet kuptimi i ''fatit'', ''të zhvillimit e ardhshëm pozitiv'', ndërsa në të dytën, zbulojmë kuptimin ''naze'', në lidhje me sjelljen e njeriut.[249] Këtë fjalë, me formën e emrit femëror, numrin shumës, me kuptimin "naze, gjendje shpirtërore të ndryshueshme e njeriut'' e zbulojmë vetëm në gjuhën popullore rumune në sintagma të tipit (*a fi în ori bune* – të jesh me humor të mirë, *a scoate pe cineva din sărite*- të acarosh dikë) dhe në dialektin arumun, si për shembull në sintagmat *a-și veni în ori* (''të rikthehesh në humor të mirë''), *a-și ieși, a scoate din ori* (''të acarohesh, të acarosh dikë''). Take Papahaxhi dhe Th. Kapidan nxjerrin në pah këtë paralelizëm midis shqipes dhe arumanishtes, duke e shpjeguar atë nëpërmjet kontakteve gjuhësore midis këtyre idiomave[250]. Një tjetër kuptim interesant i fjalës *orë*, e cila regjistrohet në fjalorin e Mitkos si një tjetër leksemë, e ndarë nga leksemi *orë,* me kuptimet e sipërmendur, është *tespihe,* me shpjegimin ''ndoshta nga që njerëzit e lashtë e mbanin tespihet për numërimin e orëve gjatë kohës që luteshin, u bë zakon që të quheshin në shqip orë''[251]. Këtë kuptim nuk e gjejmë në dialektin dakorumun, por Take Papahaxhi e regjistron në *Fjalorin e dialektit arumun*, si Mitkoja, përsëri si leksemë me vetë, në formën e shumësit, *ori* (sipas autorit, ndoshta bëhet fjalë për shumësin e fjalës *oară*) dhe me kuptimin ''tespihe'': *ori di kihlibáre* (''tespihe'' prej qelibari)[252].

- Fjala *fshat* (në rumanisht *sat*) e ka prejardhjen nga *fossatum* në latinisht. Te kjo fjalë

---

[246] E. Çabej, po aty, f. 188, shih edhe H. Pedersen *Die albanesischen l-Laute*, në KZ, 33, 1893, f. 539.
[247] K. Vëtëshesku, po aty, f. 483, Gr. Brënkush , *Concordanțe lingvistice româno-albaneze*, București, 1999, f.127.
[248] Th. Mitko, po aty, f. 368.
[249] për këtë kuptim, nxjerrim në pah homoniminë e formave njëjës-shumës në gjuhën shqipe të emrit *orë.*
[250] T. Papahaxhi, *Dicționarul dialectului aromân general și etimologic,* București, 2013, T. Kapidan,'' *Raporturile albano-române''*, në *Dacoromani*a II, 1922, f. 413-554, shih edhe Mihëeskun, ''Les éléments latins de la langue albanaise'', në *RESEE IV*, 1966, f. 26.
[251] Th. Mitko, po aty, f. 368.
[252] T. Papahaxhi, po aty, f. 937.

nxjerrim në pah ruajtjen e *f*-së nistore, etimologjike, e cila u zhduk në rumanishte. Në latinishten klasike, *fossatum* do të thotë ''hendek''. Në latinishten e vonshme ka marrë edhe kuptimin ''vend i fortifikuar me një hendek'' [253] Përmendim gjithashtu familjen leksikore të pasur të kësaj fjale: *fossare* folje <*fossa* emër femëror < fodio, fodere, fossum, folje ''të gërmosh''[254]. Gjendet edhe si term ushtarak karakteristik për zonat kufitare, duke zhvilluar në shek. IV-VI kuptimin ''vendbanim me bujq''. Fjala *fshat* është shume e ngjashme me fjalën *fsat* nga rumanishtja e vjetër, e cila ka si korrespondente në gjuhën shqipe fjalët *tendë, vend, arë, fushë*, por asnjëherë *fshat*. Prandaj, një numër gjuhëtarësh mohojnë lidhjen semantike midis fjalës *fshat* në shqip dhe *fsat* në rumanishten e vjetër. Interesante është edhe forma në arumanishte *fusat*, me kuptimin e ''hendekut mbrojtës''. Në fjalorin e Mitkos *fshat* shpjegohet si ''fshat i vogël'', duke dhënë edhe sinonimi nga dialekti geg, *katund*[255].

- *pajë,* që nënkupton ''gjthçka që merr nusja nga prindërit kur martohet'', e ka prejardhjen nga fjala latine *pallium* (shumës *pallia*). Në latinishte kishte kuptimin "mantel,veshje prej leshi që mbaheshin përsipër''. Në rumanishte *pallium* ka dhënë *pai* – "leshi që nxjerrin delet në pranverë''. Megjithatë, në rumanishte është trashëguar edhe fjala *palliolum* (shumës *palliola*) e cila ka dhënë *păioară*. Vërejmë të njëjtin evolucion fonetik në shqipe, ashtu edhe në rumanishte: grupi *ll+i* në hiat, me zbutjen e *l-së*, më pas u zhduk. K. Vëtëshesku regjistron edhe formën *palë* (it.-shqip) me të njëjtin kuptim si *pajë*.[256] Në fjalorin e Thimi Mitkos shfaqen të dyja format, *pajë* dhe *palë*, të cilat, përveç kuptimit themelor që kemi dhënë më lart, *pajë* ka edhe kuptimet ,''njëanshmëri, hir'', ndërsa *palë* ,''çift, pjesë''.[257]

- *Rrëshaje*, emër femëror në numrin shumës, e ka origjinën nga emri latin *Rosalia* (<lat.
rosa), që nënkuptonte festa e trëndafilave, kur varret e të vdekurve zbukuroheshin me trëndafila. Kjo festë u shëndërrua në festën e krishterë të Rushajëve (e cila festohet 50 ditë pas Pashkës). Në gjuhët romane perëndimore ka hyrë *Pentecoste*, me prejardhjen nga greqishtja. T. Kapidan tërheq vëmendjen se *Rosalia* vetëm në shqipe dhe në arumanishte (*Arusal'e, Rusal'e*) u ruajt me kuptimin e ''festës fetare'', jo edhe me kuptimin ''nimfë'', si në gjuhët sllave[258] . K. Vëtëshesku shënon edhe një sinonim më të ri në shqipe, *pendikost*, por edhe formën e vjetër *ërshajë*[259]. Fjalori i Mitkos e regjistron fjalën *Rrëšháje –të* dhe e shpjegon në greqisht, ashtu edhe në shqipe nëpërmjet ''Pentecoste'' (*Festa e Pentekostisë/ Εορτή της Πεντηκοστής).*[260]

---

[253] I. Fischer, *Latina dunăreană. Introducere în istoria limbii române*, București, 1985, f. 147.
[254] H. Mihëesku në *RESEE*, 2, 1969, p.273.
[255] Th. Mitko, po aty, f. 240.
[256] K. Vëtëshesku, po aty, f. 117, shih edhe Mann, *An Historical Albanian-English Dictionary*, Londër, 1948, f. 340.
[257] Th. Mitko, po aty, f. 369-370.
[258] T. Kapidan, po aty, f. 443-554.
[259] Shih Buzuku, ed. Ressuli, *Il ''Messale'' di Giovanni Buzuku*, Citta del Vaticano, 1958.
[260] Th. Mitko, po aty, f. 419.

- fjala *shpuzë* (në rumanisht *spuză*, me të njëjtin kuptim si në shqipe), vjen nga fjala

latine *spodium, spodia* (<gr. *spothia*, nr. shumës) dhe ka ruajtur kuptimin nga latinishtja, ''hi ende i ngrohtë''. Në rumanishte fjala *spuză* ka zgjeruar fushën e saj sematike, duke shtuar edhe kuptimin ''irritacion i lëkurës''. Interes paraqet edhe fakti se edhe në shqip dhe në rumanisht kemi dy folje me prejardhje nga *shpuzë-shpuzis*, respektivisht *a spuzi*.[261] Në rumanishte *shpuzë* i përket fushës semantike ku bëjnë pjesë edhe *scrum* (term autokton, *shkrum* në shqip) dhe *cenușă* (term me origjinë latine, nga *cenera* – ''hi'')[262]. Në fjalorin në diskutim, shfaqen dy leksema me formën *shpuzë*, e para me kuptimin themelor, ''hi ende in ngrohtë'', ndërsa e dyta, me kuptimet *ngut, shpejtësi*, ku fjala greke σπουδή, e cila përkthehet në shqip *ngut*, risjell në pah etimologjinë originale greke (< gr. *spothia*).

E mbyllim analizën tonë këtu, duke nënvizuar se shumica e fjalëve me prejardhje latine, të konservuara vetëm në shqipe dhe rumanishte, kanë pasur zhvillime kuptimore të ndryshme në shqipe, krahas me rumanishten. Megjithatë, specialistët në këtë fushë, kanë vënë re se këto fjalë (numri i të cilave është mjaft i vogël dhe i pasigurt) u referohen pjesëve të trupit, zbukurimeve, gatimeve, termave me karakter të përgjithshëm, realiteteve që lidhen me jetën familjare dhe shoqërinë. Një interes të veçantë paraqet fakti se këto terma nuk i referohen jetës baritore, bujqësisë dhe zanateve.[263] Në disa raste, fjalët që ruhen në shqipe, në rumanishte ruhen vetëm në dialektet e saj (sidomos në arumanishte) si në rastin e termit *Rrushajë*. Ne disa raste të tjera ndodh që arumanishtja ruan kuptime të këtyre fjalëve, kuptime që në rumanishten letrare nuk shfaqen më. Këto fenomene mund të shpjegohen nëpërmjet kontakteve të ngushta gjuhësore midis shqipes dhe arumanishtes. Nga pikëpamja fonetike, siç e pamë nga shembujt e analizuar, rregullat fonetike që kanë vepruar mbi këto fjalë janë ndryshe nga një gjuhë në tjetrën.

Fjalori shqip-greqisht i Thimi Mitkos, në botimin e ri të Akademisë së Shkencave, 2014, nëpërmjet fjalëve me prejardhje latine të regjistruara dhe shembujve që jep, dëshmon se është një mjet i çmuar për studiuesit e elementit latin në gjuhën shqipe dhe të gjuhëve në kontakt.

[261] K. Vëtëshesku, po aty, f. 266.
[262] Gr. Brënkush, *Vocabularul autohton al limbii române*, 1983, f. 147.
[263] K. Vëtëshesku, po aty, f. 511.

DHIMITRI BELLO (TIRANË)

DIAKRONI LEKSEMASH NË VEPRËN E THIMI MITKOS

Për hir të së vërtetës, nuk mund të mendohej që në një veprimari siç është kjo që i kushtohet Thimi Mitkos, të kishte edhe kaq kumtues me tematika që e vështrojnë atë nga pikëpamja gjuhësore, për vetë faktin se ai nuk është "lakuar" shumë për kontribute në këtë fushë, me përjashtime të rralla.

Në "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar", Thimi Mitkoja paraqite si: "Veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, folklorist.....U përpoq për ta paraqitur trashëgiminë folklorike në një plan gjithkombëtar, me një renditje deri diku shkencore. Në fushën e gjuhës, u përpoq të nxjerrë në dritë pasuritë e saj dhe të ngrejë shqipen e folur në shkallën e një gjuhe të punuar të përbashkët.[264]"

Mirëpo, Mitkoja përveç transmetimit të trashëgimisë kulturore dhe folklorike të shqiptarëve në atë kohë, na dëshmon edhe gjendjen gjuhësore nëpërmjet materialeve të mbledhura, leksikun e veçuar dhe trajtuar nga ana leksikografike si dhe neologjizmat e vetë autorit. Në këto dëshmi ne na vijnë tashmë edhe fakte të reja, të sjella në një formë krejt origjinale me sqarimet dhe komentet përkatëse nga studiuesi Dh. Q. Qirjazi "Thimi Mitko Fjalëtore shqip- gërqisht dhe gërqisht- shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike" dhe botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Ndaj ne sot kemi mundësinë të vjelim e të studiojmë gjithë fjalësin e asaj kohe. Materiali leksikor mund të na shërbejë si nyje lidhëse në studimet diakronike për shumë leksema të diskutueshme për nga ana semantike, rrugëtimin e saj në rrjedhë të kohës deri tek burimi.

Për lehtësi studimi, materiali gjuhësor i Thimi Mitkos mund të ndahet në dy pjesë, dhe në secilën prej tyre të bëhen studime që mund të shënojnë edhe prurje të reja në lëmin e leksikologjisë dhe leksikografisë. Së pari, kemi leksikun e vjelë prej tij nga goja e popullit në Jug dhe në Veri të Shqipërisë si dhe në trevat jashtë tij, tek arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë, për të ndërtuar materien folklorike që na është dhënë tek "Bleta shqiptare", dhe së dyti, materiali gjuhësor që përdor vetë Mitkoja në fjalëtoret e tij por edhe në letërkëmbimet, si një prirje për pastrim të gjuhës nga elementet e huaja, edhe si një prirje për unifikim të gjuhës për mbarë trevat shqipfolëse. Pra mund të bëhen dallime gjuhësore historiko-dialektore të kohës edhe ato gjuhësore të purizuara e të "përpunuara" në përpjekje për të qenë mbarëshqiptare.

Në punimin tonë, që në asnjë mënyrë nuk mund të quhet shterues, do përqendrohemi tek një numër i vogël leksemash, të vjela nga dy pjesët e sipëpërmendura, disa analiza etimologjike, krahasimtare dhe plotësuese diakronike, për të shërbyer si shembull i përgjithshëm teorik i ilustruar se si zhvillohet semantika në shënjues të njëjtë, në kohë të ndryshme në dialekte e gjuhë të ndryshme, që në

[264] *Fjalor Enciklopedik Shqiptar 2*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2008, f. 1741-1742

ndonjë rast ndoshta duhet të shënohen dhe plotësohen edhe në materien historike të fushës semantike. Një synim është, që të dihet semantika e fjalës në periudha të ndryshme të përdorimit të saj, për të mos kaluar në perceptime të gabuara.

Po e nisim me analizën e një lekseme të vetër, e konsideruar si ballkanizëm, me një etimologji të diskutueshme. Bëhet fjalë për leksemën ***kopil***. Sot, nëse i referohemi fjalorit të fundit të gjuhës shqipe kemi këtë kuptim, siç e besoj se njihet edhe nga shumica e shqipfolësve:

kopil,-i *thjesht*.'fëmijë mashkull i lindur jashtë martese; dobiç', *bised*.'njeri i zgjuar, por shejtan', *bised*. 'filiz i ri që del në rrënjën e një bime'; ***kopili,-a*** thjesht 'kopilët', 'dinakëri; dredhi' si dhe në formën foljore ***kopiloj*** 'dredhoj, shpëtoj me dinakëri'[265].

Nëse lexojmë pjesën e prozës dhe konkretisht përrallat e vjela nga Thimi Mitko, shohim se leksema në shumë prej përrallave ka një semantikë tjetër, të ndryshme nga ajo që ka ajo sot. P.sh.*atje u pajtua kopil te një bashtovanxhi (kopshtar).*. (f.368). Nga konteksti në të gjitha vendet del se në përrallat, fjala kopil ka kuptimin e shërbëtorit. Edhe në fjalorin e Mitkos "Fjalëtore shqip- greqisht" (botim i dorëshkrimit) jepet sqarimi i fjalëve ***kopilī-a***, ***kopilërī-a*** (shpjegimi në greqisht me përkthimin në shqip) 'të qenët shërbëtor, shërbim, edhe dredhë', si dhe formën foljore të saj *kopilvít* ή *kopilōnj* 'shërbej, punoj'(f. 293). Në fjalorin e G. Meyer jepet ***kopíl*** [***kopil'***] m. 'shërbëtor' edhe 'djalë', geg. 'fëmijë i paligjshëm, dobiç' edhe si mb. 'dinak, i shkathët, i zoti'. *kopile* f. 'shërbëtore'. Më pas jep edhe krahasime me gjuhë të tjera si sll. vj. kishtare *kopilь* 'fëmijë i paligjshëm', serb. *kopile* 'kopil, djalë i zoti', ukr. *kopył* 'kopil', bullg. *kopile*. Fjala mungon në gjuhët sllave perëndimore. rum. *copil* 'fëmijë', *copilă* 'vajzë' gr. e re *κοπέλι* 'djalë i ri, shërbëtor', κοπέλα 'vajzë e re, shërbëtore'; që këtej arum. *copelă*; gr. e mesme *κόπελος* 'spurius'. Kuptimi bazë i fjalës është 'fëmijë i paligjshëm', ndërsa prejardhja e errët. Mikloshiç EË. mendon se fjala është e burimit shqip (250- 251). Edhe fajlorët e tjerë, krahinorë semantika lidhet me të vjetrën si p.sh. në fjalorin e Pano Tases ***kopile-ja*** 'shërbëtore, shërbyese'[266], në Fjalori i Gazullit e hasim në trajtë foljore kopilue v. akt. me kopilue kêndin: 'me i hjekë dredhi, me torrlue, me hjekë kopili'.[267] Referuar fjalorit të Meyer-it në lidhje me kuptimet përkatëse në dy dialektet, mund të krijojmë perceptim më të plotë edhe në lidhje me burimin semantik që ka fjala sot në shqip.

E quajtëm më sipër ballkanizëm, pasi fjala është me shtrirje ballkanike (ose karpate) të cilës i etiketohet si origjinë substrati. Në gjuhë të ndryshme në arealin ballkanik ajo mbart semantikë të ndryshme, sipas fjalorit etimologjik bullgar është nga burimi trako- ilir.

---

[265] *Fjalor i gjuhës shqipe*, Botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i gjuhësisë e letërsisë, Tiranë, 2008,

[266] P. Tase, *Fjalor dialektor Me fjalë e shprehje nga Jugu i Shqipërisë*, Tiranë, 2006, f. 114

[267] [267] N. Gazulli, *Fjalori i Gazullit*, Tiranë, 2005, f. 210

Përcaktimi i leksikut mbarëballkanik me prejardhje nga substrati (ose leksiku ballkanik në kuptimin e ngushtë të tij) është një detyrë mjaft delikate edhe e gjuhësisë indoevropiane dhe ballkanike, kjo edhe për shkak të dhënat jo të plota të gjuhëve autoktone.

Nga fjalori i Mitkos na ka tërhequr vëmendjen edhe lema ***πανουκλιάρης***, me gjegjëset e saj që na shërbejnë si pjesë shpjeguese të semantikës së kësaj fjale ***proboléc*** dhe ***çumār*** ose ***xhumār***.[268]

πανουκλιάρης, πανουκλο-κτυπημένος, ή λοιμών, ή μάλλον ξεμολευτής, proboléc, ή përbulétës-i, και γ. xhumār, ή xhumār-i (θηλ.) çumaréshë-a, και përbuléce-ja, ή proboléceja. Në bazë të kësaj semantike, Dh. Qiriazi është i mendimit se shpjegohet kënaqshëm edhe mbiemri Xhumari, që haset edhe sot në Shqipërinë e Mesme.[269]

Nisim fillimisht me fjalën greke ***πανουκλιάρης***. Leksemën, që ndoshta mund të përfshihet në korpusin e ballkanizmave leksikorë, e hasim si huazim edhe në gjuhë të tjera ballkanike si bullgarishte ***панýкла*** dhe arumanisht ***pănúkle***. Në bullgarishte e kemi me shpjegimin përkatës ***чума*** [çuma], që përdoret edhe në kuptime të ndryshme dhe si përbërëse togfjalëshash, siç është edhe emërtimi i një feste *пануклин празник* [festa e panukllës] festë për nder të Sh. Harallambos që festohet më 10 shkurt (Ohër). Besojmë se e ndeshim edhe në shqipe, në areal ndoshta mjaft të kufizuar. Në Devoll përdoret si shprehje: "të rrëntë panuklla!".

Po vijojmë me fjalën shpjeguese që vjen pas saj, ***proboléc*** me variantet e tjera *përbulétës-i*, *përbuléce-ja*, *proboléceja*. Fjala ndoshta është me prejardhje sllave si formim ***pro+bolec*** përshtatur më pas në shqip edhe në format e tjera siç ka ndodhur edhe në froma të tjera të ngjashme në bullgarisht si *прободен*, *пробой*, *пробуда* etj. Pjesa e parë ***pro***, në bullgarisht përdoret si parafjalë dhe si parashtesë siç ndodh edhe me gjuhë të tjera sllave si serbisht, sllovenisht, rusisht etj. me kuptimin 'për' dhe pjesa tjetër ***bolec*** që ka kuptimin e sëmundjes. Ndoshta në krye të herës në gjuhën nga është huazuar ka qenë ***bolest***, ose ndoshta ka qenë trajta përfaqësuese e vjetër sllave **болъ** me një prapashtesë deminutivi ***–ec***. Edhe leksema ***çuma***, që na jepet më sipër për plotësim të shpjegimit semantik, përdoret në disa gjuhë sllave me të njëjtin kuptim. Në fjalorin e gjuhës bullgare jepet si me burim nga hebraishtja.

Në fjalorin shqip- greqisht hasim edhe leksemën ***aguliçe-ja*** me shpjegimin ***zugrafetë-a***, lloj lule malore.[270] Fjala që në pjesën dërmuese të studimeve është e njohur si leksemë e burimit sllav, shpjegohet me një ekuivalente të saj, që

[268] [268] Th. Mitko, "*Fjalëtore shqip- gërqisht dhe gërqisht- shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike",* përgatitur për botim dhe studim hyrës nga Dhori Qirjazi, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2014, f. 569

[269] [269] Po aty f. 69

[270] Akademia e Shkencave të Shqipërisë, "Thimi Mitko, Vepra", Tiranë, 1981, f.481

mendojmë se është po prej burimit sllav. Të dyja këto leksema i kemi trajtuar në një botim më të hershëm.[271]

Emërtimin *aguliçe* e hasim edhe tek Majeri 'lloj lule mali', quhet gjithashtu edhe *zugrofetë* dhe e lidh me gr. e re αγουλι 'mish i dhëmbëve' αγουλιερας sipas Legrandit 'lloj bari i egër'.[272]

Çabej[273]e jep edhe shpjegimin e Majerit dhe e vlerëson si të drejtë shpjegimin e Skokut që e nxjerr nga sllav. e vjet. *jaglьcь*

Tek FEB (Fjalori etimologjik bullgar)[274] jepet *Iglika* (Иглика) si dhe sinonimet: *aglika, aglëç, aguliçka, jaguliçka*. Jepen etimologji të ndryshme. Mladenov e lidh me sllavishten, Georgievi e nxjerr nga greqishtja. Në fund del se kjo është nga prasllav. * jegla (kokër). Të njëjtin emërtim e hasim edhe tek gjuhë të tjera.

Edhe në lidhje me leksemën tjetër zugorfet, jemi të mendimit se kemi të bëjmë me një togfjalësh të dikurshëm të leksikalizuar në një fjalë të vetme po nga sllavishtja ***lule mali*** *iz gora cvete* 'lule nga mali'> *zgorocvet*> *sgorofet*.

Një leksemë tjetër që na ka tërhequr vëmendjen, pasi haset dhe në gjuhë të tjera ballkanike është ***kamare***: hyri ky edhe ndë kamare të çupës...[275] Nga konteksti që del në përrallë këtu leksema ***kamare*** ka kuptimin e dhomës, pra hyri në dhomë të vajzës. Sot në Fjalorin e gjuhës shqipe ***kamár/e,-ja*** jepet me kuptimin 'hapësirë si dollap i vogël në mur, zakonisht në anë të oxhakut, ku vihen enë a sende të tjera të vogla' (434). Në fjalorin e Mitkos fjala shpjegohet: ***kamáre-ja*** 'vend i posaçëm apo i thelluar në mure a tjetërkund për ekspozimin f.v. të statujave, etj. Edhe shtëpizë, dhomë... galeri, kubé. (f. 281). Në fjalorin e P. Tases: ***kamare-ja*** 'gropë e thellë në mur, si dritare e mbyllur nga jashtë, ku vënë plaçka' (104). Në fjalorin e Meyer: ***kamare*** 'kube, thellim muri i harkuar; dhomë' (223). Fjalën e kemi me shtrirje ballkanike, me semantikë të njëjtë dhe të ndryshme si p.sh. në bullg. kemi dy leksema me këtë emërtim, një me kuptimin e një organizmi ligjor në ndihmë të diçkaje që mund të jetë tregëti, kulturë, industri etj., siç e kemi ne në shqip 'dhoma e tregëtisë', ndërsa ***камара₂*** është paraqitur me shënim stilistikor *ocmap.* si fjalë e vjetër. nga greqishtja ***κάμαρα*** huazuar edhe në arumanisht *cámară* me kuptimin 'dhomë' në rumanisht *cămárá* me kuptimin 'qilar, dhomë e vogël' në serbisht ***кáмара*** 'qilar, dhomë'

Një leksemë që ndoshta paraqet interes për historinë e gjuhës shqipe, e konsideruar si pjesa e huazimeve sllave ***gllobë*** dhe ***gllobar*** si forma të vjetra të trajtës së sotme *gjobë*. Ato janë format që i kemi shënuar nga fjalori i Mitkos, ***gllobār-i***, ***gllóbë-a*** dhe ***gllobit***. ***gllobār-i*** 'ndëshkues', 'ndëshkues për vepra penale. Edhe *gëjobār* a geg'. ***gllóbë-a*** 'ndëshkim, dënim, gjobë'. ***gllobit*** 'ndëshkoj, jap

[271] Damo, R., Bello, Dh. Paralele leksikore në emërtimin popullor të bimëve në shqip dhe greqisht. Buletini shkencor. Seria e shkencave shoqërore. Nr. 14, 2008, f. 90- 104

[272] G. Meyer. Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Tiranë, 2007, f.40

[273]E. Çabej. Studime etimologjike, vëll I, f.17

[274]*Български етимологичен речник*, vëll. II, f. 6

[275]Th. Mitko. Vepra... f. 376

dënim'.[276] Në bullg., serb. глоба 'gjobë', në rum. gloabă. Në fjalorin etimologjik bullgar del me etimologji të paqartë. Ndoshta në gjuhën shqipe është huazuar nga gjuhët sllave. Gjithsesi kjo qartësohet kur të kemi të qartë dhe etimologjinë e saktë.

Një leksemë që përdoret sot në gjuhën shqipe në raste specifike, e shënuar në fjalorin e Mitkos është ***kamínë-a kumínë***. Nga përkthimi i saj nga shpjegimi në greqisht shënon: 'furrë (Në rrethin e Korçës kemi një fshat me shumë furra gëlqereje, që quhet "Kamenicë". Furrë zjari... e metalpunuesit, hekurpunuesit, gëlqerebërësit etj. Po ashtu qoshe zjarri, sobë)'.[277] Në fjalorin e fundit në shqip e gjejmë: kamín/ë,-a 'furrë për të pjekur tulla e tjegulla, për të djegur gëlqere etj.; vatër farke' (435). Shpjegimi që lidhet me Kamenicën (fshat në Korçë), mund të jetë edhe i gabuar, pasi ajo mund të lidhet edhe me emrin ***kamen***, që në gjuhët sllave ka kuptimin e gurit ***+ica,*** prapashtesë që e hasim edhe në forma toponimesh të tjera. Në fjalorin e Meyer kjo fjalë e krahasuar edhe me bullgarishten e serbishten jepet me kuptim tjetër dhe etimologjia e errët.[278] Fjala është me etimologji nga lat. ballk. *caminus*, me kuptimin 'vatërr (zjarri)'.[279] E hasim edhe në bullg. ***комин*** 'vatërr (zjarri)'arum. ***cominǎ*** por edhe në gjuhë jashtë arealit ballkanik.

Në përrallën "Motra dhe nëntë vëllezër" (edhe në ndonjë vend tjetër) hasim si personazh të emërtuar ***llamia***, ***llamisë***, që në fjalorin e Mitkos nuk e kemi të shtjelluar. Po kështu mungon dhe në fjalorin e fundit të gjuhës shqipe. Në fjalorin e Meyer e hasim në trajtën ***lamjë*** me kuptimin 'lubi, fantazëm' me burim nga greqishtja e re λάμια. Dhe në fund shprehet: ndoshta me të është e afër. lit. *laumē*. Fjala ka një shtrirje shumë më të gjerë se trevat ballkanike si ital. *lam(m)i*, fr. *lamie*, ang. *lamia*, por edhe në Ballkan si në bullg. *ламя* 'krijesë që ha njerëz', serb. *лама* 'vampir', me të njëjtin kuptim edhe në rum. *lame*.

Në fajlorin e Mitkos gjejmë edhe fjalë që sot kanë përdorim vetëm dialektor ose i përkasin një forme të vjetër, që mund të na shërbejnë si pjesë e historisë leksikore të fjalëve dhe kuptimeve të ndryshme në tekste të vjetra.

Një fjalë, që mendojmë se kërkon sqarim është edhe fjala e shënuar në fjalorin e Mitkos: **mjeraúshë-a** (Devoll, Gorë) milingonë, (geg.) thënégëlë, dhe (tosk.) mizë-përdhése-ja. Sipas Qirjazit (Mbase duhet shkruar *mieraúshë*, dhe *mieraúshkë*). Nuk e bën të qartë se përse duhet kështu.[280]

---

[276] Mitko, Th., "Fjalëtore shqip- gërqisht dhe gërqisht- shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike", *përgatitur për botim dhe studim hyrës nga Dhori Qirjazi*, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2014, f. 249

[277] Mitko, Th., "Fjalëtore shqip- gërqisht dhe gërqisht- shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike", *përgatitur për botim dhe studim hyrës nga Dhori Qirjazi*, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2014, f. 282

[278] G. Meyer. *Fjalor etimologjik* f.249

[279] Етимологичен речник, vëll. II, f. 572

[280] Mitko, Th., "Fjalëtore shqip- gërqisht dhe gërqisht- shqip & Ndihmesa të tjera leksikografike", *përgatitur për botim dhe studim hyrës nga Dhori Qirjazi*, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2014, f. 51

Mendojmë se fjala është e burimit sllav, pasi e hasim në bullg. në format ***мрав, мрава, мравей, мравинка, мравица, мравлив, мравушки*** etj., me të njëjtin kuptim ose në serbisht ***мравица, мравушка*** etj.[281] Në artikullin sqarues të Fjalorit etimologjik bullgar, përveç gjuhëve të tjera, e gjejmë si huazim edhe në shqipe në formën ***mjaraushkë***, dhe merret në referencë një punim i studiueses ruse Desnickaja.

Një leksemë e rrallë është edhe format e leksemave ***lekovat***, ***lekovatem***.

.... mjekët që e lekovatnin ose ..që të lekovasin këtë më parë.[282]

Në fjalorin e Mitkos ***lekovás*** *po lekovas plagën. – jam sëmurë e po lekovatem. Lekovásënja, lekováta, lekováturë. Lekovás unë, lekovát ti edh' ay. Lekovátem.* 'trajtoj të sëmurin, kujdesem për të sëmurin, i shërbej të sëmurit.... (pës) trajtohem për t'u shëruar' (f. 310).

Tek Meyer: ***lekovás*** 'mjekoj, përkujdesem për një të sëmurë' dhe citon Mitkon nga sllav. e vj. kishtare *lêkovati* nga *lêkъ* 'bar, ilaç'; serb. *lijek* (282). Sipas FEB mendohet të jetë nga gjermanishtja e vjetër, krah. got. *lēkeis* 'mjek', *lēkimōn* 'mjekoj' (352)

Fjalë të fondit bisedimor në gjuhën shqipe janë edhe trajtat ***darovë***, ***darovit***.

.. ajo mirte darova prej tij . .... darovavet që ay gjithënjë po i jepte asaj.[283] Në fjalorin e gjuhës shqipe (2006) ***darov/ë,-a***, ***darovísh*** jepet si e ligjërimit bisedimor me kuptimin përkatës 'dhuratë', 'falas, si dhuratë' si dhe ***darovít (darovís)*** dhe përkatësisht darovítem darovítj/e,-a f. me shënim stilistikor *vjet*. (e vjetër) me kuptimin 'jap darovë' (f. 171).

Meyer: ***darovī*** 'dhuratë, bakshish', *darovë* f. "id." *darovís*, në Berat *darovís* 'dhuroj, jap bakshish, lëmoshë'. Nga sllov. e vj. *daroviti*, serb. *darovati* 'dhuroj'.

E hasim edhe në gjuhë të tjera ballkanike si rum. ***dar***, ***dărul*** 'dhuroj', bullg. ***дар***, 'dhuratë, një dhunti e lindur, talent'si dhe mjaft forma të tjera fjalëformusese si *даром, дарба, даровник, дарявам, дарение* etj.

Siç u shprehëm edhe në krye, pasuria leksikografike e dhënë në fjalorë por edhe nga vjelja e fjalësit të përdorur në burimet folklorike është shumë e gjerë dhe meriton studime dhe analiza shumë më të thella. Koha e ngarkuar dhe disponimi relativisht vonë i veprës së përgatitur nga Dh. Qirjazi na kanë kufizuar në analizën e një pjese realtivisht të vogël fjalësh, gjë që na bën të mendojmë për një rikthim më serioz e më të thelluar në të ardhmen.

[281] *Български етимологичен речник 4*, Sofje, 1995, f. 274-275

[282] Th. Mitko. Vepra.. f. 375

[283] Th. Mitko. Vepra.. f. 371, 373

IDRIZ METANI (TIRANË)

IDENTIFIKIMI I KRIJIMTARISË POPULLORE SIPAS LEKSIKUT VENDOR NË VEPRËN E THIMI MITKOS

Objekt i kësaj kumtese është krijimtaria popullore[284] (lirika dhe epika) e Jugut dhe e Veriut[285] të Shqipërisë që është botuar në veprën[286] e Thimi Mitkos e vështruar shkurt në tri rrafshe: **a) në rrafshin e fushave konceptore e leksikore** për të vënë në dukje spektrin e këtyre fushave në këtë krijimtari; **b) në rrafshin leksiko-gramatikor** për të parë klasat e fjalëve të pranishme te "Bleta shqiptare" e Mitkos; dhe **c) në rrafshin e fjalëformimit** për të spikatur formantet, gjedhet e tipat fjalëformues dialektorë karakteristikë për veprën në fjalë.

1 Studiuesit e shqipes [287]që janë marrë me shtresën e dialektizmave dhe të krahinorizmave e kanë quajtur praninë e tyre në krijimtarinë popullore, vecanërisht në epikën e lirikën e saj, si një tregues të fortë të karakterit dialektor e krahinor të tyre. Ata kanë përcaktuar njëherazi edhe fushat konceptore e, lidhur me to, edhe fushat leksikore që kanë fjalë dialektore e krahinore më të shumta.

Nga makrofusha e botës materiale që lidhet me veçoritë e natyrës, me karakteristikat në jetesë, në banesat, veglat e punës e të prodhimit, shtrojet, veshjet, enët etj., mund të përmendim fjalë të tilla, si: *agë, aht, atë "kalë", babë, bajrak, bajraktar, bandill, bar, beg, begun, bela, besë, bijë, bir, bjeshkë, bjeshkatar, borxh, botë, breg, bres, budall, bukë, burrë, celinë, çallma, çiban, çibuk, cini, dajë,diell,derë, daon, divan, dardhë, dynja, dorë, dylber, din, dit, det, djalë, divahane, dekë"për vdekje", dyfek, dash, djelt "për djemtë", dren, dori, dollama, dhandërr, dheu, dhenë, dhunë, e enjte, ezhdërha, filxhan, flakë, ferman, faqe, fustan, fushë, fukara, fjalë, fis, fustanellë, franjitë ''për frëngjitë", fe, faj, fletë, fund, gegë, gegëni, gojë, gurë, grue, gjak, gjemi, hank "për hanko", harac, halldup, havanë, hoxhë, hapsanë, hysmet,*

[284] A. Grauri, duke folur për folklorin gojor, e sheh gjuhën e poezisë gojore popullore si një etapë të caktuar në zhvillimin e formave gjuhësore letrare. Kjo është e pranueshme sidomos për rrafshin leksikor të gjuhës në të cilin roli historik i gjedheve të përgjithësuara të ligjërimit gojor, që veprojnë në mjedisin popullor, është, sigurisht, edhe më i madh, pasi brenda kufijve të një të folmeje të caktuar shtrihet trualli i krijimit fillestar të një kënge a përralle popullore në të cilën integrohen elemente leksikore, frazeologjike, semantike e strukturore të së folmes përkatëse. (A. Graur, Studii de linguistica generala, 1960, f. 317

[285] Krijimtaria popullore e trevave të Veriut në veprën e Thimi Mitkos është në raport tejet të zhdrejtë me atë trevave të Jugut, prandaj autori, si për ta zbutur sadopak këtë raport, përdor heraherës në gji të lirikës dhe të epikës toske edhe fjalë e shprehje të gegërishtes, të cilat nuk i kanë shpëtuar vëmendjes dhe analizës sonë sonë.

[286] Thimi Mitko, *Vepra*, 1981

[287] Shih, sidomos, Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001. Ndërsa Androkli Kostallari në artikullin e tij "*Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*", në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, pohon "Mbiemrat ekzocentrikë i gjejmë në shkallë të gjerë në veprat e krijimtarisë gojore popullore, sidomos në poezinë popullore. Shumë prej tyre përbëjnë bile, një veçori vetëm të poezisë popullore", f. 118

ibrik, izën "për lejën", jakë, javë, krahëruar, kollomoq, kumbull, krye, kujexhijtë, kunorë, kadia, krushqi, krushq, krajl, krajleshë, kërnall, krah, kala, kulshedrë, kajkë, kafaz, konak kobure, kasapanë, kamë, kordhë, kordhëtar, kumbar, kullë, kuven, kolonë, kumbonë, kokërr, kalë, krenat "për të parët, paria", kauri "për tërësia e kaurëve", kafe, letinë, lot, levend, lule, luftë, lumë, lundër, llafe, llanë "për llërë", mejdan, mal, mish, mall, mulazim, mendra, mehana, mizori, mreti, mushkun, nanë, nam, nishan, nishan, nishane "për unaza dhe dhurata të tjera që shkëmbehen në fejesë", natë, nuse, nizam, nip, nigja, nevojë, njalë, oxhak, punë, plagë, pjeshkë, plak, peng, pëqi, pashah, pritë, pikë, pacë, pushkë, pulë, patë, prezore, pazar, pëllamë, pelë, pajton, pores, petrit, qiell, qitap, qen, qoshe, qerrata, raki, re, rrugajë,surrat, syni, sahat, sefer, saraj, selam, sheh, shkumë, shoqni, shoq, shebojë, shpatë, shkallë, shall, shkja, shkie, shishane, shapkë, shtëpia, trim, tym, taborr, toskë, toskni, teqe, tehir, telina, teneqe, turqni "për tërësia e turqëve", thi, urë, uzdajë, urim, uratë,vjet, vit, vetull, vashë, vorr, voj, vorfni, vezir, vilajet, venë, vaj, vah, vend, xham, xhami, xhixha, xhixhë, xhup,ylyver, ylyfe, zot, zemër, zonjë, zotni etj., të cilat, siç shihet, janë fjalë që u përkasin fushave të ndryshme leksikore të gjallesave, të bimëve a pjesëve të tyre , të veshjeve popullore, të veglave të punimit të tokës, të leshit, të bulmetit, të drurit, të qenieve mitologjike, të emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale etj.

Ndërsa nga makrofusha tjetër e botës shpirtërore që lidhet me marrëdhëniet farefisnore, me doket e zakonet, me mendësinë e kulturën krahinore në Veri dhe në Jug të Shqipërisë, mund të përmendim më pak fjalë*, si: amanet, angështi "ankth", andër, burrni, besëtytni, dorëzani, kambësi, kumbari, maturi, nafakë, nxitim, trimni, uzdajë etj.* Po japim më poshtë, përballë njëra-tjetrës, një lirikë shkodrane dhe një të Kolonjës :

-Mirëdita për këllana/me një par` kupa t`argjana/ mirë sod e mirë mot/ na ndihmo, i lumi zot!/ Del zoja, zoj` e shtëpisë/me kulaç të zotënisë/ Del e del e dalç e bardhë/, sod me barr` e mot me djalë/ Këtu ka një shej` të mirë, shej` të mirë/ kalë kamëbardhë, vithe të prarueme/ zojë të ngarkueme/ Apo mbë një dorë/ Moj zonjë, zonj` e shtëpisë/ nxerrna rrogjen e rakisë/ t`ua ndajmë djelmurisë/ mos na e qit nga e liga/ se të gjitha bahi shtriga. (Vepra, f. 94)

2 Duke pranuar që çdo gabim deri në ±2% në numërim e përllogaritje është objektivisht i përligjur për studime të tilla, po japim më poshtë disa të dhëna që dalin nga vëzhgimi i lirikës dhe epikës popullore të veprës së Thimi Mitkos në rrafshin leksiko- gramatikor:

Së pari, numrin më të madh të leksemave shënuese (emra, folje dhe mbiemra) e përbëjnë emrat, të cilët zënë gati 40% të korpusit të përgjithshëm të fjalëve të papërsëritura në veprën e Mitkos, po kështu, edhe në numrin e njësive leksikore të përsëritura, peshën më të madhe specifike e kanë emrat. Po përmendim disa syresh: *aga, akull, armë, andar, argjend, avlli, asllan, ar, autonomiburrë, breg, breshkë, barrë, bir, bace, bilbil, bujk, ballë, borzilok, bajloz, bardhok, baba, bucelë, biskonjë, bisht, bej, borë, bedenë, besë, botë, capo, cjap, cikklop, cinxami, çukë, çun, çupë,*

çoban, çobankë, çërre, çikë, çimber, çardhak, çair, çorbë, çifut, drekë, djalë, djemuri, dash, dërrasë, dru, dyfek, dorë, dituri, degë, ditë, diell, djersë, dardhë, djalë, derë, djep, det, dhëndërr, dhi, dhjamë, dhëmbë, erë, enë, emtë, ëma, fuurë, faj, fletë, fill, faqe, fron, fushë, fjalë, flori, ftua, frikë, fshat, fustan fytyrë, fajde, fyshekë, fole, frëngji, ferman, gajtan, gomar, gallof, gushë, grosh, gur, gërshërë, gojëz, gropë, grykë, gusht, geg, gegni, gjarpër, gjel, gjerdhan, gjumë, gjurmë, gji, gjysma, gjyle, hejbe, hekur, hap, hënë, hyri, hajmali, hanko, hallë, havanë, haber, hakë, hoxhë, jatro, jaran, karafil, kënetë, këmborë, kallanxhi, këlqerexhi, kondak, kulm, kupë, këmbë, krye, kishë, kartë, kurban, kunatë, krajl, krajli, krajleshë, krushq, kandil, kapedan, kala, kasap, kahur, kordhëtar, kulshedër, kishë, kasapanë, kollomboq, lëpjetë, lule, liga (e), lumi, lajkë, lot, lëmë, lanet, lis, larje, letër, llafe, llahtari, mik, mëri, matjan, mbretëri, martir, mace, mish, mal, murtajë, mizori, mushkë, motër, mes, mëndafsh, manushaqe, mot, mike, mollë, mëmë, manastir, mendje, mall, mjaltë, natë, nge, nishan, nishane, nam, nevruz, nizam, njeri, oxhak, përrua, prokopi, pacë, plak, plakë, peshë, pendë, prift, priftëreshë, putër, punë, pëqi, perëndi, prill, pasha, pikë, qen qengj, qumësht qumështor, qafir, qorr, qepë, rob, robëri, rini, radhë, rreth, rreckë, rracë, rrezik, samar, spahi, sqepar, saraj, sefer, sene, sabah, shtëpi, shtunë (e), Shqipëri, trëndafil, trastë, top, turtull, teqe, tra, thi, thërrime, thikë, thoi, thanë, ungjill, ujem, ujk, ujem, vashë, veshë, voj, vorr, vaj, vezir, vend, xanë, xhenet, xhenhem, ylyver, zemër, zorrë, zonjë, zogë, zeza (e), zamet etj.

Në njërën nga lirikat popullore toske kushtuar dhëndërit, të cilën po e japim më poshtë të plotë, vihet re përdorimi i dendur i emrave që kap shifrën 60% të leksemave të papërsëritura: Nd`atë shesh, nd`atë mejdan/dalëkë djali ajan/ shukonie c`fustan që mban!/tegelat mbi kllapodan/ fermelenë gjithë ar/ sumbullat margaritar/ mesthin ngjeshur me toka/ gjithë larë me sërma (216)

Na tërheq vëmendjen në veprën e Mitkos, përdorimi i disa emrave përmbledhës si, ***gegëni, kauri, kumbari, mituri, toskëni, turqëri*** e ndonjë tjetër me kuptimin tërësia e gegëve, kaurëve, kumbarëve, të të vegjëlve, toskëve, turqve. Ky përdorim duket se e rrit më shumë numrin e këtyre emrave në gramatikën e gjuhës shqipe.

Së dyti, foljet renditen pas emrave për nga denduria e përdorimit, ato kapin më shumë se 31% të leksemave emërtuese të papërsëitura në vepër dhe u përkasin grupeve të ndryshme, d.m.th janë folje ndihmëse, gjysmëndihmëse, me vlerë modale, këpujore, kalimtare, jokalimtare, folje që shprehin veprim, gjendje a mënyrën e veprimit etj. Ja disa syresh: *arrij, barit, bej, bie, bëhem, brumbullet, çel, çoj çohem, dal, dërgoj, dëshiroj, di dua, dëgjoj, dergjem, derdhet, djeg, dredh, ëmbëlsoj, ftoj, flas, fshi, fle, gaboj, gatuaj, gëzoj, gjej, hyj, hap harroj, heq, iki, jam, jap, kafshoj, kam, kujtoj, kall, kërcet, këndoj, kërcej, kallëzoj, kërkoj, kapërcej ,korr, laj, lagem, lë, lëshoj, luaj, llafos, mbaj ,marr, mund, mbuloj, martoj, mbledh, mbyll, mundoj, mbush, nisem, ngesh, ngre, nxjerr, nxij, ngrihem, ndodhem, nderoj, ndihmoj, punoj, prek, prish, pres, përplas, pëlqej, pi, përgjoj, pluhuroj, përpjek "takoj me dikë rastësisht", përpiqem, pëlqej, piqem "takohem", qëndis, qortoj, qesh, qaj, quaj,*

qasem, rendit, rri, rroj, rrëmbej, rrjedh, sjell, shaj, shikoj, shkruaj, shtroj, shkoj, shëmtoj, shoh, shkel, shpie, shijoj, shtroj, shtie, trashëgoj, turpëroj, trashem, tingëlloj, tres, them, thyej, ushqej, vesh, vë, vij, vëngëroj, var, xhvishem, zë, zbukuroj, zgjoj, zgjedh, zbres etj. Po japim më poshtë një lirikë dashurie të trevës së Veriut, e cila ngjall interes, jo vetëm për lirizmin e saj të spikatur, por edhe për përdorimin e përsëritur të foljes **luloj** me kuptimin "lëshonin lule, lulëzonin": Po lulojshin pjeshkatë/ po na vijn` të zeshkatë/ po lulojshin dardhatë/ po na vijn` të bardhatë/ po lulojshin kumbullat/ po na vijn` të rrumbullat/ po lulojshin mollatë/ po na vijn` meshollatë (f. 131)

Së treti, klasa leksikore e mbiemrave përdoret në veprën për të cilën po flasim në 19% të lemave të papërsëritura duke patur kështu edhe peshën më të vogël specifike për shkak të përqindjes së ulët të dendurisë së përdorimit. Mbiemrat e pranishëm në lirikën dhe epikën e Mitkos janë cilësorë që emërtojnë shtrirje hapësinore, madhësi, formë, veti fizike e gjendje shpirtërore, cilësi të karakterit a cilësi mendore, ngjyrë, por ata janë edhe marrëdhëniorë e, si të tillë, e japin tiparin e realies, në mënyrë jo të drejpërdrejtë. Po japim më poshtë disa mbiemra cilësorë e marrëdhëniorë ashtu siç na dalin në këngët lirike dhe epike të të dyjave trevave shqiptare*:*

i argjendtë, i artë, i bardhë, buzëqengjërush, buzëkarafil, buzëburbuqe, bishtpurtekë, bujar, bujareshë, i bukur, beronjë, buzëplasur, bukurosh, cullufezezë,cicaportokalla, dorëargjendtë, i donatisur, i dalë, i eshtërtë, i ëmbël, faqekuqe, i farkuar, faqekolopuçe, fodull, faqekartë, i fortë, fustanehollë, faqeqelqe, faqezi, faqerrumbull, gushëpëllumb, grykëzënë, i gjerë, i gjatë, i hollë, hundëderdhur, jelekekuqe, këmbëkëskë, i kuq, kalesh, krahëruarbardha, këmbëkuq, kapedan, këmbëshkurtër, i lig, leshgjatë, lumëmadhe, leshkurorë, i lartë, leshmargaritar, i mavitë, i marrë, i mjerë, i mirë, i mitur, mitare, manare, meshollë, i madh, i mesëm, meskëputur, meslangore, i mëndafshtë, mjekërkuq, i praruar, i parruar, i pakafshuar, i përkëdhelur, i pikëlluar, qafëzamake, i rëndë, i ri, syrrushe, syzezë, sykanxhë, sylarmë, syderdhur, i sëmurë, i shkretë, i shtrenjtë, shamikuqe, i shkruar, shamiverdhë, i tretur, i turpëruar, trim, i thatë, i vjetër, i vdekur, i vogël, varrvidhisur, vetullhollë, vetullaqemer, i velur, i zemëruar, zemërftohtë etj.

Mbiemrat janë përdorur për qëllime të ndryshme në lirikën e epikën popullore të mbledhur me kujdes e dashuri të pashoqe prej Thimi Mitkos, por ky nuk është qëllimi i kësaj kumtese. Po japim më poshtë një lirikë gege dhe një këngë të shkurtër nga arbëreshët e Greqisë për të parë përdorimin e mbiemrave në to, sidomos të mbiemrave të përbërë a kompozitave: *Ndër dy male, ndër dy fusha/ ish nji vash` tye punue/ kapërxeu një plak bujar:/ -punamar`, syzeza vashë!/ -të mar mos pac, o plak bujar/ -a vinj të të ndihmoj pak?/ -ndihma jote u laft me gjak/ kapërxeu nji djal` i ri:/ -punamar`, e bardha vashë!/ -të lumtë goja, djal` i bardhë! (f 190). Canë dhëmbëruazë/ të të kejë gruazë: Canë me sisë statere/ bërnda ndë zemër më there (f. 235)*

3. Dukë e kundruar krijimtarinë popullore të veprës së Mitkos në rrafshin fjalëformues vëmë re se lirika dhe epika e trevave të Veriut e të Jugut shfaqin të paktën dy tipa fjalëformues dialektorë që i zgjerojnë njohuritë tona për fjalëformimin në përgjithësi të shqipes standarde : a) për emërtimet e njerëzve sipas vendit ku banojnë në të folme të ndryshme të Veriut është tipik formimi me paranyjëzim e prapashtesë *(-a, -jan)* nga tema emërore p.sh. *i krumas, i shaljan* etj., por për të treguar banorët sipas vendit në një numër emrash nyja dhe prapashtesa herë është e pranishme herë jo, p.sh. *i kastrat, i hot, i shkrel*, por edhe thjesht *kastrat, hot, shkrel* etj., ndërsa në lirikën dhe epikën e Jugut formimi i emrit të banorit ose të fisit sipas vendit të banimit bëhet me anë të prapashtesës *–atë* që nuk e ndeshim as si mjet fjalëformues, por edhe si tip formimi në të folme të tjera, p.sh. *angonatë, beqiratë, hoxhatë, zekatë* etj. b) Në krijimtarinë popullore të Jugut vëmë re një numër jo të vogël fjalësh të prejardhura të formuara me prapashtesa zvogëlimi e përkëdhelie, të cilat dallojnë qartë njërën nga tjetra të folmet brenda toskërishtes. Kështu p.sh me prapashtesën *–z(ë)* në Berat, Myzeqe, Mallakastër: *dorëz, dhomëz, molëz, pakëz, prrallëz;* në Korçë (Opar, Devoll) me *–ckë, -çkë dhe –kë*: *cackë, kusiçkë, çupkë, djalkë* etj. ; në Korçë me *–icë, -nik, -ovinë*": *gomaricë, plevicë, dhallanik, petanik, djalovinë* etj. ; në Berat me *–kë: çobankë, llafazankë*; në Çamëri e Gjirokastër me *–lë (për –je): dhënëlë, marrëlë, vdekëlë* etj, ndërkaq në folklorin e Veriut me *–shëm* përkundrejt në Jug me *–uar*: *i dëgjueshëm-i dëgjuar, i punueshëm-i punuar* etj.; me *–m(e): e cilme, e lame, e vrame*; emra veprimi prej pjesores së foljes: *dekë, dergjë, ikë, veshë, vrasë* etj.

Në përfundim dëshirojmë të themi se vepra e Thimi Mitkos është një përpjekje e madhe me vlera të jashtëzakonshme për shqipen dhe për shqiptarët që duhet nderuar dhe vlerësuar si e tillë.

JULJANA KUME (TIRANË)

ÇËSHTJE LEKSIKORE TË GJUHËS SHQIPE NË FJALORIN TRIGJUHËSH TË THIMI MITKOS

Thimi Mitko është personalitet shkencor i kulturës sonë kombëtare, i cili, së shumti vlerësohet për mbledhjen e kulturës sonë gojore popullore, jo vetëm në dialektin toskë, por edhe në atë gegë, duke u bërë kështu *babai dhe krijuesi i folklorit shqiptar;* një ndër mbledhësit më të mëdhenj të leksikut popullor të gjuhës shqipe në gjysmën e dytë të shek. XIX., si dhe atdhetari, i cili për qëllime kombëtare ka bashkëpunuar me ideologë dhe veprimtarë të Rilindjes Kombëtare[288]. Të gjitha këto tipare e kontribute të dhëna në emër të kulturës dhe gjuhës shqipe, e bëjnë Mitkon personalitetin me vlera të veçanta në radhët e rilindësve shqiptarë, në folkloristikën, në leksikologjinë dhe leksikografinë e sotme dhe historike shqiptare.

Në kuadër të kontributeve shkencore të dhëna nga Mitko, pikërisht në këtë punim, do të mbështetemi në *Fjalorin trigjuhësh italisht-greqisht-shqip*, për botimin e të cilit është përkujdesur Shpëtim Sala, historiani dhe koleksionisti, i cili pasi arriti ta gjejë dorëshkrimin në një tezgë librash në rrugët kryesore të Tiranës, brenda një periudhe kohore dy vjeçare realizoi botimin në dy vëllime I. *Dorëshkrimi origjinal* dhe II: *Transliterimi dhe fjalësi shqip*. Fjalori trigjuhësh pasqyron gjendjen e gjuhës shqipe në gjysmën e dytë të shek. XIX. Përveç përfshirjes së njësive leksikore nga dialekti gegë e toskë, përmban fjalë të reja (neologjizma), shumë prej të cilave të formuara nga vetë autori si dhe, synon pastrimin e shqipes nga gjuhët e tjera të Ballkanit e Mesdheut etj. Vepra e Mitkos është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare të shek. XIX që dha kontribute edhe në gjuhësinë shqiptare.

Albanologë vendas dhe të huaj të shek. XIX i janë referuar veprës së Mitkos. Ndër to G. Meyer në *Fjalorin Etimologjik* ka dhënë mjaft fjalë shqipe, shpjegimet e të cilat i ka marrë prej Th. Mitkos. Nga ana tjetër, Mitko për hartimin e këtij fjalori ka pasur në dispozicion një literaturë të pasur në gjuhën shqipe, duke përfshirë gjithashtu, fjalë shqipe të përdorura nga autorët shqiptarë të veriut, kryesisht këto terma fetare të përdorura nga Budi etj. Mitko, edhe pse njohës mjaft i mirë i gjuhës së popullit dhe pasurisë shprehëse të tij, nuk ka përfshirë në fjalorin e tij mjaft njësi leksikore të përdorura në *Bletën Shqiptare*, pasi leksiku i tij është përcaktuar sipas kritereve të një fjalori tematik, ku fondi i fjalëve është më i kufizuar. Fjalori trigjuhësh i Th. Mitkos është strukturuar në dy pjesë: pjesën e parë e përbën *fjalori*

[288] Sala Sh., Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos, Transliterimi dhe fjalësi shqip II, West Print, 2013, f. 14.
Dallohet bashkëpunimi me ideologë dhe veprimtarë të Rilindjes Kombëtare, si: me Abdyl Frashërin në Stamboll; Kostandin Kristoforidhin në Elbasan; Jeronim De Radën dhe Dhimitër Kamardën në Itali; Dora D'Istrian dhe Nikolla Naçon në Rumani; Jani Vreton dhe Kristo Luarasin në Sofje; Kupitorin në Athinë; Naim Frashërin në Stamboll etj.

tematik, me fjalorin onomastik dhe pjesën e dytë *fjalori bisedimor,* në përmbajtje të së cilit përfshihen biseda tematike.

Mungesa e një alfabeti të shqipes, por njëkohësisht edhe si toskë, ndryshe nga shkrimtarët dhe studiuesit e veriut, të cilët e shkruanin gjuhën shqipe me alfabet latin, Mitko si tek *Bleta shqiptare* edhe tek *Fjalori trigjuhësh italisht-greqisht-shqip* ka shkruar gjuhën shqipe me shkronja greke, duke pasur në këtë mënyrë, ndoshta si qëllim zbutjen dhe afrimin e grekëve përkundrejt shqiptarëve.

Ndërmarrjen për hartimin e një fjalori trigjuhësh italisht-greqisht-shqip ia ka dhënë Mitkos njohja e mirë e gjuhës greke dhe italiane. Në kolonën e parë ka vënë vetëm një njësi leksikore në gjuhën italiane, ndërsa në kolonën e tretë, kryesisht, ka vënë disa njësi sinonimike në gjuhën shqipe, që i korrespondojnë fjalës në gjuhën italiane, ndërsa njësinë greke e ka pozicionuar në kolonën e ndërmjetëme. Ka përzgjedhur këtë strukturë vendosjeje, duke vënë italishten si gjuhë të parë, pasi e ka konsideruar kombin italian dhe rrjedhimisht gjuhën e tij të zhvilluar në fushën kulturore, industriale, të arsimit, të prodhimit, të tregtisë dhe të fesë, ndërkohë kur trojet shqiptare kishin shkallën më të ulët të zhvillimit, si dhe konceptet nuk kishin një formë leksikore të ngurtësuar dhe të standardizuar. Me këtë, ndoshta shpjegohen dhe tre- katër njësitë leksikore sinonime në gjuhën shqipe, që kryesisht i korrespondojnë një njësie të vetme në gjuhën italiane. Kryesisht, ndër ato njësi, përveç njësive dialektore (toskë, gegë), përfshihen edhe neologjizmat e krijuara prej vetë autorit p.sh.: *pomadhe-ja, të lyerë-t; lyhnar, kandil, dritë; sallë e të ngrënit, tryesore (neologjizëm i formuar nga autori); protimët, atëria, përindët, a prinjët; këpucët shyte (për të dhënë kuptimin e fjalës së huaj pantofël, që është përdorur edhe në kohën kur shkruan Th. Mitkoja), xvaranike-t* etj.

Fjalori i shek. XIX i rilindasit Thimi Mitko për nga sasia e fjalëve të leksikut të shqipes renditet pas fjalorëve të J.G. Hanit, F. Rosit, G. Jungut e G. Majerit. Fjalori i Mitkos, sikurse edhe ai i Pulevskit, janë të vetmit fjalorë të shek. XIX me orientim tematik, të cilët përmbajnë edhe shprehje dhe përshendetje, urime, etj., që përdoren në ligjërimin e shqipes.[289]

Nëse do të bëjmë një përmbledhje të shkurtër historike të leksikografisë shqiptare mund të themi se ajo fillon me *Fjalorin latinisht-shqip* të Frang Bardhit të 1635. Hapat e para të një fjalori normativ të gjuhës shqipe, edhe pse nuk arriti deri tek fjalori shpjegues i mirëfilltë, nisin me *Fjalorin e gjuhës shqipe* të Kostandin Kristoforidhit. Hartimi i fjalorëve të mirëfilltë kombëtarë të gjuhës shqipe nis me botimin e *Fjalorit të gjuhës shqipe* të vitit 1954, i cili vijon më pas me *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të vitit 1980, me *Fjalorin e shqipes së sotme* të 1984-ës dhe botimi i ripunuar në vitin 2002, duke vazhduar me pas me *Fjalorin e gjuhës shqipe* të 2006-ës[290].Nga ballafaqimi i Fjalorit të Kristoforidhit me fjalorin e Thimi Mitkos dhe

[257]http://gazetadielli.com/thimi-mitko-e-shpetim-sala-dy-korcare-rilindes-qe-i-japin-vlera-kohes-e-njeri tjetrit/#sthash.03VvGH2e.dpuf

[290] Feka Th., Book of proceedings, International Conference, Transition and Society, an interdisciplinary approach, *Normativiteti në fjalorët shpjegues të shqipes f. 18-25*

me fjalorët e tjerë të paraçlirimit mund te themi se të dy fjalorët janë hartuar pothuajse në të njëjtën kohë, gjysma e dytë e shek. XIX. Të dy fjalorët përfaqësojnë një kontribut të çmuar dhe dëshmojnë lëvrimin dhe pasurinë e gjuhës për kohën. Fjalori i Kristoforidhit është më i rëndësishëm dhe shënon hapin e parë drejt fjalorëve shpjegues kombëtarë (edhe pse nuk është një fjalor shpjegues i mirëfilltë kombëtar), ndërsa fjalori i Th. Mitkos është më i kufizuar në fjalësin e tij, pasi hartimi i këtij fjalësi është bërë sipas kriterit tematik (grupimi i fjalësit sipas fushave leksiko-semantike). Si fjalori i Mitkos dhe i Kristoforidhit ka karakter jo njëdialektor, por gjithëdialektor, gjithëshqiptar, veçse me dallimet, Mitko e ka mbledhur një pjesë të mirë të leksikut të gjuhës shqipe nga kontaktet me shqiparët toskë e gegë të emigruar jashtë vendit, kryesisht në Egjipt, ku kaloi pjesën më të gjatë të jetës. Ndërsa Kristoforidhi e mblodhi leksikun e gjuhës shqipe gjatë udhëtimeve nga Jugu në Veri të Shqipërisë gjatë përhapjes së literaturës së Shoqërisë Biblike të përkthyer nga ai vetë në gjuhën shqipe.[291] Në pjesën e parë të fjalorit të quajtur fjalori onomastik, Th. Mitkoja, ashtu sikurse kuptohet edhe nga emërtimi, ka sjellë më shumë emra. Parashtesta dhe prapashtesat fjalëformuese emërore me përdorim më të madh të sjellë në fjalorin e tij janë si më poshtë.

Formimi prapashtesor tek emrat: Me anë të prapashtesave, kryesisht atyre të mëposhtme, Mitkoja krijoi njësi të reja leksikore.

-ak: fëqinjak/e-ja (*fqinj/ak/e-ja*);

-ar, **-tar**: besëtar-i (*besë/tar/i*); mesatar-i(*mes/a/tar-i*); kandiltar-i; murëtar-i; kthisëtar-i; shkruetar-i; skolëtar-i; fjalëtar-i; gojëtar-i; vrapëtar-i; kopështar-i; cergar-i; poçar-i ose diegullëtar-i; kaminar (bukëpiekës), opingar ose këpucar etj.

-or/-e, **-i**; -**tor**: *atëror-i(atë/r-or/i);amëror-i(amë/r-or/i); lakëror-i(lakër/or/i); piperore-ja; uthullore-ja; tryesore-ja;dritësore-ja;trokëllore-ja;gjellore-ja; ditëtore-ja; shkruetor-i;kryeushtor-i; pajëtor-i; këmbanore-ja,shentërore-ja;therrore-ja;vrapëtore-ja; tregëtor; ushtërtor; harmoshor-i;*

-(a)nik/e: uthullnike-ja; vajanik-u

Formim parashtesor tek mbiemrat:

Mitko edhe në këtë pjesë të ligjëratës formoi një numër të konsiderueshëm neologjizmash mbiemërore. Mbiemrat janë më të paktë në numër në krahasim me emrat.

Parashtesat më të përdorura të mbiemrave janë *pa-*, *për-* p.sh.:

pa-: *i pandarë, i pa-udhë, i pamençimë, i pamundurë, i paujëshimë, i pakujdesë*, dhe më të pakët në numër me parafjalën

[291] Sala Sh., *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*, Transliterimi dhe fjalësi shqip II, *Vlera e fjalorit të Th. Mitkos*, f. 64, West Print 2013.

për-: *i përshijëshim, i përprishurë, i përbuletëshimë* etj.

Formimi prapashtesor tek mbiemrat:

Prapashtesa *–ëshimë* është mjaft e përdorur tek mbiemrat e sjellë nga Mitkoja, ndërkaq, kur në shqipen e sotme duke ruajtur të njëjtën trajtëformim, ka pësuar disa ndryshime fonetike në formën e saj duke kaluar *–shëm* p.sh.: i *bollëshimë* për *i bollshëm*, *i begatëshim* për *i begatshëm*, *i shijeshimë* për *i shijshëm*, *i pan(d)iejshimë* për *i pandjeshëm*.

Prapashtesa të tjera fjalëformuese tek mbiemrat me përdorim më të lartë janë:

-or: *paqëtor, ëmëror, fjalëtor, kreshmor etj.*

-ar, -(ë)tar: *mendar, fjallëtuar, besëtar, dëmëtar etj.*

-(ë)tuar,: gazëtuar etj.

mbiemër foljor: *i papiekurë, i udhëtuarë, i ujëçuarë etj.*

Formimi me anë të kompozimit:

Të shumtë në numër janë emrat e kompozuar në krahasim me mbiemrat e kompozuar. Shumë prej këtyre emrave të kompozuar i krijon vetë autori, ose mund të jenë të asaj kohe të formuara nga rilindës të tjerë. Fjalët e përbëra që i hasim tek Mitkoja, sipas formimit të tyre janë bashkim i dy temave emërore ose emër + mbiemër. Nga dy tema emërore kemi strukturën morfematike **emër + emër + prapashtesa (sufiks)**

p.sh.: ujëdhesë-a (*ujë/dhe/së-a*), udhëkryq/e-ja (*udhë/kryq/e-ja*), uji-argjëndi (*uji/argjënd/i*), gur-argjëndi(*gur/argjënd/i*),*shami-qafe-ja,këmishë-gjumi,rrobe-shtëpie,rrathduarshet,cipë-gjarpëri, këmbë-pule-ja, shtëpizë-fushe,* etj.

Emër + folje ose pjesore foljesh + prapashtesë (sufiks): verëqitësi (verë/qit/ës/i), *lule-shtrydhëje (lule-shtrydhë/je), zemër-dashurë, bukë-shkelës-i (bukë-shkel/ës/i), lëkurë-rregjës-i (lëkurë-regj/ës/i), dorëshkrume-ja* (dorë/shkrume/ja), *gjellë-bërës* (gjellë/bërë/s-i), *derëhapuri-a* (derë/hapur/i-a), *njeridashurë-i, zemër-dashur, gojë-lëshuarë* etj.

Emër + mbiemër + mbaresë: *lëvdatëmadh-i, lëvdatëkot-i; Zëmadh-i; symadhe-ja; dritëshkurtërë; dhëmbëçalë-i; mëndië-hollë; shtat-mirë; gënjeshtërmadh, zemërmirë, sy-vëngër etj.*

Mitkoja krijon njësi të reja emërore duke u mbështetur në fjalët e tjera të fondit të gjuhës shqipe: *krye-fsat-i; kryeushtor-i; kryetitull-i; kryetullugjin-i; kryetull-i; kurmagjak-u; kryedhiak-u; kryeati,* etj.

Thimi Mitkoja, në kolonën e tretë të gjuhës shqipe, përveç njësisë në formën e përgjithshme (sot forma letrare) ka dhënë bashkëlidhur saj sinonimin dialektor ose krahinor, si dhe anasjelltas, si p.sh.:

arkë-a, sënduq-i;	*këpucar, opingar;*
virgjërat, çupa-t;	*misër, kollomboq-i;*
litar, konop;	*Krishti, ristozi;*
kërmill, ligavec, kaçamill;	*pezishkë, cipë merimange;*
shkëndijë, xhixhilë-a;	*kthistar, peshkar;*
shpëresa, pandehëma;	*bukëpiekës, kaminar;*

aretia, dhuratë-a; *furkulicë, perua;*

Njësitë leksikore dialektore e të gurrës popullore përdoren si terma për të shënuar edhe sende, veprime, veti etj., prandaj ato mund të gjejnë përdorim dhe në fusha të tilla të dijes si teknika, gjeografia, gjeologjia, bujqësia etj. Kryesisht, njësitë leksikore dialektore përfshihen në terma sidomos kur shfaqin aftësi fjalëformuese, atëherë kur prej tyre formohen emra dhe mbiemra,edhe pse në fjalorin e Mitkos njësi të tilla nuk janë shumë, sepse ai ka ndeshur vështirësi kryesisht në dhënien e terminologjisë së tekonologjisë. Një rëndësi të veçantë, ai i ka kushtuar terminologjisë së mënyrë së jetesës, gatimit, veshjes, bimëve, kafshëve, shpendëve, si dhe veçanërisht terminologjisë shkollore etj. Në kuadër të emërtimeve terminologjike, përsa i përket fjalëformimeve me prapashtesa, jemi përpjekur të evidentojmë disa të tilla edhe pse nuk janë të shumta në numër dhe që autori disa prej tyre mund t'i ketë formuar vetë me brumin e gjuhës shqipe, si p.sh.: *uthull – uthull**ore**-ja, piper – piper**ore**-ja; tryesë – tryes**ore**-ja; shkruanj për shkruaj - shkruet**ore**-ja (tryezë shkrimi); tryezë - tryes**ore** (sallë e të ngrënit); kamin - kamin**ar** (bukëpjekës); treg – tregë**tor;** uthull - uthull**nike**-ja; vaj - vaj**anik**-u; gjellë - gjell**ore**-ja; ditë - ditët**ore**-ja; këmban - këmban**ore**-ja, therr - therr**ore**-ja; vrap - vrap**ëtore**-ja* etj.

Përpjekjet për krijimin e neologjizmave me parashtesa, prapashtesa, kompozita me vetë brumin e gjuhës shqipe, qysh nga shkrimtarët e parë shqiptarë e duke vazhduar me shkrimtarët e Rilindjes, të kryesuar nga Naimi dhe Samiu e duke vijuar edhe në ditët e sotme, e ka mbështetur dhe Mitkoja me krijimet (fjalëformimet) e tij, duke e parë si një nga rrugët më të rëndësishme të pasurimit të gjuhës me njësi, shprehje dhe ndërtime të reja, ashtu sikurse e shihte të lidhur ngushtë me detyrën e pastrimit të gjuhës nga njësitë leksikore, ose neologjizmat e panevojshme. Në parathënien e Bletës Shqiptare[292], Th. Mitkoja ka shkruar, se *qëllimi i veprës ishte shpëtimi i gjuhës shqipe dhe lënia e brezave që vijnë i fjalëve dhe teksteve shqipe*.

Ashtu sikurse e përmendëm edhe më lart, po sjellim disa prej neologjizmave të krijuara me brumin e gjuhës shqipe nga autori ose që mund t'i kenë përkitur asaj kohe p.sh.:

ditëtore (për gazetë); *ventar* (patriot); *vendëri* (atëdhe); *gjellëbërës; derëhapësi-a; dorë-larës-i* (lavaman); *dorëshkrume-ja; dheshkres* (gjeografi); *shkruetor-i* (autori, shkrimtari); *shkruetore-ja* (tryezë shkrimi); *rrathduarshet ose rrathë-duarset; therrore-ja* (shenjtërore); *këpucët shyte (pantofla); rrobe-shtëpie; shami-qafe-ja; larëseja* (grua që lan rrobat); *mal i zjarrtë* (vullkan); *qindoreja* (shekull); *cipë-gjarpëri* (dantellë); *tryesore* (sallë e të ngrënit); *dritsore-ja; bythakët* (pantallonat); *vrapëtoreja* (karro); *erë-shtiellësa* (vorbull ere, stuhi) etj.

[292] Mitko Th., *Vepra*, Tiranë 1981, Vjersha nr. 401.

Për sa i përket huazimit të njësive leksikore dhe termave nga gjuhët e huaja, Th. Mitko ka përfshirë në fjalorin e gjuhës shqipe ato që ishin më të vjetrat, duke theksuar se *gjuha jonë është shumë e lashtë.* [293]

Në vijim të punimit jemi përpjekur të evidentojmë njësitë leksikore greke të sjella në fjalësin e autorit, duke lënë jashtë vështrimit huazimet e vjetra greke e latine, si *drapër, mokër, qershi, pjepër, presh* (gr.) *fre, fqinj, gjel* (lat.). Në këtë pjesë shfaqin interes ndikimet nga greqishtja e re dhe fjalëformat e shqipes me ndikimin e greqishtes, sepse autori ka pasur ndikim të vazhdueshëm nga gjuha dhe kultura greke. Madje, në një letër shkruar P. Kupitorit, Mitkoja ka shprehur simpatinë për Greqinë, duke paralajmëruar që ky shtet të qëndronte larg pretendimit për trojet shqiptare, duke nënvizuar: *Ju siguroj me mënyrën më të sinqertë se jam me mish e me shpirt për madhështinë e Greqisë, por gabohen keqas ata që mendojnë se do të mundet ndonjë herë Greqia e sotme të pushtojë dhe ta marrë nënë pushtetin e saj Shqipërinë me anë të armëve*[294]*.*

Pra, synimi ynë nuk janë huazimet sllave dhe turke, edhe pse gjatë hartimit të fjalësit të këtij fjalori Th. Mitkoja është munduar t'i evitojë ato dhe t'i zëvendësojë me njësi të shqipes ose fjalëforma me brumin e gjuhës shqipe ose futja në kllapa e fjalës turke, që ishte e njohur në atë kohë p.sh.: [295]*carne sallata* – mish i thatë (pastërma); *Kakiu* (Saç turk)

Rrjedhimisht, shumë prej greqizmave të evidentuara në fjalorin trigjuhësh të Mitkos i përkasin pjesës së ligjëratës së emrit. Kemi arritur të evidentojmë shumë pak folje dhe mbiemra, p.sh.: në shprehjet *Mish* ***i cigarisurë****, Ve* ***të tiganisura****,* këto mbiemra foljorë (nga pjesoret e foljeve) janë me temë nga aoristi (e kryera e thjeshtë) i greqishtes p.sh.: folja *cigaris* < gr. re τσιγαρίζω aoristi τσιγάρισα. Folja *tiganis* < gr. re. τηγανίζω, aoristi τηγάνισα. Në gjuhën shqipe kanë depërtuar shumë folje greke nga aoristi (koha e kryer e thjeshtë), të cilat kanë zënë vend në leksikun e shqipes standarde p.sh.:

argas-em *regj (lëkurën)* < gr. re αργάζω, αργάσω *regj, argas lëkurët, zhdëp në dru, rrah fort*. **G. Ulisch, E. Çabej;**

farmakos-em*, bised.* helmoj < gr. re φαρμακώνω, φαρμακώσω *helmoj, pikëlloj, fig. hidhëroj shumë*. **G. Ulisch;**

feks*, shkëlqen, llamburin* < gr. re φέγγω, *φέξω ndriçoj, bëj dritë, agon dita, gdhin*. **G. Meyer, G. Ulisch, E. Çabej;**

kumbis*, mbështet trupin a veten diku për t´u çlodhur* < gr. re ακουμπίζω *prek, takoj, përkas, mbështes.* fig. *depozitoj në bankë*, kjo nga lat. accumbere. **G. Meyer.**

Në fjalor, foljet pothuajse mungojnë. Shumë pak folje të gjuhës shqipe ndeshim tek pjesa e dytë e fjalorit bisedimor dhe akoma më pak ato me prejardhje greke.

[293] Sala Sh., *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*, Transliterimi dhe fjalësi shqip II, *Leksikografi*, f. 34, Ëest Print 2013.

[294] Mitko Th., *Vepra I,* Tiranë 1981, f. 614

[295] Sala Sh., *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*, Transliterimi dhe fjalësi shqip II, *Vështrim mbi leksikun e fjalorit*, f. 56, West Print 2013.

Foljet e gjuhës shqipe të zgjedhimit të parë, veta e parë, njëjës, ruajnë mbaresat e vjetra të shqipes p.sh.:
*shëko**nj*** për *shiko**j**: Më kërkonjën, duhet të vete të **shëkonj** një të sëmurë.;*
*kupëto**një*** për *kupto**j**: Ja s'kupëton, ja s'do të **kupëtonjë**.;*
*bë**nj*** për *bë**j**: Ju **bënj** be për këtë.*

Emrat grekë i janë përshtatur lakimit të gjuhës shqipe duke marrë mbaresat karakteristike të trajtës së pashquar dhe të shquar, të gjinisë mashkullore dhe femërore në të gjitha rasat e gjuhës shqipe p.sh.: **aguridhe-ja** *i papjekur, i pabërë, i paarrirë (për frutat), gresë, mufkë* < gr. re η αγουρίδα *rrush i papjekur.* **qaramidhe-ja** ose **qeramidhe-ja** *tjegull* < gr. re το κεραμίδι *tjegull.*

Pothuajse, të gjitha greqizmat e identifikuara në fjalësin e Mitkos, duke filluar që nga Fjalori i vitit '54 dhe në vijim, janë pjesë e pandashme e shqipes standarde. Janë të pakta greqizmat e sjella prej tij, si greqizma me përdorim krahinor ose dialektor, por edhe atëherë ato kanë përbri njësinë sinonimike në gjuhën shqipe p.sh.: *vivli-a, libr-i.; aretia, dhuratë* etj. Njësitë leksikore si *vivli-a* (libër), *kondil* (kalem guri), *agorastës* (blerës), *areti* (dhuratë), *qiromer* (mish derri i tymosur i përdorur në të folmet arbëreshe të Italisë së Jugut[296]), nuk janë në asnjë nga fjalorët (Kristoforidhi, Fjalori i vitit 1954 dhe 1980).

Përpjekja për ruajtjen e pastër të gjuhës shqipe nga njësitë e huaja, përshkruan gjithë fjalorin, aq më tepër ajo vihet re në përkujdesjen që tregon autori gjatë përdorimit të greqizmave në këtë fjalor, ndërkohë kur prania e elementeve greke është e ndjeshme në të folmet krahinore, veçanërisht prej nga autori mori mësimet e para.

Më poshtë jepet renditja e greqizmave të vjela nga fjalësi i gjuhës shqipe në Fjalorin trigjuhësh italisht-greqisht-shqip të Th. Mitkos:
PISA, ziarri, ferri,
Njësia greke pisa jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së 1. *Material për të shtruar rrugën në vend të asfaltit*; 2. *Skëterr, ferr;* FGJSH ´80, f. 1487 *katran; skëterrë, ferr* <gr. re πίσσα *katran*, fig. *e zezë katran.* **G. Meyer, G. Ulisch, E. Çabej**.
ARME-JA
Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ´80, f. 51, FGJSH '54, f. 16 > *lakër e vënë turshi* <gr. re η λαχαναρμία *shëllirë.* **E. Çabej.**
CIKMË-A
Jo në Fj. e Kristoforidhit, është në formën ciknë-a (acar-i); **CIKNË-A** FGJSH '54, f. 57; **CIKMË** FGJSH ´80, f. 222 1. *acar,* 2. *brymë që bie në mot me acar,* 3. *pjesa e djegur e gjellës a e qumështit, që është ngjitur në fund të enës* < Me burim nga turq. çenk, ndërmjetësuar nga gr. re η τσίκμα. **G. Ulisch, E. Çabej.**
LIMAN-I, skelë-a

[296] Scutari, P., Dizionario arbëresh di San Costantino Albanese, Presentazione di Francesco Altimari, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia 2010, f. 31.

Njësia leksikore greke *liman-i* në Fj. e Kristoforidhit f. 186; FGJSH ‘54-së *port*; FGJSH ´80, f. 1000 *gji i vogël në breg të detit, të liqenit a të një lumi të lundrueshëm, port, skelë, vendi ku ngarkohen e shkarkohen anijet* < gr. re το λιμάνι *skelë, port, fig. strehë, strehim.* **E. Çabej**

Krishti, a **RISTOZI**

Njësia leksikore greke *ristoz-i* jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH ‘54-së; Jo në FGJSH ‘80 < gr. re ο Χριστός. Njësi e sjellë për herë të parë nga Mitko.

Trup-i, **KURM-I**

Njësia leksikore greke kurm-i në Fj. e Kristoforidhit f. 174 1. *trup-i; trungu i drurit*; FGJSH ‘54-së 1. *trup i njeriut,* 2. *trungu i drurit*; FGJSH ´80, f. 923 > *trungu i trupit të njeriut, shtati pa gjymtyrë e pa kokën, trupi* < gr. re το κορμί *trup, trung*. **G. Meyer, E. Çabej**

i/e KOLMË

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së i/e hieshme, i/e këndshme; FGJSH ´80, f. 849 *që ka trup të shëndoshë, të mbushur dhe të bukur, i/e hijshëm/e* < gr. re κομψός *elegant, i hijshëm.* **E. Çabej**.

QIROMER-I

Jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH ‘54-së < gr. re το χοιρομέρι

Tek arbëreshët e Italisë Diz. di San Costantino Albanese, Pasquale Scutari, f. 31; E. Giordano, f.

FURKULICË-A

Fj. Kristoforidhit f. 110, pirun-i; FGJSH ‘54-së f. 132; FGJSH ´80, f. 519 *pirun* < gr. re η *φουρκουλίτσα*. **E. Çabej**.

AGURIDHE-JA

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f.4, *rrush i papjekur*, fig. *njeri i papjekur;* FGJSH ´80, f. 12 *i papjekur, i pabërë, i paarrirë (për frutat), gresë, mufkë* < gr. re η αγουρίδα *rrush i papjekur.* **G. Meyer, G. Ulisch, E. Çabej.**

MARULE-JA

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f. 292, *bimë barishtore me fletë të trasha e të gjata që e hanë sallatë, leqikë;* FGJSH ´80, f. 1060 < gr. re η μαρουλιά, kjo prej lat. **G. Meyer, G. Ulisch, E. Çabej**.

Fener-i, **LYHNAR**, kandil, dritë

Njësia leksikore greke lyhnar në Fj. e Kristoforidhit f. 186 në formën linar-i; Jo në FGJSH ‘54-së; Jo në FGJSH ‘80 < gr. re re λυχνιά, λυχνάρι. **LIXNI** *llampë ndriçuese*. Liχnàr, kal. χilnàr Frasc., sic. χërnàr Piana, χnar Cam. “id.” Linàr “llampë metalike, ndriçuese” geg., kal. Rada. Tek **G. Meyer**, f. 286.

QARAMIDHE-JA

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f. 446 *tjegull;* FGJSH ´80, f. 1598 qeramidhe *tjegull* < gr. re το κεραμίδι *tjegull.* **G. Meyer, G. Ulisch**.

FUSTAN-I, kotullë-a, rraxhë-a

Njësia leksikore greke fustan-i në Fj. e Kristoforidhit f. 110; FGJSH '54-së, f. 132, 1. *pjesë kostumi kombëtar, petk burrash me pëlhurë të bardhë*, 2. *kostum grash;* FGJSH ´80, f. 520 < gr. το φουστάνι. **G. Ulisch**.

Përparëca, **PODIQE-JA**, podjako-ja

Njësia leksikore greke podiqe-ja jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH '54-së < gr. re η ποδιά

ALISIVË-A, finjë-a

Njësia leksikore greke alisivë jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 7, *finjë*; FGJSH ´80, f. 24 *finjë* < gr. re η αλισίβα, me burim prej it. fj.e huaj *finjë.* **G. Meyer, G. Ulisch**.

VIVLI-A, libër-i

Njësia leksikore greke vivli-a jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH '54-së < gr. re το βιβλίο

KONDIL-I

Jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH '54-së; **KONDIL** *penë*. Nga gr. e re κοντύλι, kjo prej gr. së vj. κόνδυλος, arum. *condilu* Kav., rum. *condeiu*. f. 249.

KANON-I

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 198 *kanun-i përmbledhje ligjesh penale e civile të pashkruara, ligj;* FGJSH ´80, f. 780 *tërësia e normave të së drejtës zakonore* < prej turq, kjo prej gr. re ο κανόνας *rregulla, rregulla të përgjithshme.* **G. Meyer, E. Çabej**.

TË ARGASURIT, të munduarit

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 15 *argas* 1. *Regj*, 2. *Forcoj trupin që t'i qëndrojë të ftohtit e mundimit;* FGJSH ´80, f. 47 *regj (lëkurën)* < gr. re αργάζω, αργάσω *regj, argas lëkurët, zhdëp në dru, rrah fort*. **G. Ulisch, E. Çabej**.

PANAGJYR-I

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 372, *panagjir;* **PANAIR-I,** FGJSH ´80, f. 1344. < gr. re ose e mes. το πανηγύρι *panair, dëfrim, argëtim, gosti e madhe; iron.shamatë, grindje, zënkë,* e cila ka shkuar dhe në gjuhë të tjera ballkanike duke përfshirë dhe turq. **G. Meyer.**

KUMERQ-I

Në Fj. e Kristoforidhit f. 172; Jo në FGJSH '54-së; Jo në FGJSH '80-së < gr. re κουμέρκι, κουμερκιάρις "id.", dhe kjo nga lat. *Commercium;* sll.vj. kishtare *kumerъkъ*, arum.*cumerche,* turq. *gümrük.* **KUMERQ, KURMEQ** *doganë.* Kumerqar *doganier, G. Meyer,* f. 268.

CERGË-A

Në Fj. e Kristoforidhit f. 62; FGJSH '54-së, f. 56, 1. *Mbulesë e leshtë e trashë dhe e ashpër,* 2. *Shatorre e bërë me copa*, 3. *Rrecka, zhele* < fjalë e huaj me burim nga një gjuhë tjetër ndërmjetësuar nga gr. re τσέργα.

gr. re

CERGAR

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f. 56, *njeri a fis pa plëng e pa shtëpi, që bredh poshtë e lart me cerga në krah* < fjalë e huaj me burim nga një gjuhë tjetër ndërmjetësuar nga gr. re τσέργα + prapashtesa e shq. ar.

VLLASTAR

FGJSH ‘54-së, f. 616, *vlastar, lastar;* FGJSH ´80, f. 2177. < gr. re το βλαστάρι *filiz, lastar.* **G. Meyer**.

Misër, **KOLLOMBOQ-I**

Njësia leksikore kollomboq jo në Fj. e Kristoforidhit, FGJSH ‘54-së kollomboq, f. 224; FGJSH ´80, f. 770 krahin. *misër* < gr. re το καλαμπόκι *misër.* **G. Ulisch, E. Çabej** < gr. re

DIQEL-I

Fj. e Kristoforidhit f. 92; FGJSH ‘54, f. 101; FGJSH ´80, f. 407 > *vegël bujqësore me dy dhëmbë hekuri e me bisht druri që shërben për të rrëmihur tokën* < etimologji dyfishe. Forma me d- nga turq., ajo me dh- nga gr. το δικέλλι *bujq. diqel, vangë*. **G. Ulisch, E. Çabej**

IGUMEN-I

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f. 178, *kryetari fetar i një manastiri ortodoks* < gr. re ο ηγούμενος

TRËNDAFIL-I

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f. 573; FGJSH ´80, f. 2024. < gr. re τριαντάφυλλον. **G. Meyer**.

EFIMER, meshëtar

Jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH ‘54-së < gr. re ο εφημέριος

DHIAK, xhakon-i

Jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH ‘54-së; **DHJAK-U**, FGJSH ´80, f. 407 *titull fetar në kishën ortodokse, ndihmës i priftit në kryerjen e shërbesave fetare* < gr. mes. ο διακός pranë διάκονας *ai që kryen shërbimet fetare, ndihmës në kishë.* **E. Çabej**.

KONDIL, KALEM, **MELLAN**

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH ‘54-së, f. 304, *ngjyrë a bojë për të shkruar;* FGJSH ´80, f. 1108 vjet. *bojë shkrimi* < gr. re το μελάνι *bojë.* **G. Meyer, G. Ulisch**.

AGORASTËS

Jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH ‘54-së < gr. re ο αγοραστής *blerës*

KAMILE-JA

Fj. e Kristoforidhit f. 147 gjendet në formën *kamille-të*; FGJSH ‘54, f. 135; **GAMILE-JA,** FGJSH ´80, f. 533 *deve* < gr. re η καμήλα *deve.* **G. Meyer, G. Ulisch**.

COHË-A

Në Fj. e Kristoforidhit f. 65; FGJSH ‘54-së, f. 59, *stof i leshtë, i butë dhe i punuar hollë;* FGJSH ´80, f. 230; FGJSH ‘54, f. 59 *stof leshi i butë dhe i punuar hollë* < Me burim nga turq.*coha*, ndërmjetësuar nga gr. re η τσόχα fj. e huaj: *stof leshi, fig. dinak, batakçi,* είναι μία τσόχα *është një dinak, një batakçi*. **G. Meyer, G. Ulisch, E. Çabej**

ARETI-A, dhuratë-a

Njësia leksikore areti-a jo në Fj. e Kristoforidhit; Jo në FGJSH '54-së < gr. re η αρετή virtyt. Kemi zgjerim semantik nga *virtyt* në gjuhën greke në *dhuratë* në gjuhën shqipe.

ZALI-A

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 626; FGJSH ´80, f. 2208. < gr. re η ζάλη, ζαλίζω *marremendje, trallisje.* **G. Meyer**.

QIPARISE-JA

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 450, *selvi;* FGJSH ´80, f. 1613 *dru halor mesdhetar me trup të drejtë e të gjatë dhe me një majë të zgjatur, me gjethe të vogla luspake përherë të blerta, që bën disa boçe të vogla e të forta, selvi* < gr. re το κυπαρίσσι *selvi.* **G. Meyer, G. Ulisch**

KATOJ-I

Në Fj. e Kristoforidhit f. 152 në formën katua-oi; FGJSH '54-së, f. 206, në formën *katoq;* **KATUA, KATOQ,** FGJSH ´80, f. 802 > *ahur në katin përdhes të një shpie, ku mbahen kafshët shtëpiake dhe almiset bujqësore; bodrum, qilar* < gr. re το κατώγι. **G. Ulisch.**

KAMARE-JA

Jo në Fj. e Kristoforidhit; FGJSH '54-së, f. 196, 1. *vend në mur në formë qemeri,* 2. *kabinë;* FGJSH ´80, f. 775 *vend i hapur në murin e një shtëpie, zakonisht në të dyja anët e oxhakut, ku mbahen enë e sende të vogla që përdoren përditë; dollap i vogël pa kanata në mur* < gr. re η καμάρα *qemer, harku i këmbës, i shputës.* **G. Ulisch**

DHOGË-A

Në Fj. e Kristoforidhit f. 93; FGJSH '54-së, f. 101, *dërrasë;* FGJSH ´80, f. 410; *dërrasë* < nga gr. re η δόγα, kjo nga it. *doga*. **G. Meyer, G. Ulisch, E. Çabej.**

Përfundime:

Mitkoja, personaliteti me vlera të veçanta në radhët e rilindësve shqiptarë, njihet jo vetëm për kontributin e tij të çmuar në folkloristikën shqiptare, duke u bërë babai dhe krijuesi i folklorit shqiptar, por njëkohësisht dallohet si mbledhës i leksikut të shqipes, duke u shquar si leksikograf dhe leksikolog me vlera të veçanta në fushë të leksikografisë dhe leksikologjisë së sotme dhe historike shqiptare.

Pikërisht, Fjalori trigjuhësh *italisht-greqisht-shqip* pasqyron gjendjen e gjuhës shqipe në gjysmën e dytë të shek. XIX, duke marrë vlera të veçanta, pasi në një fjalor të tillë tematik gjenden grupime leksiko-semantike jo vetëm nga dialekti toskë, por edhe nga dialekti gegë.

Fjalëformimet (neologjizmat) e autorit me parashtesa, prapashtesa dhe kompozita nga brumi i gjuhës shqipe i shtojnë vlerat këtij punimi, duke evituar njëkohësisht mjaft njësi leksikore të huaja si turqizma, sllavizma, por edhe greqizma, etj. Purizmi i gjuhës nga njësitë leksikore të huaja ka qenë një nga detyrat kryesore në programin e Rilindjes sonë Kombëtare.

Gjithashtu, Mitkoja si njohës i mirë i gjuhës dhe kulturës greke, me formim bazë arsimor në shkollat greke, ka dhënë në këtë fjalor një ndihmesë të veçantë nga një anë për shmangien e greqizmave të panevojshme, krahinore dhe zëvendësimin e

tyre me njësin leksikore të shqipes, dhe nga ana tjetër ka lënë në përdorim greqizma, të cilat me ngjyresat e tyre të përpikta kuptimore kanë zënë vend në përgjithësi në leksikun e gjuhës shqipe dhe asaj standarde në veçanti.

KLEDI SHEGANI (TIRANË)

VËSHTRIME LEKSIKORE NË VEPRËN E THIMI MITKOS

Në këtë kumtim të shkurtër kemi bërë objekt të punës sonë njësi leksikore, të vëzhguara në veprën "Bleta shqiptare", të një prej rilindësve tanë, Thimi Mitkos. Për të përligjur prejardhjen e trashëguar të këtyre njësive kemi evidentuar argumentimet e Mitkos për këtë çështje, të cilat për t'i bërë më bindëse janë shoqëruar edhe me zhvillimet gramatikore e ndryshimet kuptimore të fjalëve.

Përpjekja për shpjegimin e fjalëve dhe të kuptimeve të tyre në gjuhën shqipe, shënimet etimologjike dhe vërejtjet e ndryshme gjuhësore paraqesin një fushë interesante dhe me vlerë për kontributin e Mitkos në fushën e filologjisë, të cilat, pa dyshim vunë gurin e parë në studimet e mëvonshme etimologjike.

Në punim kemi vlerësuar edhe përpjekjet e Th. Mitkos për t'i shqipëruar fjalët, veçanërisht ato me prejardhje nga greqishtja, duke u bërë kështu pjesë e asaj lëvizjeje të madhe që ndërmori Rilindja ndaj lemave me prejardhje të huaj. Kjo ndikoi pa dyshim në përmirësimin e semantikës leksikore të fjalëve të shqipes dhe, për më shumë, në përmbushjen e misionit për përhapjen dhe përvetësimin e gjuhës sonë.

Gjithashtu, në këtë punim do të vlerësojmë punën e Th. Mitkos për mbledhjen e visareve të gjuhës sonë kombëtare dhe sqarimin e semantikës të "Fjalë të errëta" (Gjëegjëzat)

Historia e shtetit shqiptar , gjithmonë ka qenë e lidhur me gjuhën; është një histori që ka kaluar përmes përpjekjeve për ndërgjegjësim, dhe një aktiviteti atdhetar që ka mbetur në kujtesën kombëtare si shenja dalluese e kombit tonë , në çdo etapë të historisë. Ashtu si të gjithë autorët e Rilindjes, edhe Thimi Mitkoja e shihte lëvrimin e gjuhës shqipe si një detyrë tejet të rëndësishme për evidentimin dhe ruajtjen e vlerave kombëtare.

Eftimi (Thimi) Mitko, shqiptar i Korçës, botoi në vitin 1878 në Aleksandri të Egjiptit, ku jetonte për arsye tregtie, vëllimin "*Bleta shqiptare",* me qëllimin që të ruante dhe t'u përcillte brezave tekstet e letërsisë popullore të mbledhur me shumë sakrifica dhe shpenzime, por edhe për të ilustruar karakterin, doket dhe zakonet e racës shqiptare, e për t'i dhënë nje shtysë bashkëkombasve të tij që të studionin gjuhën amtare, si i vetmi mjet që mund t'i hapte udhë qytetërimit të kombit dhe ta vinte në të njëjtën shkallë qytetërimi me vëllezërit e tyre *grekofonë.* Prandaj, Mitkoja, siç thotë në *Prologun* që paraprin përmbledhjen e tij, synon qëllimin fisnik të japë ndihmesë në qytetërimin e atdheut të tij me botimin e këtyre krijimeve të gjuhës shqipe, pasi, thoshte ai, padija luftohet me studimin e gjuhës amtare që është ushqimi kryesor i jetës intelektuale dhe morale të një populli. Mjafton të përmendim se "qysh në vitin 1857, në një takim midis Anastas Bykut, botuesit të gazetës "Pellazgu" dhe një tregtari korçar, që s'ishte tjetërkush, veçse Thimi Mitkoja, ky konflikt kishte shpërthyer me forcë të madhe. Por, ajo që ka

rëndësi këtu është fakti që Thimi Mitkoja nuk i fliste A. Bykut me emrin e tij personal, por i paraqitej atij në këtë takim të parë (1857) me mburrje, si anëtar i një shoqërie shqiptare në Stamboll, e cila po mblidhte të holla për shkolla dhe libra në gjuhën shqipe"[297] *"Nuk mund të ketë një tolerance fetare më te madhe se ajo që mbizotëron mes shqiptarëve, as mes kombeve më te qytetëruar",* thotë Mitko, pasi shqiptari, duke dashur atdheun e tij, i do bashkëkombasit e tij pa dallim besimi fetar, dhe në këngët heroike të këtij populli të ngjitur krenarisht pas atdheut të tij, dhe dashurues i ngulmët i racës së tij, *"ndeshen mjaft shembuj të pashoq të tolerancës fetare dhe të atdhetarisë".*

Mitkoja uron që përmbledhja me tekste popullore shqiptare të arrijë të lexohet në mënyrë të dobishme prej të gjithë shqiptarëve të çdo praktike fetare dhe të çdo bindjeje politike, dhe të mund të jetë për filologët dhe albanologët një shtysë e re për studime më të thelluara dhe për kërkime të mëtejshme.

Për këtë atdhetar të dalluar shqiptar, me të cilin kishte letërkëmbim vëllazëror, De Rada shkruan: *"Eftimi Mitko i Korçës ka qenë gur themeli i rimëkëmbjes së atdheut të tij. Lindi në një derë, në të cilën dashuria e vërtetë per kombin e tij të braktisur ishte tradicionale. Duke u marrë me tregëti dhe larg... asnjëherë nuk i hoqi sytë nga fati i Shqipërisë se' tij. Në "Bleta shqiptare", do të thoja, është në thelb ajo qe' ruan ende atdheu amë prej qënies së tij fisnike, dhe prej nga ngushëllohet dhe ripërtërihet".*

Mitkoja përdor alfabetin grek, pothuaj të njëllojtë me atë të Kamardës, me të cilin kishte marrëdhënie dhe prej të cilit risjell një copë të përkthimit shqip të shkrimit të Dora d'Istrias: *Kombësia shqiptare në këngët popullore,* përveç tetë koreve nga *karme dasme* të botuar në *Shtojcën.* Shumë nga këngët e "Bletës shqiptare" ishin botuar më parë të rregulluara në drejtshkrim e metrikë edhe nga Zef Skiroi,- na bën me dije Gaetano Petrota[298].

Përmes vëzhgimeve leksikore në fjalorin e "Bletës shqiptare" dhe disa shënimeve gjuhësore do të përpiqemi të evidentojmë argumentimet e Mitkos për prejardhjen e fjalëve apo edhe ndryshimet kuptimore dhe ato gramatikore që do të përligjin në fakt prejardhjen shqip të fjalëve. Eshtë interesant dhe duhet vënë re fakti i shqipërimit që Mitkoja u bën fjalëve, sidomos atyre që i konsideron me prejardhje nga gjuha greke. Vepra e Mitkos u shfrytëzua nga shumë studiues, në mënyrë të veçantë nga albanologë të huaj që kishin mangësi në tekstet shqipe. Kështu Jarnik, profesor i Universitetit të Pragës, botoi disa këngë prej Mitkos. Mitkon e përmend edhe G. Mayeri prej të cilit shfrytëzoi tekste të toskërishtes. Më vonë edhe H. Pederseni gjeti mbështetje tek vepra e Th . Mitkos, si pika referimi për të vështruar dhe argumentuar disa etimologji të shqipes , ashtu siç e kishte paraqitur vetë, pasi të kishte dhënë shënimet themelore për historinë e jashtme të

[297] Z.Reso, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 1972, f.70

[298] G. Petrota, *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, botimet Almera, 2008, f. 219

shqipes e të shqiptarëve, për zhvillimet lidhur me shkrimin e veprimtarinë tjetër rreth gjuhës në kohën e Rilindjes, për studimet krahasimtare, që shqipja kishte pasur interes qysh herët"[299],- shprehet studiuesi Ismajli.

Ashtu siç nënvizon me të drejtë studiuesi Haxhihasani, në hyrjen e përmbledhjes së veprave të Thimi Mitkos[300], ai u përpoq të vërë në qarkullim fjalë të rralla, të zgjerojë kuptimin e fjalëve popullore duke u dhënë fjalëve konkrete një kuptim abstrakt dhe të formojë fjalë të reja nga brumi i shqipes. Këto tri drejtime na duken me interes për ta përqendruar edhe ne punimin tonë, lidhur me disa vëzhgime leksikore në veprën e Mitkos.

Kështu, bie në sy emërtimi që Mitkoja u bën gjëegjëzave duke i quajtur "Fjalë të errëta"[301]. Ai ka mbledhur 89 të tilla në veprën e botuar . Po shënojmë disa, që na u dukën më interesante nga pikëpamja leksikore , të tilla si: "*Një shkorsë me arra përmbi ç*

ati"(Qielli me yjet), "*Pllocë sypër,plocë përposh, ndë mes mish i papjekur*" (Breshka),"*Kujt do t'ja vush, i bën*"(Emri);"*Shpyrt shpie, shpyrt bie, shpyrt mbë vetëhe nuku ka*" (Gjemia),"*Dora e nxe, arka s'e nxe*" (Flamuri);"*Një gjarpërë në mes të detit, pi të tër'ujët edhe ngorth*";(Fitili i kandiles edhe vajtë);"*Tërë ditën ha mish, natën rri me gojë hapur*"(Opinga, këpucët).

Duke parë fjalorin shqip-greqisht të Mitkos, bashkë me qëmtimet dhe shënimet që ai u bën fjalëve, të bie në sy kujdesi për shpjegimin deri në detaje të fjalëve, fushave ku përdoren dhe shembujve sinonimikë që shoqërojnë jo pak fjalë të fjalorit .

Duke parë fjalët dhe shpjegimet na bie në sy emri: *bullë/a,* të cilin Mitkua e shpjegon si emër

dallues të grave myslimane nga të krishterat në Shqipëri. Gjithashtu, fjalët: *aisi, baisi, bierësi, ungaisi*, të cilat, sipas tij ndeshen në një këngë alegorike, Mitkoja i shpjegon si thirrje bujqish,madje ai sqaron se i përdorin edhe nënat duke nanuritur foshnjat në djep. Në shpjegimin e fjalës "*befas*" gjejmë fjalën "*sëqetëthi*", të cilën Mitkoja e shpjegon me fjalën greke "*papritmas*".

Na bie në sy edhe sinonimia që shoqëron ndajfoljen "ashiqare": *sheshit, sythi, hapët*ë, *celëshim.* "Fjala dialektore, kur ngrihet në nivelin e gjuhës letrare mbart së pari , kuptimin e saj themelor,po brenda sistemit të ri leksikor ku hyn mund të zhvillojë më tej semantikën, duke e ndryshuar dhe duke e pasuruar me kuptime të reja"[302],- nënvizon studiuesi Thomaj. Në këtë logjikë, duke ndjekur semantikën e

[299]H. Perdersen, *Studime për gjuhën shqipe*", Akademia E Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të vecanta XLVIII,Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 20, Prishtinë 2003, f.

[300] Q.Haxhihasani, *Thimi Mitko, Vepra*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.53

[301] Thimi Mitko *Vepra*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë ,1981, f.455-460

[302] J.Thomaj, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme,* Akademia e Shkencave të Shqipërisë , Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2001, f.126

disa fjalëve të pasqyruara në fjalorin e Mitkos, apo dhe shpjegimet etimologjike vëmë re se p.sh fjala: *bandill* ose *bandith* shoqërohet me shpjegimet: i papërkulur, i pabindur, i dhënë pas qejfit. Në fjalorin e sotëm, fjala bandill shoqërohet me shpjegimin që vijon: **BANDILL** *m. bised.*1. *Djalë i ri e i pashëm; djalë i këndshëm, i afrueshëm e i qeshur. Të ka nëna bandill! Mori një bandill; 2. shak. Djalë i ri që do një vajzë, i dashuri i femrës. E priste bandilli.; 3. keq., tall. Djalë që bredh pas qejfeve e pas vajzave; ai që mbahet me të madh e hiqet si trim, por që në të vërtetë është i zbrazët. Turmë bandillësh. E kapën atë bandill.*

Pa dashur të ndalemi në më shumë hollësi domethënëse, gjë që realizohet përmes një vëzhgimi më të hollësishëm të fjalorit të Mitkos, mund të përmbledhim në rnënyrë po aq domethënëse rezultatet etimologjike nga ky fjalor :

turqizma (t)	252
greqizma (gr)	15
bullgarizma (bllg)	9
arabizma(a)	111
persizma(pr)	12
italianizma(it)	6
Arb. e Italisë (Arb.It)	15
Arb.e Greqisë (Arb.Gr)	6

Për disa fjalë, në fakt, Th. Mitkoja është në mëdyshje për prejardhjen e tyre dhe i shënon të dyja gjuhët nga të cilat ai mendon se mund të ketë prejardhjen fjala. Kështu, për fjalën berber shënon (t,it.); duhan(t.a.);etj. Në disa prej fjalëve, Mitkoja nuk mjaftohet vetëm me shpjegimet leksikore, por ai shkon më tej, duke dhënë dhe struktura gramatikore. Kështu ndodh p.sh me shpjegimin e fjalës :"*tutje*"[303], të cilën Mitkoja e përkufizon si ndajfolje që ndërtohet me gjinoren, duke shpjeguar dhe fushën leksikore të përdorimit të kësaj fjale. Po kështu edhe me fjalët : "*ko-dhe*", "*koko-dhe*"[304]";"vras dhe mvras"[305] etj.

Një fakt interesant është edhe shpjegimi i fjalës "gjeraqinë"[306], të cilën Mitkoja e lidh me emrin etnik të shqiptarëve, duke nënvizuar se shqiptarët në Greqi, gjuhën e tyre amtare e quajnë "gjuhën e zogut".

Si përfundim vlerësojmë kontributin e Th. Mitkos për t'i shqipëruar fjalët, veçanërisht ato me prejardhje nga greqishtja, duke u bërë kështu pjesë e asaj

[303] Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti I Kulturës Popullore, Tiranë, 1981,f.518

[304]Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti I Kulturës Popullore, Tiranë, 1981,f.500

[305] Thimi Mitko*, Vepra*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti I Kulturës Popullore, Tiranë, 1981,f.520

[306] Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti I Kulturës Popullore, Tiranë, 1981,f.492

lëvizjeje të madhe që ndërmori Rilindja ndaj lemave me prejardhje të huaj. Kjo ndikoi, pa dyshim në përmirësimin e semantikës leksikore të fjalëve të shqipes dhe për më shumë në përmbushjen e misionit për përhapjen dhe përvetësimin e gjuhës sonë.

Përpjekja për shpjegimin e fjalëve dhe të kuptimeve të tyre në gjuhën shqipe, shënimet etimologjike dhe vërejtjet e ndryshme gjuhësore paraqesin një fushë interesante dhe me vlerë për ndihmesën e Mitkos në fushën e filologjisë, të cilat, pa dyshim, vunë gurin e parë në studimet e mëvonshme etimologjike.

LINDITA XHANARI (LATIFI) (TIRANË)
URTIS HARRI (TIRANË)

KORPUSI I TURQIZMAVE NË PËRMBLEDHJEN FOLKLORIKE "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS DHE RËNDËSIA E TIJ NË PËRCAKTIMIN E KRONOLOGJISË SË HYRJES SË TURQIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE

Punimi ynë synon të analizojë turqizmat në përmbledhjen folklorike "Bleta Shqyptare" të Thimi Mitkos, të bëjë vlerësime të karakterit leksikor e morfologjik, si dhe të sqarojë rëndësinë e tyre në përcaktimin e kronologjisë së hyrjes së turqizmave në gjuhën shqipe. Gjithashtu, do trajtojmë edhe disa vërejtje në lidhje me klasifikimin sipas burimit që u bën Mitkoja, fjalëve të marra nga turqishtja.

Gjuhëtarë të ndryshëm, jo vetëm shqiptarë, por edhe të Ballkanit, për këto fjalë, përdorin termin "**orientalizma**", duke arsyetuar se një pjesë e mirë e këtyre fjalëve janë me origjinë perse dhe arabe. Në pamje të parë, përdorimi i këtij termi, duket si përdorim normal, pasi është e vërtetë që një pjesë prej këtyre fjalëve, turqishtja i ka marrë nga arabishtja dhe persishtja.

Që në krye, na duhet të theksojmë se, pavarësisht se një pjesë e gjuhëtarëve përdorin termin "orientalizma", ne kemi parapëlqyer të përdorim termin "turqizma" për të gjitha fjalët e huazuara nga turqishtja. Kjo bëhet për disa arsye, të cilat po i rendisim, si më poshtë vijon:

Së pari, popujt e Ballkanit[307] nuk kanë pasur kurrë, gjatë gjithë historisë së tyre, kontakte të drejtpërdrejta me arabët apo persët. Popujt e Ballkanit kanë bashkëjetuar për 500 vjet rresht me osmanët dhe prej tyre kanë pasur ndikim gjuhësor të fortë. Për ballkanasit turqishtja ishte gjuha e komunikimit brenda Perandorisë Osmane. Pjesa më e madhe e leksemave turke jo vetëm u është përshtatur gjuhëve të Ballkanit, por edhe është kthyer në një përbërës natyral të gjuhës së përgjithshme dhe asaj rajonale. Fjalët e huazuara jo vetëm u pranuan në gjuhët e folura të Ballkanit, por edhe iu bashkëngjitën letërsisë, gjuhës së mësuar fetare, shkresave administrative dhe teksteve të tjera të shkruara.

Së dyti, të gjitha fjalët e marra në mënyrë të drejtpërdrejtë nga turqishtja, u morën pasi ishin turqizuar prej saj nga pikëpamja fonetikore, morfologjike dhe kuptimore. Pra, këto fjalë u transmetuan në gjuhët e Ballkanit ashtu siç përdoreshin në turqisht, duke pësuar ndryshime të dukshme dhe duke humbur përfundimisht veçoritë e arabishtes apo persishtes. Sot në gjuhët e Ballkanit gjenden fjalë të ardhura nga turqishtja, që, pavarësisht se në origjinë të largët janë perse e arabe, janë më pranë turqishtes, sesa origjinës së tyre.

[307] L. Latifi, (Xhanari), *Turqizmat dhe semantika e tyre në fjalorët e shqipes*, Tiranë, 2012, fq. 25

Së treti, statusi i turqishtes, për gjuhët marrëse, ishte krejtësisht i ndryshëm nga statusi i gjuhëve të tjera orientale. Arabishtja e persishtja ishin të kufizuara në pak fusha të jetës, si: besimi, shkenca dhe edukimi (shkollimi), kurse turqishtja zuri vend në rutinën e përditshme si gjuhë që përdorej në institucionet qeveritare, në tregti dhe jetën shoqërore. Risitë që u futën nga kultura turke, gjithashtu sollën koncepte të reja që deri aso kohe ishin të panjohura në ato zona. Deri atëherë nuk kishte fjalë në gjuhët amtare për këto koncepte të reja ose deri sa nuk u përftuan fjalë, fjalët dhe terminologjia turke u transferuan në pothuajse të gjitha gjuhët e Ballkanit. Kalimi në një mënyrë të re jete, u shoqërua edhe me marrjen e fjalëve turke, që tashmë ekzistonin në këto gjuhë. Me fjalë të tjera, u morën fjalë që e kishin ekuivalentin e tyre në gjuhët përkatëse. Fjalët e marra gjetën vendin e tyre brenda leksikonit të secilës gjuhë në të cilën u futën, dhe me pas vazhduan të jetonin në atë sistem të ri, duke iu përshtatur veçorive të gjuhëve përkatëse. Procesi i hyrjes së këtyre fjalëve, që ka zgjatur për afro pesë shekuj, paraqitet si një tablo shumëngjyrëshe, që ngërthen në vetvete çështje historike, kulturore, etnografike, letrare e gjuhësore. Fillimisht gjuhët e Ballkanit, për shkak të rrethanave historike të ditura tashmë, kanë huazuar fjalë që shprehnin kuptime e nocione të panjohura më parë për to. Më pas, këto fjalë janë pranuar dhe kanë filluar të përvetësohen në masë, pasi përdoreshin dendur në jetën e përditshme shoqërore e administrative. Pasi u pranuan, u përdorën e u përvetësuan, huazimet filluan të përpunohen e të pasurohen në gjuhët ballkanike. Ky është një reaksion zinxhir, që ka vazhduar për një kohë mjaft të gjatë. Edhe sikur të pranojmë origjinën arabe dhe perse të një grupi fjalësh, po të bëjmë një llogaritje të thjeshtë matematikore, rezulton se numri i fjalëve me origjinë turke, që ka hyrë në këto gjuhë, është jashtëzakonisht më i lartë, sesa ai i fjalëve me origjinë arabe e perse. P.sh. në afro 5000 fjalë që ka marrë gjuha shqipe, rreth 500 prej tyre, janë me origjine arabe e perse. Pra afro një 1/10 e fjalëve. Fushat semantike që kanë kapur ato, janë shumë të kufizuara, vetëm terminologji islame dhe letrare. Ndërsa, fjalët me burim turk, janë jo vetëm të shumta në numër, por kanë kapur të gjitha fushat e jetës shoqërore, administrative, kulturore etj. Për të gjitha sa sqaruam me sipër, është plotësisht e qartë që përdorimi i termit "orientalizma" për fjalët e hyra nga turqishtja, është krejtësisht i gabuar.

Përmbledhja folklorike e Mitkos u botua më **1878**. Ajo përmban një fjalor me rreth **1000 fjalë,** hartuar për të vënë në dukje fjalët e huaja, që përmbanin tekstet folklorike të përmbledhjes. Në hyrjen e fjalorit Mitkoja shprehet se **"***fjalë të tilla janë krejt të tepërta, të pavlefshme dhe kakofone, prandaj t'i flakë populli shqiptar, sepse përveç se janë plotësisht të tepërta e kakofone prishin gjuhën".*

Mitkoja është përpjekur të përcaktojë edhe prejardhjen e këtyre fjalëve, duke shënuar origjinën e tyre (në turke, arabe dhe perse), sipas mendimit të tij. Gjithashtu, ai është përpjekur të japë mendime për zëvendësimin e fjalëve të huaja. Kështu, fjalën ***bela*** ai e ka zëvendësuar me fjalët shqipe: *të ndezur, rëndim, ngasëje,*

brengë; për fjalën ***dava*** ka përdorur: *paditëje, qarëje; për fjalën gajret: zell, sillë, ndezë, ndezëje* etj.

Nga rreth **1000** fjalët e këtij fjalori, Mitko ka përcaktuar **503** fjalë si turqizma, arabizma dhe orientalizma.

Më poshtë po paraqesim sipas rendit alfabetik korpusin e këtyre huazimeve:

adalet, ala, alaka, alamet, alem, alla, aman, amanet, ankran, arzuhall, asemin, asllan, ashkik, ashiku, ashiqare, at, azap, azat, bajrak, bajraktar, bajame, bardhak, bazerxhan, bast, bash, bahçe, beden, bedenat, behar, bekgu, beg, bela, belek, beqar, berber, berberhane, bereqet, bezdis, bilbil, bina, binish, bishbish, boja, borçxhi, borxh, bostan, bozuk, budalla, bugaszi, jatagan, xhep, çadër, çallma, çanak, çapërxhi, arixhi, çapraze, çarçaf, çardhak, çare, çarka, çati, çelengu, çerek, çezmë, çibuk, çifut, çipllak, çitjane, çizme, çoban, çollak, çorbë, dahil, daja, daim, dajlanë, daulle, dava, degdis, deli, derman, dert, deve, din, divan, divanhane, donama, dori, dovlet, duhan, duva, tyfek, dylber, dynja, dyqan, dyshek, eglenxhe, elçi, esmer, evlat, exhel, ezan, ezhdërha, fajde, fakir, fukara, felah, felek, fet, filxhan, fiqir, fodull, gaile, gairet, gale, garip, kaza, gazali, gazep, gonxhe, gjemenxhe, gjëmi, gjene, gjerdhan, gjezdis, gjoja, gjok, gjokësi, gjol, gjyç, gjyle, gjynah, gjyves, haber, hadet, hajdut, ajmali, hak, hakikat, hall, hallall, hallat, halldup, hamam, hallka, hambar, hani, hanko, hapsanë, haraç, haram, harap, harar, harbut, hasbin, haset, hasëm, hasi, hata, hatër, haxhet, hazne, hejbe, helaq, hem, heqim, hesap, hënxhir, hile, hilal, hudut, huqi, hyqëm, hyri, hyxhet, hysmeqar, ibliz, ibret, ihtikat, ilaç, ilaka, iman, imdat, inaet, inat, inqar, insaf, insan, inshallah, ispat, itilak, ixhat, izë, jahni, jallan, jara, jastëk, jatagan, javer, jediç, jeshil, jetim, jezit, jollëxhi, jorgan, jungar, jyrysh, kabah, kabil, kafas, kaftan, kahar, kahpe, kahreman, kahur, kail, kala, kallajxhi, kallauz, kallëp, kamare, kamatë, kapi, kara, karadag, karadyzen, karagrosh, karar, karaull, kasaba, kasabali, kasap, kasavet, kastilen, kavaz, kaza, kazaja, kazan, keçe, kezë, kërdis, kësëmet, këzdis, kimet, kllapodan, komshi, konak, kopil, kral, kujunxhi, kullandris, kullë, kulluk, kumbara, kurban, kurbet, kurdis, kusur, lale, lanet, lezet, lugat, llaf, magrur, makar, mall, mamur, mansup, maskara, mashalla, mavi, maxhar, medet, mehane, mejdan, melaiqe, memleqet, meqa, meram, merhaba, merxhan, mesele, meshrep, mexhelis, meze, mezil, mëhallë, mëhanë, miri, misër, misërli, misiri, muhabet, muhasere, muhtë, murat, murdar, mutaf, mymqyn, mynafik, mysafir, myshavere, nadan, nakar, nasiat, naze, nazik, nefes, neqes, niet, nihaiet, niqa, nishan, nizam, nofullzi, nur, oda, ogradis, ogur, okllai, orgjyn, orum, oxhak, palldëm, para, pazar, pegamber, pehriz, penxhere, perde, pervan, peshqesh, peshtamall, prangë, qafir, qamet, qar, qeder, qef, qehribar, qerem, qeros, qese, qira, qole, qorr, qoshe, qoshk, qylaf, qyrk, rae, rahmet, rajet, reçper, redif, rehat, rehvan, resmetar, ret, reze, rezeja, rixha, rixhal, riza, rumeli, rytbe, ryfet, sabah, sadik, sahat, sakat, sakaz, salltanat, samur, sanxhak, sarai, savat, sebep, sedef, sefer, sehir, selam, selamet, selvi, sene, sepet, serasqer, serdar, serek, serhat, sevda, sexhade, serma, simite, soj, sokak, spahi, stamboll, sulltan, sulltannevruz, surat, syrgjyn, syri, syrme, shah, shahin, shahir, shahit, shaka, shakaxhi, shall, shamata, shan, shandan, shart, sheboja, shehër, shejtan, sheriat,

shhur, shilte, shishane, shura, shuret, shyqyr, tabak, tabake, tabor, tabut, taçe, taç, tain, takat, takdir, takëm, taksirat, talim, tambura, tapanxhë, tas, tasa, tavan, tavlla, taze, tehir, telef, tellall, tenxhere, tepsi, terezi, testemel, tevabi, top, topallti, tuja, turfanda, usta, vade, vali, vasiet, veliko, veqil, veresie, vesvese, vilaet, vukuf (vakuf), vuxhuh, xhaba, xhan, xhefa, xhelat, xhenet, xhephane, xhevahir, xheza, xhiger, xhihenem, xhika, xhinde, xhindeve, xhuxh, xhuma, xhuvap, xhymert, ylefe, yrnek, yzër, zahire, zallum, zaman, zambak, zanat, zandan, zap, zarar, ziafet, zile, zymbyl.

Ky korpus paraqet këto veçori:

1. Pjesa më e madhe e këtyre huazimeve, **323 fjalë,** gjendet edhe sot në Fjalorin e gjuhës shqipe. Të tilla janë fjalët: *alamet, alem, alla, aman, amanet, arzuhall, asemin, ashkik, ashiku, ashiqare, at, azat, bajrak, bajraktar, bardhak, bast, bash, bahçe, beden, behar, beg, bela, beqar, berber, bereqet, bilbil, bina, binish, boja, borçxhi, borxh, bostan, bozuk, budalla, jatagan, xhep, çadër, çanak, çapërxhi, çapraze, çarçaf, çardhak, çare, çarka, çati, çerek, çezmë, çibuk, çifut, çitjane, çizme, çoban, çorbë, daja, dajlanë, daulle, dava, deli, derman, dert, deve, din, divan, donama, dori, dovlet, duhan, duva, tyfek, dylber, dynja, dyqan, dyshek, eglenxhe, esmer, evlat, ezhdërha, fajde, fakir, fukara, filxhan, fiqir, fodull, gaile, gairet, kaza, gazep, gonxhe, gjemenxhe, gjëmi, gjerdhan, gjezdis, gjoja, gjok, gjol, gjyç, gjyle, gjynah, gjyves, haber, hadet, hajdut, ajmali, hak, hall, hallall, hallat, halldup, hamam, hallka, hambar, hani, hapsanë, haraç, haram, harap, harar, harbut, haset, hasëm, hata, hatër, hazne, hejbe, hem, hesap, hile, hyri, hysmeqar, ilaç, iman, inat, jahni, jastëk, jatagan, jeshil, jetim, jorgan, jungar, kabah, kafas, kaftan, kala, kallajxhi, kallauz, kallëp, kamatë, kara, karadyzen, karar, kasaba, kasap, kasavet, kastilen, kavaz, kaza, kazan, keçe, kërdis, kësëmet, kimet, komshi, konak, kopil, kullë, kumbara, kurban, kurbet, kurdis, kusur, lale, lanet, lezet, llaf, makar, mall, maskara, mashalla, mavi, medet, mehane, mejdan, meram, merxhan, mesele, meze, mëhallë, misër, muhabet, mutaf, mysafir, naze, nazik, niet, niqa, nishan, nizam, nur, oda, ogur, okllai, oxhak, palldëm, para, pazar, pehriz, penxhere, perde, peshqesh, peshtamall, qafir, qar, qeder, qef, qehribar, qeros, qese, qira, qole, qorr, qoshe, qoshk, qylaf, qyrk, rae, reçper, rehat, rehvan, reze, rixha, riza, rytbe, sabah, sahat, sakat, salltanat, sanxhak, sarai, sebep, sedef, sefer, sehir, selam, selamet, selvi, sepet, serasqer, serdar, sevda, sexhade, serma, simite, soj, sokak, spahi, stamboll, sulltan, surat, syrgjyn, shah, shahin, shahir, shahit, shaka, shakaxhi, shall, shamata, shandan, shart, sheboja, shejtan, shilte, shishane, shyqyr, tabak, tabake, tabor, tabut, taçe, takat, takëm, taksirat, tambura, tas, tavan, tavlla, taze, telef, tellall, tenxhere, tepsi, terezi, top, topallti, turfanda, usta, vali, vesvese, vilaet, vukuf (vakuf), xhaba, xhan, xhelat, xhenet, xhephane, xhevahir, xheza, xhihenem, xhinde, xhuxh, xhuma, xhuvap, xhymert, yrnek, zahire, zallum, zambak, zanat, zarar, ziafet, zile, zymbyl.*

2. **Fushat semantike** që kapin fjalët e këtij fjalori janë të shumta në numër. Kështu aty gjejmë:

- **Terminologji administrative dhe ushtarake**: *xheza, vilajet, vakëf, veqil, vali, tabor, tambur, sheriat, shehër, shahin, xhelat, syrgjyn, sulltan, spahi, serasqer, salltanat, sanxhak, sadik, nizam, muhasere, murdar, mexhelis, mejdan, memleqet, mëhallë, karar, kral, kasaba, kasabali, kamat, kahreman, kala, jatagan, insan, hyqëm, hapsanë, haraç, gjyç, gjyle, elçi, dovlet, dava, jatagan, beg, bajrak, bajraktar, adalet, reçper, shart, xhephane, zap, zarar, vasijet, etj.*

- **Terminologji fetare**: *hoxhë, bajram, din, dua, gjynah, hajmali, hata, hyri, iman, inqar, jezit, kimet, kësmet, kurban, lanet, lugat, melaiqe, nijet, ogur, pejgamber, qamet, rahmet, selamet, sulltannevruz, shejtan, sheriat, xhenet, xhehenem, xhind, etj.*

- **Terminologji të jetës shtëpiake dhe shoqërore**: *bardhak, bahçe, behar, amanet, bela, beqar, bereqet, bina, boja, borxh, bostan, xhep, çadër, çallma, çanak, çarçaf, çardhak, çati, çezmë, çibuk, çitjane, çizme, çoban, çorbë, daulle, derman, dert, dyqan, dyshek, evlat, fajde, filxhan, fiqir, kaza, gonxhe, gjemi, gjerdhan, haber, gjol, hak, hambar, haset, hasëm, hejbe, hesap, hile, ilaç, jahni, jara, jastëk, jallan, jetim, jorgan, kafas, kallauz, kallëp, karadyzen, kapi, komshi, kazan, kumbara, kurbet, kusur, lale, llaf, mall, mejhane, meze, muhabet, misër, mysafir, nishan, oda, okllai, pazar, para, penxhere, perde, peshqesh, peshtamall, qar, qeder, qehribar, qira, qoshe, qyrk, qylaf, reze, riza, sahat, sebep, sedef, sefer, selam, selvi, sene, sixhade, serma, simite, sokak, surat, shaka, shall, shamata, shandan, shilte, tabak, tabake, tabut, takat, takëm, tas, tavan, tavlla, tenxhere, tepsi, usta, vade, xhevahir, xhan, xhuma, xhuxh, xhevap, yrnek, zahire, zaman, zambak, zanat, zijafet, zile, zymbyl.*

- **Fjalë që emërtojnë cilësi të individit**: *ashik, asllan, beqar, budalla, çapërxhi, arixhi, çipllak, deli, esmer, fakir, fukara, fodull, gazep, hajdut, hain, harbut, hyzmeqar, inatçi, jetim, jezit, kahreman, kasabali, kopil, qafir, qeros, qorr, sadik, usta, xhymert, etj.*

- **Terminologji e veshjeve, tekstileve etj.**: *astar, atlas, beze, bohça, çul, çit, çizme, dimi, dolama, dülbent, fes, askı, basma, biniş, çakçir, çember, çityan, çorap, don, ferace, fıstan, gömlek, yaka, kaftan, kayış, kundura, mendil, mahram, muşama, paşmege, perçe, peştamal, potur, keleş, külah, dimi, toka, köstek, gerdan etj.*

- **Terminologji e ndërtimit**: *ahır, bahçe, baca, buhar, çardak, arkapı, bina, pınar, çatı, çeşme, dayan, doğrama, gerdek, hela, kamara, kanat, kat, kubbe, mazgal, musluk, ocak, parmak, pencere, köşe, kümes, kütük, saray, tavan, döşeme, camlık, uluk, havuz, mazdar etj*.

Denduria e terminologjisë shtëpiake dhe asaj shoqërore, si dhe larmia morfologjike e tyre tregon se në këtë periudhë huazimet turko-orientale kishin filluar lulëzimin e tyre.

2. **Nga pikëpamja morfologjike** diktojmë këto veçori:

- Pjesa më e madhe e fjalëve i takon kategorisë emër. Këta emra kryesisht janë marrë pa prapashtesa turke. Kështu, vetëm në raste të veçanta gjejmë

përdorimin e prapashtesës –xhi: *borxhi, çapërxhi, arixhi, kallajxhi, kujunxhi*, si dhe përdorimin e prapashtesës perse –qar në fjalën *hyzmeqar*.

- Rastet e huazimit të foljeve janë të rralla. Përmendim: *degdis (degenmek), kërdis (kirmak), kullandris (kullanmak), kurdis (kurmak)*. Këto folje janë huazuar pa mbaresën e infinitivit –mak/-mek të turqishtes.
- Gjithashtu në fjalor gjejmë edhe pak ndajfolje lidhëza dhe pjesëza si: *aman, gjoja, gjene, hem, medet, nihajet, mymqyn*.

Vërejtje për klasifikimin në arabizma, persizma dhe turqizma të fjalëve të huazuara në Fjalorin e Mitkos.

Mitko, në Fjalorin e tij, përpiqet të tregojë origjinën e fjalëve që kanë hyrë nga turqishtja, duke vënë shënimet***: a, pr*** dhe ***t***, për fjalët me origjinë arabe, perse dhe turke. Sipas Mitkos rezulton se në këtë përmbledhje ka 110 fjalë me burim arab, 19 fjalë me burim pers dhe pjesa tjetër fjalë me burim turk. Ai nuk jep asnjë të dhënë se mbi ç'baza apo mbi ç'kritere ka përcaktuar etimologjinë ose origjinën e fjalëve të sjella nga osmanët. Nga analiza që i bëjmë sot këtij Fjalori, na rezulton se përcaktimet e Mitkos nuk janë shkencërisht të sakta. Po paraqesim vërejtjet për sa më poshtë vijon:

Së pari, Mitko ka klasifikuar **si arabizma fjalët:** *adalet, ala, alaka, alamet, alem, allah, aman, amanet, ashik, ashk, bina, bishbish, çarka, çitjanet, çizme, dahil, daim, din, dovlet, dyqan, evlat, fajde, fakir, fellah, felek, fet, filxhan, fiqir, garip, hadet, hallall, hamam, hapsanë, haraç, harbut, hasbin, hasëm, hata, hatër, hazne, heqim, hesap, hile, hudut, hyqëm, hyri, hyxhet, ibliz, iman, inqar, insan, inshallah, ispat, itllak, kahpe, kala, kësmet, lanet, mahbub, mamur, mashalla, melaiqe, memleqet, merhaba, mesele, mexhelis, mëhallë, misir, muhabet, mymqyn, mysafir, nefes, nihajet, niqa, nofuzi, odë, qira, qoshe, raije, rahmet, rajet, resmetari, rixha, rixhal, sadik, sahat, sarai, seben, sefer, selam, selamet, sene, sulltan, sulltannevruz, surat, shahit, shart, sheriat, tapanxhë, tehir, tellall, vali, vasiet, veqil, vilaet, vukuf, xhihenem, xhuma, zallum, zaman.*

Si persizma fjalët: *aheng, javer, kahreman, meshrep, pejgamber, pegamber, peshtemall, destemal, peshqesh, qylaf, sehir, serasqer, serdar, sexhade, shah, shahir, shejtan, testemel, turfanda.*

Si turqizma fjalët: *ankran, arxuall, asemin, asllan, ashik, ashiqare, at, azap, azat, bairak, bairaktar, bajame, bardhak, basergjan, bast, bash, bashtë, beden, bek, beqar, bezdis, bojë, borxh, bostan, bugas, çadëre, çallmë, çanak, çaprazë, çarçaf, çardhak, çare, çati, çeleng, çerek, çezmë, çibuk, çifut, çipllak, çollak, çorbë, dai,*

daulle, degdis, derman, dert, deve, divan, divanhane, donama, dori, duva, dylber, eglenxhe, elçi, exhel, feste, fodull, gazali, gazep, gonxhe, gjemenxhe, gjene, gjerdhan, gjoja, gjyç, gjyle, haber, hajdut, hajmali, hambar, han, hanko, hanum, harap, haset, hasi, hejbe, helaq, hem, hilal, hysmeqar, hibret, ihtikat, ilaç, imdat, inaet, inat, insaf, ixhat, jahni, jallan, jara, jastëk, jediç, jeshil, jezit, jollëxhi, jorgan, jungar, jyrysh, kabah, kabil, kafas, kahat, kallajxhi, kallauz, kapi, kara, karadagu, karadyzen, karagrosh, karar, kasaba, kasabali, kasap, kasavet, kastilen, kavaz, kaza, keçe, kërdis, këzdis, kimet, kllapodan, komshi, konak, lezet, llaf, mansup, maskara, mavi, maxhar, medet, mehane, meqa, meran, merxhan, meze, mezil, misër, misërli, muhasere, murat, murdar, mutaf, mynafik, myshavere, nadan, nasiat, nazik, neqes, nishan, ogradis, ogur, orun, oxhak, palldëm, para, pazar, pehris, penxhere, pervan, qar, qeder, qehribar, qole, qor, qoshk, qyrk, reçper, redif, ret, reze, rydbe, ryfet, sakat, sakaz, salltanet, sanxhak, sedef, selvi, sepet, serek, serhat, sevda, sermë, simite, soj, sokak, Stamboll, syrgjyn, syrih, shaka, shakaxhi, shamata, shan, shehër, shhur, shishane, shura, shuret, shyqyr, tabak, tabut, taçi, tagji, tain, takat, tagdir, takëm, taksirat, tasa, tavan, tavllë, taze, telef, tenxhere, tepsi, terezi, tevabi, top, topallti, tujë, veresije, vuxhuh, xhaba, xhan, xhefa, xhelal, xhelat, xhephane, xhevahir, xhiger, xhindeve, xhuvap, xhymert, ylefe, yrnek, zahire, zambak, zanat, zandan, zap, zarar, ziafet, zymbyl.

Mitko, ka dhënë shpjegime të gabuara për fjalët: *beden, bela, belek, bereqet, bilbil, binish, bozuk, budalla, çoban, dalldis, dava, deli, duhan, dyfek, dynja, dyshek, esmer, ezan, furrë, gaile, gairet, gjezdis, gjynah, hak, hall, halldup, hodë (odë), izë, jadigjar, jatagan, jetim, kalesh, kamat, kapak, kopil, kovë, lale, llagëm, mall, mervan, mësallë, naze, neqes, nizam, qafir, qamet, qef, qerem, rehvan, rumeli, sabah, samur, spahi, shall, shandan, shilte, xheza, xhikë, ysht, yzër, zile*, të cilat i paraqet si fjalë të shqipes, pa u cilësuar origjinën turke, arabe apo perse.

Së dyti, një pjesë e fjalëve që janë përcaktuar në Fjalor si arabizma dhe persizma, në të vërtetë janë me origjinë turke, ashtu siç një pjesë e fjalëve që janë paraqitur si turqizma apo persizma, në të vërtetë janë arabizma, si p.sh.: *"shyqyr*" (në Fjalor jepet si turqizëm) ose "*xhenet*" jepet si persizëm. Arabizmat janë kryesisht vetëm terminologji islame, kurse persizmat janë kryesisht terminologji letrare. Çdo terminologji tjetër është kryesisht me origjinë turke.

Fjalori i përmbledhjes folklorike "Bëleta shqypëtare" të Thimi Mitkos, që daton më 1878, është ndër fjalorët e parë të toskërishtes dhe që përkon me periudhën e intensifikimit të turqizmave në gjuhën shqipe. Për këtë arsye ai ka një rëndësi të veçantë në përcaktimin e kronologjisë së hyrjes së turqizmave ne gjuhën shqipe. Kjo edhe për faktin se fjalët e këtij Fjalori janë nxjerrë nga një përmbledhje folklorike. Të gjithë e dimë se krijimtaria folklorike do kohë të krijohet e të përhapet dhe pikërisht ekzistenca e këtyre huazimeve, në një numër relativisht të madh, krahasuar me huazimet nga gjuhët e tjera, reflekton jo vetëm procesin e hyrjes, por edhe atë të ngulitjes e përvetësimit të tyre, që para periudhës, kur u mblodhën krijimet folklorike. Kështu, sasia dhe fushat leksikore, që kapin këto huazime në këtë fjalor,

nuk kanë të krahasuar absolutisht, me korpusin minimal të turqizmave, që gjenden në veprat e autorëve të vjetër të shqipes. Nga ana tjetër, megjithëse në një "Fjalor" relativisht të vogël, për nga fushat leksikore dhe veçoritë morfologjike të paraqitura me sipër, turqizmat e këtij fjalori afrohen me turqizmat e "Fjalyer i Ri i Shqypes" i Shoqërisë "Bashkimi", botuar më 1908.

MAJLINDA BUSHAJ (SHKODËR)
MANJOLA DEMIRAJ (SHKODËR)

RRETH PËRDORIMIT TË ORIENTALIZMAVE NË VEPRËN "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS

Gjuha është produkt i një vargu epokash të jetës së një populli dhe pasqyron faktet historike të tij. Siç dihet, pushtimi osman në Shqipëri zgjati pesë shekuj, deri më 1912 e, si rezultat, gjurmët e tij mbetën edhe në gjuhë. Meqenëse, këtu kemi të bëjmë me huazime nga turqishtja, arabishtja dhe persishtja, pa marrë parasysh rrugën dhe mënyrën e depërtimit të tyre, është më mirë të përdorim termin orientalizma e jo turqizma. Siç shprehet Emil Lafe "*termi orientalizëm është më i përshtatshëm, sesa turqizëm edhe sepse për një varg fjalësh të tilla burimi mund të ketë qenë ndonjëra nga vendet fqinje*.[308]

Një pjesë e fjalëve kanë depërtuar thellë në fjalorin e shqipes dhe nuk mund të zevëndësohen në çdo rast, pasi fjala ka ardhur bashkë me të shenjuarin prej saj, ndërsa të tjerat po. Kështu, në sistemin leksikor të veprës "*Bleta shqiptare"* të Thimi Mitkos, vend të veçantë për nga denduria e përdorimit zë shtresa e huazimeve orientale, pasi nuk kanë depërtuar në shqipe nëpërmjet të folmesh kufitare, por nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të shqipes me turqishten gjatë pushtimit të gjatë osman.[309] Për hartimin e këtij studimi na është dashur të konsultojmë kryesisht fjalorin "*Orientalizmat në gjuhën shqipe*" (2005) të Tahir Dizdarit, *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1980), *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2006), *Studime etimologjike* të autorëve E. Çabej, David Luka etj.

Në pjesën e fundit të këtij punimi kemi pasqyruar leksikun oriental të përdorur në vepër. Qëllimi ynë ka qenë i disafishtë. Së pari, të paraqesim pasurinë leksikore të orientalizmave jo me hamendje, por të shtjelluar me hollësi. Së dyti, të paraqesim jetën e fjalëve, ndryshimet që kanë pësuar gjatë kohëve me tejbajtje, zgjerim a zvogëlim si edhe specializim kuptimi, duke kaluar nga një familje fjalësh për të dalë më vete, pra duke formuar një vatër të re leksikore. Së fundi, duke rreshtuar fjalë që deri tani kishin mbetur të pashpjeguara, ose nuk japin kuptimet e duhura.[310] Për

[308] E. Lafe, *Vend i orientalizmave në huazimet e shqipes*, SF 1-4, 93, f.35.

[309] Burimet kryesore për depërtimin e orientalizmave në gjuhën shqipe janë: sundimi shekullor i perandorisë osmane në Ballkan. Gjatë kësaj periudhe pesëqindvjeçare marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe Turqisë janë shkëmbyer në gjuhën Turke, ngase ajo ishte gjuha zyrtare dhe komunikonte i gjithë ballkani. Në anën tjetër këtë proces e ka ndihmuar edhe pranimi i besimit islam. Shih. Feti Mediu, *Orientalizmat: Hyrja dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe*, Studime për leksikun …III , f. 408.

[310] Në përmbledhjen folklorike *Bleta shqiptare* 1878, Mitkoja ka lënë një fjalës me rreth 1000 fjalë, hartuar për të vënë në dukje fjalët e huaja, që përmbanin tekstet folklorike të përmbledhjes, që së fundmi botohet në veprwn: Thimi Mitko, *Fjalëtore Shqip-Gërqisht, Gërqisht-Shqip&ndihmesa të tjera leksikografike*, Tiranë 2014 përgatitur nga Dhori Q. Qiriazi (red. Jorgo Bulo). Nga 1000 fjalët e këtij fjalori gjysma janë fjalë orientale, Mitkoja është përpjekur të përcaktojë prejardhjen e fjalëve duke

përdorimin e fjalëve orientale kemi bërë këtë klasifikim. Fushat semantike që kapin fjalët e këtij fjalori janë më të shumta.

Administrata, gjykatat, ushtria, si: *sulltan, koçobash, pasha, beg, bajraktar, vezir***,** *bazergjan***,** *aga, ajan, arxuhall, asqer, bajrak, bashibozuk, batare, beget, bylykbash, dovlet, dyfek, fishek, frëngji, gargi, dava, dovlet, gargi, hasëm, hendek, hudut, hynqar, hyqëm, hyqimat, hyxhet, ispat, izë, jatagan, javer, kapidán, kapllán, karadak, karar, kasaballi, kaza, kërdi, kolas, kollëxhi, kubure, kumbará, manastir, maxhar, mejdan, moskovoliç, muhaser, nizam, ordhi, padishah, palla, pasha, sadrazem, sanxhak, saraj, sërasqer, shishane, sultan, tabor, tapanxhë, vatan, vezir, vilajet, xhandar, xhebehane, ylema, zabit, zylyftar, turkushak, jeniçer, Çaush, kajreman, mylazim* etj.

Besimi: *bajram, din, qitab, eshdërha, hafiz, hajmali, hallall, haram, iblis, inane, inshallah, kadi, kadënëz, kurban, lugat, mashallah, merahme, merhaba, qitab, rixha, selam, selamet, xhami, xhenet, xhind, iman, kuran, sherjat, allah etj.*

Veshmbathja e stolitë*: baluke, binish, byrynxhyke, çember, dollama, dyshek, fermele, feste, çallm, gajtan, hazine, inxhi, jelek, jorgan, kaftàn, sedef, kalemqari, kllapodan, lahuri, mutaf, perçe, perde, sermá, silah, tegel, testemele, tumane, çarçaf, cohë, samur etj.*

Zejtaria, ndërtimi e arkitektura: *penxhere, avli, bash, beden, binan, çardhak, çarkë, divanhane, bina, hale, kapi, karvan, kasaphane, llagëm, mehal, mejhane, meqan etj.*

Orienditë dhe mjetet shtëpiake*: divan, filxhan, qilar, sepete, tenxhere, çarkë, çubuk, fitil, harar, hejbe, kalem, kallëp, kandil, koçi, mashë, bardhak, filxhan, gajtan etj*.

Ekonomia, tregtia, marrëdhëniet pronësore ekonomiko shoqërore, si: *allçak, bakall, bela, fajde, haber, gurgule, hak, hanxhi, harxh, haxhet, hesap, imdat, ixhade, kullandris mahmudi, myshavere, pare, pazar, rubi, veresi, xhelep, flori, kala, ylefe etj.*

Cilësi të njerëzve*: asllan, ashik, beqar, barrak, deli, derdimen, fukara, allçak, azat, jadigjar, dudi, fiqir, gajret, garip, gjider, gjidi, halldub, helaq, kaba, kabil, kahpe, karafil, kaur, lanet, levend, magruri, munafak, nadan, pusht, qafir, qerata, qerem, xhanllar, xhymert, budalla, xhagajdur etj.*

Profesione: *berberhanë, dado, jangi, kafaz, kallanxhi, kallaus, kamber, kujunxhi, reshper, rixhal, xhigerxhi* etj.

Arsimi, letërsi, kulturë: *bejte, avaz, bozuk, jari, divan, daulle, gjerdan, qemenxhe* etj.

Lundrimi dhe mjetet e tij: donamë, amber, çubuk, kaike, orgjyn etj.

Bujqësia e blegtoria: *bajame, bostani, çoban, duhan, bereqet, çomage, dori, gjok, hambar, hise, jargavan, kadimi, koçan, kësëm, nerenxë, dudë* etj.

---

shënuar origjinën e tyre, të japë shpjegime për zëvëndësimin e tyre me fjalë shqipe, por në mjaft raste nuk përputhen me kontekstin e fjalës në vepër.

Kjo përmbledhje na lejon të arrijmë në disa përfundime, në lidhje me përpjesëtimet e depërtimit të turqizmave në sferat e shtresat e ndryshme të leksikut të shqipes, që pasqyrojnë dukuritë e jetës, të veprimtarisë shoqërore në aspekte të ndryshme. Pjesa më e madhe e huazimeve lidhen me jetën qytetare. Leksiku i bujqësisë, i blegtorisë dhe i disa sferave të tjera, që lidhen drejtpërdrejt me fshatin, përfshin pjesën më të vogël të huazimeve nga turqishtja. Vërejmë se ndikimi turk mbi gjuhën shqipe shihet më shumë në jetën e qytetit se në jetën e fshatit. Kjo dëshmohet nga fakti, se terminologjia e bujqësisë dhe e blegtorisë është shumë e vogël në krahasim me pjesën që ka turqishtja në leksikun e jetës qytetare. Kjo dëshmon vetëm pasojën e pasqyrimit të zhvillimit historik.

Sasia e elementit të huazuar dhe sasia e elementit vendit, tregojnë më një anë shkallën e ndikimit të huaj mbi shqipen, dhe, më anë tjetër shkallën e rezistencës së kësaj gjuhe.[311]

Duke analizuar materialin që kemi vjelë në veprën *Bleta Shqiptare* të Thimi Mitkos, ndeshim huazime të vjetra turke, që i përkasin shtresës më të vjetër, si: ***gajtan, jaran, penxhere, sahat*****,** etj. si: ***gajtan*** "Një si sigjim i trashë prej mëndafshi, prej leshi a prej pambuku, që vihet anëve të rrobës për stoli e për të mos dalë thekët**"** *O* ***gajtan****, o* ***gajtan****!/O ku i gjete ata desh* (Bleta:20); ***jaran*** "i dashuri i një vajze" etj.

Ndeshim ndonjë apelativ të turqishtes që ruhet nëpër këngët e vjetra popullore si emër vetjak si*,* ***beu*** : *Shahin* ***be****, o kokë-mollë* (Bleta:177).

Fjalë të tjera me interes që i përkasin shekujve të parë të sundimit osman janë: ***beg, dushman, kadi, pazar, timar, sanxhak*** etj.

Shumica e fjalëve ruajnë kuptimet që ka pasur gjuha dhënëse, edhe pse kanë kaluar qindra vite ato nuk kanë pësuar ndryshime të theksuara semantike, sidomos fjalët që shënojnë zanate, kafshë, bimë apo perime, oriendi shtëpiake, sende apo emërtime kulti etj. si: ***bilbil, berberhane, daulle, divan, dynja, dyshek, fishek, grazhd, pazar*** etj., por kanë zhvilluar kuptime të tjera të reja si: fjala *halldup*, përdoret për të sharë një njeri të pagdhendur, *dynja* përdoret për të treguar shumicë etj.

Me mjaft interes paraqitet ndjekja e fjalëve në kuptime të dyta, fjalët kanë pësuar ndryshime me tejbajtje gjatë kohëve, zgjerim a zvogëlim e specializim kuptimi, duke kaluar nga një familje fjalësh për të dalë më vete, pra duke formuar një vatër të re leksikore. Fjala **divan** në *Fjalorin* 1954 "një lloj kanapeje pa mbështetje" (*Fjalor* 1954:87); Te Çabej ndeshim edhe kuptimin "korridor i gjerë në shtëpi, që përdoret ndonjëherë edhe si *odë*, *mesore*" (Çabej SE III: 253); Në *Fjalorin* e 2006 "1. kanape e veshur si kolltuk; shtrat i ngushtë anës murit të dhomës. 2. Paradhomë, mesore; ballkon i mbuluar" (Fjalor 2006: 199); Me të njëjtat kuptime e ndeshim edhe në *Fjalorin* e 1980 (*Fjalor* 1980: 345). Mitkoja në *Fjalëtoren* e tij jep

[311] E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Bleu I, Tiranë, 1982, f.115-116.

shpjegimet: **divan** "dhomë, ministri, kanape, këngë, melodi"[312]. Në vargjet e vjela në këtë vepër ne ndeshëm edhe një kuptim të ri të patrajtuar në *Fjalorët* e shqipes, *divan* (baj) "qiri në këmbë, duke pritur se ç'urdhër po i jepet" (Diz:218) *Xhemileja po pi duhan/Mylazimi ban **divan***. (Bleta:105).

Dukuri e leksikut të Bletës është se fjalët përdoren me më shumë se një kuptim, p.sh. Fjalën ***fishek*** e ndeshim me kuptimin "gëzhojë metali a kartuçi mbushur me barut e me plumb, dhe me kapsolle te fundi[313]" *Kamilet mbajnë **fishekë**.* (Bleta:133), por edhe me kuptim të figurshëm: ***Fishek** nga dera të qita.* (Bleta: 88) ku në këtë rast ndeshim si ndajfolje bisedore, menjëherë" (Fjalor 2006:275). Kjo fjalë nuk paraqitet në *Fjalëtoren* e Mitkos.

Gjatë vjeljeve në vepër kemi ndeshur vështirësi në përcaktimin e burimit të fjalës. P.sh. Në vargun *Mos je zymbyl nd'amberi,/Që rri n'**bashtët** mbret mbulumun*? (Bleta:103). Në *Fjalëtoren* e Mitkos fjala ***bashtë*** jepet si turqizëm (Fjalëtore:724), në fjalorin e Dizdarit ndeshim vetëm fjalën ***bashtinë*** si huazim nga turqishtja, por nga studiuesit e tjerë shihet ndryshe. Te *Fjalori i Kristoforidhit* shënohet: *bashtinë*-a me dy kuptime: 1. çiflik, 2. arë a vend sa mund të punojë një familje; me shënimet se këtë fjalë e ka marrë te P. Budi dhe se është "fjalë sllave"[314]. Fjala *bashtinë* del për herë të parë në letësinë e shkruar te "Meshari" i Buzukut bashtin-a; serbokroat. bashtina me dy kuptime: 1. Pronë toke që lavrohet afër shtëpisë në fshat "e i madh anshtë vend i bashtinësë saj!" (Meshari LXXIII/3, f.279)="villam emi" Luca XIV, 18.[315]Më pas te Budi "bashtinëtë"332[316]. Çabej e konsideron një fjalë të huazuar nga sllavishtja[317] Luka kësaj fjale i ka kushtuar një artikull të plotë,[318] ku sipas tij fjala *bashte*,*-ja* "kopësht, bahçe" "paraqet një formim regresiv, një shkurtim i trajtës bashtinë, e konceptuar në ndjenjën gjuhësore të popullit si e formuar nga *basht*/*e*/ me prap.-inë.*"[319]*

Fjala ***lugat*** do të përfshihet në *Fjalëtoren* e Mitkos[320], ndër ato fjalë që nuk përcaktohet burimi i saj. Edhe në fjalorin e G. Majerit nuk përcaktohet prejardhja e fjalës[321]. Çabej në serinë e pestë të veprës madhore botuar së fundmi e quan të drejtë mendimin e Joklit si fjalë me prejardhje sllave me kuptimin "i dashur, i

[312] Thimi Mitko, *Fjalëtore Shqip-Gërqisht, Gërqisht-Shqip & ndihmesa të tjera leksikografike*, Tiranë, 2014.
[313] Fjalor 1954 f. 121.
[314] K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht,* Tiranë, 1961, f.48.
[315] D. Luka, *Studime gjuhësore XII*, Shkodër, 2010, f. 99.
[316] K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1998, f.172.
[317] E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes,* vëllimi II (A-B), Tiranë 1976, f.181.
[318] Shih. D. Luka, *Rreth historisë së fjalës bashtinë* (Çështje parimesh e metode), Studime gjuhësore XII, Shkodër, 2010, f. 99.
[319] Po aty f.106.
[320] Thimi Mitko, *Fjalëtore Shqip-Gërqisht, Gërqisht-Shqip&ndihmesa të tjera leksikografike*, Tiranë, 2014, f.743.
[321] Gustav Majer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, (Përkthyer nga Anila Omari)Botimet Çabej, 2007, f.293.

këndshëm, hirplot" (Çabej SE V:249); Fjalori i gjuhës shqipe e shpjegon si: "Figurë e besimeve popullore, e përfytyruar si njeri, i cili në gjallje të tij është shumë i keq dhe pas vdekjes ngrihet natën nga varri e tremb njerëzit; njeri shumë i shëmtuar, shumë i keq" (Fjalor 2006:569); Për Lukën fjala *lugat* është huazim i shqipes nga Turqishtja.[322] Këtë mendim e përforcon edhe vetë shpjegimi i Dizdarit i cili e rreshton këtë fjalë në huazimet e shqipes nga turqishtja (Përkatësisht arabishtja) ku shprehet "*Deri para 35 vjetësh, fjalë e rëndomtë në gojë të atyne që ishin të shkollës turke e sidomos të medrezeve*" (Diz:598).

Veçoritë e huazimeve në veprën *Bleta shqiptare* janë mjaft të larmishme.

Nga pikëpamja morfologjike pjesa më e madhe i takon kategorisë emërore dhe më pas vijnë ato me temë mbiemërore, ndajfoljore dhe foljore. Në huazimet turke gjenden edhe disa pasthirrma si: *aman, mashalla* etj. Rastet e huazimit të foljeve janë të rralla. Përmendim disa raste si: *bitis, hallavit, kullandris, kërdis, dengdis, kërdis, dalldis***,**si: *Këndon qyqeja m'dy, tre lisa,/Tre maxharë ç'i* ***kësdisa****,/Dot muranë s'e* ***bitisa****.* (f.84); ***Dalldisi*** *pashaj si burrë*.(f.139). *Qysh s't'a* ***degdisi*** *qafiri*.(f.111); *O junar, o dru pre mali,/Që* ***hallavitet*** *jarani*. (f.88) etj.

Huazimet turke kanë hyrë në përgjithësi pa prapashtesa, me raste të pakta të prapashtesave turke -ler,-lar, si dhe prapashtesës xhi- në pak shembuj.

Përsa i përket turqishtes vëmë re elementet ***-ler*** e ***-lar***, që dalin në vepër në formantet ***-lerë,*** ***-llarë***, duke u bashkuar me ta dhe prapashtesa e vendit ***-ë,*** si: *turko-llarë, aga-llarë, pasha-llarë, usta-llarë, xhan-llarë, Katiler' e* ***agallarë*** (Bleta:148); *Kur më merr dyfkn' e larë/ Si vezir mbi* ***pashallarë*** (Bleta:50); *A raja ndë* ***turkallarë****!*(f.147) etj. Siç shprehet E. Hysa, këto formante të shumësit të emrave, si të gjitha elementet fjalëformuese që vijnë nga turqishtja janë huazuar së bashku me fjalët si një leksemë e vetme e pastaj janë shkëputur prej tyre. Mund të shënojmë se këto formante brenda shqipes nuk janë bërë prodhimtare, pra nuk kanë arritur të shkëputen prej fjalëve me të cilat janë huazuar, për t'u bashkuar me tema të tjera, veçse në raste të veçanta, kur është fjala për të shënuar persona që mbajnë emra të njëjtit familje.[323]

-**xhi**: Me këtë prapashtesë turke ndeshim disa raste, si: *ari****xhi,*** *han****xhi,*** *kallan****xhi,*** *kujun****xhi,*** *furrë****xhi,*** *kollë****xhi****, xhiger****xhi****, joll****xhi*** etj.;

-lli: *kasaba****lli****, ferman****lli****, kara****li****, osman****lli****, kërxha****lli*** etj.;

-hane: *berber****hane****, kasp****hane*** etj. *S'rryra dot në berber****hanë***, (f.86);

-me parashtesën **kara-:** ***kara****dyzenë,* ***kara****udhë*, ***kara****groshë,* ***kara****dak* etj;

Këto formante parashteso-prapashtesore, pavarësisht varianteve fonetike në përshtatje me harmoninë vokalike në gjuhën turke kanë depërtuar duke iu përshtatur sistemit fonetik dhe strukturës gramatikore të gjuhës shqipe.

Nga analiza morfologjike e fjalëve të bëra bie në sy se një pjesë e mirë e fjalëve kanë marrë prapashtesa shqipe, rrënjëve të huazuara u janë shtuar prapashtesa të

[322]D. Luka, Studime gjuhësore XII, Shkodër, 2010, f. 98.

[323] E. Hysa, *Elemente turke në strukturën e fjalës në gjuhën shqipe*, SF 3-4, 1998, f.150.

shqipes dhe janë formuar fjalë të reja, që përbëjnë pjesën më të qëndrueshme të huazimeve si: ***–ëri, -ar, -tare, -ore,*** etj., si: ***-ëri:*** **ashikërija:** *Mjeri unë ç'jam në kurbet,/Ç'më lypet* ***ashikërija****,/Shkon dudija me gojë s'flet*"(f.87); *Të bënetë* **misërija***,/Që të hanë turqërija*. (f.39); ***-ar:*** **bajrak~tar, karvan~ar**: *Zunë e vijnë* ***karvanarët****,/Karvanarët e Endresë*, (f.98); **karvan~arë:** *Zunë e vijnë* ***karvanarët****,/Karvanarët e Endresë*, (f.98) etj.

Ndër fjalët e formuara me anë të kompozimit, mbizotërojnë ato me marrëdhënie përcaktore midis njërës gjymtyrë me burim nga turqishtja dhe tjetrës me burim shqip, si: **binish-gjatë**, **palla-gjerë, shallvare-gjanë** etj.

Në shumicën e rasteve formimi i fjalëve u është nënshtruar tipave dhe modeleve të fjalëformimit të shqipes, që ndryshojnë nga ato të turqishtes, por ka edhe raste ku model i shqipes përputhet me atë të turqishtes.

Fjalët e reja me ndajshtesa shqipe ose kuptime të prejardhura te turqizmat kanë përdorim në gjuhën shqipe. Një pjesë e tyre shumë e vogël përdoren sot edhe si terma. Ato janë ngulitur në shqipen e sotme, sepse për to gjuha ka nevojë, meqenëse janë fjalë që shënojnë koncepte, që shqipes i kanë munguar.

Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve orientale në shqipen e sotme letrare janë vjetëruar, duke u kthyer shumë prej tyre në historizma, si: ***bejleg, tellall, jeniçer*** etj. Një pjesë tjetër e këtyre fjalëve ruajnë edhe në shqipen kuptimin që kanë pasur në gjuhën dhënëse; megjithëse kanë kaluar qindra vjet, qyshkur kanë hyrë së bashku me përmbajtjen e tyre. Por ka raste ku te fjalët me origjinë turke kanë ndodhur zhvillime semantike që nuk përputhen me zhvillimet semantike në gjuhën turke. Zhvillime semantike që bien në sy janë ato të karakterit konotativ. Ky karakter konotativ lidhet me një ngarkesë stilistike kryesisht negative që kanë fituar këto fjalë në shqipen standarde.

Shumë prej këtyre orientalizmave të përdorura nga populli e të mbledhura nga Mitkoja sjellin mirë koloritin e asaj kohe, apo të atij mjedisi ku zhvillohen ngjarjet e komunikimi, si dhe *arkaicizmin e gjuhës si kërkesë stilistike*[324], duke bërë që sot një pjesë e mirë e këtyre fjalëve të qëndrojnë në periferi të leksikut letrar.

FJALORTH I ORIENTALIZMAVE NË VEPRËN "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS

adalet~i: *Ndë Korç u bë* ***adaleti*** (f. 117)[325], "kërdi, mënxyrë "(Diz : 3)[326].

aga~i,~llar/ë: *Katiler' e* ***agallarë*** (f.148),"pronar tokash, pasanikë të pashkolluar"(Diz:6).

ajanë~t: *Dalëke dhëndëri* ***Ajan*** (f.50), "parësi, senator, krye"(Diz:10).

alem~i: *Rreth e rrotull* ***alemit*** (f.115), "rruzulli, gjithësija" (Diz:18).

allah~u:*S'kemi shpëtim, u* ***allahi***! (f.143), " Zot, Perëndi" (Diz:21).

---

[324] O. Baja, *Rreth orientalizmave të përdorura në Kryeveprën e Fishtës*, në rev. "Malësia", nr. 7, Podgoricë, 2012.

[325] Numri i faqes pas vargut i përket veprës "*Bleta Shqiptare"* e Thimi Mitkos, botimi Vjenë 1924, përkthyer nga Gjergj Pekmezi. Ky rregull është ndjekur për të gjitha fjalët e vjela.

[326] Shpjegimi i fjalëve është bërë sipas fjalorit të Tahir Dizdarit, *Orientalizmat në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005. Në ndonjë rast tjetër është cituar libri nga janë shpjeguar fjalët.

allçak~e: *Hafus-pasha fort **allçak**,/Pa meshtref, e pa qitab*. (f. 219), "tur. alcá, i ultë nga karakteri, i poshtër faqezi"(Diz: 24).
aman: *As **aman,** moj lesh-kunorë,/Qasu të m'të zë me dorë*. (f.88), "tur. amán, pasthirrmë, të lutem, mëshirë"(Diz: 26).
amanet~i: *Shtëpin **amanet** e ke* (f.110), "veprim i të besuarit ose i ruajtjes së diçkaje në mirëbesim" (Diz:27).
amber~i: *Mos je zymbyl nd'**amberi**,/Që rri n'bashtët mbret mbulumun*? (f.103), "tur. amber, një lëng i trashë si dyll, ngjyrë hini, që del prej fshikëze e zorrëve të një peshku, këtu kuptim i fig. aromë "(Diz:28).
arxuhall~i: *Po na shkroni **arxuhallë**,/duam zabitër tanë*.(f.169), "*Arzuháll*, lutje ankim me shkrim, ankesë"(Diz:38).
ashik~ëri/ja: "dashunia" *Mjeri unë ç'jam në kurbet,/Ç'më lypet **ashikërija**,/Shkon dudija me gojë s'flet* (f.87).
ashik~u: *Që hallavitet **ashiku***. (f.88), "dashtnor, dashuronjës, qefli" (Diz:42).
asllan~i: *Feizo Xhafo, bir **asllani***!.(f.170), "trim, burrë i fortë, i bashëm, i rreptë, azgan"(Diz:39).
asqer~i: *Mbëlidh **asqerë*** (f**.**125), "ushtar, ushtarak" (Diz:40).
avaz~i: *Këmbëkuqe, moj fëllënxë,/Thua ja mb'**avazë** tënde* (f.49),"za, jone, motiv muzikor"(Diz:45).
avli/avlli~ja: *Sa s'mund të kaptonj **avlinë*** (f.73), "tur. avlú, oborr" (Diz:46).
azat~i: *Në ballët ke një mishan,/Kam shahit e t'a baj ispat,/Të dy syt,/ore xhanam,/ fukaran bane **azat**.* (f.103), "tur.azát, pa fre, i lëshuar, i shpenguar"(Diz:49).
baba~i: *Thosh e bija për **babanë*** (f.32),"babë-a, tatë" (Diz:52).
bajame~ja: *Plot me lule, me **bajame*** (f. 65), "dru nga familja Rozaceve"(Diz:57).
bajrak~u: *Në dorë e rroku **bajraknë*** (f.169), "flamur, shujkë" (Diz:58).
bajram~i:*Vallë **bajram,** apo ç'është sod*, (f.32), "dy të kremtet kryesore që lusin myslimanët" (Diz:60).
bakall~i:*Sa nxora armën **bakalle***. (f.115), "tregtar që shet me pakicë gjana ushqimore dhe disa artikuj të nevojave shtëpiake" (Diz:61). Këtu me kuptim të figurshëm "e prishur".
bardhak~u: *Hypa lart nd'atë çardhak,/Vashë,nem m'atë **bardhak.*** (f.94) **"**Tur. bardak, enë kryesisht prej balte, me rrëfanë ose pa të, që kryesisht vlen për të pirë ujë"(Diz:67).
bark~u: *Puno, o fatzi! Haj o **bark**-stihi!*(f.233), "gjak, fis"(Diz:68).
barrak~u: *Feizo Xhafoa **barrak***, (f.170), "i shpejtë, i shkathët, i zhdërvjedhtë"(Diz:67).
bashibozuk~u: ***Bashibozuk**' e nizami*. (f.178), "ushtar i parregullt i mbledhur shpejt e shpejt, civil i armatosur, joushtarak, mercenar"(Diz:73).
bashoda/~ja: *E rrëmbeu e flytyroj,/Ndë **bash-hodë** e lëshoj*. (f.54**)**, "dhoma, kërthina kryesore në shtëpi" (Diz:74).
batare~ja:*Kur ra **batareja** e parë*. (f.153),"të zbrazura pushkësh menjëherësh, krismë" (Diz:76).

bazergjan~i: *Dua burrë* ***bazergjan*** (f. 26), "tur. Bazĭrgân, titull që u ka qenë dhënë si për sajdi çifutëve në vend të efendi, *aga*" (Diz: 79).
beden~i~a/at: *Moj kalaja me* ***bedena*****,** **(**f. 137), "pjesët e sipërme të mureve të kalasë që janë dhëmbë-dhëmbë, e
përdoren për mbrojtje" (Diz: 81).
behár~i: *I mjeri ç'e ndjek* ***beharë***, (f. 105),"pranverë me kuptim të zgjeruar, verë" (Diz:85),
bej~beu: *Mbetën* ***begët*** *e Ylqinit*. (f.210), "titull që u ka qenë dhënë shtëpive të para, që hiqeshin si feudalë të vendit" (Fjalor 2006:83)
bejte~ja: *Fjalë, fjalë fliten* ***bejtet****,/Her'mga herë shtohet sevdaja* (f.102), "vjershë me karakter lirik a satirik që nxjerr një vjershëtar, zakonisht i qytetit" (Diz:89).
bela~ja: *Si me maskari e zuna,/E u bash ashik mbë ty,/ Mjeri unë se ç'****bela*** *vuna* (f.102), "gjendje e mërzitshme, e vështirë, ngatërresë, hall" (Diz:91).
beqar~i: *Të njihesh, se je* ***beqare***. (f. 101), "tur. bekâr, i pamartuar, i pazanë"(Diz:94).
berberhane~ja: *S'rryra dot në* ***berberhanë***, (f.86), "rruestore, flokëtore" (Diz: 96).
bereqet~i: *Aqe* ***bereqet*** *të kesh* (f.37), "drithë, korrë, mbjellë, fig. mbarësi, pjellori" (Diz. 96).
bina~ja: *Do të më krejë* ***binanë*** (f.139), "ndërtesë, godinë" (Diz: 104).
binish~i: *Ahmet-pashë* ***binish****-gjatë,/Ku i çon ata bajrakë*? (f.121),"mantel i myslimanëve që vishej në raste festive" (Diz:105) Këtu me kuptim të figurshëm.
bitis: *Këndon qyqeja m'dy, tre lisa,/Tre maxharë ç'i kësdisa,/Dot muranë s'e* ***bitisa***. (f.84). "përfundoj një punë, i dal në skaj, e kryej, e mbaroj" (Diz:108)
bostan~i: *Iu bë kastravec* ***bostanit,*** **(**f.112). Këtu me kuptim të figurshëm, njeri i zhigatun**. "**tur. bostan, vend i mbjellur me pjepër e shalqi, por edhe vetë fryti i tyre" (Diz.114).
bozuk~u/buzuk~u: *Sjell* ***bozuk'*** e qemenxhetë (f.156), "kitarë e madhe me gjashtë tela" (Diz: 127).
budalla~i: *O Nazif,* ***o budalla*** (f.83), "I metë nga mendja" (Diz:117).
bylykbash~i: *Namnë ja le* ***bylykbashit,*** (f.221), "titull dhe funksion i kryetarit të një krahine" (Diz:131).
byrynxhyke~ja: *O moj linjë* ***byrynxhyke*** (f.74), "fije e hollë e mëndafshtë, pëlhurë, gjë e dredhur në trajtë lëmshi" (Diz:133)
çallm: *Kungulli* ***çallm'****e kadinjet,/ si çomageja e arixhinjet*; **(**f.31), "pëlhurë, napë e bardhë, ose ndonjë ngjyrë tjetër që rrotullohet disa herë rreth kësulës"(Diz:146).
çarçaf~i: *Dyshek me* ***çarçaf*** *më shtroni* (f.80),"pëlhura ose bezi që i shtrohet dyshekut ose jorganit" (Diz:151).
çardhak~u: *Hypa lart nd'atë* ***çardhak****,/Vashë,nem m'atë bardhak*. (f.94; *Brumbullet* ***çardhaku,*** *e mjerë!* (f. 92), "kati i sipërm i një shtëpije, shërben si vend i freskët për të qëndruar verës" (Diz: 152).
çarkë~a: *Me një top me dy* ***çarka,*** (f.197), "vegël për punime pjesësh të imëta, mekanizëm për shumë zanate, rrotë e dhëmbëzueme, vegël për të zënë zogj, minj; vegël për të grirë duhan; mjet për të marrë gjak, tur. **çark**" (Çabej SE III: 91).

çaush~i: *O **çaush**, tha: ndaje bukën dhe tainet.* (f.119) "nënoficer në kohën e sundimit osman" (Diz:156).
çember~i: *Atje ku lashë **çemberë***, (f.94) "shami koke me të cilën gratë e vjetra mbulonin kokën" (Diz:162).
çoban~i: *Me pisqoll' e jatagan,/Më duke si një **çoban*** (f.84) "bari, ai që ruan dhe mbarështon bagëtitë" (Diz.177).
cohë~a: *Gjithë mveshurë ndë cohë* (f.50), "stof i leshtë, i butë dhe i punuar hollë" (Diz:139).
çomage-ja: *Kungulli çallm'e kadinjet,/ si **çomageja** e arixhinje,* (f.31), "shkop me kokë që përdoret në lojën e dokrres ose për të goditë kafshë të egra në gjueti"(Diz:178).
çorbë~a: *Mëntë m'i bëre **çorbë***(f.100), "kuptimi i parë **supë**, **gjellë**, këtu me kupt. të fig. diçka e përzier pa rregull e pa shije, diçka e ngatërruar dhe e paqartë, pështjellim" (Fjalor 2006:162); Me të njëjtin kuptim (Diz: 179).
çubuk~u: *Meli digjet, e hambari s'digjet*?(*Tymësi ndë sipsi të* **çubukut**), (f.251), "1. llullë duhani, 2. direkë përmbi direkët kryesorë të anijes" (Diz:180). Këtu mjet që shërben për tymosjen e duhanit.
dado~ja: *Po jeshë me **dadonë**,/Dado-faqe-zezënë* (f.55), "grue e posaçme që merret me rritjen e fëmijëve"(Diz:184).
dajë~dajko:***Dajkua** Lëkurësjot*, (f.114), "dajë, vëllai i nënës" (Diz:188).
dalldis: ***Dalldisi** pashaj si burrë* (f.139), "tres në mendime e në kujtime, lëkundem, bahem jerm"(Diz:191).
daulle~ja: *Luaj këmbët siç bje **daulleja*** (f.246), "vegël muzikore, e përbërë prej një kashe të rrumbullakët prej druri në trajtë cilindrike" (Diz: 196).
dava~ja: *Ju, syt' e mij, gjeçi belanë, Ku t'a gjenj unë padishah,/T'a bënj sit ë dua **davanë**,* f.81; "padi, gjyq, e qame, vajtim" (Diz.196**)**.
degdis: *Qysh s't'a **degdisi** qafiri*, f.111; "e dërgoj larg, e nis për diku" (Diz: 199).
deli: *Me nizam, e me **deli,*** f.174; "trim, burrë i dheut" (Diz:200). Në fjalëtoren e Mitkos ka kuptimin **deli** "i marrë, i çmendur" (Fjalëtore:727).
derdimen~i: *Të dy syt, o Ibrahim!/ Të kam rixha as më duaj,/ Jam garip, e jam jetim,/**Derdimen** ndë dhethit t'huaj.* (f.103), "i gjorë, hallemadh" (Diz:205).
derhem: *I gjori bilbil ç'fuqi ka?/ Një **derhem** mish ndë trup s'e mba,* (f.82), "njësi peshe 1/400 e okës, 21/2 e
gr."(Diz: 206).
derman~i: *Mo më vra, po më ban **derman**,* (f.104), "tur. derman, mjet shërimi, mjet lehtësimi nga ndonjë e keqe" (Diz.207).
din~i: *T'u ndërrojmë **din**'e imanë* **(**f.147), "fe religjon, kult" (Diz.215).
divan~i: *Ndë **divan** rrinë ca gra*. (f.124), **"**tur. divan, kanape pa mbështetëse" (Diz:217).
divan~i: *Xhemileja po pi duhan/Mylazimi ban **divan***, (f. 105), "qiri në këmbë, duke pritur se ç'urdhër po i jepet" (Diz:218).

divanhane~ja: *Ndë saraj në* ***divanhane*** (f. 221),"hapësirë, korridor i gjerë midis kërthinash" (Diz:218).
dollama~ja: *Mehmet –beg, ç'të ka* ***dollama***,/*M'a kan'grisun' do keçanë*, (f.226), "rrobë e gjatë cohe, a shajaku e çelun nga përpara që arrin deri në gju" (Diz:222).
donamë~a: *Nd' Abuqir* ***donamën*** *ja doq, /I zaptoj grykën e limanit*, (f. 212); "flotë detare, lufte" (Diz: 226).
dori~u: *Të m'apë mezil-****dorinë*** (f.213),"kalë me qime të kuqrrisun" (Diz:227).
dovlet~i: *Luftoj me pëse* ***dovletë****,* (f. 166), "emër që i jepej sulltanit të Turqisë, si personifikues i shtetit dhe i perandorisë" (Diz:227).
dovlet~i: *Niza të bëji me* ***Dovlet*** (f.139), "begati, shtet, pushtet, mbretëri, perandori" (Diz:227).
dudë~a: *Kur më vë* ***duda*** *mbë ballë* (f.96), " man i zi, i bardhë"(Diz:229).
dudi-ja: *Mjeri unë ç'jam në kurbet,/Ç'më lypet ashikërija,/Shkon* ***dudija*** *me gojë s'flet,* (f.87), "zonjë e hijshme" (Diz:230).
duhan~i: *Më thanë që pi* ***duhanë*** (f. 62), "bimë industriale e njohur, me shije të vrazhdë kur tymosen e pihen gjethet e saj të thara" (Diz: 230).
dyfek~u: ***Dyfeku*** *ç'ubë?/E mori katiu* (f. 22), "Pushkë, armë, hutë"(Diz:234).
dylber~i: *Se* ***dylber*** *s'u gjent me bes'* (f.102), "dashnor" (Diz:236).
dynja~ja: *I ke ti mbë këtë* ***dynja,*** (f.81), "bota, rruzulli, gjithësija"(Diz:238).
dyshek~u: *Shtroj* ***dyshek*** *të kuq të ri* (f.55) "shtresa për të fjetë, i mbushun me lesh, pambuk etj."(Diz:241).
eshdërha~ja: *Mehmet - begu* ***eshdërha****,/Çallma syvet i ka ra* (f. 225), "figurë e besimit që përfytyrohet si kulshedër" (Diz:262).
fajde ~ja: *Naha unë s'ke* ***fajde*** (f.71), "dobi, përfitim" (Diz:263).
felah~i: *Cokë-Dima si* ***felah*** (f.111), "tur. fellá, bujk, punëtor i misrit, fshatar i fushave në atë vend" (Diz:268).
fermán~i: ***Ferman*** *ndë gjithë Turqi*, (f.146), "urdhër me shkrim i sulltanit në Perandorinë osmane për një emërtim, gradim etj." (Fjalor 2006:266); Me të njëjtin kuptim edhe te fjalori i Dizdarit. (Diz:270).
fermanli : *Fëjen një pasha,* ***fermanlli*** (142), "në kohën e sundimit osman quhej kështu një personalitet i shquar hjerark, ose oficer i lartë që kishte dekret të posaçëm prej mbretit" (Diz:271).
fermele-ja: ***Fermelenë*** *gjithë ar,* (f. 50), "mantel për gra pa mëngë, i qëndisur me ar ose argjend në Zagori"(Diz.271).
feste~ja: *Vure* ***festenë*** *mbi sy* (f.141), "kësulë e kuqe prej cohe" (Diz:271).
filxhan~i: *Se ç'i bën zingjir* ***filxhanit*** **(**f.32), "kupë prej dheu a biluri për kafe, çaj" (Diz:275).
fiqir~i: *Kujdo i shkoj ndëpër* ***fiqir****,/Nga ai mirr të math lebet*, (f.139), *Sahatnë gjithë zinxhirë,/Kur e shoh më prish* ***fiqirë*** (f.59), "mendim, kujtesë, ndërmend" (Diz:276).
fishek~u: ***Fishek*** *nga dera të qita* (f.88), kuptim i figurshëm "si ndajfolje bisedore, menjëherë"(Fjalor 2006:275).

fishek~u: *Kamilet mbajnë **fishekë*** (f.133), "ngarkesë armësh brezi, të gjata, gjuetie, mitralozi" (Diz:278).
fitil~i: ***Fitili*** *kandiles edhe vajtë*, (f.254), "fije të dredhura në një të vëna në kandil për të ndezur e për të bërë dritë" (Diz: 279).
flori~ni: *Dua një sërë **florinj*** (f.92), "ar, monedhë ari " (Diz:280).
frëngji~a: *Po morri thellë **frëngjinë**,/Trieshtën e Italinë* (f. 78), "tur. frengi" vend evropian, e në veçanti, Franca" (Diz:282); "e çarë e ngushtë në muret e kullave ose në bedenat e kështjellave prej nga qëllohej me armë; dritarëz në tank në bunkier për të parë e për të qëlluar" (Fjalor 2006:292).
fukara~ja: *Në ballët ke një mishan,/Kam shahit e t'a baj ispat,/Të dy syt,/ore xhanam,/ **fukaran** bane azat*, (f.103), "i varfër, i vobekët, i gjorë, i shkretë" (Diz:283).
gajret~i: *Asqeri do **gajret**,* (f.201), "qëndrim, përpjekje e zellshme, durim, kurajë" (Diz:288).
gajtan ~i: *O gajtan, o **gajtan**!/O ku i gjete ata desh* (f.20), "Një si sigjim i trashë prej mëndafshi, prej leshi a prej pambuku që vihet anëve të rrobës për stoli e për të mos dalë thekët**" (**Diz:289**)**.
gallatë~a: *Që rrahu tërë Stambollë,/**Gallatën** e Gjelibollë*(f.27), "tur. galát, gabim, lajthim, shprehje e gabueshme, barbarizëm" (Diz: 289).
gargi~ja: *Moj e holla, si **gargija***, (f.80), "heshtë, shtizë"(Diz: 291).
garip~i: *Të dy syt, o Ibrahim!/Të kam rixha as më duaj,/Jam **garip,** e jam jetim,/Derdimen ndë dhethit t'huaj,* (f.103), "i varfër, dorëhollë, që jeton me vështirësi e nuk shtrin dorën" (Diz:291).
gjemi~ja: "*Mbloje detinë **gjemi**,/ Zër' e qafirë si mi*" (f.146) "anije lundrimi, barkë me vela, këtu me kuptim të fig." (Diz:302).
gjerdan~i: *Treqin grosh i bën **gjerdani*** (f.94), "varg me flori, me inxhi a me gurë të mirë që varin gratë në qafë" (Diz:304).
gjider~i: *Nere **gjidersën**, bre halldub*? (f.154), "flet kot më kot, ka humbur fijen" (Diz:307).
gjidi: ***Gjidinë** e raftë deti*, (f. 212), "fjalë qortuese me karakter përbuzëse, rrufjan, ganec" (Diz:307).
gjok~u: *Mal mbë mal bariturë,/Me **gjokën** të grisurë***, (**f.26), "kali i bardhë" (Diz:309).
gjynáh~i: *As ki frik' se ban **gjynah*** (f.101), "mëkat, faj, sipas ligjeve fetarekapërcim a dhunim i vullnetshëm me fjalë e me vepra të ligjeve të shenjta dhe caqeve morale" (Diz:316).
grosh: *Dyqind grosh se ç'i pagova* (f.115), "monedhë divizionale e kohës së sundimit osman me vlerë 40 pare një e njëqinda e lirës turke; kacille" (Diz:297).
gurgule~ja/gurgulla: *Bedeni me **gurgulla**,/E mban faqe-rrumbulla,/Ajo mes-këputura,*(f.93), "zhurmë" (Diz.299).
gónxhe/konxhe~ja: *Moj syzezë, moj sy –**konxhë*** (f.99), "lule e paçelur mirë" (Diz:297).
haber ~i: *Hazizit **haber** i dhanë* (f.169), "lajm, kumt, përgjigje, mesazh" (Diz:322).

habesh~i: ***Habeshetë*** *i përndanë* (f. 202); ***Habeshi*** *e zu dyfeknë*, (f.199), "Vendas i Etiopisë, fig. i zeshkët" (Diz:323).
hajmali~ja: ***Hajmalinë*** *me zingjirë* (f.73),"objekt shkrimi që njerëzit supersticiozë varin krahëqafë, a ndryshe për t'u ruajtur prej të marrurit sysh, sëmundjeve e rrezikut, nuskë" (Diz: 331).
hak~u: *Se të digjesh e ke* ***hak****, / Zapëtove tërë dhenë*, (f.136), "e drejta, arsyeja, e vërteta, meritimi" (Diz:333).
hale~ja: *Zuri gardhin e* ***halesë*** (f. 32), "nevojtore"(Diz:336)
hall~i: *Të qajmë* ***halletë*** *tona* (f.74), "gjendje, kusht, nevojë, ngushticë, derman, brengë, vështirësi, vuajtje" (Diz:338).
hallall~i: *Tundu, moj* ***hallall*** *të qoftë*, (f.75), "gja e drejtë dhe e lejueshme në çdo marrëdhënie legjitime, meritim, e drejtë" (Diz:340).
halldub~i: *Nere gjidersën, bre* ***halldub***? (f.154, E gjejmë te Dizdari, si sharje, përbuzje e Turqve të azisë prej shqiptarëve; njeri i çrregullt e i trashë nga mendja"(Diz:341). Në *Fjalorin* e gjuhës shqipe ka edhe kuptimin "pushtues osman, bashkëpunëtor ose shërbyes i këtij pushtuesi" (Fjalor 2006:371).
hambar~i: *Meli digjet, e* ***hambari*** *s'digjet? Tymësi ndë sipsi të çubukut* (f.251), "grunar, drithanik, magazinë a depo për vendosje drithërash" (Diz:345).
han~i: *Vinjënë,vinjënë, ndë derë të* ***hanit*** (f.26), "bujtinë"(Diz:347).
hanko~ja: *Hajde, haj* ***hanko*** *Rukija*! (f.106), "titull sajdie që paraprinte emrin e grave muslimane shtëpijash të mira nëpër qytete" (Diz:351).
hanxhi~u: "tur. hanci. "Pronar ose mbarështues i hanit" (Diz:347).
haraç~i: *Këtë senenë, që dolli,/Gyftiko* ***haraç*** *na hodhi*, (f. 171), *Ep* ***haraç,*** *o mori Shkodrë*, (f. 211), "Vergji e hershme, që paguanin shtetasit jomuslimanë të perandorisë osmane për mos pjesëmarrjen në luftë ose që zente vendin e bedelit në shërbimin ushtarak" (Diz:353).
haram~i: *Preje o* ***haram*** *e paçi*.(f.112), "ndalesë kategorike nga ana e fesë e kundra ligjshme, ant. Hallall" (Diz:354).
harar~i: *O i shtiri ndë* ***harar,*** *o i sjelli mbë gomar*… (f.271), "thes i madh" (Diz:355).
harxh~i: *Njëzet mijë* ***harxhe*** *dhanë (*f. 178), "shpenzim, konsum, material" (Diz:360).
hasëm ~i: *Mikut iu rënko,* ***hasëmit*** *iu* ***l****ëvdo*. (f. 233), "armik" (Diz:364).
haxhet~i: *Psyhoijo, mos ki* ***haxhet*** (f. 189), "huadhënie, marr borxh" (Diz: 374).
hazine~ja: *Na ra poshtë* ***hazineja***. (f.182), "grumbull ari, argjendi dhe sendesh të tjera të çmueshme që ruhen në një vend, thesar" (Diz:377).
hejbe~t: *Kungull gjeçë ndë* ***hejbet.*** **(**f.31), "strajcë"(Diz. 379).
helaq: *Nizamin e ban* ***helaq****,/Muarën rotta dhe nishana* (f.219), "fëlliqem, ndyhem" (Diz: 379).
hendek~u: *Gjet ti plaka ndë një* ***hendek*** (f. 30), "vijë e ngushtë dhe e thellë që çilet rreth e qark ose midis arave" (Diz.380).
hesap~i: ***Hesap*** *i shtepijës s'del ndë pazar*. (f.234), "llogari, numërim, kalkulim" (Diz:383).
hillall~i: *Moj qepalla* ***hillall*** (f. 48), "krandëze e hollë prej druje, degëz" (Diz:388).

hise~ja: *Shokun mos e duaj, po **hisen** i a ruaj.* (f.243), "pjesë, racion" (Diz:391).
hudut~i: *Kësaj pune i gjej **hudut*** (f.137), "vija që ndan dy toka, dy shtete, kufi, cak" (Diz:398).
hynqarë~i: *Duam të shohim **hynqarë*** (f.170), "imzot, sovran, titull për sulltanët e Turqisë" (Diz: 401).
hyqëm~hyqym/ hyqmi: *Davan **hyqëm** kush e bani?* (f.222), "pushtet, autoritet, gjykim, ndikesë, reputacion" (Diz:402).
hyqimat~i, hyqumet: *Që kur jeshe ndë **hyqimat*** (f.139), "qeveri, sundim, shtet, autoritet, pushtet" (Diz:402).
hyxhet~i: *Dhe katiu ep **hyxhet** jallan* (f.102), "dokument zyrtar që provon zotërimin e një pasurie të patundshme " (Diz:405).
iblis~i: *Hafus-pasha, si **iblizi,/** E vrau zoti, edhe qitabi*. (f.219), "djall, dreq, fig. njeri i fëlliqur, intrigant" (Diz:407).
iman~i: *T'u ndërrojmë din'e **imanë*** **(**f.147), "symbol i fesë muslimane, besojmë, besim te Pejgamberi"
(Diz.417).
imdat~i: *Mbahu, se të vjen **imdati*** (f. 194), "ndihmë, asistencë" (Diz: 418).
inan: *Të shohim, ku kan' **inanë*** (f.171), "besim" (Diz: 419).
inat~i: *I foli beu me **inat**.* (f.170), "zemërim, mëri, hidhërim, mllef, urrejtje" (Diz:419).
inshallah: ***Inshallah** të gjithë thanë. (*f.146), "shprehje urimi edhe shprese që thuhet për të ardhmen, në dashtë Zoti" (Diz:421).
inxhi~ja: *Një kuti plot **inxhi***? (f.252), "trupa të vegjël të rrumbullakët me substancë gëlqerore, me ngjyrë qumështi, shumë të shkëlqyeshme të për ftuara nga guackat e detit" (Diz:421).
ispat~i: *Në ballët ke një mishan,/Kam shahit e t'a baj **ispat**,/Të dy syt,/ore xhanam,/ fukaran bane azat.* (f.103), "provë, dëshmi, vërtetim" (Diz:425).
ixhade: *Të prishim **ixhadet'** o* (f.160), "bëj inventar" (Diz: 430).
izë~a: *A kam **izë** për me fol'* (f.221), "leje, autorizim" (Diz:432).
jadigjar~i: *Ti më qenke **jadigjar***. (f.34) "i bukur, i pashëm, i akëruar"(Diz.435).
jallan~e: *Dhe katiu ep hyxhet jallan* (f.102) " rrenë, gënjeshtër" (Diz:439).
jangi~ja: ***Jangën** var po ngrehuni* (f.143), "zjarmi e madhe në tru, kllapi" (Diz:441).
jaran~i: *Merr e o **jaran** mbë krahë* (f.81), "mik, shok, dashamirë" (Diz:444).
jargavan~i: *Si ndë verë **jargavani***. (f. 80) "argavan~i: shkurre nga familja Oleacevet dhe lulja e purpurt me tufa të dendura me erë të mirë" (Diz:35).
jari: *Se më t'erdh **jari** mbë derë*. (f. 67), "grupi i jareve në ahengun e Shkodrës që përbëjnë një grup këngësh më vete, pjesëtar i grupit të këngëve popullore" (Diz:443).
jastëk~u: *Mbi jastëk, derdhurë leshtë* (f.88) "një qese e madhe me cipë pambuku mbushur me lesh, me pupla" (Diz:446).
jatagan~i: *Palla e **jatagana** qitnë*.(f. 164), "armë që pret e therë, më e vogël se shpata e kthyeme nga maja me dorëz të stolisun me fildish argjendi"(Diz. 447).

javer~i: *Me pashanë dy **javerë*** (f.201), "oficer pranë një sovrani, një komandanti" (Diz:449).
jaz~i:*Të përesëjnë shoqet ndë **jaz'** i mullirit* (f.88),"zi që mbahet për vdekjen e një njeriu të dashur, duke u veshur me të zeza dhe duke hequr dorë prej argëtimeve" (Diz:449). Këtu "vijë e ujit të mullirit, të arës etj; rrjedhë uji; gropë e madhe a hauz me ujë për ujitje" (Fjalor 2006:418).
jelek~u: *Mvish **jelekun** kadife* (f. 80), "petk i shkurtër pa mëngë që vishet nën xhaketë në rrobe civile dhe kombëtare"(Diz:450).
jeniçer~i: *Do të prishim **jeniçerë*** (f.125), "klasë e rregullt ushtarake turke" (Diz:452).
jeshil~ja: *Dru më dru, **jeshil** mbë jeshil* (f.82) "e gjelbër" (Diz:454).
jollxhi: *Sa do t'ishim jollxhi* (f.101) " udhëtar, shtegtar" (Diz:458).
jorgan~i: *Me **jorgan** të më mbuloni* (f. 80), "mbulesë fjetje e mbushur përmbrenda me pambuk"(Diz: 459).
jyrysh: *Morra dyfekun e bëra **jyrysh*** (f.81), "pasthirrmë, të hedhurit me turr, me hov përmbi armikun, sulm, vrull" (Diz:461).
kaba: *Bjer' i fyellit **kaba**,/Të më lozë Guçeja,/Faqe-tolopuçeja,/Ajo mes-këputura,/Ajo faqe-nkuqura*. (f.83), "rëndë, trashë, bjeri në bas" (Diz: 462).
kabil: *Thërret e vall' është **kabil*** (f.82), "mundësi, patjetër" (Diz:463).
kadënëz: *Dil **kadënëz** e shtëpisë…/Nxir kullakn'e zotërisë*. (f.40), "gruaja e kadiut" (Diz: 468).
kadi~u: *E vogëlë sa një lajthi, e ka mënt sa një **kadi***? (f.251), "hoxhë, gjygjtar i ligjës muslimane që në kohën e sundimit osman gjykonte dhe vendoste sipas sheriatit për punë civile e fetare" (Diz: 468).
kadife~ja: "*Mvish jelekun **kadife*** (f. 80), pëlhurë e endun me mëndafsh, lesh a pambuk e mbuluar me push të dendur"(Diz:469).
kadimi: *T'u dëftojmë **kadiminë*.** **(**f. 172), "e drejta e kullotjes në këtë krah" (Diz:469).
kafaz~i: *Një **kafaz**, se ç'e goditi.* (f.154), "rojtar i posaçëm vëndës pranë konsullatave, emisioneve të huaja në vise të huaja të perandorisë osmane" (Diz:471).
kafe~ja: *Pa merr kafenë, pa eja këtu* (f.72) "Coffea Arabica, e kultivuar në viset, kafe shqeto" (Diz:471).
kaftàn~i: "*Rroto moj vasiliko/Të më mveshnjë ndë **kaftan*** (f.26**)**, "tur. kaftàn, rrobë e gjatë e stolisur, prej mëndafshi që përdorej prej burrave në ditë të shënuara, që vishej nga dijetarët turq, në ditë të shënuara" (Diz:472).
kahpe~ja: *I dërgoj Memush **kahpeja***, (f.123), "grua e çthurur, e përdalur" (Diz:473).
kaike~ja: *Me **kaike** çanë dhenë*. (f.185), "Barkëz ose anije e vogël me vela" (Diz:474).
kajreman~i/kahreman: *Ky i bir' i **Kajremanit***, (f.104), "fatos, kreshnik" (Diz:473).
kala~ja: *Gur, gur bëhet **kalaja*** (f.102) " vend i rrethuar me mure të larta e të trasha dhe i pajisur me mjete për t'u mbrojtur për një kohë të gjatë; kështjellë" (Diz:477).
kalem~i: *Cicatë ndë mes t'jaranit,/Po **kalem'** i kallamarit*, (f.84), "petë për të shkruar, laps" (Diz:478).

kalemqari~ja: *Të holla* ***Kalemqarija***.(f.106),"shami e vogël e zbukuruar me lule të ngjyrosura" (Diz:480).
kallabak~u: *Mbi* ***kallabak****' u vërvinë* (f. 164), "turmë njerëzish, mizëri" (Diz:480).
kallanxhi~u: *Zhejotë ca* ***kallanxhij***. (f.22), "zejtari që merret me ndreqjen e enëve të bakrit, bakërpunues" (Dizdari:482).
kallaus~i: *T'enjtenë mbë sabah,/Erdh një* ***kallaus*** *e tha*: (f.197), "ai që u tregon udhën të tjerëve, e sidomos ai që e bën me qëllim të keq, hjekës në hajni" (Diz:483).
kallca~t: *T'u derdh gjaku* ***kallcave***. (f.109), "vithe" (Diz:483), por edhe "çorape të gjata prej shajaku për burra;
tirq" (Fjalor 2006:433).
kallëp~i: ***Kallëpi*** *që derdh florin*. (f.73), "përdorëse e drunjë ose e metaltë, me të cilën japin formën e dëshirueshme këpucës, kësulës" (Diz:485).
kamber~i: *Baba-Ferrua me* ***Kamberë***, (f.84), "shërbëtor i shtëpisë" (Diz:488).
kandil~i: *Fitili* ***kandiles*** *edhe vajtë* (f.254), "vegël prej metali dhe prej qelqi që shërben për të prodhuar e për të dhënë dritë për një farë kohe, llambë, dritë" (Diz:492).
kapi~ja: *Vezirit i u prish* ***kapija****.* (F.140), "derë, portë, plang" (Diz:498).
kapidán~i/kapedán: "Në kohën osmane, titull fisnikërie në disa fise malësore të Veriut e të jugut" (Diz:498); "kryetar çete, trim" (Çabej SE V:38).
kapllán~i: *O* ***Kapllan****, o Karali*,(f.142), "emër personi, tur. káplan~tigër" (Diz:500). Me të njëjtin kuptim e përdor Çabej, sipas tij fjala *kaplan* nga turqishtja ka shkuar në të gjitha gjuhët ballkanike. (Çabej SE V:41).
karabinë~a: *Një arab me* ***karabinë*** (f.148), " një pushkë e moçme kalorësish me grykë të gjanë, karaballi" (Diz:502).
karadak~u: *Që të më japë imdat/Të lëftonj me* ***Karadak***. (f.171), "Mali i zi"(Diz:504).
karadyzen: *Pse se merr* ***karadyzenë****?* (f.213), "vegël muzikore me dy tela, çifteli" (Çabej SE V: 47).
karafil: *O bilbil,* ***o karafil****/Ndo dil, ndo mos dil* (f. 18), "gjini bimësh nga familja e Karafilorëve, fjalë nga turqishtja *karanfil*, këtu me kuptim të figurshëm "i bukur" (Dizdari:506).
karar~i: *Asqerë t'a sill mbë* ***karar***. (f.140), "vendim, zgjidhje e një çështjeje juridike, administrative" (Diz:508).
karvan~i: *E vjen* ***karvani****, si bëletë.* (f.177), *Zunë e vijnë* ***karvanarët****,/Karvanarët e Endresë*, (f.98); "bashkësi qiraxhish, tregtarësh udhëtarë ose shtegtarë me ngarkesat e tyre në Orient" (Diz:514).
kasaballi~u: *Ndë Sheper* ***kasapallinj****,/Poliçanjotë xhigergjij*(f.23), "qytetar, qytetas nga Turq. kasabali" (Dizdari:515).
kasaphane~ja: *Shala po ban* ***kasaphane***. (f.221), "lokal ku theren dhe rjepen bagëtitë, therëtore" (Diz:515).
katiu: *Dyfeku ç'ubë?/E mori* ***katiu*** (f. 22), **"**Hoxhë gjygjtar i ligjës myslimane, që në kohën e sundimit osman vendoste sipas sheriadit për punë dhe ligje fetare**"**(Diz.f.468)

kaur~i: *Ti **kauri** Venedikut,/ Ç'ke, që s'vjen mbë iman/Dylber, as i fol'ashikut,/Qeder mos i ban.* (F.104), " i pabesë, i pafe, pagan, jo mysliman në disa vise" (Diz:523).
kaza~ja: *Ky Ali-Arapi mblodh gjithë **kazanë*** (f.198), "Rreth, distrikt në administratën turke, krahinë" (Diz:527).
kësëm: *E i merr **kësëmn** e parë* (f. 78), "ogiç, përçor, qengji vogël"(Diz:536)
kësmet~i: *Vajta te dahet **kësmeti***, (f.78),"fat në martesë, qarim, e shkruar, e thënë"(Diz:540**)**.
kllapodan~i: "*Tegelat me kllapodan.* (f.50), "tel sermi me të cilat qëndisin shputat përsipër, fill i artë që shërben për të qëndisur këmishat e nuseve" (Diz: 541).
koçan~i: *Kush ha lakërën, ha edhe **koçanin***. (f.242), "trupi i disa bimëve kur u shkoqen gjethet e kokrrat si: misër lakra" (Diz:542).
koçi~ja: *U avit hypi n'**koçie***. (f.214), "karrocë e hershme e mbuluar për marrje nusesh" (Diz:543).
kolas~i: *Mos bën të mirë, të mos hysh ndë **kolas***. (f.244), "gradë ushtarake e perandorisë osmane, kapiten" (Diz:547).
kollaj:*Se **kollaj** s'm'mirretë Suli* (f.119), "lehtë, pa mundim"(Diz:119).
kollëxhi~u: *Preu dyzet **kollëxhi***. (f.142), "rojë, gardian dogane" (Diz:548).
konak~u: *Bëj **konak** e shtro shtëpinë*. (f. 51), "vend ku shkojmë natën, ku bujmë" (Diz:531).
kondak~u: *Pa çark, edhe pa kondak* (f.29) "koka e trashë dhe e drunjtë e pushkës, qyta" (Diz:551)
kondis: *Vajte **kondise** te nëna*, (f.160), " zë vend në një shtëpi, përbuhem, ngul" (Diz:552).
kubure~ja: *U ngjit ndër saraj lart,/ I mbet me **kuburre** "fap*" (f.170), "Pushkë brezi e hershme që merrte zjarr me anën e strallit" (Diz:559).
kujunxhi ~a: *Dranjotëtë **kujunxhinj***. (f.23), "zejtar që merret me me shkrimjen dhe punimin e arit dhe të sermit, Tur. kuyumcú" (Dizdari: 560).
kullandris: *Bukurija s'është për fis, po kush di e **kullandris***. (f.244), "me përdoru, me mature, me vu për fije" (Diz:562).
kullë~a: *Zuri kullat e mbëdha.* (f. 124) "shtëpi e lartë 2-3 katëshe e ndërtuar me mur guri, shtëpi e fortë me frëngjija mbrojtje" (Diz:562).
kumbará~ja: *E rreh topi e **kumbaraja***. (f.155), "bombë dore, predhë e hekurt, e rrumbullakët" (Diz:565).
kuran~i: *Muhameti me **kuranë***(f.148) "libri i shenjtë i muslimanëve" (Diz:568).
kurban~i: *Se u lot i ubëfsha **kurban***. (f. 81), "bagëti që theret në kushtim të perendisë"(Diz:568)
kurbet~i: *Mjeri unë ç'jam në **kurbe**t,/Ç'më lypet ashikërija,/Shkon dudija me gojë s'flet,* (f.87), "qerbet, largim nga vendlindja, shtegtim në dhé të huaj, mërgim" (Diz:294).
kuti~a: *Sheqer i kutisë/ke babanë brënda* (f.92) "enë prej druje, kartoni ose metali me kapak" (Diz:572).

lahuri~ja: *Bardhushkat me* ***lahuri***, (f.88), "mbështjellak koke ngjyrash të çilta e me xhufka për nuset, të mbyllta për plakat" (Diz:576).
lalë~a: *Pa të lëshonj lalënë* (f.17) "gur i mirë me ngjyrë të bardhë dhe njolla të zeza"(FGjSh f.258) "në
Shqipërinë e mesme i thërrasin vëllait të madh kështu"(Diz:579).
lanet~i: *Zu prej mjekre një* ***lanet*** (148)"djall, dreq, i mallkuem" (Diz:580).
levend~i:*Vjen ditë, q'i thonë derit* ***levent*** (f.236), "njeri i hollë e i shkathët nga trupi; trim" (Diz:585). Me të njëjtin kuptim Çabej (SE V:220).
lezet~i: *Pa dolle me shume* ***lezet*** (f.96) " shije, andje, oreks " (Diz:586)
llaf~i: *Mustafa Çakalli na e nxori* ***llafnë*** (f.197), "muhabet, bisedë, fjalosje, dokrra, lloqe" (Diz:590).
llagëm~i: *Me taborë, me* ***llagëmë***. (f. 178), "vijë nëntokësore e mbuluar për sipër, që hapet për të kulluar ujërat e ndyrësirat, kanal, gjiriz" (Diz:592); "gropë e gjatë dhe e ngushtë nën dhe a në një shkëmb, që mbushet me lëndë plasëse për shpërthim: hap llagëme" (Fjalor 2006:580).
lugat~i: *burri që rri ndë shtëpi/ është si lugat i zi* (f.26), "vjet. fjalë e rëndomtë në gojë të atyre që ishin të shkollës turke e sidomos të medreseve, fjaluer" (Diz:589). "Figurë e besimeve popullore, e përfytyruar si njeri, i cili në gjallje të tij është shumë i keq dhe pas vdekjes ngrihet natën nga varri e tremb njerëzit; njeri shumë i shëmtuar, shumë i keq" (Fjalor 2006:569).
magruri: *Mos u bën kaqe* ***magruri***, (f.119), "mendjemadh, që e mban veten me të lartë" (Diz:602).
mahmudi~ja: ***Mahmudije*** *të të sjell* (f.93), "monedhë e hollë ari, stoli për gra e dalë në kohën e Sulltan Mahmutit II, mbret i Tanzimatit" (Diz:603).
mahmur: *Ej! Zot-ynë'ë e baftë* ***mahmur***. (f.103), "i porsa ngritur prej gjumit, që s`i ka dalë akoma gjumi dhe është i rëndë në kokë (ndajf.)" (Diz:294).
manastir~i: *Ku është* ***manastiri****?Pa kallogjerë sa të duash*. (f.235), "një prej katër vilajeteve të Shqipërisë etnike në kohën e sundimit osman" (Diz:614).
maras~i: *Më mbeti* ***maras****, më mbeti*, (f.88), "inat, mllef, duf, smirë, urrejtje"(Diz:617).
mashallah: *Me dy çifte* ***mashallah***. (f.197), "e faltë zoti, e rujtë zoti (psthm.)" (Diz:622).
mashë~a: *Burri s'ugënyeke,/Po* ***masha*** *u thyeke* (f. 19), " vegël hekuri me dy krahë që përdoret për të kapë thëngjijtë e ndezun ose kur përpushin zjarmin, biglë, shkullore (Dizdari:622).
mashë~a: *Kush ka* ***mashën*** *nuk' djek dorën.* (f.235), (fig) "thuhet për një njeri, që bëhet vegël e tjetrit, e përdor si të dojë" (Diz:622).
maskari~ja: *Si me* ***maskari*** *e zuna,/E u bash ashik mbë ty,/ Mjeri unë se ç'bela vuna*, (f.102), "shaka, jereni, mahi" (Diz:620).
mavija: *N'dasht të kuqe, n'dasht t'****mavija***. (f.106), "ngjyrë e kaltër, bojqielli, blu" (Diz:626).

maxhar~i: *Këndon qyqeja m'dy, tre lisa,/Tre* **maxharë** *ç'i kësdisa,/Dot muranë s'e bitisa.* (f.84), "popull fisnik i njohur me emrin ungar, një degë e familjes uralë-altaike" (Diz:626).
medet: *O shokë,* ***medet****, medet!* (f.148), "1. ndihem, nevojë, hall, 2. psthm. ofshe, vajtim" (Diz:632).
mehal~i/mëhall~a: *Dalëke dhëndëri sanxhak,/Për të prishurë një fshat,/Jo një fshat po një* ***mëhallë***, (f. 5), "trualli a vendi më i përshtatshëm për të ngritur një ndërtesë" (Diz:633).
mejdan~i: *Nd' atë shesh, nd' atë* ***mejdan****/Dalëke dhëndëri Ajan*. (f.50), "shesh luftimi"(Diz:635).
mejhane~ja: *Preu nizamin te* ***mehana***. (f.211), "lokal ku shiten pije alkolike me mezera, pijetore" (Diz:636).
meqan~i: *Së largu kam* ***meqanë***. (f.32), "vendi ku kam zakon të rri, vendqëndrim, ndeje" (Diz:641).
merahmet: *Shani jyt bën* ***merahmet***. (f.218), "njomësi shpirti për fatkeqët e të varfërit, mëshirë, dhembshuri" (Diz:645).
merak ~u: *Në shtëpofsha prej* ***merrakut*** (f.102) " dëshirë për të marrë vesh rreth një njeriu, ngjarjeje" (Diz:642)
merhaba~ja: *E besova qeratanë****,*** */ Sepse më dha* ***merhabanë*** (f.161), "përshëndetje e zakonshme, kudo që u drejtohet miqëve të njohur e dashamirëve në çdo kohë të ditës me të njëjtin kupt. si në turqisht, *mirë se qofsh i ardhun*" (Diz:644).
mervan: *Tyrqit ca njerëz* ***mervanë*** **(**f. 170), "vjet. njeri i poshtër, i dobët (mb.)" (Diz:647).
mexhelis~zi: *O ju shok'e* ***mexhelis****,/mbani vesh t'u mollois/Se mbreti dolli myflis*. (f.171), "mbledhje që bëjnë një grup njerëzish, sidomos kur janë të veshur me cilësi autoriteti për të vendosur çështje me rëndësi të interesit të përbashkët, këshillë, kuvend, asamble"(Diz:652).
mezil: *Të m'apë* ***mezil****-dorinë* (f.213), "nxitim, ngutësi, e vështirë" (Diz:655).
mirjallaj~i: *Isuf-be, o* ***mirjallaj,****/Se ç't'u duk aqë kollaj*. (f.201), "usht. në kohë të sundimit osman, officer i lartë, që komandonte një regjiment, kolonel " (Diz:661).
misër~i: *Të bënetë* **misërija***,/Që të hanë turqërija*. (f.39), "bima me emrin kallamoq në veri"(Diz. 663). Emër përmbledhës me prapashtesën -i.
moskovoliç: *Të dalç t'a potiç,/Të* ***moskovoliç***. (f.193), "Rusia, populli rus në folklore dhe gjuhën popullore deri para dyzet vjetësh, është formim prapashtesor, ku janë bashkëngjitur dy prapashtesat ~ol dhe ~iç " (Diz:666).
muhabet~i: *Do t'a shtojmë* ***muhabenë.*** (f.86), "bisedë për të kaluar kohën, kuvend, miqësi, afeksion" (Diz:668).
muhaseré~ja: *Nëntë dit'* ***muhasere***, (f.151), "përqarkim, qarkim, rrethekim" (Diz:670).
munafak~u: *Mos më qaj, o i mjeri ashik,/Se me ty dot' shkoj beharë,/Se të shumit jan'****munafak***, (f.103), "intrigant, të pabesë" (Diz:685).

mutaf: *Kali i mirë vjihet ndënë* ***mutaf*** *të lik*. (f. 233), "mbulesë kali e punuar me lesh dhie" (Diz:678).
myflis: *O ju shok'e mexhelis,/mbani vesh t'u mollois/Se mbreti dolli* ***myflis*****.** (f.171), "dal në rrugë të madhe,
falimentoj" (Diz:680).
mylazim~i: ***Mylazimi*** *ban divan* (f.105), "gradë ushtarake" (Diz:684).
mymqyn: *Mos e fshih, se s'ësht' as* ***mymqyn,/****Po le të marrë mejdanë*, (f. 87), "mundësi, gjasë, ramje" (Diz:685).
myshavere~ja: *I gjet ndë* ***myshaveret*** **(**f.140), *E bëmë* ***myshaverenë*** (f.186), "vjet. shkëmbim mendimesh, këshillim, bashkëfjalim" (Diz:690).
nadan~e: *Hasuf-pashën një* ***nadan,/****Ka zënë zallëm deli,/Me* ***meshrept****' Abu-Sofjanit*. (f.218), "mospërfillës, njëri që si shef kush hajrin, hundpërpjetë (mb.)" (Diz:695).
nam~i: *Më mirë t'i dalë syri, sesa* ***nami*** *i lik*.(f.239), "emër i madh, famë, za " (Diz:699).
nebet: "tur. nebat f. "*Është si sheqer* **nebet** (f.29), "vjet. sheqer i zi me frute të ndryshme dhe mandaj i kristalizuar, Turk. Nebat-sekeri" (Diz:708).
neqez~it: *Gjën'e* **neqezit** *e gëzon xhymerti.* (f.233), "dorështrënguar, koprac, i shtrenjtë (mb.)" (Diz:711).
nerenxë~a: *Rënëke* ***nerënxha*** *ndë det*, (f.91), "një lloj portokalli me fruta të idhta" (Diz:712).
nijet~i: *Që na mbarove nijetnë*(f.87), "caktim, qëllim, mendim, synim" (Diz:715).
nishan~i*: Pisqollat e jataganë,/***nishan** *që ke mbë ballë* (f.50), *Dy* ***nishane*** *t'i la lija* (f. 106), "Shenjë në trup; shenjë në të gjuajtur, synim" (Diz: 716).
niza~ja: *Një të enjëte nga qindija,/Ndë misir u zu* ***nizaja***. (f.133), "konflikt, zënkë, gjakësi" (Diz:718).
nizam~ë: *Zylyftar mustaqe-verdhë,/përit* ***nizamët****, se t'u derdhë*. (f.155), *Atje ç'e zunë* ***nizanë*** (f.134), *Këti i thonë usull* ***nizami***. (f.159), "ushtar i rregullt i ushtrisë osmane; rend, rregull" (Diz:718).
nur~i: *Thirri Beqir –Xhagajdhuri/More Qendro-Nikë-****nuri*** (118), "ndriçim, shkëlqim, dritë, hijeshi, dukë" (Diz:722).
odë~a: *Më shtriu në mes të* ***hodësë,*** (f.56), "dhomë e ndarë, kthinë" (Diz:725).
okë~a: *Pa na qit nga nj* ***okë*** *verë*(f.26), "masë peshe 400 derhem (1408 gr)" (Diz:728).
ordhi~ja: *Ku e shtjemë* ***ordhinë***, (f.81), "ushtri, armatë" (Diz:730).
ordhi~ja: *Zu e pson talim* ***ordhinë*** (f.124), "ushtri barbare, bandë, turmë mizore" (Diz:730).
orgjyn~i: *Ingjilizi* ***orgjyn*** *detit* (f.211), "një lloj peshku i madh, që i thuhet edhe më i bëshmi i stavritëve" (Diz:730).
osmalli~u*: Të pabesin* ***osmallinë***. (f.126), "emërtim për turqit e Azisë së Vogël" (Diz:734).
oxhak~u: *Më turpëruan* ***hoxhaknë*** (f.138), "vendi ku shkon ndizet zjarri e shkon tymi për të dalë jashtë"(Diz:138).

Padishah~i: *Si lëfton me* ***Padishah*****, (**f.138), "perandor, monark, Sovran, titull për sulltanët e Turqisë" (Diz:739).
paftë~a:*Më theve* ***paftat*** *e brezit.* (f.88), "pllakë, petë metali" (Diz:740).
palla: *Lëfton* ***palla*** *e stërralli*. (f.145), "shpatë, kopani me të cilin rrahen lëvoret" (Diz:744).
palla-gjërë: *Shqypëtar', o* ***palla-gjërë****!* (f.178), "një kompozitë e formuar nga emri pallë dhe mbiemri i/e gjerë, e gjitha kjo një komp. mbiemërore – tregon cilësi" (Diz:744).
pare~ja: *Aqe* ***pare*** *mbë një muaj*. (f.37), "copa të vogla prej metali ose karte të prera prej shteti, që shërbejnë në shitje e blerje"(Diz. 748).
pasha-llarë: *Kur më merr dyfkn' e larë/ Si vezir mbi* ***pashallarë*** (f.50), **"**Dignitar në perandorinë osmane, ofiqe të larta komanduese në ushtri, në administratë, titull për sundimtarët e vilajeteve" (Diz. 752).
pazar~i: *E ç'do ulku ndë* ***pazar***? (f. 236), "tur. pazár, trafik tregtije, tregtim. Pjesa e qytetit ku blihet e shitet" (Dizdari:755).
penxhere~ja: *Penxhere mbë* ***penxhere*** **(**f.152), "dritare" (Diz:761).
perçe~ja: *M'bë atë* ***perçe*** *fije, fije* (f.82) , "një tufë flokësh të gjatë e në trajta të ndryshme, që linin burrat në majë të kokës, përgjithësisht në Shqipëri dhe që vareshin prapa kokës krife, çirok" (Diz:762).
perç-sërmalijtë: *Ato* ***perç-sërmalijtë***, (f.224), "në toskërisht ka dhënë fjalëformim me përbërje të emrit *perçe* me emrin tjetër *sërmali* i formuar me prapashtesim nga emri *sërma* me prap. ~li të turqishtes shumë produktive në shqipe" (Diz:762).
perde~ja: *Më je mbyllur ndë* ***perde****.* (f.71), "pëlhurë që varet përpara dritares a derës për të ndaluar të parit ose për të mos hyrë drita, kultrinë" (Diz:764).
pusht~i: *Tutje, tutje,* ***pusht*** *!* (f.194), "djalosh i prishur, i dalur dore, i pandershëm, i paturp, kulim" (Diz:781).
qafir~i: *Zër' e* ***qafirë*** *si mi*, (f.146), "mohues, i pabesë, i pafe, renegat, mosmirënjohës, armik i atdheut" (Diz:782).
qeder~e: *Më ranë* ***qedere***, (f.100), "tosk. gajle, shqetësim" (Diz:786).
qeder~i: *Kush m'a vu mua* ***qederë****? Një karafil' e kanellë* (f.72), "dam, prishje, humbje në tregti, në punë, sin. me zarar" (Diz:786).
qemenxhe~ja: *Sjell bozuk' e* ***qemenxhetë*** (f.156), "muz. qemane e vogël me tri tela, violinë e vogël" (Diz:794).
qepall~a: *Moj* ***qepalla*** *hillall* (f. 48), "qerpikët e syrit" (Diz:797).
qerata~i: *Or i biri* ***qeratajt****.* (f.191), "i prapë, djalli vetë, dinak, dhelpër, njeri i gjallë" (Diz:802).
qerem: *Bëri zot-ynë* ***qerem*** (f.34), "mirësi, bujari, zemër e bardhë" (Diz:799).
qilar~i: *Më afërë dera, se* ***qilari***. (f.233), "njëfarë ndarjeje brenda në shtëpi afër gjelltores, ku ruhen gjërat e ushqimit, qyer, mblozë" (Diz:807).
qitab~i: *Hafus-pasha fort allçak,/Pa meshtref, e pa* ***qitab****/ Hafus-pasha, si iblizi****,/*** *E vrau zoti, edhe* ***qitabi****.* (f.219), "libër i shkruar ose i shtypur, i rradhitur brenda një kopertine posaçërisht për kuranin" (Diz:811).

qor-pashë~a: *Thuej **qor-pashës** dalë, ka dalë*.(f. 212), kjo kompozitë është formuar nga emri qorr, "i verbër, pa dritën e syve" (Diz:812).
qyrk~u: *Nj'ay, që ka **qyrkun** me ar* (f.222), "veshje dimri e veshur përbrenda me gëzof lëkure të disa egërsinave si:dhelpër, shqarr, si edhe qingjit kondosh" (Diz:822).
raja~j: *Një plak ndë Sul, e ngriti **rajanë***. (f.139), "kjo fjalë gjatë shekujsh ka marrë kuptime të ndryshme në lidhje me kohën, me gjendjen, me veçantitë e krahinave e të popullatës, këtu me kuptimin e bujkut, katundari që posedon dhe punon tokën dhe prej saj paguan vet haraçin dhe gjithë taksat dhe detyrimet që duhet të paguajnë pronarët e çifligjeve" (Diz:828).
reshper~i: *Edhe qepur' ndë **reshperë**.* (f.175), "kryemjeshtër ose ustabash në ndërtime" (Diz:840).
rixha~ja: *Të madhe ju bëni **rixhanë*** (f.112), "lutje, uratë" (Diz:842).
rixhal~i: *Njëmij'e treqind **rixhalë***(f.140), "në Malësi të Gjakovës, punëtor me vetëdashje e pa shpërblim, që ndihmojnë reciprokisht shokun në fshat në punimet bujqësore" (Diz:842).
rrixhal~et: *Rrin' **rrixhalet** e Stamollit,/ Ç'i xhilhen faqeja dylberit*, (f.103), "vjet. parësi, krerët e vendit, këshilltar, burrë shteti, njerëz të shquar" (Diz:843).
rubi~ja: *Të mbush ballën me **rubie**,/Bija ime* (f.91), "vjet. e katërta e një monedhe ari të qëmotshme në Perandorinë Osmane" (Diz:844).
sabah~i: *Ra dielli mbë **sabah**,/Zuri kullat e mbëdha*. (f.124), "të zbardhurit e dritës, mëngjes" (Diz:852).
sadrazem~i: *Thanë, doli **sadrazemi*** **(**f.155), ***Sadrazemn'** e zu si minë*.(f.191), "hist. kryetar qeverie, kryeministër në Perandorinë Osmane" (Diz:856).
sahat~i: *Dy plumba n'fun t'silahit,/Një në bark, nj'anës* **sahatit**. (f.226), "njësi kohe e barabartë me një orë, sahat xhepi, muri" (Diz.858).
sakaz~i: ***Sakazin** e grabëtisi, urumi s'ishte frikue* (f.217), "ai që servis verën me gota, verëgostitës (sakaxhi)" (Diz:864).
salltane: *Jam lule për **salltanet.*** **(**f. 105), "madhështi në të veshur, në të mbajtun të shtëpisë" (Diz:871).
samar~i: *S'ka seç' t'i bënjë gomarit, i bje* **samarit***.* (f.236), "i bije në fije atij që se meriton, i a kallëzon qejfin" (Diz:871).
samur~i: *Shtro shiltenë me samure* (f.96) "një farë gëzofi" (Diz:872).
sanxhak~u: *Dalëke dhëndëri **sanxhak**,/Për të prishurë një fshat,/Jo një fshat po një mëhallë* (f. 51), "në periudhën e hershme të pushtimit, osman i një guvernatorate, në kohët e vona të atij sundimi ndarje administrative ndërmjet një vilajeti me një mutesarif në krye" (Diz:875)
saraj~i: *Ndë **saraj** do vdesim o*! (f.220), "pallat mbretëror ne Lindje dhe i sulltanëve në Turqi" (Diz:878).
sedef~i: *Dyfeknë gjithë **sedefe*** (f.59), "shtresa e brendshme dhe e ndritshme e guackave të detit, që përdoren për pulla (kopsa) për zbukurimin e qytës së pushkës dhe sende stolije" (Diz:885).

sefer~i: *Krushqit për **sefer** i nxore*. (f.192), *Gati **seferin** cile* (f.211), *I ati pa lerë, i biri morri* **seferin? (**f.251) "udhëtim, shtegtim, lundrim nëpër det" (Diz:887).
sehir~i: *Se ç'më ngriti nga **sehiri***. (f.72), "veprim i të shikuemit për kureshtje ose për kënaqësi, kalim kohe, argëtim" (Diz:889).
sejran: *Ndë mejdis vetullat bana* **sejran** (f.102), "pamje e bukur soditëse" (Diz:892).
selam: *Një **selam** Smail-Kastratit*, (f.226), "përshëndetje, ngjatjeta, të fala, falmeshëndet, përshëndetje fetare. (Diz.893).
selamet~i: *Se un e gjeç **selametnë*** (f.87), "vjet. shpëtim, përfundim i mirë, shëlbesë, lumturi" (Diz:894).
sene~ja: *Një mij' e dyqind **senenë*** (f.117), "viti dymbëdhjetë muajsh, motmot" (Diz:897).
sepete: *Ndë **sepete** t'i kyça*, (f.77), "1. mobilje sa një gjysmë arke, paje e goditun prej dërrasash nganjëherë e veshur me llastër, që vlen për të shti plaçka, 2. arka e nuses e punuar me mjeshtëri" (Diz:897).
sërasqer~i: *Nëmë paç, o **sërasqer**,/Që na shpure ndë sefer*. (f.34), "kryeushtarak" (Diz:40).
serhat: *Ashiku i mjerë ndë **serhat**/ Sa u zu mashkull' i mjerë*. (f.80), "Vise të largëta" (Diz:901).
serhate: *O moj ti kulla **serhate***, (f.138), " vjet. me kupt. "kufizore" (Diz:901).
sermá~ja: *Gjithë larë me* **sërma***.* (f.50), "fill i artë, i argjentë për të qëndisur"(Diz. 906).
sevda~ja: *Të shpëtoj nga **sevdaja***. (f.104), "dashuri, merak, mallëngjim, dëshirë, pasion" (Diz:904).
sexhadë~ja: *Shtro na **sexhadënë** përanë trandafilit*.(f.88), "shtroje dimensionesh të ndryshme me push, me gjithfarë ngjyrash, vijëzimesh e lajlesh, që shtrohet në minderë, në faqe muri, në faltore " (Diz:905).
shah~i: *Moj zonjë, **shah** zonjënë*(f.33), "mbretërina në Lindje të Mesme e Afrikë Veriore, dukata, krajlni" (Diz:940).
shahin~i: *Goditi Marko **shahinë**.* (f.145), *Bir! O **Shahin** be Klisura,* (f.175), "zool. Skifter, fajkua, me kuptim metaforik këtu për të cilësuar trimërinë, burrërinë; emër vetjak" (Diz:942).
shahit~i: *Në ballët ke një mishan,/Kam **shahit** e t'a baj ispat,/Të dy syt,/ore xhanam,/ fukaran bane azat.* (f.103), "ai që dëshmon në gjyq, ai që mund të thotë diçka për një punë a për një ngjarje të asistume, dëshmitar, dëshmues" (Diz:942).
shallvaregjanë: *More halldup, **shallvaregjanë**,/Çaushollin qajn me lot* (f.209), "komp. e formuar nga emri me prejardhje turke dhe perse *shallvar*~e dhe mbiemri (gjanë) të gjerë, emri shallvare d.m.th pantallona të gjana prej cope pëlhure, që janë veshur para 50 vjetësh nëpër qytet sidomos, *poture, gaqe, bollgë*" (Diz:946).
shami~a: *S'kam para të blej* **shami** (f. 65), "një copë pëlhurë katërkëndëshe, që përdoret për të lidhë kokën ose qafën, ose për të fshirë hundët" (Diz:948).
shandan~i: *Më sjell beden me **shandan*** (f.93),"përdorëse prej tunxhi ku ngulen qirij të ndezur" (Diz:949)

sharapoll~i: *Hapni **sharapollë**, mbyllni penxherenë* (f.197), "një pjesë e dalur në qoshen e faqes së shtëpisë a të kalasë e ndërtuar me gurë të latuar dhe e pajisur me frëngji, që shërben për mbrojtje" (Diz:951).
shastis: ***Shastisem**, e s'di se ku jam.* (f.86), "habitem, hutohem, humb fijen, mrekullohem" (Diz:953).
shebojë~a: *Xhixhiëllon xhixha ndër male/rrah **sheboja*** (f.68), "bimë nga familja Kruciferre, me lule tufa-tufa në ngjyrë të verdhë, të kuqe, të bardha" (Diz:955)
sheheristan~i: *Me dylberat që jan'meshur,/ Vërtet qënëka një **sheheristan**.* (f.103), "qendër qeveritare, tregtie, trafiku" (Diz:958).
shehit~i: *Ja **shehit** e ja **gaza**.* (f.158), "ai që jep jetën për një qëllim të shtrenjtë, ai që bie në fushën e nderit, martir" (Diz:958).
shejtan~i: *Një **shejtan**, një qen i zi* (f.142), "sipas besimit fetar, qënie që nuk i është shtruar urdhërit të perëndisë" (Diz:959).
sherjat~i: *T'a keshë lënë ndë **Sherjat*** (f.139), "a.rruga e drejtë, rruga e vërtetë; b. ligje që rregullojnë marrëdhëniet e një kombi që mbështeten në ndalesa hyjnore" (Diz:964).
shilek~u/shileg~u: *Hën' e mir'e allonarit**,/shilege**, beg e çobanit*, (f.71), "qingj, që ka kaluar vitin "(Diz:969).
shilte~ja: *Shtro **shiltenë** me samure* (f.96), "një lloj dysheku i ngushtë, që shtrohet për të ndejtur këmbëkryq" (Diz:970).
shishane~ja: *Ndë mes të beharit, se ç'më plevitose,/vetullat e tua **shishane** në qoshe*. (f.90), *Shpet dërgoni **shishanetë**.* (f.168), "pushkë e moçme e gjatë me namli (me gur e çark)" (Diz:972).
shuhret~i: ***Shureti** m'Shkodrën ashtë* (f.219), "gëzim i madh, gazmend, kalim kohe me andë, me qejf e dyzen"(Diz:976).
silah~i: *Dy plumba n'fun t'**silahit**,/Një në bark, nj'anës sahatit*. (f.226), "takam prej lëkure me dy tre gojofë të mëdhenj e të petëzuar, që ngjeshen në bel, ku viheshin armët e brezit"(Diz:910).
sulltan~i: *Dua **Sulltan** –Sulejmanë* (f.32), "monark, perandor" (Diz:929).
surat~i: *Ç'i paske vënë **suratit***. (f.105), "fytyrë, faqe, çehre" (Diz:930).
tabor~i: *Se të përet **tabor-Maxhari***, (f.105), *Nga **tabor**'*i *shkretë e prunë të vrarë*. (f.197), "përbërje ushtarake turke prej njëmijë vetash nën komandën e një bimbashi" (Diz:981).
taine: *O çaush, tha: ndaje bukën dhe **tainet***. (f.119) "pjesë e caktuar, e peshuar e ushqimit që i nevojitet ushtarit" (Diz:985).
talim: *Zu e pson **talim** ordhinë* (f.124), "marshim, ushtrime në të ecur" (Diz:920).
tapanxhë~a: *Pasha **tapanxhën** e artë, thotë* (f.210), "pushkë brezi, revole" (Diz:996).
tavllë~a~ja: *Të vij te tata mbë **tavllë***.(f.115), "kalë që ushqehet gjithmonë me bukë dhe tagji" (Diz:1004).
tebab~i: *Qi varrove **tebabijtë***.(f.221),"njerëz, që i shkonin prapa një njeriu të rëndësishëm" (Diz:1031).

tegel~i: ***Tegelat*** *me kllapodan.*(f.50),“një e qepur e gjatë me dorë ose me makinë”(Diz:1009).
tehir: *M’ep* ***tehir*** *t’i ulem atit* (f.226), “pritë, kohë e paracaktuar për të kryer një punë, durim” (Diz:1010).
telall~i: *Në Stamboll qërset* ***telali****,/Del e shifni vuxhuflarë* (f. 222), “ai që shet mall në shesh të pazarit për llogari të tjetrit duke bërtitë” (Diz:1013).
tenxhere~ja:*Gjeti* ***tenxherja*** *kapakun.*(f.235),“enë bakri dhe alumini pa rrëfanë” (Diz:1019).
teqe~ja: *Ndë* ***teqe****, moj Melçanake.*(f. 31), “lokal i posaçëm ku falen e luten muhib e dervish” (Diz. 1022).
terëzi~ja: *Dua burrë* ***terëzi*** (f.26), “i mbarë”(Diz:1023)
tërsëllëm: *Kish* ***tërsëllëm*** *me të vërtet* (f.139), “ngut, vrull, rreptësi” (Diz:1035).
testemele: ***Testemeli*** *qesh e lot* (f. 79), “shami xhepi, koke” (Diz:1030).
torbë~a: *Mvari* ***torbënë*** *gomarit*. (f.37), “qese e madhe me gjalmë për t’u varur në sup, **fig**. s’ia var kush”(Diz. 1046).
tumane~të :*Sa të mbath* ***tumanetë*** (f.53) “brekë grash të gjera, që vijnë duke u ngushtur nga këmbët” (Diz:1051)
turkushak~u: *Plot asqere* ***Turkushakë*** (133) “Rilindasit në shkrime me tone përbuzëse për Turqit” (Diz:1056).
urum~esha: *S’kan vevojë për* ***urumesha****,* **(**f.226); “urum~i/orum~i, emërtim për Romën e romakët në Lindjen e Mesme e të afërme” (Diz:732).
urum~i: *Sakazin e grabëtisi,* ***urumi*** *s’ishte frikue* (f.217), “emërtim për Romën dhe romakët në Lindje të Mesme e të afërme” (Diz:732).
vakëf~i/vakuf: *Sulltan Mahmut, banu* ***vakuf*** (f.218), “kish humb qëllimin dhe kish abuzue keqës në kohët e
mbrapme” (Diz:1074).
vatan~i: *O yll* ***vatani****, din e imani*! (f.218), “atdheu, vendi ku kemi lindur” (Diz:1082).
veresije: *Kush pi* ***veresije****, dehetë dy herë*. (f.233),“shitblerje në tregtim në pritje në pagesë” (Diz:1086).
vetull-qemere~ja: *Po për ty,* ***vetull-qemere***. (f.106), “një kompozitë për bukurinë femërore” (Diz:795).
vezir~i: *Kur më merr dyfkn’ e larë/ Si* ***vezir*** *mbi pashallarë*(f.50) **“**Dignitar i madh civil në perandorinë osmane” (Diz: 1087).
vilajet~i: *Ke gjysmën e* ***vilajatit****.* (f.124); *U drithmua* ***vilaeti*** (f.170); *Shtatë* ***vialete*** *janë*.(f.175), *Ky Ali-arapi mblodhi* ***vialetnë*** (f.197), “ndarje administrativë turke, që kish në krye një Vali” (Diz:1089).
vukuf: *U bëj* ***vukuf*** *Sulltan Mahmut* (f.136), “bën çudi, çuditu, mendo thellë, reflekto” (Diz:1092).
xhagajdur~i:*Thirri Beqir –****Xhagajdhuri****/More Qendro-Nikë-nuri (118),* “kopuk, njeri që kërkon sherr*”* (D:1095).
xhami~ja: *Tutje t’u marrin* ***xhaminë*** (f.133), “ndërtesë destinue nga myslimanët për ushtrimin e kultit” (Diz:1098).

xhan~i: *Se mikeja m'a treti* ***xhanë****.* (f.71), "shpirt, jetë, zemër" (Diz:1098).
xhanan/m: *Në ballët ke një nishan,/Kam shahit e t'a baj ispat,/Të dy syt,/ore* **xhanam***,/ fukaran bane azat*. (f.103), "dashurues, mikeshë, e dashur" (Diz:1099).
xhandar~i: *O* **xhandar***, o mëngë çarë,/Më dukij, si ustallarë*.(f.160)"ushtarak i pushtimeve të hershme " (Diz:1100).
xhanllar~i: *Sod, e sod, ore* ***xhanllarë***. (f.174), "njeri i dashur" (Diz:1099).
xhebehane~ja: *Ndë* ***xhephan***' *e ke folenë*. (f.136), *Pa buk'e pa* **xhephane** (f.151), "kullë baroti, depo municionesh të ndryshme për armë" (Diz:1102).
xhefa: *Gjethet i ka si asemini,/Është një lule pa* **xhefa***,/E desh edh'azret Ibrahimi*. (f.82), "të keq, dëm, e metë, tundim, ngatërresë" (Diz:1103).
xhelep~i: ***Xhelepet****, tymjaket o* (f.160), "tatim vjetor, që paguhej për çdo kokë të gjësë së gjallë" (Diz:1105).
xhenet~i: *Shpata jote lule* **xhenetit**.(f.223); *Miku i mirë, der' e* ***xhenetit***. (f.243) "sipas besimit fetar është banesë në jetë të amshueme, parajsë, kupt. fig. vend shumë i bukur" (Diz:1108).
xhep~i: ***Xhepeve*** *të rri sheqeri* (f.74) "strajcë, goja e së cilës qepet në një të hapun të petkut, të veshjes" (Diz:1109).
xhevahir~i: *Cicatë si* ***xhevahirë*** (f.72) "diamant, brilant" (Diz:1112).
xhigerxhi: *Poliçanjotë* ***xhigerxhij****.* (f.23) "mëlqija-shitës" (Dizdari:1118).
xhind~i: ***Xhin****-deve fushavet shkreta,/kalë i bardhë me xhufeta* (f.76), "qënie të padukshme, shtojzovalle" (Diz:1120).
xhuma~ja: *Po sa ish faltur* ***xhumaja*** (f.115)"e premte, ditë e veçantë lutjeve për besimtarët muslimanë" (Diz:1123).
xhymert~i: *Gjën'e neqezit e gëzon* **xhymerti**. (f.233), "dorëdhanë, bujar, shpirtmadh" (Diz:1128).
ylefe~ja: *E t'i epni* ***ylefenë***. (f.134), "pagesa e tagjisë, ushqimit të kuajve" (Diz:1130).
ylema~ja: ***Ylejmaja*** *na ka mësue,/Me qitapët tye këndue.* (f.212),"vjet. dijetar i shquar, në hierarkinë fetare, i laruar në teologji dhe në jurisprudencë, parësi klerikale myslimane" (Diz:1131).
zabit~i: *Po na shkroni arxuhallë,/duam* ***zabitër*** *tanë* (f.169), "qeveritar, përfaqësues i pushtetit ekzekutiv në një vend të caktuar" (Diz:1137).
zahire~ja:*Se do të lëftojmë, vini* ***zahiretë*** (f.198), *Se kemi për dyzet vjet* ***zahire****, kësaj belasë*. (f.140) "sende ushqimore, që përgatiten në verë e ruhen për dimër" (Diz:1140).
zamak~u: *Davanë e ban* ***zamaku*** (f.105),"lule e bardhë me erë të mirë" (Diz:1143).
zanat~i: *Ashtu, si keshe* ***zananë***. (f.182), "mjeshtëria, që ushtron një njeri përditë për të siguruar mjetet e jetesës" (Diz:1144).
zapëtie: *Se të digjesh e ke hak, /* ***Zapëtove*** *tërë dhenë*.(f.136), "veprim i të frenuarit, pushtuarit e të grabiturit" (Diz:1145).
ziafet~i: *Pashaj bëri* ***ziafenë*** (f.168), "vjet. gosti, pasi" (Diz:1157).
zinxhir: *Se ç'i bën* ***zinxhir*** *filxhanit* (f. 32), "varg rrathësh prej metali të lidhur njëri me tjetrin" (Diz: 1159).

zylyftar~i: ***Zylyftar*** *mustaqe-verdhë,/përit nizamët, se t'u derdhë*. (f.155), "një nga dinjitarët më të shquar dhe të afërm në pallatin perandorak, që kishte në dorëzim armët" (Diz:1165).
zymbyl~i:*Mos je* ***zymbyl*** *nd'amberi,/Që rri n'bashtët mbret mbulumun?*(f.103),"bot. Hyarinthys Orientalis". (Diz:1165)

MIMOZA ZEKAJ (GJIROKASTËR)

DISA VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË GJUHËS SË THIMI MITKOS NË POEZITË E TIJ

E gjithë krijimtaria e Thimi Mitkos shquhet për vlera të rëndësishme jo vetëm letrare, folklorike, etnografike, por edhe për vlera të mirëfillta gjuhësore. Edhe ne, në punimin tonë, do të ndalemi në disa dukuri gjuhësore të poezive të Mitkos, të cilat janë krijuar duke thithur vlerat e traditës shkrimore pararendëse, vlerat e shqipes popullore, vlerat e mëdha gjuhësore të bashkëkohësve të tij.

Thimi Mitkoja, me veprimtarinë e tij letrare i përket fillimeve të Rilindjes[327]. Çdo epokë historike, edhe pse gjuha nuk bën pjesë në superstrukturë dhe është dukuri shoqërore e veçantë, lë gjurmët e veta edhe në gjuhë[328]. Mbledhja e letërsisë popullore, sidomos në vitet rreth Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, konsiderohej një punë e shenjtë. Për këtë shkak çdonjëri që dinte të shkruante e të lexonte e shihte të arsyeshme të interesohej për letërsinë që kishte krijuar gjeniu i popullit, kurse çdonjëri që shkruante vargje e shihte të arsyeshme ta njihte sa më mirë letërsinë popullore. Është e kuptueshme, prandaj, pse edhe folkloristët ishin ose poetë me prirje të shquara – si Jeronim de Rada apo Zef Skiroi ose poetë me prirje më modeste si: Zef Jubani, Thimi Mitkoja, Spiro Dineja, e të tjerë[329]. Shumë vargje, ngjarje situata, zgjidhje, modele kuptimore, personazhe dhe trajta në poezitë e tyre janë përsëritje e vargjeve, e ngjarjeve, e situatave, e zgjidhjeve, e modeleve kuptimore, e personazheve dhe e formave të poezisë popullore. Në disa raste të veçanta ata i parafrazojnë vargjet, mendimet dhe situatat e këngëve apo kallëzimeve të ndryshme popullore.[330]

Në shumicën e përdorimeve karakterizimin e kohës, mjediseve, personazheve, autori ynë e ka bërë duke u mbështetur mbi të folmen e Korçës, Kolonjës, Përmetit, (deri me elemente të çamërishtes)[331]. Megjithatë gjuha e poezive të Th. Mitkos nuk do të mbetej vetëm në rrethin e ngushtë dialektor. Shpesh ligjërimi i tij poetik doli jashtë kornizave të ngushta krahinore dhe u pasurua me shumë fjalë, trajta e konstrukte gjithëkombëtare. Ndaj, trajtimin e veçorive më tipike gjuhësore të krijimtarisë poetike të tij e kemi bërë duke u mbështetur te këta faktorë që kanë ndikuar në formimin e këtij krijuesi.

Gjuha shqipe, duke qenë një gjuhë e shkruar dhe e lëvruar relativisht vonë, në drejtshkrimin e saj zuri vend parimi fonetik, pra pasqyrimi i shqiptimit të fjalëve dhe i trajtëformave të tyre. Ky parim, i plotësuar në disa raste edhe nga parimi

---

[327]. Bulo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës,* Tiranë, 1988, f. 206.
[328] Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 39.
[329] R. Qosja, *Panteoni i rralluar*, Tiranë, 1988, f. 350.
[330] *Po aty*, f. 361.
[331] Q. Haxhihasani, *Thimi Mitko*, *vepra*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Kulturës popullore, Tiranë, 1981, f. 52.

morfologjik, ka për bazë dhe shpie më tej traditën e shkrimit të gjuhës sonë, e cila u shestua nga rilindësit tanë të mëdhenj[332] në mes të të cilëve zë një vend të rëndësishëm edhe poeti ynë. Do ta fillojmë me disa anë të rëndësishme të drejtshkrimit në poezitë e Th. Mitkos, të cilat pasqyrojnë vazhdimësinë e traditës së krijuar dhe në të njëjtën kohë përcaktojnë dhe individualitetin krijues të këtij rilindasi.

Në përdorimin e apostrofit, Mitkoja vazhdoi traditën shkrimore të letrarishtes jugore, duke pasqyruar me besnikëri një veçori shqiptimore të këtij dialekti. Apostrofohet rregullisht ***ë-ja*** fundore e patheksuar para zanores ***e,*** si: *zonj' Elenë* (T.576), *er' e Përmetit* (E.577), *dit' e zezë* (B.580), *fjal' e besëtarit* (V.596), *mëm' e lëvduar* (N.588), *blet' e shkretë* (N.588), *nom' i urtësisë, bijt' e Toskërisë* (M.600) etj. Përdorimi i tillë i apostrofit në poezitë e tij ka raste që është i detyruar nga nevojat e metrit. Megjithatë, duke pasur parasysh krijimet e bashkëkohësve të Mitkos, vërë re se elidimi i zanoreve të patheksuara më qëllim që të ruhet njësia e trajtave në të gjitha përdorimet e tyre, është gjerësisht e përdorur. Në të njëjtën kohë, përdorimi i gjerë i apostrofit tregon ndikimin e madh nga gjuha e folur.

Ndryshe nga disa autorë të Rilindjes, autori ynë parapëlqen shkrimin pa ***–j***, në shumicën e rasteve, tek emrat femërorë që mbarojnë me ***–i*** të theksuar në emërore të shquar dhe në gjinore-dhanore të pashquar njëjës: *perëndia, Vllahia, urtësia, vegjëlia, trimëria, dipllomatia.* Por kemi gjetur edhe pak forma me ***–j***: *zija, varfërija* (K.582). Kjo mënyrë shkrimi me ***–j*** është përdorur më dendur në Rilindje, si nga shkrimtarët e Jugut, ashtu edhe nga shkrimtarët e Veriut.

Në disa përdorime të veçanta, si disa nga bashkëkohësit e tij, nuk i është përmbajtur parimit fonetik, duke shkruar ***ë-***në fundore në fjalët proparoksitone, si: *vendinë, grendjatë, luftëratë, gluhënë, burratë, plagënë, zakonitë* etj. Këto trajta janë të përdorura thuajse në të gjitha poezitë e tij.

Një tipar tjetër fonetik, karakteristik, që vihet re në krijimet e tij, është pasqyrimi me shkrim i shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: *katërqint* (J. 579), *i math, i barth* (T.592), *u tremp, plump* (P.602), *tunt, djek* (B.580), *lak* (J.579) etj. Në disa përdorime vërë re sonorizimin e bashkëtingëlloreve të shurdhëta, të ndodhura pranë bashkëtingëlloreve të zëshme, si: *zboni*, por edhe *sboni* (E.575); *sbathur* (E. 575), por edhe *zbathur*.

Duke parë disa tipare fonetike të gjuhës së këtij autori, vërë re disa lëkundje te zgjedhja midis fonemës ***e*** dhe ***ë*** në fjalët që ndiqen nga një sonante hundore, si: *dhentë* (E.575), *zemër* (T.576), *vendinë* (E.577), *zembrëpërvëluar* (P.601), por edhe përdorime, si: *mënd e shpirt* (E.577), *vënditë Shqipërisë* (M.584), *ki vënd* (K.585), *brënda* (B.580), *një vënd mëndarësh* (T.589) etj.

Një tipar fonetik që është mjaft i shpeshtë në folklorin e Jugut është asimilimi i disa trajtave. Ky tipar ndihet dendur edhe në të folmet jugore. Në të njëjtën kohë, gjeti pasqyrim edhe te disa autorë të Rilindjes, të cilët, veprat e tyre i shkruan mbi

[332] Gj. Shkurtaj, *po aty,* f.51.

bazën e këtij dialekti. Në poezitë e tij kemi gjetur: *mbenë, muarrë, vanë, shini, vetë desh, kshtu, mretër, ktë, ejni* etj.

Në poezitë e Mitkos vihen re edhe disa trajta fjalësh me tipare fonetike dialektore të izoluara, të cilat në krijimtarinë e autorëve të tjerë të Rilindjes, por më të vonshëm, shmangen thuajse fare. Të tilla janë: përemrin dëftor ***ai*** e shkruan thuajse gjithmonë *ay*, si: *ay që vrau*. Me këtë trajtë e kemi gjetur edhe te bashkëkohës të autorit. Në pak përdorime në poezitë e tij e kemi gjetur edhe ***ai***, si: *ai çau krietë sulltanit; po si vdiq ai njeri* (E.575). Pjesëzën ***duke*** të përcjellores e shkruan gjithnjë *tuke*: *tuke thënë, tuke pritur, tuke përjetuarë*. Një tipar tjetër fonetik, të cilin e kemi ndeshur në një rast të vetëm, është shkrimi i një fjale me bashkëtingëlloren ***f,*** që duhej të shkruhej me bashkëtingëlloren ***th***: *Mos sprit nga mua të tëfella, as të tjera çerimonja* (T.576). Përemrin vetvetor *veten, vetes*, e shkruan në shumicën e rasteve me ***h:*** *gjall' e vethen' e dinë, që bashkoj shkjet' me vehte*. Në një rast e kemi ndeshur edhe me trajtën *vetë*: *duhet ne ta gjejmë vetë* (M. 598).

Në poezinë e tij "*Mbë shqyptarët*", kemi vërejtur shkrimin e dy fjalëve të huaja, kryesisht me prejardhje riolatine, me ***ll*** në vend të ***l***. Këtë tipar e kemi vënë re edhe te autorë të tjerë të Rilindjes, si: *sa ju vëjen dipllomatia* (M. 594). Në një poezi të mëvonshme këtë emër e kemi ndeshur edhe me trajtën diplomatia: *shini ju ato diplomatë* (M.583).

Te disa autorë të Rilindjes, ashtu si edhe në të folme të ndryshme të shqipes, përdorimi i fonemës ***/rr/*** dhe ***/r/,*** paraqitet i pastabilizuar. Te autori ynë në shumicën e përdorimeve na dalin pak lëkundje, po të kemi parasysh edhe karakteristikat e të folmes së vendlindjes së tij, Korçës. Prej të folmeve të toskërishtes veçohen dhe formojnë një areal të veçantë e folmja e Beratit me atë të rrethinave dhe të folmet e Korçës e të Devollit, të cilat kanë dy fonema më pak. Aty kanë dalë fare nga sistemi bashkëtingëllorja faringale ***h*** dhe bashkëtingëllorja dridhëse e fortë ***rr***[333]. Duke u nisur nga rastet e përdorimit, kemi vënë re se shumë herë këto dy fonema janë përdorur në mënyrë korrekte, si: *burrë, kurrë, merri, zjarre, thërres, rrëmbenjënë*. Në pak raste kemi gjetur edhe lëkundje: *ëndër, ritur, rëfejm*.

Në poezi të ndryshme kemi vërejtur edhe përdorimin e grupeve të vjetra të bashkëtingëlloreve ***kl*** e ***gl,*** si: *e kluheni shqipëtarë; shkruani gluhën e këndoni; Shqipëri mëm' e klajtur; klan e klan ka marrë vajnë; u kloftë falur, jo hua* (N.588); *më flasën gluhra të huaj, klanjën çupat e Gucinjës* (T.592) etj. Sipas prof. Çabejt, grupet ***kl e gl*** gjatë periodës letrare të shqipes janë rrudhur shumë në përdorimin e tyre. Format origjinale ruhen vetëm në skajin më jugor në Çamëri, në Muzinë, në tri të folmet marginale të toskërishtes lindore: Dardha, Sinica e qyteza afër Korçës, pastaj në dialektet e Greqisë, pjesërisht të Italisë e të Ukrahinës, të shkëputura qëmoti nga

[333] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 196.

trungu i gjuhës[334]. Në pak raste kemi ndeshur edhe fonemën ***/l/*** të përdorur në vend të fonemës ***/j/,*** si: *një fëmilë të pandarë; këta jan' fëmil bujarësh* (N.588). Por në një përdorim e kemi gjetur edhe në formën ***fëmijë****; një fëmijë të pandarë* (M.597). Edhe për këtë fonemë prof. Çabej është shprehur se vetëm në disa dialekte anësore ose të shkulura që me kohë: në toskërishten jugore, në kolonitë shqiptare të Greqisë e të Italisë si dhe në ato të Ukrahinës u ka ruajtur një ***l*** me një shqiptim ku më shumë e ku më pak palatal[335].

Th. Mitkoja, ashtu si edhe rilindësit e tjerë, me krijimtarinë e tyre synonin t'i shërbenin popullit të thjeshtë, ndaj dhe një pjesë e gjerë e krijimtarisë së tyre, qoftë nga gjuha e përdorur, qoftë nga struktura e ndërtimi, janë shumë të afërta apo të njëjta me krijimet popullore. Nëpër gazetat dhe revistat shqipe të kësaj kohe mund të gjenden mjaft vjersha prej të cilave shihet se autorët e tyre në mënyra të ndryshme e përsërisin poezinë e popullit duke marrë prej saj si prej kopshtit të babait[336]. Kjo vihet re edhe në trajtat morfologjike në poezitë e Mitkos, të cilat janë të thjeshta, të mbështetura tërësisht në modelet popullore apo të ndikuara nga modelet e bashkëkohësve të tij.

Në ndërtimin dhe përdorimin e formave rasore, në poezitë e Mitkos vihet re përdorimi i rrallë i fundores ***–t*** të gjinore dhanores së shquar shumës dhe rrjedhore të shquar shumës. Emrat e gjinisë mashkullore në numrin njëjës e formojnë rasën kallëzore, duke u shtuar mbaresa rasore ***–në*** drejtpërsëdrejti temave emërore, pa nyjet ***i*** ose ***u***: *trupnë, halldupnë* (E.575), *mundimnë* (T.578). Në letërsinë popullore të Jugut dhe te rilindasit jugorë, shfaqen dendur format e kallëzores së shquar me asimilim. Kjo dukuri del e përdorur edhe në disa poezi të Mitkos, si: *muarrnë mal* (E.575); *do mënd* (T.578); *ndëpër bujqt* (O.593); *të bëni vatan* (M.594) etj. Në pak raste kemi ndeshur edhe përdorimin e së ashtuquajturës rasë vendore: *ndë gjakt, ndë eshtrat, ndë shtëpiat.*

Te poezitë kemi gjetur pak tema shumësi me ***–e*** për emrat e gjinisë mashkullore, të cilat tregojnë mbështetjen në ligjërimin popullor, ashtu si autorë të tjerë jugorë, si: *dy trupe një shpyrti dhënë* (B.580). Në formimin e temës së shumësit të emrave femërorë, në një rast të vetëm kemi gjetur prapashtesën ***–ra***: *më flasën gluhra të huaj* (N.588). Kjo prapashtesë është përdorur gjerësisht nga autorë të tjerë të jugorë, pararendës apo bashkëkohës të autorit.

Ndonjë tipar i veçantë vihet re edhe në përdorimin e trajtës së shquar e të pashquar të emrit. Kur emri përdoret në rasën kallëzore i paraprirë nga parafjalë të ndryshme, edhe në ato raste që ai është kuptimisht i caktuar, duhet të përdoret në trajtën e pashquar. Në disa raste e kemi gjetur emrin të përdorur në trajtën e

[334] E. Çabej, "*Për historinë e konsonatizmit në gjuhën shqipe*", në BUSH, SSHSH, 1, 1958, f. 51.
[335] E. Çabej, *po aty*, f.48.
[336] R. Qosja, *Panteoni i rralluar*, Tiranë, 1988, f. 361.

shquar, si: *mbi varret të Shqipërisë* (E.578); *mbë shqipëtarëtë* (N.587) etj. Këto ndërtime mund të jenë edhe një ndikim prej gjuhësh të tjera[337].

Në sistemin e përemrave në disa përdorime vihet re ndikimi popullor i formave të gjinore-dhanores shumës për përemrin vetor *neve* për emëroren a kallëzoren, si: *përmi neve është ngritë* (M.583); përdorimi i trajtës ***u*** për përemrin vetor ***unë*** në rasën emërore, si: *U një mund', zotrinë tënde, si shqypëtar i vërtetë* (T.576), *po u s'di të të lëvdonjë* (E.577). Në disa raste të tjera, qoftë përemrin ***ne***, qoftë përemrin ***ju***, i ka përdorur pa lëkundje: *po ne tash pse ma të liqë* (M.584), *ju jeni bir të Shqipërie* (N.588). Përemrin e vetës së dytë njëjës ***yt***, në shumicën e përdorimeve e kemi gjetur në formën ***yt***: *nderi yt, emri yt* etj. Por e kemi gjetur edhe në trajtën ***jyt***: *ky i bukuri jyt emër* (T.576); *se zëri jyt ka fuqi* (E.578). Mendojmë që kjo trajtë të jetë ndikim nga arbërishtja, sepse një trajtë e tillë del në Piana d. Albanezi[338].

Në poezitë e Mitkos trajtat foljore disa herë afrojnë me trajtat e të folmes së vendlindjes dhe herë me trajtat foljore të rilindësve të tjerë. Më konkretisht: për përdorimin e pjesëzës aktualizuese ***po*** me kohën e tashme të mënyrës dëftore, afron me përdorimet e bashkëkohësve të tij, duke e përdorur shpesh, si: *po vështron, po punon, po klan, po përpiqemi* etj. Në të kryerën e thjeshtë foljet me zanore në vetën e tretë njëjës dalin me mbaresën ***–jti:*** *e turpërojti* (E.575), *shkrojti* (T.576), *zaptojti* (M.598), *shkrojti* (J.579), *dëgjojti* (P.602) etj. Këto mbaresa janë ndikime të gjuhës së folur. Format dhe përdorimet e kohës së ardhme te poezia e Mitkos, nën ndikimin e gjuhës popullore, në disa raste janë ndërtuar me pjesëzën ***do***, pa ***të-***në e lidhores, si në thjesht ligjërim: *do jetë i paharuar* (J.579); *do ndreqen me të mbesuar* (N.588); por në disa raste edhe me ***të*** e lidhores: *do ta dini* (J.579); *do t'i dërgonj* (B.581) etj. Foljet e trajtës pësore, gjatë zgjedhimit, para mbaresave vetore, herë marrin anaptiksen ***h***: *s'të ndahem* (B.581), *të bëhen, të mësohen* (J.580); herë marrin anaptiksen ***n***: *do t'i rënkonem, të leconem* (B.581), *harone, do të lëvdone* (E.578) etj.

Në poezitë e Mitkos kemi ndeshur njësi leksikore apo konstrukte nga të folmet arbëreshe. Mendojmë që prania e tyre është edhe pasqyrë e botëkuptimit të Rilindjes, edhe shprehëse e kontakteve të vazhdueshme të autorit tonë me botën arbëreshe, por edhe një vlerë e autorit që ka ditur ta përdorë këtë të folme për synimet e tij ideoartistike. Funksioni i tyre nuk është vetëm emërtues, por nëpërmjet tyre jepet më e qartë shija popullore. Të tilla janë disa emra, përemra, folje, ndajfolje, parafjalë dhe konstrukte të thjeshta të arbërishtes, si: *javo* (N. 579); *fjeçim* (M.598), *bëlejtur* (N.589), *ndëpër*, *u kloftë falur; gluhra të huaj* (N.588); *m'u nda mbë shtatë* (B.581); *nka njeri si që të dojë t'i falet perëndisë* (E. 575); *sod ë dit' e perëndisë* (M.599); *ç'ë kjo e keqe mbë ty* (N.582); *mëm' e klajtur* (N.588) etj.

Th. Mitkoja e ka pasuruar e zgjeruar poezinë e tij edhe me fjalë e trajta fjalësh të zonave të ndryshme. Ka futur në poezitë e tij disa trajta foljore perifrastike, disa njësi leksikore, të cilat afrojnë me trajtat e gegërishtes. Këto trajta janë përdorur më

[337] F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat e tij origjinale*, Tiranë, 1999, f. 102.
[338] ADGJSH, I, 2007, f. 296.

shumë te poezia "*Marsejesa*". Të tilla janë: *Dit' e namit ia ka mrritë; sa me i lan' me na mar' dhehena? Se zoti ësht' për të gjith' njin; ta duan me na shti fitë' e me na prishur vllazërinë, rrëfehena, njin, mëm', e dashun* etj. Për këto trajta studiuesi Q. Haxhihasani ka shprehur mendimin se *"*Elemente të caktuara si "*po ne tash… pse ma të liq se ata… ku dita e dëlirisë… mos dëgjoni hoxhë e prift…etj."* të kujtojnë vargjet e poezisë së njohur të Pashko Vasës: "*Mori Shqypni*", e cila qe botuar prej Janikut që më 1881, ndërsa si fletë e veçantë, pat qarkulluar që më 1879. Ka mundësi që Mitkoja ta ketë shkruar *Marsejsesën* më pas, duke u ndikuar aty këtu edhe prej poezisë së P. Vasës."[339] Lidhur me këto ndikime, prof. Sh. Demiraj ka shprehur vlerësimin e tij: "Nën ndikimin e ideve të lëvizjes patriotike të Rilindjes, që synonte në radhë të parë bashkimin dhe vëllazërimin e të gjithë shqiptarëve pa dallim feje e krahine, disa nga këta shkrimtarë jugorë të shekullit të kaluar, si: Samiu. Naimi, Vretoja etj., përdorën në veprat e tyre edhe disa fjalë, trajta fjalësh edhe forma morfologjike nga të gegërishtes. "[340]

Mësuese dhe frymëzuese e parë e shumicës së poetëve të romantizmit në fëmijërinë apo edhe në rininë e tyre, letërsia popullore mbetet mësuese e tyre edhe në pjekurinë krijuese. Ata nuk mund të shkoqen prej ndikimit të saj, ndoshta, edhe sikur të duan: kënga popullore është letërsia e formimit të shijes dhe etikës së tyre[341]. Ndaj dhe kur shkruajnë në tetërrokësh romantikët tanë kujdesen ta ndërtojnë sipas modelit të tetërrokëshit popullor në të gjitha rrafshet e tij: theksore, melodike dhe tingëlluese. Folkloristi Thimi Mitko, për shembull, shkon aq larg në imitimin e vargut popullor, saqë këmbëzat e vargut të vet kujdeset t'i rregullojë me anën e ndërshtesave, po ashtu, siç bën shpesh edhe këngëtari popullor[342]. Në vjershën "*Të nxiturit e Shqipërisë tuke përpjeturë*", autori e zgjidh me një pasthirrmë nxitëse ***moj*** problemin metrik dhe ritmik të vjershës: *Shqipëri moj dashuri, / Ne jemi trima për ti, / Mos ke frik' e mos mba zi/ Pse do vritemi për ti.* Në disa raste ndodh që në tekstet e vjershëtarëve të këtillë, që imitojnë këngën popullore, vargu mbetet i pazhvilluar dhe i paformuar në pikëpamje të strukturës figurative dhe ritmike sidomos kur ata nuk ndikohen prej këngëve më të mira popullore[343].

Gjuha e poezive të Th. Mitkos, me gjithë ndikimet e dialektit, me gjithë lëkundjet dhe shmangiet që u munduam t'i përmendim në këtë punim, është përsëri një gjuhë e punuar, e lëvruar, e kuptueshme, jo vetëm nga toskët, por edhe nga gegët. Poezitë e Mitkos, ashtu si gjithë krijimtaria e tij, i shërbyen përhapjes së dritës e diturisë. Në rrugën e rritjes së mendimit politiko-shoqëror të Rilindjes bashkë me idetë e N. Veqilharxhit, Z. Jubanit, De Radës, Viçens Dorsës, J. Vretos, Th. Mitkos dhe të P. Vasës përbëjnë një vijë të vetme e koherente; ato vunë bazat e ideologjisë

[339] Q. Haxhihasani, *Thimi Mitko*, *vepra*, Tiranë, 1981, f. 585.
[340] Sh. Demiraj, *Disa shënime reth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX,* në BUSH, SSHSH, 1, 1959, f. 73.
[341] R. Qosja, *vepër e cituar*, f. 351.
[342] R. Qosja, *vepër e cituar*, f.358.
[343] *Po aty*, f.361.

kombëtare dhe shërbyen si gurë miliarë që shënonin udhën drejt realizimit të një strategjie të vetme kombëtare. Kësaj strategjie i shërbente afirmimi i lashtësisë, i vitalitetit dhe i identitetit etnokulturor të shqiptarëve, si kusht i njohjes të së drejtës së tyre për zhvillimin e lirë dhe të pavarur dhe për të zënë vendin që u takonte në familjen e kombeve të qytetëruara të Evropës[344].

[344] J. Bulo, *vepër e cituar*, f. 128.

OLGER BRAME (KORÇË)
BLEDAR LENJA (KORÇË)

DËSHMITË LEKSIKORE TË THIMI MITKOS NË FJALORIN ETIMOLOGJIK TË G. MAJERIT

Thimi Mitkoja mbetet një nga veprimtarët më të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare. Veprimtaria e tij lidhet sa me themelimin e folkloristikës shqiptare, aq edhe me leksikografinë shqipe.

Punimi ynë rreket të sjellë në vëmendje një këndvështrim tjetër në përmasën e këtij personaliteti. Thimi Mitkoja mund të shihet si pikë reference në studime të ndryshme etimologjike të shqipes, ku nën këtë dritë, vepra e tij folkloristike, por jo vetëm, shërben si një burim i rëndësishëm.

Punimi ynë synon të analizojë dëshmitë leksikore të Thimi Mitkos, në Fjalorin etimologjik të Gustav Majerit.[345]

Në vitin 1891, MajerI harton Fjalorin etimologjik të shqipes, një vepër me rëndësi në fushën e albanologjisë në veçanti dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Dihet që vepra në fjalë , për kohën në të cilën u shkrua, fitonte një rëndësi të madhe për studimet gjuhësore – historike për shqiptarët dhe gjuhën shqipe.

Fjalori etimologjik i Majerit, është fjalori i parë etimologjik në gjuhën shqipe, njëri prej fjalorëve të parë etimologjikë për gjuhët e Evropës dhe, fjalori më i rëndësishëm i shqipes deri në gjysmën e dytë të shekullit XX. Majeri mbetet një nga studiuesit më seriozë të studimeve albanologjike dhe një prej themeluesve të studimeve ballkanologjike.[346]

Gustav Majeri e njohu shqipen jo vetëm nëpërmjet studimeve e burimeve të shkruara të kohës, por edhe duke mbledhur vetë leksik dialektor në ngulimet shqiptare. Për të thelluar më tej njohjet e tij me botën shqiptare Majeri hyri në lidhje letërkëmbimi me dijetarë shqiptarë dhe arbëreshë të kohës, me Th.Mitkon, Krtistoforidhin, De Radën, Kamardën etj.[347]

Duke iu referuar studimit të Q. Haxhihasanit mbi veprën e Mitkos, mësojmë se mes Majerit dhe Mitkos ka pasur një letërkëmbim të dendur, ku ky i fundit i dërgon pjesë të koleksionit të tij, këngë popullore toskërisht e gegërisht, përralla e proverba, shprehje, gjëegjëza, fabula të Ezopit, vjersha, krijime, doke e zakone, emra personash e anektoda , rreth 11 fletore, me qëllim dhe shpresë që të gjendej një botues për t'i shtypur ato.[348] Vetë Majeri, në një fashikullin të Studimeve Shqiptare (Fashikulli V), flet për një përmbledhje në dorëshkrim të Mitkos, prej të cilit ai nxori, përveç disa këngëve gege, pjesën më të madhe të teksteve në dialektin toskërisht .

[345] G.Meyer, Fjalor etimologjik i gjuhws shqipe, 2007
[346] B.Baliu, *Gustav Majer dhe Albanologjia*, fq.7-8
[347] S.Mansaku, Parathënie e botimit shqip, "*Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*", fq. 6-7
[348] Q. Haxhihasani, *"Thimi Mitko dhe Gustav Majeri*", Kultura Popullore 2 (1985)

Letërkëmbimi i dendur i Mitkos me Majerin, nuk kishte si të mos linte gjurmë te ky i fundit në hartimin e fjalorit etimologjik të shqipes, ku Mitkoja dhe dëshmitë e tij zënë një vend të rëndësishëm.

Kumtesa jonë përqendrohet pikërisht në dëshmitë leksikore të Mitkos në këtë fjalor, pa u përpjekur të bëjë vërejtje a kritika gjuhësore lidhur saktësinë e përfundimeve etimologjike të Majerit mbi këto dëshmi, ashtu siç sqaron mjaft qartë dhe vetë përkthyesja e fjalorit A. Omari në fillim të veprës.

Duke skeduar këto dëshmi të Mitkos në Fjalor, në mënyrë statistikore kemi evidentuar rreth **220** të tilla, si pika referimi të përdorura nga Majeri. Në këto dëshmi të Mitkos mund të dallojmë disa karakteristika.

Ka fjalë e shpjegime, të cilat shërbejnë si burim parësor dhe i vetëm për Majerin në etimologjinë që jep; ka të tjera ku Mitkoja jepet si burimi i parë, por shoqërohet edhe me burime të tjera, për të dhënë një shpjegim më të plotësuar, si dhe raste të tjera ku Mitkoja renditet ndër burimet e tjera. Me rëndësi paraqiten mjaft shpjegime, të cilat Majeri, pasi i sqaron nga burimi a burimet parësore që shënon, e plotëson shpjegimin e tij edhe me sqarimet a mendimin që ka Mitko për këtë fjalë, si psh: ... **Mitko** e shpjegon fjalën nga *kllukë* dhe *furríq*, sh. këtë. **(fq.267) ; ... pas Mitkos** edhe *kofçék, kolçék* "raft në mur për bukë" depo ushqimesh". (**fq.255) etj.**

Në disa raste të tjera, megjithëse për shpjegimin e fjalës nuk merret si burim Mitkoja, Majeri e vendos atë përsëri si pikë referimi për krahasim si p.sh: **beldarí [*bel'darí*] ?** Reinh. Ant. 50, 2 Hidra. **E panjohur për Mitkon. (fq.69); ...** Këtu duket se janë shkrirë në dy fjalë të ndryshme. *úthullë* nga **uthlā* lidhet patjetër me *úthëtë*, që **Mitko** e barazon me *áthëtë* "i thartë" ... **(fq. 521).**

Në dëshmitë ku Mitkoja merret si referencë, në mjaft raste është evidentuar edhe burimi përkatës dhe faqja nga është cituar ai, siç është rasti i *Bletës Shqiptare* p.sh: blegërás, blegërís, blegurís, blegërónj [*bl'egɛrás, bl'egɛrís, bl'egurís, bl'egɛróɲ*] "blegërij, thërras". blegërínj "thërras, për delen" **Bleta shq.** 165 ... (**fq. 77**); ... dordoléc *[dordol'éts*] m. "bubë, trembës zogjsh" geg. Në Berat *dordolece* ashtu si edhe *peperonë* = gr.περπερούνα është një fëmijë i i zbukuruar me gjethe e degë për rrëshajat, të cilit i hedhin ujë mbi kokë, ndërsa të tjerët këndojnë për të ndjellur shiun. **Mitko Bl. shq.** 57 **... (fq.125).** Dihet se përmbledhja folklorike e Mitkos është botuar më **1878**. Duke qenë se ajo përmban një fjalor me rreth **1000** fjalë, kuptohet se ka qenë një burim i rëndësishëm për Majerin për shpjegimet në Fjalorin e tij të botuar më **1891**. Fakti tjetër që paraqet interes dhe rëndësi, ka të bëjë me atë se vetë Mitko, në fjalorin e përmbledhjes folklorike, është përpjekur të përcaktojë edhe prejardhjen e këtyre fjalëve duke shënuar origjinën e tyre, gjë që Majeri e ka pasqyruar në etimologjinë e fjalëve përkatëse kur jep prejardhjen e fjalës sipas Mitkos, psh.: ...Nga gr. vjen *dollomás* " ὕφασμα κόκιυόυ" **Mitko. ...(fq.124);** ... **Mitko** dallon *venj* "end" dhe *ent* "δωάζομαι, στημονίζω,...**(fq. 141**) etj.

Por, në pjesën më të madhe të dëshmive në Fjalor, meqenëse nuk citohet vepra konkrete në të cilën Majeri i referohet Mitkos, mund të mendojmë se burimi

të jetë përftuar nga letërkëmbimet e Mitkos me Majerin ose nëpërmjet kontaktesh të tjera. Një pjesë e këtyre fjalëve dëshmi, që nuk e kanë në Fjalorin e Majerit veprën e Mitkos për referim, sot mund t'i gjejmë edhe në Fjalëtoren Shqip – Greqisht , Greqisht –Shqip të Thimi Mitkos, të përgatitur për botim dhe me një studim hyrës nga Dhori Q.Qiriazi (2014),si psh: ***belék, fanitem, gëxarínj, gliqe, karíq, korrolíth-dhi, kreçe, pëtí, shervetë, themenĺ,*** etj.

Po kështu, një pjesë e mirë e këtyre dëshmive të Mitkos që gjenden te Fjalori etimologjik, Majeri merr si prejardhje atë që ka përcaktuar Mitko nga turqishtja, persishtja, sllavishtja, arumanishtja, serbishtja, latinishtja etj, psh: **veresie [*veresie*]** "me kredi, hua" **Mitko.** Nga turq. *veresije* **(fq. 528); shishane [*šišane]*** f. lloj pushke **Mitko.** Pas këtij turke (fq. **472); ...**Krahas kësaj edhe *plug..* **Mitko** nga serb., bullg., sllov. *plug*,...**(fq.394);** ...*pizgë* f. "trumbetë" **Mitko =** serb. *piska* "fishkëllimë". **(fq. 388); nebvlebĺ [*nebl'ebĺ*]** f. "qiqra të pjekura" **Mitko**, i cili e shpjegon fjalën nga bullgarishtja. (**fq.349)** etj.

Dëshmi mjaft e rëndësishme me referencë Mitkon, në Fjalorin etimologjik të Majerit, është dhe përcaktimi dialektor i fjalëve në shpjegimin etimologjik. Nisur nga ky fakt, mund të konstatojmë edhe një anë tjetër të Mitkos, si njohës, mbledhës dhe klasifikues i fjalës së popullit sipas shtrirjes dialektore e krahinore, psh: ...**bobotë [*bobotε*]** f. "arv. Hidra. Në Korçë **pas Mitkos** është bobollë "άραπόσιτος βραστός". (**fq. 79), ...**"id." shkodr.; bubullís "qaj me zë të lartë" **Mitko**; ... (**fq. 92), ...**në Fier *ngjonj, ndërgjónj* **Mitko Bl. shq. 169,** arv dëlgónj ... **(fq.120), ... frynj[*früń*]** geg. *fryj*, tosk. edhe *frinj* **... Mitko**. (**fq. 159), kanë [*kanε*]** f. në Përmet "kallam i gjatë që rritet në ujëra të ndenjura". *kaník* m. "άποθοκι κτισμένη άπό καλάμους" **Mitko.** ... **(fq.226), karroqe [*karoḱe*]** pas **Mitkos** në Berat "një masë drithi prej dy okësh" ... (**fq.233), luâ-ni [*l'ua-ni]** m.geg., *lon-i* **Mitko, ... (fq. 292), shefk [*šefk*]** m. "mëngjes" shkodr. **Mitko... (fq. 466), ...** *zgjéburë xjéburë* (i) geg. *sqébunë* (i)... (**fq. 552), ...** E cunguar *vec* m. "trangull" në Tiranë. **Mitko...(fq. 233) etj.**

Nga rreth **220** fjalë dëshmi, ku Mitko shërben si burim për shpjegimet etimologjike të Majerit në Fjalorin etimologjik, mbështetur në karakteristikat e theksuara më sipër, mund të këtë bëjmë ndarje:

- **Fjalë ku Mitko është burim i vetëm në shpjegimin etimologjik**

Të tilla në Fjalorin etimologjik janë **44** fjalë të renditura alfabetikisht si më poshtë:

- **bobotë [*bobotε*]** f. "arv. Hidra. Në Korçë **pas Mitkos** është bobollë "άραπόσιτος βραστός". **fq. 79**
- **brahóm [*brahóm]*** m. "tas balte" **Mitko fq.79**
- **cirivĩ [*tsirivĩ]*** f."rreth, qark" **Mitko. fq.101**
- **çaqe[*tšaḱe*]** f. "merimangë" **Mitko. fq.104**
- **çëllesë*[tšełesε]*** f. "shkop i tundësit. Filiç" **Mitko. fq.107**
- **çit *[tšit]*** thirrje për të trembur macen. **Mitko. fq.108**
- **çotillë[*tšotiłε]*** f. "shkop i tundësit" **Mitko. fq.109**

- **dajlanë[*dail'anε*]** "lloj pushke" ; rrethim me gardh në një liqen a lumë për të zënë ngjala" **Mitko. fq. 112**
- **fillikati [*filikati]*** ndajf. "krejt vetëm" geg. i *vétëmi filli* "id." **Mitko. fq.152**
- **gajás[*gajás*]** *"më bie të fikët"* **Mitko. fq. 164**
- **gëxarínj [*gεdzaríń*]** "προφητεύω" arb. e lt. **Mitko. fq.172**
- **glabërím[*gl'abεrím]* m. "pushtim, shkatërrim" **Mitko. fq. 172**
- **jakúc [*jakúts*]** m. "veshje e gjatë e zezë, që arrin deri te kyçet e këmbës" **Mitko. fq.211**
- **këssém, qesém[*kεsém, ḱesém*]** m. "dash përçor" **Mitko. fq.242**
- **kllokotine [*kłokotine*]** f. "ferr" **Mitko. fq.245**
- **koko-[*koko-]*** shtesë në *kokodhḗ* (edhe *kodhḗ*) "dhe, tokë", *kokovḗ*, "vezë", *kokoshí* "shi". Thuhet edhe *boborḗ* "re". **Mitko. fq.246**
- **komtë, kómëtë[*komtε, kómεtε*] m.** "ἴφασμα ἀπὸ τρίχα τράγο ὡς οί σάκκι" **Mitko. fq.249**
- **korrolíth-dhi [*korr̃ol'íϑ-δi*]** "kaçurrel, σγουρός" **Mitko.** Duhet të nisemi nga fem. *korrolidhe* (**Mitko** shkruan edhe *korolidhe*): ... **fq.254**
- **kotéc [*kotets*]** m. " qymez pulash". *koçák* m. "qymez pulash, qymez pëllumbash". Nga sll. e vj. kishtare *kotьcь* "cella" , sllov. *kotec* "qymez pulash, thark derrash" serb. *kotac* "stallë e vogël për qingja, derra etj."... Identike me të është pas gjase (si huazim i vjetër?) *koçék*, **pas Mitkos** edhe *kofçék, kolçék* "raft në mur për bukë" depo ushqimesh". **fq.255**
- **krehkónj [*krehkóń*]** "lulëzoj, çel" **Mitko. fq.258**
- **kuacë [*kuatsε*]** f. "dele e bardhë me sy e vetulla të zeza" **Mitko. fq.263**
- **ladút[*l'adút*]** "njeri i keq, shpirtkazmë" **Mitko. fq.274**
- **lás-zi [*l'ás-zi*]** m. "διῳρυξ τού νερομύλου δἳ οὐ στρέφεται ὀ τροχός" **Mitko. fq. 279**
- **lesh [*l'eš*]** m., leshtë b"prej leshi". leshták, leshtán geg. leshëtór arv., përleshem"zihem, rrihem" **Mitko** ("kapem për leshrarsh me dikë") ... **fq.283**
- **lotë [*lotε*]** f., *loto* "short" **Mitko.** Nga it. lotto. **fq. 292**
- **mazë [*mazε*]** f. "mbledhje, takim" **Mitko.** Ndërtuar nga gr. e re μαζώνω "grumulloj, mbledh bashkë" . **fq. 309**
- **murinë[*murinε*]** f."tra mbështetës i pjerrët i çatisë" **Mitko. fq.337**
- **naft [*naft*]** m. "detar" **Mitko.** Nga gr. e re ναύτης. **fq.343**
- **nebvlebḯ [*nebl'ebḯ*]** f. "qiqra të pjekura" **Mitko**, i cili e shpjegon fjalën nga bullgarishtja. **fq.349**
- **opllë, ëpllë[*opłε, εpłε*]** f. "thundër" **Mitko.** Nga gr. e re ὀπλή "thundër" **fq. 363**
- **përgone[*pεrgone*]** f. "nevojtore" **Mitko. fq.381**
- **pisús [*pisús*]** , e shquar –zi m. "kuti gjilpërash" **Mitko. fq.388**
- **restiço [*restitšo*]** f. "lloj valleje a loje" arv. **Mitko fq. 427**
- **rëfkëtimë [*rεfkεtimme*]** f. "pulsi i dorës" **Mitko fq. 429**
- **ristós [*ristós*]** m. "Krishti" **Mitko.** Nga gr. Χριστός. **fq. 431**
- **sokḗ [*sokḗ*]** f. "mbulesë kreje grash" **Mitko. fq. 453**

- **shishane [*šišane]* f. lloj pushke **Mitko.** Pas këtij turke fq. **472**
- **shtarë [*štarε*]** f. “neriumoleander, marshallojë, helmës” **Mitko fq.481**
- **thanë[*ϑanε*]** f., thánëzë f. “cornus mas, dru dhe frut i thanës”. Thanë edhe “dru” Kull. **Mitko**. ... **fq.510**
- **ysht[*üšt*]** “shëroj me fjalë magjike” **Mitko. fq.523**
- **velvelé[*vel’vel’e*]** “σκανδαλοποιός, φιλοτάραχος” – ai që bën skandale, trazira” **Mitko.** Nga *velvele* “zhurmë”. **fq.528**
- **vigje [*viǵe*]** shm. “dhurata në ushqime që çohen për dasmë , për lindjen e një fëmije, për ndërtimin e një shtëpie të re” **Mitko. fq.534**
- **xandë [*dzandε*]** f. mungesë, difekt” **Mitko. fq.543**
- **zhup [*žup*]** “bëj potere; rrah dikë” **Mitko.** Epirot *ζιουπῶ* “shkel, shtyp” Σύλλ. 14, 218. **fq. 557**

➢ ***Fjalë ku për shpjegimin etimologjik Majer referohet Mitkos, por krahas kësaj bën edhe krahasimet e mundshme me një gjuhe tjetër***

Të tilla, në Fjalor ndeshen rreth **80** dëshmi, të cilat renditen alfabetikisht si më poshtë.

- **amáshirë [*amašírε*]** f. “tas, pjatë” **Mitko**. Mbase rrjedh nga kroat. *masur* “enë kuzhine”, që e kanë bashkuar me it. *massaro* “nikoqir”, *masseria* :fermë, ekonomi” **fq. 45**.
- **barák [*barák*]** “i shpejtë (për një rrjedhë)” **Mitko.** Turq. Barak shm. Arab. I bark “rrufe”? **fq.63**
- **cakís *[tsakís]*** “mundoj, torturoj” **Mitko.** Greq. e re σακίζω “thyej, copëtoj”. ... **fq.98**
- **çputhíq[*tšpurϑiḱ*] “**prish” (për vezët) **Mitko.** Sllov. Sperhneti, *sprhnoti* “prish, kalbëzoj”; ϑ për h. **fq.109**
- **ditë[*ditε]*** f. ngadít “ditë për ditë”, sot =*só-ditë, shih më poshtë si. *ditëtore* f. “gazetë” **Mitko. ... fq.122**
- **dordoléc *[dordol’éts*]** m. “bubë, trembës zogjsh” geg. Në Berat *dordolece* ashtu si edhe *peperonë* = gr.περπερούνα është një fëmijë i i zbukuruar me gjethe e degë për rrëshajat, të cilit i hedhin ujë mbi kokë, ndërsa të tjerët këndojnë për të ndjellur shiun. **Mitko Bl. shq.** 57 **... fq.125**
- **fërfëlínj[*fεrfεl’íń]*** për këngën e thëllëzës. **Mitko.** Onomatopeike. Khs. nap. Farfogliare, spanj. farfullar “belbëzoj”, serb. frfljati “belbëzoj, pëshpëris, dërdëllis” ... **fq. 150**
- **flad[*fl’ad*]** m. “freski”. fladís “freskoj”. geg. hladís “id.” **Mitko**. nga serb. bullg. hlad = sll. vj. kishtare hladь “ftohtësi” ... **fq. 153**
- **fonjeshë[*fońešε*]** f. arv. **Mitko** “vrasëse” , fem. shq. Nga gr. e re φονιᾶς “vrasës”. **fq. 156**
- **gaçkë[*gatškε]*** f. lakër e bardhë, kokë lakre”. Khs. *koçān*? *kazje* f. “κράμβη, καρπολάχανον – lakër” **Mitko. fq. 164**

- **gërdis[*gɛrdís]*** “më vjen ndot” . *gërdí́* f. “neveri, të ndotë”. *gërdiçm* “i neveritshëm” . Prop. *gërdhínj* “mbush me blozë, tymth (për bimët); zë morth, plasaritem (për duart, nga të ftohtit)” **Mitko ... fq. 170**
- **gliqe [*glíke*]** f. “το ὄπισῦ γόυατος ϰοίλωμα τὸ ὄπισϑευ τοῦ γόυατος ϰατά τήν ϰλείδωσιν” shkodr. **Mitko.** Ndoshta nga serb. kljuka “gremç, çengel”. **fq. 173**
- **gradinë [*gradinɛ*]** f. “kopsht”. Gardinë f. “kopsht me perime” **Mitko.** Nga sll. e vj. kishtare, serb. *gradina* “gardh, kopsht”; prej këtej edhe rum. *grădină* “kopsht”. **fq. 175**
- **gubere** f. “pelerinë, tallagane” **Mitko.** Nga serb. guber “batanije leshi”, bullg. guber “qilim” ... **fq.181**
- **guguçe [*gugutše]*** f. “kumri” **Mitko.** E afër me fjalën onomatopeike serb. gugutati “gugat pëllumbi”. **fq. 182**
- **gurgulé[*gurgul’é*]** f.”trazirë, zhurmë” **Mitko**. E afër me gr. e re γουργουρίζω “grouiller, crier”. **fq. 183**
- **gurgune [*gurgune*]** f. “shtambë e vogël balte për ujë” arv. **Mitko.**E afër me serb. krga “kungull uji” (çek. krhanice “vorbë, kuth)? ... **fq.183**
- **gjyvés [*ǵüvés*]** “i kuq i errët” (βίσσινος) **Mitko**. Nga turq. *güvez* “id.” serb. *djuvez*, rum. *ghiviziŭ “*bojë kafe”. **fq. 192**
- **hajde[*haide*]** “eja!”, *haj “hajde*”. **Mitko***. hájdeni* “ejani!” me mbaresën e v.2.shm. Nga turq. *hajde* “jepi! përpara!”; edhe bullg., serb., rum., gr. e re. **fq. 193**
- **hu-ri *[hu-ri],*** geg. *hû-ni*, kal. *yu* m. “hu; organ mashkullor”. *hu* si masë drithi shkodr. **Mitko.** ... **fq.203**
- **χulí [*χul’í*]** f. “inat” **Mitko.** Nga gr. e re χολή “vrer, mllef”. **fq. 206**
- **jadigjár [*jadiǵár*]** “ i bukur, i pashëm” **Mitko**. Nga turq. *jadḱar,* vulg. *jadiǵar* “dhuratë për kujtim; i veçantë, i çuditshëm”; serb. *jadidjar, odidjar*, “ i bukur”. **fq. 211**
- **jezitḱ [*jezitḱ*]**m. “heretik, keqbërës” **Mitko.** Pas kësaj fjale turq.=it. *gesuita*. **fq. 214**
- **kaçkaritem [*katškaritem*]** “gjej pretekste, yçkëla”. *kaçkariqe* f. “dyfytyrësi” **Mitko.** Lidhet me turq. *katšak, katšamak* “shkas, yçkël”. **fq.216**
- **kaftán [*kaftán*]** m. “ὕφασμα ϰόϰϰινον” **Mitko.** Nga turq. *kaftan* “veshje e sipërme, mantel i gjatë”; e përhapur gjerësisht edhe në bullg., serb., rum., gr.e re e gjetkë. **fq.218**
- **kalamá[*kal’amá*]** f. “fëmijë deri në tetë ose nëntë vjeç; njeri fëminor” geg. *kalamán* “id.” **Mitko.** ... **fq.219**
- **kall, kallój[*kał, kałoj*]** “ndez, nxeh” Ro. **Mitko.** E përftuar nga lat. Calor ose e afërt lashtërisht me të. **fq.222**
- **kapitem [*kapitem*]** “marr frymë me vështitësi, dihas” **Mitko.** Nga gr. e re ϰόπος “mundim? **fq. 228**
- **këlfás[*kɛl’fás*] “**çukis, qëmtoj” **Mitko.** Nga serb. kljuvati “quk, çukis”, khs. sll. e vj. kishtare klьvati etj. **fq. 237**

- **këllëf, kullúf [*kɛłɛ́f, kułúf*]** m. ‘mill, mbështjellëse, kukurë”. Nga turq.gɛlaf, gilaf, kɛlɛf, “këllëf”; bullg.kalьv, serb. kaluf, rum. călaf, călăf, chilîf. Këtu hyn mbase edhe këllapë f. “vrimë ku do të futet një shtyllë “, këllapós ‘hap një vrimë të tillë” **Mitko**. (p. me përzierje me kallúp, sh. këtë). **fq. 238**
- **kërcénj [*kɛrtséń*]** “thërras, bërtas” **Mitko.** Nga serb. (sll. e vj. kishtare) kričati “thërras”. **fq.240**
- **kotél [*kotél’*]** m. “tas druri”; “gropë në tokë në formë tasi në një lojë fëmijësh” **Mitko.** Nga bullg. kotel, serb. *kotao*=sll. e vj. kishtare kotьlь “kazan”, dhe kjo nga got. katilis. **fq. 256**
- **kreçe [*kretše*]** k. "kokë lakre, λάχανον τής ἁρμιᾶς” **Mitko**. Nga rum. *curechiu* “lakër” prej lat. *coliculus*? **fq.257**
- **krezhavitem [*krežavitem*]** “σκληρύνομαι ἀνορθώνον τάς τρίχας ὑπὸ θυμοῦ - kreshpërohem, më ngrihen qimet përpjetë nga inati” **Mitko.** Sllave, ndoshta nga serb. *krzav* “ me thekë, kaçurrel” **fq.259**
- **kuje [*kuje*] f**. “ trazirë, zhurmë” **Mitko.** Nga gr. e re χουγιάζω “bërtas”, rum. huesc “id.”, të cilat i kanë lidhur me serb. *ujati* “ulëras”. Ndoshta më mirë prej sll. së vj. kishtare *kujati* “murmurare” **fq. 264**
- **kuje [*kuje*] f**. “ trazirë, zhurmë” **Mitko.** Nga gr. e re χουγιάζω “bërtas”, rum. huesc “id.”, të cilat i kanë lidhur me serb. *ujati* “ulëras”. Ndoshta më mirë prej sll. së vj. kishtare *kujati* “murmurare” **fq. 264**
- **lajlá [*l’ail’á*]** f. “jargavan”. *lajlák* m. “physalis alkekengi, qershi dimërore” **Mitko**. Nga turq. *lejlák* “jargavan” etj., ... **fq. 275**
- **lak [*l’ak*]** m., te **Mitko** edhe *leq* (në thelb trajtë e shumësit) “gjalmë, litar a tel i lidhur si syth; lidhëse këpucësh. Shm. lakë (noeud de la gorge)... **fq.276**
- **lazhdë[*l’aždɛ*]** m. “hajdut”. *lazhdërónj* “vjedh” **Mitko.** Nga turq. last “voleur” Bianchi. **fq. 280**
- **lebetís [*l’ebetís*]** “dridhem” *lebetí́* f. “tmerr” **Mitko.** Serb. sllov. *lebetati* “lëkundem sa andej-këndej”. **fq.280**
- **lëndinë [*l’ɛndinɛ*]** f. “fushë, livadh; tokë e papunuar” **Mitko.** Nga sll. e vj. kishtare lędina “terra inculta” , serb., bullg., sllov. ledina “fushë, lëndinë”; edhe rum. lindină. **fq. 285**
- **lëzhë[*l’ɛžɛ*]** f. “λουτρὸν φυσικόν **Mitko**. *lixhë* f. “burim i nxehtë” geg. Nga turq. *ɛlɛdža* “burim i nxehtë”, serb. *ilidža* “banjë e ngrohtë”. **fq. 286**
- **lila [*l’il’a*]** f.shm. “kllapat, hekurta e duarve” **Mitko.** Lit. *lèlė* f.sh. “hekurat e duarve”. **fq. 287**
- **magazí [*magazí́*]** m. magazé f. **(Mitko *makazé*)** “depo ushqimesh, magazinë”. *mangazá* f. “dyqan” geg. *magázonj* “grumbulloj, bëj hyrje”.Nga turq. magaza... **fq.297**
- **maxhár [*madžár*]** m. “hungarez”, pas **Mitkos** edhe “lloj pushke” . *maxharí́* f. “Hungari”. *maxharísht* “hungarisht” ... **fq. 309**
- **mrezhë[*mrežɛ*]** f. “rrjetë” (**te Mitko** *mërézhëjë* f.)Nga serb. *mreža*, sll.e vj. kishtare, bullg. *mrêža* “rrjetë” rum. *mreajă*. **fq.334**

- **ndërzénj [*ndɛrzéń*]** “nxis (qentë); i ndjell”; **pas Mitkos** për bashkim seksual të kafshëve. Nga bullg. *draznja* “nxis , ngacmoj”, ndërsa rum *indărjí* përputhet me sll. e vj. kishtare dražiti “nxis, ngacmoj”. **fq. 347**
- **nerés[*nerés*]**, e shquar *nerezi* m. ‘hardhi e lënë pas dore” **Mitko.** Në thelb “e pakrasitur”: serb. *rezati* “pres” , *rez* “e prerë”; ... **fq. 350**
- **nun[*nun*]**m. “kumbarë” *núnëlë* f. “nunë”. *nunërŕ* f. “kumbari”. Së pari nga gr. e re νουός “nun, dëshmitar i martesës” ; po ashtu rum. nun “kumbarë në një kurorë etj.” kjo nga lat. *nonnus*. Kuptimi, që haset edhe në sard. *nonnu, nonna*, sugjeron rrjedhimin nga gr. e re... *nunós* **Mitko** 183 është “ἐξομλογω; *nun* pas **Mitkos** është dhe πνευματικός” **fq. 359**
- **orgjym, regjýn [*orǵűn, reǵűn*]** m. “një peshk i madh deti”, pas **Mitkos** turq., sidoqoftë nga it., spanj. orca “delphinus orca, lloj delfini”. **fq. 364**
- **patë [*patɛ*]** f., *patók,* geg. *paták* m. Fjalë e përhapur gjerësisht: sllov., bullg., serb. *patka* “rosë” serb. *patak* “rosak”, ... Hyn këtu edhe *pac* m. “zhytarak” **Mitko**? Apo nga turq. *batmak* “zhytem” khs. *kara batak* “zhytarak. **fq. 373**
- **patë [*patɛ*]** f., geg. *pât* f.,; *pat* m. “kat”. Nga gr. e re πάτος “dysheme” khs. πάτωμα “dysheme, kat”. Edhe serb. *patos* “dysheme”, bullg. *poton*”kat”, ukr. *pat* “papafingo”. *patomë* f. shputë e këmbës” ... Këtu hyn edhe *potilë* f. “shputë e këmbës” **Mitko**. **fq.373**
- **patë [*patɛ*]** f., *patók,* geg. *paták* m. Fjalë e përhapur gjerësisht: sllov., bullg., serb. *patka* “rosë” serb. *patak* “rosak”, ... Hyn këtu edhe *pac* m. “zhytarak” **Mitko**? Apo nga turq. *batmak* “zhytem” khs. *kara batak* “zhytarak. **fq. 373**
- **patë [*patɛ*]** f., geg. *pât* f.,; *pat* m. “kat”. Nga gr. e re πάτος “dysheme” khs. πάτωμα “dysheme, kat”. Edhe serb. *patos* “dysheme”, bullg. *poton*”kat”, ukr. *pat* “papafingo”. *patomë* f. shputë e këmbës” ... Këtu hyn edhe *potilë* f. “shputë e këmbës” **Mitko**. **fq.373**
- **pirpirŕ [*pirpirŕ*]** f. “veshje e sipërme grash pa mëngë” **Mitko.** Nga turq. *pirpiri* “qui appartient aux ouvriers; grossier, sans élégance” **fq.387**
- **pishtar[*pištar*]** m. “vravashkë” **Mitko.** E shformuar nga bullg. *sveštar* m. “pishtar”**. fq.389**
- **poganik, boganik [*poganík,boganík*]** m. “festë që bëhet mbrëmjen e tretë mbas lindjes së fëmijës”. **Pas Mitkos** edhe poganatë ... **fq. 396**
- **posulle, pusulle [*posułe, pusułe*]** f. “letër” **Mitko.** Nga sll. e vj. kishtare *posъlъ* “lajmëtar” prej *sъlati* “dërgoj”, khs. serb. *poslanica*”letër”. **fq.399**
- **qall[*ḱał*]** m. “dylbi” **Mitko.** Nga it. occhiale. **fq. 411**
- **qemane, qemenxhe [*ḱemane, ḱemendže*]** geg., *çemáll, çamáll, çemalle, çemanxhe* shkodr. f., *gjemenxhé* f. **Mitko.** “lloj violine”. Nga turq. *ḱeman, ḱemane, ḱemanntše* “id.” serb. *ćemane.* **fq.414**
- **qoshe, qoshé [*ḱoše, ḱošé*] f**. “kënd, cep; qoshk”. *qoshlí* “katërkëndor”. Nga turq. *ḱöše* “qoshe, kënd”; bullg. *kjoše*, serb. *ćoša.* Te *ḱöše* hyn edhe *ḱöšḱ* “kioskë, qoshk i oborrit” shq. *qoshk* **Mitko. fq.421**

- **rreshtë [*r̄eštɛ*],** pas **Mitkos** edhe *rrezhdë* f. “eshtër”; kështu quhen dy zgjatime mishtore nën mjekrën e deleve në Kaoni. Nga lat. *arista*... **fq. 437**
- **spërk[*spɛrk*]** “qose” **Mitko.** Me prapasht. zvog. *–k* nga *spër* = gr. e re σπανός “qose pa mjekër” ; rum. *spîn*, sll. vj. kishtare *spanъ.* **fq. 455**
- **shefk [*šefk*]** m. “mëngjes” shkodr. **Mitko.** E pasaktë: turq. šfak është “muzg i mbrëmjes” **fq. 466**
- **shëbojë [*šɛbojɛ*]** f. “një lloj bime” shkodr. **Mitko.** Nga turq. šeboj (pers šeh-bui “aromë nate) ... **fq. 466**
- **shervetë [*šervetɛ*]** f. “μανδήλιον” **Mitko.** Gr. e re σερβιέτα, it.salvietta ... **fq. 468**
- **tërsëllḗm [*tɛršɛłɛ́m*]** m. “zemërim” ? **Mitko.** Turq. *terslemek* “ contrarier, brusquer”. **fq. 497**
- **torrë [*tor̄ɛ*]** f. “rreth, qarkullim”; ndajf. “rreth e qark” arv. Te **Mitko** *torrë, torrua* “rrugë” Nga it. *torno* **fq. 500**
- **tralisem [*trałisem*]** “mpihem, më merren mendtë; marrosem” Samiu, **Mitko.** Nga gr. e re άντραλίζω. sh. te ndrellë. **fq. 501**
- **tragë [*tragɛ*]** f. “διεύθυνσις, καταφύγιον” **Mitko.** Serb. *trag* m. është “gjurmë këmbe” ... **fq. 501**
- **vas vazi [*vas, vazi*]** m. “predikim” **Mitko.** Nga turq. *váz* “id.”. **fq.526**
- **veresie [*veresie*]** “me kredi, hua” **Mitko.** Nga turq. *veresije* “id.” prej *veressi* “comerce à crédit”... **fq. 528**
- **vetromét[*vetromét*]** m. “erë e ftohtë” **Mitko.** Serb. *vjetromet* “rrymë ere” nga sll. vj. kishtare... **fq. 531**
- **vóbekë , vobék, vápëkë, [*vóbekɛ, vobék, vápɛkɛ*]** (i) “i varfër” f. *vobege. vabëzí, vobëzí,* kal. edhe *vapëhtí* f. “varfëri”. *vabëzí, babëzí* f. “uri e madhe” **Mitko**. Nga sll. e vj. kishtare ... **fq.539**
- **xhorë, çore [*džorɛ, tšore*]** f. çomange” **Mitko.** Është serb. *čvor* “nyje” khs. *čvornovaka* “çomange” **fq. 546**
- **zapërí [*zapɛrí*]** f.palë, rrudhë” *zapërój* “palos, rrudhos” Dh. e Re. Nga serb. *sabor* “palë, rrudhë” lidhet me sll. e vj. kishtare ... **Mitko** lidhet me gr. e re σοῦφρα “id” **fq. 548-549**
- **zëngë [*zɛngɛ*]** f. “kërcitja e armëve që varen që varen në sup; serbatori i tyre” **Mitko.** Turq. *zɛngɛr* “dridhje e vazhdueshme”? **fq. 551**
- **zgjebe, zjebe, xjebe, sqebe [*zǵebe, zjebe, dzjebe, sḱebe*]** f. “kromë”. *zgjéburë xjéburë* (i) geg. *sqébunë* (i) “që ka zgjeben, i kromosur” ... *sqebón* m. “pjepër” **Mitko** Fiam Arb. 1, 9. Nga lat. scabies ... **fq. 552**
- **zograf [*zográf*]** m. “piktor”. *zografis* “pikturoj”. *zografí* f. “pikturë”. *zugrafetë* “emër i një bime mali” **Mitko 194.** Nga gr. e re ... **fq. 554**

➢ **Fjalë dëshmi ku Mitkoja merret nga Majeri si burim parësor, i pasuar nga autorë të tjerë, vendas ose të huaj.**

Në Fjalor ndeshen rreth **50** dëshmi të kësaj natyre të renditura si më poshtë.

- **arësye *[arɛsüe*]** f., **arësén[arɛsén]** m. (**Mitko** arr-), "*ratio*" (Bardhi), "*ragione*" (Ro.). *arësénj* "qortoj, përzë". ... **fq.51**
- **arravelë [*aɟ̈avel'ɛ*]** f. harabel" **Mitko**. Sllavisht; më parë vijnë në vështrim trajtat e sllov. (*vrabel'*), ukr., rus. (*vorobej)*, pol. (*wrobel)*, sorb. (*vrobl, robel'*) Hahni ka harabel m. trumcak. Rum. Gărevel, găreveliu "shturë, gargull" , Marianu I, 426 pas gjase duhen mbajtur larg. **fq.53**
- **asprë *[asprɛ*]** f., áshpërë f**. Mitko** "monedhë e vogël argjendi turke, para në përgjithësi. Nga gr. e mesme ἀσπρον, prejardhjen e së cilës nga lat. Asperum Pschari, Mém. Soc. Ling. VI, 312 vv. E katrajtuar me hollësi. ... **fq.55**
- **asqér [*askéŕ]* m.,** *astjér* **Mitko** "ushtri"; ashqér m."ushtar" Ro. Nga turq. "askér' "ushtri, ushtarë", edhe bullg., rum.,... **fq. 55**
- **avurdë, aburdë [*avurdɛ, aburdɛ*]**. f. "mami" **Mitko**. Nga turq.(pers.) *avurden*,"apporter, amener – sjell, marr me vete", *ber avurden* "faire sortir, tirer, extraire- nxjerr", Bianchi I 240, 342? **fq.58**
- **belék-gu [*bel'ék-gu*]**m. "dyluftim, sfidë"; geg. "zhurmues, erë fishkëllyese". *beleke* ὀνομάζεται και τὸ σκληρὸν και δυσκολοτσάκιστον αύγὸν, ὁταν τά παιδία τσουγκρίζουν, συγκρούουν τά κόκκινα αύγά τὸ πάσχα" **Mitko.** **fq.69**
- **blegërás, blegërís, blegurís, blegërónj [*bl'egɛrás, bl'egɛrís, bl'egurís, bl'egɛróɲ*]** "blegërij, thërras". blegërínj "thërras, për delen" **Bleta shq.** 165 ... **fq. 77**
- **branë *[branɛ]*** f. "lesë" **Mitko.** branís, zbranis, zvarís, zvar, zvarónj "tërheq, zvarris, heq zvarrë; ... **fq.83**
- **bubë [*bubɛ]* f. "**krimb mëndafshi"; në gjuhën e fëmijëve "çdo insekt". *búbas* m. "krimb" **Mitko.** Që këtëj pas gjase geg. *bubís* "vrapoj" ... **fq.89**
- **bumbullít, brumbullít [*bumbułít, brumbułít*]** "bubullin". *Bumbullimë, brumbullimë* f., *bumbullím m. "bubullimë". bumblë* f."zhurmë e ujit" kal.; bumbëlís "gurgullitje e ujit" kal.; bumbullój "id." shkodr.; bubullís "qaj me zë të lartë" **Mitko**; ... **fq. 92**
- **cunk [*tsunk]*** cungu m. "trung; pjesa që ka mbetur nga diçka mbasi është prerë"; **pas Mitkos** "mut i thatë". It. cionco "i cunguar" ; rum, *ciung* "id" ... **fq.102**
- **digjónj, dëgjónj[*díǵóɲ, dɛǵóɲ*],** geg. edhë ndëgjój nëgjój, në Fier *ngjonj, ndërgjónj* **Mitko Bl. shq. 169,** arv dëlgónj ... **fq.120**
- **dollám *[dołám*]** m."fustan i gjatë" *dollomá* f. "shami qafe e kuqe". Nga turq. *dolama* "pallto e gjatë e jeniçerëve"; edhe bullg.(d*olama* "gilet de flanelle), serb., rum.(*dulamă*), gr.e re (*ντουλαμᾶς*). Nga gr. vjen *dollomás* " ὕφασμα κόκκινου" **Mitko. ...fq.124**
- **ent[*ent*]** rrënja *end-*, pjes. *endun,* tosk. é*ndurë* "end"; shkodr. *enn*; te hahni edhe *int*; te Kav. *enjt* "ύφρίνωα" arv. kal*. jenj* "end", *jerë* "endur", *ihem*, "endem"; **Mitko** *venj* "end", *véjturë* "endur"; *vejkë* f. "vegjë, avëlmend" ... **Mitko** dallon *venj* "end" dhe *ent* "δωάζομαι, στημονίζω, monter la chaîne- vë

majën në tezgjah", edhe Junggu jep si kuptim për *enn "*ordire- vë indin në tezgjah" po ashtu Ro. për *me ndun* (dmth. vë majën puna e parë në tezgjah", Bosnj. *ente* "krëhër i endjes, majë e pëlhurës" (Blau 229) rrjedh prej shqipes. venj e **Mitkos** flet qartë për lidhje me fjalën e vjetër i.e. *vebh-* për "end" ... **fq.141**

- **fesë [*fesɛ*]** f. arv. Hidra *feste* f. tosk., *feshte* **Mitko**, f*esták* arv. Reinh. "fes, feste". Nga turq. (=bullg. serb.) *fes*, gr.e re φέσι. **fq.149**
- **flashkë[*fl'aškɛ*]** f. "filxhan kafeje" **Mitko.** Është gr. e re φλάσκα "bouteile , flacon", it. *fiasca*, friul. *flasçhe*, frëngj. e vj. *flasche*,... **fq.154**
- **ftulë[*ftul'ɛ*]** f. "dhi e re" kal. siq.; "ftujë, vëtulë f. "dhi e vogël afro 18 muajshe" **Mitko... fq. 160**
- **galë[*gal'ɛ*]** f. "korb" **Mitko.**Sllave **... fq. 165**
- **grabís [*grabís*]** "rrëmbej". "*grabī* " f. "grabitje, plaωkë". *grabíç* [*grabítsh*] m., grabiçár [*grabitshár*] m. "hajdut, grabitqar". *grabëtís* "grabis" **Mitko**. ... **fq.175**
- **kálshimë, kólshimë, kolmë [*kál'šimɛ, kól' šimɛ, kólmɛ*]** " i bukur, i hijshëm" **Mitko.** Ro. ka konshm "amabile, suave – i këndshëm" nga gr. e re κομψός? **fq.221**
- **káltërë [*káltɛrɛ*]** "bojë qielli" **Mitko.** *kalthër* "blu azzurro, cilestro – i kaltër, bojë qielli" Rada. ... **fq.221**
- **kaminë [*kaminɛ*]** f. **Mitko**, *kuminë* f. Krist. "furrë, sobë". Në gjini përputhet me sll. e vj. kishtare *kamina* "furrë, sobë" , ... **fq.225**
- **kanë [*kanɛ*]** f. në Përmet "kallam i gjatë që rritet në ujëra të ndenjura". *kaník* m. "άποθοκι κτισμένη άπό καλάμους" **Mitko.** ... **fq.226**
- **karroqe [*kaʀoḱe*]** pas **Mitkos** në Berat "një masë drithi prej dy okësh", në Itali "kade për mjelje". *karoqë* "bardhak me vjega", edhe Schirò Raps. 314 ... **fq.233**
- **kulluvriqe, kokovriqe [*kułuvriḱe, kokovriḱe*]** f. "furriku i klloçkës" **Mitko.** Pas Hahnit *kukovriq* m. geg. është zog pule i çelur me ngrohje të njeriut. **Mitko** e shpjegon fjalën nga *kllukë* dhe *furríq*, sh. këtë. **fq.267**
- **lār [*l'ār*]** m. "dafinë". *larí́, luvarí́* f. "id." **Mitko.** *lurí* f. "korije me dafina" Bardhi(?) Nga lat. *laurus; luvarí* nga serb. *lovor.* **fq.279**
- **luâ-ni [*l'ua-ni]* m.geg., *lon-i* **Mitko,** *león* Krist. "luan". Nga lat. *leonem*, kjo e fundit nga it. *leone. londár* m. arv. është gr. e re λιοντάρι. **fq. 292**
- **lufé [*l'ufé*]** f., *ylyfé* geg., *ylefé* **Mitko**, *yléf* Ro."rrogë". ... **fq.292**
- **mandorle [*mandorl'e*]** f. "bajame" **Mitko.** Nga it. *mandorla*. kal. *mendul*, *miendul* March (f. ?) është nap. *ammennola*; *mëndulë* Bardhi, ven. *mandola***. fq. 303**
- **mëtkë [*mɛtkɛ*]** f. "mbretëresha e bletëve" **Mitko.** Është sllav. (çek., rus. sorb. E poshtme) *matka* "mbretëresha e bletëve" ... **fq.323**
- **mistréc [*mistréts*]** m. "shkurtabiq, xhuxh" **Mitko**. Është rum. *mistreţ* "mesquin, maigre, chiche", në rum zakonisht vetëm në lidhjen *porc mistreţ* Sain, 70. ... **fq. 326**

- **mjek[*mjek*]** m. “doktor”; geg. namatisje e të sëmurit me formula magjike”. *mjektár* m. “ ai që zotëron të tilla formula” *mjekeshë* f. “doktoreshë”. *mjekím* m. “bar, ilaç”. *mjekój* “shëroj” shkodr. Nga lat. *medicus* “mjek”. Nga medicare rrjedh *konj, kuanj*, “ushqej fëmijë e të sëmurë, ushqej shpend a kafshë” , për të cilën **Mitko** jep trajtën *mëkónj*... **fq. 328**
- **mor [*mor*]** “ e kaltër e mbyllur, manushaqe”; mūrë, mūrmë(i) “μαυροειδής” **Mitko**; murmë, arv. “ngjyrë hiri”, në Fier “biond”; ... **fq.332**
- **muχrutë [*muχrutε*]** f. “pjatë e thellë” arv. **Mitko**. Trapez. Μαχούρτ asnj. ... **fq. 334**
- **murk [*murk*],** e shquar “*murgu*” i errët, i zi, ngjyrë hiri”; fig. “fatkeq”. *murgashe* f. “φαιόν, άσπρογάλαζον” **Mitko.** *murxhár* m. kal. siq. “kalë”. *murgë* f. “llum i vajit” ... **fq.338**
- **mutî [*mutí*]**. e shquar mutîni m. ‘tundës, dybek” geg. pëtî f. “id.” **Mitko.** Rrjedhojë e shqipes (me lat. –īnum) ... **fq.341**
- **picërë [*pítsεrε*]** “i vogël, i imtë”. *picërónj* “zvogëloj” E afër me it. *picciolo*, *piccino* “i vogël” sard. *piccioccu* “çun, ... Këtu bën pjesë edhe *picá* m. “kalë i vogël” **Mitko** = gr. e mesme πιτζᾶς “xhuxh” ... **fq.385**
- **pishtráf[*pištráf*]** m. “dënim, gjobë” **Mitko.** Gjerm. *bestrafen* del në sllov. si *štrafati*, *poštrafati*: si ka ardhur në shqipe është e paqartë **(Mitko** nuk e jep prejardhjen e fjalës)**...** **fq.389**
- **punjashe*[puńaše*]** f. **Mitko.** *punashkë* f. Kav. “qese, pungë” ... **fq. 407**
- **pykë[*pükε*]**, *mykë* f. “fundi i dorezës së sopatës e të thikës” **Mitko.** “kunj” Ro., *pýikë* Kav., *pylkë* **Mitko.** “kunj”... **fq. 410**
- **qār [*kā́r*]** m. “dushk, lis i bardhë, βαλανίδια” **Mitko**. *çar* “lentischio” *e çarr* “faggio” Ro. është trajta shkodr. e saj. Ndoshta më saktë *qarr*, për *kierr* nga lat. *cerrus*, *çerr* “cerro” ... **fq.412**
- **rush [*ruš*]** m. rushkë **Mitko** po ajo? Foy më njofton një gr. të re ῥούσι “rrush” ... **fq.435**
- **rrashtë [*r̄aštε*]** f., *rrazhdë* **Mitko.** “garbë; kafkë”.*rrashtinë* f. “mbulesë kreje”... **fq.436**
- **sqilë, sqile [*sḱil’ε, sḱil’e*]** f. “dhelpër”. Nga gr. e re σκύλος, σκύλα “qen, bushtër”. Dhelpra është canis vulpes. Edhe gr. e vj. ka kaluar te këlyshët e kafshëve të tjera ... Një zvogëlues *σκουλίδι nga σκύλος”qen” gjendet në *skulíth,* e shquar *-dhi* “njeri i ulët” **Mitko. fq. 456**
- **stamnë [*stamnε*]**, geg. shtamë, shtambë, te Kav. stomnë f. “kanë”; shtëmbë f. **Mitko** “id.”. shtëmbár m. “poçar” në Berat ... **fq. 457**
- **shkorsë, shkorshë [*škorsε, škoršε*]** f. “velenxë, qilim” **Mitko.** *skorsë* “velenxë e pistë” Reihn ... **fq. 474**
- **upéshk, ypeshkup [*upéšk, üpeškup*] Mitko,** *ypéshkf, ipéshkf, ypeshkyf, ypeshkëf*, e shquar... **fq. 519**
- **vito [*vito*] , Mitko.** *vido* f., *vidán* m. **Mitko** “pëllumb”. Nga thirrja e të ndjellurit vit vit: në Serbi Vuk 64. **fq. 536**

- **vitllë[*vitłɛ*]** f. “vidë” **Mitko:** ‘torchio –presë, trokull” Ro. *vitllós* “shtyp, ngjesh, presoj” **Mitko.** ...**fq.536**

➢ **Fjalë dëshmi ku Mitkoja merret si burim reference për shpjegimin etimologjik të fjalëve krahas autorëve të tjerë. Në një pjesë të mirë prej tyre , referenca nga Mitkoja, përdoret si burim sqarues ose saktësues nga Majeri.**

Në fjalor, hasen rreth **50** dëshmi të tilla të renditura si më poshtë.

- **apolé [a*pol’é*]** m. “lindje, Orient”. Rada, **Mitko**. Nga *lenj* “lind (dielli”, ngrihet” , shih këtë, edhe gr.ἀπό?
- **beldarí [*bel’darí*] ?** Reinh. Ant. 50, 2 Hidra. **E panjohur për Mitkon. fq.69**
- **brengë[*brengɛ*] f**. Bag.e bujq. 4. *brengós,* po aty 7. Sami, Leximi 2, 10 “rëndoj” (**sipas Mitkos**). **fq.84**
- **çart [*tšart]*** “shkatërroj. Shkretoj” Bardhi, “transgredisko” Budi. *çartohem*” flas përçart” Doz. Për Fier. *çártëjë* f. “prishje” **Mitko.** çatës m. “xhelat”. **fq.104**
- **dallndyshe dallëndyshe [*dałndüše dałɛndüše*]** geg., **dellendýsh**[*dełendüš*] Bardhi, *dalanyshe dallnýsh* shkodr.;n *dellandyshe, dollundyshe* (Kav.), *dyllëndyshe, dëllëndyshe* tosk.; *dallandyshe tallandyshe* arv,; *ndalanís*h kal. Rada; *dalandrishë* siq. Dalandishe Schirò Raps*. dayandrishe* Piana, *dellendryshe* Doz. q*ellendryshe* Krist. *gjellëndryshe* **Mitko** f. “dallëndyshe”... **fq.113**
- **fanepsem [*fanepsem*]** kal. Rada, *faneksem* **Mitko**, *fanitem* Krist. **Mitko** , f*anarosem* siq. “shfaqem”. fanḯ f. “shfaqje, dukje” kal. Nga greqishtja. *fanarosem* nga φανερώνω... **fq. 145**
- **ferrë[*feɾɛ*]** f. “gjemb, gjembaç, shkurre, manaferrë”. Te Ro. edhe *therrë. fermác* f. “gjemb” Ro. lidhet me *ther* “pres”? Te *ferrë* **Mitko** vendos *ferrák* “bilbil” duke iu referuar një këngë poipullore ... Pas Hahnit *ferák* është një “zog i vogël ngjyrë hiri, beng, fikës” **fq. 148.**
- **frushkullínj[*fruškulíń]*** “fishkëllej” kal. Cam. II 162. Schirò Raps. 186. Frushkullímë f.”fishkëllimë” kal. frúshkullë “thupër e hollë, kamzhik” Krist. **Mitko. ... fq.159**
- **frynj[*früń*]** geg. *fryj*, tosk. Edhe *frinj* “fryj; ngop”. *frihem* “enjtem, ngopem”. *çfrynj, çfrinj* “shfryj”; kal. *çëfrínj* “shplodhem” Rada. f*rýmë*, kal. *frimë*. fryht “i trashë” Junng. Zor se hyn këtu f*iromë* f. “frymë” **Mitko**. Reinh. **fq. 159**
- **gërgás[*gɛrgás],** e kr. e thj. *gërgava* “bezdis, ngacmoj, shtie keq, fus kalla”. *gërgás* m. “ngacmues, shpifës”. *gërgám* m. “altercazione” Ro*. gërgar* f.(në thelb pjesore) “qortim i ashpër” kal. Sant. Gërgërás “thërras” **Mitko. ... fq.171**
- χ**imikó [*χimikó*]** m. “shalqi” arv. Reinh., imaník “id.” **Mitko** Fiam.Arb.1, 9. Nga greq e re χειμονικόν “id.” , ... **fq. 207**
- **kant-di [*kant-di*]** m. “skaj, buzë” geg. *kënt-di* tosk.”qoshe”. Nga it*. canto*. *kandún* m. “kënd” arv. nga gr. e re καντούι= it. cantone. Këtu hyn edhe geg. *skē^* m.”buzë, skaj”, *skundíll* m. “skaj i rrobës” Bardhi (=*cantile), kal. s*hkënt* shm. *shkëndëzit* m. “fustan” *shkëndë* shm. “rroba” **Mitko. fq.227**

- **kariqe [*kariќe*]** f. “mbështjellësja e farës së pambukut” arv. Heldr. Nga gr. e re καλύκια, shm. i –ιον; gr. e vj. κάλυξ “gonxhe, kupëza e lules”. *karíq* m. “rrjetë peshkimi” **Mitko** dorëshkr. Nuk duhet bashkuar me të. Kuptimi i dhënë nga **Mitko** është i pasaktë: gr. e re καρύκι pas Paspatit Χιακὸν γλωσσάριον 117 është shkop i gjatë, në fund të të cilit lidhet rrjeta. **fq.231**
- **kastravécë [*kastravétsε*]** f. Ro., *krastavéc* m. Hahn, *karavéc* arv. “trangull” . E cunguar *vec* m. “trangull” në Tiranë. **Mitko.** Nga serb. *krastavac*, bullg. *krastavica* nga sll. e vj. kishtare *krasta* “scabies”; edhe rum. *crastavéț*, crastavete. **fq.233**
- **kërthizë[*kεrθizε]*** geg., *kërthizë* tosk., *kërthínjëzë* Ro. Krist., *kërthíz* Ro.f. “*kërthizë;* qendër”. Është zvogëlues i lat. *cortīna* “rreth”. Fjalët që vijojnë nuk duhen bashkuar me të me kuptimin e tyre: *kërthî-ni* m. “fëmijë i vogël” Ro. *kërthí́* m., *kërthinjë* f. “i vonë, i lindur vonë (për qingjat)” **Mitko**, Reinh. Përkundër tyre *kërthinjat e dhënet* “të parëlindurit e dhenve” Krist. *kërthí* ndajf. “i vonë” *kërthinjénj* “vjetërohem (për bukën)”. **Mitko.** *kërthinjehem* “vjetërohem, squllem, bajatem, ligem” **Mitko**. **fq.241-242**
- **këthénj, kthénj [*kεθéń, kθéń*]** siq.*tëthénj* “kthehem prapa, rrotullohem; ndërroj; përkthej; hedh pije në gotë (Kav.)”. Pës. *këthenem, këthehem, kthenem, këthyme* f. geg. “kthim, përkthim”. Nga lat. *convertere*: *co(n)vertebam* u bë **kërteva*, * *kërtheva*, *këtheva, këtheva.* Me *transvertere lidhet tërthori ndajf. “*κυκληδόν”, *udha e tërthórshimë* “ὁδὸς κυκλική” **Mitko**. *udha tërthuer* “via per traverso” Bardhi. ... **fq.243**
- **kosë[*kosε*]** f. “gërshet”. *kocidhe* f. “id.” Arv. Nga bullg. serb., sll.vj. kishtare *kosa* “flokë”, *kocidhe* pas πλεξίδα. Rum. *cosiță;* arum. *cuşeaua* “gërshet”Weig.134 (= *cosella*).Këtu hyn *kocë, koce, gocë* f. “vajzë e re”; khs. *çupë* f.”flokë të gjata, vajzë”. Po ashtu *keçe* f. lab. “vajzë” duhet të lidhet me serb. *kečka* “tufë flokësh(nga sll. e vj. kishtare *kъkъ* “flokët e çaçkës së kresë) khs, *kece* “τολύμη λίνου ὁποῦ γνέθουν” **Mitko**; këtu hyn edhe *kecán* m. “ὑπηρέτης ἀνήλικός” **Mitko**. **fq.254-255**
- **krip[*krip*]** m. “flokë”, pas Cam. siq.(khs. Schirò Raps. 58), por edhe te **Mitko**. **fq.259**
- **kúkurë [*kúkurε*]** f. “këllëf shigjetash” Bardhi, Ro. Nga bizant. κούκουρου = lat e mesme *cucurum*, nga gjerm. e lartë e vj. *chohhlar*; rum. *cucură*; rus. *kokorь* “vezme fishekësh” **Mitko** ka *kukur* “tas, pjatë”, **fq.265**
- **lavinj [l’*avíń*]** “marros” kal. *lavem* “marrosem” Rada Po. III 72; “shkurajohem”siq Cam.I 347; :merakosem për diçka” kal. Frasc. Ma. 6, 25. *lavur* (i) “i marrë, budalla” kal. *laosem* “mpihem” **Mitko. fq.280**
- **lepjetë, lëpjetë, lipjetë, lupjetë [*l’epjetε , l’εpjetε, l’ipjetε, l’upjetε*]** f. ‘rumex”. Nga lat. *lapathum* = gr. χλάπαθον; bullg. *lapat*. Këtu hyn edhe arv. kal. *lëpúsh* f., pas Heldr. “borrago officinalis” , pas Radës “erba medicinale” , si edhe *lëpushkë* Samiu, lopushkë **Mitko** “bimë me fletë të gjera”; ... **fq. 282**

- **ligjís [*l'ígís*]** "përkul" arv. Nga gr. e re λυγίλçω. Këtu hyn edhe *lijízm "*i hollë, shtathedhur" Schirò Raps. 140 në thelb " i përkulshëm". Prej λυγίλçω rrjedh edhe siq. *livís* "përkul, lëviz", si edhe *lëvís* "vihem në lëvizje" Doz., **Mitko**, Krist. Gjen. 7, 21, geg. *livís* Krist. Act. 17, 28. **fq.287**
- **lok [*l'ok]** "budalla" kal. March. *loqe* "budalla, i marrë" **Mitko.** Lidhet me it. *locco* (nap. sic., por edhe në dialektet e it. veriore) "budalla" , spanj. *loco*, port. *luoco* "kokëtrashë". *lok* është huazuar nga ital. e jugut. **Mitko** jep edhe gr. e re λόκκος**. fq.290**
- **mëhónj [*mεhóń*],** mohónj, muhoj, geg. "them 'jo', nuk pranoj, i bie mohit" . me ram mboh ose mbof "mohoj". Prop. mohë, mbohë f. "mohim" **Mitko.** Nga bullg. *bъh* "mohim" serb. bah, ... **fq. 317**
- **mjerë [*mjerε*]** (i) "fatkeq". *mjér* pasth. "ah! ajmè!" *mjel*" fatkeq" kal., pas Cam. edhe *melë, mele*. **Mitko** ka *melḗ* f. "μνησικακία, πάθος". l-ja edhe këtu do të jetë më e vjetër se r-ja (si në bilë pranë bir etj.)... **fq.329**
- **piskás [*piskás*]** "cijat, këndon (zogu)" Ro. Nga serb. *piskati* "fishkëllej... këtu hyn edhe *pizgë* f. "trumbetë" **Mitko =** serb. *piska* "fishkëllimë". **fq. 388**
- **pluar [*pl'uar*],** geg. *pluer*, e shquar *plori* m. "umbi i parmendës". *pëlori i parmendës* "il vomere dell'aratro" Schirò Raps. 94. Krahas kësaj edhe *plug* Pulj. **Mitko** nga serb., bullg., sllov. *plug*, fjala e njohur sllavo-gjermane, prejardhja e së cilës ende nuk është sqaruar... **fq.394**
- **qenq-gji, qënq [*ḱenḱ-ǵi, ḱεnḱ*]** tosk. kal., te Ro. *qing*, te Jarn. *kī*ˆ m."qingj" *buzë –qengjerushe* f. "me buzë si të qingjit" **Mitko. fq. 414**
- **qerdhés [*ḱerδés*]** kal. Badessa, *qërdhénj* tosk. "fitoj". *gjërdhínj* "fitoj në lojën e letrave" **Mitko**. Nga gr. e re κερδαίνω "fitoj". **fq. 415**
- **regj [*reǵ*]** m. shkodr., kal. arv. (Frasc. Ma. 1, 5 rregj) "mbret". *rregjërī* f. "mbretëri" kal. *renjḯ* f. "mbretëri" shkodr. ... *rigatë* f. "mbretërim, sundim" **Mitko**. *regj* është lat. *rēg(u)lus*, *renjój* (që këtej *renjḯ*) ... **fq.426**
- **rudo [*rudo*] f**., geg. *rud* "lesh i hollë i një lloji të veçantë deleje e cila quhet po ashtu": *lesh rudo*, *dhëntë rudo* Hahn. Nga serb., kroat. *rud* "kaçurrel" *ruda* "bashkë leshi", vetëm sllov. *ród* "i ashpër" ... drejtpërdrejt nga lat. *rudis* rrjedh *rudhínj* "rrudh". *ruth*, pës. *rrudhem* "bëhem me rrudha, zhubrosem". *rrudhur*, "kaçurrel" siq. Rudhë f. "zhubër, palë". *rúdhëzë* "mbulesë e vogël" arv. Hidra. *rrudhë, dërrudhë, dërrullë* "kaçurrel" **Mitko ... fq.434**
- **sërë [*sεrε*]** f. "radhë" . *sëravít* "vë në radhë". Nga turq. *sεra* "radhë, rend' Këtu hyn edhe *zyrë* "syth (i trikos), hallkë; detyrë" Ro. "άναγκη, χρεία" **Mitko. (***sεra* është edhe "ordre")... **fq. 447**
- **sqap [*sqap*]** m., shm *sqep* "cjap" geg.; *cap, cjap*, shm *cep, cjep* "id." ; *cqap* Doz.; *sjap* Ro.; *cape* f. "dhi" **Mitko.** ... **fq.455**
- **shëmbëllénj [*šεmbεłéń*]** "ngjaj" *shëmbëllím* m. "ngjashmëri". *shëmbëlltyrë* f "id.", "*figurë*" geg. *shëmtýr* m. "shembull" geg. *shëmblëtḯ* f. "figurë" kal. Rada Po VI 68. Nga lat. *similare* "ngjaj"; ... Folja përndryshe është ruajtur vetëm në

kat., prov. *semblar*, frëngj. *sembler*. Përkundrazi *shëmbëll* m "shenjë , tregues" **Mitko** është lat. *symbolum*. **fq. 469**

- **shprohë [*šprohε*]** f. "kuçedër" Dan. *sprihë* "id." **Mitko fq.479**
- **shut [*šut*]** "pa brirë} Ro. *shutë* f. "drenushë". *shytë* "pa brirë; pa qafë ose pa kokë" Hahn... tek e njëjta rrënjë bën pjesë serb. *šuka* "dhi pa brirë", *šuša* "kafshë brinore shytë", *šušav* "id.", *šušilo* "cjap pa brirë". Pranë këtij të fundit unë vendos shq. *shushát, shushullás* "topis, mpij" si dhe *shushava* shm. "ecejake pa qëllim të caktuar, varavingo" **Mitko. fq. 487**
- **tevlík-gu [*tevlík-gu*]** m. "dru i përkulur që i vihet kaut në qafë për ta mbrehur në zgjedhë" Hahn; "unazë" **Mitko.** ... **fq. 495**
- **tërbónj [*tεrbóń*]** "zemëroj shumë, bëj si të tërbuar". *tërbonem, tërbohem* "zemërohem shumë, bëhem si i tërbuar" ... *trubullirë*, geg. *–inë* f. "trazirë e ujit, e qiellit; trazirë,kryengritje". *trobolicë* f. "mëti" **Mitko.** Nga lat. **turbulus* ... **fq. 496**
- **tumbë [*tumbε*],** trumbë f. "tubë, tufë, duaj (gruri etj.) buqetë lulesh" Vreto. *tubë* f. "kope, çetë" **Mitko**, Rossi... **fq.507**
- **themeńi [*ϑemeńi*]** f. "ligj, kontratë" Rada. **Mitko.** Nga ϑέμα. **fq. 511**
- **thuprë [*ϑuprε*]** Ro., Rada, **Mitko,** *shufrë* Hahn. Doz., f. "thupër, purtekë", ... **fq.515**
- **urë [*urε*]** f., geg. *ūn* m. Ro. "copë druri e ndezur". *urëth* m. "një si bizele e vogël e zezë, që rritet midis grurit dhe e bën miellin e zi, urthi i grurit" **Mitko,** pra në thelb "djegie" ... **fq. 520**
- **úthullë, úthëllë [*úϑułε, úϑεłε*]**, Ro, *úfullë*, Pulj. *oftull* f. "uthull". *uthullník* m. "enë uthulle" **Mitko**. Këtu duket se janë shkrirë në dy fjalë të ndryshme. *úthullë* nga **uthlā* lidhet patjetër me *úthëtë*, që **Mitko** e barazon me *áthëtë* "i thartë" ... **fq. 521**
- **velét [*vel'ét*]** *veletár, veleznár, velexiná* "dinak, i shkathët". *veletí, velezinί* f. "shkathtësi, dinakëri" Ro. **Mitko.** ...**fq 527**
- **vërtít [*vεrtit*]** " rrotulloj" Nga sll. e vj. kishtare *vrъtêti*, bullg. *vrъtja,* serb. *vrtjeti* "rrotulloj"... Këtu hyn edhe *vërtík* m. Naum Bageri 8**, pas Mitkos** "*ȯρμή ταχύτης*". *vërtér* m.timon" kal. **fq. 533**
- **vitllë[*vitłε*]** f. "vidë" **Mitko:** 'torchio –presë, trokull" Ro. *vitllós* "shtyp, ngjesh, presoj" **Mitko.** ...**fq.536**
- **volë [*vol'ε*]** f., geg. *vol* m. "vullnet, dëshirë". Nga serb. *volja* "vullnet, dëshirë". *vúlema* "vullneti" siq. Piana Ma. 6, 10 është gr. e re βούλεα; ... Rada është gr. e re βολήι "coup, lancement"; e njëjta gjë është *volί* **Mitko** 172, 178 ("rast, mundësi"?) **fq. 540**
- **xegë[*dzegε*]** f. "njollë" arv. , te Cam *cegë, xegónj* arv, *cegónj* Cam., *çegonj* **Mitko** "qortoj, akuzoj" ... **fq. 543**
- **zorr [*zoř*]** m. "vrull" Ro. *zōr* "vështirësi" Prop*. çorrë* "vrull, fuqi, dhunë" **Mitko.** ...**fq.554**

Duke parë këtë inventar fjalësh me karakteristikat përkatëse të tyre, përsa i takon mënyrës se si referohet Mitkoja në Fjalorin etimologjik të G.Majerit, mund të thuhet se ato përbëjnë dëshmi të rëndësishme dhe njëkohësisht ndihmesë të shquar në të parën vepër të këtij lloji për gjuhën shqipe dhe të vetmen për gati një shekull. Këto dëshmi dhe vlera e tyre për këtë Fjalor, evidentojnë edhe një herë përmasën e një personaliteti erudit si Thimi Mitkoja.

Nuk duket anashkaluar fakti tjetër që, koha në të cilën u hartua Fjalori nga Majeri, u bë në kushtet kur literatura e shqipes ishte mjaft e kufizuar, sidomos mungesa e fjalorëve në këtë gjuhë. Kjo gjë patjetër do të reflektohej edhe në kuadrin e përgjithshëm etimologjik të saktësisë shkencore të veprës. Është pikërisht ky kuadër faktik që lidhet me gjendjen e studimeve gjuhësore albanologjike dhe atë të literaturës, tek i cili prof. Çabej kërkon edhe arsyet e të metave të Fjalorit të Majerit.[349]

Ndër ato burime ekzistuese nga ku mund të hulumtohej literaturë për të hartuar një vepër me karakter etimologjik, siç ishte Fjalori i Majerit, vepra e Th. Mitkos "Bleta shqiptare", që kishte parë dritën e botimit tashmë, apo Fjalëtorja e tij , mbeten burime të rëndësishme, krahas burimeve të tjera.

Vlera e këtyre dëshmive leksikore mbart rëndësinë e saj jo vetëm për Fjalorin e Majerit dhe kohën kur këto dëshmi u morën si elemente referuese, por edhe më vonë. Shumë gjurmë të dëshmive leksikore të Mitkos, i gjejmë edhe në veprën e Çabejt, "Studime etimologjike në fushë të shqipes", vepër e cila, për nga gjerësia vëllimore (shtatë vëllime), trajtimi dhe kriteret e rrepta shkencore, burimet etimologjike të shfrytëzuara dhe shqyrtimin kritik, mbetet deri sot vepra më e plotë në fushën e etimologjisë së shqipes.

[349] E.Çabej, *Studime Gjuhësore V*, Prishtinë

SEJDI M. GASHI (PRISHTINË)

THIMI MITKO GJUHËTAR, LEKSIKOLOG E LEKSIKOGRAF I VEÇANTË

Punimi ynë përpiqet të japë të dhëna të reja për kontributin e rilindësit të njohur shqiptar, Thimi Mitko. Sado që Mitkoja është studiuar gjatë dhe shumë për veprimtarinë e tij në fushën e gjuhësisë, po synojmë të japim elemente të reja për të si leksikograf e leksikolog.

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë patriotike dhe e vlerësuar lart nga Mitkoja, ishte mbledhja e fjalëve shqipe, sistemimi dhe hartimi i fjalorëve, një pasuri e vërtetë kjo sipas tij. Ai kishte grumbulluar një fond të pasur me fjalë dhe shprehje shqipe prej vendlindjes së tij, Korçës ku kishte kaluar fëmijërinë dhe rininë.

Mitko-leksikograf, mbledhjen e leksikut të gjuhës shqipe e realizoi në forma të ndryshme: a) nga kontaktet me bashkatdhetarët e tij - emigrantë në Egjipt, b) nga udhëtimet dhe takimet e tij të shpeshta që kishte me shqiptarë në Rumani, Bullgari, Turqi; c) me letërkëmbime që realizonte me rilindës dhe patriotë të shumë shqiptarë.

Punën me të ngjeshur për mbledhjen e leksikut të shqipes, Mitkoja e realizoi pasi u vendos në Egjipt. Dëshmitë për angazhimin e kamotshëm të tij si mbledhës folklori e leksikograf na dalin nga artikulli "*Rreth Korçës*" në gazetën "*Pandora*" të datës 1 janar 1860, ku përfshihet edhe një shkrim i tij me titull "*Leksikografi greko-shqiptare"*. Këtu autori, përpos të tjerash ofron edhe shpjegimin e kuptimit të afro 80 fjalëve.

Megjithëkëtë, vlerësojmë që puna më kulmore e Mitkos në fushën e gjuhësisë, është dorëshkrimi i *Fjalorit italisht-greqisht-shqip*, fjalor i cili, me synim të qartë të autorit, u hartua si mjet afrimi mes këtyre tre popujve (italian, grek dhe shqiptar).

Rilindja Kombëtare Shqiptare shënon një arritje të madhe në historinë tonë mbarëkombëtare. Sikundër dihet, fara e këtij revolucioni dituror e shpirtëror te shqiptarët kishte kohë që ishte hedhur, qysh me Buzukun, Budin, Bogdanin, Bardhin, Matrangën, Varibobën, por bashkë me "*Lëvizjen e Rilindës Kombëtare Shqiptare, shpërtheu edhe vala e luftës për një gjuhë letrare të vetme shqipe*"[350] e që padyshim i radhitur ndër të parët në këtë luftë të shenjtë për gjuhën shqipe, ishte korçari Thimi Mitko.

Rreth viteve 1860-1890 vërehet fenomeni i revolucionit të zhvillimit për gjuhën shqipe. Atë kohë u shkruan dhe veprat më të rëndësishme rreth gjuhës shqipe dhe kulturës, që pasqyrohej nëpërmjet saj. Nismëtarë janë intelektualët: Thimi Mitko, Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Jani Vreto, vëllezërit Frashëri, etj, por edhe shqiptarët e Greqisë që njihen me emrin arvanitasit si: Kupitori, Kullurioti, Birbili, Dhriva, Botasi dhe grupi i shoqatës "Helenismos" me në krye Neokli Kazazin.

[350] Idriz Ajeti, *Eqrem Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, fq.23.

Një vepër së cilës i referoheshin shpesh ishte punimi trevëllimësh i gjermanit G.Hahn *"Albanesichce Studien*", që është botuar më 1854 në Vjenë"[351].

Qysh herët (gjë që dokumentohet përmes "Bletës Shqiptare") Thimi Mitkoja ishte i vetëdijshëm për rëndësinë e ruajtjes dhe të zotërimit të gjuhës amtare shqipe. Në parathënien e "Bletës..." Mitkoja, nëpërmjet fjalëve të Herderit theksonte:" *Një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet", se shqiptarët si gjendeshin atëherë të përçarë nga besimet fetare, do të zhduknin padiţurinë vetëm duke studiuar gjuhën e tyre amtare".* [352]

Thimi Mitkoja është figura më e shquar në mesin e të gjithë rilindësve tanë, i cili fitoi përvojë të çmuar në mbledhjen e folklorit shqiptar, dhe me të drejtë ai quhet themeluesi i folkloristikës së popullit shqiptar, por që asnjëherë nuk pushoi së punuari dhe ndihmuari në dobi të gjuhës shqipe. Vazhdimisht synonte që shqipen ta pasuronte, ta zhvillonte dhe ta bënte të aftë për të realizuar probleme jetësore që i ishin shtruar përpara popullit shqiptar. Fakti që Mitkoja thuajse tërë jetën e vet ia kushtoi gjuhës, veçmas mbledhjes së fjalëve të rralla, të vjetra dhe leksikut krahinor të shqipes, "*e vendos atë si leksikograf të shquar në gjuhësinë shqiptare, veçmas pas zbulimit të dorëshkrimit të tij të Fjalorit Italisht-greqisht-shqip"*[353]*.*

Shqetësimet e Mitkos për Shqipërinë

Duke vërejtur ndryshimet e shumta që po bëheshin në hartën gjeostrategjike të kohës, në gjithë Evropën e veçmas në Ballkan, duke vërejtur pozicionet e Perandorisë Osmane përballë Rusisë dhe aleatëve të saj, si dhe duke parë që në Shqipëri kishte pllakosur errësira e urisë dhe e padiţurisë, Thimi Mitkoja në vazhdimësi, ishte i shqetësuar për situatën e krijuar, veçmas për gjendjen e arsimit tek shqiptarët. Për të zbutur sadopak këtë gjendje, ai me shumë bashkatdhetarë të tjerë si Anastas Bykun e patriotë të tjerë u angazhua për grumbullimin e ndihmave për ngritjen e shtypshkronjave , botimin e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe si dhe hapjen e shkollave shqipe. Kështu Thimi Mitkoja arriti që të fusë në Shqipëri shtypin shqiptar të kohës, kurse në pjesën e dytë të shekullit XIX, në adresë të tij vinin pako me libra dhe gazeta nga atdhetarë dhe botues nga Italia, Rumania, Bullgaria etj, të cilat, me shumë vështirësi futeshin në Shqipëri pasi që rojet e doganës osmane nxirrnin probleme të shumta. Megjithëkëtë ishin dy gazeta që

[351] Arben P. Llalla, *Gjurmë të letërsisë së vjetër të shqiptarëve të Greqisë 1860-1889*, "Tringa design", Tetovë, 2006, fq. 30.

[352] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, *Thimi Mitko-Vepra* (Redaktor Qemal Haxhihasani) Tiranë, 1981, fq.50.

[353] Shpëtim Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos, Transliterimi dhe fjalësi shqip* II, "West Print", Tiranë, 2013, fq.7.

Mitkoja kishte arritur t'i fuste në Shqipëri, "*Zëri i Shqipërisë*"[354] dhe "*Fiamuri i Arbërit*"[355] të De Radës.

Vitet '80 të shekullit XIX, ishin vite të një krize të thellë për Perandorinë Osmane, prandaj kjo krizë kërcënonte edhe popullin shqiptar. Duke parë një situatë të tillë, "*krerët shqiptarë të Rilindjes Kombëtare , të mbledhur në Prizren, paraqiten përpara autoriteteve osmane kërkesën për një autonomi kombëtare në kuadër të Perandorisë Osmane*"[356]gjë që nuk u përfill.

Lidhur me gjendjen e krijuar, Thimi Mitkoja reagoi në shtypin e kohës përmes disa shkrimeve. Në gazetën "Zëri i Shqipërisë"[357] nga data 1 shtator 1879 e deri më 20 tetor 1879, i cili me shqetësim e përcillte situatën dhe shkruante *:"Atyre (shqiptarëve) iu duket, jo pa arsye se copëtimi i atdheut të tyre çon në shkatërrimin e plotë të racës së tyre, për të cilin u bë shkak pa gjykim ky Kongresi i Berlinit, duke i dhënë një pjesë të saj Serbisë, e veç kësaj, edhe Malit të Zi mikroskopik, këtyre dy mburojave të Rusisë në Evropën Jugore"*[358]*.* Përpos të tjerash, Mitkoja shprehte zhgënjimin e tij edhe me Greqinë. Lidhur më këtë reagoi në tre numra të gazetës "Zëri i Shqipërisë". Në vitin 1879 ai shkruante "*Qeveria greke pranon që Serbia dhe Mali i Zi të marrin krahina shqiptare dhe dëshiron e bile ndihmon për copëtimin e saj, me qëllim që të marrë edhe kjo një copë të saj të vogël e verbuar nga lakmia e atyre shteteve të cilët për nga natyra janë armiq të saj"*[359]

Letërkëmbime të Thimi Mitkos për gjuhën

Thimi Mitkoja realizonte letërkëmbime me bashkëkombës të tij të shpërndarë gjithandej kolonive shqiptare, por edhe me dijetarë dhe intelektualë të huaj. "*Këto letërkëmbime të tij shpeshherë pikënisjen e kishin nga interesat dhe shqetësimet e tij për çështjet gjuhësore."*[360] Duke pasur kujdes dhe shije të hollë prej gjuhëtari, Mitkoja, në vitin 1868 përmes një letërkëmbimi, i tërhiqte vërejtjen Dhimitër Kamardës se, në përkthimet e tij të veprës së Dora d'Istrias "*Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore*", kishte përdorur fjalë tepër dialektore, që sipas Mitkos një gjë e tillë vështirësonte punë që kjo vepër të lexohej dhe të kuptohej nga shumica e popullit shqiptar.

Për këtë shkak, Thimi Mitkoja, jo që do ta zbusë pjesën e këtij përkthimi të Kamardës, që e botoi në "Bletën Shqiptare", por i hyri punës për përkthimin e veprës së Dora d'Istrias, që kjo vepër të bëhej e kuptueshme nga të gjithë shqiptarët,

---

[354] *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëllimi i dytë, H-M, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008. fq.1741-1742.

[355] Po aty.

[356] Shpëtim Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos, Transliterimi dhe fjalësi shqip* II, "West Print", Tiranë, 2013, fq.13.

[357] *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*,Vëllimi i dytë, H-M, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008. fq.1741-1742.

[358] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, *Thimi Mitko-Vepra* (Redaktor Qemal Haxhihasani) Tiranë, 1981, fq.560

[359] Po aty.

[360] Po aty, fq.50.

kurse nga letërkëmbimet që realizoi Mitkoja me mikun e tij arbëresh Jeronim De Radën, shihet që diskutoi dhe shprehu mendime për shume fjalë të gjuhës shqipe, për fjalë që përdoren të arbëreshët në Itali, për vlerën e tyre shprehëse e artistike, ku veç të tjerash ai i kërkoi De Radës që në revistën "*Fiamuri i Arbërit*" të përdorë një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme nga të gjithë shqiptarët.

Shqetësimet e përgjithshme të patriarkut të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Thimi Mitkos, shumë shpejt u kthyen në veprime konkrete. Ai u angazhua për të nxjerrë në pah pasuritë leksikore te shqipes, për zëvendësimin e fjalëve të huaja që kishin hyrë në shqipe si dhe për ngritjen e shqipes së folur në nivelin e një gjuhe të përpunuar dhe të përbashkët për gjithë kombin shqiptar. Rezultat konkret i të gjitha këtyre përpjekjeve qe fjalori i botuar prej tij në fund të përmbledhjes folklorike "*Bleta Shqiptare*". Ky fjalor kishte rreth 1000 fjalë, qëllimi i të cilit ishte të paraqiste fjalët e huaja, që sipas Mitkos ishin fare të panevojshme, kakofone dhe prishin gjuhën shqipe.

Fjalori i botuar te *"Bleta*", me materialet që përmban, me shënimet e karakterit etimologjik, me dhënien e kuptimeve të fjalëve përkatëse, vërejtjet e ndryshme gjuhësore, paraqet një punë të vyer dhe me interes.

Shtrirja e letërkëmbimit të Thimi Mitkos ishte e gjerë, e vëllimshme në sasi dhe e çmuar në përmbajte. "*Ajo shkoi deri në qendrat kryesore të shteteve ballkanike e me gjerë, ku kishte veprimtarë shqiptarë. Ai ka bashkëpunuar me patriotë, ideologë e veprimtarë të Rilindjes Kombëtare, si: Abdyl e Naim Frashërin në Stamboll, Konstandin Kristoforidhin në Elbasan, Deronim De Radën dhe Dhimitër Kamardën në Itali, Dora d'Istrian dhe Nikolla Naçon në Rumani, Jani Vreton dhe Kristo Luarasin në Sofje, Kupitorin në Athinë. Në të gjithë letërkëmbimet e tij, me bashkëpunëtorë dhe miq, ai ka diskutuar për çështjen shqiptare të kohës, për alfabetin, librat dhe shkollat shqipe, për veprimtarinë personale në shërbim të çështje kombëtare, për jetën e tyre familjare"*[361].

Idetë e Mitkos për një shqipe gjithëkombëtare

Sa i përket pastërtisë së gjuhës shqipe, Mitkoja ishte i mendimit se gjuha e vërtetë e popullit shqiptar jeton në trashëgiminë e pasur të letërsisë popullore, e cila sipas tij duhet të vihej në bazë të gjuhës së njësuar. Një ide të tillë ai e ka paraqitur edhe në parathënien e botimit të "Bletës" ku thekson *"se qëllimi i materialeve të botuara është shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë të fjalëve dhe teksteve shqipe..., veçanërisht nxitja e bashkatdhetarëve shqiptarë për studimin e gjuhës amtare dhe të kulturës së tyre"*[362], kurse përsa i përket shqipes së përbashkët dhe të kuptueshme nga të gjithë shqiptarët, Mitkoja, për dallim nga më herët, që ishte për formimin dy të folmeve të mëdha; një për veriun-gegërishten dhe një për jugun-toskërishten,

[361] Shpëtim Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos, Transliterimi dhe fjalësi shqip* II, "West Print", Tiranë, 2013, fq.14.
[362] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, vepra e cituar, fq.51.

tani ai përparon në mendimet e tij, duke vlerësuar së është koha e duhur për formimin e një gjuhe të përbashkët, me fjalë e shprehje të mbledhura nga të gjitha krahinat e vendit si dhe me pasuritë gjuhësore të ruajtura deri në ngulimet arbëreshe në Itali e gjetiu.

Një jetë mbi problemet gjuhësore

Për t'i plotësuar nevojat e kohës , lëvrimit të letërsisë, shtypit, komunikimit të përditshëm në gjuhën shqipe, Mitko problemet gjuhësore i vuri në kalendarin e përditshëm të jetës së tij.

Në veprën "*Alvaniki Melissa*" ("*Bleta shqiptare*"), botuar më 1878 në Aleksandri, u kushton një kapitull më vete "*emrave vetjakë të kështera dhe mohamedanë"*. Në fjalësin e këtij "fjalorthi" onomastik përfshirë në këtë vepër në pjesën e dytë me titull "Të përshëndoshura", Fjalori i "Bletës shqiptare dhe shënime të tjera gjuhësore" paraqitet kjo përbërje: Emra të krishterë 65, pa përfshirë variantet e ndryshme të tyre: - Aldham= Dhame-ja, Dhamo-ja, Çame-ja. - Aleksandër= Lleshi-i, Lekë-a, Sandër-i, Sandër-a (f). - Athanas=Nasi, Nase-ja, Naço-ua, Nasho-ua, Thanë-a. -Anton= Ndonë-a, Toqe-ja, Noi, Noc-i, Noka, Ndokë, Doni. Dhimitër = Dhimo-ja, Dhimash-i, Mitr-i, Mitro-a, Mitrush-i. - Ekaterinë= Rinë-a, Kato, Katelino, Lino-a, Katrinë. - Filip= Filo, Lipe, Thëlip-i, (ose Thilip-i), - Gjergj= Gjergo-ja, Gjikë-a, Gjokë-a, Jorgo, Gaqo-ua, Gegë-ja, Xhoxhi-a. - Hristo= Risto, Lito, Kiço, Rici, Lici, Ciko, Cikë-a, Ristë. Emra mohamedanë 24, pa përfshirë variantet e ndryshme të tyre: Abidin= Bido - Adem= Demo, Demkë. - Hysejn= Hyso, Cene-ja. -Islam= Lame, Lamçe. - Mehmet= Meço, Meto. - Nuredin= Nure, Nuri (më i theksuari) - Rustem= Rustë, Rusto. - Salih= Salkë, Saliko. - Xhafer= Xhafo. - Zeqir= Zeqo. Janë dhe një numër emrash pa variante të tyre (gjithsej 43) si: Bilo, Bodo, Çurri, Diellë, Dude, Dudi, Dhoqinë, Galo, Ganxhë, Habo, Hajdho, Hënë, Kadifkë, Koçë, Kondesë, Kondë, Korrë, Llambri, Lele, Lilo, Lono, Lule, Lulë, Malo, etj."[363]

Mitko leksikograf (Fjalorit italisht-greqisht-shqip)

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë patriotike dhe e vlerësuar lart nga vet Thimi Mitkoja, ishte mbledhja e fjalëve shqipe, sistemimi i fjalësit dhe hartimi i fjalorëve, një pasuri e vërtetë kjo sipas tij. Ai kishte grumbulluar një fond të pasur me fjalë dhe shprehje shqipe prej vendlindjes së tij, Korçës, ku kishte kaluar fëmijërinë dhe rininë.

Mitko-leksikograf, e realizoi mbledhjen e leksikut të gjuhës shqipe në forma të ndryshme: a) nga kontaktet me bashkatdhetarët e tij- emigrantë në Egjipt, b) nga udhëtimet dhe takimet e tij të shpeshta që kishte me shqiptarë në Rumani, Bullgari, Turqi; c) me letërkëmbime që realizonte me rilindës dhe patriotë të shumë shqiptarë.

[363] Isuf Bazaj, *Leksiku apelativ e onomastik në makro e mikrostrukturën e fjalorëve shpjegues e dygjuhësh të shqipes*, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës shqipe, Disertacion Doktorate, Tiranë, 2014, fq.173-175.

Punën me të ngjeshur për mbledhjen e leksikut të shqipes, Mitko e realizoi pasi u vendos në Egjipt.

Dëshmitë për angazhimin e kamotshëm të tij si leksikograf e leksikolog na dalin nga botimi i artikullit "*Rreth Korçës*" në gazetën *"Pandora*" të datës 1 janar 1860, ku përfshihet edhe një shkrim i tij me titull "*Leksikografi greko-shqiptare*". Këtu autori, pos tjerash ofron edhe shpjegimin e kuptimit të afro 80 fjalëve.

Megjithëkëtë, vlerësojmë që puna më kulmore e Mitkos në fushën e gjuhësisë, është dorëshkrimi i *Fjalorit italisht-greqisht-shqip*, i cili fjalor, me synim të qartë të autorit, u hartua si mjet afrimi mes këtyre tre popujve (italian, grek dhe shqiptar).

Sa i përket dorëshkrimit të fjalorit të Thimi Mitkos, "*Fjalori italisht-greqisht-shqip*" me rreth 326 faqe, nuk mund të jepet ndonjë datë e saktë rreth fillimit të punës për hartimin e tij e as të përfundimit, por nga letërkëmbimet që Mitkoja ka pasur me rilindës të shumtë, mund të kuptohen planet e tij për t'u marrë me leksikografi dhe ortografinë që ai do të përdorte. Sipas studiuesve të ndryshëm thuhet se Thimi Mitkoja filloi të interesohet për mbledhjen e leksikut të gjuhës shqipe qysh në vitin 1859, në kohën kur ai ishte në Vjenë.

Nga një letërkëmbim që Thimi Mitkoja realizoi me Konstantin Kristoforidhin më 23 mars 1872, ai thekson *se"... një herë e një kohë un e kam studiuar gjuhën tonë dhe kam mbledhur disa fjalë shqipe..." ndërkaq në dhjetor të vitit 1887 ai e ka pyetur Th. Krein për kuptimin e fjalëve shqipe* orë, korë dhe kodhe[364]

Thimi Mitkoja ka punuar për hartimin e fjalorit trigjuhësh italisht-greqisht-shqip, njëkohësisht edhe për mbledhjen e materialeve folklorike, për afro 30 vjet. Duke u bazuar në vlerësimet e studiuesve, por edhe në përshkrimet që autori jep rreth punës së fjalorit të lartshënuar, mund të pohohet se ky fjalor ka qenë i gatshëm për botim rreth viteve 1887-1888.

Duhet pohuar me këtë rast që përpjekjet për sjelljen e dorëshkrimeve të Thimi Mitkos në Shqipëri kanë filluar qysh në qershor të vitit 1937, në kuadrin e festimeve të 25-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe "*në atë kohë Legata Shqiptare në Kajro ka pasur një letërkëmbim me Dhimitër Mitkon (djalin e Thimi Mitkos) për të siguruar dorëshkrimet që ruheshin nga pasardhësit e Thimi Mitkos"*[365]

Fjalori *Italisht-greqisht-shqip* i Thimi Mitkos, pasqyron gjendjen e shqipes në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Autori ka pasur një njohje të mirë të gjuhëve greke dhe italiane. Në kolonën e parë të fjalorit trigjuhësh ai ka vendosur italishten, në kolonën e dytë (të ndërmjetme) ka vendosur greqishten dhe në atë të tretën shqipen.

Italishten e kishte vendosur në kolonën e parë pasi që italishten e konsideronte si gjuhë të njohur në fushën e kulturës, arsimit, prodhimit, tregtisë, fesë, etj.

[364] Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, *Thimi Mitko-Vepra* (Redaktor Qemal Haxhihasani) Tiranë, 1981, fq.621.

[365] Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), f.59,D.33-Letërkëmbim nga 25.06.1937 deri më 08.10.1937, 9 faqe.

Greqishten e ka vendosur në kolonën e ndërmjetme, plotësuese me vlera për shpjegimin e fjalëve dhe frazave. Në mjaft raste autori i këtij fjalori është nisur nga gjuha shqipe për të dhënë shpjegimin e fjalëve në italisht dhe greqisht.

Fjalësi që buron nga teksti i transliteruar i fjalorit "*Italisht-greqisht-shqip*", përmban 5093 (+/- 10) fjalë.

Sa i përket fjalëve shqipe Thimi Mitkoja shpesh gjatë punës së fjalor, ka hasur në vështirësi të sjellë fjalën apo fjalinë përgjegjëse, veçmas kur ka të bëjë me terminologjinë urbane, industriale të italishtes dhe të greqishtes. Arsyeja për këtë dihet sepse në *"kohën e hartimit të fjalorit, trojet shqiptare ishin në shkallën më të ulët të zhvillimit dhe në skajin më të errët të Perandorisë Osmane në mesin e shekullit XIX"*[366].

Përfundime

Nga tërësia që parashtruam më lart, me bindje të plotë mund të themi që Thimi Mitkoja është figura më e shquar në mesin e të gjithë rilindësve tanë, i cili fitoi përvojë të çmuar në mbledhjen e folklorit shqiptar dhe me të drejtë quhet themeluesi i folkloristikës së popullit shqiptar. Kjo sepse, asnjëherë nuk pushoi duke punuar dhe ndihmuar në dobi të gjuhës shqipe. Ai vazhdimisht synonte që shqipen ta pasurojë, ta zhvillojë dhe ta bëjë të aftë për të realizuar probleme jetësore që i ishin shtruar përpara popullit shqiptar, prandaj pothuajse tërë jetën e vet ia kushtoi gjuhës, veçmas mbledhjes së fjalëve të rralla, fjalëve të vjetra dhe leksikut krahinor të shqipes.

Sa i përket vlerës dhe pastërtisë së gjuhës shqipe, Mitkoja ishte i mendimit se gjuha e vërtetë e popullit shqiptar jeton në trashëgiminë e pasur të letërsisë popullore, e cila sipas tij duhet të vihej në bazë të gjuhës së njësuar. Një ide të tillë ai e ka paraqitur edhe në parathënien e botimit të "*Bletës*" ku shprehet "*se qëllimi i materialeve të botuara është shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë të fjalëve dhe teksteve shqipe..., veçanërisht nxitja e bashkatdhetarëve shqiptarë për studimin e gjuhës amtare dhe të kulturës së tyre.*

Gjatë punë së tij krijuese e studimore prej njohësi të folklorit dhe të gjuhës, Thimi Mitkoja ka hartuar dhe ka lënë në dorëshkrim fjalor dhe fjalës si : Fjalësin *Shqip-greqisht*, të botuar në *"Bletën Shqiptare*" në vitin 1878, ku jepen shpjegimet për fjalët e huaja (greqizma, turqizma); Fjalorin "*Greqisht-Shqip*" me 145 faqe, i cili nuk ka vit të fillimit e as të mbarimit të tij (AQSh, F.59.D.18); *Fjalorin Greqisht-Shqip,* me 165 faqe, po ashtu pa vit (AQSh,F.59.D19.); *Fjalorin Shqip-Greqisht*, me 1973 skeda, pa vit (AQSh, F.59.D.19, D.20/2-20/10); *Fjalorin Italisht-Greqisht-Shqip*, 326 faqe dhe me rreth 5093 fjalë.

[366] Shpëtim Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos, Transliterimi dhe fjalësi shqip* II, "West Print", Tiranë, 2013, fq.51.

ADELINA ÇERPJA (TIRANË)

MBIPËRDORIMI I ZANORES *Ë* NË SHKRIMET E THIMI MITKOS

1. Vepra e Thimi Mitkos ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, konkretisht në periudhën e Rilindjes, në të cilën gjuha e njësuar shihej si një armë e fortë në edukimin patriotik e kulturor të popullit shqiptar. Vetë Th. Mitkoja nuk mjaftohet me vetëndërgjegjësimin, por përpiqet ta përcjellë dhe te lexuesit e tij rëndësinë që kishte gjuha, sidomos në atë periudhë të vështirë për shqiptarët, duke iu referuar dhe fjalëve të Herderit: "Një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet", se shqiptarët, si gjendeshin atëherë të përçarë nga besimet fetare, do të zhduknin paditurinë "vetëm duke studiuar gjuhën e tyre amtare.[367]

Një ndër kontributet me vlerë të Th. Mitkos përbën dhe letërkëmbimi i tij i dendur me disa prej figurave më të njohura të kohës[368]. Ndonëse një pjesë janë shkruar jo në gjuhën shqipe, ne jemi ndalur konkretisht në letrat origjinale të Mitkos në gjuhën shqipe (duke lënë mënjanë letrat e përkthyera), si një dëshmi e gjendjes së shqipes në atë kohë të trazuar për shqiptarët, si edhe e përpjekjes së tij të madhe për ta lëvruar dhe përparuar gjuhën e vet amtare.

Në morinë e letrave të shkruara prej Mitkos në gjuhën shqipe bie në sy një korrespondencë e dendur dhe e rregullt me Jeronim De Radën që prej vitit 1879 deri në vitin 1889. Po ashtu në gjuhën shqipe u është drejtuar Mitkoja edhe arbëreshit Dh. Kamarda (1868, 1869, 1878), si dhe albanologut çek Jan Urban Jarniku (1889, 1890).

Kemi menduar që në këtë letërkëmbim të shohim përdorimin e zanores 'ë', duke e krahasuar me përdorimin e saj në shqipen e sotme, për të parë jo vetëm ndeshjen e saj në atë kohë, por dhe prirjen dhe evoluimin e saj ndër vite.

Ajo çka bie në sy është se nuk hasen raste të mungesës së zanores ***ë*** krahasuar me shqipen e sotme. Prandaj do të ndalemi kryesisht në përdorimin e kësaj zanoreje në pozicione të ndryshme nisur nga vendi i theksit: në rrokjen e theksuar, në rrokjen paratheksore dhe në rrokjen pastheksore.

2. Zanorja *ë* e theksuar

Sipas kodit të sotëm drejtshkrimor[369], "Shkruhen me *ë* të gjitha fjalët te të cilat kjo zanore e theksuar i përgjigjet historikisht një *a*-je të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore". Të tillë shembuj hasen plot në letrat e Mitkos.

*Me të parrëfyer gëzim mora letrën **tënde** mbë të 19tën të muajit shënuar.*

*Pse brënda ndë Shqypëri nukë mundin të **bëjnë** gjë nga frika e trembësia.*

---

[367] *Vepra*, Thimi Mitko, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Instituti i Kulturës Popullore, Sektori i prozës dhe i poezisë, Tiranë, 1981, f. 50.

[368] *Vepra*, Thimi Mitko, vep. e cit.

[369] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Komisioni hartues: Prof. Androkli Kostallari (kryetar), Prof. Mahir Domi, Prof. Eqrem Çabej, B. shk. Emil Lafe. Akademia e Shkencave e RS të Shqipërisë. Tiranë, 1973, § 3.

*Përveç kësaj ra edhe trëmet (teremoto) i math ndë fshat tim, Korçë, po edhe nuku di sesa **dëm** ka bërë*.

Por autori, ndryshe nga drejtshkrimi i sotëm që ka normëzuar format me *e*[370], shkruan me *ë* dhe rastet kur zanorja e theksuar ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (*m, n, nj*):

*Me **dhëmbëje** të madhe të zëmbërës të them, vëlla, se Shqipëria s'ësht'e bashkuarë.*

*Tani Abdyl beu **gjëndet** në Janinë, ne fëmija e ti, po nuk di a në Janinë **brënda** është.*

Ai ruan shkrimin me *ë* edhe në fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nëse ka ndodhur zhvendosja e theksit apo jo:

*Trëmbem se mos m'i marrë Italija bijtë ndë ushtri (soldati), pasi të jem shkrojturë **vëndës**.*

*Mos **u zëmëro**, sepse nuk të shkrojta qëmoti.*

Në përgjithësi Mitkoja është treguar i qëndrueshëm në shkrimin e kësaj zanoreje. Dhe ato pak luhatje që vihen re, ndeshen pikërisht në shkrimin e këtyre fjalëve, pra në përdorimin e zanores së theksuar *ë* ose *e* kur ajo ndiqet ose është ndjekur nga një prej bashkëtingëlloreve hundore *m, n, nj*:

*Më **dhemb** zëmëra për "Flamburin", po çë mund të bënj.*
*Sa më **dhëmb** zembra për Flamurin e për gluhën tënë!*
*E i shkruajta këtë **mëndëje** Sami beut në Kostandinopojë.*
Ngritëja (la revoluzione) *e Shqypërisë, pas **mendëjesë** sime, do ngjatetë shumë.*
*Dërgo disa fletë Bukuresh me këtë ymnë; le t'u ngrohet **zemëra** capak.*
*Jam e mbledh për "Flamurin", por mezi e më digjet **zëmëra.***

3. Zanorja *ë* e patheksuar

3.1. Zanorja *ë* paratheksore. Sipas normës së sotme drejtshkrimore[371], dhe në shkrimet e Mitkos shkruhen me *ë* paratheksore fjalët në të cilat ajo i takon rrokjes së parë:

*... lexova me habi (kureshtje) në gazetën greke "Iris" letrën tuaj, me anën e së cilës pashë **ta dënonit** atë si të të drejtave të shqiptarëve.*

*Unë i dërgova zotërisë sate bileta edh' e nrova (a gëzova) për vitin e ri, ta shkonjë me gaz e të mira shumë me gjithë **fëmijë**.*

Po kështu shkruhen dhe fjalët e formuara prej tyre:

*Unë **dëshironja** qëmoti të vinj ndë Siçili e Kalabri, po nuk' mundem sotpërsot.*

*... po dëme të mëdhenj që më mbinë ndë këta të pastajmit vjetë më kanë ndalurë nga disa punëra e **dëshirime.***

Shkruhen me zanoren *ë* paratheksore dhe fjalë të prejardhura me prapashtesa që nisin me bashkëtingëllore, si dhe fjalët e përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë më *-ë*, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore:

[370] *Drejtshkrimi* ..., vep. e cit., § 1.
[371] *Drejtshkrimi* ..., vep. e cit., § 5.

*Të falem me nder **zotërisë** sate e të puth sytë si vëlla kombëtari (congenere) yt.*

*Hasan pashaj, një nga të bijt e ati që është ushtërtuar e **i shumëdashurë** ndë Berlin, ka ndërment të bëhet princ (principe) i Shqypërisë.*

Rolin e zanores mbështetëse luan *ë*-ja dhe në fjalë të prejardhura të formuara nga tema me bashkëtingëllore, por me një strukturë fonetiko-fjalëformuese të ngjashme me ato më sipër:

*Megjithatë do të më lejoni të ju kujtoj se është nevojë absolute që Shqipëria të fitojë sot gjuhën dhe **kombësinë** ...*

Por, ndryshe nga sa përshkruhet në drejtshkrimin e shqipes[372], në shkrimet e Mitkos përdoret zanorja *ë* dhe në fjalët e prejardhura të formuara nga tema më bashkëtingëllore me anë të prapashtesave ***-**tar(e), -tor(e), -ti, -toj*:

*Po unë do përpiqem si për vethen time e do kërkonj një ndihmë ndëpër **shqypëtarët** e Egjyptit.*

*Unë jam mirë me gjithë fëmijën, por **tregëtia**, qëkur hyri anglezi n'Egjyptë, nuk na vete mbarë.*

Haset tek-tuk në letrat e marra në shqyrtim dhe përdorimi i zanores *ë* në fjalët e prejardhura të formuara nga tema me bashkëtingëllore të lëngëta me theks në rrokjen e fundit:

*Mos e dërgo tashi birin tënt, tek janë kaq **ushtëri** turqish andej e ata kusarënjën më keq.*

Të tjera raste të mbipërdorimit të zanores paratheksore *ë* janë dhe në fjalë që sot dalin si njërrokëshe, p.sh.:

***Këjo** udh'e birit tënd do t'i sjellë të madh fitim Shqipërisë te ku gjithë diert do t'i hapen me hirë.*

*Pasi të marrënjëm edhe të tretën, do të nis **të mbëledh** të hollat.*

*Sepse, po të shkruhem sot, duhet **të përes** (aspetare) 10 vjet, pra të kem liq të marr pashaportë.*

Ka dhe raste të tilla në të cilat autori shfaqet i luhatur në përdorimin e zanores *ë*, si p.sh.:

*Sotir Koka rri në Zagazig edh'është i bëgatë **mëjaft**, po fort dorëshkrënguarë.*

*Letra e Vretos, që patët mirësinë të më dërgoni bashkë me letrën tuaj, është **mjaft** trashanike.*

Tek-tuk vihen re dhe raste të metatezës, si dhe të përdorimit të zanores *ë* në vend të asaj *i*:

*Pashë në ditare **grëqishte** se ka dalë në Itali një librë shqypëje.*

*... të të lutem që **ta shëkosh** pakëzë ti ku ndryshojmë.*

*M. **dëshëron** të marrë të gjitha librat e shkruara për Shqipërinë ...*

3.2. Zanorja *ë* pastheksore. Te Mitkoja vihet re përdorimi i zanores *ë* pastheksore në të gjitha rastet e parashikuara në drejtshkrim[373], si p.sh.:

[372] *Drejtshkrimi* ..., vep. e cit., § 5.
[373] *Drejtshkrimi* ..., vep. e cit., § 6.

- tek emrat femërorë më *-ëz*, tek emrat e mbiemrat mashkullorë më *-ës* dhe te femërorët përkatës, në të gjitha trajtat e lakimit të tyre:

*Le të nisëjë të dalë në dritë e mjera **gjuhëza** jonë ...*

*Kur isha duke qëndruar përkohësisht këtu, lexova ... letrën tuaj ... me anën e së cilës pashë ta dënonit atë si **mbrojtës** të të drejtave të shqiptarëve.*

-te trajta e vetës së dytë njëjës e së tashmes së mënyrës lidhore të foljeve me temë më bashkëtingëllore:

*Të dërgova edhe një gazetë gërqishte që **të shohësh.***

*... përpiqu **të bindësh** aty nja dy patriotë, që të jenë, mundësisht, në gjëndje të derdhin shumën.*

Por, përveç tyre, në letrat e Mitkos hasen dhe raste të përdorimit të zanores *ë* pastheksore ndryshe nga sa janë kodifikuar në drejtshkrim. Kështu autori e përdor rregullisht këtë zanore te format e ndryshme të lakimit të emrave dhe të mbiemrave më *-ël, -ër, -ërr*, edhe kur pas tyre vjen një zanore:

*Kam usdaj, zotërinë tuaj tju gjenjë shëndoshë e mirë këjo **letëra** ime.*

***Pjepëri**, kungulli dhe imoniku piqen fort mirë.*

*Kemi **fshatëra** (katunde) ndë Shqypëri me **emëra.***

*Mua më lypset (mi manca) **numëri** 4 i "Flamurit".*

*M. M. Markosë, **dhëndërit** tim, dërgoia fletët nd'Aleksandri.*

*Edhe afër Adrianopulit, 6 **fshatëra të vogëla**, edhe afër Dunavit një fshat çë e thonë "Rasgrat".*

Po ashtu ndeshet zanorja *ë* pastheksore te format e ndryshme që marrin gjatë lakimit mbiemrat më *-ëm* dhe më *-shëm*, kur pas tyre vjen një zanore:

*Pse qevernia nukë le ndë Shqypëri as **së brëndëshmi**, as **së jashtëmi** të shkruanjën liruarë.*

*Erën e ka **të shëndetçëme**, as të nxhetë, as fortë të ftohët.*

Pas rrokjes së theksuar vihen re dhe raste të metatezës, si p.sh.:

*Prej Meyerit pata një **librë** "Della lingua e della letteratura albanese" në gjuhën italishte.*

*Pashë te ditaret se Italia hapi kolegje me gjithë të ngrënët (con allogio) pa pagim, Janinë, Prevezë, **Shkodrë** etj.*

*Njëditëzaj më kish dërguar ay nja ditëtore (giornale)6 "La Riforma" tek u kish një artikëllë **kundrë** shqypëtarëvet.*

*Për këtë punë u rrahën me shqipëtarët ndë Shibin-el-Kom, po **hëngërën** dru, sa u lodhën.*

3.3. Zanorja *ë* pastheksore fundore. Në përgjithësi shkruhet *ë*-ja fundore te fjalët me theks në rrokjen e parafundit, si dhe në trajtat që marrin këto fjalë edhe kur kjo zanore nuk është më fundore.

*Kjo **punë** duhet bërë "sa më çpejt, më mirë".*

*Sa më dhëmb zembra për Flamurin e për **gluhën** tënë.*

Po kështu ruhet *ë*-ja fundore dhe te emrat femërorë, si dhe te një grup emrash mashkullorë:

*Mitkoja e pyet Th. Krejin për kuptimin e **fjalëve** orë, korë.*

*Pyeta zotërinë tënde për një **djalë** 12 vjeç lerë këtu ...*

*Si **burrë** shteti dhe kryeministër ai ishte shprehur në dobi të lirisë së popujve të Ballkanit.*

Dhe trajtat e shumësit të emrave dhe të mbiemrave mashkullorë shkruhen rregullisht me *ë* fundore:

*Tani, pasi u afrua lufta ndë Kostandinopojë, mbesoj se ata **shqipëtarë**, miqtë e gjuhës, do të kenë ikur s'andejmi.*

*Përpiqu të bindësh aty nja dy **patriotë** që të jenë, mundësisht, në gjëndje të derdhin shumën.*

Ndonëse në shqipen e sotme është i qartë dallimi midis çifteve të mbiemrave me *ë* dhe të ndajfoljeve pa *ë*, te Mitkoja haset dhe ndonjë rast i shkrimit të ndajfoljes me *ë* fundore:

*Ismail pashë Jysrit edhe Nerucos në Aleksandri shkruaju **drejtë** ...*

Po kështu ruhet *ë*-ja fundore dhe te numërorët rreshtorë:

*Dje muarëm edhe **të dytën** fletë të "Flamburit t'Arbërit".*

*Numurin **e gjashtë** të "Flamurit" e pata e më pëlqeu mbë të gjitha.*

Ndryshe nga sa është kodifikuar në shqipen e sotme letrare, në të cilën shkruhen pa *ë* fundore pjesoret me temë më tog zanor, të cilat theksin e kanë në rrokjen e parafundit, te Mitkoja këto forma pjesoresh dalin rregullisht me *ë* fundore. Po kështu dhe pjesoret më *-ur* dhe gjithë mbiemrat prejpjesorë që formohen prej tyre:

*Gjithë vendarët (patrioti) **e dashurë** gjenden **të helmuarë** për fatkeqërinë e Shqypërisë.*

*Ndër përrallatë që kam e po bënj gai për të **dërguarë**, pashë një të "qoses" **shpallurë** prej z/sate ...*

*Këtu ke se sa emëra kanë **paguarë** gjerë sot ...*

*Në Kostantinopojë nukë ka **vajturë** kurrë.*

*Këtë lëpushë Ethnikoj Dhesmoj ma dërgoi me anë të Kupitorit, për të **nkthyerë** shqyp ...*

*E mira është se Abramidi qëndron pa **tundurë**, e të tërë gjën'e tij e ka **falurë** për gjuhën.*

Me *ë* fundore dalin dhe mbaresat e trajtës së shquar njëjës të emrave në rasën gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore:

*Kam dy lëpushët e zotërisë sate të 8 e të 18 **prillitë ...***

*Dëgjova të gjitha sa më shkruan për udhën e **politikësë** së Rusisë, Austrisë dhe Italisë*

*Falem - **nderësë** zotërisë sate për katalogun e burrave shqypëtarë të Italisë që më dërgove ...*

***Kartënë** tënde të 27^së majit e mora, e po të përgjegjem.*

*Ngritëja (la revoluzione) e Shqypërisë, pas **mendëjesë** sime, do ngjatetë shumë, po duhet një dor'e fortë.*

Me *ë* shkruan autori dhe mbiemrat e ndajfoljet, si dhe pjesë të tjera të pandryshueshme të ligjëratës, si:

*Idhea jote për të ngrehur një typografi arbëreshe në Italitë do jetë një pun'e një shërbesë fort **e bukurë** për vendërinë tënë*

*Shumë **shkurtërë** të shkruanj, po me gjithë zemërë të dua e të puth 'sytë.*

*Do të rri këtu, ndonëse gjendemi ndër njerëz **t'egërë** e ndë rrezik.*

*S'është moti t'i shkruanjësh as Kokës,, as jetëri, 'se ikën të gjithë, siç thashë **sipërë**.*

*Mos u zëmëro, sepse nuk të shkrojta qëmoti, përse pata shërbesë këtu edh' Aleksandri 20 ditë **afërë**.*

*... sotpërsot gjendem **nënë** frikë, sikunër i mëson punëtë prej ditaresh.*

*Sot **nukë** kam ndonjë më të re të të shkruanjë, po veç të të mbyll të ngëthyemen të "Pater i mon" pas mëndjes sime e të të lutem që ta shëkosh **pakëzë** ti ku ndryshojmë.*

*Jam gëzuarë **tepërë** dua të ble atë librë **aqë** të vëlejshimë*

*Po **vetëmë** dy vjet 1887-88 nuk muntnin të nxënë gjë të madhe*

Po kështu me zanoren *ë* fundore dalin dhe trajta të njëjësit të pashquar në rasën kallëzore:

*Por më vjen keq (mi displace) se nuku mund të nxe [...] vërtetë këtë **misterë** ...*

*Ishnja vajtur nd' Aleksandri, përse m'u sëmur fort Ime bijë e me **hirë** të zotit u shëndosh.*

*Njëditëzaj më kish dërguar ay nja ditëtore (giornale)"La Riforma" tek u kish një **artikëllë** kundrë shqypëtarëvet.*

Mitkoja shkruan me *ë* fundore dhe trajtat e shumësit në rasën emërore e kallëzore:

***Këngëtë** për z. tënde po i mbleth. Edhe **libratë** të mia po i pres.*

*Muhamedanët bëjnë shala, mbathin **kuajtë** etj.*

*Ndër **përrallatë** që kam e po bënj gati për të dërguarë, pashë një të "qoses" ...*

*... përse në Egjyptë gjendem nënë frikë, sikunër i mëson **punëtë** prej ditaresh.*

*Zunë edhe **shokëtë** në Kostandinopojë të nxierrënjën një fletë shqype.*

Lidhur me shkrimin e formave foljore, Mitkoja shkruan rregullisht me *ë* fundore format joveprore të së tashmes së mënyrës dëftore, si dhe format që vijnë prej tyre:

*Ndodhur Shqipëria në mes dy dritrave të mëdha, **do të ndritsonetë** edhe **do të mësonetë**, por sotpërsot ka Elladha gluha na **prishetë**, edh-e na humbet ngaditë.*

*Ndë mundtni t'i bëni edh'aty zotëria juaj, është mirë, sa **t'i ngrohetë** zembra njeriut ...*

Po ashtu, për foljet me temë më bashkëtingëllore, shkruan me *ë* fundore dhe format e vetës I e III shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore dhe lidhore.

*Por sotpërsot nuku duhet **të heshtimë** a të shugatemi sa për Shqypërinë.*

*Më ndëleni zotënia juaj të u shënoj disa fjalë çë pashë ndë të ndershmen të shkruamen tuaj, cilatë na i **folasimë** ndrishe.*

***

Ashtu si dhe në shkrimet e tjera të Th. Mitkos, edhe në letërkëmbimin e tij mbizotëron e folmja toske. Megjithatë vihet re herë pas here përdorimi i ndonjë fjale apo forme nga zona të tjera të Shqipërisë, ashtu siç vihet re përdorimi i ndonjë fjale në arbërishte, apo i fjalëve dhe i shprehjeve në italishte, kjo veçanërisht në komunikimin me J. De Radën.

Një nga dallimet më të dukshme fonetike ndërmjet toskërishtes dhe gegërishtes është ruajtja apo rënia e zanores *ë*, dhe në shkrimet e Mitkos kjo zanore haset jo vetëm sipas rregullave të drejtshkrimit të sotëm, por dhe në fjalë e forma fjalësh në të cilat sot kjo zanore ka rënë.

Zanorja *ë* ndeshet në pozicione të ndryshme, qoftë në rrokje të theksuar, qoftë në rrokje të patheksuar para ose pastheksore. Mbizotëron në shkrimet e Mitkos përdorimi i zanores *ë* të patheksuar në pozicion fundor, dhe kjo jo vetëm në fjalë të ndryshme, por veçanërisht në format me të cilat fjalët dalin në paradigmat e tyre, si në format emërore apo mbiemërore, ashtu dhe në ato foljore.

Në letrat e Mitkos vihet re një përdorim i qëndrueshëm i zanores *ë* në të gjitha pozicionet. Janë shumë të pakta rastet e luhatjes, aq sa mund të mendohet më shumë për ndonjë gabim në shkrim, sesa për dy përdorime të ndryshme.

Përkujdesja që ka treguar Mitkoja në shkrimet e tij në gjuhën shqipe, si dhe përpjekjet e tij të shumta për përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve të rralla, për formimin e fjalëve të reja po nga fjalë të shqipes, krahas veprimtarisë së tij konkrete patriotike, bëjnë që Th. Mitko të zërë një vend të veçantë krahas figurave të tjera të Rilindjes shqiptare.

AIDA KURANI (DURRËS)

FJALIA RRJEDHIMORE NË PËRMBLEDHJEN FOLKLORIKE "BLETA SHQIPTARE" TW THIMI MITKOS

Dihet se struktura gramatikore e shqipes së sotme letrare, në vija të përgjithshme, pasqyron strukturën gramatikore të gjuhës popullore, ndaj në fazën e sotme të zhvillimit të shqipes standarde dhe me kërkesat që dalin përpara gjuhësisë shqiptare, rëndësi të veçantë merr studimi i gjuhës popullore si një domosdoshmëri për të njohur më mirë e më thellë strukturën gramatikore të gjuhës shqipe, origjinalitetin e saj. Në këtë kontekst është po aq me rëndësi të studiuarit e gjuhës së folklorit, i cili *pasqyron* identitetin kombëtar shqiptar, kulturën materiale dhe shpirtërore të tij përmes gjuhës së gjallë, ligjërimit të përditshëm.

Sintaksa popullore ruan ende vlera të pashfrytëzuara, ndërtime e kuptime, mjete dhe mënyra të shprehjes së marrëdhënieve sintaksore që mund të shfrytëzohen si për të studiuar në mënyrë më të thelluar strukturën gramatikore të shqipe, veçoritë tipologjike të saj, ashtu edhe për të pasuruar më tej me ndërtime të reja, me vlera të reja strukturore e kuptimore shqipen e sotme standarde, për të mënjanuar ndërtimet sintaksore që vijnë pa nevojë si pasojë e ndikimeve nga gjuhë të tjera dhe për të vlerësuar bazën popullore dhe zhvillimet moderne në strukturën gramatikore të gjuhës standarde shqipe. Ndërtimet e ndryshme sintaksore të ligjërimit popullor, të thjeshta e në harmoni të plotë me natyrën e shqipes, e ruajnë atë nga ndërtimet e huaja të panevojshme, që ia rëndojnë dhe ia ndërlikojnë asaj strukturën sintaksore.

Këtu zë një vend të veçantë dhe përmbledhja folklorike "Bleta shqiptare", e Thimi Mitkos, një personalitet i shquar i Rilindjes Kombëtare, që me të drejtë ka tërhequr e po tërheq gjithnjë e më tepër vëmendjen e studiuesve tanë. Siç vëren edhe A. Kostallari, Rilindja e nxori gjuhën tonë të shkruar nga gjendja e prapambetur e shekujve të kaluar, e vuri në një rrugë të re dhe shtroi krijimin e gjuhës së përbashkët letrare si një çështje të madhe të gjithë kombit[374].

Ashtu si figurat e tjera të shquara të Rilindjes, edhe Thimi Mitkoja punoi me devotshmëri për të dhënë ndihmesën e tij për lëvrimin, pasurimin dhe pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, duke treguar se gjuha e vërtetë e popullit shqiptar jetonte në trashëgiminë e pasur të letërsisë popullore, e cila duhej të vihej në themel të gjuhës së njësuar.

[374] A. Kostallari, "*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*", Tiranë, 1973, f. 22.

Objekt të punimit tonë kemi bërë pikërisht përmbledhjen folklorike "Bleta shqiptare" të këtij autori duke synuar të japim një përshkrim të periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore[375].

Nga lënda e shqyrtuar në gjuhën popullore të pasqyruar në përmbledhjen folklorike "*Bleta shqiptare*" të Thimi Mitkos, ashtu si në gjuhën standarde, në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore sipas përbërjes së tyre strukturore dallojmë dy nëntipa strukturorë:

1. Fjali rrjedhimore *e bashkëlidhur* (korrelative). 2. Fjali rrjedhimore *jo e bashkëlidhur* (jokorrelative).

1. Fjali rrjedhimore *e bashkëlidhur* (korrelative), ku lidhëzës i përgjigjet në fjalinë kryesore një fjalë emërtuese (korrelative) e bashkëlidhur (si *aq, kaq* etj.)[376]. Sasia (masa, shkalla, intensiteti) e dëftuar nga korrelatët *aq*, *kaq*, mund të ketë të bëjë me anë të ndryshme të sendeve e të dukurive:

a) Me cilësinë e shprehur nga mbiemri, sipas tipit *aq i madh* etj.

*Nga tjatra anë urinë e kish **aqë** të madhe**, sa** s'duronte dot më pa ngrënë**.** (Th. Mitko, Vepra I, f. 374)*

b) Me një rrethanë të shprehur nga një ndajfolje: *aq mirë, aq shumë* etj.

Aq shumë u zbukurua, ***sa*** s'ia gjenjej shoqen...*(Th. Mitko, Vepra I, f. 376)*

c) Me sende konkrete ose abstrakte të shprehura me emra: *aq miq, aq trimëri* etj.

*Ani kur i vate djali, e pritën të gjithë të mëdhenjtë e pallasit, sa edh' ajo vetë me **aqë** nder, e me **aqë** karige, **sa** u kënaq ay tepërë**.** (Th. Mitko, Vepra I, f. 374)*

Fjalët *aq, kaq* rrallë mund të funksionojnë dhe vetëm, por në të shumtën e rasteve ato përcaktojnë një emër, një mbiemër ose një ndajfolje. Zakonisht ato përcaktojnë mbiemra cilësorë (duke përfshirë këtu dhe mbiemrat me kuptimin figurativ), të cilët kanë aftësinë për t'u shkallëzuar. Kuptimi i këtyre mbiemrave cilësorë lejon që tipari i emërtuar prej tyre të shprehet në masë të ndryshme. Me fjalë të tjera, kuptimi i këtyre mbiemrave cilësorë lejon që cilësia e shprehur prej tyre të shkallëzohet (*i bukur, më i bukur, shumë i bukur*). Ndër ta, më të përdorshmit janë mbiemrat që tregojnë një cilësi më të përgjithshme, si *i bukur, i dashur* etj.

*Ahere vrapo i katërti i prishi pallasin atij me puterkën e hekurtë e i dyti e goditi me **aqë** sillmë**, sa** e copëtoi fare. (Th. Mitko, Vepra I, f. 358)*

---

[375] M. Domi, *Çështje të epikës legjendare heroike* (Referat), Tiranë 1983, f. 5; Q. Haxhihasani, *Folklori dhe gjuha letrare kombëtare*, "Gjuha jonë", 1984, Nr. 2, f. 47: Në prozën popullore gjenden ndërtime e lidhje sintaksore që vlejnë të bëhen pasuri e përbashkët e gjuhës së sotme letrare. Studimi i vëmendshëm i tyre do të ndihmojë të dalin në dritë vlera të reja të gjuhës sonë.

[376] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, vëllimi II (Sintaksa), Tiranë, 2002, f. 426: Përemrat dëftorë dhe ndajfoljet dëftore që përdoren përbrenda fjalisë kryesore, në bashkëlidhje me lidhëzat e fjalët lidhëse, quhen fjalë të bashkëlidhura korrelative ose dhe korrelatë. Në gramatikat e gjuhëve të huaja këto elemente gjuhësore (fjalët korrelative) emërtohen "*fjalë shkallë*" (C. L. Baker, *English Syntax*, Cambridge, MA: MIT Press, 1989, f. 317). Por, sipas mendimit tonë, pavarësisht terminologjisë së ndryshme, funksioni i tyre është i njëjtë. Ato dëftejnë pa e konkretizuar sasinë e një sendi, masën e shkallën e një cilësie a intensitetin e një procesi.

I treti kish veshët kaqe <u>të kthjellëtë</u> sa gjegjej edhe gjer e nënë dhe... (Th. Mitko, Vepra I, f. 356)

Ndërsa nga ana e fjalëformimit, më të përdorshëm janë mbiemrat e parmë, por nuk mungojnë dhe mbiemrat e prejardhur.

*...i shtati kish sytë **kaqë** <u>të çelur</u> **sa**, shihte edhe nën dhe gjer ndë fund. (Th. Mitko, Vepra I, f. 356)*

*E po djali, kur u nkthye prapë te plaka, me gjith' ato që pësoi te çupa, ishte **kaq**' <u>i pikëlluar</u> e **kaq**' <u>i ndezurë</u> për të vajturë përsëri atje, **sa** nukë mbahej dot. (Th. Mitko, Vepra I, f. 371)*

Fjalët korrelative *aq, kaq* mund të përdoren rrallëherë edhe pa u shoqëruar nga një *emër*, një *mbiemër* a një *ndajfolje* në fjalinë kryesore:

*Ndë nji fshat atje pranë këtyrevet rrinte e bukur' e dheut e djal' i math i peshkatarit, posa e nxu atë, u shti **kaqe** pas asajë, **sa** taksi të vejë e ta marr' atë për gru*. *(Th. Mitko, Vepra I, f. 352)*

Në fjalitë rrjedhimore korrelative me konstruktin përemër *aq, kaq + emër* tregohet se sasia e madhe e sendeve ose sasia e lartë e cilësisë së emrit abstrakt është rrjedhim i asaj që shprehet në fjalinë e nënrenditur:

*Ani kur i vate diali, e pritën të gjithë të mëdhenjt e pallasit, sa edh' ajo vetë me **aqë** nder, e me **aqë** kashkariqe, **sa** u kënaq ay tepër. (Th. Mitko, Vepra I, f. 374)*

Kur fjalët korrelative *aq, kaq* kryejnë funksionin e ndajfoljes dhe shoqërohen nga një mbiemër, cilësia e sendeve që shënohen nga emrat shprehet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë përmes foljes këpujë *jam* a foljeve *gjysmëkëpujore*:

***Kaqe** e pakë qenëka vëllezëria jonë, **sa** ta jep zemëra të ikësh, e të na lesh neve? (Th. Mitko, Vepra I, f. 401)*

Në prozën popullore nuk kemi hasur përemrat *i atillë, i tillë* si fjalë të bashkëlidhura (korrelative) që dëftojnë pa e emërtuar një cilësi që sjell rrjedhim.

Gjithashtu nuk kemi ndeshur raste kur në vend të ndajfoljes *shumë* të përdoren ndajfoljet e tipit *marrisht, tmerrësisht*, të cilat janë bërë pronë e gjuhës standarde, veçanërisht pronë e stilit të letërsisë artistike.

Në prozën popullore nuk kemi gjetur as raste të përdorimit të ndajfoljes *mjaft* në vend të korrelatit *aq, kaq*. Me të drejtë S. Floqi vëren se përdorimi i ndajfoljes *mjaft* në vend të korrelatit *aq, kaq* nuk është veçori e prozës popullore, por e gjuhës standarde, e përhapur nën ndikimin e gjuhëve të huaja.[377]

2. Fjali rrjedhimore *jo e bashkëlidhur* (jokorrelative), domethënë pa ndonjë fjalë bashkëlidhëse në fjalinë kryesore. Në këto periudha, në fjalinë kryesore nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë fjalë korrelative që t'i përgjigjet mjetit të lidhjes. Kjo shkakton një lidhje të dobët ndërmjet fjalive nga ana gramatikore e kuptimore. Fjalia kryesore është përgjithësisht e plotë nga struktura dhe ndërtimi. Si tregues i lidhjes

[377] S. Floqi, *Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2 , f. 74.

është intonacioni. Fjalia e nënrenditur tregon rrjedhimin si pasojë e një shkalle të lartë të shtjellimit të veprimit.

E pa prituër më, u shti ay ndë mes të të dyvet, të Yllit edhe të Detit, e i pushtoi mirë të dy, me të dy krahët, edh' u hoth me gjith' ata mbatanë pa ndonjë rëndësirë, ***aqë sa****, kur i panë gjith' ay llauz, që ish atje, u mahnitën. (Th. Mitko, Vepra I, f. 400)*

Namëta erdhi kumbareja pas zakonit tij, të cilit gruaja, i bëri pulë të pjekurë, ve të tiganisura, edhe kulaçe e bëri një barrë gas, ***aqë sa****, ia dha plakut nga ato gjellëza... (Th. Mitko, Vepra I, f. 414)*

Skilja kur u liru nga goj' e ujkut, filloi me fugu me i shpejtsi t'madhe ***saqi*** *ujku s'mujt me e zanë ma, se kishte met gardhit. (Th. Mitko, Vepra I, f. 359)*

Në fjalinë e nënrenditur mund të shprehet edhe rrjedhim, si pasojë e shkallës së lartë të veprimit të një tipari, të një sendi, të një personi a të veprimit. Në të tilla ndërtime nuk përdoren korrelatë në fjalinë kryesore, prandaj nuk i përkasin tipit mungesor.[378]

Çika ishte e bukur, ***qi*** *kurrkund shoqja mos me iu gjetë*. *(Th. Mitko, Vepra I, f. 354)*

Si përfundim mund të themi se nga analiza e lëndës së shqyrtuar në gjuhën popullore të pasqyruar në përmbledhjen folklorike "*Bleta shqiptare*" të Thimi Mitkos, periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore del me të njëjtat tipa semantiko-strukturorë që paraqitet në shqipen e sotme letrare. Në prozën popullore, ashtu si edhe në gjuhën letrare, vëmë re praninë e korrelatëve në fjalinë drejtuese, praninë e disa treguesve leksikorë për qartësimin e saktësimin e marrëdhënieve sintaksore të fjalive, tipare tashmë të rrënjosura e të përbashkëta si për prozën popullore, ashtu edhe për gjuhën standarde shqipe.

Prania e një numri të konsiderueshëm korrelatësh të lidhëzave ***sa, aq sa, saqë*** dhe ***që*** jep mundësi për të bërë më mirë diferencimin e marrëdhënieve dhe nuancave në këtë periudhë. Vetëm në ndërtimet me karakter afektiv mund të gjejmë fjali kryesore pa korrelatë të lidhëzës.

Nga ana tjetër, mungesa e disa lidhëzave dhe korrelatëve në prozën popullore dhe që gjenden në gjuhën letrare, tregon se struktura e periudhës së nënrenditur rrjedhimore të shqipes është perfeksionuar më tej nëpërmjet krijimit të lidhëzave të përbëra me kuptim të përcaktuar dhe sferë përdorimi. Kësisoj, struktura e periudhave më fjali të nënrenditur rrjedhimore në gjuhën e sotme letrare është pasuruar më tej nëpërmjet lidhëzave të reja, si p.sh. *në mënyrë që*, lidhëz që nuk e hasim në prozën popullore.

Nga shqyrtimi i lëndës sintaksore në prozën popullore na rezulton se është veçori e sintaksës popullore përdorimi i mjeteve dhe i mënyrave të ndryshme të sintaksës afektive, si dhe përdorimi i mënyrave gjuhësore-stilistike me synime të caktuara stilistike-artistike.

[378] S. Floqi, *Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, Nr. 2, 1965, f. 58-58.

Këto anë të përbashkëta që i shohim si në rrafshin historik, ashtu edhe në rrafshin e sotëm (d.m.th. vijat e përbashkëta midis prozës popullore dhe gjuhës së sotme letrare), tregojnë, në të njëjtën kohë, edhe për vijueshmërinë e qëndrueshmërinë e strukturës sintaksore të shqipes, të paktën që nga koha e dokumentimit e, deri në ditët tona, si gjuhë që ka mbijetuar duke u zhvilluar gjithnjë e më tej.

ROZANA RUSHITI (TIRANË)
ANILA ÇEPANI (TIRANË)

VEÇORI FONETIKO-GRAMATIKORE NË LETERKËMBIMET E THIMI MITKOS

Thimi Mitkoja, një atdhetar i shquar dhe themelues i folkloristikës shqiptare, i ka kushtuar kujdes të veçantë ngritjes së nivelit kulturor e politik të shqiptarëve. Pikëpamjet e tij patriotike e kulturore ai i ka shprehur në artikujt e botuar në shtypin e kohës, si edhe në letërkëmbimet me figura të shquara të botës kulturore, ku përmendim letërkëmbimet me albanologët Gustav Majer, Jan U. Jarnik, Francesko Krispi, si dhe me rilindasit Jeronim De Rada, Dora D'Istria, Konstadin Kristoforidhi, Abdyl Frashëri, Dhimitër Kamarda, J. Kosturi, V. Dodani, Th. Krei, P. Kupitori etj. në periudhën kohore 1861-1890. Letrat e tij ngjallin interes të gjerë jo vetëm për çështjet e trajtuara në to, pasi fjala dhe veprimtaria e tij ndihmuan për gjallërimin e ndjenjave të atdhedashurisë dhe popullarizimin e çështjes shqiptare në arenën ndërkombëtare, por edhe për gjuhën e përdorur, së cilës i kushtonte vëmendje të madhe. Siç vë në dukje studiuesi Haxhihasani "Ai (Mitkoja) kishte theksuar vazhdimisht rëndësinë e gjuhës si element dallues kryesor të kombësisë; kish shtruar si kërkesë të domosdoshme të kohës edukimin e popullit me kulturën kombëtare, me gjuhën dhe shkronjat shqipe"[379]. Gjuha e tij nuk kufizohet vetëm në pasurinë leksikore dhe gramatikore të së folmes së vendlindjes, që përfshihet në të folmet e toskërishtes veriore, por Th. Mitkoja e gjallëron frazën e tij me fjalë, frazeologji e struktura të marra nga të dy dialektet, madje edhe nga të folmet e arbëreshëve të Italisë. "Ai punoi me dashuri e bindje të veçantë - shprehet Q. Haxhihasani në librin e tij kushtuar Thimi Mitkos - për lulëzimin e gjuhës amtare, që siç është theksuar nga vetë Th. Mitko, është "ushqimi i parë i përbashkët që i ep gjallëri popullit"[380].

Veçoritë e gjuhës së tij në këto letërkëmbime[381], parë në këndvështrimin fonetik e gramatikor, do të jenë objekt i kumtesës sonë. Përkundër përpjekjeve të Th. Mitkos për njësimin e gjuhës shqipe, prirje e përgjithshme kjo e të gjithë rilindësve tanë, në letrat origjinale të tij, të cilat duhet thënë se nuk kanë qenë në vëmendje për gjuhën dhe stilin e tij nga studiues të tjerë, vihen re lëkundje në shkrimin dhe përdorimin e fjalëve dhe strukturave të ndryshme, të cilat ndeshen në variante të shumta, sidomos në përdorimin e trajtave foljore. Kjo, sipas mendimit tonë, është pasojë jo vetëm e mungesës së një formimi filologjik të tij, por edhe e përpjekjeve për të gërshetuar në gjuhën e tij elemente të folklorit, interesi ndaj të

[379] Th. Mitko, *Vepra*, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Instituti i Kulturës Popullore, Sektori i prozës dhe i poezisë, Tiranë, 1981, f. 25.
[380] Q. Haxhihasani, *Thimi Mitko*, N. sh. Botimeve "Naim Frashëri", Tiranë, 1962, f. 4.
[381] Kemi shfrytëzuar letërkëmbimet e botuara në pjesën e fundit të përmbledhjes së veprës së Th. Mitkos nga studiuesi Qemal Haxhihasani (Th. Mitko, *Vepra*, vep. e cit., f. 607-714). Një pjesë e këtyre letrave janë të përkthyera, ndaj na është dashur të përqendrohemi vetëm te letrat origjinale të cilat janë dëshmi reale e gjuhës së përdorur prej Mitkos.

cilit do ta shoqërojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Për arritjen e këtij qëllimi u ndihmua nga mjedisi shqiptar që gjeti në vendet ku emigroi, sidomos në Egjipt, ku pati mundësi të mblidhte thesare të trashëgimisë popullore, këngë, fjalë të urta, përralla që ruajnë e mbajnë gjallë shpirtin e një kombi, fjalë toske e veriore, por edhe arbëreshe, duke kapërcyer kufijtë e së folmes së zonës së vet.

Po cilat janë disa nga veçoritë më të spikatura të gjuhës së Th. Mitkos?

Ndër veçoritë fonetike përmendim:

1. **Përdorimi i tepërt i fonemës *ë* në pozicione të ndryshme,** por sidomos në atë fundor në disa pjesë të ligjëratës, kur dihet se kjo zanore me gjithë rolin e madh që ka luajtur në sistemin e eptimit, ka rënë në shumë pozicione[382], ndaj nuk është ruajtur kudo.

emra: *anësë, armëtë, punëtë, armëtë, përrallëtë, nderë, artikëllë, sistemë, ditaretë, emërë,*
falemnderësë, flamurë, huajtë, këngëtë, kishësë, kombësisë, kreravetë, libratë, marsitë, mendëjesë, mendjesë, mjeshtërë, muajitë, nderë, nderësë, nderjësë, numërë, prillitë, tradhitorë, trathtorë, zemërë.

folje (pjesoret dhe gjithë mbiemrat prejpjesorë që formohen prej tyre; format e kohës së tashme të mënyrës dëftore dhe lidhore; format joveprore të së tashmes së mënyrës dëftore etj.): *bashkuarë, ardhurë, hapurë, afrohetë, helmuarë, helqurë, detyruarë, gëzuarë, humbasë, lëruarë, liruarë, marrë, martuarë, mbaruarë, mbeturtë, mbledhurë, mentohetë, mërguarë, ndrequrë, ndriturë, ngrohetë, nkëthyerë, nkthyerë, mundetë, pamartuarë, pikëlluarë, plagosurë, prishetë, quhetë, pasurë, paturë, për të hapurë, rendurë, shëruarë, shkrojturë, shkruajturë, shkruarë, shkuarë, prishetë, tundetë, taksurë, tundurë, vdekurë, zëmëruarë, zihetë*.

mbiemra e ndajfolje, si dhe pjesë të tjera të ligjëratës:
afërë, cilatë, cilëtë, kaqë, katërë, kërshterë, lartërë, likshtë, megjithatë, mejaftë, nukë, pakëzë, përsipërë, përunjëtë, rrotullë, sajë, shkurtërë, sipërë, t'egërë, tëntë, tepërë, tëratë, tjeratë, tjetërë, tuajtë, t'urtë, vetëmë.

Ruajtja e kësaj foneme vihet re edhe në pozicion paratheksor në fjalët e prejardhura: *tregëtia, ardhëshme, ligjëshme, lidhëja; ngritëja, ushtëria* etj.; para bashkëtingëlloreve hundore *m,n,nj, argjëndet, brënda, brëndëshmi, cënuar, çmëndurisë, dhëmb, dhëmbëje, gjëndem, gjëndje, mëndjes, mënonj, trëmbur, vëmëndje, vënd, vëndari, vëndës, zëmbërës, zëmëroj*, por edhe në pozicionin pastheksor, si: *dhëndërit, emërat, fshatëra, letëra, pjepëri* etj.

Vihen re luhatje në drejtshkrimin e kësaj zanoreje paratheksore**,** e cila sipas normës së sotme drejtshkrimore[383] nuk shkruhet te përemrat e pakufishëm, te ndajfoljet e te lidhëzat e përngjitura që kanë si pjesë të parë fjalën *gjithë*. Këto pjesë ligjërate

[382] K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Sh.b. "Dituria", Tiranë, 2007, f. 145.

[383] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Komisioni hartues: Prof. Androkli Kostallari (kryetar), Prof. Mahir Domi, Prof. Eqrem Çabej, B. shk. Emil Lafe, Akademia e Shkencave e RS të Shqipërisë, Tiranë, 1973, § 5.

herë shkruhen sipas kësaj rregulle, e herë jo: *gjithanët, gjithashtu, gjithçish, gjithëcish, gjithëgjithë, gjithëkun, gjithëkush, gjithësej, gjithmonë*.

2. **Grupet e bashkëtingëllore *kl, gl,*** karakteristike për të folmen arbëreshe, të cilat, siç dihet, në mbarë toskërishten kanë kaluar përkatësisht në *q* dhe *gj*, përdoren e ruhen nga Mitkoja, në pak fjalë të përdorura qëllimshëm prej tij, si: *gluha/ gëluha/ giuhën por edhe gjuha, klisha, helqën/helqurë, klënë, kleva, klisha, kluajtur, sgëlidhëni.*

Kjo veçori e të folmeve arbëreshe, që sot shihet si një dukuri konservacioni, por edhe të tjera tipare që do të përmenden më poshtë, shfaqen si të tilla, sipas Q. Haxhihasanit, pasi mund të jenë "përpunime të redaksisë së gazetës, por edhe përpjekje e vetë autorit të shkrimit (Th. Mitkos)"[384]. Edhe prania e zanores **/ë/** të theksuar që e ka burimin kryesisht nga zanorja /e/ hundore *vënde, vëndës**,** zëmëro, zëmëruarë* lidhet me të folmen e arbëreshëve të Italisë.

3. Në letrat që Th. Mitkoja u dërgon Dh. Kamardës dhe De Radës shfaqet forma ***ay*** e përemrit dëftor *ai (ay mik; ay Zot; nga ay; a u nkëthye ay prej Shkodre, ay i Bukuresht(it)),* trajtë që, sipas Demirajt[385], paraqitet me disa probleme fonetike që kërkon ende hulumtime të mëtejshme për burimin se nga ka ardhur.

4. Një tipar tjetër fonetik, veçori e së folmes së tij[386], që ndeshet në shumë fjalë, është **shurdhimi i bashkëtingëlloreve** të zëshme jo vetëm në pozicion fundor, por edhe në mes të fjalës. Ndër fjalët me shurdhim në fund të tyre përmendim *burk, erth, lark, gas, leth, liq, math, mbleth*, *funt, munt,* ndërsa fjalët me shurdhim në mes janë: *kënka, kuntër/kuntrë/, liksht, mbëlithni, mentime, mentohemi, mpështiella, muntsh, trathtor*. Por vihet re se disa prej këtyre fjalëve përdoren edhe në variantin me bashkëtingëllore të zëshme, si p.sh. *këngë, mendim* etj. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme fundore në gjegjëset e tyre të pazëshme dukuri e ruajtur edhe tek arbëreshët e Italisë dëshmon shfaqjen e këtij tipari para shekullit XV[387]. Por krahas shurdhimit, në kushte të caktuara fonetike, shfaqet edhe zëshmimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta, si p.sh.: *sod* (gjer sod), *sodpërsod, mëngjes* etj.

5. **Mungesa e fonemës /y/,** e zëvendësuar nga fonema **/i/** ndeshet në disa letra dërguar De Radës, si në fjalët *diert, shpërblien*, ku togut *ye* i përgjigjet togu *ie*: *Tek gjithë diert do t'i apen me hire; na u shpërblien mentimet*. Në ndonjë rast të veçuar, shihet tkurrja e njërës zanore, duke u kthyer në gjysmë zanore si tek emri ***vëllaj,*** *(vëllaj im i dashuri).* Te shkrimet e tij shihet e përdorur krahas fjalës *nevojë*, edhe forma me -*l*, (j>l) *nevolë,...për të mirat e nevojat e gjuhës; shkruajmë kur të jetë nevola...,* krahas *bijtë* edhe *biljët e mij;* ku këto shndërrime janë tipare të të folmeve të skajit jugor të shqipes.[388] Në disa trajta fjalësh, si te përemrat pronorë dhe te

[384] Th. Mitko, *Vepra*, vep. e cit., f. 571.
[385] Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 228-229.
[386] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes,* Tiranë, 2012, f. 61.
[387] Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 88.
[388] K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Sh.b. "Dituria", Tiranë, 2007, f. 260.

ndonjë parafjalë, shihet tingulli *-j*, si një shtesë fonetike me pozicion fundor[389], si : *sytë e mi**j**, memoriet e mi**j**a, djelmt e mi**j**; nga**j** Korça, nga**j** bija*, *nka**j** Shqipëria*; *me anë të një**j** miku, prej një**j*** emicranie, *vdekëjën e një**j** patrioti tem, para një**j**i muaji* por edhe në pozicion nistor: *miku **j**yt, i **j**ati do ta dërgonjë ndë kolegjin tuaj*, të cilat sot kanë mbetur në përdorim dialektor. Në ndonjë rast shihet rënia e fërkimores ***/h/,*** përgjithësisht në pozicionin fillestar, që vihet re konkretisht në pak fjalë, si: *(h)elenë, (h)istori, (h) ymn, (h)apen*.

Ndër veçoritë gramatikore të gjuhës së Mitkos, rendisim:

1. **Disa variante morfologjike të foljeve:**

Një dukuri interesante, sa e gjuhës vetjake të Mitkos, aq edhe për mbarë gjuhën tonë në përgjithësi, është larmia e formave foljore, përkatësisht, në veta të ndryshme të së tashmes dhe të së pakryerës së dëftores por edhe të mënyrave të tjera. Sa për ilustrim kemi grupuar të gjitha format foljore të foljeve *shkruaj* dhe *bëj* të cilat janë të shumta:

shkruaj*:*

shkrojta, shkrojte, shkrojti, shkrojtim, shkrojtnë, shkrojtur, shkrojturë, shkrova, shkruaj, shkruajë, shkruajen, shkruajmë, shkruajnë, shkruajsh, shkruajta, shkruajte, shkruajtën, shkruajti, shkruajtin, shkruajtur, shkruajturë, shkruaju, shkruame, shkruamen, shkruan, shkruani, shkruanj, shkruanjë, shkruanjën, shkruanjësh, shkruanjëshë, shkruante, shkruar, shkruara, shkruarë, shkruash, shkruasin, shkrueme.

bëj:

bëhej, bëhej, bëhen, bëhet, bej, bëjë, bëjm', bëjmë, bejnë, bëjnë, bën, bënem, bënet, bëni, bënin, bënj, bënja, benjë, bënje, bënjë, bënjë, bënjëm, bënjën, bënjën, bënjësh, bënjësh, bënur, bënur, ber', bëra, bëra, bërë, bërë, bëri.

2. **Ruajtja e mbaresës së hershme *-nj* që e ka burimin te foljet me temë në *-n-* që sot ajo ka kaluar në -j:**

Në letërkëmbimet e Mitkos, ndikuar nga e folmja e vet, në përgjithësi ruhet forma më e vjetër me mbaresën *-nj* të foljeve të zgjedhimit të parë të cilat në shqipen standarde janë njësuar me mbaresën *-j*. Sipas Gjinarit dhe Shkurtajt, mbaresa e hershme *-nj* ruhet ende në disa zona të toskërishtes veriore "Vetëm toskërishtja veriore (rrethi i Korçës, i Kolonjës, i Përmetit, i Skraparit, i Beratit, Myzeqeja e Fierit e Lushnjës dhe e Vlorës, pjesa qendrore e Mallakastrës, si dhe Tepelena toske) dallohet nga të folmet e tjera të gjuhës shqipe, sepse aty ruhet edhe sot e kësaj dite forma më e vjetër e mbaresës *nj: punonj, lanj, fshinj, bënj* etj."[390]

Shumica e foljeve të letrat e tij janë përdorur me mbaresën *-nj*: *bënj, bënjë, besonj, dërgonj, dëruanj, dëshironj, falënjë, fitonjë, harxhonj, hynj, kërkonj, kujtonj, kupëtonj, lypënj, marrënj, mprapsnjë, muntnjë, ndëlgonj, ndreqnjë, numëronj,*

[389] K. Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995, f. 324.
[390] J. Gjinari; Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia,* Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2000, f. 155-156.

paguanj, përqafonj, punonj, pushtonj, rekomandonjë, rrëfenj, rronj, ruanj, shënonj, shërbenj, shkëmbenj, shkruanj, shpejtonjë, shpërenj, shtrëngonj, shtyposnjë, vinj etj.

Por për disa folje vihet re dhe përdorimi i tyre me mbaresën *-j.* Këto përdorime të dyzuara të Thimit, edhe me mbaresën *-j,* mund të argumentohen me veçorinë tipike të disa zonave të këtij nëndialekti, (të folmet e Pogradecit, të Gorës dhe të fushës së Korçës, në anën e djathtë të Devollit)[391], të cilat në dallim nga të folmet e tjera të toskërishtes veriore, në vetën e parë njëjës të kohës së tashme e kthejnë ***-nj*** *në* ***-j***: *shkruanj,* por edhe *shkruaj, besonj/besoj, dërgonj/dërgoj, dëshëronjën/dëshëroja, fitonjë/fitojë, harxhonj/harxhoj, hynjë/hyjë, kërkonj/kërkoj, kujtonj/kujtoj* etj.

Nën ndikimin dialektor, sidomos të diasporës, gjejmë te letërkëmbimet e Mitkos edhe paradigmat e së pakryerës *ishnja-kishnja*. Burimi i këtyre formave janë po foljet që përmendëm më lart, me *-nj* që gjenden sidomos në të folmet e jugut[392], me sonanten e zbutur -j, duke marrë mbaresat përkatëse -ja,-je, si: *ishnja, kishnja.* Gjithashtu, sipas temës të së tashmes paraqiten edhe format e tjera kohore si ato të së pakryerës *të bënja, të shënonja, të dëshironja, të bënja*.

3. Veçori e gjuhës së tij është përdorimi i foljeve që mbarojnë me zanore në kohën e tashme të lidhores në vetën e dytë me mbaresën ***–jsh*****:** *të dërgojsh, të shkruajsh, të shkojsh*. Këto mbaresa *-sh* dhe *-jsh* janë përftuar nën ndikimin analogjik të formave të së pakryerës të foljeve *jam* e *kam*[393].

Të *më* ***shkruajsh*** *a u kall gjuha jonë në kolegjin tuaj?*

Sot të dërgonj këtë ymn për Anastas Abramid[in] në Bukuresh, që ***t'e shkojsh*** *në "Flamburit".*

Një emër qe' ke për Kairë Nikolla Hotova» duhet ta shkruanjësh drejtë Nikolla Tako», edhe ***të*** *ja* ***dërgojsh*** *të gjitha fletët.*

Andaj them se është mirë t'i dërgosh zotëria jote 10 a 15 fletë edhe ***t'i shkruajsh*** *frëngjish (in francese)...*

Po krahas tyre shfaqen edhe format me mbaresën ***-ç***, si: *të diç; të pyeç, të ftonç, të gjenç, të veç, të març*. Sipas Topallit[394], mbaresa ***-ç*** nuk është krijuar me rrugë fonetike, sepse shndërrimi i fërkimores në afrikate (sh>ç), që është dukuri e disa të folmeve të jugut është përftuar me rrugë analogjike nga shkrirja e bashkëtingëllores fundore të temës me mbaresën e formës vetore (-s+-sh>-ç)

Andaj është mirë ***të març*** *të njohur me atë për ndo punë të mirë të dheut tonë.*

Meqenëse pasnesër, të martën mbrëma, ditën e shën' Thimiut do të kem tryezë, më do zemra ***të vinç*** *edhe ti edhe* ***të ftonç*** *nga ana ime edhe zotërinjtë Gjerq P. Plluska, S. Parthenin dhe këdo tjetërë, që* ***të gjenç*** *me udhë dhe të vini të gjithë së bashku të martën të «efthimisemi».*

Më pare duhet ***të veç*** *te Sami Frashëri ndë Kostandinopolë, i cili di të të japë udhë.*

---

[391] B. Beci, *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre,* Dituria, 2002, f. 41.

[392] K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe,* Plejad, Tiranë, 2010, f. 305.

[393] Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 335.

[394] K. Topalli, po aty, f. 314.

*Zotëria jote je i pruajtur (raccomandato) tek ay, andaj është mirë **të març** të njohur (conoscenza) me atë për ndo punë të mirë të dheut tonë.*

4. Në letrat e Th. Mitkos gjenden të përdorura edhe trajtat joveprore të tipit *u gëzuash, u menduash, u helmuash.* Prapashtesën /-sh/, Demiraj, e sheh të lidhur me "disa gjurmë të kësaj prapashtese në shqipen e dokumentuar që ndeshen vetëm në vetën e parë njëjës si *qeshë, dhashë, lashë* te disa folje tema e së kryerës së thjeshtë zgjerohet me prapashtesën /-sh/. Po këtu "duhet të kihen parasysh edhe trajtat e lartpërmenduara të tipit *u gëzua-sh* (krahas më të zakonshmes *u gëzo-v-a*)"[395].

***U gëzuash** më fort për punën e bukrë që Leonardi de Martino bëri në Shkodër për të ngjallurë gjuhënë tonë.*

*Sa për djelmat **u menduash** më pastaj t'i mbanj këtu, se ndë Italijë nuk kanë të" nxënë edhe gjuhën arabishte...*

*Postalen tënde 1/1 e pata, e fort **u helmuash**, përse zotëria jote nukë je paq.*

Për disa folje në kohën e kryer të thjeshtë autori ruan togun zanor ***ua***: muar, *muarën,* si p.sh. *ma muar një mik* apo në rastin e frazave të mëposhtme:

*Ulqinin na e **muarën,** por tashi shqipëtarët duket se kërkonjën të bashkëohen me Elladhën.*

*...t'u bëhet ndonjë ndihmë, meqënë këtu tregëtia (il negozio) dorëpërdorë **u buar** fare e bota janë fort keq.*

5. Në përgjithësi Th. Mitko përdor formën e plotë të së ardhmes, por nuk mungon në disa raste forma dytësore e saj, varianti dialektor pa pjesëzën ***të***, forma të cilat ndeshen krahas njëra-tjetrës edhe brenda së njëjtës letër. Kjo tregon që më tepër lidhet me lëkundjet në të shkruar të Mitkos se sa me evoluimin në përdorim të njërës formë kundrejt tjetrës.

*Të shohim tani, pra, çë udhë **do marrënjën** shqypëtarët!*

*Më thanë se S. Frashëri **do ikënte** nga Kostandinopoja për Itali…*

*Idha jotë për të ngrehur një typografi arbëreshe në Italitë **do jetë** një pun'e një shërbesë fort e bukurë për vendërinë tënë.*

6. Interesante është përdorimi i **përcjellores** te letrat e Mitkos, ku ndeshen disa variante të pjesëzës karakteristike *duke* të kësaj forme foljore. Pavarësisht se përcjellorja që mbizotëron në toskërishten veriore, pjesë e së cilës është gjuha e Mitkos, është e ndërtuar në përgjithësi me pjesëzën *duke*, në shkrimet e tij kjo pjesëz ndeshet në variante të ndryshme *tuke* (që mbizotëron në toskërishten jugore)*, tye* (që mbizotëron në gegërishten, por që ndeshet edhe në ndonjë të folme të toskërishtes jugore) dhe *tue* (që del kryesisht në gegërishten veriperëndimore):

*Porsi shqiptarët e këtushim gjenden, vëlla, keq të shprisht; harçime **duke** rendur pas tire, është më i madh, mbase, se çë njeri mund [të] marrë mbi vete.*

*Po edhe zotëria jote s'ka mëmiarë **tuke** shkruarë mua megjithqë kishnit të vjelat.*

[395] Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 340.

Tye *u përgjegjur mbë shkronjën tuaj të së 4 qershorit, ju shkruanj shqyp (më gjuhën e babës) edhe kujtonj se do të mirremi vesh më rnirë, meqënë [se] ju nuk dini grëqishten si edhe unë s'di italishten.*
Eladha pajtoi me Tyrqinë, ***tye*** *marrënjë pjesë ndë Thesalj e ndë Epir vetëmë Puntin.*
Të përqaf e të shtrëngonj vllazërishtë ***tue*** *puthur sytë edhe Sepes, birit tëntë.*
Mënuar përgjigjeni postales sate [të] 21 korrikut, ***tue*** *mos pasur ndo [një] të re të të shënonja.*

7. **Ruajtja** e nyjës shquese **-t,** prapangjitur formave rasore të shumësit të emrave në trajtë të shquar në rasat gjinore-dhanore-rrjedhore**:** *anëvet, armiqvet, bijëvet, bijvet, djallëzivet, dyqanëvet, elenëvet, elinëvet, familjevet, fjalëvet, gjithëvet, grekërvet, grekrëvet, huajvet, ijalëvet, katundevet, kënkavet, koshullavet, lepushëvet, lëpushëvet, libravet, miqëvet, prindëvet, rnunëvet, romunëvet, rumunëvet, shkollavet, shkronjavet, shokëvet, shqipëtarevet, shqipëtarëvet, shqypëtarëvet, shqypevet, shqyptarëvet, syvet, vëllezërvet, vendarëvet.*
Kjo dukuri paraqitet e lëkundur, sepse në raste të tjera, kjo nyjë nuk është ruajtur: *abonimeve, arbëreshëve, arbëreshve, burrave, deve, djemve, drejtave, fakteve, faqeve, festave, fjalëve, fjalëve, folmeve, gazetave, grave, grekëve, grekomanëve, ideve, interesave, këngëve, kërkesave, këshillimeve, klasave, kolegjeve, kombeve, korçarëve, kujtimeve, kujve, letrave, librave, maleve, marrëdhënieve, materialeve, mjeteve, ndihmave, njerëzisëve, pajtimeve, pasanikëve, pasurve, patriotëve, përrallave, popujve, pozitave, qarqeve, rregullave, rreziqeve, shkatërrove, shkollave, shoqërive, shpresave, shqipëtarve, shqipiarve, shqiptareve, shqiptarëve, shqiptarve, sllave, tokave, trajtave, trojeve, vëllezërve, vendasve, vendbanimeve, vendbarumeve, vendeve, viteve, vrionasve*.
Vetëm për pak emra vihet re përdorimi me *-t* dhe ai pa *-t*, si p.sh. *fjalëve/t, librave/t, shkollave/t, shqipëtarve/t, vëllezërve/t*.

8. Gjithashtu, shihet e ruajtur forma e vjetër më ***-në*** e rasës kallëzore, në trajtën e shquar, e cila në gjuhën e sotme, ka mbetur në përdorim vetëm në ndonjë rast të veçuar, si p.sh. te disa emra farefisnie, por që te Mitko del edhe në raste të tjera: *gjuhënë/gluhënë, librinë, shqypenë, zonjënë, të vërtetënë, kartënë* etj.

9. Përdorimi i emrave të ndërtuar nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa ***t(ë),*** të shoqëruar nga parafjalët e hershme *mbë* e *ndë,* që janë trajtuar nga studiues të ndryshëm si forma të një rase vendore (lokativ)[396.] Sipas Shkurtajt[397], këtë formë e kanë kryesisht të folmet që ndodhen midis lumenjve Mat dhe Vjosë, (Shqipëria e Mesme dhe Toskëria Veriore)"[398], ndaj prania e tyre është e natyrshme në frazën e Mitkos.
Të kesh ***ndë*** *fletët ndo nyl (articolo) mbë gluhë tënë.*

[396] Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 2002, f. 187.
[397] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes,* Tiranë, 2012, f. 76.
[398] Po ai, po aty, f. 76

*Dhashtë zoti të hynj gluha shqype **ndë** shkollët tuaj, sa t'apë krye (per principio), siç shkruan «Flamburi».*
*Nukë rëndon... turku **mbë** vëndit e Lidhëja shqypëtare edhe rron (vive).*

10. **Rasa rrjedhore më -*shit***

Në letrat e Mitkos ndeshet ndonjë fjalë në rasën rrjedhore të shquar të tipit më -s*hit* e cila lidhet jo vetëm me gjuhën e hershme të tij, por dhe me përpjekjen e tij për të futur detaje nga gjuha e arbëreshëve të Italisë, pasi, sipas Shkurtajt, kjo formë haset në shqipen e moçme, po edhe në ndonjë të folme anësore me fytyrë ruajtëse, si ato të arbëreshëve të Italisë[399].

*Kam përpara **syshit** lëpushën tënde të 26 qershorit.*
*Shpëreh (spero) se keni dijeni prej **ditareshit** për Lidhëjen e Prizrenit se nuk është prishur (non e sciolta), po rron e punon e shërben.*

Në lidhje me këtë trajtë, Demiraj shprehet: "Gjatë shekujve, kjo formë e rrjedhores *male-sh-i-t* është zëvendësuar plotësisht nga forma e dhanores së shquar e tipit *male- ve (t)*[400]".

11. Te letërkëmbimet e tij, përdoret shumësi i emrave me prapashtesën **-ra**, *artikëllra, barëra, gjuhëra, kartëra, pocaqira, vitra, zotra, punëra, vitëra, patriotëra, lumërat, fshatëra,* që siç dihet sot shërben për formimin e shumësit të emrave femërorë, kryesisht, të lëndës. Është për t'u përmendur edhe prapashtesa -a, në disa emra *këngat, djelmat,* që e ndërtojnë shumësin pa prapashtesë, përkatësisht vetëm me ndërrim tingujsh. Të shumtë janë emrat përmbledhës të përdorur prej tij, të cilët shënojnë shumësi frymorësh e më pak sendesh, si: *gjuhëri, vëllamëri, vëllazëri egjyptëri, shoqëri**,** kombëri, qeveritari, bejtari, sundimtari, vëntari, shkruestari, kombëtari, shqiptari, (shqypëtari, shqyptari), urdhëri, paurdhëri, programori, pandershmëri.*

12. Prirja për ngushtimin e përdorimit të gjinisë asnjanëse vihet re edhe në shkrimet e Mitkos ku pak fjalë të ardhur prej foljeve janë ndeshur në këtë gjini:

*Kam gati një **të shkrueme** për të typosurë me 40 a 50 napolona, po dorëpërdorë s'kam para e po mundohem se qysh të bënj.*
*Sa për përrallatë (novelle), që mentohetë z/jote të stamponjë vetëmë **të nkëthyemen** (la traduzione) e jo edhe shqypenë, mirë do të benjë, tek s'prishetë gjë.*
*Kam ndër duar të ndershimen **të shkruamen** të zotënisë suaj mbë gluhënë shqipe, «Metapameja e të dy kosmet», prej zonjës Dora d'Istria, shqipëtares e lëvduarë, edhe jam fort i gëzuar ka ajo.*

13. Në letërkëmbimet me Kamardën dhe De Radën haset e përdorur edhe forma e vjetër arkaike ***u*** për përemrin vetor të vetës I, njëjës ***unë***, por edhe trajtën ***un:***

[399] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes,* Tiranë, 2012, f. 76.
[400] Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 2002, f. 146.

*U lutemë të mos pandehini semos **u** (a unë) boj të diturin, të ditshmin a filologun mbi gluhën tënë, por tue klënë kjo e pashkruar gluhë, e humbur edhe e zbjerë dua t'u dëftoj vetëmë fjalët të dialektit tonë.*
Un'e di mirë se shqypëtarët as prishurë janë, as shparturë-edhe Lidhëja po rron si burrat...
Në disa raste **trajtat e shkurtra** shihen të veçuara nga pjesëza *të* e foljes në mënyrën lidhore, përdoren pranë tyre por ende jo të bashkuara, pasi nuk kemi rënie të ë-së:
*Më ndaleni zotënia juaj **të u** shënoj disa fjalë çë pashë ndë të ndershmen, të shkruamen tuaj, cilat na i folasimë ndrishe, pra, me diturinë tuaj, **të i** vështroni e **të i** sgëlidhëni.*
*Po duhet zotëria jote **të i** shkruash frëngjisht, se ay nuku di italisht.*
*..edhe **të ja** dërgojsh të gjitha fletët.*

14. Në komunikimin me atdhetarët arbëreshë, Th. Mitko përdor i vetëdijshëm, përemrin dhe lidhëzën ***çë***, ashtu siç del në të folmet e tyre[401,] krahas përemrit dhe lidhëzës nënrenditëse *që* :
*Atë **çë** qëndron ngaj Topografia e Korçës shkoe ndë dialekte tonë **çë** ta ndëlgonjën shqypëtarët; Tashi **çë** qësh; S'kam mbledhur' më të tjerë turres ngaj **çë** të shkruajta; Zotëria jote bën mirë **çë** do të zësh prapë bejtarin se atjeështë vistari i gjuhës, duket'edhe jeta e shqypëtarit. Po çë munt të bënj un'i gjori. Kur shqypëtarët e kutushmë janë të pakundërarshmë.*
*Sot të dërgonjë këtë ymn për Anastas Abramid në Bukuresh, **që** t'e shkojsh në "Flamurit"; Më 2 maj, nga ky qytet, udhëtova drejt Janinës, **që** ka qenë ndërtuar mbi rrënojat e Tebët, duke kaluar nëpër Adrianipojë, Smirnë e Lepantë, ku qëndrova rreth 6 ditë, duke vështruar qytetin **që** nuk është i keq.*

15. **Përdorimi i përemrave pronorë**

Elemente të gegërishtes, por që janë të pranishme edhe ne të folmet e qarkut të Korçës, vërehet në format e rasave gjinore, dhanore e kallëzore të përemrave pronorë të vetë së parë njëjës, kur prona e pronari janë njëjës: *nylin **tem**, firmën **teme**; mbi gluhën **tënë**, mbi emër **tem**, ndë fëmijë **teme**;...tu puthur sytë birit **tëntë**,* për vendërinë ***tënë*.**

16. **Rendi i fjalëve**

Në letërkëmbimet e tij të bie në sy paravendosja e mbiemrave të nyjshëm dhe të përemrave të pacaktuar, një prirje relativisht e vjetër e gjuhës shqipe[402], kur dihet se në shqipen e sotme përcaktorët vendosen zakonisht pas emrit.
*Kjo udh'e birit tend do t'i sjellë **të math fitim** Shqypërisë.*
***Të math gëzim** mora, sepse e i përgjegjem satesë 3 të këtij.*
*Oh, me **sa të math helm e hjidhërim**, vëlla, të shkruanj këto fjalë, që përkasënjën emërin e nderin e Shqypërisë*

[401] Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 2002, f.255.
[402] Sh. Demiraj, *po aty,* f. 207.

Shumë i lumturi, shumë i dituri, patrik i Justinianës së parë të Ohrit, dhe kryetar i saj të Korçës dhe Selasforit, Joasafi, dhuroi një shumë ***të respektueshmit dhe të shenjtit manastir të së mbishenjtës Shënmëri****.*
Pasi këndova unë ditaren edhe ca ***të tjera fjalë*** *t'ati, i shkrojta një përgjegjëjë.*
Sa për Krispin e Petro Kjarën më vjen keq të ken; ata të këtillë ***të pabesë zemërë****, po moti le t'i urtësonjë.*
Për fundi të letrës sime po t'i shënonj ato dy a tri fjalë, e, ndë mos i diç ti, të pyeç atë përmetasin a ndonjë ***tjetërë shqypëtar****, edhe të më shkruanjëshë përsëçpejti e do të bënjësh* ***të math nder.***

17. **Mungesa e përshtatjes:**

Në frazën e Th. Mitkos hasen edhe përshtatje të gabuara të mbiemrit me emrin apo të përemrit me emrin. Këto lëkundje në përshtatje vihen re sidomos në përdorimin e emrave ambigjenë, ku prapashtesa e shumësit të këtyre emrave ndryshon gjininë e për rrjedhojë mbiemrat e përemrat duhet t'u përshtaten atyre.
Edhe afër Adrianopulit, 6 ***fshatëra të vogëla****, edhe afër Dunavit një fshat çë e thonë "Rasgrat".*
Dëshiroja të kem ***të tëratë libra të shkruara*** *mbë shqip prej shqipëtarësh*.
Kam të madh dëshërim e mall të vinj e të piqem më parë me zotërinë tënde, pa edhe me të
tjerë shqypëtarë të Italisë, po ***dëme të mëdhenj*** *që më mbinë ndër këta të pastajmit vjete më*
kanë ndalurë ngaha disa punëra e dëshirime.
E Myzeqea (Matrangua, Borshi, ngaku duket se janë një pjesë e shqypëtarëve Italisë) arrin të yshqenjë (nutrire) tërë hersonesën e Ilirsë, se ka ***tre lumëra të mëdhenj****, posi Nili Egjyptit, ndërpër të.*
Mora lëpushin tënd me gas të math, sepse më shkruan ***lajme të mirë*** *për "Flamburin"*
...por, gjithashtu, me shumë vonesë mora edhe letrën tuaj bashkë ***me librat tuaja*** *dhe mendoj se shërbimi postar i* ***vendeve tuaj*** *nuk bëhet me rregull.*
Siç shihet nga veçoritë fonetike dhe gramatikore që vumë në dukje, Mitkoja, ruan tiparet e së folmes së vendlindjes së tij, Korçës, në një fazë më të hershme të saj, ndonëse pjesën më të madhe të jetës e kaloi në dhe të huaj. Në disa raste gjuha e tij pasurohet me elemente të gegërishtes dhe të arbërishtes me qëllim përmbushjen e kërkesave për formimin e një gjuhe të përbashkët e të njësuar, si faktor i rëndësishëm dhe i pandarë në fuqizimin e ndërgjegjes kombëtare në lëvizjen për bashkim dhe çlirim. Pavarësisht nga përpjekjet e tij për njësim, shpesh ndeshen variante e trajta të ndryshme eptimore për të njëjtën fjalë (*fiamuri / fjamuri / flambur / flamuri; alfabeti / alfavetëri / alfavitarios; djalë / diemtë / djelm / djelma / djelmët / djelmt; kënëka / kënga / kënka / kënkavet / këngëve; shkruaj / shkruanj / shkruanjë / shkrojta / shkrova / shkruajta / shkrojtur / shkruar / shkruarë / shkruajturë*), gjë që dëshmon që edhe ai vetë nuk kishte një gjuhë të njësuar.

Veprimtaria e tij fisnike në shërbim të çështjes kombëtare, *për ruajtjen, lëvrimin dhe njësimin e gjuhës shqipe e bën Thimi Mitkon një figurë të rëndësishme* në historinë e Rilindjes Kombëtare, ndaj duhet vlerësuar dhe nderuar nga mbarë kombi shqiptar.

ANISA KOSTERI (SHKODËR)

TEFË TOPALLI (SHKODËR)

BASHKIMET SINTAGMATIKE DHE NË NIVEL FJALIE NË FJALORIN BISEDIMOR TË TH. MITKOS"

Mitkoja mund të renditet pa mëdyshje midis lëvruesve të parë të shqipes, jo vetëm se bën pjesë ndër mbledhësit e hershëm të krijimtarisë popullore gojore, përndryshe të visarit të çmuar të gjuhës amtare, por, mbi të gjitha, edhe për trashëgiminë me vepra të drejtpërdrejta leksikografike, siç është Fjalori trigjuhësh, i përgatitur dhe publikuar tashmë prej dy vjetësh prej studiuesit Sh. Sala.[403] Botuesi ka theksuar me të drejtë, që në Hyrje, largpamësinë e folkloristit tonë të shquar se gjuhët kanë qenë dhe janë në funksion të marrëdhënieve, bashkëpunimit dhe miqësisë midis popujve që përfaqësojnë lëndën a përmbajtjen e Fjalorit të tij, kur shkruan se Fjalori italisht-greqisht-shqip i Th. Mitkos u hartua për të shërbyer si një mjet afrimi, bashkëpunimi e miqësie midis shqiptarëve, grekëve e italianëve, si një mjet i rëndësishëm bashkëpunimi kulturor, tregtar, shkencor etj. midis popujve.[404] Mendojmë se pjesa II e kësaj përmbledhjeje, që kemi zgjedhur, ka vend edhe për një analizë a paraqitje e rrafshit sintaksor të prurjeve leksikore nga niveli sintagmatik, në rrafsh fjalie deri tek struktura e frazës, në planin bisedimor që ka sjellë Mitkoja këtu e 130 vjet më parë. Tre dhjetëvjeçarët punëmbledhës, si bleta nektarin, janë përqendruar kryesisht në kontaktet e autorit me emigrantë toskë e gegë që punonin e jetonin në Egjipt dhe në vendet e tjera, mbështetur në leksikun *e ligjërimit të folur popullor, por edhe me fjalë të ligjërimit libror të shqipes së vjelur nga gjuha e shkruar*.[405]

Kjo e dhënë ka përcaktuar edhe bashkimet sintaksore në njësi sintakse "sintagma", ku, përveç karakterit të lidhjeve e marrëdhënieve, një rëndësi të dorës së parë, merr edhe valenca,[406] si përkatësi jo veç e sintagmave foljore (SF), por edhe atyre me koka a përbërës nga pjesët e tjera të ligjëratës, siç janë emri, mbiemri, numërori, përemri dhe ndajfolja.[407] Prej disa kohësh, gjuhësia teorike ka përcaktuar se veç foljeve, për valencë mund të flitet edhe për kategori e klasa të tjera emërore.[408] G. Graffi thekson se me disa ndryshime, edhe emrat, ashtu si foljet,

[403] Shpëtim Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip* (Transliterimi dhe fjalësi shqip) II, West Print, Tiranë, 2013.
[404] Po ai, po aty, f. 65.
[405] Po ai, po aty, f. 64.
[406] Thoma Dhima, *Gramatikë e gjuhës shqipe-Sintaksa*, Gjirokastër, 2010.
[407] ASHSH,IGJL, ASHAK, *Leksikografia shqipe-Trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 158-168. (Hajri Shehu: Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes)
[408] Giorgio Graffi, *Sintaksa,* Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë, 2008, f. 72.

shfaqin valenca, gjë që s'është e çuditshme, sepse shumë prej tyre e kanë prejardhjen nga foljet (e si rrjedhojë janë quajtur "prejfoljorë"), për shembull, *shpjegim* vjen nga folja *shpjegoj*, *nisje* nga folja *nisem* etj.[409] Nuk duhet lënë pa shënuar se situatat gjuhësore, në të cilat ndërtohen njësitë kumtuese të Fjalorit bisedimor të folkloristit tonë, janë nga më të ndryshmet, si: lypja a kërkesa, të falurë nderës, dialogë shtëpije, para fjetjes, në veshje, biseda ndërmjet pedagogut e vashës, biseda për moshën, gjallesën a vdekjen, dreka, darka, grishje (ftesa), shëtitje, për tregues të kohës, për motin, kohët e vitit, shkollën, vizitat, për ritet e pagëzimit, dasmës, tek i sëmuri, tek mjeku, biseda ndër zejtarë, përmbajtja e letrës, biseda tek libraria, për pyetje orientuese, për shkëmbime, për peshkim, biseda për gjahunpër takime, e të tjera situata të akteve gjuhësore. Është kjo një traditë mjaft e pasur në hartimin e Fjalorëve të tillë bisedimorë në gjuhën shqipe,[410]duke nisur nga shekulli XVIII e sidomos deri në ditët tona. Mbi këtë bazë teorike, mund të përzgjedhim nga Fjalori bisedimor i Mitkos rendet e mëposhtme sintagmatike, me:

valenca të emrave – një boce me verë, verë të kuqe, urdhërë tuaj, njeri i ndermë, punëra të vogla, motërës suajë, të huajatë e Romasit, gjuhën Italishte, tim-vëlla, të bukuritë udhëtim, rrobën e shtëpisë, këpucët shyte, çorape të linjta, qerreja përpara derës, të ardhurit tuaj, pagëzim ndë kishë, lirëjën për të ikur, dy orë, të dhemburë kreje, vaporr i Trieshtës, etj.

Struktura skematike e tyre do të ishte:



valenca e mbiemrave – i bukurë shumë, të dashurat pemët, më i madh se atë, të bukuritë udhëtimi, etj.

[409] Po ai, po aty, f. 73. (Më tej autori gjenerativit italian, vazhdon: "...*përkimi mes emrave dhe foljeve është kaq sistematik, sa në shumë raste mund t'u jepen klasave të emrave emërtimet e klasave foljore përkatëse, e kështu mund të flitet për emra kalimtarë, jokalimtarë*, etj.)

[410] Mund të përmendim këtu: *Sprachführer Albanisch* (verfasst von Skënder Doku, Verlag "8 Nëntori", Tirana, 1983); Albanisch-deutsches und deutsch-albanisches Taschenwârterbuch (mit rd. 12000 Stichvörtern und Redewendungen, hartuar nga albanologu Armin Hetzer- Helmut Buske Verlag, Hamburg, 1990; Albanski sa izgovorom, preka 4000 reči i izraza, Nolit – Beograd, 2005, hartuar nga Toni Ŝlaku; hrvatsko albanski priručnik, FAI-Fish, Zagreb, 2005, Albanski sa izgovorom, priredilo Abedin Maliqi.

valenca e numërorëve – dy pashë, tri llojë, tri pasdreke, dy a tri javësh, pesë vëllezër, më katër ndë mëngjes, dhietë mijë dërhemë, tre kute cohë, etj.
valenca e ndajfoljeve – fort mirë, fort më rrallë, shumë mirë, teprë fellë, mjaft i njohur, keq shumë, kaqë vonë, etj.
valenca e foljeve – hëngra mejaft, u pieksim me të mirë, vemë të baresim, ulodha fort, epni të falurat e mia, kuvendojmë për – së- gjati, e keni liriën me pashë, të flë aq shumë, këndoni përpara meje, të parëdrekij sod me mua,[411] afërohij ndë zjarri, të mbrehënjë ndë qerre, duhet të ngrihem mbë të zbardhëllyerit e ditës, thirrisni mbë nesërë, e pashë ndë mëngjestë, ta shihni mbë meshë, ju lypën ndjesë, gaboni shumë, e dini mirë, ejani këtu, vinj të drekem ndër ju (drekoj), jam ndë parrais, i han me sheqer, mësoni mësimen, lojtim me kartëra, shkruajta gjerë mbë mesnatë, dëftoni mbë gjuhën tuajë, do t'a paguani shtrenjtë, mbeti me shëndet, etj.





Në planin gjuhësor, mundësia e bashkëlidhjes gramatikore, ka si kusht valencën e pjesëve të ligjëratës, fakt që vë në dukje atë që quhet dikotomia "gjuhë-ligjërim", b.f. emri të lidhet me emra të rasave të ndryshme, me mbiemra, me disa përemra, numërorë, etj.; kurse foljet të bashkohen me emra, ndajfolje, me paskajore, etj. Në të gjitha rastet, mjetet e lidhjes sintaksore midis njësive ndërtimore, të quajtura sintagma, në Fjalorin bisedimor të Mitkos, janë më së pari parafjalët, mbaresat, rendi sintaksor, që jo rrallë vjen jo sipas natyrës së gjuhës shqipe, çka mund të shpjegohet me ndikimin e gjuhëve të huaja që ka qenë i detyruar të përdorte autori gjatë viteve të gjata të mërgimit. Kështu, ka mjaft modele ndërtimore "mbiemër + emër" (e bukurë grua, tietërë herë, e para punë, e madhe vapë, etj.) Po kështu, mund të shprehemi edhe për ndërtimin e ndërmjetuar të kallëzuesve me folje analitike, si: ...*nuk do të rrinja, sepse* ***kishnja <u>pra</u> dhënë fjalën*** *tim-kuneti.* Për nivelin e bashkimeve sintagmatike, bie në sy denduria e përdorimit të rasës rrjedhore pa parafjalë, si: takim miqësh, parafjalët e rasës kallëzore: "mbë" dhe "ndë": do ta shihni mbë kishë, ndë meshë, e pashë ndë treg, ndala mbë këtë, takuash mbë dialëthin, etj. Në regjistrimet bisedore të Fjalorit të Mitkos na dalin të gjitha llojet e

[411] Është interesant formimi foljor nga ndajfolja "paradreke", term që na kujton fjalën "sillë-a"- vakt të ngrëni. Fjalori i Gjuhës Shqipe, 1954 e shpjegon: " buka e mëngjesit që i shpihet bujkut në arë paradreke, më nja ora 10; koha kur hahet silla. Duhet të jetë përdorur në kohën e autorit të Fjalorit edhe si folje.

sintagmave, si nga struktura e tyre (të thjeshta e të zgjëruara): *dëftoni më të mirën, kjo fytyrë, të përkas ndë dellt, të dalët e gjakut, do t'i çanj pas zakonit, ve të reja, lëng zogu, shkruanjë themën, kishnja punë; vivlin tënde të uratës, ngrehem pa shkrepur dielli, ju pres në vend të gjyqit, nuk vëreni dorën e cohës, kthehej ndë shtëpinë time, epëni ndë krahun tuajë të djathtin, pagëzoni këtë dialë*; ashtu edhe sipas kokës që drejton përbërësit: *vjelën tekdo, largohet zjarrit, t'ju thom të drejtën, i hamë me sheqer, do të priremi sakaqë, zotërë të dashurë, të madhe bollësirë, manushaqe të bukura, ndë shtëpit, për shëndet tuajë, mbi shtrat, fort mirë, teprë lart, keq shumë*, etj.

Në nivel fjalie, duhet theksuar se në Fjalorin e bisedimeve gjenerohen pothuajse të gjitha tipat e njësive kallëzuesore që përcaktohen nga sintaksa shqipe,[412] nga fjalia dëftore, deri tek fjalitë dëshirore, nxitëse dhe ato pyetëse-dialogjike, siç quhen në raste të tilla. Për shembull: *Më bëtë me këtë shumë detyarë. Jeni shumë i fismë. Ju dua me gjithë zemërë. Epni më bukë. Siellëni më një boce me verë të kuqe. Le të lëmë kajdet. Mos harroni të më vini nga herë ndë shtëpi. Lini më të bënj unë. Thoni të fala nga unë zotit atit tuajë. Kopsitnimë. Pastroni krëhënjët tuajë. Shëndet paç zot. U gdhifsij shëndoshë*. *Mirë paçi. Mirë qofsij. Fort mirë, ju paça!* etj. Vërejmë se këto tipe fjalish dalin sipas natyrës së shqipes, pa kryefjalë, si fjali njëshe, dhe sipas një rendi të caktuar në varësi të kumtimit a intonacionit të thënieve, kryesisht, me folje në fillim. Më të pasurat në ndërtim e në mjetet gramatikore përkatëse dalin fjalitë pyetëse, mbasi funksioni i tyre në kumtim, gjatë bisedës, është më kryesori. Kështu, gjejmë tek Fjalori, më së pari, të ashtuquajturat fjali pyetëse me strukturë paralele me ato dëftore, të cilat përcaktohen të tilla vetëm nëpërmjet intonacionit pyetës, përndryshe, pa mjete gramatikore pyetëse, si përemra, pjesëza a ndajfolje pyetëse, p.sh.: *Keni ndonjë urdhërim për mua? Nukë do të ish më mirë të...? Kërkoni të më bëni t'a mbesonj? Ndëgjuat gjë? E njihni së afërmi? Më ndjeni, jeni Zonja K...? Matij të veni në valle? Dini gjuhën Anglishte? Jeni ende ndë shtrat? Vërteta ndërdyshij? Nuk doni t'a porositni? Nuk'm'ishnit zotuarë për sod? Nuk mund t'a marr nesërë? I doni të lidhura me lëkurë keci, mëshqere? Nuk mundëni të rrini të drekij me ne? Jeni frëng, zot? S'ju k'anda portokallet? Keni gjylpërë të mirë? Doni qengj a shqerë? Ky mish ësht'i mirë? Ju ka ënda të provoni këtë verë? Merrni vesht italishtet? Ay që ju thot të vërtetën, çëthur gojën?* Por shumica e fjalive pyetëse, në Fjalorin bisedimor të Mitkos dalin me mjetet gramatikore pyetëse, si:

pjesëza pyetëse: ***A*** *mund të bëhet?* ***A*** *e kuptoni?* ***A*** *më njihni mua? Zoti B.* ***a*** *i kujtohij atij të bukurit udhëtim, që bëm bashkë, që këtu e gjer ndë Smirnë? Përisni pakëz, ju lutem, kaq herët* ***a****?* ***A*** *prutë eshkëtoren?* ***A ju k'anda djathin****? Fleni edhe a? Pas dreke* ***a*** *pini kafe? Mëndesha edhe aburda* ***a*** *erdhën?* Janë pothuajse të gjitha mjete pyetëse të rrafshit të bisedës popullore.

[412] ASHSH, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1997.

përemra pyetës: ***Çë*** *urdhëroni?* ***Çë'*** *më këshilloni të bënj?* ***Qysh*** *do'e ndenjëm?* ***Qysh*** *mentohij për këtë?* ***Kush*** *do ta thoshte?* ***Çë farë*** *marrëdhënëjash keni ndë Trieshtë?* ***Cilën*** *frikë kujtoni? Die mbrëmanet mbë* ***ç'***orë duall? ***Me cilin*** *flisni?* ***Mbë ç'***orë keni zakon të ngrëhij? ***Sa*** *rëndë ju vien të ngrëhij? Sa vjetësh është vëllai juaj?* ***Ç'***orë keni zakon të paradrekij? ***Kush*** *vien atie përpara nesh?* ***E kujt*** *është këjo vivli? Për* ***çë*** *nuk më duani?* Përemrat e sjellë këtu dalin jo vetëm në rasën e drejtë, por edhe në ato të zhdrejta: në dhanore, kallëzore e rrjedhore.

ndajfolje pyetëse: ***Kur*** *dotë përsëshihemi?* ***Ku*** *vete ay?* ***Kur*** *do të shkoni për vatan?* ***Kaha*** *vjen ay?* ***Përse*** *më quani kështu?* ***Ku*** *është gërshëra juaj?* ***Për se*** *më flisni anglisht? Fort mirë,* ***për se*** *nuk hani spinaq?* ***Ngaha*** *vini?* ***Ku*** *nisnjëm? Mbë* ***ç'***orë *u ngrejtit?* Aty-këtu na bien në sy edhe vendosje të mjeteve gramatikore të pyetjes, jo në fillim, siç duhet të ngjasë në këtë tip fjalie, por edhe në fund, sidomos disa herë me pjesëza, por me një vlerë shprehëse kur këto mjete dalin në mes të thënies, duke krijuar një pauzë të mesme në melodikën e fjalisë, për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit, si bie fjala: *Kushëriri juajë* ***a*** *u kthye nga Parisi?* Në këtë paraqitje ndeshim edhe struktura fraze ku përfshihen fjali pyetëse të zhdrejta, të cilat i kanë të pranishme m.g.p., por në ndërtime të tilla kanë humbur intonacionin përkatës të pyetjes, si: *Pa më thoni,* ***a*** *dini ndë erth vapor'i Trieshtës. Ju merni vesht fort mirë se* ***ç'****ju flas unë. S'marr vesht aspak* ***ç'****thot ay. Nukë dini se* ***ç'****orë është.* Në studimet tona leksikore theksohet se, që të jetë në nivelin e duhur, sipas kërkesave gjuhësore, *trajtimi leksikografik i bashkëlidhjeve të fjalëve* duhet të jetë i tillë, *që të zbatojë thellë teorinë e veprimtarisë ligjërimore.*[413] Gjuhëtari H.Shehu nënvizon se për çështje si këto të fjalorëve, ka kritere të njohura, bie fjala **a**). Denduria e fjalës; **b**).vlera tematike dhe situatave e fjalës; **c**) gjerësia e lidhjeve leksiko-sintagmatike e fjalës me fjalë të tjera të gjuhës, duke pasur parasysh faktorët jashtëgjuhësorë, sendorë-logjikë dhe faktorët brendagjuhësorë, strukturën e vetë gjuhës...;[414] me këto dallojmë bashkimet sipas veçorive të gjuhës sonë, jo vetëm në sintagma, por edhe në gjithë strukturën e fjalisë, për të arritur në rrafshin e kërkuar të kumtimit. Modeli në vijim, me ndërtim të zhdrejtë,[415] përdorur në një kontekst të caktuar, ka një QOS (qendër të organizimit sintaksor), vendosur midis dy përbërësve kallëzuesorë, që e plotësojnë atë në treguesit kushtorë dhe kohorë: *Ndë doni t'a shihëni, ejani nesërë mbë dy, kur ne do t'a kemi për drekë.* Nëse kërkojmë çiftëzimin sipas parimit të lidhjes

hierarkike "fjali drejtuese/fjali e varur", frazën[416] e skematizojmë si më poshtë

---

[413] ASHSH,IGJL, ASHAK, *Leksikografia shqipe-Trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 167-168. (Hajri Shehu:

Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes).

[414] Po ai, po aty, f. 168.

[415] Quajmë kështu çdo strukturë fraze, me dy a më shumë përbërës predikativë, që nuk nis me fjali drejtuese.

[416] Po përdorim këtu termin e parapëlqyer nga gjuhëtari M.Totoni në veprën "**Sintaksa e gjuhës shqipe**-Fraza e përbërë", Arbëria, Tiranë, 2012.



Për të kaluar në nivelin e frazës **(periudhës),** përmbledhim qysh në fillim se përgjithësisht, në Fjalorin bisedimor të Mitkos, mbizotërojnë njësitë-fjali, por nuk janë të pakta as strukturat kumtuese-fraza, të cilat dalin si në bashkime me parataksë (në pak lloje, sipas lidhëzave), ashtu edhe me hipotaksë, përqendruar në disa marrëdhënie funksionale, siç janë ato përcaktore, kohore, kushtore, rrjedhimore korrelative e pak të tjera. E dyta, mjetet e lidhjes së përbërësve kallëzuesorë në frazë, janë më së tepërmi ato të rrafshit të prozës bisedore dhe të ligjërimit popullor. Së treti, nuk mungojnë në struktura të tilla të frazave edhe bashkime përbërësish me mjete lidhëse zero, siç quhet dukuria pa mls të njohura në sintaksë. Për shembull, në ndërtimin *Zot, më bëni më një nder// **të** m'epëni atë krypësë* mungojnë lidhëza a fjalë lidhëse apo korrelata, por një rol të tillë e luan pjesëza "të" e lidhores. Ndryshe nga marrëdhëniet funksionale përcaktore që krijohen në modelin e paraqitur, në shembullin vijues *Dot'ju jem shumë dëtuarë // **ndë** më huajçi njëqind dhrahme* marrëdhëniet sintaksore, përveç kuptimit, kanë edhe treguesin gramatikor pamor, lidhëzën kushtore "ndë" (në). Këto struktura janë mjaft të dendura në Fjalorin që po marrim në shqyrtim gjejmë ndërtime frazash dyshe, bashkuar me lidhëza nënrenditëse, mjaft të qarta nga përcaktimi i marrëdhënieve, si: *Vë shart //**se** kështu është; Ju zotohem unë// se është e vërtetë; **Kur** unë s'di gjë,// çë doni të ju përgjigjem? Vemi// **sepse** më pëlqen shumë këjo melodramë; Po ju thom //**se** nukë mund të ju gjegjem për tashi; Për sod nukë dotë kem ngeh//**të** ju gjegjem; Nem më çorapet të linjta, //**pse** është nxehëtë; Bët shumë mirë// **që** m'a kujtuat; Thuaj i // **të** hynj; **Ndë** mos arçi, // dotë ju kanos; Le të kthehemi ndë shtëpit,//**pse** shoh motin// që po vrëhet. **Kushdo që** ka për të ngrehurë orollojin e vet, // duhet të vinj ndaj mua.*Ndonjëherë, sidomos në ndërtimet me më shumë se dy përbërës[417] predikativë, dalin marrëdhënie funksionale varg, si në shembujt në vazhdim: *Nukë rri afër ziarrit,//Ju vërtetonj //**se** e nxun //edhe gënjehet ay, **se** kam frikë// **se** mos nxehem shumë. //**që** kujton //**se** nuk'e xun.*





[417] Termi përbërës u përdor në kuptimin që i jep gjuhëtari Mehmet Çeliku, në veprën "**Sintaksë e gjuhës shqipe** (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik, ILAR, Tiranë, 2012.

Gjejmë raste në Fjalorin e Mitkos të ndërthurjes së bashkimeve me bashkërenditje e nënrenditje, si në dy ndërtimet e mëposhtme, të cilat mund të jepen me skemën vijuese:

*O dialë, shpierë letrën e zotit ndë postët, //**edhe** mos harronjësh //**t'**i paguanjësh harxhin.*

*Ej, më foli për atë, // **po** më tha // **se** s'vijen gjë*.



Vende-vende fraza vjen e ndërlikohet me më tepër se 2-3 përbërës kallëzuesorë, bashkuar në mënyrë sindete dhe asindete, si në shembujt që kemi gjetur në situata të ndryshme të aktit gjuhësor, përzgjedhur nga autori: *Duan edhe të tierët //**të** jen të kënaqurë //**si** jeni edhe ju. Nuk dua //**të** bënj shkëmbim, //**përse** italishteja fjal-e vjetëra thotë, //**kush** shkëmben // gënjehet. E gjegja të thot //**se** ishte tregëtor ndë Trieshtë, //**po** tani //**se** ç'bën // nuku di.*

Edhe ndërtime me marrëdhënie nënrenditëse rrjedhimore gjenden në bisedat e Fjalorit të Mitkos: *Ej zot, e mësonj, //**po** këjo gjuhë, //**sado** e vëjejçime që është,//nuk'është pas modës. Të kënduarit e Anglishtes është kaqë të fështirë, //**sa** nukë mund të nxini //**të** këndoni mirë as mbë dhietë viete.*





*Mbë kotë mbrohij, //unë jam bindurë //**se** ju këndoni shumë mirë, //**edhe se** keni zë të bukurë.. Ju s'keni kaqë nevojë, //**tek** gjendej ndë Elladë, //**e** përherë gjeni voli //**të** flisni Grëqisht, //**meqënë** unë nuku gjenj kurrë. **Meqënë** ju, shudhasni Italishten, // **që** të merrij me tregëtiën, // thoni më // **se** qysh thohet ay // **që** heq një kambiallë?*

Ka raste kur fraza ndërlikohet me njësi kallëzuesore të ndërvendosura, bashkuar me mls dhe me mjete zero, si në modelin më poshtë:

*I dua të lidhura harxhishte, //**me-qenë-që**, // **pasij** t'i përdor pak, // dot'i ap // **të** m'i lidhënjën pas dëshirit tim.*



Ky vështrim i thjeshtë në rrafshin sintaksor të Fjalorit bisedimor të Th.Mitkos, na paraqet një gjendje të gjuhës së shkruar të kohës së tij, përndryshe të variantit të Jugut; gjëja e veçantë që duhet theksuar është se gjithë lënga gjuhësore e trashëguar prej këtij punëtori të palodhur të shqipes, është mbledhur e regjistruar në kushte të posaçme, të pangjashme me Rilindësit e tjerë; ajo gjithashtu mund të bëhet objekt hulumtimi e studimi edhe në rrafshe të tjera të gjuhës.

ANYLA SARAÇI (MAXHE) (KORÇË)

MBI DISA TIPARE DIALEKTORE TË TOSKËRISHTES VERIORE NËPËRMJET ANTROPONIMISË TE "BLETA SHQIPËTARE"

Toskërishtja veriore, si një nga grupimet me tipare mjaft të dallueshme të arealit tosk, shfaq një swrw veçorish tipike morfonologjike. Këto tipare vijnë si shkak i zhvillimeve të brendshme gjuhësore, por edhe i ndikimeve nga gjuhët fqinje që në gjendjen e sotme të këtij grupi të folmesh mund të konsiderohen konservative. Pikërisht, për të parë gjendjen e të folmeve në periudha të caktuara na vijnë në ndihmë sidomos dëshmitë nga folklori. Një meritë të veçantë në këtë drejtim kanë dhe gjithë ata që ndër shekuj u përpoqën të mblidhnin dhe të ruanin thesarin gjuhësor e kulturor shqiptar. Një nga figurat që la gjurmë në këtë përpjekje ishte padyshim Th. Mitkoja me veprën e tij "Bleta shqypëtare". Përmbledhja e Th. Mitkos "Bleta shqypëtare" na jep dëshmi onomastike, në veçanti të antroponimeve, përmes të cilave mund të kuptojmë shumë nga tiparet dialektore të toskërishtes veriore. Kalimi nga trajtat e plota në format zbunuese vijnë si rrjedhim i shndërrimeve fonetiko-morfologjike karakteristike për këtë grup të folmesh. Një pjesë e mirë e antroponimeve në veprën e Mitkos vazhdojnë të përdoren në të njëjtën formë dhe sot dhe, të japin mundësinë e studimit diakronik të tyre në kuadër të studimit diakronik të gjuhës shqipe në tërësi.

Dialektet, si kategori historike, kanë lindur në kushte të caktuara të zhvillimit të shoqërisë. Ato vijnë përmes materialeve të pasura folklorike që janë mbledhur dhe shkruar nga udhëtarë, studiues, kureshtarë e dashamirës të një vendi, populli a kulture. Shqipëria ka qenë një prej qendrave që ka ngjallur këtë lloj interesi të të huajve për njohjen e vendeve të panjohura, të shoqërive primitive me gjuhë të padëgjuara. Dialektet, si degëzime gjuhësore të lidhura me ndarjen territoriale, lidhen ngushtë dhe me një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me kulturën shpirtërore dhe materiale të këtyre territoreve. Në qoftë se dialektet vështrohen dhe trajtohen thjesht dhe vetëm nga pikëpamja gjuhësore, nuk mund të përvijonim një pamje të plotë të ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet tyre. Janë kushtet historike, shtrirja gjeografike e tyre, një sërë rrethanash etnografike që lidhen ngushtë me mënyrën e jetesës, shijet, besimet pagane e fetare, marrëdhëniet me kulturat e fqinjëve të së njëjtës kombësi, por dhe të popujve që flasin gjuhë të ndryshme në kufi me ta, të cilat kanë ndikuar në një diferencim të dukshëm të dialekteve të shqipes.

Humboldi vë në dukje se "sa më thellë të depërtojmë në erën e vjetër, natyrisht që masa e materialit që trashëgojmë brez pas brezi zvogëlohet dallueshëm.[418] Është e kuptueshme që në ditët e sotme të erës teknologjike, dëshmitë përmes trashëgimisë popullore të transmetuar si krijimtari shpirtërore të jenë zhdukur, reduktuar apo transformuar. Gjuha, si pjesë organike e sendërtimit dhe shprehjes të

[418] W. Humboldt, *Gesammelte Schriften*. Hg. A. Leitzmann. Bd. IV. Berlin. Leipzig 1905, pp. 42.

kësaj krijimtarie, ka humbur si transmetim gojor, por ka fituar përmes teknologjisë mundësinë e ruajtjes së këtyre dëshmive që vijnë kryesisht prej dialekteve.

Duke u mbështetur në studimet e shumta që janë bërë mbi ndarjen dialektore të shqipes, dialekti jugor i shqipes grupohet në dy grupe kryesore, toskërishtja veriore, toskërishtja jugore

Nën termin historiko-gjeografik "Toskëri Veriore", përfshihen të folmet që fliten mbi Vjosë, ku hyjnë të folmet e Beratit me rrethinat, Myzeqesë, të krahinës së Skraparit, të folmet e qarkut të Korçës (Gorë-Opari, fusha e Korçës, Devolli, Pogradeci, Kolonja, Leskoviku), të krahinës së

Dangëllisë, të Shqerisë, si dhe të Tepelenës toske (që ndodhet në të djathtë të Vjosës)[419]

Në ndarjen e të folmeve të toskërishtes veriore që ka bërë J. Gjinari, nën termin "Toskëri" ka përfshirë gjithë Jugun e Shqipërisë (nga Shkumbini drejt viseve jugore), por thekson se Toskëria Veriore dhe të folmet e saj përfshijnë territoret midis lumenjve Shkumbin dhe Vjosë, atë që dikur e quanin si Toskëria e vërtetë.[420] Në ndonjë krahinë, toskërishtja veriore shtrihet dhe më në jug të Toskërisë së vërtetë, matanë Vjosës, duke përfshirë qytetin e Vlorës si dhe fshatrat e saj veriore dhe verilindore (deri te vija Radhimë-Dukat).

Dëshmitë dialektore vijnë edhe nëpërmjet antroponimsë, e sidomos përmes trajtave të dyta a të zbunuara të cilat në shumë raste janë trajta fonetiko-morfologjike të dialektit, nëndialektit a të folmeve në veçanti.

Antroponimia paraqet një interes të madh për gjuhësinë në veçanti. Si një dukuri etnokulturore, antroponimet paraqiten në forma dhe kuptime të llojllojshme duke mbartur në vetvete më shumë se përfaqësimin e një njeriu të veçantë, duke luajtur sipas etnografit të njohur M. Krasniqi: "*… rolin e dokumenteve historike, në bazë të të cilave mund të konstatohen ecuritë shoqërore e kulturore të një vendi*"[421].

Studimi i antroponimeve ndjek përgjithësisht dy rrugë:

- së pari, studimin filologjik duke marrë në konsideratë origjinën, formimin, klasifikimin dhe përhapjen.
- së dyti, studimin e natyrës filozofike që merret me çështjen e mprehtë të aftësisë referenciale, shtron problemin nëse antroponimet janë ose jo bartës të kuptimit në një rreth më të gjerë faktorësh.[422]

Individualiteti i përdorimit të emrit vetjak dhe një përcaktim i qartë i individit ndihmon në izolimin e këtij lloj emri nga fjalët e tjera dhe në mënyrën e klasifikimit

[419] J. Gjinari, *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965, f. 242.
[420] J. Gjinari, *Toskërishtja veriore dhe grupimi i t ë folmeve të saj*, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965. f. 241.
[421] M. Krasniqi, *Gjurmë dhe gjurmime*, Studime etnografike, SHB "8 Nëntori", 1979, f. 100.
[422] R. Ozaeta Galvez, *Los antropónimos: nociones teóricas y modalidades de transferencia (francés-español*), EPOS, XVIII (2002), págs. 233-255.

të tyre në disa klasa leksiko-gramatikore. Emrat vetjakë (antroponimet) gjallojnë vetëm në shoqëri dhe për shoqërinë, dhe kjo detyron zgjedhjen e tyre, pavarësisht se sa personale mund të duket kjo zgjedhje. Gjithë emrat vetjakë janë gjithmonë shoqërorë[423].

Siç dihet, historia e emrave të njerëzve është një pjesë e vetë historisë dhe e gjuhës së kombeve që u përkasin. Shtresëzimi kohor dhe përdorimi i emrave vetjakë janë reflekse që shpjegohen përmes kronologjisë së vetë historisë dhe të gjuhës së popullit tonë.[424]

E. Çabej ka vënë në dukje se: "Emrat vetjakë, duke përfshirë aty emrat e viseve e të njerëzve, si një pjesë të thuash e pashkruar e leksikut të gjuhës, janë caktuar të zëvendësojnë deri diku dokumentet e shkrimit, që mungojnë kryekrejet për kohën para shekullit XV ."[425] Pa dyshim që këto dëshmi na vijnë dhe në veprën e Mitkos "Bleta shqypëtare"[426], ku ndërmjet materialeve të shumta nga folklori na paraqitet dhe një ndarje më vete me antroponime dhe patronime.

Duke u bazuar në përmbledhjen e përgatitur nga Q. Haxhihasani dhe Z. Sako në serinë "Mbledhës të hershëm tëfolklorit"vëmë re se Mitkoja i ka kushtuar një ndarje të veçantë të veprës antroponimeve. Ai i ndan në emra "të kërshtera dhe mohamedane", një element i kuptueshëm për karakterin shoqëror të emrit.

Emrat e besimit të krishterë janë më të shumtë në numër, 65 të tillë, nga të cilët 13 janë emra femrash, 2 variante femërore të njëjtit emër mashkullor. Po ashtu paraqiten 25 emra të besimit mysliman, por asnjë emër femëror. Një grup më vete përbëjnë ato që Mitkoja i paraqet si mbiemra femërorë, ai ka dhënë 44 të tilla dhe për nga trajta fonetiko-morfologjike mund t'i interpretojmë si zbunime dhe nofka.[427]

Mbiemrat e familjeve (patronimet) zënë një vend të konsiderueshëm dhe për nga forma dhe larmia e tyre përbëjnë një temë të veçantë për t'u trajtuar

Nëse u referohemi trajtave trajtave të plota, emrat e krishterë paraqiten si emra zyrtarë grekë apo me trajta të përshtatura po nga greqishtja, një dukuri e kuptueshme për faktin që emrat duhet të jenë kryesisht të qytetit të Korçës dhe të regjistruar sipas emrit të pagëzimit në kishë (në ritet dhe gjuhën e kishës mbizotëronte greqishtja).

1- Pothuaj në gjithë trajtat e shkurtra të formave zyrtare gjendet një trajtë me *–o* fundore të theksuar: *Ngjelo/Ngjelino; Dhamo; Naço/Nasho, Kato/Katelino/Lino, Taso/Tasho, Ndrio/Ndreko, Tolo, Vaso, Vasilo, Viko/Viso, Gjergo/Jorgo/Gaqo/Lolo, Bido, Demo, Xhafo, Zeqo, Miço, Saliko, Meto, Remko* etj.

[423] N. Ahanovna Shakhmetova1 & A. Hasanovna Bekbosynova, *Proper name as a cultural text*, Life Science Journal (10s), 2014, p.11.,
[424] P. Daka, *Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, nr. 3, 1970, f. 138
[425] E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, Tiranë, 1982, f. 43.
[426]Th. Mitko *Bëlëta shqyptare*, në "Mledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II, Institutii i Folklorit, Tiranë 1961.
[427] Po aty.32-35

Pedersen, në analizën e tij "Kontribut për historinë e gjuhës shqipe", duke iu referuar përdorimit të Kamardës *trim i rivo,* vë në dukje se ***o***-ja në të vërtetë është shenjë e thirrorres, që dhe në të folurit e përditshëëm dëgjohet *zonjëzo, djalo, vajzo, motro, djemo.*[428] Në antroponime shpesh kjo ***o*** paraqitet si ***o*** e gjatë dhe gjendet edhe në grupe të folmesh të tjera po si burim i pasthirrmës *o*[429]. Veçori të toskërishtes veriore përbën zbërthimi i ***o>ua*** *në* trajtën e shquar. Në fakt është e vështirë të përcaktohet nëse kjo ***ua*** në antroponimet e paraqitura nga Th. Mitkoja është diftong apo togznor. Në veprën e vet Mitkoja është mbështetur në mënyrën e shqiptimit të fjalëve, si një parim që, siç e vë në dukje Qiriazi në studimin e tij për kriteret e që zbatoi Mitkoja në hartimin e fjalorit, e ndoqën "savant të tjerë shqiptarë të dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XIX, duke e ndërthurur edhe me kritere të tjera në varësi të lëndës së disponueshme të shqipes, por dhe të formimit të tyre filologjik. Sipas tij, fakti që në të folmet jugore të shqipes nuk vihet re kurrfarrë "tkurrjeje"të fjalëve gjatë shqiptimit të tyre, na nxjerr në përfundimin se mënyra e shkrimit të fjalëve prej Mitkos përputhet me mënyrën se si ato shqiptoheshin në kohën e tij, duke qenë se folmja e Korçës dallon për ruajtjen e plotërisë fonetike të fjalëve…"[430]

Në shënimin që i është bërë botimit të "Bletës shqiptare" më 1961 vihet në dukje se, në përpjekje për të afruar dialektet e shqipes, te Mitkoja vihet re përdorimi i diftongut *ua* dhe në disa tekste të veriut[431].

Sipas J. Gjinarit në emra femërorë që mbarojnë me temë në /–o/ kemi takim të dy zanoreve të ndryshme, ku zanorja */o/* e shkurtër e patheksuar e temës është takuar me nyjen e prapme shquese femërore *a*. Bashkimi i tyre ka dhënë një diftong jo të gjatë *oa* i cili, më pas u kthye në *u̯a.*[432] Ky kthim lidhet me faktin që diftongu ndodhej në fjalë të tjera, në të cilat vinte nga zbërthimi i *o*-së së patheksuar, por nëse ky diftong u ruajt në këtë pozicion vetëm në disa të folme skajore të toskërishtes veriore, në pjesën më të madhe të të folmeve të toskërishtes veriore (përfshi dhe të folmen e Korçës) në rrokje fundore të hapur kemi togzanor.[433]

Sipas Çabejt, toskërishtja me *–ua* paraqitet shumë e njësishme, përkundrejt një larmie variacionesh të gegërishtes që vijnë si rrjedhim i copëzimit të Gegërisë në krahina të izoluara.[434] Por, në disa prej trajtave të dyta të emrave të këtij tipi, Th.

[428] H. Pedersen, *Kontribut për historinë e gjuhës shqipe*, përkth S. Riza, në "Studime rreth gjuhës shqipe", UT, IHGJ, Tiranë 1973, f.246.

[429]Shih A Xhuvani- E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, 1962; K.Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Dituria, Tiranë, 2007

[430] Dh. Qiriazi, Habent sua fata manuscript: rrugëtimi dhe vlera e veprës leksikografike të TH. Mitkos, studim hyrës në "Th. Mitko, Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike" ASHSH, Tiranë, 2014, f. 46.

[431]Th. Mitko *Bëlëta shqyptare*, në "Mledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II, Institutii i Folklorit, Tiranë 1961.f. 14.

[432] Shih J. Gjinari, *Diftongjet ua/ue, ie dhe ye në të folmet e gjuhës shqipe*, SF, nr. 1, 1968.

[433] Po aty, f. 98.

[434] Shih E. Çabej, *Diftongje e grupe zanoresh të gjuhës shqipe*, BUSHT, SSHSH, nr. 3, 1958, f. 79.

Mitkoja i paraqit pa zbërthim të *o>ua,* por me mbaresën e femërores *-ja (Ndreko-ja, Vasilo-ja, Gjergo-ja, Nano-ja, Tiko-ja, Garit-ua/Garito-ja, Shomo-ua/Shomo-ja),* ku ***j***-ja shërben si tingull antihiatizues*,* madje në disa raste edhe pa të, si: *Viko-a, Viso-a, Mitro-a*, *Margo-a, Marko-a*

Me të drejtë stdiuesi Dh. Qiriazi, në analizën që i bën përkthimit të Kamardës me tekstin në dorëshkrim të Mitkos, thekson faktin se Mitkoja zgjodhi si gjuhë shkrimi të folmen, duke pranuar plotësuar idiolektin e Kamardës me demolektin e tij[435]

1- Shumë prej trajtave të dyta dalin me *–e* fundore të patheksuar dhe nuk e reduktojnë atë në të shquarën për analogji me emra femërorë me me temë në zanoren e të patheksuar të tipit *nuse, lule*, të cilat në lëndën folklorike të mbledhur nga Mitkoja, por dhe në fjalorin e tij dalin me *e* në temë dhe në trajtën e shquar *Dhame, Toqe-ja, Tase-ja, Cace-ja, Sepe, Nine, Mine, Pavle, Çufe, Jupe, Cane, Cene-ja, Sheme* etj*.* Ashtu si dhe në trajtat me *o*-fundore, zanorja *e* paraqitet e gjatë, jo vetëm për shkak të vendit të saj në rrokje fundore të hapur, por dhe për shkak të ligjërimit afektiv.[436] Në trajtën e shquar të këtyre emrave *e*-ja fundore nuk bie dhe kjo dukuri vazhdon të jetë e gjalllë dhe sot te trajtat e dyta të antroponimeve, ndërkohë që në apelativët e këtij tipi bie.

2- Nga pikëpamja e fjlaëformimit pjesa më të madhe të këtyre trajtave të dyta dalin me prapashtesa me konotacion zvogëlues a përkëdhelës, tipike për grupin lindor të toskërishtes veriore.

-ash: *Dhimash*

-ç/-çe/-çi/-çe: *La-çe, Guçe, Lam-çe, Pano-çe, Ndri-çi/ Ndru-çi, Pe-çi, Na-ço.*

-kë: *Ngjeli-kë, Ndre-kë, Ndo-kë, Cil-kë, Gji-kë, Ni-skë, Mri-kë/Min-kë, Palo-kë, Sal-kë, Dem-kë* etj*.*

-ush/-ushe: *Mitr-ush, Mand-ush, Pand-ush, Rrap-ush, Petr-ush, Brahush Mar-ush-e*

-ushkë (si variant i përbërë përkëdhelës-zvogëlues *ush+kë*), *Marg-ushkë.*

Nëpërmjet një analize të tillë mund të arrijmë në përfundimin që pjesën më të madhe të antroponimeve Mitko t'i ketë mbledhur në Korçë dhe rrethinat e saj. Por në lëndën e mbledhur prej tij shohim përpjekjet për një një gjuhë mbidialektore, lëndë e cila të krijon mundësi për studime më të hollësishme që mund të shqyrtohen nga pikëpamja e përfaqësimit referencial të antroponimisë dhe patronimisë, që

[435] Dh. Qiriazi, Habent sua fata manuscript: rrugëtimi dhe vlera e veprës leksikografike të TH. Mitkos, studim hyrës në "Th. Mitko, Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike" ASHSH, Tiranë, 2014, f. 46.

[436] Shih K.Topalli, Fonetika historike e gjuhës shqipe, Ditutia, Tiranë, 2007.

sipas Mitkos të bëhet "...një shkak për studime edhe mendime të tjera etnologjike më të mbaruara."[437]

[437] Th. Mitko *Bëlëta shqyptare*, në "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II, Institutii i Folklorit, Tiranë 1961, f. 13.

ARMAND OMERI (DURRËS)

TIPARE TË TOSKËRISHTES LETRARE NË PËRRALLAT E "*BLETËS SHQIPTARE*"

Në botimin "*Thimi Mitko*", Vepra, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1981, kapitulli C. PROZA, f. 345-415, kemi hulumtuar tiparet e toskërishtes letrare në gjuhën e shkruar të Thimi Mitkos: përdorimin e mjeteve leksikore e gramatikore, morfologjinë, frazeologjinë, trajtat rasore, format e ndryshme që marrin fjalët kur lakohen (emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët), kur zgjedhohen (foljet), përdorimin e trajtave dialektore, leksikun dialektor dhe huazimet. Me interes është fusha e fjalëformimit, krijimi i fjalëve të reja me brumin e shqipes dhe ngushtimi i rrethit të huazimeve në leksikun e gjuhës së shkruar shqipe. Në materialin që kemi vjelë dhe përzgjedhur njëkohësisht, do të përpiqemi të bëjmë disa krahasime ndërmjet trajtave morfologjike dialektore si trajta përfaqësuese të toskërishtes letrare, me të cilat shkruan autori dhe trajtave morfologjike, që janë kodifikuar në drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Me metodën krahasuese do të zbulojmë trajtat morfologjike dialektore si raste të shmangieve prej traditës shkrimore të këtyre formave të toskërishtes letrare nga vetë autori dhe, në varësi të dendurisë së përdorimit të trajtave të njëjta, do të zbulojmë shkallën e ngulitjes së trajtave morfologjike në gjuhën e shkruar të autorit. Zbatimi i parimit fonetik të gjuhës shqipe nga Mitkoja është bërë me luhatje dhe këtë e kemi konstatuar ndërmjet fjalëve të njëjta, por që paraqiten me trajta të ndryshme apo ndërmjet trajtave dialektore dhe trajtave të standardit të sotëm letrar, që i gjejmë në shënimet e Mitkos. Materiali i mbledhur ka në inventarin e tij emra, mbiemra, numërorë, përemra, folje, ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pjesëza, pasthirrma, konstrukte sintaksore, frazeologji, kompozita, huazime e leksik dialektor, vjelë në kapitullin C. PROZA, nga botimi "*Thimi Mitko*", Vepra, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1981.

EMRI. **Rasa emërore**

Emri është pjesa e ligjëratës, që del me forma e trajta deri diku të qëndrueshme në shkrimin e Mitkos.

Emrat e gjinisë femërore më *-ër* në numrin njëjës, rasa emërore, dalin në trajtën e shquar më *–ëra,* duke e ruajtur *–ë*-në pastheksore dhe kjo e bën fjalën me theks tejfundor, ndryshe nga shkrimi sot i këtyre fjalëve, ku *-ë*-ja pastheksore bie duke ruajtur theksimin parafundor të fjalës, tipar i gjuhës shqipe dhe i standardit të sotëm letrar. Kështu kemi disa emra, gjinia femërore, numri njëjës, rasa emërore, trajta e shquar nga përrallat e hulumtuara: *bushtëra*; *zëmëra*; por edhe *bistra* (bisha); *zembra* (382) si standardi i sotëm, pa *-ë* pastheksore.

Emrat femërorë më *-e* fundore të patheksuar, në trajtën e shquar autori ynë i shkruan më *-eja*: *capeja* (dele ose dhi); *kolybeja* (383, 397); *kopileja* (380); *kumbareja* (394); *mëndeja* (395); *shoqeja*; *turpeja* (turpi); *valleja* (394). Në drejtshkrimin e sotëm këta emra në trajtën e shquar dalin pa fundoren *-e* të

patheksuar[438], megjithatë marrin mbaresën *–ja* në shkrimin e Mitkos si në standardin e sotëm letrar.

Në toskërishten veriore kemi disa emra në gjininë femërore, të cilët në gegërishte dhe në gjuhën e sotme standarde dalin në gjininë mashkullore, p.sh.: *lote* (lotët); *kopështe* (kopshti); *turpeja* (turpi);

Emrat femërorë më *-ë*, në trajtën e shquar dalin më *-a* në gjuhën e shkruar të Th. Mitkos, njësoj si në standardin e sotëm të gjuhës shqipe, duke u njësuar me një nga parimet themelore të drejtshkrimit të sotëm të gjuhës shqipe, parimin fonetik: fjala shkruhet ashtu si shqiptohet: *çupa*; *fela* (thela); *sopata* (378); *strofka*; *shtrofka*; *shqyponja;* kurse emrat femërorë më *-í* fundore të theksuar dalin më *-ja*: *shtëpija*; *verbërsija* (379). Folkloristi ynë i shkruan si emrat femërorë më *-je*. Disa emra femërorë më *-i* fundore të theksuar dalin në trajtën e shquar njësoj si në standardin e sotëm letrar: *llaftaria* (llahtaria); *Mëria* (Maria, 388).

Emrat femërorë me fundore më *-ë* në numrin njëjës, trajta e pashquar dalin njësoj si në standardin e sotëm letrar më *-ë*: *darsëmë* (401); *dhëmpallë* (390).

Emrat femërorë më *-i* të theksuar në numrin njëjës, trajta e pashquar nuk paraqesin veçanti në trajtat e tyre, duke u nisur dhe nga fakti se një pjesë e tyre janë fjalëformime nga tema të ndryshme me prapashtesat (*ë*)*ri,* (*ë*)*si*: *fatkeqëri* (fatkeqësi); *ushtëri* (ushtri); *lehtësi-rë*.

Emrat femërorë njëjës më *-ë*, në numrin shumës, në trajtën e shquar marrin *-ë* fundore pas mbaresës *-at* të shumësit dhe dalin me theks tejfundor: *gjurmatë*; *thikatë*; *bijatë* (389); ndërsa emrat femërorë në njëjës më *-e* e bëjnë shumësin si trajtat e standardit të sotëm më *-t*: *dritsoret* (dritaret, 402); *klyçet* (kyçet, çelësat, 407).

Emrat femërorë shumës, trajta e pashquar, dalin me prapashtesën më *-ra*: *punëra* (407); *gjellëra* (414); *vallëra* (valle, 415). Këto trajta i ndeshim dhe në standardin e sotëm me përdorim stilistikor[439]. Trajtat e shumësit me prapashtesën *-ra* dalin si forma dytësore dhe nuk përbëjnë normë në gjuhën letrare. Këto trajta përdoren zakonisht me një ngarkesë stilistikore[440].

Emrat mashkullorë në numrin njëjës, trajta e shquar dalin njëlloj me standardin e sotëm me *-i*: *argjëndari* (argjendari); *dreni* (dreri me rotacizëm, si trajtë e gegërishtes 379); *glishti* (gishti, si trajta në çamërisht); *gjishti* (trajtë dialektore në të folmet e toskërishtes veriperendimore, në Berat që zëvendëson *g-* me *gj-*); *pëlasi*; *pallasi* (dy trajta për *pallati* duke ruajtur shqiptimin e fjalës së huazuar nga gjuhët neolatine); *trëndafili* (383); *gjarpëri*; *i ati*; *i jati* dhe ky emër del në dy forma: forma e dytë del më *-j* nistore, ndoshta për të shmangur vështirësinë në shqiptim, kundër hiatit, që krijohet nga nyja me vlerë pronori e paravendosur te emrat e farefisnisë

[438] *Drejtshkrimi i i gjuhës shqipe*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1973, f. 40.
[439] Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Botim i Universitetit të Tiranës, Tiranë, 1987, f. 50.
[440] *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II,* Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1976, f. 76.

dhe që vërteton zbatimin e parimit fonetik në shkrimin e shqipes si parim themelor i drejtshkrimit të sotëm[441], por dalin edhe me *-u*: *bregu* (383).

Emrat mashkullorë në numrin njëjës, trajta e pashquar dalin më bashkëtingëllore, si në gjuhën e sotme letrare, p.sh.: *brek* (breg); *dëshir*(*-i*), (del në gjini mashkullore, 381); *flambur* (flamur); *funt* (fundi i diçkaje); *hoborr* (oborr); *kurris* (kurriz); po kështu dhe emrat mashkullorë prejfoljorë: *ushëtim* (oshëtimë); *çpërblim*; *mburim* (378); *kupëtim* dhe *kuptim* si standardi i sotëm letrar (411). Një grup më vete bëjnë emrat e gjinisë mashkullore më *-ër*, që në numrin njëjës dalin me theks tejfundor dhe në trajtën e pashquar dalin më *-ë* fundore pastheksore. Vihet re një mbipërdorim i *ë-së* pastheksore: *dimërë* (380); *gjarpërë*; *kopështë*. Ndërsa emrat e gjinisë mashkullore në numrin njëjës, në trajtën e pashquar me theks fundor, autori ynë i shkruan më *-ë* dhe ato dalin me theks parafundor: *trëndafilë* (380); *trandafilë* (381). Këtu kemi përdorimin e dy trajtave: të trajtës toske më *-ë-* dhe të trajtës gege më *-â-* hundore para bashkëtingëllores hundore *-n*.

Emrat mashkullorë në numrin shumës, trajta e shquar, në rasën emërore dalin në gjuhën e Mitkos në disa forma: tema e shumësit + mbaresë: *djem-at*; *djelm-at*; *zoq-ët*; shumësi më -inj: *florinj* (393); -(*i*)*nj +*(*ë*)*të*: *shkopinjët*; *jatronjtë* (kjo fjalë, që në njëjës del *jatrua* pëson dhe ndryshimin *-ua- > -o-*); me ndryshimin e tingujve *-ll* në *-j*: *qiell – qiej-t*; ka disa trajta shumësi për një fjalë, si: *prindët*; *prinjtë*; *prinjit'* (për prindërit); trajta e shumësit më *-ë* fundore pas mbaresës së shumësit *-at* dhe me theks tejfundor: *trimatë*.

Emrat e gjinisë mashkullore, që në numrin njëjës, në trajtën e pashquar dalin më bashkëtingëllore dhe me theks fundor, në numrin shumës, trajta e pashquar e tyre del më *-ë*, si shumësi i standardit të sotëm: *harmëshorë* (hamëshorë); *trëndafilë* (379); *ushtërorë* (ushtarë); dalin me mbaresë më *-a*: (këta) *djelma* (388), por hasim dhe *djelm* (si në çamërishte 388); *lépura* (lepuj); ndeshim shumësin më *–ra*: *mretra* (mbretër, 401); *këlyshëra* (401); *zanatra* (409) apo trajta me mbikarakterizim *zërëra*; shumësi me metafoni: *buj**e**rë* (buj**a**rë, 381); shumësi i mbikarakterizuar me më shumë se një mjet shumësi, me metafoni dhe mbaresën *-inj*: *deshinj* (desh); shumës pa mbaresa, si: (shumë) *mot* (378); tek emri *margaritára* (387) kemi një formë shumësi më *-a,* të ngjashme me shumësin në të folmet gege, ndërkohë që në të folmet toske shumësi del më *-ë*.

Rasa gjinore, dhanore

Emrat e gjinisë femërore në numrin njëjës, në trajtën e shquar në shkrimin e Mitkos janë të konsoliduar nga ana formale dhe ata shkruhen me nyjën e përparme të gjinores dhe me *-ë* fundore, ruajnë theksin mbi zanoren e theksuar parafundore dhe e bëjnë fjalën me theks tejfundor: *e búkësë* (382); *e dérësë* (390); *e kólibesë* (383); *e llamíesë* (389); *e plákësë* (379, 398); trajta gjinore *e nënes* (388) përputhet me drejtshkrimin e sotëm, po të përjashtojmë shqiptimin dialektor me *-e* dhe jo më *-ë*: *nëne – nënë*. Në standardin e sotëm këto fjalë dalin pa *-ë* fundore. Emrat me theks

[441] *Drejtshkrimi i i gjuhës shqipe*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1973, f. 19.

fundor më *-i* dalin me trajtat e standardit të sotëm më *-së*: *e ushtërisë*; kurse trajta *e motërës* (378) në gjinore del me mbipërdorimin e *-ë* pastheksore*,* kurse në drejtshkrimin e sotëm shkruhet pa *-ë* pastheksore, siç shkruhen emrat më *-ël, -ër,-ërr* gjatë lakimit[442].

Emrat e gjinisë femërore në numrin shumës, në trajtën e shquar dalin me mbaresën rasore *–ve-* të shumësit dhe me nyjën shquese *-t*: *të arravet* (383); *të pelavet*; *e vjetevet* (391); po kështu dhe emrat e gjinisë mashkullore: *i bujarëvet*; kryet *e të vëllazërvet* (388); *e vëllamëvet* (397); *e zoqëvet*.

Rasa gjinore pa nyjë është një përdorim që nuk mungon në prozën e mbledhur nga Th. Mitkoja. Profesor Shaban Demiraj shkruan se "dallimi formal i rasës gjinore nga dhanorja u bë pikërisht nëpërmjet së ashtuquajturës nyjë e përparme… Por përshtatja sintaksore e "nyjës së përparme" të gjinores me emrin paraprijës edhe pas kristalizimit të saj si pjesë përbërëse të kësaj rase, me kalimin e kohës, duhej të ishte mënjanuar si diçka e panevojshme"[443]. Tek toskërishtja letrare e Mitkos gjejmë emra në rasën gjinore pa nyjë të përparme,si: e së bukurës *dheut*; pas faqes *dheut*; e mbretit *atij vendi*; prej gjakut *plagëvet*; pas urdhërit *mbretit*; te pallasi *çupës*; u shduk sythit *njerëzvet*.

Interes ngjall dhe përdorimi i emrit në rasën gjinore me parafjalë, edhe pse tek proza kemi gjetur një rast të vetëm. Kjo trajtë mund të jetë përdorim autorial i Mitkos, si njeri i kulturuar, pasi ndërtimet me parafjalë të rasës gjinore nuk janë në natyrës e prozës popullore: *me anë të s'ëmësë* (388).

Emrat e gjinisë mashkullore në numrin njëjës, në trajtën e shquar në rasën gjinore, në prozën e Mitkos dalin njësoj me trajtat e standardit të sotëm letrar, si: *i gjishtit* (385), lesht *e kreit* (385); kurse emrat njërrokësh *i lisitë*, *i mbretitë* (380), *i peshkutë,* dalin më *-ë* fundore si emrat e gjinisë femërore duke ruajtur zanoren e theksuar dhe duke u kthyer në fjalë me theks tejfundor. Theksi tejfundor është tipar fonetik i spikatur i së folmes së toskërishtes, ndërsa gjuha standarde shqipe dhe në përgjithësi gjuha shqipe dallohet për theksimin parafundor të fjalës. Tek togfjalëshi *çupën e mbret* trajta e pashquar e gjinores duhet të jetë një trajtë dialektore e të folmeve toske dhe ka përdorim të rrallë.

Në përgjithësi pranohet që mbaresat rasore të gjinores e të dhanores në numrin njëjës, në zanafillë, i kanë takuar rasës dhanore e, që këtej, janë shtrirë edhe në gjinore, kurse në shumës ka ndodhur e kundërta, d.m.th. mbaresa rasore e gjinores është shtrirë edhe në dhanore[444]. Kështu emrat e gjinisë femërore dhe mashkullore në numrin njëjës, në trajtën e shquar në rasën dhanore e bëjnë theksimin tejfundor dhe kanë trajtat: *çúpësë* (380); *dérësë*; *Márosë* (379); *kopílesë* (380); *plákësë* (380); *búshtërës*; *mótërës* (381); iu fal *ndérëjes* (nderit); emrat e gjinisë mashkullore dalin me trajtat: *djalitë*; *mbretitë* (379); emrat e gjinisë

[442] *Po aty,* f. 49.
[443] Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 1986, f. 259.
[444] *Po aty,* f. 255.

mashkullore në numrin shumës, në trajtën e shquar dalin me trajta të njëjta me rasën gjinore, shumës: *djelmavet*; *trimavet* (379); *dielvet* (djemve, 408).

Rasa kallëzore

Emrat e gjinisë femërore më *-ë*, nuk paraqesin ndonjë veçanti në numrin njëjës, në trajtën e shquar në rasën kallëzore, por ato ruajnë zanoren e theksuar të fjalës, e cila e bën fjalën me theks tejfundor. Ato dalin me mbaresën *-në*: *árkënë* (388); *bíjënë*; *darkënë* (388); *derënë* (393); *furkënë*; *gjymsënë*; *kopilenë* (380); *Maronë* (379); *pelënë* (394); *të tretënë* (mbiemër i emërzuar, 392); *urënë* (393); *çúpënë* (379, 380), por edhe *çupën* (382) si standardi i sotëm letrar. Emrat *çupëzën*, *gjymësën* në rasën kallëzore autori i shkruan me mbaresën *-n* si trajtat e standardit të sotëm letrar me mbaresën *-n*. Emrat me theks fundor i shkruan me mbaresën e rasës kallëzore *-në*: *penë* (perin, 402); *fustanë*; kallëzoren *dobëtinë* (dobësinë, 383) e shkruan si trajta gramatikore e shqipes standarde, po të mbajmë parasysh emrat e cilësisë me *-si*; kurse emrat femërorë me *-ër* i bëjnë trajtat e kallëzores me *-ën*: *kokërën*; *zëmërën* (382); *zembrën* (383) duke e ruajtur *-ë* pastheksore, ndryshe nga drejtshkrimi i sotëm që nuk e shkruan *-ë* tek fjalët me *-ër, -ërr, -ël*. Emrat femërorë prejfoljorë me *-je* e ndërtojnë kallëzoren me *-n*: *gjallëjën* (377); *mëndëjen* (382, 393); *sëmundëjën*.

Emrat e gjinisë femërore në numrin njëjës në trajtën e pashquar dalin me forma të njësuara të rasës emërore dhe kallëzore dhe me karakteristikat fonetike të theksimit parafundor të përmendura më lart: *konëzë* (388); *motërë* (381); *mëndëje* (këshillë, 379) *vdekëje* (377); *dasëmë* (393), por ndeshim dhe trajtën e sotme *dasmë* (380).

Emrat e gjinisë femërore në numrin shumës, në trajtën e shquar kallëzore ruajnë theksimin tejfundor dhe për këtë arsye ata dalin me këto trajta të njësuara me rasën emërore: *eshtartë* (eshtrat, 397); *patatë* (patat, 380); *shoqetë* (388);

Emrat mashkullorë njërrokësh me bashkëtingëllore, në rasën kallëzore të shquar dalin me *-në* të vendosur menjëherë pas temës së emrit. Kjo është karakteristikë e të folmeve jugore më tepër në zonat fshatare[445]: *dashnë* (415); *dhenë* (dheun); *gjaknë* (390); *mbretnë* (378); *trimnë* (382); *trupnë* (377); *veshnë* (veshin); tek emrat dyrrokësh më bashkëtingëllore gjejmë kallëzoren: *tiganë*; *kalën* (kalin, 390); *ujën*; kurse emrat mashkullorë me më shumë se dy rrokje e bëjnë kallëzoren si në standardin e sotëm letrar: *vëllanë* (383); *shpirtin* (397) edhe *shpyrtinë* (shpirtin, 397); *djalëthin* (394); *gjishtin* (389); *krëhërin* (377); *pullumbin*; *të vetëmin* (mbiemër i emërzuar, 392);

Emrat mashkullorë në kallëzoren e pashquar njëjës kanë forma rasore të njësuara me rasën emërore dhe dalin të ngjashëm me trajtat e gjuhës standarde, si: *dre* (378); (në) *dhé* (388); *orok* (377); *vent* (vend, 382); *bukëtar* (382); *fëngjill* (389); *pullump* (pëllumb); *dëshërim* (dëshirë); *mentim* (mendim). Formë karakteristike e të

[445] J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare,* Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 74.

folmeve të jugut është dhe kallëzorja në trajtë të pashquar, por me kuptimin e trajtës së shquar: *morrë* (morrin); vajti e shojti *zjarrë* (zjarrin, 389);

Emrat mashkullorë në rasën kallëzore, numri shumës, trajta e shquar në gjuhën e shkruar të Mitkos kanë forma të njësuara me rasën emërore në numrin shumës, trajta e shquar. Ata dalin me mbaresën e shquarsisë me *-të* dhe theksi i fjalës zhvendoset në pozicion tejfundor: *trimatë* (378); *hundëtë* (hundët); *zoqëtë* (zogjtë); *kuajtë* (393), por gjejmë dhe kallëzoren *kuajt* (393), që përputhet me standardin e sotëm të gjuhës shqipe.

Në toskërishten letrare të Mitkos ndeshim një ndërtim të veçantë, numrin shumës të emrave prejfoljorë më *-je* me mbaresën më *-a* në rasën kallëzore me parafjalë: *me qarëja*; *me sharëja*; *me shtyrëja*;

Rasa rrjedhore

Emrat femërorë në rasën rrjedhore me parafjalë, numri njëjës, trajta e shquar kanë trajta të njësuara me dhanoren dhe ruajnë dukurinë fonetike të theksimit tejfundor: përbrënda *arkës* (388) është e njëjtë me standardin e sotëm; prapa *derësë* (381, 388); prej *çupësë*; pas *vdekëjes* (398). Folkloristi ynë përdor rasën rrjedhore njëjës pa parafjalë në ndërtimet: i djegur *etje* (378); i dredhurë *frike*; u drodh *frike*; çfarë *kopilërie*; në numrin shumës gjejmë rashë *këmbësh*; pas këtyre *fjalësh* (399); Në përrallat e "*Bletës…*" ndeshim dhe trajtën gege të rrjedhores me ose pa parafjalë, që ka dalë nga bashkimi i formës së rrjedhores së pashquar me nyjën *-t*(*ë*)[446]: prej *shollet* (377); marrohej *friket*.

Emrat mashkullorë njëjës, trajta e shquar në rasën rrjedhore me parafjalë kanë trajta të njësuara me rasën dhanore: anës *detit*; prej *gjakut*, njësoj me standardin e sotëm; jashtë *qytetitë*; ndeshim rrjedhore pa parafjalë: "tashi *dimërit* ku ka lëndinë të njomë" (380); u shduk *sythit*.

Rasa vendore

Disa të folme të shqipes kanë trajtën e rasës vendore. Kjo formë që ndërtohet nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa *-t*(*ë*) është bërë zakon të quhet trajtë e rasës vendore. Ajo paraprihet gjithmonë nga parafjalët *në, mbi, nën, nëpër, përmbi, me* dhe *për*[447]. Thimi Mitkoja e shkruan rasën vendore me parafjalë në dialektin toskë: *ndë brest*; *ndë gjitë*; *ndë kopështët; ndë pust; ndë lumët* (393); *ndë thest* (413); *ndë ujt*; *ndë zjarrt*; *ndë derët* (389); *ndë dorët* (393); *ndë letrët*; *ndë leqet*; *ndë pellgut* (410); *ndë thanat* (412); *ndë vërët*; *ndë zëmbrët* (381); *ndë pellgut* (410); *ndëpër lumët* (392); *mbë gomart* (413); *mbë qafët* (398); *mbë derët*; *mbi list* (379); *në gropët* (381); *në pust*; *në trungut* (378); *mbi dhetë*, por edhe *mbi dhé*. Në këtë përdorim Aleksandër Xhuvani përdor për parafjalën termin tëjore parafjalore[448] dhe sqaron se "në vend të termit rasë vendore, që nuk shkon aspak me sintagma që nuk

[446] *Po aty,* f. 74.
[447] *Po aty,* f. 74.
[448] A. Xhuvani, "Parafjalët", *Studime filologjike,* 1,1964, f.12.

tregojnë vend, por mjet a rrethanë…, po përdor këtë term këtej e tutje që më duket më i përshtatshëm për të shprehur edhe relacione të tjera veç të vendit."

EMRAT E GJINISË ASNJANËSE

Asnjanësi ruhet në disa të folme jugore e në të folmet lindore, ruhet gjithashtu dhe në qendër, në të folmet malore, por më tepër në formën e rasës kallëzore[449]. Në "*Bletën…*" e Mitkos gjejmë emrat e gjinisë asnjanëse, si: *bukët*ë (415); *brumët*ë (415); *rrushtë*; *ujët*; *të keqtë* (378); gjejmë emrat foljorë asnjanës: *të bënat* (ndodhitë, 378); *të dhembura*; *me të dhembur* (383); *të nkëthyerët*; *së ngrëni*; nga *të qarëtë* (398); pas *të luturash*; *të pallurit*.

MBIEMRI

Mbiemrat në "*Bletën shqiptare*" të Mitkos kanë larmi kuptimore dhe veçori morfologjike. Ata janë të parmë: *e bukurë*; *të glatë*; *i huajë* (393); *të kuqe*; *i math*; *i vogëlë* (383); *i vobekë* (391); *e verbërë* (379); mbiemra me prapashtesa dhe paranyjëzim, të prejardhur nga pjesoret me paranyjëzim: *i humbur'* (ay); *i fatkeqërosur*; *i bjerrë* (403); *të çelurë* (sytë); *të çmëndurë* (410); *i çkujdesurë*; *i dëshpëryerë*; *i dishëruarë* (i dëshiruar); *të gurëcuar* (të ngurtësuar, 383); *i hakëruarë* (393); *të lëvduarë*; *i panjohurë* (393); *e pluhuriturë*; *të mbyllturë*; *të ndërtuarë*; *i mfishkurë* (i fishkur, 382); *i mveshurë* (401); *të prishurë*; *të sosurë*; por gjejmë dhe përdorimin dialektor: *e përmbledhëjë* (e përmbledhur); mbiemra të formuar me tema emërore që emërtojnë lëndë me prapashtesën -(*ë*)*t*(*ë*) dhe paranyjëzim: *t' ërgjëndë* (390); *të hekurtë* (381,388); *e leshëtë* (380); mbiemra nga tema emërore, ndajfoljore me prapashtesën -*shim* (prapashtesa -*shëm* e standardit të sotëm): *të çudiçimë*; *të gatshim* (379); *i mentshimë* (392); *të rrezikshimë* (382); *të nevolëshme*; mbiemra të prejardhur nga ndajfolje me paranyjëzim: *të fellë* (392); *e vetëmë* (378, 391); *të kthjellëtë*; *të turbulltë* (392) dhe *të turbullë* me dy trajta (392). Mbiemrat e prejardhur nga një numëror, nga një emër me prapashtesën -*ç* dialektore, që në gjuhën e sotme letrare i përgjigjet prapashtesa -*sh*, Mitkoja i shkruan ndaras: *tri diç* (triditësh, 395); *njëzet diç* (njëzetditësh, 395), kurse mbiemrat *pesëmbëdhjetë vjeç* (398); *gjashtëmbëdhjetë vjeç* (402) i shkruan drejt si mbiemrat e tipit *trevjeç, njëzëtvjeç*[450], por ndaras. Nga leximi kemi gjetur dhe një mbiemër të formuar me paranyjëzimin e një emri: mbretëreshën *e rrenë* (e rreme, 381); mbiemra të prejardhur me paranyjëzim dhe me parashtesim e prapashtesim njëkohësisht (cirkumfikse, rrethshtesa[451]) : *i patrëmbëshimë* (395).

Në materialin e vjelë hasim dhe disa mbiemra të emërzuar, por që përdoren brenda një konteksti të caktuar, emërzimi kontekstual[452]. Të tillë janë: *e egëra*; *i patrëmbëshmi*; *të zinë* (litarin e zi); *të tretënë* (e treta, 392); *i vetëmi* (392, 401).

PËREMRI

[449] J. Gjinari, *vep. e cit.*, f. 69.

[450] *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II,* Botim i Akademiasë së Shkencave, Tiranë, 1976, f. 166.

[451] E. Lika, M. Çabej, *Morfologji e shqipes standarde,* Tiranë, 2013, f. 18.

[452] *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II, vep. e cit.*, f. 151.

Përemrat janë një kategori mjaft heterogjene si nga ana morfologjike, ashtu edhe nga ana sintaksore[453].

Përemri vetor

Në përrallat e përmbledhjes *"Bleta shqiptare*" përemri vetor *ti* del në rasën dhanore, kallëzore me trajtën *tynë* (trajtë dialektore e të folmeve të Korçës) dhe në rasën rrjedhore me trajtën *prej teje* që përkon më standardin e gjuhës letrare.

Përemrat e vetës së tretë njëjës në rasën emërore dalin me trajtat përfaqësuese *ay* (391); *ajy*; *ao* (ajo, 409) si në anët e Çamërisë e të Gjirokastrës[454]. Shkrimi i këtyre përemrave ka luhatje dhe është shkruar ashtu si i kanë shqiptuar folësit. Nga shembujt duket që nuk ka një traditë të ngulitur të shkrimit të përemrit *ai, ajo*. Kurse rasa dhanore shkruhet me trajtat *ati*; *atijë* (393); gjinorja shkruhet me trajtën *të atij*, duke ruajtur kuptimin gramatikor të gjinores dhe formën gramatikore të ngjashme me dhanoren.

Përemri vetvetor

Në prozën popullore të mbledhur nga Mitkoja funksioni i përemrit vetvetor është që të tregojë personin, i cili në një fjali të caktuar përfaqëson njëkohësisht atë që kryen dhe atë që e pëson një veprim[455]. Përemri *vetja* del në trajtën e rasës kallëzore pa parafjalë: *vetëhen*; në kallëzore me parafjalë: mori *me vetëhe* (380, 392); *me vetehe*; fjala *vetë* del me vlerën e një përemri përcaktues[456]: ruante *vetë*.

Përemri dëftor

Në toskërishten letrare të Mitkos, përemri dëftor *këjo,* del dhe me variantin fonetik *qo* si në të folmet në anët e Beratit, të Myzeqesë, të Mallakastrës, në Elbasan dhe në disa të folme kalimtare[457]. Në rasat e zhdrejta dëftorët dalin në gjininë asnjanëse: *e atyrevet*; *atyrevet* (390); *pranë këtyrevet*. Mitkoja përdor përemrin dëftor cilësues të ngjashëm me mbiemrin: *të këtillin*; rrjedhoren *prej syresh* (405);

Përemri pronor

Në përgjithësi përemrat pronorë pas emrit dalin me trajta të unifikuara, si:

pronori i vetës së parë me pronar njëjës: fjalët *e mia* (382); mbi kurris *tim*;

pronori i vetës së parë me pronar shumës del me nyjë të përparme: vëllai *i ynë* (403); por vëllanë *tënë* (404, 406); gjallëjën *tonë* (377);

pronori i vetës së dytë me pronar njëjës: fati *jyt* me *j-* nistore; shpyrtinë *tënt* (397); djalërinë *tënde* (401); kryet *tat* (401), që haset në të folmen e Shqipërisë së Mesme[458];

pronori i vetës së dytë me pronar shumës: zoti *juajë* (405);

---

[453] *Po aty*, f. 179.
[454] J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare,* Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 76.
[455] *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II, vep. e cit.*, f. 191.
[456] *Po aty,* f. 192.
[457] J. Gjinari, *vep. e cit.*, f. 76.
[458] J. Gjinari, *vep. e cit*., f. 77.

pronori i vetës së tretë me pronar njëjës: e dashur *e tijë*; ndë shtëpi *të tij* (393); ndë vënd *të*

tijë; mbë duart *e tija*; dhomës *së tij* (381); fustan' *e sajë*; me kopilen *e saj* (380); një kopile *të*

sajnë (380); me dinakëritë *e saja* (379). Mitko i shkruan nganjëherë përemrat pronorë pa nyjë të përparme: pas vdekëjes *tij*; drurit *saj*; anës pallasit *saj*; ndë sytë *saj* (381). Mund të themi se këtë e bën për t'i qëndruar besnik gjuhës së tregimtarit, pasi në pjesën më të madhe ai i shkruan nyjat e përparme tek përemrat pronorë. Kemi gjetur një rast të përdorimit të pronorit të emërzuar: është *joteja*; kurse nyja e përparme me vlerë pronori para emrave të farefisnisë duket një fenomen gjuhësor mjaft i përhapur dhe i ngulitur në të folmen popullore e që pasqyrohet dhe në gjuhën e shkruar të folkloristit tonë, si dhe në standardin e sotëm: *e* shoqeja (351); *i* jati (352); *e* ëma (352); *t'* et (355); me *të* vëllezërit (359); *tët* vëllezërë (363).

Përemri pyetës

Përemrat pyetës janë të njëjtë me ata të gjuhës së sotme letrare: *kush?*(353); *cila*? (388); *cili*? (390); *ç'* (njeri, 392); bën përjashtim përemri pyetës *çë*? (çfarë, 361, 392, 407), i cili nuk bën pjesë në standardin e sotëm letrar.

Përemri lidhor

Toskërishtja letrare e gjysmëshekullit XIX përdor në periudhat e përbëra përcaktore përemrat lidhorë dhe ata dalin me trajtat e standardit të sotëm të gjuhës shqipe. Të tillë janë: *që*; *e cila* (388, 397); *i cili* (355); *të cilat* (389, 397); *të cilët* (383, 386, 388).

Përemri i pacaktuar

Në përrallat e vështruara kemi vjelë disa përemra të pacaktuar, që sot nuk përdoren në standardin letrar, por përdoren në letërsinë artistike me vlera stilistikore. Të tillë janë: *akëcili*; *akëcila* (379, 380, 393); *akëcilën*; *akëcilënë* (380); *çesa* (disa, 407); *faregjë* (asgjë).

Përemrat e tjerë kanë një përdorim më të shpeshtë dhe janë pjesë e fondit leksikor të gjuhës standarde shqipe, si: *asnjë* (382); *cilado*; *ca*; *çdofarë* pune (i ngjashëm me përemrin sinonim *çfarëdo*, 381); *gjithë*; *gjithësecili*; *të gjithë*; *gjithkush*; *ndoca* (385); *njëji* (qyteti, 400); *njërësë*; *tjetërë*; *tjetërën* (378); *tjatra* si një trajtë dialektore.

Mitkoja përdor përemrat e përngjitur: *përemër i pacaktuar + lidhëza*: *gjithësa* (i duheshin); *përemër i pacaktuar + përemër: gjithato*; *gjithëajo*. Si përemra të pacaktuar të trashëguar nga një fazë e hershme në fazën e dokumentuar të shqipes shërbejnë *jetër/jatër* (sot *tjetër/tjatër*)[459]. Kështu kemi ndërtimin *përemër i pacaktura + përemër i pacaktuar* në rasat e zhdreja, të cilët sot i shkruajmë me vizë lidhëse në mes: *njërijetërit* (395); *njëratjetrës*; *njëriatërin* (406); *shoqishoqin*. Një tip më vetë krijojnë përemrat e pacaktuar që janë përftuar nga përsëritja e së njëjtës fjalë në dy rasa të ndryshme, i pari në rasën emërore dhe i dyti në rasën kallëzore

[459] Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 1986, f. 514.

me parafjalën *me* dhe që folkloristi ynë i shkruan jo ndaras: *njerimejatërin*; *shoqmeshoq*; por ndeshim disa nga këta përemra të shkruar ndaras si *shoq me shoq* (385, 395); apo pa vizë lidhëse si *njëri atrin* (398).

TRAJTAT E SHKURTRA

Në "*Bletën…*" e Mitkos format e patheksuara të përemrit vetor ose siç i quajmë ndryshe trajtat e shkurtra, përdoren me vlerën e kundrinës së drejtë, përkatësisht të zhdrejtë ose si përsëritëse të këtyre kundrinave. Trajtat e rasës kallëzore dalin me foljet në lidhore: t'*e* gënjesh (381); t'*e* març (381); t'*e* marrë (381); t'*e* siellç (381); t'*e* ngushëllonjë (379); t'*e* marrë (380); kurse në dhanore gjejmë: *më* dërgoi (356); *u* fshiu (388);

TRAJTA E SHKURTËR E BASHKUAR

Kjo formë ndërtohet me dy trajta të shkurtra përemrash vetorë njëra pas tjetrës, por në vend të trajtës së shkurtër *i* të dhanores Th. Mitkoja shkruan *j* dhe, në vend që të kemi *i* + *e* = *ia*, Th. Mitkoja shkruan *ja*: *ja* dha (380); *ja* kursenin (381); *ja* kishin thyerë (382); të *ja* shohë (389); kurse me format joveprore trajta e shkurtër *i* del si në standardin e sotëm letrar: *i*u derth.

Format e patheksuara të dy vetave të para në njëjës dhe ajo e vetës së parë shumës, përdoren

edhe si dhanore etike[460]. Ato nuk përdoren në funksionin e kundrinës së zhdrejtë, por për të

shprehur një qëndrim afektiv të folësit. Gjejmë te përrallat e Th. Mitkos përdorimet: kush *më* ha rrushtë? (353); dua të *më* gjeni çupën (356); *më* qënëka thënë të mos vetë ndë shtëpi (392); qënëke të mos *na* jetë; *ia* dhanë të qarët.

NUMËRORI

Numërorët përdoren si shoqërues të emrave që emërtojnë sende a qenie të një fare[461]. Të tillë i gjejmë dhe në prozën e Mitkos. Ata nuk paraqesin dallime me standardin dhe janë numërorë karakteristikë që i gjejmë në folklorin tonë: *dy* qirinjtë (389); *dy* vëllamëtë (389); *dy* vëllazër (406); *tre* djelm (408); *tre* vëllezër (406) në gjininë mashkullore; *tri* pela (407) në gjininë femërore; *tre* qena (407); *katërë* portarët (405); *nëntë* vëllezër (388); *gjashtë* a *shtatë* çape (393); *shtatë* djemtë e plakës (355); *shtatë* udhët (402); *njëzet e katërë* ditë (402); *njëzet e katër* orë (407); *nëntëdhjetë e nëntë* oda (407); *pesëqind* veta (406); preu *shtatëqind* veta (405).

FOLJA. Mënyra dëftore

Tek folja gjejmë këto trajta gramatikore:

Foljet që dalin me mbaresën *-j* në vetën e parë njëjës në kohën e tashme të mënyrës dëftore, ruajnë mbaresën *-nj*, tipar i toskërishtes veriore: *dëshëronj*; *vinj* (391).

Ky grup, në kohën e pakryer të mënyrës dëftore ka trajta të njëjta me standardin e sotëm: *çquante*; *çkarkonte* (410); *fatkeqëronte* (qante fatin, 379);

[460] *Po aty,* f. 455.

[461] *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II, vep. e cit.,* f. 168.

kuxonte (guxonte); *numuronte* (384); *delte* (dilte); *derdhte* (379); *diqte* (digjte). Th. Mitkoja shkruan dhe në trajta dialektore foljet më bashkëtingëllore: *hapënte* (392); *hidhëte* (çomangën); *lypënte* (381); *goditënte*; *vërtitënte*; *rritënte*; *ecënte* (401); *ikënte*. Në kohën e pakryer të shumësit gjejmë mbaresa kohore të ngjashme me standardin letrar: *shëkonin* (shikonin, 390); *rrithnin* (rridhnin 380); madje dhe trajta dialektore: *ruanjën* (ruanin, 395); *përqafonjën* (përqafonin, 388); *përgëzonjën* (përgëzonin, 388); *shkoninë* (408).

Foljet e parregullta josupletive *dua*, *lë*, *them* dalin me trajtat karakteristike të toskërishtes, por jo të ngjashme me standardin letrar: *doi* (donte); *duante* (378, 390, 413); *duanin* (donin, 381); *lírin* (linin, trajtë me rotacizëm *n* < *r*); *thosh* pa mbaresën -*te* të standardit (388).

Foljet në kohën e ardhme i shkruan me pjesëzën *do + folje në të tashmen e lidhores.* Në asnjë rast nuk gjejmë asimilimin e pjesëzës *të*: (unë) *do të gjenj'*; *do të vete*; (ti) *do të març* (382); *do të sjellç*; *do të shëkosh* (388); (ai) *do të hapnjë* (388); *do të rrëfenjë* (388) dhe në vetën e tretë njëjës ato dalin me mbaresën më *-ë* për t'u dalluar nga trajta e lidhores në vetën e parë njëjës, ashtu si në standardin e sotëm.

Në përrallat e "*Bletës…*" gjejmë dhe tipin e dytë të së ardhmes, ndërtuar me foljen ndihmëse *kam* dhe me formën e pashtjelluar të tipit *për të + pjesoren* e foljes: *kam për të marë; ka për të harruarë; ka për të marrë;* por gjejmë dhe të ardhmen e së shkuarës: *kishin për të zbriturë* (410).

Foljet në kohën e kryer të thjeshtë, veta e tretë, njëjës dalin me mbaresa që i përgjigjen standardit letrar: *kupëtoi*; *çkarkoi* (393); *çfaqi*; *kuxoi*; *mëhoi* (411); *mbesoi*; *mvari*; *mveshi* (380); *mvrau* (402); *mvodhi*; *sgëlidhi* (414); *shpuri*; *xëbathi* (zbathi); *xveshi* (401, 405); *zapëtoi* (zaptoi, 402); por hasim dhe trajta dialektore në foljet me temë në zanore: *arriu* (391, 401, 409); *dëfteu* (386); *çpojti* (410); *dështojti* (395); *durojti* (378); *gatojti* (388); *mësojti* (397); *ngarkoiti*; *sokëllijti* (397); *shkojti* (378, 391); *shtrëngojti* (380); *tregojti*; *urdhërojti* (381, 405); *zbojti* (394); foljet më bashkëtingëllore dalin me trajtat dialektore duke zbërthyer *o* < *ua*: *muar* (381, 405); *suall* (403)*; duall* (380), por edhe *dolli*.

Foljet në kohën e kryer të thjeshtë, veta e tretë shumës, dalin në trajtat dialektore të çamërishtes dhe të të folmes së Gjirokastrës: *gjetin* (414); *mbajtinë* (389); *ngrejtin*; *rrojtin*; *thertin*; foljet më bashkëtingëllore, në kohën e kryer të thjeshtë, veta e tretë, shumës dalin me mbaresën *-në*: *hypënë*; *iknë* (377); *lithnë* (379); *muarnë* (379); *ndoqnë* (378); *pikasnë* (383); *prishnë*; *rrothnë* (380); *thëritnë* (378); me mbaresën *-ën*: *duallën* (405); *suallën*; *nxuarrën*; *muarën* (406), por edhe *marrënjën* (morën, 397); *nqasën*; *rrahën*;

Foljet në kohën e kryer dalin me foljen ndihmëse *kam* dhe me *pjesoren* e foljes: *ka humburë*; *ka rar'* (rënë, 380); *kanë vaturë* (401); kemi gjetur një rast të formës së vjetër *fjeturkam*.

Foljet në kohën më se të kryer dalin me foljen ndihmëse *kisha* dhe me *pjesoren* e foljes: *kish dërguarë* (394); *kish gurëcuarë* (381); *kish ngrirë* (381); *kish shpurë*

(390); *kishin bënë* (393); *kishin dalë* (388); *kishnin vajturë* (381); *kishin thyerë* (381); *kishin kallëzuarë* (383).

Foljet në kohën e tashme të formës joveprore dalin me mbaresa të ngjashme me standardin e sotëm: *-em, -e*(*sh*)*, -et*(ë): (unë) *nkëthenem* (392); (ti) *shërohesh*; *tretesh*; (ai) *bënet* (378); *nxehetë*; (ata) *mprihenë*;

Foljet në kohën e pakryer të formës joveprore dalin me mbaresa të ngjashme me standardin e sotëm: *bënej* (393); *dëgjonej*; *humbej* (383); *mendohej* (408); *pakoheshin* (pakësoheshin).

Foljet në kohën e kryer të thjeshtë të formës joveprore ndërtohen me pjesëzën *u* dhe formën vetore të foljes: *u çpif* (408); *u derth* (379); *u dëshpërye* (382); *u mentua*; *u mallënjye*; *u mfishk*; *u msheh* (381); *u nkëthye* (377, 403, 408); *u nkthye*; *u ndoth* (379); *u ngrejt*; *u ngre*; *u përgjeq* (380, 388, 404); *u përgjegj* (398); *u sos* (393); *u shduk*; *u tremp*; *u afëruan* (405); *u gjetnë* (381); *u helmuanë* (383); *u kapitnë*; *u mahnitnë* (380*,* 388*); u çudinë* (378)*; u lothnë* (378)*; u mbluadhën; u mbëluadhën; u ngjallën; u ndothnë* (388); *u ngjallnë* (380)*; u pataksnë; u pataksën; u mbylltin; u mpruajtin; u grejtin*.

Foljet në kohën më se të kryer të formës joveprore ndërtohen me të pakryerën e foljes ndihmëse *jam* dhe me pjesoren e foljes: *ishte porositurë; ish zotuarë (*394*); ishnin ngarkuarë (*393).

Mënyra lidhore

Foljet në mënyrën lidhore ndërtohen me pjesëzën *të* dhe formën vetore të dëftores si për kohën e tashme, ashtu dhe për kohën e pakryer: *(unë) të fitonj* (391); *të gjenj* (388); *të mbaronj; të shpëtonj; të shtrinj (405); (ti) të shtijeshë; të shtiesh*. Gjejmë lidhoren me nuancë urdhërore pa pjesëzën *të* dhe me pjesëzën mohore *mos*: *mos* e *lëshosh*, *mos shkosh*, *mos lesh* (392); foljet me mbaresën *-j* të tipit *punoj* dalin me trajtat dialektore në vetën e dytë njëjës: *të bënjësh* (388); *të besonjësh* (382); *të hypnjësh;*

Lidhorja në vetën e tretë njëjës del me mbaresën e vjetër të dëftores më *-një*: (ai) *të digjonjë* (378); *të flytyronjë; të gjuanjë; të harxhonjë* (392); *të hynjë*; *të kupëtonjë; të kopilonjë (*të shërbejë*); të lanjë* (377); *të martonjë; të mpshonjë; të rrëmbenjë; të shëronjë; të shikonjë; të shtrëngonjë; të shpëtonjë*. Kemi gjetur dhe trajtën pa *–nj* si në standardin e sotëm: *të kërkojë*; *të baresë* (380).

Foljet në mënyrën lidhore e formojnë kohën e pakryer në vetën e tretë njëjës me pjesëzën *të* dhe me të pakryerën e mënyrës dëftore: (ai) *të ëndënjën* (410); *të vinjën*; *të presën; të qasën*, por gjejmë dhe *të mirte* (402).

Foljet në mënyrën lidhore në numrin shumës në kohën e pakryer dalin me format: (ne) *të bënjëm*, (386); (ata) *të gjenjën* (gjenin); *të këndonjën*; *të varrosninë* (397); *të heqën* (378).

Foljet në mënyrën lidhore në formën joveprore në kohën e tashme dalin pothuajse me mbaresat joveprore të standardit të sotëm letrar; në disa raste gjejmë *-n-* në vend të *-h-*, e cila përdoret kundër hiatusit: (ai) *të bindetë*; *të martohetë* (379);

të mentohetë (380*); të nkëthenetë; të ngjatet; të gjegjet; të humbetë* (383); *të lutetë* (379); *të vritetë*; (ata) *të ushqenen* (409); *të nkëthehen*.

Mënyra kushtore

Foljet në mënyrën kushtore dalin rrallë në përrallat e mbledhura nga Th. Mitkoja. Foljet e gjetura janë: *do të mundënte* (me kuptimin "*do të mposhtte*"); sikur *do të zbukuroneshe* (do të zbukurohej);

Mënyra dëshirore

Foljet në mënyrën dëshirore kanë të njëjtat trajta gramatikore me standardin e sotëm letrar: *rrëzofsh* (382); *mbeç me shëndet* (404); (ai) *vraftë*; (ne) *kapërxefshim* (400); (ata) *u zënçin* (405); por kemi gjetur dhe trajtën dialektore *hëngrësh* (382).

Mënyra habitore

Foljet në mënyrën habitore janë të pranishme në përrallat popullore si trajta për të shprehur habinë dhe të papriturat që vijnë nga situatat e befasishme, të rastësishme, fantastike dhe të mrekullueshme. Edhe për nga funksionet ajo takohet vetëm pjesërisht me të ashtuquajturën *mënyrë të ritregimit* të bullgarishtes dhe të maqedonishtes, e cila përdoret, ndër të tjera, edhe për të shprehur habinë e folësit, si dhe qëndrimin e tij mospajtues[462]. Habitorja e kohës së tashme del me trajtat: *qënëke* (389, 397); *qënëkan* (414); habitorja në kohën e pakryer del me trajtat: *qënëkej*; *qënkëshin*; *rënëkëshin*; *mbijkëshin*; habitorja në kohën e kryer del me trajtat: *qënëke shëruarë* (414); *qënëka thënë* (392, 393); *pasëkam fjeturë* (398, 403); *pasëka marrë* (394); *pasurkan ngrënë* (411); habitorja në kohën më se të kryer del me trajtat: *pasëkej vrarë* (411); *pasëkej fjetur* (411); *qënëkej mbjellurë* (411). Nga gjetjet, duket që Mitko nuk i shkruan këto trajta ashtu siç i dëgjon, por ndjek traditën shkrimore të toskërishtes letrare, ruan *ë-në* fundore të pjesoreve. Tek trajtat *qënkëshin*; *mbijkëshin* kemi ndoshta një njësim të rastësishëm me standardin e sotëm letrar.

Mënyra urdhërore

Folja në mënyrën urdhërore përdoret e pashoqëruar dhe e shoqëruar me trajta të shkurtra të paravendosura ose të prapavendosura. Trajtat e urdhërores janë të ngjashme me standardin e sotëm letrar: *dëgjo* (414); *shëko* (381, 414); *shkunt* (shkund, 382); urdhërorja me trajta të shkurtra të prapavendosura: *dërgomë*; *blimë*; *ngremë* (398); *premë* (398); *ami* (m'i jep, çamërisht); *siellëna* (394); *shpinie* (385); urdhërorja me trajta të shkurtra të paravendosura: mos *e nxierr* (388); *i thuaj* (388);

PJESORJA

Pjesorja në "*Bletën shqiptare*" të Th. Mitkos del me mbaresat *-ur, -r, -në*. Ai shkruan *ë-në* fundore pastheksore, duke ruajtur theksin tejfundor, karakteristikë fonetike e të folmeve toske: *dërguarë* (394); *goditurë*; *hapurë*; *hypurë* (392); *mbeturë*; *mbushurë*; *mbluarë*; *mbyllturë* (çamërisht); *mveshurë*; *ndërruarë* (378); *ngarkuarë* (393); *prishurë* (406); *porositurë*; *shkruarë*; *shtrënguarë*; *thërriturë*; *thyerë*

[462] Sh. Demiraj, *vep. e cit.,* f. 906.

(406); *xbriturë*; (vate) *zbrazurë*; *zotuarë* (394) *ardhurë*, por gjejmë dhe raste të veçuara, që përputhen me standardin e sotëm letrar: *ardhur*; *vënë*.

PËRCJELLORJA

Përcjellorja në prozën e Th. Mitkos ndërtohet me pjesëzën *duke*/*tuke*/*tue* (trajtë gege) dhe *pjesoren* e foljes: *duke luajtur; duke përqeshur; duke vaturë; tuke cëcëriturë; tuke ikurë* (377); *tuke kërkuarë* (378); *tuke u lebetiturë; tuke thënë; tuke thëthirë* (thithur, 390); *tue fshirë* (390); *tue pikasurë*; *tue thënë* (389).

PASKAJORJA

Paskajorja ndërtohet me pjesëzat *për të + pjesoren* e foljes: *për të çkarkuarë* (410); *për të çpërblyerë; për të shpërblyer; për të gjeturë* (393); *për të hallaviturë; për të ikurë* (398); *për të u martuarë; për të mbaruarë* (378); *për të ndihmuarë*; *për të nkëthyerë* (382); *për t'u ndëgjuarë; për të shpëtuarë; për të ushqyerë* (378); paskajoren në formën joveprore me pjesëzën *u* e gjejmë të shkruar me apostrof: *për t'u ndëgjuarë*; *për t'u lëshuar;* dhe pa apostrof në formën *për të u martuarë*. Kemi gjetur trajtat e paskajores së njësuar me standardin e sotëm: *për t'u lëshuar; për të marrë* (381); *për të ngrënë*; *për të qënë* (392); *për të shpënë* (394).

Paskajorja del në ndërtimin me pjesëzat *mbë* (*me*) *të + pjesoren* e foljes; pjesëza *mbë* është dialektore: *mbë t'ardhurë* (380); *mbë të nkëthyer* (378); *mbë të vajturë* (380).

FORMA E PASHTJELLUAR MOHORE

Forma e pashtjelluar mohore ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzën *pa*: *pa diturë; pa fituarë; pa hyrë; pa mënuarë; pa marr'* (as firom' ajo)*; pa ndjerë* (394); *pa njohurë; pa punuarë; pa rriturë; pa vaturë* (393, 403).

NDAJFOLJA

Në përrallat e "*Bletës shqiptare"* ka një numër të madh ndajfoljesh, që janë pjesë e standardit të sotëm letrar, si: *atëhere*, *kurdoherë, kurrë* (388), *që moti, atje, aspak, burrërisht, dalëngadalë, fshehurazi*, *paskëtaj*, *prapë* (380); *pasandaj* (383, 393); *rëndom* (397); *tashi* (380) etj. Por një grup ndajfoljesh dalin në trajta dialektore të toskërishtes: *gjithënjë, sakaqë, sonëte* (414).

Ndajfoljet e kohës

Ndajfoljet e kohës paraqesin larmi në përbërjen e tyre strukturore: ndajfolje që kanë në përbërje emrin *herë*: *atëhere* (388); *atëhernaj; atëherënaj* (404); *ahere*; *menjëherë* (385, 397); *përnjëherje*; *mbasohere*; *sakaqëherë*; ndajfolje që kanë në përbërje emrin *ditë*: *dita me ditën* (390); *ngaditë*; ndajfolje që kanë në përbërje emrin *fund*: *mbë së fundi* (382) dhe *mbësëfundi* (398) dalin me dy mënyra shkrimi: si lokucion ndajfoljor dhe si fjalë e përngjitur; ndajfolje që kanë në përbërje përemrin e pacaktuar *gjithë*: *gjithënjë* (393, 398); *gjithherë* (390); *gjithënjëherie*; ndajfolje që kanë në përbërje trajtën e ngurosur *mbrëma*: *një mbrëma* (388); *mbrëmanet* (378,388, 390); ndajfolje që kanë në përbërje emrin *moti*: *që moti* (388); *pas pak moti* (397); ndajfolje që ndërtohen me një trajtë ndajfoljore të emërzuar në formë të ngurosur: *të nesërmet* (378, 394); *të pastajmen* (388, 391,405); *të pastajmetë*; ndajfolje që ndërtohen nga një parafjalë dhe forma e ngurosur e rrjedhores së

mbiemrave të emërzuar asnjanës, por që Th. Mitko i shkruan bashkë: *përsëgjati* (folën gjatë); *përsëdyti*.

Ndajfoljet e vendit

Shumë prej ndajfoljeve të vendit janë pjesë e fondit të standardit të sotëm letrar: *lark* (383); *përsipër*(ë) (393); *së sipërmi*; *rrotull*(ë) (379); *atje* (389) dhe variantet dialektore *atjenë* (406); *atjenaj* (atje); *këtejnaj* (378); *gjith'anë*; *akseku* (diku, 398); *vënt mbë vënt* (390).

Ndajfoljet e sasisë

Disa nga ndajfoljet e sasisë janë pjesë e fondit të standardit të sotëm letrar: *aspak* (378); *capak* (393); *përgjysmë* (378); *aq(ë)*; *kaq(ë)* dhe trajtat *aqe*; *kaqe* (380); *m(e)jaft*; *tepër(ë)*.

Ndajfoljet e mënyrës

Ndajfoljet e mënyrës që bëjnë pjesë në fondin e standardit të sotëm letrar janë: *burrërisht* (403); *dalëngadalë* (393); *këmbëkryq* (390); *kruspull(ë)*; *fshehurazi* me variantet *fshehura(j)* (çamërisht 393, 394); *fshehtazi* (394); (m)*fshehura*(j) (397); (m)*fshehurazi* (413); *vrapazi*; *përsëprapi* (407); *ngadalëzë* (394) me variantet e çamërishtes *kadalëzë*; *kadalezë* (414); *shpéjto* (shpejt, 387, 397); *vràpo* (me vrap, 387, 397); *me të çpejtë* (402); *copra-copra* (381); *vetëm filli* (398).

PARAFJALA

Në përrallat e "*Bletës shqiptare"* ka një numër të madh parafjalësh, që janë pjesë e standardit të sotëm letrar, kryesisht parafjalët e rasës rrjedhore, si: *afër(ë)* (392); *nëpër* (390); *përbrënda* (388); *kundruall* (390) dhe trajta gege *kundruell* (386); *majë* (378); *prej* dhe trajta dialektore *pe*; *p*(*ë*)*ranë*; *përmbi*; *për* te ndërtimi "e përpoqi *për dheu*".

Parafjala e rasës emërore *nga* del me trajtat *nga*(*h*)*, nga*(*ha*), forma dialektore të toskërishtes jugore. Shqiptimi dialektor është pasqyruar me shkrim dhe për parafjalët e rasës kallëzore: *ndë*; *mbë*; *nënë* (dhe); *ndëpër* (një vërë);

LIDHËZA

Lidhëzat bashkërenditëse nuk paraqesin veçanti të dallueshme. Ligjëruesit e përdorin lidhëzën bashkërenditëse shtuese të përsëritur *hem…, hem*; lidhëzën veçuese të përsëritur *ja…, ja*, lidhëzën kundërshtuese *pa* (por), *po*, *veç*(*e*) dhe lidhëzën përmbyllëse *andaj* (377).

Lidhëzat nënrenditëse më të përdorura në rrëfimet popullore janë: lidhëza ftilluese *se*; lidhëzat kohore: *gjer* (388); *gjerkur*; *masi* (mbasi); *poqë* (sapo) dhe trajta *po që* (378); *posa*; *pasi* (393); *si*; *teku* (ndërsa); *tek*. Lidhëzën *tek*(*u*) e gjejmë të përdorur dendur me kuptimin e lidhëzës kohore; lidhëzat vendore: *seku*; *teku*; *tek* (388); lidhëzat kushtore: *ndë* (382); *ndë qoftë se*; lidhëzat shkakore: *përse* me kuptimin *sepse* ("Të mos hapnjë derënë kurrë, *përse* vjen llamia edh'e ha." 388); *sepse*; lidhëzat qëllimore *që* (që të t'apë, 388); lidhëzat mënyrore: *sikundër* (thamë); *sinëkur* (sikur, si, 397); *posikur*; lidhëzat sasiore *aqësa* (sa, 398); lidhëzat lejore: *megjithëkëtë* (378); *pandëçë* (me kuptimin "*edhe pse*", 401); *sidoqë*; *sadoqë* (382,

393, 395); lidhëzat rrjedhimore: *ashtu që* (kështu që); *sa* ("Këta djelma kishin dalë që moti në dhe të huaj, *sa* e motra nukë dinte se ka vëllezër." 388).

PJESËZA

Pjesëzat në përgjithësi ruajnë karakterin dialektor; të tilla janë: *nukë*; *nuku*; *munsi* (mu + si); *papo* (390); *posi*.

PASTHIRRMA

Pasthirrmat që kemi gjetur shprehin ndjenja: *oji* (403); *popo*; pasthirrmat e përshëndetjes: *mirë-dita* (399); *mirëserdhe* (399); *mirsetëgjejmë* (406); *të falem* (404).

LEKSIKU DIALEKTOR

Në materialin e vjelë bie në sy dhe një numër i madh fjalësh me karakter dialektor, kryesisht nga e folmja e toskërishtes veriore, por ka depërtuar dhe ndonjë trajtë nga gegërishtja, gjithashtu dhe nga toskërishtja jugore, nga të folmet e Çamërisë dhe të Gjirokastrës. Të tilla fjalë i kemi renditur më poshtë sipas alfabetit bashkë me kuptimet përkatëse, konsultuar me Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, 1980:

bujë "zhurmë" (407); *capeja* "dele ose dhi"; *droe* "druajtje", "frikë" në dialektin gegë; *gjegj* "dëgjoj", "përgjigjem" (383); *hallavitem bised.* "sillem kot", "sorollatem", "shkoj kohën kot" (393); *këllas* "kall", "fus"; *lebeti bised.* "tmerr" (406); *llamia mit.* "llamje, figurë e besimeve popullore si një gjarpër i madh i ngjashëm me kuçedrën" (388); *llauz vjet.* "gjindje, popull" (400); *mërej* "marr mësysh" (405); *mënoj* "vonoj" në çamërisht (391, 394); *motovile* "vegël për të mbështjellë leshin (411); *të ndenjurat* "dhomat e ndenjjes (407); *nmërezhënjë*; *pikas* "zbuloj", "vë re" (390, 403); *rrozgë* "driza, shkurre"; *e tukequrë* "e dobësuar nga të pangrënët ose nga jeta e vështirë" (379); *voli* "mundësi, çasti"; *vopëzia* "vobektësia, varfëria" (391); *xhgan keq.* "lukuni, zogori" (400); *u zbëgat* (394); *hamëje* "ushqim" (378); i dha *jern* (395); *kish leçiturë vjet.* kishte lexuar (400); *mocë* "moshë" (398); *mëhanë* "shkak" (377, 394).

HUAZIME

Huazimet që kemi renditur më poshtë, vjelë nga përrallat e *Bletës*, kanë përdorim të kufizuar në gjuhën e sotme të shkruar dhe të folur. Ato përdoren me funksione stilistike vetëm në letërsinë artistike. Të tilla janë: *asqeri*; *kadiu*; *tellalli*; *kordha*; *kofini*; *sinori*. Pjesa më e madhe e huazimeve të vjela nga materiali kanë dalë nga përdorimi në gjuhën e folur dhe në të shkruar. Ato dëgjohen në thjeshtligjërimin e moshave të vjetra, folës të dialektit toskë, si: *makar*; *leqëndis*; *levenderi*; *taks*; *jarania*; *darovit*; *u fanepsën*; *gremis*; *jatroi*; *pataks*; *thagmë*; *perusti* (këmbje, 379); *qilar.*

Më poshtë kemi renditur huazimet sipas gjuhës burimore, konsultuar me *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe,* Botimet Toena, Tiranë, 2007 nga Mikel Ndreca.

asqeri (*ar. tur.* ushtar, (405); *harar* (*ar. tur. krahin.* thes prej leshit të dhisë, 414); *katiu – kadiu* (*ar. tur.* gjykatës 411); *telali – tellalli* (*ar. tur.* kasnec);

kordha (*pers. tur. hist.* thikë e madhe, shpatë e kthyer në majë, 395); *makar* (*pers. tur.* qoftë, ose, të paktën, së paku, qoftë edhe); *penxhere* (*pers., tur.* dritare);

qilar (*lat.* kthinë e vogël, *pers. tur.* 394);
sheshtë (shestë, *it.* sestante, qëllim, plan, 377, 411); *toro* (torzo, *it.* trup pa gjymtyrë, 397);
haps (*tur*. burg, 404); *heqim* (*tur.* mjek); *kopile* (*tur.* përdoret në çamërisht me kuptimin shërbëtore); *leqëndis* (nga *tur.* leqe – njollë, njollos, 395); *levenderi* (nga levend, *tur.* i hijshëm, shtathedhur, trim, 395); *taks* (*tur.* ndaj, shpërndaj);
çehre (*pers.* fytyrë, 390); *jarania* (*pers.* miqësi, shoqëri, dashuri, shaka, hoka);
bashtovanxhi (kopshtar, *skr.* bashtina – kopsht); *bujerë* (*skr*. bujarë, fisnikët, 381); *darovit* (*skr.* dhuroj, 404); *darova* (*skr.* dhurata, 404); *orok* (*skr.* afat, 377, 382);
drëhem (*gr.* drahmi – para e vjetër greke, 400); *kofin* (*gr.* kosh me thupra, 410); *u fanepsën*; *gremis* (*gr*. rrëzoj) *jatroi* (*gr.* mjek); *pataks* (*gr.* tremb); *sinuar* (*gr.* sinor, kufi, tokë, arë, krahinë, 408); *thagmë* (*gr.* mrekulli).

FJALËFORMIMI

Në materialin e hulumtuar paraqet interes dhe fjalëformimi. Kështu, kemi zbuluar disa fjalë që paraqesin interes nga pikëpamja fjalëformuese:

Emri

a) formime prapashtesore: me prapashtesën *-ar*, *-tar*, *-or*, *-nik*, *-man*: *gomariar* (387); *bukëtar* (382, 411); *drutar* (druvar, 410); *drithnik* (410); *ushtërorë* (ushtarë); *dritsore* (dritare, 402); *shurdhaman* (414);

b)formime prapashtesore me *-i*, *-ri*; *-si*: *dhurëtí* (dhurata, 404); *dobëti* (dobësi, 383); *fatkeqëri* (fatkeqësi); *levenderi* (trimëri, 395); *pretësi* (përtesa, 412); *pabesi* (394); *lënësijë* (i lehtë nga mendja, 410); *rëndësirë* (peshë, rëndesë, 400);

c) formime prapashtesore me *-im*, *-je*: *mburimi* (378); *çpërblim*; *dëshërim* (dëshirë); *djallëzim* (djallëzi, 398); *kupëtim*, (411); *mallënjim*; *mentim* (388); *tërsëllim* (397); *qarëja* (qarje); *sharëja* (sharje); *shtyrëja* (shtyrje); *humbëjë* (humbje);

ç) formime prapashtesore me -(*ë*)*s*; *-as*; *pritëse* (përtace, 411); *therës* (kasapi, 400); *shpëtuas* (shpëtues);

d) përngjitje: *faresej* (si faresoj, farefis);

Mbiemri

a*) mbiemra të emërzuar*: *e egëra*; *të tretënë* (392); *të vetëmin* (392); *i vetëmi* (401);

b) mbiemra të formuar me parashtesa me kuptim antonimik: *i çkujdesurë*; *i panjohurë* (393);

c) formime me paranyjëzim + emër: mbretëreshën *e rrenë* (e rreme, 381);

ç) formime me paranyjëzim + pjesore: *i çmëndurë* (410); *i fatkeqërosur*; *i gurëcuar* (i ngurtësuar, 383); *i lëvduarë* (381); *i ndërtuarë*; *e pluhuriturë*; *i prishurë*; *i sosurë*; *i stapiturë* (394);

d) formime me paranyjëzim + prapashtesim nga tema emërore: *i hekurtë* (388); *e leshëtë* (e leshtë nga mendja, 380); *të çudiçimë*; *të gatshim* (379); *të nevolëshme* (të nevojshme, në çamërisht kemi *-l-* në vend të *-j-*); *të rrezikshimë* (382);

dh) formime me paranyjëzimin e ndajfoljes: veshë *të kthjellëtë*; ndë lum *të turbulltë* (392); vëllan' *e vetëmë* (378, 391);

Folja

a) formime me prapashtesë nga tema të ndryshme: *fatkeq-ëro-nte* (qante fatin, 379); *pak-o-heshin* (pakësoheshin); *bubu-tis* (nga pasthirrma "bubu" me kuptimin "bërtas", 398); *tuke cëcë-rit-urë* (nga onomatopeja);

Ndajfolja

a) formime ndajfoljore të përftuara nga përsëritja e një fjale me vizë në mes; *copra-copra* (381);

b) lokucione ndajfoljore të formuara nga dy fjalë të njëjta të lidhura në mes tyre me një parafjalë: *dita me ditën* (390); *vënt mbë vënt* (390);

c) lokucione ndajfoljore: *që moti* (me kohë, 388); *pas pak moti* (pas pak kohësh, 397); *sa kaqëherë* (menjëherë, 403); *me të çpejtë* (402); *për së çpejti* (me të shpejtë, 388); *vetëm filli* (398);

Pasthirrma

a) Lokucionet pasthirrmore që shprehin përshëndetje, ruajnë ndërtimin dhe përbërjen tingëllore të sotme ose me rënie të zanoreve dhe me ndryshime në paraqitjen drejtshkrimore: *mirë-dita* (mirëdita, 399); *mirëserdhe* (mirë se erdhe, 399); *mirsetëgjejmë* (mirë se të gjejmë, 406). Këto trajta Th. Mitko i ka paraqitur me shkrim si fjalë të mëvetësishme.

Kompozita

Në gjuhën e shkruar të Th. Mitkos kemi hasur në ndërtimet me kompozim, fjalë që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese[463]. Kështu kemi kompozita me marrëdhënie nënrenditëse përcaktore: *dorëhollë* (384); *fatmiri*; *këpucëgrisurë* (393); *krahëhapurë*; *kryeunjëtë* (393); *zemërligë* (384) etj.

Frazeologjia

Me interes për leksikologjinë paraqesin dhe një radhë shprehjesh a njësish frazeologjike:

a) shprehje frazeologjike me fjalë kryesore foljen "jap": ta jep zemëra të ikëshë "të bën zemra të ikësh" (401); *dha krye së largu një lundër* "u duk"; *u dha zë mbretërvet* "njoftoi" (403); *i dhanë zë çupësë* "e njoftuan, e lajmëruan"; ia *dhanë të qarët* "qanë";

b) shprehje frazeologjike me fjalë kryesore foljen "heq": hiq mbë shtëpi "shko në shtëpi" (388); *hoqi një udhë të gjatë* "bëri një udhë të gjatë";

c*) shprehje frazeologjike me fjalë kryesore foljen "mbes": mbetënë ndënë turp* "u turpëruan"; *mbeti fare i shkrepurë sëgjithash* "pa gjë";

ç) shprehje frazeologjike me fjalë kryesore foljen "marr": muar malë e iku (386); *muarë malë* (377); *e mori të keqtë* "u prek, i erdhi keq, u ligështua" (406); *kish marrë dashuri mbë të*;

[463] *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II,* Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1976, f. 44.

d) shprehje frazeologjike me fjalë kryesore foljen "rrah": rrahu e rrahu ta kandisnjë "u përpoq ta kandisë" (387); *rahu të prapsnjë atë* "u përpoq"; *rrahu ay ta ndalnjë* (382);

dh) shprehje të figurshme dhe frazeologji popullore: *u derth ta hajë* "u sul" (401); *fatkeqëronte fatin e saj të zi* (379); *i erth kordha, sa të fshishë sytë* "menjëherë" (403); *u gjetnë mbë ngushtim të math* "u gjendën ngushtë, keq" (382); *hapën fjalë të dy përsëgjati* "biseduan gjatë"; *ikën të prishurë* "u shkatërruan, humbën" (403); *lëshuan hundëtë* "u mërzitën"; *lidhi një fjalë* "marrëveshje"; *ja mbajti penë drejt' e përmbi atë* "shkuan drejt e te ai" (402); *një nishan dyfegu më këtej* "largësi, distancë" (395); *rashë këmbësh* "u lodha" (386); *ka për të shtirë kryet në torbë* "do të jetë në rrezik"; *t'i vërë mbë bukë të qevernisë* "të punojnë në qeveri" (390); *zu udhën* "mori udhën, u nis për udhë" (393).

TRAJTAT E DIALEKTIT GEGË

Në përrallat e mbledhura nga Th. Mitkoja gjejmë fjalë e trajta dialektore të të folmeve të gegërishtes. Kjo flet për qëndrimin që mban Th. Mitkoja ndaj gjuhës dhe formës së saj të shkruar. Ai ndjek parimin fonetik, parim themelor i drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe. Nuk mund të themi në e njihte teorikisht këtë parim Th. Mitkoja, por praktikisht ai e ka zbatuar. Po ashtu, folkloristi ynë ka ndjekur traditën shkrimore të gjuhës shqipe në këtë periudhë. Kemi mbledhur disa trajta dialektore të gegërishtes, pasi kuptohet se tregimtarët kanë qenë dhe nga trevat veriore të Shqipërisë dhe Mitkoja i ka pasqyruar disa trajta të gegërishtes siç i ka dëgjuar: *dreni* (dreri me rotacizëm, 379); *gru* (grua); *droe* (geg). Kemi gjetur përdorimin e dy trajtave dialektore tek fjalët *trëndafilë* (380); *trandafilë* (381); e para është trajtë toske me *–ë* para bashkëtingëllores hundore *n* dhe e dyta është trajtë gege me *-â-* hundore para hundores *n*. Emri *margaritára* e bën shumësin me *-a* si në dialektin e gegë (387); *marrohej friket* (rasa rrjedhore gege pa parafjalë); *prej shollet* (377); i pa patat *të ngjallme* (380); mbretëreshën e *rrenë* (e rreme, 381); *kryet tat* (në të folmen e Shqipërisë së Mesme, 401); *bonte* (410); *bohet*; *u bo*, *hangri*; *kundruell* (kundruall, 386); por gjejmë dhe trajtat e përziera gege e toske te përcjellorja: *tue fshirë* (390); *tue pikasurë*; *tue thënë* (389).

TOSKËRISHTJA JUGORE, ÇAMËRISHTJA

Në gjuhën e përrallave kemi gjetur dhe fjalë e trajta nga toskërishtja jugore, përkatësisht nga dialekti i çamërishtes, si: *të mbyllturë*; *të glatë*; *glishti*; *të nevolëshme*; *mënoj* "vonoj" (391, 394); *djelm* (388); *u mbylltin*; *u mpruajtin*; *u grejtin*; *të ap* "të jap" (380); *nemë* "më jep"; *nevolë* "nevojë"; *klyçet* etj. Trajtat që në dialektin çam kanë *-l-* ndërzanore, në shumicën e të folme të shqipes dalin me *-j-* ndërzanore[464].

FONETIKA

Në aspektin fonetik gjuha e shkruar e Th. Mitkos shfaq karakteristikat fonetike të dialektit toskë:

[464] J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare,* Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 63.

Së pari, vëmë re shurdhimin e bashkëtingëllores së zëshme në fillim të fjalës: ***k****uxonte*; *u* ***sh****duk*; ***x****veshi*; në trup të fjalës, kur ndodhet para një bashkëtingëlloreje tjetër: *di****q****te* (digjte); *men****t****im* (388); *rri****th****nin* (380); në pozicionin fundor të fjalës, kur ka përpara një zanore të theksuar: *fun****t*** ; *kurri****s***; *i ma****th***; *ven****t*** (382); *zo****q***; *p****u****llum****p***; *bre****k*** (breg, 383), por gjejmë trajtën e shquar me *-g-*: *bregu* (383);

Së dyti, disa fjalë dalin në fenomenin fonetik të shtesës së tingujve. Disa fjalë dalin me protezën *m-*, *n-*: ***m****burim* (378); ***m****besoi*; ***m****vari*; ***m****veshi* (380); ***m****vrau* (402); ***m****vodhi*; *i* ***m****fishkurë* (382); *i* ***m****veshurë* (401); ***n****qasën*; me *h-*: **h**oborr (oborr); me epentezë: *flam****b****ur*;

Së treti, bie zanorja fundore e fjalës, kur pas saj vjen një fjalë që fillon me zanore, me apokopë: *e bukur' e dheut*; *djal' i math; një plak' e asaj*; *mendj' e saj*; *të shoh edh' atë fshat*; *nga pallas' i së bukurës* etj.

Së katërti, në një grup fjalësh në vend të nistores *sh-* gjejmë nistoren *ç-* me funksion parashtesor: ***ç****përblim*; ***ç****quante*; ***ç****karkonte* (410); i ***ç****kujdesurë*;

Së pesti, në ndonjë fjalë hasim dukurinë e rotacizmit: *lírin* "linin, lejonin";

Së gjashti, në ndonjë fjalë hasim dukurinë e asimilimit të grupit të bashkëtingëlloreve në pozicion nistor *mb* < *m*: **mr**etra (mbretër, 401); ***m****asi* (mbasi).

SINTAKSA

Përralla shqipe, ashtu si simotrat e saj ballkanike, evropiane, e më gjerë dallohet dhe për formulat hyrëse dhe mbyllëse. Tek përrallat e Th. Mitkos kemi këto formula:

Qënëke të mos na jetë , qe një…(413);Qënurke të mos na jetë, qe një…; As përrallë s'ju rëfeva, po desha e ju gënjeva.

Përfundime

Në materialin e hulumtuar vërejmë se gjuha e shkruar ndjek parimin fonetik: fjala shkruhet ashtu siç e shqipton folësi dhe ashtu siç e dëgjon shkruesi. Kuptojmë se rrëfimtarët janë jo një e dy, por më shumë; jo nga një krahinë, por nga krahina të ndryshme të Shqipërisë së Jugut, madje dhe nga krahinat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Kjo shpjegon variantet, me të cilat janë shkruar fjalët. Ende nuk kemi gjurmë të përpjekjeve të ndërgjegjshme për të pasur normë drejtshkrimore. Janë këto disa arsye që të kemi një larmi trajtash, të cilat janë të njëjta nga kuptimi, por nga forma shkrimore paraqesin ndryshime dhe brendapërbrenda të njëjtit autor.

Nga sa kemi thënë më lart, arrijmë në këto përfundime:

Emri në shkrimin e Mitkos del me forma e trajta deri diku të qëndrueshme në këto përdorime.

1. Gjatë lakimit dalin me theks tejfundor dhe me mbipërdorimin e *–ë* pastheksore:

a) emra të gjinisë femërore në emërore njëjës: *bushtëra*; *zëmëra*; në shumës kemi *gjurmatë*; *thikatë*; *bijatë*.

b) emra të gjinisë mashkullore me *-ër* në emërore: *dimërë*; *gjarpërë*; *kopështë*.

c) emra femërorë më *-ë* në gjinore: *e búkësë*; *e dérësë*;

ç) emrat njërrokësh mashkullorë në gjinore: *i lisitë*; *i mbretitë*; *i peshkutë*.

d) emrat mashkullorë në kallëzore shumës: *trimatë*; *hundëtë*;

2. Gjatë lakimit dalin me mbaresat rasore të standardit të sotëm letrar:

a) emra femërorë njëjës me *-ë* që në emëroren e shquar dalin me *-a*: *çupa*; *fela*; *sopata*; *strofka*;

b) emra femërorë njëjës me *-e*, që në emëroren e shquar shumës dalin më *-t*: *dritsoret*; *klyçet*.

c) emra femërorë shumës me prapashtesën me *-ra*: *punëra*; *gjellëra*; *vallëra*.

d) emra mashkullorë në numrin njëjës me mbaresën *-i*: *argjëndari*; *i ati*;

dh) emra mashkullorë me bashkëtingëllore që në numrin shumës dalin me mbaresën *-ë*: *harmëshorë*; *trëndafilë*;

e) emra njërrokësh mashkullorë në numrin njëjës në gjinoren dalin me mbaresën *-it*: *i gjishtit*; *e kreit* (385);

f) emra mashkullorë në kallëzore: *vëllanë* (383); *shpirtin*

3. Në toskërishten letrare të Mitkos gjejmë:

a) emra në rasën gjinore me nyje të përparme: *e búkësë*; *e dérësë*;

b) emra në gjinore pa nyje të përparme: e së bukurës *dheut*; pas faqes *dheut*;

c) emra në rasën rrjedhore me parafjalë si standardi i sotëm: prapa *derësë*; prej *çupësë*; pas *vdekëjes*;

d) emra në rrjedhore pa parafjalë: i djegur *etje*; i dredhurë *frike*; u drodh *frike*; çfarë *kopilërie*; dhe në numrin shumës kemi rashë *këmbësh*; pas këtyre *fjalësh*;

e) emra në rasën vendore me parafjalë të dialektit toskë: *ndë brest*; *ndë gjitë*; *ndë kopështët; ndë pust;*

4. Disa folje dalin me trajtat e standardit të sotëm letrar për sa i përket mbaresave vetore:

a) foljet e zgjedhimit të parë që në kohën e pakryer të mënyrës dëftore bëjnë: *çquante*; *çkarkonte*;

b) foljet në kohën e pakryer të shumësit: *shëkonin*; *rrithnin*;

c) foljet në kohën e ardhme shkruhen me pjesëzën *do + folje* në të tashmen e lidhores; *do të gjenj'*; *do të vete*; gjejmë dhe tipin e dytë të së ardhmes, ndërtuar me foljen ndihmëse *kam* dhe me formën e pashtjelluar të tipit *për të + pjesoren* e foljes: *kam për të marë; ka për të harruarë; ka për të marrë;* por gjejmë dhe të ardhmen e së shkuarës: *kishin për të zbriturë*.

d) foljet e zgjedhimit të parë në kohën e kryer të thjeshtë: *kupëtoi*; *çkarkoi*;

dh) foljet në kohën e pakryer të formës joveprore: *humbej*; *mendohej*; *pakoheshin*;

e) foljet në kohën e kryer të thjeshtë të formës joveprore me pjesëzën *u*: *u çpif*; *u derth*;

f) foljet në mënyrën dëshirore: *rrëzofsh*; *mbeç me shëndet. vraftë*; *kapërxefshim*; *u zënçin*; por kemi gjetur dhe trajtën dialektore *hëngrësh*.

g) foljet në mënyrën habitore dalin me trajtat e standardit duke i prapangjitur pjesores së shkurtër ndihmësen *kam*: *qënëke*; *qënëkan*.

gj) habitorja në kohën e pakryer del me trajtat e standardit të sotëm letrar: *qënëkej*; *qënkëshin*; *rënëkëshin*;

h) foljet në urdhërore janë të ngjashme me standardin e sotëm letrar: *dëgjo*; *shëko*; *shkunt*; urdhërorja me trajta të shkurtra të prapavendosura: *dërgomë*; *blimë*; *ngremë*; *premë*; urdhërorja me trajta të shkurtra të paravendosura: mos *e nxierr*; *i thuaj*;

5. Disa folje dalin me trajta dialektore:

a) Foljet e zgjedhimit I, klasa II, nënklasa I në kohën e kryer të thjeshtë dalin në trajtat dialektore të çamërishtes dhe të të folmes së Gjirokastrës: *gjetin*; *mbajtinë.*

b) foljet më bashkëtingëllore në të pakryerën: *hapënte*; *hidhëte*; *lypënte*;

c) foljet në kohën e pakryer të shumësit: *ruanjën*; *përqafonjën*; *përgëzonjën; shkoninë*.

d) foljet e parregullta josupletive *dua*, *lë*, *them* dalin me trajtat karakteristike të toskërishtes: *doi*; *duante*; *duanin*; *lírin* (linin, trajtë me rotacizëm *n* < *r*); *thosh* del pa mbaresën *-te* të standardit letrar.

e) foljet në të kryerën e thjeshtë me temë në zanore që klasifikohen në zgjedhimin I: *arriu*; *dëfteu*; *çpojti*; *dështojti*; *durojti*; *gatojti*; dhe ato me temë në bashkëtingëllore që klasifikohen në zgjedhimin II, nënklasa I: *muar*; *suall; duall*.

f) foljet në mënyrën lidhoren me nuancë urdhërore pa pjesëzën *të* dhe me pjesëzën mohore *mos*: *mos* e *lëshosh*, *mos shkosh*.

6. Format e pashtjelluara.

a) pjesorja del me mbaresat *-ur, -r, -në* dhe *-ë* fundore pastheksore duke e kthyer fjalën me theks tejfundor, karakteristikë fonetike e të folmeve toske: *dërguarë*; *goditurë*; *hapurë*; *hypurë*; *mbeturë*; *mbushurë*; por gjejmë dhe raste të veçuara, që përputhen me standardin e sotëm letrar: *ardhur*; *vënë*.

b) përcjellorja ndërtohet me pjesëzën *duke*/*tuke*/*tue* (trajtë gege) dhe *pjesoren* e foljes: *duke luajtur; duke përqeshur*; *tuke thënë; tuke thëthirë*; *tue pikasurë*; *tue thënë*.

c) paskajorja është e njëjtë me standardin e sotëm: *për t'u lëshuar; për të marrë.*

d) forma e pashtjelluar mohore ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzën *pa*: *pa diturë; pa fituarë; pa hyrë.*

7. Ndajfoljet e kohës, të vendit, të sasisë, të mënyrës në pjesën më të madhe përdoren në standardin e sotëm letrar: *atëhere*, *kurdoherë, kurrë*, *që moti, atje, aspak, burrërisht, dalëngadalë, fshehurazi*, *paskëtaj*, *prapë*; *pasandaj*; *rëndom*; *tashi*. Por një grup ndajfoljesh dalin me trajta dialektore: *atëhernaj*; *mbrëmanet*; *atjenaj akseku* (diku); (m)*fshehura*(j); *kadalëzë*; *kadalezë*;

8. Parafjalët në shumicë janë pjesë e standardit të sotëm letrar, kryesisht parafjalët e rasës rrjedhore, si: *afër(ë)*; *nëpër*; *përbrënda*; *kundruall*. Shqiptimi dialektor është pasqyruar me shkrim për parafjalët e rasës emërore: *nga*(*h*)*, nga*(*ha*); dhe për parafjalët e rasës kallëzore: *ndë*; *mbë*; *nënë* (dhe); *ndëpër* (një vërë);

9. Lidhëzat nuk paraqesin veçori dalluese, gjejmë në përdorim lidhëzën bashkërenditëse të përsëritur *hem…, hem*; lidhëzën veçuese të përsëritur *ja…, ja*, lidhëzën kundërshtuese *pa* (por), *po*, *veç*(*e*) dhe lidhëzën përmbyllëse *andaj*. Lidhëzat nënrenditëse më të përdorura në rrëfimet popullore janë: lidhëza ftilluese *se*; lidhëzat kohore: *gjer*; *gjerkur*; *masi* (mbasi); *poqë* (sapo) dhe trajta *po që*; *posa*; *pasi*; *si*; *teku* (ndërsa); *tek*; lidhëzat kushtore: *ndë* do ti,..; *ndë qoftë se*; lidhëzat shkakore: *përse* me kuptimin *sepse*; lidhëzat qëllimore *që*; lidhëzat mënyrore: *sikundër* (thamë); *sinëkur* (sikur, si); *posikur*; lidhëzat sasiore: *aqësa* (sa); lidhëzat lejore: *megjithëkëtë*; *pandëçë* (me kuptimin "*edhe pse*"); *sidoqë*; *sadoqë*; lidhëzat rrjedhimore: *ashtu që* (kështu që); *sa*

10. Interes ngjall dhe përdorimi i emrit në rasën gjinore me parafjalë, edhe pse tek proza kemi gjetur një rast të vetëm. Kjo trajtë mund të jetë përdorim autorial i Mitkos, si njeri i kulturuar, pasi ndërtimet me parafjalë të rasës gjinore nuk janë në natyrës e prozës popullore: *me anë të s'ëmësë*.

11. Në materialin e vjelë bie në sy dhe një numër i madh fjalësh me karakter dialektor, kryesisht nga e folmja e toskërishtes verilindore, por ka depërtuar dhe ndonjë trajtë nga gegërishtja, gjithashtu dhe nga toskërishtja jugore, nga të folmet e Çamërisë dhe të Gjirokastrës: *të mbyllturë*; *të glatë*; *glishti*; *të nevolëshme*; *mënoj* "vonoj"; *djelm*; *u mbylltin*; *u mpruajtin*; *u grejtin*; *të ap* "të jap"; *nevolë* "nevojë"; *klyçet* etj. Trajtat që në dialektin çam kanë *-l-* ndërzanore, në shumicën e të folme të shqipes dalin me *-j-* ndërzanore.

12. Gjatë hulumtimit kemi gjetur dhe renditur huazimet sipas gjuhës burimore.

13. Në materialin e studiuar paraqet interes dhe fjalëformimi.

a) formime prapashtesore: *bukëtar*; *drutar*; *drithnik*; *dhurëtí*; *dobëti*; *fatkeqëri*; *levenderi*

b) formime parashtesore: *i çkujdesurë*; *i panjohurë*;

c) formime me paranyjëzim + pjesore: *i çmëndurë*; *i fatkeqërosur*; *i gurëcuar*;

d) formime me paranyjëzim + prapashtesim nga tema emërore: *i hekurtë*; *e leshëtë*

dh) kompozita me marrëdhënie nënrenditëse përcaktore: *dorëhollë*; *fatmiri*; *këpucëgrisurë*;

e) formime ndajfoljore me vizë në mes; *copra-copra*;

f) lokucione ndajfoljore: *dita me ditën*; *vënt mbë vënt*; *që moti*; *pas pak moti*;

g) përngjitje: *faresej* (si faresoj, farefis);

14. Në aspektin fonetik gjuha e Th. Mitkos në prozë shfaq karakteristikat fonetike të dialektit toskë:

a) shurdhimin e bashkëtingëllores së zëshme në fillim të fjalës: ***k****uxonte*; në mes të fjalës: *di****q****te*; në fund të fjalës: *fun****t*** ; *kurri****s***;

b) fenomeni fonetik i shtesës së tingujve: me protezën: *m-*, *n-*: ***m****burim*; ***n****qasën*; me epentezë: *flam****b****ur*;

c) bie zanorja fundore e fjalës, kur pas saj vjen një fjalë që fillon me zanore (apokopa): *e bukur' e dheut*;

d) në vend të nistores *sh-* gjejmë nistoren *ç-* me funksion parashtesor: ***ç****përblim*; ***ç****quante*; ***ç****karkonte* (410); i ***ç****kujdesurë*;

dh) dukuria e rotacizmit: *lírin* “linin, lejonin”;

e) asimilimi i grupit të bashkëtingëlloreve në pozicion nistor *mb* < *m*: **mr**etra; ***m****asi* (mbasi).

15. Frazeologjia shpreh larminë e të folurit popullor. Interes për leksikologjinë paraqesin shprehjet a njësitë frazeologjike të shënuara në punim: *ta jep zemëra të ikëshë* “të bën zemra të ikësh”; *dha krye së largu një lundër* “u duk”; *u dha zë mbretërvet* “njoftoi”; *i dhanë zë çupësë* “e njoftuan, e lajmëruan”; ia *dhanë të qarët* “qanë”; *hiq mbë shtëpi* “shko në shtëpi”; *hoqi një udhë të gjatë* “bëri një udhë të gjatë”; *mbetënë ndënë turp* “u turpëruan”; *mbeti fare i shkrepurë sëgjithash* “pa gjë”; *muar malë e iku*; *muarë malë*; *e mori të keqtë* “u prek, i erdhi keq, u ligështua”; *kish marrë dashuri mbë të*;

16. Në përrallat e mbledhura nga Th. Mitkoja gjejmë fjalë e trajta dialektore të të folmeve të gegërishtes: *dreni* (dreri me rotacizëm); *gru* (grua); *droe* (geg); *marrohej friket* (rasa rrjedhore gege pa parafjalë); *prej shollet*; *kryet tat* (në të folmen e Shqipërisë së Mesme); *bonte*; *bohet*; *u bo*, *hangri*; *kundruell*. Kjo flet për qëndrimin që mban Th. Mitkoja ndaj gjuhës dhe formës së saj të shkruar. Ai ndjek parimin fonetik, parim themelor i drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe. Nuk mund të themi në e njihte teorikisht këtë parim Th. Mitkoja, por praktikisht ai e ka zbatuar duke ndjekur traditën shkrimore të toskërishtes letrare.

BEGZAD BALIU (PRISHTINË)

THIMI MITKO DHE FILLIMET E SHKENCËS SË ALBANOLOGJISË

Objekt i kësaj kumtese është roli i Thimi Mitkos në tri fusha themeltare të Periudhës së Rilindjes Kombëtare: krijimit të identitetit kombëtar; pjesëmarrjes në dijen filologjike europiane të shekullit XIX, si dhe kontributit të tij gjuhësor, letrar dhe historik në fushë të albanologjisë.

Këtë kontribut do ta shohim fillimisht përmes koncepteve të tij bashkëkohore të kohës mbi rolin e folklorit në ndërtimin e krijimit të identitetit kombëtar përgjithësisht dhe përmes mbledhjes dhe botimit të folklorit shqiptar veçanërisht, të cilin Thimi Mitkoja e realizoi duke e botuar vëllimin "Bleta shqiptare" dhe duke e përgatitur "Bletën e vogël" e "Fjalorin italisht - greqisht - shqip".

Më tej, kontributi i tij do parë duke e vënë në dukje bashkëpunimin e tij me studiuesit e shkollës austro-gjermane, si dije prijëse e kohës dhe duke bashkëpunuar me njërin prej indoevropeistëve e albanologëve më të shquar të kohës - Gustav Majerin, brenda veprës së të cilit "Studime shqiptare", Thimi Mitko ka një pjesë të rëndësishme të veprës së tij.

Së fundi, janë me interes vlerësimi dhe konceptet e tij për gjuhën dhe disa fusha të rëndësishme të saj: leksikografinë e leksikologjinë, onomastikën etj., si dhe roli i tij prijës në jetën intelektuale të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

I. Kompleksiteti i studimit të jetës dhe veprës

Në studimet e deritanishme albanologjike Thimi Mitkoja shquhet si njëri prej personaliteteve më të veçanta, ndërsa vepra e tij ende e panjohur në përmasat e kompleksitetit të saj. Një konstatim të tillë e mbështesim në studimet e deritanishme të jetës dhe veprës së tij. Në rrafshin e parë, hynë njohja e plotë e veprimtarisë së tij, e kategorizuar thjesht si një tregtar i vogël, në rrafshin e dytë hyjnë vlerësimet për mbledhësin e folklorit, si një pasionant dhe jo e gjithë veprimtaria e tij dhe sidomos të gjitha arkivat albanologjike që lidhen me aktivitetet e tij; dhe në rrafshin e tretë, i cili mund të konsiderohet më i rëndësishmi, hyjnë qasjet metodologjike ndaj punës së tij, përkatësisht pamja kryesisht nacionale e jetës dhe veprimtarisë së tij brenda Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, në vend se ta shohin atë si pjesë përbërëse të Lëvizjes Europiane, e cila u manifestua edhe në Ballkan dhe në Lindje të tij.

I lindur në Korçë dhe i shkolluar në një shkollë fillore në gjuhën greke, Thimi Mitkoja hyri në jetën kombëtare jo si rilindësit e tjerë me formim në Lagjen e shkollës së proviniencës franceze të Zosimesë, të proviniencave Lindore të Stambollit, të shkollave fetare të proveniencës italiane apo austriake të Shkodrës, apo të ndonjë qendre të ngulitjeve shqiptare në Rumani, ndër arbëreshët e Italisë etj., prandaj rruga e formimit të tij është e veçantë, po aq sa janë të veçanta orientimet e disa prej përfaqësuesve të caktuar të Rilindjes Kombëtare, prej të cilëve shquhet posaçërisht Konstantin Kristoforidhi. Orientimi i tij në jetën kombëtare të

Rilindjes Shqiptare prandaj, nuk do të shquhet as prej koncepteve idealiste të brezit të tij, as prej koncepteve perëndimore të përfituara në ndonjërën prej shkollave me profil euro-amerikan të Janinës a Stambollit, as prej polemikave thjesht etno-historike dhe fetare të fërkimeve ballkanike.

Jetën e tij, tjetër nga bashkëkohësit e tij të Lëvizjes Kombëtare dhe sidomos nga pasardhësit e tij të kësaj Lëvizjeje, do ta formojnë para se gjithash trashëgimia familjare prej zejtarësh, të cilën Thimi Mitkoja shpejt do ta çonte përpara në një përmasë tjetër; nga një tregtar i vogël i angazhuar në rrjetet transballkanike (Korçë, Manastir, Janinë, Selanik, Athinë, Bukuresht etj.) në fillim, në një tregtar të përmasave transkontinetale (Vjenë, Venedik, Trieshtë, Stamboll, Aleksandri etj.). Në të vërtetë sikur e ka theksuar tash së fundmi studiuesja Natali Clayer "Thimi Mitkoja dhe Dora d'Istria ishin dy personalitetet më të rëndësishme në zemër të këtij rrjeti. Me origjinë nga një familje e borgjezisë së re tregtare korçare, Mitkoja (1820-1890) kishte qenë rrobaqepës, pastaj ishte hedhur në tregtinë ndërmjet Ballkanit dhe Evropës"[465]

II. Thimi Mitkoja dhe Revolucioni Borgjez i gjysmës së parë të shekullit XIX

Aktivitetet e tij tregtare dhe sigurisht përkushtimi i tij ndaj dijes, të cilën e kishte shfaqur që në

fëmijëri kur qe regjistruar në një shkollë në gjuhën greke në Korçë, do të bëjnë që ai të mësojë në qendrat e mëdha të Europës jo vetëm për zhvillimet ekonomike e tregtare, por edhe për zhvillimet politike dhe arsimore, shkencore e intelektuale, të cilat tashmë po kulmonin pas Revolucionit Francez rreth gjysmë shekulli më vonë. Në shekullin XIX dhe në shekullin XX, siç do të shprehet Eric Hobsbawm po zhvilloheshin dy nacionalizma: "I pari, nga viti 1830 deri më 1870 është një nacionalizëm demokratik, masiv dhe politik "i kombeve të mëdha", që buron nga idealet e Revolucionit Francez. I dyti, karakteristik për periudhën nga viti 1870 deri më 1914, ndryshe nga i pari, është një nacionalizëm i ngushtë etnik apo gjuhësor, reagim i kombësive të vogla, kryesisht midis popujve periferikë në zona shpesh të prapambetura, ndaj formacioneve politike anakronike të perandorive osmane, habsburge dhe cariste".[466] Kjo është edhe arsyeja pse Thimi Mitkoja fillimisht do t'i takojë nacionalizmit të periudhës së parë dhe aktivitetin e tij do ta zhvillojë brenda "nacionalizmit demokratik të kombeve të mëdha", e kjo do të thotë, se duke u mbështetur në prirjen e filozofëve, shkrimtarëve dhe intelektualëve të shumtë të Europës për të shquar trashëgiminë e lashtë dhe paneuropiane të qytetërimit helen, jo vetëm përkrahu alfabetin grek për shkrimin e gjuhës shqipe, por edhe vetë deri në "periudhën e dytë 1870", kur u shfaq "nacionalizimi i ngushtë etnik apo gjuhësor", çfarë ishin nacionalizmat grekë dhe pansllavë, botoi tekste në gjuhën shqipe me alfabetin grek, duke përfshirë këtu edhe kryeveprën e tij "Bleta Shqiptare".

[465] Clayer, Nathalie. *Në fillimet e nacionalizimit shqiptar (Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë),* Tiranë, 2012

[466] Smith, Anthony, D. *Kombet dhe nacionalizimi në erën globale,* Tiranë, 2009, fq. 22.

Ky fakt përjashton një prirje të studimeve të derivona albanologjike, sipas së cilave një pjesë e rilindësve shqiptarë fillimisht ishin nën ndikimin e kulturës greke dhe u vetëdijesuan vetëm pas zhvillimeve luftarake popullore kundër Perandorisë Osmane. Përkundrazi, janë disa nga rilindësit shqiptarë, ata të cilët, të parët u informuan me zhvillimet politike, ekonomike dhe kombëtare të Europës, dhe kësaj lëvizje ju bashkuan pavarësisht faktit se intelektualët e Europës gjuhën dhe kulturën greke e romake i kishin vendosur në themelet e trashëgimisë evropiane. Ky "nacionalizim i ngushtë etnik dhe gjuhësor", nga platforma e Magali Idesë dhe disa qarqeve sllave e greke, do të përpiqet që të përdoret për të shuar përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për të zgjuar vetëdijen historike, etnike dhe gjuhësore të tyre në dobi edhe të lirisë dhe pavarësisë.

Në të vërtetë prej dijes së zënë në rrethet tregtare, arsimore dhe shkencore të shkollave europiane Thimi Mitkoja do të njihet me disa nga konceptet bashkëkohore të kohës për vlerat dhe orientimet e kombeve të përparuara, për të cilat mund të ishin të informuar disa nga bashkëkohësit e tij ndër arbëreshët e Italisë, por jo edhe bashkëkohësit e tij në atdhe dhe përgjithësisht në Ballkan e në Lindje, mbase me përjashtim të Konstantin Kristoforidhit. Në qendrat politike, ekonomike, arsimore dhe intelektuale të Europës Thimi Mitkoja do të mësojë jo vetëm për zhvillimet më të reja politike, por edhe për ndikimin që kishin ato në zgjimet e reja kombëtare të popujve të mëdhenj, përkatësisht për përlindjet e mëdha kombëtare, që shfaqeshin në qendrat më të mëdha të Europës bashkë me zhvillimet teknologjike dhe ekonomike, në të vërtetë bashkë me revolucionin borgjez të fillimit të shekullit XIX. Thimi Mitko do të ketë fatin të jetojë një kohë të gjatë në Europë dhe të angazhohet në Lëvizjen Kombëtare pikërisht në këtë periudhë të fillimit të shekullit XIX, kur sikur shprehet historiani Patrik Geary, historia u konceptua dhe u zhvillua si instrument i nacionalizmit evropian.[467]

Prej zhvillimeve të kohës, Thimi Mitkoja do të mësojë konceptet e reja orientuese të popujve të mëdhenj, e këto sikur do të theksojë tash së fundit Anthony D. Smith ishin "nacionalizmi perëndimor: ideologjia, gjuha dhe ndjenjat sentimentale" [468] ,të formuluara në konceptet kombëtare dhe shtetërore për autonomi, identitet, shpirt kombëtar, autenticitet, bashkimi e vëllazërim, brenda të cilave qëndronte
gjuha e bashkuar dhe diskursi që ka simbolet e veta ceremoniale dhe shprehëse[469] .

III. Thimi Mitko dhe Lëvizja herderiane europiane

Në këto qendra europiane, sikur ishin Vjena, Parisi, Berlini e ndonjë tjetër, Thimi Mitkoja do të
mësojë jo vetëm për arritjet shkencore të tyre, por edhe për ndikimin që kishin ato në zhvillimet politike, arsimore dhe kulturore në periferi të Europës dhe në mënyrë

[467] Geary, Patrik, *Miti i kombeve,* Tiranë, 2009, fq.45
[468] Smith, Anthony, D. *Nacionalni identitet,* Beograd 2010, fq. 116
[469] Po aty, fq.124

të veçantë në Ballkan dhe përgjithësisht në Europën Juglindore. Për kohën e tij, këto koncepte më parë se sa Europës i përgjigjeshin Ballkanit, përkatësisht shqiptarëve të ndarë në zona administrative perandorake, në besime fetare dhe në zona të ndikimit grek e sllav. Ishin pikërisht shqiptarët më parë se sa sllavët apo grekët që kishin nevojë të dinin konceptet e filozofit gjerman Lajbnic për një "shoqëri të përkatësisë gjermane"[470] . Në të vërtetë, këtë lëvizje e projektonin më së miri konceptet e Herderit, sipas të cilit disa lëvizje "si p.sh., pansllavizmi, ishin politizuar lehtësisht, dhe të gjitha kombet që do të bëheshin, i realizuan këto lëvizje sipas aparateve të tyre të vetë-krijimit kombëtar. Këto aparate përfshinin korpusin e "monumenteve të historisë kombëtare" dhe filologjinë (shumica e filologëve ishin të arsimuar në Gjermani) për të ndriçuar origjinat e lashta të kombeve të tyre. Studimet e tyre dhe nacionalizimi u bënë një". [471] Nuk është e rastit pse më parë se sa shumë bashkëkohës të tij, me këtë lëvizje herderiane do të "politizohet lehtësisht" edhe Thimi Mitkoja.

Studimet e deritanishme albanologjike mbase me të drejtë e kanë theksuar faktin se Thimi Mitkoja jo vetëm nuk kishte dhunti prej vjershëtari, por nuk ishte as filolog i formuar, prandaj i gjithë kontributi i tij mbetet në nivel të një botuesi të folklorit, por studimet albanologjike kanë lënë mënjanë disa faktorë të tjerë të rëndësishëm të angazhimit të tij në këtë drejtim, e këta janë: njohja e mirë e zhvillimeve filologjike të kohës, të cilat ai i merrte në dy drejtime, përmes informacionit mjaft të plotë të Vjenës dhe disa qendrave të tjera të kohës dhe përmes komunikimit që kishte me disa nga bardët më të shquar të kulturës kombëtare, sikur ishin rilindësi me dhunti letrare Jeronim de Rada dhe studiuesi me formim filologjik Dhimitër Kamarda. Ndryshe nuk mund të shpjegohet, thjesht, vetëm si pasion angazhimi i tij në mbledhjen e krijimtarisë popullore, përderisa kemi një botim të plotë filologjik të kryeveprës së tij "Bleta shqiptare", të cilën më parë se sa një vëllim tekstesh popullore, në "Parathënien" e tij e quan një vëllim "studimesh albanologjike".[472]

Kishte më shumë se një shekull që kur bardi i një lëvizjeje të madhe kombëtare Herder tërhiqte vërejtjen se "në Evropë ka ende një sërë kombesh të lëna në braktisje. (...) E megjithatë, kujtonte ai, ka midis tyre disa persona, funksioni i të cilëve është të studiojnë gjuhën, zakonet, mënyrat e të menduarit, besëtytnitë e vjetra dhe doket e kombit të tyre! Dhe sikur ta bënin këtë, do t'ju jepnin kombeve të tjera gramatikën më të gjallë, fjalorin më të mirë dhe historinë natyrore të popullit të tyre". [473] Prandaj, a mund të quhet e rastit "Parathënia" e vëllimit të tij, "Bleta shqiptare", e cila hapet me tekstin programatik dhe me të cilin lexuesve ua kujtonte se "Qëllimi i "Bletës shqiptare", (...) është përgjithësisht, shpëtimi dhe dhënia

[470] Thiesse, Anne Marie, *Krijimi i identiteteve kombëtare,* Prishtinë,2004,fq.42
[471] Geary, Patrik, *Miti i kombeve,* Tiranë, 2009, fq.68
[472] Mitko, Thimi. *Vepra,* Tiranë, 1981, fq.61
[473] Thiesse, Anne Marie, *Krijimi i identiteteve kombëtare,* Prishtinë,2004,fq.46

brezave që vinë, i fjalëve dhe i teksteve shqipe, të cilat (...) besoj se do të kenë një vleftë sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare"[474]. Në këtë rrjedhë, konstatimi se Thimi Mitkoja këtë vepër e quajti vëllim me "studime albanologjike", për të përmbushur idenë e tij për një revistë antologjike, sikur janë shprehur studiuesit e deritanishëm, nuk më duket shumë i qëndrueshëm. Për Thimi Mitkon nuk ishte problem nxjerrja e një reviste të tillë, për faktin se ai kishte mjete financiare dhe rrethe shkencore e kulturore për një synim të tillë. Më parë se idenë e një reviste në këtë botim do parë konceptet fillestare herderiane për folklorin dhe gjuhën, si dhe arritjet filologjike e botimet e kësaj natyre në shkencën europiane. Këtë funksion e kanë jo vetëm tekstet folklorike të të gjitha llojeve dhe gjinive, por edhe fjalësi përshkrues, duke përfshirë këtu edhe antroponimet e patronimet e hapësirës shqiptare, me të cilat në esencë vuri themelet shkencore të albanologjisë mbi onomastikën. Dhe jo vetëm kaq, ndikimi i mendimeve të Herderit në konceptet historike, shkencore dhe letrare të Thimi Mitkos për rëndësinë që kishin vazhdojnë edhe te bashkëkohësit dhe sidomos 'pasardhësit' e tij me përkushtimin e tyre ndaj traditës dhe folklorit. Nëse sipas Herderit "poezia popullore asht pasqyra e shpirtit e t'nimeve t'nji fisit", sipas Spiro Dinës "kangët tona janë shumë të nevojshme e të vjetruara për kombin tonë, se ndër këto shikojmë të ngjarat e çdo kohe, që ka shkuar si valët e detit. Prej këtyre mund të dal një histori e plotë"[475]

Sikur ka vënë re Anna Marie Thiesse "çështja e gjuhës, zë një vend qendror në refleksionin herderian. Për të, në gjeninë e gjuhës ndodhet shpirti i kombit"[476] ,prandaj nuk është e rastit pse edhe Thimi Mitko citon mendimin e Herderit në "Parathënien" e tij, sipas të cilit "një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet", [477], ndërsa Mitko këto premisa paradigmatike i shtrinte edhe më tej në dy drejtime themelore të pazgjidhura për kohën: politike dhe gjuhësore. Në premisën e parë shihte alfabetin si akt politik, prandaj edhe kujtonte se "në qoftë se lihet Shqipëria në padijen e saj, pa shkronja vendi dhe pa shkolla të popullit, atëherë sllavët me mjete më të forta e më praktike do të shpejtojnë për të gëlltitur racën shqiptare"[478] ,ndërsa në premisën e dytë shihte pikërisht gjuhën, e cila për Mitkon ishte "ushqim i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit"[479], ashtu sikur ishte edhe për Herderin "shprehje e gjallë, organike e shpirtit të një populli, shuma e veprimit efikas të të gjithë shpirtrave njerëzorë që e kanë përbërë përgjatë shekujve". [480]

IV. **Thimi Mitko dhe europianizimi i albanologjisë**

[474] Mitko, Thimi. *Vepra,* Tiranë*,* 1981, fq.61
[475] Pirraku, Muhamet. *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë, 1989, fq. 337-338
[476] Thiesse, Anne Marie, *Krijimi i identiteteve kombëtare,* Prishtinë,2004,fq.43
[477] Mitko, Thimi. *Vepra,* Tiranë*,* 1981, fq.61
[478] Po aty, fq.62
[479] Po aty
[480] Thiesse, Anne Marie, *Krijimi i identiteteve kombëtare,* Prishtinë,2004,fq.44

Prej dijes së gjertanishme albanologjike nuk është vështirë të shihet se Thimi Mitkoja nuk kishte formim albanologjik, në përmasën që e kishin disa nga bashkëkohësit dhe pasardhësit e tij të Rilindjes Kombëtare, por prej aktiviteteve dhe bëmave e tij nuk mund të mos thuhet se atij nuk i mungonte informacioni për filologjinë, historinë dhe kulturën shqiptare. Ndryshe prej bashkëkohësve dhe sidomos pasardhësve të brezit të tij të Lëvizjes Kombëtare të shekullit XIX, Thimi Mitkos nuk i mungonte jo vetëm dija për kulturën dhe qytetërimin shqiptar e ballkanik po as për zhvillimet filologjike shumë me ndikim në gjithë Europën, një lëvizje që po përhapej si dije historike, kulturore, shpirtërore dhe identitare edhe në Ballkan edhe në Lindje, në Perandorinë Osmane.

Nuk është e rastit, që pjesë e kësaj njohjeje dhe e kësaj lëvizjeje bëhen me kohë studiuesit dhe shkrimtarët e radhës së arbëreshëve, por jo edhe intelektualët, studiuesit dhe shkrimtarët e radhës së shqiptarëve të Ballkanit dhe atyre në Lindje, me ndonjë përjashtim të rastit, sikur ishte Konstantin Kristoforidhi. Thimi Mitkoja do t'i bashkohet kësaj lëvizjeje si një intelektual i përkushtuar, prandaj në këtë mënyrë do ta manifestojë edhe aktivitetin e tij: me letërkëmbim të dendur, me dërgimin e teksteve letrare dhe shkencore kur në gazeta dhe revista të kohës e kur në formë të përshkruara, me mbledhjen e trashëgimisë etno-historike dhe gjuhësore kombëtare dhe botimin e saj në institucionet më të njohura akademike të Europës, ashtu sikur vepruan bashkëkohësit e tij nga Ballkani etj. Në këtë mënyrë, mund të themi se Thimi Mitkoja, më parë se sa të bënte albanologjinë, për të cilën i duhej formimi filologjik i Dhimitër Kamardës dhe më parë se sa të bënte letërsinë, për të cilën i duhej dhuntia e Naim Frashërit apo e Jeronim de Radës, e bëri popullarizimin e albanologjisë. "Në planin e afirmimit kombëtar të popullit shqiptar, theksonte historiani Muhamet Pirraku, "Bleta shqiptare" e kreu detyrën e një armate kombëtare të pathyeshme të Rilindjes. Ajo u bë burim interesimesh shkencore e politike për dijetarët më në zë evropianë të kohës. Drejtori i organit akademik *Acta Comparations Litterarum variarum*, këngët historike të botuara në *Bletën shqiptare* i quante "poezi të mirëfillta politike" dhe e stigmatizonte Kongresin e Berlinit të vitit 1878, duke theksuar me ironi se "çfarë parimesh mund të përligjin vendimet e këtij Kongresi, që i mohon një populli me tradita të tilla të drejtën e ekzistencës"[481] .

Dhe jo vetëm kaq.

Duke mbledhur një thesar të tërë të folklorit shqiptar (nga ninullat deri te këngët historike dhe nga

përrallat deri te tekstet tregimtare), duke mbledhur njësi leksikore (nga fjalësi historik i gjuhës shqipe deri te leksiku i përditshëm vendor dhe i huaj); duke pranëvënë antroponiminë dhe patroniminë shqipe të besimeve të ndryshme, si dhe strukturat gramatikore e semantike të tyre, Thimi Mitkoja kreu atë mision të cilin një shekull më parë e kishte caktuar Herderi për popujt e mëdhenj evropianë; ndërsa duke e botuar atë në revista me përmasa europiane që botoheshin në gazetat në

[481] Pirraku, Muhamet. *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë, 1989, fq. 518

gjuhën greke në Ballkan, në revistat arbëreshe, në revistat akademike europiane në gjuhën gjermane dhe sidomos në vëllimet albanologjike më me ndikim në studimet filologjike europiane, Thimi Mitkoja jo vetëm popullarizoi, por edhe e europianizoi dijen albanologjike, në ato përmasa për të cilat shkenca e sotme e albanologjisë nuk e ka dhënë vlerësimin e saj. Dhe nuk e ka bërë këtë, kryesisht për dy shkaqe: prej qasjes metodologjike ndaj biografisë vetjake të Thimi Mitkos, si personalitet me biografi prej borgjezi të vogël dhe, prej mosnjohjes së veprave, dorëshkrimeve dhe arkivave të plota, të shtrira në Lindje, ndër arbëreshët dhe në Europë.

Kur studimet albanologjike, e kjo do të thotë kur albanologjia të vlerësohet jo vetëm si dije historiko-gjuhësore dhe si kontribut historiko-letrar, por edhe si lëvizje intelektuale, roli i Thimi Mitkos do të dalë në plan të parë: si rol i intelektualit që në një periudhë shumë të rëndësishme të përlindjes historike, kulturore, gjuhësore dhe shpirtërore të Europës, Ballkanit dhe hapësirës shqiptare, me angazhimin e shumanshëm të tij bashkonte strukturat e shpërndara të Lëvizjes Kombëtare ndërmjet Ballkanit, Kolonive brenda Perandorisë Osmane, arbëreshëve të Italisë dhe qendrave shkencore, kulturore e arsimore, që përtej misionit shkencor e kulturor në Europë kishin rolin e orientimeve politike dhe strategjike të shteteve të tyre ndaj popujve të vegjël në periferi të saj.

BERTON SULEJMANI (TETOVË, MAQEDONI)

KONGRUENCA E KRYEGJYMTYRËVE TË FJALISË NË VEPRËN "BLETA SHQIPTARE" E THIMI MITKOS

Në këtë punim do të nxjerrin në pah se në ç'numër është përdorur kallëzuesi kur si kryefjalë ka një emër përmbledhës. Në veprën e Th. Mitkos vërejmë se në të shumtën e këtyre rasteve kallëzuesi përdoret në numrin shumës, si: **Shkojën e vin'** dynjaja... Veç rasteve tjera në këtë punim do t'i paraqesim edhe rastet kur kryefjala është e shprehur me një togfjalësh të tipit emër në emërore + parafjala me + emër në kallëzore dhe përshtatjen e kallëzuesit në këto raste. Ja një shembull të nxjerrë nga vepra e Thimi Mitkos: Dialli me të birin **ishte** për udhë e tuke shkuarë pa ndë një fshat... Në këtë rast kryefjalë e fjalisë është Dialli, e kjo kuptohet nga numri i kallëzuesit. Por, në këtë thesar popullor që na e ka mbledhur Thimi Mitko vërejmë shumë edhe kryefjalë të tipit: **Ky Resuli me Bilbilë, / tundën** gjithë Shqipërinë. Të gjitha këto, kuptohet me plotësime i kemi paraqitur në versionin e plotë të punimit tonë, ndërsa shembujt i kemi vjelur nga "Bëleta shqyptare".

Përmbledhja e Thimi Mitkos, "Bëleta Shqyptare", e botuar në Aleksandri, në vitin 1878, veç tjerash, është përmbledhja e parë e letërsisë popullore shqipe, që do të sjellë lëndën më të çmueshme, në të cilën do të mbështeten mendimet mbi vlerën e lartë artistike dhe mbi rëndësinë historike dhe kulturore të thesarit shpirtëror të popullit shqiptar. Nga fjalët e moçme, fjalët e errëta, përshëndetjet, këngët e vjetra (alegorike dhe për të qeshur, dasmore, jaranishte, gegërishte, trimërishte etj.), përrallat, baladat e kështu me radhë, të cilat, i ka përfshirë në veprën e tij "Bëleta shqiptare"[482] i kemi studiuar dhe nga to kemi nxjerrë shembuj të kongruencës së kryegjymtyrëve. Jemi përqendruar më shumë në rastet për të cilat ende nuk kemi normë sintaksore të kodifikuar, pra ende zbatohen dy lloje të kongruencës, si: kur kryefjala e fjalisë është e shprehur me një emër përmbledhës të tipit djemuria, çupëria, bota, fshati, (në kuptimin tërësia njerëzve që jetojnë në një fshat) etj.; kur kryefjala e fjalisë është e shprehur me një togfjalësh emër në emërore + parafjala me + emër në kallëzore etj., për të parë se në ç'mënyrë e gjejmë këtë dukuri sintaksore në përmbledhjen e Thimi Mitkos dhe për ta parë sesi e ka përdorur deri në atë kohë populli ynë, gjithnjë duke u mbështetur në materialin e këtij thesari shpirtëror të popullit tonë.

Kallëzuesi i përshtatet kryefjalës në numër, në gjini, në vetë dhe në rasë. Ndërmjet kryegjymtyrëve të fjalisë mund të kemi *kongruencë formale gramatikore* që ka edhe përdorim më të gjerë në gjuhë. Por, në raste më të kufizuara, në gjuhë zbatohet edhe *kongruenca sipas kuptimit*. Kongruenca ose përshtatja e

[482] Botuar nga Instituti i Folklorit *"Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar"* (1635 – 1912) II, Tiranë, 1961.

kryegjymtyrëve të fjalisë në gjuhën shqipe thuajse është e përcaktuar. Megjithatë, ka edhe disa raste kur kallëzuesi përdoret edhe në numrin njëjës, edhe në numrin shumës dhe që përbën edhe thyerje të normës.

I. Shembuj ku kallëzuesi i përshtatet kryefjalëve homogjene. Në këto raste kallëzuesi është në numrin shumës, pra kemi kongruencë sipas formës:

Nikulica dhe Gramosi s'ëmësë ***van' e i thanë****. (f. 53)*

Ani gruaja edhe kumbareja ***ranë të flenë****, e plaku ...* (f. 167)

Shkonin *plaku dhe djali...* (f. 214)

Kurvelesh e Gegëri / ***u mbëlodhë*** *në Argjiri, /* ***të bëjnë*** *kumsion të ri, /* ***të lypin*** *autonomi...* (f. 231)

II. Kryefjala homogjene, ndërsa kallëzuesi në njëjës, (përshtatja e kryegjymtyrëve sipas afrisë – kallëzuesi i përshtatet elementit që ka afër). Veç kongruencës sipas formës, sipas kuptimit, dallohet edhe kongruenca sipas afrisë. Në fjalitë e mëposhtme kallëzuesin e kemi në njëjës, edhe pse kryefjala është një togfjalësh. Nuk i përshtatet si te shembujt e mësipërm (shih I).

Qenëke *trimi edhe vasha*. *(f. 53)*

Lufton *Bendua e Suli vetë.* (f. 102)

E ***rreh*** *topi e kumbarja.* (f. 122)

... i ***vetoj*** *shpata e jatagani, / lumeja nana qi e bani!* (f. 243)

Në përgjithësi mund të pohohet se edhe në këto raste prirja është që kallëzuesi të vihet në numrin shumës, pra të përshtatet sipas formës me vargun e kryefjalëve homogjene: ***Luftonjnë*** *Bendua e Suli... .*

III. Në veprën e Th. Mitokos, kur kryefjala e fjalisë është e shprehur me emër *përmbledhës,* kallëzuesin e hasim të përdorur në shumës, por edhe në pak raste edhe në njëjës. Siç dihet, emrat përmbledhës me trajtën e numrit njëjës emërtojnë një tërësi njerëzish, kafshësh ose sendesh të një fare. Pra, ata kanë trajtën e njëjësit, por kuptimin e shumësit. Për të pasur kongruencë gramatikore, kallëzuesi duhet të përdoret në njëjës e jo në shumës. Pra, jo: *Bota* ***po bënin*** *sehirrë / Hasan gjuhëbilbilë...* por: *Bota* ***po bënte*** *sehirrë / Hasan gjuhëbilbilë... .*

Të ***kënetë*** *misëria, / Që* ***të hanë*** *turqëria.* (f. 52)

Gjithë bota le ***të thonë****.* (f. 73)

Gjithë bota ***ven' e vinë****.* (f. 89)

Gjithë bota le ***të venë****.* (f. 90)

Ku ***jeni*** *ju parësia?*

*Pas vdekjes sime ç'****do të thoni****?* (f. 109)

Ndë Sinjë u mblodh ordhia,

Seç ***u mblodhë*** *pleqësia.* (f. 133)

Ndë Stamboll kartra dërgojnë, / se raeja ***po luftojnë****.* (f. 134)

Por edhe: *Na* ***ngriti krye*** *raeja.* (f. 138)

Shkojën e vin' *dynjaja...* (f. 238)

Bota ***po bënin*** *sehirrë / Hasan gjuhëbilbilë...* (f. 217)

More fshati orëzi, pse ***vratë*** *këtë njeri, / qafëgjatë si dori...* (219)

Gjithë parësia ***t'u*** ***mbëlodhnë*** *pas varri...* (f. 234)

... ***kishin dalë*** *gjindja e tërë e* ***po ndiqnin*** *me kuje të madhe ulkunë...* (f. 249)

IV. Kryefjala e shprehur me togfjalësh të tipit **emër në emërore** + **parafjala me** + **emër në kallëzore** funksion si kryefjalë dhe përshtatet me një kallëzues në numrin shumës kryesisht në gjuhën e folur, në gjuhën popullore. Kështu e gjejmë edhe në veprën e mbledhësit të hershëm të folklorit shqiptar, pra në "Bletën shqiptare". Në shqipen e sotme standarde gjithnjë e më tepër parapëlqehen ndërtimet me kryefjalë homogjene: emër ose përemër në emërore + lidhëzën (e, dhe, edhe) + emër ose përemër në emërore. Pra, në vend të ndërtimit *Ali-beu me Islam-benë rrokën kordhatë në dorë* përdoret më shumë ndërtimi: *Ali-beu dhe Islam-beu rrokën kordhatë në dorë*. Mosvënia e kallëzuesit në shumës do të tregonte se në funksion të fjalisë s'do të ishte togfjalëshi *Ali-beu me Islam-benë*, por vetëm *Ali-beu*. Po do të ishte ndërtuar kështu fjalia: *Ali-beu me Islam-benë rroku kordhatë në dorë*, në këtë rast togu *me Islam-benë* nuk është pjesë përbërëse e kryefjalës, por gjymtyrë më vete, kundrinë me parafjalë.

Ali-beu me Islam-benë,

Rrokën *kordhatë në dorë.* (f. 102)

Elmas Xhemi me t'vëllanë,

Për Zylyftarë u ***vranë****.* (f. 122)

Elmazi me kushurinë,

Mun te kisha, seç u ***shtrinë****.* (f. 122)

Ky Resuli me Bilbilë,

Tundën *gjithë Shqipërinë.* (f. 123)

Frenk-pasha me Melniklinë / e ***bënë*** *tertipin. / I* ***lëshuan*** *kalorinë...* (f. 144)

Bidoja (Abidini) me Muharremnë. / U ***lëshuan*** *anë-mbë-në, / e* ***bënë*** *flakë dynjanë, /* ***përmbysnë*** *gur' edhe malë...* (f. 152)

Haxh-Alia me të birë, / në haraç ***vu*** *Venetinë...* (f. 162, në këtë rast nuk kemi kryefjalë togfjalëshin *Haxh-Alia me të birë* e këtë e kuptojmë nga numri njëjës i kallëzuesit)

Asllan beu me Veli bejnë / në Mecovë ***bënë benë****, / në Manastir* ***do të venë****, /* ***të kërkojnë*** *ylefenë...* (f. 225)

Bukureshti me Vllahinë / ***zaptuan*** *Bullgarinë, / ndë Plevnë e* ***zun'*** *ordhinë.* (f. 231)

Çanëza me Kiçonë, / ***luajnë*** *restiçonë.* (f. 246)

Prifti me priftëreshënë / ***van' të vielën*** *vreshtënë. /* ***Erdhën*** *torrë-torrë, /* ***u kukullosnë****...* (f. 247)

Çana me Dimopullin / ***shajtin*** *Pirgopullin...* (f. 248)

Dialli me të birin ***ishte*** *për udhë e* ***tuke shkuarë*** *pa ndë një fshat...* (f. 251 - në këtë rast nuk kemi kryefjalë togfjalëshin *Dialli me të birin* e këtë e kuptojmë nga numri njëjës i kallëzuesit)

V. Shembuj ku kryefjala e fjalisë është një emër vendi, si: fshati, qyteti, krahina etj., i përdorur në mënyrë metonimike (p.sh.: *"u rreshtua klasa e dytë"* në vend të *"nxënësit e klasës së dytë"*) për të shënuar tërësinë e njerëzve që jetojnë atje, kallëzuesin në veprën të cilën e kemi studiuar, e gjejmë edhe në njëjës, edhe në shumës. P.sh.:

Kështu deshi perëndia,
Që u ***çkulnë*** *mbretëria,*
...s'os të dhanë vilaeti
Po të gremisi dovleti. (f. 111)

Ylemaja na ***ka mësue****...* (f. 158) (Ylemaja – dijetarët)

Gjithë trimave u dha dhenë, / edhe krerëtë tok ***u mbluadh****, / të gjith' ikn' e më s'i venë...* (f. 223)

Sa di i zoti i shtëpisë, ***nuku di*** *një fshat i tërë.* (f. 25)

Kur emrat e tillë përdoren si kryefjalë, kallëzuesi në gjuhën shqipe mund të vihet edhe në numrin shumës. Por, gjithnjë prirje po bëhet kongruencë sipas formës, d.m.th. kongruencë gramatikore të kryegjymtyrëve, është mirë, madje duhet të ngrihet si normë, përdorimi i kallëzuesin në njëjës.

Në rastet kur kryefjala është e shprehur me një toponim me kuptim përmbledhës (si në shembujt e mëposhtëm) kallëzuesi përdoret edhe në njëjës, edhe në shumës. Edhe për këto raste duhet të ngrihet normë sintaksore, përdorimi në njëjës i kallëzuesit. Edhe në shembujt e nxjerrë nga vepra e Th. Mitkos prijnë kallëzuesit në njëjës. Ja shembujt e nxjerrë:

... lëftonin Korfuz kalanë,
Se Korfuzi ***ka të zonë****,*
Të zonë shën Spiridhonë. (f. 101)
Rumelia ***u ngrit e iku****.* (f. 102)
Shqipëria ***të qan*** *me lot,*
Mbajnë *zi derë mbë derë*. (105) kallëzuesi i dytë në shumës – mbajnë.
Thanë, ***doli*** *Rumelia,*
Ngriti *krye Shqypëria.*
...Edhe Shkodra i ***dërgoi***
Manastir ***u ngrit e shkoi****.* (f. 121)
*Misollongji, se ç'****u mblodhë****,* (f. 123 – nëse Misollongji është një emër vendi)
Zunë malet e rrënkojnë, / Kurveleshi ***po luftojnë****...* (133)
Po *na* ***vjen ndihmë*** *Mirdita...* (f. 156)
Shqipëria anë mb'anë / ***u ngren'*** *e një fjalë* ***thanë****: / mbretiti s'i apëm nizamë...* (f. 228)

Malzia ***ngriti krye****...* (f. 231)

Ç'ka deti që ban tallas? / ***Thot*** *Janina "kam maras".* (f. 240)

VI. Kryefjalë homogjene me lidhëzën e përsëritur **as..., as...** Në këto raste veprimin e shprehur nga folja-kallëzues e kryejnë bashkërisht, por ai i takon veç e veç secilit nga kryerësit e veprimit:

As mbretër', as perandorë, / gjë me forcë ***s'kanë gjetur****...* (f. 153)

FATON KRASNIQI (GJILAN)

ONOMASTIKA NË VEPRËN E THIMI MITKOS

Onamastika e folklorit në veprën e Thimi Mitkos është një nga pjesët më të rëndësishme, njëherë shumë e pasur me emra të përveçëm vendesh e njerëzish, toponime e antrotoponime që janë pasqyruar në veprën e tij. Në veprën e Thimi Mitkos përpos onomastikës gjenden elemente logjike, etike, psikologjike, fizike e metafizike. Në lidhje me këtë, Thimi Mitkoja sjell citate për të mbështetur mendimet duke përmendur emra autorësh e vendesh shkrime të ndryshme. Onomastikën e veprës së Thimi Mitkos do ta paraqesim në formë fjalori sipas rendit alfabetik në mënyrë që lexuesi apo studiuesi, duke i parë të renditur, ta ketë më të lehtë kërkimin e gjetjen e elementeve onomastike, që duhen për t`i njohur ose për t`i studiuar.

Pikëpamjet e Thimi Mitkos për onomastikën

Në këtë pjesë jemi marrë me onomastikën (emra të përveçëm vendesh e njerëzish-toponime e antroponime) që janë pasqyruar në veprën e Thimi Mitkos. Kështu këta emra vetjakë (personal) me vendet e tyre na njohin edhe me kulturën e Thimi Mitkos, natyrisht brenda rrethanave të kohës e të hapësirës së tij. Së treti, onomastika në veprën e Thimi Mitkos përmban emra të përveçëm, që i përkasin kohës së vjetër të Lindjes së Mesme, por edhe greqishtes së vjetër e latinishtes; ata emra, të përmendur nga Thimi Mitkoja, kanë interes gjuhësor për t'u renditur, sepse në një mënyrë a në një tjetër ka mundësi të bëhen vrojtime të ndryshme, ndër të cilat edhe ato gjuhësore për nga përshtatja fonetike e tyre në gjuhën shqipe, për nga burimi e të tjera si këto. Së katërti, një pjesë e onomastikës përmbledh toponime e antroponime, që lidhen me vetë Thimi Mitkon e veprën e tij ose me vendin, popullin e gjuhën tonë, çka merret si dokumentim për nga ana historike.

Po ndalemi në disa pikësynime që kemi mbajtur parasysh. E para ka qenë për t'i paraqitur në formë fjalori sipas rendit alfabetik në mënyrë që lexuesi apo studiuesi, duke i parë të renditura, ta ketë më të lehtë kërkimin e gjetjen e elementeve onomastike, që i duhen për t'i njohur e për t'i studiuar. E dyta lidhet me faktin se autori i shkruan antroponimet e toponimet rregullisht po me atë grafi të përdorur për fjalët shqipe e po me atë morfologji shqipe, në lakimin e emrit rregullsi të cilës i jemi përmbajtur edhe ne.

Kështu do veprohet edhe për njësitë e onomastikës. E treta ka të bëjë me ato raste, kur emri i përveçëm del disa herë për të njëjtin njeri o vend, me të njëjtën trajtë fonetike. Ndër këto rrethana ai emër është shkruar vetëm një herë. E katërta i takon kontekstit, në të cilin qëndron si element onomastic, prandaj që të dihet se ç'është ai emër i përveçëm, toponim apo antroponim e, bashkë me ndonjë karakteristikë tjetër, që mund të ketë, janë nxjerrë shprehje e citate më të gjera ose më të ngushta, ashtu si janë lexuar ato shprehje te Thimi Mitkoja në veprën e tij. Thimi Mitko e hartoi veprën e tij në mars 1878, kur po zhvilloheshin, ngjarje

historike vendimtare, prandaj ka shtruar në të probleme të rëndësishme politike e kulturore[483]. Me krizën Lindore të vitit 1877-78 qeveritë shoviniste të Serbisë e të Malit të Zi dhe Bullgaria e madhe, e krijuar nga Rusia me Traktatin e Shën Stefanit, do të realizonin planet e tyre grabitqare në kurriz të tokave shqiptare. Përpara këtij rreziku udhëheqësit e lëvizjes shqiptare e panë të nevojshme të hynin në lidhje me qeverinë greke për formimin e një aleance për të përballuar ekspansionin e shteteve sllave, që vinte në rrezik edhe interesat e Greqisë. Këtij qëllimi i shërbyen edhe kontaktet që pati më 1877 dhe në janar 1878 Abdyl Frashëri me përfaqësues të qeverisë greke. Një mendim të tillë shpreh këtu edhe Thimi Mitkoja, deri sa vetë ngjarjet treguan qëndrimin armiqësor antishqiptar të politikës greke ndaj Shqipërisë. Vetë Thimi Mitkoja në hyrjn e "Bletës" i shihte qartë rreziqet që i vinin popullit shqiptar nga rrethet shoviniste greke të Athinës dhe politika kishtare e Patriakanës së Stambollit, që në fakt e bënin të pamundur një bashkëpunim të tillë[484]. Vepra e Thimi Mitkos është e mbushur me ngjarje nga fusha të ndryshme si: kulturore, historike, gjeografike, politike, folklorike etj. Normalisht që edhe onomastika në veprën e Thimi Mitkos është shumë e pasur. Onomastikën e Thimi Mitkos do ta paraqesim në pjesën lirike dhe historike që përfshin: 1. Këngë vegjëlish, 2. Këngë për festat popullore të motmotit, 3. Këngë dashurie, 4. Këngë dasme, 5.Kurbeti, 6. Vaje e këngë të pavajëshme, 7. Të ndryshme, 8. Balada, dhe 9. Këngë historike. Synimi ynë është që të marrim pjesë sadopak në plotësimin e veprës së tij. Nëse deri tani kishim një studim themelvënës të onomastikës shqiptare, brenda të cilit Thimi Mitkoja kishte bërë një tipologji modeste në studimet albanologjike, tani, këtu kemi edhe pjesën tjetër nga lënda të cilën e kishte vjelë edhe në kuadër të hulumtimit të leksikut. Le të besojmë se edhe ky hulumtim do t'i shërbej synimeve të para një shekulli të tij.

Fjalorthi onomastik i veprës letrare të Thimi Mitkos

Abas beu: Me gjithë ta, më shullë po bën niza, mbylltur brënda ndë kala. 312
Abdi Hysa: I biri plakës përnjiherje ia dha flakës. 338
Abdyl Frashëri: Edhe Abdul be Frshëri u përpoq i varfëri. 346
Abudalla pasha: Abdullai pashai e priti. Hajde, Sherif Mutalipi. 308
Adem/i: Qaj, mok Katerinë, qaj për Ademanë. 139 (Këngë dashurie)
Adile: Tundu, moj, se të ka hie, posi dielli kur bie. 144 (Këngë dashurie)
Ago Omeri[485] : Ç`peng po len, Ago Omerit?. 244 (Balada)
Ago Përmenë: Kush pyet për Ago Përmenë, qajeni me Musta bejnë. 270
Ago Tivari: Ka thanë: Çojm` e thërrasim ylqinjlinjtë ato perçesërmalijtë. 320
Ahmet bej: E bëmë myshaverenë të vrisnim Ahmet benë. 328
Ahmet pashë: Ahmet pashë binishgjatë. 252
Aja Sofi/a: Më kërkon për kërshterimnë Stmaboll` e Aja Sofinë. 338

[483] Thimi Mitko, *Vepra*, Tiranë, 1981, fq 63.
[484] Thimi Mitko, *Vepra*, Tiranë, 1981, fq 64.
[485] Po ay, fq 244.

Ali Asllani: Mirsevjen, o Pano Jani-mirsetëgjenj o Ali Asllani. 323
Ali Beshiri: Prej Tirane na shpëtoi shpyrte, shpëtoi xhane. 336
Ali beu: Ali beu me Islam benë. 254
Ali pashai: Të mbahi, burra, të mbahi se u tremb Ali pashai. 257
Ali pashë Janina: Prej Ali pashës Janine po i marin nuse qenit, gruen e Ago Omerit. 244
(Balada)
Alush Tabaku: Jam e Alushë tabakutë. 118 (Këngë dashurie)
Allamanë: zunë dyzet e kapedanë, që n'Athinë e nd'Allamnë. 297
Andruc/i: Andruci ndë Livadhi tike thirrë "Livadhi", 273.
Angjelinë/a: Janin`e mjera Janinë emërin e ke Angjelinë. 228 (Të ndryshme)
Anthinë/a: Musta beut frikën ja kanë, Anhin`e mjera Anthinë. 270
Arapistan/i: U djegsh o Arapistan. 206 (Kurbeti)
Arbër/i : Arbër-o, gjarpër-o, leshkorra, bir-o! 137 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Arbëri: Këtej i thon' Arbëri, që të zënë ty si mi. 304
Armerosë[486] : Humbe mëndjen e s`e gjen, o budall i Armerosë. 111 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Artinë: Çë kej Artinë, ajo mbjovi apo thinjë. 236 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Asllan Beu : Në Dhiavat të Manastirit Asllan beu i hypi çilit. 288
Avarik/u: E Kuconika sokëlliu, qatje nga Avariku. 259
Avdul Borshi: O Sanë, e zeza Sanë. Avdul Borshi të vu zjarrë. 308
Avionë: Sa mbuavë k`Avuona. 236 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Avram/i: Qir Avramit ushtri, fill i kllapodanit. 211 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Avzi Pasha: Të kam rixha, Avzi pashë, urdhëro të dalëm jashtë. 283
Baba Ferro: O sulltan, me pisqoll`e jatagan. 117 (Këngë dashurie)
Balil/i: o Balil, jelek me koqe mi nizamët ç'u përpoqe, sa u zhurite, u dogje. 305
Beligrati: Tre bajrakë nga Filati, pashai nga Beligrati. 303
Bendo Shapërdani: More Bendo Shapërdani ndë Stamboll të vate nami.. 251
Beqir Xhagajadhuri: Thirri Beqir Xhagajdhuri more qendro Nikë Nuri. 262
Berat/i: Me Kurt pashanë e Beratit. 254
Berat/i: Ujë kanë verë s`kanë, levend i Beratitë. 188 (Këngë dasme)
Berlin/i: Na duam autonominë atë q`u lith në Berlinë. 345
Besim pashaji: Se na vrau Zenel agaji, u thye Besim pashaji. 297
Boçar/i: Ku jin`, o djemt` e Boçarit. 259
Bubarinë/a: Dymbëdhjetë mijë të rretho(s)njën Shënvasilë, Nivicën, Bubarinë. 258
Bububulinë/a: Bubulinës kur i thanë: "Musta bejnë seç e vranë". 270
Bukuresh/i: Bukureshi me Vllahinë zapëtuan Bullgarinë. 343
Bushati/i: Mir`se vjen beg i Bushatit, m`ep tehir t`i ulem atit? 280
Cmëjan/i: Ta kam xan` hoxhën e Cmërjanit. 345
Cokë Dima: Si fellah dhentë te furra i pa: kur i pa dhentë te furra, sokëllijti..322

[486] Po aty, fq 111.

Çamëri/a: Lumi i Vlorës nëndë mijë, Delvina me Çamërinë 291
Çaush Hormova: Kapedan Çaush Hormova dhjam`e e dyll të pikova..253
Çaush Liga: Njëzet e tetë fishekë i zbras Çaush Liga vetë. 264
Çelo Mehmeti: Shahin be, o djalë mbreti mos u tremb Çelo Mehmeti 291
Çelo Picari: Kapetan Çelo Picari o shejtan Veis Vasjari. 281
Çelo Picari[487]: O kalem` i kallamarit, pisqoll`e Çelo Picarit. 112 (Këngë dashurie)
Çeloja: Çeloja me katër mijë mbi Kallabak`u vërvërinë. 317
Çun Aliu: Pa dëgjuar si miu iu duk si Çun Aliu. 320
Dakua: Mun në gropat e kalasë, u vra Dakua i fukarasë. 282
Dasho Shkreli: As me top as me havana, Dasho Shkrelin s'e ban nana 293
Deli Nou: Pa m`u nal, më ke nji borxh pa ma laj. 332
Delijan/i: Seç ta punoi kapedani, kapedani Delijani. 318
Delvinë/a: Erdh Kraiskua Delvinë. 258
Delvinë/a: Lumi i Vlorës nëndë mijë, Delvina me Çamërinë. 291
Dervish Ahmeti: Ndë Korç` u bë adaleti, na u vra Dervish Ahmeti. 255
Dervish pasha: Kur dëgjoi, mbë të pabes'e helmoi. 309
Dimopull/i[488]: Solli mjalt` edhe recinë. 234 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Dudë/a: Moj dudë, Dudileja, buzëkarafileja. 107 (Këngë dashurie)
Dudileja [489]: Dudileja, buzëkarafileja. 107 (Këngë dashurie)
Dudusheja: Moj Dudë, Dudesheja, buzë qengjerusheja. 107 (Këngë dashurie)
Dukagjin/i: Mbush kupen me Dukagjin moj bija ime. 150 (Këngë dasme)
Dukat/i: Brënda u nodh një Dukat ia ngrejti koburen lart. 331
Dunavecnë/a: Lumtë këmb` e kalit bardhë. 74 (Këngë të vegjëlish)
Durrësë: Kali vajti Durrësë, në katund të pulësë. 78 (Këngë të vegjëlish)
Dush/i: Tir, nanja e Dushit. 221 (Të ndryshme)
Dhiavat /i : Në Dhiavat të Manastirit Asllan beu i hypi çilit. 288
Dhimitraq/i : Dhimitraq, o Dhimitraq, u sëmure e s`pat ilaç. 210 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Dhoskë Korçari: Xveshi jatagan u derth si petriti, të presi Myftarë.
Elbasan: Duda ish prej Elbasani. 107 (Këngë dashurie)
Elen/i: I muarë me lemona. Elinë, çë kej Artinë. 236 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Elmas Xhemi: Elmas Xhemi me t'vllanë për Zylyftarë u vranë. 290
Elmaz Dukati: Bythë Rrapi Tepelenë, bir, o bir Elmaz Dukati. 303
Engliterë : U bëfsha frëng me kapellë lir` e frëngut nd`Engliterë. 132 (Këngë dashurie)
Ersekë/a: Që n`Ersek` e në Sofie Malzia ngriti krye. 343
Erzegovinë/a: Ç`pat Erzegovina, ç`apti? 341

[487] Po aty, fq 112.
[488] Po aty, fq 234.
[489] Po aty, fq 107.

Ezer Foriçi: I biri burrit kishte nenj` n`ysbe të gurit. 333
Ëlli: Rri rri shën Ëlli. 94 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Fan/i: Të mbledhën krenat e Fanit, të Fanit të Mirditës. 345
Feim Prodani: Feim be Prodani o mustaqezi, vallë vet`u vrave, a të vrau njeri? 338
Feiz/i: Ky Feizi burrë, që hoqi jorganë e çoban. 125 (Këngë dashurie)
Fejzo Xhafoja: bajrak difi pa zorrë ndë bark. 321
Ferro: O sulltan me pisqoll`e jatagan. 117 (Këngë dashurie)
Filat/i: Sheh Sejkati ndë Filat Zoto Mahmuti Cmokthinë. 286
Foto Xhavella: Ti, more Foto Xhavella seç na bore me kapella.. 259
Frenk pasha: ndë Konjë u ngrit e shkojti Frenk pasha me Melniklinë 293
Galinë/a: Vallë ç`e prishi Galinë. 341
Gogua: Gogua me Mangananë erth Niqita e të pru fjalë. 314
Gramos/i: Nikulica dhe Gramosi ndë mest na rënëke Ristosi. 93 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Gramozë: Gramozë muarë përpjetë hidhenë posi shigjetë. 313
Greqi: U nxi jeta shum`u nxi, ngrinë krye ndë Greqi. 275
Guçeja: Të më lozë Guçeja, faqekolopuçeja. 117 (Këngë dashurie)
Gjakovë/a: Prit o djalë kokrën e plumit, këta janë djelt` e Gjakovës. 340
Gjeraqinë/a: Flytyroi një Gjeraqinë, me zile nëpër këmbë. 169 (Këngë dasme)
Gjika: Gjika vajti mbë të parë, gjeti Kostandin`e vrarë. 210 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Gjin/i: Gjini erth e shkoi. 94 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Gjirokastrë/a: E kur vajçë Gjirokastrë, kungull pashë ndë çdo bashtë. 221 (Të ndryshme)
Gjon Lekë Lapi: Kordhëtari, zoti im, o Gjon Lekë Lapi, seç të humbi nami. 311
Gjonlekë Kuçi: Te viti dyzet e gjashtë na dolli Gjonleka jashtë. 297
Hafiz pasha: Hafiz pasha kryelopa, s'mirret Shkodra me tre topa. 293
Hajçeja: Hajçeja, i biri i Puçesë, foli faqekuqesë. 80 (Këngë të vegjëlish)
Halil/i: Hesht, Halil mos ban of, lele. 337
Hamzo: Hamzo, ku i ke trimatë? 255
Hani i Valaresë: Me të pabesë ç`i vranë, mun te Han`i i Valaresë. 262
Hanko Rabiani: Na mori mbë qafë, këta prodonakët.
Haris/i: O Haris, ç`ma bëre gjënë? 264
Hasan bej: Hasan bej, Hasan Kolonja, mos të turpëronjë zonja. 110 (Këngë dashurie)
Hasan beu: Dako, karafil me vesë, të vrau Hasan beu mbë besë. 282
Hasan Kolonja: Hasan bej, Hasan Kolonja, mos të turpëronjë zonja. 110 (Këngë dashurie)
Hasan/i; Ke teqja e Baba Hasanit. 254
Hava Meçe: Moj zeza Hava Meçe, shtatë djem edhe një keçe. 265
Haxhi Alina: Ju të mjerë ylqynakë. 250
Hormovë/a: Që Hormov`e tatëpjetë ndë atë Starovën. 253

Hristo Koka: Hristo Koka ndë Vuno, Spiro Gjika Qiparo, Jano Milua himarjot, Hodo Beu borshit. 285
Hysen beu: Hysen beut me pikë ndë ballë. 124 (Këngë dashurie)
Hyso Arap Shahinë: Çpeito zini manastirë, se Shqypëtarët na pinë..282
Ibrahim beu: Shan` e Ibrahim beut shtat vjet beronjë[490]. 140 (Këngë dashurie)
Ibrahim pasha: Ibrahim pasha, një buall, gjithë trimave u dha dhenë. 261
Ilia: Ilia, Ilia.. 71 (Këngë të vegjëlish)
Isen/i: Vjen Iseni me ordhi kallarat me tevabi. 265
Islam beu: Ali beu me Islam benë. 254
Ismail beu: Qaj, moj Vlorë e moj Kaninë, Ismail beu na u vra Janinë. 284
Ismail beu: Vran` Ismail bejnë. 216 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Ismail/i: Me takëme, o sheh Islami me mëndje. 103 (Këngë dashurie)
Isuf Arapi: Tyn` ore Isuf Arapi, ç`t`ethka ndore kasapi. 253
Isuf begu: Mustafa thërret Isuf Begun prej Serezit. 260
Itali/a: Po miri thelë frëngjinë, Trieshtën e Italinë. 142 (Këngë dashurie)
Ivani: Aty gjen dy probatina, Ivani, Mehmet Alia. 338
Jaçe/ja: Moj` e bij` e Jaçesë karafil pas faqesë. 117 (Këngë dashurie)
Jakë: Jakë, o Qorr, se ja te rrimë. 254
Janinë/a: Janin`e mjera Janinë emërin e ke Angjelinë. 228 (Të ndryshme)
Jano Milo: Hristo Koka ndë Vuno, 285
Spiro Gjika Qiparo, 285
Jano Milua Himarjot, 285
Hodo Beu borshit. 285
Janjesë/a: Vranët na ish, na binte shi, ndër malet e Janjesë. 205 (Kurbeti)
Jovanë: Të kisha Jovanë pranë se të çkulte jataganë. 283
Kallarat/i: Kapokudhës Qirhati, po të vrau i Kallarati. 215 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Kamenicë/a:[491] Ç`deshe në Kamenicë. 175 (Këngë dasme)
Kaninë/a: Qaj, moj Vlorë e moj Kaninë, Ismail beu na u vra Janinë. 284
Kapokudhës Qirhati: Kapokudhës Qirhati, po të vrau i Kallarati. 215 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Karaiskaq: Veli Be Tripoliçanë. Të dërgon Karaiskaqnë. 257
Karaiskua: Erdh Kraiskua Delvinë. 258
Karbunarë: Ç`deshe ti ndë Karabunrë. 211 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Katerinë/a: Qaj, mok Katerinë, qaj për Ademanë[492]. 139 (Këngë dashurie)
Kavajë/a: Ti, more pash`, pash` Kavaja. 255.
Kiç Andoni: Kiç Andoni, vet` i tretë në mëngjes e gjer mbë drekë. 262
Kiçonë: Çanëza me Kiçonë luajnë restiçonë. 234 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)

[490] Po aty, fq 140
[491] Po aty, fq 175.
[492] Po aty, fq 8

Koikua (Mal në Përmet)[493]: Dolle mbi Koikua, seç pe Libivanë. 104 (Këngë dashurie)
Kolë Kalkaçi: Me pallën e tij e ngriti edhe ky Kolë Kalkaçi. 322
Kolonjësë: Kali mari udhënë, udhënë e Kolonjësë. 78 (Këngë të vegjëlish)
Kollonatë: I biri i Kollonatësë. 233 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Korçë/a: Ndë Korç` u bë adaleti, na u vra Dervish Ahmeti. 255
Korfus/i: Lëftonin Korfus kalanë. 249
Korfuz/i: Më vjen si gjemi Korfuzi. 133 (Këngë dashurie)
Korfuz/i: Se Korfuzi ka të zonë. 249
Kostandin/i: Gjika vajti mbë të parë, gjeti Kostandin`e vrarë. 210 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Kostandin/i: Kostandin mustaqeziu edhe aty Nino Kumiu. 320
Kostandinkë/a: Paç edhe jatronj të mijtë, të gjorin Kostandinkë. 109 (Këngë dashurie)
Kostë Rrella: Kostë Rrella zu thërriste, Spiro Hormova zu vise. 313
Krisht/i: Ndek farkonteji shpatënë, të zotit Krisht. 90 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Kuconik/u: O djemt` e Kuconikës? 259
Kullur/i: Vjen një kartë ka Kulluri. 233 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Kumiu: Stefan Prifti shënvasiot, edhe Kumiu niviciot. 286
Kurt/i: Ik`, o Kurt se ta arrinë. 254
Kurvelesh: Këta djemt e Kurveleshit, luftojnë me palla sheshit. 297
Lackë/a: Ndë krua të Lackës t`u gjet lahuria. 140 (Këngë dashurie)
Lako Panariti: Mbi malet në Samarinë vranë Lako Panarinë. 263
Lamçe/së: Pisqollat e Lamçesë i mban mesi i Hajçesë. 80 (Këngë të vegjëlish)
Lamçe: Plaçi, ju gjinokastritë se ju vrava Lamçe Çipnë. 327
Lame Liga: Që ndë Vlorë e Tepelenë Lame Liga zu dyfeknë. 264
Lazare: Lazare o Lazare, ngreu, ngreu, se u err. 90 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Lazër/i: Lazëri që bëre lazuarë. 90 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Lepsinë/a: Dolli barka në Lepisnë. 234 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Leskovik/u: Tin'o Leskovik i shkretë, delnie hapnie penxheret 291
Libivanë (Fshat në Përmet)[494]: Dolle mbi Koikua, seç pe Libivanë. 104 (Këngë dashurie)
Lima: Magjor Lima kordhëshpata. 257
Limotogë: Haj vemi për Limotogë. 203 (Nizami)
Linë/a: Një kushtrim që qiti Lina, ikua Toma ra ndër Trima. 338
Livadh/i: Andruci ndë Livadhi tuke thirrë "Livadhi". 273
Lulushe/ja: Të gënjeu, Lulesheja me një shami mollë. 140 (Këngë dashurie)
Llazëri: Llazëri, shën Llazëri[495]. 89 (Këngë për festat popullore të motmotit)

[493] Po aty, fq 104.
[494] Po aty, fq 104

Mahmut beu: Me takëme, o sheh Islami me mëndje. 103 (Këngë dashurie)
Mahmut Daci: Vetoi shpata; vetoi shpata e jatagani lumja nana qi e bani! 324
Mahmut Harbija: Ndëgjo ti, Mahmut Harbija, pse s'dolle Tudas nde vija? 311
Majan agai: Ubë ulërimë vajit, than` u vra Majan agai. 212 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Mali i Zi: Bini, o djelm, lodrave, bini se mbet n`Mal të Zi veziri. 256
Malinat/i: E kur dola në Malinat.. 261
Malishovë/a: Aman përrënj me dëborë. Që Sinic` e Malishovë. 225 (Të ndryshme)
Malzi/a: Që n`Ersek` e në Sofie Malzia ngriti krye. 343
Manastir/i: Në Dhiavat të Manastirit Asllan beu i hypi çilit. 288
Manastire: Erç edhe të kërkova shpirt, o moj Manastire. 108 (Këngë dashurie)
Mane Bendua: Mane Bendua seç, i priti mun në zembrëtë i goditi. 216 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Mangana: Gogua me Mangananë erth Niqita e të pru fjalë. 314
Manusho: Ballët moj manusho. 101(Këngë dashurie)
Marinë/a: Pa pyetni Marinë, sa dhallë me barrë. 222 (Të ndryshme)
Marko Boçari: Preu dyzet kollëxhi ky qe Marko Boçari, nëmë pastë si ari. 273
Marko Sulionë: Mesollonjë u helmua e dedhi lotët si krua. 278
Maze Merke: Lule, o Maze Merke, o lule dërgove djemtë të shtijnë. 323
Meço Bonos: Njëri qe Myftar pashait, tjetri i Meço Bonos. 258
Mehemt pashë Maxhari: Hem i mretit, hem i krajlit. 345
Mehmet Alia: Aty gjen dy probatina, Ivani, Mehmet Alia. 338
Mehmush/i: I dërgoi Mehmush kahpeja. 257
Melniklinë/a: ndë Konjë u ngrit e shkojti Frenk pasha me Melniklinë 293.
Mëria: Lutij zonjës shën Mëri. 71 (Këngë të vegjëlish)
Mirdit/a: Të mbledhën krenat e Fanit, të Fanit të Mirditës. 345
Mirëdita: Mirëdita moj kadënë, mirë sot, mirë motë. 95 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Misir/i: Ky Misiri fort i largë. 206 (Kurbeti)
Misir/i: Ndë Misir e ndë Vullakë, kamilet mbajnë fishekë 294
Mitro Dedë Duka: U vra Mitro Dedë Duka, treqind dhen i la kërruta. 215 (Vaje e këngë të përvajëshme)
More: O e bukura More! 249
Moskov/i: Fati ndë Korfus na hodhi, zumë dorë te Moskovi. 259
Muhedin/i: Të them një fjalë Shemua nuk ziret gjallë. 325
Musta beu: Musta bejnë seç e vranë...270
Mustafa Çakalli: Na e nxorri llafnë Hanko Rabiani. 327
Mustafa pash Gjiriti: T`u përgjeq po si petrit, qani male, qani gur...337
Mustafë/a: Mustafa thërret Isuf Begun prej Serezit. 260
Myftar Lapi: Ndë Psar të shkret lëfton Myftar Lapi me tetëmbëdhjetë. 327

[495] Po aty, 89

Myftar pashai: Njëri qe Myftar pashait, tjetri i Meço Bonos. 258
Myrtoja: Myrtoja fora jataganë, nëpër dolli matanë. 327
Nazif/i: O Nazif, o budalla bjeri fyellit kaba. 117 (Këngë dashurie)
Negoshtli: Këto grat`e Negoshtlisë në duart e turqërisë!...279
Ngjelinë/a: Ngjelino buzëburbuqe, ti s`m`i pate këto huqe. 126 (Këngë dashurie)
Nikë Nuri: Thirri Beqir Xhagajdhuri more Qendro Nikë Nuri. 262
Nikollau: Mençikofnë e kam si djalë, se lëfton me pashallarë, ua vërvit me pashallarë. 312
Nikulica: Nikulica dhe Gramosi ndë mest na rënëke Ristosi. 93 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Nino Kumiu: Kostandin mustaqeziu edhe aty Nino Kumiu. 320
Niqita: Gogua me Mangananë erth Niqita e të pru fjalë. 314
Nivicë/a: Dymbëdhjetë mijë të rretho(s)njën Shënvasilë, Nivicën, Bubarinë. 258
Ohrie: Të solla ty ca molla, ca molla pe Ohrie. 108 (Këngë dashurie)
Omer/i :[496]O Omer ago i shkretë. 244 (Balada)
Osman Kuçi: Nga Zhulati, tre bajrakë nga Filati. 303
Osman pasha: U bë gjaku der në gjunjë Osman pashanë e zunë. 343
Palabardh/i: Ju, o djelmt`e Palabardhit. 256
Pano Jani: Mirsevjen, o Pano Jani-mirsetëgjenj o Ali Asllani.323
Petro beu: I apim nese dudinë, të bijën e Petro beut. 154 (Këngë dasme)
Përmet/i: Çupë pe Përmeti, nuse në Janinë. 104 (Këngë dashurie)
Pilo Dime: Sa nxora arën bakalle u hodh qeni Pilo Dime. 321
Pilo: Pilo, me shokë ze vëndë, ze vënd`e qillo mbi ta. 314
Pirgopull/i: Çana me Dimopullin shajtin Pirgopullin. 234 (Këngë të Arbëreshëve të Greqisë)
Pjetrë: Triko, i shën Gjini se na vjen zot` i shën Pjetrë. 94 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Pjetri: I shën Pjetri na afëroi. 94 (Për festat popullore të motmotit)
Plevnë/a: Plevn` e shkreta pse u fale, dyzet tabore i vrave. 343
Poliçanë: Sipër, mbë Poliçanë. 210 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Polo: Bilbil, o kapedan Polo...264
Povëlo: Dili o shokë se do dalëmë, o to piqemi Povëlo. 198 (Nizami)
Prusi/a: Pati zënë madhështinë të bën dyfek me Prusinë. 341
Psar/i: Ndë Psar të shkret lëfton Myftar Lapi me tetëmbëdhjetë. 327
Puçeja: Hajçeja, i biri i Puçesë, foli faqekuqesë. 80 (Këngë të vegjëlish)
Qaf`e Shëndlliut: Tri zogëza po rininë, nde Qaf` Shëndlliut. 258
Qafëkrabë: Kapërxeve Qafëkrabë, harrove nan` edhe babe. 119 (Këngë dashurie)
Qamil/i: Na prishe nga mëntë, kopil` e Qamilit! 115 (Këngë dashurie)
Resul Prognanë: Bilbil o pisqollarë! Qaje mirë gushëbardhë. 326
Rexhep Qollaku: unë jam Rexhep Qollaku, jua thoni vetë vezirit. 294

[496] Po aty, fq 244.

Rexhep/i: Krushqit prapa malitë, Rexhep, hypi kalitë. 216 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Rexhep/i: O Rexhep i fis i Gashit, namnë ja le bylykbashit. 333
Ristos/i: Nikulica dhe Gramosi ndë mest na rënëke Ristosi. 93 (Këngë dashurie)
Rugovë/a: Sa more bregun lumit, rashë në va të Rrogovës. 340
Ruki/eja: Hajde, haj, hank` Rukija. 110 (Këngë dashurie)
Rumelia: Rumelia u ngrit e iku. 252
Rusi : O enges, o derëzi, vure sendrë me Rusi. 312
Rustem Dibra: kahremani, sa me vrap xuni xhaminë. 296
Rrapo Hekali: Hajde, more Rrapo Hekali, kur thërret sa tundet mali! 300
Rrogozhinë/a: Qor Pashaj në Rrogozhinë. 254
Sali Rakia: Hajde, haj Sali Rakia, tash an duket trimëria. 280
Samarinë: Mbi malet në Samarinë vranë Lako Panarinë. 263
Selanik/u: Pllumbi na iku, shkoi nga Selaniku. 78 (Këngë të vegjëlish)
Selim Reçi: Dredh mustakun, ndë Vranin` do t`derthnjë gjakun. 319
Serez/i: Mustafa thërret Isuf Begun prej Serezit. 260
Sevastopul: Gjashtëdhjetë gjeneralë ndë Sevastopul u vranë. 312
Sërbi/a: Sërbin` edhe grekërinë, harruat Shqipërinë. 345
Siçan: Të përpjetën e Siçanit, vetëtti kordh`e...272
Sinan Çaushi: Ç`e priti, mun në kokët e goditit. 337
Sinicë/a: Aman përrënj me dëborë. Që Sinic` e Malishovë. 225 (Të ndryshme)
Smail Kastrati: Në Tiranë s`kam qillua nji selam Smail Kastratit. 280
Sofi/a: Që n`Ersek` e në Sofie Malzia ngriti krye. 343
Sofkë/a: Vate dielli një copë seç` na shkon milonja Sofkë. 144 (Këngë dashurie)
Sokrat/i: Thotë kapedan Sokrati: - Të mbahi, burra, të mbahi. 257
Spanjë/a: Prej asaj së zesës Spanjë. 244 (Balada)
Sparimiosë/a: Ti u bure për gumenë, në Manastir të Sparmiosë[497]. 111 (Këngë dashurie)
Spiro Buti: Spiro Buti qafëgjati. 257
Spiro Gjika: Hristo Koka ndë Vuno, Spiro Gjika Qiparo, Jano Milua himarjot, Hodo Beu borshit. 285
Spiro Himara: Këtu ta gjetëm limerë Spiro Himaren ta therë. 314
Spiro Hormova: Kostë Rrella zu thërriste, Spiro Hormova zu vise. 313
Spiro Labova: Kapedan Spiro Labova s`e leshon pallën nga dora.313
Stamboll/i: O sheh Islam` i Stambollit. 104 (Këngë dashurie)
Stamboll: Dolla ditën e shënimitrit ndë saraj të Stambollit. 249
Starovë/a: Që Hormov`e tatëpjetë ndë atë Starovën. 253
Starovë/a: Shkon e vete në Starovë. 132 (Këngë dashurie)
Stefan Prifti: Stefan Prifti shënvasiot, edhe Kumiu niviciot. 286
Sul/i: U mblodhë shqypëtarëtë iu turrë kako Sulit. 258

[497] Po aty, fq 111

Sulejman/i: Qeni lihte ham ham as e prit, o Sulejman. 78 (Këngë të vegjëlish)
Sulo Kafexhiu: Një i Sulo Kafexhiut. 216 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Sulltan Mahumti: Mustafa pash o lule, vure mbret Sulltan Mahmutin. 261
Sulltan Selimi: O pasha, sa shum` e qave si një bir, Sulltan Selimnë. 261
Shaban: Shaban/i: Shaban agën ku e keni? 283
Shalë/a: U Ndroq Shala, ra në Shkodrë..257
Shaqir/i: Shaqir agën kus ma thret? Do të çonj mbë nji hyzmet. 333
Sheh Baxhia: Mirsevjen o Sheh Baxhia! Ylyver, ju bë shtëpia.
Sheh Sejkati: Sheh Sejkati ndë Filat Zoto Mahmuti Cmokthinë. 286
Shemo: Tre pashallarë ç`u ngrinë për Shemo Gjiroksatrinë. 324
Shën Elli: Rri rri shën Ëlli[498]. 94 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Shën Mëria: Lutij zonjës shën Mëri. 71 (Këngë të vegjëlish)
Shënvasilë: Asqer dymbëdhjetë mijë të rretho(s)njën Shënvasilë. 258
Shkodra: E zeza Shkodër çka mrenda! 251
Shkumbinë: Ndë ta mba, shkoe Shkumbinë. 254
Shqiperisë: Kulshedrë e Shqipërisë. 254
Tafil/i: E shkurtër` po si Tafili. 109 (Këngë dashurie)
Tahir/i: E mban kordhënë me dhëmba, o Tahir mustaqedhjamë. 264
Tare Çuti: Bir o bir o Tare Çuti, opër ty qau Sulltan Mahumti. 272
Tatushan/i: Tatusha, moj meslangore, pse s`na rrëfen, se nga dole?138 (Këngë dashurie)
Telha beu: Vranë Telha bejnë. 216 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Tepelenë/a: Që ndë Vlorë e Tepelenë Lame Liga zu dyfeknë. 264
Testemel/i: Qesh e lot, ç`ke lule, që qanë me lot? 162 (Këngë Dasme)
Tiranë/a: Në Tiranë s`kam qillua nji selam Smail Kastratit. 280
Tise: Tise, Tis` e e mjera Tise jeniçerët i bitise. 342
Tomë/a: Iku Toma ra ndër trima. 338
Tomor: Sa lule ndë Tomor, aqe nuse ndë hobor. 89 (Këngë të vegjëlish)
Trieshtë/a: Po miri thelë frëngjinë, Trieshtën e Italinë. 142 (Këngë dashurie)
Tripoliçanë: Veli Be Tripoliçanë, të dërgon Karaiskaqnë. 257
Turqi: Që s`bënte fjala dy, të hidhenë mbi Turqi. 273
Vasil Tereziu: Vasil Tereziu i tha: na e zënëkan, o Telha. 216 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Vasiliqi: O e gjora Vasiliqibëni be për perëndinë. 273
Veis Vasjari: Kapetan Çelo Picari o shejtan Veis Vasjari. 281
Veli beu: Veli Be Tripoliçanë. Të dërgon Karaiskaqnë. 257
Velikoja: Velikoja xbrizste malit. 93 (Këngë për festat popullore të motmotit)
Veneti: Në haraç vu Venetinë. 249
Vezir/i: Ndë Korç` u bë adaleti, na u vra Dervish Ahmeti. 255
Vezir/i: Vasha me çbuk Veziri, lesht e saj si fqoll liri. 126 (Këngë dashurie)

[498] Po aty, fq 94

Vidi: Në Stamboll e në Vidin, fort po ishte qe ky trim. 110 (Këngë dashurie)
Viktoriesë: Lidhi duart'e zu vrajnë. 312
Vlorë/a: Kur më vëje mbë kurorë, po si Xhafer beu në Vlorë. 214 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Vlorë/a: Që ndë Vlorë e Tepelenë Lame Liga zu dyfeknë. 264
Vlladika: Ky bajrak, pika-pika e rrëmbeu deri Vlladika. 256
Vllahi/a: Bukureshi me Vllahinë zapëtuan Bullgarinë. 343
Vraninë/a: Dredh mustakun, ndë Vranin` do t`derthnjë gjakun. 319
Vrion/i: Kemi hall me Vriono. 198 (Këngë dasme)
Vullakë: E shkreta Vullakë, ti u bëfsh fëngjill e flakë. 206 (Kurbeti)
Vullakë: Ndë Misir e ndë Vullakë, kamilet mbajnë fishekë 294
Vuno: Hristo Koka ndë Vuno, Spiro Gjika Qiparo, Jano Milua himarjot, Hodo Beu borshit. 285
Xhafer beu: Kur më vëje mbë kurorë, po si Xhafer beu në Vlorë. 214 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Xhafer Demi: Abas beu mbet jara, Xhafer demi erth pasha. 313
Xhemil/eja: Moj Xhemil` e kujtia je? Jam e Alush Tabakutë. 118 (Këngë dashurie)
Ylqin/i: Banu burre` e shkojm` Ylqin[499]. 229 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Ylqin/i: Pashë, tapanxha floririt, mbetën begat e Ylqinit. 256
Zenel agai: Dy plumba me tel për Zenel aganë. 213 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Zenel Çareja: Zenel Çareja shah ty, kuj, kuj, kuj të keqenë[500]! (Vaje e këngë të përvajshme, 214)
Zenel pashaji: Se na vrau Zenel agaji, u thye Besim pashaji. 297
Zoto Mahumti: Sheh Sejkati ndë Filat Zoto Mahmuti Cmokthinë. 286
Zylyftar pashai: Than` u vra Majan agai, q` ish si Zylyftar pashai. 212 (Vaje e këngë të përvajëshme)
Zylyftar/i: I treti e m`i bukuri ishte i Zylyftari. 259
Zhulat/i: Mo na shkoni nga Zhulati. 253

[499] Po aty, fq 29
[500] Po aty, fq 214

IZMIT DURMISHI (TETOVË)

SHQYRTIM MBI GJUHËN E FJALËVE TË MOÇME DHE PËRRALLAVE TË THIMI MITKOS

"Bleta shqiptare" e Thimi Mitkos është padyshim një ndër veprat më të rëndësishme të folkloristikës sonë. Në të përfshihen materiale të mbledhura nga goja e popullit me plot zell nga atdhetari i shkëlqyer Thimi Mitko, ashtu siç mbledh bleta nektarin e lules. Duke mbledhur visarin e krijmtarisë popullore,edhe atë: këngë popullore, fjalë të moçme, gjëegjëza, anekdota, përralla etj., Mitkoja zgjodhi mënyrën më të mirë për t'iu përgjigjur më së miri kërkesave për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit turq.

Në këtë kumtesë do të orvatemi të trajtojmë vlerën gjuhësore të fjalëve të moçme e përrallave të Thimi Mitkos, pasi ai me kohë ishte munduar për mënjanimin e fjalëve të huaja nga përdorimi dhe zëvendësimin e tyre me gjegjëset e shqipes. Për më tepër, përmes shpjegimit të domethënies horizontale dhe pingule të përrallave e fjalëve të moçme , do të përpiqemi të nxjerrim në pah mesazhet kuptimplote të këtyre krijimeve. Punimi do të pasqyrojë njëkohësisht edhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me analizën leksikore, morfologjike, si edhe tregues të tjerë dialektor, të krijimeve që do të merren në shqyrtim.

Thimi Mitkoja bën pjesë padyshim në grupin e atdhetarëve shembullorë të kohës. Krahas De Radës, Kamardës, Jubanit etj., dha një kontribut të madh për mbledhjen e folklorit. Pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi në Egjipt, por gjithmonë me përpjekjen për të nxjerrë në pah ato këngë popullore korçare - shqiptare, historike dhe lirike, fjalë të rralla, anekdota e përralla, të cilat do të ishin përgjigjia më e mirë kundër dhunës e diktatit të pushtuesve turq.

Ai botoi veprën madhështore "Bleta shqiptare" më 1878 pikërisht në prag të Lidhjes së Prizrenit, periudhë kjo kur shqiptarët dhe "çështja e tyre" po përjetonin momente nga më të vështirat në historinë e kombit. "Bleta shqiptare" e Mitkos ishte indi që nxori në dukje veset dhe virtytet fisnike shqiptare : besën, trimërinë, dhe të drejtën për të jetuar i lirë si popull i lashtë në trojet e veta. Vepra në fjalë ishte argumeti më konkret që dëshmoi bindshëm se shqiptarët kishin gjuhën e tyre të pasur, traditën, historinë; pra kulturën e tyre burimore, përkundër pretendimeve ogurzeza të armiqve brenda dhe jashtë vendit, për t'i quajtur shqiptarët si të pakulturuar.

Lënda e trajtuar në vepër është mjaft e pasur, me çka Mitkoja dëshmon se nuk ishte vetëm mbledhës formal i traditës artistike popullore, por edhe një folklorist i vyeshëm e i përgatitur. Kjo e bëri që "Bleta shqiptare" të jetë një ndër veprat më të kërkuara të kohës ndër lexues, si dhe gurthemel për mbështetjen e letërsisë së shkruar në krijimtarinë popullore.

1. Tregues burimor të leksikut popullor të shqipes

Në kumtesën do të paraqesim kryesisht tregues të karakterit burimor të gjuhës së përrallave, fjalëve të urta apo *"të moçme"* siç i kishte quajtur Mitkoja, pra atij visari kryesor të krijimtarisë popullore në veprën e tij.

Fjalët e urta që përbëjnë një numër të konsiderueshëm në veprën "Bleta shqiptare", sigurisht se, nuk e kanë burimin të gjitha nga Korça–vendlindja e autorit, por nga mbarë trojet shqiptare. Po të analizojmë shprehjen "fjalë e urtë" do të kuptojmë një mendim të ngjeshur por të shprehur me pak fjalë. Fjalët e urta, shprehet Demush Shala[501] *"janë thënie të shkurtra që bashkëjetojnë në popull dhe pasqyrojnë urtësinë dhe përvojën e gjatë jetësore të individit"*. Nga kjo kuptojmë , se fjalët e urta shprehin mendime të thella përmes të cilave vihet në dukje urtësia, mençuria e individit të dalë nga gjiri i popullit. Populli pati kujdes të posaçëm sidomos për mendimet e gjykimet e shëndosha të njerëzve mendjemprehtë e të dalluar të një moshe e përvoje të theksuar ndër shqiptarët. Këto gjykime, vlerësime, pikëpamje e opinione , gjetën mbështetje në gjirin e popullit dhe u bënë pronë e përbashkët e kulturës sonë shpirtërore. Fjalët e urta ngërthejnë në vetvete ide të një realiteti shoqëror në periudha të caktuara. Ato i krijoi gjeniu popullor me qëllim që përvojën e vet jetësore ta përcjellë në mënyrë të organizuar gojore te brezat e ardhshëm.

Duke pasur parasysh kohën kur u shkrua "Bleta shqiptare", si dhe nivelin e lëvrimit të shqipes në atë periudhë, me gojën plot mund të pohojmë se gjuha e këtij lloji të leksikut ishte një gjuhë e pastërt burimore shqipe. Thimi Mitkoja, qysh herët kishte tërhequr vërejtjen për ruajten e shqipes nga fjalët e huaja.

Fjalët e moçme që pasqyron autori në vepër janë të shumta (afro 500), ndërkaq më poshtë po shënojmë disa nga ato, për të parë mesazhet e tyre kuptimplote dhe karakterin e tyre burimor të krijuar nga gjeniu popullor: *Ari, tek e njohin, atie vëlen. Atij i piell edhe këndesi. Ay është një njeri, që s'turbullon ujët. Bëj më o tatë, të të ngjas. Bëni udhë të ligut. Bushtërën, pa luajturë bishtin, nuk' e ndiekin qenat. Çdo mizë nuk bën mialtë. Ç'ep atë mer. Ç'farë të mbiellç, do të korç. Ç'siell një orë, s'e siell viti.*

2. Rreth statistikës gjuhësore të fjalëve të moçme

Në vazhdim po japim në mënyrë statistikore fjalët shenjuese - kryesore dhe ato shërbyese që përbëjnë fjalët e moçme të sipërpërmendura , për të tipizuar përdorimin e tyre.

[501501] Demush Shala, *Letërsia popullore*, Prishtinë, 1983, f. 435.



3. Gjuha e përrallave

Përrallat bëjnë pjesë në llojet më të njohura të tregimeve popullore të cilat i përshkon edhe fantazia. Në to rrëfehet për personazhe dhe ngjarje të çuditshme, që flasin për vise dhe kohë fantastike . Edhe pse flasin për ngjarje të çuditshme, ato në thelbin e vet mishërojnë jetën reale të popullit, ndjenjat e dëshirat e tij, luftën midis së mirës e së keqes, optimizmin popullor për të ngadhënjyer e vërteta etj. Për këtë shkak gjeniu popullor krijoi heronj me moral të lartë e të jashtëzakonshëm, që do të përballen me padrejtësitë që i shkaktonin regjimet e ndryshme.

Përrallat shqiptare përgjithësisht kanë karakter edukativ, pasi gjeneratat e hershme kanë besuar se ngjarjet e mrekullueshme që rrëfehen në to, kanë qenë të mundshme apo të realizueshme. Përrallat janë reflektim i jetës së popullit që lidhen drejtpërdrejt, sidomos me luftën e së mirës kundër së keqes. Në përralla si zakonisht rrëfehet për trimërinë, besnikërinë, mikëpritjen, besën e dhënë etj., të heronjve të jashtëzakonshëm shqiptarë,virtyte këto që i karakterizonin shqiptarët. Lufta midis së mirës dhe së keqes i ndan heronjtë e përrallave në dy grupe: negativë dhe pozitivë. Ndër personazhet negative që ka krijuar populli në përralla duhet përmendur Kuçedra, Divat, Katallani, Shejtani etj., ndërkaq si kundërpërgjigje ka krijuar edhe ato pozitive, si: Dragonjtë, Orët, Zanat, Shtojzovallet etj.

Në pjesën e parë të veprës së tij “Bleta shqiptare” Thimi Mitkoja ka përfshirë 12 përralla, ndërkaq pas vdekjes së tij, panë dritën e botimit edhe 22 fabula, anekdota e përralla me ndihmën e filologut çek Jan Urban Jarnikut në Doreshkrimin

e Pragës[502]. Jarniku ishte dashamir i shqipes dhe një nga miqtë e mëdhenj të Thimi Mitkos.

Për të analizuar gjuhën e përrallave shqipe që ka pasqyruar Mitkoja në veprën e tij, po marrim për ilustrim dy nga përrallat e tij të pjesës së dytë të përfshira në Dokumentin e Pragës.

4. Rreth domethënies horizontale dhe pingule

Plaku dhe vdekja

Një plak i rraskapiturë kish vajturë një ditë në mal për të bërë dru. Si i bëri drutë, tek s'munte të ngarkonjë, si plak i dobët, zu të psherëtinjë tue thënë: " E përse s'vien, o mort, të më març që të shpëtonj nga këto të këqija?". E morti, posa e digjoj, i erdhi plakut edh' i tha: " Ngreu, nisu, se do të të marr shpyrtin siç më thonie". Po plaku u hoth me të luturë e i tha: "Jo nuk të thirra që të më març shpyrtin, po që të më ndihësh të ngarkonj drutë ".

Përralla na mëson për rrugën jetësore plot vështirësi nëpër të cilën kalon njeriu. I lodhur nga kjo rrugë dhe mosha që po kalon, shpeshherë lutet mbrapsht. Edhe pse bën gabime në momente të caktuara, ai përsëri mundohet të gjejë zgjidhje të mençura për t'i tejkaluar problemet. Ajo që i jep forcë njeriut për t'i tejkaluar problemet e vështirësitë me të cilat ballafaqohet në përditshmëri është dashuria dhe pasioni për jetën. Jeta është e ëmbël edhe në moshë të thyer.

Nevola mëson njerinë

Një mëm' e vobegëtë dërgoj të birin, një çun të pamunduarë, herën e parë ndë mal, për të bërë dru, edh' e porositi, pasi t'i bësh drutë, t'i thërrasë nevolës, që t'i ndihnjë për të ngarkuarë. Dhe çuni vajti në mal, edhe, pasi bëri gati drutë, i thirri nevolës, po nevolë s'ka. Ashtu zuri të mentohet e të vrasë mëndëjën se si të ngarkonjë drutë. Më në funt pra i ra ndërmënt e bëri një vastangarkë për të mpështeturë njërën anë, dhe kështu ngarkoj. Kur pruri drutë në shtëpi, i rrëfeu s'ëmës se nevolën nuk e gjeti, po ngarkojti me ndihmë të një vastangarke e e ëma i tha: "Ajo është nevola, o bir".

Në përrallën e dytë rrëfehet për episode të një jete të varfër të fshatarit shqiptar. Një nënë shqiptare, e zënë ngusht nga varfëria, detyrohet të angazhojë djalin fare të ri me punë të rënda fizike, siç është prerja e druve në mal. Angazhimin e tillë të djalit që në moshë të re, e ëma e shihte si domosdoshmëri për të mbijetuar. Për ta kalitur dhe aftësuar për jetën plot peripeci, e ëma e këshillonte djalin si të veprojë në raste të ndërlikuara. Idetë e gjeniut popullor, përmes personazhit të nënës, dalin në pah kur djali e kupton përfundimisht këshillën e së ëmës, pasi ishte kthyer nga mali se, "nevoja" ishte pikërisht të menduarit, hapi që kishte bërë vet për ta zgjidhur çështjen. Përralla përcjell mesazhin se, "nuk të kruan dora e huaj, si e jotja". Duhet përveshur krahët se kush s'të ndihmon. Po prite ndihmë nga të tjerët, mund të mbetesh pa të, ashtu siç mbeti djaloshi kur e thirri "nevojën".

[502] Në Dorëshkrimin e Pragës janë përmbledhur materialet folklorike, që ka pasë lënë autori në dorëshkrim ose që janë botuar pas vëllimit të tij të njohur "Bleta shqiptare".

5. Veçori morfologjike e dialektore të përrallave

Shkurtësia e tekstit të përrallave që po shqyrtojmë nuk ka penguar përdorimin e llojllojshëm të njësive leksikore. Siç mund të vërejmë në volumin sasior të leksemave, janë përdorur pothuajse të gjitha llojet e fjalëve, duke filluar nga emri, mbiemri, përemri, nyja, numërori, folja, ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza, pasthirrma. Qofshin ato fjalë shenjuese-kryesore[503] në përrallë apo ndihmëse[504], që kryejnë funksion shërbyes të fjalëve kryesore , bashkarisht e begatojnë gjuhën e përrallave me kuptime të reja leksikore.

Në vazhdim po paraqesim një tabelë të përafërt të fjalëve kryesore dhe atyre ndihmëse, për të kuptuar gjendjen faktike të fjalëve të përmendura, si dhe kuptimin leksikor të ndonjë fjale karakteristike në përrallat e përmendura.

Plaku dhe vdekja

Nr.	Njësia leksikore	Numri i përgjithshëm
1	Emra	13
2	Mbiemra	3
3	Përemra	5
4	Folje	23
5	Ndajfolje	/
6	Nyja	15
7	Numërorë	2
8	Lidhëza	11
9	Pjesëza	10
10	Parafjala	5
11	Pasthirrma	1

Nevoja mëson njeriun

Nr.	Njësia leksikore	Numri i përgjithshëm
1	Emra	20
2	Mbiemra	2
3	Përemra	5
4	Folje	24
5	Ndajfolje	8
6	Nyja	14
7	Numërorë	6
8	Lidhëza	14

[503] Me fjalë shenjuese-kryesore këtu kemi nënkuptuar: emrat, mbiemrat, përemrat, foljet dhe ndajfoljet.

[504] Ndërkaq, me fjalë ndihmëse kemi nënkuptuar: numërorët, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat.

9	Pjesëza	4
10	Parafjala	6
11	Pasthirrma	1

Nga tabelat mund të vërejmë se, raporti i fjalëve shenjuese – kryesore dhe atyre ndihmëse është normal, sikurse edhe në llojet e tjera të krijimeve artistike në prozë.

Në aspektin dialektor mund të theksojmë se, përrallat e Mitkos, por edhe leksikun e veprës së tij përgjithësisht, i përshkon pak a shumë përdorimi i krahinorizmave dhe dialektizmave, sikurse mbarë krijimtarinë tonë popullore dhe artistike.

Në përralla hasim krahinorizmin *"vastangarkë*" që e ka kuptimin e një druri (mjeti) mbështetës në të folmet e Korçës me rrethinë. Në anën tjetër, vërejmë aty – këtu trajta të së folmes së Jugut, siç është sintagma "të më març shpyrtin"; foljen "vajti"; emrin "nevolës" etj.

Duhet shtuar se, në përrallën e dytë kemi gjetur të përdorur edhe rasën vendore të emrit*"ndë mal"* te fjalia " *herën e parë ndë mal "*. Të gjitha të folmet e shqipes kanë nga pesë rasa, si edhe gjuha standarde; përveç se Toskëria Veriore dhe Shqipëria e Mesme, kanë edhe një formë më tepër: rasën vendore.

Përfundim

Vepra e Thimi Mitkos "Bleta shqiptare" është një visar i pasur dhe i begatë. Në këtë kumtesë trajtuam diçka që ka të bëjë me gjuhën e fjalëve të moçme e përrallave. S'do mend se në një punim të tillë nuk mund të përfshihen të gjitha vlerat gjuhësore të veprës madhështore të përmendur. Bëmë një përpjekje që ka të bëjë me analizën e gjuhës, pasi jemi të mendimit se, ky lloj studimi i ndonjë teksti të shkruar, qoftë në prozë ose poezi nuk është i përhapur sa duhet. Mitkoja pa dyshim do të kujtohet ndër ne si mbledhës i rrallë i folklorit dhe krijimtarisë popullore dhe si atdhetar i shkëlqyer që u ka shërbyer si model studiuesve të ardhshëm, duke u lënë porosinë për lëvrimin e shqipes.

MUSTAFA IBRAHIMI (TETOVË)

ONOMAT NË "BLETËN SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS

Në traditën gojore të çdo populli, një element shumë i rëndësishëm që e përdor çdo njeri në komunikimin e tyre është emri. Emrat e vendeve (toponimet), emrat e njerëzve, apo emrat vetjakë (antroponimet), emrat familjarë (patronimet), përkatësitë etnike (etnonimet), nofkat, hipokoristikat etj., jo vetëm që kanë vlerë për vërtetimin e autoktonisë së një populli, por ato kanë vlerë të rëndësishme edhe për zhvillimin e kulturës së një populli në rrjedhën e ngjarjeve historike të tij. Madje ata janë një element që në njëfarë mase, tregon edhe zhvillimin shoqëror e kulturor të një populli, të një ambienti gjeografik.

Të gjitha këto shenja të krijuara dhe të përdorura si në të folurin e përditshëm ashtu edhe në hapësirën që i rrethon njerëzit, janë dokumentuar edhe në veprat folklorike, duke e bërë traditën gojore shqiptare një fushë shumë e theksuar dhe e pasur në fushën e onomastikës. Këtë tërësi të karakteristikave onomastike, duke marrë parasysh edhe variantet dialektore e hasim dendur në korpusin e materialit gojor të mbledhur nga Thimi Mitkoja, e të botuar në "Bëleta shqypëtare".

Karakteristike e këtij korpusi të emrave që i gjejmë në folklorin e Thimi Mitkos është se emrat që janë përfshirë aty, nuk kanë vetëm karakter lokal dhe rajonal, por ata kanë edhe karakter ndërkombëtar. E gjithë kjo krijon një hapësirë folklorike, e cila nuk mbështetet vetëm në homogjenitetin e një etnie të mbyllur, por në shumë raste, në motivet dhe në zhanret e ndryshme janë përfshirë emra dhe mbiemra, rajone, qytete dhe shtete të largëta që lidhen me gjuhët tjera.

Objekt studimi në këtë kumtesë, gjithsesi përbën korpusi i emrave onomastikë që e hasim në pjesën e parë të librit të Thimi Mitkos.[505] Përmbledhja përbëhet nga tri pjesë: Pjesa e parë përfshinë **"Bëleta Shqypëtare"** botuar më 1878, pjesa e dytë ***Dorëshkrimi i Pragës*** dhe ***Tekstet e botuara në gramatikën shqipe të Majerit*** dhe pjesa e tretë materiale tjera folklorike. Ne jemi bazuar vetëm në materialin e pjesës së parë, pra të "Bëletës Shqypëtare", ku Thimi Mitkoja na sjell një lëndë të pasur onomastike me gjithsej 1210 onoma të llojeve të ndryshme, prej të cilave 996 antroponime dhe patronime dhe 214 toponime. Edhe pse shumë prej tyre kanë ardhur jo të ruajtura në gjuhën e emërtimit të parë, por si përkthime në gjuhën e pushtuesit, sërish ato, gjatë shpjegimit, mbartin me vete të vërteta që duhen vlerësuar.

I. KORPUSI I ANTROPONIMEVE DHE PATRONIMEVE

Korpusi i antroponimeve dhe patronimeve në veprën "Alvaniki Melissa" (Bëleta shqipëtare), botuar më 1878 në Aleksandri, të Thimi Mitkos është shumë i

[505] *Mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II.* Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë, 1961.

madh. Gjithsej kemi evidentuar 996 onoma që lidhen me emrat dhe mbiemrat e njerëzve, që më së miri mund të shihet në tabelën e mëposhtme:

Antroponime dhe Patronime					
	Meshkuj		Femra		Gjithsej
	Mysliman	Krishterë	Mysliman e	Krishter e	
Antroponime	86	65	6	13	170
Patronime					268
Nofka					85
Hipokoristikë	37	221	44		302
Emra që lidhen me ndonjë gradë shoqërore dhe ushtarake					73
Emra që lidhen me shenjtorë fetarë	5	16			21
Trionime					10
Etnonime					67
Gjithsej					996

Sipas kësaj tabele rezulton se nga gjithsej 996 emra, më së shumti kemi regjistruar emra hipokoristike me 302 shembuj, patronime me 268 shembuj, antroponimet me 170 shembuj dhe nofkat me 83 shembuj. Me numër më të vogël janë trionimet me 10 shembuj, emra që lidhen me shenjtorë fetarë 21, etnonimet me 67 dhe emrat që lidhen me ndonjë gradë shoqërore dhe ushtarake 73. Më poshtë po japim emrat me shembuj konkretë, ashtu siç i gjejmë në përmbledhjen e Mitkos.

1. Emrat në kapitullin "Emërat vetjakë të kërshtera e mohamedane"

Thimi Mitkoja, në këtë përmbledhje, emrave u kushton një kapitull më vete të titulluar *"Emëra vetjakë të kërshtera dhe mohamedanë"*. Në fjalësin e këtij "fjalorthi" onamastik përfshirë në këtë vepër në pjesën e dytë me titull "Të përshëndoshura" gjenden gjithsej 441 emra. Në fjalorin e "Bletës shqiptare dhe shënime të tjera gjuhësore" kemi këtë përbërje:

Emra të krishterë*:** Nga 65 emra, janë përfshirë 121 variantet e ndryshme hipokoristike të tyre, Ja disa prej tyre: **Adham:** *Dhame-ja, Dhamo- ua, Çame-ja;Aleksandër:** *Lleshi-i, Lekë-a, Sandër-i, Sandër-a (f) ;***Anastas:** *Nasto, Taso-ja, Tase-ja, Stas-a, Cace-ja, Tasho-ja, Taso, Taskë, Nastë-a (f) ;***Andrea:** *Ndrio-ja, Ndreko-ja, Ndriçi, Ndruç-i, Ndrekë-a;***Angjeliqi:** *Ngjelo, Ngjelino, Ngjelikë;***Anton:** *Ndonë-a, Toqe-ja, Noi, Nou, Noc-i, Noka, Ndokë, Doni;***Apostol:** *Tolo-ua, Postol-i;***Athanas:** *Nasi, Nase-ja, Naço-ua, Nasho-ua, Thanë-a;***Athina:** *Thinë-a, Thinushe-ja;***Dhimitër:** *Dhimo-ja, Dhimash-i, Mitr-i, Mitro-a, Mitrush-i;***Ekaterinë:** *Rinë-a, Kato, Katelino, Lino-a,*

*Katrinë;***Filip:** *Filo, Lipe, Thëlip-i, (ose Thilip-i) ;***Gjergj:** *Gjergo-ja, Gjikë-a, Gjokë-a, Jorgo, Gaqo-ua, Gegë-ja, Xhoxhi-a;***Hristo:** *Risto, Lito, Kiço, Rici, Lici, Ciko, Cikë-a, Ristë;***Joan:** *Jano-ja, Jan-i, Nano-ja, Gjon-i, Gjin-i, Janko, Naqo, Vani;***Kostandina:** *Ndino, Ndile, Nine, Koto, Kotinë-a;***Llazar:** *Llazër, Lazër-i, Laçe-ja, Llazo-ua;***Maria:** *Maro, Marino-a, Mëri-a, Mrikë, Marushe, Mine, Minkë;***Petro:** *Pet-i, Peco, Petrush, Peçi, Pjero, Pjetro, Pjetri;***Sofia:** *Sofo, Fije, Sofkë;***Vasil:** *Vaso-ja, Cile-ja, Vac-i, Vaskë-a, Silkë-a;***Vasiliq:** *Cile-ja, Vashë-a, Vasilo-ja, Cilkë-ja;***Zahari:** *Zari, Zaro-ua, Zahar-i;***Viktoria:** *Vikë-a, Viktore-ja;***Visarion:** *Vito, Viko-a, Viso-a* etj.

Emrat mohamedanë janë të pranishme me 25 emra dhe 37 variantet e ndryshme të tyre: **Abidin:** *Bido;* **Adem***: Demo, Demkë;* **Ali:** *Likë, Liço, Alo;* **Emin:** *Minkë;* **Hajredin:** *Hajro;* **Hasan:** *Cane;* **Hysejn:** *Hyso, Cene-ja;* **Ibrahim:** *Braho, Brahush;* **Islam:** *Lame, Lamçe;* **Ismail:** *Malo, Malkë;* **Isuf:** *Cufe;* **Jakup:** *Jupe;* **Mehmet:** *Meço, Meto;* **Muharem:** *Remko;* **Muhtar:** *Tare;* **Mustafa:** *Mustë, Muço;* **Nuredin:** *Nure, Nurí;* **Omer:** *Mero;* **Rustem:** *Rustë, Rusto;* **Salih:** *Salkë, Saliko;* **Shemsedin:** *Sheme;* **Sulejman:** *Sulo;* **Xhafer:** *Xhafo;* **Zeqir:** *Zeqo;* **Zylyfqar:** *Zylfo;*

***Emra femrash krishtere dhe myslimane*:** Në këtë përmbledhje kemi gjetur edhe 44 emra femrash, si: *Bilo, Bodo, Çurri, Diellë, Dude, Dudi, Dhoqinë, Galo, Ganxhë, Habo, Hajdho, Hënë, Kadifkë, Koçë, Kondesë, Kondë, Korrë, Llambri, Lele, Lilo, Lono, Lule, Lulë, Malo, Nerënxë, Nicë, Noni, Paruqe, Peristerë, Qafo, Rendë, Ruçë, Simo, Sojë, Sone, Shegë, Tënkë, Tinë, Vitore, Xhinxhife, Zarë, Zogo, Zoro.*

Mbiemra familjesh 239 si: *Aleko, Alizoti, Alia, Balo, Balla, Beka, Beshiri, Brisku, Bubuli, Buja, Capo, Cara, Ceka, Çako, Çalo, Çuko, Çuli, Dakli, Dako, Dedeja, Dema, Dumi, Durro, Gallan, Gode, Guri, Gusho, Gjikondaj, Hodo, Jare, Kalanderi, Karbunara, Kaso, Koka, Kuçi, Koroveshi, Kryezoti, Kuqo,Lapa, Laro, Londo, Lulaj, Mako, Mara, Mato, Mema, Nushi, Papo, Paruca, Piperi, Pula, Pupo, Qafo, Qendro,Qypi, Ramizi, Rërësi, Sallabanda, Sara, Stamo, Shapllo, Shetro, Shkurti, Shtylla, Telo, Toska, Themeli, Veveçka, Xavara, Yrija, Zaro, Zguri, Ziko, Zoto, Zhuro* etj.

2. Antroponimet në vargjet e këngëve popullore të "Bëleta Shypëtare"

Në vargjet e këngëve popullore të **"Bëleta Shypëtare"** të Thimi Mitkos, kemi një fond të madh të emrave vetjakë të njerëzve. Marrë në përgjithësi tek emrat gjejmë të gjitha llojet e emërtimit në gjuhën shqipe nga e kaluara e deri sot. Nga studimi që kemi bërë, përqindjen më të madhe e përbëjnë emrat mashkullorë, sepse zakonisht meshkujt janë më të lëvizshëm që është bërë objekt frymëzimi të artistit popullor, i cili ka ditur ta përshkruajë trimërinë dhe bukurinë e djalit.

***Emra meshkujsh myslimanë*:** Nëpër vargjet e ndryshme të kësaj përmbledhjeje hasim 61 emra meshkujsh myslimanë, siç janë: *Abaz, Abdyl, (Abdul), Abedin (Abidin), Ahmed (Ahmet), Ali, Asllan, Avdul, Beqir, Bori, Dervish, Elmas, Feim, Habesh,Hajro, Halim, Hamza, Hasan, Haziz, Hyso, Idris, Isen, Islam, Ismail, Isuf, Kamber, Karafil, Latif, Mahmut, Mehmet, Memush, Miriallajnë, Muhamet, Muharrem, Murat, Mustafa, Myftar,Myhyrdar, Mylazim, Nazif, Omer, Rakip, Ramë, Resul, Rexhep, Rushit, Rustem, Salih, Sali, Selim, Selman, Shaban, Shahin, Sherif, Sulejman, Tahir, Veli, Veis, Xhemil, Ysen, Zylyftar.*

Emra meshkujsh të krishterë: Për shkak të vështirësisë, disa emra jepen me hipokoristikat e tyre, gjithsej 67 shembuj: *Aliko, Avram, Çelo, Cokë, Dhimarhiu, Dhimitraq, Drako, Dukë, Dush, Farmaqi, Gjon, Gogua, Griva, Harisi, Hristo, Igumeni, Ilia, Ivani, Jak, Jani, Jano, Kakaranxhë, Kallapodhi, Karaiskaq, Karaiskua, Kardhiqotë, Kërxhalli, Koçodhulë, Konstandi, Konstandin, Kosta, Kostandinë, Kostaq, Kostë, Kurt, Lepenjoti, Lima, Lluka, Mallakof, Mangananë, Marko, Maza, Meçan, Mecoviti, Mençikof, Nikë, Nikolla, Nikollau, Niqita, Notaranë, Nule, Ollani, Pano, Papakosta, Petë, Pilo, Polo, Postoli, Qiriako, Rrapo, Serdari, Sokrati, Spiro, Thodhor, Thodhoraq, Toma, Vasil.*

***Emra femrash myslimane*:** Antroponimet femërore myslimane janë më të pakta, vetëm disa emra: *Adile, Gjikë, Hava, Mahmudie, Mine, Rukije.*

***Emra femrash të krishtera*:** Emra femrash të krishtera që i gjejmë në vargjet e këngëve popullore janë: *Apostoleja, Bubullina, Gjikë, Janaqa, Konstandinika, Leonidha, Nataçnë, Ngjelina, Pisqolla, Sofkë, Vasiliko, Vasiliqi, Viktoria.*

3. Patronimet në vargjet e këngëve popullore të "Bëleta Shypëtare"

Në përmbledhjen "Bëleta Shypëtare" të Thimi Mitkos, hasim edhe shumë mbiemra familjarë dhe fisesh të personave të caktuar. Ndër ta, më të rëndësishëm janë mbiemrat: *Hysa, Alijaj, Asllani, Bushati, Çausholli, Desho, Dudë, Shkreli, Zado, Ndreu, Xhemi, Prodani, Xhafua, Gashi, Leka, Lapi, Progoni, Rella, Leshi, Kosta, Boçari, Suli, Suljoti, Kuçi, Hekali, Peci, Hasani, Kastrati, Gjika* etj.

4. Format hipokoristike të emrave mashkullor dhe femëror

Një numër i madh të emrave mashkullorë dhe femërorë, qoftë të krishterë apo myslimanë në këtë përmbledhje janë shënuar edhe në format e tyre hipokoristike. Një pjesë shumë të madhe të varianteve apo emrave hipokoristikë, Thimi Mitkoja i ka shënuar edhe si studim (shih nëntitullin 1), ne po paraqesim edhe disa që i hasëm nëpër vargjet e ndryshme në "Bëleta Shqipëtare", siç janë: *Bido* (<Abedin); *Demo* (<Adem); *Fejzo* (<Fejzullah); *Foto* (<Theofan), *Kolë* (<Nikolla), *Lekë* (<Aleksandër), *Meço, Mem, Meta* (<Mehmet); *Musta dhe Tafil* (<Mustafa), *Norka* (<Elonora), *Smail* (<Ismail), *Sule* (< Sulejman), *Mine* (<Maria por edhe Emine) etj. Një numë i emrave hipokoristikë të panjohura për autorin: *Guçe, Hajçe, Jaçe, Lamçe, Lino, Puçe, Lina, Toma, Hodo, Ferro, Nino, Kiço, Desho, Jan, Veso, Dhosi, Çun, Zoto* etj.

5. Nofkat në vargjet e këngëve popullore të "Bëleta Shypëtare"

Duke u mbështetur në klasifikimin e nofkave që kemi bërë, sipas vetë autorit[506], nofkat e përdorura në përmbledhjen "Bëleta Shqypëtare" të Thimi Mitkos, përbëjnë një nga elementet më të pasura onomastike të shqipes, ata mund të grupohen si më poshtë:

1). Nofka që janë krijuar sipas pamjes së jashtme të trupit*: Mustaqeverdhë* (<Myhyrdar); Sipas fizionomisë së fytyrës nofkat mund të jenë ata që kanë për bazë

[506] Ibrahimi, M., *"Pasqyrë e nofkave si pagëzime popullore ndër shqiptarët e Prilepit".* Në *Interpretime dhe studime gjuhësore.* Shkup, 2003, f.51-62.

fjalën **buzë:** *Buzëkarafileja, Buzëmustaqeziu* (<Tafil) **,** *Buzëqengjerusheja;* **kok(ë):** *Koka* (Hristo); **qafë:** *Qafëgjati* (<Spiro-Buti), *Qafezezli;* **kurriz:** *Kurrizdalë* (< Nule); **hundë:** *Hundëçoviti* (<Jano); **faqe:** *Faqe-kuqeja, Faqe-tolopuçeja*.

2). **Nofka të formuara nga ndonjë të metë trupore:** *Çollaku* (<Rexhep), *Qorri, Çelo* (<Mehmeti).

3). **Nofkat me karakter më të dukshëm keqësues (pejorativ):** *murtajëmadhi* **(<**Aliko);

4). Sipas profesioneve e zanateve: *Kallanxhiu , Çobani,*

5). Vendin që e zë në hierarkinë shtetërore, ushtarake ose fetare: *Qihaja* (<Ramë), *Magjor* (<Lima kordh shpata), *Prifti* (<Çaush), *Mutalipi* (<Sherif), *Resulë (<Progani)*;

6). Nofka sipas figurave mitologjike: *Eshderi* "Kulçedra", (< Ali-Eshderi), *Çirosi.*

7). Nofka të fituara sipas përkatësisë nacionale ose fisnore: *Arapi* (<Ali, Hyso Arap Shahini); **Vlashi** "vllah"(<Jano), *Gega* (<Shaban), *Rabiani* "Arbani"(< Hanko), *Kastrati* (<Smail), *Kuçi* (< Osman)

8). Nofka të marra nga sfera e toponimeve: Selenica (<Laze), *Tivari* (<Ago), *Labova* (<Spiro*), Dukanjin* (<Myrto) që na kujton toponimin Dukagjini*, Dibra* (<Rustem), *Picari* (<Çelo), *Golemi* (< Çun), Lapi (<Myftar), *Grebeneja* (<Veli-aga), *Himarioti* (<Spiro), *Himarra (<*Spiro), *Korça* (< Spiro), *Delvina* (<Shahin), *Boçari* (<Marko) etj.

9). Emra familjarë që burojnë nga nofkat: *Cokë Dima, Cokë Mura, Jano-Milua*

10). Nofka të krijuara nga emrat e kafshëve (zoomorfe): Këto janë emërtime metaforike, d.m.th. emra kafshësh të ndryshme pas të cilëve nënkuptohen cilësitë përkatëse të njerëzve, si p.sh në: *Çakalli* (<Mustafa), *Derrë* (<Turk), *Xhagajdhuri* (< Beqir), *Bilbil* (<Sako).

11). Nofka të fituara nga shkaqe të ndryshme: Nofkë e formuar sipas një artikulli ushqimor që më shpesh e ka përdorur personi ***:*** *Rakia* "njeri që pi raki" (<Sali); nga vegla për punë, ushtarake.. ***:*** *Shpata* (<Rexhep); nga asortimane të ndryshme: *Dukati* (<Elmaz)

12).Emra dhe llagape të arbëreshëve të Greqisë. Në pjesën e dytë të librit "Dorëshkrimi i Pragës" janë përfshi edhe 33 llagape (nofka) si: *Belec-i, Beno-ua, Bricë-a, Bëricë, Bulë-a, Çakall-i, Çallë-a, Çam-i, Çelo-ua, Çullë-a, Dervish-i, Karaçol-i, Kocir-i, Kokëzëa, Kollombos-zi, Koros-zi, Kricë ose Këricë-a, Lanës-i, Lasko-ua, (lazaros), Leco-ua, Makul-i, Nikë-a, Paqë-a, Pepë-a, Sallapata, Suflë-a, Cuflë-a, Vito-ua, Xhakristo-ua, Xhavellë-a, Zurë-i*.[507]

6. Emra që shoqërohen me ndonjë gradë shoqërore ose ushtarake

Në këngët lirike antroponimi, zakonisht qëndron i vetëm, pra i pashoqëruar me fjalë të tjera, por ndodh që pranë antroponimit të vendosen ndajshtesa sqaruese a vlerësuese. Për meshkujt janë titujt: **sulltan (2), pashë (26), vezir (1), çaush (2), beg (24), aga (6), kapedan (9), bajraktar (2), vojvodë (1):**

Sulltan: *Sulltan Mahmuti, Sulltan Selimi*

[507] *Mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II.* Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë, 1961, f.269.

Pashë: *Abdulla Pasha, Abdyl Pasha, Ali Pasha, Kurt Pashë Berati, Mahmut pasha,* Mehmet pasha, Mustafa Pasha, Musta-pasha, Myftar Pasha *Ahmet Pashë, Ali Pashë Janina, Ali Pashë Tepelena, Ali-Pashë, Avzi-pasha, Dervish Pasha, Frenk Pasha, Gordon Pasha, Hafuz-pasha, Hasan pasha, Ibrahim Pasha, Myftar-pasha (i biri i Ali Pashës), Osman pasha, Qorr pasha, Reshit pasha, Shkodran-Pasha, Qorr Ibrahim (Pasha i Shkodrës)*

Vezir: *Vezir Ali,*

Çaush: *Çaush Prifti, Çaush-Hormova*

Beu: *Kostaq beu, Mahmut beu, Meço beu, Mehmet bej Vlora, Mehmet beu, Musta beu, Abedin beu, Ali-beu, Asllan Beu, Bori be Feimi, Halim beu, Hamza beg, Hodo beu, Islam-beu, Ismail beu, Isuf – be Berati, Isuf beg, Isuf Beu, Omer-benë, Rakup beu, Shasho beu, Veli Beu, Ysen Beu, Karafil Beu.*

Aga: *Hamza –aga, Omer ago, Selim-aga, Shaban aga, Veli-aga, Veli-agai*

Kapedan: *Marko Kapedani, Kapedan Konstandi, Kapedan Sokrati, Kapedan Delijani Mecoviti, Kapetan Çelo Picari, Kapetan Leshi, Kapetan Polo, Kapetan Spiro Labova; Kapitan Kiç-Andoni.*

Bajraktar: *Mustafa Bajraktarë, Dush -Bajraktarë,*

Vojvoda: *Myftar Vojvoda*

7. Emra që shoqërohen me ndonjë emërtesë fetare

Emërtesa të fesë myslimane: *Sulltan-Nevruz , Sheh-Islam, Allah, Mulla Velia, Sheh Sejkati*

Emërtesa të fesë krishtere: *Aja Sofija (Shën Sofia), Shën Gjini, Shën Iliu, Shën Llazëri, Shën Mëhilli, Shën Mëria, Shën Mitri, Shën Nikolli, Shën Pjetrë, Shën Spiridhonë, Shën Vasil, Shën Vasjo, Krishti, Peperona, Vangjelizmoi, Vlladika.*

8. Trionimet

Me rëndësi për antroponiminë shqiptare janë edhe trionimet (përbërja e emrave personalë shqiptare prej tre emrash). Kjo kategori emrash është mjaft e pranishme në përmbledhjen "Bëleta Shqypëtare të Thimi Mitkos. Ndonëse në numër të kufizuar, këto patronime kanë përhapje shumë të gjerë. Kemi gjetur këta trionime: *Hyso Arap Shahinë, Marko Boçari Suljoti, Ali Pashë Tepelena, Ali Pashë Janina, Kurt Pashë Berati, Bori be Feimi, Kapedan Delijani Mecoviti, Kapetan Çelo Picari, Kapitan Kiç-Andoni. Ali Feim Çami.*

9. Etnonimet

Në përmbledhjen "Bleta shqiptare" të Thimi Mitkos, vend të rëndësishëm zënë edhe disa emra me të cilët emërtohen vetë banorët sipas vendbanimit të caktuar, të njohura si etnonime. Ky material ka rëndësi të madhe për etnolinguistikën shqiptare, sepse Mitkua i ka mbledhur drejtpërdrejtë nga goja e popullit.

Etnonime që lidhen me emërtimin e një populli ose grupi etnik: Më të shpeshta janë disa shprehje me onomitë e atyre popujve me të cilët ekzistojnë kontakte të afërta dhe të shumta, para së gjithash me popujt **sllav** (që emërohen me termin **kaur** dhe disa variante tjera), si: *kahurë, krishterë, kërshterëtë*; për turqit: *turq, turkoshakë, turqëri;* për boshnjakët *boshnjalli* dhe për romët takohet etnonimi

jevgjë, moskovi për popullin rus. Në përmbledhjen e Thimi Mitkos kjo dukuri është e pranishme edhe me banorë të shteteve më të largëta siç janë etnonimet: *arap, englez, francez, vlleh, çifutë* dhe *judh* .

Përveç etnonimeve që lidhen me shtete të caktuara, hasim edhe etnonime që lidhen me krahina ose perandori, si: *osmanllinë* (si dhe varianti *osmallinë)* , *bishbish* (emër i familjes mbretërore të Abisinisë), në një etnonim kemi edhe një rast që lidhet me një krahinë franceze, siç janë: *normanët.*

Në mënyrë të veçantë hasen edhe etnonimet që si gjymtyrë kanë variantet që lidhen me shqiptarët, si: *shqypëtarë, arnaut, arvaniti,* si dhe *gegë, toskë* dhe *lap(b).*

Etnonime që lidhen me emërtimin e banorëve të një vendi, fshati krahine apo qyteti: *ambellaqotë* (fshat i Kretës), *borshiot, delvinjot, dibran, dranjot, shkupjan, dishniçar, himarriot, hormovitë, hoshtaviat, flomovit, kalasiot, katerinë, kolonjar, kopaçot, korçarë, konicot, labër, labotit, lariot, lëkurisiot, lukoviot, lushnjarë, matian, mesojatët, mirëdita, morritë (More), manjatë (Manis – Peloponez), myzeqar, niviciot, piqerasiot, poliçanjot, skorovit, sopiçot, shën-vasiot, shkodran, shkodranesh, ylqinjlijtë, ylqynakë, zharkanjlijtë (f.Zharkanj – Kolonjë), zhejotët,*

Etnonimet dhe paragjykimet

Në disa vargje të këngëve popullore të mbledhura nga Thimi Mitko, përveç emërtimit të banorëve të një vendbanimi të caktuar, përdoren edhe paragjykime që janë karakteristike për emërtimin midis banorëve të një fshati me fshatin tjetër, ose janë të njohura në një rajon të caktuar. duke u konsideruar ndoshta si paragjykime të para në gjuhën shqipe. Disa nga këto paragjykime lidhen me mostolerancën provinciale ose dallimet gjuhësore.

Kështu në një këngë të mbledhur nga Thimi Mitkoja, theksohet se vendet **Sinicë** dhe **Malishovë** janë goricë e mollë, **Zhejotët** janë ca kallënxhinj, **Lariotët** të varfër, fshati **Bythuq** është vetëm dhjetë shtëpi, **Hoshteviatët** nuk i di, **Konicotët** shalë-dema, **Labovitët** krejt shkarpa e lajthi, **Dranjotët** janë kujunxhi, **Poliçanjotët** janë xhigerxhi, **Skorovitët** Stambollij, **Sopiqotët** janë sqeparxhij, **Flomovitët** janë këlqerexhij.[508]

II. KORPUSI I TOPONIMEVE

Për dallim nga antroponimet dhe patronimet, toponimet lindin shumë rrallë dhe kanë jetë shumë të gjatë.

Pothuaj të gjitha qytetet shqiptare, si Durrësi, Shkodra, Vlora etj., janë po ato (me ndonjë ndryshim të vogël fonetik)! Kështu gjatë tërë krijimtarisë gojore në gjuhën shqipe janë krijuar shumë pak emra vendesh. Këngëtari popullor për të krijuar këto emërtime është mbështetur në fondin e leksikut vendas.

Oikonimet (emrat e qendrave të banimit: qytete, lagje, katunde etj.). Takohen më shpesh se çdo emër tjetër vendi, meqë qendrat e banimit krijohen kohë pas kohe në përshtatje me nevojat e komuniteteve të ndryshme dhe me zhvillimet e mundshme

[508] Th.Mitko. "*Bëleta Shypëtare"* . Në *Mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II.* Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë, 1961. f.40-41.

ekonomike të zonave të caktuara. Më poshtë paraqesim tabelën që e ilustrojnë këtë dukuri në përmbledhjen "Bëleta Shqypëtare" të Thimi Miktos, me rreth 214 toponime të ndryshme.

Toponime							
Emra	Shqipëri	Kosovë	Maqedoni	Greqi	Mali i Zi	Tjera	Gjithsej
Shtete						24	24
Qytete	17	1	5	2	2	32	59
Krahina	17	3	4	1	/	2	27
Fshatra						54	54
vende	15	/	/	2	/	3	20
Mikrotoponime	14						14
Hidronime	2					6	8
Oronime						8	8
Gjithsej	65	4	9	5	2	129	214

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, shihet qartë se kemi toponime të ndryshme nga të gjitha trevat ku banojnë shqiptarët, si nga: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, dhe Greqia. Më së tepërmi gjejmë qytete (me 59 emërtime), fshatra (me 54 emërtime), krahina 27 dhe vende 20 shembuj. Me numër më të vogël përfaqësohen mikrotoponimet me 14 shembuj, dhe hidronimet dhe oronimet me nga 8.

Sipas madhësisë së vendeve që emërtojnë, këto emërtime grupohen si më poshtë:

Emra shtetesh: Në përmbledhjen e Thimi Mitkos, hasim një numër të konsiderueshëm shtetesh, siç janë: *Allamanja* (<Gjermania), *Anglia, Arapistani, Arbëria, Axhemia* (Persia), .*Bosnja, Ermenia*, *Franceza dhe Frëngjia* (<Franca)*, Greqia, Italia, Kahuristani, Mali i Zi, Misiri* (<Egjipti)*, Magjaria (*Hungaria), *Osmanllia, Rusia, Shqipëria dhe Shqypëria, Spanja, Sudia* (<Suedia), *Turqia, Venetia, Vllahia*.

Emra qytetesh: Qytetet që pasqyrohen në këtë libër, janë nga trevat e ndryshme shqiptare në Ballkan, ato zakonisht përmenden për shkaqe të ndryshme ekonomike, politike dhe kulturore. **Ndër trevat ku jetojnë shqiptarë, përmenden:** *Berati, Delvina, Devolli, Dibra, Durrësi, Elbasani, Filati, Gjakova, Argjira (Gjirokastra), Himarra, Janina, Kavaja, Korça, Manastiri, Mati, Ohri, Përlepi, Përmeti, Qiparoi, Rrokozhina, Selenica, Shkodra, Shkupi, Tirana, Tivari, Avuona (Vlora)* dhe *Ylqini.*

Ndër qytetet dhe lagjet e huaja, përmenden qytetet*: Armero* (në bregdetin e Thesalisë), *Anthinë dhe Athinë, Beligradi, Budini* (Budapesti), Bullaka (Vullaka – lagje në Kairo), *Dymeqea* (Thesali), *Edrene, Geda* (Arabi), *Grebenea (Greqi), Filati* (Çamëri), *Halepi* (Siri), *Kallabaka (Thesali), Kairë, Karpenisi* (Greqi), *Karsi* (Armeni), *Konia (Siri), Korfuzi, Margelliçi* (qytet i Çamërisë), *Mecova (Janinë), Moskof, Musova* (Abisini-Eritre), *Nebaht (Turqi), Negozhdi (Maqedoni – i prishur), Livadhi (Beoti), Qytah, Plevna* (Bullgari), *Sana (*Jemen), *Selenik, Sevastopuli, Stambollë, Triesht, Vidin.*

Emra fshatrash: Edhe fshatrat janë shumë të pranishme në përmbledhjen e Thimi Mitkos, në të shumtën e rasteve nga jugu i Shqipërisë, Çamëria dhe Greqia. Janë pasqyruar këto fshatra: *Andruci, Avariku, Belen, Bozhigradi (f.Devoll),* Bolena (f.Kurvelesh), *Bubarinë, Cmokthinë, Dranjovë, Dhjavati (f.Thesali), Flomovë, Hormovë, Horshi, Hoshtevë, Kamenica (f.Korçë), Kanina (f.Vlorë) Kallarati, Konicë, Kuçi (f.Kurvelesh), Fener (Greqi), Labovë, Lari, Leskovik, Malinat (f.Berat), Meçovë, Melenik, MIlacë, Musovë, Nivicë, Omer, Orope, Pagarusha (Kosovë), Palabardhi, Palavli (Delvin), Poliçan, Picari, Qafëzezi, Rrehovë, Rahova (Beoti), Shën vasalë, Siçani, Sinicë, Sinjë (Mallakastër), Skorovë, Slimnica (f.Follorinë), Smokthinë, Starovë (Pogradec), Shurpi (f.Livadhi), Vraninë, Velabishti* (f.Berat), *Vuno, Vuvosa (f.Greqi) Zhejotë, Zhulanë, Zhulati (f.Gjirokastër).*

Emra krahinash: Në përmbledhjen e Thimi Mitkos, hasim disa krahina që sot gjenden në shtete të ndryshme ballkanike, por ku kanë jetuar ose ende jetojnë shqiptarë, përmenden: *Çamëria, Devolli, Dukagjini, Dymeqena, Fani, Gramozi, Hormova, Karadaku, Kolonja, Kurveleshi, Labëria, Lunxhëria, Malisheva, Mallakastra, Mirëdita, Moreja, Nafpakto, Nebahti, Palopogoni, Pelagonia, Prespa, Podrina (Prizren), Reka, Rumelia, Tepelena, Toskëria, Velebishta*

Emra vendesh: *Adresë, Bab el Luh, Barbëllutë, Barburi, Buninë, Haoni, Kako-Sulë, Kallabakë, Kaninë, Karbeneshi, Komboti, Ksillohuar, Lëthariç, Makrinorë, Mersinë, Nebaht, Shurp, Tripoliçan, Vuno,*

Mikrotoponimet: Në trevat ku banojnë shqiptarët takohen gjithandej emërtime njësish të vogla topike të emërtuara me fjalë nga leksiku i shqipes. Në "Bëletën" e Thimi Mitkos, hasim këto mikrotoponime: *Arë Bakalle (top.), Gurë, Han i Valaresë (fushë në Gjirokastër), Karbunarë, Kullat e Qarit, Llak' e Sulit (top), Melesini (mal), Qaf' e Koresë, Qafë-Kërrabë, Shoteli (pyll), Tomori, Udha e Kolonjësë, Ura e Kastarqit, Misollongji (fushë), Tinglimaimun* (toponim që ndeshet në përralla),

Oronimet: Janë përfshirë edhe disa emra malesh, si: *Agrafa* (mal në Thesali), *Erzegovina* (tur.Ercek – krahinë malore), *Grivica* (mal pranë Plevnës), *Hoshteviatet* (mali i Hoshtevës- Zagori), *Makrinori* (vargmale në Çamëri), *Malakof* (kodër në Krime), *Samarina* (male në Greqi), *Suli* (krahinë malore në Çamëri)

Hidronimet: Kanë përdorim të kufizuar në tekstet e këngëve popullore, sepse zakonisht hidronimet lidhen vetëm me të keqen dhe tersin. Nga hidronimet lumenjtë pasqyrohen me katër shembuj: *Shkumbini, Mati, Dunaveci* (lumë në Korçë) dhe *Tiza* (lumi i Hungarisë), një ishull *Korfuzi* dhe tre porte: *Abukiri* (skelë në Aleksandri), *Bender* (port në Moldavi), *Modhoni* (port në More).

Përfundime

Pas analizave të shumta, mund të themi se në përmbledhjen "Bëleta Shqypëtare" të Thimi Mitkos, gjejmë një material shumë të pasur onomastik si një dëshmi e qartë e kokëfortë e pranisë së shqipes e të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Emrat e viseve, njerëzve, bashkë me emrat familjarë i gjejmë dendur në krijimet gojore lirike, frazeologjizmat, fjalët e urta, përrallat, gjëegjëzat dhe zhanre të tjera folklorike të përmbledhura në veprën e Mitkos.

Hulumtimi është bazuar vetëm në materialin e pjesës së parë, pra të "Bëletës Shqypëtare" të Thimi Mitkos, që pasqyron një lëndë të pasur onomastike me gjithsej 1210 onoma të llojeve të ndryshme, prej të cilave 996 janë antroponime dhe patronime dhe 214 toponime. Nga antroponimet më së shumti kemi regjistruar emra hipokoristike 302 shembuj, patronime me 268 shembuj, antroponimet me 170 shembuj dhe nofkat me 83 shembuj. Me numër më të vogël janë trionimet me 10 shembuj, emra që lidhen me shenjtorë fetarë 21, etnonimet me 67 dhe emrat që lidhen me ndonjë gradë shoqërore dhe ushtarake 73. Toponimet janë të pranishme me 214 shembuj të ndryshme nga të gjitha trevat ku banojnë shqiptarët, si nga: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, dhe Greqia. Më së tepërmi gjejmë emra qytetesh (59 emërtime), emra fshatrash (54 emërtime), krahina (27), shtete (24) etj. Me numër më të vogël përfaqësohen mikrotoponimet (14), hidronimet dhe oronimet (me nga 8).

Disa emra kanë peshë historike, sepse zbulojmë funksionet, veprimet dhe të arriturat e tyre, duke luajtur edhe rolin e dokumentit historik në bazë të të cilave mund të konstatohen ecuritë shoqërore në periudha të caktuara. Ky material që sjell Thimi Mitkoja në një farë mënyre rifreskon kujtesën qytetare për një numër të madh emrash, mbiemrash, nofkash, toponimesh etj., që janë përdorur në të kaluarën, me qëllim që ato të njihen edhe nga brezat që vijnë, që jo vetëm t'i përdorin, por edhe të dinë vendndodhjet dhe domethënien e tyre. Në këtë mënyrë kjo vepër ndihmon në lidhjen e ngushtë të onomastikës me historinë e gjuhës shqipe, ndaj jo më kot, antroponimet dhe toponimet janë cilësuar si "përmendore të kujtesës njerëzore" që kërkojnë sa më shpejtë të mblidhen, evidentohen dhe të pasqyrohen në fjalorë të caktuar.

SENAD NEZIRI (PRISHTINË)

HABITORJA E SHQIPES NË VEPRËN E THIMI MITKOS, KRAHASUAR ME GJUHË TË TJERA TË BALLKANIT

.

Hyrje

Objekti i hulumtimit, për temën në fjalë, do të jetë përmbledhja "Bleta shqiptare" e Mitkos dhe format e habitores të gjuhëve të ballkanike, sipas ballkanologëve. Ndërsa, qëllimi i hulumtimit është, evidentimi i habitores dhe formave të saja në përmbledhjen e Mitkos, ku do t'i evidentojmë të gjitha rastet të përdorimit të habitores, mënyrën e përdorimit të habitores dhe dendurinë e përdorimit të kohëve të habitorës. Rastet e formave të habitores nga gjuhë të tjera ballkanike do t'i analizojmë dhe do të tentojmë t'i japim përkimet e shqipes me përdorimet në gjuhë të caktuara ballkanike.

Punimi është përgatitur për nder të 195-vjetorit të lindjes së Thimi Mitkos, me këtë rast në Korçë është organizuar Konfernca shkencore ndërkombëtare. Titullin e temës në fjalë e kemi formuluar në bashkëpunim me prof. dr. Ali Jasharin – dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, përmes postës elektronike.

Për të arritur deri te rezultati i habitores së shqipes në veprën e Mitkos, në këtë rast në përmbledhjen "Bleta shqiptare" dhe përdorimin e saj edhe në gjuhët e tjera të Ballkanit, kemi shfrytëzuar përmbledhjen "Bleta Shqypëtare" të Thimi Mitkos, të cilën e përshkroi, përktheu në shqip dhe e radhiti Dr. Gjergj Pekmezi më 1924 në Vjenë, pra, nuk është fjala për botimin e veçantë i botuar si "Vepra" e Mitkos nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, por fjala vepër, në këtë titull, nënkupton njërën prej veprimtarive të Mitkos. Nga kjo përmbledhje, të cilën ne e kemi pasur në dorë si material i kopjuar, ku në disa faqe nuk ishin mirë të dukshme vargjet e shënuara, për të cilën arsye, ndoshta mund t'na ketë ikur edhe ndonjë rast tjetër ose formë e habitores, e kemi hulumtuar habitoren dhe format e saj në krerët e këngëve, si: *Kënga të motshme. Aligorike dhe komike*; *Kënga që këndohen ndër disa ditë të shënuar*; *Kënga shqype dasëmore*; *Kënga dashurije*; dhe *Kënga shqype trimërishte*. Shembujt i kemi ndarë në kuadër të krerëve të këngëve dhe për çdo shembull kemi dhënë të dhënat e referuese, si autorin (Mitko), shkurtesën e përmbledhjes Bleta Shqypëtare (BSh) dhe faqen se ku e kemi gjetur vargun me formën foljore të habitores. Siç thamë, përmbledhjen e patëm një variant të kopjuar nga origjinali i vitit 1924, prandaj për këtë arsye nuk kemi pasur mundësi ta lexojmë e ta hulumtojmë habitoren edhe në pjesën tjetër të përmbledhjes. Për shpjegimin e habitorës në sferën e përgjithshme të shqipes, kemi konsultuar literaturën akademike që e trajton problemin e habitores në pikëpamjet e ndryshme.

Krahasimin e habitores me gjuhët e tjera të Ballkanit, më së shumti, e kemi bazuar në materialet e botuara nga gjuhëtarë që janë marrë ose merren me hulumtimet e ndërsjellta të gjuhëve ballkanike, por në disa raste, kemi shfrytëzuar

edhe përmbledhjen e Mitkos për të treguar moshën ose formën e habitores në shqipe.

2. Habitorja, format kohore dhe kuptimi i habitores

Gjuha shqipe gjatë evolucionit të saj historik ka krijuar edhe disa forma foljore, nëpërmjet të cilave shprehet kryesisht habia e folësit për një veprim (a gjendje) të papritur, që është kryer në të shkuarën ose që është në të kryer e sipër në çastin e ligjërimit[509], dhe përpos këtyre edhe modaliteti i vërtetësisë[510]. Ndërsa, Topalli[511], përpos këtyre tipareve, shton se në të folmen popullore këto forma mund të shprehen edhe me veprime që zhvillohen ose janë zhvilluar, pa u shprehur ndonjë qëndrim i folësit, domethënë si një formë treguese duke u përdorur në vend të së pakryerës ose të kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore. Këto forma foljore, që në gramatikat e gjuhës shqipe janë grupuar në një mënyrë më vete të quajtur habitore, përdoren relativisht dendur edhe për të shprehur një qëndrim ironizues, mosmiratues, kundërshtues të folësit (Demiraj,[512]; Riza[513]; Gramatika 1[514]).

Habitorja në kuptimin e mirëfilltë të habisë, përdoret në fjali të pavarura ose kryesore, kurse me kuptimet e tjera (shih Demiraj 1988: 905, shemb. B) përdoret më fort nëpër fjali të varura, nëpërmjet të cilave zakonisht riprodhohen fjalët e një tjetri, me të cilat folësi nuk pajtohet. Natyrisht me kuptimin e dytë habitorja mund të përdoret edhe nëpër fjali të pavarura ose kryesore me intonacion pyetës ose thirrmor (Demiraj; [515]Gramatika 1[516]).

Tema e habitores së tashme ndërtohet mbi bazën e formës së pjesores. Por, në disa folje, për shkak të vështirësive që krijohen nga ndeshja e formës së pjesores me format e foljes *kam*, habitorja ndërtohet nga një temë që përkon me të tashmen, si: *punúakam*, *punúakemi*[517] ,ndërsa, Riza[518] e shton edhe paskajoren. Pra format e habitores ndërtohen duke i paravendosur dhe prapavendosur pjesores së foljes ndajshtesat e foljes ndihmëse *kam*.

Nëpër gramatikat e gjuhës shqipe janë pranuar si më të gjalla format foljore të kohës së tashme (*hapkam*) dhe të së shkuarës (*hapkësha, paskam hapur dhe paskësha hapur*). Por në disa nga këto gramatika është vënë në dukje se aty-këtu edhe format e mbipërbëra të tipit *paskam pasë hapur* dhe *paskësha pasë hapur*, si

[509] Sh. Demiraj, "*Gramatika historike e gjuhës shqipe*", Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 905; Sh. Demiraj, "*Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I dhe II*", Prishtinë, 1980, f. 324.
[510] "*Gramatika e gjuhës shqipe 1*", AShSh, Tiranë, 2002, f. 318.
[511] K. Topalli, "*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*", QSA, Tiranë, 2011, f. 829.
[512] Demiraj, Shaban (1988). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
[513] S. Riza, "*Vepra 2"*, AShAK, Prishtinë, 1997, f. 133, 461.
[514] Gramatika 1 (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe*, AShSh, IGjL, Tiranë.
[515] Demiraj, Shaban (1988). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
[516] Gramatika 1 (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe*, AShSh, IGjL, Tiranë, fq.319
[517] K. Topalli, "*Gramatikë historike e gjuhës shqipe*", QSA, Tiranë, 2011, f. 834-835
[518] S. Riza, "*Vepra 4*", AShAK, Prishtinë, 2004, f. 150.

edhe format e së ardhmes së tipit *do të hapkam* dhe *do të hapkësha* e në ndonjë rast edhe *do të paskësha hapur*[519].

Habitorja në gjuhën standarde shqipe ka kohën e tashme dhe kohën e shkuar, zgjedhimin vepror dhe jovepror.[520]

Koha e tashme e mënyrës habitore ndërtohet duke i prapangjitur pjesores së shkurtër të foljes ndajshtesat *-kam, -ke, -ka* (njëjës) dhe *-kemi, -keni, -kan* (shumës), p.sh.: *la-* (*kam, ke, ka, kemi, keni, kan*).

Koha e shkuar ka:

1.Kohën e pakryer e cila del me forma sintetike të përftuara duke i prapangjitur pjesores së shkurtër të foljes ndajshtesat *-kësha, -kështe, -kësh -kej* (njëjës) dhe *-kështim, -kështit, -kështin* (shumës). Këto kanë dalë nga format vetore të së pakryerës së ndihmëses *kam*. p.sh.: *la-(kësha, kështe, kësh, kështim, kështit, kështin)*;

2.Kohën e kryer e cila ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të kohës së tashme habitore të ndihmëses *kam*: *paskam* (*paske, paska, paskemi, paskeni, paskan*) *larë*;

3.Kohën më se të kryer e cila ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së pakryerës habitore të ndihmëses *kam*: *paskësha* (*paskëshe, paskësh, paskëshim, paskëshit, paskëshin*) *larë*.

Aty këtu ndeshen edhe forma të mbipërbëra të së kryerës (të tipit *paska pas larë*) dhe të së ardhmes (të tipit *do të laka*).

3.Habitorja në "Bleta Shqypëtare" e Thimi Mitkos

Në analizën që i kemi bërë përmbledhjes "Bleta Shqypëtare" të Thimi Mitkos, botuar më 1924, në Vjenë, nën përkujdesjen e Dr. Gjergj Pekmezit, kemi hasur trajtat e mënyrës habitore. Në këtë përmbledhje të Mitkos, jemi përqëndruar kryesisht te këngët e përmbledhura, si: *Kënga të motshme. Aligorike dhe komike*; *Kënga që këndohen ndër disa ditë të shënuar*; *Kënga shqype dasëmore*; *Kënga dashurije*; dhe *Kënga shqype trimërishte*. Ndër këto këngë, format foljore të mënyrës habitore i kemi hasur në: **kohën e tashme** (*qenëke*, *thyeke*, *zënëke* etj.); **kohën e pakryer** (*zënkëshin*); dhe **kohën e kryer** (*pasëke vunë*). Nga hulumtimi, kemi konstatur një përdorim më të dendur të kohës së tashme, kuptohet me shprehje dhe shkrim të kohës së Mitkos dhe të Pekmezit, por kuptimi shprehës është i habitores. Gjithashtu, është shumë më i shprehur numri njëjës kundrejt numrit shumës. Për ta parë gjendjen origjinale të habitores në përmbledhjen e Mitkos, në vijim do t'i japim vargjet ku e kemi evidentuar foljen në mënyrën habitore dhe në **kohën e tashme**, sipas cilkit të këngëve.

Kënga të motshme. Aligorike dhe komike

Po mosha **u thyeke** (Mitko[521], BSh : 19);

[519] Demiraj, Shaban (1988). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, fq. 909

[520] Gramatika 1 (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe*, AShSh, IGjL, Tiranë, fq. 291-293 dhe 318-320

Pasëke krahëtë me lesh (Mitko, BSh : 29);
Ti më **qenëke** jadigjar (Mitko, BSh :34);

Por edhe një formë mohuese të foljes në mënyrën habitore:

Burri **s'ugënyeke** (Mitko, BSh : 19).

Kënga që këndohen ndër disa ditë të shënuar

Qenëke trim edhe vasha (Mitko, BSh :41);
Zënëke zonj' e shën Mëri (Mitko, BSh: 43).

Kënga shqype dasëmore

Na **qenëke** nuseja jonë erë (Mitko, BSh : 48);
Dalëke dhëndri Ajan (Mitko, BSh : 50):
Dalëke, dhëndri sanxhak (Mitko, BSh : 51);
Qenëke i biri i botësë (Mitko, BSh : 56);
Dalëke bosiloku i rri (Mitko, BSh : 58);
Ububu! **qenëke** një valle (Mitko, BSh : 59);
Ububu! **lojtëke** një djalë (Mitko, BSh : 59);
Ububu! ç'**pasëke** dyfeknë (Mitko, BSh : 59);
Mirrë ti **pokka**, motëra ime (Mitko, BSh : 68);

Kënga dashurije

Se ç'**qenëke** një vetëtimë (Mitko, BSh : 72);
Se ç'të **rënëke** erë balli (Mitko, BSh : 81);
Se ç'të **rënëke** erë gusha (Mitko, BSh : 81);
Se ç'të **rënëke** erë gjiri (Mitko, BSh : 81);
Të **paske** hie shamija (Mitko, BSh : 81);
Bënëke nerënxha ndë det (Mitko, BSh : 91);
Se ç'të **ndriturke** ajo lërë (Mitko, BSh : 97);
Vërtet **qenëke** një sheheristan (Mitko, BSh : 103);

Kënga shqype trimërishte

Se ç'**qenëka** e mesëmeja (Mitko, BSh : 124);
Qenëke keq plagosurë (Mitko, BSh : 188);
Qenëkan judh' e të pabesë (Mitko, BSh : 195);

Gjatë hulumtimit tonë bërë përmbledhjes "Bleta Shqypëtare" të Mitkos, kemi hasur vetëm një herë në formën foljore të **kohës së pakryer** të mënyrës dësftore, në kreun Kënga shqype trimërishte:

Të m'a **zën-këshin** të gjallë (Mitko, BSh : 152).

Por, edhe një shembull te Kënga dashirije, nëse nuk e ka kuptim për festën e Pashkëve, çka unë e kuptoj si shprehje për festën e Pashkëve, duhet të jetë një e pakryer e habitores:

Dalç **pashkësh** me ve të kuqe (Mitko, BSh :95).

---

[521] Th. Mitko, "*Bleta Shqypëtare*", Rabeck, Vjenë, 1924, e përshkroj me shkrojla shqype, e përktheu shqyp dhe e radhiti Dr. Gjergj Pekmezi, Konsulli i Shqypërisë.

Gjithashtu një herë e kemi hasur formën foljore të **kohës së kryer** të mënyrës habitore, në kreun Kënga dashurije:

Ç'i **pasëke vunë** suratit (Mitko, BSh : 105).

4.Habitorja dhe gjuhët e tjera të Ballkanit

Duke u mbështetur në fjalët e thëna brenda këtij punimi dhe në tezat e studiuesve të ndryshëm për historinë e gjuhës shqipe, na del që habitorja në gjuhën shqipe është një kategori foljore e krijuar gjatë evolucionit historik të kësaj gjuhë qysh në periudhën parashkrimore të saj, pra me një zanafillë më të vjetër se koha e Buzukut[522] por edhe fakti se në kohën e Mitkos është e pranishme në këngët popullore. Me këto fjalë na del i pambështetur edhe mendimi i Koneskit[523] kur thotë se "në shqipe kemi disa rudimente të saj në të folmet e qyteteve, në të cilat ndikimi i turqishtes ka qenë më i fortë", mendim i cili na lë të mendojmë se habitorja ka ndikim nga turqishtja dhe është formuar në kohën kur administrata turke është vendosur në trojet shqiptare. Por, kur e marrim parasysh faktin se administrata turke ka pushtuar qytetet, ndërsa fshatrat shumë më vonë, dhe se habitorja në ambientet fshatare ka gjetur përdorim të dendur edhe duke mos e njohur turqishten, atëherë na shtohet bindja se habitorja nuk ka kurrfarë ndikimi nga turqishtja, por është një formim i vetë shqipes. Demiraj për ta dëshmuar praninë e saj në fshatrat ku s'ka pasur ndikim të turqishtes merr citimin e Cardignano-s i cili thotë se "habitorja në malësitë, sidomos në disa malësi (p.sh. në Pukë) përdoret së tepërmi". Pastaj, edhe sikur habitorja në gjuhën shqipe të mos ishte më e vjetër se periudha e parë e pushtimit turk të Shqipërisë, prapëseprapë mundësia e një ndikimi turk në këtë rast nuk ka si të mendohet, po të kemi parasysh se:

1. Turqishtja si gjuhë e një tjetër familjeje, me një sistem foljor të ndryshëm nga ai i shqipes, nuk

mund të ushtronte brenda një kohe të shkurtër një ndikim kaq të madh mbi gjuhën shqipe;

2. Midis habitores së shqipes dhe modalitetit subjektiv ose modalitetit në –*mish* (është fjala për

forma foljore që shprehin modalitetin subjektiv. Këto forma ngërthejnë edhe ngjyresa kuptimore karakteristike për të shkuaren subjektive, nëpërmjet së cilës folësi paraqit e përshkruan diçka që se ka parë vetë me sy, por e ka dëgjuar nga të tjerët) të turqishtes ka ndryshime të rëndësishme si në tipin e ndërtimit ashtu edhe në kuptimet themelore të tyre;

3. Ndikimi i turqishtes mbi gjuhën shqipe edhe në periudha më të vona të sundimit turk ka qenë i

kufizuar kryesisht në fjalor edhe në një numër të vogël prapashtesash, si: *-çi / -xhi, -llëk, lerë / llarë, çe*.

[522] Demiraj, Shaban (1988). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë

[523] B. Koneski, „*Istorija makedonskog jezika*", Prosveta-Kočo Račin, Beograd-Skopje, 1966, f. 176.

Për sa i takon pyetjes a ka ndonjë lidhje historike midis habitores së shqipes dhe mënyrës së ritregimit të bullgarishtes e të maqedonishtes Weigandi ka shprehur supozimin për ndikimin e shqipes mbi bullgarishten nëpërmjet maqedonishtes. Këtu është fjala për disa forma analitike homonime me ato të së kryerës (perfektit), më se të kryerës etj., që Weigandi i interpreton si forma habitoreje (admirativi). Por gjuhëtarë të tjerë si A. Teodor Balan-i, L. Andreičin-i, Stojanov-i, Debraekeber-i, Demina (sipas Demiraj[524]) flasin për ekzistencën e një "mënyre të ritregimit" në bullgarishte. Edhe për maqedonishten pranohet ekzistenca e kategorisë së ritregimit, d.m.th. përdorimi i formave analitike të së kryerës për të ritreguar diçka që folësi s'e ka parë vetë me sy. Koneski thotë që e kryera përdoret me vlerë habitoreje. Për sa i takon vjetërsisë së kësaj mënyreje në bullgarishte, Weigandi thotë se në bullgarishten e vjetër dhe të mesmen nuk ka gjetur ndonjë shembull habitoreje. Kurse, Mirčev-i[525] pohon se procesi i zgjerimit të funksioneve të së kryerës, gjë që çoi më vonë në zhvillimin e formave të ritregimit, ka nisur që në shekullin XIV. Kurse Fiedler-i ("Zu einigen Problemen des Admirativs in den Balkansprachen, në Actes, VI, 369) bën fjalë për mundësinë e një ndikimi të ndërsjellë midis shqipes, maqedonishtes e bullgarishtes. Fiedleri[526] për gjuhët arumune, të përdorura brenda territorit të Maqedonisë Jugperëndimore, gjen forma të mënyrës habitore apo përdorime foljore të ngjashme, gjë që ngjet në disa gjuhë ballkanike të tjera, si shqip, maqedonisht dhe bullgarisht. Ndërsa, Atanasov[527] në gjuhën megleno-rumune gjen një të kryer të përmbysur (perfekt të përmbysur) me foljen ndihmëse prapa pjesores dhe me kuptime të ngjashme me të mënyrës habitore të shqipes apo me të përdorimeve jovepruese (habi, dyshim, ritregim) të maqedonishtes dhe të bullgarishtes, shembuj që i përdor edhe A. P. Sitov[528] kur flet për aspektin ballkanik i çështjes së admirativit, si p.sh. **meg-rum**. – **ă bră, tu fost-ăi mări om**!; **bullg-maq**. – a be, ti si bil golem čovek!; **shq**. Ore, ti qenke njeri i madh!; **bullg**. – **Toj ne priliçall na bashta si! shq**. Ai nuk i gja-ka të babait! (shembullin e fundit e përdor vetëm Sitov, i cili në punimin e cituar , i përdor edhe tetë trajtat krahasuese me shqipen).

Nëse analizohen pak shembujt e dhënë do të shohim se fjala **fost** është pjesore dhe **ăi** është folje ndihmëse, ndërsa e kryera normale meglano-rumune do të ishte **ăi fost**. Pra, paralelja morfologjike në gjuhën shqipe bie në sy, edhe pse kjo dukuri mund të mos ishte e saktë, por kur e marrim parasysh faktin se popullata shqiptare në shekujt e shkuar ka mërguar në Meglen në rrugen e tyre për në vende të tjera, kjo dukuri, ndoshta, ka mundësi të jetë një ndikim i drejtpërdrejtë morfologjik nga

[524] Demiraj, Shaban (1980). *Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I dhe II*, Prishtinë
[525] Mirčev, "*Istoričeska gramatika na bělgarskija ezik*", Sofija, 1958, f. 123.
[526] Cituar, sipas V. Friedman, "*Ndikimi i shqipes në të folmet arumune të Maqedonisë Jugpe-rëndimore: mënyra habitore*", në Studime, 1, 1994, AShAK, Prishtinë, 1995, ff. 195-197
[527] P. Atanasov, "*Le mégléno-roumain de nos jours,* Hamburg, Buske, 1990, f. 220.
[528] A. P. Sitov, "*Kategoria e admirativit në gjuhën shqipe dhe bashkëgjegjësitë e saja ballkanike*", në Gj. alb., Seria e shkencave filologjike, 20-1990, Prishtinë, 1991, f. 152.

shqipja. Këto fjalë të lartshënuara mund të na dalin të sakta, pasi që ta marrim edhe një shembull nga Friedman[529] , kur në vitin 1992 në Ohër të Maqedonisë në të folmet arumune të vllehëve nga Frashëri që banonin në Belicën e Sipërme gjen një formë foljore jovërtetuese, që funksionon si habitorja e shqipes dhe disa përdorime të foljes foljore me **-l** të maqedonishtes, ku funksionimin e habitorës së shqipes në këtë të folme dhe në këtë territor mund ta arsyetojmë me faktin se deri në kohët e vona banorët e Belicës dinin shqip dhe se së paku një pjesë e tyre kishte ardhur më përpara nga Shqipëria, p.sh: **arum. – Mi l'oi di minti: "A be tora tini fuskă avut om!**"; **maq**. – Se šašardisav: "A be sega ti si bil bogat čovek!"; **shq**. U habita: "Ore, tani qenke njeri i pasur!". Nga aspekti i përdorimit të admirativit në letërsinë e shkruar, lirike e epike, dhe të përdorimit stilistik të admirativit në shqipen Desnickaja[530] na jep dësmi të shumta të përdorimit të admirativit në shqipen në shumë stile. Bile në një rast Desnickaja, pjesën veriore e sheh më karakteristike: "Mund të thuhet që përdorimi i gjerë i kategorisë stilistiko-gramatikore të admirativit është një nga veçoritë karakteristike të koinesë epike të Veriut. Kur ta marrim faktin se mënyra habitore e shqipes është e formuar prej një perfekti të përmbysur të tipit *pjesore + folje ndihmëse*, p.sh.: ai **ka qenë** = ai **qenka**[531], nga kjo na del se habitorja e arumanishtes është formuar përmes një analizimi abduktiv të habitores së shqipes. Këtë ndikim morfologjik të shqipes në të folmet arumune të Belicës në Ohër të Maqedonisë, Friedmani (po aty) e shpjegon dhe e arsyeton: "në këtë të folme të arumanishtes duket se morfema **-ka**, që në shqipen shënon vetën e tretë të habitores, do të jetë kuptuar si shenjë e habitores në përgjithësi dhe do të jetë lidhur me pjesoren arumune: ***fustă + ka = fuskă**, që përdoret për çdo vetë dhe me shumë folje". Pra, kjo dëshmi e dhënë është më tepër se një shembull interesant i një morfeme gramatikore që ishte huazuar (**-ka** shqipe në rumanishte). Kjo pa kurrfarë dyshimi na del si ndikim nga shqipja, gjë të cilën e vërteton edhe Friedman-i. Po ashtu, Friedman është ndër të parët i cili tenton ta zhgjidhë çështjen ndërmjet *habitores* së shqipes, *minalo preizkazvano* e bullgarishtes, *prekazuvanjeto* e maqedonishtes dhe *mazii naklî* i turqishtes, duke i përshkruar si opozicion gramatikor vërtetues/jovërtetues. Ose edhe siç shprehet Ismajli[532]: te foljet vërehet se trajtat e sllavishtes (maqedonishtes) janë krijuar në bazë të pjesores së shqipes me një morfemë që përdoret në maqedonisht, pra pas analogjisë: *tut-kam, špot-am, plagos-am* etj.

Për dukurinë e ngjashme të dy a më shumë gjuhëve ballkanike nuk mund të nxirren përfundime të sigurta duke u mbështetur vetëm në mendimin që si gjuhë

[529] V. Friedman, "*Ndikimi i shqipes në të folmet arumune të Maqedonisë Jugpe-rëndimore: mënyra habitore*", në Studime, 1, 1994, AShAK, Prishtinë, 1995

[530] A. Desnickaja, "*Disa vërejtje dhe mendime rreth çështjes së kuptimit të kategorisë së admirativit në shqipe*", Gj. alb., SShF, 16-1986, Prishtinë, 1987, ff. 69-80.

[531] Për më shumë shih. *Gramatika* 1, 2002: 291-293

[532] R. Ismajli, "*Fjalë shqipe në maqedonishte*", në " Artikuj mbi gjuhën shqipe"**,** Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 172.

fqinje ato duhet të kenë ushtruar ndikim mbi njëra-tjetrën. Në rastin në shqyrtim para se të jepen gjykime të sakta për ndikimin e mundshëm të shqipes mbi maqedonishten e bullgarishten, siç supozon Weigandi, apo mbi ndikimin e mundshëm të ndërsjellë midis shqipes, maqedonishtes dhe bullgarishtes në krijimin dhe intensifikimin e përdorimit të formave foljore me vlerë habitoreje, siç supozon Fiedler-i, Demiraj kërkon sqarimin e një sërë pyetjesh, ndër të cilat edhe këto:

1. Sa të vjetra janë format zanafillëse të së ashtuquajturës mënyrë të ritregimit në maqedonishte dhe bullgarishte dhe a ka ushtruar turqishtja ndonjë ndikim mbi këto dy gjuhë në këtë rast? Kjo kërkesë vjen pasi që disa gjuhëtarë, si: K. Conevi, K. Mirčevi, L. Andrejčini e lidhin zanafillën e ritregimit dhe të mjeteve të shprehjes së tij në bullgarishte me ndikimin e gjuhës turke, ndikimin turk në këtë pikë e pranon edhe Koneski për maqedonishten. Mundësinë e ndikimit të turqishtes mbi bullgarishten e maqedonishten në këtë pikë e pranon edhe Fiedler-i. Por disa gjuhëtarë të tjerë si Triponov, Dilenskij, Gëlëbov janë shprehur kundër mendimit që format e ritregimit në bullgarishte të kenë lindur nën ndikimin e turqishtes[533]
2. A është kuptimi modal i habitores historikisht parësor apo dytësor dhe sa i vjetër është ai tek format e së ashtuquajturës mënyrë të ritregimit në maqedonishte e bullgarishte?
3. Ku paraqitet më dendur historikisht përdorimi i formave në shqyrtim me vlerën e habitores, në bullgarishte apo në maqedonishte?

Vetëm pas sqarimit të këtyre pyetjeve mund të jepet një mendim i mbështetur mbi lidhjen e mundshme historike midis habitores së shqipes dhe mënyrës së ritregimit të maqedonishtes e bullgarishtes. Por, ndërkaq, do pasur parasysh se e tashmja dhe e pakryera e habitores së shqipes, ashtu siç paraqiten që nga Buzuku e këtej, por edhe te përmbledhja e Mitkos, dalin me forma të përngjitura dhe se të gjitha format kohore të kësaj mënyre, në zanafillë, kanë qenë përdorur kryesisht për të shprehur habinë e folësit në çastin e ligjërimit të tij për diçka të papritur. Kurse mënyra e ritregimit në maqedonishte e në bullgarishte del me forma analitike që nuk kanë arritur të përngjiten dhe, me sa duket, edhe historikisht kuptimi modal i habitores te format e kësaj mënyre është dytësor.

5.Përfundime

Gjatë hulumtimit të përmbledhjes "Bleta Shqypëtare" për format e habitores, kemi gjetur gjithsej 29 raste ku shprehet habitorja në kohë, numër e veta të ndryshme. Prej tyre, 26 raste janë shprehur në kohën e tashme, 2 në kohën e pakryer, prej të cilëve njëri rast besoj se nuk e ka kuptimin e habitores, dhe një rast në kohën e kryer. Rastet e habitores përdoren atëherë kur rasti shprehet me një habi ose me një pasigurie për diçka që flitet, por kemi raste kur kemi ngatërrimet e vetave, ku folja përdoret në veten e dytë të habitores brenda ndërtimit të fjalisë. Nga rastet e evidentuara kemi hasur një përdorim më të dendur të kohës së tashme,

[533] Demiraj, Shaban (1980). *Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I dhe II*, Prishtinë ,338-339.

kundrejt kohëve të tjera që i kemi gjetur në përdorim në këtë përmbledhje të Mitkos.

Nëse bazohemi në gjendjen e përdorimit të habitores edhe në gjuhë të tjera ballkanike, mbi gjendjen diakronike të habitores dhe me kontaktet e ndërsjella të gjuhëve të Ballkanit, na del se habitorja e shqipes ka një ndikim në gjuhë të tjera ballkanike, së paku kemi disa pohime rreth këtij përkufizimi.

SPIRIDHULLA POÇI (GJIROKASTËR)

DUKURI MORFOLOGJIKE NË PROZËN E THIMI MITKOS

Në studimin e zhvillimit historik të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, të dialekteve, nëndialekteve e të folmeve rëndësi të dorës së parë kanë veprat e shkruara, në të cilat gjejmë të dokumentuara dukuri gjuhësore arkaike, të cilat, sot, gjuha letrare nuk i ka bërë pjesë të sistemit të saj. Edhe vepra " Bleta shqiptare" e Thimi Mitkos shërben si dëshmi e karakteristikave fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës shqipe në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Mitkoja, si iluminist, si një rilindës i ndërgjegjshëm[534], i rënë në kontakt me kulturat e reja të Evropës e të Ballkanit dhe me përpjekjet e popujve nën zgjedhë që luftonin për liri, kuptoi rëndësinë dhe vlerën e kulturës kombëtare shqiptare, në përgjithësi dhe të gjuhës shqipe, në veçanti, në plotësimin dhe realizimin e idealeve të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare. Ai thekson: "Qëllimi i këtyre studimeve albanologjike është, përgjithësisht, shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë, i fjalëvet dhe tekstevet shqipe, ..., sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare; veçanërisht dua që t'u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën edhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare"[535].

Në veprën "Bleta shqiptare" Mitkoja ka përmbledhur rreth 21 tekste përrallash, disa të papërfunduara. Për sa i përket mënyrës së shkrimit, në këto tekste, vërejmë shumë shmangie të karakterit fonetik, gjë e cila e bën disi të vështirë studimin e sistemit morfologjik në pjesë të ndryshme të ligjëratës. Brenda të njëjtit tekst vërehen shkrime të ndryshme për të njëjtën dukuri dhe kjo, ndoshta, për faktin që Mitkoja nuk ishte një gjuhëtar i mirëfilltë ose për faktin që përrallat mund të jenë mbledhur në diasporë ku të anketuarit kishin kohë që kishin shkëputur lidhjet me gjuhën në atdheun e tyre.

Analiza gjuhësor e teksteve të përrallave të Mitkos dëshmon se gjuha e tyre i përket toskërishtes verilindore, por nuk mungojnë dhe elemente gjuhësore që shtrihen në një hapësirë gjeografike më të gjerë, në toskërishten jugore ose perëndimore. Në këto tekstet gjejmë, gjithashtu, në një numër të kufizuar, edhe elemente të gegërishtes, p.sh: ta marr' atë për gru ose s'qe me mundë të bindetë etj.

Ndër dukuritë më kryesore morfologjike mund të veçojmë:

Në gjuhën shqipe, në klasën e emrave, gjinia asnjanëse ka filluar të çintegrohet që herët e vazhdimisht. Në qoftë se do të krahasonim sasinë e emrave asnjanës në periudha të ndryshme deri në ditët tona ajo do të vinte duke u

[534]Dh. Shuteriqi, *Mbi veprimin e Mitkos si folklorist dhe mbi botimin e "Bletës Shqiptare",* Çështje të folklorit shqiptar, 1, Tiranë, 1982, fq. 384

[535] Thimi Mitko, *Vepra,* Tiranë, 1981, fq. 61

zvogëluar. Në përrallat e Mitkos gjejmë të përdorur shumë emra të gjinisë asnjanëse, shumica emra prejfoljorë, të tillë si: *të vaturit, të kallurët, të zbriturit, së qarit, me të përunjët, të mpruarit*, por dhe emra të tjerë, si: *kryet, nga ujët të gjallë, të gjallët, lumët* etj. Në disa raste disa prej emrave asnjanës dalin dhe me parafjalë, si: *nga të keqtë, me të dhembur, mbë të nkëthyerët* etj. Paqëndrueshmërinë e gjinisë asnjanëse ndaj dy gjinive të tjera e vërejmë edhe në tekstet e këtyre përrallave. Në disa raste në këto tekste gjejmë emra të gjinisë femërore të panyjshëm, si *thirma, britma, e qara* ose emra femërorë të nyjshëm, lakimi i të cilëve në numrin shumës nuk dallohet nga emrat e gjinisë asnjanëse, si: *në të keqe, me të dhembura* etj. Po kështu gjejmë *lumët*, por dhe *lumi.*

Sistemi rasor i emrave në këto tekste dëshmon për praninë e formave rasore arkaike. Gjejmë shpesh të përdorur atë rasë të cilën Pederseni e ka quajtur "kallëzore parafjalore"[536]. Është fjala për kallëzoren e shoqëruar nga parafjalët në, mbi, mbë, ndë dhe nga mbaresa –t, p.sh.: *ndë zjarrt, mbë derët, ndë pust, ndë pëlast, mbi dhet, ndë dhomët, mbi list, në gojët , ndë brest, në gropët* etj. Kjo është një dukuri e vjetër morfologjike që e gjejmë te autorët e vjetër veriorë dhe jugorë si Buzuku, Budi, Bardhi e Matrënga. Sot ajo del ende në gegërishten jugore dhe toskërishten veriore, kurse në të folmet e skajit jugor dhe verior të shqipes nuk ndeshet, pothuajse, fare[537].

Në trajtën e shquar, të numrit shumës, rasat e zhdrejta dalin me nyjen shquese të prapme-t, e cila fillon të kufizohet që nga shkrimet e Nolit e në vazhdim, p.sh. *trimat e bujarëvet, anët e anëvet, të pelavet, karshi penxherevet, për kryet e të vëllazërvet, anët e dy litarëvet, me ujë të gjallë të malevet, u thirri trimavet, u tha të vëllezërvet, u hodhi bretkosavet* etj.

Në pak raste në emrat e gjinisë femërore gjejmë rrjedhoren dytësore të formuar me nyjën e prapme –t, e cila është shtrirë tek emrat femërorë në mënyrë analogjike nga emrat e gjinisë mashkullore[538], p.sh., *marrohej friket,* por dhe formën më të re dhe më të përgjithësuar, *i dredhurë frike, u droth frike*.

Rasa emërore e emrave të gjinisë femërore me –e- të patheksuar përgjithësisht e ruan këtë edhe në rasen emërore të trajtës së shquar, si: *kopileja, e shoqeja, kumbareja, e keqeja* etj.

Edhe në formimin e rasës kallëzore të shquar njëjës të emrave gjejmë gjedhën e vjetër të gjuhës shqipe, pra trajtë e pashquar + nyjë shquese, si *veshnë, synë, ftuanë (por dhe ftuan), mbretnë, trimnë* etj. Sot kjo formë rasore ndërtohet nga forma e rasës emërore të shquar +nyjen shquese, gjedhë e cila duhet të përgjithësohet edhe tek emrat në temë më –ua ose á , për të cilët "Gramatika e gjuhës shqipe I"[539] dhe "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe[540]" bien ndesh.

---

[536] E. Likaj, *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe*,Tiranë, 2003, fq. 78
[537] Po aty, fq. 77-78.
[538] Po aty, fq. 80
[539] *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, fq. 113
[540] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, fq. 52

Shpesh në tekste gjejmë togfjalësha ku mungon nyja e përparme e rasës gjinore përpara një emri a përemri, ndoshta, për arsye se nyja e përparme tingëllon e njëjtë me nyjen e prapme, si: *te shtëpija e së bukurës dheut, vuri veshnë pas faqes dheut, lodrën e çupërisë saj, vinte të turbullë prej gjakut plagëvet llamisë, pas urdhërit mbretit, e kryesë tij, karshi penxherevet mbretit, u shduk sythit njerëzvet, anës pallasit saj, nga an'e pallasit çupës, prej lakmisë saj, te pallasi çupës, jo lark shtëpisë asaj, pas vdekjes tij* etj.

Në klasën e përemrave, shkrimi dhe përdorimi i tyre, në përgjithësi, karakterizohet nga forma të përziera. Në tekstet e përrallave gjejmë forma që përputhen me format në gjuhën letrare shqipe, si: unë, ajo, mua, kjo, ata etj, por gjejmë dhe forma karakteristike dialektore të toskërishtes, sidomos, të toskërishtes verilindore. Në shkrimin e shumë formave vihen re shmangie fonetike të kushtëzuara nga dukuritë fonetike të së folmes në fjalë.

Përemri vetor dhe dëftor ai del në formën *ay (ajy),* që është një formë karakteristike për toskërishten verilindore: në pak raste gjejmë formën e hershme – *si / sij,* (*kishte marrë prej si ndë kopështët)*, formën e rrjedhores për të dy gjinitë, prej syresh ose formën pas kësosh; në pak raste gjejmë formën *ao për ajo* (po ao thosh, ao i tha), që është më shumë një variant fonetik dhe që del si variant i parë në të folmen e Gjirokastrës[541]. Varianti i përemrit pronor *tënë* del në toskërishten lindore dhe perëndimore. Edhe forma *tem* (*ndë vend tem*, në këtë rast në kallëzore) është karakteristike për rasat e zhdrejta në të folmet e Shqipërisë së Mesme dhe të Korçës[542]. Po kështu gjejmë variantin *tënt* që përdoret në Shqipërinë e Mesme dhe shumë të folme të toskërishtes veriore. Në format *njërijatrin, njërijetërit*, në elementin e dytë vërehen forma dialektore *jatrin* dhe jetër për formën tjetër. Forma jetër pasqyron një fazë të ndërmjetme midis formës indoevropiane *èter* dhe *tjetër*. Edhe për përemrin vetvetor gjejmë të përdorur formën më të vjetër të tij *vetëhen* ose *me vetëhe.* Gjithashtu në lakimin e disa formave përemërore nuk mungon lakimi, si tek emri, me anën e nyjes shquese –t, p.sh., *pranë këtyrevet* (dhe *këtyreve), atyrevet (dhe atyreve), të gjithëvet* etj.

Edhe në klasën e foljeve vërejmë dukuri dialektore, të vjetra e të reja, dukuri që kanë të bëjnë si me temat dhe me mbaresat e foljeve. Temat e foljeve që e formojnë të kryerën e thjeshtë me apofoni dalin me grupin *ua* edhe pse midis temës dhe mbaresës gjejmë tingullin mbështetës *–ë,* e cila sot konkonsiderohet si pjesë e mbaresës, si: *nxuarrën, muarën, mbluadhën, duallën*, por në disa raste tema foljore del pa mbaresë, si: *muar, duall*, ose me një formë të shkurtuar si *pru (pruri), e zu*, karakteristikë kjo për të folmet gege, të folmet kalimtare, të Kurveleshit dhe Bregdetit të Poshtëm[543].

[541] ADGJSH, 2007, fq. 274
[542] J. Gjinari-Gj. Shkurtaj, *Dialektoogjia*, Tiranë, 2003, fq. 220
[543] Po aty, fq. 230

Për sa u përket mbaresave, në vetën e tretë të së kryerës së thjeshtë del mbaresa *–i,* si në gjuhën letrare të sotme, si: *kuptoi, qëndroi, mbushi, shpëtoi, mori,* por dhe mbaresa *jti/iti,* që është karakteristike për toskërishten jugore, veçanërisht, në anët e Gjirokastrës, si: *tregojti, urdhërojti, shkojti, mësojti, ngarkoiti, urdhëroiti*[544]. Në numrin shumës, krahas mbaresave arkaike të trashëguara, *mahnit-në, lith-në, arth-në, prish-në,* shfaqen dhe mbaresat e një faze të ndërmjetme dhe ato më të rejat, të cilat përkojnë me mbaresat e gjuhës letrare, si: *shypënë, hypëmë, hodhën, ikën, u mblodhën, u sosën* etj.

Në kohën e tashme të mënyrës lidhore e dëftore foljet dalin me mbaresat *–(ë)një/(ë)nj* në vend të mbaresës *–j,* si: *martonj, të gjuanjë, të qepënjë, ta martonjë, ta mundonjë, të shkonjë, ta shtrëngonjë, të shpëtonj, të mbronj, të thyenj* etj. Kjo mbaresë ruhet dhe sot në të folmet e toskërishtes veriore[545]. Edhe në vetën e dytë, të kohës së tashme, të mënyrës lidhore, foljeve me zanore marrin mbaresën *–sh* ose, rrallë, *-jsh*, si: *të zësh, të rrëmbesh, t'ikësh, të më rrëfejsh*, kurse foljet me bashkëtingëllore marrin mbaresën *–ç,* në vend të mbaresës *–sh,* si: *t'e març e t'e siellç, ta sheç, të pyeç, të vraç*, dukuri kjo karakteristike për toskërishten, duke përfshirë këtu, për foljet me bashkëtingëllore, dhe të folmen e Korçës.

Për sa i përket mënyrës së ndërtimit të zgjedhimit joveprore të foljet me zanore, krahas formave që përputhen me ato të gjuhës letrare të sotme, si: *të bëhemi, do të lëshoheshe, do të lëshohet, zihej et*j, ndeshim dhe trajta foljesh që marrin midis temës dhe mbaresës një *–n-* në vend të *–h*-së, si: *bënet, po mendonej* etj.

Nga sa trajtuam më lartë, mund të themi se dukuritë morfologjike në gjuhën e teksteve të përrallave, në veprën "Bleta shqiptare" e Thimi Mitkos janë dukuri karakteristike të toskërishtes, sidomos, të toskërishtes verilindore. Studimi më i thelluar i tyre mund të na japë të dhëna më të sigurta edhe për mbartësit e përrallave dhe kohën e mbledhjes së tyre.

[544] Po aty, fq. 231
[545] Po aty, fq. 223-224

TEUTA TOSKA (ELBASAN)

PËR DISA SHPREHJE SI SHFAQJE TË LIGJËRIMIT POETIK POPULLOR TE "BLETA SHQIPTARE"

Në botimin e "Bëleta shqiptare[546]", në kategorinë "Fjalë të moçime" Th.Mitkoja përfshin, sipas nesh, një lëndë etnogjuhësore heterogjene, e pritshme kjo në një fazë kur mendimi shkencor në folkloristikë ishte në hapat e parë dhe ende nuk ishin përvijuar koncepte të qarta për gjinitë e folklorit dhe, për më tepër, të mund të bëhej analiza sipas këtyre koncepteve e lëndës folkloristike të mbledhur. Klasa e njësive të "Fjalëve të moçime" përbëhet jo vetëm nga fjalë të urta (*të moçime*), si p.sh. *ari tek e njohin, atie vëlen; çkul dhëmbin, të të shëndoshet kryet; gjuha e paashtë thyen rrashtë; koka që s'dëgjon, më shumë pëson; kush lypën, gjen kudo* etj., por edhe nga njësi frazeologjike, si: *atij i piell edhe këndesi; atie ku ha qeni petulla; ay është një njeri, që s'turbullon ujët* (pjesa e nënvizuar është njësi frazeologjike); *e mëson si plaka furkën; erdhi me lugë në brez* etj. Por edhe nga njësi, sipas nesh, me tipologji të tjera, që karakterizohen nga funksione, vlera dhe kuptime të ndryshme nga fjalët e urta, ku i ka grupuar Mitkoja.

Në këtë lëndë etnogjuhësore që na sjell Th.Mitkoja tek "Bëleta" ne jemi të interesuar për një klasë njësish të përbërë nga shprehje popullore që përmbajnë edhe këto elemente të ligjërimit poetik, ku shfaqet një energji gjuhësore poetike që i prodhon këto formula të ngulitura, që kanë ngarkesë emocionale por dhe vlerë aksiologjike, megjithëse jo aq të spikatur sa fjalët e urta. Këto njësi të tjera formësohen në nivelin e formës së shprehjes (sipas termit të L.Hjelmslevit) pothuajse nga po ato përftesa që e karakterizojnë letërsinë popullore, por edhe njësitë frazeologjike e fjalët e urta: elemente që karakterizojnë mbizotërimin e funksionit poetik të gjuhës (sipas termit që përdor R.Jakobsoni). Ato karakterizohen nga përpunimi në nivelin fonetik, morfologjik, leksikor etj., dhe nga një shkallë e theksuar emocionaliteti, nga një institucionalizim, përsëritshmëri etj. Të konceptuara prej nesh[547] kështu, këto njësi, bashkë me njësitë frazeologjike, fjalët e urta etj., do të zënë një vend të ndërmjetëm midis gjuhës dhe letërsisë gojore. Është një terren ku interesi i folësit (krijues i njësisë, por edhe përdoruesi i saj) për formën e mesazhit (qoftë të formës së shprehjes, qoftë të formës së përmbajtjes) është më i madh sesa për substancën, referentin, i cili tashmë është shfaqur në diskurs me elemente të tjera gjuhësore.

[546] "*Mbledhës të hershëm të folklorit",* vëllimi 1, Tiranë, 1961, "Bleta shqiptare", Th.Mitko, "Fjalë të moçime", nga f.17-27.

[547] T. Toska, "*Elemente të mendësisë shqiptare në frazeologji*", "Naimi", Tiranë, 2014.

Në librin "Communicare"[548] autorët flasin për katër faza në zhvillimin e veprimtarisë dhe proceseve të komunikimit. Faza e parë i takon kulturës dhe komunikimit gojor. Ky komunikim karakterizohet nga disa veçori, që kushtëzohen në radhë të parë nga nevoja për të ruajtur në kujtesë informacione, udhëzime, besime etj. "Për të mundësuar kështu një memorizim më të lehtë, kultura gojore [orale] zhvillon formula të posaçme: mendimet kanë një ritëm, janë të pasura në përsëritje, aliteracione, asonanca, njohje standard të përbashkëta për të gjithë, proverba të kuptueshme prej të gjithëve". Këto formula janë të tipologjive të ndryshme. Dhe veçanërisht njësitë për të cilat po flasim, edhe pse tashmë komunikimi njerëzor e ka tejkaluar fazën e komunikimit gojor (nuk krijohen më eposet e ndryshme dhe gjinitë e tjera të folklorit letrar, si poemat, baladat, përrallat etj.), këto njësi vazhdojnë e krijohen, janë gjithnjë të gjalla në komunikimin gojor dhe gjenerohen prej një energjie poetike gjithnjë aktive.

Së pari, dallimi i këtyre shprehjeve prej njësive frazeologjike është tashmë i qartë, për shkak se nga ana gjuhësore njësia frazeologjike e ka një përcaktim dhe problematika e kufirit të saj është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme në gjuhësinë shqiptare (ajo është barasvlerëse e fjalës semantikisht, funksionalisht dhe për nga rendi e pozicioni në fjali).

Por, së dyti, shprehjet që na interesojnë, në mendimin tradicional shqiptar, janë përfshirë në përgjithësi në klasën e fjalëve të urta a të proverbave. Ndaj çështja themelore është të dalë në pah dallimi që ekziston mes tyre, nëse ekziston, në planin e shprehjes, përmbajtjes dhe të funksionit të tyre.

Sipas "Hyrjes" në "Fjalët e urta të popullit shqiptar[549]" proverbat / fjalët e urta dallohen nga disa karakteristika shumë të përgjithshme dhe përcaktimi për to është shumë i gjerë. Duket se nuk ka qenë në interesin e autorëve të përcaktojnë kufirin e një njësie të dallueshme qartë nga të tjerat, të përdorin kritere përzgjedhëse, por, më së shumti, të grumbullojnë dhe të ruajnë një pasuri gjuhësore, të përfshijnë, më fort sesa të përjashtojnë njësi disi të ndryshme nga ajo që në përgjithësi pranohet si "proverbë" apo në shqip "fjalë e urtë".

Kështu, sipas autorëve, te njësia duhet të shfaqet më së pari "...elementi vlerësues i ngjarjeve dhe fenomeneve jetësore dhe, lidhur me këtë, synimi edukativ, synimi etiko-moral."[550] dhe vazhdojnë duke përcaktuar se "Ato paraqiten kështu edhe si mesazhe të brezave të shkuara brezave pasardhëse. Dhe, pavarësisht nga forma me të cilën paraqitet, çdo proverb e ka gjithmonë synimin moral."[551] Pas kriterit "synimi edukativ, etiko-moral", autorët përcaktojnë edhe se fjalët e urta janë të ndryshme për nga forma, duke nënkuptuar këtu strukturën e tyre gjuhësore. Por

[548] "*Communicazione",* Sintesi, a cura di Gian Paolo Caprettini, Ave Appiano, Alessandro Scali, Antonio Vallardi Editore, 2005, f.15-17.
[549]Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, "*Fjalët e urta të popullit shqiptar*", Tiranë, 1983.
[550] Instituti i Kulturës Popullore, "*Fjalët e urta të popullit shqiptar*", Tiranë, 1983, f.7.
[551]Po aty, f.8.

në të dyja citimet më sipër synimi moral, mesazhi me vlerë urtësie, diturie, aksioma e urtësisë popullore spikatet qartë. Kjo duhet të mbizotërojë, pavarësisht kontekstit ku përdoret dhe kuptimi i fjalës së urtë duhet të jetë moralisht i qartë, edhe nëse ajo shkëputet nga konteskti gjuhësor apo jogjuhësor (situata shoqërore e mjedisi gjeografik).

Mirëpo le të vëmë përballë njëra-tjetrës, në disa shembuj, fjalët e urta dhe disa nga shprehjet popullore që duam t'i dallojmë nga të tjerat:[552]

Fjalë të urta	**Shprehje popullore**
Buka s'bahet vetëmë (Fj.ur)	*Bëjmë, o tatë, të të ngjas*
I duruari, i lëvduari.	*E ç'do ulku në pazar?*
Kush lypën, gjen kudo.	*E di Gjoni ç'ka në trastë.*
Kush ecën kadale, sosetë më tej.	*Eja bukë, të të ha.*

Siç duket edhe nga shembujt më sipër, fjala e urtë ka një synim moral të shprehur qartë. Kjo veçori është kaq e spikatur, sa ajo mund të funksionojë e lirë nga konteksti gjuhësor dhe jogjuhësor. Kështu nga "përdorimi i gjatë i proverbave nga populli, ... ndodh që ana historike e çështjes mjegullohet, por kuptimi mbetet shumë i qartë...[553]"

Ndërsa njësitë e kolonës tjetër nuk kanë një synim moral, këshillë, madje mund të mos kenë ndonjë vlerë aksiologjike të spikatur. Secila prej fjalëve të urta nxit një virtyt, këshillon për një sjellje të caktuar, formulon në mënyrë sintetike përfundimin e një ngjarjeje. Ndërsa këto shprehjet janë më fort vlerësime, përshkrime, gjykime për sjellje të caktuara, të vlerësuara pak a shumë në mënyrë pejorative. Shpeshherë këto shprehje popullore, të shkëputura nga konteksti dhe mjedisi jogjuhësor, janë kaq të errëta në kuptim, si p.sh. *Dhia mish edhe capi mish; ja terra, ja laga; jona, more jona!; ku'shtë manastiri? pa kallogjerë sa të duash* etj.

Duhet të kemi gjithnjë parasysh se këto shprehje karakterizohen prej një shkalle të lartë shprehësie emocionale, me nuancat e ndryshme të negatives, si ironi, sarkazëm, tallje, turpërim, zvogëlim, zmadhim, teprim etj. Më fort këto njësi shfaqen si një lojë gjuhësore, të vënët në lojë të atij që flet për çfarë po flet, në disa raste, në raste të tjera shfaqen edhe si dëshirë për të vënë në dukje zotësinë gjuhësore të atij që flet. Por këto shprehje janë edhe si një "valvul sigurie", që "shkarkojnë" gjuhësisht bashkëbiseduesit nga emocionet e forta që mund të shoqërojnë një bisedë ose, madje, shkarkojnë tensione të ndryshme shoqërore, të krijuara nga

[552] I jemi shmangur si fillim përdorimit të një termi të veçantë, duke përdorur termin gjenerik "shprehje popullore". Termi, në vetvete, siç edhe nga fjala që përdoret, është një shenjë kufizuese; por ne mendojmë se brenda kësaj klase ka disa tipa njësish, që do të kërkojnë një punim tjetër shtjellues e përcaktues. Ndaj nuk kemi dashur, si fillim, ta kufizojmë lëndën dhe fushën me një term.

[553] "*Fjalët e urta të popullit shqiptar",* vepër e cituar, f.13.

ngjarje dramatike ose tabu, duke e përshkruar si të zakonshme, të përsëritshme brez pas brezi atë që në sytë e bashkëbiseduesit mund të duket ngjarje e pazakontë, e re, e pakrahasueshme etj.

Po kështu këto shprehje janë të ndryshme nga fjalët e urta edhe nga pozicioni që zënë në diskurs (pothuajse mund të themi me siguri se rendi i këtyre shprehjeve është gjithnjë në fund, si "vulë" e bisedës apo e debatit mes bashkëbiseduesve, ndërkohë që fjala e urtë mund të jetë një fjali që e nis një bisedë, mund të gjendet edhe në mes të një bisede, për të shënuar kulmin e një debati, dhe me siguri mund të përdoret fare mirë në fund, për të mbyllur e përforcuar argumentin individual të folësit).

Siç edhe po duket nga shembujt më sipër, shprehjet popullore janë të tipave dhe llojeve të ndryshme, ndryshe nga proverbat/fjalët e urta, të cilat në tërësinë e tyre, nga pikëpamja semantike, funksionale, janë më homogjene, sepse "Te proverbat nuk kemi zhvillim subjekti a veprimi..., por janë vetë ekstrakti. Ato ... janë vetë ideja, pavarësisht nga forma me të cilën shprehet ajo: si gjykim apo si konkluzion logjik, si vlerësim apo si këshillë, si rregull apo si normë etike.[554]" Në numrin e njësive që Th.Mitko i ka mbledhur në kategorinë "Fjalë të moçime" ka një numër të konsiderueshëm shprehjesh te të cilat nuk e gjejmë përfundimin logjik të një ndodhie, këshillë, rregullën shoqërore që individi duhet ta ketë parasysh në situata të reja apo normën etike. Kur flasim për homogjenitet, flasim për praninë e përhershme në to të synimit moral, normës etike, rregullës shoqërore etj.

Nga ana tjetër, sipas nesh, është e vërtetë që edhe shumë shprehje popullore, njësoj si fjalët e urta, janë "fosile" ngjarjesh të rrëfyera, anekdotash, përrallash etj., sikundër e shprehin autorët edhe te hyrja e monografisë për fjalët e urta: "Aftësia e popullit për të zgjedhur fakte të veçanta e për t'i ngritur në lartësinë e përgjithësimit artistik me mjetet e proverbit duket dhe në atë që disa fjalë të urta janë përfundime anekdotash, fabulash, përrallash, këngësh etj., formulime në një trajtë karakteristike të ideve që dalin në krijimet e sapopërmendura...[555]". Por "fosilet", mbetjet gjuhësore, janë të dy tipologjive të ndryshme: fjala e urtë e ruan mësimin moral të plotë, ndërsa tjetra ruan vetëm shprehjen që ka pasur më shumë intensitet emocional, kulmin e rrëfimit, një shprehje që e identifikon më së shumti rrëfenjën etj., p.sh.:

Fjalë të urta	**Shprehje popullore**
Laraska rrahu të nxierë t'ecurit e fëllënzës, po harroi edhe të sajtë	*Kush ka fajë? I varfëri*
Plaka me një dhëmb hangri një qytet	*S'të pyesin: Si ka qënë? Po si je?*
Zure gjarpërin? Shtyp'i kryet	*Puno, o fat-zi! Hai o bark-stihi*
Nuku bëhet nom i ri ndë fshat të vietërë	*Shpyrt o ziarr! E shpyrt o burrë!*

[554] Po aty, f.11.
[555] "Fjalët e urta të popullit shqiptar", f.12.

Për sa i përket strukturës së tyre gjuhësore, duhet të themi se këto shprehje kanë ngjashmëri me fjalët e urta dhe me njësitë frazeologjike, në lidhje me mjetet gjuhësore që i përftojnë. Ashtu si edhe fjalët e urta dhe njësitë frazeologjike, të cilat "Me qëllim që të arrihen përgjithësime sa më të gjera dhe mendimi të shprehet në mënyrë të gjallë, emocionale e me kolorit, fjalët e urta i referohen figurës artistike[556]."., edhe shprehjet në fjalë janë të pasura me figura në të gjitha nivelet e strukturës gjuhësore[557]: në nivelin fonetik - me përdorimin e asonancës, konsonancës, aliteracionit, rimës etj.; në nivelin semantik– me përdorimin e metaforës, metonimisë, sinekdokës, hiperbolës, onomatopeve etj.; në nivelien sintaksor – me mbizotërimin e përsëritjes (së fjalëve, grupeve kuptimore, së skemave
së sintagmave apo frazave), e strukturave sintaksore tipike, si parataksa etj.

Le të japim disa shembuj:

Asonancë - Dimëri ha kashtën; gusht, e gunë; Ç'e do viçeja urovin?; Ja terra, ja laga!; Kruan tek s'i ha; Ku di dhia ç'është bari?; qan pylli për sëpatë; etj.

Konsonancë – ç'la dimëri të marrë mortëja? Gjete kishë ku të falesh; Bëjmë me fat, pa hithmë ndë plehë; Gjymës'e mijës pesëqind; s'ndahet marsi nga kreshmët; etj.

Rimë – Çonj një kashtë e gjenj gashtë; Diali pa lerë, kësula blerë; gjen shesh, pa bën përshesh; Barku firë s'kërcen mirë. \ Barku plot s'kërcen dot; Ferra e nis, ferra e grisi; Puno, o fat-zi! Hai o bark-stihi; etj.

Metaforë - Drit'e ziarr, o shpyrt o burrë; Iku nga shiu, ra ndë breshërë; mos u bën ur' e vik, të shkonjë i mirë e i lik; muri ka veshë; etj.

Metonimi - Dora vetë, mëma vetë; Hapi sytë, se t'i hapin; Perëndia i jep miellin, dialli i merr thesin; prish gjinë, arënon pëqinë; etj.

Hiperbolë - I riu, si veriu; etj.

Sinekdoka – Kush nuk kërcen në darsmë të botës; Puno, o fat-zi! Hai o bark-stihi; etj.

Përsëritja – As ndë thes, as ndë torbë; As pula kemi, as me dhelpërë zihemi; Dhia mish edhe capi mish; Ferra e nis, ferra e grisi; Ja fito të kesh, ja vdis të mos jesh; Jona, more jona; Ka keq e më keq; Keq me burrë, keq pa burrë; motëra jemi e shoqe s'jemi; etj.

Parataksë - Diali pa lerë, kësula blerë; Ku miza, ku shpretëka?; Ku pilaf, ay lugë; Pare me kamatë, petulla përnatë; prish gjinë, arënon pëqinë; prish kanaçe, bën bucelë; si rruarë, qethurë; etj.

---

[556] Po aty, f.17.

[557] Kështu te "Fjalët e urta të popullit shqiptar", f.17-18, paraqiten disa elemente të strukturës gjuhësore: "Te fjalët e urta popullore tërheq vëmendjen edhe mënyra e organizimit të gjuhës. ... Në raste të tjera kemi masë, ritëm, kadencë poetike, inversion të kësaj apo asaj natyre etj." ... proverbat përdorin me shumë guxim të gjitha liritë poetike, gjejnë një mori ritmesh, rimash, masash, kombinime vargjesh etj., që, ndonjëherë, nuk i hasim në poezinë e mirëfilltë."

Nga shembujt më sipër, shohim elementet karakteristike të artit gjuhësor popullor, ku kemi mbizotërimin e përsëritjes, në forma të ndryshme të saj, dhe duhet të kemi, gjithaq, parasysh se në artin gjuhësor popullor «strategjitë që lehtësojnë të kujtuarit e një mesazhi lidhen me "mbajtësit gjuhësorë ritmike", që fokusohen në formula që përsëriten vazhdimisht...[558]»; shohim mbizotërimin e parataksës[559] dhe redondancën e transmetimit të mesazhit gojor, i cili karakterizohet nga përsëritje të shumta, të temave[560], fjalëve, varianteve etj.

Ajo që bie në sy është se një pjesë e madhe e këtyre shprehjeve janë realizime të skemave ritmike të njëjta, formula që përsëriten, "mbajtës gjuhësorë ritmikë", të cilët mendojmë se janë të gjallë edhe sot, duke gjeneruar të tjera njësi në ligjërimin e përditshëm. Interesi ynë më tej, në një punim tjetër, do të jetë formalizimi i këtyre skemave, qoftë në nivelin e strukturave sipërfaqësore, qoftë në nivelin e raporteve semantike dhe të figurave tipike që i përftojnë. Ndryshe nga gjinitë e folklorit, të cilat nuk krijohen më sot në kushtet e zhvillimit të tipave dhe mjeteve të komunikimit në shoqërinë njerëzore, këto forma të artit gjuhësor, si fjalët e urta, njësitë frazeologjike dhe shprehjet popullore, të cilat i spikatëm sot, krijohen gjithnjë dhe skemat që i gjenerojnë janë të gjalla në kompetencën e jo vetëm të një kulture dhe bashkësie gjuhësore, por edhe atë të çdo folësi.

[558] "Communicare", vepër e cituar, f.17.

[559] "Communicare", vepër e cituar, f.16: për parataksan shkruhet, "pra një strukturë gjuhësore që shfaqet me lidhjen e fjalive të pavarura (pra, jo të bashkërenditura), tipike e lutjeve dhe e proverbave".

[560] "Fjalët e urta të popullit shqiptar", vepër e cituar, f.10 "Për këtë arsye janë krijuar një varg proverbash rreth të njëjtit problem, fenomen, situatë etj., që plotësojnë njëri-tjetrin dhe, në tërësinë e tyre, e japin mendimin popullor për këtë problem në gjithë gjerësinë e thellësinë e tij. Kemi kështu cikle të ndryshme proverbash sipas problemeve, çështjeve a shfaqjeve jetësore."

AGATA ROGOŚ (POZNANJ, POLONI)

MITI I GJUHËS NË LETËRKËMBIMIN E THIMI MITKOS NË DRITËN E NDËRTIMIT TË IDENTITETIT SHQIPTAR

Miti i gjuhës në traditën shqiptare ka të bëjë me disa kategori themelore të teorisë së nacionalizmit dhe të ndërtimit të identiteteve në kohën e Rilindjes Kombëtare, të cilat dukshëm kanë ndikuar në ndërtimin e kombit dhe, në të njëjtën kohë i kanë krijuar dhe i kanë ndërtuar sistemet e simboleve dhe të miteve në kohën moderne. Vetëdija kombëtare bashkë me ndërtimin e strumbullarit të identitetit ka ndryshuar shumë në një moment shumë të rëndësishëm për historinë e popullit shqiptar,prandaj miti i gjuhës do të ishte një nga ato shtresa të „vellos së mistershme" sikur përcaktohet nga Althusseri dhe Zhizhku, se funksioni i *ideologji-kritikës* nuk është vetëm për të parë ose përceptuar gjera, siç janë në të vërtetë, por, në fakt për të parë se si realiteti nuk mund të rrijë vetë pa këtë mistifikim, i cili vetë riprodhon kushte për të manipuluar me ideologjinë sunduese ose duke ndjekur Benedikt Andersonin se rrëfimi i bashkësisë së imagjinuar e përforcon unitetin e bashkësisë ose unitetin e një grupi.

Siç thekson Eric Hobsbawmi me këtë temë ballafaqohen format e identifikimit popullor në dimensione gjithëhapësinore, që kanë lidhje të ngushta politike si me shtetin dhe institucionet e tij, ashtu edhe me gjuhët e grupeve, që, në momente të caktuara mund të quhen lidhje universale dhe të përshtatshme.

Në këtë kumtesë do ta analizojmë zhvillimin e mendimeve të Thimi Mitkos rreth çështjes së gjuhës shqipe dhe të vlerësimit të saj në kontekstin e ndërtimit të identitetit kombëtar duke iu referuar edhe shkrimeve dhe mendimeve të intelektualëve tëtjerë të periudhës së Rilindjes Kombëtare, të cilët kishin po të njëjtin qëllim, ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare.

1. Miti i gjuhës shqipe është një nga mitet kombëtare më të rëndësishme në traditën shqiptare. Rrënjët e tij mund t'i kërkojmë shumë më herët se sa në kohën e Rilindjes Kombëtare, kur, në fakt ky mit, bashkë me mitet e tjera është ringjallur në kontekstin e ndërtimit të identitetit. Mitin e gjuhës shqipe mund ta perceptojme në disa shkallë, siç janë: çështja e etnonimit shqiptar dhe zhvillimin e tij, çështja e alfabetit dhe ndërtimi i strukturës bazë të gjuhës shqipe dhe, *last but not least*, në aspektin kulturor, i cili këtu na intereson më së shumti, si elementi bazë i identitetit kombëtar edhe në aspektin e nacionalizmit kulturor ose gjuhësor.

Në këtë pjesë e studimit vëmendjen do ta koncentrojmë rreth çështjës së mitit politik ose kombëtar në aspektin teorik, që do të na mundësojë t'i vështorjmëmendimet e Thimi Mitkos në kontekst më gjerë kulturor. Shaban Sinani,në analizën e tij për mitologjinë në traditën shqiptare shkruan: „...në të gjitha kohërat, prej lashtësisë antike deri në mijëvjeçarin e ri, miteve rregullisht u janë shtuar e ngatërruar gjatë rrjedhës së historisë gjithfarë mitologjemash. Ideologjia

dhe tregu kanë luajtur rolin parësor për gjinikimin e mitologjemave. Kjo lloj „mitologjie apokrife" shpesh në vështrimin estetik është ndërtuar aq ngjashmërisht me mitin, saqë dallimi i sipërfaqshëm është thuajse i pamundur[561]

Rrëfimët mitike tregojnë për dallimet e origjinës, sa mënyra grupesh kanë ndikuar dhe kanëluftuar me njëri-tjetrin në të shkuarën dhe në vijimësi. Ato mund të funksionojnë si zëvendësuese apo nënshtresa të dallimeve të vërteta. Mitet u mundësojnë anëtarëve të grupeve t'i asgjësojnë dhe injorojnë ngjashmëritë e dukshme duke i ulur proporcionet e dallimeve midis unit dhe tjetrit.[562]

Miti i gjuhës shqipe fillimisht ka të bëjë me mitin e origjinës, si elementi dallues, thekson Kolstø, midis unit dhe tjetrit. Është paraqitur që në kohën e Humanizmit dhe ka luajtur rolin kryesor në konstruimin e identitetit shqiptar.

Bronislaw Malinowski ka argumentuar se mitet zëvendësojnë numrin e funksioneve të domosdoshme në shoqëritë moderne dhe ato primitive, prandaj ato nuk do të zhduken as edhe sot me zhvilllimin modern të njerëzimit „. Funksioni i mitit, me një fjalë, ka përforcuar dhe pajisur traditën me autoritetin dhe vlerat më të mëdha përmes rivendosjes së tyre në një realitet më të mirë, më të ngritur dhe sa më të natyrshëm. Miti, pra, është përbërësi i domosdoshëm për ta mbajtur gjallë dhe për t'i dhënë shpresë etnitetit në të gjitha kulturat".[563]

Prandaj edhe këtu, nëse bëjmë një lloj krahasimi midis teorisë antropologjike të një studiuesi të shquar polak, i cili ka punuar në një ambient tjetër; situatën e funksionit të mitit në traditën kulturore shqiptare mund ta strukturojmë pa pasur problem qoftë politik, qoftë kombëtar dhe ta saktësojmë për t'i përsëritur fjalët e Malinovskit si „përforcim i traditës me autoritetin". Prandaj mund të themi se miti i gjuhës në traditën shqiptare u bë strumbullari i identitetit, i cili është zhvilluar si nocion shumë i fortë gjatë shekujve, që nga periudha e Humanizmit deri në Rilindjen Kombëtare dhe është duke vazhduar në shekujt XX e XXI.

Miti është një rrëfim i treguar dhe i ritreguar për përfaqësuesit e bashkësisë, për konfliktet e brendshme dhe të jashtme, por edhe për zbërthimet e tyre. Ky është rrëfim i vertëtë, përsa i përket kujtimeve të ngjarjeve, të cilët, në një farë mënyre, e kanë formuar bashkësinë dhe renditjen e saj përmes shfaqjes së forcimit të besimeve dhe normave. Në të njëjtën kohë miti e tejkalon të vërtetën e ngjarjeve, sepse miti nuk është historiografi.[564]

---

[561] Sinani,Shaban. *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, Tiranë, 2011, 363

[562] Kolstø, Pål . Assessing the role of historical myths in modern society: *Myths and Boundaries in South-Eastern Europe*, ed. Pål Kolstø, London, 2005,3-4

[563] Malinowski, Bronislaw *Myth in Primitive Psychology*, ribotuar: Robert A. Segal, *Theories of Myths*, New York, vëllim 2, 1996,101, 146

[564] Puntscher, Riekmann, Sonja, *The Myth of European Unity*: *Myths and Nationhood*, ed. Geoffrey Hosking, George Schöpflin, London, 1997, 61-62

Sipas mitit nacionalist, gjuha është baza e vetëdijes së kombit. Në njërin aspekt mund t'i referohemi çështjes së artefaktit kulturor[565] . Mbështetur në konstatimin e Wittgensteinit se gjuha është një trashëgimi, edhe ne, në analizën tonë, gjuhën do ta trajtojmë si artefakt kulturor dhe jo vetëm si formë të shprehjes apo si një mjet komunikimi. Gjuha si vlerë kryesore është një njësi simbolike brenda sistemit të simboleve. Gjuha nuk është kuptuar si lëndë e hulumtimit gjuhësor, por këtë aspekt funksional e krahasojmë me konceptin e „atdheut", i cili në vetvete përmbledh një dimension simbolik të ekzistimit të njëteritori të veçantë.

Në anën tjetër, gjuha është një mjet komunikimi për anëtarët e njëgrupi të caktuar. Gjithësesi bashkë me atdheun, i cili është përcaktuar si një territor specifik, ku në të dyja aspektet gjuha zhvillohet në nivelin e saj të përdorimit utilitar dhe të funksionimit të simboleve të cilat kanë rëndësi[566] Pamja gjuhësore është interpretim i realitetit, përfshirë këtu edhe gjuhën me variantet e saj të ndryshme, të cilat mund të përcaktohen si përmbledhje e gjykimeve për botën. Sipas Tokarskit: „çdo gjuhë mund ta konceptualizojë realitetin e njeriut në mënyra të ndryshme, për shkak të nxitjes, lehtësimit dhe sugjerimit të interpretimit tipik të botës për një kulturë të përcaktuar"[567]

Auerbachu, në mënyrë të shkëlqyer e përshkruan ndikimin e Humanizmit mbi ndërtimin e identitetit në momentin kur nis zanafilla e humanizmit në vetëdijen shoqërore. Në atë kohë është përhapur edhe ideja e mitologjisë dhe e historisë antike, bashkë me predikimet biblike,të cialt ishin kufizuar gjatë asaj kohejo vetëm nga shkaku i kohës së shkuar, por edhe nga shkaku i kushteve të ndryshme jetësore. Humanizmi traditën antike e ka parë si korrigjim të historisë në perspektivën kohore. Zhvillimi i ashtuquajtur histori krahasimtare ka bërë që krijimi i konceptit të „modernizmit" më vonë të bjerë në kundërshtim me traditën e „antikitetit".

Tashmë sipas Herodotit „grekët kanë qenë një popull, sepse kishin prejardhjen, gjuhën, zotët dhe vendet e shenjta, festat, zakonet dhe normat e përbashkëta" (....).

Historia e gjuhëve është historia e popujve që i flasin a i kanë folur. Popujt e kombet gjatë jetës që bëjnë si popuj, si kombe kanë fatet e tyre historike e politike. Ata gjatë historisë së tyre zhvillojnë mënyrën e jetës e të mendimit. Ndryshojnë marrëdhëniet ekonomike e shoqërore, idetë politike, institucionet fetare etj. Gjithashtu, me kohë zhvillohet mënyra e jetesës, mënyra se si banojnë, si hanë e si vishen, edhe mënyra e trajta e të menduarit. Të përshkruash zhvillimin e gjithë

[565] Haugen, Einar , Language Conflict and Language Planning: *The Case of Modern Norwegian*, Harvard University Press, 1966.

[566] Molas, Jerzy, Language and territory as core values in serbian, croatian and bosnian tradition: *Sprawy Narodowościowe*. *Terytorializm i Tożsamość*. *Bałkany słowiańskie i niesłowiańskie*, Seria nowa, r. 2007, z. 31, ed. Jolanta Sujecka, Poznań – Warszawa,2007, 202

[567] Kawka, Maciej. Językowy obraz Macedończyka w najnowszej: „Historii narodu macedońskiego": *Tożsamość narodowa w społeczeństwie multietnicznym Macedonii*, Kraków. 2000,9-10.

këtyre trajtave të jetës së një populli, do të thotë të shkruash historinë e tij. Po një nga këto trajta është gjuha.[568]

Gjuha në kuptimin herderian si e folme e popullit ose të themi e kombit (Volk), nuk ka qenë faktor kryesor në procesin e ndërtimit të vetëdijes paranacionaliste, por siç thekson Hobsbawmi s'mund të themi se ka qenë krejt e pa rëndësishme. Në mënyrë indirekte u bë shtyllë e definicionit modern të kombit. Pra, aty ku ekziston gjuha e elitave intelektuale ose administrative bile-bile edhe te një numër i vogël i folësve, mund të zëvendësohet në elementin e ndërtimit të unitetit paranacionalist.

Gjuhët e shkruara e kanë krijuar vetëdijen kombëtare në tri nivele. *Së pari* e kanë formuar fushën e komunikimit midis latinishtes dhe gjuhëve të folura amtare. Folësit të cilët nuk kishin mundësi për të komunikuar në gjuhën e tyre mund ta gjenin kuptimin përmes shtypit dhe letrës. Kjo i ka bindur se ka miliona përdorues të të njëjtës gjuhë dhe se të gjithë i përkisnin hapësirës gjuhësore. Ata folës kanë krijuar bërthamën e bashkësisë kombëtare si një bërthamë e imagjinuar dhe një padukshmëri të dukshme. *Së dyti* shtypi e ka thelluar njohjen e gjuhëve dhe ka zhvilluar vizionin e lashtësisë që ka qenë me shumë rëndësi për idenë subjektive kombëtare. *Së treti* ka krijuar një gjuhë të pushtetit, e cila është dalluar prej gjuhëve të vjetra të administratës.[569]

Pra, në të gjitha lëvizjet kombëtare çështja e gjuhës së shkruar ka marrë ngjyrim të rëndësishëm politik dhe ideologjik. Johann Gottfried Herderi në fund të shekullit XVIII pat konstatuar: „Denn jedes Volk ist Volk; es hat seine National Bildung wie seine Sprache".

Çdo popull, sipas Herderit, ka dhe duhet ta zhvillojë shpirtin e tij karakteristik. Kështu, Herderi te bashkëqytetarët e tij ka nxitur kthimin e traditës kulturore lokale dhe rizbulimin e shpirtit kombëtar të letërsisë së tyre: „Ecim në rrugën tonë /…/ Le të flasin të tjerët mirë apo keq për kombin tonë, letërsinë tonë, gjuhën tonë: ato janë tonat, ato jemi ne dhe kjo duhet të na mjaftojë"[570].

Koncepti herderian, pra, ka qenë mendim i krijuar në fushën e letërsisë dhe jo rezultat i përvojave jetësore. Pyetja tjetër është në gjuha, siç konstaton Hobsbawmi në kontekstin shqiptar do të jetë edhe një nga faktorët e identifikimit apo faktori kryesor?

Bashkësinë e komuniteteve mund ta përcaktojmë, sipas Benedict Andersonit si *bashkësinë e imagjinuar.* Duke përqasur pikëpamjen e Eric Hobsbawmit, me këtë temë ballafaqojmë format e identifikimit popullor në dimension gjithëhapësinor, me lidhjet politike dhe gjuhët e grupeve të cilët janë tëlidhur ngushtë me shtetin dhe institucionet e tij,
mund të universalizohet dhe bëhet e përshtatshme në momentin e caktuar.

---

[568] Çabej, Eqrem. *Studime Gjuhësore, vëll. III*, Prishtinë, 1976.
[569] Anderson, Benedict. *Wspólnoty wyobrażone*. Rozważania o źródłach i rozprzestrzenianiu się nacjonalizmu, Kraków. 1997,54-55
[570] Smith,Anthony D. Nacjonalizm. Teoria, ideologia, historia, Warszawa, 2007,43.

Shtrohet pyetja sa rendësi ka gjuha në ndërtimin e identitetit dhe konstituimin e lëvizjeve të popujve paranacionalistë dhe, si rezultat i këtyre proceseve në ndërtimin e nacionalizmit gjuhësor ose kulturor?

2./Periudha e Rilindjes Kombëtare – AR/ karakterizohet kryesisht nga përpjekjet për një zhvillim konvergjent të gjuhës së shkruar. Këto përpjekje, që nisin qysh në kohën e Lëvizjes Kombëtare të Rilindjes, marrin një hov të madh dhe bëhen më të vetëdijshme sidomos pas vendosjes së pushtetit popullor në Shqipëri, kur u krijuan edhe kushtet objektive për zhvillimin e një gjuhe letrare të njësuar me norma të përpunuara për të gjitha nënsistemet. Gjatë kësaj periudhe vihet re një ndikim gjithnjë e më i fuqishëm i gjuhës së shkruar mbi gjuhën e folur, çka e ka përshpejtuar procesin e afrimit ndërdialektor.[571]

Rilindësit kishin shpallur moton: „...shkronjat e gjuhës së mëmës janë drita e perëndisë, që ndriton dhe sjell begatinë e popullit“. Në kohën e tyre gjuha ka marrë vendin e elementit bazë të nacionalizmit kulturor,të cilin mund ta quajmë edhe nacionalizëm gjuhësor ose filologjik. Me formimin e alfabetit lind edhe çështja e shkrimit dhe e botimit të librave shqipe, të cilat do të sillnin zhvillimin kulturor të masave popullore, ngritjen e ndërgjegjes patriotike dhe mobilizimin e masave drejt qëllimeve të larta kombëtare. Identifikimi i kombit me gjuhën, që krijohet nga suksesi i nacionalizmit gjuhësor, kërkon ndikim mbi politikën e shtetit ose së paku pranimin e statusit të saj zyrtar. Në qendër të mendimit të nacionalizmit gjuhësor është çështja e pushtetit, e statusit, e politikës dhe e ideologjisë dhe jo e komunikimit ose e kulturës.

Po të flitet në një mënyrë jospecifike, lidhur me raportet midis gjuhës dhe kombit (shtetit) shpesh ndeshen dy qëndrime të kundërta: qëndrimi sipas të cilit „kombi ekziston sepse ka një gjuhë”, identitetin e kombit e derivon nga gjuha, në të kundërtën e qëndrimit, sipas të cilit „kombi ekziston, pra duhet t’i japim një gjuhë”, që domethënë se identiteti kombëtar paraekziston, ndërsa gjuha vjen si element që e shoqëron atë.

Sadoqë shtetet-kombe të Evropës i kanë shpallur gjuhët e tyre kombëtare, që shpesh janë barazuar me gjuhën shtetërore, ndonjëherë është folur për gjuhë të qytetërimit, zhvillimet në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të fundit kanë qenë të atilla që kanë dëshmuar vazhdimisht rritjen e numrit të shteteve-kombe, ashtu si të gjuhëve, u quajtën ato kombëtare, të përbashkëta, standarde, apo ndryshe.[572]

Pierre Bourdieu, sociolog frëng, proceset e sipërpërmenduara i quajti*prodhim dhe riprodhim i gjuhës së legjitimuar* në fushën e raporteve shoqërore lidhur me gjuhët standarde.[573]

Në procesin e krijimit të gjuhës, elementet kryesore janë: elementi politik dhe ideologjik. Ai mund të bazohet mbi standarizimin e gjuhëve që janë përdorur në

[571] Demiraj, Shaban. *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988,210
[572] Ismajli, Rexhep. *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005,251.
[573] Bordieu, Pierre . *Language and Symbolic Power*, Harvard University Press, 1975,23.

kulturë ose ndërtimi i gjuhëve nga format dialektore ose ringjallja e gjuhëve të vdekura që do të thotë ndërtim i gjuhëve të reja.

Gjuhët bëhen më shumë e më shumë mjete të inxhinierisë shoqërore, ku kuptimi simbolik i tyre mbizotëron ndaj përdorimit të saktë. Megjithatë, edhe pse gjuhët janë simbole të aspiratave të kombit, ato kanë edhe zbatime të ndryshme praktike e shoqërore.

3. Për të ngritur dinjitetin e gjuhës amtare, Mitkoja shkruante në parathënien e Bletës: „Shqiptarët /.../ do të mundin të ndriten edhe të humbasin ngjyrën e padijes vetëm dyke studiuar gjuhën e tyre amtare. Gjuha amtare është ushqimi i parë e i përbashkët që i jep gjallësi popullit".[574]

Letërkëmbimi i Mitkos me De Radën(dhe intelektualëtëtjerë) sjell një jehonë të gjallë të ngjarjeve, problemeve dhe shqetësimeve të Rilindjes.[575] Nga ky letërkëmbim ndjehet roli i Mitkos, si një nga propagandistët më aktivë të çështjes shqiptare në rrethet politike ndërkombëtare.

Kërkesa e ideologëve shqiptarë të Rilindjes Kombëtare për alfabetin latin, i pranuar edhe nga Mitkoja, në fund të karierës së tij dhe jo për alfabetin arab ose grek, nuk kishte të bëjë me poshtërimin e saj në kontekstin e kulturave turke ose greke, por shkrimi turk dhe grek ishte i parëndësishëm për qerthujt shoqërorë që nuk kishin mundësi të lexojnë fare.

Në kushte të tilla gjuha ka qenë elementi më i unifikuar dhe më i besueshëm për popullin, ku në rastin e kundërt do të binte në belá duke u sunduar prej fuqive centrifugale të rrezikshme. Edhe pse çështja e gjuhës dhe e arsimit në fushën e gjuhës shqipe kishte marrë vendin kryesor për lëvizjen kombëtare shqiptare, e cila shumë shpejt ishte shndërruar nga një çështje e thjeshtë e Rilindjes në një çështje politike.[576]

Në krijimtarinë e Thimi Mitkos mund t'i gjejmë elementet kryesore të mitit të gjuhës shqipe. Siç theksonte Qemal Haxhihasani: „Ai kish theksuar vazhdimisht rëndësinë e gjuhës si element dallues kryesor të kombësisë; kish shtruar si kërkesë të domosdoshme të kohës
edukimin e popullit me kulturën kombëtare, me gjuhën dhe shkronjat shqipe".[577]

Në „manifestin" e tij, siç mund ta quajmë parathënien e *Bletës Shqiptare* të Mitkos, ai ka shprehur në mënyrë shumë të qartë mendimin për rëndësinë e gjuhës në ndërtimin e identitetit kombëtar dhe në zhvillimin e traditës kulturore shqiptare: „veçanërisht dua që t'u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për

[574] Mitko,Thimi .*Vepra*, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë,1981,61
[575] Haxhihasani,Qemal .*Thimi Mitko*, Tiranë, 1962,37
[576] Schwander-Sievers, Stephanie,Fischer, Bernard J. (ed.) *Albanian identities. Myth and history*, ed., Indiana University Press,2002,41.
[577] Haxhihasani,1981, vep. e cit. 25

kulturën edhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare; në këtë mënyrë t'u sjell dobi që të mundin edhe këta të përparojnë"[578]

Duke ndjekur ideologjinë herderiane ai rolin e gjuhës e ka theksuar si faktor kulturor, mbase si faktor të ndërtimit të kombit modern:

„Një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dale nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet thotë Herderi. Edhe shqiptarët, si gjenden tani të ndarë në mohamedanë edhe të kërshterë, dhe këta në katolikë edhe ortodoksë, do të mundin të ndriten edhe të humbasin ngjyrën e padijës së tyre vetëm duke studiuar gjuhën e tyre amtare. Gjuha amtare është ushqimi i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit" [579]

Mitkoja ngre një çështje me rëndësi themelore për zgjimin kulturor dhe politik të bashkadhetarëve: nevojën e shkrimit lirisht të gjuhës dhe me një alfabet të vetin, nevojën e edukimit me shkolla dhe me kulturën kombëtare, nevojën e botimit të një organi periodik, të fjalorëve dhe të librave në gjuhën amtare, të mëkëmbjes të një sistemi arsimor që t'i shërbente zgjimit politik e kulturor të popullit.[580]

Në letrën që Mitkoja i shkruante Kristoforidhit, në mars viti 1872, duke e lëvdruar veprimtarinë e tij, ka theksuar në mënyrë shumë të qartë domosdoshmërinë e gjuhës amtare në ndërtimin e kombit shqiptar:

I kam parë me kujdes të gjitha letrat dhe, duke ju lëvduar për zellin tuaj për atdheun, i përshendes idetë e drejta, të mbeshtetura mirë dhe mjaft praktike, nga të cilat jeni i frymëzuar lidhur me qytetërimin natyral dhe rrënjësor të Shqipërisë, që mund të bëhet vetëm e vetëm nëpërmjet gjuhës amtare.[581]

Pak më poshtë,po në të njëjtin shkrim ai ka shprehur nevojën e botimit të fjalorit dhe të gramatikës shqipe, për ta ruajtur traditën dhe gjuhën amtare, të cilat, sipas tij ishin në pragun e harresës: „...prandaj lutem nga zemra, që të kini mundësinë të botoni samë parë të jetë e mundur, fjalorin e gjuhës shqipe dhe gramatikën, në mënyrë që gjuha jonë të dalë në dritë përpara se sa të humbasë pak nga pak".[582]

Në letrën e qershorit 1879, që Mitkoja ia shkruante Fr. Krispit i përforconte kërkesat e tij për nevojën e ndërtimit të kombit me gjuhën e vet zyrtare,të cilat kishin të bënin me mendimin nacionalist, i cili ishte shumë i natyrshëm në kohën e Mitkos. Kjo letër ka domethënie shumë të madhe për krijimtarinë e ideologjisë së Mitkos dhe për zhvillimin e ideve kombëtare dhe nacionaliste në kohën e Rilindjes Kombëtare. „Megjithatë do të më lejoni të ju kujtoj se është nevojë absolute që Shqipëria të fitojë sot gjuhën dhe kombësinë dhe të sigurojë kufinjtë e natyrshëm të Atdheut të saj".[583]

[578] Mitko, 1981, vep. e cit.
[579] Po aty, 61.
[580] Haxhihasani,1981, vep. e cit. 21-22
[581] Mitko, 1981, vep. e cit.
[582] Mitko, 1981, vep. e cit.616
[583] Po aty, 632

Miti i gjuhës në letërkëmbimin e Mitkos mund të përceptohet akoma më ifortë nëse e kemi parasysh kontekstin politik dhe historik,si dhe pozitën e vetë autorit në dritën e marrëdhënieve shqiptaro-greke në atë kohë. Në veprimtarinë e Mitkos mund ta hetojmë zhvillimin e mendimeve rreth çështjes shqiptare në raport me Greqinë dhe ndikimet e kulturës greke. Në atë kontekst, miti i gjuhës është element i diskursit politik, i cili ka të bëjë me raportet midis gjuhës kombëtare (zyrtare) dhe ndërtimit të kombit (shtetit). Bindja e Thimi Mitkos për nevojën e ndërtimit të sistemit gjuhësor si shkallae parë e strukturalizimit të sistemit shoqëror dhe politik ishte shprehur shumë qartë në letrën që ia kishte shkruar Zhapës në mars 1880:

Që ta konsideroni Shqipërinë si një pjesë të pashkëputur të Greqisë, kjo është një ide që jua nxit ndjenja e zemrës suaj /…/. Por që të arrihet kjo, kërkohet më parë zhvillimi moral i Shqipërisë me anë të gjuhës së vëndit, domethënë të këtij mjeti të vetëm natural të qytetërimit të çdo kombi /…/.

Lejomëni, pra, o bashkadhetar shumë fisnik, të ju them me guxim patriotk, se ju, si një bamirës i madh i grekëve kini mundësinë sot, kur shqiptarët, muhamedanë e të krishterë, u ngritën njëzeri, si prej providencës hyjnore dhe kërkojnë, pos së tjerave, edhe shkrimin e gjuhës së tyre, mundeni, them, ta flakni tej këtë iluzion të mallkuar mesjetar të mohimit tëarsimit, duke hapur shkolla shqipe në tërë Shqipërinë.[584]

Çështja e alfabetit dhe e shkollimit në gjuhën amtare ka qenë një nga hallkat më të gjalla në letërkëmbimin e Mitkos me De Radën. Çështja e shkollës dhe e librit shqip ngriti një tjetër problem të rëndësishëm, që shkaktoi rrahje mendimesh e polemikash të ashpra për një kohë të gjatë midis patriotëve të Rilindjes, çështjen e alfabetit. Në fillim Mitkoja, për shkak të kulturës që kish marrë në rini të tij dhe të marrëdhënieve që pati me njerëz që ishin nën ndikimin e kulturës greke, e shtroi çështjen e shkronjave shqipe në një mënyrë jo të drejtë: „Toskët të vazhdojnë shkrimin e shqipes me alfabetin grek, kurse gegët me atëlatin“[585]

Në dorëshkrimet e tij të fundit, në materialet folklorike që u gjendën në arkivin e Jarnikut, Mitkua ka përdorur alfabetin e adaptuar për shqipen nga albanologu gjerman G. Majer (alfabet latin me shenja diakritike dhe shkronja të veçanta). Kjo tregon se, në vitet e fundit, Mitkua u largua përfundimisht nga ideja e të përdorurit të shkronjave greke për shqipen.[586]

Mendimet për alfabetin dhe shkollimin në gjuhën amtare ishin aq të gjalla në letërkëmbimin e Mitkos, edhe pse, në vjeshtën e vitit 1869, në vazhdën e po asaj krize, qeveria osmane shpalli një plan për arsimin në gjuhët kombëtare. Duke përfituar nga kjo, edhe shqiptarët e ngritën menjëherë komisionin për shqipen, sepse çdo gjë ishte e përgatitur nga koha. Kështu saktësohet edhe kjo datë me rëndësi: Komisioni për alfabetin e shqipes është ngritur në nëntor 1869. Për shkak të

[584] Po aty, 636-637
[585] Haxhihasani, 1962, vep. e cit. 63.
[586] Po aty,63

diskutimit të madh rreth çështjes së alfabetit të shqipës në qarqet intelektuale edhe Mitkoja ka shprehur disa herë mendimin e tij duke i shkruar De Radës në qershor 1882:

Do të jetë fort një pun' e mirë të hapni typografinë e të dali një ditare mbi gjuhë tënë; po të jetë me shkresat (lettere) e Samiut, mbase s'ju mundet (*forse non vi e possible*). Ama pa fjalë duhet të jet' edhe mbë gjuhë ja frëngjisht, ja italisht – jo vetëm shqyp. Kështu kupëtohet mirë.[587]

Përfundim

Në këtë kumtesë kemi analizuar nga pikëpamja historike, antropologjike, sociologjike dhe kulturore çështjen e gjuhës shqipe dhe mitin e saj në kontekstin e ndërtimit të identitetit dhe ndërtimin e lëvizjeve të popujve paranacionalistë dhe kjo si rezultat i këtyre proceseve në ndërtimin e nacionalizmit gjuhësor ose kulturor.

Në mënyrën kritike dhe analizuese i kemi përshkruar proceset historike dhe mitologjizuese të ndërtimit të vetëdijës kombëtare shqiptare në kohën e Rilindjes Kombëtare, duke përqendruar vëmendjen rreth çështjes së gjuhës, si elementi bazë i ngritjes së identitetit shqiptar. Raportet midis gjuhës dhe shtetformimit, të cilët janë tregues për rëndësinë e këtij elementi në zhvillimin e diskursit politik dhe kombëtar, si kemi theksuar, ishin shumë të dukshëm në krijimtarinë e qarqeve intelektuale në shekullin XIX, sidomos në shkrimet e Thimi Mitkos.

Miti i gjuhës shqipe ishte shprehur në veprimtarinë e Thimi Mitkos shumë fort dhe se çështja e gjuhës shqipe në kontekstin e ndërtimit të identitetit kombëtar ka qenë shumë i gjallë në mendimet e Mitkos, i cili ishte futur shumë thellë në diskursin më të gjerë të disputës për çështjen e gjuhës mes Rilindësve.

Mitkoja qe nga luftëtarët e parë që punoi me devotshmëri për të ngjallur te bashkadhetarët dashurinë dhe sedrën për gjuhën amtare, për të krijuar te ata bindjen se gjuha shqipe është një nga gjuhët më të lashta të Ballkanit, më të bukurat, me aftësi shprehëse nga më të pasurat, me të gjitha mundësitë për t'u ngritur në shkallën e një gjuhe të lartë kulturore.

[587] Mitko, 1981, vep. e cit.657

AGRON XHAGOLLI (TIRANË)

FJALORËT E THIMI MITKOS NË VËSHTRIM ETNOKULTUROR

Fjalorët kanë rëndësi dhe vlera të shumta dhe të gjithanëshme. Midis të tjerash, duhet përmendur fakti se ata janë edhe një burim i terminologjisë dhe i praktikave etnokulturore. Ndaj mund të shprehemi se nxjerrja në pah dhe pasqyrimi i termave konkretë prej tyre pasqyron realitete etnokulturore të atyre periudhave historike kur është hartuar secili fjalor. Mbi këtë bazë vlerësuese kemi përzgjedhur temën e përcaktuar, duke qenë të bindur se kemi të bëjmë me një rrugë që duhet ndjekur në përgjithësi nga studiuesit e fushave etnokulturore.

Thimi Mitkoja deri vonë është njohur dhe konsideruar kryesisht si babai i folkloristikës shqiptare. Në tërësinë e veprës së tij spikat mbledhja dhe botimi i përmbledhjes më të gjerë, më përfaqësuese të folklorit shqiptar deri në vitin 1878, "Bleta shqiptare". Krahas, ka pasur edhe informacione të ndryshme, të cilat dëshmonin se përveç kësaj pune shumë të vyer dhe të vlerësueshme, ai kishte mbledhur edhe disa materiale me interes gjuhësor, ka shkruar dhe botuar artikuj dhe krijime poetike, ka një korespondencë të pasur me patriotë të dalluar, miq apo studiues, me të cilët kishte bashkëpunim. Dhe, sa përmendëm, i gjejmë të pasqyruara më së miri te "Thimi Mitkoja. Vepra", përgatitur nga Q. Haxhihasani dhe botuar në vitin 1981. Por, gjithsesi, ndihmesat e Mitkos në disa fusha të dijes nuk kanë qenë të njohura në përmasat reale të saj.

Kohët e fundit kanë rënë në duart e studiuesve, por edhe të njerëzve të tjerë të interesuar, dy botime të mira, që dëshmojnë konkretisht punën e madhe që ka bërë Th. Mitko edhe në fushën e gjuhësisë shqiptare dhe më gjerë. Fjala është për dy vëllime të autorëve: Shpëtim Sala, *"Fjalori italisht - greqisht – shqip i Thimi Mitkos"*[588]*,* ku jepen dorëshkrimi origjinal, transliterimi, fjalësi shqip, si edhe vepra e titulluar: *Thimi Mitko, "Fjalëtore shqip – gërqisht, gërqisht – shqip dhe ndihmesa të tjera gjuhësore"*, përgatitur nga Dhori Q. Qirjazi[589].

Natyrisht që këto botime e pasurojnë së shumti gjerësinë e veprimtarisë së realizuar nga Th. Mitkoja. Krahas vlerave të natyrës gjuhësore, duhet thënë se botimet e reja mund të kundrohen dhe të vlerësohen edhe nga një këndvështrim tjetër, pikërisht në aspektin e ndihmesës që ato sjellin edhe për etnokulturën shqiptare në përgjithësi. Për të pohuar këtë nisemi nga fakti se, jo vetëm historia e etnokulturës shqiptare në përgjithësi, por edhe pasqyrimet e dokumentimeve konkrete me shumë vlerë mund të përcillen nisur edhe nga dëshmi të autorëve të ndryshëm, në kohë të ndryshme. Duhet thënë se ka mjaft botime që paraqiten në

[588] *Thimi Mitko. Fjalor italisht-greqisht-shqip, I, II,* Qendra Mbarëkombëtare e Koleksionistëve Shqiptarë, përgatiti: Shpëtim Sala, West Print, Tiranë, 2013.

[589] *Thimi Mitko. "Fjalëtore shqip-gërqisht; gërqisht-shqip & ndihmesa të tjera leksikografike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, përgatitja e dorëshkrimeve për botim dhe studimi hyrës nga Dhori Q. Qirjazi, Tiranë, 2014.

përmasa të pëlqyeshme dhe të mirëpritura, të cilat mund të shërbejnë edhe si një pikënisje për çdo studiues të etnokulturës shqiptare, që dëshiron të merret me traditat më të hershme. Dhe midis këtyre botimeve kanë vendin e vet, duke sjellë një ndihmesë shumë të rëndësishme për etnokulturën shqiptare, edhe veprat e Thimi Mitkos, të cilat i përmendëm më lart. Pikërisht ndihmesa e fjalorëve të Mitkos për etnokulturën shqiptare është objekt i trajtesës në këtë parashtresë.

Njohja dhe shfrytëzimi i një pasurie kaq të vlerëshme, siç është etnokultura, ka gjithmonë autorët e vet të caktuar, të njohur. Do të përmendnim faktin se nga Frang Bardhi folkloristë dhe etnologë të ndryshëm kanë pasur parasysh dhe kanë shfrytëzuar në mënyrë të pjesëshme elemente nga dëshmitë e sjella prej tij, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kështu, A. Gjergji, ndër të tjera, duke trajtuar veshjet popullore, nisur prej fjalorit të tij, sjell në qendër të vëmendjes përcaktimet që ka shënuar për elemente apo pjesë të ndryshme të tyre.[590] M. Tirta, gjithashtu, në punime të ndryshme të tij u referohet herë pas here burimeve të dëshmuara nga Bardhi.[591] Po kështu, R. Sokoli citon shpesh herë në punimet e tij për organologjinë dëshmi të sjella nga F. Bardhi. Ndër të tjera, ai kur
sjell emërtimin e veglave muzikore, midis fjalorëve të shfrytëzuar citon edhe atë të F. Bardhit.[592]

Megjithatë, duhet thënë se deri më sot mungojnë trajtesa përgjithësuese në përmasa të gjera rreth dukurive etnokulturore shqiptare të përcjella përmes veprës së trashëguar nga autorë të ndryshëm, të cilët, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë janë marrë me problematika të kësaj natyre, pasi përmes punëve në fusha të tjera kanë sjellë mundësi e dëshmi konkrete për t'u përfshirë në interesimet e studiuesve. Ka mjaft botime që paraqiten në përmasa të pëlqyeshme dhe të mirëpritura, të cilat mund të shërbejnë edhe si një pikënisje për çdo studiues të etnokulturës shqiptare, që dëshiron të merret me traditat më të hershme. Midis këtyre botimeve kanë vendin e vet, duke sjellë një ndihmesë shumë të madhe e të rëndësishme për etnokulturën shqiptare, edhe veprat e Thimi Mitkos. Dhe në këtë rast të mirë paraqitjeje, do të përqëndrohemi pikërisht në ndihmesën e fjalorëve të Mitkos.

Nisur nga puna shumë e vlerëshme e autorëve Sh. Sala dhe Dh. Q. Qirjazi, që cituam më lart, për të nxjerrë në dritë leksikun e gjuhës shqipe të përdorur nga Th. Mitkoja, kemi mundur që të realizojmë përzgjedhjen e një fjalësi, me të gjithë ata terma që vijnë dhe shprehin përbërës të ndryshëm nga fusha të kulturës popullore shqiptare, nga leksiku i plotë i shqipes, që është nxjerrë nga fjalorët e Mitkos. Mund të theksojmë se te "Fjalori italisht – greqisht – shqip" Mitkoja ka sjellë edhe fjalorin tematik, një ndihmesë mjaft e madhe për studiuesit, pasi në të ka të përcaktuar një

[590] A. Gjergji, *Veshjet popullore shqiptare*, Akademia e Shkencave, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1998.
[591] M. Tirta, *Etnologjia e shqiptarëve*, Geer, Tiranë, 2003.
[592] R. Sokoli, *Gjurmime folklorike*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1981, f. 368.

shumësi tematikash të natyrës etnokulturore. Janë kështu në tërësinë e punës së Mitkos me fjalorët e tij, një numër vërtet i konsiderueshëm termash që dokumentojnë praninë e dukurive apo praktikave të ndryshme etnokulturore përmes fjalësit të përzgjedhur. Këto vlera të punës së tij, jo vetëm shërbejnë për të përcaktuar se cilat janë dukuritë etnokulturore në atë kohë, por mund të shërbejnë, njëkohësisht edhe për studime të planit krahasues me botimet e mëparshme, konkretisht me autorët e vjetër të gjuhës shqipe, gjë që pastaj do të dëshmonte vazhdimësinë e dukurive etnokulturore, harrjet apo bjerrjet, pasurimin apo ndryshimin e terminologjisë etnokulturore nga koha në kohë.

Konkretisht, mund të themi se na përcillen informacione për prani etnokulturore, përmes fjalorëve të Mitkos, nga fusha të veçanta. Mund të përmendim fillimisht praninë e termave që përcjellin **figura mitologjike**, si: lipath-dhi (dhi; qenie mitologjike e pangopur), lash-i (i stërmoçëm, i kryehershëm), kulçedrë apo klëshedhrë, krahas kuçedrë, që e përcakton demon, gjarpër mitologjik), goçë (përbindësh mitologjik), dragua-goj-i (gjarpër i madh), div-i dhe dif-i (gjigant), diall-i (djall), krahas baal, bali (djall), fatia (fatitë qenë tri...), fani (shfaqje e një qenieje më të lartë, kur shfaqen engjëj dhe frymë të tjera mirëbërëse a keqbërëse), hyjni-ja apo dhe hyiri-a (hyj), bigan-i (gjigant), magji-ja (magji), magjishtar-i (magjistar), care-ja (magjistare, shtrigë), bushi (stihi, gogol për të vegjlit), bubë-a (bishë mitologjike), gogë-a (përbindësh i mitologjisë) etj.

Nga këqyrja e këtyre termave që shënojnë figura të caktuara mitologjike dëshmohet fakti se midis tyre ka edhe një numër syresh rreth të cilave nuk ka pasur dijeni nga etnologët e interesuar rreth ekzistencës së këtyre figurave. Një gjë e tillë, që dëshmon një pasuri mitologjike shumë më të pasur ndër shqiptarë, mundëson që të kërkohet ende në mjedise të ndryshme, me shpresën se mos mund të merret një informacion më i plotë dhe më i hollësishëm rreth figurave të tilla mitologjike, si: lipath, lash, goçë, fani, bigan, bushi, care etj.

Nëse u hedhim një sy krahasueshmërisht figurave mitologjike që shënon F. Bardhi, vemë re se në periudhën e Mitkos kanë pasur përdorim në vazhdimësi figura të tilla, si: *djalli, engjëlli, kulshedra,* etj. Krahas, do thënë se në fjalorët e Mitkos mungojnë një numër nga fjalësi i figurave mitologjike, të përfshira nga Bardhi në fjalorin e tij, si: çirka, xhudhinj etj[593]. Një dukuri e tillë mund të shpjegohet si me gjerësinë e kërkimeve në terren, ashtu dhe me trajtat dialektore të termave për mitologjinë, si dhe, ndoshta, me daljen nga qarkullimi të fjalëve apo termave të caktuar.

Shumica e termave që janë përfshirë në fjalorët e Mitkos vijnë nga fusha të ndryshme të jetës njerëzore. Gjejmë fjalë që përcjellin **terminologji të veshjeve dhe të zbukurimeve**, si: terma që përcjellin **veshje apo pjesë veshjesh të grave dhe të burrave**: fustan-i, brenevek-u (brekushet e gjera të grave, tumanet), cilonë-a (fustan

[593] Shih më gjerësisht A. Xhagolli, "Vëzhgime etnokulturore në shkrimet e Bardhit", *Buzuku dhe shkrimet e hershme shqipe"*, Universiteti i EJL, Tetovë, 2006, f. 126.

grash luksoz, që vishet për festa), këzë-a, lakuri-a, mafes-i, dhemazë-a (përdoren për shami koke), dylben-i (vello grash, e hollë dhe e bardhë), çapar-i (shirit, brez i pleksur, që vendoset në pjesën e poshtme të fustanit), jetullë-a (rrip, kordele, shirit), fundore-ja (pjesa fundore e këmishës së grave), citanik-u (pjesa e fundit e fustanit), jiirë-a (pjesa e poshtme e fustanit), mbërtheckë (kopsë, pullë); terma që përcjellin **zbukurimet e grave**: anakë-a (gushore, gjerdan), çapraze (zbukurime floriri a argjendi të vendosura në gjoksin e burrave dhe grave), çufë-a (xhufkë), damar-i (thekë), byzylyke-ja, bishër-a (stoli të çmuara), kaliqe-ja (stoli grash, byzylyk), kaçirube-ja (pupël, që gratë e Shkodrës e vënë në kokë për zbukurim), ilek apo jelek, mbarre-ja (veshje, rroba), brekashe-ja (pantallona), dolloma (zhgun), llabane-ja (mbulesë e kokës për t'u mbrojtur nga shiu), jakut-i (mantel i përzishëm, i shkurtër deri në kryqet dhe me mëngët deri në bërryl, që veshin mirditorët në kujtim të Skënderbeut), gjyrdi-a, gubere-ja (pallto, me mëngë dhe e shkurtër deri në gjunj), kaliqe-të, kacare-të (shapka, këpucë pa thembra), carige-të (opinga), bostalle-të (këpucë të mëdha të detarëve), folë-a (rrip) dhe deri te ndonjë veshje kishtare, si fjala: kotë-a apo ndonjë emërtim i një rrobe të vjetër, në formë rrethore, të cilën hamejtë, kur bartin diçka mbi kokë, e shtrojnë poshtë.

Krahas ka dhe një numër më të paktë termash që përcjellin **përgatitësit e këtyre veshjeve apo zbukurimeve** apo dhe **procese të ndryshme për përgatitjen e tyre**, si: kaç-i (endës), çepkas (kap leshin me gishta për ta punuar), ënd, end (përgatis fijet për endje), çile-ja (lëmsh), kanavace, kanafe-i (pëlhurë prej kërpi) etj.

Shënojmë se përgjithësisht, lidhur me veshjet ndër shqiptarë, informacionet kanë qenë të pakta, duke vënë në dukje se me fundin e shekullit XIX kemi dëshmi më të shumta. Në këto kushte, mendojmë se "galeria" e sjellë nga Mitko dhe për veshjet popullore dëshmon më së miri për praninë, në kohën kur ai regjistronte fjalësin e ij, të një numri veshjesh apo pjesë veshjesh, të cilat mund të shërbejnë, ndër të tjera, për të thelluar kërkimet e etnologëve dhe për të sjellë një tablo edhe më të plotë të veshjeve shqiptare në periudha më të hershme se sa fundi i shekullit XIX.

Vend shumë të gjerë zenë në fjalorët e Mitkos termat që përcjellin **mjete dhe vegla pune**. Duke përjashtuar nga lista e gjatë e fjalësit të termave që shprehin këtë tematikë ato që janë të pranishme deri në ditët tona, po sjellim më poshtë vetëm një numër të kufizuar termash që nuk janë të njohura për etnologët në ditët tona: kacë-a, gaviç-i (koritë e rrushve), kaptindullë-a (rrotulla e boshtit të furkës), blud-i (cipa e bardhë në sipërfaqe të verës, kur kjo zë e thartohet), brahom-i (tavë balte për pjekjen e bukëve të mëdha), careqe-ja (kanistër), cifun-i (grykë e jazit të mullirit me ujë a e sterrës së tij), cirofiq-i (tigan, enë gatimi), cmak-u (kuj druri në mur që shërben si varëse), amashërë-a (enë druri për gjellë, geg.), athëtirë-a (lloj dërrase me të cilën përgatisin fuçi), belçik-u (unazë e vogël e thikës), bër-i (shigjetë, shtizë), bërzhilë-a (lloj vegle, kurora e krehërit të vegjës), gashti (guri me të cilin provojmë floririn), ferric-i, filiç-i, çëllesë-a, çotilë-a (shkopi me të cilin rrahin qumështin brenda dybekut për të nxjerrë gjalpin), fishpiar-i (grep i peshkatarëve), drithësnik-u (depo e drithërave), gaviç-i (tork, tirë ku shtypin rrushtë), gërdhuze-ja (byk, lëmishte),

kathetë-a (vegël peshkimi), kurrubele-ja, kurrupe-ja (enë e madhe uji, prej balte), kutrule-ja (shtamëz, enë e vogël balte), llangjele-ja (enë për bartjen e ujit), gurgunë-ja (poçe balte), marruf-i (shtamë, enë vere), kariqe-ja (enë prej kungulli, për të marrë ujë, kungullujës), kutulishte-a (havan), mashtre-i (çanak, pjatë), çotrë-a (pagur druri, enë vere e drunjtë) etj., etj.

Ajo që bie në sy nga tërë kjo pasuri etnografike rreth veglave dhe mjeteve të punës, që sjell Mitkoja, është fakti se dëshmohet një jetesë e ngulitur e shqiptarëve në trojet e veta, ushtrimi i zanateve apo profesioneve të ndryshme, një numër i konsiderueshëm i të cilëve janë të pashkëputur nga jetesa e ngulitur.

Të shumtë janë dhe termat që bëjnë fjalë për **ushqimet dhe pijet dhe mjetet e përdorura në lidhje me to**, si: krokomel-i (misër), kreçe-ja (kokëlakër turshi), korrovec-i (lloj pjepri), maznik-u (gatesë brumi prej gjalpi dhe mielli të misërt), marq-i (kopër), mareshtë-a (luleshtrydhe), mardha-ja, baz-i (ajo çka mbetet në fund të enës, llumi i vajit dhe i gjalpit), mamëzë (e misërokut) (dhjamët në gjoksin e gjelit të detit), larth-dhi (dhjamë derri), lëkëënkë-a (salsiçe), leqikë-a (salatë marule), langërishte, lëngërishte-ja (supë, lëngurinë, çdo gjellë e ujshme), kurmagjak-u (suxhuk), këllanë-a (kuleç që jepen gjatë kolendrave, para Krishtlindjeve), gërmëradë-a, gromëratë (qumështi i parë, kulloshtër), drop-i (mbushja e peshkut a e gjelit të detit apo e diçkaje tjetër), dible-ja (ëmbëlsirë prej brumi), askath-thi (fik i pjekur), aksivë-a (ujë i përzier me hi), cullan-i, cufan-i (copë e madhe, pjesë, thelë, si p.sh., buke, mishi), cëpe-ja (petë për gatesa prej brumi, si byrek etj.), bulinj (vë salcë përsipër), zbyll (zbut, e lë mishin një ditë që të zbutet), brushtull-i (gjalpë dhe miell dhe asgjë tjetër), hupëtë (i) (bukë e butë, dmth., jo dhe aq e freskët apo taze, por as e thatë), hundurne-ja (bukë e ashpër prej krundesh), grashinë-a (bizele, bishtajore), gomole-ja (rrotull djathi, e madhe rreth 10 okë) etj.

Duke paraqitur gjithë këtë laryshi termash që bëjnë fjalë për ushqimet dhe pijet ndër shqiptarë, ndonëse kemi shënuar vetëm një pjesë të atyre që nuk ndeshen në praktikim në ditët tona, besojmë se dëshmohet bindshëm realiteti etnologjik i kohës kur janë regjistruar, duke sjellë një tablo të mënyrës së jetesës, të gjendjes ekonomike, ...

Një vështrim krahasues me fjalorin e Bardhit dëshmon se nga ajo periudhë ka vazhdimësi të një numri termash që janë dhe te Mitkoja. Të kësaj natyre mund të përmendim terma të tillë, si: diathë, kulloshtrë, bukë, gjellë, kripë, groshë (fasule) etj.

Me shumë interes paraqiten edhe termat që shprehin aspekte të ndryshme nga arkitektura popullore ndër shqiptarë. Midis tyre do të përzgjidhnim për të sjellë këtu vetëm një numër syresh, ato që tashmë kanë dalë nga praktikimi, duke mënjanuar termat që ende në ditët tona kanë përdorim. Të tillë do të shënonim: koce-ja (thurimë kallamash që shtrohet poshtë tjegullave të çatisë së banesave), buhari-a (oxhaku i brendshëm), gufomë-a (pjesa e lugët e anijes etj.), boçkë-a (koritë, stere, rezervuar që i çon ujë mullirit nëpërmjet sifonit), hath-i (stallë, bashtinë, stallë për tufën), grunar-i (depo, hambar), kamberi-a (tarracë, apo pjesë e mbulesës së

shtëpisë), kanik-u (ndërtesë e thjeshtë, një lloj depoje, më së shumti në vreshta e në ara), çolë-i (truall publik i lënë djerrë), konec-i (kasolle e qenit), masharkë-a (kthinë dosido, kasolle), leth-dhi (mur i thatë, mur me ose pa llaç), gllavani-a (deriçkë në dysheme, me anë të së cilës zbresim në bodrum), gathë-a (stallë, grazhd), flegurë-a (fletë e derës a e dritares), dritësore (dritare) etj.

Nuk janë të paktë edhe emrat që bëjnë fjalë për **terminologji nga folklori**, si: fyell-i, jonisi-a (harmoni muzikore), kangjele-ja (lloj valleje që shoqërohet me këngë), luanj (vallëzoj), lodërtonj (u bie daulleve; luaj muzikë), lodërti-ja (muzikë; daulle), lele (pasthirrmë vaji), karramuncë-a (vegël muzikore), dyzen-i (harmoni muzikor),curle-a (vegël muzikore), fe-ja, fejëzë-a (fyellqezë; pipëz; fyell), çpikës-i(një kallam që e sajojnë fëmijtë si pisqollë; nuk e di se si e mbushin, por kur e zbrazin, bën zhurmë si pisqolla) etj.

Në mënyrë të veçantë do të ndaleshim, se fundi edhe te termat që përcjellin *sëmundje të ndryshme, shërimin prej tyre*. Duhet thënë se për herë të parë ndeshemi me një numër kaq të madh të termave të kësaj natyre, duke e përcaktuar Mitkon si të parin që e ka hapur përpara studiuesve një fushë të tillë, siç është mjekësia popullore. Midis tyre do të shënonim: kromë-a (lepër), korrëzë (sëmundje e pulave), maras-zi (lloj sëmundjeje e barkut), mak-u (bar gjumëndjellës), llackë-a (pikë e bardhë në trup të kafshëve të zeza a të kuqërremta), lungë-a (shyta, ënjtja e pjesës poshtë veshëve), les-i (prekë, pikla e murrme që del në fytyrë; lythi), lekovas (trajtoj të sëmurin; kujdesem, i shërbej të sëmurit), le-barke-a (dizenteri), lagë-a (klizmë), kulufiskë-a (tuberkuloz), kukudh-i (mortajë), kukul-i (urtikarie), këlbazë-a (sëmundje dhensh), kath-i (elbth, puçërr që del zakonisht në kapakët e syrit), fshik' e ligë (puçërr e keqe në trup), fruthi-i, bëtajë-a (lëngat' e tokës, sëmundje e hënës), bumbar-i (duoden, zorrë e madhe, që lidhet me stomakun), hardhëjë-a (difterit), gurthi (sëmundje, litiazë, gur i formuar në fshikë; vështirësi në të urinuar), gryk' e bardhë-a (sëmundje; difterit), grënthëlie-ja gjëndër e qafës), kolenicë-a (paralizë e pjesëve të trupit, sidomos e këmbëve; çalim, çalë), koçkuar-i (kallo që del sidomos në këmbët e njeriut) etj.

Të tëra këto dëshmi, të ardhura që nga periudha kur jetoi e punoi Th. Mitko, flasin dhe dëshmojnë bindshëm për praninë e një teknike popullore të zhvilluar, për mjeshtëri e zeje popullore, që nuk mund të zhvilloheshin në kushte të një popullsie në lëvizje. Dëshmitë e të dhënat e sjella edhe nga Bardhi janë fakte shumë të qarta që flasin për një popullsi që bënte jetë të ngulur në hapësira të caktuara dhe jo për nomadë endacakë.

Sa thamë deri tani është e bazuar te fjalori i Mitkos me titull "Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht –shqip". Por të mos harrojmë se dhe në fjalorin tjetër të tij, "Fjalori italist-greqisht-shqip i Thimi Mitkos", kemi një numër termash që përcjellin një fjalës me interes të veçantë nga etnokultura shqiptare. Në këtë fjalor, ku përfshihet në një vëllim të veçantë transliterimi dhe fjalësi shqip, janë të përfshira një numër jo i paktë fjalësh, gjegjëse të dukurive etnokulturore ndër shqiptarë. Siç shprehet përgatitësi i këtij botimi, "Th. Mitko ka përfshirë në fjalorin tregjuhësh fjalë

dhe shprehje të fushave të ndryshme të jetës, të kulturës, fesë, të ekonomisë e të mjedisit shqiptar në shekullin XIX"[594].

Për më tepër, në trajtesën e tij, *Vështrim mbi leksikun e fjalorit*, sjell faktikisht një numër të konsiderueshëm fjalësh nga fusha e etnografisë shqiptare. Në ilustrim të këtij pohimi ai shënon fjalët: çapar (f. 52, 55), dizgat (f. 190, 197), dyaku (f. 47), fermele-ja (f. 53), fqolla (f. 54), gubere-ja (f. 51), kallcat (f. 52), mafes (f. 193), neja (f. 53), shorkë (f. 52) etj.[595] Ndërsa në faqet në vazhdim, kur jepet fjalori tematik, gjejmë një numër shumë më të madh të termave që shprehin apo kanë lidhje me fushat e etnokulturës shqiptare në përgjithësi. Vetë ndarja tematike të lehtëson gjetjen e këtyre termave. Midis tyre gjejmë fillimisht fjalësin e *Të parave ditë të kremte*, të tilla, si: Moti, a viti i ri, a kryet e vitit; Dit' e shën Vasilit, a e rreth-prerëjës; Ujët e bekuarë; Të lidhura-t; Kreshma e madhe; E Mart' e javës bardhë. Pasojnë në ndarje të veçanta ato që quhen prej autorit: *Ditë të përbuleçime* (me fjalë të tilla, si: E diela e luleve; Rrëshaet etj.); *Lidhjet farefisnore* (Biri; Bija; Nip-i, mbesa; Bliznak-u, a binjaku; Krushqë-i-t; fara, fisi, gjaku; Dasëma, a darësma; ndrikullë-a etj.); *Ushqimet dhe pijet* (Ve-ja; Kurmagjak deri; Groshë-a, koqe-frash; Lakëror-i; Mish lëjepuri; Sallatë; Trahan-i; Hirrë; Dhallë; Kupë, gotë; Krypë-a; Vaj, a val-i; Bosilok-u; Ushunj-i; Kopërë-a; Repë; Fasule-t, a frashuall; Domate-ja; Qiqërë-a; Patlixhan; Agjinar' e egërë etj.); *Shtëpia dhe anët e saj* (Themelet; Kthisat; Vatërë-a; Kamberi-ja; Strehë; Derë-a; Zileja etj.); *Për teshat e shtëpiës* (Të shtruarit, shtresa; Kanape-ja, sofati; Arkë-a, sënduq-i; Shtrat-i; Plaf-i; Eshkë-a; Përrush-i; Tundës-i etj.); *Mjete të ndryshme* (Shtëmbë-a; Kotrove-ja; Zile-ja; Voze; But-i; Qiri, dritë, kandil; Rrogos-i; Magje-ja; Sqepar-i; Pasqyrë-a; Sitë-a; Napë e diathit); *Anë a enë për gjellë* (Poçe-ja; Kazan-i; Lug-a; Skarë-a; Misurë e piata, a talure; Rende-ja; Lengjer-i); *Për rrobet, a petkat e burrit dhe gravet, si dhe zbukurimet* (Këmisha, linja; Jelek-u, xhamadan; Syrtyke-ja; Xhoketë-a); Këpucët, opingat; Kallcat, tirqit, kallëzat; Gunë-a, sharkë-a;; brez-i; Fustan-i, Kotullë-a, rraxhë-a; Nënë-fustane-ja; Vëthët; Byzyliket etj.); Groshës e drithërash, a për groshë e për... dhe Ondërij, a orendij Bulkërie (grur-i; Elb-i; Tep-a; Qiqëra-t; Fasule-t; Urov-i; Plug-u, zëgjedhë-a; Umi-ja; Shatë-a; Diqel-i; Kinzë, a kizë-a; Branë-a etj.); *Drurë, Pemësh edhe pemët e tyre* (Kaisi-a; Gështenjë; Limua-ja, limoji; Shegë; Arrë; Ulli-ri; Qerëshi; Vishënjë; Thanë; Vëreshtë-i; Rrush-i; Fik-u; Goricë-a etj.); *Bagëti katërkëmbëshe* (Lopë-a; Ka-u; Gomar-i; Kalë-i; Pelë-a; Mëz, a maz-i; dem-i; Dash-i; Dele-ja etj.); *Mieshtërij* (Miek, a miekës. Bejtar; Tregëtor. Vrapëtar; Poçar, diegullëtar; Kthistar. Peshkar; Bukëpiekës, kaminar; Punëtor; Këpucar, opingar; Qepës; Kovaç-i; Bulk-u; Qethës-i; Lëkurë-regjës-i; Kaç (a endës); mullinës, mullirës; Shkruas-i etj.).

Natyrisht, përveç sa përmendëm, në këtë fjalor tematik, në të cilin ka edhe përzierje temash të ndryshme, gjejmë dhe shumë fjalë të tjera që dëshmojnë për praninë etnokulturore shqiptare. Në tërësinë e tyre ato janë një pasuri e vlerëshme,

[594] Sh. Sala, vepër e cituar, f. 52.
[595] Po aty, f. 53.

që dëshmon se në periudhën kur Thimi Mitkoja është marrë me regjistrimin e termave apo fjalëve të ndryshme ato kanë pasur praktikim aktiv.

Jemi të mendimit se kjo pasuri e vyer që përcjell Th. Mitko përmes fjalorëve të tij, krahas shqyrtimit të leksikut historik të gjuhës shqipe në dokumentet e para (tri dokumentet e para të gjuhës shqipe) dhe në autorë të tillë të hershëm, si: Buzuku, Matrënga, Budi, Mazreku, Bogdani, duhet dhe mund të shërbejë edhe për të ndriçuar në planin historik dukuri të ndryshme etnokulturore. Realisht, parë në këtë këndvështrim, nuk kemi të bëjmë thjesht me emra, por edhe me shprehje të koncepteve, dukurive, veprimeve të ndryshme, pranisë së tyre në realitetet shqiptare, duke e sjellë më afër një periudhë kohore të caktuar. Pikërisht në këtë shtrirje mendojmë se duhet parë në përgjithësi kjo ndihmesë që vjen për etnokulturën shqiptare përmes vëzhgimeve në shkrimet e vjetra shqipe dhe në vazhdimësi. Nga ana tjetër, edhe nëse fjalë a terma të ndryshëm nuk i gjejmë tek autorët e vjetër të shkrimit shqip, por tek autorë të mëvonshëm, gjithsesi mund të themi se puna e tyre është me shumë vlerë, pasi me një vështrim në raporte krahasuese, mund të dëshmohet periudha e fillesës apo e vazhdimësisë së vetë fjalëve apo termave.

Nga ana tjetër, besojmë se në këtë mënyrë do të ndriçohet më së miri gjithë ajo punë fisnike, kultura dhe niveli i lartë që kishte Thimi Mitkoja, për kohën, si një nga përfaqësuesit e denjë të patriotëve rilindas të shkrimit shqip. Përmes shqyrtimit të trashëgimisë së tij mund të hidhet dritë më e plotë dhe për një numër dukurish nga fusha të ndryshme të kulturës popullore shqiptare, gjë që jo në të gjitha rastet është mbajtur parasysh dhe është zbatuar. Me një këndvështrim të tillë të trashëgimisë së autorëve të vjetër të gjuhës shqipe dhe në vazhdim të të gjithë atyre që kanë lënë trashëgimi të kësaj natyre mundet që, në një të ardhme të afërt, këta të konsiderohen realisht edhe si autorët e dëshmive etnokulturore në tërë plotërinë e tyre. Përmes kësaj rruge mund të ndiqet edhe ecuria historike e terminologjisë, etnokulturore, dhe jo vetëm, duke e pasuruar së brendshmi nxjerrjen në pah të kësaj trashëgimie, pasi vjen e dokumentuar nga njohës dhe mbledhës të dukurive të ndryshme, në kohë të ndryshme, të realiteteve shqiptare.

ALMIRA SADIKAJ (GJIROKASTËR)

FJALËT E URTA POPULLORE SI SHPREHJE E ETNOGRAFISË SË TË FOLURIT NË VEPRËN E THIMI MITKOS.

Folklori dhe etnografia edhe pse janë dy disiplina të veçanta, në mjaft drejtime lidhen ngushtë njëra me tjetrën, kjo për faktin se etnografia merret me kulturën materiale, me mjetet dhe mënyrën e jetesës, me ritet e zakonet e një populli dhe njëkohësisht përbën edhe fondin kryesor të folklorit. Thimi Mitkoja, ashtu si dhe Rilindasit e tjerë, i kushtoi një rendësi të madhe lëvrimit dhe vlerësimit të gjuhës amtare, si një nga detyrat më të ngutshme të lëvizjes së çlirimit kombëtar[596]. Thimi Mitkoja, tashmë njihet në auditoret e shkencës dhe shkollës shqiptare jo vetëm si "babai e krijuesi i folklorit shqiptar" me veprën e tij "Bleta Shqiptare", botuar një muaj para Lidhjes së Prizrenit 1878, por edhe si leksikograf i shquar i shqipes me veprën "Fjalori" (2013), botuar nga historiani korçar Shpëtim Sala. Autori e kishte të qartë se, një nga faktorët e zhvillimit të gjuhës letrare do të ishte gjuha popullore e marrë së bashku me traditat, zakonet, këngët e ndryshme, etj. Duke e parë në këtë këndvështrim prof. Eqrem Çabej thekson:"Visaret e ligjërimit popullor, zunë të mblidhen e të hyjnë në literaturë, më anë tjetër, gjuha letrare u pasurua me leksema të reja pjesërisht të marra prej gurrës popullore[597]". Kjo shërben për të kuptuar lidhjet e ngushta të gjuhës letrare me të folmet popullore, të cilat i ndeshim në zhdërvjelltësinë e frazës dhe dinamikën e saj, në tingullin dhe ngjyrën e fjalëve pa lënë mënjanë edhe trajtat dialektore. Megjithatë, ndërmjet gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar në këtë periudhë ka pasur një asimetri, çka do të thotë se, jo vetëm gjuha e shkruar qëndronte më lart nga ana letrare, por edhe se në të pasqyrohej gjithë fuqia shprehëse, thesari leksikoro-frazeologjik që bënte jetë të gjallë në ligjërimin e folur popullor. Me anë të këtij punimi, synojmë klasifikimin e *fjalëve të urta* në lëmin e etnolinguistikës. Duke qenë se, etnolinguistika një disiplinë gjuhësore merret me situatat dhe përdorimet, modelet dhe funksionet e të folurit si një veprimtari më vete[598], atëherë, mund të themi se ajo studion dhe vlerëson mendimet popullore, kulturën e të folurit, si dhe disa prej tipareve treguesve të fisnikërisë dhe bukurisë shpirtërore të popullit shqiptar, gjuha e të cilit pasqyron çdo tipar artistik të kulturës sonë. Në shpjegimin që u bëhet proverbave në "Fjalori i gjuhës shqipe 2006", thuhet: 1) *fjali e shkurtër me një mendim të plotë e të figurshëm, që përgjithëson përvojën e shumë brezave e përmban një mësim të urtësisë popullore*; 2) *fjalë e urtë*. Ndërsa, folkloristi Jorgo Panajoti në klasifikimin që i bën prozës popullore thekson se: *Fjalët e urta (proverbat)* janë nga zhanret më të

[596] Mitko. Th, Parathënie, Vepra, ASHRSH, f. 49
[597] Çabej. E, studime gjuhësore, V, Prishtinë, 1975
[598] Shkurtaj. Gj, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004, f. 29

gjalla e më aktive folklorike[599]. Ato praktikohen gjerësisht, zhvillohen e pasurohen nga brezi në brez, përdoren me shkathtësi e me ëndje nga populli. Në veprën e Thimi Mitkos gjejmë një pasuri të gjerë dhe të larmishme të fjalëve të urta, të cilat pasqyrohen si një mjet i shprehjes që merr vlera artistike, ku secila prej tyre e marrë në tërësinë e saj, paraqitet si figurë më vete. Fjalët e urta ndryshe nga llojet e tjera të krijimeve folklorike nuk e nxjerrin idenë nëpërmjet zhvillimit të subjektit, ato janë vetë ideja. Th. Mitkoja duke u mbështetur në gjuhën e popullit, mundi të përthithë dhe të aktivizojë në mënyrë krijuese gjithë potencialin e gjuhës popullore, të folklorit.

1) Klasifikimi tematik i fjalëve të urta

Në bazë të klasifikimit që u behet fjalëve të urta, kryesisht atij tematik dhe vlerave ideore, fjalët e urta përkojnë kryesisht me atë sistem idesh dhe me atë tematik që bart folkori. Duke e parë në këtë pikë, autori respekton lëndën origjinale të folklorit, motivet e subjektet, situatat e veprimet, stilin e rrëfimit oral folklorik dhe i lartëson ato artistikisht. Kështu kemi tematikën e dashurisë për atdheun (vendlindjen), lirinë e dinjitetin, punën, besën, miqësinë, bujarinë jetësën, dijen, familjen, etj. Te fjalët e urta popullore vihet re ndërgjegjshmëria e popullit si dhe dashuria e madhe e pakufishme për jetën. Nëpërmjet tyre, autori ka arritur në përgjithësime të gjera duke shprehur mendimin në mënyrë sa më të gjallë e më tërheqëse. Fjalët e urta e përdorin figurën artistike ose janë figura më vete, këtë gjë e vërejmë edhe te proverbat: *Ay stan atë bulmet ka; çkul dhëmbin, të të shëndoshët kryet; I duruari, i lëvduari; Iku nga shiu, ra ndë breshërë* (këtu kritikohen njerëzit që veprojnë pa një plan e një mendim të tyre).*Kush duron, trashigon; Lumi s'bie kërcunj' përherë, Shkoi vapa me gushtin; Pa brumë s'ziren kuleçtë*, etj (theksohet nevoja e planifikimit, e rregullit dhe marrja e masave paraprake)*; Puno si rop, të rrosh si zot*; *Njëra dorë lan tjetërën, të dyja lajnë faqetë*; *Peshku qelbetë nga kryetë*; domethënë njerzit duhet të jenë vigjilent. etj.

***Atdhedashuria.** Autori ngre nevojën e përpjekjes për përparimin e kombësisë dhe krenarisë kombëtare. *Ari, tek e njohin, atje vëlen; Guri ndë vend të tij ësht'i rëndë;* pra, njeriu e ka nderin vlerën e vet, sigurinë në atdheun e tij. Ndërsa në rastin kur thuhet: *Guri që s'rri mbë një vend rrënjë nuk zë;* proverbi dënon njeriun e pavendosur, kritikon paqëndrueshmërinë. *Behari (vera e pranvera) s'shkon me një lule*: kerkohet bashkimi i shumë njerëzve mund të sjellë një të mirë të madhe, pra:" Bashkimi bën fuqinë"; po kështu në: *Gjëj e turkut - haj e ujkut*, ngrihet nevoja e kujdesit, e vigjilencës ndaj armikut. *Më mirë plak e ndë fshat, se ndë qytetë e i poshtërë*: theksohet lidhja shumë e ngushtë me vendlindjen, krenaria për historinë, respekti ndaj pozitives vendëse dhe vlerësimi i saj, kërkesa e vazhdueshme për liri e pavarësi.

[599] Shih më gjerësisht, Jorgo Panajoti, Fjalët e urta, Proza popullore, SHBLSH, 1985 , f. 187-189

* **Besa** është një nga virtytet që populli i thur vargje e këngë popullore të ndryshme, këtu hyjnë proverba të tilla si: *Piviti rrëzon qytetëzë*, përdoret për njerëzit e pabesë, njeriun që s'mban fjalën që dredhon, (*spiuni*). Këtu hyjnë edhe çështje të moralit, kritikohen njerëzit e pamoralshëm. Në rastin kur thotë: *Nderja s'blihet me para*; dimensionet semantike të nderit populli i ka shtrirë deri në atë masë sa të mund të përfshijë në të edhe të drejtën, të vërtetën, dinjitetin, besën, bujarinë, madje edhe thjeshtësinë e maturinë. Nga ana e vet e drejta paraqitet aq e lidhur dhe aq e ndërthurur me të vërtetën saqë ndonjëherë ato shkrihen me njëra tjetrën (E drejta - e vërteta, thuhet në një proverb)[600]; ndërsa te Thimi Mitkoja kemi: *E drejta mbretëron, e shtrembëra ka këmbë të të shkurtëra.*

***Puna**. *Eja bukë të të ha; Gjumë e rroba të vjetra sa të duash,* kuptohet dembelizmi, kritikohen njerëzit e paaftë e dembelë që gjithçka u duket e vështirë, njerëzit që kërkojnë gjithmonë të vrapojnë pas punës së lehtë. Ndërsa, *Syri i të zot plehëron arën,* thuhet për njerëzit që e duan, e respektojnë jetën dhe punën. Po kështu, kemi raste kur proverbi përdoret për të treguar pakujdesinë në punë, mungesën e përqendrimit, si dhe raste të tjera ku populli kërkon kursim, por me masë dhe atje ku duhet, prandaj ai është kundër kopracisë, kundër kursimit të paarsyeshëm, p.sh: *As pula kemi, as me dhelpërë zihemi; Doli hëna, shuani qirinjtë; Kursen gozhdën, humbet potkuanë*, etj. Ndërsa në rastin: *Puna e rrëfen njerinë*, përdoret për të treguar karakterin, personalitetin e një njeriu që nëpërmjet punës së tij arrin të integrohet në shoqëri.

*Po kështu kemi edhe rastet kur nëpërmjet proverbit kritikohen njerëzit që flasin shumë pa një ide të tyren, pa arritur në konkluzione të dobishme: *Qeni që leh nuku kafshon*; ndërsa në rastin: *Miqësia miqësi, qeseja (kuleta) të jet'ndë mes; Vëllazëria, si shokëria*, jepet respekti ndaj mikut dhe vetvetes.

***Dinjiteti.** *Mos u bën si gjell pa krypë*: kritikohet, ironizohet mungesa e dinjitetit, shpirti i nënshtrimit e i përuljes e pavarësisë, kujdesit për vetveten, përdoret kundër atyre që nuk kanë një mendim të vetin, a një gjykim përsonal, thyhet me ironi për njerëzit pa personalitet: *Atë që ecin me qafë unjur, e dh….. pulat; Dorë e huaj, është e thatë; Më mirë të bërtasëm si macja, se të ulemi si lopa; Dy duar për një kokë,* etj.

***Trimëria**. Tematikën e trimërisë në proverbat e Th.Mitkos e gjejmë në rastet kur kritikohet njeriu i pavendosur e frikacak, thuhet me ironi: *Frikamanë mos e ndiq fort, se e bën trim me pahir.* Te trimëria kuptohet vetvetiu besa, e drejta ose aftësia për të gjykuar a mposhtur edhe vetveten: *Duaje mikun me gjithë kusuret e tij; Kur s'kam faj as perëndisë si trembem. Trim i mirë me shokë shumë; Trimin vraje e mos e sha, etj.*

***Mirësia**. Në rastin kur thuhet*: E mira s'humbet kurrë; E keqeja të shpie ndë derë t'armikut,* krahasohen e mira dhe e keqja si dy virtyte që e shoqërojnë njeriun gjatë gjithë jetës së tij. Ndërsa; *Po ta zu ferra peqinë, preje dhe lene*, është

[600] Jorgo Panajoti, *Karakteri kombëtar i fjalëve të urta popullore*, Kultura Popullore, 1987/2, f. 60

fjala për të keqen siç mund të krahasohet edhe me proverbin tjetër "*po të erdhi në shtekt, bjeri me dyfek*".

* **Dija**. Në vepër kemi edhe raste kur kritikohet shkëputja nga realiteti, kritikohen njerëzit që nuk vlerësojnë dijen dhe vlerat shpirtërore, por mbështeten dhe u japin rëndësi vlerave materiale, dhe populli u thur edhe proverba të tila si: *Mëndeja s'blihet me para; Më mirë të dish, se të kesh*, pra, në këtë mënyrë vlerësohet njeriu që di më shumë, që ka dije më të sakta e më të qëndrueshme, që është rrahur nga jeta që ka përvojë, sesa ai që i ka fituar dijet vetëm nga librat.

* **E bukura**. Një interes i veçantë u kushtohet edhe fjalëve të urta që trajtojnë idealin tradicional të së bukurës, flasin për ndjenja, koncepte e shije estetike karakteristike, jepet lidhja e së bukurës me forcën, pranimi i rolit aktitë njeriut në krijimin e së bukurës, kështu kemi, p.sh: *Bukuria s'është për fis, po kush di e kullundris.*

* Në veprën e Th. Mitkos të bie në sy prapambetja e zhvillimit industrial, ambienti fshataresk, sidomos ai blegtoral dhe bujqësor, karakteristike në folklorin tonë, të tilla janë: *Ai (ay) stan, atë bulmet ka; As pula kemi, as me dhelpërë zihemi; Atij i piell edhe këndezi; Atje ha qeni petulla; Bëni vinë kopështit, pastaj lësho ujët; Çalon gomari nga veshi?; Deleja ku kullot, atje lë leshtë; Delen që ndahet nga tufa (grigjeja) e ha ulku, etj.* Një karakteristikë tjetër themelore e fjalëve të urta është përdorimi me shumë art i mjeteve satirike si: ***humori, ironia, sarkazma***[601], gjë e cila lidhet edhe me dëshirën për të vënë në lojë e për të kritikuar negativen, alogjikën, qesharaken e të ultën në çfarëdo formë a shkallë që të shfaqen ato, p.sh: *Çalon gomari nga veshi? Dit' e mirë duket që ndë mëngjes, E di Gjoni çka ndë trastë, Eja baba të të dëftenj arat; Erdhi me lugë ndë bres; E vura si vëth në vesh; Kur s'ka krye mundon këmbët; Nderja s'blihet me para,* etj.

2) Ndërtimi i fjalëve të urta nga ana strukturore

Fjalët e urta kanë karakter sintaksor dhe stilistikor. Ato dallohen për mënyrën e veçantë organizative të mendimit si dhe për një figurshmëri me burim vendës. Tek fjalët e urta bëjnë pjesë edhe frazeologjitë dhe lodrat e fjalëve. Frazeologjitë dallohen për shkak të natyrës formulative dhe të forcës shprehëse të cilat janë mjaft tërheqëse, si: *Gjen shesh, pa bën përshesh; Hap sytë, se t'i hapin; Hilq e mos e këput; Njeriu për gjënë le kokën; Perëndia i merr mentë më parë njeriut, pa gjënë; Krushka nd'anë derës, si guna nd'anë ferrës; Më mirë ti dalë, shi në prill, gjithë hir; shi në maj, gjithë vaj, Ti zot, unë zot, lopët kush na i kullot*, etj. Duke u nisur nga klasifikimi gjuhësor që u bën Jorgo Panajoti fjalëve të urta, kryesisht nga kriteri ndërtimor dhe struktura sintaksore[602], në veprën e Th. Mitkos dallojmë dy tipe fjalish kryesore: proverbat fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra (periudha). Proverbat fjali të thjeshta, nga ana e tyre mund të jenë të pazgjeruara, si p.sh: *Buka s'hahet vetëmë; Puna e*

[601] Shih më gjerësisht, Jorgo Panajoti, Fjalët e urta , Proza popullore, SHBLSH, 1985 , f. 187-189

[602] Jorgo Panajoti, Struktura e fjalëve të urta, Çështje të Folklorit Shqiptar/6, ASHRSH, Tiranë, 1998, f. 158-160

rrëfen njerinë; Dardha bie nënë dardhë; ose të zgjeruara: Dit'e mirë duket që ndë mëngjes; Djalli s'prish folenë e tij; E mira s'humbet kurrë, etj. Për shkak të aftësisë së tyre që të shprehin mendimin, ndjenjën dhe qëndrimin në mënyrë sa më të plotë ndaj lexuesit, proverbat (periudha) përdoren më dendur[603]. **a)** Nga mënyra e lidhjes ato në shumicën e rasteve dalin me bashkërenditje, kryesisht me lidhëzat *e, dhe, edhe*, por nga ana semantike këto luajnë rolin e një lidheze nënrenditëse, kështu kemi: *Ay të rreh e stë lë të qash; As pula kemi, as me dhelpërë zihemi; As ndë thes, as ndë torbë; Bukë e hi e ndë shtëpi; Çkërkoi e gjet, siç shtroi fjet; Eshtë lir' krypa ndë Durrës, po e ha qiraja udhës,* etj. **b)** Po kështu, në vepër dallojmë edhe raste të proverbave periudha me nënrenditje të cilave shpesh ju mungon edhe lidhëzat, pra dalin asintetike: *Drith patën, të mos i digjet sqepi;* **c)** dalin në marrëdhënie kryefjalore, qëllimore, rrjedhore, kushtore: *Çdo të të zërër, do ta heqësh; Çë të mbiellç, do të korrç*; *Kush duron trashigon; Kush flet, prêt; Kush kërcen, më shumë harxhon; Sa rron mëson; Si e kërkoi e gjeti; Po s'mbolle, skorr; Ferra e nisi, ferra e grisi; Guri pëlcet, njeriu s'pëlcet; I duruari, i lëvduari,* etj. **d)** Dallojmë edhe raste të proverbave-periudha të cilat mund të përbëhen nga dy a më shumë njësi kallëzuesore. Kryesisht, në veprën e Th. Mitkos gjejmë proverba-periudha me dy fjali të thjeshta, por ka edhe raste kur mund të hasim proverba me tre ose katër fjali të thjeshta, pra: *Gjanë ta çon gjeli, madhështinë s'ta Çon as qerri; Iku nga shiu, ra ndë breshër; Ha si të të dojë zemëra, po mvishu siç mvishen bota; Ja dha drurit, u tha, ja dha gurit, u ça, ja dha njeriut e e mbajti,* etj.

3) Veçoritë gramatikore, fonetike dhe dialektore

Duke qënë se, tek të folmet popullore si edhe te fjalët e urta, përveç përmbajtjes e motiveve që dalin aty si elemente përbërëse me rëndësi për nga forma dhe nga stili i tyre, hasim edhe reflektimin gjuhësor-poetik të autorit, gjë e cila njihet si moment i rëndësishëm në jetën e popullit[604], atëherë mund të pohojme se dhe "Bleta shqiptare" e Th. Mitkos luajti një rol mbizotërues në botimet e folklorit në dialektin e toskërishtes juglindore. Ky reflektim duket qartë në një grup të caktuar fjalësh, ku përveç figurës artistike veme re disa tipare morfologjike, fonetike dhe dilektore karakteristike të shqipes në kohën kur shkruante Th. Mitkoja.

a) Në sistemin gramatikor, sidomos atë morfologjik, si tipare dialektore, kemi praninë e: ***a) gjinisë asnjëanëse me -ët:*** *ujët, preshët;* ***b) dhanorja me -et:*** *pleqvet, përrënjet.*

b) Në sistemin fonetik, në inventarin e fonemave: 1) ***përdorimin më shpesh a më gjerë të sesa sot, të: ë-së së patheksuar në trup ose në fund të fjalëve,***

[603] Jorgo Panajoti, Struktura e fjalëve të urta, Çështje të Folklorit Shqiptar/6, ASHRSH, Tiranë, 1998, f. 158-160

[604] Çabej. E, Studime gjuhësore, V, Prishtinë, 1975

Shënim. Të gjithë shembujt janë marrë nga vepra e Th. Mitkos, "Bleta shqiptare", Botim i Institutit të Kulturës Popullore 1981.

p.sh.: *Benjën udhë lopëtë, shkon edhe ay atje; Bjeri pragutë, që të dëgjojë dera; Më mirë të kesh armik të mençurë sesa mik të çmendurë*; *Me mënt gjetën perëndinë, se me sy nuk pa kush; Mëndëja s'blihet me para, Mos i dëfto babajt (ose babësë) aratë, Mos u gëzo i gëzuarë, mos u helmo i helmuarë, etj.* 2) ***shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalëve****: Kush ka mashën nuk djek dorën; Me mënt gjetën perëndinë, se me sy nuk pa kus;, Më mirë t'i dalë syri, se sa nami i lik; Më ndë funt kërcet hobeja; Ndë (ose në) mos do të korrësh, mblith urov; Njerin' e lik mos e gjeç mb'udhë, Peshku i math ha të vogëlin, etj.*

c) Në fushën e dialektologjisë kemi të pranishme trajtat dialektore të toskërishtes veriore, si: ***bashkëtingëlloren qiellzore mbylltore –nj, të cilën e hasim kryesisht në kohën e pakryer dëftore:*** *Eja baba, të të dëftenj arat; Çonj një kashtë e gjenj gjashtë; Të pështynj përpjetë më bie ndë sytë e tatëpjetë më bie ndë gjitë; Tymi të shkonjë drejtë, pa le të jetë oxhaku i shtrëmbëtë,* ndërsa, në ditët e sotme kjo bashkëtingëllore ka evoluar duke u kthyer në shtegore **–j**, në proverba është ruajtur forma arkaike. Ndërsa rastet: *Ay të rreh e s'të lë të qash (ai); Çë të mbiellç, do të korrç (sh); Zili paç, nakar mos paç; Eshtë lir' krypa ndë Durrës, po e ha qiraja udhës;* mendoj se janë forma arkaike të së folmes së Korçës.

Thimi Mitkoja duke qenë nën ndikimin e purizmit, në disa proverba ka përdorur edhe fjalët në turqisht: *Behari (vera e pranvera) s'shkon me një lule; Goja verë, barku grunar (proverbi jeton në popull"Goja behar, barku hambar"); Gruaja, kali edhe sahati s'fitohet me të xgëledhurë, po me t'ecurë; Dynjaja është shkallë, ca hypinë, ca zbresinë.*

Duke studiuar fjalët e urta të Th. Mitkos arrijmë në përfundimin se, numri i fjalëve të urta të krijuara është i madh dhe i shtrirë në të gjitha sferat e shoqërisë dhe veprimtarisë njerëzore. Duke i parë fjalët e urta nga pikëpamja etnologjike, mund të pohojmë se ato janë ngulitur plotësisht në gjuhën letrare dhe janë të përdorshme në të gjitha trevat shqiptare. Autori, nëpërmjet proverbave të tilla, jo vetëm që ka ngritur probleme me interes si: atdhedashuria, besa, trimëria, puna, morali, por, njëkohësisht është përpjekur të hyjë në thellësinë e tyre dhe të na japë kulturën folklorike të vendit tonë. Gjuha e Th. Mitkos, edhe pse e ngarkuar me dialektizma, bëri të mundur që të tingullojë si gjuhë e një stili artistik, që ngjizet me vlerat e gjuhës popullore. Kjo vepër lë vend edhe për shumë studime të tjera në fushë të leksikologjisë, gramatikës, sintaksës etj.

ANTON NIKË BERISHA (KOZENCË, ITALI)

RRETH PARATHËNIES SË "BLETËS SHQIPTARE" (1878) TË THIMI MITKOS

Çështja e interesimit dhe e studimit të letërsisë gojore është e hershme, po ajo mori një përmasë më të gjerë gjatë shqyrtimit të origjinës së dy epeve antike, "Iliadës" dhe "Odisesë". Në mënyrë të veçantë kjo ndodhi kur dijetari francez, Abbé d'Aubignac (1604-1676), pasi studioi dy epet, pohoi se ato nuk ishin vepra të krijuara nga një person, të cilin e quanin Homer, por nga shumë rapsodë, krijimet e të cilëve u bashkuan në një vepër[605]. Studiuesi italian, Giambattista Vico (1668-1744), shkoi edhe më tej: ai mendonte se s'ka ekzistuar një poet i vetëm, por epet homerike janë krijime, vepër kolektive e një populli, të përshkruara nga fryma krijuese e gjeniut grek[606].

Duke pasur për bazë mendimet paraprake, pas një pune të gjatë e sistematike, gjermani Friedrich August Wolf në veprën "Prolegomena" (1795) theksoi se Homeri s'ka ekzistuar në të vërtetë dhe se dy epet nuk janë krijime të një autori.

Brenda studimit të këtij problemi pati mendime të ndryshme. Nga njëra anë u theksua se epet janë krijuar në bazë të modelit dhe të strukturës së krijimeve gojore - sidomos të epikës gojore, që e kultivonin dhe e zhvillonin *aedët* dhe *rapsodët* grekë[607], ndërsa nga ana tjetër, duke e studiuar me përkushtim botën poetike të dy epeve, disa studiues (të ashtuquajturit - analitikë) [608] arritën në përfundimin se ato janë krijime të shumë autorëve, të cilat, pastaj, redaktorët e ndryshëm i bashkuan, duke u dhënë një tërësi të caktuar[609].

Çështja, mos "Iliada" dhe "Odiseja" janë me burim gojor apo krijime të letërsisë gojore, vepra të një krijuesi ose të disave, jo vetëm që nxiti shumë studiues të merren me këtë problem, sa të rëndësishëm aq dhe të ndërliqshëm, po i hapi shtigje

---

[605] Otto Holzapfel, *Homer - Nibelungenlied – Novalis.* Zur Diskussion um die Formelhaftigkeit epischer Dichtung. Në "Fabula", Zeitschrift für Erzählforschung, Herausgegeben von Kurt Ranke, 15 Band; Walter de Gruyter. Berlin, New York, 1974, f. 35.

[606] O. Holzapfel, *Homer-Nibelungenlied - Novalis,* pun. i përm., f. 35.

[607] Shih, Tvrtko Čubelić, *Književni leksikon*. Treće nadop. i proš. izdanje, Zagreb 1972, f. 153.

[608] Shih më gjerësisht, Branimir Glavičić, *Aktualni problemi homerologije.* - Radovi Filozofskog fakulteta u Zadru, sv. VII. Razdio lingvistički-filološki, 1965/1966-1967/1968, Zadar 1968, f. 229; Alfred Heubeck, *Die homerische Frage.* Eine Berichte über die Forschung. Darmstadt 1974, sidomos f. 3; Tvrtko Čubelić, *Epske narodne pjesme.* Zagreb 1970, f. LIV.

[609] Disa studiues theksojnë të ashtuquajturën redakturë të "Iliadës" dhe "Odisesë". Në një vepër latine është ruajtur dokumenti më i vjetër mbi redaktimin e këtyre dy epeve. Në vështrimin *De oratore* (III, 34, 137) të Ciceronit thuhet: "Për të cilin (Homerin) se në të njëjtën kohë ishte më i dijshmi ose mjeshtëria e oratorisë së tij letrarisht ka qenë e përshkruar nga Pizistrati? Ndërsa për të (Pizistratin) thonë së veprat e Homerit, që më parë ishin të përziera, i radhiti i pari si i kemi sot". Edhe shkrimtarë e dijetarë të tjerë antikë theksojnë se tirani aga Atena (Pizistrati, shek. V) i pari i kishte rregulluar dhe, ndoshta, i kishte shënuar epet e Homerit. Shih Zdeslav Dukat, *Homersko pitanje od Heziode do M. Parry-ja*. Në "Književna smotra", god. VII, br. 21, Zagreb 1975, f. 71.

të reja studimit të letërsisë gojore e sidomos të përkimeve poetike me letërsinë e shkruar.

Në këtë rrjedhë duhet përmendur dhe të ashtuquajturin *mistifikim letrar,* i cili edhe pse jo i lidhur drejtpërdrejt me epet e Homerit, në qenësi, përkon me çështjen homerike dhe ka gjasë të ketë dalë prej saj. Duke i paraqitur krijimet e tyre si të lashta, që u përkitnin kohëve dhe krijuese të hershëm, autorët mistifikatorë mendonin se ato do të çmoheshin dhe do të lexoheshin më shumë. Një veprim i këtillë vetvetiu zgjoi një interesim për krijimtarinë letrare gojore që kishte ekzistuar tek të gjithë popujt dhe ishte bartur shekuj me radhë gojë më gojë nga një brez në tjetrin. Përmend këtu përfaqësuesin kryesor të mistifikimit letrar, Makfersonin (James Mapcherson 1736-1769), i cili i hartoi tri vepra në prozën ritmike "Pjesë poetike të lashta" (*Fragmentes of Ancient Petry,* 1760), *Fingal* (1762) dhe *Temora* (1763) dhe i paraqiti përkthime nga gjuha gaelike e veprave të bardit (këngëtarit) të lashtë të shekullit të tretë pas Krishtit - Osianit (Ossian). Duke u çmuar si të tilla, veprat përjetuan një popullaritet të jashtëzakonshëm; arritën në pjesët më të largëta të Evropës dhe në disa shtete u bënë shumë të lexuara dhe të çmuara. Natyrisht ky popullaritet i "Poemave të Osianit" i përket faktit se ato u morën si krijime gojore të lashta[610], të cilat Makfersoni kinse i kishte mbledhë në terren dhe nga subjekt të caktuar e pastaj i kishte përkthyer dhe botuar[611]. Ato, siç është thënë me të drejtë, ushtruan ndikim të dukshëm në letërsinë e romantizmit.

Një gjë të ngjashme me Makfersonin në letërsinë tonë bënë Zef Skiroi me *Rapsodie Albanesi* (1887), Gavril Dara i Riu me poemën *Kënga e sprasme e Balës* (e cila për herë të parë filloi të botohet në vazhdime në revistën "Arbëri i ri" më 1887 në Palermo)[612] dhe Fishta me këngët e para të veprës *Lahuta e Malcís*, që i botoi pa emrin e tij[613].

Përfaqësuesi kryesor i lëvizjes gjermane "Strum und Drang", Johann Gottfried von Herder ((1744 – 1802), në punimet "Fragmente nga një letërkëmbim mbi Ossianin dhe të këngëve të popujve të lashtë" (Auszuge aus einem Briefvveshsel über Ossian und die Lieder alter Völker), "Mbi zhvillimin e poezisë dhe të dokeve në kohën e lashtë dhe të re" (Über die VVirkung der Dichtkunst auf die Sitten der Völker in alten und neuen Zeiten, 1778) dhe "Ndihmesë mbi prejardhjen e gjuhës" (Abhandlung über den Ursprung der Sprache) shtroi edhe çështjen e gjuhës / të

[610] Duke i çmuar vepra të bardit të lashtë, Osianit, edhe kritiku i njohur, bashkëkohës i Makfersonit, Hazlit, citoi disa pjesë të kësaj poezie si shembuj të lartë të të shprehurit artistik. Mistifikimin e Mekfersonit i pari e vërtetoi Doktor Xhonsoni.

[611] Si u shpreh interesimi për krijimtarinë gojore te anglezët në periudhën prej klasicizmit kah romantizmi, çka e cilësoi punën e Grejt (Thomas Gray), të Çatertonit (Thomas Chatterton) e të ndonjë tjetri, sidomos të James Macpherson-it, shih Dr Dušan Puhalo*, Istorija engleske knjíževnosti, XVIII vek i romantizam* (1700-1832). Beograd 1966, f. 117-132.

[612] Përkimet poetike të poezisë gojore arbëreshe dhe veprës "Kënga e sprasme e Balës" i kam shqyrtuar me gjerësisht në *Përkime poetike*, Rilindja, Prishtinë 1978, f. 120-150.

[613] *Vepër e qenies dhe e qenësisë sonë. Vëzhgime mbi artin poetik të Fishtës.* "Shpresa" & "Faik Konica", Prishtinë 2003, sidomos faqe 269 – 303..

folurit. Ai thotë se në fjalë është vetë shpirti që shprehet dhe anasjelltas: shpirti ekziston vetëm nëse shprehet në fjalë.

Herderi shquhet sidomos për përmbledhjen "Këngë popullore" (Volkslieder 1778 – 1779), që më vonë u bë e njohur me titullin "Zëra të popujve në këngë" (Stimmen der Völker in Liedern*)*. Në të jo vetëm ndriçoi disa nga çështjet e rëndësishme të artit të lashtë të popujve, po dhe disa nga veçantitë e letërsisë gojore e cila në rrjedhë të shekujve kishte ekzistuar duke u përcjellë gojarisht.

Me veprën e vet Herderi dëshmoi se të ashtuquajturit "popuj primitivë" ishin të rëndësishëm për arsye se dëshmonin një kulturë të pasur, veçmas në krijimtaritë e tyre letrare gojore, në ritet dhe zakonet e lashta që i kishin ruajtur. Si dëshmi të kësaj ai e merr dhe e vështron poezinë gojore ose këngët popullore[614]. Sipas Hermann Bausingerit, Herderi nuk e përdori termin art popullor, poezi popullore, vetëm në kuptim të krijimtarisë letrare gojore, por si përbërës gjithëkohor, që përshkon secilën poezi të vërtetë. Duke u mbështetur në këtë parim, në veprën e vet Herderi përfshiu dhe disa poezi të Gëtes (Goethe) dhe të disa poetëve të tjerë[615].

Pikëpamjet e Herderit patën një jehonë dhe një përkrahje të fort në periudhën e romantizmit, kur shkrimtarët (sidomos ata gjermanë) iu kthyen botës së legjendave, të miteve, të përrallave, pra dukurive që ishin larg realitetit të përditshëm. Kjo ndodhi edhe më vonë në kulturat e disa popujve të tjerë.

Interesimi për krijimtarinë letrare gojore shqipe dëshmohet së pari ndër arbëreshët e Italisë. Krijimi i parë i shënuar, i njohur deri më sot, është rapsodia e Pal Golemit, e mbledhur para vitit 1693 nga prifti italian, Nilo Katalano (Catalano), i cili për disa kohë ishte dhe misionar në Shqipëri. Dëshmi më e plotë e teksteve të letërsisë gojore arbëreshe të mbledhura është Dorëshkrimi i Kieutit (1735 - 1750, me 18 tekste nga poezia gojore e arbëreshëve të Italisë. Pasojnë tekstet e mbledhura nga Françesk Avati në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, për të mbërritur një rrafsh të lartë me materialet që botuan më 1866 Dhimitër Kamadra[616], Jeronim De Rada[617] e ndonjë tjetër[618].

Përmbledhja „Bleta shqiptare" e botuar më 1878 në Aleksandri të Egjiptit nga Thimi Mitkoja paraqet një ngjarje të rëndësishme në fushën e letërsisë gojore shqipe

[614] Duke folur për përrallën si krijim i rëndësishëm i prozës gojore Herder theksonte: "Në karakterin e fëmijës, që nuk ka dëgjuar përralla, mbetet një zbrazëti që më vonë nuk mund të kompensohet". Shih Dr Stjepko Težak, *Interpretacija bajke u osnovnoj školi*, Pedagoški književni zbor, Zagreb, 1969, f. 7.

[615] Maja Bošković-Stulli, *O pojmovima usmena i pučka književnost i njihovim nazivima.* Në "Umjetnost riječi", Zagreb, XVII, 1973,3,149-184; 4,237-260 (poseban otisak) f. 150.

[616] Demetrio Camarda, *Saggio di Grammatologia Comparata sulla lingua albanese*. Ristampa anastatica, Palermo 1989; Demetrio Camarde, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Ristampa anastatica, Palermo 1989.

[617] *Rapsodie d'un poema albanese*. Raccolte nelle colonie del Napoletano. Tradotte da Girolamo De Rada e per cura di lui i di Noccolò Jeno de' Coronei. Tip. Di Federigo Bencini, Firenze, 1866.

[618] Më vonë edhe Zef Jubani botoi të përkthyer në italisht vëllimin *Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi*. Tradotti nell'idioma italiano da Giuseppe Jubani. Trieste 1871. Shih Ribotimin në Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar. Tiranë 1961.

dhe të historisë së saj. Në "Shpjegmin[619]" e botimit të dytë në Vjenë (1924) të "Bletës", Gjergj Pekmezi e cilësoi atë "[...] librëzë të rrallë e të çmuar[620]", me të cilën: "[...] do të pasurohet pak literatura jonë e varfër[621]" ose, siç thekson Qemal Haxhihasani, me të Mitkoja dha një shembull të përpjekjeve plot pasion për kërkimin dhe zbulimin e thesareve të mrekullueshme të trashëgimisë sonë kulturore e letrare[622].

Punën në mbledhjen e materialeve të letërsisë gojore me gjasë Mitkoja e filloi rreth vitit 1868, siç i shkruante në letrën e datës 9 janar 1868 nisur Kamardës[623].

Në "Bletën shqiptare" Mitkoja përfshiu disa lloje të letërsisë gojore që i mblodhi nga imigrantë shqiptarë që punonin në Aleksandri, ose në ndonjë qendër tjetër të Egjiptit, si këngë të motmotit, këngë dasme, këngë dashurie, këngë trimërishte (toske dhe gege), pastaj përralla, fjalë të errëta, të përshëndosha etj.

Materialeve të botimit të parë të "Bletës shqiptare" u prin një *Parathënje* e Mitkos, ku shtrohen disa dukuri e çështje me rëndësi, që dëshmojnë jo vetëm arsyet pse Mitko ia hyri mbledhjes dhe botimit të materialeve të letërsisë gojore shqipe (në prozë e në poezi), po dhe të rëndësisë së tyre për botën shqiptare, siç thoshte Gjergj Pekmezi: "[...] e donte më gjithë zemrë si popullin ashtu edhe gjuhën e ti[624]".

Tri çështje janë kryesore, që heqin peshë në këtë parathënie.

ÇËSHTJA E PARË: shpëtimi i materialeve nga harresa dhe dhënia e brezave një varg krijimesh të letërsisë gojore shqipe të mbledhura nga subjekte të ndryshme shqiptare. Këtë qëllim MitkoJA e thotë që në fillim të parathënies:

"Qëllimi i 'Bletës shqiptare'; d.m.th. i këtyre këndimeve albanologjike, është përgjithërisht, shpëtimi dhe dhënija brezave që vinë i fjalëvet edhe tekstevet shqipe, sa para vjetesh me shumë mundim e prishje (shpenzime – v. ime) mblodha, të cilat besoj se do kenë një vjeftë, sepse në këto duket fisi, karakteri, adetet e zakonet e rasës shqiptare; veçanërisht duha (nevoja – v. ime) që t'u ipet një shkak e shtyrje bashkatdhetarëve shqiptarë për të kulturuar edhe studiuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë natyrale edhe të vetëm fitimprurëse të mundin edhe këta të civilizohen edhe të kenë njësoj vjeftë me vëllezërit e tjerë të tyre ellefonë[625]".

---

[619] "Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos". E përshkroj me shkronja shqype, e përktheu shqyp dhe e radhiti Dr. Gjergj Pekmezi. Konsull i Shqypërisë. Vjen-ë 1924, f. 5 – 9.

[620] Gjergj Pekmezi, *Shpjegim.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep. e përm., f. 5.

[621] Gjergj Pekmezi, *Shpjegim.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep. e përm., f. 8.

[622] Qemal Haxhihasani, *Hyrje*. Në Thimi Mitko, *Vepra*. Përgatitur nga Qemal Haxhihasani. Instituti i kulturës popullore. Sektori i prozës dhe i poezisë. Tiranë 1981, f. 58.

[623] Shih Thimi Mitko, *Vepra.* vep. e përm., f. 610.

[624] Gjergj Pekmezi, *Shpjegim.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep. e përm., f. 6.

Rreth rëndësisë se "Bletës shqiptare" të Mitkos Qemal Haxhihasani shkruan: Mitko mbetet një shembull i lartë pune vetëmohuese në dobi të çështjes së lirisë e të pavarësisë së Shqipërisë dhe një shembull të përpjekjeve plot pasion për kërkimin dhe zbulimin e thesareve të mrekullueshmet trashëgimisë sonë kulturore e letrare". Shih Qemal Haxhihasani, *Hyrje*. Në Thimi Mitko, *Vepra*, vep. e përm., f. 58.

[625] Thimi Mitko, *Parathënje.* Në "Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos", vep e përm., f. 11..

Mitkoja përmend rëndësinë e materialeve që mblodhi dhe botoi sidomos për gjuhën e tyre, që ishte gjuhë më vete dhe e ndryshme nga gjuhët e tjera dhe si i tillë (populli) duhej të kishte dhe shtetin e vet dhe pikërisht përmes gjuhës të zhvillohej e të përparojë, ta përdorte gjuhën shqipe në libra dhe në shkolla, e jo gjuhët e tjera, pa marrë parasysh rëndësinë e tyre. Për Mitkon gjuha ishte përbërësi më kryesor i kulturës së një populli, që do të ndihmojë edhe formimin e shtetit e të zhvillimit. Këtu dhe qëndron arsyeja që Mitkoja citon në parathënien e vet një mendim të rëndësishëm të Herderit: "Një komb nuk mund me as një mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet[626]".

Mitkoja theksonte se "Gjuha amtare është ushqimi i parë e i përbashktë q'i jep gjallësi popullit[627]". Të gjitha ata që mendojnë dhe veprojnë ndryshe, i bëjnë shërbim të keq kulturës dhe gjuhës së tyre, prandaj ai i vë ata në thumb të kritikës: "Kërkimi i cave të mbytin gjuhën shqipe edhe me përdorimin e shtrënguar të greqishtes t'a thëthinë fjesht rasën shqiptare ose t'a shuajnë edhe t'a bëjnë sikur s'ka qenë, është një gabim i tmeruar, shpikje e një mendje të shkurtër, politik' e kalbur edhe i çdo 'idee të madhe' mosmeritonjës[628]".

Rëndësinë e gjuhës si përbërës kryesor të një kombi Mitkoja do ta theksojë edhe në shkrime të të tjera, madje edhe në letrat që ua dërgoi disa bashkatdhetarëve. Kështu, në një letër të dt. 13 janar të vitit 1879, ai i shkruan De Radës: "Të gjithë shqiptarët, myslimanë e të krishterë të bashkuar, kërkojnë prej Portës së Lartë, disa privilegje edhe, veçanërisht, shkrimin dhe mësimin e gjuhës[629]". Edhe përmes një letre dërguar Visar Dodanit të dt. 31 dhjetor të vitit 1888, Mitkoja u shkruan bashkatdhetarëve në Bukuresht: "Përpiqi, o trima, për gjuhën tënë, sa të shtijem farën e shenjtë e të zerë rrënjë, pastaj do të mbinjë e do të shtohet vetiu edhe të mirën që po bëjmë sot, Zot' i jetës do na e shpërblejë[630]". Meqenëse shqiptarët e kishin ruajtur gjuhën e tyre me shekuj, ata duhet të vazhdonin ta ruanin atë edhe më tej për arsye se kjo ishte edhe vullneti i vetë Hyjit: "Zoti i merr mendjen atij populli që kërkon të humbasë[631]".

Ruajtja e gjuhës në një formë më të ngritur e më të sigurt Mitkoja e shihte pikërisht përmes shkrimit të saj, përkatësisht përmes hapjes së shkollave dhe arsimimit. Në Parathënien e "Bletës" ai thekson se përdorimi i gjuhës shqipe dhe hapja e shkollave në gjuhën shqipe në Shqipëri është gjë e domosdoshme, qoftë edhe për të përhapur ndër ta qytetërimin grek: "Qytetërimi grek, siç gjenden sot punrat, munt të të hyjë vetëm në të paktë Shqiptarë, vetëm në mest të atyre, të cilët kanë pak dituri. Po si munt të hyjë qytetërimi grek në shumicën e gjendjes shqiptare,

[626] Thimi Mitko, *Parathënie*. Në Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 61. Shih dhe Thimi Mitko, *Parathënje.* Në "Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos",vep. e përm., f. 11.
[627] Thimi Mitko, *Parathënje.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep e përm., f. 12.
[628] Thimi Mitko, *Parathënje.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep e përm., f. 12.
[629] Shih Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 631.
[630] Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 707.
[631] Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 637.

në familjen e zanatçiut edhe të industrialit, në kasollen e bariut, në qoftë se nuk përhapen iderat greke me përdorimin e gjuhës së tyre shqiptare që flitet? Apo duhet të presë njeriu gjersa tërë populli shqiptar të mësojë gjuhën e shkrimit të Athinës edhe pastaj të fillojë përhapjen e iderave greke? Gjer atëhere do të kalojnë shumë shekuj[632]".

Mitkoja shkruan ngjashëm dhe në letrën e datës 14 mars 1880 dërguar Kostandin Zhapës: "Lejomëni, pra, o bashkatdhetar shumë fisnik, të ju them me guxim patriotik, se ju, si një bamirës i madh i grekërve kini mundësinë sot, kur shqiptarët, muhamedanë e të krishterë, u ngritën njëzëri, si prej providencës hyjnore dhe kërkojnë, pos së tjerash, edhe shkrimin e gjuhës së tyre, mundemi, them, ta flakni tej këtë iluzion të mallkuar mesjetar të mohimit të arsimit, duke hapur shkolla shqipe në tërë Shqipërinë[633]" ose "[...] kjo është një ide (Shqipëria është pjesë e pandarë e Greqisë, siç mendonte Zhupa – v. ime) se që jau nxit ndenja e zemrës suaj [...] Por, që të arrihet kjo, kërkohet më parë zhvillimi moral i Shqipërisë me anë ë gjuhës së vendit, domethënë të këtij mjeti të vetëm natyral të qytetërimit të çdo kombi[634]".

Me një fjalë, gjuha ishte "fara e shenjtë" që do të "zërë rrënjë" dhe se të gjithë përbërësit e tjerë vinë mbas saj. A nuk përkon kjo dukuri plotësisht me mendimin e Herderit të përmendur më parë se gjuha – fjala është vetë shpirti që shprehet dhe anasjelltas: shpirti ekziston vetëm nëse shprehet në fjalë?

Duke u nisur pikërisht nga një qëndrim i këtillë i qartë, Mitkoja i botoi materialet me gjuhën origjinale që ia treguan subjektet konkretë, siç thekon dhe Gjergj Pekmezi, "[...] nuk e ka zbukuruar gjuhën, as me ë-za apo gjë-za as me theksa apo shkrepca[635]", po ashtu siç ia thanë të tjerët.

ÇËSHTJA E DYTË që shtron Mitkoja në Parathënien e "Bletës" është fakti se materialet që botoi ai "do kenë një vjeftë, sepse në këto duket fisi, karakteri, adetet e zakonet e rasës shqiptare". Me fjalë të tjera, Mitkoja ishte i bindur se përmes materialeve të letërsisë gojore të mbledhura e të botuara do të mund të ndriçoheshin edhe një varg tiparesh të botës e të karakterit të krijuesve dhe të bartësve të tyre, pastaj të njihen ritet e lashta, gojëdhënat, baladat që ishin përcjellë gojarisht shekuj me radhë prej një brezi në tjetrin. Ato do të ndihmonin njohjen e botës shqiptare nga të tjerët dhe shtimin e dashurisë së shqiptarëve ndaj vetë botës së tyre, ndaj vendit, pastaj ruajtjes, njohjes dhe pasurimit të trashëgimisë së tyre, pa të cilën populli shqiptar do të ishte i zhdukur. Ky përcaktim dëshmonte se Mitkoja, edhe pse në mërgim, kishte ruajtur dhe me punën e vet përligjte dashurinë e madhe ndaj popullit dhe trashëgimisë së tij të pasur[636].

---

[632] Thimi Mitko, *Parathënje.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep e përm., f. 12.
[633] Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 637.
[634] Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 637.
[635] Gjergj Pekmezi, *Shpjegim.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep. e përm., f. 7.
[636] Këtë e dëshmojnë dhe fjalët e Qemal Haxhihasanit për "Bletën shqiptare": "Jeta e huaj që e rrethoi për më se Jeta 40 vjet në mërgim, me gjithë format e saj të stërholluara, nuk ia veniti Mitkos asnjëherë

Rëndësinë e shumëfishtë të mbledhjes dhe të botimit të materialeve të letërsisë sonë gojore e theksuan, edhe paraardhësit, edhe pasardhësit e Mitkos. Kështu, në Parathënien[637] e përmbledhjes "Rapsodi të një poeme shqiptare" (1866)[638]", të botuar në arbërishte dhe me përkthim në italisht (rishikuar nga Nikollë Tomazeu, për t'u siguruar atyre udhën që të hidheshin gjithkah, siç i pati uruar ai[639]), Nikollë Jeno De Koronei, shpreh qartazi qëllimi i botimit të vëllimit me rapsodi: "Kjo pasqyrë e thjeshtë e jetës sonë, po të kishte vetëm një randësi poetike, nuk do ta qitshim në dritë, pse nuk do të çmohej. Por ajo ka tashti një oportunitet të madh politik[640]", që përkon me atë që shkruante Mitkoja në parathënien e "Bletës".

Këtë gjë e theksonte edhe De Rada në veprën e tij "Parime të estetikës", të botuar më 1861: "Ajo që i bën ato (Rapsoditë e botuara nga De Rada më 1866 – A. N. B.) mbi të gjitha të rëndësishme për ne është pikëzimi i mënyrës së vjetër të jetës shqiptare [...] Së fundi, për të gjithë ne (poema - A. N. B.) është monumenti më i vjetër i gjuhës sonë dhe një model i madh stili të thjeshtë, të kulluar, të fuqishëm".

Duke folur për veprën e De Radës "Parime të estetikës" M. Markiano përmend edhe Rapsoditë dhe thotë se ato janë "Monumenti më i ndritur dhe më i lashtë i gjuhës dhe letërsisë kombëtare[641]".

Edhe arbëreshi tjetër, Dhimitër Kamarda, në veprën e vet *Sprovë gramatikore krahasuese mbi gjuhën shqipe* - përkatësisht në "Shtesën" (Appendice)[642] shtroi disa çështje të rëndësisë së teksteve të botuara nga ai për botën arbëreshe dhe për arbëreshët *"të pafatën gjindje arbëreshe"*, po dhe për rëndësinë e tyre në rrafshin gjuhësor-shprehës dhe estetik: "Nga pikëpamja estetike unë kujtoj se këto këngë arbëreshe nuk vijnë pas këngëve popullore të asnjë kombi tjetër". Kamarda mendonte se te disa këngë, sidomos te ato të viseve që janë larg fushave dhe qyteteve, gjuha është ruajtur më shumë; është më arkaike, më e pastër dhe më origjinale. Për ta mbështetur këtë mendim të vetin ai citon Hahnin, i cili më 1853, botoi disa materiale të poezisë gojore shqipe. Hani i kishte përkthyer materialet në gjermanisht dhe sipas tij ishin shumë të bukura dhe uron që poezia gjermane të marrë pak nga ai frymëzim i thjeshtë i natyrës që kanë këngët shqipe.

---

dashurinë për traditat dhe zakonet e mëmëdheut". Shih Qemal Haxhihasani, *Hyrje*. Në Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 38.

[637] "Fiamuri i Arbërit". La Bandiera dell'Albania. Pubblicazione periodica mensile. Per cura d'un comitato di signori d'Albania e delle colonie. Ann0 1. S. Demetrio Corone, 2 Gennaio 1883. Num. 1.

[638] Vëllimin *Rapsodie d'un poema albanese*, Firenze, 1866 De Rada e ribotoi në "Fiamuri i Arbërit" 1883 – 1887.

[639] Shih Jup Kastrati, *Dy parathaniet e rapsodive të De Radës*. "Shkodra" nr. 6, Shkodër 1966, f. 309; shih dhe N. Jorgaqi, *Antologji e mendimit estetik shqiptar* 1504-1944. Tiranë 1979, f. 110.

[640] [640] Jup Kastrati, *Dy parathaniet e rapsodive të De Radës*. "Shkodra", nr. 6/1966. f. 306.

[641] Mikele Markiano, *"Parimet estetike*". Në N. Jorgaqi, *Antologji e mendimit estetik shqiptar* 1504-1944. Tiranë 1979, f. 175.

[642] Demetrio Camarda, *Saggio di Grammatologia Comparata sulla lingua albanese*. Ristampa anastatica, Palermo 1989; *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Ristampa anastatica, Palermo 1989.

Në *Parathâne-n* e "Kanunit të Lekë Dukagjinit[643]" Fishta, pos që vinte në dukje çështje të qenësishme të vlerës së krijimeve të letërsisë gojore shqipe, të lashtësisë, sidomos të gjuhës, nëpërmjet së cilës veprat e letërsisë gojore krijohen dhe ndikojnë në marrësin, po dhe për zhvillimin e letërsisë së shkruar të popujve e të përkimeve poetike[644], shkruan:

"*Folklora* asht pasqyra e kthjelltë e psihes së komit; âsht rrasa mermerit, më të cillen historija zgavrron t'endunt e të shendunt e popujve; âsht cehja e pashterrshme e gjuhsís e e letërsís komtare. 'Folklorën', po do të skjyrtojsh, po deshte me shkrue historín e komit, e cilla me hamende nuk shkruhet, por qi edhe pa tê komi jetë nuk ka; 'folklorës' do t'i sillesh, po deshte me shtue pasunín e gjuhës me fjalë të permvetsueme, me frazeologjí shprehsore, me shembulltyra të gjalla e dramatike; në 'folklorë' prap ke me ndeshë me type ma të nalta, me karaktere ma të forta, e me motive mâ t'ardhuna e të perkueshme për zhvillimin e leteratyrës komtare. - Epopét mâ të mdha e mâ të bukura të botës: si nji 'Iliade', nji 'Shah-Name', nji 'Niebelungen', nji "Fingal" etr. etr. kanë ngallitë e janë zhvillue mbi bazën e 'folklorës' komtare[645]".

Edhe Bernardin Palaj, mbledhës dhe studiues i shquar i këngëve kreshnike[646], thotë: "Shpirti i rapsodive âsht fjesht shqiptár, pse paraqet kjartë të gjitha karakteristikat e Shqiptarit e vetëm të Shqiptarit: besa e zânavet, e orvet dhe kreshnikvet; burrnija e trimnija e tyne edhe me anmiq: me slavë; brestytnít e popullit t'onë, doket, miku, dashtnija e ndera e familjes, trimnija e ndera e gravet etj: shprehen ndër kângë në mënyrë të gjallë, e janë ngjyrat e ndryshme, me të cillat rapsodët e maleve t'ona paraqesin fytyrat e herojve në ket duel[647]" ose "Kângët e vjetra, qi njifen prej malcorvet nën êmnin 'kângë kreshnikësh, kângë të moçme,

---

[643] P. Gjergj Fishta, O. F. M, *Parathâne.* Në "Kanuni i Lekë Dukagjinit". Përmbledhë e kodifikue prej A. Shtjefën Konst. Gjeçov, O. F. N., Shtyp. Franceskane, Shkodër, 1933.

[644] Për dukurinë e përkimeve të letërsisë sonë gojore me letërsinë e shkruar kam bërë fjalë në veprën time, *Përkime poetike*. Rilindja, Prishtinë 1978 dhe në punimet *Poezia gojore arbëreshe dhe "Këngët e Milosaut" të De Radës*. Në "Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italis. Luigi Pellegrini Editore. Cosenza 2008, f. 451 – 467, *Ndikimi i letërsisë gojore arbëreshe në poemën "Kënka e sprasme e Balës".* Në "Kultura popullore" n. 2, Tiranë 1984, f. 87-95; *Përkimet poetike të poezisë gojore dhe të krijimtarisë së Lasgush Poradecit.* Në "Gjurmime albanologjike folklor dhe etnologji", XIII, 1983, Prishtinë 1984, f. 7-22; *Epika gojore shqiptare dhe epika e shkruar e Gj. Fishtës*. Në "Jeta e re" n. 9, 1990, f. 1067-1090; *Proza e shkruar shqipe dhe proza gojore nga fundi i shekullit të kaluar deri në Luftën e dytë botërore.* Në "Gjurmime albanologjike folklor dhe etnologji", 18, 1988, Prishtinë 1989, f. 27-43 etj.

[645] P. Gjergj Fishta, O. F. M, *Parathâne.* Në "Kanuni i Lekë Dukagjinit", vep. e përm., f. XXI.

[646] Atë Bernardin Palaj*, Mitologji, doke dhe zakone shqiptare*. Zgjodhi, shtjelloi dhe përgatiti për shtyp Anton Nikë Berisha, Shpresa, Prishtinë 2000, f. 55.

Duke folur për mendësinë e banorëve të Dukagjinit, po dhe më gjerë, B. Palaj thotë: "Nji qi jeton me popullin e malevet dhe e studjon ket argument shef se të tana dukjet e natyrës kanë për themel nji mytologji të rrallë, ruejtë me zéll si themel i njij besimi të patrandshëm". Po aty, f. 19.

[647] P. Bernartin Palaj dhe P. Donat Kurti, *Hymje.* Në "Visaret e Kombit. Vëllimi II. Kângë kreshnikësh dhe Legjenda". Mbledhë e redaktuem nga At Bernartin Palaj dhe At Donat Kurti. Shtypshkroja "Nikaj", Tiranë 1937, f. XI.

kângë lahute' janë visari mâ i çmueshmi i gjuhës, shprehja mâ e gjalla e shum ndiesive bujare e përfytyrimi typik i fizjonomís së kombit t'onë"[648]. Pra në këto këngë "[...] këndohet fuqija e nji rrace rreth njeriu, qi ká punë me zâna shqiptare"[649].

Në hyrjen "Shka kallxon populli..." në *Prralla kombtare* (1940)[650], Donat Kurti përmend faktin se ky krijim gojor i pasur te shqiptarët ka ndihmuar të kalohen "orët má të bukurat e má të argtueshmet në fmini e janë kanë ushqimi i mendes e i fantazis s'onë[80]". Ai thotë po ashtu se

përrallat shqipe nuk u lënë mangu përrallave më të përmendura të kombeve të tjera[81]".

ÇËSHTJA E TRETË e rëndësishme që meriton të veçohet nga Parathënia e Mitkos është theksimi i nevojës që edhe të tjerët të merreshin me mbledhjen dhe me botimin e materialeve të tilla të letërsisë sonë gojore, përkatësisht që puna e bërë nga ai t'u japë një shkak e shtytje bashkatdhetarëve shqiptarë për të shpjerë e pasuruar edhe më tej atë: "Lutem që të tjerë, më të zotrit se mua në këtë punë, të pasurojnë këtë mbledhje edhe t'a zbukurojnë, ashtu që të përdoret për dobinë morale të kombit".

Mitkoja ishte i vetëdijshëm se puna që bëri ai në mbledhjen dhe botimin e disa llojeve të letërsisë gojore[651], të përfshira në "Bleta shqiptare" të vitit 1878 dhe të materialeve të "Bletës së dytë", të mbetura në dorëshkrim, ishte vetëm një fillesë e rëndësishme, punë që duhet ta bënin të tjerët që kishin më shumë njohuri për këtë fushë veprimtarie dhe të ishin të profesionit. Ai mendonte se puna duhej bërë sidomos në Shqipëri, ku ishin me dhjetëra e qindra subjekte tipike, këngëtarë dhe rrëfimtarë, të cilët kushtëzonin jo vetëm bartjen e krijimeve të ndryshme të letërsisë gojore shqipe prej një individi tek tjetri dhe prej një brezi në tjetrin, po dhe të pasurimit të kësaj tradite – dëshmi e lashtësisë së popullit tonë e të trashëgimisë së pasur. Me një fjalë, Mitkoja dha vetëm një shembull, siç thekson Gjergj Pekmezi në "Shënimin" e botimit të dytë të "Bletës": "[...] ata që duan të shkojnë (shqiptarë të tjerë – v. ime) pas gjurmave të këti mbledhësit të famshëm (kanë) një shembull të bukur e të pëlqyer[652]".

---

[648] P. Bernartin Palaj dhe P. Donat Kurti, *Hymje.* Në "Visaret e Kombit. Vëllimi II, vep. e cit. f. IX – X; shih dhe Atë Bernardin Palaj*, Mitologji, doke dhe zakone shqiptare*, vep. e cit. f. 155.

[649] P. Bernartin Palaj dhe P. Donat Kurti, *Hymje*, vep. e përm., f. IX – X; shih dhe Atë Bernardin Palaj*, Mitologji, doke dhe zakone shqiptare*, vep. e cit. f. 154.

[650] Donat Kurti, *Prralla kombtare*. Shkodër 1940.

[80] Donat Kurti, *Prralla kombtare,* vep. e perm., f. 5.

[81] Po aty, f. 9.

[651] Mitkoja nuk jep të dhëna as për subjektet nga i shënoi materialet, as për moshën e as për profesionin e tyre. Pa dyshim se duke jetuar jashtë atdheut dhe duke i mbledhur materialet përkatëse ai nuk kishte mundësi t'i zgjedhte subjektet tipike e as t'i kërkonte llojet e veçanta dhe më të plota, qoftë të poezisë ose të prozës gojore. Shih për këtë edhe mendimin e Gjergj Pekmezit në "Shënim" të botimit të dytë të "Bletës shqiptare" Gjergj Pekmezi, *Shpjegim.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep. e përm., f. 6.

[652] Gjergj Pekmezi, *Shpjegim.* Në Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos, vep. e përm., f. 8.

Se Mitkoja kishte të drejtë kur pohonte se "[...] që të tjerë, më të zotrit se mua në këtë punë, të pasurojnë këtë mbledhje edhe t'a zbukurojnë" , e dëshmon puna që bën pasardhësit e tij, sidomos françeskanët tanë me radhuan e njohur *Visaret e Kombit* në vitet '30 të shekullit XX, ku botuan një varg materialesh të lirikës, të epikës e të llojeve të tjera, pastaj doke e zakone të lashta, Kanunin e Lekë Dukagjinit etj.

Edhe materialet shqipe që u botuan më vonë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi dëshmojnë për pasuri të jashtëzakonshme të llojeve të ndryshme të letërsisë gojore e të ekzistencës së tyre.

Përmbledhtas mund të thuhet se Parathënia e Mitkos që i prin botimit të parë të "Bletës shqiptare", njësohet plotësisht me vetë rëndësinë dhe qëllimin e botimit të materialeve të përfshira në të, pikërisht ashtu siç i shkruante ai De Radës në letrën e 7 korrikut të vitit1879: "Bëleta ime, me krahë të miqevet, do të shërbenjë e do të punonjë për të gjithë këto punëra për të bashkuarë muhamedanëtë e të krishterët shqypëtarë[...][653]".

Pa dyshim se materialet e letërsisë gojore shqiptare janë një nga dëshmitë më të qenësishme të tërësisë (njëjtësisë) të botës sonë e të trashëgimisë së saj.

[653] Thimi Mitko,*Vepra*, vep. e përm., f. 635.
Rreth unitetit të shqiptarëve me fe të ndryshme Mitko shkruan: "Një liri feje më e madhe se ajo që mbretëron midis shqiptarëve nuk mund të gjendet as në kombet më të qytetëruara. Shqiptari, duke dashur pa fund atdheun e tij, do edhe bashkatdhetarin e tij, dhe kur ay është në tjetër fe, sepse fenë e ka në vend të dytë, kur puna është për atdheun e përgjithshëm". Shih Thimi Mitko, *Vepra*, vep. e përm., f. 14.

ARJANA SEITI (TIRANË)

ENTITET ETNIK TE "BLETA SHQIPTARE"

Korçë moj, e mjera Korçë.
Ç'është ky gazep mbi ty
Të ra zjarri në çarshi
Të dogji të bëri hi!
Mos kij keq e mjera Korçë.
Se ke djemtë kurbetlinj
Në Misir e në Vllahi
Të ndërtojnë me florinj[654].

Për këtë punim, shkëputa vargjet e një kënge folklorike, të gjetur në arkivat e Institutit të Antropolgjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve, sepse vetë Mitkoja, ishte një nga këta "kurbetlinj" të Misirit. Do t'iu sjell në vëmendje se këngët, përrallat, legjendat, gjëegjëzat apo rrëfimet e udhëtarëve, përshkrimet e etnografëve, nuk i mungojnë arkivave të këtij instituti. Ndonëse Thimi Mitkoja, konsiderohet si themelues i studimeve folklorike shqiptare, arkivave tanë i ka munguar dokumentacioni i tij, për faktin se ato janë krijuar dhe institucionalizuar pas Luftës së Dytë Botërore. Botimi i veprës së Thimi Mitkos në vitin 1981 e promovon atë në disa dimensione: historike, shkencore, kulturore e politike. Pikërisht, në këtë kumtesë do t'i referohemi këtij botimi, për të parë sesi dokumentimi i traditave themelore do të mbushte boshllëkun e historisë së Shqipërisë në shek. 19, por njëkohësisht do të pasqyronte dhe vizionin kulturor, politik e fetar të Thimi Mitkos.

Në vitin 1981, studiuesit Qemal Haxhihasani, iu besua botimi i veprës së Thimi Mitkos. Vepra e këtij rilindasi vjen e plotë nën kujdesin e Akademisë së Shkencave, pasi aty përfshihen një sërë albanologësh dhe bashkëpunime ndërinstitucionale me Arkivin Qendror të Shtetit dhe Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë. Në botimin e Qemal Haxhihasanit pasqyrohet lënda folklorike, fjalori, si dhe komunikimi i Mitkos me rilindasit e diasporës dhe albanologë. Falë punës hulumtuese dhe sistematike, Qemal Haxhihasani rrok një plejadë të tërë emrash, që ndihmuan në promovimin e vlerave kulturore dhe gjuhësore të shqiptarëve, ku spikat kompetenca albanologjike dhe angazhimi patriotik i Thimi Mitkos. Botimi i Haxhihasanit nxori në pah lidhjet e Shqipërisë otomane me botën e jashtme, bashkezistencën ndëretnike dhe shumëgjuhëshe, ndërkohë që Shqipëria socialiste në ato vite, ishte vendi më i (vetë)izoluar në kampin lindor. Thimi Mitkoja lartohet si një qytetar përtej kufijve, ku dijet albanologjike të shumë rilindësve shkëmbehen me etikë apo debatohen me qëllimin e vetëm të njësimit të gjuhës

[654] S. Saraçi; 1963, IAKSA, AE, material i pabotuar, nr. dok. 242/14, f.54. Një version i ngjashëm me këtë këngë është dhe një nga poezitë e Mitkos tek botimi i 1981, në fq. 582.

shqipe, fakt ky që i mungonte kaq shume elitës intelektuale shqiptare në periudhën kur e botoi studiuesi Haxhihasani.

Përgjatë jetës së tij 70 vjeçare, Thimi Mitkoja [1820-1890] arriti të shihte botimin e parë *'Bleta Shqiptare'*[655], më 1878 në Egjipt, por jo për herë të dytë, më 1924 në Vjenë, kur tashmë ai kish vdekur. Ai punon për subjektin e tij duke plotësuar boshllëkun përmes folklorit, idesë patriotike nga jashtë dhe nga brenda, si dhe argumentimin prej filologu në lidhje me prejardhjen e kombit shqiptar, duke krijuar ndërgjegjen [ose vetëdijen] etnike tek ky patriot. Një këndvështrim i shkurtër i tyre do të qartësonte dhe idetë e shoqërisë shqiptare të asaj kohe. Synimi i tij për të mos lejuar asimilimin e gjuhës dhe kulturës shqipe, bëhet qëllim jete.

Botimi folklorik i Mitkos ofroi një bazament të qëndrueshëm që do t'i shërbente më pas jo vetëm studimeve folklorike shqiptare. Hulumtimet e tij në Misirin e largët edhe pse i kushtëzuar nga emigrimi i një grupmoshe relativisht të re, si dhe nga lokalizimi gjeografik, nuk e zbehën aspak punën kërkimore. Koleksionimet e tij folklorike, përfshijnë ngjarjet e jetës, që jepen përmes këngëve të dashurisë, të dasmës, të motmotit, të trimërishte e historike, etj. Ai shqetësohet për rolin asimilues dhe identifikues që luante feja në shoqërinë shqiptare të shek. XIX. Myslimani shqiptar quhej turk, ortodhoksi shqiptar thirrej grek ndaj dhe e pasqyron këtë aspekt përmes këngës, përrallës, fjalëve të urta. Lënda vjen e ruajtur në kujtesën e një grupi emigrantësh, kryesisht meshkuj. Në këtë botim emrat e bartësve nuk gjenden, pasi qëllimi kryesor ishte mbledhja dhe publikimi i këngëve dhe ngjarjeve të zhvilluara në hapësirën shqiptare, por ama misioni i tij shpaloset, kur citon Herderin se *një popull nuk mund me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet.* Shumë prej këngëve të mbledhura prej Mitkos në emigracion, do të botohen apo regjistrohen edhe pas gjurmimeve të tij, një fakt i vërtetueshëm falë materialeve që disponohen në arkiva. Lidhja me folkloristin çek Jan Urban Jarnikun si dhe këmbëngulja e tij për shkrimin në shqip të këngëve dhe fjalëve të urta, apo rënia në ujdi për përkthimin e përrallave, bëhet tregues i domosdoshmërisë dhe rolit që luan tradita në përcaktimin e entitetit etnik te kombit shqiptar.

Përsa i përket shkrimit të gjuhës shqipes, vetë Mitkoja dha kontributin e tij në këtë aspekt. Është e çuditshme, kur has ndonjë mendim skeptik, që Mitkoja nuk ishte filolog. Përpilimi i fjalorit dygjuhësh shqip-greqisht nga ana e tij, mund të trajtohet si një nga paradokset, kur personalisht ai ndodhej në Egjipt dhe jo në ndonjë hapësirë gjeografike që i përkiste Greqisë. Mitkoja u arsimua në Korçën e Teodor Kavaliotit e të Mjeshtrit Dhanili, ku i pari kish botuar një *Fjalor të greqishtes, vllahishtes dhe shqipes popullore*[656], të përfshirë në abetaren e tij (1710), dhe i dyti kish botuar një *Fjalor katër gjuhësh* (1802), ku shtoi dhe bullgarishten. Ndoshta duhet të themi, se kjo qe dhe rruga që e orientoi Mitkon në hartimin e një fjalori

[655] *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar* (1635-1912) II, f.7-11. Tiranë.
[656] S. Skëndi, *Studime kulturore ballkanike*, 1980, f. 235.

dygjuhësh duke i paraprirë betejës së krijimit të një gjuhe zyrtare, gjë për të cilën ai flet shumë në letërkëmbimet e tij. Se sa i rëndësishëm ishte roli i gjuhës dhe njesimi i Alfabetit të Shqipes [1908], u vërtetua, kur pak vite më vonë Shqipëria u deklarua si shtet më vete [1912]. Gjuha për këtë rilindës ishte gur themeli i identitetit kombëtar dhe njohja e saj e qartësoi dhe rivitalizoi harmoninë midis popujve fqinjë, si dhe i ktheu dinjitetin e mohuar kombit shqiptar. Rreziku i humbjes së gjuhës amësore jo vetëm në sytë e kurbetlinjve, por dhe të rilindësve me emër, kish gjeneruar në konfrontime gjuhësore, kulturore apo fetare, të cilat prodhonin krizë identiteti dhe e vinin në pikëpyetje faktin se kush janë shqiptarët. Do t'i referohemi një letre të Mitkos adresuar De Radës në të cilën shkruhet: *'..meqë të folurën shqip që ka përdorur At Kamarda mund ta kuptoj me vështirësi, m'u desh të kërkoja dhe të gjeja tekstin greqisht ose frëngjisht'.* [657]

Një nga aspektet, ku do të ndaleshim është dhe gjuha letrare e përdorur në letërkëmbimet e tij, e cila nuk ka asgjë të përbashkët me këto gjurmime folklorike apo me fjalorin e përpiluar prej tij tek *Bleta Shqiptare*. Gjuha e tij e letërkëmbimit rrezaton etikë, dlirësi dhe delikatesë prej shkruesi dhe lexuesi, qoftë në adresim e qoftë në mbyllje të letrës. Të bën përshtypje, se si Mitkoja i adresohet një *bashkëatdhetari shumë fisnik*, të cilit i kërkon të flakë iluzionin e mallkuar mesjetar të mohimit të arsimit në gjuhën shqipe[658]. E ndërkohë letërkëmbimi i tij i vazhdueshëm me De Radën pikëzohet prej shprehjeve të dashurisë vëllazërore: T*ë puth sytë vëllazërisht e jam vëllai yt.* Letërkëmbimet e tij dëshmojnë qartazi përpjekjet e Mitkos për të mos e lënë atë në një gjuhë individësh, por në marrjen e përmasave ndërkombëtare, apo e thënë ndryshe të një statuti zyrtar për të njesuar abetaret e shumta që qarkullonin asokohe.

Nëse mbledhja dhe gjurmimi i folklorit shqiptar do të nënkuptonte kujtesën apo traditën, përpilimi i fjalorit dygjuhësh si bashkekzistencë e tyre, si dhe letërkëmbimi i Mitkos si Un i tij, do të rrezatonin njohuri, qytetari dhe përpjekje patriotike për të mos lejuar asimilin e gjuhës së folur. Teorikisht përmes *Bletës shqiptare,* Thimi Mitkoja, arriti të publikonte njohuritë popullore si dhe komunikimin me botën, të realizuara përmes emigracionit si një fenomen në lulëzim përsa i përket shekullit XIX. Duhet shtuar se kujtesa kolektive nuk mbeti vetëm në fazën e konservimit, por u pasua me botimet dhe ribotimet në sferën e albanologjisë, duke formësuar tek ne, atë ç'ka ekzistonte në Unin e tij. Pa hezitim vepra e tij përbën një entitet etnik, ku përmes këtyre traditave kulturore u synua të nxirrej në pah Shqipëria, populli i saj dhe bota elitare e munguar.

[657] Th. Mitko; *Bleta Shqiptare Vepra,* 1981, f. 631.
[658] Po aty, f. 637.

ARTUR LAMAJ (GJIROKASTËR)
JANI JANI (GJIROKASTËR)

ASPEKTE ETNOLINGUISTIKE E SOCIOLINGUISTIKE NË PËRRALLAT E "BLETËS SHQIPTARE"

Në radhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, *Thimi Mikoja* bën pjesë ndër personalitetet që hulumtoi e përcolli jo vetëm mesazhe patriotike *"për qëllimet e larta të kombit"*[659], por edhe kumte mitike, poetike, mendime, kritika, letërkëmbime me vlera të çmuara morale, estetike, retorike e psikosociale.

Kujdesi dhe vizioni i Thimi Mitkos për t'i përcjellë materialet e mbledhura *me të dhëna zakonore,* çelin shtegun për të kundruar e veçuar interesat e tij etnologjike, pasionin për gjuhën dhe letërsinë popullore, falë të cilave, sipas kritikës, "ai u ngrit në lartësinë e figurave të njohura të vendeve të tjera"[660].

Prirjet e tij, për të nxjerrë në pah *pasuritë leksikore* të shqipes, janë sendërtuar në vlerësimin se gjuha e vërtetë e popullit shqiptar jeton në letërsinë gojore[661], në tërësinë e mesazheve të traditës, në tekste ku mrekullitë janë të natyrshme dhe magjitë rregull.[662] Në këtë hulli, ai iu afrua një kategorie klasike letrare ku ruhet kujtimi i moteve të harruara, ***përrallave***, të cilat i mblodhi me kujdes e kërshëri.

Në studimet etnogjuhësore europiane *ato janë perceptuar* si tekste që mbartin surpriza, fakte dhe aventura imagjinare, entitete magjike që sendërtohen në objekte të caktuara etj. Si të tilla, mund të kundrohen *në disa drejtime*: si një vektor i çmuar për identifikimin e specifikës kombëtare të një prej popujve të lashtë të Ballkanit; *si një hapësirë fantastike* që çel shtigje për shkodimin e individualitetit të personazheve e identifikimin leksemave që i sendërtojnë ato gjuhësisht; si *një areal interesant* për përqasjen e dikotomisë tekst-sistem kulturor.

Në një vështrim *të përgjithshëm* etno e sociogjuhësor, mund të thuhet se 21 përrallëzat që ndeshim në veprën e Mitkos, përbëjnë një dokument interesant me dëshmi për institucionet, sistemin e vlerave e vizionet e veçanta të botës shqiptare. Të mbushura me realitete të vërteta dhe imagjinare[663], ato mbartin këshilla, porosi, betime e rregulla, fushëveprime të personazheve dhe ecurinë e tyre morale.

Realitet e jetës sociale në botën e përrallave lidhen *me respektimin* e normave dhe të «les conditions rituelles"[664] që rregullojnë ndërkëmbimet emocionale *mes*

[659] Qemal Haxhihasani, Parathënie, *Thimi Mitko*(vepra), Tiranë, 1981, f.47.
[660] Qemal Haxhihasani, vep. cit. 1981, f.57.
[661] vep. cit. 1981, f.50.
[662] Shih Mustafa, M. *Përralla shqiptare* (poetika dhe mistikja), Prishtinë, 2003, f. 20.
[663] Shih *Calame-Griaule Geneviève*. Pour une étude ethnolinguistique des littératures orales africaines, *Langages*, nr.18, 1970, f. 22-47.
[664] Hampate Ba A. et Dieterlen G. Koumen. Texte initiatique des pasteurs peuls , Paris, *Cahiers de l'Homme*, 1961, p. 3

personazheve. Në një vështrim të parë, vërejmë se statusi i personazheve të përrallave të "Bletës shqiptare" jepet me anë të mesazheve që mbartin udhërrëfimin e perceptime filozofike të veçanta. Kështu, në përrallzën "Tri këshillat e një plaku", falë fjalive nxitëse, shprehen këshillat e porositë[665] e një burri që "*shet fjalë me para*": *Në lumë të turbullt,mos të shkosh; Gruan në dorë të botës, mos e lësho; Bagëtinë, në dorë të huaj mos e lë*sho etj.

Një element i rëndësishëm që shërben për zbulimin *e identitetit shoqëror të personazheve* të
përrallës, janë formulat hyrëse, termat klishe[666], përsëritjet e pjesëve të tekstit apo të thënieve: *Qe
një mbret* që kishte një kopsht të bukur(të madh), ishte një baba fort i begatë; Marua dhe Ndreu ishin vëllazër *të varfër* nga e ëma; një plakë e vobektë që rrinte me kursim të madh nga *vopëzia; tre* vëllezër që perëndinë dhe mushkën kishin për gjë e pasuri – Dy vëllezër kishin një motër *që e duanin kaq fort* sa çdo gjë që u lypëte, s'ja kursenin etj.

Duke e kundruar personazhin si një element të domosdoshëm në ndërtimin e fabulës së përrallave, vërejmë se *vramendësi* i epsiodeve të përrallave është *heroi*, me funksione të caktuara e ngjyrim emocionor më të gjallë. Në këtë hulli, një lexim i vëmendshëm e lehtëson, nga njëra anë, perceptimin e heroit lavdimadh falë disa *identiteteve sociale tipike pozitive,* si: djali i vogël, vëllai i vogël, çupëza e vetme, çupa fort e bukur, mëria, plaku i mençëm, mbreti i yjeve etj., por, nga ana tjetër, nuk mund të lësh larg vëmendjes faktin se trajektoret etike e psikologjike, ndërkëmbimet e papritura ky hero i sendërton me personazhe të pabesë, meskinë e hipokritë që përfaqësohen nga *entitete negative*, si: kopilja e plakës, motra e keqe, kumbara, njerka etj.

Nëse do të përshkruanim veprimet e një heroi të përrallës shqiptare *semiologjikisht,* ai mund të pikturohet me disa elemente shenjorë metaforikë e hiperbolikë, si p.sh. *godit* mollën e artë, *shëron* me gjuhë plagët e lisit që e shkurtojnë me sopatë, *kapërcen hendekun* e gjerë, *përballet* dhe arrin fitoren me kuçedrën, *zë* mollën me dhëmbë, *pi* ujë gjunjazi; kur *qesh,* i dalin trëndafilë nga goja, kur *qan* ajo, i rrjedhin margaritarë nga sytë etj.

Në albumin social të përrallave paraqet interes fantazia e rrëfyesit popullor *për enigmat e martesës,* lojërat e dashurisë, për provën e inteligjencës së atyre që kërkojnë dorën e heroinës. Në hapësirat e disa përrallave, vërejmë se disa episode strukturohen me fjalë, sintagma dhe shprehje të figurshme që mbartin veprime, dëshira, gjendje emocionore të heroit për dashurinë. P.sh.: *Me mendje të prishur* nga jarania, *zjarri* i dëshirimit të çupës, zu t'i *çelet* zemra, vajti me *të madh nder*, e

[665] Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1997, f.134.
[666] Shih më gjerë Mustafa, M. *Veçortië e stilit rrëfimor të përrallës*, në "*Përralla shqiptare*" (poetika dhe mistikja), Prishtinë, 2003, f. 243.

pritën të gjithë *të mëdhenjtë* e pallatit, djali *vu besë* mbi dashurinë e saj, më tepër *i rrihnin* këmbët nga pallas i çupës etj.

Duke i shkoduar përrallat e Mitkos sipas ndryshorëve *rregull, normë, tabu, ndalesë*, bie në sy *rritja e gravitetit të sanksioneve* për ato personazhe që nuk janë të vëmendshme ndaj një kodi moral të shpallur, apo që bëhen pengesë për realizimin e dëshirave të të tjerëve. Situata të tilla jepen falë disa mesazheve: Tani, pra, *të kam në dorë time*(djali-e bukura e dheut, 377): Hap sytë se, ndë mos më rrëfesh drejtë, *nukë shërohe* (Kopilja-djali i një babai fort të begatë,376); pasi mësoi edhe të këqijat që i bëri e emëta çupës, *urdhëroi dhe e vranë atë grua*...(I biri i mbretit- motra zemërligë që hodhi mbesën e saj në plehun e fshatit,387).

Rregullat, doket etnolinguistike, ndalesat në shoqërinë shqiptare të kohëve të shkuara lidhen me *disa çifte interesante* personazhesh, dukurish natyrore e shpirtërore, s*i* burrë-grua, i martuar- i pamartuar, brenda (shtëpisë, pallatit) – jashtë (te dera, te porta, te kroi, të mali, te hije lisit), vdekje-jetë, mbi tokë-nën dhe, afër- larg, natë-ditë, dritë- errësirë etj. Dekodimi etno e sociolinguistik bëhet më i vlershëm, sidomos, kur iu referohet gjendjeve fiziologjike të qenieve të gjalla, fushëveprimit të disa personazheve që sjellin gëzim e lumturi në jetë apo humbje të qartësisë mendore. Nata paraqitet *si mbretëresha* e errësirës. Enigmat e natës në përrallëzat e Mitkos lidhen përgjithësisht me frikën, si: trembja nga *ushtima e pelave të egra* (Pelat e egra, 387), tmerri nga lamia që, në mes të natës, tuke pallur me një zë të shëmtuar, rrëmben një ftua dhe ikën si rrufe (Qerozi,358).

Në shtratin e disa përrallave të "Bletës shqiptare" ndodh edhe transformimi i qenieve njerëzore në sende a gjëra pa frymë e shpirt, dmth ajo që në studimet linguistike europiane quhet "vdekje sociale"[667]. Në këtë hulli, mund të përmendet situata e transformimit në gur(*e bëri gur) të djalit të madh të peshkatarit që do për grua perëndeshën e dheut (*Peshkatari dhe e bukura e dheut*, 352), apo aftësinë e valltares - fustanellë *për të ngrirë e gurëcuarë* të gjithë trimat e bujarët që e kishin dashur ta merrnin atë për grua (Gjyrgjylë Çingija, f.382)

Kodimi psikosocial dhe përmbajtja semantike e përrallave mund të zbulohet edhe ***në rrafshin semantik e leksikor.*** Është e rëndësishme të theksojmë se episodet e përrallave marrin udhë në saj të njësive leksikore që emërtojnë qenie, sende, dukuri sipas tipareve të tyre të përbashkëta në jetën natyrore, në kulturën racionale dhe mitike. Sipas këtij pikëvështrimi, mund të shqyrtojmë leksikun historik, mitologjik dhe folklorik.

Leksiku historik

Kjo shtresë paraqitet për mes një larushie tipash, ku do të veçonim:

1. Së pari, leksemat që tregojnë personazhe *sipas statusit social.* Kjo nënshtresë e leksikut historik shpreh qartë perceptimet, veprimet dhe vlerësimet psikosociale të mbretërve, monarkëve, bujarëve për shtresa e kategori të tjera sociale dhe,

[667] Shih Calame-Griaule Geneviève. *Pour une étude ethnolinguistique des littératures orales africaines*, *Langages, nr.18, 1970, f. 35*

anasjelltas, repertorë gjuhësorë, emocione dhe vlerësime afektive përcjellin për ta shtresat më të ulëta të shoqërisë.

Sipas këtij ndryshori sociolinguistik, mund veçojmë:

a-Fjalë që emërtojnë personazhe që i përkasin *shtresës sociale më të lartë*, si: mbreti, mbretëresha, bujarët, i biri apo djemtë e mbretit, çupa(t) e mbretit;

b-Fjalë që emërtojnë personazhe që i përkasin *shtresës së mesme*: mjeku (i mbretit), gjyqtari, kadiu;

c-Fjalë që emërtojnë personazhe që kryejnë një *mjeshtëri të dobishme*, si: argjendar, bashtovanxhi (kopshtar), bukëtar, drutar, druvar, peshkatar, pendar (roje) i vreshtës etj.

d- Fjalë që emërtojnë personazhe që i përkasin *shtresës më ulët*: kopilja e mbretit(e çupës së mbretit), kopili i bashtonvaxhiut, plaka e vobekët, portari i mbretit etj.

2. Së dyti, leksemat që përdoren në popull se *e kanë pse-hin e vet e nuk janë trillue prej kurrëgjëje*[668]. Ato emërtojnë fushën hapësinore[669], mjediset ku zhvillohen ngjarjet, tërësinë e realieve që lidhen me jetën e përditshme (objekte shtëpiake, sistemin monetar, veshjet), armët nga të cilat mund të veçojmë:

a- Fjalë që emërtojnë *vende apo elemente hapësinore*: anë e detit (u sos të shikonte ndonjë lundër), drithnik, dhoma të ndritshme, furrë buke, hauz, hije lisi, kashtore, kote(e të et), kamare e çupës, krua për ujë, kullë, lumi i turbullt, makazinat, mal (ariu ndë), mulli, odë, pyll i madh, qilart të thellë, udhë, va i lumit etj.

b-Fjalë që lidhen me emrat e *armëve shqiptare:* çomangë-topuz, kubure, kordhë, pallë, purtekë e hekurt.

c- Fjalë që emërtojnë *pije* dhe *ushqime*: gjalpë, gjellëra, kulaç, lakruar (pite), pulë e pjekur, verë, vezë të tiganisura ujë etj.

d- Fjalë që tregojnë mjete dhe objekte *të përdorimit të përditshëm*: arkëz, dru ftoi, harar, ibrik, kofinë, legen, pambuk, pendë, pëlhurë, poçe, thes, vozë (me ujë) etj.

dh- Fjalë që emërtojnë *metalet e çmuara*: unaza e gishtit, byzylyket e dorës së vajzës së mbretit etj.

e- Fjalë që emërtojnë *kafshë e shpendë*: çapë, dre, kalë, kone, langua, mushkë, patat në lëndinë, pelat e egra; një pëllumb e kishte çupëza etj.

f-Fjalë që emërtojnë sistemin monetar: tre grosh, 5 drëhemë, para.

Leksiku mitologjik e folklorik (sipas perceptimit psikosocial)

Protoganisti i përrallave shqiptare është i rrethuar nga dy tipa personazhesh: njerëzorë dhe mitologjikë[670]. Qeniet mitike që ndeshim në përrallat e Mitkos, veprojnë në botën tokësore e nëntokësore[671]. Duke kundruar leksikun që lidhet me

[668] Atë Kolë Berisha, *Rrjedhia e disa shprehjeve popullore në kallxim*, *Etnografi, 5,* Tiranë, 2004, f. 13.

[669] Civjan Tatjana, *Rreth semantikës së elementeve hapësinore të përrallës mitike*, "*Gjurmime albanologjike*", Prishtinë, 1982, XII.

[670] Uçi, A. *Mitologjia, folklori dhe letërsia*, Tiranë, 1982, 158- 213.

[671] Myzafere Mustafa, *Përralla shqiptare* (poetika dhe mitikja), f. 95.

botën demologjike e mitike, vërejmë procese sociolinguistike, indicie[672], përbashkësi dhe interferenca të hershme mes etnikumeve ballkanike.

Në përrallat e Mitkos ndeshim zakonin e vëllezërve-kryq, vëllamëve (Petriti- mbreti i yjeve- mbreti e i peshqve; kordha-ylli- deti)); zakonin e tri grave në lindje[673] (i erthnë tri fatiat për të lidhur fatin e çupës mbë të tretatë, *Cmiri në dy motra*,385); ekzaltimin, jetësimim dhe mrekullitë që mbart perëndesha e nëntokës, *e bukura e dheut,* por edhe atributet e së keqes që personifikojnë qeniet e tjera mitologjike, si: *bistra, bushtra, djalli, kuçedra* dhe *lamia.*

E bukura dheut, e bukura e jetës arb. si një njësi leksikore, estetike simbolizon idealin e së bukurës. Ajo perceptohet me funksione sociale në episode të caktuara dhe ndërkëmbimi i personazheve të tjerë me të(martesa) kërkon sakrifica, hyrjen e heroit në vështirësi, para, vetëmohim, durim, mençuri[674] e ndonjëherë vetëflijim. Sipas këtij perceptimi, janë strukturuar dialogu me qerosin, kushti i pagesës së florinjve për ndjesinë e bukurisë fizike nga djali me kësulë e kënaçe (371), dyluftimet e Petritit, Kordhës me kuçedrën me 6 këlyshë etj. (396)

Në subjektet me trill përrallor mund të veçohen edhe disa çifte sintagmash *me semantikë të veçantë:* ujë i bardhë- ujë i kuq (ngrin-ngjall njerëzit, 353), ujët e gjallë të maleve (ngjalli të vëllanë, shëron mbretin, 369) të cilat emërtojnë disa *mjete mitike për ringjallje*[675]; fjalë, shprehje e sintagma informative: *pendë* në derë që pikon gjak (tregon një ditë të keqe, 401), *trëndafili (lulja) i vyshkur* (tregon rrezik), me të cilat kodohen *mjete mitike sinjalizuese* me statusin e personazheve bashkëvepruese me heroin të përrallës, me simbolikën rilidhjes me të.[676]

Në episode të caktuara ndeshemi me emërtime të *objekteve të animuara*, të mjeteve mitike vepruese:[677] *guri i kripës* (shfaq një mal të lartë), *krehri*- shfaq një pyll me shumë drurë, *furka* që tirrte vetiu ar (361), atje, jashtë pallasit, ... *një dru molle* po e vështronte djalin(402), *kapa, kësula* që sapo i çon në kokë të shpien në vendin e dëshiruar, *kënaçja* e pluhurosur që vë në veprim ushtarët. Këto objekte e ndihmojnë heroin në udhën e suksesit dhe (njëkohësisht) shërbejnë si tregues kulturorë të etnisë së moçme shqiptare, tregues që i ndeshim edhe në simbolikën emërtuese e shenjtërimin e numrave simpatikë të lidhur me kalendarë parakristianë (1,2,3,7, 9 etj.) [678]: *tre* (tri)- çupa, djem, groshë, fati, fytyra, ftonj, llambadhe, pela, pendë, qen, trima etj. dhe dëshmojnë në të mirë të argumentit se mitologjia shqiptare është një përmendore parashqiptare dhe paraslllvave[679].

[672] Çabej, E. *Zakone dhe doke të shqiptarëve*, në "*Studime gjuhësore*", Prishtinë, 1975, V, 202.
[673] Çabej, E. *Zakone dhe doke të shqiptarëve,* në "*Studime gjuhësore*", Prishtinë, 1975, V, 201.
[674] Myzafere Mustafa, *Përralla shqiptare* (poetika dhe mitikja), f. 97.
[675] Myzafere Mustafa, *Përralla shqiptare* (poetika dhe mitikja), f. 204.
[676] Myzafere Mustafa, *Përralla shqiptare* (poetika dhe mitikja), f. 205.
[677] Myzafere Mustafa, *Përralla shqiptare* (poetika dhe mitikja), f. 172.
[678] Sinani, Sh. *Etnos në epos*, Tiranë, 2011, f. 14.
[679] Sinani, Sh. *Etnos në epos*, Tiranë, 2011, f. 15.

Përrallat e "Bletës shqiptare" kanë në përmbajtjen e tyre edhe një seri fjalësh, imazhesh shprehjesh me rimë, të cilat ndërtohen sipas raportit e vërtetë-gënjeshtër: Ndrit, unë, ndrit shtëpia, ndritënjë *poçet* e mija(410), Zbritën *shpesat e përëndisë* të hanë sytë' e njerëzisë (411, Druvari dhe gruaja budallaqe), o i shtiri në harar, o i sjelli në gomar, as dëgjo, o shurdhaman... (414, Kumbara); por nuk mungojnë edhe *njësitë frazeolgjike*: ⋆mori dhenë, ⋆i jepte zemër, ⋆ia dhanë gazit, ⋆bëj zemër "trimërohem", ⋆iu dha zë (vëllezërve), ⋆s'më ha malli, ⋆me mendje të prishur, ⋆me gjithë shpirt (uronte), ⋆e bëri trokë, me gjithë zemër, ⋆u bë e tëra vrerë etj.

Nga sa parashtruam më sipër, ***mund të përfundojmë se*** tekstet, episodet e përrallave shqiptare mund të shqyrtohen sipas ndryshoreve sociolinguistike, kategorive etnolinguistike që ato përmbajnë. Përrallat janë tekste identitetike e intresante, me formula lidhëse dhe informative konstante. Ato mbartin mentalitetin primitiv të kohëve të shkuara, afeksionin, të mrekullueshmen në disa forma: *hyjnore*(objekt a mjet mitik), *magjike* (fuqitë magjike të

objekteve të animuara), *njerëzore* (heroi me fuqi magjike)[680].

Në themel të përmbajtjes së tyre ndeshim ***entitete leksiko-semantike*** me statuse, role dhe fushëveprime funksionale të larmishme, të cilat mund të zbulohen përmes tekstit, përshkrimeve fizike, veshjes, frazeologjisë, motivimit psikologjik, mjeteve ndihmëse, referimit në të dhëna historike që përcaktojnë fatin e tyre, si dhe falë përftesave gjuhësore e stilistike.

[680]Heidi Ripatti, L'analyse des symboles du merveilleux dans les contes en prose de Perraul, *Philologie romane*, 2011.

BEXHET ASANI (STRUGË, MAQEDONI)

NGJASHMËRITË E DISA KËNGËVE TË " BLETËS SHQIPTARE " ME KËNGËT E FSHATRAVE TOSKE TË TREVËS SË STRUGËS

Kanë kaluar njëqind e tridhjetë e shtatë vjet që nga botimi i "Bletës shqiptare" të Thimi Mitkos dhe ende ndihet nevoja për studimin e saj të mëtejshëm. Në veprën folklorike të Thimi Mitkos janë botuar 505 këngë popullore të zhanreve të ndryshme. Ndërsa në veprat folklorike "Ç' u këput një degë qarri" dhe "Zura trëndafil me vesë" janë botuar 537 këngë popullore. Një numër i kosiderueshëm i këngëve, edhe pse ka kaluar aq kohë, janë përcjellë gojë më gojë e brez pas brezi gjer në ditët tona, në fshatrat toske të trevës së Strugës, në veçanti dhe në trevën e Strugës në përgjithësi. Mbi dyzet këngë popullore të llojeve të ndryshme, pothuaj janë identike me ca ndryshime të vogla dhe një numër mjaft i madh i tyre janë pak a shumë të ngjashme me këngët të cilat i ka shënuar folkloristi Thimi Mitko. Vetëm një numër shumë i vogël i këngëve kanë ardhur të zbehta deri në ditët tona. Natyrisht këngët kanë pësuar një evoluim, ato kanë kaluar nga një lloj në një lloj tjetër të këngëve. Kështu, ka këngë që te "Bleta shqiptare" e Thimi Mitkos janë këngë dasme, ndërsa sot na dalin si këngë dashurie, këngë kurbeti etj., dhe anasjelltas. Vlen të theksohet se gati te një e treta e këngëve ka një varg të ngjashëm, dy, tre apo edhe katër vargje, apo janë të zëvendësuara me fjalët si: venë – shkojnë ose ikin etj. Te "Bleta shqiptare" këngët janë të shoqëruara me emra kristianë: Ilia, shën Nikolli, shën Mëria, vangjelizmoi, Kostaq, Kostandin, Dhimitraq, Angjelinë, prift, priftëreshë etj. Nga gjithë këta emra, përveç emrit Kostandin, te balada "Tinë mor Kostandin" emër i vetëm i krishterë, i cili ka mundur të mbijetojnë gjer në ditët tona te këngët popullore shqiptare të trevës së Strugës edhe pse popullsia i përket besimit islam, ndërkaq të tjrët janë zëvendësuar ose janë zhdukur.

Në ciklin e parë me titull "Këngë të vegjëlish" të përmbledhjes folklorike "Bleta shqiptare", Thimi Mitko i ka radhitur këngët e motmotit si: këngët e dallëndyshes së parë, këngët e dordolecëve etj. Në këtë cikël ka radhitur edhe këngët dhe lojërat e fëmijëve etj.

Ciklin e dytë e ka titulluar "Këngë për festat popullore të motmotit" këtu i ka radhitur kryesisht këngët kalendarike, qofshin ato fetare ose këngë pagane. Nga ky cikël i këngëve të Thimi Mitkos, asnjë këngë nuk është shënuar gjer më sot në trevën e Strugës, duket haptas se këngët e këtij kapitulli nuk kanë mundur t' i përballojnë presionit fetar, në këtë rast atij islam.

Te variantet e këngëve të kapitullit të parë "Këngë të vegjëlish": "Hëna e re" apo "Hën' e re, vash' e re" fëmijët, në të kaluarën edhe të rriturit i drejtoheshin hënës për shëndet, si dhe për shërimin e ndonjë sëmundjeje. Këtë e shohim te kënga "Hën' e re, vash' e re", e cila është e shoqëruar me një shënim mbase nga redaktori i librit: "këtë këngë ia këndonin gratë hënës së re, duke mbajtur një

gjësend metali në dorë, veçanërisht kur donin të shëronin ndonjë sëmundje lëkure"[681].

Simotrën e këtyre dy këngëve e gjejmë sot e kësaj dite në fshatrat toske të trevës së Strugës. Përderisa në zonat më të thella të Jugut të Shqipërisë i drejtohen hënës për shëndet, në rajonin e Strugës fëmijët i drejtohen dallëndyshes së parë për shëndet. Besohet se dallëndyshja do t'u sjellë shëndet gjatë vitit. Pasi e përsëritin këngën disa herë fëmijët e heqin veroren, të cilën e quajnë martinkë dhe, që e kanë vënë në byzylyk të dorës një ditë para ditës së verës më 13 mars, duke e vënë në degë të trëndafilit apo edhe të ndonjë peme tjetër. Le të shohim tani një variant të Thimi Mitkos dhe një variant të fshatrave toske të Strugës sesa të ngjashme janë:

Hën' e re,
vash' e re,
tinë plakë,
Ti gërshet -
ti gërshet,
Unë shëndet.[683]

Dallëndyshe,
Faqekuqe ,
un' e re,
Unë shëndet,
Dushmani në dhet![682]

Më e zbehtë na vjen një këngë e dordolecëve, siç është kënga "Dordolece bjerë shi". Kjo këngë te përmbledhja folklorike "Bleta shqiptare" është më e plotë, ndërsa në trevën e Strugës këtë këngë e kemi vetëm si mbijetojë. Pse? Përgjigjja është fare e lehtë dhe e thjeshtë. Kënga "Dordolece bjerë shi" ka elemente të krishterimit, ndërsa popullsia e trevës së Strugës, siç u tha është e besimit islam, prandaj kënga është e zhveshur nga elementet religjioze që i ka te Thimi Mitko:

Dordolece bjerë shi.
O i zoti shënd Illi!
As na ep një pikë shi,
të na bëhet grur' i ri,
një karroqe një kalli,
ju shenjtore, pamberë,
që ju lutemi përherë,
lutij zonjës shën Mëri,
Dordoleci bie shi,
me kryq, e me luvari[684]
një karroqe, një kalli.[685]

[681] Mitko, Thimi., "*Vepra*" Instituti i Kulturës Populllore, Sektori i prozës dhe i poezisë, Tiranë, 1981, 69.
[682] Asani, B., "Ç' u këput një degë qarri" (Këngë populllore nga fshatrat toske të Strugës), Onufri, Elbasan, 1996
[683] Mitko, Thimi., "*Vepra*" Instituti i Kulturës Populllore, Sektori i prozës dhe i poezisë, Tiranë, 1981, 72.
[684] Mitko, vep. e cit.,72
[685] Asani, B., "*Lirika populllore shqiptare në Maqedoni*" (Studim monografik), Iris, Strugë, 2011, f. 204.

Këngën “Maji, maji, rritna leshtë” te “Bleta shqiptare” e gjejmë vetëm me pesë vargje, te fshatrat e trevës së Strugës simotra e saj “Maj, maj kokomaj“ ka katërmbëdhjetë vargje. Pra, është më e plotë dhe më e arrirë. Këngëtari popullor siç duket ka pasur aftësi krijuese, i ka shtuar edhe nëntë vargje të tjera dhe e ka bërë më interesante. Fjalët: leshtë, drurë, kut, si dhe vargun e dytë: “si vllastarja në vëreshtë“, i ka zëvendësuar me fjalët: flokët, purtekë, udhë, kurse vargun e dytë e ka hequr fare. Le të shohim ngjashmëritë dhe dallimet:

Maji, maji, rritna leshtë,
si vllastareja në vëreshtë,
si bishti i kalitë,
si drurë të malitë,
si kut i pazaritë. [686]

Maj – maj kokomaj
Ritmi flokët;
Sa t’i mbaj
Për një javë
Sa një stav.
Për një muëj,
Sa një duëj.
Për një vjet,
Sa një plep.
Sa pragu i derës,
Sa bishti i pelës,
Sa qimja e kalit,
Sa purtek’ e malit -
Sa udh e pazarit.[687]

Nga cikli “Këngë të vegjëlish“ të ngjashme janë edhe këngët: “Re, re bobore“ (f. 70), “Moj laraskë këmbëlaskë“ (f. 73), “Pyr, pyr, pyr, bekëza“ (f.78), “Ç’e bëre mishtë, moj nuse?“ (f. 81), dhe “As ia thoni njëzë, të bënenë dyzë“ (f. 83) etj. Këto këngë me tituj të ndryshëm mund të gjenden te përmbledhja folklorike “Ç’ u këput një degë qarri“, si: “Dil, dil, ore diell“ (f. 16), “Oj laraskë“ (f. 18), “Olloman, dolloman“ (f. 22), “Ptu, ptu lekëza“ (f. 26), “Oj nuse“ (f. 24), “Aj t’i thomi njëzë..” (f. 219) etj.

Në kapitullin e katërt të “Bletës shqiptare“ Thimi Mitkoja i ka radhitur këngët e dasmës. Nga ky cikël i këngëve, gjer në ditët tona, edhe pse kanë kaluar plot njëqind e tridhjetë e shtatë vjet, nga viti i botimit të “Bletës shqiptare“ kemi gjetur shtatë këngë të ngjashme dhe një numër këngësh të tjera, të cilat janë transformuar plotësisht. Megjithatë, në brendi të tyre mund të gjendet një, dy apo edhe tre vargje, me pak ndryshime.

Kënga me numër 171 dhe me titull “Ç’ vetëtit atje rëposh?“, të cilën e ka shënuar Thimi Mitkoja, në veprën folklorike “Ç’u këput një degë qarri“ e gjejmë me titullin “Ç’ vetëton në derë posht?“. Kjo kjo këngë për dallim nga kënga që e ka shënuar Thimi Mitkoja, ka edhe refrenin “o more xhaxha“, gjë që te Mitkoja nuk e kemi. Kënga, përveç dy vargjeve të para, pothuaj është transformuar plotësisht.

[686] Mitko, vep. e cit.
[687] Asani, B., vep. e cit.

Këngëtari popullor e ka ndryshuar edhe titullin, por në këtë rast, kemi "Ç' vetëton në derë poshtë" pra, vetëtima që duket nga të plasurat e derës poshtë. Përderisa te "Bleta shqiptare" vargun e dytë të të njëjtës këngë e kemi "shkon një djalë bukurosh", sot e kemi "vjen një djalë bukurosh". Si duket këngëtari popullor ka intervenuar edhe te foljet, te Mitkoja kemi foljen shkon, sot kemi foljen vjen. Vargjet tjera ndryshojnë plotësisht:

Ç' vetëtit atje rëposh?
Shkon një djalë bukurosh.
Doje ta keshe ilaka,
ja kushëri, ja vëlla,
Japo burrë me nigja,
të shkonje jetën sefa.[688]

Ç' vetëton në derë poshtë,
o more, xhaxha ?
Vjen një djalë bukurosh,
o more, xhaxha.
Kërkon shumë e 'epi pak,
o more, xhaxha.
'Epja gjymat me gjithë kapak,
o more, xhaxha.
'Epja vreshtin me gjithë pojlak,
o more, xhaxha.
'Epja nusen me gjithë dullak,
o more, xhaxha. [689]

Këngën "Loste plaku gjunjëzaj" në trevën e Strugës, sidomos në fshatrat toske e kam shënuar në dy variante: "Dë të 'ap moj, bijë e nënës" dhe "Shkon plaka malit". Kënga "Loste plaka gjunjëzaj" të cilën e ka shënuar Mitkoja është e shoqëruar me refrenin "rroto moj vasiliko", kurse variantet, të cilat kanë arritur gjer në kohën tonë, asnjëra prej tyre nuk ka refren. Në të tre variantet kemi dialogë, te kënga e Thimi Mitkos zhvillohet dialog midis plakut – babait dhe të bijave të tij, në variantet e sotme zhvillohet dialogu midis plakës – nënës me të tri të bijat e saj, te njëri variant dhe te tjetri variant kemi dialog midis nënës dhe të bijës së saj të vetme. Te varianti i Thimi Mitkos, vajza e madhe kërkon "burrë kapedan, me pisqoll' e jatagan", vajza e dytë, e mesmja e do "burrin terëzi të më mbanjë ndë pëqi", kurse vajza e tretë, e vogla kërkon "burrë bazergjan, të më veshnjë ndë kaftan". Te varianti i sotëm vajza e madhe thotë: "unë dua burrë kasap, të më ushqejë me qebap", vajza e mesme thotë: "dua burrin dyqanxhi, të më ushqejë me leblebi", kurse vajza e tretë, e vogla do ta ketë: "dua burrin çifçi, të më ushqejë me lajthi, të më mbajë gjithë natën në gji". Te kënga e dytë, vajza e vetme e nënës, nuk e do "burrin mullunxhi" sepse "e lë pa shami". Kur nëna i thotë se do të të japë një djalë të ri, vajza përgjigjet: "e dua nëna ime, e dua, Ati' i thonë djalë i ri, Gjithë natën më mban në gji".

[688] Mitko, vep. e cit., 150
[689] Asani, B., vep. e cit.39

"Do të të marr, o vllastar i gjatë" është një këngë tjetër erotike që e ka shënuar Thimi Mitko. Kjo këngë është mjaft e përhapur në të gjitha trevat shqiptare. Në variantin e sotëm ka këtë titull "Dë të marr që dë të marr moj syzezë", e që është këngë më e plotë se kënga të cilën e ka shënuar Thimi Mitko, dhe më e arrirë artistikisht.

Këngë të tjera të ngjashme nga cikli i "këngëve të dasmës", vlen të theksohet se te ky cikël i këngëve Mitkoja i ka radhitur edhe disa këngë të dashurisë siç janë: "Zunë yjet e perëndojnë " (k. 211, f. 165), "Shkova mbrëm' asaj ulice" (k. 247, f. 178), "Nusja jonë ndër valle, a kish shum' flori ndë ballë?" (k. 257, f. 181), "Dhëndëri nëpër limonj" (k. 262, f. 183), "Të martoi nënoceja dymbëdhjetë vjeç" (k. 280, f. 191), "Më martoi nënoceja" (k. 281, f. 191). Këto këngë i gjejmë me pak ndryshime edhe te vepra folklorike "Ç' u këput një degë qarri" si: "Mora tatëpjetë, moj" (k. 189, f. 88), "Ypa më një degë ulliri" (k. 308, f. 142), "Lirie mos të zërë gjumi" (k. 184, f. 86), "Mendiu nëpër limonë" (k. 116, f. 56), "Naskë të thërret jët ëmë" (k. 130, f. 63). Varianti i kësaj kënge është botuar te përmbledhja folklorike "Zura trëndafil me vesë" me titull "Matkë të thërret jet ëmë" (k. 31, f. 38).

Varianti i këngës "Naskë të thërret jët ëmë" është bërë hit nëpër dasmat dhe ahengjet shqiptare në Ohër, në Strugë dhe më gjerë. Këtë këngë e këndon grupi i këngëve dhe valleve popullore "Sazet e Ohrit". Kënga është regjistruar dhe xhiruar nga TVSH-ja në fillim të viteve tetëdhjetë. Këtë grup e kanë formuar evgjitët e qytetit të Ohrit rrëzë kalasë, të cilë, gjuhë të nënës kanë shqipen dhe flasin dialektin e toskërishtes. Disa prej tyre ofendohen nëse i quajnë evgjitë, sidomos ata të cilët e ndiejnë veten shqiptarë.

Në kapitullin e "Këngëve të dashurisë" të Thimi Mitkos përveç këngëve të llojeve të ndryshme, ka edhe këngë kurbeti, njëra ndër to padyshim është kënga "Vanë çunat, vanë" (f. 142), e që variantin e kësaj kënge e gjejmë edhe te përmbledhja folklorike "Ç' u këput një degë qarri" me titull "Ky beari i vogël" (f. 187). Kënga të cilën e ka shënuar Thimi Mitkoja i ka 18 vargje, ndërsa kënga "Ky beari i vogël" i ka 10 vargje. Te të dy variantet këngëtari popullor e ka ruajtur strukturën e vargut, që të dyja këngët janë të përbërë nga vargje të përziera me pesë dhe gjashtërrokëshin.

Kënga e fundit e ciklit "Këngë dasme", me titull: "Një burrë që paçë ma muarnë nizam" (k. 250, f. 198), siç shihet edhe nga titulli është këngë nizamësh, por, Thimi Mitkoja e ka radhitur te këngët e dasmës. Variantin e kësaj kënge e gjejmë në trevën e Strugës me titull "Bukuroshe ishe" (k. 409, f. 195), folja ishe do të duhej të ishte "isha", por e folmja toske e trevës së Strugës nuk e ka vetën e parë njëjës, e ka vetëm vetën e dytë dhe të tretë njëjës, në disa raste sidomos në të kryerën. Kënga të cilën e ka shënuar Thimi Mitkoja ka tre vargje, me nga dhjetë rrokje, kënga nuk e ka ruajtur strukturën e vargut, sot ajo këngë na del me vargje të përziera: me pesë dhe gjashtë rrokje. Kënga ka 12 vargje dhe është më e plotë. Si duket këngëtari popullor ka pasur aftësi krijuese, jo vetëm që është më e plotë dhe ka më shumë vargje, por nga ana artistike dhe estetike është më e arirë.

Kapitullin e gjashtë të veprës folklorike “Bleta shqiptare“ Thimi Mitko e ka titulluar “Kurbeti“, siç shihet edhe nga titulli në këtë cikël kryesisht janë përfshirë këngët e kurbetit. Nga ky cikël e ngjashme është kënga “Ky Misiri fort i largë“ (k. 305, f. 206), e cila ka ardhur deri në ditët tona, por ka ardhur me mjaft ndryshime. Te kënga e sotme “Oj syzezë vetullzezë“ kemi një dialog midis vjehrrës dhe të resë së saj. Te të dy variantet e këngës gruaja e gjorë dhe nëna e mjerë, i kanë humbur shpresat dhe, se burri apo djali i saj nuk do të kthehet më. Te të dy variantet është ruajtur struktura e vargut, që të dyja këngët ruajnë tetëvargëshin e preferuar të këngëtarit popullor.

Të dy variantet e këngës kanë nga trembëdhjetë vargje:

Ky Misiri fort i largët,
që s’na vjen as fjal’ as kartë,
Misir, i shkreti Misir,
Ti më mban atje tim bir.
U djeksh, o Arapistan,
Burrën tim atje ma mban,
. Vullak’ e shkreta Vullakë,
Ti u bëfsh fëngjill e flakë!
Ç’ faj të kanë bërë gratë,
që u le jorganët thatë ?
Për ditë nga një mandatë.
Shkretove kaqe shtëpi,
të djekshin të bëfshin hi...[690]

Oj syzezë vetullzezë,
Sa net ke pa qitur brezë?
- Si ta qesh si ta xhvesh?
Unë tët bir këtu s’ e kam.
E kam çuër në Rabistan
Rabistan o mbeç viran
Na i le nuset tye qarë.
- ‘Esht moj, nuse, ‘esht moj bi’,
T’i dërgojmë të na vi’,
Në mos ardhtë merr një ‘u,
Mer një ‘u digjja shtëpinë,
Boja shesh, boja lëndinë,
Që të luëj macja me minë.[691]

Nga cikli i tetë i këngëve “Të ndryshme“, kënga “Priftit i ngordhi gomari“ ka bërë jetën e saj te popullsia e trevës së Strugës. Kënga është e ngjashme megjithatë ka pësuar pak ndryshime. Si të gjitha këngët e mëparshme edhe kjo këngë është e zhveshur nga elementi fetar, janë hequr emrat: prift, priftëreshë. Me gjithë se janë hequr emrat, nuk janë zëvendësuar me emrat hoxhë e hoxhore, mbase nuk ka tingëlluar mirë në këngë apo ndofta këngëtari popullor nuk ka dashur të tallë e të përqeshë hoxhën dhe hoxhoren! Elementet e tjera të këngës me pak ndryshime, pothuaj janë ruajtur sot e kësaj dite edhe pse ka kaluar më se një shekull që nga botimi i saj dhe me kufi të ndarë politikë.

Në vend të “Priftit i ngordhi gomari “ sot kemi këngën humoristike me titull “Na ngordhi gomari mbrëmë“. Kënga “Priftit i ngordhi gomari”, të cilën e ka shënuar Thimi Mitko ka 12 vargje. Te shumica e vargjeve është ruajtur tetërrokshi. Kënga “Na ngordhi gomari mbrëmë“ i ka 18 vargje me rrokje të përziera tetërrokëshin dhe gjashtërrokëshin. Këngën “Na ngordhi gomari mbrëmë“, pas çdo vargu e shoqëron refreni “Tyf, tyf unë e mjera“:

[690] Th. Mitko, vep. e cit.,1981, 228
[691] Asani, B., vep. e cit., 1996, 195

Priftit i ngordhi gomari,
mbi kurris i mbet samari;
Priftëresha u helmua:
- Ç' më pati gomari mua?
Priftëreshë pse rënkon?
Se, ne gomari na shkon,
Kokën ja bëjmë kupë,
ja bëjmë drugë,
veshëtë ja bëjmë lugë,
brinjëtë ja bëjmë furkë,
këmbët ja bëjmë paça,
Zorrët tërkuzë për gra.

Na ngordhi gomari mbrëmë,
Tyf, tyf unë e mjera.
Çar t'i bojm' lëkurës-ë?
Tyf, tyf unë e mjera. -
T' ja bojm qyrkun nuses-ë.
Tyf, tyf unë e mjera.
Na ngordhi gomari mbrëmë,bishtin
Tyf, tyf unë e mjera.
Çar t' i bojmë veshëve?
Tyf, tyf unë e mjera.
T' ja bojmë vëthë nuses.
Tyf, tyf unë e mjera.
Na ngordhi gomari mbrëmë.
Tyf, tyf unë e mjera.
Çar t' i bojmë thundrave?
Tyf, tyf unë e mjera.
T' ja bojmë kundra nuses-ë.
Tyf, tyf unë e mjera.[692]

Po bëhet gati një shekull e gjysmë që është botuar "Bleta shqiptare" dhe kaloi një shekull të ndarë nga trungu amë, megjithatë kënga nuk ka njohur kurrfarë kufijsh, ajo bën jetën e saj në fashatrat toske të Strugës në veçanti dhe në trevën e Strugës në përgjithësi. Natyrisht ajo ka pësuar ndryshime ku më të vogla e ku më të mëdha. Për ne këto ndryshime që ka pësuar kënga kanë ndikuar faktorë të ndryshëm. Këtu mund të përmendim faktorët historikë, socialë, ekonomikë, religjiozë, politikë etj. Kënga është dëshmi e të gjitha këtyre proceseve të zhvillimit shoqëror. Të gjitha këto elemente i gjejmë në veprat folklorike "Bleta shqiptare", "Ç' u këput një degë qarri", "Zura trëndafil me vesë" etj. Nga veprat e përmendura janë marrë në shqyrtim mbi njëmijë këngë të botuara kryesisht te këto vepra folklorike.

Këngët e "Bletës shqiptare" të Thimi Mitkos edhe pse kanë arritur që të mbijetojnë gjer në ditët tona, ato gjatë viteve mund të kenë evoluar ose jo: herë-herë u janë shtuar vargje, u janë hequr vargje, herë vijnë më të përsosura nga ana artistike e herë vijnë më të zbehta, herë me refrene e herë pa refrene, herë na vijnë si pesërrokëshe, gjashtërrokëshe, shtatërrokëshe, tetërrokëshe etj., herë vargjet na vijnë me rrokje të përziera.

Nga hulumtimi që kemi bërë, kemi dalë në përfundim se këngët të cilat i ka shënuar dhe botuar folkloristi Thimi Mitko, sot e kësaj dite janë të gjalla dhe bëjnë jetën e tyre te popullsia e trevës së Strugës.

[692] Asani, B., vep. e cit., 1996, 171

ERIS RUSI (KORÇË)

GJITHÇKA ËSHTË PËRRALLË – TRASHËGIMIA E RRËFIMIT NË VEPRËN E THIMI MITKOS

"Ndër instrumentet e shumtë të njeriut, më i mahnitshmi, pa dyshim është libri. Instrumentet e tjera janë zgjatim i trupit të tij. Mikroskopi dhe teleskopi janë zgjatim i pamjes; telefoni është zgjatim i zërit; kemi edhe parmendën dhe shpatën, kuptohet zgjatime të krahut. Por libri është diçka tjetër: libri është zgjatim i kujtesës dhe imagjinatës"[693]. Jorge Luis Borghes

Letërsia ka lindur me mitet dhe përfytyrimin arkaik të njerëzimit. Përmes procesit të krijimit dhe interpretimit të miteve, duke kaluar në legjendat dhe përrallat popullore, imagjinata e njeriut gjeti hapësirën e skajshme të përballjes dhe kapërcimit të realitetit, duke siguruar një lloj lehtësimi metafizik sa herë mundësohej ky kalim. Bëhet fjalë për një çlirim, që nënkupton ngritjen e përfytyrimit përtej të mundshmes, por pa u dorëzuar në vështirësi të pakalueshme e të patjetërsueshme.

Ne kërkojmë prehje brenda kësaj letërsie në mënyrë të mos jemi të palumtur dhe që të mos jemi të paplotë. Betejat imagjinare, e qeshura ngadhënjyese *e* fantazisë ndaj realitetit zymtues, të gjitha këto janë mënyrat që na i lehtësojnë përfytyrimin; na japin ndjesinë e një jete të plotë, e një dimensioni të përbërë jo nga një, por nga shumë rrathë ekzistencash. Kapërcimi në secilin prej tyre, tek gjithsecili prej tyre, bëhet duke i dhënë shtytje të pandalshme hovit të imagjinatës, për sa kohë nuk jemi një e të vetëm, por mbartim shumë identitete, e përjetime realitetesh, përbrenda vetes.

Brenda këtij konteksti, mund t'i analizojmë përrallat si një lloj universal narrativ. Gjithçka është përrallë, mund të pohojmë, kur i referohemi përrallës si pikënisje, gjenezë e imagjinatës. Përrallat bëjnë lidhjen ndërmjet oralitetit dhe shkrimit, siç do ta shohim më poshtë; janë gjithë përfshirëse, gjenden në traditën gojore të çdo populli, kalojnë nga një brez në një tjetër duke ndryshuar gradualisht dhe duke iu përshtatur ndryshimeve të kohës dhe hapësirës.

Nëpërmjet përrallave ne mund të zbulojmë karakteristikat dhe dallimet që karakterizojnë një grup, një vend, një mënyrë e jetës; vijnë në për një moment përmes bukurisë dhe magjisë së fjalës të transmetuar në jetën e përditshme. Në anën tjetër, përrallat na kujtojnë paralele të shumta dhe ngjashmëri ndër*mjet* kontekseteve, vendeve, hapësirave që mund të jenë në distancë midis tyre.

Përshkrimi i përrallës ndërmjet të djeshmes dhe të sotshmes letrare

Gjatë shekullit XX studiuesit perëndimorë i janë qasur studimit të folklorit nga një këndvështrim krejt i ndryshëm, të themi, nga ai i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ndryshe nga pararendësit e tyre, që e trajtonin folklorin në kuptimin e zakonshëm të

[693] Ligjëratë e mbajtur nga autori me studentët e Universitetit të Belgranos, Buenos-Aires, 1977

kësaj fjale, duke futur brenda tij “përrallëzën”, “sajesën”, “trillimin”, ata e kanë pranuar atë ashtu siç kuptohej në shoqëritë arkaike, ku, përkundrazi, përmes rrëfimit dhe transmetimit gojë më gojë të miteve, të legjendave, të përrallave të hershme të një vendi, mundësohej vijim*ësia në kohë, përfaqësimi i s*ë shenjtës, të çmuarës dhe të vyerës në formimin identitar të një kombi.

E mrekullueshmja dhe fantastikja që përbën terrenin e përrallës, nxit imagjinatën dhe luan rol kyç në leximin e tekstit. Fantazia lejon pranimin e dimensioneve të tjera, kohore, ndryshme nga e zakonshmja, ku ligjësitë e jetës së përditshme humbasin vlerë, tjetërsohen, apo shndërrohen dhe janë në proces të ngadaltë e të vazhdueshëm ndryshimi. Studiuesi dhe kritiku rus Vladimir Propp, përmend fiksionin dhe trillimin si cilësi përfaqësuese të letërsisë zanafillore. Në shumë gjuhë sipas tij, fjala përrallë është sinonim i fjalës “gënjeshtër”, “trillim”. “Përralla u krye, më nuk gënjehet, kështu rrëfimtari rus e përfundon përrallën,” thotë Proppi. Ndarja më e zakonshme e përrallave është ndarja në përralla më përmbajtje të mrekullueshme, përralla të jetës së përditshme, përralla mbi kafshët”[694].

Pra mitet, legjendat përrallat, kanë qenë burimi i shkëndijës imagjinare krijuese të njerëzimit. Nga kjo, kuptohet se në përrallat e rrëfyera ne gjejmë lodrën e simboleve, gjuhën e tyre dhe nëse duam të kapim domethënien e vërtetë të tyre, duhet të dimë të "lexojmë" brenda ngjarjeve, subjektit që paraqitet në to, duke e parë pikërisht këtë lëvizje ngjarjesh si lëvizje simbolesh.

Me fjalë të tjera, fantastikja te përrallat na tregon se si, nëpërmjet bëmave të njerëzve, mund të ndryshohej realiteti, që në zanafillën e kohërave. Siç shprehet studiuesi Adem Jakllari:

“Prodhimet e para të folklorit lindën bashkë me njeriun. Këto rituale i lindi nevoja e njeriut të vjetër.

Pra ky njeri nuk ndërtoi marrëdhënie estetike me botën, por këtë ndërtim e vuri në shërbim të nevojave të tij, pra prodhimet e para folklorike janë të lidhura ngushtë me magjinë, religjionin”[695].

Përrallat e përfshira në “Bleta shqiptare” shquhen për larminë e fantazinë e tyre dhe për thurjet interesante të subjekteve. Roli i fantastikës është element i pazëvendësueshëm në harmoninë e rrëfimit të tyre. Me anë të saj evidentohet mënyra se si krijuesi popullor realizon dhe përpunon subjektin, elementet e realitetit duke krijuar një simbolikë të pasur. Pikërisht në vlerën e saj filozofike qëndron edhe një nga anët më të rëndësishme të përrallës. Nëpërmjet saj jepen gjykime për jetën, për lumturinë, për të mirën dhe të keqen, për të bukurën dhe të shëmtuarën, për aspiratat dhe ëndërrimet e njerëzve.

[694] Vladimir Propp, “Morfologjia e përrallës”, përktheu nga origjinali Agron Tufa, “Shtëpia e Librit e Komunikimit & Aleph”, Tiranë, 2004, fq. 12.

[695] Adem Jakllari, “Historia e mendimit etnologjik”, “Shtëpia Botuese e Librit Universitar”, Tiranë, 2003. fq. 62.

Duhet thënë se vizioni i përgjithshëm që buron për botën e jetën është optimist. Kështu, edhe në përrallat e mbledhura nga Mitko*ja*, e mira triumfon dhe njeriu ia arrin më në fund lumturisë, arrin ta fitojë atë. Përmes procesit të krijimit dhe interpretimit të përrallave popullore, imagjinata gjen atëherë hapësirën e skajshme të përballjes dhe kapërcimit të realitetit, duke siguruar një lloj lehtësimi metafizik sa herë mundësohet ky kalim.

Bëhet fjalë për një çlirim, që nënkupton ngritjen e përfytyrimit përtej të mundshmes, por pa u dorëzuar në vështirësi të pakalueshme e të patjetërsueshme. Eliade e përkufizon fantastiken dhe të mrekullueshmen brenda përrallës, kur tregon që: Rrëfenjat flasin për aventurat e mrekullueshme të heroit kombëtar, një të riu me prejardhje të thjeshtë, i cili bëhet shpëtimtari i popullit të tij, duke i çliruar nga përbindëshat, duke i shpëtuar nga uria dhe fatkeqësi të tjera dhe duke kryer bëma të tjera të dobishme dhe madhështore. Më tej vijnë historitë që trajtojnë botën e magjistarëve dhe shpjegojnë se si aksh magjistar fitoi fuqitë e tij mbinjerëzore, se si ka zënë fill aksh shoqëri shëronjësish, e kështu me radhë"[696]

Trashëgimia e rrëfimit në veprën e Thimi Mitkos

Në librin "Cezari dhe Kleopatra", Bernard Shou thotë për bibliotekën e Aleksandrisë se ajo është kujtesa e njerëzimit. Por libri ka diçka më tepër. Ai është edhe imagjinata e tij. Sepse a nuk është e kaluara jonë një seri ëndrrash? Ç'ndryshim mund të ketë midis kujtoj ëndrrat dhe kujtoj të kaluarën. I tillë është funksioni që kryen libri"[697]. J. L. Borghes

Jemi në të drejtën tonë nëse e konsiderojmë Thimi Mitkon si një mecenat i kulturës shqipe, i cili arrinte të shihte te folklori shpërfaqjen e një universi vlerash ku identiteti i kombit shqiptar do të qartësohej e do të lartësohej njëlloj si identitetet e kombeve të tjera të mëvetësuara e të lira nën shekullin e XIX: "Shqiptari, duke dashur pa fund atdheun e tij, do dhe bashkatdhetarin e tij, edhe kur ay është në tjetër fe, sepse fenë e ka në vend të dytë, kur puna është për atdheun e përgjithshëm. Në këngët heroike të popullit gjenden shumë shembëlla të tilla, që s'e kanë shoqen, patriotizmi dhe lirije të fesë"[698].

Këto mendime të shprehura nga Thimi Mitko*ja* hasen edhe te rilindës të tjerë që u morën me folklorin. Këta e shihnin folklorin si përcjellës të vlerave shpirtërore, të tipareve e të virtyteve më të qenësishme të shqiptarëve, të ndjenjave e të shijeve të tyre. Vetë autori, në parathënien e botimit, ilustron qëllimin e sipërmarrjes së vet: "shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë, i fjalëvet dhe i tekstevet shqipe, të cilat, para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime, dhe besoj se do të kenë një vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare..."[699].

[696]Eliade Mircea, Myth and Reality, "Harper & Row", Nju York, 1963, f.11
[697] Ligjëratë e mbajtur nga autori me studentët e Universitetit të Belgranos, Buenos-Aires, 1977
[698] Thimi Mitko, Vepra, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Tiranë, 1981, f.20
[699] Po aty, f.61

Në mënyrë të ngjashme me patriotë dhe përqafues të çështjes kombëtare shqiptare, nën kornizën e Rilindjes, edhe Mitko*ja* identifikoi te folklori aftësinë për të ndihmuar në shpërfaqjen e identitetit shqiptar. Mund të përmendim krahas tij autorë të tjerë të angazhuar në mbledhjen e folklorit, që kanë ushqyer të njëjtin orientim të Mitkos. P.sh. Spiro Dineja, duke shkruar për vlerat e krijimtarisë folklorike në përgjithësi dhe të këngëve në veçanti, në parathënien e përmbledhjes "Valët e detit" (1908) pohon se "këto janë shumë të nevojshme e të vjëjtura për kombin tonë, se ndër këto shikonjëm të ngjarat e çdo kohe, që kanë shkuar si valët e detit dhe prej këtyreve munt të dalë një istori e plotë".

Në parathënien e përmbledhjes së Vinçenc Prenushit "Kangë popullore gegënishte" (1911) thuhet se qëllimi i botimit:

"asht përparimi dhe qytetërimi i kombit... Kanga popullore asht e madhnueshme për kah t'benët e vet t'përmrenshëm, asht e hijshme edhe kah trajta e vet... ajo do ruajtë si një visar i çmueshëm, si një flakë, prej t'cillës do t'marrë dritë e ner komi"[700].

Por veçmas tyre, Mitko e shihte folklorin edhe si një potencial me vlera të spikatura dhe me

funksione të qarta për krijimin e një hapësire të unifikuar shqiptare. Ishte i padyshimtë mendimi i tij që folklori jepte ndihmesën e vet për të ruajtur të gjallë dhe për të përforcuar ndërgjegjen kombëtare, si dhe për të dëshmuar identitetin kombëtar shqiptar. Mbledhja e botimi i folklorit, sipas tij, do t'i shërbente për të pohuar gjenezën e lashtë e të përbashkët të shqiptarëve (krijimtaria folklorike e kohës në një masë të madhe ishte përcjellë nga rrjedhat shekullore), si edhe për ruajtjen e vlerave më të qenësishme brenda njësisë etnike.

Folklori ishte mënyra e duhur *q*ë përmes artit të fjalës, të arrihej në krijimin e kulturës së re që i duhej vendit, për të formësuar emrin dhe pavarësinë mes vendeve të tjera evropiane. Spiro Dineja ka nënvizuar në shënimet e veta që më 1866 Mitkoja jo vetëm ka kërkuar të mbledhë këngë popullore nga ai, por është përpjekur edhe t'i mbushë mendjen se me një veprimtari të tillë merren njerëz të shquar si:

"Dh. Kamarda, Panajot Kupitori dhe shumë filozofë të mëdhenj evropianë, të cilët thonë që në këngët dhe në përrallat e vjetra të një populli ruhen zakonet, gjuha dhe historia e tij".

Nga gjerësia dhe larmia e materialeve dhe nga burimet e prejardhjes së tyre, mund të themi që Mitko*ja* kryen një punë të kolosale, në një terren të vështirë, ku i duhet të emigrojë e të jetë vetë në kontakt me njerëzit nga merr kujtesën kolektive të rrëfimit. Hulumton, qëmton, gjen dhe koleksionon atë çka do të shndërrohet një një fond të pasur materialesh, (490 proverba, 80 gjëegjëza, 359 këngë, 12 përralla) ku hidhet dhe fiksohet në formë të shkruar tradita e rrëfimit në letërsinë shqipe.

[700] Po aty

Ky proces, përmes pasionit të gjurmimit të traditës dhe origjinës shpirtërore të kombit, e orienton Mitkon të lokalizojë dhe të ndërtojë bazat e qëndrueshme të trashëgimisë folklorike shqiptare. Në këtë, ai është një nga të parët që ia del të përçojë shkëndijat e frymëzimit popullor shqiptar, në letërsitë e tjera evropiane. Kjo, nëpërmjet daljes jashtë kontureve të Shqipërisë të asaj kohe, e përrallave të mbledhura nga Mitko. Në fakt, gjashtë vjet pas botimit të përmbledhjes, më 1883 albanologu gjerman Gustav Majer botoi në vëllimin XII të "Arkivi për Historinë e letërsisë" përrallat e "Bletës Shqiptare".

Brenda Bletës shqiptare. 12 përralla dhe një përfundim

"Bota dhe njeriu *ekzistojnë*, vetëm sepse në "zanafillë" Qeniet e Mbinatyrshme ushtruan fuqitë e
tyre krijuese. Por pas kozmogonisë dhe krijimit të njeriut ngjanë ndodhi të tjera, dhe njeriu *ashtu siç është sot* është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e këtyre ndodhive mitike, *ai është mbrujtur prej tyre*, Ai është i vdekshëm, sepse diç ndodhi *in illo tempore*. Nëse kjo gjë nuk do të kish ndodhur, njeriu nuk do të ishte i vdekshëm – ai do të rronte përjetë, si shkëmbinjtë; ose do të ndërronte lëkurën periodikisht si gjarpërinjtë dhe, kështu, do të ishte në gjendje të përtërinte jetën e tij, domethënë ta rifillonte atë pafundësisht"[701].

Vështruar në rrafshin kohor, përrallat e grumbulluara nga Thimi Mitko*ja* kanë për brendi epoka të mjegullta, kohore, ditë e rrugëtime që kanë kaluar në histori. Është zakonisht koha e gdhendur në kujtesën e popullit, të cilin autori e gjurmon, e interpreton, e qartëson dhe e përshkruan. Ajo vjen nga e hershmja, përmes qeniesh e bëmash të jashtëzakonshme, si pjesë e mjegulluar e historisë dhe shpaloset në ngjarje e figura të qarta. Edhe kur shtjellon ngjarje që e kapërcejnë këtë kufi, ato tregohen më shumë si ndodhi të së kaluarës.

Pra jemi brenda dimensionit të kulturës shpirtërore të vetë kombit, me një vizion që shtrihet përtej, synon të kapë dhe të afrojë gjithë botën shpirtërore shqiptare, duke u endur nga skajet mitike të origjinës, deri në kumbimin që elementi fantastik,, i mrekullueshëm, popullor, ka mbi realitetin e sotëm.

Duke iu referuar përrallave të përmbledhura nga Mitko*ja*, mund të perceptojmë një lloj dëshire dhe pikësynimi, për të ofruar një shëmbëlltyre të qëndrueshme, e jo relative, të kohës së fiksuar në truallin shqiptar. Mitko*ja* ofron mundësinë për të identifikuar në hapësirën e përrallës, personazhe imagjinarë, heronj të gjithëfuqishëm, njerëz të thjeshtë dhe identitete të jashtëzakonshme tokësore, brenda një harku ciklik ku megjithëse e kaluara dhe e sotmja konceptohen si kategori historike dhe e para nuk shkëputet nga e dyta.

Kështu ne prapë ndeshemi herë-herë me një frymë ekzaltimi pas së kaluarës, me një lloj magjepsje ndaj njerëzve dhe bëmave të tyre për të cilat flet përralla dhe rrëfenja. Tregimi futet në një tjetër dimension, ku vlejnë rregulla të tjera, ku vetëm ndjenjat janë ende të nxehta e përvëluese, ndërsa jeta qëndron e ngrirë dhe e varur

[701] Eliade Mircea, Myth and Reality, "Harper & Row", Nju York, 1963, f.1

kokëposhtë në muret e kohës së shndërruar në përjetësi. Në këtë realizim të gjetur, pikërisht rindërtimi i kohës dhe i hapësirës ofrohet si një element i domosdoshëm për t'i dhënë nuanca dhe efikasitet rrëfimit

Pa dyshim që përzierja e botëve, asaj reale ashtu si e njohim dhe një bote tjetër, misterioze, kufirin e së cilës mund veç ta perceptojmë, shpaloset në optikën e teksteve të grumbulluara. Po ashtu, mbi sa më sipër, edhe ne e gjejmë të pranueshme që ta konsiderojmë Thimi Mitkon edhe si një autor, i cili shumohet dhe njehsohet me tekstin e tij letrar. Ky lloj anonimati i kërkuar merr parasysh edhe kërkesat që lindin nga vullneti për të shkruar për publikun e gjerë ne terma komunikues.

Nëse është e mundur t'iu flitet dhe t'iu adresohet njerëzve, zëri rrëfimtar duhet të jetë koral dhe letërsia duhet të ngjasojë jo si një sëmbim i fantazisë unike të autorit, po si një përzierje imagjinate, ndodhish, rrëfenjash, ku ambientimet identifikohen me dhomat e shumta të labirintit rrëfimtar. Kushdo mund të futet, të hapë cilëndo derë të dojë brenda këtij labirinti, e të orientohet mes peizazhit letrar të përzgjedhur, të ritreguar dhe të servirur nga autori. përrallat e mbledhura nga Mitko*ja* si një lloj antologjie ku ndjehesh pjesë e universitet kulturor botëror. Sikur je brenda rrëfenjave të njëmijë e një netëve, sikur populli ka zërin e vet që vjen nga origjina, e në flakën e shpirtit arrin të ngrohtë dhe të qartësojë dëshirat, vitalitetin, ekzistencën e vet.

Në regjistrimin e përrallave, legjendave, anekdotave dhe rrëfimeve popullore, Mitko*ja* ka bërë kujdes, të gjurmojë mjaft prej tyre që sjellin vlera të rralla në kulturën tonë popullore; me elemente, motive e subjekte që janë pjesë e identitetit shqiptar, por nuk hezitojmë të shtrihen e t'i latohen universales njerëzore.

"Peshkatari dhe e Bukura e Dheut" është përralla që hap përmbledhjen, një përralla e shkurtër ku ilustrohet mençuria e djalit të vogël, për t'iu bërë ballë peripecive e për të triumfuar ndaj çdo pengese në fund. Që në këtë përrallë, ne kemi elementin mitologjik të ngurosjes, vëllai i madh niset të marrë për grua të Bukurën e Dheut, por dinakëritë e antagonistes plakë e kapin në kurth dhe ai përfundon i ngurosur, pa jetë.

Menjëherë mendja na shkon te transformimi, metamorfoza, që është një nga elementet më përfaqësuese të letërsisë fantastike, por edhe te gjurmët mitologjike të shndërrimit në gur të njerëzve, tek miti i Gorgonës së famshme që mjaft ta shihje në sy për t'u thërrmuar në statujë, apo nëse duam edhe tek sfondi i krishterë, me Sodomën dhe Gomorrën, qytetet e mallkuara ku gruaja e Lotit, në largim e sipër kthehet për t'i parë edhe njëherë dhe përfundon e kthyer në statujë kripe.

Por, jemi brenda përrallës në këtë rast, e transformimi s'është i pakthyeshëm:

"Ata pra, ndë kaq, shtinë ujë të kuqe mbi vëllanë edhe leonin edhe sakaq u ngjallën. I vëllai duke fshirë sytë tha: "Oh sa shumë fjeturkam".

-Nuku fjete, i tha ajy, o vëlla, po kështu, kështu...

Ndë cast edhe selvia ndë shtëpi u krejt e u krehka. Ia dhanë gazit edhe prinjtë e tyre se u është ngjallur djali.

As përrallë s'iu rrëfeve, po desha e iu gënjeva."[702].

Përpos mbylljes që është një nga klasiket e përrallës së rrëfyer, ne e shohim se si shndërrimi, nënkupton edhe kalimin nga jeta në vdekje. Por kjo nuk shihet asnjëherë si një traumë e parikuperueshme. Pikërisht ky korpus temash të përzgjedhura në seleksionimin e tij nga Mitko*ja*, na bind të orientohemi drejt shkëndijës së shpresës dhe të botëkuptimit optimist që frymëzon imagjinarja e përrallave. Gjërat ngjajnë si në ëndërr, vdekja është gjumë e do vijë një moment që të zgjohemi sërish.

Mitko nuk i shmanget rrëfimit tradicional popullor, duke sjellë në përralla atmosferën e shoqëruar gjatë transkriptimit të përrallave të mbledhura. Te përralla e dytë, "**Capeza**", ai servir muzikalitetin, një lloj harmonie e rime gati të këngëzuar të tekstit në prozë. Kjo bën që të ketë një harmoni valëzimi fjalë në materialin e servirur:

"Cupëzë moj cupëzë, kazani po nxehet, thikat po mprihenë, mua të më thernjënë"

Te përralla "**Shtatë djemtë e plakës**", ruhen elementet tradicionale të rrëfimit. Por mund të shohim që pikërisht numri "7" ka një origjinë gati mistike dhe mitologjike, që në zanafillën e kohërave, ndaj është gati i pazëvendësueshëm në çdo përmbledhje përrallash. Kështu, nëse synojmë të bëjmë një përqasje me simbolikën e re të shekullit XX, që gjen zbatim në letërsinë e disa prej autorëve më përfaqësues të fantastikes në letërsi (mbi të gjitha Dino Buxati me novelën 'Shtatë lajmëtarët") mund të themi që numri 7 është numri i shenjtë i Hebrenjve, që përsëritet pambarimisht. Fillesa është nga Kozmogonia, kur Zoti kompleton krijimin e botës për shtatë ditë. Po ashtu, në Testamentin e Vjetër tregohet që Noes i kërkohet të futë në arkën e shpëtimit 'shtatë krerë nga çdo kafshë e botës dhe shtatë lloje nga çdo shpend i botës, pasi pas shtatë ditësh do të bëjë përmbytje mbi tokë...dhe pas shtatë ditësh ujërat e përmbytjes universale u derdhën rrebesh mbi tokë" (Gjeneza 7, 2-10). Nga hera e parë që Noe lëshon jashtë arkës pëllumbin dhe tentativës së dytë, kalojnë shtatë ditë, e po kështu ndërmjet tentativës së dytë dhe të tretë (Gjen.8, 10).

Pra, nëse duam, përherë është e mundur të gjejmë një mundësi interpretimi që lidh mistiken, arkaiken, fantastiken, në terminologjinë e letërsisë moderne që hap shekullin XX. Megjithatë në kontekstin e përmbledhjes në fjalë, mund të themi që në pjesën më të madhe të përrallave të përfshira, kemi të përfaqësuar tiparet më klasike të llojit letrar, ku një rol të vecantë luan e jashtëzakonshmja, e mrekullueshmja, trillimi artistik. E shohim këtë te përralla "Petriti", "Qerozi" Djali me Kësulë e kënaçe dhe e Bukura e Dheut", "Pelat e egra" "Djali i mbretit dhe mjeku", Druvari dhe gruaja budallaqe" etj. Në të gjitha këto raste, ne shohim si marrin formë e jetëzohen elementet aventureske në përballjen e vështirësive, me mundësitë e

[702] Thimi Mitko, Vepra, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Tiranë, 1981, f. 353

arta që dalin papritur, me shndërrime, fuqi misterioze, qenie të panjohura e përplot pushtet, që ndryshojnë fatet e personazheve në rrëfim.

Kemi të bëjmë me akumulimin e një morie identitetesh, të cilat notojnë brenda dallgës së jetës, kërkojnë të mbushen me ajrin e dëshirave e vetëm në fund, arrijnë të japin hovin e beftë që i bën të kapërcejnë një dallgë përpara, e të dalin në bregun e tokës së lumtur. Megjithëse nuk është e përfshirë te "Bleta shqiptare", por futet në përmbledhjen "Bleta e vogël", me interes të padyshimtë mund ta përfshijmë brenda këtij punimi një nga përrallat me një titull të mrekullueshëm metaforik: **"**Çupa që derdhte trëndafilë nga goja kur qeshte dhe margaritarë nga sytë kur qante**".**

Thimi Mitko*ja* në shënimet e tij tregon që titulli i përrallës në origjinal ishte "Kudo shkel i mbin lëndinë", e në fakt mënyra si është frymëzuar titulli i ri, ka një ndikim të menjëhershëm në përfytyrimin e lexuesit: pa u futur ende në përrallë kemi ndjesinë e së bukurës, të së mirës, të hyjnores dhe qiellores që shkëlqen hijeshinë e moshës së re. Ne thelb kjo përrallë ka edhe intimen e dashurisë, krijimin e harmonisë, ku pikërisht brenda dhomës, në kontaktin e mbretit me vajzën, është e mundur që kjo të bëhet pranverë nga veprimet e mbretit, e po ashtu të shndërrohet në vjeshtë të rrëmbyer me shi nga veprimet e tij. Njëlloj si përditësia e njerëzores, ku stinët asnjëherë s'janë njëlloj dhe gjithmonë ka vend që të ndërrohen brenda ciklit të përhershëm të dashurisë:

"Çupa kur pa këtë pallas e këto dhoma të shndritshme, pa sa gjithë dhomën e mbretit, e cila shkreptinte porsi rreze e diellit.

E pra i dolli mbreti ndë sytë asaj, që prapa derësë, e muar për krahu edhe bariti me të ndëpër cardhak, papo, namëta sakaqe, mbiu lëndin' atje. E bëri të qeshnjë, edh'i duall' trëndafilë nga goja; e bëri e qau edh'i rrothnë margaritarë nga sytë"[703].

Te përrallat "Gruaja përtace", "Kumbara" "Kordha, Ylli dhe Deti", ne shohim të trajtohen marrëdhëniet e harkuara brenda familjes, raportet midis babait dhe birit, midis motrave me njëra tjetrën, harmonia e krijuar nga miqësia e përhershme mes shokësh, që ngrihet mbi besën e dhënë për t'i dalë krah e zot njëri tjetrit.

Jemi brenda mikrokozmosit të familjes, por identiteti i mirëfilltë shqiptar plotësohet edhe nga universalja e raporteve njerëzore që *e ka she*njëzuar njeriun nga fillimi i kohërave. Urtësia e personazheve të moçëm që japin këshilla të pashlyeshme, transmetohet si zëri i traditës që kërkon të respektohet, por edhe që udhërrëfen shtegun e së drejtës që duhet të ndiqet nga eksperienca e njomë e të rinjve. Përralla "Kordha ylli dhe deti", po ashtu ka një efekt kuptimplotë personifikues. Çdo herë që përmendet emri i njërit prej personazheve, lexuesit i krijohet përshtypja e detit dhe valëzimeve të tij, e ajrit që tejçohet e mërmërit nga kordha e lëshuar furishëm, e dritës që regëtin dhe mposht vetminë e shurdhër të qiellit.

[703] Po aty, f.381

(Një) përfundim

Gjuhëtari Ferdinand de Saussure i "penalizonte" shkrimit aftësinë për të "errësuar" vizionin e gjuhës, e shtyhej deri aty sa të fliste për "tirani të shkronjave" : fjala e shkruar synon të zëvendësojë në mendimet tona fjalën e kuvenduar, duke synuar kapjen e modelit të pakundërshtueshëm për t'u praktikuar. Por ndajvënia midis këtyre dy modeleve, është akoma më e hershme, siç sugjeron një tjetër gjuhëtar, Tullio de Mauro:

"Në tekstin e "Fedros" (274 b-275 d) Platoni tregon për faraonin mitik egjiptian Thamus që i thur lavde fjalimeve të kuvenduara, duke ofruar nga ana tjetër një sërë argumentesh që synonin të zhvlerësonin shpikjen e shkrimit, të kryer nga perëndia Theuth. Faraoni e qortonte Perëndinë Theuth që kishte shpikur një art i cili ofronte vetëm zgjidhje artificiale dhe kopje të dobëta të ligjëratave me vlerë, që ishin ligjëratat e folura. Ligjërata e shkruar, përmendte faraoni, është një fëmijë bastard i asaj orale dhe asgjë tjetër më shumë"[704].

Në këndvështrimin e folklorit, është ndoshta përralla ajo që di të afrojë më shumë se çdo lloj tjetër bashkekzistencën e tekstit të shkruar dhe të rrëfyer, duke realizuar kështu zbulimin e një mbivendosjeje të vazhdueshëm ndërmjet zërit dhe tekstit. Kjo mbivendosje zbulon lidhjen e thellë ndërmjet imagjinatës popullore mbi të cilën bazohet përralla (që përvijon modulet stilistike, ekonominë strukturale dhe shkathtësinë shprehëse të ligjëratës orale) dhe funksionit ekzistencial të letërsisë, për të ushqyer përfytyrimin e njeriut me rregullat dhe botën e miteve dhe origjinës. Pikërisht në këtë drejtim, ne spikasim interesin e shtuar mbi përmbledhjen folklorike të Thimi Mitkos. Nëse shohim me kujdes profilin e tij atdhetar, Mitko bën çmos që të nxjerrë në dritë origjinën e lashtë dhe fisnike të shqiptarëve, imponimin e kombit shqiptar brenda Evropës që injoronte ekzistencën e tij:

"Ajo që kundërshtojnë shqiptarët me tërë fuqinë e tyre është thëthitja, nëse mund të shprehemi kështu, e individualitetit të tyre kombëtar, dmth. vdekja politike dhe shoqërore e kombit të tyre, e gjuhës,e dokeve, e zakoneve dhe e traditave të tyre; ata mendojnë se janë stërnipërit e një race heroike dhe mbahen krenarë për fisnikërinë e origjinës së tyre shumë të lashtë, e cila i lidh ata me pellazgët e moçëm"[705].

Por veçmas kësaj, Mitko*ja* gjen te folklori potencialin e qartë për krijimin e një hapësire të unifikuar shqiptare. Ishte i padyshimtë mendimi i tij që folklori jepte ndihmesën e vet për të ruajtur të gjallë dhe për të përforcuar ndërgjegjen kombëtare, si dhe për të dëshmuar identitetin kombëtar shqiptar.

Përralla është një lloj letrar thelbësisht i rrëfyer me gojë në gjenezën e saj; gjithmonë e orientuar drejt oralitetit, edhe në rastin e përrallave të shkruara. Si e tillë, brenda këtij identiteti të dyfishtë, si dokument etnologjik dhe si vepër arti –

[704] Tullio De Mauro, "Senso e significato. Studi di semantica teorica e storica", Bari, 1971, f. 96

[705] Thimi Mitko, vep. cit.

mund të cilësohet si lloji letrar që mundet të përballojë në mënyrë ekzemplare temën e qarkullimit të formave letrare nga oraliteti drejt shkrimit dhe anasjelltas.

Merita e Mitkos është që hulumton nga të parët këtë lloj letrar, duke sjellë një katalog të rëndësishëm të përrallës shqiptare. Ndryshe nga qasja tradicionale e kritikës, ku marrëdhënia ndërmjet letërsisë orale dhe asaj të shkruar është paraqitur shpesh në formën “para dhe pas”, duke i atribuuar traditës gojore karakteristikat e arkaikes dhe të naivitetit primitiv, Thimi Mitko*ja* diti të balancojë ekzistencën dhe vlerat e këtyre dy formave letrare, duke lartësuar autenticitetin e përrallës së rrëfyer, brenda kornizës të përzgjedhur të tekstit të shkruar letrar.

ERMIRA YMERAJ (SHKODËR)

NDIKIMI PËRMBAJTËSOR I MOTIVEVE TE "BLETËS SHQYPTARE" NË KRIJIMIN E PROFILIT ETNOLOGJIK DHE KULTUROR TË THIMI MITKOS.

Ky artikull synon të evidentojë forma të ndryshme motivore të teksteve të mbledhura nga Thimi Mitko në "Bleta Shqyptare", si rrugë kyçe për të ndërtuar udhëtimin etnologjik dhe kulturor të mbledhësit, si urë për një rilexim shkencor e më të detajuar të tij. Në gjithë folkloristët esencë e mendësisë mbledhëse e vepruese ka qenë kodi nacional. Motivimi për ruatjen e traditës, e njëzëri motivimi për vlerësimin e kulturës popullore, karakterizojnë vullnetin e çdo mbledhësi. Etnologjia nënkupton dhe synon studimin e kulturës dhe simboleve kulturore, ajo studion proceset kulturore dhe qytetëruese që ndodhin në kuadër të një grupi etnik, por edhe në grupe të ndryshme njerëzore dhe shtresa shoqërore, në të cilat, fenomenet kulturore gradualisht ndryshohen, gërshetohen, mbijetojnë ose zbehen krejtësisht. Në këto rrethana, mund të thuhet se tërësia motivore e folklorit të mbledhur nga Mitko, ishte në funksion të institucionalizimit të identitetit gjuhësor dhe kombëtar të dheut amë, legjitimimit ideologjik të tij, (e natyrshme për rrethanat dhe zhvillimet sociale, ekonomike e politike të asaj periudhe).

Pyetja kryesore e këtij studimi është: Si ndikon përmbajtja motivore e teksteve të mbledhura nga Thimi Mitko në prezantimin e të dhënave etnologjike dhe kulturore të tij?

Në këtë studim do ndjekim rrugën e interpretimit të marrëdhënieve mes tipologjive motivore të poezive të mbledhura nga Mitko, për të mbërritur te profili i etnologut dhe kulturologut.

Autori që në hyrje flet për qëllimin e punës së tij si mbledhës. Ai thotë: "(...) domethënia e këtyre studimeve albanologjike, është përgjithësisht, shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë, i fjalëve dhe teksteve shqipe, të cilat para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime dhe besoj se do të kenë vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare; veçanërisht dua që t'u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën dhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare, që, me këtë mënyrë t'u sjellë dobi që të mundin edhe këta të përparojnë"[706]

Rikonceptimin e profilit etnografik e kulturor e ndeshim në gjeografinë e përfshirjes[707] të tipeve të këngëve që mblodhi si, lirikë, epikë, balada, epikë historike,

[706] Akademia e Shkencave të RPSSH, IKP, *Thimi Mitko,* vepra, Tiranë, 1981. f. 43.

[707] Po aty, f. 43. Këto materiale (490 proverba, 80 gjëegjëza, 359 këngë, 12 përralla etj) përfaqësonin një kuadër të gjërë, të gjithanshëm dhe autentik të traditave popullore, një konceptim real të trashëgimisë folklorike shqiptare. Mitkoja i kish rregjistruar nga njerëz të masave, nga zanatçinj, bahçevanë, ushtarakë etj, kryesisht me prejardhje nga fshatrat, një pakicë edhe nga qyteti, të cilët këto thesare i sillnin drejtpërsëdrejti nga jeta e gjallë folklorike e Atdheut duke i ruajtur, atje ku i kishin degdisur hallet ekonomike, me nostalgjinë e mërgimtarit.

prozë, përralla, fabula anekdota, fjalë të moçme, gjëegjëza, këngë të vegjëlish, këngë për festat popullore të motmotit, këngë dashurie, këngë dasme, nizami, kurbeti, vaje e këngë të përvajshme, këngë të arbëreshëve të Greqisë, të përshëndoshura, të gjitha këto tregojnë se Mitkoja është i interesuar për dukuri dhe procese të ndryshme të zhvillimit folklorik që mbartin vlera estetike të ndryshueshme.

Njohjet e tij ruajnë një ekuilibër shkencor[708]. Në konceptin e tij si albanolog, u përpoq t'i grumbullojë sipas tematikës, dhe t'i rëndisë në vija të përgjithshme pas një kriteri tematik, kohor[709] e etnografik. Ai është objektiv në përcjelljen e materialeve me të dhëna zakonore që plotësonin veprimet dhe dukuritë folklorike dhe ky përbën një ndërgjegjësim për profilin e tij kulturor. Periudha iluministe[710], kultura greke, Viena, Stambolli, Bukureshti, Egjipti, janë vatra të formimit të tij kulturor e etnologjik, ai kërkoi si mbledhës identitetin historik dhe botën shpirtërore të shqiptarëve.

Këngët, ai i shoqëron me të dhëna të hollësishme, duke ndërtuar një kronologji motivore të qartë, p.sh. te **motivi trimërisë**, mbledh këngë ku bëhet i dallueshëm *vetja dhe tjetri*, si: *Kënga e Skullariq Arhondit* : vargjet: *kur dolli Frëngu dhe Frënga*[711], *Kënga e Spahinjve*, motivi i ruajtjes së fesë. Dallohen këto njësi motivore: motivi i besës, i bashkimit në rast rreziku[712], i rënies në luftë, i burrërisë, i mërisë[713], i amanetit, i mbrojtjes së pasurisë, i vrasjes së pabesë, motivi i gjakmarrjes[714], motivi i shëmtimit të kufomës, psh. (Kënga e Kiç - Andonit).

Vetë grupimi në cikle, tregon se autori ka hulumtuar me kujdes motivet, strukturat fonetike dhe figuracionin për të klasifikuar çdo krijim apo njësi sado të vogël poetike. Në të vërtetë, ndjekja e ***ritualit të dasmës*** dhe ***epikës historike***, na shpie në një lëmë interesant të rrafshit gjuhësor e pikërisht në atë të onomastikës[715], në toponiminë[716], e larmishme edhe të vyeshme për shpjegime e shqyrtime etnolinguistike e antropologjiko - kulturore me rëndësi për historinë e popullit shqiptar. Risitë e ritualit të dasmës, dhe ngjarjet e epikës historike janë parë të

[708] Akademia e Shkencave të RPSSH, IKP, *Thimi Mitko,* vepra, Tiranë, 1981, f. 63. "Uroj që ky shkrim albanologjik, t'u bëhet mësim i përbashkët gjithë shqiptarëve pa ndryshim mendimi politik ose feje edhe filologëve që studiojnë, një shkak për studime edhe mendime të tjera etnologjike më të mbaruara".

[709] Shih epikën historike. Kohëtaria e këngëve nis me një këngë të vitit 1637 dhe mbaron me 1976, Kënga e Spahinjve, f. 110, nr. 3.Shih dhe nr. 5. f. 113-114.

[710] Akademia e Shkencave të RPSSH, IKP, *Thimi Mitko,* vepra, Tiranë, 1981. f. 13. Shih përkushtimin: "I ndritshmi diell i diturisë lindi, dhe vjen mbi të gjithë. Ngreu e shiko, o nën'e dashur, shekullin e dritës…Ju o fëmijë të kini dëshirë në dituri, atyre t'u ngjisni. Ja tek ju ngrehmë mësojtoret, që të marrin dhuratat e muzave"

[711] Gjergj Pekmezi, *Bleta Shqypëtare e Thimi Mitko*, Vjenë, 1924, f. 109.

[712] Po aty, f. 113-114.

[713] Po aty, f. 116. *Kënga e Çaush priftit Hormovitit*.

[714] Po aty, f. 118, *Kënga e Kiç – Andonit*.

[715] Emra të shumtë trimash shqiptarë, ngulisin tiparet e tyre e bashkë me to dhe aktet heroike.

[716] Pjesa më e madhe e këngëve mbartin në rreshta toponime të rëndësishme për identifikimin etnologjik të kombit. Shih psh në fq 30. Nr 30.

lidhura ngushtë me të gjitha përjetimet historiko - shoqërore e etno - kulturore të popullit shqiptar, lidhur jo vetëm me pushtimin disa shekullor të tij nga osmanët, po edhe me trysninë asimiluese që i kanë drejtuar gjithnjë fqinjët, si "shpërblim" të dashamirësisë e të bujarisë tipike që shqiptari u ka nderë gjithnjë fqinjve të vet[717].

Këngët me larmi motivore, janë një pasuri e vërejtur dhe e njohur në shumë aspekte edhe nga vetë Mitko si:

- ***në aspektin e përmbajtjes***: motivet e ndjenjës: te këngët e dashurisë e të dasmave, motive atdhetare: te këngët e trimërisë; motive rituale – fetare: të këngë për festat popullore të motmotit, këngë të vegjëlish; motive social–ekonomike: te këngët e nizamit dhe kurbetit; motive politike– shoqërore: te epika historike; motive filozofiko–meditative: te fjalët moçme.
- **në aspektin etnografik**,(përshkrimi kombit), përfshihen motivi i veshjes, i zbukurimit, i zanatit, motivi marrjes së nuses, i zakoneve, i muzikës, motivi i traditës së lutjeve diellit[718], hënës, shenjtëve.
- **Në aspektin etnologjik**, motivet e kulturës shpirtërore dhe gjuhësore, jeta humane, ceremoniali i dasmës etj.
- **në aspektin historik**: trajtohen ngjarje, tablo, figura, që sjellin informacione të gjera, të shoqëruara edhe me shënime sqaruese e gjeografike dhe përftohen ndjesi, përfytyrime, realitete artistike të mirëfillta
- **në aspektin gjuhësor**: kemi ndryshimet dialektore[719], lexuesi permes larmisë së këngëve të mbledhura kundron, studion, vlerëson shprehjet dhe formësimin estetik, ndjesor të poetit popullor për të bukurën, për vlerat e vërteta artistike. Dikton marrëdhëniet e ndërsjella të gjuhës me kulturën në planin e brendshëm, po edhe më gjerë, përfshi shkëmbimet kulturore në rite e zakone, huazimet gjuhësore e artistike.

Mitkoja, reflekton me *Bletën* një strukturë të qartë motivore psh; **te fjalët e urta** që mbartin fuqinë krijuese, etnike[720] , kulturore e filozofike, Mitkoja përcjell ato fjalë, që mbajnë gjallë e kanë të bëjnë me etjen për liri, ruajtjen e etnisë, të kulturës dhe identitetit në veçanti. Janë fjalë që dallohen për një etnologji të lashtë. Ato japin mprehtësi të veçantë, mendime me domethënie mbi të cilat mund të përshkruhet një jetë e tërë, që i shërbejnë moralit më shumë se këshillimet.

---

[717] Këngët epiko-lirike arbëreshe dhe të zonave të tjera përbëjnë një përmendore të mrekullueshme estetike, me pasuri për kulturën gjuhësore, ato janë një trashëgimi e çmueshme në të cilën mund të verifikohen dëshmi shumë interesante të proceseve historike e dialektologjike të shqipes.

[718] Po aty, f. 17. Diellë, o diell, / nem m'një kupë miellë, / të martojmë lalenë,/ të apëjmë djalënë.

[719] Apëmë-jap, udhësë- ushës, dërgonj-dërgoj, etj.

[720] Po aty, f. 233-248. Lisi bën mëkatën e dega e kla./ Mos ik nga mbreti i keq, po ik nga dheri i keq. / Po të bjerë lisi nga degat, kushdo bën dru / Bjeri pragutë, që të dëgjojë dera. / Ja do buza, po s'ja lë hunda. / Gjuha e pashtë, thyen rrashtë. / E keqja të shpie në derë të armikut. / Pare me kamatë, petulla për natë. / Të dihej e mirë e kaut, nuk e thernin t'i hanë mish. / Atë që ecën me qafë unjurë, e dhjesin pulatë. / Më parë shih rrotull vatrësë, pastaj përjashta avlijës. / Sorra sorrës s'i nxjerr sytë. / Kur ti nuk e ke zanat, mos u bëj hoxhë në fshat.

Tematika është e mpleksur me brendi të lashta si ***këngët për festat popullore të motmotit***, me mendësi të shekujve të shkuar; nga ana tjetër, këngët kuptohen pa ndonjë vështirësi të veçantë, jo vetëm në Gegëri, po edhe më gjerë. Kjo dëshmon se gjuha motivore[721] është e përpunuar në një shkallë të lartë me figura të hijshme e leksik të zgjedhur, prandaj edhe mund të konsiderohet me të drejtë si *thesar estetik i gjuhës sonë poetike*.

Si krijimtari artistike popullore, folklori i mbledhur nga Mitkoja, me përmbajtjen e tij, na sjell jehonën e kohëve dhe gjurmë të ndryshme evoluimi me fjalë vendore (lokale), me variante a invariante këngësh më të përhapura e që i përkasin një areali mbarëshqiptar[722].

Ai mori me vete informacionin e bashkëkohësve, trashëguar në forma të ndryshme. Si një filolog me kulturë[723], ***rikrijon portretin*** e trimit, e të dashurit, të dashurës, e kurbetqarit apo nizamit deri në formimin e pamjes së plotë të natyrës së shqiptarit. Në këtë rendje të gjatë, ne takojmë emra luftëtarësh të shquar[724], vajzash, e djemsh, dokesh e zakonesh. Kënga është dëshmitarja më besnike e kohës, është arkivi e kujtesës njerëzore, ndaj Mitkoja e qëmton me kujdes që në thellësi këto forma të ndryshme letrare, ku njeriu ka pasqyruar jetën e vet shpirtërore dhe materiale dhe ka shprehur ndjenjat e tij, si një nevojë e brendshme shpirtërore, për të zbuluar botën me besimet, zhgënjimet, ngadhënjimet e veset e saj njerëzore, për të zbuluar bukurinë e tyre, forcën e karaktereve, patriotizmin dhe bëmat që kanë lënë gjurmë në kujtesën e njerëzve, e që i këndojnë bashkë me ngarkesat emocionale, të cilat, Mitkoja është i aftë të na i transmetojë ashtu siç dhe i dëgjon pa i ndryshuar a përshtatur.

Edhe në planin diakronik në boshtin vertikal (përmes kohës) çdo fakt lidhet me faktet që e paraprijnë ose e ndjekin historikisht, Mitkoja udhëhiqet, gjithashtu, nga nevoja e realitetit kulturor shqiptar në fazat e caktuara, shpalos atë që është e

---

Do të marr o yll i dritës,

[721] Ku këndojnë ato fëllënxa / nuse lule / si pëëlumbat e qellvet,/ këmbëkuqe moj fëllënxë / me nusen si gjeraqinë (f. 46-49)

[722] Paka n' andërr një tubë berresh, / Tufa ishte treqind delesh" Aty ndeshim herë tufë delesh, herë tubë berresh: e para (dele) është një fjalë më e njohur, e përbashkët si fonetikisht, ashtu edhe nga ana semantike, kurse e dyta (tubë berresh) është e njohur në një areale më të ngushtë, kryesisht në trevat e gegërishtes veriore.

[723] Sh. Sinani: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 13-27 gusht 2012, shprehet se: *Filologjia si shkencë e tekstit, në rastin e trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve, gjendet përballë detyrash shtesë: tejshkrimi dhe botimi kritik, me alfabetin e njësuar të shqipes qysh më 1908, i koleksioneve të mbledhur prej etnologëve të huaj nga tradita gojore shqiptare [Reinhold, Hahn, Karadjić, Meyer, Dozon]; numerizimi dhe shenjimi me alfabetin e shqipes dhe alfabetin ndërkombëtar i Kartotekës së Leksikut të Shqipes me mbi 5.5 milionë njësi [QSA: 2012]; si dhe përballja me detyrat e mbledhësit të kësaj pasurie edhe sot në terren*.

[724] Bendo Starovasit, Kurt Pashë Berati, Ali Pasha, Marko Boçar Suljotit,Rexhep Shkodranit, Rustem Dibranit, Gjikë Thana Borsiljoti, Çaush Prifti i Hormovitit, Hyso Arap Shahini, Kiç –Andoni, Veli Gega, Çuno Aliu, Kristo Koka i Vunoit, Spiro Gjika Qiparo, Idris –Agaj, Zylyftar Podës.

nevojshme dhe jo gjithçka, duke pasur pikënisje dijen, historinë, kulturën, gjuhën e politikën.

Teksti i mbledhur shpesh është një reagim i qartë kundër presionit asimilues të fqinjëve, duke u kthyer në mbrojtje të autenticitetit kulturor. Mbledhja e këngëve, kthehet kështu në një tekst valid, që lëviz nëpër kohë, me këngë të riteve pagane[725], me këngë të festave fetare, me elementet të poetikës lirike, epike. Ai identifikon kështu, ato motive, që përbëjnë arsyen dhe shkakun fillestar të krijimit, pra origjinën, prejardhjen e etimologjinë.

Me punën e tij si mbledhës, ai bëhet ndërmjetës i traditës, me profil të qartë kulturor, që në variacionet dialektore, paradigmat metrike, modet muzikore, në transmetimin e informacionit me këngët epike, në sinkretizimin me elemente të tjera të folklorit joletrar, si etnografia[726], kostumografia[727]. Kështu ai bëhet një mbledhës që përfshin ***kulturën materiale të popullit***, objekte të shumta që ilustrojnë një nga punët më të vjetra të popullit (gjahun, blegtorinë, bujqësinë). Veçmas ka materiale të së drejtës kanunore, të së drejtës zakonore si dhe këngë që i këndojnë zakoneve të jetës familjare.

E gjitha kjo, dëshmon për njohje të mirë të veçorive së kulturës materiale, shoqërore, shpirtërore dhe artistike në krahina të veçanta[728], e fituar gjatë kërkimeve të shumta në terren. Kjo i dha mundësi që të studionte e t'i gruponte në njësi territoriale etnografike, sipas tipareve dalluese dhe të përbashkëtat e tyre. Ndryshimet[729] në ***ritet martesore***, dallojnë zonat e jugut dhe qytetit ku gjejmë detyrime ekonomike të palës së djalit kundrejt vajzës, e në disa të tjera jo.

Mitkoja nuk lë pa mbledhur dhe motive interesante si: ***ceremoniale nga kulturat e lashta***, gojëdhënat, tek të cilat vihen re shkallëzimet e para mbi të cilat u ngrit arti teatral. Nuk mungojnë motive që të kujtojnë zanafillën e tragjedisë. Prandaj mbledhja e tyre, ka rëndësi, se depërtojnë në mendësinë, shijet dhe prirjet e kulturës shqiptare.

Edhe te zbavitjet e fëmijëve, vërehen shfaqje dhe motive të thjeshta që mund të cilësohen dramatike. Shumë zbavitje fëmijësh marrin shkas nga imitimi i të rriturve, ku zë fill shkallëzimi i parë i dramaturgjisë[730]. Në repertorin e fëmijëve ka shfaqje dramatike me subjekt të përcaktuar, si *Nata e buzmit*, apo këngë me motive të shumta mimetike dhe onomatopeike, imitime[731] shpendësh, kafshësh. Zakoni i

[725] V. Xhaçka, Festa kalendarike popullore në Devoll, "Busht", 1959/3.

[726] Etnografia shqiptare IV, UHT; Institutii historisë, Tiranë, 1972. Rrok Zojzi, Gjurmë të një kalendari primitiv, Buletini i Institutit të Shkencave 1949/1.

[727] Andromaqi Gjergji, "Veshjet popullore, këmisha e grave, Nr. 11, f. 23-25.

[728] Akademia e Shkencave, IKP, Etnografia shqiptare 11, Tiranë, 1981

[729] Ramadan Sokoli, "Gjurmime folklorike", Tiranë, 1981, f. 5. Në shfaqjet popullore, ndryshojnë në trajtë dhe përmbajtje, sipas breznive, e sipas gjinisë, sipas krahinave, sferave shoqërore, pasqyrohet fantazia, botëkuptimi i popullit, me shijet, prirjet, aftësitë krijuese etj..

[730] Gjergj Pekmezi, Bleta Shqypëtare e Thimi Mitko, Vjenë, 1924, f. 39.

[731] Po aty, shih nr.5, 6 dhe 13. f. 39 - 42. Shih dhe: Mark Tirta, "Besime të ndryshme në kulturën popullore shqiptare", f. 99.

romakëve të vjetër me 14 mars, ky ritual vërehet te "Vangjelizmoi"[732] ku fëmijët zbojnë zvarranikët me zhurmë, brtima. *Lazoret* paraqesin gjëra të veçanta, si funksioni argëtues - ritualesk, efekti i dobishëm, argëtimi, largimi nga hallet. Ato përcjellin dhe funksionin[733] etiko - shoqëror, nuk shmang këngë me përmbajtje të ironisë, satirës, apo të metat e njerëzve, si edhe funksioni edukues e moralo - etik.

Të pasura me motive dhe me elemente dramatike, janë doket dhe zakonet, ritet e dasmës ku marrin shkas një mori shfaqjesh dhe gjejmë atmosferën më të volitshme të zhvillimit të tyre. Doket e martesës shtjellojnë një sërë veprimesh ceremoniale, ku nuk mungojnë dialogët, vallet, këngët, ato janë skenarë piktoreske, plot gamë të gjerë poetike - muzikore që vërehen në çdo fazë të dasmës[734]. ***Motivi i imitimit*** të veprimeve të grabitjes, kur vijnë të marrin nusen, si të thejnë sanxhak, apo të përleshen
gjoja, të çon në lashtësi në doket e martesës me grabitje[735]. Mitko mbledh ato këngë që tregojnë motive
të fazave tranzitore nga grabitja e nuses deri te martesa dhe transmeton shijet dhe ndjeshmërinë e
popullit ndaj emocioneve.

Veshja[736], nga roli i saj i dobishëm dhe funksioni që kryen përbën një nga elementet e rëndësishme të kulturës materiale. E parë nga elementet e zbukurimit që përmban, nga format artistike që merr, roli dekorativ që luan edhe një element të çmuar estetik, duke integruar kulturën shpirtërore si pjesë përbërëse e artit popullor, karakteri i veçantë i elementeve të zbukurimit, pasqyron specifikën kombëtare të çdo populli në këtë fushë. Ato rindërtojnë aspekte të rëndësishme të mënyrës së jetesës në periudha të ndryshme si dhe zhvillimin e shijes mbi të bukurën[737]. Larmia e kulturës tradicionale, krahinorja dhe kombëtarja ajo çfarë është e përbashkët mes krahinave apo zonave të vendit, por edhe nga tiparet që e dallojnë nga kulturat e popujve të tjerë. Veshja merret si simbol për të cilësuar anën etnike[738].

---

[732] Po aty, f. 42, nr. 15

[733] Po aty, f. 39. nr. 6, Rona, rona, peperona, / bjerë shi mbi arat tona. Të bënetë grurëtë, / të hanë kahurëtë / të bënëtë misëria, / që të hanë turqëria.

[734] Po aty, f. 50. Nr. 13. Shih: Kur shkon dhëndëri me krushq që të marri nusen këndojnë: Dyzet e pesë kalorë / dhëndëri vezir bi ta /gjithë me dyfek mbë dorë, / gjithë veshur ëndë cohë, / dhëndëri vezir mbi ta, do të prishinë stambollë etj.

[735] Po aty, f. 51. nr. 14. Dalkë dhëndëri në sanxhak,/ për të prishurë një fshat, / jo një fshat po një mëhallë, as atë mëhallë gjithë,/ por shtëpinë e zotit krushkut, të marrim nusen tënë,/hajde, moj lule, me neve, / hajt të vemi në fshat tonë,etj.

[736] Andromaqi Gjergji, ASHSH, IKP, Veshjet shqiptare në shekuj, Origjina, Tipologjia, Tiranë, 2005.

[737] Gjergj Pekmezi, Bleta Shqypëtare e Thimi Mitko, Vjenë, 1924, nr. 26. f. 80. Moj e vogla xhinxhife / mvish jelekun kadife. f. 52, nr.16. Shih dhe nr. 23, f. 79. Testimet me rruaza, lule, mos bëj ujeza, se rrobat t'i shtruan, me plaf t'i mbluanë.

[738] Akademia e Shkencave, IKP, Lirika popullore 3, Tiranë, 1981.

Ndërsa me mbledhjen e ***këngëve të kurbetit***[739], Mitkoja hedh dritë mbi kuadrin historik-social të kohës mbi ambientet shoqërore. Notat elegjiake, struktura, ndjenjat e rebelimit dhe zemërimit, ankimet dhe thirrjet e gruas, sjellin të dhëna për situata të ndryshme ekonomike dhe politike.

Përfundime: Folklori, poezia, historia, filologjia, etnologjia, estetika, etika asgjë nuk ia ndaloi vetes. Mitkoja shfaq përmes tyre, vulën e etnicitetit shqiptar, ishte para së gjithash gjuha, religjioni, shfaq mbresat e ekzistencës së një bote poetike të fituar nga mbledhja e këngëve popullore që afrojnë një fushë të re, një gjuhë të re, e interesante. Mitkoja shndërrohet në themelor të pohimit se privilegji i njerëzve qëndron në njohjen e botës dhe qëllimeve të tij. Kjo zbërthen konceptin e Mitkos krenar për origjinën, jetën shpirtërore, jeta e një populli është historia e ti. Ai arriti të mblidhte aq sa të formonte bazën natyrale[740].

Resuli do shprehej: Si veprim atdhetar ai kishte marrë edhe gjithë punën vigane qi kreu- ndër ma të parët-në të mbledhun të visarit kombëtar, të kangvet, të përrallavet, të proverbave e të prodhimeve të tjera të mrekullueshme të popullit t'onë. Me to ai do provonte të drejtën e Shqipnis për t'u quejtë komb [741]. Me të drejtë De Rada thotë se : "Thimi Mitkua Korçar qe guri i themelit i rindërtimit t'atdheut të vet. Leu prej shtëpije në të cilën dashtënija vepruese e atdheut të shkretë ishte porsi trashëgim. Dhanë mbas tregtije në mërgim (...) kurrë s'i a ndau synin fatit të Shqipnis së vet. Në "Bletën Shqiptare" kemi, të thuesh, si në gji të nanës, gjithshka atdheu ka rujtë prej qenës së vet fisnike, kah mund të përtrihet e të ringjallet[742].

---

[739] Gjergj Pekmezi, Bleta Shqypëtare e Thimi Mitko, Vjenë, 1924, f. 85, nr. 39. Mun ndë kishë do të vete, / ti ndez kandilë panajasë,/të më bjerë Konstandinë,/ se po prishem prej sevdasë. Shih dhe nr. 43. f. 87. nr. 52. f. 91. Zunë yjet e radhëtojnë,/ ksenetarët zun'e shkojnë,/ gjithë venë e ti spo duke, O Stambol, more i shkretë, / rëntë zjarri e të djektë,/ Pu të djektë anë mb'anë,/ se na mban burrat tanë, / karahi e manxuranë.

[740] Namik Resuli, "Shkrimtarët Shqiptarë" nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë, Pakti, 2007. f. 180. *Andej shkruante e mirrte udhëtimin pa u lodhë për dobi të çështjes kombtare. S'la njeri të kohës së vet qi të mirrej me kulturë a me politikë shqiptare, pa hy në marrëveshje me të. Miqsi të madhe kishte sidomos me De Radën (me të cilin bashkëpunoi në "Fjamuri i Arbrit", a me Kamardën; gjithnji me Dora d'Istria, me Francesk Krisp-in e me Zef Skiroin.*

[741] Po aty, f. 181. E njëmend jo vetëm desht t'i botojë ndër dy vëllime "Bleta Shqiptare" (1878) e "Mbleta e Vogël" (e pabotume, e mjerisht e humbun), por kundra dishirit të natyrshëm të çdo shkrimtari qi don vetë me shfrytzue prodhimin e mundit të vet-landën e vet të pasun s'u a kursei miqve, shqiptarë e të huej, qi të mund t'i qitshin në dritë ma të madhin lavd të gjenis së kombit. (u botue me alfabetin greqisht, por në vjetin 1924 u përshkrue me shkronja t'alfabetit të sotëm, u përkthye në shqip dhe u radhit nga Gjergj Pekmezi në Vjenë, burimi i Vjenës ka 304 fq.)

[742] Po aty, Zef Valentini. f. 182.

ILIR SHYTA (KORÇË)

KONCEPTI POPULLOR PËR DASHURINË DHE VAJZËN TE KËNGËT E DASHURISË TË "BLETËS SHQIPTARE"

Lirika erotike është një nga gjinitë më të pasura të folklorit tonë dhe që që rezulton e mbledhur më shumë ndër shekuj. Këngët e dashurisë kanë një rëndësi të madhe, mbasi në to jepet ideali i popullit për femrën, në mënyrë të veçantë edhe për familjen. Në to zbulohet vizioni i përparuar për jetën dhe marrëdhëniet midis të rinjve, që populli i ruante në zemër edhe pse kanunet dhe zakonet ishin kundër dashurisë. Pasuria e madhe e mjeteve artistike, koloriti dhe ngrohtësia e këngëve të dashurisë, tregon ndjenjat e thella dhe shijen shumë të hollë të popullit. Një vend të rëndësishëm zë në këngë përpjekja për një dashuri të lirë dhe protesta ndaj pengesave.

Nëse kërkojmë gjenezën shkencore të mbledhjes së këtyre këngëve, padyshim, mendimi shkon te Th.Mitkoja, i cili në gjithë atë material të gjerë folkloristik që mblodhi, përzgjodhi midis shumë të tjerash edhe një kolanë këngësh lirike popullore të dashurisë, të cilat konsiderohen si nga më të bukurat e folklorit tone.

Te vepra e tij "Bleta Shqiptare", që konsiderohet si përmbledhja më e mirë folklorike e kohës, por jo vetëm, të tërheq vëmendjen fakti se autori i quan këngët popullore të dashurisë, "këngë shqype jaranishte". Në këtë vëllim janë përfshirë rreth 123 këngë popullore erotike, të cilat pasqyrojnë në thelb gjendjen emocionale të njëriut të dashuruar, qoftë vajzë apo djalë dhe kalvarin e vështirë të rrugëtimit të kësaj ndjenje. Dashuria është një fenomen njerëzor që lidhet me jetën dhe që shprehet me një ndjenjë të fuqishme."Dashuria si një nga ndjenjat më të thella e më komplekse të njeriut, ka frymëzuar ndër shekuj muzën poetike duke shkrirë në një përjetim të vetëm një spektër aq të gjerë ndjenjash të kundërta si harenë e trishtimin, guximin e frikën, dhimbjen dhe kënaqësinë, vetmohimin dhe egoizmin. Shtysat e dashurisë burojnë nga natyra, por përjetimi njerëzor i saj është një akt kulture. Edhe në krijimtarinë tonë folklorike kjo ndjenjë është materializuar në një numër mjaft të madh këngësh"[743]

Në këtë cikël gjejmë të pasqyruara me një art e finesë të jashtëzakonshme si dhe me një emocionalitet drithërues, etapat në të cilat kalon dashuria. Te "Bleta Shqiptare", Thimi Mitkoja ka botuar kryesisht këngë dashurie të jugut dhe një numër të vogël këngësh dashurie të veriut, të cilat i quan "gegërishte"(janë rreth 13 të tilla, karahasuar 110 të tjerat nga jugu). Ashtu si në ciklin e këngëve të dasmës edhe në atë të dashurisë te "Bleta", duket qartë se vetëdija estetike dhe artistike e Mitkos ka selektuar dukshëm këngën e dashurisë së jugut. Kjo mendojmë për dy arsye:

[743] GJ.Misha, Lirika popullore e dashurisë, Çështje të folklorit shqiptar, IV, Tiranë, 1989, f.189.

Së pari, Mitko e njihte mirë këngën popullore të jugut, sepse i përkiste kësaj zone.

Së dyti, Mitkoja, te emigrantët në Egjipt ndoshta nuk ka pasur mundësi të mbledhë një material më të pasur këngësh dashurie të veriut, sepse, në fakt, malësori i jugut ishte ai që kishte emigruar më shumë.

Dihet se interesi për folklorin te Mitkoja ka ekzistuar që herët dhe punën e tij për mbledhjen e folklorit ai e nisi me mbledhjen e materialit folklorik të vendlindjes. Mundësia për të grumbulluar një numër të madh këngësh popullore dashurie ishte e madhe, sepse këto këngë këndoheshin gjerësisht në ambiente gjëra apo dhe ato familjare dhe me aftësinë e tij përzgjedhëse Mitkoja diti të pasqyrojë te vepra e tij tharmin e këtyre këngëve, në të cilat të spikaste qartë ideali popullor për dashurinë, lirizmi i hollë, figuracioni fin, portretet e përkryera të bukurisë së vajzës dhe gjendjet emocionale të një bukurie të jashtëzakonshme.

Një çështje që duhet prekur këtu është ai i klasifikimit të këtyre këngëve. Te vëllimi II, i "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar", në të cilin është pasqyruar renditja e këngëve sipas variantit të "Bëletës Shqypëtare", shohim se Mitkoja ka vendosur në fillim këngët e jugut dhe më pas ka grupuar këngët gegërishte të dashurisë[744]. Midis këngëve erotike të jugut ai ka përfshirë edhe disa këngë kurbeti dhe nizami. Mitkoja, përveç kësaj ndarjeje në këngë të jugut dhe gegërishte, shihet se nuk ka përdorur ndonjë kriter tjetër klasifikimi. Ndoshta ky do të ishte një pretendim i tepërt po të kemi parasysh kohën e botimit të veprës dhe aplikimit të parimeve shkencore në përmbledhjet folklorike. Por, ndoshta në mënyrë intuitive, Mitkoja ka bërë një renditje të këngëve sipas shkallës së përshfaqjes së gjendjes emocionale të njeriut të dashuruar. Këngët që hapin ciklin e "këngëve jaranishte" trajtojnë në përgjithësi pamundësinë e realizimit të dashurisë dhe bashkimit shpirtëror e fizik të djalit me të zgjedhurën e zemrës së tij, pastaj kalohet në disa këngë që shprehin, në një farë mase, guximin e djalit (në raste më të rralla dhe të vajzës) për të realizuar takimin, jepen më pas portrete të mrekullueshme bukurie, kryesisht të vajzës, vazhdohet me ndonjë këngë lulesh, këngë nizami dhe kurbeti. Në botimin e vitit 1981, të "Bletës Shqiptare" të Institutit të Foklorit, prej Q. Haxhihasanit, i cili pretendohet të jetë një modifikim i veprës nga pikëpamja shkencore, shohim se këngët e jugut dhe ato gegërishte të dashurisë janë renditur bashkë. Kjo për faktin se te ky botim, këngët e dashurisë janë botuar sipas rendit alfabetik, gjë që e vë në dukje dhe hartuesi i këtij botimi në parathënien e veprës.[745]

Por le të shohim se si shpërfaqet në këto këngë koncepti popullor për dashurinë si ndjenjë thellësisht njerëzore dhe burim jete. Dashuria si formë e ndërgjegjes shoqërore ka lindur bashkë më njeriun dhe është po aq e vjetër sa ai. "Si një ndjenjë dhe atribut thelbësor i njeriut dashuria ka ndjekur rrugën e zhvillimit të shoqërisë njerëzore nga një formacion ekonomiko-shoqëror në tjetrin, ka ndryshuar edhe

[744] Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, II, Tiranë, 1961.
[745] Th.Mitko,*Vepra*, Parathënia,Q.Haxhihasani, Tiranë, 1981.f..7

evoluar edhe koncepti për këtë ndjenjë. Kënga erotike ka pasqyruar jo vetëm mentalitetin e një shoqërie të caktuar, por përmes kuptimeve, vlerave dhe imazheve artistike ajo lidhet me gjithë universin ideor me zakonet, praktikat dhe besimet e ndryshme që janë pjesë përbërëse e sistemit të vlerave estetike e psikologjike të popullit tonë"[746]

Lirika popullore e dashurisë është një dëshmi artistike e pengesave që haste ndjenja e dashurisë nga kufizimet shoqërore, por ajo është, njëkohësisht, një pasyrë e gjallë e shpirtit të popullit, e botës së tij të gjerë shpirtërore, si dhe e pasqyrimit të evoluimit të koncepteve morale për këtë ndjenjë. Konceptet morale për dashurinë nuk kanë qenë të njëllojta në të gjitha kohërat. Ato kanë ndryshuar vazhdimisht në bazë të kushteve historike dhe social-ekonomike. Duke parë këngët e dashurisë së Veriut dhe ato të Jugut, vërejmë se edhe kur ato janë vërtet dramatike, populli në to na paraqet faktin në mënyrë asnjëanëse, pa dënuar askënd e pa mbajtur anën e askujt, haptazi. "Populli, në poezinë e tij nuk është kurrë as moralist, as fanatik. Në jetën e tij populli, në shumicën e rasteve, nuk e ka pranuar dashurinë, kurse në artin e tij nuk e ka dënuar kurrë. Nuk ka asnjë këngë dhe asnjë varg kundër dashurisë. Në jetë dashuria ishte përgjithësisht një dramë. Kjo dramë ishte shpesh me të shtëna armësh dhe shpesh e brendshme. Dashuria në poezinë popullore është përgjithësisht një ndjenjë dramatike e parealizuar, një ëndërr ose një ndarje e gjatë. Intuita e tij e madhe i ka thënë që dashuria është një ndjenjë e lidhur me të ardhmen dhe prandaj në artin e tij i ka dhënë asaj një vend që nuk ia ka dhënë në jetë".[747]
Qani o syt e mi qani,/ qani pa pas të pushuar, / qani se po më del xhani, / gjak pikon në kraharuar,

Populli qendron mbi ngjarjet mbi dukuritë, por nuk është e vështirë të kuptosh se ai merr gjithnjë në mbrojtje ndjenjën e pastër edhe kur ajo është shkatërruese për individin, mbasi zëri i dashurisë është zëri i jetës:

Sevdaja, shokë sevdaja, / m'e keqe se fukuraja,/ Moj sevdaja qysh më ke bërë, / do më vraç pa më thënë. Këngët jaranishte të "Bletës" e përshkruajnë ndjenjën e dashurisë në të gjitha fazat dhe në shumësinë e përshfaqjeve të saj. Por, në shumicën e këngëve dashuria konceptohet si një romancë e dhimbshme, e trishtuar që sjell melankoli, trishtim dhe vuajtje pa fund: *I mieri ç'u mbush vrer, / bie të fle gjumi s'më merr*, ose: *Malli yt moj malli yt, / m'u bë det, njëmend më mbyt, / Pandeha se do të rrinje, / ti të dhëmburat mi dije*. Konceptim i dashurisë si plagë shpirtërore kthehet në lajtmotiv dhe përmes kësaj dhimbjeje konceptohet bota dhe jeta. Forca që ushtron ndjenja e dashurisë është e jashtëzakonshme, aq sa e nxjerr njeriun nga realiteti në një gjendje të re, e cila jepet në vargjet e këngëve të "Bletës" përmes një sistemi të tërë mjetesh stilistike të konsoliduar, për të shprehur përmasat e dhimbjes, të turbullimit të mëndjes, të gjendjes së dehjes në të cilën e fut dashuria. Duke lexuar këto këngë të krijohet përshtypja se dashuria është

[746] GJ.Misha, *Lirika popullore e dashurisë*,Çështje të folklorit shqiptar ,IV, Tiranë,1989, f.200.
[747] I.Kadare ,*Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë, 1980, f.71-72.

realiteti i vetëm ekzistues dhe bota funksionon vetëm prej saj dhe për të. Aq i fuqishëm është ky përjetim i ndjenjës, sa njeriu që vuan prej saj e koncepton atë si një vuajtje të përmasava të mëdha, më të dhimbshme se një gjymtim fizik. Ai ose preferon më shumë vdekjen, ose shkon deri në agoni prej peshës që ushtron pamundësia e realizimit të kësaj dashurie: *Ku ma bëni mua varrë, / se mikja ma treti xhanë, / O moj fëllënxa mitare, / për ty qajnë fush'e male, / as ma thuaj ashiqare, / ndo më vraj, ndo më bën care,* ose: *Të të keshë moj biskonjë, / pa më vrisje me pisqollë*.

"Konceptimi i dashurisë si një plagë e shpirtit si një lëngim pa shpëtim në shtratin e Erosit, ka bërë që kjo ndjenjë në tekset poetike popullore të përqaset me vdekjen. Në ligjërimin poetik këto dy terma; dashuria dhe vdekja plotësojnë njëra-tjetrën duke u shndërruar në një çift të pandashëm.Vdekja nuk është gjë tjetër veçse një figurë stilistike e retorikës së këngës erotike, që ka për qëllim të shprehë forcën e ndjenjës duke u shndërruar në fakt, në një pohim të fuqishëm të dashurisë për jetën."[748]

Janë jo të rralla, këngët që e shprehin këtë sintezë të dashurisë, e cila duket sikur në çdo çast bashkëjeton me vdekjen. Këto këngë nuk japin përshkrime të hollësishme të gjendjeve shpirtërore dhe stadeve nëpër të cilat kalon vuajtja e dashurisë, por përqasja e saj me vdekjen në mënyrë shumë poetike, dhe sintetike jep cakun deri ku ka arritur dhimbja, çka e bën të pamundur jetën në boshllëk pa praninë e dashurisë: *Le të më vrasën le të më presën, / ne të dy bashkë do të vdesëmë*, ose: *Ndë vdekça kësi lëngimi, / ndë atë varr që të këllini, / një penxhere të më lini, /që të vinjë bilbili*. Duket sikur ligjet kozmike kanë pushuar së funksionuari dhe njeriu nuk i nështrohet më kozmosit, por kozmosi iu nështrohet kërkesave të njeriut të dashuruar. Dashuria jetohet vetëm në mendje dhe distanca që ndan ëndrrën nga realiteti duket se është gremina ku rrëzohet në mënyrë të pashmangshme i dashuruari i pashpresë*: Mal më mal do të përpiqem, / gjersa të humbas gjëkundi, / si pervani do të digjem, / do të tretem si plumbi*. Një element që ekziston në lirikën popullore të dashurisë, që e gjejmë edhe në disa këngë të "Bletës", është mallkimi ose "nëma", që djali i jep vajzës ose anasjelltas, për vuajtjet që shkakton mospërgjigjia e dashurisë. Zakonisht, në këngët popullore mallkimi përfshin kryesisht penguesit e dashurisë së dy të rinjve, por te Mitkoja hasim këngët e mallkimit respektiv midis të rinjve. Edhe njëherë, gjen rast të shpërfaqet forca shkatërruese e dashurisë, aq sa prek edhe altruizmin njerëzor dhe prej dhimbjes mendja, arsyeja flet një gjuhë të ndryshme nga ajo e zemrës: *Të nëma, të nëma shumë, / moj copë cop' e bëfsh gjunë, / Moj e bëfsh cop'e thërrime, / të kesh mall për besën time, ose, Pse s'më sqove? / A! paç nëmë, / të bënim punën tënë.* Ndonjëherë mallkimi merr një karakter përgjithësues, si shprehje e një rezultati që dikush e ka nxjerë nga përvoja e dhimbshme dhe ju lë miqve nëmën nëse do të bëjë si ai bëri*: I*

[748] GJ.Misha, Lirika popullore e dashurisë, Çështje të folklorit shqiptar, IV ,Tiranë, 1989, f.214.

gjori ç'u sillojisa, / O shokë kush u mendoftë, / o shokë lanet i qoftë. Pamundësia e dashurisë shpesh nuk vinte vetëm prej normave e kodeve zakonore, që nuk lejonin njohjen e vajzës me djalin, por shpesh vinte dhe prej aspekteve të jetës materiale. Djali, që të merrte vajzën që donte duhet të zotëronte një status të mirë shoqëror dhe ekonomik*: Ti sos jeshe për çobanë, / po për djem, për kapedanë,* ose: *Ç'ato sytë e zez që ke, / dëfto pazarë t'i blesh,* ose*: Dyzet gjysma idare, / do të vete në More, / të fitonj pa të t'i ble, / ty s'të ndahem moj lule*. Djali është gati të bjerë dhenë pozitat e lypsit për të arritur te e dashura e zemrës së tij: *Lir e frëngut nd'Engliterë, / më pafshin derë mbë derë, / sikur lypënj buk'e verë*. Ka raste kur vajza e provokon dashurinë e djalit për të matur forcën e qëndrushmërisë dhe dashurisë së tij. *Dua një sërë florinj, / pa të t'ap ballin tim, / Mos o moj aman, aman! / Se jam djalë e florinj s'kam, / U'në të fola me shaka, / të të njoh a ke sevda.*

Romantika e këngëve të dashurisë te Mitkoja, por dhe në krejt lirikën tonë erotike, ka rrjedhur nga kushtet e vështira të takimeve shpeshherë të rrezikshme, pasi të rinjtë nuk mund të shiheshin dot. Kjo romantikë gërshetohet me një ndjenjë të thellë guximi, ku shprehet qartë ideja e dashurisë së vërtetë: *Ngaha të të rynj brënda, / këm' e dor'-argjenda, / mes për mes avëllisë, / sheqer i kutisë, / ke babanë brenda, / këmbë e dorë argjenda,* ose: *Mora dyfekun e bëra yrysh, / e gjeç portën me kyç*

Këngët e dashurisë te "Bleta", përveç një karakteri të theksuar romantik kanë disa here edhe karakter natyralist. Kjo gjendje ka ndikuar, në raste të ndryshme, edhe në disa shfaqje sensualizmi. Me gjithë atë, në qendër të vëmendjes së tyre është dashuria e pastër njerëzore, që shquhet për një sinqeritet të madh. Populli është realist dhe krahas dëshirës për realizimin e dashurisë, si bashkim shpirtëror, shprehet dhe dëshira për bashkim fizik: *Shokë kur i hapa gjinë, / Seç qënke një vetëtimë,* ose: *Në buzë të putha, të ëmbël si mjaltë, / si lumthi jot ëmë si lumthi yt atë, / mbë gosti të thirra për darkë një natë, / moj gostia jote vetëm rrush të thatë,* ose: *O der, o i bir i derit, më theve paftat e brezit, / mbi jastëk derdhur leshtë, / Si vllastareja në vreshtë, / A qasu të të puth njëherë, / me dy grushta më bjerë, / bardhushkat me lahuri, / më kënda t'i mbanj në gji.*

Korpusi poetik i këngës jaranishte të "Bletës" na shpalos një sërë situatash e gjendjesh psikologjike, ku dhimbja dhe trishtimi harmonizohen bukur me dëshirën e fortë për të realizuar dashurinë dhe për t'ju gëzuar çdo çasti të saj. Edhe pse situatat që përshkruhen në këto këngë janë ato të vuajtjes, e cila shkon gati në agoninë e vdekjes, prapësëprapë, në nëntekstin e çdo vargu buron forca e madhe jetëdhënëse e dashurisë si motivi kryesor që i jep kuptim jetës. Në tërësinë e tij ky cikël do të formonte një roman të vërtetë dashurie që do të përfshinte në të të gjitha fazat e dashurisë.

E gjthë kjo fuqi e dashurisë nuk do të mund të konceptohet pa bukurinë e vajzës, e cila në poezinë popullore është burimi kryesor i lindjes së ndjenjës.Të bie në sy mënyra e veçantë me të cilën këngëtari popullor e ndërton portretin fizik të

saj. Është e natyrshme që ajo të vishet me cilësi dhe bukuri të jashtëzakonshme, në mënyrë që të justifikojë ndjenjën e fuqishme që ka lindur në zemrën e djalit.

Figura e femrës në këngët jaranishte të Mitkos përshfaqet më një rrëzëllim magjepës shumëplanësh. Portreti i saj merr forma të larmishme, të cilat zbulojnë evoluimin e koncepteve estetike popullore. Ai është një përshkrim i bërë sipas një vizioni të caktuar, i cili na jep objektin erotik në një pamje disi të idealizuar. "Kur i këndon vashës poeti popullor përdor një kod poetik të veçantë, një gjuhë të tipizuar, e cila funksionon si pjesë përbërëse e një sistemi vlerash të kristalizuara në traditën folklorike. Megjithëse vashat e këngës lirike mund të kenë një emër konkret, të kenë tipare fizike të dallueshme ato nuk janë individualitete, por tipa folklorikë[749]: *Sos e mira prej së mbarit, / o kalem I kallamarit, / pisqoll e Çelo Picarit* . Vetëm me tre vargje, autori poullor ka arritur të sendërtojë një portret të brendshëm dhe të jashtëm të vajzës, në një harmoni të përkryer dhe në mënyrë kaq të sintetizuar. Vargu i parë jep portretin moral të saj, i dyti elegancën dhe nurin dhe e treta është një kombinim i dy portreteve të mësipërme, kombinimi i të cilave e bën vajzën një pisqollë që të shpon tejpërtej: *Sy –zezë, vetllë –hollë, / leshtë tat derdhur si fqollë, / O moj dardha rrubullake, / Mer furkën jakë pasdarke*. Vajza është përveçëse e bukur, punëtore dhe me vlera të larta morale. Ja si jepen përmes një figuracioni fin këto tri cilësi të vajzës në një harmoni të paparë: *Endi molla endi dardh, / endi kraharua bardha, / Ajo që mban lahurinë, / murga ç'e shëron njerinë*. Aftësia përtëritëse e dashurisë si forcë që vë në lëvizje jetën, buron nga vlerat e brendshme dhe hiret e vajzës.

Te "Bleta" gjejmë portrete të mrekullueshme të vajzës, të cilat kapin ose një element të bukurisë së saj, ose disa të tillë, por nuk gjejmë, më pak përjashtime, një përshkrim total të bukurisë së saj fizike. Ndër elementët fizikë që përmendem më shumë në këngët jaranishte të Mitkos janë sytë, balli, flokët, vetulla, gusha, faqja, gjiri, llëra, beli, etj. Sytë janë ata që vendosin kontaktin e parë, lidhjen e drejtpërdrejtë me të dashuruarve, ata përfaqësojnë organin e gjithëpushtetshëm të dashurisë prej ku fillon e mbaron ajo. Ata përbëjnë kanalin kryesor mes mikrokozmosit të ndjenjave njerëzore dhe makrokozmosit të jashtëm. Sytë kanë një pushtet magjepës, aq sa hapja e tyre krahasohet me hapjen e stinës më të bukur: *Ç'faj të pata bërë, / moj cullufezezë, / fajën ta ka syri moj cullufezezë*, ose: *Këto syzezat kur flenë, / synë e zi qysh e mbërthejnë, / Qasu të të puth njëherë*. Edhe i mbyllur syri vazhdon të përcjellë magjinë e tij të dashurisë. Shpeshherë përshkrimit të syrit i bashkohet edhe ndonjë element tjetër fizik për të bërë më të fortë efektin estetik si; flokët, balli, vetulla, faqet etj: *Leshtë tat si korbë, / mëntë m'i bëre çorbë, / syri i zi i yti, / ndë grykë më mbeti, ose: O moj Dudë moj syrrushe, / florinjtë që ke pas gushe*. Elementet që përmenden më shumë pas syrit të portreti i vajzës në këtë cikël janë; gusha, buzët dhe faqet, si elemente që gjenerojnë erotizmin dhe ndjelljen e

[749] [749] GJ.Misha, *Lirika popullore e dashurisë*, Çështje të folklorit shqiptar, IV ,Tiranë, 1989, f.214.

ëndrrave dhe dëshirave të fshehta*: Bukurinë e ballit moj do të ta marr, / dhe gushën e bardhë si margaritar*, ose: *Tumanetë e tua në degë t'ullirit, / të ndrit faqeja jote si dritë e kandilit*, ose: *U ndam o shpirt larg mërguar, / faqeja jote pakafshuar,* etj. Femra në poezitë e "Bletës" është gjithmonë objekt i dëshirave të djalit, por shpesh në këngë shfaqen edhe dëshirat e vajzës: *As unë s'e doja, / vet u ngrit e erdhi, / se më mallëngjeu , / me ca lot që derdhi*, ose: *Ndë lagjin digjej qiriri, / shkova e mu ndes pëqiri, / O qiri, more qiri këtë që ma bërë ti , / s'ma ka bëra asnjeri, / po një djalë mituri*, ose: *Del në penxhere, po më shëkon ,/ me sy më sheh, s'më kuvendon*. Pozita që ka femra në këngët e dashurisë së "Bletës" është një pozitë disi e emancipuar. Ajo është përgjithësisht superiore ndaj djalit, që digjet për dashurinë e saj, madje edhe luan me ndjenjat e tij: *O vulë e gjakut sërma, / e bukura shoqe s'ka, / vetëm një të lig'i ra, / që me këdo lodrat i ka*. "Në poezinë popullore femra ka një shkallë respekti, lirie aktiviteti, zhvillimi që nuk e ka pasur në jetë. Duket sikur atë që nuk ia dha në jetë bijave të tij, populli me një shpirtmadhësi të paanë ua jep në këngë. Sidoqoftë, një gjë është e padiskutueshme; që femra shqiptare ka pasur më tepër fat në këngë"[750]: *Zënë si bilbili, m'ecën si fëllënxë, / me këpucë frënge ngritur një pëllëmbë*, ose: *Ç'janë ato zonja që vijnë, / Të gjitha mbë këmbë rrijnë*, ose: *Jaranit që vjen ndajnatë, / hapi derën thuaji jakë*, ose: *Ore bandall o buzëplasur, / më shumë besë të ka pasur, / mos hajde ditën, po haj natën, të shohin burrat pa të vrasën*. Në përshkrimin që i bën vashës, poeti popullor përdor shpesh disa simbole erotike si: molla, dardha, limoni, etj. Simboli i mollës është një simbol universal mjaf i përhapur në këngët e "Bletës". Ajo shfaqet në këtë simbolikë dhe si metaforë e frutit të ndaluar.Vendin e mollës shpesh e zënë dhe simbole të tjera si: dardha, ftoi, kumbulla, rrushi, të cilat shërbejnë si metafora për të shënuar pjesë të ndryshme të trupit të njeriut: *Mos je mollë për të ngrënë, / -mollë jam po s'hahem kurrë, / as ndë turq , as ndë kahurë*, ose: *Të gënjeu lulusheja me një shami mollë, / Shan'e Ibrahim beut shtatë vjet beronjë*, ose: *Kam një fjalë për të thënë , / kam një mollë për të ngrënë, /Mos je dardhë mos je ftua? / Të të puth e të të dua, / të të shtrydh porsi limua.*

Këngët e dashurisë te Th.Mitkoja janë të një bukurie të jashtëzakonshme, përshfaqin, siç e thamë, një kuadër të gjerë emocional dhe përcjellin ndjesi fine dhe të mrekullueshme. Shpesh në këto këngë ndjenja e përmallimit karakterizohet nga një ngrohtësi e jashtëzakonshme. Thellësisë së mendimit i përgjigjet dhe një formë e lartë artistike. Shpesh këngët e dashurisë kanë formën e dialogut, ku shkëmbehen batuta nga djali dhe nga vajza. Herë tjetër ajo merr trajtën e një rrëfimi në vetën e parë, si një monolog në miniaturë, që shtron dilemën e një zemre. Disa këngë janë portrete të punuara me mjeshtëri të madhe artistike: *Djersa jot'e ballitë,er'e jargavanitë! / Djersa jot'e e faqesë, / er'e maushaqesë! / Djersa jote e gushës, / borzilok i fushës! / Djersa jote e gjirit, / er'e trëndafilit*. Krahasimet dhe metaforat që

[750] I.Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë,1980, f.78.

përdoren për vajzën janë marrë nga bota e luleve. Refrenet e këtyre këngëve janë nga më të ndryshmit dhe i japin këngës shkathtësi të atillë që i përgjigjet plotësisht idesë së ndjenjës. Refreni mund të jetë i njëjtë, ose mund të ndryshojë brenda së njëjtës këngë. Ndonjëherë tjetër refreni mund të vijë pas dy vargjesh, ose mund të përbëhet nga dy vargje. Këngët jaranishte të Mitkos paraqiten në vargje e forma të ndryshme strofike, një pasuri e madhe metrike,që dëshmon për pasurinë e metrikës popullore. Kështu, përdoren vargjet 8-rrokëshe ose 6-rrokëshe shpesh të dyzuar dhe të dyja këto lloje vargjesh mund të përzihen. Rrallë hasim edhe vargun 10-rrokësh e ndonjëherë 4-rrokëshin, vetëm si refren. Rima ose asonacat janë thuajse të domosdoshme dhe zor të gjesh këngë të parimuara. Këngët përdorin mjete të shumta stilistike si: përsëritja, anafora, apostrofi etj., të përshtatur për valle me distikë dhe tercina. Fiigurat më të përdorura janë: hiperbola, metafora, krahasimi, personifikimi, epiteti etj. Këngët dallohen për lakonizmin dhe koncizitetin e tyre, për lirizmin e thellë që përcjellin dhe ngrohtësinë e ndjenjave. Mbi të gjitha, në to spikat elementi njerëzor në dimensionin më shpirtëror të mundshëm. Ato mbeten ndër perlat e folklorit tonë, të papërsëritshme, lidhur me ndjenjën dhe emocionin që ofrojnë. Prandaj, studimi i tyre zbulon dhe hedh dritë mbi aspekte që lidhen me botën shpirtërore të popullit, që është e thellë dhe e gjerë si deti. Eshtë meritë, së pari, e Mitkos që na shtroi përpara sofrës e na gostiti me këto këngë të ëmbla e mallëngjyese, brilante e rrëzëllitëse, pasqyrim i pjesës më të bukur dhe humane të shpirtit tonë kombëtar.

IZAIM MURTEZANI (SHKUP, MAQEDONI)

ASPEKTE NARRATOLOGJIKE TË PËRRALLËS: KORDHA, YLLI DHE DETI

Përralla *Kordha, Ylli dhe Deti*, mbledhur, regjistruar dhe publikuar nga Thimi Mitkoja, është një ndër përrallat më të gjata të tij dhe njëheras me më shumë variacione të elementeve narratologjike. Përralla në fjalë, në strukturën e saj narrative, i përmban pothuajse të gjitha funksionet themelore të cilat janë të patjetërsueshme dhe vendimtare në përcaktimin e identitetit të këtij lloji të rëndësishëm letrar në kuadër të prozës sonë popullore. Shtatë funksionet e apostrofuara të përrallës, sipas Propit janë: shkaktimi i dëmit, ose mungesa, braktisja e shtëpisë nga ana e heroit, takimi me ndihmësin mitik dhe marrja e mjetit mitik, lufta, përkatësisht dueli me kundërshtarin, fitorja, kthimi i heroit në shtëpi, martesa e heroit. Pra, të gjitha këto funksione, apo fragmente narrative janë pjesë përbërëse e strukturës kompozicionale të përrallës së sipërpërmendur, nënkuptohet me veçoritë e saja specifike. Narratologjia klasike, në shumicën e rasteve, funksionet në fjalë i paraqet si kalim nga një gjendje në një veprim, ose nga një veprim në një veprim tjetër. Si rrjedhojë, jo vetëm koha, por edhe hapësira, apo shtrirja hapësinore e veprimit të përrallës, paraqesin elemente të rëndësishme të çdo strukture rrëfimore. Në këtë kontekst, koha në përrallë, sipas Lihaçovit, cilësohet si e mbyllur, pasi është e pashkëputshme nga syzheu, ngjarjet e njëpasnjëshme, apo nga vetë përralla. Me përfundimin e syzheut – përfundon edhe koha. Po ashtu edhe trajektorja e lëvizjes së heroit, në rastin tonë konkret, Kordhës (kryeprotagonist i përrallës) është tejet e rëndësishme, pasi zhvillohet në nivele të ndryshme të hapësirës që i përgjigjen kësaj bote dhe botës tjetër në të cilën jeton e Bukura e Dheut pas së cilës gjakojnë të gjithë heronjtë e përrallave. Me këtë rast, si tejet të rëndësishëm paraqiten figurat tjera të përrallës, përkatësisht ndihmësit mitikë, Ylli dhe Deti që ndërlidhen me sfera të caktuara hapësinore, gjegjësisht me atë qiellore dhe ujore.

Në kontekst të përrallës së publikuar nga Thimi Mitkoja mund të venerohen edhe elemente që ndërlidhen edhe me ritin e rishtarisë (inicimit). Në këtë funksion është areali i pyllit ku qëndron protagonisti i përrallës (Kordha), pastaj takimi me ndihmësit mitikë, kulla në mal, udhëkryqi e kështu me radhë. Strategjia narrative e përrallës synon kah rishtaria e pubertetit, pasi heroi i saj i përgjigjet kësaj moshe, por njëherit sfidat heroike nëpër të cilat kalon ai, nxjerrin në sipërfaqe edhe llojin tjetër të rishtarisë, përkatësisht rishtarinë heroike.

1. Venerime hyrëse

Thimi Mitkoja është një figurë tejet e shquar e Rilindjes sonë Kombëtare. Ai arriti të zërë vend të merituar në panteonin e rilindësve tanë në cilësinë e një mbledhësi të spikatur të folklorit shqiptar, madje duke i vënë edhe bazat e kësaj veprimtarie tejet të rëndësishëme në rrugën drejt zhvillimit të mëvonshëm të

folkloristikës shqiptare. Kontributi i tij në fushën e folklorit shqiptar u kurorëzua me publikimin e përmbledhjes tanimë të njohur "*Bëlietta shqipëtare"* (Bleta shqiptare) në Aleksandri të Egjiptit në vitin 1878. Kjo përmbledhje në brendinë e vet përfshin një material folklorik, si këngë popullore, përralla, fjalë të urta e kashelashe, etj., të vjela kryesisht në pjesën jugore të Shqipërisë. Një pjesë e rëndësishme e këtij materiali folklorik, e përfshirë brenda kopertinave të përmbledhjes në fjalë, u referohet përrallave popullore, por mes tyre spikat përralla me numrin rendor 4 (katër). Kjo përrallë veçohet me një strukturë kompozicionale tejet të zhvilluar duke ngërthyer në brendinë e saj një numër të madh të episodeve të ndryshme rrëfimore. Përralla në fjalë me numrin e apostrofuar rendor, sipas emrave të protagonistëve të saj, është pagëzuar me titullin *Kordha, Ylli dhe Deti*, por ajo është ribotuar edhe me titull tjetër si *Tre shokët dhe e Bukura e Dheut*[751] . Duke pasur parasysh faktin se kjo përrallë posedon një strukturë të begatshme përmbajtësore, ndoshta do të ishte i arsyeshëm venerimi i saj nga prizmi narratologjik duke i veçuar me këtë rast segmentet më të rëndësishme të brendisë së saj rrëfimore, por njëkohësisht edhe elementet tjera që ndërlidhen me protagonistët e saj, kohëhapësirën e kështu me radhë. Njëkohësisht, venerimi i saj nga prizmi narratologjik, apo sinkronik do të shoqërohej edhe me ndonjë ndërhyrje të caktuar të natyrës diakronike, apo historike, pasi përralla është një materie tejet komplekse dhe kërkon një qasje teorike më të gjerë. Dihet se narratologjia si disiplinë teorike e teksteve letrare, mjetet e saj teorike i shfrytëzon në funksion të diagnostifikimit dhe analizës së kategorive themelore të narrativëve, apo më mirë thënë, mëton t'i vëzhgojë dhe t'i izolojë si struktura specifike rrëfimore, t'i klasifikojë sipas rolit të tyre dhe relevancës së tyre për narracionin dhe t'i analizojë dhe sintetizojë si kategori të përgjithshme narrative, përkatësisht si pjesë përbërëse të çdo rrëfimi letrar të shkruar në prozë. Në këtë mënyrë mund të përfitohet një bazë letrare–teorike në funksion të interpretimit të çdo vepre letrare. Në drejtim të përmbushjes së këtij synimi shkencor, narratalogjia operon me koncepte të ndryshme shkencore nëpërmjet të cilave mëton të interpretojë tekstet e ndryshme letrare, sidomos ato me strukurë të zhvilluar rrëfimore.

Tanimë është i njohur fakti se narratologjia si disiplinë shkencore buron nga strukturalizmi, përkatësisht nga qasja strukturaliste që u zbatua në kuadër të teksteve të ndryshme narrative. Ajo paraqitet në vitet '60 të shekullit XX në Francë, kurse si "vit i lindjes", apo si fillim i vërtetë i narratologjisë në shumicën e rasteve merret viti 1966. Në këtë vit në Paris publikohet numri i tetë i revistës *Communications* me artikullin hyrës të Roland Bartit, i cili flet për narratologjinë si disiplinë e studimit të teksteve letrare. Megjithatë, fillet e narratologjisë duhet të kërkohen shumë më herët, përkatësisht në dekadat e para të shekullit XX, sidomos

[751] PP, I, (1963): *Proza popullore. Vëllimi i parë.* Instituti i Folklorit. Tiranë. 1963, 133-139.

me paraqitjen e shkollës formaliste ruse (1915-1928). Ndërkaq, si paralajmërues i narratologjisë duhet të merret Propi, autor tanimë i mirënjohur i librit me titull "Morfologjia e përrallës", publikuar për herë të parë në vitin 1928. Ky libër pas publikimit të tij të parë, ishte i harruar një kohë të gjatë, kurse vetëm në vitet '60 – '70, arriti të riaktualizohet dhe popullarizohet, madje duke zënë një vend të rëndësishëm në qarqet letrare-teorike. Ky libër ushtroi një ndikim tejet të madh në përparimin e njohurive teorike, veçmas në fushën e teksteve narrative. Në kontekst të thellimit të njohurive teorike që rezultuan nga Propi duhet gjithashtu të përmenden edhe autorët si Klod Levi-Strosi, Barti, Grejmasi, Todorovi, Kristeva, Amoni etj., që ofruan modele të ndryshme në studimin e teksteve letrare.

Në funksion të përcaktimit të strukturës narrative, Propi në librin e tij të njohur *Morfologjia e përrallës*, pas një analize të detajuar të përrallave ruse, arrin në përfundimin e arsyeshëm se të gjitha përrallat ngërthejnë në brendinë e tyre dy kategori të rëndësishme përbërëse. Ai shton se është e dukshme prania e elementeve *të përhershme* (veprime konstante që përmbushen nga bartës të ndryshëm të këtyre veprimeve) dhe *të ndryshueshme* (protagonistët që pranojnë emra të ndryshëm kur përmbushin veprime të njëjta), ose siç elaboron Propi: "ndryshojnë emrat (njëkohësisht edhe atributet) e protagonistëve, kurse ajo që nuk ndryshon, janë veprimet e tyre, përkatësisht funksionet. Kjo ndikon të konkludohet se në shumicën e rasteve, përralla, veprimet e njëjta, ua përshkruan protagonistëve të ndryshëm. Kjo, po ashtu, mundëson që përrallat të studiohen duke u nisur nga funksionet e protagonistëve. Funksionet e përrallës janë të kufizuara dhe janë tridhjetë e një: *ndarja, tabuja dhe shkelja e tabusë, hetimi i dëmtorit dhe dhënia atij e informatave mbi heroin, intriga dhe bashkëpunimi, dëmtimi (apo mungesa), ndërmjetësia, kundërveprimi fillestar, nisja, funksioni i parë i dhuruesit dhe reaksioni i heroit, marrja e sendit magjik, zhvendosja hapësinore, përleshja, shenjimi (damkimi) i heroit, ngadhënjimi, likuidimi i mungesës, kthimi i heroit, përndjekja dhe shpëtimi, mbërritja e paidentifikuar, pretendimet e heroi të rremë, misioni i vështirë dhe zgjidhja, njohja dhe demaskimi, transfigurimi, ndëshkimi, martesa* (më gjerësisht, Prop, 2004).

Nënkuptohet se një përrallë që të konsiderohet si e tillë nuk është e patjetërsueshme që t'i zotërojë të gjitha funksionet e apostrofuara, apo të ketë një radhitje të ngjashme të tyre.

"Nga analiza e tërësishme e përrallës, që e bëri Propi, shihet se ai pati vështirësi të ndryshme në përcaktimin e elementeve apo njësive konstante. Njëra ndër to ishte se shpeshherë bëhet i vështirë diferencimi i funksioneve, meqë gjatë zhvillimit dhe transformimit historik të përrallës janë bërë *asimilime* të ndryshme të funksioneve"[752] . Si rrjedhojë e këtij fakti, përkatësisht asimilimit, apo mungesës së

[752] Mustafa, Myzafere (2005): *Proza gojore. Teksti dhe konteksti.* Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.

disa funksioneve, Propi më vonë rishqyrton pozicionin e tij teorik, veçmas në pjesën e funksioneve të përrallës. Kështu, në librin e tij të mëvonshëm me titull *Rrënjët historike të përrallës magjike,* të publikuar për herë të parë në vitin 1946 në gjuhën ruse, ai e definon përrallën si konfiguracion të qëndrueshëm, i përbërë prej shtatë elementesh, përkatësisht funksionesh. Pra, përralla fantastike, apo e karakterit magjik mund të zotërojë vetëm shtatë funksione që të konsiderohet si zhanër i mirëfilltë i kësaj natyre. Shtatë funksionet kryesore të përrallës, sipas Propit janë: *shkaktimi i dëmit, ose mungesa, braktisja e shtëpisë nga ana e heroit, takimi me ndihmësin mitik dhe marrja e mjetit mitik, lufta, përkatësisht dueli me kundërshtarin, fitorja, kthimi i heroit në shtëpi, martesa e heroit.* Pra, të gjitha këto funksione, apo fragmente narrative janë pjesë përbërëse e strukturës kompozicionale të përrallës së Mitkos që është në epiqendër të trajtesës sonë shkencore. Si rrjedhojë, përrallën në fjalë do ta shqyrtojmë nga prizmi i këtyre shtatë funksioneve themelore, por njëkohësisht, siç theksuam më lart, ajo do të plotësohej edhe me ndonjë të dhënë nga sfera e ndërlidhjes eventuale të përmbajtjes së saj me ndonjë institucion shoqëror të së kaluarës dhe sidomos me ritin e rishtarisë.

2. Struktura narrative e përrallës

Përralla e karakterit fantastik *Kordha, Ylli dhe Deti*, mbledhur, regjistruar dhe publikuar nga Thimi Mitkoja, përmban në brendinë e saj shtatë funksionet e mësipërme themelore të Propit. Dihet se çdo përrallë, gjithmonë sipas Propit, fillon me *situatë nistore*, por kjo sekuencë rrëfimore nuk mund të ndërlidhet me ndonjë nga shtatë funksionet e numëruara më lart. Kjo situatë nistore i referohet ndonjë gjendjeje statike, apo nxjerr në syprinë pjesëtarët e familjes dhe sidomos prezanton kryeheroin e ardhshëm, nënkuptohet duke përfshirë edhe emrin e tij. Përralla në shqyrtim e paraqet këtë gjendje nistore në këtë mënyrë: *Një burrë pas vdekjes tijë la të shoqen mbarsë, e cila pas gjashtë muajsh lindi një dialë, edhe me gjithë varfëri të sajë e rriti dialin gjersa u bë pesëmbëdhjetë vjeç. Pasi erdhi mbë mënt diali pyeti tëmën se mos kish ndonjë sendë pe të tet, me qënë i kish thën ajo, se ay kish baba. E ëma i u përgjigj, se i jati kish lënë shumë plaçka, po ajo i shiti, që rriti atë gjerë mb'atë mocë. Po ay gjithnjë po e grindëte t'ëmën tuke lypurë ndonjë send, çfarëdo, nga të tet. Edh' ajo i tha mbësëfundi: më bëhet sikur është një kordhë ndë hatullë të shtëpisë ak-se-ku. E diali i tha: ngremë mbë krahë që të arrij, e t'a marr. Pasi morri këtë kordhë diali të palarë që motit, e të ndryshkurë, e lau e e shkëlqeu, edhe e mvari mbë qafë*[753]*.* Nga kjo sekuencë hyrëse, mësojmë menjëherë se kemi të bëjmë me zhanrin e përrallës, pasi ngjarja që do të zhvillohet në vazhdim lokalizohet në një kohë të kaluar, apo të largët. Njëkohësisht, jepet edhe bartësi i subjektit të përrallës, siç është i riu pesëmbëdhjetëvjeçar. Po ashtu, nuk mungon të jepet edhe struktura sociale e bartësit të veprimit, nënkuptohet si zakonisht tejet i varfër, madje i rritur në mjerim pa ndihmesën e babait të vdekur. Fillimi i përrallës pasqyron edhe

[753] Teksti i përrallës jepet në trajtë autentike (origjinale), ashtu siç është regjistruar dhe publikuar nga Thimi Mitko.

konfliktin e kryeheroit me të ëmën, pasi kjo e fundit e lut që të mos e braktis shtëpinë duke pasur drojë për jetën e tij. Megjithatë, djali i saj, apo kryeheroi i përrallës është këmbëngulës, madje edhe kategorik që ta braktis shtëpinë. Kjo dëshirë e tij bëhet e papërmbajtur, sidomos pas gjetjes së kordhës, apo shpatës së babait të ndjerë. Me këtë rast, ai përfiton edhe emrin e tij, si: *Pas këtyre fjalësh ndërroj edh' emërin e tijë, ay e e vuri "kordhë", edhe morri pallën e shkruajti emërin e tijë përsipër.* Kjo situatë nistore që pasqyron të dhënat elementare që i dedikohen kryeheroit të përrallës është e mjaftueshme që më vonë, sidomos me braktisjen e shtëpisë nga ana e kryeheroit, të fillojnë të rrjedhin veprimet, apo funksionet e përrallës të cilat do t'i paraqesim në vazhdim sipas kronologjisë së zhvillimit të ngjarjeve të përrallës.

a) shkaktimi i dëmit, ose mungesa. Pothuajse çdo narracion i përrallës fillon me ndonjë dëm që shkaktohet në fillim, ose si rrjedhojë e ndonjë mungese që ndjen kryeheroi dhe që duhet më vonë të përmbushet. Ndodh në shumë raste që fillimi i përrallës të ndërlidhet me ndonjë urdhër të prerë që të ndalohet ndonjë veprim që u dedikohet fëmijëve, apo kryeheroit të përrallës. Ky urdhër në trajtë të tabusë që diktohet nga ana e prindërve, zakonisht nuk respektohet, apo shkelet tabuja dhe pastaj fillojnë sfidat e protagonistit të përrallës. Në rastin e përrallës sonë në shqyrtim, nuk kemi shkelje të hapur të ndonjë ndalese që diktohet nga ana e prindërve, përkatësisht nga ana e së ëmës, pasi babai i heroit të përrallës tanimë prej një kohe të gjatë ishte i vdekur. Megjithatë, në mënyrë implicite mund të hetohet se njëfarë lloj shkeljeje e tabusë nga ana e kryeheroit ndoshta mund të jetë braktisja e shtëpisë, pasi e ëma e tij nuk pajtohej kurrsesi me një veprim të tillë, madje duke qenë edhe kategorike kundër një veprimi të tillë. Ky moment dramatik në përrallën e Mitkos paraqitet në këtë mënyrë: *E e ëma zu të qanj, e të bubutisnjë, e t'i lutet atijë për të mos ikurë, aqë sa të pastajmen i tha: premë kryet mua me pallën e t'yt-et, pastaj ikë, o bir* [754]. Si zakonisht, edhe në çdo përrallë tjetër, braktisja e shtëpisë nga ana e kryeheroit patjetër të ndodhë pasi ky i fundit ndjen një lloj mungese që ndërlidhet me nevojën e zotërimit të nuses edhe pse kjo nuk thuhet haptazi në përrallë, por në mënyrë implicite edhe mund të nënkuptohet. Në të vërtetë, kryeheroi është pesëmbëdhjetëvjeçar dhe kjo fazë jetësore ndërlidhet me adoleshencën. Duke iu referuar këtij elementi, përkatësisht fazës së adoleshencës dhe martesës që pason më vonë, një numër i caktuar i studiuesve duke përfshirë edhe Propin theksojnë se përralla, sidomos ajo fantastike reflekton realitetin e një ndodhie, siç është rituali i rishtarisë (inicimit) së pubertetit, apo dasmës. Pra, rishtaria e pubertetit dhe dasmës paraqiten si dy rrënjë kryesore nga të cilat buron përmbajtja e përrallës magjike, apo fantastike. Në të vërtetë, përralla fantastike paraqet një variant të ritit të rishtarisë nëpërmjet të cilit ushtroheshin tortura të ndryshme fizike dhe psikike ndaj të rinjve, sidomos në shoqëritë e lashta me qëllim që ata (të rinjtë) të përgatiteshin për të aderuar, apo integruar në fazën e ardhshme

[754] MHFSH *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar. I.* Instituti i Folklorit. Tiranë, 1961, 168.

të burrërisë (më gjerësisht, Prop, 2011)[755]. Ndërkaq, sa i përket hapësirës së veprimit të kryeheroit të përrallës duhet thënë se shtëpia është vendi, apo vatra në të cilën fillon syzheu i përrallës. Shtëpia si pikë fillestare e rrugëtimit të heroit ndërlidhet me fazën parapërgatitore të nisjes së syzheut të përrallës. Njëkohësisht, shtëpia është edhe vendi ku kthehet heroi i përrallës, nënkuptohet si zakonisht me nusen e tij të re. Kthimi në shtëpi nënkupton edhe epilogun, apo përfundimin e përrallës. Si rrjedhojë, shtëpia është vendi i qenieve njerëzore, shenjë e botës njerëzore, madje edhe shenjë e kësaj bote që ndërlidhet me kryeheroin e përrallës, kurse bredhja apo rrugëtimi i heroit si pikë përfundimtare ka "botën tjetër", apo botën e huaj në të cilën vlejnë rregulla tjera të sjelljes dhe veprimit, sidomos nga ana e kryeheroit me qëllim që të jetësohet synimi i tij përfundimtar.

b) braktisja e shtëpisë nga ana e heroit. Duhet theksuar se braktisja e shtëpisë në përrallë nga ana e kryeheroit është shumë e thjeshtë dhe nuk përmban asgjë joshëse, apo interesante. Në përrallën tonë, braktisja, apo marrja e rrugës nga ana e heroit është edhe më e thjeshtë, si: *E pasi i u largua fshatit pes'a gjashtë orë diali arriu ndë një mal, i vetëmi filli*[756] . Pra, në dukje të parë asgjë interesante, pasi përralla anashkalon momentet përcjellëse të rrugëtimit, andaj Kordhën saora e hasim të vetmuar në një pyll të papërcaktuar. Lëvizja në përrallë, si zakonisht asnjëherë nuk pasqyrohet gjerësisht, por çdoherë përshkruhet vetëm me dy-tri fjalë, apo ajo vetëm figuron në kompozicionin e përrallës, pa ndonjë përpunim të caktuar. Së këndejmi mund të vërehet se hapësira në përrallë ka rol të dyfishtë. Nga njëra anë, hapësira ekziston në përrallë dhe është element i patjetërsueshëm i saj, kurse nga ana tjetër sikur ajo nuk ekziston fare. Ngjarjet e përrallës zhvillohen vetëm gjatë stacionimit në një vend të heroit, apo vetëm stacionimet, apo vendqëndrimet e tij përpunohen në mënyrë të detajuar. Duke u ndalur në këtë çështje, Propi me të drejtë theksonte se Odiseu është dukuri më e vonshme sesa përralla. Këtu, rruga dhe hapësira janë përpunuar në mënyrë epike, pasi bredhjet e Odiseut janë përshkruar në mënyrë të detajuar. Së këndejmi, mund të konkludohet se elementet statike, elementet e stacionimit në një vend janë më të lashta sesa kompozicioni që zhvillohet në kuadër të hapësirës. Hapësira, apo përshkrimi i detajuar i saj ka depërtuar në diçka që ka ekzistuar më herët[757] . Pra, epi i Homerit që i referohet Odiseut, sipas Propit, është dukuri më e vonshme se përralla pasi përpunon gjerësisht rrugëtimin e heroit. Ndërkaq, në kuadër të kompozicionit të përrallës anashkalohen lëvizjet e heroit duke u përqendruar vetëm në disa segmente të hapësirës ku ndodh ndonjë veprim i caktuar, si pylli, qyteti, bota tjetër, etj.

Nëse i kthehemi kompozicionit të përrallës sonë do të shohim se veprimi tjetër i kryeheroit tonë ndërlidhet me qëndrimin e tij në pyll si vendqëndrim i tij i parë pas

[755] Проп, Владимир (2011): *Историски корени на волшебната приказна.* Македонска реч. Скопје.
[756] MHFSH *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar. I.* Instituti i Folklorit. Tiranë, 1961, 168.
[757] Проп, Владимир (2011): *Историски корени на волшебната приказна.* Македонска реч. Скопје.

braktisjes së shtëpisë. Në këtë vend është i rëndësishëm takimi i tij me ndihmësit mitikë me ç'rast hapet rruga e një funksioni tjetër të rëndësishëm të syzheut të përrallës sonë. *c) takimi me ndihmësit mitikë dhe marrja e mjetit mitik.* Takimi i heroit të përrallës me ndihmësit mitikë është shumë i rëndësishëm dhe shënon kthesë të rëndësishme në zhvillimin e veprimit të përrallës fantastike. Në kuadër të përrallës sonë, ky takim i kryheroit ndodh në pyll dhe në këtë mënyrë: *E pasi i u largua fshatit pes'a gjashtë orë diali arriu ndë një mal, i vetëmi filli, edhe ndenji mbë një shesh, e nxorri kordhën e e puthi edhe e lëshoi ndë prëhert. Nukë shkoi gjymës' ore edh'i erthi një dialë mbë mocë të tijë, e i tha: Mirë dita o mik – Edhe ky i u përgjeq: Mirë s'erdhe o vëlla. – E pyet ay këtë: Ngaha vien, e ku vete? – Ky i tha: Kam dalë për kësmet. – Edh'unë kështu i thot' ay, edhe ndë do, haj të bëhemi vëllezërë, e të vemi për kësmet mbë-një. Ky i shtiu duart mbë qafë, e e puthi, e pyeti edhe për emërin, ç'e quanin, ay i tha, se, quhet "yll" i rrëfeu edhe ky të tij në "kordhë".* Në dukje të parë asgjë e jashtëzakonshme, pasi narratori i përrallës, nuk zbulon vetitë mitike të bashkudhëtarit të Kordhës, përkatësisht Yllit, por më tutje do të vërejmë se ky protagonist zotëron vetitë e yllit të hapësirës qiellore, apo kozmike. Të dy miqtë, apo protagonistët e përrallës vazhdojnë rrugëtimin: *U nisën pra këta të dy, e muarrën udhën drejtë gjersa i zuri nata. Ndejtin atje mbë një vend, e pasi folën pak, ranë të flenë pa ngrën'e pa pirë.* Me siguri se areali i pyllit, por edhe sfidat të cilat privojnë të rinjtë nga ngrënia dhe pija paraqesin relike që kanë të bëjnë me ritet e rishtarisë. Rruga e mëtejme tanimë e dy protagonistëve të përrallës, përkatësisht Kordhës dhe Yllit i çon ata drejt takimit edhe me ndihmësin tjetër mitik, përkatësisht Detin i cili po ashtu zotëron vetitë e kontrollit, apo zotërimit të ujit, përkatësisht detit si areal i rëndësishëm i hapësirës së planetit tonë. Edhe ky protagonist i fundit u bashkëngjitet dy të parëve dhe vazhdon rrugën me ta drejt jetësimit të synimit të tyre.

Nga kjo sekuencë rrëfimore mund të vërehet se kryeheroi i përrallës sonë, apo Kordha vetëm takohet me ndihmësit mitikë, por nuk përfiton ndonjë objekt magjik nga ata. Kordha vetëm posedonte paraprakisht mjetin, apo objektin e tij magjik, përkatësisht kordhën që e trashëgon nga babai i vet i ndjerë. E përcaktojmë si mjet magjik shpatën, apo kordhën me emrin e të cilit identifikohet edhe heroi i përrallës sonë, pasi ajo (shpata) zotëron cilësi të jashtëzakonshme. Nga kompozicioni i ardhshëm i përrallës do të vërejmë se kordha do të jetë një mjet tejet i nevojshëm magjik për jetësimin e synimit të kryeprotagonistit të përrallës sonë. Megjithatë, ky mjet mitik, pra shpata nuk është e mjaftueshme që kryeheroi të jetësojë synimin e tij përfundimtar, pasi do të ketë nevojë edhe për ndihmësit mitikë, përkatësisht dy miqtë e tij – Yllin dhe Detin.

ç) lufta, përkatësisht dueli me kundërshtarin, si dhe *fitorja.* Në vazhdim këto dy funksione, apo veprime të përrallës në fjalë i paraqesim të përbashkuara midis tyre duke pasur parasysh faktin se ato ndërlidhen njëra me tjetrën, pasi çdo luftë e heroit me antagonistët e tij si zakonisht sjell edhe fitore, kurse kjo e fundit nuk paraqet ndonjë veprim që shtjellohet në mënyrë të veçantë

nga ana e narratorit të përrallës sonë. Përralla në shqyrtim e Thimi Mitkos paraqet një amalgamë të llojit të vet, sidomos në raport me ndihmësit mitikë, pasi edhe ata arrijnë të kurorëzojnë synimet e tyre në kundërshtim me kompozicionin e rëndomtë të përrallave tjera në të cilat vetëm kryeheroi përmbush synimin e tij përfundimtar, përkatësisht martesën e tij. Kështu, në përrallën e Thimi Mitkos edhe njëri ndihmës mitik i kryeprotagonistit arrin të martohet me të bijën e mbretit, nënkuptohet si pasojë e marrëveshjes mes tre miqve, apo protagonistëve të saj. Si rrjedhojë e një logjike të tillë do të vërejmë se sfidat e heronjve janë të ndryshme. Rrugëtimi i heronjve të përrallës në fjalë do t'i nxjerrë ata në një qytet. *Kështu pra muarrën udhën të tre, e tuke ecurë vatën përanë njëji qyteti, teku kishte edhe mbëret, i cili ato dit' kishte çarë një hendek të gjerë, edhe kish leçiturë e përhapur fjalë që, ay që të kapërxenjë këtë hendek, do të marrë çupën e mbëretit për grua, e atijë që të mos e kapërxenjë do t'i pritet kryet.* Pra, kjo sfidë nuk nënkuptonte ndonjë duel luftarak, por kryerjen e një detyre të vështirë. Kësaj sfide do t'i përgjigjen së bashku të tre protagonistët e përrallës sonë - Kordha, Ylli dhe Deti. Ata, në mënyrë paralele do të kapërcejnë hendekun, nënkuptohet në saj të zotërimit të aftësive të tyre mitike, sidomos të ndihmësve mitikë. Megjithatë, e bija e mbretit sipas sugjerimit të Kordhës do t'i takojë Yllit. Pas dasmës së Yllit, Kordha ndahet nga ndihmësit mitikë, por atyre u jep nga një pendë e cila po qe se do të pikonte gjak, kjo do të ishte shenjë se ndihmësit mitikë do të duhej t'i vinin në ndihmë, pasi ai do të ishte në rrezik. Kordha në cilësinë e kryeheroit, pas ndarjes me ndihmësit mitikë, vazhdon rrugëtimin e mëtejmë, si vijon: *Tuke ecur ky tani tri, katërë diç udhë i vetëmi, arriu ndë një vënd, që ndaheshin shtatë udhë. Atje ishte një kullë tek rrinte një plakë*[758] . Pra, mund të vërehet se kulla e plakës është e vendosur në udhëkryq ku ndaheshin shtatë rrugë. Udhëkryqi paraqet vend të kalimit nga njëra botë, apo nga kjo botë në botën tjetër, nga njëra jetë në jetën tjetër, apo nga jeta në vdekje. Në mitologjinë greke një hyjneshë e padefinuar, me prejardhje jo të sigurtë dhe njëherit e fushëveprimit të pakufizuar e cila mishërohet me Arthemidën, Dhemetrën, Apolonin, ose edhe me ndonjë hyjni dhe hyjneshë tjetër, ishte Hekata që cilësohej si *hyjneshë e udhëkryqeve*. Këtë emër *funksional*, ajo e kishte përfituar duke qenë sunduese, apo zotëruese e tri botëve: asaj qiellore, tokësore dhe nëntokësore[759]. Në përrallën tonë, këtë e konstaton edhe Propi, plaka njëjtësohet me rolin e shtrigës[760] . Shtriga paraqitet si ruajtëse e hyrjes në botën tjetër, kurse njëkohësisht edhe si qenie e ndërlidhur me botën e kafshëve, përkatësisht me botën e të vdekurve. Ajo e veneron heroin si qenie të gjallë dhe nuk dëshiron ta lëshojë të shkojë në botën tjetër, andaj ia tërheq paraprakisht vërejtjen me fjalët si vijon: *Mos, o bir, hump*

[758] MHFSH *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar. I.* Instituti i Folklorit. Tiranë, 1961, 171

[759] Chevalier, J., Gheerbrant, A (1983): *Rječnik simbola.* Nakladni Zavod MH. Zagreb., 550-552

[760] Проп, Владимир (2011): *Историски корени на волшебната приказна.* Македонска реч. Скопје.

kryet tat, e djalërinë tënde mbë kot, për se mb'atë udhë kanë shkuarë mëretëra me ushtri të forta, edhe s'kanë vaturë dot atje, tek kërkon të vesh ti, një fill i vetëmi.[761]

Megjithëkëtë, heroi i përrallës (Kordha) e merr rrugën drejt të Bukurës së Dheut. Ai në këtë rrugë ndeshet me kuçedrën, apo me kryekundërshtarin e tij. Ky dyluftim (duel) në përrallë jepet në këtë mënyrë: *Vajti pak më tej, e gjeti kuçedrën me gjashtë këlyshëza mb'udhë, e cila i u derth t'a hajë, po ay xveshi kordhën edhe e preu me gjithë këlyshëret. Tuke prijturë më tej, i u duk atij pallasi i së bukurës dheu.* Heroi e mposht kuçedrën dhe tani niset kah pallati në të cilin jetonte e Bukura e Dheut. Ajo së bashku me kuçedrën tjetër që e ruante në pallat shikojnë nga dritarja arritjen e kryeheroit. Ky i fundit, në kroin pranë pallatit nuk pi ujë me dorë, por bie mbi gjunjë dhe pi ujë me gojë. Njëkohësisht, në pemën me mollë nuk e kap mollën me dorë, por e pret me dhëmbë. Këto dy sjellje jo të zakonshme e bëjnë kuçedrën që të frikësohet dhe të pranojë humbjen para kohe të dyluftimit me heroin. Ashtu edhe ndodh, pasi heroi me kordhën e tij magjike e copëton kuçedrën në dy pjesë dhe e zapton të Bukurën e Dheut. Edhe me këtë rast mposhtja e kuçedrës është shumë e thjeshtë, si: *Kulçedra u ndes nga zemërimi edhe po shukonte t'i hidheshe Kordhës. Po ky ariu e veshi kordhën ndë çast, edhe ia hoqi asajë, e e bëri dy gjymësa.* Në funksion të këtij dyluftimi, të gjithë konsumuesit e përmbajtjes së përrallës presin që lufta si pikë kulminante e përrallës, të përshkruhet më gjerësisht, madje edhe me ëndje, me të gjitha detajet nëpërmjet të cilave do të dilte në shesh fuqia titanike e heroit të përrallës. Megjithatë, ky horizont i pritjes nuk është tipik për stilin e përrallës. Në kundërshtim me eposin heroik të shumë popujve të lashtë, ku lufta, apo dueli luftarak zë vendin qendror dhe ndonjëherë përshkruhet edhe me të dhëna të hollësishme, përralla është shumë e thjeshtë dhe tejet e shkurtër. Dyluftimi i heroit me antagonistin e tij nuk përshkruhet në mënyrë detajuese, por vetëm nëpërmjet disa fjalëve tejet të kursyera.

"Në rrafshin sintagmatik, në përrallë kuçedra është njëra ndër pengesat kryesore që duhet ta kalojë heroi për ta vazhduar veprimin dhe aventurat deri në sendërtimin e qëllimit dhe të fillimit të jetës së lumtur. Në kalimin e kësaj pengese, që paraqet ballafaqimin me një krijesë të fuqishme ku në të shumtën e rasteve ajo është sinonim i një rreziku permanent, heroi i përrallës dëshmon aftësinë dhe pjekurinë emocionale dhe fizike për ndeshjen me probleme qofshin ato të botës së tij të brendshme, qofshin ato të botës së jashtme që në shumë aspekte ndryshon nga bota e tij e deriatëhershme. Hyrja në rreziqe dhe tejkalimi i tyre është një lloj inicimi për heroin e përrallës dhe dëshmi për kalimin e tij në fazën e pjekurisë e të pavarësimit emocional dhe fizik"[762]

Nga ana tjetër, ekzistimi paralel dhe polarizimi i protagonistëve të përrallës sipas kundërvënies mirë/keq (ata çdo herë janë ose të mirë, ose të këqinj) menjëherë e veçon këtë zhanër nga zhanret e tjera të prozës, ku një ndarje e këtillë

[761] MHFSH, 1961. Vep. e cit., 170.
[762] M.Mustafa, vep. e cit.2003, 146

e rreptë nuk ekziston. Ndryshe, "lufta e së mirës ndaj së keqes pasqyrohet njëkohësisht edhe në përpjekjet për nënshtrimin e forcave të errëta të natyrës. Që këtej buron fakti se luftën midis së mirës e së keqes në përrallat fantastike e ndeshim në këto forma: së pari, në përpjekjet për nënshtrimin e natyrës; së dyti, në përpjekjet për ndryshimin e raporteve shoqërore; së treti, në qëllimin për të arritur në majat e një lumturie familjare e vetjake"[763]

Edhe përkundër zaptimit të së Bukurës së Dheut nga ana e heroit edhe më tutje fitorja nuk është definitive, pasi objektin e njëjtë (të Bukurën e Dheut) e synojnë edhe të tjerë. Një gjë e tillë prodhon konfliktin, në rastin tonë konkret me mbretërit të cilët posa kuptojnë se një djalë gjashtëmbëdhjetëvjeçar ka zaptuar të Bukurën e Dheut në pallatin e saj vërsulen që t'ia marrin atë. Djali reziston afër njëzet e katër ditë dhe më në fund mbretërit të mposhtur kthehen te plaka (shtriga) për të kërkuar ndihmën e saj. Kjo e fundit u premton një gjë të tillë. Ajo shkon e viziton të Bukurën e Dheut në pallatin e saj dhe kërkon të mësojë se ku fshihet fuqia e bashkëshortit të saj (Kordhës). E Bukura e Dheut e pyet Kordhën t'ia tregojë misterin e fuqisë së tij: *E ay i gjori, nga dashuria, që kish mbë të i rrëfeu tuke thënë se, gjithë trimëria e tijë ishte kordha e tijë, e se, po t'i merrte kush kordhën, ishte fare i bjerrë, e i humburë. Ashtu pra plaka ndë krye pak diç ia gjeti volinë dialit, ia mvodhi kordhën, edhe ia hodhi ndë det. Posa ia hodhën kordhën ndë det Kordhës që mb'atë çast ay ra ndë lëngim, e u bë për vdekje.* Nga aspekti i kompozicionit të përrallës, shkaktimi i tillë i dëmit paraqet bazë solide për aktivizimin (dinamikën) e veprimeve tjera dhe është në ndërlidhje të ngushtë me atë që Aristoteli e definon si shthurje. Një zhvillim i tillë i ngjarjeve është parakusht qenësor për hapjen e një rrjedhe të re narrative, si dhe gjenerimit të një varg elementesh që do të orientohen kah mbajtja e pasigurisë së kompozicionit të përrallës, apo protagonistëve të saj.

Një gjendje e tillë e volitshme, përkatësisht privimi nga mjeti mitik i kryeprotagonistit, gjithnjë sipas përmbajtjes së përrallës, e detyron plakën (shtrigën) t'u tregoj mbretërve që të nisen për në pallat dhe ta marrin pa luftë të Bukurën e Dheut. Në ndërkohë, në këtë gjendje dramatike dalin në skenë ndihmësit mitikë. Atyre fillon t'u pikoj penda gjak duke sinjalizuar se Kordha ndodhet në rrezik. Me këtë rast: *Ylli morri Detin mbë krahë edhe sa kaqëherë ia arritën Kordhës më parë shumë se mbretërat, e me të vaturit pyetën të bukurën e dheut: Ku e ka kordhën vëllai i ynë? – Ajo u tha se, ia muarën, edhe ia flakën ndë det. Përandaj u ngre Deti ndë ças, hyri ndë det, edhe e gjeti kordhën, e ia suall të vëllait i cili, posa i erth kordha, sa të fshishë sytë, u tha atyre: Oji! ç'paskam fjeturë shumë; po kur pa të vëllezërit përanë, pikasi që e kish gjetur e keqeja.* Në ndërkohë, Kordha zgjohet nga gjumi dhe kur arrijnë mbretërit në pallat i mposht shumë lehtë ata në luftën e fundit, përkatësisht fitoren e fundit për ta nxjerr të Bukurën e Dheut nga pallati i saj. Pas kësaj fitoreje, Kordha së bashku me ndihmësit mitikë dhe njëkohësisht me të Bukurën e Dheut marrin rrugën të kthehen në shtëpi te e ëma e tij.

[763] Xhagolli, Agron. *Klasifikimi i prozës popullore shqiptare.* Dudaj. Tiranë, 2001, 101.

d) kthimi i heroit në shtëpi. Kthimi si zakonisht realizohet në mënyrë të njëjtë sikur dhe mbërritja te e Bukura e Dheut. Megjithatë, të fiksosh këtu menjëherë pas kthimit një funksion të veçantë, thekson Propi, nuk është e domosdoshme, pasi kthimi tashmë do të thotë kapërcim i hapësirës[764] . Duke ndjekur një logjikë të tillë, ndalesa e parë e kthimit të tyre është vendi (udhëkryqi ku jetonte plaka, apo shtriga). Kordha në vend që ta ndëshkojë për të keqen që ia kishte bërë e shpërblen atë duke e porositur që t'u tregonte mbretërve se shkonte në vendin e tij dhe i priste atje sërish ata. Ndërkaq, ndalesa e dytë, ishte pallati i mbretit, përkatësisht i babait të bashkëshortes së Yllit. Mbreti kërkon që dhëndri të mbetet aty me nusen që të mos shkonte në shtëpinë e tij, madje edhe duke u kanosur me dhunë. Megjithatë, kjo nuk ndodh, pasi largimi i tyre është i karakterit mitik, apo si vijon: *E Ylli u ngrit, e qëndroi ndë mes të hodës, e i thotë mbëretit: "Të falem, o im vjehërrë, e mbeç me shëndet", edh' u hoth ndëpër penxheret me gjithë të shoqen, edhe Detin, edhe duallnë të tre, e Kordha mbeti i vetëm.* Kordha mbetet me të Bukurën e Dheut, por do ta çajë rrugën me shpatën e tij duke i mbytur nëpunësit e mbretit. Ky i fundit urdhëron ushtarët që t'u vihen prapa dhe t'i kapin e vrasin. Kordha i porosit ushtarët që të kthehen prapa, pasi nuk donte që t'i mbyste, por ata ishin këmbëngulës në qëllimin e tyre: *Atëherë Kordha pa, ç'pa, u tha të vëllezërve: Merri gratë ju, edhe shkoni përpara. E ay i vetëm, veshi pallën e tijë, e u derth mbi ata, e preu shtatëqind veta prej syresh, edhe të parin e tyre bashkë.* Tani Kordha, bashkë me ndihmësit mitikë marrin rrugën për në shtëpi. Ndërkaq, sa i përket konfliktit mes dhëndrit dhe babait të nuses së tij, përkatësisht mbretit, Propi duke e cituar antropologun e njohur Xhejms Frejzer thekson se kjo sekuencë ka bazë historike, pasi në të kaluarën e largët në disa fise arkaike ekzistonte besimi, apo riti që nënkuptonte tërheqjen, apo mbytjen e mbretit në moshën e pleqërisë, pasi besohej se dobësohej fuqia e tij magjike, andaj në mënyrë analoge besohej se dobësohej edhe fuqia e tij magjike në ndjelljen e mirëqenies së bashkësisë njerëzore. Koha e mbytjes së mbretit përkonte me kohën e martesës të vajzës së tij, andaj dhëndri ishte ai që do ta zëvendësonte atë, apo do ta ripërtërinte fuqinë magjike. Përralla ka ruajtur në brendinë e saj një konflikt të kësaj natyre[765]

dh) martesa e heroit. Heroi martohet më në fund duke u kthyer në shtëpi te nëna e tij. Lidhur me këtë funksion, Propi numëron gjashtë variante të tij: a) Nusja dhe mbretëria i jepen ose menjëherë, ose heroi përfiton së pari gjysmën e mbretërisë, kurse pas vdekjes së prindërve edhe tërë mbretërinë; b) Ndonjëherë heroi vetëm martohet, por nusja e tij nuk është bijë mbreti dha ai nuk e merr fronin mbretëror; c) Ndonjëherë, anasjelltas, bëhet fjalë vetëm për marrje të fronit; ç) Nëse përralla shkurtimisht para kurorëzimit ndërpritet me shkaktimin e ri të dëmit, rrjedha e parë e veprimit, përfundon me fejesë, premtimin e martesës; d) Rast i

[764] Propp, Vladimir. *Morfologjia e përrallës.* Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit & Aleph. Tiranë, 2004, 61.

[765] Проп, Владимир (2011): *Историски корени на волшебната приказна.* Македонска реч. Скопје

kundërt: heroi i martuar e humb nusen e vet; si rezultat i përndjekjes, martesa mëkëmbet; e) Ndonjëherë, heroi në vend të bijës së mbretit, merr një shpërblim në të holla, ose ndonjë kompensim tjetër.

Ndërkaq, fundi i përmbajtjs së përrallës sonë nuk mund të inkuadrohet në gjashtë skemat, apo variantet e sipërpërmendura. Në të vërtetë, sipas përrallës në fjalë, Kordha kthehet në shtëpi me dy ndihmësit mitikë, Detin dhe Yllin. Ndonëse janë tre, vetëm dy prej tyre posedojnë bashkëshortet e tyre, andaj Kordha propozon që Detit (të mbetur pa nuse) t'i takoj mbretëria: *Tynë do të të bëjmë mbëret mbi gjithë vëndin tënë. Edhe e bënë mbëret, e mbretëroi gjithë jetën e tijë. Edhe sa rrojtin ata që të tre, ishin tërë jetën vëllezër të dashurë.* Pra, kjo përrallë përfundon, ndoshta me një skemë, apo variant paksa tjetër krahasuar me ato të Propit, pasi kryeheroi ia jep mbretërinë ndihmësit mitik në shenjë të një kundërshpërblimi për shkak se nuk zotëronte bashkëshorten e këtij të fundit. Pra, përralla, në shumicën e rasteve, vlerat e veta themelore i ndërton në bazë të parimeve të njohura ideologjike-idealiste dhe morale-didaktike, sipas të cilave e mira shpërblehet dhe çdoherë ngadhënjen në fund, kurse e liga ndëshkohet dhe përjeton disfatë.

3. Përfundim

Nga e gjithë kjo që u theksua më lart mund të konkludohet se përralla në fjalë ka një strukturë të ngjeshur, apo komplekse, madje kompozicioni i saj është tejet specifik, pasi ndihmësit mitikë që vihen në shërbim të kryeheroit (Kordhës), ndajnë trofetë, apo *objektet* (term i Grejmasit) e synuara. Përderisa kryeheroi i saj, Kordha merr të Bukurën e Dheut, nga ana tjetër, edhe ndihmësit mitikë, si Ylli dhe Deti po ashtu jetësojnë dëshirat e tyre. I pari, Ylli, merr të bijën e mbretit në cilësinë e bashkëshortes, kurse tjetri, apo Deti përfiton të drejtën e trashëgimisë së mbretërisë. Ndarja e këtillë, do të kishim thënë e barabartë e këtyre objekteve e bën këtë përrallë të jetë e veçantë, madje edhe të dalë jashtë skemës së funksionit të fundit të Propit, të përkufizuar si *dasma* në të cilin si zakonisht kryeheroi nëse merr të bijën e mbretit, sipas një rregulli të pashkruar, trashëgon edhe mbretërinë e tij. Përralla e publikuar nga Thimi Mitkoja vë në spikamë solidaritetin e ndërsjellë midis kryeheroit dhe ndihmësve mitikë. Në përrallë janë të pranishëm pothuajse të gjitha llojet e protagonistëve, përveç dhuruesit të objektit mitik, pasi Kordha qysh në fillim të përrallës e trashëgon objektin e tij mitik (shpatën, apo kordhën) nga babai i tij i ndjerë. Si rrjedhojë, eliminohet nevoja e paraqitjes së mëvonshme të dhuruesit të objektit mitik. Njëkohësisht mungon edhe rrethi i veprimeve të heroit të rremë me të gjitha veprimet e tij, por nga ana tjetër rrethi i antagonistëve të kryeheroit është tejet i gjerë duke filluar nga qeniet mitike, si kuçedrat, por edhe qeniet njerëzore, përkatësisht mbreti, apo mbretërit që gjithsesi se mposhten shumë lehtë nga shpata, apo kordha magjike e Kordhës. Specifiteti i përrallës së Mitkos qëndron edhe në ndërlidhjen mes emrave të protagonistëve si qenie antropomorfe dhe objekteve që ata shënojnë, kryesisht me prapavijë hyjnore. Kordha ka shpatën (kordhën) e tij mitike, kurse Ylli zotëron vetinë e fluturimit, apo përvetësimin e

shpejtë të hapësirës fizike, ashtu siç është e shpejtë edhe lëvizja e yjeve në sfondin qiellor, apo kozmik. Një besëtytni e kësaj natyre edhe sot është e pranishme te masat e gjera popullore e cila flet për ndërlidhjen e yjeve me jetën e njerëzve. Në të vërtetë, çdo njeri ka yllin e vet në qiell, andaj kur shuhet jeta e tij, po ashtu shuhet edhe ylli i tij duke rënë në tokë. Edhe Deti, si protagonist i përrallës po ashtu ndërlidhet me kontrollin, apo sundimin e hapësirës ujore duke përfituar atributet e njëjta, si të Poseidonit. Kjo flet se përralla në strukturën e saj narrative ngërthen trajta të lashta të besimeve me prapavijë kryesisht mitike. Përralla në fjalë i përket tipit të përrallave në të cilat si kryprotagonistë të tyre janë heronjtë në cilësinë e kërkuesit të objektit të tyre e jo heronjtë në cilësinë e viktimës. Përralla si e tillë, kryeprotagonistin e saj e vë përballë sfidave të karakterit heroik. Si rrjedhojë, narratori popullor e modelon përrallën fantastike sipas parimit të amalgamës së rishtarisë adoleshente dhe njëkohësisht të asaj heroike. Në frymën e këtij konstatimi, fundi i përrallës këmbëngul në betejat që i zhvillon kryeprotagonisti i saj me ushtritë e mbretërve, por edhe me kuçedrën. Bartësi i veprimeve të përrallës nëpërmjet betejave dhe fitoreve, si dhe tejkalimit të sfidave të ndryshme, ndonjëherë edhe të njëpasnjëshme identifikohet me heroin. Me aderimin e heroit, apo protagonistit të përrallës në martesë përmbushet edhe shkalla e fundit e kierarkisë komplekse të rishtarisë: avancimi në një shkallë më të lartë të ekzistencës shoqërore, përkatësisht në atë të burrërisë.

JONELA SPAHO (KORÇË)

KËNGËT E DASMËS DHE RITUALI I TYRE TE"BLETA SHQIPTARE" E TH.MITKOS

Thimi Mitkoja me veprën e tij "Bleta Shqiptare", botuar në Aleksandri të Egjiptit, në vitin 1878, bëhet themeluesi i folkloristikës shqiptare, jo vetëm për lëndën e pasur, me vlerë të lartë artistike, me shumë rëndësi për evidentimin e kulturës kombëtare, por edhe përpjekjen e dallueshme që bëri ai për të zbatuar parimet e shkencës folkloristike në strukturimin e vëllimit. Para Mitkos edhe autorë të tjerë, kryesisht arbëreshë, kishin botuar veprat e tyre folkloristike, por siç thekson dhe R.Qosja, prapsëprapë "Bëleta Shqypëtare" është permbledhja më e mirë e letërsisë popullore shqipe si në pikëpamje të kohës dhe të hapësirës në të cilën është krijuar, ashtu dhe në pikëpamje të vlerës me të cilën është krijuar kjo letërsi. Për më tepër mund të thuhet se kjo përmbledhje do të jetë gjatë dhe madje edhe në shekullin tonë njëra prej përmbledhjeve më të bukura të letërsisë popullore shqipe, gati një antologji e kësaj letërsie"[766]

Ky pohim na bën të ndalemi veçanërisht te aftësia përzgjedhëse e Mitkos midis gjithë atij materiali të gjerë folklorik që mblodhi, për të na dhënë këtë përmbledhje, e cila jo vetëm i rezistoi kohës, por merret shpesh dhe si pikë referimi. "Mitkoja u fut në fusha të ndryshme të folklorit, në krijimet poetike të botës së të vegjëlve, në atë të djemve dhe vajzave, të burrave dhe të grave, duke kërkuar dhe mbledhur me kujdes çdo gjë që tërhiqte vëmendjen, si dëshmi e një trashëgimie të vyer kulturore dhe artistike të krijuar gjatë zhvillimit historiko-social të popullit tonë, në sfondin e luftrave të paprera për mbrojtjen e vendit dhe të lirisë, apo në rrethanat intime të jetës familjare, në atmosferën e gëzueshme të lindjes, fejesës e martesës"[767].

Aftësia përzgjedhëse e Mitkos duket veçanërisht te këngët e dasmës. Janë rreth 84 këngë të tilla, të cilat paraqesin aspekte të ndryshme të ceremonialit të dasmës, si dhe aspekte të ndryshme rituale që shoqërojnë këtë ceremonial. Këto këngë janë interesante, gjithashtu, edhe për sa i përket aspektit artistik, vlerës ideo-estetike, ritualeve pagane si dëshmi e një trashëgimie të lashtë kulturore, emocionalitetit dhe figurës artistike. Ceremoniali i dasmës është një pasqyrim i rëndësishëm kulturor i ndjenjave dhe mendimeve të popullit tonë, ndaj paraqet një interes të shumfishtë studimi jo vetëm për folkloristët por dhe për etnologët, etnografët, sociologët, antropologët etj. "Dasma në kohë të ndryshme është kthyer në një proces të tërë zakonesh dhe këngësh, të cilat përfaqësojnë mendime dhe formacione të ndryshme historiko-shoqërore dhe etnografike, por me gjithë copëtimin fedudal dhe ndryshimet fetare mjaft nga këto janë të përbashkëta në gjirin e popullit tonë"[768].

[766] R.Qosja, Historia e letërsisë shqiptare, Romantizmi II, Tiranë, 2000, f.285
[767] Th.Mitko, Vepra, parathënia Q. Haxhihasani,Tiranë, 1981, f.44.
[768] Z.Sako, Studime për folklorin,Tiranë,1984, f. 150.

Këngët e dasmës janë një pasuri e madhe e lirikës sonë, në të cilat subjektivizohen ndjenjat, dëshirat si dhe konceptet popullore për familjen dhe jetën. Padyshim, përpjekjet e para për klasifikimin e ciklit të këngëve të dasmës janë shumë të rëndësishme dhe lidhen me emrin e Thimi Mitkos. Mitkoja ishte i ndërgjegjshëm për detyrën që kishte marrë përsipër, prandaj që në krye të parathënies së "Bletës Shqiptare" ai shkruan se qëllimi i veprës është përgjithësisht të vërë në dukje origjinën, karakterin dhe zakonet e racës shqiptare. Pra, Mitkoja lë të kuptohet se nuk është vetëm lëvizja romantike me interesin e saj për evidentimin e vlerave artistike kulturore të popullit, por vetëdijësimi i shqiptarëve lidhur me çështje të identitetit të tyre historiko- kulturor dhe social.

E theksuam më sipër se Th.Mitkoja, ndryshe nga paraardhësit e tij në këtë fushë ka një vetëdije më të qartë të folkloristit, gjë që duket në renditjen e materialit, besnikërinë ndaj origjinalit, të dhënat sqaruese që jep për disa këngë,etj. Në ciklin e këngëve të dasmës Mitkoja është përpjekur të paraqesë aspekte të rëndësishme të ceremonialit si dhe ritet e lashta pagane që e shoqërojnë dasmën, pa pasur ndoshta një pretendim për një renditje sinkronike të këtij rituali nga e hëna kur fillon dasma deri të hënën tjetër kur ajo mbaron. Gjithashtu, vërehet se në këtë cikël jo të gjitha mund të jenë këngë të mirëfillta dasmash dhe cikli ka mungesa përsa i përket ritualit. Rituali i dasmës ruan një karakter të lashtë pagan, i cili në një mënyrë ose një tjetër është transmetuar nga një brez tek tjetri ndër shekuj, duke përfaqësuar mendimin dhe vlerat tona shpirtërore si komb. "Ritet e dasmës i referohen një kohe të stërlashtë në të cilën jeta shpirtërore dhe ajo materiale nuk ndaheshin në mënyrë të prerë. Nëpërmjet riteve paraqiteshin marrëdhëniet sociale e farefisnore, duke lidhur fenomenet natyrore me ngjarjet e jetës së përditshme. Ngarkesa mitologjike e riteve e shtyn veprimin e praktikimin e tyre në kohërat kur njeriu nuk bënte dallimin midis natyrës dhe kulturës, imagjinatës dhe realitetit, kur njeriu besonte në realitetin e mitit; kur përfshirja e tij në kozmosin mitik ishte gjëja më e natyrshme për të, ashtu si dhe përfshirja në fisin e tij, në bashkësi, në natyrë."[769]

Është vështirë të përcaktohet në mënyrë të saktë nisja dhe praktikimi i këtyre riteve, por fakti që ato kanë arritur deri në ditët tona, qoftë dhe të cunguara, tregojnë përpjekjen e popullit për t'i kultivuar ato nga njëri brez tek tjetri. Th.Mitkoja, padyshim, në mbledhjen, grupimin dhe botimin e këtyre këngëve u nis nga një përvojë e pakët ekzisutese sepse, siç pohuam dhe më sipër, para tij përpjekje për mbledhjen dhe klasifikimin e këngëve të dasmës jasnë bërë nga arbëreshët; Dorsa, Kamarda, De Rada, Skiroi etj, por, përsa i përket cilësisë dhe sasisë së materialit të mbledhur, përzgjedhjes së këtyre këngëve, pajisjes së tyre me shënime, shpjegime të ritit etj, cikli i këngëve të dasmës tek Th.Mitkoja është më i bukuri dhe më i sakti dhe në pikëpamje shkencore. E theksuam se qëllimi i Mitkos ishte të evidentonte këtë visar të pasur kombëtar, veçanërisht në një moment tepër të vështirë në cilin gjendej Shqipëria e pushtuar dhe ky ka qenë qëllimi kryesor i tij.

[769] A. Uçi, Mitologjia, folklori, letërsia, Tiranë, 1987, f. 27.

Përsa i përket zbatimit të shkencës folkloristike në mbledhjen dhe botimin e këtyre këngëve, kjo merr një rëndësi të dorës së dytë dhe të krijohet përshtypja se qëllimi i shkencëtarit autodidakt i nënshtrohet qëllimit të parë. Natyrisht, Mitkoja kishte përgatitur botimin e veprës së vet në një klimë të përshtatshme siç ishte ajo e lëvizjes romantike (lidhur me interesin e kësaj lëvizje për mbledhjen dhe botimin e folklori) dhe ka pasur një truall në të cilin është mbështetur përpjekja e tij prej folkloristi si dhe pretendimet shkencore të këtij botimi.

Cikli i këngëve të dasmës te "Bleta shqiptare" titullohet "Kënga shqype dasmërore" dhe përbëhet prej këngësh, të cilat kapin aspekte ndryshme të ceremonialit të dasmës, aspektin ritual dhe një pjesë e mirë e tyre gjendjen emocionale të personazheve kryesorë të këtij ceremoniali; nuses dhe dhëndërit dhe në ndonjë rast dhe të prindërve respektivë.

Pjesa më e madhe e këtij cikli këngësh rezulton që të jetë mbledhur në zonën e Korçës. Këto këngë nga aspekti ritual dhe nga elementi artistik, estetik dhe emocional, përfaqësojnë një arketip i cili gjendet gati në gjithë jugun e Shqipërisë. Rezulton në këtë cikël vetëm i këngë shkodrane dasme, ndërsa pjesa tjetër i takon këngës së dasmës që këndohet në jug të vendit, gjë të cilën përpos gjuhës dhe fjalëve dialektore e tregojnë dhe aspektet që përmendëm më sipër.

Këngët e dasmës te"Bleta Shqiptare"pasqyrojnë momentet më të rëndësishme të kësaj ceremonie. "Ceremonia e dasmës ka një skemë të përbashkët në të gjithë shqiptarët dhe përbëhet nga disa faza: faza e parë, prej nisjes së dasmës deri në marrjen e nuses, faza e dytë, marrja e nuses dhe faza e tretë përfundimi i dasmës në shtëpinë e dhëndrit. Dasma zgjaste një javë: niste të hënën dhe mbaronte të dielën".[770]

Dasmës i paraprin fejesa, prandaj ekzistojnë në folkorin tonë dhe një cikël këngësh të tilla. Edhe fejesa ashtu si dasma ka rregullat e veta. Në të kaluarën fejesat kryheshin me shkesi. Fejesat zakonisht bëheshin në pranverë dhe zgjasnin rreth një vit sepse kishin për qëllim që vajza të mund të bënte gati pajën. Fejesa bëhej zakonisht me anë të një shkesi, i cili quhej dhe lajmës. Duke qenë se të rinjtë nuk kishin mundësi të njihnin njëri-tjetrin, sepse i fejonin pa dëshirën e tyre, sipas vullnetit të familjes, shpesh këto këngë, në folklorin tonë, bartin në vetvete një ngarkesë të madhe emocionale, në të cilat shpaloset me mjeshtëri gjendja psikologjike e të fejuarve para njohjes. Te "Bleta Shqiptare" ekziston një cikël i tillë këngësh, të cilat më shumë se me fejesën kanë të bëjnë me gjendjen psikologjike dhe emocionale të të rinjve para martesës dhe janë integruar në fillim në mes ose dhe në fund të ciklit të këtyre këngëve. Të bie në sy fakti që Mitkoja nuk i ka grupuar këngët e dasmës në mënyrë kronologjike, ashtu siç paraqitet në përgjithësi ceremoniali i dasmës, nga e hëna në të hënë.

Cikli hapet me disa këngë që pasqyrojnë emocionet e dy të rinjve para se të martohen, vazhdojnë me këngë që kanë të bëjnë me ritin e të veshurit të dhëndrit,

[770] Gj. Zheji, Folklori shqiptar, Tiranë, 2004, f.71.

pastaj me nisjen e dhëndrit bashkë me krushqit për të marrë nusen, hyrja e krushqve në shtëpinë e nuses, më pas hyn një këngë për dhëndrin që i dërgon rrobat nuses(që po të kemi parasysh ecurinë e dasmës, ky moment i takon fillimit të saj, para se dhëndri të shkojë të marrë nusen). Cikli vazhdon me këngët e largimit të nuses nga shtëpia e vet dhe hyrjen në shtëpinë e dhëndrit dhe gjendja e saj në shtëpinë e re. Më pas thyhet kronologjia përsëri dhe cikli vazhdon me këngë të stolisjes se nuses, të porosive që prindërit i japin nuses paras se të hyjë në shtëpinë e dhëndrit, vazhdohet me ritin e së enjtes, kur nusja shkon të mbushë ujë te kroi dhe më pas cikli mbyllet më këngën ritual të të mbushurit të ujit ditën e hënë pas dasme[771].

Kjo është në mënyrë të përmbledhur renditja e këtij cikli te "Bleta shqiptare". Një çështje që duhet diskutuar këtu është kriteri që ndoqi Mitkoja për renditjen e këtyre këngëve. Lind pyetja: ç'farë kriteresh ka pasur parasysh Mitkoja në grupimin e këtyre këngëve, përderisa nuk është ruajtur në mënyrë të përpiktë kronologjia e ceremonialit të dasmës. Dihet se Mitkoja zotëron njohuri të hershme mbi këngët e dasmës, ritet pagane, zakonet dhe traditat e jugut, të cilat në kohën kur jetonte Mitkoja ishin më lehtësisht të aplikueshme për një sërë arsyesh. Por ka të ngjarë që Mitkoja të ketë pasur parasysh në këtë renditje vjetërsinë e këngëve, pasqyrimin e përshkallëzuar ngjitës të gjendjes emocionale të dy të rinjve që po martohen, por edhe të krejt grupit shoqëror që është pjesëmarrës në këtë kurorëzim.

Në ribotimin e "Bletës Shqiptare" nga Prof. Q. Haxhihasani, në vitin 1981, vihet re ndërhyrja në vepër për qëllime klasifikimi të këngëve, natyrisht një ndërhyrje e cila bëhet për ta rimodeluar nga ana shkencore veprën. Në këtë botim këngët e dasmës të "Bletës Shqiptare" janë grupuar në disa cikle si: fejesa, fillimi i dasmës, nisja dhe veshja e nuses, përgatitja dhe dërgimi i rrobave, në shtëpi të nuses, veshja e dhëndrit, nisja e krushqve-marrja e nuses, ardhja e nuses në shtëpi të dhëndrit, një këngë dollie dhe cikli i fundit që ka të bëjë me demaskimin e martesave me mosha të ndryshme. Cikli, siç shihet, ndjek në mënyrë kronologjike ecurinë e ceremonalit të dasmës dhe aspektin ritual të tij, gjë që bën më të lehtë perceptimin dhe studimin e tij. Në përpjekjen për klasifikimin e këngëve të dasmës, kriter përcaktues paraqitet raporti i këngës me ritin. Ky klasifikim, i cili natyrisht paraqet dhe problematikën e vet, për vetë kushtet në të cilat zbatohej shkenca e folkloristikës në vendin tonë asokohe, na e bën më të qartë, gjithsesi, se deri në çfarë shkalle Mitkoja ka arritur të përcjellë ceremonialin e dasmës nëpërmjet këngëve. Natyrisht që Mitkoja, siç na rezulton nga të dhënat biografike, mblodhi një material të gjerë këngësh dasme që këndoheshin në gjithë Shqipërinë dhe më pas e përzgjodhi këtë material për botim. Pyetjet që lindin nga kjo përzgjedhje që ai ka bërë janë: pse Mitkoja ka botuar vetëm këngë dasme të jugut? Pse ka lënë pa përfshirë në këtë cikël këngët ritual që lidhen me ritin e brumit ose të bukës që është një nga aspektet më të rëndësishme të ceremonialit? Pse nuk pasqyrohet në këto këngë roli i kumbarit, i cili referuar ritualit

[771] Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, II, Tiranë,1961, f. 55-70

të dasmës është regjizori i gjithë ceremonisë? Pse Mitkoja ka preferuar të përfshijë këtu edhe këngë që nuk i përkasin plotësisht ceremonialit të dasmës,etj?

Të gjitha këto pyetjen shtrohen duke marrë parasysh qëllimin e Mitkos lidhur me botimin e veprës së tij, si dhe vetëdijen e tij prej shkencëtari, që pavarëshisht shkollimit dhe njohjes së parimeve të shkencës folkloristike të kohës, na rezulton të ketë pretendime për një botim edhe shkencor. Një arsye e përzgjedhjes kryesisht të këngëve të dasmës që i përkasin jugut të Shqipërisë e konkretisht zonës së Korçës, rrjedh së pari prej faktit se këto ishin këngë dhe rite që Mitkoja i kishte mbledhur herët, që kur nisi të shfaqej pasioni i tij për mbledhjen e folklorit dhe së dyti sepse kjo ishte një trashëgimi kulturore që ai e njihte mirë madje dhe si pjesëmarrës apo aplikues i ceremonialit të dasmës. Nga ana tjetër, Mitkoja del se ka përzgjedhur kryesisht ato këngë dasme të marra kryesisht nga vendlindja, të cilat në thelb përfaqësonin, siç e kemi pohuar dhe më sipër, arketipin e këngës popullore lirike të dasmës në juglindje dhe jugperëndim të vendit. Këtë na e vërteton dhe fakti që, në ndonjë rast Mitkoja bën përpjekje për të sjellë dhe bashkëvariante këngësh. Nga ana tjetër është pohuar shpesh nga studiuesit shija përzgjedhëse e Mitkos dhe siç dihet, shumë prej këngëve të dashurisë dhe dasmës që ka përfshirë ai në këtë përmbledhje janë nga perlat e folklorit tonë. Prandaj ndodh që për shkak të efektit estetik, emocional apo artistik ai të anashkalojë në ndonjë rast aspektin shkencor, sepse qëllimi kryesor i tij, i pohuar prej vetë Mitkos ishte transmetimi i vlerave të thesarit shpirtëror kombëtar te brezat e rinj. Për këtë arsye ai do të hulumtonte dhe përzgjidhte më të mirën e mundshme, bazuar në njohuritë e tij, traditën, por natyrisht dhe në vetëdijen e vet estetike. Arsyeja tjetër të cilën e prekëm edhe më lart është ndoshta renditja e këngëve edhe sipas një përshkallëzimi ngjitës emocional, gjë që ceremoniali i dasmës apo vetë martesa, si akt i kurorëzimit të një bashkimi shpirtëror, si gjenezë e ripërtritjes së jetës dhe e vazhdimësisë të trashëgimisë, e përmban në vetevete me tepri.

Gjithsesi, mund të themi se Mitkoja e ka njohur dhe pasqyruar mirë ceremonialin e dasmës dhe ritualin e saj dhe ka synuar ta pasqyrojë nëpërmjet këngëve të botuara. Mungesat që vihen re në plotësimin e këtij rituali mund të jenë konsekuencë dhe e faktit se Mitkoja synonte të ishte plotësisht autentik në pasyrimin e vlerave kombëtare. Një ritual i rëndësishëm që mungon te cikli i këngëve të dasmës te “Bleta”, është ai i brumit apo i bukës, por ky rezulton të jetë dhe një ritual që e kanë edhe popujt e tjerë të Ballkanit ndoshta edhe më gjerë, ndaj ai nuk ka preferuar ta përfshijë në vepër. Dihet që ritet vijë nga një periudhë e arkaike pagane, parakristiane dhe paraislamike dhe ato në gjenezë përfaqësojnë kryerjen e veprimeve të caktuar me qëllim kryesor sjelljen e mbarësisë në jetën e çiftit dhe familjes së re që do të krijohet. Raporti këngë artistike-rit në ciklin e këngëve të dasmës te “Bleta Shqiptare”, na paraqitet në një sintezë të përkryer dhe në një harmoni solide, gjë që do të thotë që përmes sistemit të ligjërimit artistiko-poetik përcillet në mënyrë organike dhe thelbi i ritualit.

Një nga ritualet që hap ceremonialin e dasmës është ai i stolisjes së nuses dhe veshjes së dhëndrit."Rituali i stolisjes së nuses apo ajo e të rruarit të dhëndrit duket qartë se janë rite të inicimit të përgatitjes së tyre për të hyrë në një grup të ri njerëzish, në grupin e njerëzve të martuar. Në këngë të tilla rite, fjalët e këngëve u kujtojnë të rinjve faktin që po kapërcejnë në një fazë të re të jetës së tyre dhe se për këtë duhet të jenë të përgatitur."[772] Në këngët e "Bletës" që lidhen me dërgimin e rrobave dhe stolisjen e nuses, gjejmë përshkrime të holla të emocionalitetit të vajzës në këtë moment, si shprehje e kontaktit të parë të vendosur mes dy të rinjve që për një javë do të martohen, por ende nuk e kanë njohur njëri-tjetrin. Rrobat bëhen kështu shkaku i një gjendjeje psikologjike turbulluese dhe eterike, gjatë së cilës vajza bëhet e vetëdijshme për gjendjen e re ku do të hyjë dhe veshja e paralajmëron hapin e parë të këtij ndryshimi, prandaj edhe emocioni bëhet i fuqishëm nëpërmjet monologëve apo dialogëve imagjinarë shkëmbyer mes dy të rinjve: *Fustanë që të dërgova, / vallë a ta suallë?, / Ma suallë të lumtë krahu, / ndë hodë të mirë ma mvuarë, / kaq fort jam gëzuarë, / m'a mbajç trashëguarë! / Pipirinë ta dërgova, / Tumanetë*. Siç e shohim nga këto vargje, Mitkoja jep në këngë detaje të veshjes nusërore si dhe vendin ku porositeshin veshjet: *Do të vete në Janinë, / të të qep ty pipirinë*, si dhe ngjyra e veshjes: *pipirinë bojëgjake, / t'ma mbash ti moj mestumbake*".

Veshja e rrobave përmbante në vetvete një hije misteri, i cili lidhej me fshehtësinë e intimitetit të martesës: *Ç'ay trim që pret ndë shkallë, / thojini l'e të presë ca, / sa të mvesh linjën e hollë, / Thojini le të presë ca…*

Ndërsa riti i të veshurit të dhëndrit paraqitet më interesant. Përshkrimin e këtij riti e gjejmë te S.Dineja: "Kur rruajnë dhëndrin mblidhen farefisi edhe të tjerë burra e gra rrotull dhëndrit duke kënduar e darovitur berberin, gjithkush me sa i lëshon dora...Andej ia hedhin berberit në legenin me ujë që rruhet dhëndri."[773] Pasqyrimi i këtij riti është fare i qartë te kënga e "Bletës" "Berberi që rruan mbrenë": *Berberi që rruan mbrenë, / na rruan edhe dhëndër benë*. Me interes është dhe roli i vëllamit, i cili duhet të daroviste i pari kur rruhej apo vishej dhëndri: *Nxirr kuletën e mëndafshtë, / o vëllamë, / të na daroviç gjëkafshë, / o vëllamë*. Në disa raste nusja i dërgonte rrobat dhëndrit, ose i qëndiste atij shaminë që e merrte me vete në pajë, ndërsa në në raste të tjera rrobat porositeshin jashtë: *Baba dhëndër të ka nisur, / rrobat Janin' t'i ka qëndisur*. Shumë i bukur është dhe përshkrimi i veshjes së dhëndrit, i hollësishëm, natyrisht për të vënë në pah edhe një trashëgimi etnografike shqiptare, ç'ka i shërbente më mirë qëllimit të Mitkos: *Tegelat mbi kllapodan, / fermeletë gjith ar, / sumbullat margaritar, / mesthin ngjeshur me toka, / gjithë larë me sërma*. Gjurmë të riteve pagane hasen veçanërisht në momentin kur krushqit nisen të marrin nusen. Përshkrimi është madhështor. Krushqit janë herë 40, herë 100, herë 1000, të veshur bukur, të prirë prej dhëndrit. Furia e tyre është e

[772] Gjergj Zheji, Folklori shqiptar, Tiranë, 2004, f.71
[773] Gj.j Zheji, *Folklori shqiptar*, Tiranë, 2004, f. 72.

papërmbajtur, aq sa nusja e paralajmëron dhëndrin të vijë me më pak krushq, se i druhet furisë shkatërruese të tyre: *Mos më vish me krushq shumë, / se më gjen arat mb'udhë, / pa m'i prish, m'i bën rrëmbullë*. Ideja e prishjes, rrëmujës dhe pushtimit, spikat qartë në të gjitha këto këngë: *Dalke dhëndri sanxhak, / për të prishurë një fshat,* ose *Dyzet e pesë kalorës, / dhëndri vezir mbi ta, / Do të prishinë Stambollë*. Paradoksi është i çuditshëm, sepse siç thotë dhe I. Kadareja te "Autobiografia e popullit ne vargje", lexuesi pyet nëse këtë janë krushq apo pushtues? Dhe më tej jep këtë shpjegim: "Në të vërtetë ata janë krushq dhe këtu nuk ka asnjë paradoks, as ndonjë realitet të dyzuar. Ka vetëm një portret të vërtetë kolektiv të krushqve shqiptarë. Këta krushq edhe në mes të gëzimit mendojnë një marshim, një prishje Stambolli. Dhe ky nuk është aspak një donkishotizëm apo një kokëkrisje, por është thirrja e rebelimit që nuk fle kurrë në ndërgjegjen kombëtare"[774]

Një cikël këngësh dasme te "Bleta Shqiptare" lidhet me ardhjen e nuses në shtëpinë e dhëndrit. Ky është një rit i lashtë që aplikohet edhe në ditët tona, e që lidhet me momentin kur nusja kapërcen pragun e shtëpisë së dhëndrit dhe vjehrra ia lyente gishtat me mjaltë ose i vinte sheqer në gojë: *Hapij ju sorra, / se vjen gjeraqina, / me sheqer në gojë të na ëmbëlsojë*. Qëllimi i këtij riti ishte që nusja të ishte e ëmbël dhe gojëëmbël si sheqeri në shtëpinë e re, ndaj këtu hyjnë shpesh edhe porositë dhe shprehja e dëshirave të prindërve të dhëndrit që nusja të marrë sa më parë zakonet e shtëpisë së re, duke treguar kështu edhe një lloj rivaliteti mes krushqive, karakteristike këto për këngët e dasmës: *Harroi moj nusja ime, / zakonet e asaj shtëpie, / këto zakonezit tanë, / gjithë mjalt e sheqer janë* . Urimet që shoqërojnë hyrjen e nuses në shtëpinë e re janë nga më të çuditshmit dhe ndonjëherë tingëllojnë edhe të frikshëm, sikur t'i përshkonte një hije vdekjeje, si kumt, si parlajmërim që ajo(nusja) të mos guxonte të shkelte normat dhe rregullat e një jete të kontrolluar rreptësisht nga kodet e ngurta etiko-morale: *Nuse ku kalle këmbëtë, / këtu të rënçin dhëmbëtë, / dhëmbët dhe dhëmballatë /, eshtrat e kokallatë*. Një rast i ngjashëm është ai i këngës ku nusja porositet të jetë e bindur, e urtë, sepse në të kundërt kërcënimi i ndëshkimit të ashpër qëndron mbi të: *Dëgjo, nuse, ç'thotë ungjilli, / Burri flet e ti mos fol, / se ti flet, stapi kërcet*. Që të mbështetet dhe ligjërohet ndëshkimi përmendet dhe ungjilli. Kjo këngë hedh dritë mbi një stad të hershëm historiko-social, ku femra në shtëpinë e burrit duhet të ishte e pafjalë dhe të bindej verbtazi.

Me shumë interes janë dhe këngët në të cilat jepen porositë që prindërit i japin vajzës para se të shkojë nuse: *Bijë atje ku të veç, / tët vjehërrë për nder ta kesh, / se t'ka rritur bejçenë, t'i ka krehur perçenë.*

Një aspekt tjetër i dasmës, që Mitko e ka pasqyruar përmes dy këngëve të shkurtra nëpërmjet

shënimeve përkatëse se si aplikohej ky rit, është ai i të mbushurit ujë në krua. Dihet se uji dhe zjarri janë dy elementet kryesore të ritit, të cilët kodifikohen si element

[774] I.Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë, 1980, f.89.

purifikuese. Të enjten e dasmës nusja shkon me farefisin e saj për të mbushur ujë në krua, dhe pastaj spërkaten të gjithë me ujë për të larguar të këqijat: *Mer stomnat, haj për ujë, / moj me lajka shumë, / ngadalë mos i thyesh mb'udhë, moj me lajka shumë, / ndë mos munt, nem ti mbaj unë, moj me lajka shumë*: *Ç'ke këtu, i lënç këtu.., / Atje ku vete vafsh plot".* Mitkoja shpjegon për këto dy vargje vazhdimin e ritit: "Si zakon është që kur nusja me far'e fisin kthehet nga kroi stomnat ia marrën dhe i jepen një krahë dru, të cilat i çon në vatër"[775]. Zakoni i vajtjes së nuses në krua përsëritet dhe të hënën pas dasmës si rit i hershëm i purifikimit. Të hënën shkojnë gjithashtu prindërit të shohin nusen dhe t'i japin porositë e fundit. Meraku i prindërve është si ka kaluar nusja natën e parë dhe a është trajtuar mirë, a i ka nderuar apo turpëruar: *Qysh mu ngryse qysh m'u gdhive bija ime? / Porsi zogu në mulli, o babai imë, / Si fëllënxa në kuti, o babai imë .*

"Dasma është padyshim një moment që gjeneron gëzim jo vetëm për dy të rinjtë që nisin një jetë të re, por për gjithë komunitetin që merr pjesë në të, megjithatë në tërë ceremoninë endet një tis mallëngjimi që hetohet në mjaft këngë. Në mënyrë të veçantë kjo bie në sy te këngët që i kushtohen nuses, e cila largohet nga shtëpia e saj dhe nis një jetë vërtet të re në të gjitha anët në shtëpinë e dhëndrit, shpesh me shumë të papritura"[776]. Ankthi i të papriturës në mos vërehet ndihet në çdo këngë, sidomos kur përshkruhet gjendja psikologjike e vajzës para martesës. Momenti i daljes apo ndarjes së nuses bëhet motiv për një shfrim lirik të gjitha mllefeve, padrejtësive, dëshirave intime, ku rendi patriarkal ka kurorëzuar me shekuj raporte të ashpra e brutale ndaj vashës-nuse. Motivi i ngritur në këngë e përcjell edhe gjithë aspektin social të problemit, aspektin etnografik në plan diakronik e sinkronik, sepse edhe kur janë zhdukur format konkrete të kulturës materiale, kënga mbetet. Për të harmonizuar gjithë marrëdhëniet shoqërore, për të mbjellë frymën humaniste midis nuses nga njëra anë dhe anëtarëve të tjerë të familjes lindi dhe një faktor i rëndësishëm i kësaj jete, faktori këngë. Kjo mori mbi vete detyra e funksione të tilla që s'mund t'i bënte riti. Kënga përmes gjuhës magjike i jep shpirt hyrjes në familjen e re duke e pajisur këtë moment jetësor të rëndësishëm me ngjyra romantike, me qëllim që të zbusë sadopak realitetin e vrazhdë"[777]: *Ngremu moj bijë, ngreu të keqenë, / Erdhën të të marrëjnë, / S'munt o moj nënë, s'munt për perëndi, / Se më zunë ethetë, / Folu moj nëne, folu moj shpyrte, / Folu le të presinë.* Në ndonjë këngë, vajza iu ankohet prindërve se përse e martuan dhe e shkulën prej gjirit të tyre: *Më rrite baba më rrite, / më rrite me tul simite, / nga gjiri yt pse më shqite?* Ndonjëherë ky ankim kthehet gati në një kërcënim; ndëshkimi hyjnor do të bjerë mbi prindërit që e martuan vajzën me pahir: *S'ke frikë pe përëndija nëna ime, / që më nxjerr plëng'e shtëpie*

[775] *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, II, Tiranë,1961, f. 69
[776] Gj.j Zheji, *Folklori shqiptar*, Tiranë, 2004, f.72
[777] N.Vinca, *Mbi poetikën e folklorit shqiptar*, Shkup, 1996, f.54.

Si rregull nusja qan gjithmonë kur largohet nga shtëpia e saj, duke vajtuar kështu ndarjen nga prindrit, nga vajzëria dhe ndoshta edhe pakënaqësinë e saj për martesën: *Ç'të derdhen lotët moj bijë, / par e par pas faqeshit, sumbulla pas gjinjëshit*. Por ka dhe raste të tjera në këngë kur vajza është e gëzuar së brendshmi që do të martohet, por nuk mund ta shprehë hapur gëzimin se është e ndrojtur para prindërve: *Gjithë guguçet këndojnë, / ti guguçe pse s'këndon", / Se kam tim atë aty pranë, / pa më flet pa më qorton*

Këngët e dasmës janë të larmishme, por duhet pasur parasysh se gjatë dasmës nuk këndohen vetëm këngë që janë të lidhura me ceremonialin e dasmës apo me ritin, por edhe këngë dashurie apo këngë gazmore. Padyshim, që këngët që lidhen me ritin te "Bleta Shqiptare" janë nga më të vjetrat, ndërsa një pjesë tjetër është e përbërë edhe nga këngë që i përshtaten ngjarjes apo ndonjë momenti të veçantë. Ka disa këngë që shprehin dhe një notë të dukshme erotizmi siç janë ato që kanë të bëjnë me takimin fshehtazi të çiftit para martese, me ëndërrimet e vajzës, me moment intime mes çiftit të ri, etj. Ndërsa një pjesë tjetër këngësh kanë të bëjnë me shqetësimin e dhëndrit, prindërve apo farefisit të tij, se a do të jetë nusja në gjendje t'u bëjë ballë punëve të shtëpisë së re dhe t'u përshtatet rregullave e zakoneve të reja. Ka dhe këngë të tilla të cilat shprehin shqetësimin e prindërve të nuses se nëse vajzën e tyre do ta tajtojnë mirë, madje këtu ndërthuret edhe ndonjë element i jetës materiale: *Thotë krushka, krushkësë, / ndëpër vesh të mushkësë, / mos më mundosh bijënë, / ndaj të dhashë mijënë*. Ndërsa në ndonjë këngë tjetër qesëndisen sjelljet e nuses se re nga farefisi i dhëndrit.

Në qendër të të gjitha këngëve të dasmës është figura e nuses dhe e dhëndrit. Shumica e këngeve kanë për bazë përshkrimin fizik të tyre. Nusja shpesh krahasohet me lulen, me gjeraqinën, thëllëzën, zogun e beharit, guguçen etj. Asaj i vihen epitete te tilla si faqeqelqe, sylarme, zerdeli, gojëmbël, qafëgjatë si sorkadhe, cullufe fillar etj, ndërsa dhëndri është trim, petrit krahargjentë, vllastar i gjatë, yll i dritës, borziloku, qiparisi, leshramargaritari, azgan, bujar, vezir mbi pashallarë etj. Por, në përgjithësi, në këngët e dasmës objekti kryesor është nusja dhe bukuria e saj. Në figurat që përshkruajnë bukurinë e nuses, shihet qartë karakteri romantik në trajtimin e së bukurës. Sinqeriteti për këtë bukuri ishte i çasteve entuziaste të ditëve të dasmës, po që mbaronte qysh në ditët e para të saj. *Dill moj nënë dil, / dil të bësh sehir se ç' të solli djali, / një thëllëzë mali, / një zok të beharit, / një degë leimonit ndë mes të hoborit.* Te "Bleta Shqiptare" e Mitkos ka realizime portretesh të përkryera të nuses dhe dhëndrit: *Djersa jot e ballit erë e jargavanit, / djersa jot'e e faqesë, er'e manushaqesë*

Për djalin: *Ububu lojtke një djalë, një djalë pëllumb i bardhë, / dyfeknë gjithë sedefe, kur e shoh më ngjethen ethe, / sahatnë gjithë zinxhirë, / kur e shoh më prish fiqirë*.

Zakonisht, këto këngë janë të shkurtra, sepse kështu i përshtaten më mirë gjallërisë dhe ecurisë së ceremonialit të dasmës. Figuracioni është i përzgjedhur dhe i larmishëm. Figurat që përdoren në këto këngë, si për nusen dhe për dhëndrin, janë

marrë zakonisht nga jeta fshatarake. Këngët përgjithësisht janë të shkurtra. Ato kanë një larmi të madhe ndërtimi në vargje gjashtë, shtatë e tetë dhe dhjetë rrokëshe, herë-herë të gërshetuara midis tyre në formën e refrenit nga më të ndryshmet. Roli i refreneve është i madh, ato u japin këngëve jo vetëm një shkathtësi në të kënduar, po edhe në të kërcyer. Refrenet shpesh janë pjesa e dytë e vargut të parë: *Nusja jonë ndër valle, / moj ndër valle*… Por ka dhe raste kur refreni është përsëritja e gjysmës së parë të vargut të parë: *Do të marr,o yll i ditës, / o do të marr*

Këngët e dasmës janë nga pjesët më të bukura të lirikës sonë popullore për arsyet që përmendëm më sipër.I.Kadareja te "Autobiografia e popullit në vargje" na jep një përshkrim të jshtëzakonshëm të asaj se si paraqitet dasma në foklorin tonë: "Dasma është spektakli kryesor, që populli ynë ka krijuar gjatë shekujve, asnjë ceremoni tjetër pagane, apo fetare, e hareshme apo e përmortshme, zbavitëse apo heroike, nuk i afrohet asaj.Prej dasmës ngjan i spërkatur gjithë terri shekullor i jetës shqiptare. Po të shikosh stolitë e nuses, ato të kujtojnë, kryesisht, kristalet e borës, brymën mbi bar, diçka me të cilën është spërkatur krejt Shqipëria. Kjo lidhet me atë ndjenjë tronditëse, totale qe emeton vetëm spektakli i dasmës. Si një teatër i madh ai vë në lëvizje gjithë emocionet njerëzore. Asnjë jetë shqiptare nuk mund të ketë qënë jashtë veprimit trazues të dasmës. Edhe tani, kur si rrjedhim i jetës moderne koha e dasmave të mëdha ka kaluar, ndriçimi të tyre që vijnë herë pas here nëpërmjet artit kanë ende një fuqi tronditëse.[778]

Kjo fuqi e madhe tronditëse të pushton sa herë lexon këto këngë dasmash që Mitko i nxorri nga thellësia e shekujve nga gjiri i njerëzve të kombit të vet, i përzgjodhi, i botoi dhe ashtu siç ai dëshironte ua përcolli brezave që të shihnin vërtet "origjinën zakonet dhe ritet e racës shqiptare", për t'i bërë ato të pavdekshme.

[778] I. Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë, 1980, f.76-77.

MYRVETE DRESHAJ–BALIU (PRISHTINË)

POEZIA E THIMI MITKOS MES FOKLORIT DHE VJERSHËRIMIT ROMANTIK

Objekt i kësaj kumtese do të jenë tekstet letrare poetike të Thimi Mitkos. Edhe pse ato nuk janë shumë, në krahasim me kontributin e tij në fushëne folklorit dhe të gjuhësisë, megjithatë paraqesin një veçanti dhe përplotësojnë përgjithësisht poetikën krijuese të Rilindjes Kombëtare.

Duke qenë mbledhës i pasionuar i krijimtarisë popullore, si dhe botues e vlerësues i saj, Thimi Mitkoja dhe madje një numër krijuesish të brezit të tij nuk arrijnë të dalin nga përbërësit teorikë, semantikë, gjuhësorë dhe estetikë të 'vargnimit' të letërsisë popullore, të cilët i bartin edhe në tekstet krijuese autoriale, para se gjithash në vjershat dhe poemat e tyre.

Thimi Mitkoja është njëri prej personaliteteve, pa të cilin nuk mund të shkruhet historia e periudhës së Rilindjes Shqiptare, pavarësisht se në historinë kombëtare nuk shquhet për ndonjë angazhim të veçantë në situata të caktuara historike. Ai është personalitet pa të cilin nuk mund të shkruhet historia e diasporës shqiptare e sidomos e Kolonisë së Egjiptit, pavarësisht se nuk e shohim në krye të ndonjërës prej organizatave a klubeve kombëtare; ai është krijuesi letrar pa të cilin nuk mund të shkruhet *Historia e letërsisë shqipe*, pavarësisht se krijimtaria e tij letrare nuk shquhet as për veçantitë estetike letrare me të cilën shquhen shkrimtarët e rendit të parë Naim Frashëri e Jeronim de Rada, shkrimtarët e rendit të dytë Zef Serembe apo Pashko Vasa dhe madje deri diku edhe shkrimtarët e rendit të tretë Jani Vreto, Filip Shiroka e ndonjë tjetër.

E megjithatë, Thimi Mitkoja hyn në *Historinë e popullit shqiptar*, në *Historinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare* dhe në *Historinë e letërsisë shqipe* për bëmat e tij të veçanta në veprimtaritë politike, ekonomike, intelektuale dhe kulturore e krijuese në jetën e popullit shqiptar. Në të vërtetë ai është rilindësi "me pikëpamje plotësisht të formuara historike, politike dhe kulturore, sepse është autor me vetëdije plotësisht të formuar kombëtare"[779].

Ai është njëkohësisht krijuesi me vetëdije të plotë dhe me koncepte bashkëkohore evropiane të kohës për misionin kombëtar që kishte krijimtaria letrare popullore dhe ajo e shkruar, por edhe krijues me shije individuale të formuara dhe estetike të kohës. Kjo është edhe arsyeja pse me veprimtarinë e tij të përgjithshme historiko-letrare ai do të shquhet para se gjithash për rëndësinë e mbledhjes dhe të botimit të thesarit shpirtëror popullor, por edhe për krijimtarinë vetjake poetike të asaj trashëgimie shumë të pasur deri atëherë në letrat shqipe.

Në fondin e letërsisë krijuese artistike të Thimi Mitkos deri tani njohim rreth njëzet poezi, por duke ditur se disa prej tyre tashmë njihen me pseudonime, të pabotuara apo të shpërndara në formë letrash dhe, duke ditur se fondet e Thimi

[779] Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe (Romantizimi) II,* Prishtinë, 1994, f. 241.

Mitkos dhe bashkëkohësve të tij ende janë të panjohura plotësisht, nuk përjashtohet mundësia që të gjenden edhe krijime të tjera letrare të tij. Pavarësisht nga kjo, edhe vëllimi më i madh i tyre, nuk pritet ta ndryshojë mendimin e deritashëm të historianëve të letërsisë për vlerat artistike të tyre si edhe për strukturën motivuese apo për strukturën e vargëzimit të saj.

Pjesa më e madhe e poezisë së tij është poezi përkushtuese, para se gjithash për Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe rolin e tyre në historinë e largët dhe atë të kohës; për gjuhën shqipe dhe krenarinë e të shkruarit të saj; për mbretëreshën e imazheve shqiptare në Evropë - Elena Gjikën përkatësisht Dora d'Istrinë; për dy nga tregtarët e kohës - Jovan M. Bankën dhe Vasil Ruso Korçarin; për vendlindjen e tij - Korçën, për aktin tragjik të mbetjes së Ulqinit nën pushtimin sllav dhe, më në fund për tragjedinë e vdekjes së gruas së tij.

Sprovat më të shpeshta si në strukturën përmbajtjesore ashtu edhe në strukturën vargore e gjuhësore Thimi Mitkoja i ka bërë me poezitë kushtuar Shqipërisë, shqiptarëve gjuhës shqipe, të cilat, në pjesën më të madhe shtrihen brenda po të njëjtit tekst poetik dhe përbëjnë një tërësi, si cikël më vete. Në poezitë e kësaj natyre, si ajo me titull "E ndë shqypëtarëtë gjithë sa janë", shkruar në një varg ende të pastabilizuar, u bëhet thirrje kushtrimore shqiptarëve pa ndasi fetare e krahinore që të bashkuar të ngritën në luftë kundër pushtuesit shekullor osman:

"*Leni besatë mbënjanë e luftoni gjithnjë bashkë,*
Pra, si të zboni Osmanë, bëni bajram, bëni pashkë.
Nka njeri që të dojë t'i falet perëndisë,
e me dorë, e me gojë, e në xhami, o në qishë".[780]

("E ndë shqypëtarëtë gjithë sa janë")

Kjo poezi, duket sikur i prin poezisë shumë të popullarizuar të Vaso Pashë Shkodranit "Mori Shqypëni, e mjera Shqypëni". Po të kësaj natyre motivuese, por tashmë me vargëzimin kryesisht tetërrokësh dhe gjithsesi shumë më afër poezisë popullore, janë poezitë që e ofrojnë edhe me të tjerë krijues të kohës, si: "Këngë për Shqipërin'e shqiptarëvet", "Nxitëje mbë shqiptarëtë për të shkruarë gluhën e tyre", "Nxitje mbë shqiptarët", "Mbë shqiptarët" etj., shembuj tipikë, që do të përsëriten nga njëra poezi në tjetrën dhe nga njëri autor te tjetri (nga Naim Frashëri te Pashko Vasa e Andon Zako Çajupi) gjatë gjithë Rilindjes Kombëtare dhe më vonë:

"O vëllezër shqiptarë,
ju flas për ditë të mbarë!...[781]

("Mbë shqyptarët")

ose

"Ngreu, Shqipëri, të thonë,
sado je shtrirë në gjumë,
helmuarë jetën gjithmonë,

[780] Thimi Mitko, *Vepra*, 1980, f. 575.
[781] Po këty, f. 597.

me varra, me plagë shumë"[782].

("Nxitje mbë shqipëtarët")

apo

"Ju o shqipëtar', ndë doni,
nga i huaji të shpëtoni,
duhetë që të vëzhdoni
kombin tuaj të ndërtoni"[783].

("Këngë për Shqipërin'e shqipëtarvet")

Përpjekjet për të çuar misionin e tij deri në fund, në të vërtetë për të kundërshtuar vendimet e Kongresit të Berlinit (1878), e shtynë Thimi Mitkon të krijojë edhe tekstin e "Marsejezës", sipas shembullit të këngës së njohur të Revolucionit Francez (1789). Strofa e parë dhe refreni sikur dihet, është përshtatje e drejtpërdrejtë e "Marsejezës" franceze, ndërsa pjesa tjetër e poezisë është shkruar sipas natyrës, stilit e preokupimeve kombëtare të poezive të tjera të tij, që përgjithësisht janë të natyrës së poezisë popullore, por që brenda saj ka edhe elemente të thella dramatike dhe emocionale personale:

"Çka do Nemsja në Jenipazar?
Çka do Serbi në Prishtinë?
Malëziu në Tivar,
Bullgaria në Manastirë?"[784] ("Marsejesa")

apo

"Moj Shqipëri, si s'u dogje,
kur të muarën Ylçinin?!"[785]

("Mbë shqypëtarët")

Ndër krijimet poetike të tij shquhen edhe dy vjershat kushtuar Elena Gjikës, të cilat, gjithashtu, përfaqësojnë edhe dy sisteme të vargëzimit: klasik dhe popullor, me ndikim edhe në natyrën e ndërtimit dhe artikulimit poetik të mendimit:

"Zonj' Elenë Istriadë, të lutem, për sa kuxova,
këto fjal' edhe të tjera, zotërisë sate të shkrova."[786]

("Të Fortëndriçmesë Zonjës Dorë Istriadë")

dhe

"Elen'e Gjikë Përmetit,
lul'e malitë qytetit,
ke dal'e rri mbanë detit,
tek afron er'e Përmetit."[787]

[782] Po aty, f. 596.
[783] Po aty, 585.
[784] Po aty, f. 583.
[785] Po aty, 594.
[786] Po aty, f. 576.

(“Ende këtë vetë zonjë”)

Nëse në mendimin kritik shqiptar, përkatësisht në historinë e letërsisë shqipe, do të bëhej një përpjekje për të diferencuar krijimtarinë letrare të Thimi Mitkos dhe për ta përfshirë në ndonjërën nga antologjitë e letërsisë shqipe, kjo do të ishte poezia “Burri klan gruan e tij q’i vdiqi”, sado, siç do të shprehej Profesor Qosja “me gjithë ngarkesën, vërtet, të fortë emocionale, edhe kjo vjershë dëshmon se prirja poetike e Thimi Mitkos, gjithsesi, është modeste në krahasim me rëndësinë që i kushton poezisë. Poezinë ai nuk e çmon për shkak të vlerës së saj si art sa e çmon për shkak të gjuhës dhe të jetës popullore që e dëshmon”.[788]

“Moj Ndino, moj mall’ i zjarrtë,
shpyrt e jet’e diell e hënë,
kurora imez’ e artë,
dy trupe një shpyrti dhënë.”[789]

(“Burri klan gruan e tij q’i vdiqi”)

Në të vërtetë, ai mbledh, përkatësisht regjistron dhe boton, letërsinë popullore nga e gjithë hapësira shqiptare për vlerat estetike dhe më shumë për vlerat gjuhësore, historike e kombëtare të saj, disa prej të cilave, si leksikun dhe trajtat historiko-gjuhësore të arvanitasve dhe arbërorëve, i bën pjesë të teksteve të tij krijuese letrare, pavarësisht se ato nuk përdoreshin më, si te vargu: “Nxitëje për shqiptarët për të shkruarë *gluhën* e tyre”. E megjithatë, ai e shkruan poezinë e tij duke imituar letërsinë popullore, sado ajo nuk shquhet në mënyrë të veçantë as për vlerat estetike, as për pasurinë gjuhësore të saj.

Thimi Mitkoja e njeh edhe letërsinë artistike, përkatësisht krijimtarinë letrare të Naim Frashërit, e megjithatë rrallëherë i gjason ndikimi i kësaj krijimtarie letrare në poezinë e tij; ai e njeh mirë poezinë e Jeronim de Radës sepse edhe komunikon gjatë dhe shumë me këtë bard të letërsisë së romantizmit shqiptar dhe të formatit evropian, prandaj edhe përpiqet t’i imitojë për shumëçka konceptet e tij për letërsinë dhe sidomos për gjuhën dhe folklorin, por përveç me disa tekste të karakterit shkencor-popullarizues, nuk arrin t’i përgjasojë me asnjërën prej vlerave krijuese letrare. Më parë se sa ndikimin e Jeronim de Radës dhe të Naim Frashërit poezia e tij mund të themi se si në strukturën përmbajtjesore të jashtme ashtu edhe në strukturën metrike të brendshme, bart më shumë ndikim nga letërsia e bejtexhinjve, e cila sigurisht qëndronte më afër letërsisë popullore, jo vetëm për krijimtarinë e tij, por edhe të bashkëkohësve të tij Spiro Dines dhe Kosta Trebickës, të cilët i këndonin njëri tjetrit, duke përfshirë këtu edhe Thimi Mitkon:

“Thimi Mitko shqiptari,
Dëgji ç’të thotë fshatari”[790]

---

[787] Po aty, f. 577.
[788] Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe (Romantizimi) II,* Prishtinë, 1994, f. 248.
[789] Thimi Mitko, Vepra, f. 580.
[790] Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II, Prishtinë, 1961, f. 324.

Pra, Thimi Mitkoja e shkruan poezinë dhe, në vargëzimin popullor të saj i jep detyrë vetes që të nxjerrë në plan të parë vlerat gjuhësore kombëtare, por edhe kur i përdor, ato nuk e kanë funksionin letrar artistik, të cilin e gjejmë te poezia e De Radës Naim Frashërit, Ndre Mjedës etj.

Thimi Mitkoja mbledh, boton dhe madje nxit të tjerët të mbledhin dhe të botojnë poezinë dhe prozën popullore në funksion të dokumentarizimit të historisë dhe të gjuhës, ndërsa e shkruan poezinë kryesisht në funksion të popullarizimit dhe të propagandimit të misionit kombëtar.

Si në rastin e parë ashtu dhe në të dytin vlerat krijuese estetike të saj mbeten në plan të dytë, jo vetëm pse Thimi Mitkos i mungon dhuntia e krijuesit, ashtu sikurse në gjuhë i mungon dija e filologut, por se ai i ka ndërtuar konceptet e tij jo shumë larg koncepteve që mbretëronin në lëvizjet kulturore dhe kombëtare të shumë vendeve të Europës, të cilat , që më parë i kishin propaganduar Lajbnici dhe sidomos Herderi, e sipas të cilëve në trashëgiminë popullore gjendet shpirti gjuhësor i kombit, ndërsa krijimtaria artistike e shkrimtarit s'është veçse imitim i krijimtarisë popullore.

ROVENA VATA (TIRANË)

"THIMI MITKO: PARIME TË NËNKUPTUARA METODOLOGJIKE DHE ESTETIKE NË PUNËN E TIJ SI MBLEDHËS FOLKLORI"

Thimi Mitkoja ishte një veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare ku ka edhe kontributin e tij të njohur si folklorist, por mbi të gjitha ai njihet si themelues i folkloristikës shqiptare.

Qëllimi i kësaj kumtese është të krahasojmë metodologjinë me praktikën e cila gjendet të Thimi Mitkoja, si dhe parimet profesionale që u kristalizuan më vonë, kurse të estetika e nënkuptuar gjenden pikëpamjet e tij për konceptin së bukurës, së shëmtuarës dhe të ironisë, alegorisë, etj. të nënkuptuara nga përzgjedhjet e tij në visaret popullore.

Për autorët që nuk janë shprehur teorikisht për parime krijuese a estetike të tyre, siç është edhe rasti në fjalë, ato hetohen në krijimtarinë e tyre, në përzgjedhjet që bëjnë, në përkthime, apo në tekstet për të cilët është përkujdesur për t'i shpëtuar, botuar dhe popullarizuar.

Për trashëgiminë kulturore shqiptare dhe posaçërisht për folklorin është folur vetëm kalimthi[791], kryesisht nga udhëtarë që kanë përshkruar vendin tonë dhe nga konsuj me interesa kulturore, gjithashtu disa albanologë, që janë interesuar kryesisht për gjuhën shqipe, i janë referuar folklorit. Kjo ka qenë gjendja deri në mesin e shek. XIX kur edhe shohim fillimet e një përpjekjeje të vetë shqiptarëve për të nxjerrë në dritë trashëgiminë e folklorit shqiptar.

Gjatë zhvillimit kulturor të shqiptarëve, një rol të rëndësishëm luajti krijimtaria letrare gojore, e cila me anë të komunikimit artistik, me të gjitha format e krijimtarisë, po në veçanti edhe me këngët lirike, arriti të bëhet një jehonë shprehjesh, ku sintetizohet në mënyrë të veçantë e tërë përvoja estetike kolektive e krijuar ndër shekuj.

Mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar u nxitën nga Romantizmi Europian për të vlerësuar trashëgiminë folklorike dhe sidomos trashëgiminë e këngëve popullore. Mbledhja e folkorit përkon me Romantizmin Europian. Edhe studimet për folklorin datojnë gjatë periudhës romantike. Folklori si shkencë nisi të zhvillohej në këtë këtë periudhë. Romantizmi përkon me krijimin e shteteve kombëtare dhe me rivlerësimin e ndjenjave kombëtare.

Mbledhësi i parë i folklorit letrar të trashëgimisë kombëtare në Shqipëri, mbetet Zef Jubani, me veprën "*Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare*", botuar më 1871. Ndërsa përmbledhja më cilësore me letërsi gojore shqiptare e hartuar nga një shqiptar u botuar nga folkloristi dhe personaliteti

[791] Para shekullit të 19 nuk ka asnjë vepër të plotë ose shqyrtim serioz posacërisht për folklorin shqiptar.

kombëtar Thimi Mitkoja nga Korça, përfaqësues i shquar i kolonisë shqiptare të Egjipit, i cili rezulton të këtë pasur relativisht të qarta kriteret e klasifikimit të materialit folklorik dhe rëndësinë e kontekstin e botimit të veprës që kur ka nisur punën për grumbullimin e materialit.

Ndaj pyesim: *Mbledhës përshkrimor, shpjegues apo faktues*?

Studimi dhe mbledhja e folklorit bëhet në sisteme të specifikuara dhe me metoda të përcaktuara nga antropologë, të cilët mbledhin lëndën, e klasifikojnë, e shoshitin, e studiojnë dhe kështu më në fund nxjerrin rezultatet e vyera që jep shkenca folklorike. Si një punë kolektive ku shteti jep ndihmën financiare e morale më të madhe për t'ia arritur qëllimit.

Në këtë arsyetim, mund ta quajmë edhe folklorin si një funksion shtetëror. Si të tillë e pa dhe Mitko, edhe pse në metodologji, ndryshon nga ai i një mbledhësi të sotëm, pasi nuk jep të dhëna se nga kush e mblodhi, ku e mblodhi.

Rëndësi për të si mbledhës e metodist ka mostjetërsimi i asaj që mbledh, siç bënë shumë mbledhës
të tjerë në europë. Me objektivitet, në hulumtime dhe qëndrime, Mitkoja përjashton paragjykimet personale subjektive, përdor qasje sistematike në nxjerrjen e qartë të konkluzioneve.

Duke u nisur nga lënda që mbledh dhe retushimi i varianteve në variantet thelbësore duket se Mitkoja i referohet ***metodës së sondazhit***. Nëse ndalemi në mbledhjen, krahasimin dhe analizën e informacioneve për numrin e fenomeneve sociale që sjell, mund ta pranojmë këtë pohim, duke e quajtur Mitkon një pararëndës në studimet moderne shoqërore, ku studiuesit gjithnjë e më tepër janë duke përdorur metodën e vrojtimit për hetimin sasiore të fenomeneve dhe analizave sociale.

Vetë Mitkoja pohon në parathënie se ka bërë ***studime në terren***. Ai qas rajone me sjellje të veçantë gjeografike, kulturore të njerëzve, sjell qëndrime, ndjenja. Hulumtimi i tij në terren u fokusua në kuptimin albanologjik si depërtim, si zbulim i portretit të vërtetë të shqiptarit dhe të jetës së tij shoqërore. Duket se qëllimi i kërkimeve të tij në terren, nuk përqëndrua në analizën sasiore të këngëve të të njëjtit lloj, por në larminë e gjinive, që sillnin njohuri të saktë për komunitetin, për gjendjen e tij të përgjithshme si dhe lloje të ndryshme të shpërndarjes sipas zonave.

Në ***Bletën*** e Mitkos nënkuptojmë metodën e ***studimit krahasues***. Ai i referohet disa fenomeneve sociale, të krahasueshme në zona të shumta sociale. Ne kemi mundësinë, nisur nga lënda e mbledhur të shqyrtojmë ngjashmëritë dhe dallimet në rituale, ceremoniale të ndryshme.

Nuk mungojnë qasjet e krahasim historik nisur nga epika heroike, krahasime ndër-kulturore, nisur nga riti i këngëve të dashurisë (gege, arbëreshe e ato të jugut). Nuk mungojnë studime sociologjike, i referohemi analizës së fakteve të njohura të komunitetit sociologjik që ofron.

Duke vërejtur metodologjinë është kryesisht një version i ripunuar i Shkollës Historiko-Kulturore Gjermane[792], e institucionalizuar në shumë vende si "një përpjekje e qëllimshme dhe e organizuar për të formuar një kulturë sa më të kënaqshme", po e njohur ndryshe si "lëvizje e rigjallërimit", ose më saktë e rizgjimit kombëtar, kjo shkollë priret nga thelbi, dhe këtë thelb ne e gjejmë në lëndën e përzgjedhur nga Mitkoja. Gjithë lënda që mbledh është shprehje e dimensionit shpirtëror të traditës. Ai mbledh ato këngë që transmetojnë kulturën shpirtërore të pandarë nga ajo materiale.

Duke u bazar në parimet e metodologjisë, Thimi Mitkoja, qëllimin e veprës së tij e jep që në parathënie të saj kur shprehet se "shpëtimi edhe dhënia brezave që vinë, i fjalëvet dhe tekstevet shqipe, të cilat, para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime, dhe besoj se do të kenë një vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare, veçanërisht dua që t'u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën edhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare, në këtë mënyrë t'u sjell dobi që të mundin edhe këta të përparojnë.

Vlen të shtohet fakti se Thimi Mitkoja mbetet mbledhësi më i përkushtuar i folklorit shqiptar, i pari që botoi një përmbledhje materialesh folklorike si rezultat i një pune të gjatë dhe i vetmi që nuk tentoi të redaktonte tekstet e mbledhura, duke u prirur që puna e tij të mbetet të dokumentimi.

Me anë të punës së tij si mbledhës folklori ai nxorri në pah vlerat dhe identitetin kulturor të vendit dhe popullit të tij. Thimi Mitkoja e ka njohur mirë gjuhën e popullit të vet dhe ka lënë një pasuri të çmuar në fushën e folkloristikës shqiptare.

Mitko kishte si parim të tij që lëndën para se ta hidhte në letër, ta përpunonte, duke shmangur kështu fjalët e huaja, orientalizmat nga puna e tij që bëri në dobi të popullit të vet. Pra duke qenë kështu shohim se ai kishte kritere të nënkuptuara për të realizuar punën e tij më mbledhjen e fjalëve shqipe. Ai jo vetëm që nuk përdor

[792] Leopold Von Ranke, "Historia Universale", 1880. Shumë kërkimt tregojnë se Ranke preferon shkëmbimin e lirë të informatave shkencore mes historianëve sepse është rruga e vetme që historia të vazhdojë të zhvillohet dhe të futet në çdo kohë. Në Gjermani u zhvillua teknika e përpumimit të burimeve dhe teknika e përpunimit të historisë.Të parët ishin romantikët që i vunë kujdes burimeve historiografike (shkolla narrative) e mandej shkolla historike e Rankes (1795-1886) i cili vuri kujdes dokumenteve dhe e zhvilloi teknikën e hulumtimit në një shkallë më të lartë. Shkolla e Rankes dhe pasuesit e tijë,themeluan bazën teknike të hulumtimit historik, rezultatet e të cilave, të korrigjuara dhe modifikuara në një masë i përdorim edhe sot. Sipas Ranke-s secila ndodhi në histori është pjesë e një një njësie shpirterore. Prandaj ajo "mund të jetë e kapshme vetëm prej përceptimit shpirtërorë". Sipas Ranke-s.e vërteta është se nuk ka histori empirike për faktin e thjeshtë se nga pikpamje empirike faktet nuk janë prezente para historianit. Ato janë ngjarje të kaluara, që nuk mund të kuptohen në mënyrë empirike, po përmes një procesi konkluzionesh sipas parimesh racionale nga të dhënat që zbulohen. " Historia është në të njëjtën kohë art dhe shkencë…Ajo duhet t'ë japë mendjeve te mësuara të njëjtën kënaqësi si edhe një letërsi mjaft e arritur".

fjalë të huaja si p.sh të turqishtes, por është i kujdesshëm edhe në mospërdorimin e fjalëve të reja (neologjizmave).

Materialet folklorike në këtë vëllim fillojnë me proverbat dhe vazhdojnë me gjëegjëzat, emrat e njerëzve, këngët alegorike të ditëve të shënuara të vitit, të dasmës, të dashurisë, të trimërisë, këngët gegërishte, përrallat dhe mbyllen me një fjalor shpjegues të fjalëve krahinore që përbëjnë tekstet folklorike duke shprehur edhe parimet e tij estetike për koncepin e së bukurës, së shëmtuarës, të ironisë, alegorisë etj.

Këto materiale përbëjnë 490 proverba, 80 gjëegjëza, 359 këngë, 12 përralla, të cilat përfaqësonin një kuadër të gjerë dhe autentik të traditave popullore.

Vëllimi mbyllet me fjalor shpjegues të fjalëve krahinore që përmbajnë tekstet folklorike të botuara në po këtë vepër. Inventari i tërë përmbledhjes është relativisht i madh: 490 proverba, 80 gjëegjeza, 359 këngë, 12 përralla.

Puna e tij si folklorist karakterizohet nga një nxitje e fortë patriotike, krahasuar me mbledhës të tjerë, bashkëkohës, Mitkoja ka qëndruar më afër me origjinalin, nuk ka ndërhyrë në këngët dhe gjithë materialin tjetër folklorik, lejon sot të shihet nga studiuesit gjendja reale e krijimeve popullore siç i ka mbledhur në terren. T'u referohemi studiueseve sesi e shohin ata paanshmërinë e autorit[793].

Materiali i *Bletës shqiptare* është klasifikuar dhe renditur sipas gjinive. Libri përfshin pjesë me këngë të vegjëlish, këngë për festat popullore të motmotit, këngë dashurie, këngë dasme, nizami, kurbeti, këngë e vaje, balada, epika historike, si dhe përralla, fabula e anekdota, kurse si shtojcë ka një fjalor shqip-greqisht. Me këtë përmbajtje në atë kohë kjo përbënte një vepër themelore për letërsinë gojore shqiptare[794].

Mitkoja i kish regjistruar ashtu siç jetonin këto thesare në përvojën aktuale popullore, pa bërë përpunime e shtesa të këngëve me ngjarje që nuk i kishin tekstet origjinale. Ai nuk i jetoi shqetësimet e romantikëve, për të zbuluar e stisur me materialet e mbledhura të folklorit, epopetë e hershme kombëtare, as nuk u fut në labirintet e përpunimit të materialeve popullore, por pa kufizuar këtu ndikimet e tij prej ideve romantike, lidhur me rolin edukativ të folklorit ndaj ndërgjegjes patriotike dhe qytetërimit të kombit.

Mitkoja e konceptoi trashëgiminë folklorike mbi një parim kombëtar historik realist. Ai u fut në historinë e folkloristikës, me një përgatitje teorike modeste, por me pikëpamje të drejta rreth karakterit të mirëfilltë që duhej të kishin krijimet popullore.

Mitkoja punoi për mbledhjen dhe botimin e folklorit për disa dekada, por nuk është ende e qartë se kur saktësisht e filloi këtë ndërmarrje[795].

---

[793] Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1981.

[794] Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 219.

[795] Olimbi Velaj, *Balada shqipe në kontekst ndërballkanik*, ruhet në arkivin e Institutit e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, fl. 102.

Autori kishte botuar artikuj në revistën "Pandora"[796], të Athinës që më 1859 dhe mënyra se si kishte punuar për mbledhjen dhe përzgjedhjen e fakteve, për renditjen dhe argumentimin e tezave të tij, tregonte se ai zotëronte aftësitë e një studiuesi të mirëfilltë dhe se kishte kohë që punonte në fushën e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve.

Spiro Dineja në shënimet e veta pohon se Mitkoja më 1866, jo vetëm ka kërkuar të mbledhë këngë popullore nga ai, por edhe është përpjekur t'i mbushë mendjen se me një veprimtari të tillë merren njerëz të shquar si: Kamarda, Panajot Kupitori dhe shumë filozofë të tjerë europianë, të cilët thonë se në këngët dhe në përrallat e vjetra të një populli ruhen zakonet, gjuha dhe historia e tij[797].

Në studimin e veprës së Thimi Mitkos të bërë nga studiuesit e Akademisë së Shkencave, jepen disa konsiderata për saktësinë dhe rigorizitetin me të cilin është hartuar përmbledhja e tij.

Autorin e karakterizojnë veçoritë e një folkloristi të shquar, ai di të zgjedhë individët të cilët janë vërtet të talentuar në trasmetimin e folklorit dhe e shtrin kërkimin në një hapësirë mjaft të gjerë, di të regjistrojë me saktësi materialet dhe t'i specifikojë ato.

Duke iu referuar metodologjisë e cila të vë para përgjegjësisë së përcaktimit të vendit, të kohës dhe të çdo gjejë që lidhet me marrjen e informacionit gjatë mbledhjes së të dhënave folklorike, një gjë të tillë nuk e hasim të autori në fjalë, ai filloi të interesohej dhe ta mblidhte sistematikisht atë, por mbetet për ta studiuar edhe më tej çështjen e përgatitjes së "*Bletës shqiptare*", pasi nuk është përcaktuar ende sa duhet çasti kur ajo u shtyp e nisi të qarkullonte.

Vepra ka disa mungesa të karakterit metodologjik që përdoren në ditët e sotme gjatë mbledhjes dhe studimit të materialit folklorik si p.sh: Nuk përmendet vendi, koha e regjistrimit, të këtyre materialeve, por ka shpesh shënime shpjeguese edhe për prejardhjen e këngëve, edhe për rastet kur ato këndoheshin, në rast se ato ishin këngë rituale.

Ka rëndësi të përmendet fakti se Mitkoja nuk nisi të mbledh këngë si talent dhe pastaj të zbulonte vlerat e larta të atyre këngëve, por ai e nisi këtë punë me një qëllim të caktuar patriotik, i shtyrë nga dashuria e vendit dhe e gjuhës. Punoi në mënyrë autodidakte, pra ai nuk vinte nga ndonjë formim etnologjik dhe folkorik, por duke qenë përpara kësaj situate të habit fakti që vepra ka një karakter të mirëfilltë shkencor këtë ai e tregon që në fillim arsyen pse e ndërmori këtë punë të madhe.

Bleta pati një rol pozitiv pasi i dha botës së huaj për herë të parë folklorin shqiptar[798], *Bleta shqiptare* e Mitkos, që u botua në atë moment historik të rëndësishëm, luajti një rol të dyfishtë: ajo i shërbeu çështjes nacionale ndër shqiptarë.

[796] Pandora përshkruhet si gazetë nga studiuesit, por ajo ishte revistë sipas fakteve të viteve të fundit.
[797] Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1981, f. 40.
[798] Ziaudin Kodra, *Përkujtime*, me rastin e 70 vjetorit të vdekjes së Thimi Mitkos Bleta Shqiptare, f, 145.

Ajo që e shquan Mitkon si mbledhës të folklorit veç të tjerave është aftësia dhe shija për të zgjedhur materialin. Mitkoja ka meritë se ripordhon me saktësi gjuhën e përdorur dhe kjo është shenjë e seriozitetit të tij[799], duke u mbështetur në këtë dëshmi mund të themi se Mitkoja që në Korçë ka pasur një traditë lokale të regjistrimit të këngëve dhe kjo është me rëndësi të veçantë për të e për folkloristikën shqiptare. Duhet besuar se, në fillimet e veprimtarisë së tij prej folkloristi, ai është nisur nga tradita vendëse, nga ajo lokale e Korçës, për regjistrimin e këngëve popullore.

Më 1872 (25 mars), në letrën e vetme që njohim prej Mitkos drejtuar Kristoforidhit[800],

shënon diçka për punën e tij me mbledhjen e folklorit dhe pikërisht këto fjalë, që kanë të bëjnë me lidhjen e tij me gjuhëtarin arbëresh Dhimitër Kamarda: “Me sa vërej unë, ai është kaq i zënë, sa nuk ka pasur ende kohë për të botuar gjithë ato këngë kombëtare, gjëegjëza dhe përralla shqiptare, që i kam dërguar për këtë qëllim, e pikërisht ato që kisha mbledhur gjatë pesë a gjashtë vjetëve. Fatkeqësisht, unë nuk kam mbajtur ndonjë kopje të tyre, për shkak të punëve që më kanë mbytur”.

Çfarë mund të nxjerrim prej kësaj dëshmie të shkurtër, po të rëndësishme? *Së pari*, po jo dhe në mënyrë të domosdoshme siç do ta shohim më poshtë, që Mitkoja i hyri punës me folklorin përpara pesë a gjashtë vjetëve, d.m.th. rreth viteve 1866-1867. *Së dyti*, se ai ka të shtrirë në disa lloje veprimtarinë e tij prej mbledhësi të krijimtarisë së popullit, këngë kombëtare, gjëegjëza dhe përralla popullore. *Së treti*, se lëndën që ka mbledhur, ia ka dërguar Kamardës. Ia ka dërguar të tërë? Me sa duket po, ose i ka dërguar pjesën më të madhe. *Së katërti*, se ai prej asaj lënde nuk ka mbajtur kopje, për shkak të punëve që e kanë mbytur[801].

Në maj të 1866, Dora D’Istria boton këngën e njohur të një Rexhep Age, i cili luftoi në Misir në kohën e Mehmet Aliut. Këngën e kishte nga Thimi Mitkoja[802].

Mitkoja, duke u marrë me tregti dhe duke qenë në lëvizje të shpeshta nëpër Europë dhe Ballkan, nuk iu vu dot punës për një mbledhje sistematike të folklorit.

Thimi Mitkoja, shqiptar i Korçës, botoi në vitin 1878 në Aleksandri të Egjiptit, ku jetonte për arsye tregtie, vëllimin “*Bleta shqiptare*”, me qëllimin që të ruante dhe t’u përcillte brezave tekstet e letërsisë popullore të mbledhura me shumë sakrifica dhe shpenzime, por edhe për të ilustruar karakterin, doket dhe zakonet e racës shqiptare, e për t’i dhënë një shtysë bashkëkombasve të tij që të studionin gjuhën

[799] http://www.gazeta-korca.com/gazetat/mars2011.pdf.

[800] *Studime filologjike*, nr 2, Tiranë 1974, f. 150.

[801] Dhimitër Shuteriqi, *Mbi veprimin e Miktos si folklorist dhe mbi botimin e Bletës Shqiptare*, ÇFSH, nr. 1, Akademia e Shkencave, Tiranë, f. 375.

[802] Dora D’Istria, *La nationalité albanaise d’aprés les chants* populaires (Revue des Deux Mondes), Paris maj 1866, f. 392), V. për këngën e Rexhep Agës të mbledhur nga Mitkoja, mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, Tiranë 1961, vëll. II, f. 106, nr. 18, variant i Bletës.

amtare, i vetmi mjet që mund t'i hapte udhë qytetërimit të kombit dhe ta vinte në të njëjtën shkallë qytetërimi me vëllezërit e tyre grekofonë.

Pra qëllimi i tij ishte të japë ndihmesë në qytetërimin e atdheut të tij me botimin e këtyre krijimeve të gjuhës shqipe, pasi, siç thoshte ai, padija luftohet me studimin e gjuhës amtare që është ushqimi kryesor i jetës intelektuale dhe morale të një populli.

Mitkoja dënon propagandën që bëhej për të shuar gjuhën shqipe dhe për ta shtyrë popullin të flasë greqisht. Nuk mund të ketë një tolerancë fetare më të madhe se ajo që mbizotëron mes shqiptarëve, as mes kombeve më të qytetëruar, shprehej Mitkoja[803], pasi shqiptari, duke dashur atdheun e tij, i do bashkëkombasit e tij pa dallim besimi fetar dhe, në këngët heroike të këtij populli të ngjitur krenarisht pas atdheut të tij, dhe dashurues i ngulmët i racës së tij, ndeshen mjaft shembuj të pashoq të tolerancës fetare dhe të atdhetarisë.

Më në fund Mitkoja uron që përmbledhja me tekste popullore shqiptare të arrijë të lexohet në mënyrë të dobishme prej të gjithë shqiptarëve të çdo praktike fetare dhe të çdo bindjeje politike dhe, të mund të jetë për filologët dhe albanologët një shtysë e re për studime më të thelluara dhe për kërkime të mëtejshme.

Për këtë atdhetar të dalluar shqiptar, De Rada shkruan: Eftimi Mitko i Korçës ka qenë gur themeli i rimëkëmbjes së atdheut të tij. Lindi në një derë, në të cilën dashuria e vërtetë për kombin e tij të braktisur ishte tradicionale. Duke u marrë me tregti dhe larg, asnjëherë nuk i hoqi sytë nga fati i Shqipërisë së tij. Në *Bletën shqiptare*, do të thoja, është në thelb ajo që ruan ende atdheu amë prej qenies së tij fisnike, dhe prej nga ngushëllohet dhe ripërtërihet.

Mitkoja përdor alfabetin grek, pothuaj të njëllojtë me atë të Kamardës me të cilin kishte marrëdhënie dhe prej të cilit risjell një copë të përkthimit shqip të shkrimit të Dora d'Istrias: *Kombësia shqiptare në këngët popullore*. Në këtë përmbledhje të Mitkos lexohen më tepër se 500 proverba dhe gjëagjëza në tekstin shqip me përkthimin në greqishten popullore, një varg mënyrash përshëndetjeje dhe emrash vetjakë të njerëzve, një pjesë të cilëve i ka nxjerrë nga vepra e Hahnit.

Përmbledhja ka shumë këngë të Shqipërisë dhe të kolonive të Greqisë e të Italisë: janë këngë alegorike dhe satirike (38); këngë për festa të caktuara (19), nga të cilat tre për Ringjalljen e Lazarit, dy për Pashkët; këngë dasme (56), këngë dashurie (84, 12 gege), këngë heroike (98, mbi 25 gege), një këngë e përmortshme.

Prej këngëve të *Bletës shqiptare* një numër i mirë i tyre ishin ribotuar, me variante dhe më të ndrequra në drejtim dhe në metrikë, mes Këngëve popullore të Shqipërisë nga Zef Skiroi, bashkë me përkthimin në gjuhën italiane. Një botim me shtesa dhe ndreqje i kësaj përmbledhjeje të Mitkos, është botuar në këto vite nën kujdesin e Gjergj Pekmezit.

Mitkoja ka lënë përmbledhje të tjera në dorëshkrim mjaft të rëndësishme, me poezi dhe rrëfime popullore, prej të cilave botoi ndonjë në revista apo në vepra ku

[803] Gaetano Petrota, *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Almera, Tiranë 2008, f. 218.

qe kërkuar bashkëpunimi i tij për gjuhën shqipe, dhe la ndonjë krijim të tij jo krejt të shpërfillshëm.

Këngët, ai është përpjekur t'i grumbullojë sipas tematikës dhe t'i rendisë pas një kriteri kohor. Në brendinë e këtyre këngëve shihet përpjekja e autorit për gjallërimin e tyre, për nxjerrjen në dukje të traditave heroike të popullit tonë.

Këngë të tjera popullore të mbledhura nga Mitkoja ishin botuar në veprën e titulluar: *Mialt'e Mbletësë e Dodanit*, botuar në Bukuresht në vitin 1898: është një vëllim me 234 faqe, që përmban vargje, poezi, proverba dhe krijime të tjera të letërsisë popullore.

Spiro Dineja, thotë se Mitkoja kishte tashmë gati për shtyp një përmbledhje të re me tekste popullore shqiptare, më të pasur se ajo e botuar dhe së cilës i kishte dhënë titullin *Mbleta e Vogël*.

Edhe Majeri, në fashikullin VI të Studimeve Shqiptare të tij, flet për një përmbledhje në dorëshkrim të Mitkos, prej të cilit ai nxori, përveç disa këngëve gege, pjesën më të madhe të teksteve në dialektin toskërisht që përbëjnë pjesën e dytë të krijimeve të këtij fashikulli VI.

Mitkoja i kishte dërguar një pako të madhe me tekste të ndryshëm shqip Majerit, i cili askohe ishte në fillimin e studimeve të tij mbi gjuhën shqipe, dhe e luste, nëse do të ishte e mundur, t'i botonte ato.

Majeri kopjoi shumë krijime nga dorëshkrimi i Mitkos, dhe botoi tre rrëfime dhe 21 këngë dasme të Korçës mes leximeve që i kish bashkangjitur Gramatikës shqipe të tij. Në fashikullin VI të përmendur botoi, vetëm në tekstin shqip, 8 këngë me temë të ndryshme, 7 këngë të përmortshme apo vaje dhe një fragment, 7 këngë dasme, një këngë për Krishtlindjen, tre këngë mbi Shën Lazarin, një poezi të vogël me tre vargje, dhe më në fund nga vargu i përnumërt i këngëve të dashurisë zgjodhi 55 poezi të shkurtra. Disa prej atyre jane variante të atyre të botuara më parë nga vetë Mitkoja; të tjera të Dozonit.

Në arkivin e IGJL-së në Tiranë ruhet një fond i gjetur në Arkivin e Mitkos në Aleksandri nga akademik Jorgo Bulo gjatë dy ekspeditave kërkimore më 1984 dhe më 1986 është sjellë prej tij në Shqipëri dhe është depozituar një pjesë në Arkivin e IGJL-së dhe pjesa tjetër, më e madhe, në Arkivin e Shtetit.

Fondi në fjalë është mjaft i gjerë, ai përmban tekste folklorike të mbledhura prej Mitkos, krijime origjinale të tij, poezi, prozë e studime, një radhua me kujtime, një fjalor shqip-greqisht në fletë të shkëputura, letërkëmbim të Mitkos me veprimtarë të lëvizjes politike e kulturore të Rilindjes dhe me albanologë të huaj dhe dorëshkrime të tjera që interesojnë historianin e letërsisë, etnologun, filologun në kuptimin e gjerë të fjalës dhe historianin e kulturës në përgjithësi.

Prej këtij fondi që përmban tekste të botuara e të pabotuara prej Mitkos, ose variante tekstesh të botuara prej tij, gjatë këtyre 15 vjetëve nga koha e sjelljes së

tyre në Shqipëri, nuk është vënë në qarkullim shkencor[804].

Megjithë atë nuk u mësua fati i dorëshkrimeve në fjalë, dhe në asnjë vend nuk kam gjetur ndonjë shënim për to. Këto përmbledhje të Mitkos do ishin mjaft të çmueshme, ndërkohë kur për botimin e *Bletës Shqiptare* Majeri shkroi: me këtë libër është provuar si e sigurt ajo për të cilën më parë dyshohej, domëthënë se edhe tek shqiptarët jeton ndër këngët kujtimi i ngjarjeve të ndryshme të historisë kombëtare[805].

Lëvizja romantike në Europë kishte ngjallur një interes të dukshëm për traditat folklorike dhe letërsinë gojore. Këngët popullore dhe përrallat popullore shqiptare kishin rrëmbyer imagjinatën jo vetëm të shkrimtarëve shqiptarë gjatë Rilindjes Kombëtare, por edhe të studiuesve dhe gjuhëtarëve të huaj të shek. XIX. Përmbledhja më e hershme e letërsisë gojore shqiptare u botua në Gjermani nga Johan Georf fon Han[806].

Duke iu referuar krijimtarisë artistike, këngëve të dasmës në rastin tonë dhe sidomos kur bëhet fjalë për konceptimin artistik të figurës së nuses, do të vërejmë se këto nocione si e mira, e dobishmja janë të njëhësuara me të bukurën.

Kënga është një element i estetikës së pjesës së mbledhjes së folklorit nga Thimo Mitkoja, kënga e përcolli jetën e njeriut në të gjitha situatat e jetës së përditshme si: në punë, në lojë, në gëzim, në dasma, në raste hidhërimesh.

Korpusin e këngëve lirike e përbëjnë: këngët e motmotit, ninullat, këngët e lojërat e fëmijëve, këngët e dashurisë, këngët e dasmës, këngët e punës, këngët e mërgimit, vajet.

Karakteri shoqërues i tyre me ritin flet për kohën e krijimit dhe vjetërsinë e këtyre këngëve nëpërmjet të cilave mund të vërehet një ecuri e artit letrar gojor në periudha të caktuara historike[807] si në këngët: *Kënga e Gjikës Thana Borsijotit, kënga e spahinjve, kënga e një zihjes në mest të kështerëve edhe mohamedanëve himarjotë, kënga e luftës së Turqisë në Korfus, kënga e Kurt pashë Beratit, më 1798, u bë lufta e Ali-pashës kundra gjytetit Shën Vasil në Himarë, një copë e këngës së Rexhepit, kënga e Rustem Dibranit zëvëndësit të Rexhepit, kënga e Hyso Shahinit*, etj.

Këngët e motmotit, këngët e punës dhe këngët dhe lojërat e fëmijëve janë kryesisht të lidhura me këngët ritualo-zakonore, këngët dhe lojërat për fëmijë, këngës e punës ku shpreh një estetikë të pasur si në rastet e këngëve: Këngë që këndohen ndër disa ditë të shënuar si në rastet: *E shën Lazërit*: As na ep tri koqe ve, / ashtu paç tri pëndë qe, / sa qepra edhe drasa, aqe nuse, aqe vasha, / sa lesh mbi treqin buaj, aqe parë mbë një muaj[808], *Për kolendra këndohet:* Dil moj /, dalç e

[804] Besa Vila, *Një dorëshkrim i hershëm i Thimi Mitkos*, Studime filologjike, nr. 3-4, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2001, f. 145.
[805] Gaetano Petrota, *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, vep e cit., f. 220.
[806] Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 216.
[807] Leontina Gega-Musa, *Studimi dhe karakteristikat e lirikës gojore*, në: Gjurmime albanologjike, Folklor dhe Etnologji, 43/2013, Instituti Albanologjik, Prishtinë, f. 64.
[808] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 37.

bardhë, / gjer'mot me një djalë, / dil moj, dalç e kuqe, gjer'mot me një nuse[809], Ndë Berat këndojn fëmija për Shën Gjon, që bje në muaj qershor si në vargjet: Triko, triko, i shën Gjini, / Sa vjen zot'i shën Pjetri, / i shën Gjini erth, e shkoj, / i shën Pjetri na afëroj[810], f. 41.

Një tjetër e këtillë, të cilën e këndojnë më të parin e marsit, si mallkim kundra gjarpërinjve e të tjerëve shtazëve të dëmshme si në vargjet: Ikëni, gjërpënj, / ikëni, /shtërpënj, / Se vjen i Vagjelizmoj, / Pa ju vret, e pa ju pret, / Me kordh'edhe me dyfek[811].

Dhëndëri i dërgon robat nusës, / Dhëndëri me përsjellësit arrin te nusja, / Niset nusja me dhëndërin, / Kur hyn nusja të dhëndëri, / Kur e stolisin nusen këndojnë.

Në këngët lirike të dashurisë, krijuesi gojor ka shprehur tërë lirizmin e tij, me një thjeshtësi kuptimore, por të sinqertë dhe të pasur artistikisht. Këto këngë që përfaqësojnë një pjesë të madhe të lirikës gojore, janë tematikisht dhe artistikisht të veçanta, sepse në to na shfaqen situata të papritura dramatike të të dashuruarve, gjithmonë në ballafaqim të dëshirës së djalit ose vajzës me pamundësinë e realizimit të dëshirës së tjetrit si në vargjet: të *Kënga shqype dasëmore*: Ku këndojnë ato fëllënxa? / Atje lart n'ë ato dëllinja, / Këmbëkuqe, moj fëllënxë, / Thua j a mb'avazë tëndë, / Them të vete të marr njëzë, / T'a kem, q ëtë los me tëzë[812], ose në këngën: *Kur shkon dhëndëri me krushq*, që të mari nusën këndojn: Dyzet e pesë kalorë, / Dhëndëri vezir mbi ta, / Gjithë me dyfek ndë dorë, / Dhëndëri vezir mbi ta, / Gjithë mveshurë mbë cohë, / Dhndëri vezir mbi ta[813].

Në këngët lirike të dashurisë na shfaqen tablo të përshkrimit fizik të vashës, krijuesi shfrytëzon figuracionin e pasur popullor[814] si në vargjet: Sy-zezë,/ vetull-hollë,/ leshtë tat derdhur' si fqollë, o, moj dardha rrumbullake, me furkën, jakë pasdarke, moj je dardh' a mos je ftua?, ndë je ftua, je për mua, të të puth, te të dua, të të shtrydh posi limua[815].

Lirika gojore e Thimi Mitkos, përveç pasurisë tematike karakterizohet edhe me një pasuri vlerash artistike, me një nivel të lartë shprehës dhe me mesazh të pasur poetik me figura stilistike si: epiteti, metafora, krahasimi, hiperbola, krahas kësaj pasurie të gjuhës poetike për këngët lirike mbeten veçoritë karakteristike, si: improvizimet, formulësimet, përsëritjet që e përforcojnë origjinalitetin e krijimtarisë letrare gojore si në rastet e këngëve: *Fjalë të moçmë* si: Tek është dashurija, është vetë perëndija, koka, që s'dëgjon, më shumë pëson, barku plot, s'kërcen dot, kur ti nuk e ke zanat mos u bëj hoxhë në fshat, ka keq, e më keq, guri, që s'rri mbë një

[809] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 40.
[810] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 41.
[811] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 42.
[812] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 49.
[813] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 50.
[814] Shefqet Pllana, *Këngët popullore të dashurisë*, GJAFE, nr 33-34, IAP, Prishtinë 2005, f. 58.
[815] Thimi Mitko, *Bleta Shqyptare*, vep e cit., f. 76.

vënd, rrënjë nukë zë, hypi kali të zotin, ferra e nisi, ferra e grisi, mos u zgjat se këput mish, ku është lart e s'arrin dot. më mirë t'idalë syri, sesa i lik.

Përfundime:

Si rrjedhim i kësaj, mund të themi se nisur nga studimi i *vlerave semantike dhe funksionale*, të folklorit që mbledh, është i distancuar nga orientimi lokal. Ai zbaton ***metodën filologjike***. Nisur dhe nga *perspektiva antropologjike*, mund të themi se përparësi studimi kanë këngët dhe format e tjera verbale të traditave gojore ose objektet e tjera të kulturës materiale, kryesisht ato me natyrë artistike, ndërsa ceremonitë, ritet dhe praktikat e ndryshme mund të konsiderohen mbijetoja të institucioneve folklorike.

- *Në anën analitike dhe antropologjike*

Qëllimi i tij kryesor ishte objektiv: T'u siguronte shqiptarëve një identitet kombëtar, për të forcuar dhe bashkuar kombin gjuhësisht dhe kulturalisht. Qëllimi i tij ishte të regjistronte etnografinë folklorike dhe ritet zakonore, për të rritur e ndërgjegjësuar atë, po dhe për ta ruajtur gjatë në kujtesë. Puna e tij mbledhëse është akt i pastër etnocentrizmi. Në kohën kur shënohej dhe botohej krijimtaria jonë folklorike ndër popujt e tjerë të Ballkanit, të Europës dhe të botës krijimtaria folklorike ishte zbehur. Ndërsa të shqiptarët kjo krijmtari ishte ende e gjallë, jo vetëm në fazën e bartjes, por edhe të përtëritjes së saj. Me fjalë të tjera në krijimtarinë letrare gojore kishte ende krijues aktivë e jo vetëm bartës pasivë. Ishte kjo kohë e volitshme për të mbledhur krijimtarinë letrare gojore e cila kishte një rëndësi të madhe në planin kulturor kombëtar. Edhe pse mbledhja e folklorit shqiptar kishte filluar që me 1635 me Frang Bardhin që kishte mbledhur e botuar 113 proverba, më vonë kemi dorëshkrimin e Kieutit (1737) të Nikollë Filjes, përmbledhjet e Vinçenc Dorsës, të Dhimitër Kamardës, Rapsoditë e De Rades (1866) si dhe Bletën Shqiptare të Thimi Mitkos (1871).

Materialet e mbledhura nga ato kanë vlerën e madhe dhe të pakontestueshme. Mund të thuhet se këto mbledhës ashtu si dhe si vëllezërit e tyre, që në fillim të shekullit XX, kishin bërë një punë sistematike dhe të organizuar në mbledhjen dhe botimin e folklorit shqiptar. Të gjitha këto krijime dallohen për vlerën tyre artistike dhe pasurinë tematike.

Mitkoja mbledhjen e krijimtarisë folklorike nuk e bënte rastësisht. Gjatë regjistrimit të saj ai kërkonte vlera të mirëfillta; kjo duket në larushinë e llojit dhe tematikës.

Vlerat e tilla i kërkonte në shumë plane. Nga materialet e shënuara del se ai ishte i përqendruar në gjetjen e bartësve të talentuar, në hulumtimin, gjetjen dhe shënimin e gjithçkaje shqiptare (veçojmë përrallat me figura dhe qenie mitologjike dhe me mjete mitike). Duke qenë njohës i mirë i kulturës, si albanolog, ia ka arritur që këto dukuri t'i gjejë në lirikën dhe prozën gojore jo vetëm si dëshmi për ekzistencën e tyre, ato i kërkoi dhe i gjeti të funksionalizuara brenda krijimeve letrare artistike gojore, sidomos brenda lirikës, epikës.

Ai ishte i vetëdijshëm se ato që i shënonte dhe i botonte ishin një vlerë e rëndësishme për kulturën shqiptare, prandaj edhe thotë: "(...) domethënia e këtyre studimeve albanologjike, është përgjithësisht, shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë, i fjalëve dhe teksteve shqipe, të cilat para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime dhe besoj se do të kenë vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare; veçanërisht dua që t'u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën dhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare, që, me këtë mënyrë t'u sjellë dobi që të mundin edhe këta të përparojnë"[816].

Ky kërkim i krijimeve popullore tregonte se ai i njihte botimet e vlefshme dhe të rëndësishme të shumë popujve të njohur të botës, prandaj edhe qëllimi i tij ishte që me botimin e krijimtarisë folklorike, përkatësisht asaj letrare gojore të dëshmojë se krijimtaria jonë letrare gojore ka një identitet të vetin, ka një traditë të lashtë dhe të pasur artistikisht. Këtë bindje e fitojmë kur i lexojmë parathënien e Bletës, ka dhënë gjithashtu një pamje unike të traditave shqiptare në perspektivë historike, sidomos në fushën e kulturës materiale, organizimit shoqëror, apo mitologjisë dhe besimeve, madje jep edhe disa vëzhgime interesante rreth ndryshimeve sociale.

Ai kishte njohuri se përralla si zhanër i prozës gojore ka një strukturë kompozicionale specifike dhe të kodifikuar, prandaj edhe mund të thuhet se përrallat e botuara nga ai kanë një strukturë të qëndrueshme kompozicionale dhe mund të analizohen sipas sistemit të funksioneve të V.J. Proppit. Gjithashtu ai dëshmon se këto përralla kanë specifikat nacionale në aspektin përmbajtësor, por edhe kanë specifikat universale në aspektin e strukturës sintagmatike dhe kompozicionale, por edhe të motiveve ndërkombëtare.

- *Në rrafshin përmbajtësor*

Mund të thuhet se këngët epike, lirike, baladat e fjalët e urta shquhen për një pasuri tematike me kuptime thelbësore. Ai i përcillte me kujdes studimet, teoritë dhe metodat e studimit të krijimtarisë letrare folklorike. Kjo duket në parathënie e sidomos në letërkëmbimet ku shkruan me kompetencën e një studiuesi. Mund të themi me bindje se ai ishte në dijeni për teorinë mitologjike (se mbledh këngë rituale), për teorinë historiko-gjeografike (se mbledh lloje të këngëve si arbëreshe, gege e të jugut), për teorinë e animizmit (mbledh këngë ku shpirtërizohen kafshët), për teorinë antropologjike (sepse mblodhi këngë që trajtojnë çështje thelbësore të tilla si nacionalizmi, përfaqësimi gjuhësor, përfaqësimi i kulturës materiale, racën dhe diferenca gjinore, migrimit, fesë dhe të ekonomisë. etj.

Parathëniet e shkurtra me esence shpjeguese, datuese, janë *analizë* e njohësit të thellë të lëndës, të strukturës kompozicionale, tematike, motivore, përmbajtësore e estetike. Ai ishte i vetëdijshëm se kultura gojore shqiptare[817]

[816] Akademia eShkencave të RPSSH, IKP, *Thimi Mitko,* vepra, Tiranë, 1981. f. 43.

[817] Edith Durham se: "Perandoritë e tjera erdhën e ikën, por ato kaluan mbi shpinën e shqiptarit, si ujët mbi shpinën e rosës… dhe ai ruajti zakonet dhe identitetin e tij", (Durham: *Brenga e Ballkanit* 1991, f. 104).

është shumë e lashtë dhe lashtësia e saj dëshmon lashtësinë e etnisë tonë, prandaj dhe lëndën që mbledh e vë në raport të barabartë me një traditë të pasur kulturore.

Kjo duket në qëndrimin "nacionalist". Përballë qasjes krahasuese, duhet të kemi parasysh se është me rëndësi të konsiderueshme kur flitet për metodologjitë. Përmes këngëve të dasmës, epikës historike kemi ***metodën shpjeguese*** dhe ***krahasuese*** kur jep më shumë se një variant.

.

SHABAN SINANI (TIRANË)

BËLETA SHQIPËTARE E TH. MITKOS DHE BLETA SHQYPËTARE E GJERGJ PEKMEZIT[818] (NJË KANGJELJ I MILOSAAT NË KOLEKSIONIN E MITKOS)

I.

Bëleta shqipëtare (*Αλβανικά Μέλισσα*), e botuar për herë të parë në Aleksandri më 1878, ndonëse *gjithëshqiptare* në shtrirje dhe në përmbajtje, iu adresua përparësisht lexuesit të një qarku letrar, që E. Çabej, duke vënë si kriter alfabetin, e quante *qarku ortodoks jugor*. Megjithëse në kohën e botimit të parë të *Bëletës* alfabeti i greqishtes ishte në përdorim edhe tek një pjesë e poetëve dhe studiuesve arbëreshë, si D. Camarda, ajo do të mbetej për një kohë relativisht të gjatë në shkallën e një *nënsistemi letrar*, pavarësisht se njihej mirë prej shumë albanologëve të huaj dhe prej shkrimtarëve të Rilindjes[819].

Në kohën që u botua dhe sidomos më pas, *Bëljeta shqipëtare* e Mitkos shenjohet si nga të parat vepra që dha provën e kapërcimit të alfabetit si kufi. Ishte dr. Gjergj Pekmezi ai që, me ribotimin e saj pas afro 40 vjetësh (Vienë 1924), duke e tejshkruar me alfabetin latin, përmes sistemit grafematik të shqipes miratuar në Kongresin e Manastirit (1908), e integroi për herë të parë në tërësi *Bletën shqypëtare* në sistemin letrar kombëtar shqiptar[820].

---

* Për konferencën shkencore ndërkombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos, në 195-vjetorit të lindjes, organizuar nga Universiteti *Fan S. Noli*, Korçë, në bashkëpunim me Universitetin *Aristotel* të Selanikut (*Αριστοτέλειο Πανεπιστήμιο Θεσσαλονίκης)*, Università degli Studi di Calabria dhe Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë, 25-26 mars 2015.

819 Jeronim de Rada mund të vlerësohet si një prej njohësve më të cilësuar të *Bëletës shqiptare* në kohën e botimit të saj. Për këtë vepër ai shkroi që në numrin e parë të së përmuajshmes që drejtonte *Fiamuri Arbërit*. Në lidhje me *Bëletën* dhe autorin e saj De Rada shkroi në këta numra të *Fiamurit*: janar 1883, f. 1, kryeartikull; qershor 1884, p. V (*buljarët e rinj të Arbërisë*); korrik 1884, p. VI-VII (*Topografia e Corcës*, artikull i Th. Mitkos); maj 1885, p. I (letër e Mitkos për De Radën); prill 1886 (*Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi*, artikull i Mitkos për toponimet arbëreshe të njësojta me ato të Shqipërisë); prill 1886, p. I-II (lajme nga Misiri prej Th. Mitkos); nëntor 1886, p. VI-VII (*letër e korçarit Orhan Cercis për Thimi Mitkon*); mars 1887, p. VII (letër tjetër e Mitkos për De Radën); maj 1887, p. I (*Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi*: De Rada shkruan për *Bëljetennë Shsceptāre* dhe krahason rapsodinë e mbledhur prej tij në *Rapsodie di un poema albanese* me titull *Vién marsi mire se vién* me disa motive këngësh rituale-kalendarike të mbledhura prej Mitkos); maj 1887, p. IV (De Rada i shkruan Mitkos dhe i drejtohet *catundaar e velaa Mitko - bashkatdhetar e vëlla Mitko*). Nuk kemi pasur mundësi të kështillojmë numrat e munguar të koleksionin e *Fiamurit*, publikuar në *Biblioteca Deradiana*, nën drejtimin e Francesco Altimarit, të cilit i shprehim mirënjohjen për lehtësitë e krijuara.

** Për fat të keq, *Bleta shqyptare* e dr. Gjergj Pekmezit, megjithëse në më të shumtën e rasteve këngët e saj ribotohen sipas tejshkrimeve të tij, nuk u përmend për më shumë se një gjysmë shekulli në studime e botime, duke përfshirë edhe vëllimin I *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar* (bot. i Institutit të Folklorit, Tiranë 1962). Shih dhe Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko (1820-1890)*, Tiranë 1962, f. 105-109.

Për fat të keq, në botimet e mëvonshme të *Bletës shqiptare*, që për çudi nuk u bë pjesë e serisë *Visaret e Kombit*[821], kur u përfshi në përbërje të kolanës *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, përveç mjaft cenimeve në tekstin e mbledhur prej Mitkos, u dëshmua dhe një qendrim nënçmues për punën filologjike të Pekmezit, i cili mund të cilësohet si një prej bashkëthemeluesve të filologjisë shqiptare.

Bashkë me K. Kristoforidhin, i cili përshtati për herë të parë 14 kangjelje prej *Rapsodive të një poemi arbëresh* të De Radës, të pabotuara ende deri më sot, në *Fondin e Lef Nosit* në AQSH ku ruhen prej më shumë se një gjysmë shekulli, Thimi Mitko është themelues i traditës së ndërkomunikimit të traditës gojore dhe të letërsisë romantike arbëreshe me sistemin letrar shqiptar.

Gjergj Pekmezi në tërësi nuk e preku veprën e Mitkos. Tirazhin e botimit të vet ia dhuroi *shtëpisë jetimore të Korçës*, e cila mund dhe ta shiste, *për lirimin e sajë* nga shpenzimet e shtypshkrimit dhe të transportit[822]. Përmes një shpjegimi hyrës, Pekmezi njofton korrektësisht lexuesit për punën që ka bërë me *Bletën* në procesin e ribotimit të saj të parë me alfabetin e njësuar të shqipes, duke tejshkruar gjithë lëndën folklorike me këtë alfabet, si dhe duke përkthyer prej greqishtes hyrjen e Mitkos dhe shenjimet shpjeguese të tij[823]. Në të njëjtin koment hyrës me titullin *Shpjegim*, Pekmezi bën të ditur, gjithashtu, se çfarë la jashtë prej saj në botimin e tij, për shkak t*ë shtrentësisë së madhe të shtypit të sotëm*:

1. *Katër fletë me disa këndime historike të Dora D'Istrja, të përkthyera e shtypura më tjetër vent prej Dhimitri Kamardës*;

2. *Shqypëria para zapëtimit të turkut*;

3. *Istorija e Vasilit të Janosë dhe e Mahmut beut Vlorës*;

4. *Kënga e parë e këngave shqype trimërishte, e cila nuk është këngë popullore, po është një vjershë e z. K. Dorsës edhe ishte e shtypur prej z. Dh. Kamardës 'Vdekja e Skanderbegut'*;

5. '*Kënga e Veli Gegës Dervenagajt të Ali pashës' është gërkisht e u përkthye shqyp prej z. Dr. Bashos*;

6. *Mbet pa u shtypur dhe një vjershë e De Radës*;

7. *Gjithashtu e lashë pa shtypur dhe fjalurthin e vogël, i cili nuk përmban fjalë që kanë nevojë për shpjegim*[824].

---

821 Me të drejtë shkrimtari Milto Sotir Gurra, në artikullin e tij me titull *Thimi Mitkua*, botuar në të përditshmen *Bashkimi i kombit*, 5 mars 1944, ankohej: *U bënë shumë punime, u shtypnë shumë Visare të Kombit, u muarnë shumë pjesë nga 'Bleta shqiptare', po nuk u kujdesua askush të bënte një rishtypje të mirë të 'Bletës shqiptare'*.

822 Dr. Gjergj Pekmezi (*e përshkroj me shkrojla shqipe, e përktheu shqyp dhe e radhiti*), *Bleta Shqypëtare*, Vjen-ë' 1924, f. 4.

823 Po aty, f. 5-9.

824 Po aty, f. 9.

Gjergj Pekmezi (në qendër), Faik Konica dhe Fan S. Noli
në fillimet e shoqërisë shqiptaro-amerikane *Vatra*.

Pekmezi jep shpjegim pse në botimin e tij nuk janë përfshirë për të gjitha rastet e përmendura më sipër, përveçse për poezinë e De Radës. Duke qenë se në kriter ai nuk i përfshiu te *Bleta* e tij disa nga përkthimet dhe krijimet autoriale, mund të mendohet se kjo ishte arsyeja dhe për vjershën e De Radës: për të njëjtën arsye mbetën jashtë saj edhe *disa këndime istorike të Dorës d'Istrja të përkthyera e të shtypura shqyp edhe më tjetër vent prej Dhimitri Kamardës: faqe 1-2 'Folia shqypëtare nga këngët e llauzit' (dhe një pjesë e istorisë 'Dora de Istria' që u shpall ndë dhetoret 'Epitheorisis ton dhio kosmon'* (*'Επιθεώρηση τον δύο κόσμον'*) - në origjinal me titullin *'Fylétia e arbenoré prèj kanekate laoshima*[825] *- në Paris që qe e nkëthyer thuajse mbë të gjitha gjuhët e Europës edhe zoti Kamarda e nkëtheu shqyp me shkronja italishte mbë 1857*[826]. Mirëpo ky mbetet një argument i pamjaftueshëm duke vërejtur se nuk e mbajti të njëjtin qendrim me poezinë *Burri klan gruan e tij q'i vdiq*[827], poezi-vajtim me karakter autobiografik e vetë Mitkos; lirikën *Tri zogëza po rrinë*, që studiuesit e cilësojnë përkthim nga greqishtja[828], dhe tri-katër të tjera janë quajtur përshtatje dhe përpunime[829].

[825] Eshtë fjala për *Fylétia e arbenoré prèj kanekate laoshima, enkethyeme ne shkjipe perèi Demetrio Camarda*, *në Livurnë, te typografia e P. Vannini e të biritë*, 1867, përkthim shqip i D. Camarda-s i studimit të Dora d'Istrias *La Nationalité albanaise d'après les chants populaires*, botuar në *Revue des Deux Mondes*, 1866.

[826] Dr. Gjergj Pekmezi (*e përshkroj me shkrojla shqipe, e përktheu shqyp dhe e radhiti*), *Bleta Shqypëtare*, Vjen-ë' 1924, f. 8.

[827] Dr. Gjergj Pekmezi, vep. cit., f. 205. Gjithashtu Qemal Haxhihasani, vep. cit, f. 89.

[828] E paraqitur si e Sulit (Dr. Gjergj Pekmezi, po aty, f. 205), prej studiuesve është konsideruar këngë lirike greke e përkthyer prej Mitkos. Shih tek Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko (1820-1890)*, shtëpia botuese *Naim Frashëri*, Tiranë 1962, f. 89.

[829] Eshtë fjala për këngët kushtuar Marko Boçarit, Dhosi Zados, Abidin Pirgut etj. Shih Qemal Haxhihasani, vep. cit., f. 89.

Më anë tjetër, nëse mund të supozohej që Pekmezi e la jashtë kangjeljin e De Radës për shkak të gjuhës, sërish mbetet pyetja pse nuk e mbajti të njëjtin qendrim me ciklin e poezive të botuara më herët prej D. Camarda-s dhe të zgjedhura prej Mitkos për *Bëletën* e tij me alfabet të greqishtes[830].

Mbetet të mendohet se Pekmezi e la jashtë *Kangjeljin VII* të *Milosaat* sa për shkak të autorësisë (rasti nuk ishte krejt i ngjashëm me poezitë e Mitkos, sepse në një farë mënyre ky ishte autor i gjithë librit), aq dhe për faktin se, në procesin e përshtatjes, teksti i ishte larguar jo pak burimit.

II.

Se cila ishte poezia e De Radës që gjendet në botimin e parë të *Bletës*, këtë e ka njoftuar vetë Mitko dhe e ka verifikuar e krahasuar studiuesi Titos Jochalas (*Τίτος Γιοχάλας*), në trajtesën e tij *I rapporti di De Rada con gli Arvaniti di Ydhra*, paraqitur në konferencën kushtuar De Radës në 200-vjetorin e lindjes (Università della Calabria, 28 nëntor 2014)[831]. Mitko shkruan, në hyrje të kësaj kënge: *E përshtati prej 'Rapsodive shqiptare' të De Radës dhe e dërgoi për mua z. P. Kupitori i Ydhrës (Kënga VII)*[832]. Në të vërtetë kjo këngë është marrë nga botimi i tretë i *Këngëve të Millosaut* (1873)[833] dhe jo nga *Rapsodi e një poemi arbëresh*.


Παρεφράσθη ἐκ τῆς τοῦ DE RADA Ἀλβανικῆς ποιή-
σεως, καὶ μοὶ ἐστάλη ὑπὸ τοῦ Κ. Π. Κουπιτώρη
Ὑδραίου (ἄσμα 7ον.)

Thimi Mitko, *Bëljeta shqipëtare*, Aleksandri 1878, f. 95.

Pra, është fjala për *Kangjeljin VII* të poemës *Milosaat (Milosāt)*, botimi i tretë (Corigliano Calabro 1873), me titullin e plotë *Poesie albanesi di Girolamo de Rada, volume I. Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari.*

Eshtë pikërisht kënga që nis me vargun *Cë të veen ndë dètit / noeriit ʒëmëra ime*, në të cilën studiuesit gjejnë vargun manifest të ndjenjave atdhetare të De Radës: *Erδ ditta e Arbërit*! Mitko e pati përfshirë këtë kangjelj në kreun *Këngë shqiptare heroike - Këngë shkipe trimërishte* (*Αλβανικά άσματα χεροικα*), krahas me një numër të madh këngësh historike kushtuar Ali pashë Tepelenës, Marko Boçarit,

[830] Dr. Gjergj Pekmezi, vep. cit., f. 67.

[831] Krhs dhe Titos Jochallas, *Hidra, gjuha e harruar* (**Τίτος Γιοχάλας,** *Ύδρα, λησμονημένη γλώσσα)*, në dy vëllime (τόμ. Α/-Β/), Αθήνα 2006.

[832] Thimi Mitko, *Bëljeta shqipëtare* (*Αλβανικά μέλισσα*), Aleksandri 1878, f. 85.

[833] Kjo këngë, me titull '*Çë te vēn nde dejtit / noerīt zemëra ime?*', në botimin e parë (1836) mban numrin *Kangjelji V*; në botimin e dytë (1847) renditet si *Kangjelji VII* dhe po këtë numër mban në botimin e tretë (1873). Teksti i përshtatur nga Panajot Kupitori i përgjigjet *Kangjelit VII* në *Canti di Milosao*, Firenze 1873, p. 34-35.

heronjve suljotë e arvanitas të revolucionit grek, Bushatlinjve dhe protagonistëve të kryengritjeve shqiptare antiosmane. Mitko e rendit këtë kangjelj me numrin 94 në koleksion. Tërthorazi, ajo bashkohet me *këngët trimërishte toskërishte*. Këngët heroike gegërishte nisin vetëm 4-5 njësi më tej dhe ndahen më vete.

***Kangjelji VII*, i *Milosaat*, teksti arbërisht**	**Teksti italisht i prozifikuar, autopërkthim**



VII.

nder 4 të Lonârit 1406

Cë të veen ndë dëtit
noeriit Zemëra imme?
Shardëtin aniZit,
rëatin, pran' u shëghtin;
erë ditta e Arbërit!
Ndómòs, vëdëcuris
mbi shtratti na vemnië
mos përpara shpivet;
e te botta na garronnen
shoet e vëlëZerit,
cronjet, e catundi iin.
Nanni cë natta e ZeeZ
me të bûttë'in një shii
paru më përbaljtën uJët,
gapni ju dërian
tech të Zódura copiljet
ljottënjëa garrûamië.
Vasha foor-madia
më rrëmbëft për dôrie
t buvZ-Zahmen,
mua m' ó siélt përparanië.
Cëra më i JëZiet
me ndë mest sh ënchë'in
eë te xóshinj e Jürmez.
Vet cë siit të na rûghian
jetta ò të për mbsiet.



VII.

a' 4 Luglio 1406

Perchè ti vanno i pensieri al mare, o cuor mio? Hanno biancheggiato le navi Turche, hanno mirato e poi sono disparite. Si approssima il grande giorno d'Albania!...

E sia pure: noi avremo a giacer morti ne' letti se non cadiamo combattendo avanti alle case. E un giorno dovrà essere che sotto la polvere ci si dimenticheranno i compagni, i fratelli, le fontane ed il paese nostro.

Or che la notte fosca infanga da per tutto le strade con una morbida pioggia, aprite, o voi, la porta della casa, ove raccolte le donzelle danzano immemori di sè medesme.

La giovine più dispotica si pigli per mano quella mia ninfa di bocca graziosa e la meni a danzar meco. Il volto di lei con la piccola incisione che 'l segna nella guancia, si farà di fuoco, com' ella pudica sorriderà.

Che gli occhi nostri si scontrino guardandosi, e poi rovini l'Universo!

***Kangjelji VII, Milosaat*, Firenze 1873, p. 34-35.**

Sipas konstatimit të studiuesit greko-shqiptar Titos Jochalas, kjo poezi qe përshtatur në të folmen e arvanitëve të Hidrës (Ydhra) prej Panajot Kupitorit. Mitko e përfshiu atë tek *Bëleta* si një përshtatje, më saktë si një rikrijim, sepse Kupitori jo vetëm e pastroi poezinë prej italianizmave, por dhe e aktualizoi në përmbajtje, duke forcuar frymën antiosmane. Jochalas ka të drejtë sa i takon pohimit se në tekstin shqip të Kupitorit kundërshtari identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mund të krahasohen këto vargje, në të cilat duket se me të vërtetë Kupitori e ka aktualizuar tekstin e De Radës dhe ka shtuar tonet marciale, që mund të diktohen në leksemat *turka* (për anijet) dhe *ljuftë* (që mungon te poeti):

Tek De Rada	Tek P. Kupitori
Sbardhëtin anizit	Sbárdhë návetë turka
… … … … … … … … … …	… … … … … … … … … …
Erdh ditta e Arbërit!	Arbërìs' i érth dita!
Ndómòs, vëdékurith	Kliòftë véemi ndë ljuftë
… … … … … … … … …	… … … … … … … … …

Nuk mund të hamendësojmë nëse Kupitori, duke përshtatur në arvanitikisht poezinë e De Radës, sa i takon frymës, qe i ndikuar edhe prej tekstit italisht të saj, ku nuk mungon as identifikimi i armikut turk (*le navi turche*), as dhe thirrja për të luftuar e qendruar (*se non cadiami combattendo avanti alle case*). Nuk dimë gjithashtu nëse Kupitori përshtati në arvanitikisht edhe këngë të tjera të poemës *Milosaat* apo të *Rapsodive të poemit shqiptar*. Një përgjigje të dëshmuar me burime të shkruar mbetet të pritet prej Titos Jochalas-it. E sigurt është që ai i kishte në duar *Milosaat* në shqip dhe autopërkthimin italisht, sepse botimi i vitit 1873 i tillë është: dygjuhësh, me tekst paralel, po aq sa është e sigurt që Mitko ishte njohës shumë i mirë i italishtes, deri në shkallën që të hartonte një fjalor trigjuhësh italisht-greqisht-shqip[834]. Në këtë kuptim, mund të mendohet se P. Kupitori nuk shtoi gjë në frymën antiosmane të kangjeljit, thjesht barti tek version shqip çfarë gjeti plus në autopërkthimin italisht:

Milosao shqip	Milosao italisht
Çë të veen ndë dèetit	*Perche ti vanno i pensieri al mare, o cuor mio?*
Noeriit, zëmëra imme?	
Sbardhëtin anizit	*Hanno biancheggiato **le navi turche**,*
Rùatin, pran' u shéghtin;	*hanno mirato e poi sono disparite.*
Erdh ditta e Arbërit!	*Si approssima il grande giorno d'Albania!*
Ndómòs, vëdékurith	*E sia pure: noi avremo a giacer morti ne' letti*
Mbë shtratt na vemith	*se non cadiamo **combattendo** avanti alle case.*

Ndryshimi më i rëndësishëm që ka pësuar kangjelji i De Radës në procesin e përshtatjes prej Kupitorit ka të bëjë me prozodinë. Ndryshe prej poezisë së De Radës, që, siç kanë mundur të provojnë tashmë studiuesit arbëreshë Francesco Altimari e Nicola Scaldaferri, cilësohet prej një ritmi tonal vetërregullues sipas modeleve poetike popullore, që qendron mbi kuantitetin formal fonologjik, përshtatja e Kupitorit pajton ritmin me sasinë e zanoreve si në gjedhet inovative folklorike të shekujve të vonshëm[835].

[834] Shih Shpëtim Sala, Pavli Haxhillazi (translit. përg. për botim), *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*, vëll. I-II, *West print*, Tiranë 2013.

[835] Nicola Scaldaferri, *Strutture ritmiche nella versificazione tradizionale arbëreshe: una proposta di analisi* paraqitur në konferencën *Letërsia dhe kultura arbëreshe: Jeronim de Rada në 200-vjetorin e lindjes*, organizuar nga Universiteti *Aleksandër Xhuvani* dhe mbajtur në Elbasan më 4-5 qershor 2014;

Poezia e Jeronim de Radës, në pikëpamje të theksimit tonal-rrokjesor, është agramatikore, ashtu si poezia tradicionale popullore arbëreshe, sepse vendosja e theksave nuk i nënshtrohet të njëjtit rend shqiptimi si në përdorimin e përditshëm, sepse masat tonale prozodike në shqiptimin e saj janë të ndryshme prej ligjërimit të zakonshëm gjuhësor. Në parimet estetike të tij rima dhe ritmi në poezinë shqipe cilësoheshin të papërshtatshme: *La rima, che alla nostra lingua, é impropria, porta sempre offensioni a grammatica*[836]. Agramatikorësinë në prozodinë popullore tradicionale, historike e lirike, përkundër rendit normal-intonativ të ligjërimit jashtë poetikës, kemi pasur rastin ta vërejmë edhe në fshatrat e Bregut të Detit, gjatë një ekspedite të karakterit ndërdisiplinar[837]. Siç pati vërejtur Arshi Pipa në veprën e tij *Trilogia albanica*, prozodia e kangjeljeve të De Radës përmban elemente të një vargëzimi gnomik-topik të lashtë[838].

Leximi paralel i *Kangjeljit VII* dhe i përshtatjes arvanitikisht lejon të kuptohet se ndryshimi është më i dukshëm në rrafshin e prozodisë se në atë të përmbajtjes.

Tek De Rada	**Tek Kupitori**
***E**rdh ditt**a** e **A**rbër**it**!*	**A**rbër**ì**s' i **é**rth d**i**ta!

Mund të mendohet se ndryshimet ritmike e tonale në *Kangjeljin VII* të De Radës kanë të bëjnë vetëm me përftimin estetik të poezisë. Në fakt, ky ndryshim ritmi, që mund të krahasohet me ndryshimin e shkallëve *maggiore* me ato *minore* në muzikë, të lirizmit me heroizmin në tipologjinë e llojit në letërsi, çon deri atje sa *besojma* e kësaj kënge, shprehur në dyvargëshin e fundmë, që paraqitet në dy variantet këtu më poshtë, në përshtatjen e Kupitorit ta humbasë krejt kuptimin, duke u zëvendësuar me një thirrje atdhetare: ***A**rbër**ì**s' i **é**rth d**i**ta!*, gjë që ka ndodhur përgjithësisht me të gjitha përshtatjet e mëvonshme, në të cilat, ndryshe prej parimeve të romantizmit, është theksuar detyra mbi ndjenjën. Sido që prekja është vetëm në rrafshin ritmik-prozodik, në fakt, *Kangjelji VII* i *Milosaave* në këtë përshtatje, nga një himn dashurie, është kthyer në marsh atdhetar:

Tek De Rada	**Tek Kupitori**
Vet çë siit të na rùghien	Pra ndë së nd'u përpiékshim
Jetta è të përmìssiet.	Déef u-rëbártë i tërë

Francesco Altimari, *Introduzione, La metrica*, p. 65 passim në *Girolami de Rada, Omera omnia*, vol. VI, *Skanderbeg sventurato* (a cura di Vincenzo Belmonte), Rubbettino Editore 2005. Shih dhe Costantino Marco, *Cenni sulla metrica del De Rada* në *Omaggio a Girolamo De Rada (a cura di Italo C. Fortino), Microprovincia,* Napoli *2003.*

[836] Girolamo de Rada, *Fiamuri Arbërit*, maggio 1884, p. IV.

[837] Shih Shaban Sinani, *Himara, identiteti i bashkësisë dhe etnotipi*, në *Himara në shekuj*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2004.

[838] Arshi Pipa, *Hieronymus de Rada*, edit. *R. Trofenik*, Muenchen 1978, *Albanische Forschungen* 18.

Për të kuptuar dallimet në prozodinë e De Radës dhe në atë të Kupitorit e shohim me vend të sjellim për shembullzim një strofë prej poezisë së tij *Vjershë satyrike*, botuar nga D. Camarda, ku lexuesi mund të vërejë rolin sovran që ka në poezinë popullore dhe atë të kultivuar toske rima, si dhe theksimi semantik, që nuk lejon paratheksime dhe as prapatheksime të fjalëve për nevoja prozodike, dukuri që do të shfaqej më vonë, bashkë me mjaft shenja të tjera konvergjence të një poetike të vetëdijshme, edhe në poezinë e Vincenzo Camarda-s, Giuseppe Schirò-it e më vonë të disa breznive poetësh arbëreshë të shekullit XX:

Kupitori	**Giussepe Camarda, *At Vincenzo Schirò-it***
Ishte trim edhe ia thotë Pse vish llaze barbarjotë Ka dhe hundën të ergjendtë Ndaj ecën me di bëndë Di puarezitë me bishtë[839].	Ti ke ljik, se kam mënuar E saa kaa ngë të kam shkruar Po mbi gjith ka t'më kesh besë Se akjë shumë nëng' i ftes ... ...[840]

Duke qenë se vepra e De Radës është receptuar për më shumë se një gjysmë shekulli në formën e përshtatjeve, të cilat sa kanë ndihmuar për njohjen e saj, aq dhe kanë ngadalësuar studimin shkencor filologjik-tekstor, *Kangjelji VII* i *Këngëve të Millosaut* në botimin e Mitkos merr rëndësi për hartimin e një historie receptimi të kësaj vepre. Kështu, rezulton se P. Kupitori është përshtatësi i parë i poezisë deradiane dhe arvanitikishtja e Hidrës dialekti i parë ndërmjetësues i udhëtimit prej afro 180 vjetësh të saj. I dyti, jo rastësisht, në pikëpamjen kronologjike vjen K. Kristoforidhi, i cili përshtati 14 prej kangjeljeve të *Rapsodie di un poema albanese*, me qëllim botimi[841].

Marrin rëndësi gjithashtu dhe mund të mirëkuptohen ngurrimet që kishin Th. Mitko dhe më pas F. Konica për mundësinë e leximit të poezisë së De Radës prej lexuesit në Shqipëri. Ngurrimet shkonin deri atje sa, me anë të një letre, t'i kërkonte De Radës që artikuj të tij në *Fiamuri Arbërit* t'i afronte *ndë dialettë tonë, që ta ndëlgonjën shqypëtarët, pse gluhën tuaj as unë s'e ndëlgonj*[842].

Për të mundësuar një lexim të krahasuar midis dy autorësive të *Kangjeljit VII* të *Këngëve të Millosaut*, japim më poshtë transliterimin e dy versioneve:

---

[839] Panajot Kupitori, *Vjershë satyrike*, në *Shkrimtarë shqiptarë*, vëll. I, përg. Namik Ressuli, nën kujdesin e Ernest Koliqit, Tiranë 1941, f. 353. Për herë të parë u botua nga D. Camarda, në *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua Albanese*, Prato 1866, p. 88-90.

[840] Giuseppe Camarda, *At Vincenzo Schirò*-it, në *Shkrimtarë shqiptarë*, vëll. I, përg. Namik Ressuli, nën kujdesin e Ernest Koliqit, Tiranë 1941, f. 336-337. Për herë të parë u botua nga G. Schirò, në *Canti tradizionali*, Napoli 1923, p. 316-318.

[841] Dhimiter S. Shuteriqi, *Jeronim de Rada dhe 'Këngët e Milosaos'*, botuar në *Milosao*, 18 janar 2015, f. 16 (ribot. nga Mynever Shuteriqi).

[842] Dhori Q. Qiriazi, *Hapa të hershëm të Thimi Mitkos për një shqipe të përbashkët*, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Shkodër 2014, f. 45-60.

***Kangjelji VII* i *Këngëve të Millosaut* (1873)**[843]

Sipas G. de Radës, *Milosāt*, 1973	**Sipas Mitkos (Kupitorit), 1878**
Çë të veen ndë dèetit	Psè ndë déet po të véenë,
Noeriit, zëmëra imme?	Méntë, zëmëra ime.
Sbardhëtin anizit	Sbárdhë návetë turka[844]
Rùatin, pran' u shéghtin;	Tan' sa hiera u fshehnë
Erdh ditta e Arbërit!	Arbërìs' i érth dita!
Ndómòs, vëdékurith	Kliòftë véemi ndë ljuftë
Mbë shtratt na vemith	Vdìkja mbi shtrát' ndë mos vdékshim
Mos përpara shpivet;	Née përpára shtëpìvet'
E te botta na garronnen	Psé harróimë ndë bótë
Shokt e vëllezërit,	Vllézër, shók' edhé króie
Kronjet e katundi iin.	Edhè vénd' e katundit[845];
Nanni çë natta e zeez	Nan' tsë náta e zézë
Me të bùtëthin një shii	Nan' tsë shìthi i butë
Paru më përbaljtën udhët,	Bálëtë mblion tsë-do udhë
Gapni ju dèrien	Hápni dérënë juve,
Tek të hedhura kopiljet	Ts' u-mbëlióthtë kopìlie
Ljottënjë garrùamith.	Pa kulidès, e këcéni
Vasha fort madhia	Fòrt e mádheia váizë
Më rrëmbéft për dórie	Më rëmbéftë ka dóra
Të buuz-hjéshmen,	Buzjikéshmenë time
Mua m'é siélt përparanith.	É m'e séftë ndë bállë
Céra më i déziet	É liée nkuqin ka turpëia
Me ndë mest shënkëthin	Mésit, fákiesi shéngëthi[846]
Çë të késhinj dhùrmez	E dëfton kur të kiéshinë
Vet çë siit të na rùghien	Pra ndë së nd'u përpiékshim
Jetta è të përmìssiet.	Déef u-rëbártë i tërë[847].

[843] Transliterimi ynë. Për shkak të dëmtimeve të shumta të kopjes së rrallë të *Bëletës shqiptare* që kemi pasur në duar kërkojmë ndjesë për ndonjë interpretim grafematik të pasigurt në vargun e katërt dhe eventualisht në ndonjë varg tjetër.

[844] Cilësori *turke*, për *anijezit* (*le navi turche*), gjendet në vetë tekstin autopërkthim të vetë De Radës: *Hanno biancheggiato le navi Turche,* Jeronim De Rada, *Vepra letrare*, vëllimi III, *Këngët e Millosaut, I Canti di Milosao*, botim kritik i tri varianteve (1836, 1847, 1873), përgatitur nga, Francesco Altimari, Tiranë 2014, f. 235.

[845] Për përdorimin e fjalës *katund* në vend të fjalës *atdhe* shih tek Jeronim De Rada, *Vepra letrare*, vëllimi II, *Këngët e Millosaut/ I Canti di Milosao,* botim kritik i tri varianteve (1836, 1847, 1873), përgatitur nga Francesco Altimari, Tiranë 2014, p. 234-235.

[846] Shenja, *nishani*.

[847] *U shembtë*, *u përmbystë*.

Procesi i hyrjes në qarkullim të *Kangjeljit VII* të *Milosaat* (dhe i disa motiveve të tjera arbëreshe) është me një interes të jashtëzakonshëm për ndërthurjen e shkallëve të autorësisë dhe për ndërkomunikimin jo vetëm midis qarqeve dhe nënsistemeve letrare gjatë Rilindjes, por dhe midis letërsisë dhe traditës gojore. Shkallë pas shkalle janë këto mbivendosje autorësie dhe zhvendosjeje në skemat e komunikimit, që i japin kësaj kënge karakterin e një vepre palimpsest:

1. E shkroi Jeronim de Rada më 1836 (*Kangjelji IV*: *Cú ty veen ndy deitit / Noeriit ʒymmɛra ime)*;
2. E ribotoi autori më 1847 (*Kangjelje VII*, *Ndur 4 tu Lonârit 1406*);
3. E ribotoi për herë të tretë autori më 1873, *Kangjelje VII*, me të njëjtin titull të përmendur më parë);
4. E përshtati, duke e rikrijuar në të folmen e Hidrës, Panajot Kupitori;
5. E mblodhi dhe e botoi si këngë popullore në *Bëletën shqipëtare* Thimi Mitko më 1878, megjithëse nuk harron të shenjojë dhe emrin e De Radës dhe të rikrijuesit të tij P. Kupitorit, për të cilin thotë se e përshtati posaçërisht për të, por duke përfytyruar se është bërë tashmë këngë popullore e arvanitasve;
6. Gjergj Pekmezi nuk e përfshiu në *Bletën shqyptare* (1924), duke sqaruar se është poezi e De Radës dhe jo folklor;
7. Nuk u botua as prej Z. Sakos (red.) në autorësi të popullit në *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)*, vëllimi I, Tiranë 1961-1962.

Është për t'u përmendur se De Rada, megjithëse me një vetëdije autorësie shumë të qartë, siç shkruan vetë në *Autobiologjinë* e tij, provonte ndjenja vlerësimi kur rastiste të dëgjonte *vashat e Makjit* duke i kënduar vargjet e *Milosaat*, poemë të cilën në këtë vepër e quan *cantica di Milosào*, si këngë
popullore[848].

Duke qenë se *Bëleta shqipëtare* e Mitkos është kthyer në një rrallësi librore, e shohim me vend të paraqesim këtu një shembullzim të *Kangjeljit VII* botuar prej tij më 1878 sipas përshtatjes së P. Kupitorit:

[848] Girolamo de Rada, *Autobiologia, primo periodo*, Cosenza 1898, p. 17.



Πσὲ νδη δέιτ πῶ τη δέινη.
μέντη, ζήμτρα, ἰμι;
αδάρδη ναδετη τεύρκα,
χίρκ ου-φυσεζνη.
Αρδηρίτ' ι έρθ δίτα!
Κλιόφτη' δέεμι νδη λιούφτη,
δδίαιμ μδι σεφράτ' νδη μῶ;
νέε πηπόρκ σεπηπίδετ'
πσὲ χαρρόιμη νδη δότη
βλέζηρ, σιόκ', εδὲ κρόιε,
εδὲ δίνδ' ε κατούνδιτ;
Νᾶν τεη νάτα ε ζέζη,
νάν τεη σιέθι ι δούτη
δάλιτη μδλιᾶν τεη-δὸ αάδη,
Χάπνι δέρηνη ἰουδι,
τι' ου-μδηλιόθτη κοπίλιε,
πᾶ κουλιδὶς, ε κτητένι.

(1) Ὁ στίχος οὗτος εἶναι περιτοσύλλαβος.

—(150)—

Φὸρτ ε μάδεια' δίζη
μη ρημβέφτη κᾶ δόρκ
δουζηκιέσεμενη τίμε
έ μ' ε σέφτη νδη δάδε
έ λίδε 'γκοῦνίη κα τούρπηιε·
μέσιτ φάκιεση σέγγηθι
ε δηφτῶν κοῦρ τη κιέσενίη.
Πρᾶ νδη σῦ νδ' ου-πηροπιέκτεμι
δέσφ ου-ρηδάρτη ι τῆρη.

Përshtatja e Kupitorit në *Bëletën shqipëtare*

III. De Rada qe shumë i vëmendshëm ndaj *Bëljettës Shkipëtare* (*Ape Albanese*), për të cilën njofton me entuziazëm qysh në numrin e parë të së përmuajshmes *Fiamuri Arbërit*, që ai vetë drejtoi. Në faqe të parë ai u bën të ditur lexuesve të *Fiamurit* se Mitko e përgatiti *Bëljettën* e tij duke kuptuar se *un popolo non può uscire dalla barbaria se non coltivando la lingua a sè nativa*[849], duke e renditur ndër vijuesit e punës së Dhaskal Todrit (Theodoro di Elbasan), i cili nuk u kthye më nga Rusia, ku kishte shkuar për të porositur shkronjat e një alfabeti të shqipes. Në të përmuajshmen e tij përmendet korçari tjetër Peti Mitko, *promotore delle scuole di Corcia*[850], *per le sforzi individuali* të tij për hapjen e një shkolle shqipe në qytet[851], ndërsa *Ljigoor Mitcua*, kushëriri, ndërmjetëson korrespondencën midis tyre: *Me*

VESTIGIE DELLE ANTICHE NOSTRE SEDI, CHE DURANO TRA NOI

Chèmi fshatëra ndé Shkjipëri me ëmra të shpivo tonjà.

1. Myzakjia ßé fush o gjoer ej o pjàlshëmë; zilja mbaan ce Vëljoor ßára Durrëzit; andéi shpii o Musakjëravet.

2. Matranghëja ndé fush të Beràtit (*Toscheria*); andéi shpia Matranga.

3. Borshi nd'Arberii (*Chaonia*); andéi shpia Boshe o ferse Barci.

4. Dragoti ndé Arbërii; andéi shpia Dragoti.

5. Radhati ndé fush të Coljoßé (*Toscheria*); andéi shpii o Radhaßet.

6. Ljopsi ndé Ciamerii (*Thesprozia*); andéi shpii e Ljopsatiot.

7. Sulji jaan tre a cater fshatëra mbé dii sá vende, andéi shpia Shulji.

8. Stamile ndé Shkipëriit mesëmë nga jira e Macedonies, andéi shpii o Stamilenet. Chëtó dii un vde për ann t' ónn.

Abbiamo terre in Shkjipëria con nom di casati nostri.

1. Miezakjia, una regione vasta e fertile, la quale si estende da Vallona a Durazzo; di là la casa de' Musakji.

2. Matranghia nella provincia di Berat (*Toscheria*); di là la casa Matranga.

3. Borshi in Arbëria (*Chaonia*); di là la casa Bòscia; o forse l' altra Buscia.

4. Dragoti in Arbëria; di là la casa Dragoti.

5. Radhagni nella regione di Coliona, (*Toscheria*); di là la casa de' Radha.

6. Ljopsi nella Ciameria (*Thesprozia*); di là la casa dei Lupes.

7. Sogli son tre o quattro villaggi in diverse parti di là il casato Sulji.

8. Stamile nella Shkjipëria media verso il lato della Macedonia; di là la casa Stamile. Questi so in stare alle nostre spese.

Kurmo Mitko.

[849] Girolamo de Rada, *Fiamuri Arbërit*, gennaio 1883, p. I.
[850] *Fiamuri Arbërit*, luglio 1884, p. VII.
[851] *Fiamuri Arbërit*, giunio 1884, p. VIII.

gasz të madh mòra ncà cushëriri jyt Szotti Ljigoor Mitcua sà i chishë e ati scrùar për mua, si cùndër edhè unë cam maal të madh cë te shchembèjem càrtëra për punë të gjùghës t'oonn[852].

Thimi Mitko shkruan në rubrikën e De Radës *Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi*, në *Fiamuri Arbërit*, aprile 1886, p. VIII.

Kur De Rada niset të inkurajojë bashkatdhetarët me shpresë se bujaria shqiptare nuk është shuar, shkruan: *u gap ditta e paam buljaar të tieer: Cristoforidhi, Mitkoa, Padre Leonardo (de Martino), Culurioti*[853]. Mitko botoi shpesh tek *Fiamuri*, lajme e letra drejtuar De Radës, po dhe artikuj që i shkroi posaçërisht për të, si *Topografia e Korçës*[854]*.* Lajmet e gëzueshme të dërguara nga Mitko *Fiamuri* i vë në faqe të parë[855]. Ndoshta ky artikull u bë shkas për nxitje që abati i Mirditës Preng Doçi (Primo Dochi) të botonte vetëm një vit më vonë në të njëjtën gazetë *Topografinë e Lezhës*[856]. Midis të tjerash Mitko bëri kërkime dhe botoi një artikull të shkurtër për bashkëpërkimet e mbiemrave patronimikë dhe e disa emërvendeve që gjenden tek shqiptarët dhe tek arbëreshët: *Chemi fshatëra ndë Shkjipëri me emra të shtëpive tuaja*, i shkruan në krye Mitko De Radës[857].

Sipas njohësve të veprimtarisë së Mitkos, stilit të tij në publicistikë: në fillim Dh. S. Shuteriqi e më pas Q. Haxhihasani, edhe disa artikuj të tjerë të botuar në *Fiamuri Arbërit* me heteronimin *Një shqypëtar* duhet të jenë të dorës së tij[858]. Ky heteronim shfaqet i pranishëm disa herë në tribunën e De Radës, krahas me *Një shkiptar nga Toskëria (Një Škjiptaar ngaj Toschëria*)[859]. Fakti që Mitko ka nënshkruar rregullisht me emrin e vet edhe kur i dërgonte *Fiamurit* një lajm të shkurtër prej dy-tri fjalish, si dhe fakti tjetër, që De Rada nuk veproi si rilindësit e tjerë sa i takon përdorimit të tjetëremrave, na shtyn të mendojmë se prapa këtyre heteronimeve do menduar ndonjë autorësi tjetër.

Botimi i *Bëljettës Shkipëtare* e bën të vëmendshëm De Radën për verifikimin e njëjtësisë së përfytyrimit tradicional popullor në Shqipëri e ndër arbëreshët:

E chështù mosse bèghet dritt mee e mee mbi ate ce s' dijim. Ce szàli na erdhëtim? Cu ljeen Rapsodhiit? Ziljt jemmi ncà leghet e mocceme? Edhè gjemi ndë Skjipëri të poshtëme, me të tjera, se chéntòhet e II[a] rapsodhii e të parit liver te të 'Bënnavet të trimavet':

---

[852] *Fiamuri Arbërit*, novembre 1886, p. VI, *Orhan Cercis i shkruan Mitkos*.

[853] *Fiamuri Arbërit*, giunio 1884, p. V. Në përkthimin italisht, në vend të emrit të Kulluriotit, De Rada shenjon atë të Frashërllinjve (*Bey Frašëri*).

[854] *Fiamuri Arbërit*, luglio 1884, p. VII, Mitko përmend kushëririn e tij Peti Mitkon si veprimtar atdhetar për arsimin, në shkrimin *Topografia e Corces*.

[855] *Fiamuri Arbërit*, maggio 1885, p. I.

[856] Primo Dochi, *Topografia e Lezhjes*, në *Fiamuri Arbërit*, ottobre 1885, p. VII-VIII.

[857] *Fiamuri Arbërit*, aprile 1886, p. VI.

[858] Dh. S. Shuteriqi, *Thimi Mitko dhe 'Bleta shqiptare*', në *Literatura jonë*, II, nr. 3-4, 1948, f. 238-239. Gjithashtu: Qemal Haxhihasani, vep. cit., f. 16.

[859] Shih për shembull: *Një Škjiptaar ngaj Toschëria, Na schruañinë mbi chëte cà Toschëria*, në *Fiamuri Arbërit*, gennaio 1883, p. III.

S'emes vaan e me i thaan:
Te szuu gjarpëri t'et biij.
- Nd'e szuu gjarpëri u sheroft,
Nde e szu trimi u trascigcoft.

E te chenteca e Bëljetës Shcheptare, mbë fijet 58, n. II per chonnet Rapsodhia joon 'Vién Marsi mire se vién'[860]. Mitkos De Rada i drejtohet rregullisht me nderim me apelativin *catundaar e velaa*, që në italisht i përgjigjen *compatriota e fratello*[861]. Sipas De Radës, kangjelji që merr për krahasim është trimërishte (*de gestibus*), megjithëse versioni i *Bëletës* bashkohet me *këngët e Pashkëve*.

Duke qenë se *Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi*, në *Fiamuri Arbërit,* në një prej vijimeve ka mbajtur nënshkrimin e Th. Mitkos[862], nga disa studiues është përfytyruar se edhe shkrimet e tjera nën këtë titull mund të kenë qenë të tij. Q. Haxhihasani, ndër të tjera, megjithëse me ngurrim, arrin në përfundimin se *nga mënyra e trajtimit, stili, gjerësia dhe kompetenca e rrahjes së problemeve në dy pjesët e fundme të këtij studimi do të thoshim se ato nuk duhet t'i përkasin autorit tonë*, më tej plotëson se *nuk përjashtohet mundësia e ndikimit të tij (Mitkos), sidomos në problemet folklorike që trajtohen në të*[863]. Ngjan se tërthorazi, edhe Matteo Mandalà, ia njeh autorësinë e të gjitha vijimeve Thimi Mitkos, pavarësisht ndryshimeve gjuhësore dhe vetës së autorit, që ndryshon nga pjesa në pjesë[864]. Titulli i përbashkët, me vijime të herëpashershme, por jo të njëpasnjëshme, ka krijuar mendimin e diskutueshëm për një autorësi homogjene, të lidhur vetëm me emrin e Mitkos. Në të vërtetë, *Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi* rezulton të jetë titulli i një rubrike, që De Rada donte ta stabilizonte, duke e mbajtur herë vetë e herë me anë të bashkëpunëtorëve, ndër të cilit Mitkos i takoi nderi të jetë i pari. Me sa duket, De Rada donte ta kthente në rubrikë dhe botimin e të dhënave për toponiminë. Sikurse është pohuar, përveç Primo Dochi-t, që shkroi një artikull të posaçëm në rubrikën e toponimisë, *Fiamuri Arbërit* u bë nxitje për studime të tjera të ngjashme, si ai i Harallamb Karmitsit, Nikolla Naços, S. Llambros etj.[865].

[860] *Fiamuri Arbërit*, maggio 1887, p. I: Shenjim i De Radës për ngjashmërinë e rapsodisë *Vien Marsi mire se vien* me një motiv popullor të mbledhur e të botuar nga Mitko.
[861] *Fiamuri Arbërit*, maggio 1887, p. IV, De Rada i drejtohet Mitkos me shprehjen *catundaar e velaa szotti Mitkua*.
[862] Thimi Mitko, *Chemi fshatëra ndë Shkjipëri me emra të shtëpive tuaja* botuar në rubrikën *Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi* të *Fiamurit të Arbërit*, aprile 1886, p. VIII.
[863] Qemal Haxhihasani, vep. cit., f. 56.
[864] Në bibliografinë e artikullit *L'origine du mythe pélasgique: G. de Rada et G. E. Bidèra*, botuar në *Studia Albanica*, nr. 1/2014, p. 33, Matteo Mandalà e shenjon në këtë formë autorësinë e titullit të përmendur: Mitko, Thimi, *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora*, in *Fiamuri Arbërit*, anno III, 20 aprile 1886, n. 12, Cosenza, 1886, f. VIII; n. 5, 15 maggio 1886, f. I-IV; n. 7, 15 novembre 1887, f. V-VII, duke i njohur të gjitha vijimet si pjesë të një të tëre, që i takon Mitkos.
[865] Shih Qemal Haxhihasani, vep. cit., f. 54.

Jashtë çdo dyshimi, artikulli që u botua në *Fiamuri Arbërit* nën këtë titullim, në numrin e muajit maj 1887, f. 1, në të cilin flitet për disa ngjashmëri në motive midis rapsodive arbëreshe dhe këngëve popullore të mbledhura e botuara nga Mitko, është shkruar nga De Rada. Këtë e identifikon jo vetëm arbërishtja dhe pastaj alfabeti (njëri prej tyre) i krijuar prej atij vetë, por dhe theksimi i *rapsodhis soon* që merret në krahasim me *Bëljetten*, forma e të shkruarit të titullit të veprës së Mitkos dhe përbërës të tjerë. Në pak rreshta që përmban ky artikull na bëhet e ditur se *Bëljetta shsceptare* e Mitkos vështrohet së jashtmi, *në leximin e tjetrit*, që qendron në një shkallë largësie përtej autorësisë, dhe pikërisht kjo largësi i lejon De Radës të paraqitet me vështrime krahasuese, duke gjetur pikëtakimet e poezisë popullore arbëreshe me atë shqiptare përmes pranëvënies së dy veprave: *Rapsodie di un poema albanese*, ku gjendet dhe *rapsodhia joon*, me *Bëletën shqiptare* të Mitkos, të cilën e citon me korrektesën e një studiuesi.

VESTIGIA DELLE ANTICHE NOSTRE SEDI CHE DURANO ANCORA

(*Continuazione; vedi numero 12 anno II*).

E chë-hrú mosse bëghet drit mee e mee mbi âttë cë's dijim. « Ce szâli na erdhëtim? Cu ljesa Rapsodhit? Zilji jâmmi ncâ lëghët e mocëcme? »

I Edhé gjëmi ndë Skjipërii të pështëme, me të tjera, se chënëghet e II.ª rapsodhii e të parit liver te të Bënnavet e trimavet:

S' cmes vaau e me i thaan:
« Te szau gjârpëri t' et bij
— Nd' e szau gjârpëri u shërôft;
nde e szau trimi u trasigeôft ».

E te chëntëca o Bëljettus shchoptâre, mbë fjet 58, n. II per chonnet Rapsodhia joon « Viêu Marsi mure se viêu » (1).

E così sempre si fa più e più lume su quello che non sapevamo « Da che regioni noi proveniamo? Ove nacquero le Rapsodie? A quale delle nazioni antiche apparteniamo? »

I Troviamo anche nella bassa Albania che, con altre, si canta la II.ª Rapsodia del I.º libro delle *Gesta degli Eroi*.

Alla madre andarono e le dissero:
« Ha morso il serpente tua figlia:
— Se morso l' ha il serpente guarirà;
se presa l' ha il giovine, se'n con lui viva ».

E nel canto riportato nell'*Ape Albanese*. a pag. 58, n. II. vi si sente la eco delle Rapsodia « Viene Marzo sia il benvenuto ».

(1) In Epiro e propriamente verso Tepeleu e verso Arta, sono i due villaggi ricordati nelle Rapsodie nazionali *Rindine* ed *Armirò*, del quale ultimo, non sapendo, volemmo dire: Così alcuni fatti, in quelle Rapsodie, noi malamente riferimmo alle spiagge della Morea: e il verso. « Nde kjazzet Anapuljit » nella Rapsodia VI del II Libro delle Eroiche, è inestato evidentemente da cantatrici delle Colonie d' Italia; o perchè Napoli era la città magna e regale di esse, o che si richiamassero la Napoli della Morea ricordata in altra Rapsodia.

De Rada shkruan në rubrikën e *Fiamurit Arbërit Vestigie delle antiche nostre sedi, che durano tra noi*, numri i majit 1887, p. VIII.

Fiamuri Arbërit, ashtu sikurse dhe letërkëmbimi midis De Radës dhe Mitkos, një pjesë e të cilit ende e pabotuar, është pasqyra e një sinergjie që u krijua në periudhën e romantizmit jo vetëm në shkallën e lëvizjeve atdhetare, por edhe në bashkëpunime të frytshme midis protagonistëve të tyre. Me trishtim u njeh De Rada lexuesve se *Bëljetta*, që u nxiti *suoi connazionali all amore della propria lingua*, *fu*

bruciata nella piazza di Atene[866]. *Rapsodie del secolo XV* dhe *Ape Albanese* poeti i bashkërendit si dy vepra plotësuese ndaj njëra-tjetrës[867]. Në shenjë vlerësimi për Mitkon, De Rada boton dhe letrën vlerësuese të korçarit Orhan Cercis, në të cilën çmohet botimi i *Bëljettës Shkipëtare* jo vetëm si veprim kulturor, por dhe si akt patriotik. Herë pas here lartëson veprimtarinë atdhetare të Peti Mitkos në dobi të shkollës shqipe.



Vien, marsi mirò se vien (1)
Vien i butt' e i ðartiθ
Ture shtunur shii me diel;
Fùshaζit i lhulhòζon
Màlheζit i mugulòn.
Dritta e scolèlhòvet
Cy grammaticossógnyn,
Monoshtireshit tò vryryt.
Mori ζógna ndalanishe
Cy m lhûan mbî at ðocaar,
Ndy chee ndogn'laijm pyr mua
ðùame e ζymren mò sherif.
Nda: O jalhimo nò ti trim! (2)
Laijmi, cò vet siel,
I gareem chòtèi jashtì;
Paru dòti se u sherii.

Viene Marzo, bene a noi venga,
Vien mite e pur aspretto,
Gittando pioggia con sole;
Le campagne empiele di fiori,
Le montagne coprele di nebbia:
Luce degli scolari
Che apprendon lettere
Ne' monasteri foschi.
O nobile rondine
Che mi danzi su quella trave,
Se hai qualche imbasciata per me,
Dimmela e 'l cor mi allevia.
Ron: Ahi a te giovine!
Le notizie, ch' io reco,
Liete son qui nei difuori;
Che il mare è per tutto sciolto e
spianato.

***Vien marsi mirë se vien* në *Rapsodie di un poema albanese*, p. 37-38.**
(Vijuar me transliterim dhe tejshkrim)

Transliterim	Tejshkrim
Vien marsi mire se vjen	Vjen marsi, mirë se vjen
Vien i butt' e vjen i thartith	Vjen i but' e vjen i thartith
Ture shtunur shii me diell;	Ture shtënur shi me diell;
Fùshazit i ljuljëzòn	Fushazit i lulëzon
Màlhezit i mugullòn.	Malezit i mugullon.
Dritta e skolèirëvet	Drita e shkollarëvet
Çë grammatikossinjën	Që mësojnë gjuhën
Monoshtireshit të vrërët.	Monoshtireshit të vrërët
- Mori zònja ndalanishe	- Mori zonja dallëndishe
Çë më lùan mbi at dhokaar,	Çë më luan mbi at' dhokar
Ndë chee ndognj' laijm për mu	Ndë ke ndonjë lajm për mua
Thùamë e zëmren më shkrii.	Thuamë e zemrën më shkri.

[866] *Fiamuri Arbërit*, novembre 1887, p. III.
[867] *Fiamuri Arbërit*, novembre 1886, p. VII.

Nda.: Oi jalhimo né ti trim! Laijlmi çë vet siel I ghareem chëtéi jasht Páru deti se u shkrii.	*Dall.*: Ajme, dhe ti o trim Lajmi çë vetë sjell I haremë këtej jashtë Aq sa dhe deti u shkri.

Sipas De Radës, mund të jetë e krahasueshme me *Një tjetër, q'i përngjan*, që bën pjesë në ciklin e llazoreve dhe ka në frymën e vet ringjalljen e natyrës, përtëritjen, njësoj si rapsodia *Vjen marsi mirë se vjen*: *E te chéchénta e 'Bëljettes shsceptâre', mbë fiet 58, n. II, për chonet Rapsodhia joon "Vién marsi mirë se vién"*[868]. Dallimi mes tyre është se kangjelja arbëreshe nga ana tipologjike shkon me këngët rituale të lidhura me kalendarët primitive, kurse tek *Bëleta* me të drejtë Mitko variantin e mbledhur prej tij e rendit tek *Kënga që këndohen ndër ditë të shënuar*. Me to hapet cikli i *këngëve të ringjalljes*, *të lidhura me emrin e Shën Lazrit*, që këndohen në javën e Pashkës. Kangjelja e krahasuar prej De Radës me motivin e botuar në *Bëleta* bashkohet me të si këngë kalendarike rituale, që këndohej prej fëmijëve në ditë të caktuara të vitit, të dyja për ringjalljen, por e para për ringjalljen e krishterë dhe e dyta për ringjalljen në mendësitë pagane:

O pëllumbth, o pëllumbth,
Mos më pe Lazuarë?
Këtu drejt më shkuanë
Ndë derë të zotitë.
Ay zot se qysh punon
Kill' e aspër numëron.
Darovit Lazuarë
Ashtu, dalç gëzuarë,
Me djathë ndë napëzë,
Me nuse për qafëzë.
Sa lule mbë Tomor,
Aqe nuse ndë hobor.
Sa lule ndë qershi,
Aqe djem' ndëpër shtëpi[869].

Vjen marsi mirë se vjen ka gjithashtu ngjashmëri me dy këngë të tjera lodra, siç i quan M. Lambertz, të dyja të karakterit ritual-kalendarik dhe me frymë evangjelike, të dyja gjithashtu me një përbërëse të riteve të kalimit, si *këngë rishtarie*, moshe dhe statusi:

Këndojn fëmijët në maj, tuj u lut për shi:

[868] Girolamo de Rada, *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora*, në *Fiamuri Arbërit*, maggio 1887, p. I: *E një nga këngët e 'Bletës shqiptare', në f. 58, me nr. 2, ndihet jehona e rapsodisë sonë 'Vjen marsi mirë se vjen'.*

[869] Dr. Gjergj Pekmezi (e përshkroj me shkrojla shqipe, e përktheu shqyp dhe e radhiti), *Bleta Shqypëtare*, Vjen-ë' 1924, f. 37.

Maji, maji, rritna leshtë,
Si vllastareja në vreshtë
Si bishti i kalitë
Si drurë të malitë
Si kut' i pazaritë[870].

Kënga e dytë cilësohet nga Mitko me këtë titull më shumë tipologjizues se emërtues: *Çupat e Korçës lidhin më të parin e marsit një lithcë të kuqe më qafë apo dorë e këndojn*:

Dëllëndyshe, dëllëndyshe!
Na këtʼ verore të kuqe,
Të ma shpjesh anës detit
Të më sjellç bukë shëndetit![871].

Jo vetëm Mitkoja njihte poezinë e De Radës dhe rapsoditë e mbledhura dhe të botuara prej tij (në shenjimin hyrës për *Kangjeljin VIII* ai citon *Rapsoditë shqiptare*), por dhe De Rada jep dëshmi se *Bëljetten* e Mitkos e njihte dhe e studionte dhe këngët e saj i shërbyen për të parashtruar edhe pyetje të teorisë së folklorit: *Nga kemi ardhur, si lindin rapsoditë, çfarë jemi sipas këngëve të moçme*? Për tʼiu përgjigjur këtyre pyetjeve ai nuk mjaftohet me këngët popullore arbëreshe, por krahason dhe bën të njohura edhe këngë të *Bëljettes*. Ka një dallim në përcaktimin tipologjik të së njëjtës këngë midis Mitkos dhe De Radës: i pari e cilëson *këngë Pashke*, kurse i dyti *këngë trimash*. Mund të mendohej se në ligjërimin e De Radës *trima* ka kuptimin *djem*, si në lirikën e dashurisë (*trimi dhe vasha*). Por çështja ndërlikohet sepse De Rada përdor saktësisht sintagmën *liver i te bènnavet të trimavet*, që i përgjigjet këngëve të gjesteve, *de gestibus*, këngëve heroike[872]. Poeti i Machi-t arbëresh botoi në *Fiamurin Arbërit* jo vetëm folklor arbëresh, për të cilin ruajti një rubrikë periodike, por edhe këngë popullore gegërishte, që nuk kishin lidhje me *Motin e Madh* apo me qendresën mesjetare shqiptare në përgjithësi, por me ngjarje e protagonistë të kohërave të mëvonshme, ndër të cilat përmendim *Shqipëri, qind vilajete* (*Fiamuri Arbërit*, mars 1884, p. IV), *Krisi pushka te mejtepi* (*Fiamuri Arbërit*, korrik 1883, p. II) etj.

[870] Dr. Gjergj Pekmezi, po aty, f. 39.
[871] Dr. Gjergj Pekmezi, po aty, f. 42.
[872] Girolamo de Rada, shenjim në *Fiamuri Arbërit*, maggio 1887, p. I, rreth ngjashmërive të poezisë popullore arbëreshe *Vien Marsi mire se vien* me këngë popollore të mbledhura nga Mitko.



d)
10
Për pashkë.
Nikulica dhe Gramosi,
Nde mest na rënëke ristosi.
Qënëke trimi edhe vasha,
Sëmësë van' e i thanë,
Të zu gjarpëri tët-bijë,
Nd' e zu gjarpëri, ushëroftë.
Nd' e zu trimi, utrashigoftë.

Një këngë nga *Bëleta* e Mitkos e parë në krahasim, e cituar në *Fiamuri Arbërit* nga Jeronim de Rada[873].



E chështú mosse bèghet drítt mee e mee mbi áttè cé's dijim. « Cè szàli na erdhètim? Cu ljeen Rapsodhiit? Ziljt jètmni neà lèghèt e moccème? »

I Edhé gjémi ndè Skjipërii të póshtème, me të tjera, se chën:òghet e II.ª rapsodhii e të parit liver te të Bènnavet o trimavet:

S' emes vaan o me i thaan:
« Te szuu gjàrpëri t' et biij.
— Nd' e szuu gjàrpëri u shërôft;
nde o szuu trimi u trascigeôft ».

E te chéntèca o Bèljettes shchoptâre, mbë fjiet 58, n. II per chonnet Rapsodhia joon « Vién Marsi mire se viên » (1).

De Rada shkruan për një motiv kënge trimërishte toske që mund të ilustrojë si lindin rapsoditë.

IV. Interes shkencor përfaqëson fakti që tek Mitko balada e mirënjohur mesjetare *Konstantini e Garentina* (*Konstantini e Jurëndina*), megjithëse tek De Rada gjendet tri herë, në dy variante tek *Rapsodie di un poema albanese* dhe një herë tjetër tek *Canti premilosaici*, vjen në një version të prozifikuar, e paraqitur si përrallë, në përmbyllje të veprës, në të njëjtën mënyrë dhe tek Pekmezi. Ndoshta Mitko nuk e gjeti të versifikuar as tek arvanitët, as te mërgimtarët. Ndërsa përmbledhjen me këngë popullore të De Radës mund të mos e njihte. Por ndoshta njihte paraqitjen e saj në studimin e Dora d'Istrias, e cila gjithashtu e prozifikoi motivin, madje e paraqiti si tekst të dramatizuar, në një mënyrë më të plotë dhe më analitike se Mitko, gjithnjë duke ia kujtuar lexuesit të huaj se burimi ishte balada e mbledhur prej De Radës[874]. Dhe kështu preferoi një version të rrudhur, që e mblodhi prej një shqiptari mysliman nga Kruja (*turko-alvanos, τούρκο-αλβανός*)[875], por mjaft e krahasueshme me baladën arbëreshe, shumë konvergjente me të, krahasuar me variantin në gegërisht *Kënga e Halil Garrisë*. E çuditshme është që Mitko nuk e gjeti me vend të përfshinte në koleksionin e tij dy variantet e botuara prej D. Camardas, *Kostantini i vogëlith*

[873] Dr. Gjergj Pekmezi, *Bleta shqyptare*, Vien-ë 1924, f. 41.

[874] *Ce chant était peu connu jusqu'à ce jour; j'en possédais une copie d'après un vieux manuscrit calabrais, Aujourd'hui tous les albanologues pourront le trouver dans l'important recueil (livre Ier, chant XVI) que publient à Florence M. G. de Rada, et M. Nicole Ieno de' Coronei. J'ai concilié la leçon de mon manuscrit avec celle du recueil*. Dora d'Istria, *La nationalité albanaise d'après les chants populaires,* në *Revue des Deux Mondes*, tom 63, 1866.

[875] Këtë të dhënë pati mirësinë të ma ofronte miku dhe kolegu Dhori Qiriazi, që në mënyrë sovrane zgjidhi vitin e kaluar problemin e njohjes dhe botimit të kontributeve leksikologjike të Mitkos, përmes përgatitjes për botim dhe përballjes së të gjitha shërbimeve filologjike të *Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht-shqip & ndihmesa të tjera leksikografike* të Thimi Mitkos, botim i Akademisë së Shkencave dhe i shtëpisë botuese *Kotti*, Tiranë 2014.

(*Κοσταντινι ι βόγελιθ*) dhe *Ke të vish me mua ndë shpi* (*Κέε τέ βίσς μέ μοούα νδέ σςπί*), të cilat ai i njihte me siguri prej koleksionit të botuar në Livorno më 1866[876].

Studiuesi Qemal Haxhihasani, një prej njohësve të sprovuar jo vetëm të trashëgimisë së tij, por dhe të fondit të baladave mesjetare shqiptare, në studimin e tij monografik për Mitkon dhe veprën e tij, megjithëse paraqet një klasifikim tipologjik sipas llojeve brenda kreut të prozës në *Bëletën shqipëtare* të Mitkos, duke ndarë më vete *dy balada*, nuk i kushton vëmendje faktit që motivi i vëllait të vdekur që ngrihet nga varri, me shumë ngjashmëri evidente me motivin e mbledhur dhe botuar prej D. Camarda-s dhe De Radës, u botua prej tij e prozifikuar[877], vende-vende dhe si tekst i dramatizuar, duke e quajtur në krye përrallë, me titullin *Plaka me nëntë djelm*.

Siç u pohua më herët, Mitkoja nuk qe rreptësisht përjashtues ndaj përshtatjeve e rikrijimeve, madje edhe ndaj përkthimeve prej greqishtes. Në *Bëletën* e tij gjenden edhe krijime autoriale, dhe jo vetëm të atij vetë. Të gjitha këto e bëjnë të pashmangshme pyetjen se pse Mitkoja e botoi në variant të thjeshtuar, motivin themelor të baladës së të vdekurit që ngrihet nga varri, me përhapje të gjerë tek arbëreshët dhe tek shqiptarët e Jugut. Vetë përmbajtja e baladës njofton përkatësinë jugore të saj, si në anën gjuhësore, ashtu dhe në emrat e karaktereve (Konstantini dhe Garentina), për më tepër në frymën e saj të përgjithshme evangjelike. Në këtë pikë, meriton një gjykim kritik pohimi i Mitkos, që këtë variant e kishte mbledhur prej një bartësi verior. Përveç formës *djelm* për *djem*, edhe kjo mjaft e sforcuar në mikrokontekstin gjuhësor ku gjendet, asnjë tjetër e dhënë për një burim prej shqiptarëve të Veriut nuk mund të vërehet.

Ndoshta Mitkoja e pa shumë të vështirë pranimin e një varianti të botuar nga arbëreshët me të folmen e tyre. Ndoshta përshtatja në vargje iu duk e vështirë, dhe kështu zgjodhi rrugën e botimit në variantin e transmodeluar. Dhe kështu, *Bëletës shqipëtare* i shtohet edhe merita e ofrimit për studiuesit për mundësi krahasimi dhe interpretimi për çka ndodh në procesin e transformimit të zhanrit edhe në letërsinë gojore. Veç kësaj, historia e transmodelimit të llojit, me këtë baladë të prozifikuar, thellohet gati një gjysmë shekulli, nëse si përvojë të rendit parësor i referohemi punës së mëvonshme të Mitrush Kutelit, me *Tregime të moçme shqiptare*[878].

Është e njohur që vetë De Rada pati pëlqyer prozifikimin e vargjeve të tij në autopërkthimet italisht. Në këtë formë iu bënë të njohura lexuesit italian tre botimet e *Milosaat*, dy botimet e poemës *Serafina Topia* dhe *Scanderbeccu i pa-faan*. Kësaj mund t'i shtohet fakti i rëndësishëm që, sidomos tek *Serafina Topia* dhe

[876] Demetrio Camarda, *Appendice al saggio de grammatologia comparata sulla lingua Albanese, Livorno 1866, p. 90-98.*

[877] Qemal Hiaxhihasani, vep. cit., f. 84.

[878] Krhs nga ky autor vëllimin *Netë shqiptare*, bot. *Albania*, Bukuresht 1938. Ribotimi i fundmë *Tregimeve të moçme shqiptare (balada dhe rapsodi popullore të ritreguara për fëmijët e moshës së mesme e të rritur shkollore)* u bë në vitin 2012 nga shtëpia botuese që mban emrin e autorit.

Scanderbeccu i pa-faan, ka me shumicë përshkrime kalimtare prej një situate në tjetrën, që mund të cilësohen lirisht *proza të versifikuara*, madje herë pas here edhe *proza të vertikalizuara*. Një model i kryehershëm i versifikimit a vertikalizimit të prozës gjendet tek *Shkrimet e Shenjta*, prej të cilave De Rada u ndikua jo vetëm në frymë, por dhe në formë. Këtu nuk është fjala thjesht për rastet e shumta të përmbylljes së fjalisë në mes të vargut, që më pas do të shndërrohej në mjet të poetikave moderne, por përgjithësisht për sundimin e narracionit dhe të përshkrimit, si poetika të prozës.

Nga *Pasqyrë e shpirtit njerëzor* (*Storia seconda*, botimi i vitit 1839)	**Po aty (Tekst i lexuar pa vertikalizim)**
E pse ti me mbesove te dhjovasja? Vet andej pasiqir kemi te moti, theatr' e te shkuameve ce me mbjonjen ghelm. Te shoghesh gjerī njērezish ce deshtin, e bën me burgām, gharruat e rān te rrethe i motit teku lēn! E rrethit jater u ngrën pasandaj te tjera fitera e faregjës te atire: stistin, zvistin nga dukt e jetes, e te grisur vjeteshit i mbuloi sheshe i dheut nën lule te rēa. Na jemi e ni me kēmb te kāllta kesaj luc mē i shkār mbrenda[879].	Dhe ti pse më mësove të lexoj? Vetëm prej andej kemi një pasqyrë të kohëve, teatrin e të shkuarës, që më mbulon me helm. Të shohësh raca njerëzish që ç'deshtën e arritën me krenari, dhe harruat që ranë tek rrethi i jetës ku lenë. E rrethit tjetër u ngritën pastaj të tjerë filiza prej farëgjësë së tyre; prishën, zhveshën nga pamjet e jetës, e të grisur prej vitesh i mbuloi sheshi i dheut nën lule të reja. Na jemi tani me këmbë të kallura brenda kësaj lluce, me i shkarë brenda.

Bëleta shqipëtare, për meritë të botuesit të saj të parë, mbledhësit e kodifikuesit prej gojës së popullit, provoi në shkallën e sistemit ndërkomunikimin midis të gjitha bashkësive shqipfolëse: toske e gege, çame e labe, arvanite e arbëreshe, duke dëshmuar jo vetëm afrinë gjuhësore dhe homogjenitetin shpirtëror të shqiptarëve, po dhe vetëdijen e përbashkët të tyre për jetë kombëtare të njësuar.



Pjaka me nëntë djelm.

Qe një pjakë që kish nëndë djelm' edhe një çupë. Këtë çupë e martuan ata djelm'së largu ndë një fshat të huajë, thuaj se pa dashuri të sëmës, e me tepërë nga të gjithë Kostandini vuri ngulmin për të martuar' atje.

Pas ca kohe ngjanë luftëra të mëdha, edh' ata djem' vatën ndë luftë, si gjithë trimat e tjerë, e u vranë të nëndë asij viti. E zeza e ëma, helmuarë kaqe tepërë, tuke mos pasurë përanë as çupëzën ndobare, që t'i rëkonej asajë, vente mbi varr' të djemvet sajë, e më tepërë të Kostandinit, e thërrisëte tuke qarë mbi të: „O Kostandin biri im! Ku ke besën, që më dhe? Siellë më çupëzën, që m' e martove sëlargu, se m' u doq zeméra, e dua t' a shoh, që të shuanj këtë zjarrë që kam, edhe shkove, o bir'! E Kostantini, passi s' pushonte e ëma së vajtuari, e së ulëryeri, nga të keqëtë, që i arth, u ngreit nga varri, e vate tek e motëra, edhe e morri atë, t'i a shpjerë s' amës.

nderbeku i pafān - Scanderbeg sventurato (botim lmonte), Tiranë 2014, f. 372-374.



Udhës tek' ecënin të dy Kostandini me të motërën, nanëta u kënduan galat: „Ga, ga, ga ecën i gjalli me të vdekurin". Atëhere i thot e motëra të vëllai: „Kostandin vëllaj imë, ç' thonë kështu këto gala"? E ay i u përgjegj: Nuk' është gjë, moj motërë, se ata si shpesa që janë, po këndojnë". Vanë më tej, e u kënduan arravelat: „Ciu, ciu, ecën i gjalli me të vdekurin". E pyet papa e motëra Kostandinë, po ay i u përgjegj përsëri ashtu, si edhe më parë. Tuke bequr udhë, u afëruan te fshat' i tyre, e atje pameta u kënduan këndezët: „Ki, ki, ki, shkon i gjalli me të vdekurin". Të pastajmen kur ata u ngasën te shtëpija e tyre, Kostandini gënjeu të motërën tuke thën' asaj: Shko ti përpara, ja edh' unë po vinj pas teje, edhe vate përapë ndë varr. Ajo hoqi e vate nde der' e shtëpijës, edhe trokiti mbë derët, „tak, tak". E ëma thirri: Kush është? — Unë jam, jot bijë, po hap. (I tholë çupa). E ajo i tha: Nukë je ti, ime bijë. Çupa i tha përsëri: Unë jam. Pasandaj i tha plaka: Fut glishtin e vogëlë të dorës ndëpër derët, sa të t' a shoh më parë, pa të të hap. Edhe çupa e futi glishtin e saje ndëpër derët, papo e ëma posa e pa atë, vdiq ndë çast edh' ajo për mbrenda, edhe e bija për jashta derës'. As perrallë s' ju rrëfeva, po desha e ju gënjeva.

***Plaka me nëntë djelm*, tejshkrim i Gjergj Pekmezit, *Bleta shqypëtare*, f. 303-304.**

Ndërsa vëmendja e rilindësve arbëreshë ndaj veprimit dhe mendimit kombëtar shqiptar ka qenë në vijimësi argument studimesh për shkencën shqiptare, e anasjellta, interesimi i rilindësve të Shqipërisë së kryehershme për traditën gojore e të shkruar të arbëreshëve ka qenë më i pandjeshëm. Mitko botonte këngë prej koleksionit të Demetrio Camarda-s dhe vetë shkruante për paralelet toponomastike mbiadriatike, tek shqiptarët, arvanitët dhe arbëreshët në të përkohshmen *Fjamuri Arbërit*, që e drejtonte De Rada[880]. Një tjetër veprimtar rilindës më pak i njohur, Thoma Paçe, u mor me mbledhjen dhe botimin e folklorit
arbëresh si pjesë e trashëgimisë së popullit shqiptar[881].

Bëljeta shqipëtare e Mitkos është prova e parë e funksionimit të një hapësire letrare të njësuar dhe mbarëshqiptare, që përfshinte këngët arvanite, arbëreshe, çame, toske dhe gege. Me emrin e *Bëljetës* janë paraqitur koleksione popullore edhe më vonë. Një vëllim me titullin *Mjaltë nga bleta shqiptare*, mbledhur e koleksionuar nga Dhimitër Pilika, me një vëllim prej 147 fletësh, ruhet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (mikrofilmi nr. 15). Nga studimet e fundme të Dhori Q. Qiriazit bëhet e ditur se vetë *Bëleta* e Mitkos ka ekzistuar në tri variante. *Mialt e Bletës* titullohej koleksioni me këngë popullore i Visarion Dodanit, botuar në

[880] Thimi Mitko, *Vestigia delle antiche nostre sedi che durano ancora*, në *Fiamuri Arbërit*, 20 aprile 1886; 15 maggio 1886, f. I-IV; 15 novembre 1887, f. V-VII.

[881] Shuteriqi S. Dhimitër, *Një rilindës e botues i parë i folklorit arbëresh në shek. XIX, Thoma Paçe*, botuar në *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*, bot. *Naim Frashëri*, Tiranë 1987.

Bukuresht më 1898. ***Bléta e ree*** **u quajt dhe nj**ë prej veprave të Dom Ndoc Nikajt. Ashtu si tek popujt sllavë të jugut (*Matica ilirska*, *Bleta ilire*, qe quajtur shtëpia e parë botuese kroate, e themeluar në vitin 1842 nga *Janko Drašković*, më vonë e njohur me emrin *Matica hrvatska*, *Bleta kroate*), me emrin e Bletës u përshkua edhe në botën shqiptare fund e krye shekulli i romantizmit.

VALBONA SINANAJ (ELBASAN)

VËSHTRIME FOLKLORIKE NË VEPRËN E THIMI MITKOS

Si fillim, dëshiroj të falënderoj oganizuesit e kësaj konference shkencore ndërkombëtare, që më dhanë mundësinë për të nderuar dhe kujtuar veprimtarinë patriotike, folklorike, gjuhësore, publicistike e letrare të jetës dhe veprës së Thimi Mitkos në 195-vjetorin e tij të lindjes.

Në këtë kumtesë të shkurtër do të vë në dukje kontributin me karakter folklorik të rilindësit tonë të shquar Thimi Mitko.

Në veprimtarinë e Thimi Mitkos një vend të veçantë zë folklori shqiptar. Ai njihet kryesisht si folklorist, por veprimtaria e tij ka një shtrirje të gjerë, duke pasur parasysh letërkëmbimet e tij me De Radën, Kristoforidhin, A. Frashërin, Dora d'Istrën etj., për çështje të ndryshme të lëvizjes kombëtare, të alfabetit dhe të shkollës shqipe.

Thimi Mitkoja gjatë veprimtarisë së tij shprehu ndjenja dhe dashuri patriotike për vendin dhe popullin e tij, duke u përpjekur për vëllazërimin e kombit dhe për lëvrimin e gjuhës shqipe. Këto shqetësime që vlojnë në shpirtin e tij, ai i shpreh edhe nëpërmjet një poezie me titull "E ndë shqiptarët të gjithë sa janë"(Kamarda – d'Istria, 1867: 84, 85, 1870: 65). I nisur nga këto qëllime patriotike, ai iu vu me pasion grumbullimit të trashëgimisë kulturore dhe artistike shqiptare. "Bleta shqiptare" ishte një kushtrim për shqiptarët për të rrokur armët dhe për të fituar lirinë, por njëkohësisht një monument kulture i trashëgimisë së pasur mendore, morale dhe shoqërore e ekzistencës të kombit shqiptar. "Bleta shqipare" është një dëshmi e rëndësishme e letërsisë popullore dhe një model i përsosur i motiveve dhe vlerave krijuese të popullit shqiptar. Nëpërmjet këngëve të dashurisë, të dasmës, të kurbetit, të nizamit, të vajeve, të baladave, të epikës historike etj., shprehen ndjenjat e shqiptarit për një jetë të gëzuar. Nëpërmjet fjalëve të urta, përrallave apo gjëegjëzave shprehet mençuria dhe përpjekjet e popullit shqiptar për një jetë më të mirë dhe mbi të gjitha të lirë. Materialet e mbledhura nga Mitkoja në këtë vëllim, janë një dëshmi e padiskutueshme e unitetit kulturor dhe etnik të popullit shqiptar, të një kombi të gjallë dhe krijues me virtyte të shquara morale dhe ndjenja atdhedashurie.

Vepra "Bleta shqiptare" e Thimi Mitkos u botua më 1878, gjatë kohës kur Shqipëria ishte përfshirë nga ngjarje të rëndësishme ku mbizotëronte ndjenja patriotike e shoqëruar me thirrjen për të rrokur armët dhe për të fituar lirinë e humbur. Kjo vepër u prit me dashuri jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë saj, duke ngjallur tek shqiptarët e mërguar kujtimet e ëmbla të zakoneve shqiptare dhe mallin e zjarrtë për mëmëdhenë. Autori e vazhdoi punën për mbledhjen e folklorit edhe pas botimit të "Bletës shqiptare". Më 1879 Mitkoja pati njoftuar se kishte për botim vëllimin e dytë me materiale folklorike.

Në parathënien e “Bletës” autori, thekson nëpërmjet fjalëve të Herderit se: “Një komb nuk mund me asnjë mënyrë të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet”. Gjuha shqipe jeton pikërisht në trashëgimin e pasur të letërsisë popullore shqiptare, në folklorin e këngëve të dashurisë të dasmave, të kurbetit, të vajeve etj që janë mjalti i krimtarisë dhe i zakoneve kaq të bukura të jetës shqiptare. Rëndësia e kësaj vepre qëndron pikërisht në punën e mençur dhe të bukur që Mitkoja bëri me mbledhjen dhe paraqitjen folklorike shqiptare të veprës së tij, ku qëllimi ishte “shpëtimi dhe dhënia brezave që vijnë i fjalëve dhe teksteve shqipe, por edhe nxitja e bashkatdhetarëve shqiptarë për studimin e gjuhës amtare dhe të kulturës së tyre.

Gjatë gjithë veprimtarisë së tij patriotike, ky autor mblodhi trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit shqiptar, mjaltin dhe kujtimin e të parëve ashtu si dhe bleta mbledh nektarin në lulet me të bukura.

Në pjesën e parë të “Bletës shqiptare janë përmbledhur tekstet që përfaqësojnë veprimtarinë folklorike të Thimi Mitkos. Në këtë pjesë del në pah qartë veprimtaria e tij folklorike, kërkimet në gjinitë, llojet e temat e ndryshme, vëllimi dhe cilësia e tyre. Vëllimi hapet me këngët e të vegjëlve, vazhdon me këngët për festat popullore të motmotit, me këngë dashurie, me këngë dasmash, me këngë të nizamit, me këngë kurbeti, më këngë vaje të përvajshme, me këngë të ndryshme, me këngët e arbëreshëve të Greqisë, vazhdon me baladat, me epikën historike, më pas me prozën, përrallat, fabulat, anekdotat etj. Pra paraqiten gjini të ndryshme të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar dhe të arbëreshëve të Italisë e Greqisë, duke treguar dhe nxjerrë në dukje njësinë e shtresave të hershme të kulturës sonë kombëtare.

I nisur nga qëllime patriotike, Mitkoja me pasion grumbulloi trashëgiminë kulturore dhe artistike të shqiptarëve, nëpërmjet të cilave ai i bënte thirrje shqiptarëve të mbronin gjuhë e tyre duke ua transmetuar brezave. Nëpërmjet kësaj vepre, Mitkoja u përpoq të ngjallë tek bashkatdhetarët ndjenjën e identiteti kombëtar, duke folur me entuziazëm për lashtësinë e shqiptarëve. Ai i kultivon këto ndjenja dhe vlerat shpirtërore të popullit tonë nëpërmjet folkorit, në këngët e ndryshme të mbledhura prej tij në vëllimin “Bleta shqipare”.

Thimi Mitkoja e zhvilloi veprimtarinë e tij folklorike në mërgim midis bashkatdhetarëve të Jugut dhe Veriut që ndodheshin në Egjipt. Ndonjë element të folklorit mund ta ketë mbledhur në Shqipëri, gjatë udhëtimeve që bëri përpara se ta shpërngulte familjen nga Korça. Për regjistrimin e thesareve folklorike, të kujtimeve të traditave që sillnin bashkatdhetarët nga atdheu autori ndërmori udhëtime “shpeshherë me shpenzime të mëdha” siç thotë vetë ai, në qytete të ndryshme të Egjiptit, në Kajro, Aleksandri, por edhe në qendra më të vogla, ku banonin shqiptarët. Këtë veprimtari ai e zhvilloi jo vetëm me dashurinë dhe pasionin e një folkloristi, por edhe me bindje të forta patriotike. Botimin e këtij vëllimi ai e quan si “të shkuarën më të përshtatshme për zgjuarjen dhe bashkimin e shqiptarëve”, sepse këto thesare folklorike, duke qenë fryt i gjenisë krijuese të masave, duke lindur

jashtë dallimeve krahinore e fetare, nën frymën e dashurisë për liri, “e cila është karakteristika kryesore e shqiptarëve, ka për të qenë këndimi më i kënaqshëm si i të krishterit edhe i muhamedanit” (Lajmërimi i vitit 1874), si i banorit të Veriut, ashtu edhe i atij të Jugut. Nga gjerësia dhe larmia e materialeve të mbledhura prej tij dhe nga burimet e prejardhjes së tyre, shihen përpjekjet e Mitkos për të gjurmuar pasuritë folklorike të popullit të vet me një koncept të thellë patriotik, për t’i dhënë këto thesare në një kuadër të gjerë kombëtar. Ky qëndrim i tij bie në sy në të gjithë kapitujt e vëllimit, në larminë e këngëve, në shënimet e tyre shpjeguese, etj. Autorin e karakterizuan veçoritë e një fokloristi të shquar, pasioni i tij për të treguar vlerat e vërteta të trashëgimisë folklorike shqiptare, aftësia e kërkimit të gjithanshëm të pasurive folklorike dhe saktësia e regjistrimit të këtyre materialeve. Këngët ai i ka grumbulluar sipas tematikës duke i renditur sipas një kriteri kohor.

Vëllimi “Bleta shqiptare” është një monument kulture, dëshmi e një trashëgimie të pasur mendore, morale e shoqërore e shqiptarëve. Nëpërmjet këngëve të këtij vëllimi shprehen ndjenjat e shqiptarit për një jetë të gëzuar dhe të lirë. Veprimtaria patriotike dhe folklorike e Thimi Mitkos është gjithmonë aktuale ai do të kujtohet si “babai e krijuesi i folklorit shqiptar”.

Thimi Mitkoja vdiq më 22 mars 1890, larg Atdheut të tij, pa mundur të përmbushë dëshirën e botimit të materialeve që mblodhi pas “Bletës”.

Më lejoni ta mbyll këtë kumtesë me shkrimin në pllakën përkujtimore që mban emrin e tij në një godinë shkollore të qytetit të Korçës që në vitin 1843: “I ndrishtmi diell i diturisë lindi, dhe vjen mbi të gjithë. Ngreu e shiko, o nën’e dashur, shekullin e dritës… Ju o fëmijë të kini dëshirë në dituri, atyre t’u ngjisni. Ja tek ju ngrehmë mësojtoret, që të marrin dhuratat e muzave”.

DION TUSHI (KORÇË)

THIMI MITKOJA NËPËRMJET ARTOGRAFISË DHE LETËRKËMBIMEVE

Përveçse folklorist Th. Mitkoja, ka një aktivitet të denduar epistolar dhe një kontribut të admirueshëm si artikullshkrues. Vepra e tij e shtrirë në kohë, përmban në vetvete një tërësi elementesh shumë të çmuara të antropologjisë kulturore dhe historisë. Letërkëmbimi i tij me De Radën, Kamardën, Thimi Krein, K. Kristoforidhin, Dora D'Istrian, Françesk Krispin, Gustav Majerin etj, hedhin dritë mbi profilin e tij dhe prirjen e vazhdueshme për të kontribuar me të gjitha mundësitë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe historisë. Nëse do të kalojmë nëpër duar të gjithë korrespondencat e botuara të Th. Mitkos, me personalite të Albanologjisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi, do të konstatojmë se nga letërkëmbimet dhe rrahjen e mendimeve, ai del jo vetëm një punëtor i palodhur dhe i apasionuar i etnokulturës, por edhe një studiues i mirinformuar dhe një debatues i kulturuar, që arrinte jo vetëm të fitonte simpatinë e këtyre personaliteteve, por edhe të këshillohej dhe të krijonte marrëdhënie besimi në aspektin profesional, me ta.

Eshtë koha kur Vjena luante rolin kryesor, në lëvizjet politike dhe kulturoe të pupujve të Ballkanit. Shkencëtarë gjermanë si J. G. Han, F. Bop etj, kishin filluar të përqëndronin vëmendjen edhe mbi probemet gjuhësore, historike dhe folklorike të popullit shqiptar. Pikërisht, duke e kapur me intuitën e tij nevojën e dokumentimit të gjithçkaje të hershme të historisë dhe etnokulturës shqiptare, në këtë kohë, Th. Mitkoja, ndonëse me profesion tregtar, përpiqet që njohuritë dhe kulturën e tij ti vërë në shërbim të idealeve. Tepër modest për nga qëndrimi, porse aspak i tillë nga prurjet, Th. Mitkoja përpiqet të bëjë sa më shumë të mundet.

Kështu, në letrën e vetme të njohur prej Th. Mitkos drejtuar K. Kristoforidhit, ku bëhet fjalë për punën e tij në mbledhjen e lëndës folklorike dhe letërsisë gojore, tregon edhe arsyen përse ai ndërmerr edhe inisiativën për botimin e folklorit. Gjithashtu kjo lidhet edhe me gjuhëtarin arbëresh Dhimitër Kamarda: "Me sa vërejmë, ai është kaq i zënë, sa nuk ka patur ende kohë, për të botuar gjithë ato këngë kombëtare, gjëagjëza dhe përralla shqiptare, që i kam dërguar për këtë qëllim, edhe pikërisht ato që kisha mbledhur gjatë pesë a gjashtë vjetëve. Fatkeqësisht unë nuk kam mbajtur ndonjë kopje të tyre, për shkak të punëve që më kanë mbytur"[882]. Nga letërkëmbimet me Kamardën, mësojmë se Th. Mitkoja i dërgonte herë pas here folklor të mbledhur nga korçarët e Misirit dhe Korçës dhe duket, se me nxitjen e tij, ai filloi të mbledhë në mënyrë sistematike. Gjithashtu po nga letrat e tij mësojmë se ai i dërgonte material të mbledhur folklorik studiuesit humgares Hugo Melec, i cili nxirrte në Kluzh, një revistë të letërsisë krahasuese dhe, në vitin 1879, në 30 Tetor, boton diçka nga Mitkoja. Gjithashtu ai i dërgoi mjaft

[882]Shuteriqi Dh. "*Mbi Barletin dhe shkrime të tjera*" Tiranë 1979, fq. 207

material, si proverba dhe këngë dasmash, studiuesit J.U. Jarnik, të cilat ai i botoi në gjermanisht në një revistë folklorike në Leipzig (1889 – 90[883]).

Mjaft prej materialit të tij të mbledhur, kryesisht këngë dhe përralla, ai ia dërgoi edhe albanologut G. Meyer, i cili i botoi ato, në Studime Shqiptare "Albanesischen Studien", vëllimi II, Vjenë 1897. Arsyeja që Mitkoja, mblodhi me zell të madh folklor, botoi "Bletën Shqiptare", përgatiti botimin e tij të dytë folklorik "Bleta e Vogël", e cila mbeti pa u botuar dhe, dërgoi mjaft mbledhje folklorike në studiues të ndryshëm dhe albanologë të njohur, të cilat u botuan kohë pas kohe dhe, që përbëjnë në tërësinë e tyre një material shumë të vlefshëm albanologjik. Është pikërisht promovimi i trashëgimisë, si një element i rëndësishëm i etnogjenezës dhe vijueshmërisë autoktone, por edhe si një nxitje për studiuesit dhe albanologët. Ndonëse me profesion tregtar, Mitkoja me ndihmesën e tij, shfaqet si një filolog dhe albanolog i shquar, vepra e të cilit krijon akoma mundësi të reja studimi dhe prezantohet gjithmonë e më tepër dhe evidentohet denjësisht me punime dhe studime, akoma të panjohura, të cilat studiuesit i sjellin kohë pas kohe. Në një ribotim të përkthyer në shqip të "Bletës Shqiptare" në Vjenë, në vitin 1924, prej Dr. Gjergj Pekmezit, të bën veçanërisht përshtypje, mënyra se si ai flet për vlerat dhe dhuntitë e Mitkos si studiues dhe folklorist, duke theksuar pikërisht gadishmërinë e tij për t'ju dalë punëve në krye me sukses. Kështu ai shprehet: "Mitkoja ishte i njohur edhe me albanologë të tjerë të kohës së tij, të cilët ditën ta çmojnë së tepërmi punën dhe diturinë e lartë të Mitkos, ashtu që sot me të drejtë emri i tij i pavdekur, zë vendin e merituar ndër fjalorët enciklopedikë të përbotshëm."[884]

Nga artikujt e botuar në shtypin e huaj, të bëjnë përshtypje, artikujt e tij të karakterit historik dhe përshkrues në lidhje me historinë e qytetit të Korçës. Kur lexon ato, të krijohet përshtypja se je duke lexuar punimin e ndonjë autori bashkëkohor dhe harron se këto janë shkruar para 150 vjetësh[885]. Në tërësi, artikujt e botuar të krijojnë përshtypjen e një pune të mirëfilltë shkencore, me bibliografi, burime dhe shpjegime. Të dhënat e mbledhura nga tradita gojore i nënështrohen një mënyre deduktive arsyetimit, bazuar në fakte historike dhe ngjarje të cituara me burimin përkatës, emrin e autorit, titullin e dokumentit historik dhe kronologjisë, së cilës i përket dokumenti. Pikërisht me këtë metodologji shkrimi do të thonim sot, operon ai, kur flet në mënyrë diakronike për shtresat dhe periudhat historike, qysh nga shekulli VII deri në mes të shekullit XIX, për Korçën dhe zonat përreth. Një mënyrë tjetër e veçantë e parashtrimit të fakteve hisorike, kur nuk ka studime të mirëfillta historike, në lidhje me qytetin e Korçës, nga burime të drejtpërdrejta bizantine, autori citon shkrimtarët bizantinë, të dhënat e tyre në lidhje me zonën e gjerë, dhe duke përdorur metodën e diferencimit të të dhënave, konkludon duke referuar burimet e drejtpërdrejta për zonat fqinje me Korçën, që nga periudhat e

[883] Buda A. Studime Historike, "*Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare*", Tiranë 1965, fq. 47.
[884] Pekmezi Gj. "*Bleta Shqypëtare*", Vjenë 1924, fq.6.
[885] Thimi Mitko, Akademia e Shkencave…, Tiranë 1981, fq 36.

hershme, deri në ato bizantine e, më të vonta, me regjistrat turke të karakterit administrativ, siç është rasti kur ai merr në konsideratë, traditat e shumta në lidhje me themelimin dhe me etimologjinë e qytetit të Korçës.

Të gjitha këto modalitete, flasin për një studiues të kulturuar, shumë fin dhe elegant në mënyrën e të arsyetuarit dhe tepër modern në mënyrën e shkrimit, argumentimit dhe pasqyrimit të historografisë. Mitkoja nuk ishte historian por puna e tij, të paktën artikujt e botuar, tek "Pandora", një organ prestligjioz i karakterit filologjik, që dilte në Athinë, me botime shumë dinjitoze, nga autorë të njohur vendas dhe të huaj, të krijojnë një profil prej historiani për të, edhe si në rastin e botimeve folklorike; edhe këtu, qëllimi i Mitkos është, që të kontribuojë sadopak, për të vërtetën historike, në lidhje me shumë çështje, që nga autorë të tjerë, kryesisht të huaj, nuk po thuheshin si duhet, duke ngritur në normë variante te kontestueshme për mendimin e tij, të cilat ai arrin ti argumentojë me mënyrën e vet. Kështu, ai krejt pa dashur bëhet një prej studiuesve, vepra historike e të cilit, zë vend pothuajse në të gjitha bibliografitë e studiuesve të mëvonshëm, vendas dhe të huaj, që do të shkruanin për Korçën. Vlen të përmendet fakti se Th. Mitkoja është autori i parë korçar që shkruan, qysh në mesin e shekulit XIX , për qytetin e tij, dhe jo vetëm për historinë; studimi i tij historik, është i mbushur me të dhëna të shumta demografike, arkeologjike, me të dhëna interesante të jetës qytetare zakonore në shekuj, me fakte interesante mbi jetën kulturore dhe arsimore përgjatë shekullit XIX, deri me ndryshimet administrative dhe fatkeqësitë natyrore, që kanë ndodhur në këtë periudhë, në qytetin e Korçës dhe zonën përreth dhe në përgjithësi me prurje të konsiderueshme pra në fushën e antropologjisë kulturore, duke e renditur atë, në një prej burimeve më të rëndësishme dhe më të cituar, të shumë autorëve që janë marë me zonën e Korçës. Për herë të parë po botojmë të plotë këtu, dy artikuj të Th. Mitkos në lidhje me Korçën, botuar me pseudonimin Thesproti, pjesë të studimit të tij historik, të cilat në botimin e plotë të veprës së Th. Mitkos, me rastin e njëqind vjetorit të "Bletës Shqiptare", nuk janë botuar, si edhe në ndonjë botim tjetër të mëvonshëm për të, nuk janë përfshirë. Janë pikërisht dy artikuj, të botuar në "Pandora" në 27 Nëntor të vitit 1867[886].

Kur lexon shkrimet e Th, Mitkos shkruar në gjuhën greke, që në epigramet e thjeshta, si ajo që i dedikohet përurimit të godinës së liceut grek themeluar në vitin 1848, në qytetin e Korçës, deri tek letrat dhe artikujt e tij te botuar, nuk ka se si të mos impresionohesh nga stili elegant dhe forma klasike, me të cilën ai e shkruante këtë gjuhë. Puna dhe dijet e Th. Mitkos, për të cilat ai u vlerësua qysh nga bashkëkohësit e tij, janë tregues jo vetëm të një intelekti të spikatur, por mbi të gjitha produkte të një arsimimi dhe kulturimi shumë të mira. Nga të dhënat biografike, mësojmë se ai, u arsimua në qytetin e tij të lindjes, ku krahas shkollës elementare dhe gjimnazit, ndoqi studimet edhe në liceun e këtij qyteti, ku edukimi klasik, gjuhët e vjetra dhe gjuhët europiane mësoheshin nga profesorë të shquar.

[886] Pandora, "*Peri Koritsas*", Athinai, Nëntor 1867.

Shumë pak është hulumtuar në lidhje me arsimin dhe kulturën në qytetin e Korçës, përgjatë kësaj periudhe. Nga të dhënat e pakta të botuara nga studiues të huaj, mësojmë se programet e shkollave këtu ishin të njëjta me ato simotra në Europë dhe se, në liceun e këtij qyteti, i cili funksiononte qysh nga viti 1844, një pjesë e konsiderueshme e profesorëve atje, ishin përveçse të diplomuar edhe të doktoruar[887], në universitetet e Athinës, Vjenës dhe Italisë. Pra edhe Efthim Mitko, duhet parë fillimisht si produkt i kësaj shkolle dhe këtij qytetërimi.

Artikull i Efthim Mitkos, botuar në Pandora 1867

Në Lidhje me Korçën[888]

Drejtorit të nderuar të Pandorës

Nga Epiri në 27 Nëntor 1867

Qyteti dhe qendra e tij me këtë emër, është i njohur si qark adminiatrativ. Gjatë kësaj kohe Korça dallon nga pikëpamja natyrore dhe etike ndër katërmbëdhjetë zonat e Epirit të Ri[889], të cilat qysh prej kohës së pushtuesit , Sulltan Mehmetit, kanë qëndruar dhe qëndrojnë prej vitesh nën juridiksionin e Rumelisë.

Në qendër të zonës administrative të Korçës, shtrihet lugina më e lartë se çdo luginë tjetër epirote, e cila, duke filluar që nga fshati i Pendavinjit, është e gjatë pothuajse dhjetë orë dhe e gjërë dy deri tre[890]. Këtë luginë e rrethojnë male të larta, vazhdim i vargmaleve të Pindit, të quajtur Moravë. Në Jugperëndim, të Qarit[891] ka një kompleks malesh. I formuar prej maleve të Vithkuqit, Voskopojës, Oparit, Gorës dhe Mokrës, më në Veri zgjatet një vargmal tjetër, i cili mbaron me malin Skardon. Malet më të rëndësishëm të këtij vargmali janë, mali i Nikolicës, Kosturit, Ivani dhe Mali i Thatë, male të Devollit, në majën e të cilit gjatë gjithë vitit qëndron një liqen i vogël.

Prej këtyre maleve të rëndësishëm formohohet rrafshnalta e Korçës, e cila ka vetëm dy dalje të buta. Dalja e parë është atje ku shrihet Devolli, këtu është ndërtuar fshati Cangonj, nëpërmjet së cilës Korça komunikon me Kosturin, ndërsa ngushtica e dytë ndodhet në cepin verior të liqenit të Maliqit, që quhet ndryshe

[887] Ismairliadhu A. "Koritsa" Athina.

[888]Në periodikun tuaj kaq të dobishëm për kombin, po dërgohen dhe disa informacione sporadike në lidhje me Korçën, qytetit epirot plot vlera. Nëse ju këtë monografi të dërguar, që është një punë e imja e pabotuar, e gjeni pozitive dhe me interes, kini mirësinë që ta botoni. Këtë e kam shkruar para dy vjetësh, duke mbledhur mjaft të dhëna nga vendi, prej një miku, dashamir i historisë dhe intelektual epirot, i cili jeton në këtë qytet, emrin e të cilit nuk po e përmend për momentin, duke respektuar dëshirën e tij. P Thesprotos

[889]Shih në Pjesën e Sipërme, kapitulli i gjashtë, emrat e katërmbëdhjetë zonave.

[890]Thuhet se në kohë të vjetra kjo luginë mbulohej prej pyjesh të dendur, një tregues i kësaj janë emrat, të cilat në disa vend janë ruajtur, si psh, Orman Çiflik (Çifliku i Pyllit), Shelgjet, Shelgjet e Stefanecit etj.

[891]Mal që vazhdon pas vargmalit të Pindit, maja e të cilit quhet Gramica (Gramoz) dhe formon në mbylljen e tij së bashku me pesë malet që e pasojnë vargmalin, të cilin bizantinët e quanin Parithea, ose malet e Pirineas. Qari gjatë kohërave të shkuara, si rezultat kthimit të tij në një çerdhe kusarësh, ka qenë tmerri i udhëtarëve dhe i zonës.

Sovjan, nga del prej kësaj lugine lumi Devoll; nga ky pozicion komunikohet me vendet e Ohrit, me Behilicën, Tomoricën, Skraparin, Gorën dhe Mokrën.

Megjithatë, kjo luginë ka edhe dy dalje jo shumë të përshtatshme; njëra ndodhet në Veri Perëndim, afër fshatit Zvezdë, që quhet shqip Prohthinë (Προχθήν) (bregu i ndërprerë), midis malit Ivan dhe Malit të Thatë, e cila të krijon përshtypjen e një porte, me anën e së cilës komunikon me pjesën më perëndimore të Maqedonisë. Kjo dalje në formë porte, në kohët e vjetra ka qenë e zënë me mur, për të penguar armiqtë që mund të hynin që këtu për në luginën e Korçës. Dalja tjetër e pavolitshme është në Jug, në malin e Qarit, nëpërmjet së cilës kryhet komunikimi me zonat e Përmetit dhe Kolonjës.

Këtë luginë e lagin përrenj dhe lumenj të përhershëm, njëri prej të cilëve është edhe Dunaveci, që buron prej malit Devoll (Δεβάλι). Ky lumë mbasi ujit një pjesë të madhe të saj, derdhet në lumin Devoll afër fshatit të Maliqit. Ndërsa lumi Devoll e ka burimin e tij kryesor në majën veriore të vargmaleve të Pindit, afër majës së Nikolicës, afër Resnjës, duke u bashkuar me të në liqenin Drenovon, buron dega e Devollit, që vjen në luginën e Devollit, dhe më pas në Korçë, ku pasi shkon përmes fshatit Pendavinj dhe del që këtu nëpër ngushticën e Sovjanit, duke kaluar nëpër fshatrat e Gorës, Elbasanit dhe Peqinit, derdhet në gjirin e Adriatikut në Perëndim të Osumit, lumit të Beratit, të quajtur Shkumbi (Σκόμπις), në derdhjet e tij, dhe këtë Bizantinët e quanin Tovin dhe Paniason.

Kjo luginë e përshkruar, përmban toka mjaft të mira, pjellore, të punuara si duhet rregullisht, prej banorëve të qytezave dhe fshatrave të saj, të cilat ndahen në katër seksione administrative, në atë të Kosturit, Devollit, Bilishtit (Μπεχλίστας) dhe Korçës. Dhe (toka) si punohet prodhon grurëra cilësorë me bollëk, me të cilat ushqehet kryesisht e gjithë zona malore e Shqipërisë së Mesme, Gjithashtu nga vreshtat tepër frytdhënëse të Korçës prodhohen edhe një mori verërash të vlerësuara. Fatkeqësisht në pjesën fushore, që i përket Korçës (e cila është më pjellore se të tjerat), është krijuar në fillimet e këtij njëqindvjeçari liqeni i Sovjanit, tre orë larg qytetit të Korçës, i mbushur me peshk dhe ngjala, i cili pak nga pak ka zënë pjesë të konsiderueshme toke, si rezultat i një lloj argjinature në një pjesë të madhe të shtratit të lumit Devoll, në vendin e quajtur Evrenes. Kjo lloj pende, është krijuar nga aluvionet që sjellin Dunaveci dhe lumenjtë e tjerë në kohën e rreshjeve të shumta. Kur ujërat e kapërcejnë këtë dhe derdhen, atëherë zmadhohet liqeni në fjalë, duke zënë dhe përmbytur sipërfaqe të tjera toke. Deri tani, megjithë masat që janë marrë dhe zbatuar nga administrata lokale, duke qenë të mangëta dhe jo profesionale, nuk ka patur asnjë rezultat për eleminimin e saj.

Në pjesën fushore të Korçës dhe në atë malore të qarkut administrativ, numërohen mbi gjashtëdhjetë qyteza dhe fshatra, të banuara prej pothuajse njëzet mijë vetash të krishterë dhe otomanë, numri i këtyre të fundit është më i madh, pasi

gradualisht si rezultat i presionit në këto vende, është shtrirë islamizmi[892]. Numrin e Banorëve të zonës së Korçës, Pukëvili në kohën e tij e ngre 6080 familje (Περιγ. Τομ 3, βιβ. Ζ. κεφ. ΙΣΤ'). Gjuha që mbizotëron në këtë vend është shqipja, pasi kjo racë është shumë më e shumtë. Flitet edhe vllaçja, sidomos nga banorët e Moskopolit (Voskopojës) dhe Shipskës, si dhe në pak qyteza dhe fshatra përreth të themeluara prej tyre. Gjuhën bullgare[893] e flasin banorët e Boboshticës, Drenovës dhe Zvezdës, zonë e Devollit. Burrat e këtyre tre racave e njohin gjithashtu edhe dialektin grek, si rezultat i marrëdhënieve të tyre me grekët epirotë dhe maqedonas.

Në zonat malore të administratës së Korçës banojnë të krishterë dhe muhamedanë, të cilët ushtrojnë kryesisht dy zeje, blektorinë dhe ndërtimin, këtë të fundin kaq shumë e kishin ushtruar sa nga epirotët ndërtuesit quheshin në përgjithësi Korçarë (Κορτσιαλίδες). Ata të cilët jetojnë në fshatrat fushore, i kultivojnë tokat e tyre me mjeshtëri dhe në mënyrë sistematike. Nga muhamedanët të rrallë janë ata që largohen nga vendi për të bërë shërbimin ushtarak, edhe këta edhe ata (do të thotë, edhe
muhamedanët dhe të krishterët), janë të paaftë në ushtrimimin e armëve.

Kjo pjese administrative e Epirit të Ri, përmendet qysh në epokën helenistike, nuk kemi diçka tjetër për të thënë[894]. Nuk ka asnjë dyshim se ky vend ka qenë banuar nga Illirët, para se këto vende të pushtoheshin prej Maqedonasve, të cilët, si i pushtuan atëherë zonat e Epirit, i quajtën këto Maqedonia e Poshtme. Për këtë arsye, zonat e Pindit u quajtën prej Justnianit të Madh zonë Prevalitane

[892]Tek Muhamedanët e qytetit dhe zonës së Korçës, vërehen jo pak mbetje të adhurimit stërgjyshor. Midis të cilave ja vlen të përmendim besimin dhe devotshmërinë e Otomanëve të qytetit, të cilët ditën e përkujtimit të shën Gjergjit në mënyrë sistematike shkojnë tek burimi në kishën e Fjetjes së Hyjlindëses, që quhet Ajazma dhe lahen me devocion për shenjtërim shpirtëror. Përmendim gjithashtu edhe respektin e thellë që tregojnë, pothuajse të gjithë otomanët vendas, sa herë që vijnë ose ju afrohen vendeve të shenjta të krishtera. Gjithashtu është edhe një traditë, të cilën e ruajnë dhe ushtrojnë banorët e fshatrave të Voskopit dhe Goskovës. Në vigjilje të Krishtlindjeve, ata të veshur në argjend (mirë) shkojnë duke kënduar këngë fetare nëpër shtëpitë e bashkëfshatarëve të tyre, ashtu siç bëjnë edhe të krishterët përreth këtë ditë.

[893]Në këtë vend toponimet, ashtu si në vendet e tjera të Epirit dhe Maqedonisë, kanë më së shumti origjinë sllave. Diçka e tillë është imponuar dhe ka zënë vend si rezultat i pushtimit bullgar. Në shumicën e rasteve (fjalët) nuk u formuan por u përkthyen në sllavisht. Për këtë po sjell si shembull pak prej tyre: Zvezda – Selas ose Selasfor - Ylli i Mëngjezit, Drenovë – Thanë, Gora – i lartë, Bellovoda – Ujëbardhë etj.

[894]Midis popullatave të Epirit të Ri bëhet fjalë edhe për Parthinët ose Parthionët, të cilët siguristh kishin edhe një qytet të quajtur Parthion. Polivi (Βιβ. Ζ, σελ. 1506), na thotë se romakët i dhanë Pleuratit, për arsye të alenancës që bënë me të, dy qytete ilire, të cilat i përkisnin Filipit (të Maqedonisë), Lihnidhën dhe Parthion. Malet Parthike i hasim edhe tek autorët Bizantinë, sipas të cilëve ato ndanin Epirin e Ri nga Epiri i Vjetër. Këto tek ne shtrihen me vazhdimin e vargmaleve të Gramozit dhe Qarit. Kështu mund të hamendësojmë, se qyteti i shquar i Barçit, tashmë një fshat i Korçës, ku ruhen shumë rrënoja të vjetra, vjen nga deformimi i fjalës Parthu ose Parthiu. Nuk është tepër e guximshme pra të konkludojmë se Parthët ose Parthianët kanë banuar në këtë vend, banorët e të cilit Pukëvili duke shpjeguar Strabonin në mënyrë arbitrare, i quan Eordhianë dhe Lingisë, kombe ndoshta të konsideruara maqedonase.

(Πρεβαλλιτάνα επαρχία), arsyet e së cilës ne i shpjeguam në monografinë e zgjeruar për Ohrin.

Gjeografi Meletios e vendos në qytetin e Korçës, qytetin antik të Ormas, por kjo dëshmi nuk ka bazë, pasi veç të tjerash, asnjë rrënojë antike prej këtij qyteti nuk duket të ketë këtu[895]. Ndoshta gjeografi në fjalë, duke dëgjuar emrin Orman Çiflik, e ka vendosur këtë afër Korçës, duke menduar se këtu ka qenë qyteti Ormas.

Qytete mesjetare në këtë zonë kane qenë: Selasfori, Barçi, Deaboli i Madh dhe i Vogël, Emboria (Mborja), Bithëkuqi, Nikolica dhe Ipiohia (ndoshta Shipska), të gjitha këto tani janë qyteza dhe fshatra.

Në këtë vend ruhen edhe disa kala (fortesa) bizantine, një prej të cilave në qytetin e Korçës, e cila ruhet mjaftueshëm, një tjetër në këmbët e Malit të Thatë, e cila tregon për shtrirjen dhe fortifikimin e saj dhe një tjetër shtrihet në malin e Mborjes[896].

Këto përsa i përket pozicionit dhe lashtësisë së zonës së Korçës. Përsa i përket themelimit të qytetit të Korçës, duke mos patur ndonjë gjë për të referuar, po publikoj vërejtjet që pasojnë. – Dy tradita (variante) ruhen prej korçarëve në lidhje me themelimin e qytetit. E para thotë se në këtë vend, gjatë periudhës bizantine ka patur një hotel të madh, pronë e vajzës së hegjemonit (sunduesit), i cili e kishte qendrën e tij në kalanë e fortifikuar të atëhershme, të quajtur qytet. Dhe nga ky hotel, me kontributin dhe dëshirën e pronares në fjalë dhe të sunduesit, u krijua një vendbanim, i cili e mori emrin Koritsa, prej emrit kori•. Tradita e dytë thotë se gjatë periudhës së sulltan Muratit të parë, mohuesi i krishtërimit Hoxha Imbrohor (Mirahor)[897], ngriti disa ndërtesa në këtë vend, dhe me predispozicionin e tij u ngrit

[895]Rrënoja të shumta të qyteteve antike ruhen në vende të ndryshme të zonës së Korçës, në fshatrat Boboshticë, Zahmatishtë, Kolenc (ndoshta Kolanec), Turan, Bithëkuq (Vithkuq), Zvizdan, Barç dhe Siptokan. Në këto rrënoja mund të kërkohet edhe Ormas e Meletios dhe Kreoni dhe Gotia dhe Gerunda dhe ndonjë qytet tjetër që citon Polibi (Ο Πολύβιος).

[896]Qyteti, fjalë shqipe, prej Citade, një fortesë e njohur, ndërtim i periudhës bizantine, e cila është meremetuar prej pushtuesve otomanë, ka qenë e banuar dhe e fortifikuar deri në vitin 1824, prej 20 familjesh otomane, të cilat gëzonin privilegjin që të mos shkonin ushtarë dhe të mos paguanin taksa. Ata kishin vetëm detyrimin që të shoqëronin thesarët e shtetit që kalonin andej, si dhe të vërenin nga maja e fortesës shfaqen e hënës së re dhe të lajmëronin bashkëbesimtarët për fillimin e Ramazanit dhe për Bajramin. Në një kohë më të vonë u braktis dhe u shkretua, pasi Mustafa bej Plasa, për të cilin do flasim më poshtë, e hoqi që andej Teleskopin (Τηλεβόλα) dhe e vendosi në kalanë e Korçës.

•Rrënja kori që mbart fjala Koritsa në greqishten bizantine do të thotë bijë, sipas këtij varianti emri Koritsa thuhet se vjen nga fjala kori, ndërkohë që Korçë është trajta e deformuar e emrit Koritsa. Në këtë rast vlen të përmendet fakti se Mitkoja fjalën Κοριτσά e shkruan me ι (giota) dhe jo me υ (ipsilon) Κορυτσά, siç shkruhet rëndom në gjuhën greke. Në rastin e shkrimit me ι (giota) Κοριτσά mund të pranohet etimologjia e fjalës nga rënja κόρις (bijë).

[897]Sipas një tradite të përbashkët Hoxha Mirahori kishte qenë djali i një prifti nga zona e Përmetit prej qytezës së Panaritit. Kur kaloi andej sulltan Mehmeti (është më e drejtë të thuhet ati i tij, Sulltan Murati), pushtuesi i Shqipërisë, e mori këtë djalë të ri në shërbimin e tij, si bir të një ati të rëndësishëm; dhe sipas mënyrave joshëse dhe detyruese që përdornin atëherë, mundi që t'i ndërronte besimin. Trim dhe intiligjent, i riu në fjalë, mohues i Krishtit, iu përkushtua shërbimit ushtarak dhe si rezultat i të dhënave të mira që kishte arriti në poste drejtuese. Gjeneral në mësymjen kundër Kostandinopojës,

qyteti në fjalë, me emrin Korçë, e cila më parë në këtë vend quhej Episkopi, sepse ruhej dhe mbahej një manastir i denjë i Fjetjes së Hyjlindëses, i ngritur në 1225, si dhe një kishë dinjitoze e shën e Premtes, të cilën Mirahori në fjalë e shndërroi në faltore muhamedane. Kjo traditë ushqehet edhe nga një shkrim turk, i cili i është dhënë në formën e një dorëshkrimi vetë Mirahorit. I pari nga këto dy variante, tregon se Korça është ngritur shumë kohë para pushtimit otoman, ndërkohë që varianti i dytë sjell vitin 1490.

Kur erdhi të banojë këtu Mirahori, ruheshin kishat dinjitoze dhe vendi quhej Episkopi. Kështu kjo traditë përputhet, nëse do të pranojmë se Mirahori zgjodhi për ngritjen e pallatit të tij, truaj të ndodhura në një lagje të qytetit të ngritur të Korçës, e cila quhej lagjja Episkopi, dhe mbas vendosjes së tij atje për banin, erdhën dhe u vendosën edhe shqiptarë të tjerë të prosilitizuar. Ndërkohë qyteti u zgjerua, u ripërtëri dhe mori një rëndësi të tillë, të cilën as pararendësit dhe as pasardhësit nuk e kishin shënuar ndonjëherë në këtë vend.

Themelimin e Korçës qysh në periudhën Bizantine e dëshmon midis të tjerash dhe mbetjet e kalasë së lashtë të saj, ekzistencën e së cilës gjatë pushtimit e nxjerrim edhe prej historianit Amir, i cili në regjistrin e taksave (Κατιλικίων), këto kanë qenë të njohura gjatë periudhës së shkëlqimit të Sulltan Mehmetit, në regjistrin e dytë numër 138, thotë se në qytetin e Korçës atëherë, ishte katedra (qendra) e të parit të vendit. Por çfarë emër kishte ky qytet në periudhën Bizantine? Etimologjinë e traditës së parë e konsiderojmë të papranueshme, dhe në lidhje me këtë do shpjegohemi në numrat e ardhshëm.

Në Lidhje me Korçën

(Vijon nga faqja 442)

---

triumfoi me marrjen e Psomathisë, dhe në këtë lagje , si shenjë triumfi me vendim të sulltanit mori kishën e famshme të Shën Kostandinit, që ndodhej atje dhe e shndërroi atë në faltore otomane, së cilës i blatoi prona të një vlere të konsderueshme. Kështu për një vijueshmëri sa më dinjitoze, vuri në dispozicion të saj, të gjitha të ardhurat e shtëpive dhe truajve të kësaj lagjeje. Këto të ardhura kishin të drejtë ti ndanin drejtuesit e kësaj faltoreje, të cilët ishin pasardhësit e tij. Kur u plak ky shqiptar, mohues i Krishtit, ju lut sulltanit të atëhershëm Bajazitit (për nga fundi i shekullit XV), që t'i jepej leja për të shkuar dhe jetuar në tokën e tij atërore. Si rezultat i kontributeve të tij ndaj fronit, sulltani ja përmbushi kërkesën, duke e shoqëruar atë me një ferman që i siguronte atij dhe pasardhësve legjitimë të tij, privilegjin e vjeljes së të ardhurave të bollshme të shumë pasurive shtetërore që ndodhshin në zotërim. Në një situatë të tillë plaku Mirahor zbret në Shqipëri, dhe për arsye të panjohura, ndoshta sepse bashkëfshatarët e tij nuk donin të kishin të bënin me të, qëndroi pak kohë në Panarit dhe më pas zbriti në Korçë. Këtu në Korçë ngriti pallatet dhe nxitoi që ta zëvendësonte kishën e Shën e Premtes në faltore otomane, ashtu si në Psomathi. Për ta mbajtur, blatoi pronat e afërta të dhuartës sulltanore, të ardhurat (legimin) e njëmbëdhjetë qytezave dhe fshatrave të zonës së Korçës, si dhe ato truajve dhe të gjitha shtëpive në Korçë. Drejtimin dhe kujdestarinë e këtyre të ardhurave ai ia u delegoi pasardhësve të tij, nën titullin "Imbrohor Evel" (Kryestallieri i Parë), sipas urdhërit të të cilëve këto të ardhura drejtoheshin dhe ndaheshin, ata ndanin gjithashtu dhe të ardhurat e tjera të pasurive me vlerë të madhe të trashëguara, të cilat ndodheshin në Shkodër, në Janinë dhe në Babiloni, vetëm një e pesat e tyre derdhej në arkën sulltanore. Varri i Imbrohorit (Mirahorit) është i vendosur në këtë faltore, dhe korçarët otomanë tregojnë një respekt të madh për varrin e tij.

Në krisobulin e Vasil Bullgaroktonit, lexojmë këto të dhëna: "Episkopi i Kosturit, e shtrin (administrimin e tij shpirtëror) në kështjellat e enorisë së tij, në Kostur, në Korestio, në Kolonin (Kolonjë), në Diavolin (Devoll, në Buzan dhe Moron, me dyzet klerikë dhe tridhjet banorë, (të cilët e kanë për detyrë ti shërbejnë Kishës së episkopatës), megjithëse më përpara ka patur më shumë, ndërkohë nuk nuk e kalon numrin e klerikëve dhe banorëve të Kryepishkopatës (së Ohrit)".

Nga kjo urdhëresë, informohemi, se në vitin 1020, episkopata e Kosturit e shtrinte juridiksionin e saj, në të pesta kështjellat e sipërpërmendura dhe vendbanimet e ruajtura në Epirin e Ri; dhe për arsye se midis Kosturit, Devollit dhe Kolonjës, shtrihet zona e Korçës, besojmë dhe arrimë në konkluzionin se, krisobuli , nëpërmjet emrit Kureston, nënkupton Korçën, e cila është quajtur kështu më pas, si rezultat i deformimit fonemor, (Pra nga Kurestion në Korçë). Nëse fjala Kurestion, e ka zanafillën etimologjike nga fjalët Kuri, ose Kori (bijë), nuk dihet se përse, dhe kur të ketë ndodhur diçka e tillë, para 1020. Nga të dhënat e mësipërme nxjerrim se deri në atë kohë, Koritsa (Korça) apo Kurestios, nuk ishte episkopatë, më pas u ngrit në rangun e episkopatës, nga Kryepeshkopët e Bullgarisë, ose të Ohrit, të cilët kishin privilegjin të krijonin episkopata të reja, të shpërndara në zonat episkopale të juridiksionit të tyre[898], si dhe bashkimin dhe shkrirjen e të tjerave. Një episkopatë e tillë e re, mendojmë se u ngrit, në kohën e Kryepeshkopit Leon Mungu, në vitin 1120, duke ngritur në rangun e episkopatës qytezën e Grevenasë, dhe kjo edhe me të drejtën kryepiskopale, në kohën e pushtimit, apo pak kohë para tij, për të përfshirë në juridiksionin e vet Kishën e Korçës, të Devollit dhe episkopatën e Selasforit, duke marë edhe titullin e Mitropolisë.

Nga burimet e shtjelluara, të cilat nuk janë për t'u neglizhuar, në mungesë të studimeve të mirëfillta historike, pasi fatkeqësisht nuk kemi gjetur ndonjë dokument historik në lidhje me këtë vend, midis shkrimtarëve bizantinë, arrijmë në konkluzionin, se Korça ka qenë fortesë dhe qytezë, qysh nga koha e Bullgarëve, dhe se mbas vitit 1030 u ngrit në rangun e episkopatës.

Si rezultat i konjukturave politike, zona e Korçës së bashku me atë të Ohrit, të Devollit dhe të vendeve të tjera të Maqedonisë së Poshtme, ka kaluar vuajtje dhe mundime të mëdha, sa herë që kjo provincë e Perandorisë Bizantine rrezikohej nga pushtimi Bullgar si dhe nga inkursionet armiqësore të Normandëve, qysh nga shekulli i shtatë, deri në shekullin e dymbëdhjetë.

Mbas pushtimit të Kostandinopojës në vitin 1204[899], këto zona në fjalë, të Perandorisë Bizantine, u pushtuan nga Serbët, në vitin 1218, prej sërbit Asthlla, familjarit të Assanit, mbretit të atëhershëm të Serbisë. Në gjysmën e dytë të shekullit të trembëdhjetë, këto vende i pushtoi Despoti i Epirit, Mihaili i Dytë, dhe prej tij u shkëputën në vitin 1260 nga Perandori Mihail Komnini. Përgjatë shekullit të

[898] Mendimi i Pukëvilit (Libri 7, Kapitulli 6), se autoriteti kishtar I Gotisë, u quajt më pas Koritsas (i Korçës), është arbitrar dhe i pavend.
[899] Prej latinëve. Nga Kryqëzata e katërt.

katërmbëdhjetë, (këto vende) u bënë pre e arbitraritetit dhe sundimit të kryetarëve të fiseve të pushtuesve të atëhershëm shqiptarë. Në kohën e sundimit të Arianit Komnenit, vjehrrit dhe aleatit të Gjergj Kastriotit të lavdishëm, supozojmë se zona e Korçës, së bashku me atë të Devollit, Kolonjës, Përmetit, Dangëllisë dhe Shqerisë, përbënin pjesën më të madhe të zotërimit të tij. Mbas vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut, (këtë zonë) e pushtoi totalisht Sulltan Mehmeti i Dytë.

Qyteti i Korçës shtrihet në këmbët e malit të Moravës, përgjatë bregut të majtë të lumit Devoll, karakterizohet nga një klimë e qëndrueshme, dhe një pozicion i përshtatshëm, me ujëra të shumta të jashtme dhe të brendshme. Popullata e saj arrin në këtë kohë në njëzet mijë shpirt, prej së cilës një e dhjeta i përket besimit mysliman. Banorët i përkasin në shumicën e tyre racës shqiptare, gjuhën shqipe e flasin si gjuhë nëne, ndërsa greqishten e dinë dhe e flasin burrat dhe të rinjtë. Nga zakonet dhe mënyra e jetesës, ndryshojnë prej fiseve të tjera të njëjtë të epirotëve; e aspirojnë qytëtërimin me çdo kusht, janë tregtarë dhe zanatçinj të zellshëm dhe të denjësuar. Ky qytet, si rezultat i shkatërrimit të Voskopojës, është bërë qendër tregtare, dhe është lidhur para disa viteve, me Korfuzin, Triesten, Venecian dhe Vienën, si dhe me çdo qytet tregtar të zotërimit Otoman. Shumë prej banorëve të saj, merren me zeje nga më të rëndomtat deri tek ato më të himtat, me rregjjen e lëkurës, me bërjen e këpucëve, përpunimin e hekurit, bërjen e qirinjve, ngjyerjen, rregullimin e orëve, argjendarinë dhe endjen e llojeve të ndryshme të prodhimeve të leshta, për veshje dhe shtroje, shumica e të cilave përpunohen në mënyrë sistematike prej grave. Vlen të përmendet, se dashuria për punën e korçarëve të krishterë, poseidohet atje edhe nga elementi otoman (banorët myslymanë), të cilët merren me zanate të ndryshme, dhe kryesisht me veshjen e kuajve dhe me rregjjen e lëkurëve.

Një konsumim i madh i mallit të magazinuar dhe të përpunuar, bëhet çdo të Shtunë, që është dita e pazarit, ku vijnë mijëra njerëz, nga fshatrat e Kolonjës, Rupishtit, Prespës, Oparit, Devollit, Sarparit, Tomoricës, Taras, Mokrës dhe Përmetit.

Prej banorëve të krishterë, një numër i konsiderueshëm prej tyre, në këtë kohë, për të ardhura më të mëdha, e provojnë fatin, duke emigruar në vende të ndryshme të Turqisë, dhe sidomos në Egjypt, ku kanë nxjerrë mjaft fitime; dhjetra prej tyre janë instaluar përgjithmonë në Kairo dhe Aleksandri, ku janë pasuruar shumë nëpërmjet tregëtisë. Ndonëse të larguar ata kujdesen dhe preokupohen për mbarëvajtjen e bashkëpatriotëve të tyre. Korça disponon ndërtesa të denja arsimore, Gjimnaz Grek (Ellinikon Frondistirjon), shkolla alilodidaktike dhe shkolla vashash. Në vitin 1837, u ndërtua shkolla elementare greke, me kontributin e disa prej parisë së qytetarëve, të krye të të cilëve qëndronin vëllezërit Mitko. Në këtë shkollë, i pari që ka dhënë mësim ka qenë Nikokliu nga Kozani. Mbas pak kohësh, kjo shkollë u zmadhua si rezultat i kujdesit dhe mirësisë së paanë të elementit qytetar. Në vitin 1848, për shkak të kontributeve bujare, të qytetarëve të mërguar (dhe sidomos të atyre të vendosura në Egjypt), u arrit të mblidhet një kapital i konsiderueshëm, i cili u pasurua me blatimet bujare të qytetarëve rezidentë, ku

secili dha sipas mundësisë. Ky kapital u depozitua në një vend të sigurt, dhe nga renta vjetore e tij, së bashku me ndihmat e dhëna kohë pas kohe prej të mërguarve, mbulohen shpenzimet e institucioneve arsimore. Në këtë mënyrë përhapet në Korçë dhe në zonën përreth arsimi dhe edukata, si rezultat i bujarisë së patriotëve artistë dhe të ndjeshëm.

Përsa u përket ndërtesave me vlera, në Korçë ka pesë kisha të shenjta, të kompletuara me shumë paime dhe enë të shenjta me vlerë: 1. Kisha e Burimit Jetëdhënës, ose katedralja, e ngritur nga themeli në vitin 1750[900]. 2. Kisha e Fjetjes së Hyjlindëses, e cila u restaurua në vitin 1844, mbi themelet e një kishe antike me të njëjtin emër, dhe mban vitin 1225. 3. Kisha e Profetit Ilia, 4. Kisha e Shën Athanasit dhe 5. Kisha e shën Gjergjit. Ngritja e këtyre tre kishave të fundit nuk dihet, ashtu si dhe ajo e shën e Premtes, të cilën Hoxha Imbrohor e mori dhe e shndërroi në një xhami pozante, e cila ruhet dhe sot.

Për t'u përmendur është edhe një ndërtesë me vlerë në qendër të qytetit, në këtë ndërtesë publike, është vendosur një orë; tek kjo ka qenë edhe një fortesë e periudhës bizantine, të cilën e ka zënë një pararendës i korçarit Dervish Ismailbej, dhe e ka ngritur dhe e ka rrethuar, për ta patur si strehim në një moment nevoje. Fortesa e sipërme bizantine, e meremetuar prej otomanëve u rrafshua nga shqiptarët muhamedanë (Turkoallvanon) të qytetit dhe të fshatrave përreth, mbas tërheqjes nga Korça të Mustafa Bej Plasës, që të mos zinte vend atje ndonjë tjetër, për të sunduar qytetin dhe fshatrat[901].

Kulla (fortesa) antike ruhen afër dy fshatrave, Turanit dhe Malavecit, kulla e parë një orë larg kullës së Korçës, dhe po aq larg kulla e dytë nga e para. Thuhet, se dikur këto tre kulla komunikonin nën tokë me njëra- tjetrën. Por edhe dy shtylla të tjera, të periudhës bizantine, duken të ngjashme me të tjerat në fshatin Dishnicë.

---

[900] Të bën përshtypje mënyra se si u ngrit kjo kishë, nga zelli dhe kontributi i disa anëtarëve të parisë së atëhershme Vasil Makut, Mitro Gllancos dhe Haxhi Kostit nga Voskopoja. Të tre këta, të krishterë besimtarë, në konspiracion të thellë, për tre vjet më rradhë, ndërtuan themele për një kishë të bollshme në një vend në qendër, dhe këtë e bënë, për të thënë pastaj se rastësisht zbuluan themelet e një kishe të vjetër, dhe me mënyra të ndryshme e kërkuan dhe e nxorrën lejën, që mbi themelet e një kishe gjoja të vjetër të ngrinin kishën. Vendosën që të betoheshin për tu dukur si e vërtetë gjetja e themeleve të vjetra. Mbas tri ditësh të betimit vdiq papritur Vasil Maku i përmendur. Kjo vdekje u mor nga njerëzit e thjeshtë si ndërshkim hyjnor.

[901] Ky ka qenë i biri i Ahmet Pashë Plasës, kriminel nga natyra, i cili u dha me mish e me shpirt pas Ali Pashë Tepelenës. Dhe si bëri shumë të këqija, duke i shërbyer atij (Ali Pashës), vrau Ali bej Moglicën, vëllain e nënës së tij, pasi ky ishte armik i Aliut. Si shpërblim për këtë që bëri, u emërua Muselim i Korçës, vend që e mbajti jo vetëm për sa kohë ishte gjallë Aliu, por edhe mbas vrasjes së tij, deri në vitin 1826, duke qenë një ndërshkim për qytetin e Korçës dhe fshatrave përreth. Kur Reshit Pasha, ishte kryegjeneral në ushrinë kundër Greqisë (në kohën e Kryengritjes Greke të 1821), kishte në shërbimin e tij si këshilltar Ismail bej Moglicën, vëllain e Ali Beut të vrarë, i cili e detyroi këtë vrasës të ikte në Shkodër, dhe prej andej në vitin 1832, të largohet në Serbi. Nga ku prej andej filloi marrëveshjet me Reshit Pashën, për t'u rikthyer në atdhe, i amnistuar, por me të hyrë në Bitola ju pre menjëherë koka, me këmbënguljen e të sipërpërmendurit, si hakmarrje për vrasjen e të ungjit.

Zona e Korçës, qysh prej shekullit të pesëmbëdhjetë është në juridiksionin e Rumelisë, dhe ka qëndruar në të deri në kohën e lulëzimit të Ali Pashës, për tu shkëputur më pas së bashku me Ohrin dhe me provincat përreth[902], duke rënë në arbitraritetin dhe shtypjen e tij. Mbas vrasjes së tij, mbeti në një gjendje anomalie, nën sundimin e Mustafa Pashë Plasës deri në vitin 1826, vit kur rivjen nën juridiksionin e Rumelisë, si njësi administrative nën Kajmekanin (nënprefekturën) e Kosturit, së fundi është bërë qendër nënprefekture, duke patur nën juridiksionin e vet Devollin dhe Bilishtin. Shfaqëm disa nga ngjarjet e vjetra të këtij qyteti, por le të shtojmë edhe disa të tjera, përgjatë këtij qindvjeçari. Popullata e qytetit dhe e zonave përreth, u zvogëlua ndjeshëm përgjatë vitit 1827, dhe kjo për shkak të epidemive, të shkaktuara nga ardhja pa pushim në vend e hordhive të huaja, për sa kohë mbajti rrethimi i Ali Pashës. Në vitin 1822 një zjarr i madh që ra bëri shkrumb e hi një pjesë të konsiderueshme të qytetit, duke shkaktuar një dëm të madh. Përgjatë periudhës gjashtëvjeçare të sundimit absolut të Mustafa Beut, të këqija të mëdha kaluan banorët e qytetit dhe të zonave përreth, otomanë (myslymanë) dhe të krishterë. Në vitin 1834 u prish qetësia dhe për larjen e detyrimeve shumë të mëdha të përbashkëta, të vendosura në kohën e Ali Pashait dhe Mustafa Beut, u ngarkua komuniteti i Krishter. U vendosën në Korçë mjaft të krishterë Skalisçinj dhe ish-voskopojarë, të cilët ndërtuan lagjen e tregut (Varoshin). Gjatë vitit 1836 një epidemi shkaktoi mjaft dëm. Qyteti dhe zonat përreth hoqën jo pak në vitin 1855 për shkak të një kolere shfarosëse, që u përhap dhe mbajti dy vjet.

Më lart u tha se kur Kisha e Korçës u ngrit në rangun e episkopatës, dhe se kur duke u bashkuar me kishën e Selasforit, mori titullin (u ngrit në rangun) e Mitropolisë, nën Kishën Autoqefale të Ohrit. Nën juridiksionin e saj, ajo qëndroi deri në vitin 1767. Kur me vendim sinodik u shfuqizua Kryepiskopata e Ohrit, Mitropolia e Korçës, u rendit në Fronin Ekumenik, (Në Patriarkanën e Kostandinipojës) duke marë vendin e 75 shtëdhjetë e pesë, dhe mbante titullin (Mitropolia) e Korçës dhe Voskopojës.[903]

Nën juridiksionin e kësaj Mitropolie, përpara disa qindvjeçarëve, futej pjesa më e madhe e zonës së Devollit, tre zonat, e Përmetit, e Denicës, Rizës dhe Cerjes, dhe dy zona të Tepelenës; Dervenasi dhe Viri, të cilat para dy shekujve ju nënështruan islamizimit. Edhe zona e Kudhësit ishte nën juridiksionin baritor të saj (të Mitropolisë së Korçës), për këtë arsye, kur Ali Pasha, vendosi në këtë vend të krishterë, në vend

[902] Hronogram. Vell. 1, Fq. 286. Vlen të përmendet se para Aliut, Korça ka qenë nën Kara Mustafa Pashën, sunduesin e Ohrit.

[903] Në Mitropolinë e Korçës, ruhet një kodik, i cili përmban disa praktika dhe kontrata, mbi të shkruhet: "Kodik i Mitropolisë së Shenjtë, të shpëtuar nga Perëndia i Korçës dhe Selasforit, në kohë të Jerarkut dhe Patriarkut (në Ohër), të fortlumturisë dhe fort të diturit Kryepiskopit të Justinianës së Parë të Ohrit Zotit Zotit Parthen nga Korça, dhuruar prej tij në vitin 1670. Vlen të përmendet fakti, se në kohën e lulëzimit të Voskopojës, u hoq fjala e Selasforit dhe u shtua e Voskopojës, deri në vitin 1828. Sipas katalogut të kryepriftërinjve mbas kësaj periudhe, ndryshohet përsëri titulli i Mitropolitit të Korçës midis viteve 1670 – 1848."

të myslymanëve shqiptarë të dëbuar, atëherë Mitropoliti i Korçës, ishte bariu shpirtëror i atyre që kishin mbetur.

Në vitin 1828 u fshi nga Diptikët e Kishës së Madhe të Krishtit Mitropolia e Pogonianisë, dhe komunitetet e krishtera të këtij vendi, të ndodhura në të djathtë të lumit Vjosa, ju bashkëngjitën Mitropolisë së Korçës.

Nga Kryepriftërinjtë e kësaj Kishe, gjejmë të përmenden vetëm të mëpasshmit (d.m.th. mbas Parthenit).

Parthen Korçari, Kryepiskop i Ohrit, nga Korça, në vitin 1670.

Joasafi, me titullin Kryetari i Korçës, për arsye se në të njëjtën kohë drejtonte edhe Kryepiskopatën e Ohrit, prej vitit 1718 deri në vitin 1745.

Joakimi i Korçës dhe Voskopojës, deri në vitin 1781.

Meleti i Korçës dhe Selasforit, deri në vitin 1828.

Visarioni i Korçës dhe Pogonianisë, deri në vitim 1835.

Qirilli i Korçës dhe Përmetit, nga Veria, deri në vitin 1847.

Neofiti Gjirokastriti, ish Mitropolit i Drinopolit, i përndershmi i Korçës.

Nën juridiksionin e Mitropolisë së Korçës, prej manastireve të shumta të mëparshme, kanë mbetur vetëm këto të mëposhtmet:

1. Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses, në fshatin Boboshticë.
2. Manastiri i Shën Nikollës, po këtu, ndërtim i vitit 1450.
3. Manastiri i shën Kostandinit, në malin e Drenovës.
4. Manastiri i Profetit Ilia, në fshatin Hoçisht.
5. Manastiri i Profetit dhe Pararendësit në Voskopojë, ndërtim i viti 1630.
6. Manastiri i Apostojve të Shenjtë, në Vithkuq[904]
7. Manastiri i Profetit Ilia, në mal të Korçës, përballë majës së malit që quhet Qyteti[905]
8. Manastiri i Analipsit (Ngjitjes së Zotit Krisht në Qiell), përballë, një orë larg nga qyteza e Devollit[906]
9. Manastiri i Shën Gjergjit, në mullirin e Zvezdës.

E mbyllim këtë monografi, duke e referuar lexuesin, edhe në kapitullin E (e pestë), të pjesës së dytë të këtij përshkrimi, në fjalën Korça. (**Përktheu D. Tushi).**

[904] Në emër të këtij manastiri, një klerik me banim në Venetik, bleu përgjithmonë taksën e Peshores, në mënyrë që e ardhura vjetore e saj ti kalojë për dobi Igumenit (të parit të manastirit), qysh prej vitit 1797 (kur është blerë), deri sa të ekzistojë shteti i Venetikut.

[905] Ky manastir, që i përket bashkësisë së Mborjes, sipas një tradite, është ndërtuar nga sundimtar i Qytetit, në mënyrë që të kishërohej në të. Ai shkonte atje (nga Qyteti) nëpërmjet një ure të drunjtë, e cila lidhte majat e dy maleve të sipërpërmendur.

[906] Gërmadha të manastireve të tjerë, dallohen në vende të ndryshme, si ai i Shën Gjergjit, në fshatin Mangulion, ikonë e të cilit ruhet në manastirin që përmendëm më parë të Shën Nikollës. Manastiri i Shën Nikollës, midis fshatrave Dinicë dhe Kuç, një orë e gjysëm larg Korçës. Manastiri i Ungjillëzimit, i cili ndodhet në një vend të vështirë për të shkuar, ikonë e të cilit ruhet e pikturuar në faqen ballore të kishës në ruajtje.

ELVIRA LUMI (ELBASAN)
LEDIONA LUMI (ELBASAN)

EVOLUMI I FIGURAVE POETIKE NË VEPREN "BLETA SHQIPTARE" TË THIMI MITKOS

Duke pasur parasysh natyrën e punimit, objekt i tij është përpjekja për të klasifikuar, krahasuar dhe për të zbërthyer figurat poetike në veprën "Bleta Shqiptare" të Thimi Mitkos. Figurat poetike përbëjnë fjalë, fraza apo imazhe që ruajnë mbeturina të një përfytyrimi poetik të thjeshtë, konkret dhe të drejtëpërdrejtë që lidhen me një të menduar primitiv, por edhe si figura që evoluojnë, që lidhen dhe me një të menduar modern ku gjuha evoluon nga kuptimi konkret në kuptime te ndryshme ku rol luan imazhi poetik dhe valenca e kuptimit të fjalëve në varësi të funksionit poetik. Figurat poetike ku përfshihen dhe tropet, përmbajnë mbetje përfytyrimi të një shoqërie të hershme dhe botëpërjetimin e saj mbi natyrën, jetën dhe universin, por dhe zhvillimin historik të vetë figurës.

Figurat dhe klasifikimi i tyre ishin një fushë e rëndësishme në retorikën klasike. Me objektin e studimit të figurave poetike është marrë dhe kritika moderne, veçanërisht dekonstruksioni poetik i fjalëve, frazave dhe imazheve. Qëllimi ynë është që duke u nisur nga kriteret e klasifikimit të figurave poetike si: 1.figura të ngjashmërisë apo marrëdhënies, 2.figura të theksit, 3. shfaqjes, 4. figura të kuptimit, 5. figura të gabimeve, 6. figura gjuhësore, të grupojmë fjalët dhe frazat e zgjedhura në poezinë dhe prozën e "Bletës.." mbi një model të mbaruar poetik që i referohet valencës së figurës dhe formës së shprehjes.Në rastin më të shpeshtë, poeti popullor më tepër imagjinon se sa arsyeton si tek "Këngë të vegjëlish", tek cikli "Këngë për festat popullore të motmotit", "Këngë dasme" dhe "Përralla". Në këto cikle, figurat poetike janë të thjeshta, konkrete dhe përfytyrimi poetik është i drejtpërdrejtë, herë i varur dhe herë i pavarur që ngrihet mbi perceptimin fizik dhe ngjashmërinë e objekteve me bazë ngjyrën, formën, zërin, zhurmën, funksionin dhe analogjinë e tyre me tiparet e jashtme njerëzore. Këto lloj figurash si personifikimi, simboli, krahasimi, paralelizmi figurativ zbulojnë një përfytyrim konkret dhe naiv mbi botën. Ky përfytyrim është me bazë përjetimin emocional, imitues dhe që i referohet një shkalle fëminore të perceptimit të botës që lidhet me një kohë të lashtë të shoqërisë shqiptare dhe është një përjetim personal i së bukurës ku figura është më tepër një zbukurim apo theksim i fjalës. Nga figura të thjeshta dhe konkrete, figurat poetike veçanërisht tropet evoluojnë në figura mendimi, ku përfytyrimi poetik ngrihet tashmë mbi një abstragim dhe është një perceptim abstragues i natyrës, jetës dhe historisë. Në ciklet e këngëve "Nizami", "Kurbeti", "Vaje e këngë të përjavshme", "Epika", "Epika historike" referuar "Bletës..", figura bazohet mbi një lloj sqarimi logjik ku përjetimi bëhet kolektiv dhe ngjyrimi i fjalës buron nga një histori e evoluimit të saj në disa kuptime, deri në shkëputjen nga kuptimi i parë i fjalës. Tashmë, figura poetike, i referohet një mendësie kolektive mbi zakonet dhe

konstitucionin shpirtëror të popullit që zhvillohet historikisht. Zgjedhja e figurës bëhet jo vetëm me një vetëdije dhe qëllim të caktuar, por funksioni i saj stilistik është i fshehur dhe duhet një operacion mendor për të zbuluar përmbajtjen kuptimore te fjalës si gjuhë e ligjërimit poetik siç është metafora poetike, metonimia, sinekdoka, ironia. Metafora poetike, sinekdoka, ironia, metonimia, janë figura që ngrihen mbi imazhe të mendimit dhe shfaqen në këngë dhe poezi të mëvonshme si baladat, epika legjendare, epika historike dhe pasqyrojnë një fazë më të zhvilluar të shoqërisë shqiptare, kur tiparet e kulturës së etnosit ndërthuren me konflikte historike dhe krijimin e një ndërgjegjeje që zhvillojnë vetëdijen e kombit.

Duke u nisur nga klasifikimi i tre grupeve të para si: 1.figura të ngjashmërisë apo marrëdhënies, 2.figura të theksit, 3. Shfaqjes, kemi vërejtur, se në veprën e Mitkos, ka një përdorim të madh të paralelizmit figurativ, epitetit, personifikimit, enumeracionii, anaforës, si figura poetike që lidhen me një përfytyrim me bazë tiparet e jashtme mbi bukurinë, veçanërisht bukurinë e fëmijës, të vashës, bukuria e natyrës, që zbulojnë një shkallë konkrete të njohjes dhe një përjetim shqisor dhe fizik të së bukurës.

-Figura të shfaqjes i gjejmë në shembullin e mëposhtëm te cikli "Këngë të vegjëlish" në këngën "Dielli Hëna" : *Hën' e re/ vash' e re/tinë plakë/un' e re;/ti gërshet,/unë shëndet*.[907]

Në këtë rast, përsëritja tre herë e epitetit e *re* i jep poezisë karakter lodrues, fëminor, por dhe një lloj funksioni ushtrimor me sa duket për të zhvilluar kujtesën tek fëmijët. Në poezi kemi dhe antitezën *e re-plakë* që përftohet duke vënë ballë për ballë dy gjendje të kundërta, që të dalë me shprehës e më në pah mendimi i poetit. Është përafrim i dy antonimeve, që në rastin tonë realizon diferencën midis të vegjëlve dhe të vjetërve. Ajo që del nga kjo antitezë e bukur është takimi i shpejtë i dy gjërave të kundërta, por, diferenca midis antonimeve *e re-plakë* është e karakterit evolutiv, që e kapërcen karakterin lodrues të poezisë dhe mbart një fuqi mendimi që tek të vegjëlit nuk kapet nga logjika, por thjesht si një fakt empirik që lidhet me kohën dhe historinë e sendeve dhe të frymorëve. Epiteti në vetvete duket i thjeshtë, konkret dhe i drejtpërdrejtë, por kur pranëvihen dy epitete me kuptim të kundërt, duke krijuar figurën e antitezës, mendimi zbulohet nëpërmjet një abstragimi më të ndërlikuar edhe kur figura mbetet në rolin e epitetit të thjeshtë.

-Një ndërtim me figura të ngjashmërisë e gjejmë edhe tek poezitë e dashurisë. P.sh: 112. *Në buzët të putha, të ëmblë posi mjaltë,/si lumthi jot ëmë, si lumthi yt atë/..kur më del te dera, e bardhë si patë/më s'më hiqet mendja me dit e me natë.* Në rastin tonë më shumë i përdorur është krahasimi, i cili ndërtohet mbi ngjashmërinë e dy sendeve, dy frymorëve apo dy dukurive nga ana e jashtme, për të ndriçuar më mirë njërin prej tyre, për ta bërë më të gjallë e më të pasur mendimin. Eshtë një nga figurat më të thjeshta, sepse mjafton të vihen përballë fjalët që shënojnë dukuri, sende a frymorë, që kanë ngjashmëri dhe të lidhen me lidhëzat : si,

[907] Mitko,Th.*Vepra,* Tiranë 1981.

ashtu si, porsi,etj., për ta patur krahasimin. Sa më e thjeshtë dhe e përdorur të jetë figura poetike, aq më e vjetër rezulton të jetë ajo, sepse dëshmon një shkallë konkrete të njohjes, por dhe një përjetim poetik të thjeshtë të figurës.

-Personifikimi është një tjetër figurë e thjeshtë e marrëdhënies që e gjejmë sidomos në këngët që u përkasin cikleve me karakter ritual, siç janë p.sh: këngët për fenomenet e natyrës-diellin, hënën, retë, shiun, dëborën, festat e motmotit apo këngët që lidhen me psikologjinë fëminore si vargjet e të vegjëlve për zogjtë, fluturat, pilivesat dhe këngët e djepit që ndërtohen zakonisht me dialogë midis nënës dhe gjumit[908]. Ja një shembull personifikimi i thjeshtë: *Moj larëskë këmbëkëskë,/na këtë dhëmp t'eshtërtë/të më sjëllësh një t'ërgjëndë.*

-Figurat e theksit realizohen me onomatope dhe fjalë të thjeshta që e fitojnë ngjyrimin stilistik me anë të theksit të fjalës dhe rimës që krijohet si: *Re, re bobore,/lëshona diellin përdhe.* Në këtë rast, një përfytyrim metaforik si vargu: *lëshona diellin përdhe* është një lidhje gjeniale e poetit popull me bazë një përfytyrim fëminor të reve dhe diellit si elementet më të vjetra të natyrës dhe të lidhjes së tyre të ngushtë me njeriun.

Grupi i dytë i figurave si: 4. figura të kuptimit, 5. figura të gabimeve, 6. figura gjuhësore që lidhet me tropet dhe figura stilistike si : metafora, metonimia, alegoria, simboli, sinekdoka, ironia, perifraza, idioma që mbartin jo vetëm një ngjyrim stilistik, por dhe një shkallë më të lartë të përfytyrimit poetik që buron nga një logjikë e valencave të fjalëve dhe funksionojnë si figura që burojnë nga imazhe të mendimit në zhvillim.

-Në kategorinë e figurave të kuptimit kemi këtë grupim: •metafora, •antiteza, • grotesku, • hiperbola, • ironia, • kontrasti, • litota, • paradoksi, • sarkazmi, • satira, • simboli.

Nga studimi që i kemi bërë veprës së Thimi Mitkos, vëmë re se figurat e kuptimit shënojnë një evoluim të figurave stilistike dhe një përdorim më të madh në këngët dhe lirikat e poezitë epike. Baza e këtyre figurave është abstragimi poetik ku rol luan jo vetëm imagjinata dhe përfytyrimi por edhe një mënyrë e të menduarit logjik mbi dukuritë, sendet e fenomenet që pasqyrojnë një histori zhvillimi dhe evoluimi të figurave poetike, siç janë në përdorim më të shumtë metaforat, metonimia dhe idioma.

Le t'i referohemi figurës së simbolit, sepse atë e gjejmë në mënyrë të përsëritur sidomos në këngë dashurie p.sh: *Ditën që hyri prilli,/zuri e këndoi bilbili,/O bilbil, o zogu i parë,/fjala jote s'ka të sharë/Këndona bilbil këndona,/ndë na zëntë gjumi sqona*. Bilbili është simboli më i përdorur në veprën e Mitkos dhe ai merr trajtën e një kulti poetik në këngët popullore. Në rastin tonë, bilbili nënkupton djaloshin që ka rënë në dashuri dhe, të cilit, poeti i kushton këngët e fjalët më të bukura ashtu si një zogu që këngën ia pëlqejnë të gjithë. Ndërsa djali është bilbili, trëndafili apo karafili,

[908] Haxhihasani, Q. "*Disa të dhëna rreth figuracionit të lirikës popullore shqiptare*", Studime Filologjike 1972.

vajza quhet fëllënxë, lule, biskonjë. Simboli është marrë nga natyra dhe shpreh një ngarkesë emocionale romantike më tepër ëndërrimtare, por dhe një abstragim poetik që realizohet si një paralelizëm i nënkuptuar.

Në këngët epike historike, metafora, sinekdoka, metonimia dhe idioma, janë figurat më të përdorura. Në shembullin e mëposhtëm, kemi figurën e theksit, thirrorit, të inversionit, metaforës, metonimisë dhe idiomës: *O e bukura More! /Çëkur të le, më nënkë të pe.../Atje kam u zotin tatë,/atje kam unë zonjën mëmë/atje kam tim vëlla./O e bukura More,/çë kur të le, më nënk të pe.*

Janë vetëm shtatë vargje dhe mbartin një ngarkesë sa metaforike aq dhe idiomatike , që zbulojnë jo vetëm dramën dhe tragjedinë e largimit të arbëreshëve të Greqisë nga vendi i tyre, por dhe ngarkesën e madhe të mallit që mbartin arbëreshët larg vendit të të parëve. Në këtë poezi abstragimi është maksimal sepse figurat megjithëse janë konkrete dhe të thjeshta në pamje të parë shfaqin mallin si një ndjenjë që buron së brendshmi për mungesën e gjërave më të dashura. Ky abstragim i referohet toponimit arbëresh *More* dhe foljeve që kanë një formë një rrokëshe le-pe dhe përsëritjes së foljes që mbart një pronësi si *atje kam u zotin tatë/, atje kam u zonjën mëmë, atje kam tim vëlla.*

Këngët historike kanë të dhëna për ngjarje historike që lidhen me kohën, vendin dhe heronjtë që u referohen. Kështu ngjarjet shtrihen në Shkodër, Berat, Elbasan, Tepelenë, Janinë etj. dhe është më e thjeshtë për të zbuluar kohën e krijimit të tyre.Për shembull, këngët për Zenel Gjolekën apo Ali Pashë Tepelenën e dimë që datojnë në vitet 1820-1840, pra janë të vonshme. Figurat që përdoren më shumë në këto këngë janë metaforat, epitetet dhe hiperbolat. P.sh: *Që në Berat e në Vlorë/ u mbush deti me pamporë/S'e dinë me kë luftojnë/Me Gjon Lekë Kuçin lëftojnë./Me Gjon Lekë Kuçin thonjë./Me Gjolek e Hodo Aliu./mbë dorë palla çu ngriu.*

Në këngët e nizamit, të kurbetit dhe epikës historike, rol më të shpeshtë luajnë figurat e kuptimit dhe figurat gjuhësore që lidhen me imazhe poetike dhe një abstragim të potetit rreth ngjarjeve, përshtypjeve dhe emocioneve që ngjallin tek ai këto ngjarje. Ky abstragim realizohet me një evoluim të figurës që, megjithëse ka bazë realiste, shfaqet i zmadhuar. Rast i tillë është hiperbola.

Figurat stilistike, sipas një grupi tjetër studiuesish, ndahen në :

2. Figurat e shqiptimit poetik (figurat tingullore dhe të intonacionit): • aliteracioni, • anafora • apostrofa, • asonanca (zanorësia) • epanalepsa • epanastrofeja • epifora • konsonanca (bashkëtingellorësia) • onomatopeja, • paronomaza, • pasthirrma • pauza (ndërprerja) • përsëritja • pretericioni (tejkalimi) • pyetja retorike • retiçenca (heshtja) • simploka.

3. Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve (tropet) :

• alegoria, • antonomaza. • asteimi, • epiteti, • eufemizmi, • ironia, • katakreza, • metafora, • metonimia, • oksimoroni, • paradoksi, • perifraza, • sarkazmi, • sinekdoka.

4. Figurat e fjalorit poetik (të leksikut) : • antonimet, • arkaizmat, • barbarizmat (huazimet) • dialektizmat (krahinorizmat) • homonimet, • sinonimet, • neologjizmat,

5. Figurat e sintaksës poetike : • antimetabola • anadiploza (kapërcimi) • asindeti, • elipsa, • enumeracioni, • shkallëzimi • inversioni, • kiazma, • konversioni, • pleonazmi, • polisindeti, • tmesi.

6. Figurat e mendimit: • antiteza, • hiperbola, • krahasimi, similituda • litota, • oksimoroni, • paradoksi.

7. Figurat gramatikore (ose liritë poetike): •apokopa• asindeta •polisindeta •elipsa •epiteza •elizioni •enalazhi •inversioni •pleonazma •proteza •sinalepsa •zeugma .

EMINE SHABANI (TETOVË, MAQEDONI)

THIMI MITKO - ATDHETAR, STUDIUES DHE MBLEDHËS I FOLKLORIT

Shqiptarët kanë pasur një traditë të hershme, të kultivimit dhe ruajtjes së pasurisë shpirtërore dhe kulturore, ndërsa kulmi u arrit në shek. XIX dhe vazhdon edhe sot. Në shek. XVIII, Goethe dhe Herder, dy filozofë dhe dijetarë gjermanë themeluan rrymën e romantizmit, e cila në thelb kishte spikatjen e pasurisë shpirtërore dhe materiale të popujve evropianë. Mbledhja e folklorit u bë detyrë dhe krenari e shumë shkrimtarëve, mendimtarëve dhe filozofëve evropianë, përfshirë këtu edhe shkrimtarët shqiptarë. Shumë krijime artistike u ndërtuan mbi këtë themel të letërsisë popullore, si veprat e Naimit, De Radës, Shirokës, Mjedës, Çajupit, Gavril Darës, Skiroit, Serembes, etj., që, përveçse ishte parim i një programi mbarëkombëtar, ai e ngrinte lart shpirtin artistik të popullit.

Gjatë shekujve të sundimit osman, shqiptarët nuk kishin shkollat e tyre në gjuhën amtare, gjë që ndikoi në rruajtjen dhe bartjen e kulturës popullore brez pas brezi, që ishte institucioni i vetëm i tyre. Kultura popullore është e larmishme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo merret me edukimin e fëmijëve e të rinjve, por edhe moshave më të pjekura. Vëmendja që u kushtohet fëmijëve dëshmohet në krijimtarinë dhe mençurinë popullore, duke filluar me këngët e djepit/ninullat, përrallat, legjendat, gojëdhënat, ritet, lirika dhe epika, të pasura me elemente të jetës reale dhe fantastike, që përfaqësojnë shpirtin e kohëve në të cilat janë krijuar. Në shumë raste historia dhe historiografia kanë dështuar në ruajtjen fakteve dhe argumenteve të rëndësishme, por këto janë ruajtur me kujdes nga vetë populli si dëshmitar i ngjarjeve, bëmave, luftërave apo gëzimeve, e fitoreve etj.

Duke u nisur nga faktet e këtyre gojëdhënave ne mund të konstatojmë se vepra e Jeronim de Radës *Këngët e Serafina Topisë* dhe *Këngët e Milosaos*, *Rapsodi e një poeme shqiptare*, ashtu si edhe *Kënka e sprasme e Balës*, e të tjera, u ndërtuan mbi fakte historike e motive të vërteta popullore të ruajtura me kujdes, në kujtesën e popullit. Ndërgjegjja e përgjithshme është më e saktë se ajo individuale, ashtu sikurse edhe kjo ndërgjegje mund edhe t'i ndryshojë e hiperbolizojë disa fakte, por ajo mbetet përsëri më e besueshme.

I ndikuar nga iluminizmi evropian në moshën 23 vjeçare dhe, i kapluar nga dashuria e madhe për shkollim dhe arsimim të popullit të tij, ai do të shkruajë vargjet e para në pllakën e shkollës së rindërtuar të Korçës: "*I ndriçim Djell i diturisë lindi, zë vjen mbi të gjithë, ngrehu e shiko o nën'e dashur, shekullin e dritës o plaka jime. Degë, fëmi, kini dëshirë në dituri, atyre tu ngjisni, na mësonjëtore u ngrehmë dhuratat e musavet të fitoni*"[909].

[909] Qosja, R. *Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi II*, Prishtinë, 1990, 235

Krahas dëshirës së madhe për dituri, ai do të mësojë se jo vetëm shkolla e librave ka rëndësi, por një dituri tjetër e marrë nga shkolla e jetës është po aq e rëndësishme sa kjo e para. Gjithë jetën do t'ia kushtojë çështjes kombëtare, kontributit për përhapjen e librave në gjuhën amtare. Afirmon lashtësinë e monumenteve kulturore në esenë *Mbi Topografinë e Korçës*, krahas tregtisë me të cilën do të merrej për të siguruar ekzistencën. Gjatë punës që do të bënte si tregtar, ai do të njihet me bashkatdhetarë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe kjo do t'i ndihmojë në punën për mbledhjen e folklorit, të cilat më vonë do t'i botojë nën titullin *Bleta Shqiptare*, e cila është një vepër folklorike monumentale, si për përmbajtjen ashtu edhe për vlerën e paçmuar që kishte dhe ka krijimtaria popullore. Vepra ka një larmi të madhe krijimesh sepse ishte folklor i mbledhur dhe i shënuar me kujdes nga kurbetçinjtë e të gjitha trevave shqiptare, në kolonitë e Egjiptit, Sirisë, Bukureshtit, Stambollit etj.

Nga epika historike e mbledhur kryesisht në koloninë e Kairos, gjejmë informacione për luftrat e pashallëqeve të mëdha shqiptare kundër turqve, malazezëve, luftën greko-turke, si dhe luftërat mes shqiptarëve vasalë të Turqisë dhe shqiptarëve në mbrojtje të të drejtave të tyre.

Në këto vargje që rrëfejnë trimërinë, heroizmin dhe virtytet e patriotëve, si Marko Boçari me suljotët, të Rapo Hekalit kundër Isuf Vrionit, historinë e pesëqind feudalëve jo luajalë ndaj perandorisë që u ekzekutuan dhe masakruan në Manastir, që rrëfehen nga poeti popullor me detaje interesante, të fokusuara në ato elemente ku spikat dinakëria e otomanëve, e asgjësimit të të gjithë atyre që nuk iu bindën urdhrave të tyre dhe në anën tjetër të kritikuar nga poeti popullor, për mungesën e vigjilencës së bejlerëve shqiptarë ndaj pabesisë së provuar turke. Në këngët epike njihemi edhe me historinë më të vjetër të heronjve dhe udhëheqësve ushtarakë shqiptarë; Balsha, i cili u vra në betejën e Beratit, njëri ndër besnikët e mëdhenj të Skënderbeut. Në këto këngë flitet për Ptolome Lagu-n nga Berati, i cili kishte qenë ndër komandantët trima të Lekës së Madh dhe që në vitin 323, pas vdekjes së tij, ai dhe dinastia e tij, sundoi Egjiptin për 290 vjet me radhë bashkë me 13 nipërit e tij. Ajo që është më mbresëlënëse në këtë histori, është fakti se Ptolomeu vuri themelet e shkollës-muze, në të cilën studioheshin të gjitha shkencat. Biblioteka e themeluar në vitin 285 p.e. s., kishte 700 mijë libra dhe këto institucione ishin nën mbikëqyrjen e Ptolomejve, ku me urdhrin e tij, çdo njeri që kalonte në Aleksandri duhej të linte së paku një kopje libri.[910]

Në veprën-monument, kuptojmë të vërtetat historike që i gjejmë tek librat e historisë shqiptare të shekujve 17, 18, e 19 dhe argumentet e vërtetësinë e tyre. Ky fakt përputhet me thënien se letërsia gojore është institucion popullor, arkiva e kujtesës gjithë popullore, që ruan elemente të qenësishme kombëtare, historike dhe artistike me vlera monumentale.

[910] Vinca, A. *Kurs i Teorive Letrare*, Prishtinë, 2002,62

Jo vetëm epika historike, por edhe ajo legjendare, madje edhe përrallat e legjendat, fshehin brenda tyre të vërteta të mbështjella me misticizëm e fantazi, që e bëjnë më të qëndrueshme e më enigmatike bërthamën e mitit që ruajnë brenda tyre. Përrallat si Ura e Skiles (murosja e gruas në themel të saj), motra e nëntë vëllezërve (Doruntina), etj., ngërthejnë në vetvete kode sa të çuditshme aq edhe të vërteta mbi mendësinë, besimin pagan dhe vlerat e paprekshme të këtyre besimeve që çojnë në sakrifica. Për mendimin tonë, thesari popullor nuk duhej të ishte në ''modë'' vetëm në shek. XVIII e më pak në shek. XIX, sepse kjo vlerë është aktuale gjithmonë, madje në periudhën post moderne, në format e shkrimit të realizmit magjik, intertekstualitetit apo edhe palimpsestit, që ngërthejnë në vete realen dhe fantastiken, tekstualen dhe jashtëtekstoren, si tendenca të artit postmodern dhe të rrëfyerit të tërthortë, si rruga më e qëlluar e krijimeve artistike, që e bëjnë më tërheqës e më të rëndësishëm rrëfimin.

Fjalët e urta të mbledhura pothuajse nga të gjitha krahinat, mund të ndahen edhe sipas kriterit tematik, që është utilitar dhe pragmatik. Secila prej tyre është e ndërlikuar dhe një ndërlikim i këtillë e ngre tekstin në një segment të hiperbolizuar dhe si rrjedhojë asnjë fjalë e saj nuk përfaqëson shenjë tematike.

Meqë proverba, flet për segmente të dukurive të jetës njerëzore dhe ato i zgjedh sipas kriterit të përsëritjes, atëherë poetikën e tyre do ta plotësojmë sipas kapitujve kompozicionalë të tyre. Në fillim janë proverbat sipas formës, me të cilën, nënkuptojmë ato proverba të cilat janë të plota nga aspekti sintaksor dhe automatikisht edhe semantik: ajo çdo herë e abstragon përvojën jetësore në përfundim ose komentimqë e shpreh tërthorazi. Si rrjedhojë edhe nga ana sintaksore është e plotë: ndahet në një pjesë ose dy. Kur është me dy pjesë kemi të bëjmë me kompozicion binar, i cili edhe pse në miniaturë, ekziston, si p.sh.: nëse-atëherë, më mirë-se sa, kush-ai/ajo, etj.

Tek proverbat shpesh hasim **metaforën**: luaji këmbët siç bie daullja. Ajo ka në përbërje edhe **metonimi**: Një iskrë zjarri dogji Stambollë; hekuri rrihet sa është i nxehtë; etj.

aliteracioni: ferra e nisi, ferra e grisi; helli prej mishi, mishi prej hekuri; gjuha eshtra s'ka e eshtra thyen; **asonanca:** djali pa lerë, kësula blerë; më i keq gërgasi se dorasi**; etj.**

proverba alegori: laraska zu të ecnjë si thëllëza pa harroi dhe të ecurit e saj; këndezi ndë plehë të vet këndon; vunë ulkun të rruanjë dhentë; vetëm një gomar buzëbardhë; vatë me shoshë për ujë; gjarpëri këmbët s'i rrëfen; bjeri pragutë të dëgjojë dera**; etj.**

proverba ironi: kërkon kallëz nëpër dëborë; dhi e zgjebur, bishtin përpjetë; është mbuluar mulliri me dëborë; s'ka seç ti bëjë gomarit i bie samarit; etj.

proverba hiperbolë: atij i pjell edhe këndezi; fluturoi gomari; fjal' e keqe rrëzon male; qumësht dallëndyshe;

proverba antitezë: lumi fle armiku s'fle; lumi që fle ai të mbyt; kush flet shumë, bën pak; kush ndot këmbët, lyen dhëmbët; mikut iu rrënko, hasmit iu lëvdo;etj.

proverba krahasim: si cjapi te kasapi; si kofini pas të vjelit; si i jati i biri; si maceja me minë; etj. **proverba namatisje**: mbeç si gurë në lumë; **proverba urime**: zili paç nakar mos paç; shëndosh veshët pa vëth sa të duash; **proverba litota**: shteruan lumëruat, daullen rrëkerat; mos i ver pleshtit fre; **Proverba pyetëse**:çalon gomari nga veshi?, kush ka faj? I varfëri, Ku është manastiri? Pa kallogjerë sa të duash, kush ta bën të ligën? Ta bën vedi. **Fjalët e urta në vargje**: Mahmut beu paske fat brenda u ndodh një dukat (f.331), ç'thua o çoban i gjorë, plumbin tënd e zë me dorë ! (f. 330),

Hasim edhe **proverbat anekdota**: frikamanë mos e ndiq fort se e bën trim me të pahirë; është e lirë krypa në Durrës po e ha qiraja udhës; ftojnë gomarë ndë dasëm që të mbajë dru e ujë; bëjm' o babë të të ngjas; kur kisha dhentë s'kisha mentë; kur më erdhën mentë, i hëngrën qentë; kërrabë heq nga vetja e saj etj. **Proverba të lidhura fort në kontekstin e tyre**: delen që ndahet nga tufa e ha ujku; turku si ulku; vëllazëria si shokëria; i urtë posi dielli; jona more jona; shpata e trimit e sofra e zemërbardhit nuk pritenë kurrë; turpja më e mprehtë se shpata; turpja është kordhë etj. **Proverba llogaritëse**: mijë mijë shkojnë e dy i numërojnë ((mulliri); një baba ka dymbëdhjetë djelma, secili djalë ka dymbëdhjetë bija me njërën faqe të bardhë e tjetrën të zezë (viti, dita e nata); mijë mijë nyje, mijë mijë vrima (mrezha); shkuan tre vetë mbë një urë. I pari shkoi duke parë edhe duke shkelur, i dyti duke parë vetëm e pashkelur, i treti as pa , as shkeli, edhe u gjentnë të tre mbatanë (gruaja me barrë duke sjellë fëmijën në krah); një lis i madh me dymbëdhjetë dega, nga çdo degë ka tridhjetë fole me zogj, të gjitha kanë treqind e gjashtëdhjetë zogj (viti me 360 ditë).

Proverba gjëegjëza: dora e nxe arka s' e nxe (flamuri); dy shigjeta pendëza tek do i lëshon atje venë (sytë); dy vëllezër mbajnë zjarr në dorë e s' digjen (masha); e vogël sa një lajthi e ka mënd sa një kadi (sahati); gjith gjënë e ha e të ngopure s' ka (mulliri); ferk e ferk e mas deret (fshesa); helli mish qebapi hekur (unaza); rrumbullak strumbullak me ca flutura në bark (kungulli) etj.

Tipologjizimi i tyre më i përshtatshëm është sipas sferave **semantike:**

Fjalë të urta historike, sfera historiko-semantike: Një iskrë zjarri dogji Stambollë. (1881, f.447); Më la si vllahu gunën. (1881, f 444); Pa barut s'merret qytetëza. (1881, f. 447); Para me kamatë, petulla për natë (1881, f 447); Që në kohë të hirit (Nuhit) (1881, f 449); Shpjer pishë në shtëpi, pastaj qiri në xhami (kishë). (1881, f 451).

Sfera etnologjike-semantike:

U ngrit dbora nga (ose Zbora) nga dhjavati, po Muçua mbeti pa këmbë ! (1881, f 453); Si eshka me uruarin. (1881, f 450); Pa faqe e kothëri, mos ha tul, mos le të shkonjë keza për kësulë. (1881, f 447); Luaji këmbët siç bie daullja, (1881, f 443).

Sfera semantike- filozofike (vdekje, fat, gjykim qiell ferr/eshatologji, etiologji etj.)

Kush s'ka krye, mundon këmbë. (1881, f 442); kush pi veresie, dehet dy herë (1881, f 447); kush s'ndau me vëllanë, ndau me djallë. (1981, f.442); i fëlliquri shokë do (1981, f.447).

Sfera semantike-politologjike

Dy mace, mposhtin një leon. (1981, f.436); E drejta mbretëron, e shtrëmbëra ka këmbë të shkurtëra; Ndizi edhe djallit një qiri që të mos të prishnjë punë. (1981, f. 446).

Sfera semantike-sociologjike

Peshku i madh ha të voglin. (1981, f. 448); Pyet shtatë a tetë, bëj si di vetë. (1981, f. 449); Vëllazëria, si shoqëria. (1981, f. 453); Vjen një ditë që i thonë derrit levent. (1981, f. 453);Shokun mos e duaj, po hisen ja ruaj. (1981, f. 451) .

Sfera semantike-psikologjike

Ta këndon kartën në xhep. (1981, f. 451); Tek është peri i hollë, atje këputet. (1981, f. 452) ;Zili paç, nakar mos paç. (1981, f. 453); Pi verën, e mos pi mentë. (1981, f. 448).

Sfera semantike-teologjike

Një herë u fut prifti ndë thest (1981, f. 447); Perëndia ndërton shkallë. (1981, f. 448); Perëndia të ruajtë nga njeriu i papunshmë. (1981, f. 447); Pashkë s'ka përditë. (1981, f. 447); Perëndija të ruajtë nga spanoi, kur lishon dy qime mjekërë. (1981, f. 447).

Sfera semantike-antropologjike

Te evgjiti kërkon kosë. (1981, f. 451); Turku si ulku. (1981:452); S'hahet pata me fatën (1981, f. 450);

Sfera semantike-morale

Njeriun e lik mos e gjeç mbë udhë. (1981, f. 447); Puna e rrëfen njerinë (1981, f. 449); Mos të hajë qeni shkopin. (1981, f. 445); Më mirë t'i dalë syri, se nami i keq. (1981, f. 444).

Sfera semantike-profesionale

Gjumi i tepërt, me rroba të vjetra (1981, f. 438); Gjer sa të mentohet i urti, i marri vete mbaron punë. (1981, f. 438); Qan puna për të zotin dhe i zoti qan, për punën. (1981, f. 449).

Fjalët e urta, ose proverbat, janë pjesë utilitare dhe pragmatike e jetës së njeriut. Ato janë përdorur dhe do të përdoren edhe në të ardhmen si pjesë e pandarë e kulturës popullore. Puna që do të bëjnë rilindësit ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Gjurmët e interesimit për pasurinë shpirtërore të shqiptarëve i gjejmë që në Mesjetë tek fjalori dygjuhësor i Frang Bardhit, 113 proverbat në fund të fjalorit janë të një rëndësie të veçantë, për mendësinë popullore, për gjuhën e shkruar dhe për përmbajtjen e tyre filozofike, shoqërore, psikologjike, morale e edukative.

Edhe *Bleta e Vogël* dhe proza e poezia origjinale e Mitkos përbën një thesar të paçmuar e monumental, të kulturës shqiptare, për vlerën artistike, estetike dhe sidomos etike, edukative e utilitare të të gjitha moshave. Letërkëmbimi përbën një vlerë të veçantë dhe pasqyron shpirtin e brengosur të shkrimtarit për fatin e Shqipërisë dhe shqiptarëve të cilin e ndjekim përmes letrave që ai i shkruan De Radës dhe intelektualëve tjerë të kohës.

Është i njohur fakti, se rëndësia e folklorit për një popull është pasqyrë e shpirtit artistik të atij që e prodhon, e krijon dhe e ruan me fanatizëm. Letërsia popullore është forma artistike më e vjetër dhe më jetëgjatë e mediumeve gojore. Periudha të ashtuquajtura agrafike, ka pasur çdo popull në të kaluarën e vet dhe, pikërisht letërsia popullore kishte ndikim të madh në jetën e grupimeve etnike, fiseve, komuniteteve dhe popujve. Me paraqitjen e letërsisë së shkruar ajo nuk e humbi vlerën dhe ndikimin e saj. Teknikat e ndryshme të formësimit të dy letërsive asaj gojore dhe autoriale ishin arsyet e mos përplasjes mes tyre. Ky ishte ndërtimi ndryshe i formës kompozicionale të dy letërsive. Struktura gjuhësore e çdo populli është një sistem i pashtershëm vlerash gjuhësore dhe artistike, e cila ka ndikuar në krijimtarinë artistike të tij, por edhe të autorëve që e krijuan atë. Kur është fjala për krijime autoriale, flasim për poetika të veçanta të periudhave të veçanta (romantizmi, modernizmi, post modernizmi etj.) dhe brenda këtyre periudhave, për poetika dhe stil individual autorial. E marrë në përgjithësi këta autorë, krijojnë në gjuhën e popullit të tyre dhe, letërsia autoriale dhe ajo popullore, qëndrojnë në të njëjtën lartësi, vetëm se ndryshojnë nga ana stilistike. Letërsia gojore dhe ajo e shkruar kanë qenë dhe janë më marrëdhënie reciproke me njëra-tjetrën. Në periudhën romantike themelet e krijimit të letërsisë autoriale duhej të ishin mbi atë popullore, për faktin se ajo veçse i kishte të njohura dhe të pranuara vlerat estetike dhe cilësore të saj. Gjuha e krijimeve popullore duhej të ishte origjinale, sepse me anë të saj do të bëheshin hulumtime gjuhësore-stilistike, e leksikore.

Përrallat e mbledhura e të botuara te Bleta, janë të gërshetuara me elemente fantastike dhe më
pak me ato reale. Karakteristike tek ato është narracioni linjës një drejtimshe, pa episode, digresione, ngadalësime (retardime), etj. Heronjtë e përrallave kanë një qëllim: të arrijnë ta përvetësojnë objektin apo subjektin e kërkuar, të cilin e kanë pasur apo u ka humbur dhe rendin pas rigjetjes ose rendin të shpëtojnë të Bukurën e Dheut nga kuçedra, bajlozi, shtriga, llamja, etj.

Urtësia popullore e autorëve anonimë, ka abstraguar çdo element gjeografik, duke mos treguar emra konkretë vendesh, njerëzish, kohë, vit apo shekull të caktuar. Nga ky aspekt del edhe karakteri ahistorik, duke mos përmendur emra njerëzish, apo mbretërish, d.m.th. ky abstragim ka lejuar mundësinë e ndërfutjes së mitologjisë, fantastikes, irracionales, metafizikes etj. Duke pasur parasysh faktin se në antikë vetëm poezia epike shkruhej në formën e këtillë, heronjtë apo personazhet ndihmës e kundërshtues të heroit kryesor, kalojnë nëpër pengesa a rreziqe, duke synuar arritjen e qëllimit të vetëm që në fillim të aventurës së tyre.

Në Antikitet thuhej se poezia është më e vërtetë se historia. Kjo mund të shpjegohet me atë se,poezia, e tregon të vërtetën përmes figurave të abstraguara mitologjike, ngjarjeve irracionale, metafizike. Pra, prapa elementeve mitologjike dhe irracionale nuhasim rruajtjen e motiveve të fshehta, nxjerrjen e prejardhjes dhe gjetjen e origjinës së tyre.

Deri në fillim të shekullit XX, përrallat, madje edhe veprat artistike, interpretoheshin në mënyrë sipërfaqësore duke u ndalur në formën dhe përmbajtjen e tyre. Një kundërshtim të një interpretimi të tillë, e bënë formalistët rusë të shkollës së Petersburgut dhe grupi tjetër i studentëve të Pragës në krye me Roman Jakobson-in, duke arsyetuar mënyrën e re të interpretimit dhe të zbërthimit të formave letrare dhe hulumtimit gjuhësor që përmbajnë ato. "Origjinaliteti përbëhet vetëm nga një ripunim i mjeteve të dobishme, e jo nga vizioni dhe përvoja e shkrimtarit […] sipas tyre forma është e barabartë me materialin dhe përmbajtja me mjetin. Forma është enë ku zbrazet përmbajtja, e njëjta enë mund të mbajë përmbajtje të ndryshme. Dhe nëse forma ndryshon, kjo vjen si kërkesë e përmbajtjes."[911]

Këto ndjesi të reja shkencore-hulumtuese, ndikuan në kërkime dhe studime, më të sakta e të thella të krijimeve artistike, si atyre popullore ashtu edhe autoriale. Duke u nisur nga analiza që Vladimir Propp bën përrallës ruse, funksionet që ai përkufizon në rrjedhën e ngjarjeve-subjektin, veprimet e personazheve dhe funksionet që gjenden në mekanizmin e veprimit të tyre janë prezentë edhe në përrallën shqiptare. Duke analizuar me vëmendje përrallat e mbledhura nga Thimi Mitko siç janë Qerosi, Tre vëllezërit, Peshkatari dhe e bukura e dheut, Shtatë djemtë e plakës, Motra me nëntë vëllezër, Tre këshillat e plakut, Djalli dhe i biri etj., kemi arritur të përfundojmë se në të gjitha përrallat ekzistojnë funksionet e ngjashme/identike.

Te përralla Qerosi, kemi tipologjinë kallëzuesore, që mund të përputhet me funksionet narrative të V.Propp-it, dhe që mund të jenë akte që i vlerësojnë kushtet dhe rolin që luan motifema në rrafshin e veprimit [912]. Gjatë debateve teorike mbi këto funksione që janë të kthyeshme dhe të përshtatshme sipas rolit të heronjve të të gjitha përrallave, (Barthes, Greimas, Tomaschevski, Veselovski, Bremond. Levi Shtraus,) Strausi u mor me zbulimin e elementeve mitike në një vepër sesa në përbërjen e tregimeve të veçanta. Ai u përpoq t'i shpërndajë njësitë e mitit, në mitema. Vazhdimi krijon konflikt/opozicioni e shtyn narrativen (rrëfimin) përpara (opozicioni mund të duket p.sh., si drita dhe errësira, dinamikja dhe statikja ose konceptualja si dashuria ose urrejtja, kontrolli ose frika, të cilat me një fjalë mund t'i quajmë binare opozitare (antonime).

Secili prej këtyre funksioneve të quajtura narrema, e lëvizin subjektin përpara, sigurisht në drejtime të ndryshme. Jo të gjitha këto funksione/narrema janë prezentë në çdo përrallë. Subjekti lëviz nga ngjarjet dhe zgjedhjet e protagonistit, por këta funksione janë rregulla/urdhëra mes karaktereve të mëdha.

Nga 31 funksionet narrative që Propp-i i hulumton në përrallën ruse, të cila gjenden edhe në

[911] A.Jefferson-D.Robbey, *Teoria Letrare Moderne,* 2000, f. 58
[912] G.Prince, *Dictionary of Narratology*, 2001, f.144

përrallat e popujve tjerë, dhe që lënë mundësi për ndryshime dhe stërhollime të mëtejshme, ai përcaktoi edhe shtatë tipa kryesorë të karaktereve: heroi, demoni/armiku (shtriga, kuçedra, vëllezërit etj) që luftojnë kundër tij haptazi ose fshehurazi, ndihmësi (që e përgatit heroin ose i jep një objekt magjik për të fituar. Në rastin e përrallës Qerosi, mbreti e ndihmon me këshilla si ta gjejë shqiponjën që do ta kthente nga nëntoka mbi tokë, (në mitologjinë antike të ngritjes së Orfeut nga Hadesi ku kishte shkuar të kërkojë Euridikën, atë e ngre shqiponja, por me kushtin që ai ta ushqejë me mish dhe ujë).

Ndihmësi/shqiponja që e merr mbi kurriz dhe e ngre lart mbi dhe, por duke i kërkuar ta ushqejë me mish të pjekur, ujë e bukë dhe, kur mbarojnë këta, ai pret mish nga trupi i vet dhe i jep asaj, princesha (shpesh e kërkuar për ta vazhduar narracionin) heroi fals, i cili në fillim paraqitet si karakter i mirë, por më në fund del se është armik)/vëllezërit, përfaqësuesi/mbreti i nëntokës(ndërmjetës, përmbarues, që e përcjell heroin deri në fundin e gëzuar) etj., janë personazhet që mund të kenë edhe rol të kthyeshëm nga ai që i njohim zakonisht.

Rrjedha e ngjarjeve që përfundojnë me ngritjen e heroit mbi dhe, është e përshtatshme në mënyrë analogjike me funksionet narrative të Vladimir Propp-i që i bëri strukturës narrative të përrallës ruse.

Paraqitja e funksioneve narrative të Proppi-it, të cilat janë gjithsej 31 të pandashme dhe të pa krahasueshme me njëra tjetrën, njëmbëdhjetë pikat të cilat do t'i paraqesim më poshtë përputhen me hapat e heronjve të përrallave shqiptare siç thuhet edhe nga teoricienët Todorov, Greimas dhe Barthes se ”tipologjia kallëzuesore e Propp-it mund të stërhollohet edhe më tej” dhe se “mjafton t’i krahasojmë dy nga dy fjalitë (funksionet) për të vënë re se kallëzuesit shpesh kanë tipare të përbashkëta e të kundërta që d.m.th., mund të nxirren kategori të nënkuptuara që përcaktojnë kombinimin, nga i cili janë përftuar funksionet e Propp-it”[913].

Funksioni i parë i tipologjisë së Propp-it të përralla jonë tejkalohet ose transformohet/kombinohet, sepse ata janë në shtëpi, por llamja/antiheroi, cenon integritetin e mbretërisë, duke vjedhur ftoin, në mbrojtjen e të cilit ishte vënë djali i madh i mbretit, i cili duke qenë frikacak dështon me ç’ rast ajo i vjedh një kokërr ftoi dhe largohet me vrap. Pas dështimit të djalit të madh vihet për ta luftuar llamjen/bishën i dyti, i cili po ashtu dështon. Në fund djali i vogël i turpëruar nga dështimi dhe dobësia e vëllezërve merr iniciativën mbrojtëse ndaj bishës dhe ia del mbanë duke e plagosur atë dhe drama këtu fillon. Mosvrasja e plotë e bishës e shtyn subjektin përpara dhe, elementi shkak-pasojë, nxjerr në pah edhe ngjarje tjera më interesante, duke inkuadruar edhe parimin e tragjedisë së Aristotelit nga mosnjohja te njohja/vëllezërit, peripetia dhe katastrofa/shthurja.

[913] T. Todorov, *Poetika e Prozës*, 2000, f. 111

1. Heroit i imponohet një ndalim. Kur bisha duke ikur e plagosur, hyn në strofullin e saj, asnjëri nga dy djemtë e mëdhenj nuk pati guximin ta ndiqte, përveç të voglit.

2. Shkelet ndalimi. Heroi pa hamendje u vu në ndjekje të saj dhe zbriti shkallët. Pasi i zbriti ato, pa një pllakë të hekurt të cilën e hapi, zbriti tri shkallë dhe shkeli fort(u fut në këtë korridor të nëndheshëm), ku pa një shtëpi, trokiti dhe, që andej doli një vajzë e bukur. Pasi i tregoi asaj qëllimin pse kishte ardhur, ajo me skepticizëm i tha "Sa për të vrarë bishën aq të fuqishme, duhet të mendojnë më parë a është i fuqishëm dhe se ka për të shtirë kryet e tij në torbë...në vraftë dot egërsirën ai, do të quhet një shpëtues i këtij vendi dhe ajo ka për ta marrë për burrë" kjo i fal një furkë që vetvetiu tjerr ar dhe trimi e përpjek për toke e ajo formoi një mollë të artë. Ai troket edhe në shtëpinë e vajzës së dytë dhe ajo i jep një "stagua" ku ishte gdhendur një langua duke ndjekur lepuj, të cilën e përpjek për toke dhe ajo krijon një mollë të artë. Vajza e tretë pas një bisede më të ëmbël se dy të tjerat i jep heroit një kovaçkë/kovë me dymbëdhjetë zogj duke ia treguar strofkën e bishës largohet për në shtëpi.[914] Bisha kërkonte vajza të reja çdo ditë nga ajo mbretëri, por tre vajzat afër burimit të ujit dhe "rezidencës" së bishës duket se jetojnë të sigurta/janë të paprekshme nga ajo. Në përrallën e vëllezërve Grimm "Ruajtësja e pritave të burimit" duket se gjendet shpjegimi për pozitën e tre të mirave. Ndërsa hapësira e paraqitur, nëntoka është shenjim që asocion në mbretërinë e nëntokës me korridore/katakombe, të bajlozit, kuçedrës, bishës etj.

Të kthehemi tek fantazia njerëzore që krijoi perënditë dhe perëndeshat për të plotësuar dëshirat që në realitet nuk ju plotësuan. Miti i tre Horeve/Orët që më herët/në kohën Homerike, ishin perëndesha të shiut, më vonë evoluojnë në perëndesha të bimësisë, begatisë tokësore, frutave, drithërave etj. Gjithashtu ato ka mundësi të ishin transformuar/tek grekët, edhe me emrat Persefona, Artemisa dhe Hekata. Mbasi Persefona, emri tjetër i saj ishte Hore, përfaqëson perëndeshën e nëndheshme përgjegjëse e frutave, drithërave, e veçanërisht shegës, shkopit/furkës, farërave dhe drerit, Homeri tek Iliada e paraqet si grua të bukur, magjepsëse, e mbretërisë së Hadesit. Artemisa, perëndesha e gjuetisë, mbrojtëse e shigjetës harkut, drerit, qenve të gjahut dhe hënës. Hekata ishte perëndeshë, e hyrjeve dhe dyerve të fshehta, qenve, dritës, muajve të vitit, magjisë, kthimit, njohëse e bimëve, barërave helmuese dhe shëruese, mrekullive etj. Pasi i shpjeguam këto, ndërlidhja e tre të bukurave të nëntokës dhe shenjat e besnikërisë të dhëna nga ato, janë plotësisht të përshtatshme. E madhja furkën që tjerr vetë perin e artë. E dyta drerin dhe e treta një shportë me dymbëdhjetë zogj/ dymbëdhjetë muajt e vitit/koha kalendarike dhe pjelloria e tyre.

3. Agresori/heroi përpiqet të mbledhë të dhëna me anë të vashave dhe bijës së mbretit, të cilën sapo e takoi. Drejt tij vinin një grumbull njerëzish duke qarë sepse ia

[914] Mitko, Th. *Vepra*, Tiranë, 1981, 300

çonin të bijën e mbretit bishës si formë takse për t'ua lëshuar ujin. Këtu marrim vesh se bisha kërkonte çdo ditë nga një vajzë për ta ngrënë dhe atë ditë i kishte rënë shkurta (radha) bijës së mbretit !

Vendi ku ndodhej Qerosi ishte ai që kërkonte dhe pas një bisede me bijën e mbretit atë e zuri gjumi. Ndërkohë u paraqit bisha e përgjakur dhe trishtimi i vajzës e zgjoi trimin; ky e qetësoi atë, iu sul bishës dhe e goditi për vdekje.

Krijimet e tilla janë suksesi i njohjes së njeriut me fenomene natyrore të cilat ai i mishëron në figura mitologjike, si tre motrat, tri vëllezërit bisha /e keqja, natyrore ose faktori njeri/armik, që ka nën pushtetin e tij ujin, burimin e jetës njerëzore dhe si zotërues i tij ai ka kërkesa të çoroditura...

4. Agresori/heroi (në rastin tonë) merr të dhëna për viktimën e vet dhe e vret atë. Për këtë triumf feston e tërë mbretëria e nëndheshme/ose e robëruar. Mbreti vetë e kërkon heroin ta shpërblejë. Por ai nuk ka asnjë dëshirë, është modest. Tek ai shquhen veti thellësisht antropologjike, si mbajtja e fjalës ndaj të atit e të bukurës së dheut. Ndërsa shpëtimin e zogjve të shqiponjës nga gjarpri e konsiderojmë si mundje të errësirës nga drita.

5. Agresori/(vëllezërit) orvatet ta mashtrojë viktimën për të futur në dorë atë ose pasurinë e tij. Ata marrin vajzat nga nëntoka/tre të mirat dhe ngjiten lartë me ndihmën e vëllait të vogël. Intuita profetike e të bukurës së dheut realizohet/vëllezërit e tradhtojnë, e lënë nën tokë. Por ai ka akoma shpresa për t'u ngjitur lart, shpejton tek dy deshët që kishte nën pushtetin e saj bisha dhe, në panik e godet të ziun/dështon dhe mbetet brenda.

6. Viktima gënjehet dhe padashur ndihmon armikun e vet. Funksioni i gjashtë pëson një transformim pothuajse të plotë: Viktima/heroi me vetëmohim dhe me vetëdije i ndihmon ata (vëllezërit e vet)/armiqtë në këtë rast. Qerosi i ndihmon të ngjiten lart, duke besuar se do t'ia dalë mbanë përkundër tradhtisë.

Në secilën nga këto funksione kemi vazhdimisht ndërrime vendesh dhe rolesh.

7. Agresori dëmton një nga anëtarët e familjes ose e rrëmben dikë. Vëllezërit rrëmbejnë të Bukurën e Dheut dhe e lënë heroin në botën e nëndheshme.

8. Njoftohet lajmi për fatkeqësinë ose rrëmbimin i drejtohen heroit me një kërkesë apo me një urdhër, e dërgojnë diku ose e lënë të niset. "I menduar ay nga i madhi pikëllim i tij, për të madhen të keqe që e gjet, vajti nën hijen e një lisi dhe ndenji. Atje ndien zë shpesas e tek ngre sytë përpjetë, sheh mb' atë lis një fole zogj shqiponje edhe një gjarpërë që po ngjitej pas lisit sa të vejë n' dë foletë e të hajë zogjëtë[…] u ngre me vrap dhe nxorri kuburen dhe vrau gjarpërin e i shpëtoi zogjëtë pastaj vajti prapë ndë vendit edhe fjeti"[915]. Lisi dru i shenjtë tek ilirë-shqiptarët, ku gjen prehje dhe ngushëllim heroi...

9. Kërkuesi pranon të veprojë apo vendos të bëjë një gjë të tillë. Heroit shqiponja i thotë të kërkojë nga ajo çfarë dëshiron si kundërvlerë e shpëtimit të të vegjëlve të saj. Ai i kërkon ta ngrejë në botën e mbidheshme. Ajoi vë kushte, ai i

[915] Th. Mitko *Vepra*, Tiranë, 1981, f.364

pranon ato dhe niset me fluturim për në sipërfaqen e tokës. Këtu ngritja është analoge me mitin e Orfeut, ku shpendi kërkon mish dhe ujë për të pasur fuqinë t'ia arrijë qëllimit...

10.Heroi largohet nga shtëpia. Heroi largohet/arrin në qytetin e lindjes, por nuk shkon në pallatin atëror, ai bluan një hakmarrje, ndaj vëllezërve. Dhe ashtu siç ndodhi me Josifin e njëmbëdhjetë vëllezërit ai do t'i vejë në sprovë ata, e pret këtë ditë me durim e urtësi, deri në triumfin përfundimtar dhe shpirtmadhësia e trimëria e tij nuk e lë t'i dënojë vëllezërit ziliqarë...ai më në fund i fal.

Krahas funksioneve të Propp-it në analizën e teksteve/përrallave, vërejmë se tipologjia kallëzuesore, mund të studiohet edhe me anë të ekuilibrit të Todorovit dhe binarit opozitar të Barthes-it.

Në fillim paraqitet gjendja ekuilibruar/familja mbretërore, bënte jetë relativisht të qetë. Prishja e ekuilibrit nga provokimet e bishës. Njohja e prishjes së ekuilibrit: plagosja dhe ndjekja e bishës. Kjo fazë është më e gjatë dhe me shumë peripeci, që rrjedhin në nënndarje të tjera, nga njohja te mosnjohja dhe anasjelltas/vëllezërit, katastrofa/mbetje në botën e nëndheshme/Hades. Përpjekja për ta vendosur ekuilibrin, është pas eliminimit fizik të bishës, por është më e vështira dhe njëkohësisht më artistikja sepse ka shumë gërshetime dhe peripeci deri në arritjen e ekuilibrit. Vendosja e ekuilibrit bëhet pas kthimit të heroit mbi dhe, sprova me vëllezërit, e deri tek zgjidhja përfundimtare me triumfin e tij.

Kombinimet e këtilla janë të arsyeshme pasi që sipas Claude Bermond "Dy veprime të ndryshme nuk mund të ngatërrohen me dy perspektiva të ndryshme të një veprimi [...] Në nivelin e analizës ku ne punojmë , ato kërkojnë mospranimin e nocionit për "Heroin" për të Ligun", të menduar si numrat mbi fanella të cilët u janë shpërndarë një herë e mirë personazheve. Çdo veprues është hero i vetvetes " në perspektivën e tij/heroit, partnerët e tij cilësohen si aleatë, kundërshtarë etj. E njëjta sekuencë e ngjarjeve pranon strukturime të ndryshme, sipas asaj që ajo ndërtohet në funksion të interesave të këtij apo atij personi "[916]

Pra paraardhësit e teorive narrative mbi tipologjinë e personazheve të përrallës me fjalë të tjera pranojnë ndryshime në strukturën narrative të pjesëmarrësve në aksione. Kjo, do të thotë se çdo funksion rrjedh nga një tjetër për shkak se këto përralla kanë "një njësi veprimi të lidhura me njëra-tjetrën edhe një veprim të vetëm, siç thotë Aristoteli në veprën Poetika [...] Vepra letrare nuk mund të jetë grumbull episodesh por duhet të ketë një njësi veprimi"[917].

Nëse i lëmë vend shpjegimit të mitologjive të vjetra ilire-shqiptare, atëherë mund të themi se ne kemi të njëjtën përrallë për tre Moiret që ishin zana të fatit; në Veri njihen si orë/zana, në Jug fatthënat, në Çamëri Tri Moirat, Miret, të bijat e Zeusit dhe Themit/Dhemit (dheut). E madhja quhej Atropo (Ατροπος), e

[916] Tz. Todorov, 2000, vep. e cit. f.113

[917] Aristoteli,*Poetika,* Prishtinë, 1998, f. 45

pashmangshme si fati. E dyta quhej Laki (Λαχε), fati ose te e folmja popullore e gegërishtes qendrore laki=nyja dhe e treta Klothi ajo që tjerr(kë loth/lidh).

Meqë funksioni i këtyre Moireve është të "tjerrin" fatin njerëzor, në këtë rast atë shqiptar, edhe emrat e tyre janë në përputhshmëri me punën e tyre. Etimologjia e emrit Kloth: kë lodh=(ajo) që lidh, tjerr Laki=nyja, Atropa=preva në të folmen e gegërishtes qendrore e tropita/që d.m.th., e preva. Edhe logjikisht ka lidhshmëri me funksionet e tyre, pra, e vogla, e tjerr fatin, e dyta lidh=thur dhe e madhja e pret=pret fatin njerëzor. Nëse kthehemi dhe bëjmë një paralelizëm me luftrat e Aleksandrit të Madh, atëherë kjo lidhet me metaforën e nyjës së Gordonit /qytet në Azinë Qendrore Phrygia (Anadolli qendror i sotëm) që ishte e lidhur një nyje në një shtyllë të tempullit të Zeusit dhe legjenda thoshte se kush do ta zgjidh këtë nyje do të bëhet sundimtar i gjithë Azisë. Aleksandri e preu këtë nyje dhe e mori si fat të paracaktuar nga Zeusi me atë rast u nis ta pushtojë Azinë.

Thimi Mitkoja me veprën Bleta Shqiptare na la trashëgimi të paçmuar të urtësisë popullore të të gjitha trojeve. Vlera e tyre është shumanëshme dhe e larmishme. Duke filluar me pjesën e parë të lirikës këngë për fëmijë, e cila tregon për kujdesin dhe rëndësinë që populli u kushton të vegjëlve dhe edukimit të përgjithshëm të tyre e në veçanti edukimit artistik. Institucioni i vetëm i edukimit të brezave ka qenë letërsia popullore me rrëfimet, përrallat, gjëegjëzat, proverbat, epikën historike e legjendare, lirikën familjare e shoqërore anekdotat dhe gjithë urtësinë popullore e etnologjike të shqiptarëve.

GËZIM RREDHI (GJIROKASTËR)
YLLKA KËNAÇI (GJIROKASTËR)

LETËRKËMBIMI ME PERSONALITETE TË BOTËS SHQIPTARE, SHPREHJE E INTERESAVE TË LARTA KOMBËTARE TË THIMI MITKOS

Thimi Mitkoja përfaqëson një ndër figurat më të ndritura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i cili me veprën dhe aktivitetin e tij në ndihmë të çështjes kombëtare, dha një kontribut të vlefshëm në themelimin e sistemit arsimor shqiptar, në zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, në emancipimin kulturor dhe në çeljen e rrugës për studimet albanologjike, veçanërisht në fushë të gjuhësisë dhe folkloristikës.

Siç shprehej Jeronim De Rada më1879: "Thimi Mitkoja i dha kombit një vepër madhështore, që nuk mundën t'ia dhuronin as kolonitë arbëreshe të Italisë, me gjithë kolegjet e tyre[918]".

Thimi Mitkoja nuk ishte as historian, as gjuhëtar, as folklorist dhe as pati arsimin përkatës për ndonjë fushë shkencore a kulturore, por në kërkimet dhe hulumtimet e fakteve historike, e fjalëve të lashta e të rralla, në mbledhjen e letërsisë gojore, ai tregoi pasionin dhe mprehtësinë e një specialisti.

Pikëpamjet iluministe të Thimi Mitkos, shfaqen në interesimet e vazhdueshme që ka ai për gjuhën, historinë dhe problemet politike të kohës. Këtyre çështjeve madhore ai u kushton edhe veprimtarinë artistike e publicistike, sprovat kërkimore e studimore dhe përpjekjet intelektuale. Tek e kaluara historike ai kërkon dhe gjen fakte për të mbështetur polemikat e tij në mbrojtje të identitetit kombëtar përballë keqinformimeve që bënte shpesh shtypi i fqinjëve, e veçanërisht ai grek i kohës, mbi historinë e Shqipërisë.

Ai ndjek me vëmendje e interes gjithçka që botohet në lidhje me çështjen shqiptare, studimet për çështjen e prejardhjes, të gjuhës, të kulturës siç janë botimet e De Radës, Dhimitër Kamardës, Frans Bopit, Dora d'Istrias. Atë e entuziazmojnë në veçanti, vlerësimet që të huajt i bëjnë lashtësisë, historisë, vlerave morale dhe trashëgimisë kulturore shqiptare. Studimin e Dora d'Istrias, "Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore", për të cilin merr dhe nismën për ta përkthyer e botuar në gazetën "Fjamuri i Arbërit" të De Radës, e sheh si kontribut të vlefshëm për mbrojtjen e aspiratave të popullit shqiptar para opinionit botëror.

Interes të madh në fushë të letërsisë, historisë, publicistikës e kulturës, përbën letërkëmbimi i tij i vëllimshëm me përfaqësues të botës kulturore shqiptare si dhe personalitete të tjera të kohës; shqiptarë e të huaj, si: Jeronim De Rada, Dhimitër Kamarda, Panajot Kupitori, Jan Urban Jarnik, Dora d'Istria, Kostandin Kristoforidhi, Visar Dodani, Gustav Majer, etj. Nëpërmjet këtyre letrave zbulohet në

[918] Shefqet Pllana, *Veprimtaria folklorike e Thimi Mitkos*, Seminari 15-16,1995,Prishtinë,fq.25

mënyrë më të qartë e më të plotë profili iluminist i Thimi Mitkos, pikëpamjet dhe vizioni i tij për të ardhmen e vendit dhe aktiviteti i tij konkret për zhvillimin e arsimit, për përhapjen e fjalës së shkruar shqipe përmes periodikeve të ndryshëm, për themelimin e shkollave shqipe, për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe, për botimin e librave shqip më qëllim që "të shkonte përpara kështu populli ynë dhe të kishte njësoj vleftë me kombet e tjerë të qytetëruar"

Që nga vitet '50 të shek. XIX e deri në fund të jetës, Thimi Mitkon e shohim të vihet në kontakt dhe të bashkëpunojë, me rilindës të tjerë të Bukureshtit, Stambollit, të kolonive arbëreshe të Italisë dhe me studiues të huaj që interesoheshin për çështjen shqiptare. Me entuziazmin iluminist e romantik që e karakterizon, Thimi Mitkoja nuk mjaftohet vetëm me komunikimin që ndërton vetë, por ua rekomandon këtë edhe miqve të tij, pasi e sheh se një organizim gjithpërfshirës i intelektualëve të Rilindjes do të shpinte në rezultate të shpejta për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Madje ai parashtron disa herë në letrat e tij, nevojën e krijimit të shoqërive "që të çojnë përpara" idetë e Rilindjes". "Pa një shoqëri ose një klub, që të mbështesë punën tuaj dhe të përhapë idetë tuaja në të gjitha cepat e Shqipërisë, unë kam frikë, mos qoftë kështu, se qëllimi juaj me të vërtetë i shenjtë nuk do t'ia dalë mbanë"[919] Ndërsa në letrën dërguar Panajot Kupitorit, më12.5.1871, ai i kërkon që të hyjë në marrëdhënie me Dh. Kamardën për qëllime patriotike:

"Si shqiptar, edhe unë dëshiroj të ju shoh që të dy në kontakt, dhe, në qoftë se do të më lejohet, do të jetë nderi im më i math të ju shërbej si mjet rekomandimi për qëllimin e shenjtë, që me anë të këtillë personash kompetentë të gjendet një rrugë e dobishme për të qytetëruar në përgjithësi Shqipërinë e gjorë, këtë komb… prej natyre fisnik[920].

Letëkëmbimin më të dendur, Th. Mitkoja, e ka me romantikët arbëreshë, veçanërisht me Dh. Kamardën dhe J. de Radën, punën e të cilëve e sheh me adhurim dhe e vlerëson së tepërmi dhe, shpesh bëhët ndërlidhës dhe pjesëmarrës në projekte të përbashkëta. Në përpjekjet e tyre për mbledhjen e folklorit dhe gjuhës dhe në prirjen për të botuar në gjuhën shqipe, ai sheh të realizuara idetë e veta. Madje kërkon herë pas here që botimet dhe shtypi arbëresh të përhapen e të lexohen edhe në Shqipëri e vende ku jetojnë shqiptarë të Shqipërisë. Në një situatë të tillë, Mitkoja e sheh përhapjen e shtypit si një nga mjetet që do të sensibilizojë intelektualët e kohës dhe do të përgatisë shtratin e nevojshëm për lëvizjet çlirimtare. Mitkoja është përpjekur ta bëjë "Fjamurin e Arbërit" një organ të gjithë shqiptarëve, prandaj e këshillon herë pas here De Radën të përdorë një gjuhë më të kuptueshme, një alfabet më të thjeshtë. Për këtë qëllim i propozon përdorimin e alfabetit të Stambollit.

Në zemrën dhe ndërgjegjen e këtij patrioti të madh të kombit tonë gjithmonë ndihet brengosja për fatin e gjuhës dhe librave të shkruara shqip. Në një

[919] Thimi Mitko, Vepra, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1981, fq.615
[920] Thimi Mitko, Po aty vep.cit.,, 1981, fq.613

letër dërguar Dhimitër Kamardës, më 09.01.1868, ai i shprehet: "Dëshiroja të kem të tëratë libra të shkruara mbë gluhë shqip prej shqiptarësh. Zemërën time të plagosurë për fatkeqërën'e madhe të Shqipërisë sotme, ma ngroh mjaft patriotismi, dituria dhe mësimi i shqipëtarëvet Italisë. Ndodhur Shqipëria mes dy dritareve të mëdha, do të ndritësonet dhe do të mësonetë, por sotprsot ka Eladha gluha na prishetë, edhe na humbet nga ditë"[921]

Ndërsa në letrën dërguar De Radës, më 17.06.1881, Thimi Mitkoja përshëndet hapjen e një shtypshkronje me një ton gati ekzaltues e triumfues, por edhe me dhimbje, që nuk ka mundur t'i realizojë këto ide, që kanë vluar më pare në zemrën e tij: "Idhea jote për të ngrehur një typografi arbëreshe në Italitë do të jetë një punë e një shërbese fort e bukurë për vendërinë tënë (*per la nostra patria*)….. Këtë idhe kam pasur unë që moti, po nukë munda t'e kryenj….Përandaj "Bëleta ime" fle! ….Oh me sa të math helm e hidhërim, vëlla, të shkruanj këto fjalë, që pëkasënjën emërin e nderin e Shqypërisë" [922]

Komunikimi që ndërton me De Radën e kapërcen nivelin e bashkëpunimit për çështjet e krijimtarisë dhe të projekteve të përbashkëta, dhe kthehet në një komunikim miqsh. Megjithatë, ashtu siç ndodh edhe me figura të tjera, Mitkoja nuk i sakrifikon pikëpamjet e tij, sidomos mbi çështjen e alfabetit, për shkak të miqësisë dhe respekti që ka për ta. Ai i shprehet pa rezerva për mospëlqimin që ka ndaj alfabetit që përpiqet të hartojë De Rada. "…edhe alfabeti i zotërisë sate më duket i rendë (dificile). Ay i Dorsës (Evangelio…) më vjen më mirë."[923]

Mitkoja ushqente besim të madh në rolin që mund të luante në këtë kohë, veprimtaria patriotike e arbëreshëve të Italisë për çështjen kombëtare. Siç mund të vihet re shumica e letrave i drejtohet De Radës, këtij personaliteti që qëndron në qendër të Rilindjes sonë Kombëtare. Për këtë figurë Thimi Mitkoja ka një nderim dhe vlerësim të lartë. Veprimtaria letrare dhe publicistike e tij e entuziasmon dhe e mbush me shpresa. Me De Radën. Thimi shkëmbën përvojën e vet, pikëpamjet, bashkëpunon për të pasuruar veprën e tij "Bleta shqiptare". Mitko i shkruan vazhdimisht De Radës mbi zhvillimet në Shqipëri, mbi Lidhjen e Prizrenit, mbi botimet në periodikë të tillë si "Zëri i Shqipërisë", mbi marrëveshjet greko-turke për ndarjet e territoreve, mbi nismat për hapjen e shkollave shqipe, mbi fatin dhe veprimtarinë e figurave të tilla si Hoxha Tasin, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, mbi aktivitetin e shoqërive shqiptare në Egjipt dhe mbi çështje personale.

Letërkëmbimet, gjithashtu, dëshmojnë se Thimi Mitkoja ishte njeri aktiv në lëvizjen kombëtare, sidomos si autor i disa artikujve në periodikë evropianë në mbështetje të çështjes kombëtare shqiptare. Ai përktheu në shqip *Marsejezën*. Më 1881 Thimi Mitkoja qe një nga anëtarët themelues të seksionit egjiptian të

[921] Mitko, Thimi, Vepra, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1981, fq.610
[922] Mitko, Thimi, Po aty, vep.cit., 1981, fq.650
[923] Mitko, Thimi, Po aty, vep.cit.,, 1981, fq.681

“Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip.” Marrëdhëniet me patriotët e Stambollit dhe të Bukureshtit përbëjnë një faktor shumë të rëndësishëm në formimin politik të Mitkos. Ato i forcuan bindjet për një bashkërendim të forcave të kombit; i zgjeruan horizontin për një konceptim të drejtë të detyrave që shtronte lëvizja kombëtare në këto çaste historike. Në këtë platformë me të cilën nis mendimi përparimtar i Rilindjes, do të kristalizohet vija themelore e veprimtarisë patriotike të Th. Mitkos. Kështu ai fillon aktivitetin botues, fillimisht në Greqi, në gazetën “Pellazgu” më 1857 e “Pandora” më 1859. Në këta artikuj ai trajton tema si lashtësia e gjuhës shqipe, prejardhja e saj pellazgjike, të kaluarën historike të popullit shqiptar, traditat shqiptare, etj.

Aktiviteti tregtar bëri që Thimi Mitkoja të kalonte kohë në vende të ndryshme të Europës, si Austri, Rumani, Francë, Hungari, Itali etj. Kjo përvojë i mundësoi njohjen e lëvizjeve nacionaliste dhe ideve përparimtare të cilat, siç vihet re, i bëri shpejt të tijat. Europa e shek. XIX, ishte vendi i revolucioneve dhe i vizioneve të reja që do të ndryshonin më vonë rrjedhën e historisë së shumë shteteve. Këto ide atij i përforcohen më tepër edhe nga kontaktet e ngushta me arbëreshët e Italisë. R. Qosja thekson se ai është autor me pikëpamje plotësisht të formuara historike, politike dhe kulturore, sepse është autor me pikëpamje plotësisht të formuara kombëtare.[924]

Interesimi i Thimi Mitkos dëshmohet në njohjen që ka ai mbi politikat e vendeve të ndryshme lidhur me Shqipërinë, në informacionin e pasur historik e kulturor. Ai i shkruan De Radës: “Dëgjova të gjitha sa më shkruan për udhëën e politikësë(së)…Rusisë, Austrisë dhe Italisë, ashtu edhe mendjen e zotërisë sate se nuk jep dorë të ngrihet flamuri i Shqypërsisë sot në këtë kohë”[925]

Letërkëmbimi dëshmon se shqetësimi më i madh i Thimi Mitkos është arsimimi dhe dituria në gjuhën kombëtare si faktorët themelorë të emancipimit kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve. Siç i shprehet Francesko Krispit, *“*është koha që shqiptarët të kenë gjuhë dhe kombësi.*”*[926]. Pikërisht arsimi dhe afirmimi si komb, humbja e të cilave do të thotë humbje e identitetit, janë për Thimi Mitkon, dy qëllimet më imediate, dy kushtet, dy rreziqet më të mëdha që i kanosen popullit shqiptar, nëse nuk i mëshohet kësaj lufte. Unitetin kombëtar Thimi Mitkoja e sheh të parealizueshëm pa njohjen e gjuhës shqipe dhe krijimin e sistemit arsimor. “Por që të arrihet kjo,-shprehet ai në letrën drejtuar Kostandin Zhapës- kërkohet më parë zhvillimi moral i Shqipërsisë me anë të gjuhës së vëndit, domethënë të këtij mjeti të vetëm natural të qytetërimit të çdo kombi…”[927]

Thimi Mitkoja, ndjek me vëmëndje të gjitha përpjekjet për hartimin e një alfabeti të gjuhës shqipe. Fillimisht ai mban shpresa tek intelektualët arbëreshë, më

[924] .Qosja, Rexhep, *Romantizmi II*, Toena, Tiranë, 2000, fq.273
[925] Mitko , Thimi, Po aty, vep.cit. 1981, fq.635
[926] Mitko , Thimi Po aty, vep.cit. 1981, fq.632
[927] Thimi, Mitko, Po aty, vep. Cit. 1981, fq.637

tej hyn në polemika për alfabetin e Jani Vretos të cilin nuk e miraton për shkak të shkronjave latine e greke që ai pati përfshitë në të, shkronja që Thimi Mitkoja i quan "shenja elinollatinishte". Polemikën, Thimi Mitkoja, nuk e kursen as kur vëren se figura që mund t'i shërbejnë kombit, priren për të krijuar iluzionin e shpëtimit nëpërmjet politikave të huaja. Në letrën dërguar Francesko Krispit, figurë e shquar politike e Italisë, kryeministër i saj prej vitit, 1887-1896, me 21.06.1879, bëhet e ditur se ai i dërgon një artikull polemizues për ta botuar në gazetën "La Riforma", (siç kuptohet nga letra pasi artikulli nuk njihet, sepse mund të mos ketë arritur të botohet), ku mbrohen të drejtat legjitime të shqiptarëve. Francesko Krispi po në këtë gazetë, i ndikuar nga politika greke, pati botuar një artikull ku shprehet për shqiptaret me fjalët: "Mondo ladro, mondo traditore". Kjo gjë e nxit Mitkon t'i hyjë një debati në mbrojtje të çështjes shqiptare, por që mbetet pa përgjigje.

Si përfundim mund të themi se tek Thimi Mitkoja, ashtu si në të gjithë veprimtarinë e tij
kulturore, atdhetare, krijuese, edhe në letërkëmbimet me bashkëkohësit, rreh pulsi dhe zemra e një patrioti rë shquar, që si një tribun i vërtetë i kushtoi lëvizjes kombëtare shqiptare gjithë energjitë e tij fizike dhe shpirtërore. Nga letërkëmbimi kuptohet qartë se marrëdhëniet dhe bashkëpunimet mes këtyre figurave, ishin shumë më të forta nga ç'mund të jetë menduar. Pa atë sinkronizim të pikëpamjeve, ideve dhe nismave të tyre, Rilindja Kombëtare nuk do të kishte pasur ato arritje që pati në fushë të arsimit dhe afirmimit të identitetit kombëtar e kulturor.

HAMIT XHAFERI (TETOVË, MAQEDONI)

KONTRIBUTI I THIMI MITKOS NË MBLEDHJEN E FOLKLORIT SHQIPTAR

Kumtesa ka për objekt të hedhë dritë mbi kontributin e Thimi Mitkos si folklorist dhe atdhetar i përmendur i Rilindjes dhe mbledhës i thesarit shpirtëror të popullit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet punës së tij të madhe, i cili së bashku me rilindësit tjerë do të merret me mbledhjen dhe botimin e vlerave të krijimtarisë popullore. Në këtë drejtim, Mitko ka dhënë një kontribut të spikatur, duke e vlerësuar dhe çmuar këtë fushë të rëndësishme të trashëgimisë e të vazhdimësisë kulturore të kombit shqiptar, si një nga dëshmitë e vetëqenies sonë kombëtare. Kërshëria e tij e zgjuar ndaj monumentit të kulturës shpirtërore të popullit, është tregues i qartë i aftësive dhe mundësive që vijonte të kishte populli ynë për krijimin e vlerave artistike e shpirtërore të tij. Këtu e ka burimin përpjekja e tij për të mbledhur dhe botuar këngët e popullit. Duke pasur për bazë periudhën kohore kur ka jetuar dhe kur është marrë me mbledhjen e folklorit, rrethanat shoqërore në Ballkan dhe Evropë në këtë kohë, si dhe gjendjen e shoqërisë shqiptare, del qartë se gjithë ky material i pasur folklorik i mbledhur dhe botuar nga ai, është interesant dhe me vlera të jashtëzakonshme. Përmes këtij punimi do përpiqemi të ndriçojmë dhe të shqyrtojmë në tërësi kontributin e tij në këtë fushë. Mitkoja duke qenë i përqendruar kryesisht në çështjen shqiptare, kjo e nxiti dhe e motivoi edhe më tepër angazhimin e tij në mbledhjen dhe botimin e folklorit, përcaktim ky i nxitur dhe i ndezur kryesisht nga motive atdhetare.

Në kuadrin e një studimi pak më të gjerë, objekt i këtij kumtimi është kryesisht lënda e "Bëletës shqiptare" të Thimi Mitkos, botuar në Aleksandri më 1878. Në parathënien e botuar te përmbledhja e tij folklorike "Bëleta shqiptare", me pasionin e shpirtit do të shpreh qartë qëllimin e ndërmarrjes së tij, kur thotë se: "shpëtimi dhe dhënia e brezave që vinë, dhe fjalëve e tekstevet shqipe, të cilat, para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime, besoj se do të kenë një vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri dhe zakonet e racës shqiptare...". Mitkoja këto të dhëna i shpreh bile në parathënien e "Bletës", kur përmend thëniet e folkloristit të njohur gjerman, Herderit: "Një komb nuk mund në asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet", ku përveç të tjerave thotë se: "Gjuha amtare është ushqimi i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit"[928]. Përmbledhja "Bëleta shqiptare" nis me një Parathënie të Mitkos, prej ku paraqiten ndjesitë e thella atdhetare të këtij vjelësi, i cili lëndën e krijimtarisë gojore e ngërthen të veçuar sipas tërësisë së tipareve në këto lloje: në fjalë të vjetëra (proverba), fjalë të errëta (gjëegjëza), të përshëndoshura (përshëndetje), emëra personal të kërshtera apo mohamedane, këngë të moçme alegorike, kryesisht për të qeshur, këngë që këndohen në disa ditë të caktuara, këngë shqype dasëmore, këngë

[928] Instituti i Folklorit, *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar* (1635-1912), Tiranë, II, 1961, f.371

shqype jaranishte, (këngë) gegërishte, këngë shqype trimërishte, (toskërishte dhe gegërishte), që krijojnë pa mëdyshje njësinë mjaftë joshëse të kësaj përmbledhjeje, ngaqë në këto këngë popullore paraqiten para së gjithash stoicizmi trimëror i bijve të popullit nga bota shqiptare përballë zgjedhës osmane. "Përrallat shqype" e përfshijnë përmbledhjen e parë të Mitkos, prej të cilave u mënjanuan gati krejt këngët e bejtexhinjve, gjithashtu edhe ca njësi të cilat, sikundër paraqiten në mënyrë të detajuar nga redaktorët "nuk i sjellin ndonjë dobi kulturës shqiptare, ndoshta janë të mbushura me vargje apo fjalë tepër liçensjoze"[929].

Në këtë kumtesë, do të ndalemi më gjerësisht te ky atdhetar i përkushtuar pas folklorit dhe traditës popullore, i cili i shihte si një potencial me vlera të veçanta për kulturën shpirtërore shqiptare, në të cilën reflektohen qartë krijimet e larmishme gojore të hapësirave të njësuara shqiptare, duke iu kundërvënë në këtë mënyrë përpjekjeve asimiluese, por edhe proceseve vetëmënjanuese kombëtare, kudo që jetonin shqiptarët. Sipas Mitkos, edhe folklori jepte ndihmesën e vet për të ruajtur të gjallë dhe për të përforcuar ndërgjegjen kombëtare, për të dëshmuar identitetin kombëtar shqiptar. Duke u vënë në mbrojtjen e fuqishme të kulturës shpirtërore dhe materiale të popullit shqiptar, ai do të udhëhiqet nga ideali shpirtëror dhe kombëtar se mbi të gjitha: “Shqiptari, duke dashur pa fund atdheun e tij, do dhe bashkatdhetarin e tij, edhe kur ay është në tjetër fe, sepse fenë e ka në vend të dytë, kur puna është për atdheun e përgjithshëm". Me këtë duam të themi se Mitkoja është një qëmtues, mbledhës, gjallërues dhe botues i folklorit të popullit të vet. Mjafton të kuptojmë se në burimet e këngëve heroike shqiptare gjenden shumë "shembëlla të tilla patriotizmi dhe lirije të fesë”. Këto përpjekje të shpirtëzuesit të kërshërisë folklorike të Thimi Mitkos, i hasim edhe te rilindës të tjerë që u morën me folklorin. Këta e shihnin folklorin si përcjellës të vlerave shpirtërore, të tipareve e të virtyteve më të qenësishme të shqiptarëve, të ndjenjave e shijeve të tyre, historikisht të njohura ose shpirtërisht të ndërtuara në folklor. Nga ana tjetër, sipas Mitkos dhe rilindësve, folklori ndihmonte bashkimin kombëtar, zgjonte ndërgjegjen disi të topitur, por të mbrojtur me zjarrin e shpirtit dhe të pasuruar me dritën e mendjes, e hidhte popullin në veprime konkrete për çlirim nga pushtuesit. Po kështu, folklori shërbente edhe për krijimin e kulturës së re që i duhej mëmëdheut si për të arritur çlirimin kombëtar, ashtu edhe për të formuar një shtet të pavarur. Me mbledhjen dhe botimin e folklorit, përveç Mitkos janë marrë edhe pena shumë të njohura të kulturës sonë kombëtare, të cilët kanë qenë të njohura për gjallërimin e lëvizjes kulturore. Mitkos, për fat të mire, iu dha mundësia të takohet me një sërë nismëtarësh të lëvizjes kombëtare, midis tyre edhe me De Radën dhe Dhimitër Kamardën, nën ndikimin e të cilëve iu përvesh punës së mbledhjes së folklorit[930].

Mitkoja ishte i pari që ia arriti qëllimit të grumbullojë një lëndë folklorike

[929] Çeta Anton, *Gjurmime Albanologjike*, Folklor dhe etnologji I, 1971, f. 298
[930] Qemal Haxhihasani, Thimi Mitko, Naim Frashëri, Tiranë, 1962, f. 5

mjaftë të pasur, në të cilin përmblidhen tiparet dhe llojet më të larmishme në poezi dhe në prozë[931]. Pëveç 87 proverbave, 10 gjëegjëzave, 21 këngëve dhe dy tregimeve, këtu ndeshim edhe dy letra të Thimi Mitkos dërguar Kamardës, një uratë, dy vjersha autentike personale të Mitkos dhe dy të tjera dedikuar këtij nga Thanas Kushta dhe Loni Logori. Duke u nisur nga konceptime të tilla, këtu do të spikasin në mënyrë të veçantë me kontributin e tyre një varg rilindësish si De Rada, Zef Jubani, Spiro Dine, Shtjefën Gjeçovi, Vinçenc Prenushi etj. dhe mbi të gjithë Thimi Mitkoja, të cilët jo vetëm që mblodhën folklorin nga mjedise të ndryshme, por edhe botuan krijime e vëllime të veçanta folklorike. Duke qenë në lidhje të përhershme me ta dhe, duke vlerësuar rëndësinë e krijimtarisë gojore të popullit nga vështrimi etnografik, historik dhe gjuhësor, ai, jo vetëm që iu dedikua me forcën frymëzuese të shpirtit për tu vënë pas mbledhjes së folklorit, porse me vullnet dhe përqëndrim të veçantë e botoi tërë lëndën e mbledhur për t'ua vënë në pritshmëri shkencëtarëve të kohës, duke qenë i bindur dhe shpresëplotë se këta do të kishin një rol shumë pozitiv gjatë lëvizjes së Rilindjes (veçanërisht këngët e trimërisë), të cilat ndikuan në begatimin dhe dëlirësinë e gjuhës sonë, si tipar dallues i veçantë në krijimin e vetëdijes kombëtare dhe përparimin e mëpasshëm të letërsisë artistike dhe mbarë kulturës shqiptare[932].

Në fushën e folklorit u bënë përpjekje për të vënë në pah vlerat e krijimtarisë shpirtërore të popullit. Kësisoj filluan të dalin në dritë përmbledhjet e para të folklorit shqiptar, të cilat iluministët e Rilindjes i çmonin jo vetëm për vlerat artistike letrare, por edhe si mjete për mësimin dhe lëvrimin e gjuhës amtare, për afirmimin e kulturës kombëtare shqiptare dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve. Një ngjarje e shënuar është veçanërisht botimi në vitin 1878 i vëllimit të Thimi Mitkos "Bëleta shqiptare" (në Egjipt), që përbën hapin më të rëndësishëm në pasqyrimin ndërkrahinor të krijimtarisë gojore dhe gjerësinë e llojeve e të zhanreve folklorike, për njohjen dhe respektimin e kritereve të regjistrimit dhe botimit folklorik. Puna e mbledhjes së folklorit që filloi në vitin 1878, për vetë kushtet historike të kësaj kohe, ishte e vështir, për të mos thënë e pamundur të zhvillohej në mënyrë normale një veprimtari e gjerë folklorike. Në këtë periudhë u shtuan edhe më shumë përpjekjet e këtij folkloristi të palodhur për mbledhjen e kësaj krijimtarie poetike popullore. Por megjithatë, me këtë përmbledhje folklorike filloi historia e botimit të vlerave shpirtërore të popullit, me të cilën Thimi Mitkoja u bë i njohur si themelues i folkloristikës shqiptare. Sikurse vihet në dukje në parathënie, qëllimi i tij ishte t'u jepte nxitje bashkatdhetarëve të vet që të kulturoheshin dhe të studionin gjuhën amtare, e cila "është ushqimi i parë i përbashkët që i jep gjallëri popullit".

Interesimi për mbledhjen e krijimtarisë gojore gjatë Rilindjes qarkulloi dhe u pasurua me lloje e zhanre të ndryshme, duke shprehur në mënyrat e veta specifike periudhën kohore dhe problematikën që ajo ngërthente. Por në mënyrë më të

[931] Çetta Anton, Gjurmime Albanologjike, Folklor dhe etnologji I, 1971, f. 298)
[932] Instituti i Folklorit, Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912), Vëllimi II, 1961, f. 370

drejtpërdrejtë dhe më të hapur, periudhën historike të Rilindjes Kombëtare e pasqyrojnë këngët e epikës historike dhe të mërgimit, duke qenë, së pari, krijimtari e komunikimit artistik popullor, dhe, së dyti, edhe plotësim i dëshmive historike. Pikërisht kjo kishte kuptimin e vet, sepse ishte më afër realitetit të gjendjes shpirtërore shqiptare. Ajo që binte në sy ishte ideja e bashkimit kombëtar, pa dallim feje e krahine, që shihej fare qartë në mjaft tekste këngësh historike, si një kërkesë e domosdoshme dhe e vetmja rrugë për të arritur lirinë e pavarësinë, qëndresën dhe përballimin kundrejt qarqeve shoviniste fqinje dhe të Fuqive të Mëdha që i përkrahnin këta gllabërues të tokave shqiptare. Thimi Mitkos i tërheqin vëmendjen ato këngë që u bëjnë jehonë ngjarjeve më të rëndësishme e që ruheshin në kujtesën e popullit. Vetëm te botimi i përmendur i tij ndër të tjera gjejmë edhe vargje të tilla: “Shqipëria anë mb’anë / U ngren’ e një fjalë thanë: / - Mbretit s’i apëm nizamë!”; “O shokë, ndë kini besë, / Kush ka lindur do të vdesë. / Shqypëtarë ne na thonë, / Bëjmë si ç’kemi zakonë”; “Ziafeti i osmanllisë / Është helm i Shqipërisë”; “Sulltan, mos dëgjo Frëngjinë, / Na s’lëshojmë Shqipërinë”; “Frënk, e gjeç nga Perëndia, / S’ë se humbi Shqipëria. / Na madhuat Malëzinë, / Sërbin’ edhe Grekërinë, / Harruatë Shqipërinë, / Q’i ka trimat si shahinë”. Vargjet e kësaj kënge bëhen shprehëse e përpjekjeve për një atdhe të lirë, me tipare themelore të shqiptarizmës dhe me frymëmarrje të gjerë kombëtare. Janë këto porosi të qarta që dilnin nga goja e rapsodit popullor shqiptar, të cilat ruhen njëkohësisht si vlera të konsiderueshme të folklorit tonë. Me sa duket pasioni i tij për mbledhjen e krijimtarisë popullore gjente mbështetje sidomos në predispozitat e tij patriotike.

Po të vështrojmë me kujdes vendin ku është mbledhur folklori ynë, apo t'i qasemi në veçanti Mitkos, kur ky do të njihet me albanologët Dozonin, Pedersenin, Meyerin, Jarnikun të cilët treguan interesim për mbledhjen ose botimin e folklorit tonë. Nga gjithë kjo punë e madhe e këtyre albanologëve, konstatimi ynë është se më të zbehta janë përmbajtjet që janë huazuar nga dy veprat e G. Majerit, të cilit Mitkoja ia kishte dërguar "duke e lutur t'i gjente ndonjë editor", mirëpo ky zell i tij nuk u plotësua, me gjithë orvatjet këmbëngulëse të Majerit. Prej kësaj lënde të pasur janë të pranishme në këtë ble 14 këngë dhe dy përralla, të huazuara nga "Gramatika shqipe", kurse nga "Studimet shqiptare, VI" janë marrë 31 këngë, prej të cilave do të bëhej një antologji e bukur e folklorit, që më vonë do të kishin si shokë të pandarë nxënësit, mësuesit, të gjithë punëtorët e penës e të krahut dhe tërë ata që deshën të shkruajnë vërtetë shqip[933].

Dorëshkrimi i Pragës, përmbledh sidomos lëndën folklorike në dorëshkrim që u gjet nga Dh. Pilika në arkivin e filologut çek Jarnik, si dhe disa krijime popullore, të publikuara pas "Bëletës"[934]. Siç dihet, ky dorëshkrim iu dorëzua qeverisë shqiptare, nga qeveria çekosllovake, i cili ndodhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Materialet e mbledhura të thesarit shpirtëror të popullit, Mitkoja i kishte bërë gati

[933] Instituti i Folklorit, Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, (1635-1912), Vëllimi II, 1961, f. 370
[934] Çetta Anton, Gjurmime Albanologjike, Folklor dhe etnologji I, 1971, f. 298

për t'i botuar në një ble të posaçëm. Botuesit vienez Veckenstedt, të cilit i ishte paraqitur Mitkoja, i dërgoi disa pjesë të dorëshkrimit të Jarnikut, që asokohe ishte i njohur si njëri ndër njohësit dhe studiuesit më të dalluar të gjuhës shqipe[935]. Siç dihet, Jarniku e pranoi me ëndje redaktimin e një vepre të tillë duke hyrë në të njëjtën kohë në mirëkuptim me folkloristin tonë, i cili i dërgoi njëkohësisht pjesë të tjera të veprës së tij. Por ndodhitë e papritura që ndodhën asokohe, veçanërisht vdekja e Mitkos, e bënë të pamundur botimin e këtyre teksteve, që mbetën nga kjo kohë në bibliotekën e Jarnikut". Dorëshkrimi përmbante 169 këngë tiparesh dhe llojesh të ndryshme, 22 fabula, anekdota, përralla apo 133 proverba. Siç duket, për fat të keq janë lënë pas dore dhe në këtë vëllim ndeshim vetëm një këngë, një përrallë dhe pesë proverba. Materialet e këtij vëllimi, ndoshta jo aq me peshë si ato të "Bletës", prapëseprapë pasqyrojnë një ndihmesë me peshë të veçantë nga trashëgimia folklorike që na ka lënë Thimi Mitkoja[936].

Pa dyshim, një rol të rëndësishëm si aktivist i lëvizjes kombëtare, filloi të luante në këto vite Thimi Mitkoja nga Korça i mërguar në Egjipt, i cili me veprën e tij "Bleta shqiptare", të përgatitur për botim më 1874, ndërmori një veprimtari të madhe e të frytshme për mbledhjen e folklorit shqiptar. Pikërisht vlera e kësaj vepre ishte e madhe për kohën, "duke simbolizuar me të edhe përkushtimin e tij të gjatë ndaj letërsisë popullore"[937]. Për këto tipare të veprimtarisë së tij në fushën e mbledhjes së kujdesshme të visarit popullor, sigurisht se në formimin e tij më kryesori është mjedisi ku lindi e u rrit. Në ndikimin e Thimi Mitkos nuk duhet përjashtuar veçanërisht mjedisi qytetar të Korçës, ku ruheshin e praktikoheshin vlerat e krijimtarisë popullore, në dasma, në ditë të shënuara apo në gëzime të ndryshme familjare. Një vend të rëndësishëm në të, krahas folklorit popullor në tërësi, siç ishte lirika popullore jetonin të gjalla njëherazi këngët popullore polifonike, të cilat këndoheshin në shumë ngjarje e zakone gjatë jetës së përditshme, veçanërisht mënyrës së të jetuarit, të cilat ai i mblodhi, duke thënë se "…isha i pështetur ndë dorëgjerësinë dhe atdhetarinë e bashkëmëmëdhetarëve të mij, shpërenj që, ndë mbledhje të dytë, të jap ndë dritë lëndë më të shumëtë e më të plotë, prej së cilës gumëzhin Shqipëria". Në këto përpjekje bën pjesë edhe puna e palodhur e Mitkos për të mbledhur e mbajtur gjallë prijimtarinë popullore si shprehje e identitetit kombëtar, si dokument i pavdekshëm për brezat që vijnë. Fan S. Noli më 1958, do të flasë përpara bashkatdhetarëve në Boston për këngën polifonike të "Rrapo Hekalit", të mbledhur nga Thimi Mitkoja, të cilat zgjojnë interes për mendimin shkencor folklorik. Madje, kjo këngë sjell informacion të saktë historik, pra fytyrën e kohës së cilës i përket. Në vargjet e saj gjenë forcë të rrallë shprehëse ndjenja e ndërgjegjes sonë kombëtare. Të gjitha këto ofrojnë mundësi për hulumtime apo studime, për të vënë në pah angazhimin e Mitkos mbi mbledhjen,

[935] Po aty, f. 298
[936] Po aty, f. 298
[937] Qemal Haxhihasani, Thimi Mitko, f. 74

sidomos botimin e këngëve popullore. Mbledhja e folklorit ishte një pasion i veçantë për Mitkon. Visarin popullor e çmonte si pjesë të rëndësishme të kulturës kombëtare, për këtë arsye si bleta i mblodhi këngët, gjë që flet për njohjen e thellë të folklorit të trevës së Korçës[938].

Të tërheq vëmendjen vendi ku është mbledhur ky thesar, sepse Thimi Mitkoja ka qenë i lidhur shumë afër me traditën folklorike. Pothuajse kanë gjetur pasqyrim të gjithë llojet e krijimtarisë popullore, disa nga të cilat janë shumë të realizuara nga ana artistike. Kërkimi i kësaj tradite, po ashtu publikimi i "Rapsodi të një poeme arbereshe" e vitit 1866 dhe "Përmbledhje të këngëve popullore dhe rapsodi të poemave shqiptare" e vitit 1871, nga Jeronim de Rada, megjithëse qe shquar me përmbledhjen e tij folklorike me cilësi mjaft të larta, madje për ritmikën e begatë ose për rëndësinë dhe cilësinë artistike të vetë këngëve popullore. Prandaj, nuk është për tu habitur, pse në letrën që i dërgon,. Jeronim de Radës, në vitin 1880, i thotë se në vëllimin e dytë, në Bëletën e Vogëlë: "do këllas edhe tre a katër kënga nga Rapsodjiat e tua Skënderbeku i pafanë"[939]. Në këtë rast duhet përmendur në mënyrë të veçantë kontributin e "Bletës Shqiptare" të vitit 1878 nga Thimi Mitko, ishin pjesë e programit kulturor të Rilindjes Kombëtare për stabilizimin e një etnie kompakte, veçanërisht identitetit kulturor të Shqiptarëve. Me mendje të kthjelltë, me shumë horizont kulturor e vullnet të çuditshëm, bëri një punë shumë të vyer në mbledhjen apo botimin e visarit popullor. Bile i ka kushtuar shumë kujdes këngës popullore lirike, ku gjejmë krijime të vërteta, shumë të bukura artistike popullore. Në Misir, në ambientin e një ngulimi të njohur bashkatdhetarësh nga të gjitha shtresat e popullit, fshatarë, zejtarë e punëtorë, që patën marrë rrugën e gjatë të kurbetit për të siguruar bukën e gojës për vete dhe familjet e tyre, Mitkos i jepet mundësia për të mbledhur nga goja e këtyre shqiptarëve materialin e kulturës shpirtërore, sikur bleta lule më lule, në të cilin reflektohet gjeniu krijues artistik i popullit tonë, ku në realitet paraqiten lëngimet ose mundimet e tyre, synimet apo stoicizmi, gjendja e brendshme shpirtërore dhe e brishtë, gjer te grafullimet e vrullshme lirike - ndjenja e kënaqësisë ose dëshpërimi, thënë prerazi, pikëpamjet më të larmishme të gjëllimit të popullit, siç është vetë shpirti i popullit[940]. Për këtë qëllim, vëmendjen do ta përqendrojmë tek interesimi për folklorin muzikor, qysh më 1869, kur Mitkoja i shkruante Kamardës se "…këngëtë për zotninë tënde po i mbledh". Këtë punë fisnike për thesarin shpirtëror të popullit e bëri me ndjenjën e kënaqësisë të një folkloristi me dhunti e aftësi të veçantë, i cili bëri ndarjen apo klasifikimin e tyre me një përpikëri e zotërim të shkëlqyeshëm të kësaj fushe, me parime të qëndrueshme shkencore, duke na dhënë veçanërisht variante me tërësi të shëndosha, të shkruara me përpikëri sidomos ato që kanë të bëjë me të folmen, veçanërisht të dialektit të

[938] Për këtë shiko Fan S.Noli, "Vepra 5", fq. 277-279, Tiranë 1988
[939] Thimi Mitko, Vepra, f. 642
[940] Po aty, f. 298

toskërishtes[941]. Punimi do të mbyllet me mbledhësit e shquar në trojet ballkanike të shqiptarëve, siç janë pa dyshim Zef Jubani, Thimi Mitkoja, Spiro R. Dineja dhe Vinçenc Prenushi, të cilët si intelektualë më të spikatur të kohës së tyre, në këto troje patën barrën më të madhe. Spiro Dineja nisi të merret me mbledhjen e krijimtarisë gojore qysh kur arriti në Egjipt, në vitin 1866, ku ishte i përkrahur nga Thimi Mitkoja. Fillimisht filloi të mbledhë me vullnet dhe dashuri krijime popullore të llojeve të ndryshme. Dineja ndër të tjera konstaton se: "karakollet e Kairos qenë plot me gegë e toskë. Këngët e vallet nukë reshtnin, bozuku, tamburaja e bakllamaja buçisnin me të katër anët, na dukej sikur gjendeshim në Shqipëri"[942]. Ky disa krijime të mbledhura popullore së pari ia dorëzoi Mitkos, për të cilin kishte një respekt të veçantë. Duke patur ndërmend faktin se Dines i mungonte formimi i nevojshëm i mësuesit të tij, Thimi Mitkos, për këtë arsye dhe Valët e Detit, megjithëse kishin një rëndësi të jashtëzakonshme për folkloristikën shqiptare, prapëseprapë nuk ishin në nivelin e Bëletës Shqyptare[943]. Mitkoja e meriton të radhitet krahas folkloristëve shqiptarë më në zë, duke zënë vendin që i takon në historinë e folkloristikës shqiptare. Të gjithë ata që e njohën, e çmuan për ndihmesën e madhe si mbledhës folklori apo si patriot. Botimi i vlerave të krijimtarisë popullore të mbledhura nga ai do të jetë një punë e çmuar për trashëgiminë tonë kulturore. Ky ishte rezultati i një veprimtarie afërsisht prej tri dekadash, përpjekje të ngjeshura e këmbëngulëse që e kishin zanafillën që nga viti 1860, kur Mitkoja do të vendoset në Misir, ku do të merret me vlerën e thesarit shpirtëror të popullit deri më 1890 kur vdiq. Thimi Mitkoja është pa mëdyshje shëmbëlltyra më e shquar si mbledhës i folklorit tonë, që njihet për gjallërimin e lëvizjes kulturore, për mbledhjen e visarit popullor dhe pasurimin e mendimit shkencor, veçanërisht në fushën e folklorit.

[941] Po aty, f. 298
[942] Spiro Risto Dine, Valët e detit, Mbrothësia, Sofje, 1908, f.II.).
[943] Po aty, f. 299

IRENA NIKAJ (KORÇË)

NGA REVOLTAT E ARMATOSURA TE RRJETI KULTUROR I INTELEKTUALËVE NË SHËRBIM TË ZGJIDHJES SË ÇËSHTJES KOMBËTARE-ROLI I THIMI MITKOS NË KËTË LËVIZJE

Në punimin e mëposhtëm kemi si synim të shfaqim disa ide në lidhje me rolin e Thimi (Efthim) Mitkos në lëvizjen kombëtare shqiptare, rolin e natyrës kulturore, me punën e tij në radhë të parë në kuadrin e Vëllazërisë Shqiptare në Egjipt, botimin e Bletës Shqiptare si ndihmesë në jetëzimin e funksionimit të rrjetit kulturor të intelektualëve dhe atdhetarëve shqiptarë, sidomos jashtë kufijve të Shqipërisë, që u rrit së tepërmi pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si kundërveprim ndaj disfatës së saj, si ndërrim taktik në kursin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe zgjimit kombëtar, për të realizuar qëllimin final, dhe Pavarësinë e Shqipërisë.

Evropa Qëndrore dhe Lindore, përfshirë edhe pjesa Juglindore e saj apo Ballkani ka një histori politike, e cila ka ndikuar në të gjitha fenomenet që ka jetuar rajoni, jo vetëm me natyrë politike, por edhe ekonomike, kulturore, sociale, fetare, e për këtë arsye ka pasur studime të veçanta dhe të përgjithshme, për çështje të veçanta, por edhe të natyrës krahasuese. Kjo ka krijuar një bashkësi studimesh që kanë krijuar jo vetëm opinion, po kanë shërbyer edhe për të ndezur debate shkencore, por më shpesh debate publike, të cilat kanë ndikuar në rutinizimin e disa miteve historike në këtë rajon, mite të cilat historikisht kanë ushqyer konfliktet, jo të pakta dhe as të lehta që të kapërcehen, e duke krijuar, për rrjedhojë, frymën e diversifikimit dhe emancipimit të diskursit shkencor e publik, që tashmë ka zenë vend prej më shumë se dy dhjetëvjeçarë edhe në këto vise.

Përmendim studimet klasike të O. Bauerit dhe E. Renanit, më pas veçojmë E. J. Hobsbaum, E. Gellner, M. Hroch, M. Cornis-Pope, J. Neubauer. Studimet e fundit kanë krijuar hulli të reja, veçanërisht studimet e M. Hroch-ut për lëvizjet e vogla kombëtare evropiane. Në rastin e kombit shqiptar, rrethanat e krijuara gjatë gjithë shekullit XIX, u reflektuan në atë natyrë që mori lëvizja atdhetare për zgjidhjen e çështjes kombëtare e, bashkë me të, zgjidhja e çështjeve kulturore, fetare, marrëdhënieve me kombet apo shtetet e tjerë ballkanikë, etj.

2. Karakteristika të zgjimit kombëtar në Evropën Juglindore

Erik Hobsbaum argumenton në studimet e tij për kombet, se si u shndërruan nacionalizmi, ideja e kombit, shteti kombëtar nga koncepte të largëta për njerëzit e zakonshëm në forca të mëdha politike, transformuese, shtetformuese. Sigurisht, kombi është një komunitet i përfytyruar, sipas B. Anderson dhe e lindën nevoja me natyrë emocionale, në kushtet e mungesës së lidhjeve reale midis komuniteteve, u nxitën variante ndjenjash të përkatësisë, identiteteve kolektive, që ekzistonin në trajtë protonacionale.

Këto lidhje shfaqen dy llojesh: *së pari*, forma mbilokale të identifikimit popullor, që kapërcejnë kufijtë hapësinorë të vendeve ku njerëzit kalojnë pjesën më të madhe të jetës së vet; *së dyti*, lidhjet dhe leksikun politik, karakteristikë e disa grupeve të veçanta që u lidhën drejtpërdrejt me shtetin dhe institucionet dhe që mundën të përhapen dhe popullarizohen ndërmjet komuniteteve të ndryshme për arsye që lidhen me zhvillime të natyrës objektive dhe subjektive, e u bënë mbizotëruese në marrëdhënie me karakteristika të tjera.

John Neubauer e të tjerë, në studimin e tyre për Kulturën e shkruar në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, kanë dalluar disa etapa historike(ku përfshihen dy shekuj), në rajon si më tej:

1. Zgjimi kombëtar dhe institucionalizimi i letërsisë 1800-1890,
2. Institucionet letrare të Modernizmit 1890-1945,
3. Reforma radikale të instuciove ekzistente në rregjimet komuniste 1945-1989.

Kjo ndarje, ku përfshihet edhe përcaktimi i etapës së parë, është mbështetur mbi arsyetimin se vendet e rajonit qëndror dhe lindor të Evropës e realizuan zgjimin kombëtar mbi korniza dhe mekanizma historikë të përbashkët[944] (), por në segmente kohore me gjatësi të ndryshme dhe me realizime që ndryshojnë shpesh njëri nga tjetri..

Tipologji e zgjimit kombëtar në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore pati një model të tillë nga
pikëpamja sociale dhe materiale, që kishte këta përbërës:

1. Krijimi i revistave dhe gazetave me natyrë kombëtare
2. Krijimi i shtëpive botuese
3. Krijimi i shoqërive letrare dhe kulturore

Baza mbi të cilën u mbështet lëvizja kulturore ishte rikrijimi mitik i së kaluarës historike, i kohës së Skënderbeut, i bëmave të tij, pastaj botimi i librave në gjuhën shqipe, i revistave, i shoqërive kulturore, të gjitha me një qëllim: krijimi i vetëdijes konstruktive të origjinës së përbashkët, të heronjve të përbashkët, të vlerave, etikes, poezisë, rrëfimeve, përrrallave, të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes.

3. Zgjimi kombëtar në Shqipëri

Në studimet historike shqiptare periudha prej mesit të shekullit XIX deri në vitin 1912, pra, viti në të cilin u shpall Pavarësia e Shqipërisë njihet me emrin Rilindje Kombëtare Shqiptare. Ngjashmëritë e emërtimit me Rilindjen Evropiane janë vetëm për pjesën e parë të shprehjes, ka ndryshime në kohë dhe në hapësirë, në qëllimet dhe mjetet me të cilat u zhvilluan ndryshime të tilla, ndërsa ngjashmëritë më të mëdha u shfaqën me të njëjtat lëvizje në emër dhe objektiva që u shfaqën në gjithë Evropën Lindore dhe Juglindore, ku në përgjithësi, lëvizjet që çuan në krijimin e shteteve kombëtare u quajtën kështu, ose me emërtime të afërta, si

[944] shih M.Cornis-Pope dhe J. Neubauer.: 2010.History of the Literary Cultures of East-Central Europe-in 4 Volume. 2010. Edited by Marcel Cornis-Pope and John Neubauer. John Benjamins Publishing DOI::10.1075/chlel.xxv

Ärkamisaeg(Zgjimi Kombëtar) në Estoni, *Văzraždane*(Ringjallje) në Bullgari, *Obrozeni*(Rilindje) në Bohemi, *Redesteptare culturală si natională*(Zgjimi Kombëtar dhe Kulturor) në Rumani, *Nemzeti Ébredés*(Zgjimi Kombëtar) ose *Reforma Kor*(Epoka e Reformës) në Hungari, *Φιλική Εταιρεία*(Shoqëria e Miqëve) dhe *Ελληνική Επανάσταση*(Kryengritja Greke) në Greqi, pavarësisht nga koha në të cilën u realizuan.

Rilindja Kombëtare ose Zgjimi Kombëtar shqiptar u ndikuan, para së gjithash, nga epoka e Revolucioneve dhe lëvizjeve shoqërore ekonomike, industriale të Evropës si dhe nga Revolucioni grek dhe shpallja e Pavarësisë së Greqisë, për arsye jo vetëm të afërsisë së kombeve, por edhe për shkak se shumë shqiptarë luajtën rol parësor në fitoren e Revolucionit Grek. Në mënyrë të natyrshme ata do të mendonin të realizonin një pavarësi të tillë edhe për kombin e tyre duke e llogaritur edhe ndihmën greke për këtë qëllim.

Por na duhet të vërejmë se fitorja e pavarësisë dhe shkëputja nga Perandoria Osmane e të gjitha pjesëve të perandorisë që pretendonin të krijonin shtete-kombe në Ballkan, por ishin njëkohësisht edhe të interesuara të zgjeronin territoret e tyre me pjesë që nuk u përkisnin dëmtoi, në radhë të parë, interesat shqiptare, e, mbase këtu mund të gjejmë një pjesë të madhe të shpjegimeve për vuajtjet, shkëputjen e territoreve që vuajtën shqiptarët për më shumë se një shekull, pasojat e të cilave janë të pakthyeshme në pjesën më të madhe sot e kësaj dite për fatin e Shqipërisë.

Lëvizjet me natyrë çliruese intensifikohen me lëvizjet kundër Tanzimatit, lëvizjet e Z. Gjolekës dhe R. Hekalit në jug, pasurohen në frymë me gjithë lëvizjet çliruese rrotull Shqipërisë dhe vijnë e kulmojnë tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit(1878-1881), e cila përfaqëson lëvizjen e armatosur, kryengritjen ushtarake shqiptare, që për fat të keq përfundoi me disfatë. Mbase edhe rreshtimi i Fuqive të Mëdha (pas Kongresit të Berlinit-1878), Perandorisë Osmane dhe shteteve fqinje i krijoi rrethanat e mjaftueshme për disfatën e saj.

Në rastin shqiptar duhet të nënvizojmë se ka pasur konfuzion në realizimin e etapave drejt pavarësisë, pra ka një pjesë të atdhetarëve luftëtarë dhe intelektualë, të cilët përqafuan rrugën e kryengritjes së armatosur, ka të tjerë që e shikonin progresin më të ngadaltë si më të rëndësishëm, duke ruajtur lidhje të vazhdueshme me Portën e Lartë. Arsyet pse mendonin kështu një pjesë e intelektualëve dhe luftëtarëve, sidomos në jug lidhej me përpjekjen e tyre për të shënuar kufijtë e kulturës dhe kombit në këtë trevë përballë dobësimit të fuqisë ushtarake të Portës së Lartë, faktor që e llogarisnin më shumë në favor të ruajtjes së tërësisë së tokave shqiptare, sesa në të kundërt, qëndrim ky që nga gjykimet e sotme mund të duket si zgjedhje strategjike mjaft e dobët.

Na duhet të mbajmë parasysh se në fund të shekullit XVIII ishin suprimuar dy njësi të mëdha fetare në rajon: Patrikana e Pejës dhe Patrikana e Ohrit dhe të krishterët ortodoksët shqiptarë ishin, si edhe të krishterët e rajonit, që atëherë anëtarë të rum-miletit. Më pas lëvizjet e ndryshme kombëtare dhe krijimi shteteve-kombe ndikoi në komunitetet ortodokse për të rimenduar pozicionin e tyre në

kushtet e vetëdijes kombëtare, statusit socialekonimik dhe identitetit fetar. Në këto kushte këto komunitete filluan të kujdesen për çështje të tilla si edukimi dhe feja.

Në kushtet kur ndikimi i Patrikanës Ekumenike të Kostandinopojës ishte mjaft i fortë dhe rrjeti i shkollave greke shumë i përhapur, identiteti i tyre kulturor dhe kombëtar u rrezikua ndjeshëm. Sigurisht, gjuha greke për këto komunitete ishte një *lingua franca*, me status ekonomik dhe tregtar. Pra në këtë kuadër u përfshi edhe Mitkoja në diskutimet dhe shkrimet me natyrë kombëtare, në mbrojtje të kulturës dhe viseve të origjinës së tij. Por kjo lëvizje kishte pengesa në vetvete, sepse duhej përhapur gjuha shqipe, por me shkronja latine apo greke, ajo e humbte një pjesë të rëndësisë së vet si shenjë kombëtare, shumë prej atdhetarëve kishin qëndrime dhe pikëpamje të ndryshme për aleancat dhe dobinë e tyre, pjesa më e madhe e atdhetarëve të Jugut u edukuan në Greqi, pikërisht në Zosimea Skoli të Janinës dhe agjenda kombëtare e tyre u ndikua nga mjetet në dispozicion dhe gjykimet e tyre. Është e vetëkuptueshme, sipas nesh, pse nisi një përpjekje e madhe për të ndërtuar origjinën pellazgjike-iliro-shqiptare nga pikëpamja historike dhe kulturore, mendojmë për të tërhequr, më së pari dhe para së gjithash, ndihmën greke përmes ftesës për të pranuar se pellazgët dhe helenët janë të parët në viset ku jetojnë si autoktonë dhe të tjerët nuk e kanë këtë status.

Të bindur se ballafaqimi ushtarak ishte i pabarabartë, për më tepër, komunitetet ishin të ndarë nga shumë dallime, intelektualët shqiptarë të Rilindjes Kombëtare veçuan gjuhën si faktor identitar për bashkimin kombëtar të shqiptarëve. Një cilësi të tillë të lëvizjes kombëtare shqiptare e ka evidentuar edhe E. Hobsbaum, duke u mbështetur edhe në burime të tjera, që shkruan se [I] tillë është me sa duket edhe rasti i shqiptarëve, të cilët kanë jetuar qysh nga lashtësia klasike nën ndikime kulturore rivale dhe që ndahen në tre fe rivale, në fenë islamike, në atë ortodokse dhe në atë katolike(ose madje në katër fe, po të shtojmë edhe kultin lokal mysliman të bektashinjëve). Ishte e natyrshme që themeluesit e nacionalizmit shqiptar ta kërkonin identitetin kulturor shqiptar tek gjuha, përderisa feja dhe përnjëmend pothuajse gjithçka tjetër në Shqipëri, ishte faktor ndarës më shumë se unifikues[945]

Kështu që pas përplasjeve të mëdha, padrejtësive politike të mëdha, pamundësisë për të krijuar njësinë identitare kombëtare kulturore, atdhetarët shqiptarë iu drejtuan një punë të mundimshme, të vështirë e me shume rreziqe dhe të kushtueshme, siç ishte përhapja e gjuhës shqipe dhe krijimi i mitit të kombit përmes saj, para së gjithash e cila përsëri kurorëzohet me një ngjarje politike, shumë vonë në fakt, por gjithsesi prapë shumë e rëndësishme, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, ngritja e Flamurit në Vlorë në 28 nëntor 1912..

[945] Hobsbaum, J.E. 1996. Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780-ta. Toena & Fondacioni Soros, Tiranë, 40.

4. Variacione të pamjes së lëvizjes atdhetare shqipare dhe roli i Efthim Mitkos

Pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, lëvizja kombëtare merr natyrë mjaft të spikatur kulturore, bile në traktatin e vet, S. Frashëri i jep aq forcë idealizmi, sa të përfytyrojë hapjen e një Universiteti shqiptar, gjë që ishte realisht e pamundur në një vend ku nuk lejoheshin shkronjat dhe shkrimi shqip.

E. Gellneri në studimet e veta ka nënvizuar se përfshirja e një populli në një kulturë me përmasa të gjera, veçanërisht në një kulturë letrare, ..., u mundëson vërtet grupeve etnike të fitojnë cilësira që më vonë do t'i ndihmojnë për t'u shndërruar në kombe dhe për t'u strukturuar si të tillë.[946]

Brenda kornizave që krijoi lëvizja atdhetare shqiptare duke u fokusuar te çështjet kulturore, e gjetën veten atdhetarët shqiptarë, intelektualë dhe luftëtarë për të punuar për kombin dhe identetin kombëtar, po kështu edhe E. Mitkoja.

Efthim Mitkoja ka lindur në Korçë dhe ka pasur ato peripeci që merrte përgjithësisht jeta e emigrantëve shqiptarë në dhè të huaj. Pas përvojave të ndryshme në disa vende evropiane apo balkanike, ai vendoset në Egjipt, ku në gjysmën e dytë të shekullit XIX ka pasur një komunitet të konsiderueshëm shqiptarësh, brenda të cilit E. Mitkoja zhvilloi një veprimtari të gjerë në mbështetje të çështjes shqiptare.

Përsa i përket veprimtarisë së Mitkos në Greqi, ndër shumë libra, broshura dhe gazeta të shek.XVIII-XX që gjenden në arkivat greke, ka edhe materialet që lidhen me aktivitetin e Ethim Mitkos.

Gazeta greke "Pandora" (pretendohet që ka qenë revistë jo gazetë) u themelua më 12 dhjetor 1849 dhe doli në qarkullim në prill të 1850, dy herë në muaj. Kjo revistë u botua deri në vitin 1872 dhe përgatitej nga Nikolao Dragumi (arvanitas), Kostandin Paparigopulo, Aleksandro Riyo Ragapi, Kristo A. Duka. Në faqet e revistës "Pandora" Thimi Mitkoja ka dhënë një kontribut të madh duke botuar shkrimet e veta për të vërtetën e Korçës dhe Maqedonisë së atëhershme. Një nga shkrimet më të rëndësishme ka qënë polemika e Thimi Mitkos me historianin grek Panajot Aravantinoi. Nuk u botua asnjëherë e plotë për arsye të ndryshme, por pjesa më e madhe e pa dritën e botimit për të sqaruar më mirë lexuesin greke të atyre viteve që ushqehej me keqinformime për fqinjët e tyre që ende ishin nën pushtimin osman. Titulli i shkrimit të Mitkos është "Shënime mbi Maqedoninë dhe Korçën". Një pjesë e kësaj polemike është botuar në veprën e Thimi Mitkos "Bleta Shqiptare", 1981, Tiranë. Këto shkrime janë botuar në veprën e Mitkos, por pa asnjë shënim mbi revistën Pandora apo edhe paraqitje të faksimileve që dëshmojnë për të.

Interesant është fakti se shkrimet e Thimi Mitkos për Korçën u botuan dy në vitin 1859 dhe dy, pas 8 viteve, më 1867. Mendohet që në stafin e revistës greke "Pandora" për botimet e shkrimeve të Mitkos duhet të ketë ndikuar ndonjë nga punonjësit e brendshëm, sepse shkrimet janë botuar me emrin anonim "Një nga

[946] Gellner, E.1983. Nation and Nationalism. N. Y. Cornell University Press, 49.

pajtimtarët". Në ato vite ka qenë e vështirë për të mbrojtur çështjen shqiptare në shtypin grek për arsye se sapo ishte hedhur projekti për realizimin e Greqisë së Madhe më 1850. Në programin e Idesë së Madhe mbretëria e Greqisë kishte synimin të përfshinte brenda saj të gjithë ortodoksët e Ballkanit dhe të Azisë së Vogël ashtu si pretendimet territoriale i shtrinte deri në Lumin Shkumbin. Një pjesë e këtij projekti u realizuan në vitet 1912-1914 me marrjen e qyteteve të Artës, Janinës, Prevezës dhe Konicës.

Përveç veprimtarisë së dendur të ditës në mbrojtje të çështjes kombëtare, ne duam të vëmë në dukje dhe rolin e veçantë, rëndësinë që ka vepra *Bleta Shqiptare* e E. Mitkos. Ajo u krijua pikërisht në frymën e Rilindjes Kombëtare në një periudhë shumë të rëndësishme të saj, kur veprat letrare ndërtonin vazhdimësinë e projektit kombëtar, frymën e përbashkët nga krijimi i përfytyrimeve se kështu ka qenë dhe kështu do të jetë Shqipëria dhe shqiptarët, një ekzistencë e paprerë e përbashkët. Bleta shqiptare ishte njëlloj minienciklopedie e kulturës popullore, sillte strukturat historike të përbashkëta të kulturës së jugut, doket, zakonet, këngët, vjershat e jugut. Mitko për të krijuar këtë minienciklopedi u konsultua me më të shquarit e kohës: De Radën, Dh. Kamardën, D. D'Istria, K. Kristoforidhi, G. Mayer, J.U. Jarnik.

Efthim Mitko bën pjesë tek ajo pjesë e intelektualëve shqiptarë të besimit ortodoks, që mendonin se lëvizja kombëtare duhet të çonte në forcimin e kulturës kombëtare përmes gjuhës që duhej të bëhej pjese e administratës, edukimit dhe jetës ekonomike, por do të ruante varësinë e Shqipërisë nën Perandorinë Osmane, sidomos në fazën e parë të kësaj lëvizjeje. Kjo lëvizje do të çonte drejt zhvillimeve të shkallëshkallshme politike, në fazën e parë autonomi dhe më pas pavarësia e plotë, ashtu si do të krijonte elitat e reja, burokracinë dhe institucionet. Kështu shkallë-shkallë e konceptoi dhe pothuajse në këtë mënyrë u realizua shteti, kombi, çështja kombëtare shqiptare.

Ne sot vetëm duke kujtuar veprën e shqiptarëve të shquar atdhetarë të së kaluarës, mundemi vetëm t'i shqyrtojmë gjërat, veprat janë kryer dhe kanë krijuar rrjedhoja, e kaluara është një muze real, e po aq virtual, që mund të marrë pamjen e bibliotekës shkencore, nëse gjeneratat e sotme flasin me respekt për të kaluarën dhe mësojnë nga pamjaftueshmëritë e organizmit atdhetar të së kaluarës për të mos përsëritur gabimet e së kaluarës, ashtu si mund dhe duhet të hedhin më shumë dritë mbi ngjarjet në mënyrë më shkencore dhe ta bëjnë më të qartë atë që ka ndodhur, ashtu si ka ndodhur.

KUJTIM BEVAPI (ELBASAN)

THIMI MITKOJA DHE KONSTANDIN KRISTOFORIDHI

Sa herë që do të përkujtojmë figura si Th. Mitkoja dhe K. Krisfoforidhi, në radhë të parë ne përkujtojmë veprën që lanë pas këta rilindës, sepse Rilindja ishte një tufë idesh, ishte projekti dhe veprimataria e tyre konkrete, në shërbim të kombëtarizimit. Për rrjedhojë, në këtë vepër, ata kanë shumë gjëra të përbashkëta, nëse i pranëvëmë me njëri–tjetrin. Ndërkohë, kalimi i dhjetëvjeçarëve na krijon një ndjesi tjetër për t'i parë këto vepra jo të distancuara në kohë, por gjithnjë e më të afërta në këtë hapësirë.

Në këndvështrimin e sotëm, për hartimin e tyre u deshën shumë vite kërkimi. Ato u përballën me vështirësi e ndërlikime të shumta dhe kjo, është një arsye më shume që ne të ndiejmë adhurim për këto figura, për veprën e tyre, që mbi një shekull më parë, jo vetëm patën guximin t'i përvisheshin të vetëm një detyre të tillë, por e ndoqën atë me përkushtim për shumë vite. Këta dy rilindës punuan dhe luftuan ashtu si rilindësit e tjerë, për ta bërë vepruese ndërgjegjen kombëtare dhe për t'i ngritur të gjithë rreth flamurit të lirisë e pavarësisë.

Puna madhore e Th.Mitkos është "Bleta shqiptare", ndërsa e K. Kristoforidhit "Fjalori i gjuhës shqipe". këta dy rilindës kanë patur dhe një letërkëmbim jo të paktë midis tyre, ndonëse për ne deri më sot është e njohur vetem një letër, që Mitkoja i dërgonte Kristoforidhit më 25 mars 1872 nga Kajroja[947]. Letërkëmbimi i Mitkos me Kristoforidhin fiton një vlerë të dorës së parë, sepse si gjëja më e rëndësishme e saj, spikat prania e një programi pune, për të cilin ata luftojnë së bashku për ta vënë në jetë, pavarësisht nga pengesat si dhe mjetet e rrugët e shumta, që u detyruan të kërkonin për të ecur përpara.

E gjithë veprimtaria e Mitkos përmblidhet në veprimtari patriotike, folklorike, publicistike, gjuhësore e letrare dhe, si e tillë, ajo do të zgjerohet gjithnjë e më shumë në lidhjet e tij me aktivistë të çështjes kombëtare, që veprojnë në atdhe, kolonitë shqiptare të Stambollit, Bukureshtit, Misirit, si dhe veçanërisht me K. Kristoforidhin. K. Kristoforidhi e nisi veprimtarinë me gjuhën dhe e mbylli me të, sepse shqipja dhe Shqipëria ishin për atë të pandara. Ai mbetet një gjuhëtar i madh në historinë tonë kombëtare.

Nuk është e rastit për përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike të Londrës, Aleksandër Thomosn, me lidhje të gjata pune me Kristoforidhin do të shkruajë për Mitkon në një letër dërguar eprorëve të tij se: "*Z. Mitko mban një korrespondencë të gjërë me studiues e botues të tjerë shqiptare dhe për mendimin tim është një nga letrarët*

[947]Letër e Z. E.Mitko për Z. K. Kristoforidhin – 25 MARS 1872. Dok 82. Në: Xh. Lloshi – *Kristoforidhi përmes dokumentimit. Tiranë*, 2005 f. 302-304.

profesionistë më kompetentë për të dhënë një mendim mbi cilësitë letrare të punëve të Z. Kristoforidhi…..”[948].

Ndërkohë Kristoforidhi e ndiente nevojën t'i ndante me dikë tjetër planet e tij. I shkruan disa letra Thimi Mitkos në Egjiptin e largët. I dërgon disa kopje të psallmeve toskërisht dhe abetareve të botuara[949]. Kontaktet e Mitkos me albanologët e njohur si G. Majer, J.U.Jarnik, Dh. Kamarda etj., e rritën më shumë personalitetin e tij dhe në këto kushte, çështja themelore ndaj së cilës drejton vëmendjen autori, mbetet lufta për bashkimin e vetëdijshëm kombëtar, për forcimin e ndërgjegjes kombëtare. Materializimi i këtyre ideve u realizua me "Bletën shqiptare", e cila jep kuadrin e përgjithshëm më të gjerë e më të plotë të kohës, për pasuritë e folklorit shqiptar, që i kapërceu të gjitha botimet folklorike të deriatëhershme.

Por duhet të theksojmë se si Th. Mitkoja ashtu edhe K. Kristoforidhi, punuan kryesisht në periudhën kur Rilindja ende nuk kishte marrë format e organizuara. Ndaj, dhe Mitkoja, i shkruante me çiltërsi Kristoforidhit më 1872: *"Ju jeni një i ri e keni kohë për t'i sjellë të mira kombit fatkeq shqiptar". I kam parë me kujdes të gjitha letrat dhe duke ju lëvduar për zellin tuaj për atdheun, i përshëndes idetë e drejta…por pa një shoqëri ose një klub që të mbështesë punën tuaj dhe të përhapë idetë tuaja në të gjithë cepat e Shqipërisë, unë kam frikë mos qoftë kështu, se qëllimi juaj me të vërtetë i shenjtë, nuk do t'ia dalë mbanë*[950]*".*

Letra e Mitkos për Kristoforidhin është një diskutim për format organizative të veprimtarisë, që përfshinin botimin e një gazete, ngritjen e një shoqërie, aktivizimin e sa më shumë vetëve nga anë të ndryshme të Shqipërisë e jashtë saj, botimin e veprave gjuhësore e të folklorit etj.

Por shenja më e parë e kombësisë dhe bartësja më e qëndrueshme e tyre është gjuha dhe pikërisht, tek kjo vlerë i përqëndruan dijet, energjitë dhe përpjekjet e palodhura Mitkoja e Kristoforidhi. *"I përshëndes idetë e drejta-* vijon letra e Mitkos *– të mbështetura mirë dhe mjaft praktike, nga të cilat jeni i frymëzuar lidhur me qytetërimin natyral e rrënjësor të Shqipërisë, mund të bëhet vetëm e vetëm nëpërmjet gjuhës amtare"*[951]*.*

Ndaj ai e përqëndron vëmendjen që në fillimet e veprimtarisë tek gjuha, duke e konsideruar lëvrimin e gjuhës amtare si një nga detyrat më të ngutshme të lëvizjes së çlirimit kombëtar.

Fjalori i "Bletës", materialet që përmban, shënimet etimologjike, shpjegimet e kuptimit të fjalëve, vërejtjet e ndryshme gjuhësore, përfaqësojnë një punë filologjike me interes, pavarësisht nga përgatitja e tij në këtë lëmë. Mitkoja tregoi qoftë edhe tërëthorazai se gjuha e vërtetë e popullit shqiptar jetonte në trashëgiminë e pasur të

[948] Pjesë nga letra shoqëruese e A. Thomsonit për S.B.Bergne, Stamboll 13 maj 1872 në: Xh. Lloshi – *Kristoforidhi përmes dokumentimit,* Tiranë, 2005, f.304.
[949] Letër e TH. Mitkos për Dh. Kamardën 22 dhjetor 1871. Dok.78. Në: Xh. Lloshi- *Kristoforidhi përmes dokumentimit*. Tiranë 2005, f.299
[950] Letër e Z. E. Mitko për Z. K. Kristoforidhin. 25 mars 1872 artk. cituar.
[951] Letër e Z. E. *Mitko për Z. K. Kristoforidhin*. 25 mars 1872 artk. cituar.

letërsisë popullore, e cila duhej vënë në bazë të gjuhës së njësuar[952]. Me këto ide është mbledhur lënda e fjalorit të K. Kristoforidhit, për të cilin Mitkoja shton: "Lutem nga zemra që të keni mundësinë ta botoni sa më parë të jetë e mundur fjalorin e gjuhës shqipe dhe gramatikën, në mënyrë që gjuha jonë të dalë në dritë përpara se të humbasë[953].

Të dy këta veprimtarë, nuk kishin dyshim në mundësinë dhe pasurinë e shqipes, të një shqipeje që, nuk kishte nevojën e fjalëve të huaja, për të përballuar gjithë kërkesat që i dilnin si gjuhë e lëvruar. Por kjo kërkonte një luftë sistematike për hapjen e shkollës dhe të shkrimit të gjuhës amtare. Çështja e shkollës dhe shkrimit të shqipes, ngrinte një tjetër problem të rëndësishëm, i cili vijoi gjatë me rrahje mendimesh, debatesh dhe organizim të disa takimeve midis patriotëve të Rilindjes për çështjen e alfabetit. Por Mitkoja dhe Kristoforidhi kishin mendimin e përbashkët për ta shkruar gjuhën amtare pavarësisht problemit të alfabetit. Siç do të kujtojë një bashkëkohës i Kristoforidhit : *"Për mua tashti pak rëndësi kanë shkronjat, shenjat dhe alfabeti. Unë dua dhe kam dëshirë të madhe që gjuha ime të shkruhet në çfarëdo mënyre, mjaft që të shkruhet. Admirojmë mrekullinë që e shohim atë të ketë mbijetuar për kaq shekuj dhe e kemi trashëguar ne stërnipër të vonë të stërgjyshërve të famshëm, porse tashti është urgjente ta shkruajmë, ta shkruajmë, të tjerat vijnë pastaj".*[954]

Arsimimin në gjuhën amtare këta rilindës e shihnin si mjetin për të arritur atë që Kristoforidhi e quante "qytetërimi natyror e rrënjësor i Shqipërisë". Duke e lidhur këtë me interesin e tyre për historinë, arkeologjinë, për letërsinë, për folklorin zakonet, për autorët e vjetër shqiptarë, gjejmë tek Mitkoja dhe Kristoforidhi një pamje më të plotë për kulturën kombëtare në tërësi. Kjo kulturë ishte mjet për të siguruar bashkimin kombëtar e përparimin. Ky ishte koncepti i përbashkët i ndriçimtarëve tanë rilindës, për të cilët zhvillimi e përhapja e kulturës kombëtare ishte një armë për zgjimin e ndërgjegjes së popullit shqiptar në luftën për pavarësi.

Ngjarjet e historisë janë si një atmosferë që i shikon të gjitha së bashku. Kështu ishte dhe Rilindja Kombëtare për Thimi Mitkon e K. Kristoforidhin, por formimi vetjak i çdo figure i jep vulën e veçantë të ndihmesës në një ose disa fusha. Që të dy së bashku u morën me punë të mëdha, të cilat kërkojnë një forcë që t'i shtyjë përpara, për vite e vite me radhë. Dhe kjo nuk mund të jetë një dëshirë e momentit, por një ide e madhe.

"Bleta Shqiptare", qe një ngrehinë e kulturës sonë, dëshmi e qartë e ekzistencës së shqiptarëve si komb, për qëllimet e larta të të cilit, tek Mitkoja, u shkrinë në një të vetme publicisti, etnologu, poeti e gjuhëtari. Ndërsa "Fjalori i gjuhës shqipe", i Kristoforidhit qe një detyre madhore që ai i vuri vetes për ta ngritur shqipen krahas

[952] Thimi Mitko, *Vepra. Akademia e Shkencave*. Instituti i Kulturës Popullore Tiranë 1981, f. 51
[953] Letër e Z. E. *Mitko për Z. K. Kristoforidhin*… art. cit.
[954] La Nazione Albanese, 31 janar 1897, f.7

gjuhëve të tjera të përpunuara dhe nëpërmjet saj t'i ngrinte edhe shqiptarët krahas popujve të tjerë të qytetëruar e të pavarur.

Për këta dy veprimtarë të palodhur të çështjes kombëtare, kjo ishte një barrë tepër e madhe për shpatullat e dy njerëzve të vetëm, në ato rrethana të vështira. Për këtë veprimtari nevojitej një radhë e madhe luftëtarësh të penës. Porse, me veprimtarinë e tyre, ata i siguruan vetes një vend nderi në këtë plejadë të fuqishme, që mban emrin Rilindje Kombëtare.

Ajo që ka mbetur nga veprimtaria e tyre është vetëm një pjesë e programit të gjerë, që ata i kishin caktuar vetes dhe që nuk patën mundësinë ta vinin plotësisht në jetë, ndonëse për të luftuan pa u stepur para vështirësive të shumta, prandaj ato mbeten figura të mëdha në historinë tonë, por edhe shqiptarë të mëdhenj në vetëdijen e kombit.

LABINOT BERISHA (GJAKOVË)

SA E ÇMOI DHE SI E NDIHMOI THIMI MITKOJA BOTIMIN E "FIAMURIT TË ARBËRIT" (1883 – 1887) TË DE RADËS

"Dëshirimi im është të mbahet' mirë e fort 'Flamuri', që na bën nderë ndër Evropë".
Thimi Mitko
(Letër De Radës, 12 dhjetor 1885)

Thimi Mitkoja (1820 – 1890), mbledhës dhe botues i vëllimit të famshëm me materiale të letërsisë gojore "Bleta shqiptare", botuar më 1878 në Aleksandri të Egjiptit[955], është ndër veprimtarët e shquar të Rilindjes sonë Kombëtare që pati një letërkëmbim dhe një bashkëpunim të rëndësishëm me disa nga intelektualët e kohës, midis tyre dhe me intelektualët dhe shkrimtarët e arbëreshëve të Italisë, në mënyrë të veçantë me Dhimitër Kamardën nga Hora e Arbëreshëve të Siçilisë dhe me Jeronim de Radën nga Maqi Arbëresh i Kalabrisë. Një studim i mirëfilltë i këtij letërkëmbimi dhe bashkëpunimi do të hidhte dritë rreth disa dukurive të rëndësishme të asaj kohe në botën shqiptare dhe në botën e arbëreshëve të Italisë.

Në këtë kumtesë do të ndalemi rreth mendimeve – vlerësimeve të Thimi Mitkos për revistën "Fiamuri i Arbërit". La Bandiera dell'Albania[956], themeluar e botuar nga De Rada gjatë viteve 1883 – 1887 dhe rreth mënyrës së nxitjes të botimin dhe të shpërndarjes së revistës në trojet shqiptare dhe tek shqiptarët që jetonin në vende të ndryshme të botës, në mënyrë të veçantë në Egjipt, Rumani dhe Turqi. Krahas kësaj do të flasim dhe për bashkëpunimin e Mitkos me këtë revistë.

Mendimet dhe të dhënat për temën i morëm kryesisht nga letrat e Thimi Mitkos dërguar vetë De Radës, letërkëmbim që zgjati rreth 10 vjet[957], dhe nga revista "Fiamuri i Arbërit" ribotuar më 2005[958].

Sipas të dhënave që janë të njohura, letërkëmbimi dhe bashkëpunimi i Thimi Mitkos me arbëreshët e Italisë filloi nga viti 1868, çka dëshmohet nga letra e tij e 1 janarit të të njëjtit vit[959], nisur intelektualit të shquar, Dhimitër Kamardës nga Hora e

[955] Thimi Mitko, *Bleta Shqipëtare*. Aleksandri, 1878. Shih botimin e dytë *Bleta Shqypëtare e Thimi Mitkos*. E përshkroj me shkronja shqype, e përktheu shqyp dhe e radhiti Dr. Gjergj Pekmezi. Konsull i Shqypërisë. Vjen-ë 1924.
[956] "Fiamuri i Arbërit". La Bandiera dell'Albania. Pubblicazione periodica mensile. Per cura d'un comitato di signori d'Albania e delle colonie. Anno 1. S. Demetrio Corone, 2 Gennaio 1883. Num. 1.
[957] Shih vëllimin Thimi Mitko, *Vepra.* Përgatitur nga Qemal Haxhihasan. Instituti i kulturës popullore. Sektori i prozës dhe i poezisë. Tiranë 1981, f. 617 - 715.
[958] Girolamo De Rada, *Opera Omnia. XI.* Opere filologiche e storico-culturali. Fjamuri i Arbërit (1883 – 1887). Introduzione di Matte Mandalà. Rubbettino. Soveria Mannelli. Catanzaro 2005.
[959] Thimi Mitko, *Vepra.* Përgatitur nga Q. Haxhihasani, vep. e përm., f. 610.

Arbëreshëve në Siçili, domethënë rreth dy vjet pas botimit të vëllimit "Shtojcë e vështrimit krahasues gramatologjik të gjuhës shqipe." (*Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese* 1866), ku arbëreshi kishte botuar një varg materialesh të letërsisë gojore të arbëreshëve të Italisë dhe disa të Greqisë[960]. Pikërisht në këtë letër Thimi Mitkoja shtron nevojën që tek arbëreshët të fillonte të botohej një organ periodik, meqenëse në vendin amë, në Shqipëri, as në diasporën tjetër, ku jetonin shqiptarët, nuk ekzistonin kushte për një veprimtari të tillë[961].

Sipas gjasash, letërkëmbimi me Kamardën dhe me princeshën rumune me origjinë
shqiptare, Dora d'Istria, kushtëzoi dhe njohjen e Mitkos me Jeronim De Radën, me të cilin, jo vetëm këmbeu rreth 65 letra që njihen deri më sot, po bashkëpunoi për disa vjet edhe me revistën "Fiamuri i Arbërit".

Letërkëmbimi me De Radën duhet të ketë filluar para botimit të "Bletës shqiptare"[962]. Sipas një
letre, që mendohet se është e Mitkos, letërkëmbimi midis tyre nis në vitin 1872, domethënë disa
vjet pas letërkëmbimit me Kamardën.

Nga letra e Mitkos e datës 13 janar 1879, mësojmë se ai i shkruan De Radës me vonesë për shkak të sëmundjes së syve "Vërtet letrën time të datës 17/29 të muajit dhe vitit të kaluar e vonova...", pra në vitin 1878 kur Mitkoja botoi në Aleksandri "Bletën shqiptare".

Arsyet pse Mitkoja pati një letërkëmbim të dendur me De Radën dhe pse bashkëpunoi me revistën "Fiamuri i Arbërit", janë të ndryshme. Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat politike dhe kulturore të botës shqiptare nën sundimin otoman, do të ketë mbipeshuar ajo që theksonte Qemal Haxhihasani: "Te De Rada, Mitkoja pa një personalitet të madh kulturor e politik, një patriot që kish vënë gjithë mendjen, zemrën e talentin e tij në shërbim të idealeve çlirimtare të mëmëdheut të *zbjerrë*[963]". Në një letër të mëvonshme edhe vetë Mitkoja e shpreh qëllimin konkret të botimit të një reviste tek arbëreshët e Italisë: "Dëshirimi im është të mbahet' mirë e fort 'Flamuri', që na bën nderë ndër Evropë, po besonj se, pasi të përkëmbet Sillogu (shoqëria) e Bukureshtit, do të ketë ndihmë edhe 'Flamuri'[964]."

Pra, një intelektual arbëresh i nivelit të lartë, një shkrimtar i orës së parë i dëshmuar me veprat "Këngët e Milosaos", "Këngët e Serafina Topisë", "Skanderbeu i pafán", "Katër histori të Shqipërisë", pastaj mbledhës dhe botues i njërës prej

[960] Shih Demetrio Camarda, *Appendice al Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Prato 1866 dhe Demetrio Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Ristampa anastatica, Polermo 1989.
[961] Shih letrën e tij nr. 4. në Thimi Mitko, *Vepra.* Përgatitur nga Q. Haxhihasani, vep. e përm., f. 610.
[962] Thimi Mitko, *Vepra*, vep. e përm., f. 36.
[963] Qemal Haxhihasani, *Hyrje*. Në Thimi Mitko, Vepra, vep. e përm., f. 36.
[964] Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 677.

përmbledhjetve më të njohura deri në atë kohë "Rapsodi të një poeme shqiptare[965]" (1866) me materiale të arbëreshëve të Kalabrisë, autor i studimit "Parime të estetikës" (1861), themelues i gazetës së parë në gjuhën arbërishte "L'Albanese d'Italia" (Shqiptari i Italisë (1847) etj., ishte një figurë e rëndësishme që të këmbente me të mendime të ndryshme rreth fatit të atdheut të tyre të përbashkët, Shqipërisë, po dhe të ndërmerrnin veprime konkrete për t'i ndihmuar përpjekjet për t'u liruar nga sundimi otoman[966]. Po ashtu me De Radën, Mitkoja mund të trajtonte edhe çështje të kulturës, të gjuhës, të arsimit në gjuhën shqipe, këmbimin e librave, themelimin dhe botimin e ndonjë organi – reviste, ku do të nxiteshin e do të shqyrtoheshin dukuri të rëndësishme të botës aktuale shqiptare, arbëreshe dhe të gjithë shqiptarëve të diasporave të tjera. Mitko mendonte se, siç pohonte dhe princesha rumune me origjinë shqiptare, Dora d'Istria, "Drita për të ndritur Shqipërinë duhet të niset e të dalë ngaha Italia[967]".

Letrat e Mitkos dërguar De Radës bëhen më të shpeshta mbas botimit të "Bletës shqiptare" (1878) e sidomos para dhe gjatë botimit të revistës "Fiamuri i Arbërit" – 1883 - 1887, kur dhe fillon bashkëpunimi konkret midis këtyre dy personaliteteve të rëndësishme të botës sonë.

Çështjen e botimit në shqip të një gazete – reviste, tek arbëreshët e Italisë, ku do të rraheshin dukuri aktuale të botës shqiptare, të lashtësisë, të kulturës, të gjuhës e të traditës së pasur të tyre, Mitkoja ia kishte shtruar Dhimitër Kamardës nga Hora e Arbëreshëve e Siçilisë në letrën e 9 janarit të vitit 1868 – "[...] do të ishte një punë e mirë, edhe e vëleshime për shqiptarët, ndë munt të jepeshe ka Italia një gazetë vetëm shqip[968]".

Meqenëse Kamarda nuk ia kishte dalë ta përmbushte këtë punë, Mitkoja e aktualizon atë dhe në letërkëmbimin me De Radën nga Maqi i Kalabrisë. Në të vërtetë, në një letër të De Radës dërguar Mitkos, shkrimtari i madh i bënte të ditur atdhetarit të vet Mitko, për përpjekjet e tij që të siguronte një shtypshkronjë për fillimin e botimit të një reviste, po dhe të librave të tjerë në gjuhën arbëreshe. Për këtë ndërmarrje të rëndësishme Mitkoja i përgjigjet De Radës më 17 qershor 1881. Idenë për të ngrehur një shtypshkronjë Mitkoja e kishte pasur edhe vetë, po nuk ia kishte dalë ta përmbushte: "Idhea jote për të ngrehur një typografi arbëreshe në Itali

[965] *Rapsodie d'un poema Albanese*. Raccolte nelle colonie del Napoletano, tradotte da Girolamo De Rada, e per cura di lui e di Niccoló Jeno de Coronei, Firenze 1866; Shih dhe Jeronim De Rada: Vepra 5. *Rapsodi të një poeme shqiptare*, mbledhur në kolonitë e rrethit të Napolit. Transliteruar dhe përgatitur për shtyp nga Anton Çetta dhe Anton Berisha, Rilindja, Prishtinë 1983.

[966] Për gjendjen e vështirë të shqiptarëve nën sundimin otoman dhe nevojën që ata të lirohen dhe të kenë pavarësinë, ta kenë shtetin e tyre dhe gjuhën, Mitko i shkruan (më 21 qershor 1879) arbëreshit Françesko Krispit (1818 – 1901), i cili aso kohe ishte kryeministër i Italisë (1887 – 1891 dhe 1893 – 1896): "Është koha që shqiptarët të kenë gjuhë dhe kombësi" dhe se "Megjithatë, do të më lejoni të ju kujtoj se është nevojë absolute që Shqipëria të fitojë sot gjuhën dhe kombësinë dhe të sigurojë kufinjtë e natyrshëm të Atdheut të saj". Shih Thimi Mitko, *Vepra,* vep. e përm., f. 632.

[967] Thimi Mitko, po aty, f. 651.

[968] Thimi Mitko, po aty, f. 610.

do të jetë një pun'e një shërbesë fort e bukur për vendërinë (atdheun) tënë (për la nostra partia). Këtë idhe e kam patur' unë qëmoti, po nuk munda t'e kryenj[969]".

Një muaj më vonë, më 18 korrik 1881, Mitkoja i shkruan De Radës: "Fort jam gëzuarë tek më shkruan se puna e tipografisë do të vejë mbarë; sivjet do të bënjëm gati, pa motin që vjen të zihet puna[970]".

Rreth rëndësisë së botimit të një reviste tek arbëreshët, Mitkoja i shkruan De Radës edhe në qershorin e vitit 1882 ku i sugjeron që revista të botohet edhe në ndonjë gjuhë tjetër, italisht ose frëngjisht, në mënyrë që çështja shqiptare të bëhet e njohur në qarqe evropiane: "Do të jetë një pun' e mirë të hapni typografinë e të dalë një ditare mbi gjuhë tënë; po të jetë me shkresat (lettere) e Samiut, mbase s'ju mundet (forse non vi é possibile). Ama pa fjalë duhet të jet' edhe mbi gjuhë ja frëngjisht, ja italisht – jo vetëm shqyp. Kështu kupëtohet mirë[971]".

Natyrisht, Mitkoja nuk i shpreh De Radës vetëm gëzimin e madh për nismën e nxjerrjes në dritë të një reviste, po i premton se do të bëjë gjithçka që është brenda mundësive të tij që ta ndihmojë në këtë ndërmarrje për shumëçka të rëndësishme: "Edhe unë po të jap zë (notizie) të mirë se nja dy fshatarë që u shkruajta për ndihmë, m'u përgjegjen se janë gati të na ndihnjën e ashtu shpërenj se edhe për (anticipata) do kemi ndihmë edhe pasandaj për ditaren do gjenjëm 50 – 100 prisa (abonati). Kjo punë duhet bërë 'sa më çpejt, më mirë'. Ndë vënt tonë thonë 'hekuri rrihet i nxehtë' il ferro si batta caldo[972]".

Pra, përkundër vështirësive me të cilat do të përballet, Mitkoja, i premton De Radës ndihmë për botimin e revistës "Fiamuri i Arbërit" si të ishte ajo revistë e tij. Do ta ndihmonin sidomos shqiptarët që jetonin në Egjipt, ku jetonte edhe Mitkoja: "Po unë do përpiqem si për veten time e do kërkonj një ndihmë ndërpër shqypëtarët e Egjyptit".

Edhe në letrën e datës 18 mars 1883, Mitkoja i shkruan De Radës për punën që bënte për të siguruar pajtimtarë (parapagues) të revistës ndër shqiptarët e Misirit: "Sotir Koka (Sotiri Cocca) rri në Zagazig edh' është i begatë mjaft, por fort dorështërnguar (streto). Nukë kam të madhe besë (besim) t'i ndihmojë tipografisë, po mundet të bënjë dobare (al meno) disa ndihmëtarë (abunati) për ditaren...[973]".

Me të marrë numrin e dytë të revistës "Fiamuri i Arbërit" më 10 nëntor 1883, Mitkoja i shkruan vëllait të tij arbëresh, siç e quan ai De Radën: "Se politika e Flamburit na pëlqen[974]" (Letra e datës 3 korrik 1886) ose "Përse politika e Flamburit na pëlqen[975]" (Letra e 20 shkurtit 1687) dhe për punën që do të bëjë në grumbullimin e të hollave nga pajtimtarët dhe kërkon se ku t'i dërgonte të hollat në

[969] Thimi Mitko, po aty, f. 650.
[970] Thimi Mitko, Po aty, f. 652.
[971] Thimi Mitko, po aty, f. 657.
[972] Thimi Mitko, po, aty, f. 652.
[973] Thimi Mitko, po aty, f. 661.
[974] Thimi Mitko, po aty, f. 685.
[975] Thimi Mitko, po aty, f. 691.

Romë: “Dje muarëm edhe të dytën fletë (numër) të ‘Flamburit t’Arbërit’. Pasi të marrënjëm edhe të tretën, do të nis të mbledh të hollat. Po shkruajmë te cili të t’i dërgonj (të hollat) ndë Romë (a chi devo rimentervi a Roma)[976]”. Në të njëjtën letër Mitkoja ia dërgon De Radës dhe adresat e pajtimtarëve të rinj në Aleksandri ose gjetiu: “Dërgo flet’ edhe te këta ndihmëtarë të rinj siç të shënonj poshtë[977]”, ndërsa në letrën e 16 tetorit 1884: “Të shkruajta javën e parë e të thashë të dërgojsh edhe ndër Magaga (alto Egitto) 4 fletë (numra të revistës)[978]”.

Mitko është i bindur se revista “Fiamuri i Arbërit” do të shkatojë kënaqësi ndër shqiptarët që do ta marrin atë, në mënyrë që: “t’u ngrohet zemra capak[979]”, prandaj kërkon prej De Radës që “Dërgo dica fletë (numra të revistës) Bukuresh[980]”.

Mitkoja nuk interesohej vetëm që “Fiamuri i Arbërit” të shpërndahet ndër shqiptarët e Egjiptit,
po edhe në Turqi, në Rumani, në Shqipëri dhe në vende të tjera. Kështu, duke iu ankuar për gjendjen në Shqipërinë e Jugut, Mitkoja i shkruan dhe për propagandën antikombëtare greke që pengonte çdo gjë që lidhej me gjuhën dhe me kulturën në gjuhën shqipe. Megjthatë, atë e mbante shpresa se “Flamuri i Shqipërisë”, siç e quante ai revistën e De Radës, do të rritet e të madhohet: “Mbesonj se ndë Shqypëri të poshtme nuk kë... ndimëtarë (abonati), përse janë të [...] ngënjyerë ngaj propagandat e grekërvet. Po dalengadale do të rritet e madhohet ‘Flamburi i Shqipërisë[981]”. Mitkoja i premton De Radës (Letra e datës 24 skurt 1886) se do të vazhdojë punën për shtimin e pajtimtarëve dhe blerësve të revistës: “Do të shkruanj në Bukuresh, ndë u pelqft’ atyre, të marrin 100 fletë (numra) të ‘Flamburit’[982]”.

Se sa përpiqej Mitkoja të gjente pajtimtarë të rinj dhe t’i siguronte revistës së De Radës daljen me rregull, dëshmojnë edhe këto fjalë: “Do të dërgonj turres (parat) për së shpejti, po fletët (numrat e revistës) mënonjën (vonohen) fort. Shumë pajtimtarë nuk kanë marrë veçse një numër të vetëm gjer tani[983]”.

Mitkoja e njofton De Radën edhe për shuma konkrete të hollave që kishte mbledhur për “Flamburin” nga pajtimtarët, siç thekson në letrën e datës 12 dhjetor 1885: “Gjithë-gjithë kam mbledhur’ ndo (nja) frënga 60 e dua të mbledh edhe ca pak, që të dërgonj njëherësh[984]”. Të dhëna të sakta për mbledhjen e të hollave nga parapagimi dhe shitja e revistës, Mitkoja jep dhe në letrën e datës 16 shkurt 1886: “Këtu ke një shënim se sa haroma (të holla) kam mbledhur ngaj ndihmëtarët njera mbë sot. Janë gjithsej frënga 156 e të kam dërguar frënga 151. 50. Po shpërenj të

[976] Thimi Mitko, po aty, f. 662.
[977] Thimi Mitko, po aty, f. 662.
[978] Thimi Mitko, po aty, f. 669.
[979] Thimi Mitko, po aty, f. 675.
[980] Thimi Mitko, po aty, f. 675.
[981] Thimi Mitko, po aty, f. 662.
[982] Thimi Mitko, po aty, f. 680.
[983] Thimi Mitko, po aty, f. 663.
[984] Thimi Mitko, po aty, f. 677.

mbëleth edhe dalekadale e të dërgonj[985]". Të dhëna konkrete për të hollat e grumbulluara nga pajtimtarët e revistës Mitkoja jep dhe në letrën e datës 16 prill të vitit 1888[986]. Ai i bën të ditur De Radës edhe emrat konkretë të atyre që i kishin paguar të hollat, siç dëshmon letra e datës 5 janar 1885[987] ose të mos zemërohet për vonesën e pagesave nga pajtimtarët: "Mos u zëmëro, sepse nuk të shkrojta qëmoti, përse pata shërbesë... Jam e mbledh turres për 'Flamurin', por mezi (dificilmente) e më digjet zemra[988]".

Mitkoja i shkruan De Radës edhe për vështirësitë e ndryshme që shfaqeshin për pajtimin (abonimin) e revistës, ku ndër kryesoret përmend çështjen e gjuhës së revistës, që ndikonte drejtpërdrejt tek disa që të mos e porosisin atë: "Pse gjuhën tuaj, besomë (credemi) as unë s'e ndëlgonj. E këjo është mehana (il motivo) çë s'paguanjën[989]". Ai i shkruan se do të ishte mirë që brenda revistën të shtonte katër faqe në alfabetin e shqiptarëve – lexuesve në Bukuresht: "...zotëria jote të shtonjë 4 fletë tek ay me alfabetin e atyre e të shohim çë do të përgjegjen?[990]" ose "Po dhe alfabeti i zotërisë sate më duket i rëndë (dificile). Ay i Dorsës (Evangelio...)[991] më vjen më i mirë[992]". Në të vërtetë, Mitkoja i shkruan De Radës se do të ishte mirë që të gjithë shqiptarët të kishin një alfabet: "Do t'ish mirë të merrej gjithëkun alfabeti i Shqypërisë, tek u përhap njëherë ndëpër gjithë shkollat pra. Duhet të vihemi ndënë një sistemë të gjithë shqyptarëtë[993]" ose "Të kesh ndë fletët ndo nyl (articolo) mbi gjuhë tënë[994]".

Vështirësia tjetër lidhej me mosarritjen e revistës dhe me ndalesën që i bënte asaj Turqia: "Gjeraz D. Qiriazi ndë Manastir, thotë se e dëshiron 'Flamurin', po nuk vete fare. Duket se Turqia e ndal[995]". Kjo gjë ndodhte nga fakti se çështjet që shtroheshin tek "Fiamuri i Arbërit" nuk përkonin me politikën aktuale të Turqisë,

[985] Thimi Mitko, po aty, f. 678.
[986] Thimi Mitko, po aty, f. 703 – 794.
[987] Thimi Mitko, po aty, f. 670.
[988] Thimi Mitko, po aty, f. 676.
[989] Thimi Mitko, po aty, f. 669.
[990] Thimi Mitko, po aty, f. 680.
[991] Është fjala për përkthimin të Dorës në arbërisht të Ungjillit.
[992] Thimi Mitko, po aty, f. 681.
[993] Thimi Mitko, po aty, f. 705.
[994] Thimi Mitko, po aty, f. 669.
Mitko i shkruan De Radës që të futet arbërishtja – shqipja në Kolegjin e Shën Adrianit, ku De Rada mbante mësim "Dhashtë Zotitë hynj gluha shqype ndë shkollët tuaj, sa t'apë krye (per principio), siç shkruan 'Flamburi' (Thimi Mitko, po aty, f. 678) ose "Pashë në fletën e dytë programën e shkollësë *'S. Adriano'* tuaj... E nuk shoh ndë të të mësonet edhe gjuha shqypie. Pse jo?" (Thimi Mitko, po aty, f. 694. Shih dhe faqet 695, 696, 703, 706).
Kur merr njoftimin nga De Rada se ishte përmbushur një kërkesë e tillë, Mitko i përgjigjet plot shend: "Fort' pun' e mirë u bë, që vutë shqypen në Kolegjet tuaj. Kjo do t'i ndihmojë kombit tynë fort shumë..." (Thimi Mitko, po aty, f. 706.)
[995] Thimi Mitko, po aty, f. 693.

prandaj ajo e pengonte shpërndarjen e saj në trojet shqiptare dhe në Turqi: "Ta preu fletën edhe Turqia[996]".

Po ashtu, Mitkoja i shkruan De Radës edhe për faktin se revista nuk mbërrinte në duart e atyre që e kishin parapaguar atë, siç ndodhte në Korçë ku "paka fletë të 'Flamurit' kanë marrë[997]" ose "Prapë më shkruanjën nga Korça, se s'kanë marrë fare 'Flamburin'. Ndë munt ta dërgonjësh me dorë të konshullës italiane[998]".

Edhe për mbledhjen e të hollave nga pajtimtarët Mitkoja kishte vështirësi. Në letrën e datës 7 tetor 1884, ai i shkruan De Radës: "Nukë beson zotëria jote se sa hidhërohem, sepse shqyptarët këtej s'duan të bëhen galantomë për 'Flamburin', po mëhanoen (si scusano), se s'dinë gjuhën tuaj (il vostro dialetto)[999]" ose "Gjithë fjala është se nuk' munden të kuptonjën (capire) 'Flamurin' shqypëtarët këtej[1000]".

Natyrisht, gjithë puna e Mitkos për shpërndarjen e revistës "Fiamuri i Arbërit" ndër shqiptarë në vende të ndryshme të Evropës, duke përfshirë këtu dhe Shqipërinë, kishte si qëllim që shqiptarët të informoheshin për rrjedhat kryesore të botës e të fatit të tyre dhe që çështja e Shqipërisë të bëhej e njohur sa më shumë që ishte e mundur, po dhe të nxitej dhe formimi i shoqërive të shqiptarëve në qendra të ndryshme, si, fjala vjen, themelimi i shoqërisë së Bukureshtit për arsye se do ta ndihmonin edhe 'Flamurin'[1001].

Mitkoja, jo vetëm e nxiti dhe e përkrahu De Radën për botimin për katër vjet rresht të revistës "Fiamuri i Arbërit" dhe për përhapjen e saj ndër shqiptarë në atdheun e tyre dhe ndër shqiptarët në diasporë, sidomos në Egjipt, Rumani, Turqi etj., po dhe bashkëpunoi me të.

Bashkëpunimi u shpreh, pos të tjerash, në dy forma kryesore: me punime që i dërgoi Mitkoja për botim në revistë dhe për idetë dhe propozimet konkrete që i bëri De Radës për pasurimin e fizionomisë së saj.

Bashkëpunimi dëshmohet që në numrin e parë të Fiamurit të Arbërit", ku De Rada në artikullin hyrës (të shkruar në emër të Redaksisë), e përmend dy herë Thimi Mitkon si mbledhës dhe botues të përmbledhjes së rëndësishme "Bleta shqiptare[1002]" (1878), sidomos për mendimin e Herderit, që ai e kishte përdorur në "Parathënien" e librit: "Një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet[1003]". Në revistën "Fiamuri i Arbërit", De

[996] Thimi Mitko, po aty, f. 665.
[997] Thimi Mitko, po aty, f. 666.
[998] Thimi Mitko, po aty, f. 675.
[999] Thimi Mitko, po aty, f. 667.
[1000] Thimi Mitko, po aty, f. 677.
[1001] Thimi Mitko, po aty, f. 677.
[1002] Thimi Mitkoja i dërgoi De Radës 8 kopje të librit "Bleta shqiptare" (1878), siç dëshmohet nga letra e datës 7 korrik 1879, po dhe i shkruan se "Bëleta ime, me krahë të miqevet, do të shërbenjë e do të punonjë për të gjithë këto punëra për të bashkuarë muhamedanëtë e të krishterët shqypëtarë, për të helqurë me ne, shqypëtarët e Eladhës edhe për të ndërtuar gjuhën tonë". Shih Thimi Mitko, *Vepra*, vep. e përm., f. 635.
[1003] Thimi Mitko, *Parathënie.* Në Thimi Mitko, Vepra, vep. e përm., f. 61.

Rada botoi disa krijime të Mitkos, qofshin punime, siç ishte topografia e Korçës[1004], ndonjë poezi si "Himn Abramidhit"[1005], qofshin materiale të letërsisë gojore të mbledhur nga Mitkoja ose nga shqiptarë të tjerë.

Mitkoja kërkon nga De Rada të botojë në revistë edhe ndonjë lajm të rëndësishëm nga bota shqiptare, si, ishte, fjala vjen, se Abdyl Frashëri jetonte dhe se sulltani e kishte falur dhe e kishte ftuar në Konstatinopojë: "Ky është një shenj i mir' e i mbarë për Shqypërinë e jam fort i gëzuar. Shkoe këtë lajm të bukurrë ndë Flamburi"[1006] apo i sugjeronte botimin e punimit të princeshës rumune me origjinë shqiptare, Dora D'Istrias "Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore[1007]".

Mitkoja bashkëpunoi me De Radën edhe në forma të tjera, fjala vjen, i dërgoi artikuj në italisht që t'i shihte e pastaj t'i botonte në ndonjë gazetë italiane: "Të shkruajta përpara se do të të dërgonjë një nyl (articolo) italishtë e sot ja ku ta mbyll këtu e të lutem ta ndëreqësh (correggere) ndopak edhe ta këllaç ndë një ditare edhe të më dërgosh ndonjë fletë (numër) këtej[1008]".

Kur De Rada i bën të ditur për ndërprejen e daljes së revistes "Fiamuri i Arbërit", Mitkoja i shkruan: "Më dhemb zëmëra për 'Flamburin', po çë mund të bënj[1009]?" dhe "Mua më shembet zemra për 'Flamurin' e vëlejtshimë! Po çë munt të bënj un' i gjori, kur shqypëtarët ë këtushëm janë të pakënduarshmë e prandaj të pazell e të pakupëtuarshimë për të mirat e nevojat e gjuhës[1010]".

I ballafaquar me aktin e padëshiruar të ndërprejes së botimit të revistës "Fiamuri i Arbërit" të De Radës, meqenëse Mitkoja kishte bërë shumëçka për ta mbajtur gjallë e për ta përhapur, ai gjen ngushëllim duke i shkruar "vëllait të vet" arbëresh: "I lutem Zotit edhe zotëria jote të rronj edhe shumë vjete e të jet mirë, për hir të Shqypërisë[1011]". Pra, i thotë se duhet të përdorën forma të tjera për t'i dalë zot Mëmëdheut: "Zotëria jote bën mirë çë do të zësh prapë bejtarin (poezinë), se atje është vistari i gjuhës, duket' edhe jeta e shqypëtarit. Dhashtë Zotynë të ketë

[1004] Shih "Fiamuri i Arbërit", 30 qershor 1884, num. 9, f. VI – VIII dhe vazhdimi në "Fiamuri i Arbërit", 30 korrik 1884, Num. 10, f. VII – VIII.

[1005] Shih "Fiamuri Arbërit", 20 gusht 1885, Num. f. II – III.

[1006] Thimi Mitko, *Vepra.* Përgatitur nga Qemal Haxhihasani, vep. e përm., f. 678.

[1007] Thimi Mitko, po aty, f. 631.

[1008] Thimi Mitko, po aty, f. 635.

[1009] Thimi Mitko, po aty, f. 679.

[1010] Thimi Mitko, po aty, f. 704 – 705.

[1011] Thimi Mitko, po aty, f. 678.

Mitko bashkëpunoi me De Radën edhe në këmbimin e librave: "Përsëri ju shpreh kënaqësinë time shumë të madhe, me të cilën prita librat tuaja të çmuara që më dërguat, prej të cilave shumë do të përfill në librin tim, që do të nxjerr pas dy-tre muajsh[1011]".

Mitko i çmonte lart veprat e De Radës prandaj i shkruan: "Çfarëdo bejtarie (poezia) që të më dërgonjë ay për të kallturë në vivllë teme do ta pres me gëzim e do ta kem për vivllën teme si atë, ashtu edhe këngat e tua si një lule e një nderë". Shih Thimi Mitko, *Vepra*, vep. e përm., f. 659.

Mitko gëzohet edhe për botimin e librit të abreshit Leonardo De Martino-s, *L'Arpa d'un italo albanese* (Harpa e një arbëreshi të Italisë), botuar në Veneci më 1881. Shih letrën e datës 18 mars 1883.

Shqypëria fat të mirë, përse kemi shumë armiq' e më të mëdhenj janë grekërit (elenët) që na luftojën me kishën e me koshullatat' e tyre[1012]".

***

Të dhënat që i sollëm më sipër dëshmojnë qartazi, se, sa Thimi Mitkja u zotua dhe e ndihmoi De Radën për fillimin e botimit të revistës ndër arbëreshët e Italisë e sidomos për punën e jashtëzakonshme që bëri për mbajtjen në jetë dhe për shpërndarjen e "Fiamurit të Arbërit" në disa shtete si në Egjipt, Rumani, Turqi etj., ku jetonin shqiptarët, po edhe në atdhe, në Shqipëri, me qëllim që, siç dëshmojnë edhe këto fjalë të Mitkos nisur De Radës në letrën e datës 15 korrik të vitit 1887: "Edhe zotëria jote plak, edh' unë plak, e Zoti na lashtë të rrojm' edhe pak e t'i shërbëjm' edhe Shqipërisë[1013]".

[1012] Thimi Mitko, *Vepra*, vep. e përm., f. 706.
[1013] Thimi Mitko, po aty, f. 698.

LILI SULA (TIRANË

KRIJIMTARIA LETRARE E THIMI MITKOS

Romantizmi ynë si lëvizje e gjerë që synonte rilindjen kombëtare politike, kulturore e letrare u parapri nga formacione shoqërish e vatrash kulturore të themeluara më së shumti jashtë vendit, si në Bukuresht, Sofje, Stamboll, Bruksel, Kajro etj. Thimi Mitkoja qe nga të parët patriotë të shquar të kolonisë sonë në Egjipt që organizoi shoqërinë shqiptare të Misirit, me veprimtari të spikatur politike, kulturore, artistike, publicistike dhe arsimore për mësimin e gjuhës amtare dhe botimin e librave shqip. Punën e Th. Mitkos si folklorist e më pas si poet e ndoqën të tjerë patriotë shqiptarë si Spiro Dine që, në përmbledhjen folklorike *Valët e detit*, botoi dhe vjersha të ndryshme të vetat; Jani Vreto i cili mblodhi folklor e la edhe ndonjë vjershë si poemthin mbi Skëndërbeun; Zef Jubani, Milo Duçi, Loni Logori, Thoma Avrami etj. Të përfshirë në veprimtari ekstraletrare, politiko-kulturore e folklorike, këto autorë u angazhuan me krijimtari artistike me synimin e qartë për të përcjellë mesazhe ideore pa pretendime mirëfilli esteteke. Si misionarë të ndërtimit kombit përmes përtëritjes së trashëgimisë kulturore, gjuhës e historisë, Mitkoja me shokë e bënin detyrë të tyren edhe lëvrimin e poezisë artistike, që do të shquante kombin tonë, edhe në këtë drejtim.

Në parathënie të *Bletës shqiptare*, Th. Mitkoja citonte Herderin sipas të cilit "Një komb nuk mund me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet"[1], duke sjellë kështu në vëmendje të lexuesit përtëritjen e trashëgimisë popullore, përmes së cilës Herderi me botimin e *Këngë popullore* , botuar më vonë nën titullin *Zerat e popujve në këngën popullore,* 1778-`79 entuziasmoi një brez të tërë romantikësh europianë. Praktika e mbledhjes dhe botimit të këngëve popullore u ndoq dhe nga rilindësit tanë, që zhvilluan veprimtari të përbashkët politike e më pas kulturore e letrare. "Metafora më e madhe romantike, e kthimit te rrënjët dhe e rizbulimit të shiprtit të etnisë, siç e quan Prof. J. Bulo mbledhjen e trashëgimisë folklorike, nxiti veç të tjerave kërkimet folklorike dhe në përgjithësi zgjimin e interesit për kulturën tradicionale popullore, si shprehje e gjenisë krijuese dhe e individualitetit të bartësve të kësaj kulture. Shqiptarëve u mungonte një botim si një monument madhor që të paraqiste para vetës e të tjerëve këtë pasuri që jetonte në kujtesën, në këngët, baladat, përrallat, legjendat dhe eposin e tyre, e përcjellë gojarisht por e pahulumtuar, e papërmbledhur dhe e pavënë në qarkullim shkencor."[2]

[1] Thimi Mitko: *Vepra*,- Tiranë, 1981, f.61

[2] Jorgo Bulo: Burimet kulturore të lëvizjes kombëtare dhe vepra e Thimi Mitkos,- Në: *Shpirti i fjalës*, Tiranë, f.40

Marrëdhënia e ngushtë midis krijimtarisë folklorike e asaj të kultivuar si dhe imitimi kreativ i folklorit përbënte një konstante të rëndësishme të estetikës romantike. E këtu, rilindësit tanë romantikë patën vlerë të dyfishtë: ata mblodhën, botuan e jetësuan trashëgiminë tonë popullore si dhe e shfrytëzuan atë si lëndë të parë në krijimtarinë artistike autoriale, duke dëshmuar ngritjen e gjuhës në shkallën më të lartë, të kulturës dhe krijimtarisë letrare.

Pjesë përbërëse e *Bletës shqipëtare* janë dhe 15 poezi artistike, që zënë vend pas krijimeve popullore dhe para letërkëmbimeve, duke na sugjeruar një metodë pune e organizuese të mirëstrukturuar.

Mitkoja edhe si poet thellësisht i angazhuar trumpeton idetë nacionale në shërbim të kombit, i bindur se rilindja kombëtare përmbushet dhe përmes mbrujtjes se gjuhës letrare e artistike.[3] Nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Revolucionit Francez, ku ka rrënjët nacionalizmi, tipar thelbësor edhe i poezisë së Mitkos, duhet analizuar *Marsejesa,* (*La Marseillaise*) që karakterizohet nga ligjërimi propagandistik dhe entuziasmi patriotik, një imitim i pastër i poezisë franceze me të njëjtin titull, aq sa strofa e parë dhe refreni vijnë si përshtatje e vargjeve franceze.

Nd`arm`, shqipëtarë,	*Aux armes, citoyens*
hyni nëpër taborë,	*Formez vos bataillons,*
ecni, ecni që donjë anëmik,	*Marchons, marchons !*
mos shkelinj në sinor. (f.583)[*]	*Qu'un sang impur*

Vargjet e mësipërme ashtu si gjithë poezia mbartin dukshëm ndikime edhe nga poezia e P.Vasës *O moj Shqypni*. Ndërgjegjësimit të popullit përtej besimit fetar, Mitkoja i përgjigjet me unifikimin e gjuhës përmes ndërfutjes së leksemave e trajtave gramatikore dilektore të gegërishtes (*çka do, me pas frikë, tash, rrëfehena, me u damun, me i lan`* etj.) në dialektin e toskërishtes. Në ligjërimin poetik të Mitkos, si dhe në publicistikë e letërkëmbim, zotëron e folmja e zonës jugperëndimore të Jugut, e folmja e Korçës, Përmetit e Kolonjës si dhe trajta dialektore të çamërishtes e arbërishtes. Në leksikun poetik të autorit, si dhe te rilindësit e tjerë, dallohet vetëdija për purifikimin e gjuhës amëtare, si dhe rifunksionalizimi i fjalëve të rralla të trevave të ndryshme (*gluha, klishë, klajtur, plis, shtresë, shpërenj, befas,* etj.), zgjerimi i fushës semantike i njësive leksikore (ose frazeologjike) popullore si dhe krijimi i neologjizmave me funksion poetik nga trungu i gjuhës amtare (*vendëri për atdhe, parëflas, i ndarë për i shquar, përndarë për i zgjedhur, jetat për shekujt, i pamburuar për i pambrojtur, besëprapi për i pabesë* etj.)[4] Rilindasit ishin të bindur që gjuha më shumë se besimi fetar e regjioni është tipar identifikues i kombit, e ky popull që ka gjuhën e tij, një nga më të lashtat në Europë, me të cilën ka krijuar thesare të krjiimtarisë folklorike duhet të jetë i pavarur

[3] Eqrem Çabej: Romantizmi në Europë Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare,- Në: *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë, 1994, f. 79

[*] Vargjet e Th. Mitkos, këtu e në vijim, janë nxjerrë nga Th. Mitko: *Vepra*, Tiranë, 1981

[4] Qemal Haxhihasani: Parathënie,- Në: Th. Mitko: *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 52,53

dhe i lirë në trojet e veta. “Fjala *komb* e shqipes, shënon Prof. Bulo, e përdorur së pari nga rilindësit është parapëlqyer prej tyre sepse buron nga ai element themelor që i lidh, i bashkon shqiptarët, siç është gjuha, dhe jo nga elemente të tjera si dallimet fetare, fisnore e krahinore që i ndanin.”[5] Rilindësit tanë kishin motiv të fortë për të përdorur në krijimtari fjalë prej të dyja dialekteve; parimi i tyre se njësia e gjuhës është njësia e kombit i nxiste në lëvrimin e gjuhës të shtresave të ndryshme regjionale e historike për ngritjen e saj në gjuhë letrare. Nën këto nxitje është krijuar poezia *Nxitëje mbë shqipëtarëtë për të shkruarë gluhën e tyre* botuar më 1879. Teza pellazgjike e përkrahur nga rilindësit tanë, në emër të krenarisë e autoktonisë së popullit, shtyn poetin ta vendosë perëndinë Pellazge në majë të hierarkisë hyjnore, para perëndeshës së Hënës:

Ju jeni me Pellazgun farë,
që ka lindur para hënës,
që e ka Homeri të parë,
edhe për mbësimedhënës. (f. 587)

Bashkohet në këtë poezi parimi krijues romantik e iluminist i Mitkos me romantikë të tjerë shqiptarë që propagandojnë mësimin dhe shkrimin e gjuhës amtare, (N. Frashëri, Çajupi, Asdreni, Fishta etj.), përmes këndimit të gjuhës si njësi identitare kombëtare. Botimi i *Bletës shqipëtare* synonte të shpëtonte dhe t`u linte brezave që vijnë fjalët dhe tekstet shqipe e veçanërisht “nxitjen e bashkatdhetarëve shqiptarë për studimin e gjuhës amtare dhe të kulturës së tyre.”[6]

Poezia e Mitkos, nga një këndvështrim, mund të klasifikohet si poezi portreti, ku përfshihen *Të fortndriçmesë zonjësë Dorë Istriadë*, *Ende këtë vetë zonjë*, *Jovan M. Bankës*, *O Vasil Ruso Korçari*, *Nxitëje mbë shqipëtarët* dhe poezi situatash a ngjarjesh politike si *E ndë shqypëtarëtë gjithë sa janë, Korç` moj Korç` e mjera Korçë, Marsejesa, Këng për Shqipërin` e shqipëtarvet, Nxitëje mbë shqipëtarëtë për të shkruarë gluhën e tyre, Të nxiturit e Shqipërisë tuke përpjeturë, Mbë shqypëtarët, Mbë shqypëtarët, Prapë greku e rëfeu*.

Titujt ofrojnë qasjen e parë analitike drejt poezive, në sensin e marrëdhënies komunikative që poeti
i paracakton receptuesit të tij. Titulli përmban njësi kyçe të ligjërimit artistik që përfaqësojnë
semantikisht ftesën e parë (ndoshta të vetmen nga pikëpamja e *intencio auktoris*) për lexim e shijim artistik. Jo më kot autorët i kushtojnë shumë kujdes titujve të veprave të tyre, sa në periudha të veçanta ku bën pjesë dhe Mitkoja, funksionit informativ të titujve që synojnë t`i përcaktojë lexuesit horizontin e pritjes, i mbivendoset dhe fuksioni plotësues ose përforcues i rrafshit të mesazhit. Titujt e lartshënuar i luajnë të treja funksionet duke i mëshuar përcjelljes së mesazhit, pra leximit të dëshiruar si *intencio auktoris.* Nga poezitë e situatës *Korç` moj Korç` e*

[5] J. Bulo, vep. cit. f. 36
[6] Th. Mitko, vep. cit. f.51

mjera Korçë (në disa variante *Korçë moj e zeza Korçë*) duket sikur parainformon për një lirikë mbi qytetin; ndoshta lexuesi me kompetencë parapërgatitet për një poezi për vendlindjen e poetit, për një elegji emigrimi mes mallit e kujtimit, po në fakt kemi të bëjmë me një lirikë të thjeshtë situate; tërmeti dhe zjarri që i ranë qytetit më 1879-ën përbëjnë thelbin e saj që nxisin te subjekti poetik të kritikojë sundimtarin e Korçës, së asaj kohe.

Titujt qendërzohen në leksemat: *shqypëtarëtë, këng, Shqipërin`, nxitëje, gluhën,* që shënojnë fjalëkyçet e të pesëmbëdhjetë lirikave të Th. Mitkos. Nuk duket e rastësishme që tri krijimet e fundit të ciklit të poezive artistike, tri krijime të ndryshme, mbajnë thuajse të njëjtin titull, madje dy syresh kanë titull të përbashkët: *Mbë shqypëtarët, Mbë shqypëtarët,* dhe *Nxitje mbë Shqipëtarët.* Edhe te *E ndë shqypëtarëtë gjithë sa janë, Këng për Shqipërin` e shqipëtarvet, Nxitëje mbë shqipëtarëtë për të shkruarë gluhën e tyre, Të nxiturit e Shqipërisë tuke përpjeturë,* qendra semantike mbetet konstante, po shtohen përbërës të tjerë informues si përemra të pacaktuar me funksion gjithëpërfshirës, shpallet synimi utilitar përmes emrash foljorë, theksohet parafjala duke synuar përputhjen denonative mes titullit parainformues dhe krijimit qëllimor. Të krijuara ndër vite ngjarjesh të rëndësishme historiko-politike si Lidhja e Prizrenit, tipari thelbësor i gjithë krijimeve të Mitkos, si na parainformon e fton dhe titulli, është ideja kushtrimore për luftë*: Eani, trima të Shqipërisë,/dit`e namit ia ka mrritë…Sot leu dita e dëlirisë,/me u damun prej halldup*, Marsejesa; *Ju o shqipëtar`, ndë doni,/ nga i huaji të shpëtoni,/ duhetë që të vëzhdoni/ kombin tuaj të ndërtoni.* Këng për Shqipërin` e shqipëtarvet; *Shqipëri, moj dashuri,/ ne jemi trima për ti,/ mos ke frik`e mos mba zi, pse do vritemi për ti.* Të nxiturit e Shqipërisë tuke përpjeturë; *Të ju them, o shqypëtarë,/…/Bashkohi gjithë një herë/ me dashuri e me besë/ musulman` e të krishterë,/ gjithkush për vatan të vdesë*./ Mbë shqypëtarët; *Digju, o Shqipëri, digju,/ bëje dhenë të dal` ujë,/ armikut me zjarr përgjigju./ Bëni flakë dhenë tuaj,/ pas zakonitë që keni*, Mbë shqypëtarët.

E veçantë nga këto, është poezia *Burri klan gruan e tij q`i vdiqi*, që karakterizohet nga shenja autobiografike e tone elegjiake, që të ligjëruara në vetë të parë prej subjektit lirik artikulojnë dhe kujtimin në formën e dialogut prekës që rrit emocionalisht poezinë. /Më thoshe:-Folë Thimi/… Un` të pyesnja: - Ç`më të dhëmb? Ti më theshe: - Mos u tremb/ Një këngë vaji mbi humbjen e bashkëshortes[7] parateksti i së cilës kapet shpejt te krijimet që vetë Mitkoja mblodhi ndër bashkëkombës, botuar nën titullin *Vaje e këngë të përvajshme* te *Bleta.*

[7] Në një letër drejtuar De Radës, më 14.5.1886, Mitko i kërkon mikut të tij ta regjistrojë si banor në ndonjë fshat arbëresh dhe i jep disa të dhëna për familjen e tij. Shkruan Mitko: "Unë dëshironja qëmoti të vinj ndë Siçili e Kalabri, po nuk mundem sotpërsot. Ndë rrofsha edhe ca vjete, do të vinj. Jam 66 vjeç. Ime shoqe (la mia moglie) më vdiq mbë 1877 ndë Kairë; pas asaj edhe dy vajëza. Sot kam një bijë të martuarë, Eleonorën, edhe dy bij, Kostën – 24 vjeç edhe Mitrin 22. Trëmbem se mos m`i marrë Italija bijtë ndë ushtri (soldati), pasi të jem shkrojturë vëndës. Po ngaj Egjypti gjer mbë sot, nuk` ka marrë ndonjë trim kurrë."- Sipas Th. Mitko: vep. cit. f. 684

këndon populli: këndon Mitko:

Mitri la një porosi: Do të vajtonj, do të të qanj,
-Të më qani me violi, (f.211) edh` me këng` edhe më violi, (f.581)

Sprovë e formësimit poetik si ligjërim dialogues duket në një të vetme poezi të Mitkos, *Të nxiturit e Shqipërisë tuke përpjeturë,* ku spikasin ngjarje dhe figura të rëndësihme historike midis Shqipërisë dhe zërit popullor, që kulmojnë si vetëdije kombëtare në ligjërimin dramatik të formacioneve të burrave, trimave e çupave.

Nga poezitë portret veçojmë *Të fortndriçmesë zonjësë Dorë Istriadë*, *Ende këtë vetë zonjë* që i kushtohen veprimtarisë dhe kontributit të Elena Gjikës për çështjen shqiptare. Idealizimi i vlerave të Zonjës Dorë Istriadë, si e quan poeti, pikturimi fizik, psikologjik e moral i subjektit real historik intonohet stilistikisht mes pyetjesh retorike të derdhura në varg tipik popullor. (Ti Bubulinë, harone?/Ti, sulote, do të lëvdone./ Na, do mënd e dituri?/ Kemi Dorënë d`Istri.)

Studiuesi fondamental i romantizmit tonë Prof. Çabej vërente se në krijimet artistike "Distanca midis poetit e popullit, midis literaturës e poezisë popullore nuk ka qenë kurrë e madhe…. Poeti s`mund të shqitet nga rrethanat sociale, shkrimtaria nuk mund të çlirohet prej fuqisë së poezisë së populit."[8] Raporte mes artit e folklorit janë produktive sa në nivel motivor aq dhe të atij stilostiko-metrik. Si praktikë e pastër imituese që bëhet gjithnjë e më organike nga mbledhja dhe botimi i lëndës popullore te *Bleta Shqiptare*, Thimi Mitkoja thur vargje sipas modelit popullor; ai kujdeset të njësojë vargun e tij me vargun falklorik. Përveç dy krijimeve *E ndë shqypëtarëtë gjithë sa janë* dhe *Të fortndriçmesë zonjësë Dorë Istriadë* që janë në 16 rrokësh, një varg i përbërë popullor (ose në 8-rrokësh të dyzuar), të gjitha poezitë e tjera janë në 8-rrokësh. Me gjatësinë e cezurës, me segmentimin e tij në gjymtyrë të barazvlerëshme, me vargun kryesisht trokaik, me lëvizjet ritmike si dhe me figuracionin e thjeshtë mes krahasimesh, epitetesh mbiemërore, metaforave, enumeracioneve, pyetjeve retorike, apostrofave e pasthirrmave tipike popullore po aq dhe me oralitetin e melodizmin, Mitkoja e modelon poezinë e tij shumë përngjashmërisht me atë folklorike.

Për ndikimin e thellë të folklorit në poezinë rilindase është folur shumë. Ky ndikim ka qenë shpesh model vlerash artistike, por po aq shpesh edhe thjeshtëzim vargëzimesh, që si e vë në dukje Prof. Ali Xhiku në *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe, 1555-1944,*[9] qenë karakteristikë për veprimtarë të Rilindjes, të cilët edhe kur nuk kishin ndonjë talent të veçantë, besonin se vargëzimi i mesazheve

[8] E. Çabej, vep. cit. f. 54

[9] Për studiuesin, krijimet letrare të Th. Mitkos, S. Dines, Th. Kreit, K. Hoxhit, Z. Jubanit, M. Duçit, L. Logori, Th. Avrami etj. i interesojnë historisë së letërsisë "nga pikëpamja faktologjike e sasiore; në raste të veçantë edhe nga pikëpamja e gjinisë dhe e llojeve letrare. Vlerat e tyre artistike ishin fort të rralla e fare të thjeshta" : *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe, 1555-1944,*- Tiranë, 2014, 118

ishte mundësi e mirë për të komunikuar me bashkatdhetarët. Nga këta veprimtarë, ndër më të shquarit ishte Thimi Mitkoja.

MERITA GJOKUTAJ-SHEHU (GJIROKASTËR)

"BLETA SHQYPËTARE" –TOPOGRAPHIA SACRA E HISTORISË DHE TRADITËS SHQIPTARE

Folklori përbën një ndër elementet e qenësishme të kulturës sonë pararilindase. Sa më shumë zhytesh në kohë aq më i vëllimshëm është vendi që zë folklori në kulturën shpirtërore shqiptare, çka shpjegohet para së gjithash me faktin që kemi të bëjmë me një kulturë të shkruar relativisht vonë.

Kjo krijimtari ka tërhequr vëmendjen e njerëzve të kulturës sonë kombëtare që në krye të herës, kur nisi rrugën e vet shkrimi shqip. Le të kujtojmë Frank Bardhin, i cili në fillim të shekullit XVII botoi disa proverba e përshëndetje, që ia bashkoi fjalorit të tij latinisht - shqip. Më pas, në shekullin XVIII, vjen një radhë e tërë mbledhësish të apasionuar të folklorit, si Nikollë Filja, Gavril Dara Plaku, Anton Santori, De Rada, Kamarda etj. Por roli i folklorit në kulturën shqiptare u thellua e u bë më organik sidomos gjatë shekullit XIX.

Interesimi për kulturën popullore zuri vend të dukshëm në mendësinë e rilindësve tanë, sepse veçantia e *"dokeve dhe e zakoneve"*, siç shprehej Veqilharxhi, apo përkatësia në *"një palë zakone e një farë të rrojturi"* siç thoshte Samiu, konsideroheshin si një ndër përbërësit themelorë të nocionit *"komb".* Në një kontekst të tillë, kultura popullore përbënte një armë të fuqishme për të dëshmuar ekzistencën e kombit shqiptar, për të pohuar identitetin e tij dhe, rrjedhimisht, për të kërkuar lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Qëndrimi i rilindësve ndaj kulturës popullore u përvijua si një kapërcim i vrullshëm krahasuar me mendimin paraardhës dhe kjo rrodhi para së gjithash nga fakti se në shekullin XIX spikati si asnjëherë më parë domosdoja e forcimit të kohezionit kombëtar. Një nga mjetet për të arritur këtë ishte të nxirrje në dritë ekzistencën e njësisë etnike edhe brenda kulturës popullore, sepse s'mund të ecje larg pa përfillur dëshmitë e saj në kushtet kur ishin të varfra e përgjithësisht pak të eksploruara burimet e shkruara.

Duke e çmuar kulturën popullore në tërësi, rilindësit e përqendruan vëmendjen veçanërisht te folklori, duke u marrë me vjeljen, studimin dhe botimin vetëm të lëndës letrare folklorike. Paraardhësit e tyre, duke nisur që me Bardhin, në mos që me Barletin, kishin regjistruar lëndën letrare të folklorit, madje, jo aq për vlerat artistike, sa për qëllime gjuhësore, historike etj.

Gjithë rilindësit që gërmuan sadopak në fushat e kulturës popullore, nuk u udhëhoqën aq shumë nga kërshëria shkencore; në radhë të parë e mbi të gjitha, ata i nxiti dëshira për t'i ardhur në ndihmë mëmëdheut, çështjes kombëtare. Mendimi rilindës rreth kulturës popullore, para se të jetë shkencor, imagjinativ, realist, romantik etj., është një mendim që synon të vihet në dobi të praktikës politike-shoqërore, të luftës për kombin dhe të ardhmen e tij, të kërkesave politike të ditës.

Në vitet e fundit të gjysmës së parë të shekullit XIX etja romantike për të njohur popuj egzotikë dhe krijimtarinë e tyre shpirtërore zuri të shuhej. Krijimtaria

popullore gjithnjë e më pak, gjithnjë e më rrallë ishte burimi kryesor që i shërbeu njohjes së zakoneve, të mentalitetit dhe të së kaluarës historike të popujve të vegjël. Kjo do të thotë se interesimi romantik dalëngadalë do t'ia lëshojë vendin interesimit, në radhë të parë, shkencor. Rezultat i këtij interesimi janë: vepra e Hahnit me këngë, përralla, gjëegjëza, fjalë të urta dhe fraza popullore shqipe; vepra e Rainholdit me këngë dashurie, këngë djepi, fjalë të urta, e të tjera, të mbledhura në kolonitë arbëreshe të Greqisë; vepra e Dozonit me përralla, këngë, proverba; vepra e Jarnikut me përralla dhe proverba; vepra e Pedersenit me këngë, përralla, gjëegjëza, besime popullore, etj; vepra e Gustav Majerit me fabula, përralla, këngë, anekdota, proverba etj.

Të huajt interesoheshin që përmes gjuhës dhe folklorit shqiptar, të kristalizonin disa çështje gjuhësore apo etnografike me rëndësi të përgjithshme shkencore, *kurse mbledhësit shqiptarë interesoheshin që të afirmonin kombin, historinë dhe gjeniun e tij krijues.*

Më 1878, do të botohet përmbledhja më e mirë e letërsisë sonë popullore "*Bëleta Shqypëtare",* e Thimi Mitkos, që siç e përcaktoi De Rada, përmbledh thelbin e trashëgimisë të ruajtur nga jeta heroike e kombit. Thimi Mitkoja është figura më e shquar dhe më e rëndësishme në fushën e botimeve folklorike, në shekullin XIX. Ai hapi gjerësisht rrugën për njohjen e vlerave artistike e morale të popullit, për zbulimin e traditave, zakoneve, këngëve dhe pasurive të tjera folklorike. Me anë të kësaj vepre, ai përpiqet të ngjallë te bashkatdhetarët ndjenjën e dinjitetit kombëtar, të fusë në luftën shekullore të popullit tonë perspektivën e çlirimit kombëtar. Këtë ai e bën edhe në shënimet e këngëve popullore të botuara në të. Me këtë botim letërsia gojore shqipe bëhet e njohur, e popullarizuar dhe e çmuar si në pikëpamje sasiore ashtu edhe në pikëpamje artistike. Mitkoja është nga të parët që përpiqet t'u japë materialeve një paraqitje shkencore (gjinia, tematika, kronologjia historike) etj. Koncepti i Thimi Mitkos për letërsinë popullore është më i gjerë se i Jeronim de Radës dhe i Zef Jubanit. Nëse De Rada është nismëtari i mitit të folkloristit ndër arbëreshët e Italisë, Mitkoja, pa dyshim, është ai që i jep nxitjen më të fortë krijimit të mitit të folkloristit si ndër shqiptarët e kolonive të huaja, ashtu edhe ndër shqiptarët brenda atdheut.

Tradita folklorike përbënte për të thesarin e qytetërimit njerëzor, ndërsa kënga popullore, që jetonte në popull, përfaqësonte zërin e gjeniut të njerëzimit. Sa më të vjetra e të pastra të jenë rrënjët, aq më të pastra jane doket e zakonet e popullit dhe sa më të vjetra zakonet, aq më të mëdha janë lidhjet me të, aq më i madh do të jetë kombi. Prandaj, mbledhja e letërsisë popullore prej Mitkos, gjatë gjithë kësaj periudhe, konsiderohej një punë e shenjtë. Për këtë shkak çdonjeri që dinte të shkruante e të lexonte e shihte të arsyeshme të interesohej për letërsinë që kishte krijuar gjeniu i popullit, kurse çdonjëri që shkruante vargje e shihte të arsyeshme ta njihte sa më mirë letërsinë popullore. Ashtu siç krijohej ndjenja e heroizmit kombëtar në këngët popullore historike, po ashtu shprehej përmes mbledhjes së tyre dhe, në përgjithësi, përmes mbledhjes së letërsisë popullore,

vetëdija e formuar kombëtare. Prandaj është e kuptueshme, pse edhe folkloristët ishin ose poetë me prirje të shquar - si Jeronim de Rada apo Zef Skiroi, ose poetë me prirje më modeste - si Thimi Mitkoja, Zef Jubani, Spiro Dine etj.

Lënda e botuar nga Mitkoja është nga më të pasurat, kriteret e mbledhjes dhe botimit dëshmojnë se ai ishte jo vetëm një patriot i dashuruar pas traditës artistike popullore, por edhe një folklorist i përgatitur, çka bënë që "Bleta" të pritej me interesim të madh brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe të bëhej një nga librat më të kërkuar të kohës. Në këtë mënyrë Mitkoja ndihmoi që letërsia e shkruar të gjente një mbështetje të sigurt në krijimtarinë e popullit.

"Bëleta Shqypëtare" e Mitkos është kujdesur të mbledhë:

-krijime popullore të gjinive, të llojeve dhe të formave të ndryshme, këngë të motmotit, këngë për festat, këngë dashurie, dasme, nizamësh, kurbeti, vaje, këngë të përvajshme, epike, balada, historike, përralla, fabula, anekdota, fjalë të urta, gjëza, emra karakteristikë muslimanësh, të krishterësh etj.,

-krijime të periudhave të ndryshme kohore, krijime të viseve të ndryshme, prej Atdheut në Jug e Veri, Malësia e Shkodrës, Përmeti, Skrapari, Myzeqeja, Kosova dhe prej kolonive shqiptare të botës së huaj, si tek arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë duke i dhënë veprës karakter gjithë shqiptar, çka bie në sy pothuajse në të gjithë kapitujt e përmbledhjes së tij, në larminë tematike të këngëve, në kapitullin e onomastikes, në shënimet e tyre, në shpjegimet gjuhësore etj.

Ajo është përmbledhja më e mirë e letërsisë popullore shqipe, si në pikëpamje të kohës dhe të hapësirës në të cilën është krijuar, ashtu edhe në pikëpamje të vlerës, madje, mund të themi se ajo është një antologji e kësaj letërsie.[1014] Te Bleta gjendet fuqia, mendja, thellësia, guximi, vjetërsia dhe ndjenja e një kombi.

Th. Mitko te "Bleta shqiptare" ka 500 fjalë të moçme si enciklopedi e filozofisë, estetikës dhe etikës popullore. Janë nga më të bukurat e më përfaqësueset e folklorit tonë, duke dhënë gjykime dhe vlerësime të ndryshme të jetës materiale dhe shpirtërore: *"Kush zgjedh, mbledh", "Nga kryet qelbetë peshku", "Siç ka kryet vuri kësulën", "Sorra sorrës si nxjerr sytë", "S'qëndrojnë kërcunjtë mbi kërthija", "Puno si rrop, e shko si zot", "Puno o fatzi, ha o bark stihi", "Prish kanaçe, bën bucelë"* etj. Nëpërmjet tyre shikon, gjykon, vlerëson dhe përgjithëson.

Vëmë re se për të njëjtin problem apo dukuri ka shumë fjalë të urta, sepse bëhet shikimi në shumë drejtime (poliedrik): *"Më mirë ku dhënë se ku thënë", "Më mirë ndë plehë të tim biri, se ndë kënd të dhëndërit", "Më mirë nga pak të pikonjë, sesa rriedh e të shkonjë", "Më mirë një dëm i çpejtë se një fitim i mënuar", "Më mirë një ve sod se një pulë mot", "Më mirë pak e për hir sesa shumë, e për lumë", "Më mirë të dish se të kesh"* etj, etj.

Fjalë t'errëta ose gjëegjëza

Të përshëndoshura, ku të bëjnë përshtypje emërtesa si: *më të pjekur, më të ndarë, më të nisur, të kremtet, për motin e ri, për dasmë, ngushëllime* etj.

[1014] R. Qosja, Historia e Letërsisë Shqipe. Romantizmi , II, Tiranë, 2000 , fq. 285

Emra vetjakë të kërshtera e mohamedane.

Këngë të vjetra që hedhin dritë mbi një botëkuptim të lashtë, mbeturina të kultit të forcave të natyrës.

Këngë që këndohen në ditë të veçanta, në festat rituale të motmotit me urime për të korra të bollshme, për shëndet e lumturi.

Kënka shqype dasëmore, me pasurinë dhe larminë e saj, jep një kuadër të bukur e emocionues të ceremonialit të dasmës shqiptare. Një pjesë e mirë e këngëve të mbledhura prej Mitkos janë evidente edhe te lirika e dasmës tradicionale gjirokastrite, çka tregon shtegëtimin e këngës popullore, variantitetin e saj: *"Unju mal të dalë hëna, të stolisetë kadëna....."*, *"Më rrite baba më rrite, më rrite me tul simite, nga gjiri jyt pse më qite....."*, *"Më rrite baba më rrite, erdhi dita dhe më shite....." LDGJ, "Qysh m'u ngryse, qysh m'u gdhive, bija ime, posi zogu ndë mulli, o babai ime, si thëllëza ndë kuvli, o babai ime....."*, *"Si m'u ngryse si m'u gdhive bija ime, si thëllëza në kuvli moj nëna ime....."LDGJ, "Moj unaza rreth flori, more burrin trim të ri, burrin trim të ri e more, babanë se turpërove....."*, *"Nuse ku kalle këmbëtë, këtu të rënçin dhëmbëtë....."*, *"As na përit moj gjeraqinë, bëj konak e shtro shtëpinë"*. Këto këngë na japin kënaqësinë e takimit dhe të çmalljes me të parët tanë, me botën e tyre pak të vjetëruar, por gjithsesi të dashur e të respektuar.

Këngë shqype jaranishte. Këto këngë mbajnë vulën kolektive, mbajnë mijëra vula të disa brezave, që i kanë krijuar e pranuar, i kanë përpunuar dhe i kanë mbajtur gjallë, pavarësisht nga prania e elementit individual. Spontaniteti dhe sinqeriteti në këto këngë janë të dukshme: "*Dielli rrëzën e malit, hën e mir e allonarit*", "*Folë moj mike një fjalë, se jam gati për të dalë, ku vete mos vafsh i gjallë*", "*Çke moj syskë që po trëmbe, folna moj për kokën tënde….*", "*O ylli që del Cmokthinë, vështro mirë hape synë, zër mbë rradhë djelmurinë, mos u vështro bukurinë, po t'u vështrosh trimërinë…*","*Ndë portë të trokëllita, fishek nga dera të qita*", "*Vetë e bardhë, shami kuqe, as i krih ato baluke, as i krih e hidhi prapa , se je nuse të zë vapa "etj, etj.*

Këto këngë kanë një realizëm të thellë, shfrytëzim mjeshtëror të detajeve, thjeshtësi të ndërtimit, s'kanë asnjë lloj komplikimi a mjegulle dhe nga mënyra si ndërtohen mbahen mend me lehtësi.

Këngë trimërie, është kapitulli më i rëndësishëm, mbledhja e të cilave është realizuar në Jug e Veri, shoqëruar me shënime historike prej Mitkos, të cilat formojnë një burim të rëndësishëm për ngjarjet kryesore që u zhvilluan në vendin tonë, sidomos gjatë shekujve XVIII-XIX. Gjejmë në këtë kapitull kryengritje të armatosura masive kundër pushtimit osman nga të gjitha anët, në Shkodër, Dibër, Kosovë, Labëri, Korçë, Kolonjë, Çamëri; këngë që tregojnë qëndresën e shqiptarëve nën udhëheqjen e Ali Pashë Tepelenës; këngë fshatare kundër Tanzimatit; gjejmë figura si Rrapo Hekali, Gjoleka, Çelo Picari, Tafil Buzi, Hodo Aliu, këngë për heroizmat e kaçakëve si Bilbilenjtë, Shemo Gjirokastriti, Kapedan Gjika etj.

Përralla shqype e mbledhur prej Mitkos padyshim paraqet një interes më të madh për studiuesit e folklorit, qoftë për brendinë e saj të pasur me motive episode e situata, me personazhe dhe përjetime, me fenomene dhe botëkuptime të ndryshme

shoqërore, qoftë për strukturën e saj të formës, për stilin dhe për atë pasuri të brendshme gjuhësore e shprehjesh figurative, veti këto që i ngrenë përrallat në shkallën e krijimeve të denja artistike gojore. Përralla besohet si realitet artistik, prandaj gjejmë edhe mbyllje të tilla si : *" As përrallë s'ju dëfteva, por desha dhe ju gënjeva"* .

Në gjykimin e figurës dhe kontributit të Thimi Mitkos mbajmë parasysh aksiomën që, meritat historike nuk çmohen në bazë të asaj që nuk dhanë njerëzit e shquar në krahasim me kërkesat e sotme, por në bazë të asaj që ata dhanë të re në krahasim me paraardhësit e tyre.

Si i tillë, kontributi i Thimi Mitkos ka të bëjë me përpjekjet për mbledhjen dhe publikimin e thesarit shpirtëror të popullit, për ta shpëtuar prej harresës, për interesa kulturore, për studimin e traditave kulturore dhe historise kombëtare, ndaj me të drejtë "Bëleta Shqypëtare" është cilësuar nga mendimi kritik si -**topographia sacra**- e historisë dhe traditës shqiptare.

MIRELA SARAÇI (GJIROKASTËR)

KONTRIBUTI I THIMI MITKOS NË KULTURËN E RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE.

Në këtë kumtesë do t'i referohemi veprimtarisë patriotike, folklorike, gjuhësore, publicistike e letrare të Thimi Mitkos.

Në këtë kohë për çështjen e Rilindjes Kombëtare kemi një plejadë të tërë rilindësish që morën pjesë dhe ndihmuan duke sjellë shumë vepra letrare, studime historike, publicistike dhe traktate politike kushtuar Shqipërisë. Lëvizja për shkollën dhe librin shqip shërbeu si pikënisje për lëvizjen kombëtare shqiptare.

Nëse flasim për rëndësinë e Rilindjes Kombëtare si lëvizje kombëtare dhe kulturore, nuk mund të anashkalojmë figurën e Thimi Mitkos. Ndonëse pa shkollimin e duhur për një personalitet të këtyre përmasave, por me një njohje dhe përvojë të gjerë jetësore, ai shquhet për një veprimtari të shumëllojshme intelektuale, si gjuhëtar, mbledhës folklori, poet, gazetar, botues, etj.

Përfshirja e tij në këtë lëvizje, në një moment historik mjaft kritik, shërbeu si nxitje për shumë figura të tjera, si N.Veqilhaxhi, J.Vreto, N. Frashëri, etj. Në këtë lëvizje rilindësit ngritën zërin për arsimin duke theksuar se ai është faktori kryesor i emancipimit kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve.

Thimi Mitkoja derdhi gjithë pasionin dhe energjinë e tij veçanërisht në çështje si arsimimi i shqiptarëve dhe afirmimi i kulturës kombëtare. Duke bashkëpunuar me këmbëngulje me shumë patriotë të tjerë shqiptarë ai u bë përçues i ideve më themelore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Lidhur me këtë figure R. Qosja shprehet: "Thimi Mitkoja është autor me pikëpamje plotësisht të formuara historike, politike dhe kulturore, sepse është autor me vetëdije plotësisht të formuar kombëtare"[1015].

Idetë e Naum Veqilharxhit në skicimin e programit që do të paraqiste te lëvizja e Rilindjes Kombëtare, synimi i Jani Vretos, veprimtaria kulturore, patriotike dhe politike e arbëreshëve të tjerë si edhe veprimtaria folklorike e Thimi Mitkos tregonin vlerat dhe bindjet e tyre për zhvillimin e Rilindjes Kombëtare.

Gjatë kësaj periudhe përmendim Naum Veqilharxhin, i cili më 1844 botoi një abetare të vogël në gjuhën shqipe të titulluar "Evëtar" të shkruar me një alfabet të posaçëm të sajuar prej tij. Nëpërmjet veprave të tyre ata donin të përçonin në popull një kulturë të veçantë duke pohuar se me botimin e veprave të tyre shqiptarët i kishin ruajtur dhe krijuar në mënyrë të mrekullueshme vargjet artistike dhe thesaret e paçmueshme të letërisë popullore shqiptare.

Kontributi i Thimi Mitkos, bëhet dyfish i rëndësishëm për lëvizjen e Rilindjes Kombëtarë, po të marrim parasysh faktin se ai u bë një zë i fortë i Shqipërisë në botë

[1015] Qosja, Rexhep. " Historia e letërsisë shqipe", Romantizmi II, Prishtinë, 1984, fq.273.

nëpërmjet botimeve në gazeta të ndryshme jashtë vendit, si "Pandora" (Greqi), "Fiamuri i Arbrit", etj. Nëpërmjet prezantimit të kulturës popullore, të historisë së lashtë, nëpërmjet sprovave studimore në fushë të gjuhësisë dhe nëpërmjet artikujve polemnizues lidhur me çështjen kombëtare, Thimi Mitkoja i prezantoi shqiptarët dhe Shqipërinë përpara opinionit botëror si popull me një të kaluar historike të pasur dhe me unitet kulturor.

Qëndrimi në vende të ndryshme të Evropës, vende me histori të pasur kulturore dhe letrare, si: Austria, Italia, Rumania, Gjermania, etj., i mundësuan njohjen me rrymat dhe drejtimet letrare me në zë të kohës si: iluminizmi, romantizmi, etj. e sidomos me lëvizjet nacionaliste të popujve. Thimi Mitkoja dha një kontribut të madh për mbledhjen dhe botimin e thesarit shpirtëror popullor. Kështu, më 1878 ai do të botojë në Aleksandri përmbledhjen e parë të letërsisë popullore shqiptare "Bëleta shqypëtare". Me këtë vepër Thimi Mitkoja do të sjellë lëndën më të çmueshme të historisë dhe të kulturës të thesarit shpirtëror të popullit shqiptar. Sipas Rexhep Qoses kjo përmbledhje "do të jetë gjatë gjithë kohërave një prej përmbledhjeve më të bukura të letërsisë popullore shqipe, gati si një antologji e kësaj letërsie"[1016].

Thimi Mitkoja si një nga figurat më të shquara në fushën e botimeve folklorike dha një kontribut të madh dhe në njohjen e vlerave artistike dhe morale të popullit shqiptar, gjithashtu dhe për njohjen e traditave, zakoneve dhe këngëve të ndryshme folklorike.

Kontributi i tij shprehet qartë edhe në letërkëmbimin e tij me disa personalitete të rëndësishme të Rilindjes si: De Rada, Dh. Kamarda etj., në të cilin dëshmon për pikëpamjet iluministe me të cilat është mbrujtur kjo figurë. Letërkëmbimi i tij me bashkatdhetarë dhe me studiues të huaj e merr pikënisjen nga interesat dhe shqetësimet për çështjen gjihësore. Thimi Mitkoja i dha lëvizjes kombëtare jo vetëm veprën e tij të vyer "Bëleta Shqypëtare", por edhe gjithë energjinë e tij si ideolog dhe si aktivist i palodhur në dobi të çështjes kombëtare shqiptare. Veprën e tij "Bëleta Shqypëtare"1878, ai e quan thesar shpirtëror. Me këtë vepër ai dëshmon se ishte kujdesur t'u përmbahet me kujdes porosive që u kishte dhënë të tjerëve në mbishkrimin e shkollës së Korçës. Në këtë letër më 22 prill 1845 tregohet se me sa entuziazëm u prit dhe me sa shpejtësi u përhap në Shqipëri abetarja e parë shqipe ku shkruhej "Të gjithë i morën me të madh gëzim e kënaqësi duke lavdëruar e hyjnizuar Zotin e plotfuqishëm që ju ndriçoi mendjen të bëni në gjuhën tonë shkronja që prej kaqë shekujsh kombi ynë ka qenë privuar për të treguar historinë e tij"[1017].

Thimi Mitkoja i ishte kushtuar mbledhjes së kulturës të popullit për ta shpëtuar atë prej harresës, për të kënaqur kërkesat kulturore kombëtare, për të ndihmuar studimin e traditave kulturore. Lënda folklorike që pasqyrohet te "Bëleta

[1016] Qosja, Rexhep. " Historia e letërsisë shqipe", Romantizmi II, Prishtinë, 1984, fq.285.
[1017] Qosja, Rexhep. " Historia e letërsisë shqipe", Romantizmi II, Prishtinë, 1984, fq.288.

Shqypëtare" do të jetë burim i nxitjeve në romantizmin shqiptar më tepër se asnjë vepër tjetër e letërsisë shqipe deri në atë kohë. Thesarin popullor Thimi Mitkoja e mbledh jo vetëm " që t'u bëhet mësim i përbashkët gjithë shqiptarëve pa ndryshim mendimi politik ose feje", por që t'u " bëhet edhe filologëve që studiojnë, një shkak për studime edhe mendime të tjera etnologjike më të mbaruara"[1018].

Me materialet që na jep Mitkoja në veprën e tij, pasqyron një kuadër të gjerë vlerash autentike dhe një trashëgimi folklorike shqiptare. Me këtë përmbledhje Thimi Mitkoja është kujdesur të mbledhë krijime popullore të gjinive, llojeve dhe formave të ndryshme. Ai ka mbledhur këngë të vegjëlish, këngë dashurie, këngë dasmash, këngë që këndohen në muajin maj, këngë që këndohen kur bie shi, këngë që i kushtohen hënës, këngë për lulet e zogjtë, këngë të motmotit, këngë për festat, këngë të nizamit, këngë epike, balada, këngë historike, përralla, fabula, anektoda, gjëegjëza, emra myslimanësh dhe të krishterësh etj, duke mbledhur me kujdes çdo gjë që tërhiqte vëmendjen si dëshmi e një trashëgimie të vyer kulturore e artistike.

Botimin e tij ai e quan si "të shkuarën më të përshtatshme për zgjuarjen dhe bashkimin e shqiptarëve" sepse këto thesare popullore, duke qenë fryt i gjenisë krijuese të masave, duke lindur jashtë dallimeve krahinore dhe fetare, nën frymën e dashurisë për liri "e cila është karakteristika kryesore e shqiptarëve", ka për të qenë këndimi më i kënaqshëm si i të krishterit, edhe i muhamedianit", si i banorit të veriut ashtu edhe i atij të jugut"[1019]. Me "Bletën shqiptare" Thimi Mitkoja paraqet një monument kulture, një dëshmi të shkëlqyer dhe të rrallë të një trashëgimie shumë të pasur mendore, morale e shoqërore. Kjo vepër është cilësuar si monumenti i parë dhe më i qartë i ekzistencës së shqiptarëve si komb. Në parathënien e veprës ai thotë se: "Qëllimi i Bletës është shpëtimi dhe dhënia e brezave që vijnë, i fjalëvet dhe tekstevet shqipe të cilat para disa vjetësh i mblodha me shumë mundim e shpenzime dhe besoj se do të kenë një vleftë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare, veçanërisht dua që t'i ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë për kulturën dhe për të studiuar gjuhën e tyre amtare që në këtë mënyrë t'u sjellë dobi që të mundin edhe këta të përparojnë"[1020].

Si përfundim do të theksonim se me kontributin e tij, Thimi Mitkoja plotësoi gjithë mendimin e figurave të tjera të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Me kontributin që përcjell vepra e tij në letërsinë shqiptare, emri i Thimi Mitkos zë një vend nderi në historinë e folkloristikës dhe të letërsisë shqipe si një folklorist dhe mendimtar i shquar i Rilindjes. Ai i dha lëvizjes kombëtare jo vetëm veprën e tij të vyer "Bëleta shqypëtare" por edhe gjithë energjinë e tij si ideolog dhe si aktivist i palodhur në dobi të lëvizjes shqiptare.

[1018] Qosja, Rexhep. " Historia e letërsisë shqipe", Romantizmi II, Prishtinë, 1984, fq.291.
[1019] Mitko, Th. " Bleta shqiptare" parathënia, fq.42.
[1020] Mitko, Th. " Bleta shqiptare" parathënia, fq.41.

Të gjitha tekstet që trashëgojmë sot prej tij kanë jo vetëm vlerë historike dhe kulturore, por dëshmojnë qartë se kjo vepër është një nga gurët më të rëndësishëm në krijimin dhe afirmimin e identitetit kombëtar shqiptar.

NELI NAÇO (KORÇË)

"BLETA SHQIPTARE" SI MEMORJE KULTURORE DHE HISTORIKE

Memorja kulturore është një term që vjen nga disiplinat e arkeologjisë dhe ka gjetur një përdorim të gjerë në studimet kulturore. Termi është krijuar nga Jan Assmann dhe nënkupton sipas tij "dimensionin e jashtëm të memories njerëzore". Po e përdorim termin memorie kulturore për të shenjuar krijimet, konstruktet dhe veprat, të cilat, të krijuara në një kohë të shkuar të dhënë ndikojnë dukshëm në vazhdimësinë kulturore, janë ndikuese në kontekstet e reja dhe shpjegojnë edhe kontekste më të vona historike dhe kulturore. Memorja historike është ruajtja e zhvillimeve historike kombëtare, të ruajtura në këto krijime, konstrukte dhe vepra. Ajo është vetëm një pjesë e memorjes kulturore, por që duhet dalluar për disa karakteristika specifike si një pjesë e saj.

Për të mbështetur ideologjinë e vet mbi të cilën ndërton këto "këndime albanologjike" Thimi Mitkoja ka zgjedhur një shprehje të Herderit që thotë "Një komp nuk munt me as një mënyrë tjetër të dalë pe barbarismës, përveç se dyke punuar gjuhën e vet."[1021]

Herderi është ai që i ka dhënë rëndësi kulturës popullore dhe ka krijuar frazën "kulturë popullore" (*Kultur des Volkes*), duke e vënë përballë me "kulturën që mësohet" (*Kultur der Gelehrten*). "Ajo çka është e re tek Herderi dhe vëllezërit Grimm si dhe ndjekësit e tyre është, së pari, mëshimi i vëmendjes mbi popullin dhe, së dyti, bindja e tyre që 'sjelljet', zakonet, ritet, supersticionet, baladat, proverbat e të tjera, ishin pjesë e një tërësie më të madhe, që shprehte shpirtin e një kombi të caktuar."[1022]

Veprat folklorike ndihmojnë në hulumtimin e memories historike dhe memories kulturore. Ato janë së pari vetë mediumi që fikson, ruan, konservon këtë memorie historike dhe kulturore, por edhe vetë janë objekt i kujtesës.[1023]

Mbledhja e thesarit folklorik prej Thimi Mitkos për shkak të rrethanave në të cilat mblidhet , shfaq disa cilësi të caktuara të rëndësishme. Materiali i Mitkos përbën një mbledhje të krijimtarisë folklorike të shtrirë në një rrafsh të gjerë, një mbledhje sinkronike këngësh e cila na lejon të arrijmë në disa përfundime të cilat mund të fillojnë me krahasimin e materialit folklorik. Nuk do ta lejonte plotësisht këtë vëzhgim nëse mbledhja e materialit folklorik do të ishte qoftë e një kohe të caktuar, ose e përsëritur në mënyrë diakronike vetëm në një zonë të caktuar folklorike. Thimi Mitkoja mbledh në mënyrë sinkronike një material që përfaqëson

[1021] Thimi Mitko, *Bleta shqiptare*, 1924, përgatitur nga Gjergj Pekmezi, faqe 11.
[1022] Peter Burke, *Popular Culture in Early Modern Europe*, Harper Torchbook, London, 1978, faqe 8.
[1023] Shih Astrid Erll and Ann Rigney, *Literature and the Production of Cultural Memory: Introduction*, European Journal of English Studies, 10:2, faqe 111-115.

thuajse gjithë trevat shqiptare dhe e sistemon atë sipas llojit dhe karakteristikave të zhanrit dhe jo sipas trevave prej nga buron kjo memorie kulturore.

Duke u marrë me llojet e zhanreve që Thimi Mitkoja ka në shumëllojshmërinë e këngëve folklorike të mbledhura, shohim grupet si më poshtë.

Kënga të motshme. Alegorike edhe komike
Kënga që këndohen ndër disa ditë të shënuar
Kënga shqype dasmore
Kënga shqype trimërishte
Kënga shqype trimërishte Gegërishte

Kjo memorie kulturore mund të ndahej në dy grupe bazë, grupe që do të paraqesnin një ndarje e cila do të përfshinte 1. këngët e motshme dhe ritualistike dhe 2. këngët trimërishte. Grupi i parë, pra i këngëve të motshme, këngët e ditëve të shënuara dhe këngët dasmore vijnë nga tradita të lashta të ruajtjes së ritit, respektimit të tij riprodhimit thuajse ekzakt të tyre dhe pandryshueshmërisë rituale. Në pjesën më të madhet tyre, po të shohim formën e poezisë gojore, artikulohen nga fëmijët dhe gratë. Këngët trimërishte pavarësisht zonës së krijuar janë pjesë e memories historike kulturore dhe janë pjesë e një sinkronie dhe historie thuajse bashkëkohore. Nuk vijnë nga histori të shkuara apo të lashta, por janë thuajse të freskëta dhe nuk reflektojnë thellësinë e kohërave. Janë histori me një objektivitet të dukshëm dhe personazhet e tij përfaqësojnë një memorie të kthjellët historike, siç nuk duket të ndodhë në memorien kulturore arbëreshe ose në grupet e sipërpërmendura. Këto këngë duhet të jenë artikuluar kryesisht nga burrat.

Disa probleme që lidhjen me memorien historike dhe sinkroninë që reflekton kënga trimërishte në veprën “Bleta Shqiptare” të Mitkos mund të zbulohen fare qartazi nga mungesat. Pa i hyrë një trajtimi të gjatë mbi këtë çështje mund të verifikojmë fare qartazi që mungojnë krijimet trimërishte që lidhen me figurën e Skënderbeut. Tek kënga trimërishte figura e tij duhej të ishte e pranishme patjetër. Ideologjia e Rilindjes Kombëtare do ta kërkonte një gjë të tillë, por kjo figurë nuk është e pranishme sepse memoria historike i nënshtrohet qartazi aktit të harresës.

Aleida Assmann thotë: “Kur shqyrtojmë më afër këto praktika kulturore, ne mund të dallojmë midis dy formave të harresës, një që është më aktive dhe një tjetër që është më pasive. Të harruarit aktiv është përfshirë në akte të qëllimshme të tilla si fshirit dhe të të shkatërruarit. Aktet e të harruarit janë një pjesë e domosdoshme dhe konstruktive e transformimeve të brendshme shoqërore; ato janë, sidoqoftë, shkatërruese me dhunë kur drejtohen ndaj një kulture të huaj ose ndaj një minoriteti të keqtrajtuar. Censura ka qenë një instrument i efektshëm, edhe nëse jo gjithmonë i suksesshëm, për të shkatërruar produktet kulturore materiale dhe mentale. Forma pasive e harresës kulturore është e lidhur me akte të pa qëllimshme të tilla si të humburit, të fshehurit, të hallakaturit, të braktisurit, të

abandonuarit ose të lënët pas dore. Në këto raste objektet nuk janë të shkatërruara materialisht: ato dalin jashtë kufijve të vëmendjes, vlerësimit dhe përdorimit."[1024]

Figura e Skënderbeut, veprat kushtuar asaj i janë nënshtruar me sa duket këtyre transformimeve shoqërore që veprojnë në memorien kulturore të individit, ajo me sa duket ka qenë produkt i të dy formave të harresës, asaj aktive dhe i asaj pasive. Edhe nëse do të kishim përmendje të rralla të saj brenda veprës "Bleta shqiptare" përsëri ky fenomen do të quhej që i nënshtrohej procesit të harrimit të memories historike. Një term i përdorur për fenomenin në totalitet, i cili është edhe më i pëlqyeshëm, për shkak të domethënies dhe rezultatit që bart, në rastin tonë, harresa përfundimtare, është "amnezi sociale" ose "amnezi kulturore"[1025].

Memorja historike e periudhës kur u mblodh "Bleta Shqiptare" është e njëanshme. Nuk janë të pranishme dy anët e saj të dallueshme, memoria erudite, shkencore dhe memorja kolektive. Për shkak të rrethanave historike ky ndryshim nuk funksionon si në vendet e tjera europiane. Sipas Burkes: "Halbwachsi bëri një dallim të mprehtë midis memories kolektive, e cila ishte një konstrukt social dhe historisë së shkruar, të cilën ai e konsideronte – në mënyrë tradicionale – se ishte objektive."[1026]

Mitkoja ka në dorë vetëm njërën anë të medaljes, atë të memories kolektive dhe pjesën tjetër historinë e shkruar përpiqet që ta rindërtojë vetë duke mbledhur fakte dhe të dhëna historike për ngjarjen, duke bërë deri diku edhe vetë pjesën e historianit objektiv dhe duke e mbushur me fakte të plota fragmentin historik, letrar – popullor duke u përpjekur që këtë letërsi folklorike të transfiguruar të përpiqet ta vendosë sado pak në një sfond historik. Në këtë mënyrë i relativizon vlerat letrare dhe i bën ato të hapura ndaj pikëpamjeve të ndryshme. Kjo mund të bëhet me tekste të gjata, ndonjëherë duke ju referuar edhe historianëve profesionistë, ose me tekste të shkurtra, thuajse një fjali, që sidoqoftë sqarojnë sfondin historik dhe krijojnë një opinion tjetër për veprën. Plotëson si të thuash mungesën e një historie të institucionalizuar dhe sqaruese të problemit. Ai ka qenë kështu në një pararojë të mendimit historik. Ai realizon kështu një subjektivizim të ngjashëm me atë që pranohet për vepra të mirëfillta historike. Mund të themi se sqarimi i tij për vepra, në dukje me origjinë mitike a mitologjike, çmitologjizon shpeshherë qëndrimet në vepër. Ka një lëvizje historike sipas Natalie Davis që fillon nga vitet 1960 kur historianët kthjellohen në të kuptuarit e "historisë orale". Ajo thotë që "madje dhe historianët që punojnë mbi periudha më të hershme, kanë diçka për të mësuar nga lëvizja e historisë orale, meqë ata kanë nevojë të jenë të dijshëm për dëshmitë dhe traditat orale të mishëruara në shumë burime të shkruara"[1027]

[1024] Aleida Assmann, *Canon and Archive*, në *Cultural Memory Studies*, Walter de Gruyter, Berlin, 2008, faqe 97-98.

[1025] Peter Burke, *What is Cultural History?* (Second Edition) Polity, Cambridge 2008, faqe 67.

[1026] Peter Burke, *Varities of Cultural History*, Corell University Press, Ithaca, New York, 1997, faqe 45.

[1027] Natalie Davis cituar sipas Peter Burke, *Varities of Cultural History*, Corell University Press, Ithaca, New York, 1997, faqe 46.

Mbledhja e folklorit në veprën e Thimi Mitkos shkon nga këngët për figura të njohura historike deri tek figura historike të panjohura ose që rëndësia e tyre është zbehur për shkak të së sipërpërmendurës "amnezi sociale". Ajo shkon nga historia deri tek një zhanër i quajtur "mikro - histori". Shumë figura historike lokale të dorës së dytë apo të dorës së tretë kanë shpëtuar nga kjo "amnezi sociale" vetëm nga kontributi i madh i këtij folkloristi me veprën "Bleta Shqiptare". Në fakt i gjithë sfondi i këtyre këngëve të mbledhura nga Mitkoja i ngjan këngëve që kanë të bëjnë me mikro - histori. Ajo ka vlerë në ruajtjen e kulturës regjionale, dijeve lokale dhe proceseve të forta të fshirjes globalizuese. Nëse procesi do t'i ishte nënshtruar amnezisë kulturore me "Kënga të motshme. Alegorike edhe komike", "Kënga që këndohen ndër disa ditë të shënuar", "Kënga shqype dasmore" nuk do të kishim humbur fort, sepse vlerat ndonëse të ndryshme, relative dhe variable janë deri diku të përsëritshme, me "Kënga shqype trimërishte" dhe "Kënga shqype trimërishte Gegërishte" do të kishim humbur një pasuri të vlefshme që shpëton nga humbja përmes botimit të "Bletës shqiptare".

"Bleta shqiptare" është një vepër e cila mund të shpjegojë shumë për antropologun dhe për etnologun. Në plot raste kjo memorie historike e realizon një gjë të tillë dhe është një dëshmi që mund të hedhë dritë mbi të dhëna që flenë në këngët e Thimi Mitkos. W. H. R. Rivers pohon: "Pika e parë që konstatohet është që, si rregull, etnologu, duhet të zbulojë historinë e shkuar të njerëzve që nuk kanë dokumente të shkruara të ndonjë lloji, dhe traditat orale të të cilëve janë kaq të përziera me veçori dukshëm mitike në karakter, sa që ka nevojë për një disiplinë speciale për të dalluar nivelin e historicitetit të tyre ose, në të vërtetë, në plot raste për të vendosur nëse ato kanë ndonjë vlerë historike në fund të fundit. Tashmë është zbuluar që, atje ku traditat autoktone duket se regjistrojnë ngjarje historike, konkluzionet e nxjerra prej tyre janë në përputhje me ato që arrihen nëpërmjet linjave të tjera të sigurimit të të dhënave"[1028]

Kjo vepër në pikëpamjen e memories kulturore, sociale dhe historike duhet studiuar edhe më tepër në thellësinë e vet.

[1028] W. H. R. Rivers, *History and Ethnology*, Society for Promoting Christian Knowledge, London, 1922, faqe 7.

SOKOL SUPARAKU (KORÇË)

THIMI MITKOJA SI AKTOR I EPOKËS MODERNE DHE I PËRHAPJES SË NACIONALIZMIT

Kur flasim për lidhjen midis veprëssë Thimi Mitkos dhe modernitetit në kuptimin më gjithpërfshirës të fjalës, kemi parasysh rolin që ka pasur vepra e tij në kontekstin shqiptar të kësaj periudhe dhe, gjithashtu, ndikimin që moderniteti pati në veprën e Mitkos. Pra qëllimi i këtij punimi është kontekstualizimi historik i veprës së Mitkos, interpretimi i kësaj vepre nëpërmjet një qasjeje relativiste, si nga pikëpamja historike si nga ajo antropologjike.

Termi "modernitet" këtu i referohet asaj periudhe historike që në studimet shoqërore përkon me fillimin e shek. XIX (me fundin e shekullit pararendës). Për sa i përket zvillimeve shoqërore, kjo periudhë përkon me shfaqjen e një sërë risish në teknologji, kulturë, zhvillime sociale dhe politike. Në rastin tonë na intereson fusha e zhvillimeve kulturore dhe politike. Në këtë fushë termi dhe koncepti kyç për kuptuar këtë realitet është ai i "nacionalizmit". Siç e thotë dhe vetë prapashtesa ky term tregon që kemi të bëjmë me një ideologji sociale, e cila ka të bëjë me teorizimin e kombit dhe realizimin politik të tij. Teoricienët të cilët e kanë zbërthyer më së miri këtë ideologji (pra ata që merren me analizën kritike të saj), quhen "modernistë". Këta studiues, që më shumti i përkasin fushave të antropologjisë, sociologjisë dhe historisë sociale, e kanë marrë etiketimin si modernistë pikërisht sepse mbrojnë pikëpamjen se nacionalizmi është një dukuri që lind me Epokën Moderne, e cila korrespondon me fundin e shek. XVIII dhe, që si datë simbolike e shfaqjes më të bujshme ka vitin 1789, viti i Revolucionit Francez[1029] (rrugëtimi i kësaj epoke shkon deri në vitet e fundit të shek XX, ku dhe flitet për fillimin e epokës postmoderne, ose postnacionale).

Ideja kryesore mbi perceptimin e kombit që lindi nga Revolucioni Francez ishte "vetëvendosja e popujve". Kjo nënkuptonte që fati i popujve nuk duhet të ishte më në duart e klasave të larta, përfshi dhe vetë familjet mbretërore dhe, që nuk përfaqësonin interesat e popujve, por ato të vetat, duke bërë që pjesa më e madhe e shoqërisë të mbetej e varfër dhe e pashkolluar dhe si pasojë e paemancipuar. Në bazë të këtyre zhvillimeve të reja qëndronte shfaqja e një klase të re sociale që kishte lindur përgjatë zhvillimit të industrisë dhe teknologjisë, borgjezisë. Sipas Ernest Gellner ishte industrializmi ai që bëri të mundur krijimin e kushteve për lindjen e një shoqërie të re, "shoqërsë së masave" dhe lindjen e borgjezisë, si rrjedhim pabarazia e përhapjes së industrializmit është motivi i pabarazisë në

[1029] Në fakt një nga veprat më tërëndësishme në lidhje me nacionalizmin, ajo e Eric, J Hobsbawm, jo më kot titullohet: *Kombet dhe nacionalizmi, nga 1780,(Nations and Nationalism since 1780. Programe, myth, reality,* Cambridge University Press, 1990.

përhapjen e nacionalizmit gjë që e ndau njerëzimin në grupe rivale"[1030]. Kështu, edhe zhvillimi i borgjezisë nuk do të ishte i njëjtë, për pasojë disa popuj do të kishin më shumë e ca të tjerë ca më pak borgjezi, duke bërë që edhe përhapja e ideologjisë kombëtare të ishte jo e barabartë.

Nga ana tjetër, Benedict Anderson[1031] tregon se një element i rëndësishëm për të kuptuar përhapjen e nacionalizmit është lindja e shtypit të shkruar dhe shtypja e teksteve në gjuhët kombëtare. Kështu prirja për përhapjen e arsimit bënte që popujt të gjenin kënaqësi në rritjen e prestigjit të gjuhës dhe kulturës së tyre kombëtare, dhe kjo e bënte më të lehtë legjitimimin social të klasës së lartë, kryesisht asaj borgjeze, e cila zakonisht merrej me edukimin kombëtar ose zgjimin e identitetit kombëtar të popullit. Ishte kjo arsyeja që nga mesi i shek. XIX u përhap shumë numri i filologëve dhe folkloristëve të cilët kishin si qëllim emancipimin e kulturave të origjinës së tyre nga niveli tradicional i mëparshëm. Edhe në këtë rast vlen të theksohet se nacionalizmi dhe suksesi i kulturave kombëtare ishte i varur nga shkalla e zhvillimit të gjuhës dhe të kulturës së një vendi të caktuar.

Këto përfundime paraprake janë të rëndësishme për të kuptuar edhe natyrën e këtyre zhvillimeve në Ballkan dhe Shqipëri. Përhapja e nacionalizmit në këtë territor do të ndikohej jo vetëm nga shkalla e përhapjes së industrializimit apo të ideologjisë kombëtare, ose të ideve të romantizmit mbi kombin, por edhe falë një imperializmi, ose "nxitjeje" nacionaliste që vinte nga kombe më të përparuara mbi ato më të prapambetura. Në fakt, që në fillim, format e ndryshme të nacionalizmit evropian u zhvilluan falë një gare reciproke ndërmjet atyre shteteve që më pas do të quheshin "Fuqitë e Mëdha" dhe do të ishin eksportuesit e nacionalizmit në vendet e vogla.

Për Guy Hermet vetë zhvillimi i nacionalizmit romantik, pra romantizmit gjerman, është pasojë e drejpërdrejtë e pushtimit të Gjermanisë nga republika e re franceze, që vetëquhej "Republikë Universale" dhe impononte botëkuptimin e saj mbi kombformimin; për këtë arsye "shoqëria gjermane reagonte ndaj hegjemonisë franceze, jo sipas parimeve të qytetarisë së përbashkët, por sipas parimit të bashkimit gjuhësor"[1032]. Pra, nën këtë shembull do të kemi edhe zhvillimet ndërmjet nacionalizmave fqinje në të gjithë globin. Gjithashtu, ideologjia nacionaliste do të konsolidohet edhe me prurjet e romantizmit në lëmin e kulturës kombëtare. Sidoqoftë, për kombet me kulturë të shkuar më pak të përparuar, përhapja e këtyre ideve do të ishte e vështirë për t'u përqafuar, edhe pse prirja e intelektualëve që merreshin me kërkime mbi kulturën kombëtare ishte një konstante e të gjithë shoqërive, por diku më shumë e diku më pak. Në ata popuj evropianë që gjendeshin në periferi të Europës së zhvilluar përparimi i nacionalizmit do të kryhej nëpërmjet një patronazhi të fuqive të mëdha dhe kërkesat nacionaliste ishin të drejtuara më shumë nga dëshira e pavarësisë politike se sa nga vetëdija një identiteti të veçantë

[1030]E.Gellner, *Nazioni e Nazionalismi*, Editori Riuniti, Roma 1997, f. 60.
[1031] B. Anderson, *Comunità Immaginate*, Manifestolibri, Roma 1996, f.101.
[1032]G. Hermet, *Nazioni e Nazionalismi in Europa*, il Mulino, Bologna, 1997, f. 120.

etnik. Kështu për Plumyéne përhapja e nacionalizmit në Greqi, si rasti më i famshëm i eksportimit të kësaj ideologjie të re për kohën, ishte një pasojë e filhelenizmit europian, i cili mund të konsiderohet një "nacionalizëm në transfertë", "meqë çështja e përqafuar nga filhelenët është çështja e një vendi tjetër"[1033]. Sa i përket popullsisë lokale në ato kohë ajo perceptohej me identitet kristiano-ortodoks dhe me shtetësi otomane, "dhe nuk ia kishte idenë Greqisë pagane". Ndërsa ata pak grekë nacionalistë "janë grekët e perëndimorizuar, janë tregtarët dhe armatorët, të drejtuar nga aktivitetet e tyre ekonomike drej porteve të Mesdheut dhe kryeqyteteve evropiane dhe në kontakt me atë ide mbi Greqinë që vlonte në sallonet romantike evropiane"[1034].

Kjo ishte atmosfera e hyrjes së ideologjisë nacionaliste dhe në Shqipëri, ku sigurisht do të depërtonte fillimisht në mendjet e inteligjencës lokale e cila ishte në kontakt me këto zhvillime. Këta intelektualë që u përkisnin shtresave të larta të shoqërisë dhe sigurisht asaj shtrese të re që ishte borgjezia tregtare do të ishin edhe propaganduesit e nacionalizmit romantik shqiptar. Pra kjo ishte në linja të përgjithshme ardhja e modernitetit në territorin shqiptar. Thimi Mitkoja, me jetën dhe veprën e tij, me pozicionin e tij social, një pjesëtar i borgjezisë kombëtare dhe një personazh i rëndësishëm i jetës politike dhe kulturore të shoqërisë shqiptare gjatë shek. XIX, është një nga simbolet më përfaqësues të kësaj epoke.

Siç e dimë, Mitkoja ishte një intelektual i Rilindjes i frymëzuar me idetë emancipuese dhe laike që lindën nga Revolucioni Francez dhe nga Romantizmi. Këtë bindje na e tregon që në hyrje të "Bletës Shqiptare" kur Mitkoja citon edhe Herderin: "Një komb nuk mund, me asnjë mënyrë tjetër të dalë nga barbaria, përveç se duke punuar gjuhën e vet"- thotë Herderi. Edhe shqiptarët [...] do të mundin të ndriten dhe të humbasin ngjyrën e padijes së tyre vetëm duke studiuar gjuhën e tyre amtare"[1035]. Kjo ishte arsyeja për të cilën ai u bë tribun i emancipimit kulturor të etnisë shqiptare, i civilizimit të shoqërisë shqiptare. Për këtë arsye kundërshtonte përpjëkjet asimiluese që vinin nga ajo pjesë e shoqërisë greke e lidhur ngushtë me moralin dhe botëkuptimin fetar, ortodoks:

"Përpjekjet e cave të mbytin gjuhën me përdorimin e shtrënguar të greqishtes, ta thëthinë racën shqiptare ose ta shuajnë edhe ta bëjnë sikur ska qënë, është një gabim i tmeruar [...] një politikë e kalbur e pikëpamjes së padenjë të idesë së madhe («megali idhesë»), si fjala vjen politika kishëtare e Patrikanës së Stambollit edhe e qeverisë së Athinës kundër Bullgarisë, e cila politikë, në vend të bashkimit, solli përçarje dhe, në vend të bindjes edhe të thëthitjes, pruri mëri race të papajtuar.[1036]

Siç shihet, në këto rreshta kemi manifestimin e asaj përplasjeje që kishte karakterizuar nacionalizmin edhe në rastin e Francës "universaliste" me Gjermaninë

[1033] J, Plumyéne, *Le Nazioni Romantiche, Storia del nazionalismo nel XIX secolo*, Sansoni, Firenze, 1982, f. 203.
[1034] Po aty, f. 196-7.
[1035] Q, Haxhihasani (Përgj.,), *ThimiMitko, Vepra*, ASH, Tiranë 1981, f.61.
[1036] Q, Haxhihasani, *ThimiMitko. Vepra*, ASH, Tiranë 1981, f.61.

"romantike" dhe këtu Mitkoja shndërrohet në një intelektual romantik që denoncon njëfarë imperializmi të ri. Por në të njëjtën kohë ai ishte dhe intelektual i një shoqërie që i kalonte kufijtë etnikë, sepse duke publikuar në greqisht, duke e trajtuar argumentin e kulturës shqiptare në gjirin e shoqërisë greke, ai kontribuonte edhe në iluminimin e kësaj të fundit. Në fakt qëllimi i Mitkos, siç do të shkruante në hyrjen e "Bleta Shqiptare", ishte emancipimi i shoqërisë shqiptare në gjirin e kulturës mëmë greke:

"po të mësohej shqiptari në gjuhën e tij amtare nga mësonjësit dhe kleri me mendime greke, edhe në
qoftë se mbillej tek ay idea greke me gjuhën, e tij shqipe, që flitet, kishte për të zënë rrënjë ay patriotizmi
grek edhe dija e vetëtijat aqë shumë sa të ishte i zoti të mbrojë atdheun e tij [...] edhe kombësinë greke dhe [do ta mbështeste mëndjen] te mëma Greqi, duke sjellë ndërmend gjyshërit e tij epirotët dhe maqedonët.."[1037].

Në këtë kuptim ai nuk ishte një nacionalist përjashtues që e konceptonte kombin si një entitet i bazuar tek gjuha e veçantë që dallon nga ajo e fqinjëve, por që e lidhte përkatësinë kulturore të kombit të tij mbi shumë elemente kulturore, ku bënte pjesë edhe përkatësia në një qytetërim, që ishte ai grek dhe që i referohej kulturës klasike të Greqisë antike dhe që nuk kishte të bënte me traditën fetare kristiano-ortodokse. Pra, mund të themi, që Mitkoja nuk ishte një nacionalist etnicist, që do të vinte në pah me doemos veçantinë e etnisë së tij përballë atyre fqinje, por edhe një atdhetar që e lidhte etninë e tij me përvojat qytetëruese që i kalonin kufijtë etnikë. Kështu, nëpërmjet publikimeve të tij, Mitkoja jepte një leksion qytetërimi edhe në gjirin e shoqërisë greke, e cila, për fat të keq kishte "avancuar" drejt një nacionalizmi ekskluzivist dhe monopolizonte disa elemente kulturore të përbashkëta me etnitë fqinje, siç ishin feja dhe një histori marrëdhëniesh kulturore dhe politike e përbashkët. Pra, nëse do të shpreheshim për atë se si e konceptonte ai identitetin kulturor të shqiptarëve, mund të themi me siguri se Th. Mitkoja nuk ishte një nacionalist që mëton ndërtimin e një identiteti kombëtar të bazuar në elemente kulturore diferencuese, por ishte një intelektual që kërkonte formimin e një identiteti kulturor sa më gjithëpërfshirës në mënyrë që populli të kishte një traditë kulturore sa më të pasur në funksion të emancipimit të tij. Vetëm për sa i përket formimit të një identiteti politik, mund të themi se ai ishte i interesuar për lindjen e një nacionalizmi shqiptar, por edhe ky nuk duhet parë si i mbushur me doza konfliktualiteti ndaj fqinjëve, sepse, siç e përmendëm më sipër, qëllimi i Mitkos ishte emancipimi i popullit të cilit i përkiste, gjë që mund të arrihej vetëm nëpërmjet realizimit të vetqeverisjes (për kohën duhej të realizohej pikësëpari mbas lindjes së një nacionalizmi politik).

Me kalimin e shek. XIX, andej nga dhjetëvjeçarët e fundit, nën ndikimin e zhvillimeve politike ndërkombëtare, Th. Mitkoja do të bëhej mbështetës i atij

[1037] Po aty, f. 62.

pragmatizmi politik që ndikohej më shumë nga zhvillimet politike të nacionalizmit se sa nga logjika etniciste e karakterit kombëtar. Pra, kur Greqia përfundimisht tregoi se nuk kishte ndërmend të shkonte drejt një shteti komb me baza laike të frymëzuar nga klasicizmi, por drejt një shteti-komb që mëtonte më shumë krijimin e një perandorie ballkanike të bazuar tek identiteti fetar dhe e kaluara bizantine, gjë që për Shqipërinë nënkuptonte një vasalizim të ri modern, Mitkoja u bë më shumë ithtar i një kulture shqiptare plotësisht të ndryshme nga ajo greke. Kjo tregohet në letrat që ai u dërgon aktorëve të tjerë që ishin përfshirë në formimin dhe lindjen e një kulture shqiptare kombëtare dhe më qartë në letrat e dërguara mbas viteve '70 të shek XIX, Krispit, De Radës dhe Kamardës. Me rëndësi simbolike do të ishin periudha e krizës lindore, lufta ruso-turke, Traktati i Shën Stefanit dhe Lidhja e Prizrenit si momente kyçe të fitores të një farë revizionizmi fetar mbi parimin e nacionalizmit laik dhe universal në gjirin kombeve fqinje të Shqipërisë.

Në këtë kontekst, Mitkoja do të dononconte tek De Rada veprimtarinë antishqiptare të shovinistëve grekë. Më konkretisht do të denonconte ndërhyrjen e klerit grek ndaj veprimtarisë edukative të patriotëve shqiptare dhe nga ana tjetër u jep kurajo shqiptarëve që donin ngritjen e kulturës kombëtare për rezistencë ndaj presionit të kishës greke dhe dëshirave të shqiptarëve helenistë.

Këto dëshmi historike kanë një interes antropologjik për të zbuluar gjendjen e identitetit kulturor që ekzistonte në gjirin e shoqërisë shqiptare, si p.sh. mbi zhvillimet e kulturës kombëtare tek letra për De Radën e datës 31.12.1886, ku flet për "despotin elen me disa korçarë të liq e trathtarë" që nuk donin gjuhën shqipe sepse Krishti u kish "dhënë elenishten". Ishte kjo arsyeja për të cilën Mitkoja i shkruante se "ndë Korçë te disa të kërshter' e otomanë të fortë, të mbahen fort kundrë djallëzivet elenëvet"[1038]. Kështu na paraqitet një realitet interesant (ndonëse Mitkos nuk i intereson), ku kemi dëshmi mbi etnonime që nuk i korrespondojnë imazhit tradicional të identiteteve etnike: korçarë që nuk duan shqipen se kanë elenishten, dhe disa të tjerë që paraqiten si të krishterë e otomanë por që janë mbrojtës të shqiptarizmës.

Tek ky aksion dhe pozicionim politik e kulturor të Mitkos gjejmë nevojën e një borgjezi për realizimin e një shoqërie kombëtare që i korrespondonte botëkuptimit të ri social, atij të shoqërisë civile të emancipuar nga idetë e iluminizmit dhe të kulturës kombëtare të frymëzuar nga romantizmi. Për arsye se nuk zotëronte ndonjë kompetencë akademike, Mitkoja është shumë aktiv nëpërmjet letrave të tij nxitëse dhe frymëzuese ndaj atyre figurave historike që i përkisnin më shumë se ai kategorisë së intelektualëve siç ishin Anastas Kullurioti dhe Jeronim De Rada. Mbështetja inkurajuese që u jepte Mitkoja është tregues i dëshirës së klasës së re shqiptare, borgjezisë, që po lindte dhe konsolidohej në atë kohë. Kjo ishte dhe arsyeja e lindjes dhe zhvillimit të gazetave "Zëri i Shqipërisë" botuar nga Kullurioti

[1038] Q, Haxhihasani, *ThimiMitko. Vepra*, ASH, Tiranë 1981, f. 686.

dhe "Fiamuri i Arbrit"[1039] botuar nga De Rada. Për më tepër, vetë "Bleta Shqiptare" është rezultat i këtij aktiviteti, sepse siç e dimë Mitkoja kishte mbledhur një numër të madh dëshmish folklorike për Kamardën.

Gjithashtu tek interpretimet e tij gjejmë dëshmi mbi traditën kulturore dhe folklorike, të mbledhura dhe të lartësuara nga ai, dëshirën e borgjezisë për një vlerësim social dhe ndërkombëtar nëpërmjet traditës më fisnike të kombit të cilit i përket, sepse vetëm kjo përkatësi grupore mund të shërbente si bazë për ekzistencën e kësaj klase të re, përkundër ideologjisë së deriatëhershme të klasave të vjetra, aristokracisë dhe fshatarësisë.

Kjo dëshirë manifestohet edhe tek aksioni i purifikimit të gjuhës, ku shohim vullnetin e "borgjezit nacionalist" për krijimin e gjuhës së kulluar dhe unifikuese (shih komunikimin me De Radën, ku ndër të tjera i sugjeron të përdorë një gjuhë më pak dialektale dhe më shumë të përpunuar në funksion të një versioni më kombëtar[1040]). Siç e thamë në fillim të punimit kjo ishte një nga karakteristikat kryesore të epokës moderne, sepse një gjuhë kombëtare e unifikuar ishte e domosdoshme për krijimin e uniteti politik të kombit, për funksionimin e shtetit kombëtar, që ishte institucioni kryesor për përhapjen, konsolodimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kulturës kombëtare dhe të identitetit kombëtar të popullit.

Pikërisht tek vjersha "E ndë shqyptarët gjithë sa janë" (me pseudonimin "Një shqypëtar") do të gjejmë thirrjen e Mitkos drejtuar shqiptarëve për çlirim nga pushteti otoman, duke u angazhuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në aksionin e ngritjes politike, nëpërmjet thirrjes për çlirim dhe, nga ana tjetër, për emancipim kulturor nëpërmjet shembullit të vetë vjershës. Në këtë rast është interesante, nga pikëpamja antropologjike, dëshmia se Mitkoja edhe njëherë u drejtohet bashkëpatriotëve duke i përmendur me terma që përfaqësojnë një ndarje socio-fetare si "turq e të krishterë", ndërsa antagonisti i shqiptarit, turku i vërtetë, paraqitej me termin "halldupi" dhe "osmani". Pra mund të themi se, edhe pse Mitkoja në fillim nuk ishte për konfliktin dhe ndarjen e popujve ballkanikë, kur kritikonte qëndrimin mospërfillës të Patriarkanës dhe Athinës ndaj etnisë shqiptare, por ai ishte njëkohësisht edhe kundërshtar i një botë politike dhe kulturore me të cilën shqiptarët kishin kishin pothuajse 500 vjet që bashkëjetonin. Ndoshta kjo kundërshti ndikohej nga vetë misioni socio-kulturor i Mitkos i cili, duke dashur të përhapë idetë e iluminizmit dhe të romantizmit tek shqiptarët, e lidhte pushtetin otoman me obskurantizmin e pushtetit të vjetër, atë që revolucionet sociale të kohës po mundoheshin të përmbysnin.

Padyshim që jeta dhe vepra e Mitkos na ofron një dëshmi të qartë mbi zhvillimin dhe përhapjen e frymës së re të vetëvendosjes së popujve dhe të zgjimit kombëtar përgjatë asaj epoke që në shkencat sociale quhet *modernitet*.

[1039]"Fiamuri i Arbrit" do të publikohet, më 1883, siç ai kështillonte, në shqip dhe italisht; shih: Q, Haxhihasani, *Thimi Mitko. Vepra*, ASH, Tiranë 1981, f.36.

[1040]Q, Haxhihasani, *Thimi Mitko. Vepra*, ASH, Tiranë 1981, f. 610.

Në një kohë që quhet si përmbysëse e *modernitetit*, pra postmoderne, nuk është vetëm jeta dhe vepra e Mitkos që na shërben si një udhërrëfyes për disa probleme të natyrës politike dhe kulturore që hasim në ditët tona. Në fakt, në kohët tona postmoderne ne jemi dëshmitarë të rikthimit të identitetit fetar si identitet dominant shpesh më i rëndësishëm se ai kombëtar. Në rastin e Shqipërisë këto identitete të reja shpeshherë përfaqësohen në të njëjtën kohë si përkatësi fetare dhe si përkatësi etnike, të ndikuara nga natyra e identiteteve kombëtare të shoqërive fqinje, të cilat nën diktatin e globalizimit (një term që shpesh është i shkëmbyeshëm me atë të postmodernitetit), janë gjithnjë e më ndikuese në gjirin e shoqërisë shqiptare. E kemi fjalën kryesisht për njëfarë "greqizme", ose "helenizmi", që shfaqet sërish në disa kontekste sociale të veçanta të Shqipërisë së Jugut dhe që tenton të ngrejë përplasje midis identitetit shqiptar dhe atij grek. Dhe këtu dëshmitë e Mitkos marrin një rëndësi të veçantë antropologjike, sepse na ndihmojnë të kuptojmë origjinën e harruar të kësaj dukurie. Ai na kujton se greqizma, ose helenizmi dhe shqiptarizma janë dy identitete kulturore që janë rritur bashkë nën një çati historike dhe kulturore dhe që u ndanë nga aksioni nacionalist i epokës moderne, e cila pati si qëllim të vetëm krijimin e shteteve dhe shoqërive kombëtare të ndërtuara në mënyrë ekskluzive mbi baza kulturore që duhet të ndanin dhe jo të bashkonin, duke bërë një padrejtësi ndaj zhvillimit natyror të shoqërive dhe kulturave.

VEBI BEXHETI (TETOVË , MAQEDONI)

NGA FONDI I DORËSHKRIMEVE TË THIMI MITKOS, NË DRITËN E STUDIMEVE TË JORGO BULOS

Nga shumë vatrat e kolonive, ku vepronin e krijonin rilindësit, Egjipti për shqiptarët peshon më tepër në kujtesën historike. Kjo tokë e njohur për ne, që në kohën e Mehmet Aliut, gjatë kohës së Rilindjes vazhdoi të jetë diaspora më aktive në veprimtarinë atdhetare të shumë personaliteteve, ndër të cilët u dallua edhe korçari Thimi Mitko. Ashtu si në Kolorinë e Stambollit ku vepronin rilindësit e njohur siç është Samiu dhe veprimtarët tjerë rreth tij, edhe në krahun që me kohë vepronte në Egjipt, u dalluan me veprimtarinë e vetë letrare, gjuhësore, folklorike e publicistike , shumë intelektualë e veprimtarë shqiptarë. Ata lanë gjurmë në aktivitete patriotike, kulturore dhe mbeten edhe sot figurat e ndritura të rilindjes sonë , duhet përkujtuar e nderuar bashkë me veprën e tyre. Se kjo koloni shqiptare ishte shumë aktive në këto fusha , flet edhe fakti se atje vepruan veprimtarë të shquar të Rilindjes si Thimi Mitko, A.Z.Çajupi, Th.Tashkoja , M.Duçi, J.Vruho, S.Dine, F.S.Noli, etj. Kjo diasporë për punën e veprimtarsë së vet dallohet edhe në botimin e shumë veprave që kanë bërë emër në lëtërsinë tonë siç është edhe "*Bleta shqiptare"* e Thimi Mitkos, *Baba Tomorri* e Çajupit, etj. Ky aktivitet aq i rëndësishëm i rilindësve të Egjiptit që krahas veprimtarisë së rilindësve që vepronin në Kolorinë e Stambollit , dhe në atë të Bukureshtit, përbënte fuqinë kryesore që proceset të ecin përpara. Përveç veprave të botuara, ky aktivitet i gjithanshëm i rilindësve të Egjiptit, në masë të madhe mbeti në dokumente dorëshkrimesh, pjesë nga të cilat edhe sot e kësaj dite mbeten për t'u zbuluar nëpër arkiva shtetërore edhe të vendeve të tjera.

Edhe vepra aq e gjithanshme e Thimi Mitkos, në kohën kur mendohej se është e plotë dhe si e tillë ishte në duar të lexuesve dhe studiuesve, si e kompletuar, u zbulua tepër vonë . Nga hulumtimet e vazhdueshme në kërkim të veprave si dokumente dorëshkrimesh, ata që i tejkaluan edhe parashikimet dhe e thyen pesimizmin se mund të zbulohet aq fond i pasur, ishin kërkimet e një grupi studiuesish të udhëhequr nga prof. Jorgo Bulo, i cili kishte të dhëna se vepra e Thimi Mitkos është ende e panjohur tërësisht. Për veprimtarinë e rilindësve të Egjiptit dhe për vlerat e panjohura deri atëherë shkruante edhe Dora D'Istria, e cila në letrën e datës 27 tetor 1869 që ia dërgoi Thimi Mitkos, ndër të tjera shkruante: *Një ditë kur koha dhe fuqitë e mija nuk do më mungojnë do të merrem edhe me shqiptarët e ndodhur në Egjipt, të cilët kanë kryer kaq vepra të mëdha. Megjithatë po iu rekomandojë gjallërisht atyre të mbledhin me një vëmendje më të madhe të gjitha kujtimet që e nderojnë atë koloni, rëndësia e së cilës është e jashtëzakonshme, por që edhe historia e së cilës është aq pak e njohur.*[1041] Siç

[1041] Jorgo Bulo, *Në gjurmët e rilindësve,* në " *Magjia dhe magjistarë t e fjalës"* Tiranë 1998 f.206.

shihet nga kjo letër, dërguar Mitkos, Dora D'Istria me kohë e kishte konstatuar se në këtë koloni shqiptarësh duhet të mblidhen faktet, në bazë të të cilave do të bëhen studime nga njerëz kompetentë , për t'u rrumbullaksuar kjo vlerë kombëtare e krijuar atje. Edhe profesor Jorgo Bulo, si shumë të tjerë , Aleksandrinë dhe disa qytetet tjera të Egjiptit i llogariste si terren ende të paeksploruar sa duhet, ku mund të gjenden shumë dorëshkrime, që nga korrespondenca e letërkëmbimeve, dokumente të ndryshme, e deri te veprat e pabotuara. Ai në ekspeditën e tij shkencore hulumtuese të vitit 1984, në kohën kur mendohej se me gjetjen e dorëshkrimeve folklorike në fondet e albanologut çek Jarkin, ishin shterrur burimet për të cilat ishte shpresuar deri atëherë , e arriti suksesin më të madh në gjetjen e fondit me shumë dorëshkrime të veprave të Mitkos, që sot njihen si Fondi i Aleksandrisë . Hulumtimet e profesor Jorgos, bashkë me historianin Petrika Thëngjilli, punët hulumtuese kërkimore, fillimisht i nisën në Arkivin Nacional të Kështjellës së Mehmet Aliut në Kajro, e pastaj në Bibliotekën Nacionale të Kajros, në Arkivin e shtypit në bibliotekën e Universitetit Al-Azhar, në Bibliotekën e përgjithshme dhe universitare të Aleksandrisë , në Arkivin e Kolegjit" Shën Katrinë ", po në Aleksandri dhe takimet me personalitete, të afërm e trashëgimtarë të rilindësve të njohur, ishin mjaftë frytdhënëse. Pas gjysmë shekulli kërkimesh që herë pas herë u bënë në këtë vatër me aq vlerë për studimet e filologjisë shqiptare, angazhimi i tij gjatë hulumtimit të vitit 1984 i tejkaloi të gjitha parashikimet, madje edhe skepticizmin se pas një kohe aq të gjatë kërkimesh ka mbetur diçka e pazbuluar. Për nga pasuria dhe vlera e materialeve që përmban ky fond, thotë profesor Jorgoja, ky përfaqëson një nga fondet më të mëdha që është gjetur deri atëherë për Rilindjen. Në Fondin e Aleksandrisë , përveç shumë dorëshkrimeve të Thimi Mitkos, që gjithsesi ishin më të bollshmet, bëjnë pjesë edhe shumë materiale tjera arkivore të rilindësve tjerë dhe personaliteteve të njohura me të cilët Thimi Mitkoja kishte pasur korrespondencë, si: me vëllezërit Frashëri, De Radën, Dhimitër Kamardën, Jani Vreton, Kristiforidhin, Dora D'Istrian dhe me albanologët e huaj, G.Majerin, J. U. Jarnikun, etj. Pa këto materiale dorëshkrimesh me vlera aq të rëndësishme për Mitkon dhe për shumë të tjerë , letërsia shqiptare dhe historiaografia e kësaj faze të Rilindjes do të ishte më e varfër.

Profesor Jorgo Bulo, si studiues dhe historian i letërsisë, krahas studimeve edhe të veprave tjera të rilindësve, me kohë kishte treguar interesim edhe për veprimtarinë krijuese letrare të krahut të Egjiptit, siç është edhe interesimi për Çajupin dhe veprën e tij. Duke qenë vazhdimisht i interesuar për fondin e Çajupit , ai u njoh edhe me trashëgimtarin e tij Sofokli Çapin i cili sipas profesor Bulos, me t'u kthyer në atdhe nga Egjipti , më 1957, e njoftoi ate për shumë dorëshkrime të vjetra të Thimi Mitkos që në Aleksandri i ruanin pasardhësit e tij. Pasi i ra në gjurmë këtij thesari, ai me bashkëpunëtorët u nis për në këtë qytet. Ajo që fillimisht ndriçoi diçka të rëndësishme, ishte një letër mes dorëshkrimeve të Fondit, nga e cila u kuptua se Kristo Floqi, qysh në vitin 1937 i ishte drejtuar djalit të

Thimi Mitkos, Dhimitër Mitkos, që fondin e të atit ta dorëzojë në Shqipëri, me rastin e 25 vjetorit të Pavarësisë së Shqiptërisë. Përgjigjja e Dhimitër Mitkos nuk dihet, por, dihet se ky fond nuk u dorëzua në Shqipëri me rastin e këtij përvjetori e ky ishte një fat i madh, sepse ndoshta do ta përjetonte fatin e fondit të Çajupit që u dorëzua me këtë rast në shtetin amë, por që i humbën gjurmët. Sipas njohurive të profesor Bulos, Fondi i Aleksandrisë i dorëshkrimeve të Mitkos është ruajtur nga Daniel Adami, dhëndri i Dhimitër Mitkos, burrit të njërës nga katër vajzat, që ishte me prejardhje nga Korça. Falë dashurisë së këtij trashëgimtari për atdheun dhe nevojën që ky fond me dorëshkrimet e Mitkos dhe disa rilindësve të tjerë të kthehet në Shqipëri, me aq shumë dorëshkrime me interes për kulturën dhe letërsinë shqipe, dhe insistimit e angazhimit të Jorgo Bulos, sot kjo vlerë gjendet në Shqipëri. Nga vizita e parë e studiuesit Jorgo Bulo në Aleksandri, ai mori me vete vetëm një pjesë dorëshkrimesh, me rreth 1400 faqesh që i depozitoi në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, ndërsa pjesën më të madhe e solli me vizitën e dytë, të vitit 1986.

Arkivi i Mitkos ka qenë deri diku i njohur edhe para zbulimit të fondit të Aleksandrisë, falë zbuluesve tjerë shqiptarë që kërkimet i bënë edhe në Kozencë, Pragë, Grac, Kopenhagë, Londër etj. Dorëshkrimi i Pragës përmbante kryesisht folklor, ndërsa materialet e qendrave tjera ishin më tepër me dorëshkrime letërkëmbimesh me De Radën, Kamardën, Kristoforidhin, Majerin, Jarnikun etj. Me gjithë rëndësinë e dorëshkrimeve të gjetura në këto qendra që ndihmuan në ndriçimin e opusit krijues të Thimi Mitkos, në bazë të cilave u bënë edhe shumë studime, me zbulimin e Fondit të Aleksandrisë që përmban shumë materiale të panjohura më parë, u krijuan mundësitë për studime të reja dhe për plotësimin e atyre ekzistuese. Brenda këtij fondi me materiale të fushave të ndryshme, u gjetën edhe mijëra vargje me këngë popullore, dhe shumë përralla, gjëegjëza, proverba, anekdota etj. Këto dorëshkrime me materiale nga fusha e folkorit që na e solli ky fond, u ndriçuan në kohën kur mendohej se me botimin e " Bletës…", më 1878, të botimit të disa këngëve të Gustav Majerit, dhe botimit të Jarnikut, ishte përfunduar ky proces. Në letrën, po të këtij fondi, që i shkroi De Radës më 1887, Thimi Mitkoja, me keqardhje shkruante se megjithë atë mund për mbledhjen e folkorit, një pjesë e këtyre këngëve mbeten të pa botuara. Disa nga këto këngë që mbetën jashtë botimit, autori i kishte shpërndarë te disa albanologë për botim. Një pjesë e madhe e tyre sipas profesor Jorgo Bulos kishin përfunduar te Jan Urban Jarniku, për tu kthyer më vonë sërish që të botohen në Shqipëri. I tërë fondi i dorëshkrimeve i Aleksandrisë, u zbulua pasi Akademia e Shkencave e Shqipërisë, më 1981 e kishte botuar "Veprën" e Thimi Mitkos, nga studiuesi i folklorit me kompetencë të madhe shkencore, Qemal Haxhihasani, që llogaritej studimi më i kompletuar deri atëherë. Dorëshkrimet e fondit të Aleksandrisë krijojnë më së fundi fondin e gjerë dhe të sigurtë për një botim të plotë kritik- shkencor, mbi bazën e një analize tekstologjike e krahasimi të shumanshëm të varianteve e nënvarianteve që ekzistojnë brenda

folklorit ose brenda punës së Mitkos me tekstet[1042]. Këto dorëshkrime, përveç lëndës së folklorit, që mbet pa u përfshirë në përmbledhjen "Bëleta shqiptare", përmbajnë edhe lëndë të fushave tjera, siç është edhe ajo e leksikologjisë.

Para zbardhjes së vlerave të këtij fondi, dihej shumë pak edhe për fjalorin shqip-greqisht, konstaton studiuesi Jorgo Bulo. Me zbulimin e fondit, e kemi në dorë dorëshkrimin e këtij fjalori, që është e papritura më e madhe e këtij zbulimi. Ky fjalor përbën ndoshta korpusin më të rëndësishëm të dorëshkrimeve të Mitkos, të gjetura në Aleksandri, thotë zbuluesi i këtij fondi në studimin "Në gjurmët e rilindësve". Sipas tij, ky fjalor me 3000 faqe, pas atij të Kristoforidhit, përbën veprën më të madhe dhe më të rëndësishme në fushën e leksikografisë gjatë Rilindjes. Për ta kuptuar më mirë rëndësinë dhe fatin e këtij dorëshkrimi se është varianti përfundimtar i përgatitur për botim, apo vetëm forma e pa përfunduar, dhe mundësinë për botimin e tij, Jorgo Bulo e komenton letrën e Jani Vretos, të gjetur po në këtë fond, në bazë të së cilës vjen te konstatimi i vërtetë për fatin e dorëshkrimit të këtij fjalori. Kjo letër e Jani Vretos, dërguar Mitkos nga Bukureshti është e datës 23.09.1885 dhe e botuar për herë të parë në "Drita". Nga kjo letër dorëshkrimi u kuptua se fjalorit nuk i ishte dhënë dora e fundit për botim, ndërsa për atë se a kërkoi Mitkoja ndihmë profesionale nga J. Vretoja, nënkuptohet nga kjo pjesë e letrës: *Për fjalotorenë që më thua se ke shkruar, harrinë të jetë e pasurë nga fjalët që ka gjuha dhe ndë defter. (…) për punurat të mësonj vëllazërisht si ma merr mendja, dhe më vjenë mirë ashtu të mësojsh...*

Për vështirësitë dhe dilemat që kishte hasur Mitkoja në kriteret e përfshirjes së leksikut dialektor e të neologjizmave, Vretoja e këshillon të konsultohet me Sami Frashërin, kur i thotë: *Duhe të vësh, në mos të (ka) rënë në mend, fjalët e gjithë shkronjave që gjendenë gjer më sot shqip. Edhe merru vesh me Sami Bejnë.*[1043] Për pamundësinë e botimit të fjalorit në shtypshkronjën shqiptare të Bukureshtit, profesor Bulo i referohet një letre tjetër të këtij fondi, të datës 8 gusht 1886, që Mitko i dërgon Gustav Majerit, nga e cila kuptohet se " ata" të Bukureshtit nuk e kanë ndërmend ta botojnë këtë fjalor para se ta përfundojnë shtypjen e librave bazë për shkollat shqipe . Në letrën e dytë të Mitkos, dërguar Majerit , tre muaj pas letrës së parë, vazhdon të hedhë dritë mbi fatin e këtij fjalori, dhe mundësitë që ai të dalë në dritë deri sa ishte gjallë autori . Nga kjo letër shihet se Mitkoja nuk heq dorë që fjalori të botohet në Bukuresht , por që më parë i duhet ndihmë për korigjimin e tij: … *ka nevojë të korigjohet sepse nuk kam besim në njohuritë e mia gjuhësore*[1044]. Ëndrra për botimin e kësaj vepre leksikologjike , sipas letrave që i përmendëm , nuk u realizua për të gjallë të Thimi Mitkos.

Dorëshkrimi i Aleksandrisë përfaqëson pikërisht këtë shkallë të përpunimit të kësaj vepre madhore ,së cilës Mitkoja nuk arriti t'i jepte dorën e fundit. Zbulimi i fjalorit

[1042] Jorgo Bulo, *Në gjurmët e rilindësve*, te "Magjia dhe Magjistarët e fjalës", Tiranë 1998 f. 211
[1043] Jorgo Bulo, *Në gjurmët e rilindësve*, te "Magjia dhe Magjistarët e fjalës" Tiranë 1998 f. 213
[1044] Po aty

shqip-greqisht , thotë Jorgo Bulo,- Mitkos i jep një vend të ri në historinë e lëvizjes kulturore të Rilindjes . Siç njihemi nga ky fond, gjithmonë në dritën e studimeve të akademik Jorgo Bulos, mjaft me interes për shkencën e leksikologjisë, aty u gjet edhe një fjalor bisedor tri gjuhësh: italisht-greqisht-shqip dhe disa fragmente provash tjera leksikografike. Siç shihet, përveç punës së gjatë e të palodhshme në mbledhjen e visarit folklorik, e traditave të letërsisë gojore që ka qenë kryemotivi i gjithë aksionit dhe i përkushtimit atdhetar e intelektual[1045], Thimi Mitkoja gjatë kohës punoi edhe në përpunimin e fjalorit, punë kjo që i kushtoi shumë mund e kohë e që nuk e pa dritën e botimit, madje, deri në ditët e sotme , kur tani vonë, ky fjalor u botua në Tiranë nga Dhori Q. Qiriazi).

Fondi i dorëshkrimeve të Aleksandrisë , përveç lëndëve folklorike dhe asaj leksikologjike , është i pasur

edhe me krijime tjera origjinale të Mitkos, sçi janë : vjershat , proza , publicistika etj. Të një rëndësie të veçantë të këtij fondi janë edhe letrat , dërguar nga shumë personalitete të njohura për historinë dhe kulturën shqiptare, disa nga të cilat pjesërisht i cituam. Nga ky fond letërkëmbimesh është me interes të veçantë letra dërguar nga Naim Frashëri, e vitit 1879 , që ka vlera të theksuara , përveç tjerash , edhe për idetë që shprehen në te , dhe për ndonjë informatë që sjell për Naimin , burimet rreth veprimtarisë së të cilit në vitet e Lidhjes së Prizrenit janë tepër të kufizuara[1046]. E një rëndësie të madhe që hedh dritë mbi veprimtarinë e Sami Farshërit është edhe letra dërguar nga Jani Vretoja, e vitit 1885, që flet për fjalorin e tij e që e heq dilemën nëse me të vërtetë Samiu pat shkruar nje fjalor të shqipes që mbeti dorëshkrim . Nga letërkëmbimi i tij me Gustav Majerin , mësojmë për një poezi të gjatë me titull " Poemë shqiptare " të A. Priftit përmetasit , poezi kjo me motive atdhetare që Thimi Mitkoja ia dërgoi këtij albanologu. Kohët e fundit, thotë Jorgo Buloja, është provuar se edhe teksti i baladës "Mbetç more shkok mbetç", është gjetur në arkivin e Mitkos, i regjistruar me dorëshkrim prej tij[1047]. Në studimin, " Një variant i ri i vjershës "Moj shqypni ", të Pashko Vasës , po në librin "Magjia dhe magjistarët e fjalës" , Jorgo Buloja bën fjalë përmes një vështrimi kritik edhe për variantin e tretë të vjershës aq të popullarizuar, që u gjet në fondin e Mitkos , pas zbulimit të variantit të dytë në Bibliotekën Qytetare të Kozencëz që i ishte dërguar De Radës . Ky version, që sipas shumë analizash, u konstatua se De Radës nuk ia dërgoi vetë Pashko Vasa, po sipas të gjitha provave atë e dërgoi Samiu nga Stambolli , që do të thotë se edhe varianti i dytë , pas atij të Jarnikut nuk është origjinali i vjershës dhe nuk përfaqëson autografin e Pashko Vasës. Edhe varianti i fondit të Thimi Mitkos , sipas J. Bulos, nuk i është dërguar atij nga autori, por me siguri kjo vjershë atdhetare shumë e njohur, Mitkos iu dërgua nga Jani Vretoja me të

[1045] Jorgo Bulo *Burimet kulturore të lëvizjes kombëtare dhe vepra e Thimi Mitkos* në "Shpirti I fjalës", Tiranë 2014, f. 25-46

[1046] Jorgo Bulo, *Në gjurmët e rilindësve*, te "Magjia dhe Magjistarët e fjalës", Tiranë 1998 f. 216

[1047] Shih te Jorgo Bulo *Burimet kulturore të lëvizjes kombëtare dhe vepra e Thimi Mitkos* në "Shpirti I fjalës", Tiranë 2014, f. 24-46

cilin ai kishte edhe korrespondencë letërkëmbimesh . Zbulimi i versionit të Aleksandrisë ,që sot një pjesë ruhet në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë , hedh dritë të re ne gjeografinë e përhapjes së vjershës gjatë Rilindjes, thotë Akademik Jorgo Bulo. Duke e vlerësuar atë si një kushtrim lufte e thirrjeje për bashkim të të gjithë shqiptarëve , miqtë e Pashko Vasës që e patën vjershën nëpër duar, e dërguan gjithandej nëpër kolonitë shqiptare, shton ai. Në këtë fond aq të pasur të Mitkos, u gjetën edhe pjesë nga letërsia e vjetër, si p.sh. Kopja e " Isagogjisë" , e Dhaniel Haxhiut dhe disa vjersha të Hasan Zyko Kamberit, ndër të cilat edhe një variant i poezisë "Paraja" .

Nga studimet e profesor Jorgo Bulos në dy veprat e tij: Magjia dhe magjistarët e fjalës , botuar në Tiranë më 1998 dhe " Shpirti i fjalës ", botuar poashtu në Tiranë më 2014 , konstatojmë se pa këto kontribute shkencore që bëjnë fjalë për zbardhjen e këtij fondi, sjelljen e tij në shtetin amë në dy faza kohore , me 1984 dhe më 1996 , vepra e Thimi Mitkos që iu kushtua kërkimit jo vetëm të burimeve folklorike të identitetit shqiptar , por shumë më gjerë , duke përfshirë gjuhën, historinë, kulturën materiale të shqiptarëve dhe të historisë e të gjenezës së tyre si popull, nuk do ishte deri vonë e njohur plotësisht[1048]

[1048] *Burimet kulturore të lëvizjes kombëtare dhe vepra e Thimi Mitkos* në "Shpirti I fjalës" Tiranë 2014 f. 25-46

YMER ÇIRAKU (TIRANË)

THIMI MITKOJA PËRMES LETËRKËMBIMEVE ME DE RADËN

Letërkëmbimet janë një traditë mjaft e njohur në botë, të cilat vërehen të kenë qarkulluar në kohë e në rrethana të ndryshme, edhe mes personaliteteve të botës shqiptare. Sado brenda formatit *konfident* që ato kanë/përcjellin, letërkëmbimet përcaktohen si burime të dorës së parë, pasi krijojnë mundësi për të depërtuar në trajtat më autentike e më shumëkahëshe të situatave e ngjarjeve të ndryshme, qofshin këto të natyrës personale - apo përtej personale. Në një letër të formuluar me destinacion adresimi, shenjohet jo vetëm një informacion dhe njëherazi gjykim/vlerësim i caktuar (autonom) i përpiluesit të saj, porse aty kryqëzohen thekshëm edhe një mori të dhënash të tjera rrethanore, të cilat vijnë si përcjellje reciproke mes dërguesit e marrësit. Dhe këto për studiuesit mund të jenë (sipas rastit) pista të atilla, që jo pak herë, mund të çojnë natyrshëm në zbulime të dhënash dhe në interpretime mjaft të rëndësishme të natyrës historike, filologjike, antropologjike, ekonomike etj.

Është tashmë e njohur, si traditë e letërkëmbimeve, edhe ajo mes mjaft figurave të shquara shqiptare. Epoka e Rilindjes sonë Kombëtare e pati këtë dukuri mbase në kuotën më të lartë dhe kjo spiegohet me faktin se protagonistët e kësaj lëvizjeje ishin të detyruar ta ushtronin misionin e tyre kryesisht në qendra jashtë Shqipërisë dhe letërkëmbimi, mbetej instrumenti që mund ta luante më mirë rolin e komunikimit mes tyre. Viteve të mëvonshme, ky model shkrimi do të vazhdonte të funksiononte, porse do të orientohej më së shumti drejt formatit të dialogjeve në distancë, të këmbimit apo parashtrimit të opinioneve dhe vlerësimeve intelektualiste, të natyrës këto filozofike, estetike, morale, politike, teologjike…

Në korpusin e veprës së Th. Mitkos (1820-1890) zënë jo pak vend edhe letërkëmbimet e tij me shumë nga personalitetet e njohura të kohës, shqiptarë e të huaj. Mund të përmendim korrespodencën e tij me Dh. Kamardën, P. Kupitorin, K. Kristoforidhin, Th. Krein, J. Jarnikun, G. Majerin, F. Krispin, A. Frashërin, Dora D` Istrian, K. Zhapën, V. Dodanin etj. Këto letra, ndonëse janë dërguar në kohë e nga qytete të ndryshme të tre kontinenteve si: Viena, Athina, Selaniku, Aleksandria, Stambolli, Trieste, Manastiri, Bukureshti…, kudo ku ndodhej Mitkoja, gjithsesi, *kryetema* në to do të mbetej çështja shqiptare, kërkimi dhe gjetja e rrugëve për të projektuar e për të zgjidhur fatin e Shqipërisë.

Letrat e Th. Mitkos drejtuar De Radës, zënë për nga vëllimi ndofta numrin më të madh të tyre. Letërkëmbimi mes tyre zgjati për afër thuajse vjet dhe përfshin afër 70 letra të nisura prej Mitkos që njihen gjer më sot.[1049] Përtej sjelljes e kujdesjes njerëzore, shfaqur në mënyrë të përkorë e aq prekëse në çdonjerën prej tyre, në to përcillet vizioni dhe angazhimi i qartë i Mitkos në realizimin e projektit rilindës për

[1049] Q. Haxhihasani, Parathenie tek Th. Mitko *Vepra*, 1981, fq. 36

zgjimin e botës shqiptare. Tek shkrimtari më i autoritetshëm arbëresh (sikundër ishte De Rada), ai e ndjen të nevojshme t`i përcjellë atij në mënyrë sistematike informacion të hollësishëm prej ngjarjeve ballkanike të ndodhura rrotull trojeve shqiptare, prej aktivitetit të grupeve e shoqatave atdhetare, duke i dëshmuar me fakte e argumente se zgjidhja e çështjes shqiptare tashmë ka dalë në rend të ditës në kontekstin e Perandorisë Otomane. Sigurisht se nuk mund të ishte e rastësishme kjo lidhje e ngushtë e tij me këtë figurë arbëreshe. Kjo kishte të bënte me autoritetin e lartë që gëzonte ky personalitet, por edhe me qasjen që mund të kishte përmes tij e patriotëve të tjerë arbëreshë kauza shqiptare nëpër kancelaritë europiane. Pra, Mitkoja shihte/vlerësonte tek De Rada dhe komuniteti arbëresh, përmes botimeve dhe influencave të tyre, një kanal mjaft të rëndësishëm për ta përcjellë atë kauzë edhe në qarqet perëndimore. Në një nga letrat e tij të dates 17.6. 1881 [1050], ai e ndjen/shpall qartazi, duke u mbështetur edhe në pikëpamjen e Dora d`Istrias (shprehur tek vepra e saj *La nazione Albanese)* se: …*drita për të ndriturë Shqipërinë duhet të nisetë të dalë ngaha Italia…* Dhe me këtë rast, nuk nguron ta dëshmojë entusiazmin e tij për projektin e De Radës për të nisur ngritjen e një tipografie arbëreshe në Itali, ku mund të realizoheshin në rrethana më të favorshme për kushtet e kohës – edhe botime nga plejada e patriotëve shqiptarë. Madje merr përsipër, krahas përpjekjeve për të siguruar pajtimtarë për revistën *Fiamuri i Arbërit (1883-1887)*, që të mbledhë fonde nga shqiptarët e Egjiptit për të mbështetur ngritjen e tipografisë arbëreshe, të cilën, në mënyrë metaforike e quan një dritare *mbi gjuhë tënë…*, madje duke i sugjeruar që, materialet të botohen edhe në italisht e frengjisht, me qëllim që çështja shqiptare të bëhet e njohur sa më gjerë në qarqet europiane.

Mund të thuhet se Mitkoja ishte ndër ata personalitete që për kohën u përpoq të luante mbase misionin më të rëndësishëm për mbajtjen e kontakteve dhe të komunikimeve me arbëreshët e Italisë. Këto ishin kontakte me dobi të ndërsjellta, të cilat, i sillnin doemos edhe atij perceptime të tjera emancipuese, si vlera pasuruese këto, që vinin prej një metropoli të avancuar civilizues. Këtu mund të kujtojmë, si faktor ndikues tek ai, edhe ndryshimin e pikëpamjes për zgjedhjen/përcaktimin e alfabetit të shqipes, që, nga pranimi/zbatimi fillimisht të alfabetit të Stambollit – shkon tek përkrahja e shkrimit të shqipes me alfabet latin, si më i dobishmi për shqiptarët nga çdo pikëpamje.

Prej letrave dërguar De Radës, përtej referencave të natyrës personale, transmetohen dukshëm një mori ngjarjesh e rrethanash të realitetit shqiptar, sigurisht, të përjetuara e të gjykuara nga Mitkoja. Duhet kujtuar se ai ka intuitën, ka prirjen për lëvizje e kontakte të pandalura/palodhura kudo ku kishte koloni shqiptare, ka aftësi të rralla komunikuese me komunitetet shqiptare, por mbi të gjitha, ka të fiksuar tek vetja përkushtimin e palëkundur ndaj fateve të Shqipërisë, të cilat, e bëjnë atë ta pasqyrojë/dëshmojë sa më bindshëm/objektivisht skakierën e

[1050] Thimi Mitko *Vepra*, T. 1981, fq.650

ngjarjeve të kohës, duke mos dominuar në gjykim subjektiviteti, i cili, sigurisht që nuk mund të jetë i përjashtuar, sidomos për vetë specifikën konfidente që ka zhanri i letërkëmbimit. Përmes letërkëmbimit që disponohet gjer më sot, del mjaft i spikatur profili i Mitkos njeri e patriot, prind e mik, idealist dhe praktik i orientuar drejtë në jetë, i cili ruan koherencë të palëkundur përsa i përket angazhimit të tij ndaj misionit kombëtar, sado që mund të shfaqë/zgjedhë rrugë e pikëpamje të ndryshme për ta kryer atë, sipas konjukturave e raporteve që krijohen.

Th. Mitkoja ndihmoi mjaft që të njihej mes shqiptarëve të viseve të ndryshme revista e De Radës *Fiamuri i Arbërit* dhe vet drejtuesin e saj e mban në kontakt me botimet që bëhen nga shqiptarët në vise të ndryshme të botës. Tregon preokupim për t`i bërë të njohur e për t`i rekomanduar atij për kontakte - mjaft prej aktivistëve të njohur të çështjes kombëtare, i udhëhequr prej idesë se duhej kompaktësuar maksimalisht kjo lëvizje nacionale, që të mos mbetej kurrsesi ishullore, çka do t`i atrofizonte asaj energjitë. Është rasti të kujtohet p.sh. letra ku Mitkoja i bën atij të njohur figurën e Abdyl Frashërit, duke u kujdesur t`i tregojë edhe adresën e tij, me qëllim që të vendoseshin kontakte mes tyre.[1051] Madje, në një letër tjetër, nisur dhe prej një dëshire që kishte shfaqur De Rada për të vizituar Shqipërinë, por që në fakt nuk u realizua dot asnjëherë, Mitkoja e siguronte se miku më i mirë për të në këtë pelegrinazh atdhetarie do të ishte pikërisht A. Frashëri, që kësaj kohe ndodhej në Janinë e mund të dilte ta priste atë në port të Prevezës.[1052] Madje nuk harron ta njoftojë edhe për rolin e madh që ai po luante në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, deri në rënien e saj prej ushtrisë otomane (1881) dhe kur A. Frashëri, si shumë eksponentë të tjerë të kësaj lëvizjeje kombëtare, dënohet me vdekje e që pastaj i kthehet në burgim të përjetshëm.

Si edhe në letërkëmbimet me atdhetarë të tjerë të njohur e me albanologë të kohës, edhe me De Radën, Th. Mitkoja gjen rastin të këmbejë pikëpamje e të marrë informacion rreth historisë së shqipes e të shqiptarëve, mbi raportet e tyre me fqinjët e sidomos me grekët, mbi teorinë e rrënjëve pellazge të shqipes - që kësaj kohe kishte marrë njohje të gjerë ndër studiues, mbi rrugët që duhej të merrte arsimi në shqip etj. Në rrethana krejt autodidakte, ai u kishte hyrë hulumtimeve historike, gjuhësore e folkloristike shqiptare, me një përkushtim admirues, duke mos i dëshmuar ato vetëm si pjesë të diskurit të tij propogandistik nëpër klubet e kohës, por edhe duke i dokumentuar konkretisht në shkrime të atilla, të cilat, edhe sot vazhdojnë të kenë vlerë të dorës së parë. Dhe me gjithë këto punë të çmuara që la pas - Mitkoja rrezatonte një *përvujtëni* impresionuese/prekëse dhe për këtë mund të kujtojmë atë çka i shkruante në letrën e tij një arbëreshi tjetër, Dhimitër Kamardës, ku mes të tjerash theksonte me modesti: … *u lutemë të mos pantehini semos u (a unë) boj të diturin, të ditshmin a filologun mbi gluhënë tënë, por tue klënë këjo e*

[1051] Po aty,fq. 642
[1052] Po aty, fq. 639

pashkruar gluhë, e humbur edhe e zbjerë, dua t`u dëftoj vetëmë fjalët e dialektit tonë…[1053]

Në letrat që i dërgon De Radës, Mitkoja gjen rastin të shprehë një varg pikëpamjesh mbi Shqipërinë e pas pushtimit. Në këtë vend ai sheh një natyrë të begatë ku mund të kultivohen drithëra e pemëtari pa fund dhe shkruan me entusiazëm se …*Myzeqea është një tokë posi Egjypti e posi Napoli i Italisë… se ka tre lumëra të mëdhenj, posi Nili i Egjyptit, ndëpër të…* (letër më 17.7. 1880) Po në këtë letër e në të tjera, tregohet i preokupuar e jep vlerësime edhe për statusin politik të Shqipërisë pas shkëputjes së saj nga Perandoria Otomane. Një farë kohe i përmbahet variantit të përfshirjes brenda një konfederate me Greqinë, nisur prej fqinjësisë së lashtë dhe sidomos prej pranisë disa milionëshe të arvanitasve atje dhe të rolit vendimtar të tyre në historinë, qeverisjen dhe në kulturën dhe ekonominë atje. Por shpejt do t`i largohet kësaj ideje, pasi tek qarqet ultarnacionaliste të megalidhesë greke shikonte orekse gllabëruese dhe jo bashkëpunuese me shqiptarët. …*Elenëtë nuk` kanë besë, nuk kan` fjalë nderi. Udh` e tyre është` një rrëzim për ata vetë e për Shqipëërinë…*, i shkruan De Radës, duke dëshmuar vizion largpamës, që i kapërxente interesat/pasionet thjesht nacionale, duke iu kujtuar përfaqësuesve të qarqeve shoviniste greke se, nga një Shqipëri e rrënuar, siç ata synonin ta bënin atë me politikat e tyre dritëshkurtëra nuk do të kishin asnjë përfitim dhe do të rrënoheshin edhe ata vet. Sipas pikëpamjes së tij të drejtë për kohën, një aleate strategjike e Shqipërisë aso kohe mbetej të ishte Austria, e cila, do të luante rolin e një bastioni të sigurtë për të ndalur orekset/dyndjet sllave e të fqinjëve të tjerë mbi territoret e saj.

Për nga tipologjia e tyre, letrat e Mitkos drejtuar De Radës, kanë një veçori dalluese krahasuar me ato drejtuar figurave të tjera të njohura të kohës, qofshin shqiptarë apo të huaj. Ato kanë një intensitet të lartë komunikimesh, që duket si në numrin e madh të tyre, ashtu edhe në gamën e problematikave e të interesimeve të shprehura në to. Aty mpleksen çështje nga më madhoret për fatet e atdheut e deri tek interesimet dhe sentimentet njerëzore, që dëshmojnë se Th. Mitkoja shikonte tek De Rada një ikonë të autoritetshme të kauzës shqiptare, i cili rrezatonte vlera të mëdha prej një vendi, që sikundër shkruante Naimi …*atje lind dielli ku perëndon.* Kjo dëshmon një qëndrim të drejtë të tij, si për nga orientimi perëndimor, ashtu dhe për nga synimi për të bashkuar tërë gjymtyrët e botës shqiptare drejt rilindjes së energjive të saj - për betejën finale të çlirimit e të prosperitetit kombëtar. Me këtë mbase duhet spieguar edhe diskursi i letrave të tij, që kanë të derdhura edhe mjaft shprehje e leksik nga tërë dialektet e të folmet lokale, madje dhe dialekti arbëresh. Nuk besojmë që kjo të jetë shtyrë nga ndonjë projekt apo vetëdije e tij për modelin e një gjuhe të njësuar shqipe që duhej ndjekur, pasi ai do ta kuptonte i pari, për atë kulturë jo të pakët që kishte edhe në filologji, se kjo do të ishte sajesë artificiale dhe *kakofonike*, sikundër ia kishte ënda të shprehej shpesh për zgjidhjet arbitrare apo të

[1053] Po aty, fq. 610

pamenduara mirë. Këto shprehje të fondit të gjerë dialektor të shqipes - të derdhura në shkrimet e tij, me sa duket janë pjesë e stilit të paramenduar apo tendecioz, për të dëshmuar përbashkësinë, vëllazërinë mes shqiptarëve. Në fakt ky do të jetë lajtmotivi i tërë misionit të tij prej aktivisti atdhetar, prej publicisti, folkloristi e poeti.

Kjo kredo shprehet edhe tek vjersha e tij *Mbë shqypëtarët:*

O vëllezër shqypëtarë,
ju flas për ditë të mbarë!...
Duhet, duhet të bashkohet
mbë një gjithë Shqypëria…
Se flasin shqypen të tërë
edhe quhen shqypëtarë,
Perëndia i ka bërë
një fëmijë të pandarë…

ZEQIR KADRIU (TETOVË, MAQEDONI)

VLERA KULTURORE E PATRIOTIKE E THIMI MITKOS NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

Në kohën kur kultura evropiane nëpërmjet Franc Bopit, Johan Geor Hahnit, Reinholdit, Huankin Hekardit, Gustav Majerit etj. kishte ndihmuar shqipen dhe etimologjinë e saj përgjithësisht,po në këtë vazhdë do të bashkangjitet për të thelluar mendimet dhe idetë e veta edhe Thimi Mitkoja; njëri ndër mbledhësit e thesarit shpirtëror të popullit shqiptar,me prozën e tij historiko-letrare.

Në sajë të gjithë kësaj që po themi,Thimi Mitkoja bëhet njëri ndër romantikët e parë që në të njëjtën kohë jep ndihmesën e tij për formimin e historizmit romantik dhe kontribuon për prozën e tij të shumëpreferuar mbi Korçën dhe rrethinën e saj.

Ky qe edhe motivi, që në një farë mënyre më shtyri që t'i qasem shqyrtimit të një teme mbi aspektin kulturor e patriotik , pse jo edhe shumë dimensional të Thimi Mitkos që rrëfen në prozat e tij me vulën:"*Disa shënime rreth Korçës dhe Topografi e Korçës".*[1054]*(*)*

Topografia semiotike e monumentit

Për Thimi Mitkon, kjo nuk qe vetëm një qasje rasti, por një kuptim më i thellë që do jetë një ndërmarrje më serioze për të kultivuar,dhe jo vetëm kaq por edhe për të trajtuar dhe mbrojtur njëkohësisht me shumë këmbëngulje aspiratat e fqinjëve grekë rreth Korçës dhe tërsisë së saj gjeografike shumë të preferuar e kënduar nga të tjerët.

Jo rastësisht në vija shumë të holla, Thimi Mitkoja do të flasë për shtrirjen gjeografike të Korçës për kushtet shumë të përshtatshme për kultivimin e zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore e industriale, duke u ndalur më pas edhe për klimën e butë e të ashpër, që ka Korça, më tej për kushtet e lidhjes e komunikimit natyror shumë të përshtatshëm, që rrethohet me fshatrat të cilat përbëjnë kurorën e përgjithshme topografike.

Këto dhe shumë të dhëna të tjera flasin se, pavarësisht që fondi i të dhënave të tyre është pak a shumë i varfër, prozat e Thimi Mitkos si "Disa shënime rreth Korçës dhe Topografi e Korçës", përbëjnë portretin më të bukur kulturor që për ndonjë qytet shqiptar është shkruar në shekullin e nëntëmbëdhjetë[1055]

Mitkoja duke dashur të shkruajë në këtë formë historinë e Korçës njëkohësisht kishte për qëllim të të ruante dëshmitë materiale e në radhë të parë rrënojat,muret, kishat,manastiret dhe kodikët e ndryshëm.*"Kështu për çudi nuk mbetet asnjë gjë që ai nuk shënon në prozat e tij që ka të bëj me Korçën,në të vërtetë,që nuk i përshkruan me një gjuhë e cila,në shikim të parë duket racionale,e ftohtë, por e cila doemos e shpreh qëndrimin e tij emocional ndaj historisë".Ai më pas shton se:"në qoftëse*

[1054] Qosja Rexhep,*Histori e Letërsisë shqiptare*,II.Thimi Mitko,Kap.IV,faqe ,235-264
[1055]Qosja Rexhep,*Histori e Letërsisë shqiptare*,II.Thimi Mitko,Kap.IV,faqe ,243

historinë e themelimit të Korçës e mbështet në legjendën mbi Koxha Mirahorin,historinë e zhvillimit të saj,do ta mbështesë në të dhënat materiale që dëshmojnë traditat e saj kulturore"[1056]

Gjithsesi, është shumë me rëndësi qasja e autorit me një vëmendje e përkushtim me të cilin dëshiron të dëshmojë : rrethoja e një fshati të shkatërruar, që quhet Athanasica; xhamia dhe hamami i Mborjes; kodiku i Mitropolisë së shenjtë të Korçës; kodiku i Manastirit të Shënprodhomit në Voskopojë; manastiri i Shënkollit në Kamenicë; manastiri i i apostujve Pjetër e Pavel në Vithkuq, manastiri i Shëndëllisë në Hoshiçt, kështjella qytet e Drenovës, tempulli i vogël i i Shën Konstantinit në malin e Drenovës; manastiret e Shënkollit e Shënmërisë në Boboshticë, themelet e një muri të lashtë e të gjatë që e pandeh mur të një kështjelle në Boboshticë, pranë manastirit të Shënkollit; rrënojat e dy kullave mbi dy maja mali në Boboshticë; kisha e Shëngjergjit në Magulen etj. Nga e gjithë kjo duhet thënë se qëllimi i vetë Thimi Mitkos ishte që të kënaqet duke regjistruar këto monumente dhe duke i nxjerrë në sipërfaqe si vlera kombëtare.

Semiotika e monumenteve

Një element shumë i rëndësishëm për të cilin me përkushtim e shkruan Mitkoja , është çështja e Monedhave të zbuluara, kodikëve të cilët do t'i regjistrojë e në të shumtën e rasteve edhe do t'i lexojë. Nga ata do të nxjerrë pastaj edhe mjaft shënime me konstatimin se: kur mund të ishte ndërtuar një monument, cili mund të ketë shërbyer për një kohë të caktuar, cili klerik dhe në cilën kohë mund të ketë shërbyer aty dhe cilat ishin lidhjet e atij monumenti me një tjetër, cilat qenë hierarkitë e kush qenë bamirësit e tij...?etj.

Në fakt Kodikët bëhen, histori e shkurtër e monumenteve dhe madje e qytetit, e klerikëve që kanë shërbyer në ta e bamirësve të tyre, e lidhjeve në mes njerëzve, mitropolive dhe krahinave . Në këtë mënyrë (sipas R.Q.),"*Rrethojet e mureve të lashta,murrçimet,monumentet e kultit fetar dhe kodikët e tyre bëhen shenja që e plotësojnë hapësirën historike, ashtu siç bëhet pllaka me mbishkrim në shkollën e rindërtuar të qytetit të Korçës, shenjë që e plotëson hapësirën shoqërore të vetëdijes kulturore dhe kombëtare të borgjezisë së qytetit*". Kjo flet se sa e rëndësishme është shenja e monumentit që mund të rrënohet ,por nuk zhduket kurrë.

Pra, nuk janë monumentet kulturore e materiale të vetmet shenja në bazë të të cilave vetë Mitkoja ndërton historinë e Korçës dhe të Shqipërisë; me çka dinjitetin e të dhënave materiale ua jep edhe të dhënave shpirtërore me të cilat krijohen vizionet historike e kombëtare.Në këtë mënyrë Mitkoja duke e përshkruar mirë e me kujdes topografinë e Korçës dhe të rrethinës së saj përdor fjalë të lashta që edhe sot mbeten si simbol i një përshkrimi të kujdesshëm në shqipe si: Rrënojat, murnimet,kishat ,manastiret,kodikët, të cilat janë shenja të një kulture apo të një besimi që bëhen elemente të individualitetit kombëtar e kulturor. Kjo flet se Thimi Mitkoja ka për qëllim të dëshmojë se populli shqiptar është një popull i lashtë , me

[1056] Lushaj Ramiz,*Thimi Mitko e Shpëtim Sala dy korçarë që i japin vlera kohës e njëri -tjetrit*.Tiranë,2007

tradita e kulturë që ka themel të thellë dhe histori të dëshmuar. Përmes semiotikës së monumenteve, autori mundohet t'u japë përgjigje shumë mendimeve e shkrimeve të të huajve, të cilat, duke dashur që ta mohojnë gjuhën shqipe,apo edhe kulturën shqiptare, mohojnë njëkohësisht edhe lashtësinë e këtij populli dhe vlerat kulturore të tij.

Vetë proza historiko-letrare e Thimi Mitkos është përgjigje më e mirë dhe më efikase kundër asaj propagande të njëpasnjëshme që shtyn Mitkon të trokas më me forcë në këtë drejtim.

Përfundimisht proza e Mitkos mbi Topografinë e Korçës të përkujton traditat e njohura të romanit historik evropian, të cilat realisht ai edhe mund të mos i ketë njohur, por: *"Pranë manastirit të Shënkollit,në bregun e majtë të lumit që rrjedh atje pranë,gjenden themelet e një muri të vjetër dhe të gjatë rrethues,ndoshta të ndonjë kështjelle,në një pozicion më të lartë në krahasim me fshatin,ku dallohen dy porta të mëdha,njëra nga lindja,afër luginës së maleve,dhe tjetra nga perëndimi,pranë fshatit të tanishëm".* Nga kjo buron filozofia e tërë e asaj gurre popullore që nxjerr Mitkoja në sipërfaqe përmes poezisë dhe vetë semiotikën historike,anën kulturore e shpirtërore të lashtësisë së qytetit të lashtë të Korçës.

Korespondenca dhe jeta kulturore

I ushqyer me ndjenjën nacionaliste të rilindësve të mëhershëm, pjesën më të madhe të veprimtarisë së tij patriotike, rilindësi Thimi Mitko e ushtroi në Egjipt si shumë patriotë të tjerë që vepruan e punuan për të mirën e atdheut. Një jetë e tërë, një veprimtari këmbëngulëse, e cila la gjurmë të thella për të mos u shlyer kurrë nga një plejadë patriotësh të cilët për asnjë momement nuk lëshuan nga dora testamentin e të parëve të tyre " *Të ruajme gjuhën e kultrurën e te pareve*". I tillë ishte edhe rilindasi Thimi Mitkoja, i njohur nga historiografia shqiptare si atdhetar,folklorist dhe publicist i shquar. Th.Mitkoja ishte njëri nga themeluesit e shoqërisë "*Vëllazria shqiptare*" në Egjypt; aty ku kishin vepruar e punuar më herët patriotë shqiptarë si: Andon Zako Çajupi, Filip Shiroka, Aleksandër Xhuvani etj. Atje, siç dihet, u themeluan disa shoqata dhe janë botuar gazeta, libra dhe broshura të ndryshme që luajtën një rol të madh në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe ngritjen e nivelit të vetëdijes kombëtare. Gazetat dhe revistat që u botuan vetëm në Kajro ishin: *"Toska", "Besa", "Sëpata", "Shkreptima",*që aso kohe e mbajtën të gjallë kulturën shqiptare nga veprimtarët e shquar në mesin e të cilëve për shumë vite punoi edhe Thimi Mitkoja . Në Egjipt veçanërisht nga mesi i shekullit XX ka ekzistuar një komunitet i madh i shqiptarëve që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare. Shqiptarët e parë në Egjipt ,siç dihet kanë ardhur si përfaqësues të Perandorisë Osmane ose si drejtues ushtrie dhe ushtarakë të asaj kohe.Vlen të thuhet se Kolonia shqiptare u forcua shumë në kohën e sundimit të Mehmet Ali- Pashë Kavallës në vitet 1805-1848, i cili i dha një përkrahje të fuqishme komunitetit shqiptar të Egjiptit. Për fat të keq , pas asaj periudhe, ky komunitet nuk do të funksionojë si duhet dhe do të mbetet vetëm një kujtesë në historinë e së kaluarës. Por Mitkoja do të mbetet në kujtesën e historiografisë

shqiptare si njeriu që mblodhi folklorin burimor shqiptar dhe vuri vulën simbolike të quajtur "*Bleta shqiptare*", atë nektar të çmueshëm që populli shqiptar e ruajti, kultivoi dhe e përcolli brez pas brezi.

Në shumë libra e broshura apo gazeta të shek. XVIII-XX që janë gjetur në arkivat greke, ka edhe materiale që lidhen me aktivitetin e Thimi Mitkos. Janë faqe të gazetës "PANDORA" (ΠΑΝΔΩΡΑ) ku mes të tjerash, shkrimtari shqiptar polemizon me historianin grek Panajot Aravantinoi. Një pjesë e kësaj polemike është botuar në veprën e Thimi Mitkos "Bleta Shqiptare", 1981, në Tiranë.

Në faqet e kësaj reviste, Thimi Mitkoja ka dhënë një kontribut të madh duke botuar shkrimet e tij për Korçën. Këto shkrime janë botuar në veprën e Mitkos, por pa asnjë shënim mbi revistën Pandora dhe faksimile. Interesant është fakti se shkrimet e Thimi Mitkson për Korçën u botuan dy në vitin 1859 dhe dy pas 8 viteve më 1867, botuar me emrin anonim *"Një nga pajtimtarët".*

ZEQIRJA NEZIRI (SHKUP, MAQEDONI)

NJË NGJARJE HISTORIKE E KËNDUAR NË TRI KËNGË

Studimi i marrëdhënieve të letërsisë gojore me ngjarjet historike gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e studiuesve në të dyja këto disiplina shkencore. Të shumtën e herëve i është dhënë përparësi faktografisë për ndonjë ngjarje historike dhe mundësive të bartjes së saj në artin letrar gojor. Është e ditur se krijuesi i artit letrar gojor duke folur në emër të bashkësisë përherë përpiqet që në krijesën e tij artistikisht ta përjetësojë disponimin e përgjithshëm dhe ta pasqyrojë qëndrimin kolektiv ndaj ngjarjes historike. Në rastin tonë konkret kemi një ngjarje historike të gjysmës së parë të shekullit të 19 – të, që në shkrimet histoike njihet si masakra e Manastirit (gusht 1830). Thimi Mitkoja ka regjistruar dy këngë që i bëjnë jehonë kësaj ngjarjeje. Janë midis këngëve të para që janë krijuar në bashkëkohësi të zhvillimit të ngjarjes historike.

Për këtë ngjarje tronditëse kanë kënduar jo vetëm shqiptarët, por edhe nga popujt ballkanikë sllavë (bullgarë e maqedonas). Krijuesit e këtyre krijimeve poetike, në kontekst të traditës së tyre kombëtare kanë dhënë botëperceptimin e tyre rreth ngjarjeve të ndryshme historike. Në të dy krijimet dalin shumë pika të përbashkëta, por edhe të veçanta. Ato aq sa janë pasojë e raportit midis faktografisë historike dhe fiksionit artistik, po aq janë edhe pasojë e ndjekjes së traditës kombëtare të secilit krijues veç e veç. Punimi është i rëndësishëm si për studimet historike ballkanike, aq më shumë për studimet në fushën e letërsisë gojore dhe në këtë kontekst synon të japë ndihmesë në afirmimin e pikëpamjeve të këtilla me rrezatime përtej ballkanike.

Konteksti historik

Shpresat për një çlirim të afërt që kishin ngjallur principata e Bushatllinjve dhe e Ali pashë Tepelenës, në vitet ’20-’30 të shekullit të 19-të kishin hyrë në një fazë të re. Ishin paraqitur kryengritje të pashkëputshme në të gjitha anët e vendbanimeve shqiptare. Perandoria Osmane në anën tjetër përdorte të gjitha mënyrat e mundshme për t’i shuar edhe shpresat më të vogla. Në këtë kontekst ngjarja e Manastirit paraqet vetëm njërën prej hallkave të shumta të ndëshkimeve ndaj shqiptarëve që ndëmerrte Porta e Lartë.

Ndaj, pas njohjes së pavarësisë së Greqisë (1830), Porta, kryesisht do te merret me nënshtrimin e Shqipërisë, e cila, bashkë me Bosnjën, konsideroheshin si dy mbështetjet e pushtetit osman në Rumeli. Këtë detyrë duhej ta kryente Veziri i Madh, Mehmet Reshid pasha. Ai, me të arritur në Manastir, në gusht të vitit 1830 ftoi të paraqiteshin të gjithë feudalët e Toskërisë për të shpallur amnistinë e përgjithshme dhe për të marrë gjoja shpërblimet e mbetura.

Midis të ftuarve ishin Zylyftar Poda, Tafil Buzi, Çelo Picari, Zejnel Gjoleka, të cilët, bashkë me disa të tjerë dyshuan për ndonjë kurth që mund të ishte kurdisur dhe nuk u paraqitën; por Asllan bej Puçeja dhe Veli bej Jaçeja, të cilët, pasi u takuan

në Mecovë, vendosën të shkonin bashkërisht në Manastir të shoqëruar me kontingjente të forta ushtarësh.

Mehmet Reshit Pasha, më 26 gusht 1830, në Manastir kishte organizuar një paradë ushtarake. Pas pritjes madhështore, përderisa dy të ftuarit po përcillnin ceremoninë e paradës ushtarake, gjenden nën breshërinë e predhave të ushtarëve që parakalonin dhe kishin filluar të qëllojnë mbi ta.

Dy bejlerët shqiptarë dhe shoqëruesit e tyre të qëlluar në befasi nuk mundën të bënin veçse një qëndresë të vogël. Veli Beu u vra në vend, kurse Asllan Beut iu pre koka në ikje. Kështu, brenda pak minutave, në pabesi u shfarosën më tepër se 500 feudalë, kokat e të cilëve u dërguan në Stamboll. Po në këtë kohë, në Berat i pritet koka, Hasan bej Vrionit; në Manastir varet Shaban Gega; ndërkaq në Janinë, Emin Pasha, i biri i Mehmet Reshit pashës, përgatiti një kurth tjetër, por me përmasa më të kufizuara.

Kjo ngjarje e trishtueshme dhe tronditës pati jehonë të madhe dhe përnjëherë u ngrit në këngë. Në to, me plot tone të thella elegjike këngëtari i qorton të masakruarit për vigjilencën që nuk treguan ndaj mashtrimeve të pushtetit osman[1057] . Kjo ngjarje tronditi edhe popujt e tjerë të Perandorisë. Ndaj asaj nuk i kënduan vetëm nga shqiptarët, por edhe popujt e tjerë sllavë, midis tyre edhe maqedonasit. Mbi këtë ngjarje Ismail Kadare ka shkruar novelën *Komisioni i festës*.

Qerthull këngësh kushtuar viktimizimit dhe mashtrimit

Objekt i këtij studimi janë dy këngë të botuara nga Thimi Mitkoja në përmbledhjen e famshme *Bleta Shqiptare* (1879) dhe një këngë në maqedonisht e botuar nga Kuzman Shapkarevi (1891). Ato i bëjnë jehonë kësaj ngjarjeje dhe këtyre dy figurave historike. Bashkë me këngë të tjera, të botuara nga Hani (më herët) e nga mbledhës të mëvonshëm ato krijojnë një qerthull këngësh më vete, të cilat i kushtohen dy kategorive të kundërta etoke morale: viktimizimit e mashtrimit.

Përshkrimin e një atmosfere të këtillë fatkeqe e sjellin të dyja këngët e Thimi Mitkos, si dhe kënga e Shapkarevit, të cilat janë temë e studimit tonë. Në botën e tyre përshkrimore ndeshen mungesa e vigjilencës me lakminë për pushtet. Protagonistët kryesorë të këtyre tri këngëve janë Asllan bej Puçeja dhe Veli bej Jaçeja, dy pretendentë për pushtet në Perandorinë Osmane.

Megjithëse mungojnë të dhënat shtesë, mbështetur në kohën e botimit, si dhe në të dhënat e tërthorta (botimi i tri këngëve nga Hani, 1853-1855), lirisht mund të supozojmë se këngët e Thimi Mitkos, pas atyre të Hanit (1853-1855) dhe kjo e Shapkarevit janë midis këngëve të para që janë krijuar në një kohë shumë të afërt me zhvillimin e ngjarjes. Në këtë kontekst ato sjellin informacion shumë të rëndësishëm për mënyrën e krijimit e të jetesës së këngës epike, si dhe për mënyrën e reagimit të rapsodëve ndaj ngjarjeve historike.

Në secilën nga të dyja këngët që i ka regjistruar dhe i ka botuar Thimi Mitkoja, si dhe në atë të Shapkarevit, në mënyrë të veçantë i bëhet jehonë kësaj

[1057] Neziri, Zeqirja (2010), *Epika gojore shqiptare*, Shkup, 107

ngjarjeje fatkeqe dhe kësaj ndodhie shumë tronditëse e mbresëlënëse. Ato si variante që janë plotësojnë njëra-tjetrën dhe të trija bashkarisht krijojnë atmosferën e pasqyrimit të plotë të kësaj masakre. Varianti **403**[1058] ka **29 vargje**, varianti **404**[1059] ka **33 vargje**. Sipas kësaj del se varanti 403 pjesërisht është më i thjeshtë, përballë variantit të dytë, i cili pjesërisht është më i zgjeruar për katër vargje. Megjithatë të dyja këto variante dalin shumë të thjeshta, në krahasim me variantin e Shapkarevit[1060] , e cila ka **89 vargje**. Për nga sasia duket sikur kënga në maqedonisht e Shapkarevit është dyfish më e gjatë. Por të trija bashkarisht mundësojnë të ndërtohet arketipi.

Zgjerimet dhe ndryshimet dalin në tri skena:

(a) në pjesën pas arritjes në Manastir dhe para skenës që përshkruan qitjen e ushtarëve të Sadriazemit;

(b) dialogun sinkronik epik midis Veli e Asllan beut, në variantin e Mitkos, si dhe dialogun epik midis Pashait dhe Veli beut, në variantin maqedonisht të Shapkarevit; si dhe

(c) fundin e këngës, i cili, në të tria variantet mbyllet në mënyra të ndryshme.

Përkundër këtyre mospërputhjeve në strukturimin e përshkrimit, këngët midis tyre kanë përputhshmëri të plotë në të dhënat kryesore: përgatitjen për Manastir, planin, mirësjelljen e Pashait, ceremoninë e pushkatimit dhe përfundimin.

Dy variantet e Thimi Mitkos

Të dyja këngët e Thimi Mitkos në strukturën e tyre kompozicionale ruajnë: përshkrimin epik, gjerësinë përshkrimore, dialogun epik sinkronik dhe mbylljen. Në aspektin struktural këngët ndahen në tetë njësi, tri prej të cilave kanë nga dy ose tri nënnjësi përshkrimore: marrëveshja e protagonistëve, vendimi dhe qëllimi i pranimit të ftesës, si dhe i pjesëmarrjes në këtë manifestim, gostia, dialogu epik: afërsia e Veliut me pashain (intriga), ironia e Asllanit; përshkrimi i shkallëzuar i kurthit të Pashait, qortimi dhe përfundimi.

1. Në katër vargjet e parë njihemi me marrëveshjen midis dy protagonistëve të pranojnë dhe t'i përgjigjen ftesës së pashait të Manastirit: Asllan dhe Veli beu në Mecovë bëjnë marrëveshje se në Manastir, përveç nishaneve të premtuara nga pashai do të kërkojnë edhe njohjen e tyre si sundimtarë të krahinave:

Asllan beu me Veli benë,
Në Mecovë bënë benë:
Në Manastir do të venë,
Të kërkojnë ylefenë.

[1058] Mitko, Thimi (1981), *Vepra*. Përgatitur nga Q. Haxhihasani, Tiranë, 287-288

[1059] Po aty, 288-289

[1060] ШАПКАРЕВ, Кузман А. /Собрал и издава/ (1891), *Сборник од балгарски народни умотворенија*. Част прва. Простонародна блгарска поезија или блгарски народни песни. Отдел III. Книга III. Песни из политическиј живот, Софија.

2. Por ata kanë edhe një **plan shtesë**, i cili shpjegohet në dy vargjet në vijim:

Po s'ua dha me të mirë,

Do të djegin Manastirë.

Pra, kanë planifikuar që, nëse pashai me dëshirë nuk ua njeh meritat, atëherë do ta djegin Manastirin.

3. Mirëpo pashai mendon ndryshe. Ai ka përgatitur kurthin, të cilin këta nuk mund ta imagjinojnë. Për t'i nderuar mysafirët ai kishte përgatitur një gosti madhështore:

Veziri bëri gostinë,

Thirri Asllan' e Velinë.

4.0. Të dy bejlerët mashtrohen nga kjo gosti madhështore. Në skenën vijuese, të realizuar përmes pesë vargjeve në formë të **dialogut epik** midis Asllan e Veli beut mësojmë se Veliu kishte afërsi të madhe me pashanë. Kjo bisedë e tyre, në të dyja variantet paraqitet në dy mënyra të ndryshme. Në variantin e parë (kënga 403) jepet shumë shkurtimisht, ndërkaq në variantin e dytë (kënga 404) zgjerohet dukshëm dhe me këtë zgjerim kënga fiton shprehshmëri më të madhe dhe qartësi më të plotë.

4.1 Në fakt varianti i dytë (kënga 404) e zgjeron përshkrimin me një varg shtesë. Ky varg e plotëson edhe më shumë këngën e parë dhe fjalës së Asllan beut i jep vërtetësi më të madhe, si dhe funksion më të lartë artistik:

Tek i thirri mbë të parë,

Asllan beu foli një fjalë:

- Ec' o Veli bej, më parë,

Se veziri t' ka si djalë.

Ndaj të thërret mbë të parë (k. 404).

Dialogu i dy protagonistëve në këngën e parë (k. 303) mbyllet me dy vargje, në të cilët përshkruhet ofendimi që ndien Veli beu nga fjalët e Asllan beut. Ndaj ky i prekur në sedër i përgjigjet:

Veli beut i erdhi rëndë,

Tha: - O Asllan, mos u trëmb (k. 403).

4.2. Kjo pjesë e dialogut në këngën e dytë (404) zgjerohet dukshëm. Ky zgjerim sjell dykuptimësinë: (a) vendosmërinë dhe besimin e verbër të Veli beut, si dhe (b) rritjen e dyshimit të Asllan Beut. Dy vargjet në vijim, sidomos vargu i fundit i kësaj skene (*Nukë vret babaj të birë.*) flasin se Veli beu kishte besim të madh te pashai:

Asllan bej, mejtohu mirë,

Nukë vret babaj të birë.

Në këtë skenë të zgjatur të këngës së dytë na paraqitet parandjenja e Asllan beut, kur i kërkon Veli beut të mos futen në brendi të paradës ushtarake:

- Veli bej, o mëndjehollë,

Mos na shtjerë në taborë.

5. Gjerësia përshkrimore e masakrës e paraqitur në mënyrë **të shkallëzuar** përshkruan befasinë që u kishte përgatitur veziri. Kjo mënyrë përshkrimi përkon me

të gjitha krijimet e gjata epike dhe është në harmoni me to. Kjo tregon se kënga jo vetëm që ka ruajtur, por edhe ka kultivuar traditën. Të kujtojmë këtu tri kërkesat e Bajlozit, si dhe kërkesat e tre nallbanëve që duhet t'i plotësonte motra e Gergj Elez Alisë. Megjithatë kjo skenë përshkrimore lidhshmëri akoma më të madhe ka me këngët e periudhës së Rilindjes Kombëtare, sidomos ato që thurren rreth ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si dhe me ato të Pavarësisë.

Përshkrimi, si zakonisht ngjet në këngët e gjata epike. Ai është ngritur në paralelizëm nëpër tri shkallë, të cilat janë ndërtuar me të njëjtat fjalë, me ndryshim vetëm te numrat: *batareja e parë*, *e dytë* dhe *e tretë*. Por secila ka funksion të veçantë dhe shpjegohet me vargun shoqërues pasues. Në të trija rastet përshkruhet nga një akt, nga një gjendje shpirtërore e veçantë e mënyrës së rënies së Asllan beut, i cili në të parën *lonte revanë*, në të dytën *po hapte sytë*, ndërkaq në të tretën *bëri përpjetë*. Kjo situatë përshkrimore jep të kuptohet sikur Asllan beu kalonte nëpër tre momente të rënda shpirtërore, sikur ishte në gjumë dhe zgjohet vetëm pas batares së dytë, që pas të tretës të marrë vendim përfundimtar nga t'ia mbathë:

Kur ra batareja e parë,
Asllan beu lonte ravanë.
Kur ra batareja ***e dytë****,*
Asllan beu po hapte sytë.
Kur ra batareja ***e tretë****,*
Asllan beu bëri përpjetë.

Në këngën e dytë (404) mungon kategoria e tretë e shkallëzimit. Në të janë të pranishëm vetëm dy të parat. Përshkrimi në të mbyllet me bataren e dytë. Megjithatë, përshkrimi i ikjes së Asllan beut jep të nënkuptohet se është i pranishëm. Në aspektin faktografik kjo krijon mundësi të mendohet, ndoshta, Asllan beu nuk e ka pritur bataren e tretë, domethënë e ka kuptuar kurthin dhe menjëherë ia ka mbathur.

6. Pjesa më e plotë e zgjerimit të këngëve paraqitet në përshkrimin e veçantë të mënyrës së ikjes e të vdekjes së Asllan beut. Kjo skenë shtesë, në variantin e dytë (404) të këngës në hollësi e përshkruan mënyrën e ikjes, të ndjekjes e të zënies së tij. Kjo skenë mungon në variantin 403. Ky përshkrim është i ndarë në tre dyvargësha. Kjo skenë tërësisht realizohet përmes tri situatave përshkrimore: (1) arratisjes së Asllan beut; (2) përhapjes së lajmit në taborin e ushtrisë osmane se ai ka shpëtuar i gjallë; dhe (3) përgatitjeve për ta zënë.

6.1 Në dyvargëshin e parë njihemi me arratisjen e Asllan beut. Mësojmë se ai i është ngjitur malit të Dhiavatit dhe po përpiqet të largohet nga kasaphana e përgatitur.

Në Dhiavat të Manastirit, (k: 404)
Asllan beu i hypi çilit.

6.2 Dy vargjet vijuese përshkruajnë përhapjen e lajmit se Asllan beu i shpëtoi kasaphanës dhe po përpiqet të ikë:

Sadrazemit van' i thanë:
- Asllan beu shpëtoi i gjallë.

6.3. Dy vargjet e fundit të kësaj skene shtesë,në bariantin 404 përshkruajnë vendimin e pashait që Asllan beu të ndiqet deri në vdekje. Për zënien e tij angazhohet Qorr pashai:

- *Shpejtoni mbë Qor pashanë.*

Asllan ben' e duan gjallë. (k: 404).

7. Njësia e shtatë përshkrimore është e njëjtë në të dyja variantat. Me dy vargjet në vijim njësoj përshkruhet qortimi i rapsodit dhe paralajmërimi i fundit të jetës së tij. Përpjekja për të ikur është e kotë:

Ikë, ikë o çil i shkretë,
Se Qor pasha na vjen vetë.

8. Në njësisë e tetë është përfundimi, i cili është i njëjtë në të dyja variantat. Por edhe këtu vërejmë dallime, përkatësisht hasim zgjerime. Përfundimi i përshkrimit të ngjarjes në të dyja variantet është i ndryshëm. Në variantin e parë kënga zgjerohet me dialogun midis Asllan beut dhe Qorr pashait, ndërkaq në variantin e dytë (404) kënga mbyllet pa këtë zgjerim.

8.1 Katër vargjet vijues përshkruajnë përfundimin e jetës së dy protagonistëve. Me ta mbyllet edhe kënga e variantit të dytë (404):

As e shihni Qor pashanë,
Se si ka përveshur krahnë,
Marrë garginë me nj'anë,
Për Velinë për Asllanë![1061]

8.2. Megjithatë, edhe në variantin 403 vërejmë një zgjerim: në të shtohen tri vargje me tekst në turqisht, ku përshkruhet zhvillimi i një bisede midis Asllan beut dhe Qor Pashait:

- *"Nere gjidersën", bre halldup? (ku po shkon)*
- *"Sana isterem Arnaut". (Ty po të lyp shqiptar)*
- *"Emir eder Sulltan Mahmut". (Nep urdhër). /*[1062]

Qortimi i nënës

Edhe kënga në maqedonist ka ruajtur strukturën kompozicionale të këndimit epik. Për dallim nga këngët shqipe, në të cilat të dy protagonistët Asllan dhe Veli beu paraqiten në mënyrë të barabartë, në këngën maqedonase personazh kryesor është Veli beu dhe përgjithësisht kënga i kushtohet atij. Asllan beu është personazh dytësor dhe paraqitet vetëm në skenën e arritjes në Manastir dhe vajtjes në gosti te Pasahi. Edhe kënga maqedonase, po ashtu ndahet në gjashtë njësi tematike me nga tri nënnjësi në njësinë e tretë, të pestë e të shtatë. Nis me qortimin e nënës, vijon me përshkrimin e arritjes në Manastir dhe takimin me Asllan beun e me Vezirin dhe bisedën me këtë, qortimin e rapsodit; vajtjen në gosti, përshkrimin e planit të Pashait, konsultimi i Veliut me ushtarët, përfundimi që përshkruhet në tri shkallë.

[1061] Mitko, Thimi (1981), *Vepra*. Përgatitur nga Q. Haxhihasani, Tiranë,
[1062] Po aty

1. Qortimi i nënës (v. 1 – 8) [1063]. Kënga nis me qortimin e Veli beut nga nëna e tij që të mos shkojë në Manastir, sepse Sadriazemi është i hidhëruar me rrebelimin e tij, si dhe me fushatën e marrjes së Janinës, banorët e të cilit janë luftëtarë, por dhe armiq.

2. Takimi me Asllan beun (v. 9 – 19) [1064]. Veli beu nuk e dëgjon të ëmën. Mbledh një ushtri kolonjarësh dhe shkon në Manastir. Manastiri dridhet nga ushtarët e tij. Në kafene takohen me Asllan beun dhe bisedojnë të shkujdesur: këmbën mbi këmbë.

3. Takimi dhe biseda me Vezirin (v. 20 – 39). Andej kalon Veziri. Përshëndetet prej të gjithëve, por edhe nga Veli beu (v. 20 – 23)[1065]. Zhvillohet një bisedë midis Vezirit dhe Veli beut. Kjo bisedë zhvillohet në tri shkallë: pyetja e Vezirit, përgjigja e Veli beut dhe kurthi.

3.1 Veziri (v. 24 – 27) [1066] kërkon shpjegim nga Veli beu pse nuk ia merr përshëndetjen dhe pse është i zemëruar në të.

3.2 Veli beu (v. 29 – 32)[1067] arsyetohet se tri herë ka bërë kërkesa për pagat e mbetura, por në asnjërën pashai nuk ka marrë përgjigje.

3.3 Veziri (v. 33 - 39) [1068] kërkon nesër të shkojnë në zyrat e tij, ku do të shtrojnë një gosti dhe, ndërkohë do t'u paguhen pagat.

4. **Mashtrimi** i Veli dhe Asllan beut (v. 40 – 43)[1069]. Të dy bejlerët mashtrohen: pranojnë të shkojnë në gosti te pashai.

5. Kurthi dhe përfundimi (v. 44 – 89). Kjo skenë përbën gati gjysmën e këngës. Është e ndërtuar në dy pjesë: në njërën shpaloset plani i Vezirit për mënyrën e vrasjes së Veli dhe Asllan beut (v. 47 – 62); ndërkaq në të dytën përshkruhet mënyra e aplikimit të të planit të tij (v. 63 – 89): mënyra e vrasjes së dy bejlerëve shqiptarë.

5.1 Pashai bën gostinë (v. 44 – 45)[1070] dhe u shpjegon ushtarëve si të veprojnë gjatë demonstrimit të paradës (v. 46[1071] – 62).

[1063] Вели бег мајка караше: / „Не оди, синко не оди, / Не оди во град Битола; / На тебе лут је Везирот, / Везирот, Садриазамот, / Зашч(о) го пленифте Кожани. / Кожанци ти се душмани, / Тешки давии сториле!"

[1064] Вели бег мајка не слушат, / Многу си аскер собрало; / Поведе Тоски Колунци, / Право ми тргат Битола: / Битола, ми ја наполни, / Битола ми ја потресол!

[1065] Тука ми Везир поминал. / Везирот селам даваше; / Сите му селам зедоа. / Вели бег селам не зеде.

[1066] Тогај му Везир велеше: / „Вели бег, чедо царево! / Шчо си на мене налутен? / Шчо лошо јас сум ти сторил?"

[1067] „Везире, Садриаземе! / Како да не сум налутен? / - Три пати дајдоф на индат, / Ајлокот не си ми платил!"

[1068] Утре да дојдеш Довледжик; / Тамо ке ручек ручаме, / Есабот ке си сториме; / Сарафи пари ке проиат, / Граматици ке пишеет, / Аилокот да си семите".

[1069] Вели бег ми се исмами, / Со Арслан бега заедно / Пра(в)о ми о(ти)шле Довледжик; / Тоските зеле со себе.

[1070] Паша зииафет направил / Довледжик, ручек ручале,

[1071] Тога ми велит пашата / На сфојте си аскер, повелат: /„Слушајте, царски сино(в)и: / Ај да си талим сторите; / Сеир ние ке чиниме!" / Пашата шчо (м)и научил; / Перви талим ке сторите, / Куршуми да не клавате, / От как(о) ке талим сторите, / Тоските ке (г)и натерам, / И тије ке талим стореет, / От как(о) ке талим стореет, / Бории ке засфиреет. / Тога (в)и пушки да полните, / Да (г)и полните с(о) куршуми. / От как(о) ке Тоски испразнат, / На ними да си удрите".

5.2 Pastaj i drejtohet Veli beut që t'u thotë ushtarëve të tij të demonstrojnë (v. 63 – 69)[1072].

5.3 Rapsodi e qorton Veli beun që u mashtrua (v. 70 – 71)[1073].

5.4 Veli beu që ta plotësojë kërkesën e Pashait i drejtohet ushtarëve të tij të demonstrojnë me pushkë të zbrazura. Kjo skenë prëshkruhet në vargjet 72 – 74[1074].

5.5 Në vargjet vijuese (75 – 89) përshkruhet mënyra e realizimit të planit të pashait:

5.5a Ushtarët e Veli beut bëjnë detyrën në vrojtimin e Vezirit dhe kur zbrazin pushkët bien boritë dhe ushtarët përgatiten (v. 75 – 79) [1075].

5.5b Derisa ushtarët e Veliut i mbushnin pushkët ushtarët e Vezirit nisin të qesin mbi ta dhe i shpartallojnë (v. 80 – 84)[1076].

5.5c Në vargjet vijuese (85 – 89)[1077] përshkruhet se Veli beu, kur sheh se ç'u bë nisë të ikë, por e zënë ushtarët e Vezirit dhe e mbysin bashkë me ushtarët e tij.

Përfundim

Lindja e këtyre këngëve nën ushtimën e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të ngjarjeve, fut në brendi të tyre mbresa, përshtypje, gjykime, lëndë faktike dhe elemente social-kulturore konkrete. Është theksuar nga studiuesit se kënga nuk ka synim ta riprodhojë realitetin historik me gjuhën e dokumentacionit. Megjithatë, ajo sjell kaq të dhëna me interes për karakterin dhe zhvillimin e konflikteve, psikologjinë dhe botën shpirtërore të personazheve, marrëdhëniet shoqërore, sistemin ekonomik administrativ e ushtarak të kohës, saqë e bëjnë atë të jetë dëshmi me interes për mbështetjen në të të historisë kombëtare.

Vëmendja e rapsodëve e kushtëzuar nga kërkesat e dëgjuesit, lidhet gjithmonë me faktet shoqërore politike të jetës reale, me luftën kundër pushtuesit dhe me çlirimin prej tij. Forcohet edhe karakteri kronologjik – fiksimi i ngjarjeve që rrjedhin njëra pas tjetrës. Nga pikëpamja e ndërtimit artistik, këngët, krahas elementeve që vijnë nga një traditë autoktone të përpunuar prej shekujsh, fitojnë edhe elemente të reja.

Kënga gjithmonë me një vetëdije kritike ka përcjellë ngjarjet historike. Kjo periudhë e këngës epike shqiptare konsiderohet etapë bazë e konsolidimit të këngës së mirëfilltë epike shqiptare me temë historike, sepse tani kemi të bëjmë me ngjarje e probleme të mëdha e të përbashkëta, që dalin nga qortimet e rapsodëve. Me këtë unitet tiparesh, duke sjellë jehonën e ngjarjeve të veçanta që ndodhin në çdo krahinë, kënga e kësaj periudhe jeton në të gjitha krahinat shqiptare. Me këto tipare

---

[1072] Тога им Паша по(в)елал: / „Вели бе, чедо царево! / Натерај Тоски, Колунци, / И тие талим да сторат; / Да чујам пушки Тоскински, / Да видам талим Колунски, / Какоф ми талим имате".

[1073] Вели бег ми се измами, / Натера Тоски Колунци:

[1074] „Слушајте, моjте сино(в)и! / Хај и ви(е) талим сторите, / Везир ке сеир починит!"

[1075] Како (г)и Тоски натера, / И тие талим сторија; / Везирот сеир чинеше. / Колку ми пушки (и)спразнале, / Бории ми засфириле;

[1076] Хазар се аскер стори(j)а. / Дури да Тоски наполнат, / Аскерот на ним (им) фрла(j)а; / Силен ми jуруш стори(j)а, / Тоските ми (г)и скершија,

[1077] Вели бег тога побегна; / Хатлии ми се спушти(j)а, / И него ми го фати(j)а, / Есабот (!?) му го плати(j)а, / Сите му тоски загубил!

bazë, duke u pasuruar edhe me elemente të reja në raport me realitetin historik, ajo do të vazhdojë të përforcojë jetën e saj edhe në etapat e ardhshme

Shtojcë:

1. Nga Thimi Mitko:

403

Asllan beu me Veli benë,
Në Mecovë bënë benë:
Në Manastir do të venë,
Të kërkojnë ylefenë.
Po s'ua dha me të mirë,
Do të djegin Manastirë.
Veziri bëri gostinë,
Thirri Asllan' e Velinë.
Tek i thirri mbë të parë,
Asllan beu foli një fjalë:
- Ec' o Veli bej, më parë,
Se veziri t' ka si djalë.
Veli beut i erdhi rëndë,
Tha: - O Asllan, mos u trëmb.
Kur ra batareja **e parë**,
Asllan beu lonte ravanë.
Kur ra batareja **e dytë**,
Asllan beu po hapte sytë.
Kur ra batareja **e tretë**,
Asllan beu bëri përpjetë.
Ikë, ikë o çil i shkretë,
Se Qor pasha na vjen vetë.
As e shihni Qor pashanë,
Se si ka përveshur krahnë,
Marrë garginë me nj'anë,
Për Velinë për Asllanë!
-"Nere gjidersën", bre halldup? (ku po shkon)
-"Sana isterem Arnaut". (Ty po të lyp shqiptar)
-"Emir eder Sulltan Mahmut". (Nep urdhër).

404

Asllan beu me Veli bejnë
Në Mecovë bënë benë,
Në Manastir do të venë,
Të kërkojnë ulefenë.
Po s'ua dha me të mirë,
Do ta djegim Manastirë.
Veziri bëri gostinë,
Thirri Asllan' e Velinë.
Asllan beu foli një fjalë:
- Ec, o Veli bej, më parë,
Se veziri të ka djalë,
Ndaj të thërret mbë të parë.
Asllan bej, mejtohu mirë,
Nukë vret babaj të birë.
- Veli bej, o mëndëjehollë,
Mos na shtjerë në taborë. (shtesë)
Kur ra batareja e parë,
Veli beu ra i vrarë.
Asllan beu lonte rahvanë.
Kur ra batareja e dytë,
Asllan beu po hapte sytë.
Në Dhiavat të Manastirit,
Asllan beu i hypi çilit. (shtesë).
- Ikë, ik' o çil i shkretë,
Se Qor pasha na vjen vetë.
Sadrazemit van' i thanë:
- Asllan beu shpëtoi i gjallë,
- Shpejtoni mbë Qor pashanë.
Asllan ben' e duan gjallë. (shtesë).
Pa shihni Qor pashanë,
Se si ka përveshur krahnë,
Marrë garginë me nj'anë,
Për të rrokurë Asllanë!

(Mitko, 1981: 287-289).

II. Mbledhur e botuar nga J. G. Hahn, 1854.

11. Për Abas Thanën

Trima vet e trima beu,
Sa hoqtë faqen e dheut!
Sadrazemi ç'u gënjeu,
Ndë Manastir seç u preu.
Kush të mor të shtkretat' armë,
Pisqollat' e jataganë,
Dhe atë dyfkn' e larë?
Kush të xhveshi fermëlenë,
Edhe kokënë ta prenë?
Koka të mori Stambollë,
Kurmi të mbeti Bitolë,
Abas Thanë luleja!
Trim si Asllan Puçeja!
U vëlla zeza! Mbledhës I: 76).

14. Për një të mbetur në Manastir

Zëmëra jote me majë,
Kordha jote me bëtajë;
Kur e nxierë nga milli,
Lëftoje vetëmë filli.
Kur dalje në Rumeli,
Thoshnë gjithë: "Çisht ai?"
Agai me tevabi,
Aga seç përsuatë
Plumbatë që muartë?
Me nam o aga!
(Mbledhës I: 77).

379

Вели бег мајка караше:
„Не оди, синко не оди,
Не оди во град Битола;
На тебе лут је Везирот,
Везирот, Садриазамот,
Зашч(о) го пленифте Кожани.
Кожанци ти се душмани,
Тешки давии сториле!“
Вели бег мајка не слушат,
Многу си аскер собрало;
Поведе Тоски Колунци,
Право ми тргат Битола:
Битола, ми ја наполни,
Битола ми ја потресол!
Вели бег шчо ми кондисал
На кафе()аната висока.
Нога на нога седнало,
Со Арслан бега заедно.
Голем му()абет чинеет.
Тука ми Везир поминал.
Везирот селам даваше;
Сите му селам зедоа.
Вели бег селам не зеде.
Тогај му Везир велеше:
„Вели бег, чедо царево!
Шчо си на мене налутен?
Шчо лошо јас сум ти сторил?“
Бели бег му говореше:
„Везире, Садриаземе!
Како да не сум налутен? -
Три пати дајдоф на индат,
Ајлокот не си ми платил!“
„Вели бег, чедо царево!
Утре да дојдеш Довледжик;
Тамо ке ручек ручаме,
Есабот ке си сториме;
Сарафи пари ке проиат,
Граматици ке пишеет,
Аилокот да си семите“.
Вели бег ми се исмами,
Со Арслан бега заедно
Пра(в)о ми о(ти)шле Довледжик;
Тоските зеле со себе.
Паша зииафет направил
Довледжик, ручек ручале,
Тога ми велит пашата
На сфојте си аскер, повелат:
„Слушајте, царски сино(в)и:
Ај да си талим сторите;
Сеир ние ке чиниме!“
Пашата шчо (м)и научил;
Први талим ке сторите,
Куршуми да не клавате,
От как(о) ке талим сторите,
Тоските ке (г)и натерам,
И тије ке талим стореет,
От как(о) ке талим стореет,
Бории ке засфиреет.
Тога (в)и пушки да полните,
Да (г)и полните с(о) куршуми.
От как(о) ке Тоски испразнат,
На ними да си удрите“.
Тога им Паша по(в)елал:
„Вели бе, чедо царево!
Натерај Тоски, Колунци,
И тие талим да сорат;
Да чујам пушки Тоскински,
Да видам талим Колунски,
Какоф ми талим имате“.
Вели бег ми се измами, -
Натера Тоски Колунци:
„Слушајте, мојте сино(в)и!
Хај и ви(е) талим сторите,
Везир ке сеир починит!“
Како (г)и Тоски натера,
И тие талим сторија;
Везирот сеир чинеше.
Колку ми пушки (и)спразнале,
Бории ми засфириле;
Хазар се аскер стори(ј)а.
Дури да Тоски наполнат,
Аскерот на ним (им) фрла(ј)а;

Силен ми јуруш стори(ј)а,
Тоските ми (г)и скершија,
Вели бег тога побегна;
Хатлии ми се спушти(ј)а,
И него ми го фати(ј)а,
Есабот (!?) му го плати(ј)а,-
Сите му тоски загубил!
(Shapkarev 1891: 181-183)

SHTOJCË

DOKUMENTE PËR "BLETËN SHQIPTARE"

Mbledhur dhe përkthyer[1078] nga Dh. Q. Qirjazi

-I-

Dorëshkrim i Fondit Mitko, me datën 1852 dhe vargun *"më pesëdhjet' e dy senéa"*. **Kënga e regjistruar aty bën fjalë për rrethimin e Sevastopolit (shtator 1854 – shtator 1855). Viti 1852 mund të jetë shënuar më vonë, për arsye që nuk i dimë, ose të jetë datim real dhe vargjet të jenë regjistruar më pas. – Χειρόγραφο του Αρχείου Μήτκου, με χρονολ. <u>1852</u> και τον στίχο** *«το έτος πενήντα δυο»*. **Το καταγραμμένο εκεί τραγούδι αναφέρεται στην πολιορκία της Σεβαστούπολης (Σεπτ. 1854 – Σεπτ. 1855). Το έτος <u>1852</u> ίσως αποτελεί μεταγενέστερη προσθήκη, για λόγους που δεν γνωρίζουμε, ή να αποδίδει την ακριβή χρονολογία και οι στίχοι να προστέθηκαν στη συνέχεια.**



Karaiskaqi me dhjetë mijë / ungrit e vajte n' Athinë / seç na tunde Rumelinë / Rumelinë dot s'etunde / po kryet tat seç e humbe.

**Sevastopol anë deti / ç'të vuri synë Dovleti / Mempleqet' i mirë i shkreti / ç'e qëllon me top nga deti / lëfton englez' e frëncezi.*

-II-

[1078] Teksti shqip i Parathënies së 1875-s (Parthënmja) është përkthyer nga Th. Mitkoja kurse Parathënia greqisht e "Bletës" së 1878-s u përkthye prej Dr. Jani Basho dhe u botua në "Bletën" e 1924-s, përgatitur prej Gj. Pekmezit.

Από του Ελληνικού αγώνος του 1821, όστις συνταράξας όλα τα έθνη της Ανατολικής Ευρώπης (και μάλιστα το Αλβανικόν) κατέταξεν εν έκαστον αυτών υπό δύο θρησκευτικάς σημαίας, αφύπνισε δε του ληθάργου διά των πολλών φώτων, άτινα πράγματι και ομολογουμένως διέδοσε κατά την Ανατολήν, ανεφύη απανταχού η πολυθρύλλητος «των εθνικοτήτων» ιδέα. Το μέγα γεγονός του αγώνος συνεκίνησε και την λοιπήν Ευρώπην εν γένει, το τε ενδιαφέρον και το αντιδραστικόν πνεύμα Κυβερνήσεων τινών, επιδιωκόντων ιδίους σκοπούς και ιδία συμφέροντα εν τῃ Ανατολῃ. Η αντίδρασις αύτη, και εξ αρχής μεν δι' άλλων πολλών και πολυμηχάνων αντενεργειών έβλαψεν επαισθητώς τους λαούς της Ανατολής, αλλ' αι συνεχείς και αναρίθμητοι αυτής προπαγάνδαι, πλημμυρούσαι έκτοτε όλην την χώραν, και παραλύουσαι τας του αγώνος αρχάς εν γένει, καθίστανται τραύμα δεινόν διά την Ανατολήν. Διότι μετημφιεσμέναι αύται εις διδασκάλους δήθεν αθώων και σωτηρίων διδαγμάτων, ωφελούμεναι δε εκ της αμαθείας και απλοϊκότητος των διαφόρων εθναρίων εισχωρούσι και εις τα άδυτα, ούτως ειπείν, του λαού, και διαφθείρουσιν ήθη, έθιμα, και παν πατριωτικόν και ενωτικόν καθ' όλου φρόνημα αυτού, και ανάπτουσιν ανεάως το πυρ της διχονοίας και διαιρέσεως εκμεταλλευόμεναι τας υφισταμένας εθνικάς αυτών αδυναμίας και θρησκευτικάς προλήψεις. Τούτο δε όπως ματαιωθῃ διά παντός η κηρυσσομένη αδελφική ένωσις είτε όπως μη πραγματοποιηθῃ η σωτήριος, και ιερά του νυν πολιτισμού ιδέα, «η Ανατολή διά της Ανατολής».

Των πολυπληθών τούτων συμμοριών (προπαγανδών), αίτινες από της αποκαταστάσεως της Ελλάδος και μέχρι τούδε ακαταπαύστως μαστίζουσιν Ανατολήν και Ασίαν, κορωνίς είναι η Πανσλαβιστική, ήτις διά της ολεθρίας διαιρέσεως Ελλήνων και Βουλγάρων, κατέστησε την χώραν δύο πολέμια στρατόπεδα, χάριν σκοπών ιδιοτελών. – Μετ' εγκαρδίου άλγους λοιπόν βλέπω προ πολλού την τοιαύτην καχεκτικήν κατάστασην των λαών της Ανατολής, και μάλιστα των καθ' όλου Αλβανών, οίτινες, καίτοι μετ' αφελούς επάρσεως δύνανται να ισχυρισθώσιν, ότι είναι το μόνον αυτόχθων έθνος της Ελληνικής χερσονήσου, και πατήρ πολλών Ελληνικών φυλών, βοηθείᾳ δε σχηματισμού της χώρας του και δυνάμει του αρειμανίου και ανδρικού χαρακτήρος του και της φιλανεξαρτησίας του ηδυνήθη να επιζήσῃ και μετά τοσάυτην πληθύν αιώνων αρκετά αμιγές και ανόθευτον, ουχ' ήττον όμως μείναν μέχρι τούδε κοινωνικώς απροόδευτον, άνευ γραμμάτων και φιλολογίας, διηρημένον δε θρησκευτικώς και υπό τίνων επουσιωδών φυλετικών διαφορών υπόκειται εις μεγαλήτερον και σπουδαιότερον κίνδυνον παντός άλλου. Κατατρυχόμενος να φανώ χρήσιμος, έστω και επί μικρόν εις το έθνος μου, του οποίου το μέλλον προμηνύεται πολλά θλιβερόν ως εκ του επαπειλουμένου Πανσλαβισμού, εξευρών δε, κατ' εμέ κριτήν, το προς τον διακαή μου πόθον δραστικώτερον μέσον και ισχυρότερον ελατήριον, καταγίνομαι προ πολλού εις μίαν συλλογήν Αλβανικών ασμάτων, παραμυθίων, Παροιμίων, Αινιγμάτων, κυρίων Ονομάτων και λοιπών, την οποίαν απεφάσισα νυν διά του τύπου να εκδώσω, ομού με μια λεξικογραφίαν ξένων λέξεων, επί το πλείστον Τουρκικών, μεταφραζομένων Αλβανιστί και Ελληνιστί, και με εν απόσπασμα εκ της υπό της Σεβαστής Κυρίας Δώρας Ιστριάδος Πραγματείας περί Αλβανών, Η ΑΛΒΑΝΙΚΗ ΦΥΛΗ, εν τῃ Γαλλικῃ Εφημερίδι η Επιθεώρισις των δύο κόσμων, 1866, 1 Μαΐου, μεταφρασθείσης υπό του Κυρίου Δημητρίου Καμάρδα εις την Ιταλο-Αλβανικήν διάλεκτον με Λατινικά γράμματα. Καταναλώσας διά την συλλογή ταύτην επί πολλά κατά συνέχειαν έτη, κόπους και δαπάνας όχι μικράς, θεωρώ αυτήν ως το καταλληλότερον σύγγραμμα προς αφύπνισιν και ένωσιν των Αλβανών εν γένει. Διότι της συλλογής ταύτης η ύλη ούσα κοινόν δημιούργημα Χριστιανών τε και Οθωμανών Αλβανών, άνευ του παραμικρού θρησκευτικού φανατισμού, αλλά μάλλον μετά της μεγαλητέρας ανεξιθρησκείας, τούθ' όπερ είναι το κύριον χαρακτηριστικόν των Αλβανών, θα καθίσταται ευχάριστον ανάγνωσμα του τε Χριστιανού και του Οθωμανού, και διά αυτού του μέσου θα γνωρίσῃ την ιστορίαν του, την καταγωγήν του, και το ομογενές της καθ' όλου Αλβανίας. Και τέλος πάντων, προσφέρω, το επ' εμοί την ύλην ταύτην προς το έθνος μου, άμορφον και ακατέργαστον ένεκα

της αδυναμίας μου, όδε ικανώτερός μου ας κάμῃ καλυτέραν και κοινωφελεστέραν χρήσιν αυτής, διευθετών αυτήν προσφυώς και μεθοδικώς.

Εκδίδω αυτήν υπό το όνομα, η «Αλβανική Μέλιττα» = Βηλjέττα Σςκjυπητάρε, με Ελληνικά στοιχεία πλην τριών Λατινικών. Η δε τιμή του βιβλίου, συνισταμένου εξ είκοσιν ως έγγιστα τυπογραφικών φύλλων εις όγδοον, ορίζεται διά μεν τους εντός συνδρομητάς εις εξ φράγκα, διά δε τους έξω της Αιγύπτου εις εξ και ήμισυ ένεκα των εξόδων, πληρωτέα μετά την παραλαβήν του βιβλίου. Βασιζόμενος εις την γενναιοδωρίαν και τον πατριωτισμόν των ομογενών μου, ελπίζω εις δευτέραν συλλογήν να εκδώσω περισσοτέραν και πληρεστέραν ύλην, της οποίας βρίθει η Αλβανία.

Εν Καΐρῳ, 26 Μαρτίου 1874.

Ε. ΜΗΤΚΟΣ.

NJOFTIM

Qysh prej kryengritjes greke të 1821-së, e cila tronditi gjithë kombet e Evropës Lindore (e sidomos atë shqiptar) dhe e radhiti çdonjërin syresh nën dy flamuj fetarë, sikurse e zgjoi prej gjumit letargjik me dritat e shumta, që me të vërtetë e siç pranohet gjerazi i përhapi në anët e Lindjes, u shfaq gjithandej famëmadhja ide e "nacionaliteteve". Ngjarja e madhe e kryengritjes trazoi shpirtin e Evropës mbarë, si dhe ngjalli interesimin dhe frymën kundërshtuese të disa Qeverive, që synonin [realizimin] e qëllimeve të veta dhe të interesave vetiake në Lindje. Ky kundërshtim, i shfaqur qysh në fillim mes shumë veprimesh intriguese gjithfarësojesh, i dëmtoi ndjeshëm popujt e Lindjes, por edhe aktet e vazhduara e të panumërta të propagandës së tij, që vërshuan qysh ahere në mbarë vendin dhe përgjithësisht e tulatën kryengritjen në hovet e para të saj, po bëhen një plagë e rëndë për Lindjen. Sepse duke veshur petkun e mësuesve të mësimeve gjoja të padjallëzuara e shpëtimtare, ato, duke përfituar edhe prej padijes dhe naivitetit të kombtheve të ndryshëm, depërtojnë nëpër labirinthet, si të thuash, e shpirtit të popullit, dhe përçudnojnë doke, zakone, dhe çdo ndjenjë atdhetare e bashkimdashëse të tij, si dhe mbajnë ngahera ndezur zjarrin e përçarjes e të përndarjes duke shfrytëzuar dobësitë aktuale dhe bestytnitë fetare të kombtheve. Dhe këtë e bëjnë që të dështojë përgjithmonë bashkimi i shpallur vëllazëror apo që të mos hedhë shtat ideja shpëtimtare dhe e shenjtë e qytetërimit të sotëm, "Lindja nëpërmjet të Lindjes".

Mes këtyre bandave (propagandave) gjithfarëshe, të cilat qysh prej rimëkëmbjes së Greqisë e deri më sot fshikullojnë papushim Lindjen dhe Azinë, kryet e vendit e mban Pansllavizma, e cila me anë të përçarjes së grekëve dhe të bullgarëve, e ktheu vendin në dy kampe armike, për hir qëllimesh vetiake. -Më dhemb shpirti pra tek vërej prej kohësh këtë gjendje mos më keq të popujve të Lindjes, e sidomos të mbarë shqiptarëve, të cilët, edhe pse me një mburrje naive mund të pretendojnë se janë i vetmi komb autokton i Gadishullit helenik [ballkanik], dhe prind i shumë fiseve helene, se falë natyrës së gjeografisë së vendit të vet dhe në saje të karakterit luftarak e burrëror të racës si dhe të frymës së pavarësisë që e dallon, ia dolën mbanë të mbijetojnë edhe pas kaq shekujsh e të mbeten mjaft të pastër e të papërzier, veçse, gjer më sot shoqërisht jo më pak të prapambetur, pa shkronja e letërsi, të ndarë fetarisht dhe për shkak të disa ndryshimeve krahinore që s'ngrejnë peshë, ndodhen në rrezik më të madh e më të rëndë sesa çdokush tjetër. Me merakun për të qenë i dobishëm, qoftë edhe njëçikëz, për kombin tim, e ardhmja e të cilit përvijohet mjaft trishtuese për shkak të Pansllavizmës që po i turret; duke qenë se gjeta, sipas gjykimit tim, mjetin më efektiv dhe motivin më të fuqishëm të përmbushjes së dëshirës sime të zjarrtë, po merrem prej shumë kohësh me një përmbledhje këngësh, përrallash, fjalësh të urta, gjëagjëzash, emrash vetiakë etj., të farës shqiptare, të cilën tashmë kam vendosur ta botoj në shtypëtore, së bashku me një fjalorth fjalësh të huaja, shumica turke, përkthyer shqip dhe greqisht, [shoqëruar] edhe me një pjesë të studimit rreth shqiptarëve, me titull FILIA SHQIPTARE, të Zonjës së Nderuar Dora d' Istria, botuar në gazetën franceze "Revistë e dy botëve", 1866, 1 maj, përkthyer prej Zotit Dhimitër Kamarda me shkronja latine në të folmen italo-shqiptare. Pasi harxhova për mjaft mote me radhë mund të madh e shuma jo të vogla për këtë përmbledhje, e konsideroj atë si librin më të përshtatshëm për zgjimin dhe bashkimin e mbarë shqiptarëve. Sepse lënda e kësaj përmbledhjeje, duke qenë krijim i përbashkët i shqiptarëve të krishterë e myslimanë, pa as më të voglin fanatizëm fetar, por mbase me më të madhen tolerancë fetare, e cila është edhe veçoria dalluese themelore e shqiptarëve, do të bëhet një lexim i këndshëm për të krishterin e myslimanin, e me anë të atij mjeti ka për të njohur historinë e vet, rrënjët e veta, dhe indin lidhës të njëjtë të mbarë Shqipërisë. Dhe tek e mbramja, po ia ofroj kombit tim këtë lëndë, të palëmuar e të papërpunuar, për shkak të pamundësisë sime; [dikush] më i zoti se unë le ta përdorë më mirë e në dobi të më shumë njerëzve, duke e renditur me përkushtim e dituri.

Po e botoj me titullin «Αλβανική Μέλιττα» = Βηλjέττα Σςκjυπητάρε [Bëleta Shqypëtare], me shkronja greke përveç tri syresh të latinishtes. Çmimi i librit, që do të përmbajë rreth njëzet fashikuj tipografikë tetësh, caktohet gjashtë franga për pajtimtarët e ndodhur brenda, dhe gjashtë e gjysmë për ata jashtë Egjiptit, për shkak të shpenzimeve [të postës]; [që] do të paguhen pasi të merrni librin. Bazuar në shpirtin e madh dhe në patriotizmën e bashkëkombësve të mi, kam shpresë se në një përmbledhje të dytë do të botoj lëndë më të bollshme e më të plotë, që haset me shumicë gjithandej nëpër Shqipëri.

Emra pajtimtarësh të "Bletës", shënuar në pjesën e poshtme të fletëve të NJOFTIM-it të marsit 1874. Këtu duken pajtimtarët nga Fesna e Egjiptit (shih edhe Katalogun e pajtimtarëve te "Bleta" e Aleksandrisë) – Ονόματα συνδρομητών της «Μελισσας», σημειωμένα στο κάτω μέρος της ΑΓΓΕΛΙΑΣ του Μαρτίου 1874. Εδώ φαίνονται οι συνδρομητές από Φέσνα Αιγύπτου (βλ. και κατάλογο συνδρομητών στην «Αλβ. Μέλισσα» Αλεξάνδρειας)

Listë pajtimtarësh nga Minet el Gamh, e së njëjtës përmbajtje me katalogun e botuar te "Bleta" e Aleksandrisë – Λίστα συνδρομητών από Minet el Gamh, ιδίου περιεχομένου με τον κατάλογο συνδρομητών της «Μέλισσας» Αλεξάνδρειας



Boca të Parathënies greqisht, 10 mars 1875
Τυπογραφικά δοκίμια του ελληνικού Προλόγου, 10 Μαρτίου 1875





μνθοδία.

Β) Παρακίβια, καὶ

Γ) Λεξικὸν τῶν ξένων λέξεων, ὡς ἐπὶ τὸ πλεῖστον Τουρκικῶν, ἀπαντωμένων εἰς τὰ ἄσματα καὶ ἀλλαχοῦ, μεταφραζομένων Νεοελληνιστὶ καὶ Ἀλβανιστί.

Παρέλειψα νὰ προσθέσω, κατὰ τὸν ὑπάρχοντά μου, τὰ νομογνωμικὰ καὶ κύρια ὀνόματα, διότι δὲν μοὶ ἐντέλλοντο ἐγκαίρως οἱ ἀναγκαιότεροι συμπάτριοι, ἂν καὶ τὸ βιβλίον κατέστησαν ἐγκαιδότερον ἀφ' ὅτι προσεδόκουν ἐγὼ, καὶ ὑπαρχέτω διὰ τῆς ἀγγελίας μου. Ἐλπίζω δὲ εἰς δευτέραν ἔκδοσιν νὰ συμπληρώσω καὶ τὰ στίλη τῶν ἐλλιπῶν ἀσμάτων καὶ ταῦτα.

Ζητῶ συγγνώμην διὰ τὰ ὀρθογραφικά μου λάθη, τὰ μὲν διότι δὲν ὑπάρχει γραμματικὴ τῆς γλώσσης μας, καὶ ἐγὼ δὲ μικρὸν πάρεργον ἔχω αὐτὴν· τὰ δὲ διότι ἡ τύπωσις τοῦ βιβλίου ἔγινε μακρὰν τοῦ τόπου τῆς διαμονῆς μου, καὶ ἐπιτρόπους ἔχι ὑπὸ τὸν ὄμματα ἐπιστασίαν μου.

Ὡς δὲ πρὸς τὸ ὕφος τῆς Ἀλβανικῆς γλώσσης μετεχειρίσθην ἐνίοτε τύπους τῆς γενικῆς διαλέκτου, διότι αὐτοὶ εἶναι ἁπανταχοῦ εὐτροπώτερα καὶ πλουσιώτερα πρὸς παραγωγήν, καὶ οἱ τύποι δὲ τῶν μετεχῶν αὐτῆς εἶναι ἐπὶ τὸ ἑλληνικώτερον.

Καθὼς εἶπον ἐν τῇ ἀρχῇ τοῦ Προλόγου μου, ἐφιλοτίμησα τὸ παρὸν συγγράμματον, μόνον καὶ μόνον διὰ νὰ φανῶ ὠφέλιμος εἰς τοὺς ὁμογενεῖς μου, καὶ εἰς πάντας τοὺς περὶ τοιούτων γλωσσικῶν ζητημάτων ἐνδιαφερομένους, διότι ὑπὲρ πάντα ἄλλον ἐγὼ προσεπάθησα τὰς ἐλλείψεις μου. Ἂν ὅμως ἐνοπίον ὅτι ἔχω, ἔστω καὶ μικρόν τινα εἶδος τὸ βιβλίον μου τοῦτο, θὰ προσπαθήσω νὰ τὸ συμπληρώσω, ὅσον τὸ δυνατὸν, καλλίτερον ἐν δευτέρᾳ ἐκδόσει.

Ἐν Καΐρῳ Αἰγύπτου, τὴν 10, Μαρτίου, 1875.

Σ. ΝΙΚΟΛ.

Πρόλογος α΄ έκδοσης της «Αλβανικής Μέλισσας», Μάρτιος 1875 – Parathënie e motërzimit të parë të "Bëletës Shqypëtare", mars 1875

Τολμήσας να δημοσιεύσω διά του τύπου την ύλην του παρόντος βιβλίου, δεν εκινήθην ούτε υπό υλικού συμφέροντος, ούτε υπό αδυναμίας τινός προς φιλολογικήν επίδειξιν· όχι, ουδέτερον τούτων με ώθησεν εις το τοιούτον τόλμημα, και έστω απόδειξις η αγοραία τιμή του βιβλίου μου κατά τους παρόντας μάλιστα καιρούς, και αυτό τούτο το οιονδήποτε πόνημά μου, όπερ εξελέγχει με μάλλον φιλόπονον σταχυολόγον, ή επιστήμονα γεωπόνον. Κύριον ελατήριόν μου υπήρξεν απλούν αίσθημα καθήκοντος, πόθος τις εκ νεαρής ηλικίας εν εμοί συλληφθείς, και μετ' εμού ανδρωθείς να φανώ ποτε καγώ χρήσιμος εις την φυλήν μου την Αλβανικήν, ήτις κακή τη μοίρα υπό μεν των γνησίων τέκνων της παραμεληθείσα, εκ δε των συγγενών της αφρόνως εγκαταληφθείσα, εκ δε τούτου νοσούσα αιώνιον πολύπλοκον νόσημα, κινδυνεύει εν τω μέλλοντι να διαμελισθή, ή και ν' απορροφηθή. Αι επόμεναι σκέψεις, νομίζω, ότι θα με δικαιολογήσωσιν.

Ο μέγας, του 1821, πνευματικός αγών, εξανάψας από οικείας ύλης μέγαν πυρσόν, ανέτειλεν ομολογουμένως φως ανέσπερον διαφωτίσας την Ανατολικήν Ευρώπην, τας οικείας νήσους, την μικράν Ασίαν, και υπό τινά έποψιν και την μεγάλην. Αναγράψας δε επί της πολιτικής σημαίας του, «Μία ποίμνη και εις ποιμήν διά την Ανατολήν» συνεκρότησε και εδημιούργησε συμφώνως τη παγκοσμίω αποστολή του τον κατά ποσόν και ποιόν και κατά ποικίλας φάσεις παράδοξον καθόλου βίον αυτού, και ούτω διεχάραξε διά παντοίων θυσιών και δι' εαυτόν και διά την Ανατολήν ακριβή και ιστορικώς επίζηλον εποχήν πλήρη παντοδαπών συνεπειών και αποτελεσμάτων. Αφυπνίσας δε και διασείσας τα υπό δύω θρησκευτικάς σημαίας τασσόμενα έθνη της Ανατολής και μάλιστα την Αλβανικήν φυλήν, είπεν ιδιαιτέρως προς αυτήν, παρωδήσας δικαιωματικώς το ιερόν λόγιον «Μη νομίσητε ότι, ήλθον βαλείν ειρήνην επί την γην σου, ουχί, αλλά πυρ και σίδηρον· ήλθον γαρ διχάσας τέκνα κατά πατέρων, και αδελφούς κατά αδελφών, έως αν, βαπτιζομένη εν τω αίματί σου, εξαγνισθής εν τη αδελφική ενώσει». Είπε και εγένετο. Αρχίζει η πολυχρόνιος εκείνη και αγρία αιματηρά σύγκρουσις, ήτις εκπλήττει και συγκινεί και τα πορρωτέρω έθνη και τους λαούς της τε Εσπερίας και της Αρκτώας Ευρώπης. Αλλ' όμως αυτών τούτων απάντων ένεκα εκινήθη και το αντιδραστικόν πνεύμα κυβερνήσεων τινών, εχουσών εκάστης εις την Ανατολήν ιδίαν εξωτερικήν πολιτικήν, ιδίας παραδόσεις, ιδίους υλικούς σκοπούς και συμφέροντα. Συμμορφούμεναι δε εκάστοτε προς τας περιστάσεις και χρησιμοποιούσαι τα εκ της αυτενεργείας των εξαγόμενα, εξαποστέλλουσι κατά της Ανατολής και Ασίας πολυειδείς συμμορίας και πολύχροα στίφη, Προπαγάνδας, μετημφιεσμένας εις αποστόλους και διδασκάλους σωτηρίων δήθεν και εκπολιτιστικών διδαγμάτων, δι' αυτών δε και διά των απανταχού της χώρας εγκαθεστηκότων κατασκόπων αυτών (ευφήμως πρακτόρων), ωφελούμεναι δε και εκ του προσιτού ήδη από του αγώνος κατασταθέντος εδάφους, εισδύουσιν ολεθρίως εις εν έκαστον εθνάριον, εξάπτουσαι ακαταπαύστως το

πυρ της διχονοίας, εδώ μεν παρά τοις Έλλησι και Αλβανοίς, εκεί δε παρά τοις Βλάχοις, Σέρβοις, Μαυροβουνίοις, Βουλγάροις, παρέκει δε παρά τοις Αιγυπτίοις, Άραψι, Συρίοις, και πολλά και ποικίλα ραδιουργούσαι εκμεταλλεύονται την απλοϊκότητά των, τας διεγηγερμένας ήδη εθνικάς συνειδήσεις, τας θρησκευτικάς προλήψεις, υπόσχονται ενί εκάστῳ εθνικήν αποκατάστασιν, όπως ματαιωθή η κηρυσσομένη αδελφική ένωσις. Αλλ' εν τούτοις μία συνάδελφος αυτών, επιτηδειοτέρα, πλέον πολυμήχανος, την αλωπεκήν, ή την λεοντήν κατά τας περιστάσεις φέρουσα, χρησιμοποιεί υπέρ εαυτής πάντα τα εξαγόμενα από της τοιαύτης άφρονος εκείνων διαγωγής, καθισταμένη οσημέραι ημίν τοις Ανατολίταις εφιάλτης. Προσποιουμένη δηλαδή αντιπεπονθότως ότι, όχι μόνον δεν εννοεί τας συναδέλφους αλλά και πιστεύει εις τας εν τῇ Ανατολῇ αγαθάς ενεργείας των, αφήκε σκοπίμως το στάδιον αυτής ελεύθερον, μειδιώσα δε μειδίαμα διπλωματικόν, υποτονθορίζει, «Αψηφάτε, σχολαστικοί Φράγκοι, εφημέρως την χώραν, μεταβάλλατε τας τρίβους αυτής εις λεωφόρους = ρωσσοφόρους· ρυμοτομείτε, εξομαλίζετε τας προς την Μεσόγειον οδούς μου· απαλλάξατέ με από της ασφυξίας της μεσογαιότητός μου· συντομεύσατέ μοι το πλήρωμα του χρόνου, εμόν εστί το μέλλον»· η δε λόγω φυλετικής συγγενείας, ή λόγω θρησκευτικής αδελφότητος, πού μεν περιοδική, πού δε συνεχής Ιουδαϊκή εύνοια αυτής προς τούτο ή εκείνο το εθνάριον της Ανατολής : τα κατά καιρούς έντονα επίσημα και ημιεπίσημα παράπονά της, τα διά των μεγάλων και πολυειδών μέσων της καθ' όλον τον κόσμον διασαλπιζόμενα : αι εις διαφόρους επικαίρους πόλεις ραδιουργίαι της, αυτοί οι λόγῳ θρησκευτικῷ πόλεμοί της, ταύτα πάντα είναι ένθεν μεν ευστροφώτατοι χείρες του εκατόγχειρος Γίγαντος Μοσχοβίτου, ένθεν δε τοις μεν Ανατολίταις πανουργότατον δέλεαρ όπως πάντοτε προς αυτήν εμβλέπωσι και εις αυτήν αναθέτωσι τας ελπίδας των, τοις δε Ευρωπαίοις διηνεκές διερέθισμα προς εξακολούθησιν της ανωτέρω τακτικής των. Η πολυμήχανος λοιπόν αύτη εταιρεία, η ποικιλόφρων και πολυώνυμος, Προπαγάνδα καλουμένη, είναι ασυγκρίτῳ τῳ λόγῳ επικινδυνωδεστέρα. Αύτη προπαντός άλλου απειλεί να καταβροχθίσῃ την Αλβανίαν όλην, και ένεκα της γεωγραφικής θέσεώς της, και ένεκα της διαιρέσεως και της βαρβαρότητος των κατοίκων της των διατελούντων άνευ γραμματικής της εγχωρίου γλώσσης των· όθεν οι Αλβανόπαιδες αναγκάζονται να σπουδάζωσιν οι μεν την Ιταλικήν γλώσσαν, οι δε την Τουρκικήν, οι δε την Ελληνικήν, και ταύτα ακροθιγώς και ανωφελώς γινόμενοι εξ ανάγκης ημιμαθείς προς βλάβην αυτών, και της πατρίδος.

Εις ταύτην ιδίως την έλλειψιν αποβλέψας, και ότι άνευ των γραμμάτων της εγχωρίου γλώσσης αδύνατον είναι να εκπολιτισθώσιν οι καθόλου Αλβανοί, εφιλοπόνησα το παρόν πονημάτιον. Εν αυτῷ δε παρεδέχθην το διά των ελληνικών γραμμάτων γραφικόν σύστημα, πλην ολίγων μεταβολών, του πολυμαθούς Κυρίου Δημ. Καμάρδα του Αλβανο-Σικελού, διότι η Αλβανική γλώσσα έχουσα στενωτάτην συγγένειαν προς την αρχαίαν Ελληνικήν, και πλείστας ρίζας τας αυτάς είναι δύσκολον να γράφηται δι' άλλων στοιχείων χωρίς ν' απολέσῃ μέγα μέρος των τεκμηρίων και των στοιχείων της ελληνικής κοινής καταγωγής και συγγενείας. Και μολονότι το ζήτημα τούτο της στενωτάτης συγγενείας της Αλβανικής (Πελασγικής) γλώσσης μετά της αρχαιοτάτης Ελληνικής, επομένως και της Λατινικής, είναι ήδη λελυμμένον καταφατικώς, καθ' όσον έγραψαν περί τούτου τόσοι φιλολόγοι Ευρωπαίοι, μολατάυτα χάριν των αναγνωστών μου Αλβανών (Πελασγών) ως αγνοούντων των πλείστων Ευρωπαϊκάς γλώσσας, αναφέρω ενταύθα ολίγα μόνον γλωσσικά παραδείγματα, όπως εννοήσῃ έκαστος αν είναι λογικόν να επιζητώμεν άλλα γραφικά στοιχεία πλην των ελληνικών, άτινα παρεδέχθη άπασα η Ευρώπη. Και αυτό δε το ημίφωνον της γλώσσης όπερ γράφω διά του ελλην. η, ήτοι το γαλλικόν e, προερχόμενον από άλλα φωνήεντα ή διφθόγγους κοινάς με την ελληνικήν, είναι φυσικώτερον να γράφηται διά των ιδίων εκείνων φωνηέντων, είτε διφθόγγων, παρά δι' ιδιαιτέρου στοιχείου· οίον τα, «ποιώ, εστί, μήνες, πυρρός, στράγγω = bήj, ήσχτη, μηνῖ, πηρρούς, στρηνγόj», ορθότερον θα εγράφοντο, κατά το ελληνικόν κείμενον, bόj, έσχτ, μηνῖ, πυρρούς, στρανγόj κλπ.

Ιδού τα εν λόγω παραδείγματα.

….

Ταύτα λοιπόν είναι τα ολίγα γλωσσικά παραδείγματα, τα οποία εγώ εξέλεξα, της συγγενείας της Αλβανικής γλώσσης μετά ης Ελληνικής ιδίως. Το δε περιεχόμενον του βιβλίου μου είναι

Α) Μέρος της ιστορίας της Δώρας Ιστριάδος περί Αλβανικής εθνότητος εκδοθείσης Γαλλιστί και παραφρασθείσης εις την εν Ιταλίᾳ Αλβανικήν διάλεκτον υπό Δημητρίου Καμάρδα, υπ' εμού δε εις την Δαγκλο-Τοσκικήν.

Β) Παροιμίαι Αλβανικαί.

Γ) Αινίγματα >> >> .

Δ) Δημοτικά άσματα, ηρωικά, ερωτικά, και γαμήλια, διῃρημένα εις Δαγκλο-Τοσκικά, Αρβορο-Τσαμικά, και εις Γεγικά. Ενιαχού δε παρετέθησαν και τινά Γραικικά, ηρωϊκά, συνάμα με την παράφρασιν εις την Αλβανικήν, ως έχοντα σχέσιν με τα ίδια Αλβανικά, καθώς και τινα ιδιωτικά ποιήματα, διάφορα. Εκ των ασμάτων μερικά είναι εις αποσπάσματα μόνον και ατελή, καθώς εδυνήθην να τα προμηθευθώ.

Ε) Παραμύθια, και

Στ) Λεξικόν των ξένων λέξεων, ως επί το πλείστον Τουρκικών, απαντωμένων εις τα άσματα και αλλαχού, μεταφραζομένων Ελληνιστί και Αλβανιστί.

Παρέλειψα να προσθέσω, κατά την υπόσχεσίν μου, τα οικογενειακά και κύρια ονόματα, διότι δεν μοι εστάλησαν εγκαίρως αι αναγκαιότεραι σημειώσεις, αν και το βιβλίον κατήντησεν ογκωδέστερον αφ' ότι

προϋπελόγισα εγώ, και υπεσχέθην διά της αγγελίας μου. Ελπίζω δε εις δευτέραν έκδοσιν να συμπληρώσω και το ατελές των ελλιπών ασμάτων και ταύτα.

Ζητώ συγγνώμην διά τα ορθογραφικά μου λάθη, το μεν διότι δεν υπάρχει γραμματική της γλώσσης μας, και εγώ δε μικράν πείραν έχω αυτής· το δε διότι η τύπωσις του βιβλίου έγεινε μακράν του τόπου της διαμονής μου, και επομένως όχι υπό την άμεσον επιστασίαν μου.

Ως δε προς το ύφος της Αλβανικής γλώσσης μετεχειρίσθην ενίοτε τύπους της γεγικής διαλέκτου, διότι αύτη είναι οπωσούν ευστροφωτέρα και πλουσιωτέρα προς παραγωγάς, και οι τύποι δε των μετοχών αυτής είναι επί το ελληνικώτερον.

Καθώς είπον εν τῃ αρχῃ του Προλόγου μου, εφιλοπόνησα το παρόν πονημάτιον, μόνον και μόνον διά να φανώ ωφέλιμος εις τους ομογενείς μου, και εις πάντας τους περί τοιούτων γλωσσικών ζητημάτων ενδιαφερομένους, διότι υπέρ πάντα άλλον εγώ συναισθάνομαι τας ελλείψεις μου. Αν όμως εννοήσω ότι έχει, έστω και μικράν τινα αξίαν το βιβλίον μου τούτο, θα προσπαθήσω να το συμπληρώσω, όσον το δυνατόν, καλλίτερον εν δευτέρᾳ εκδόσει.

Εν Καΐρῳ Αιγύπτου, την, 10, Μαρτίου, 1875.

Ε. ΜΗΤΚΟΣ.

Simbole korrigjimi të Mitkos në fletoren e të birit, 1875
Σύμβολα διόρθωσης του Μήτκου, σε τετράδιο του υιου του, 1875



Bocat e Parthënmes shqip, mars 1875
Τυπογραφικά δοκίμια του αλβανικού Προλόγου, Μάρτιος 1875





Παράφρασις εις την Αλβανικήν
Nkëthyerë mbë Shqypen Parthënme

Kuxuarë të shpall me shtypë sendin e kësaj vivlie, nuku më ndoonjë lakëmi për fitim, as ndoonjë ligështi për të kërkuarë nam fillollogu; jo; as një nga këto më shtyri mbë këtë kuximë, edhe ja tek' është për deshmi pazar' i vivliës sime, sagjithë mbë këto koha të sotmet: edhe këjo vetë e shkruameja, e cila më kallëzon më tepërë për një punëtuar kallës-mbë-ledhësin, sesa për një të dijtëshim bulk. Ajo që më holqi mua me-vërtetë mbë këtë, kële një njejme dëtyrë, e një mall që m' ushti që mbë vogëli e urrit bashkë me mua, sa të jem edh' unë i vëjejtëshim ndoopak për filiën time Shqypëtaren, të cilën për fatkeqëri, diemët' e saj të vërtetët, përtuarë shumë, s'i kan rën përapa aspak; e farat e saja, pa-a mentuarë mirë, e lëryen, aqë sa ajo përandaj po lëngon ndë sëmundnë të glatë e të përjetëshime të ngatërruame, e këndy e tutie gjendet ndë rrëzek të copëtohet, a të surbitet e të përpihet kryekëput. Këta mentime të mijt që po ndiekën këtu pas, kujtonj se më ndëreqëtonjën e më japën liqë.

E madheja frymëtoreja luftë e vitit 1821, që ndezi pe sendi të vet një fanua të madh, e shkrepi, siç' u rrëfye për gjithë, dritë të paa-ngrysëme, tue ndriçuarë Anatoleshten Europë, ujëdhesat e saja, Asiën e vogëlë, e pas një-far' udhe, edhe të madhen: e tue mbishkruarë mbi gjytetorin flámurë për Anatoliën "një grigj e një bari", aratisi [e] kryjoi passiç' i kle dhënë për gjithë botën, të përgjithëshmen jetën e saj të çudiçimen, për sa, e për qysh, e për gjithë-farësh të shpallme, e kështu pra shënoi me dëme të mëdhenj edhe për vetehen e saj, edhe për Anatoliën, një të shtrenjtë edhe ishtorisht të zellshime kohë plot me disa duar godijash, e të ndiekëmesh edhe të bëmesh e tuke xgjuar' edhe tuke tundurë gjithë-farëshit kombe të Anatoliës, të cilët uvun nënë dy flámura besash, e aqë më tepërë filiën Shqypëtare, i tha kësaj veçanë, tuke përmendurë atë fjalën shenjtë "Mos pandehni se ardha të vë paqië mbi dhé tënd; jo; po zjarr e hekurr; Përse ardha të ndanj bijët // kundra atërve, edhe vëllezër kundra vëllezërve, gjerësa, pagëzuarë ti ndë gjak tënd, të lahesh e të dëliresh ndë bashkim vëllazërie". Tha, edhe ubë. Nis ajo e glatë e e egërë gjakatare niza, që çudit e mallënjen edhe te perëndon dielli. Po nga gjithë këto utund edhe fryma kundrastare e disa Qyverniave, që sicila kish ndë Anatoli mpósë të vetëtën gjytetië, të vetëta përdhënële, të vetëta ondij e të dhënadorë. Tuke u mfytyruarë e tuke ndërruarë fytyrën nga-herë ato një me peristeat e me godiat, e tuke bërë të vëjenjën për vetë-vetehen gjithë seç' nxierrën nga kundrëstia e tyre, dërgonjën kundrë Anatoliës edh' Asiës disa-farë-kollesh e fytyrash Propaganda, të përveshura e të ndërruara si Apostoj e si dhaskaj për të mësuarë sikuur mësime shpëtimtare e gjytetëruashime; e me anë të këtyrevet edhe të përgjonjësvet tyre (për të dhënë emër të bukurë të lajmëset) që kishin mbë çëdo vënd vendosurë, me qën ethé trualli që pas luftës e këndy hapëtë, hynjën për dëm te cilido komth, edhe ndezën për herë ziarrin e ndariës e të grindiës; këtu ndër Elinët e Shqypëtarët; atje ndër Vllehët, Sërbët, Malëzesët, Shqet; më tej ndër Egjyptianët, Arapët, Syrianët; edhe shumë e gjithë-farë të ligash tuke sherrëgjuar e çpifurë, rëmojën për gënjim mituriën e të paaditurit e tyre, të ndezurën tani komëtoren vetë-dijën,

parë-marriën e besavet; e u zotohen të vendosnjën gjithë-se-cilin një kom mbë vete, që kështu pra të kotet e të prishet bashkim' i vëllazëriës që po ligjëronet.

Po ndër kaqe një shoqe nga këto më e voliçime, më rexhule e më dinake, tuke mbarturë pas peristeavet edhe të dhelpërës lëkurën edhe të leonit, bën e i vëjenjën për vetehen e saj të gjitha çë dalën nga këjo e paa-mençime gjytetië e atyrevet, aqë sa tek' na Anatolitët është për ditë një Efialt. Bëhet përsëprapi sikuur jo vetëmë nuk i merr vesht shoqet e saja, po edhe sikuur mbeson se ato bënjën vërtet sikuur vepëra të mira ndë Anatoli, e përandaj la për të keq sheshin të lëruarë tek ata edhe tuke qeshurë nënë buzët dhipllomatërisht' iu pishpillon "Lëroni, o Frënq skollastikë, vëndin dítie; ndërroni rrugat e tij e i bëni udha të gjera për njerëzit=rusët; çani, e sheshoni udhat për mes-tokësin det; shpëtoni më nga të fikët e nga zalia e të brëndit dheut tim; shkurtoni më të mbushurit e motit; emeja është e përitmeja. E dashuria ludhishte e saj mbë këtë, a mbë atë komth të Anatoliës me mëhanën e filetishtes farë, a të vëllazëriës besës, dikuur herë herë, dikur e ngahershime; të qarat e saja të tërsëllëmshime, të zotuara e të gjymësa-zotuara, kohë mbë kohë, që shprishen e dëgjohen ndëpër gjithë botët me anë të së mëdhenjet krahëvet saj; sherrëgjit e saj ndë çesa të voliçimë gjytetë; ato luftat e saja me fjalë të besës; të gjitha këto jan nga njëra anë, duar të nkëthyeshime e të çkathëta të njëqind-duarsit gjigandit Moskof; nga tietëra, një helm e një froto një e pime për Anatolitët, që si të dejturë nga-herë mbë atë të shukonjën, e tek ajo të ken pandehmën e tyre; e për Europasit një të lënduarë e një xanxë sa gjithënjë ata të mbanjën gjytetiën që tham përsipëri; Adhá këjo shoqëri, mieshtëri-madheja, mënt-balasheja, e emër-ploteja, që quhet Propagandë, është paa masë më e rrëzikshime. Këjo më parë se të tërë, edhe për ndariën, e të paabashkuarit e të paa-diturit të ndënjëset saj, që gjenden paa gramátikë të gjuhës vëndit tyre, e përandaj diemët Shqypëtarë jan të nxituarë të mësonjën disa Tyrqishten, disa Italishten e disa Grëqishten gjuhë, po edhe këto për-së-shqarë-thi, e paa ondi tuke ubërë aqë më tepërë paa hir gjysëmakë, a të gjymës-mësuarë për dëm të vetë-vetehes edhe të vatanit tyre.

Mbë këta të mangët tuke shtirë sytë më tepëre, kuur paa shkrime të gluhës vëndit është një gjë e paa-munçime të gjytetërohen e të hapën sytë Shqypëtarët të tërë, vepërova këtë të shkruame. Ndë atë morra shkrimet Elinishte, me pak ndërryshim, të zakoniës të dijshimit Zotit Dh. Kamardhë Shqypëtarit nga Syqelia, përse gluha Shqype, tuke paturë të ngushtë farë e fis me të lashtën Elinishte, e më të shumatë rrënja gjithë-një ndër të dyja, është fështirë të shkruhet me të tiera shkrime pa vdierrë të madhe pjesë nga thelbi e nga shenjat e Elinishtes, që jan një skotëkë, e kan dalë përej një heri mbë-një. E ndoonëse këjo kafshë e pyetme e të ngushtës farë të gjuhës Shqype (Pellasgjishte) me fare të lashtën Elinishten më tepërë, pastaj edhe me Llatinishten është tani e shqyerë e e ndarë paa mbohë, passiç' shkruajtin aqi shumë Europasë fillollogë për këtë, me gjithë këto për hir të përshkuaset mij Shqypëtarëvet (Pellasgëvet) së çilëshit më të shumit nukë din gluhëra Europaishte, përmend kë-...[1079] [-tu vetëm pak shembuj nga gjuha, që të kuptojë çdonjëri nëse është e arsyeshme të kërkojmë të tjera shkronja tej atyre të greqishtes, të cilat i ka pranuar Europa mbarë. Madje edhe vetë gjysmëzanorja e gjuhës që e shkruaj me anë të greq. *η*, apo të frëngj. *e*, e cila rrjedh prej zanoresh apo diftongjesh të tjera të përbashkëta me greqishten, është më e udhës të shkruhet me anë të vetë atyre zanoreve, sesa me anë të një shenje të posaçme; pra fjalët «ποιώ, εστί, μήνες, πυρρός, στράγγω = bnj, ήσχτη, μηνῖ, πηρρούσς, στρηνγój», do të shkruheshin më drejt, sipas tekstit grek, bój, έσχτ, μηνῖ, πυρρούσς, στρανγój etj.

Po japim këtu shembujt në fjalë.

…….

Këta pra janë ata pak shembuj të gjuhës, që unë vetë i zgjodha, [tregues] të farefisnisë së gjuhës shqipe sidomos me greqishten. Libri im përmban

A) Një pjesë të historisë së Dora d' Istrias për kombësinë shqiptare botuar në frëngjisht dhe kthyer në dialektin shqiptar të Italisë prej Dhimitër Kamardës, e mandej prej meje në të folmen dangëllishte-toskërishte.

B) Fjalë të urta shqiptare.

C) Gjëagjëza shqiptare.

Ç) Këngë popullore, heroike, erotike, dhe të dasmës, të ndara në dangëllishte-toskërishte, labërishte-çamërishte dhe gegërishte. Janë përfshirë tek tuk edhe disa [këngë] greke, heroike, bashkë me kuptimin në shqipen, ngaqë kanë lidhje me të njëjtat [këngë] shqip, si dhe disa poezi me autor, të ndryshme. Disa prej këngëve janë vetëm fragmente dhe të paplota, ashtu siç munda t'i siguroja.

D) Përralla, dhe

Dh) Fjalor fjalësh të huaja, më së shumti turke, që hasen në këngët a tjetërkund, përkthyer greqisht dhe shqip.

Kam lënë pa shtuar, ndryshe nga sa kisha dhënë fjalën, emrat dhe mbiemrat e njerëzve, për shkak se nuk m'u dërguan në kohë të dhënat më të nevojshme, ndonëse libri doli më i vëllimshëm nga sa e kisha llogaritur unë,

[1079] Në këtë pikë ndërpritet teksti i *Parthënmes* shqip, për të cilin ia vlen të kryhen gjurmime të tjera arkivore, me shpresën se do të gjendet diku. Në vazhdim po japim pjesën tjetër të Parathënies, përkthyer prej nesh në bazë të tekstit greqisht, që na ka mbërritur i plotë.

dhe e pata premtuar me anë të njoftimit tim. Kam shpresë që në një botim të dytë të plotësoj sa më sipër si dhe boshllëqet e këngëve të mangëta.

Kërkoj ndjesë për gabimet e mia ortografike, ngaqë, në njërën anë, nuk kemi gramatikë të gjuhës sonë, dhe unë pak përvojë kam prej saj; nga ana tjetër, shtypja e librit u krye larg vendit ku unë banoj, dhe rrjedhimisht jo nën kujdesin tim të drejtpërdrejtë.

Sa për llojin e gjuhës shqipe, kam përdorur nganjëherë trajta të gegërishtes, ngaqë ajo është disi më e zhdërvjelltë dhe më e pasur në fjalëformim, ndërsa trajtat e pjesoreve të saj ngjajnë më shumë me greqishten.

Sikurse thashë në krye të Parathënies sime, e kreva këtë punëz vetëm e vetëm që të jem i dobishëm për bashkëkombësit e mi, dhe për gjithë ata që interesohen rreth kësi çështjesh të gjuhës; sepse më shumë se çdokush tjetër unë vetë i ndiej mangësitë që kam. Por nëse vërej që ky libër imi ka ndopak vlerë, qoftë edhe të vogël, do të përpiqem ta plotësoj e ta bëj, me sa është e mundur, më të mirë në një botim të dytë.

Në Kajro të Egjiptit, më 10 mars 1875.

E. MITKO.

-IV-

Kartelë për regjistrimin e pajtimtarëve, që qarkulloi në mars 1878.
Këtu, kartela me pajtimtarët prej Stambolli*, plotësuar nga J. Vretoja.
Κάρτα εγγραφής συνδρομητών, που κυκλοφόρησε το Μάρτιο 1878.
Εδώ, η κάρτα με τους συν/τές Κων/πολης*, με υποσημ. του Ι. Βρέτου

BËLETA SHQYPËTARE
LIBËR
SHQIP-GREQISHT

P ë r m b a n

Pjesë të historisë “Dora d’ Istria – filía shqypëtare”, Fjalë të Urta dhe Gjëegjëza Shqip-Greqisht, emra vetiakë shqiptarë, Këngë dhe Përralla shqiptare, dhe Fjalor Shqip-Greqisht me përqasje të fjalëve shqip me ato të greqishtes së lashtë.

H a r t u a r
PREJ

E. MITKOS.

Del në dritë falë ndihmesës bujare të pajtimtarëve miq të muzave dhe me kujdesin e
Dh. A.
Përbëhet prej 12-14 fashikujsh tipografikë në 8-she të madhe; e ka çmimin franga 5.
Kajro, muaji mars 1878.

Emri dhe mbiemri	Kopje	Vendbanimi	Vendlindja
……..	…….	……	……
……..	…….	……	……

Ma shumë s'munda të shkruánjë se dhè s' kanë mësuarë se çë munt t'u shuanjë etjenë, ndonëse gajasnjënë. J. Vretua. [Περισσότερους δεν μπόρεσα να γράψω διότι, αν και έχει γανιάσει το στόμα τους, ακόμα δεν έχουν καταλάβει τι είναι αυτό που θα τους κάνει να ξεδιψάσουν. Ι. Βρέτος.]

*Τα ονόματα συνδρομητών του καταλόγου Ι. Βρέτου είναι τα ίδια με εκείνα που φαίνονται στον κατάλογο συνδρομητών που συμπεριέλαβε ο Μήτκος στην έκσοδη Αλεξάνδρειας.

Ballina e botimit të Aleksandrisë

Εξώφυλλο της έκδοσης της Αλεξάνδρειας

ΑΛΒΑΝΙΚΗ ΘΗΒΑΙΣΣΑ
(Βαλίστα Σκιπιώτικη)
ΣΥΓΓΡΑΜΜΑ
ΑΛΒΑΧΟ-ΕΛΛΗΝΙΚΟΝ
ΠΕΡΙΕΧΟΝ
ΣΥΝΤΑΧΘΕΝ
ΕΚΔΙΔΟΤΑΙ ΔΑΠΑΝΗ
ΤΗΣ ΕΠΙΜΕΛΕΙΑΣ ΤΟΥ
Δ. Α.
ΕΝ ΑΛΕΞΑΝΔΡΕΙΑΙ

Ballina e "Bletës Mjekësore", Athinë 1856
Εξώφυλλο της «Ιατρικής Μέλισσας», Αθήνα 1856

Η ΙΑΤΡΙΚΗ ΜΕΛΙΣΣΑ.

ΣΥΓΓΡΑΜΜΑ ΠΕΡΙΟΔΙΚΟΝ.

ΕΝ ΑΘΗΝΑΙΣ,

“Bleta” e Venedikut, Shtypëtorja e N. Gliqit prej Janine, 1680
«Μέλισσα» της Βενετίας, Τυπογραφείο Ν. Γλύκυ, του εξ Ιωαννίνων, 1680

Μ Ε Λ Ι Σ Σ Α

ΤΟΜΟΣ ΤΡΙΤΟΣ.

ΕΚΔΟΣΙΣ Β.

ΚΕΦΑΛΑΙΩΝ ΠΕΡΙ ΤΕΛΕΙΑΣ

ΘΕΟΦΙΛΟΥ ΠΡΟΣ ΑΥΤΟΛΥΚΟΝ ΠΕΡΙ

ΤΑΤΙΑΝΟΥ ΑΣΣΥΡΙΟΥ ΛΟΓΟΣ ΚΑΤΑ ΕΛΛΗΝΩΝ.

Κ Ν Ε Τ Τ Η Σ Ι.

CON LICENZA DE' SUPERIORI, E PRIVIL.

Dorëshkrimi i Parathënies së botimit të Aleksandrisë
Χειρόγραφο του Προλόγου της έκδοσης της Αλεξάνδρειας







Parathënia e botimit të Aleksandrisë
Πρόλογος της έκδοσης της Αλεξάνδρειας

ΠΡΟΛΟΓΟΣ

ΣΚΟΠΟΣ της «Αλβανικής Μελίσσης» ήτοι των ανά χείρας αλβανολογικών μελετών, είναι καθ' όλου μεν η διάσωσις και παράδοσις εις τας επερχομένας γενεάς αλβανικών λόγων τε και κειμένων, όσα προ χρόνων μετά κόπου και δαπάνης συνέλεξα, και άτινα ελπίζω ότι θα έχωσιν αξίαν τινά, καθ' όσον απ' αυτών εμφαίνεται η καταγωγή, ο χαρακτήρ, τα ήθη και τα έθιμα της αλβανικής φυλής· ιδία δε ίνα δοθή αφορμή τις και ώθησις τοις ομογενέσιν Αλβανοίς προς γραμμάτισιν και σπουδήν της μητρικής των γλώσσης, όπως διά του φυσικού τούτου και μόνου τελεσφόρου μέσου κατορθώσωσι και αυτοί την εκπολίτευσίν των και συμπαρακαθήσωσιν ομότιμοι μετά των λοιπών Ελληνοφώνων αυτών αδελφών. Εύχομαι δε άλλοι εντριβέστεροι εμού περί τα τοιαύτα να πλουτίσωσι την εν λόγω συλλογήν και καλλύνωσιν αυτήν ώστε να χρησιμεύσῃ εις ηθικήν ωφέλειαν του λαού. — «Λαός δεν δύναται να εξέλθῃ της βαρβαρότητος, ειμή καλλιεργών την ιδιάζουσαν αυτῷ γλῶσσαν», λέγει ο Herder· οι δε

Αλβανοί ως νυν διάκεινται διῃρημένοι εις Μωαμεθανούς, και Χριστιανούς, και ούτοι πάλιν εις λατινίζοντας και ορθοδοξούντας, μόνον διά της σπουδής της μητρικής των γλώσσης θα ηδύναντο να φωτισθώσι και αποβάλωσι τον ρύπον της βαρβαριζούσης αυτούς αμαθείας· η μητρική γλώσσα είναι η ζωογονούσα τον λαόν πρώτη και κοινή τροφή, ας μένῃ δε διά τας ανωτέρας τάξεις η τελειωτέρα και δόκιμος ελληνική.

Το να ζητώσι τινές να καταπνίξωσι την Αλβανικήν γλώσσαν και διά της καταναγκαστικής χρήσεως της ελληνικής να απορροφήσωσιν ολοτελώς ήτοι εξοντώσωσι και καταστήσωσιν ανύπαρκτον την αλβανικήν φυλήν, είναι πλάνη οικτρά, περιορισμένου νοός αποκύημα, σάθρα πολιτική και ανάξια πάσης «μεγάλης ιδέας». Παράδειγμα έστω η προς τους Βουλγάρους εκκλησιαστική του εν Κωνσταντινουπόλει Πατριαρχείου, και της εν Αθήναις Κυβερνήσεως πολιτική, ήτις αντί ενώσεως έφερε σχίσμα, και αντί υποταγής και απορροφήσεως έφερε μίσος φυλετικόν αδιάλλακτον. Ως έχουσι νυν τα πράγματα, μεταξύ ολιγίστων Αλβανών δύναται να εισχωρήσῃ ο ελληνικός πολιτισμός, μεταξύ εκείνων, οίτινες μετέχουσι παιδείας τινός· αλλά μεταξύ του ογκωδεστέρου αλβανικού πληθυσμού, εις την οικογένειαν του τεχνίτου, και βιομηχάνου, εις την καλύβην του ποιμένος, πώς δύναται να εισχωρήσῃ ο ελληνισμός εάν δεν μεταδοθώσιν αι ελληνικαί ιδέαι διά της χρήσεως της καθομιλουμένης αυτών αλβανικής γλώσσης; ή πρέπει να περιμένῃ τις ίνα εκμάθῃ απαξάπας ο αλβανικός λαός την γραπτήν των Αθηνών ελληνικήν γλώσσαν, και έπειτα να αρχίσῃ την μετάδοσιν των ελληνικών ιδεών; έως τότε θα παρέλθωσιν αιώνες πολλοί. –Παράδειγμα έστωσαν τα πέριξ των Αθηνών αλβανικά χωρία, όπου εις τα πρόθυρα αυτής της ελληνικής πρωτευούσης, και μετά πεντήκοντα ελληνικής βασιλείας έτη, δεν έμαθον ακόμη ουδέ μίαν λέξιν να ομιλώσιν ελληνιστί.

Άλλως τε, εγκαταλειπομένης της Αλβανίας εις την εαυτής αμάθειαν άνευ εγχωρίων γραμμάτων και σχολείων του λαού, θα σπεύσωσιν τότε οι Σλάβοι με ισχυρώτερα και πρακτικώτερα μέσα προς καταβρόχθισιν της Αλβανικής φυλής. Ήδη οι Μαυροβούνιοι κατέρχονται εκ των γυμνών και αγόνων αυτών ορέων προς κατάκτησιν και εκσλαβισμόν της βορείου Αλβανίας, και οι Σέρβοι σπεύδουσιν επί τῳ αυτῷ σκοπῷ εξ ανατολών. Ουδέ μένουσι με εσταυρωμένας τας χείρας της Ρώμης οι προπαγανδισταί μοναχοί, αλλά δι' αλβανικών ήτοι εν Αλβανική γλώσσῃ γεγραμμένων κατηχήσεων, ομιλιών, και συναξαρίων, προσηλυτίζουσιν υπέρ το ήμισυ του αλβανικού πληθυσμού εις το λατινικόν δόγμα και τον ιταλικόν εθνισμόν. Εν ᾧ εάν εξεπαιδεύετο ο Αλβανός εν τῇ μητρικῇ του γλώσσῃ υπό ελληνιζόντων διδασκάλων και κληρικών, και εάν μετεφυτεύετο εν αυτῷ η ελληνική ιδέα διά της καθομιλουμένης αυτού αλβανικής φράσεως, ήθελε ριζωθῇ εν αυτῷ επί τοσούτῳ ο ελληνικός πατριωτισμός και η αυτοσυνείδησις, ώστε να είναι ικανός να υπερασπισθῇ την φύσει οχυράν και απόρθητον πατρίδα του, και τον ελληνικόν εθνισμόν του, και θα έκλινε τον νουν και την καρδίαν του ουχί προς τους Σλαύους και Ιταλούς, αλλά μάλλον προς την μητέρα Ελλάδα, φέρων εις μνήμην τους προγόνους του Ηπειρώτας και Μακεδόνας, και τους εν τῃ ελευθέρᾳ Ελλάδι ομοφύλους του και της μεγάλης πατρίδος προμάχους Σουλιώτας, Πετσιώτας, Υδραίους, και λοιπούς.

Αλλά και η Ελλάς οφείλει να φέρηται προς τους Αλβανούς ως αληθής και φιλόστοργος μήτηρ, ομιλούσα αυτοίς εις τη νηπιακήν των και οικιακήν γλώσσαν, ουχί δε ως κακόζηλος μητρυιά ομιλούσα αυτοίς διά μιας και απροετοιμάστως την διά τους πεπαιδευμένους ωρισμένην γλώσσαν του Ξενοφώντος και Θουκυδίδου, την οποίαν αυτοί μη εννοούντες σκοτίζονται την διάνοιαν και μένουσι νωθροί, καταφρονούμενοι παρά των άλλων αδελφών των ως άξεστοι, χυδαίοι, και απόβλητοι, την ελληνικήν δήθεν ευγένειαν ασχημίζοντες, υποβολιμαίοι αδελφοί.

Η Ελλάς, ως φιλόστοργος μήτηρ έπρεπε να περιθάλψῃ ουχί μόνον τους ομοθρήσκους εκ των Αλβανών, αλλά και αυτούς τους μωαμεθανίζοντας και λατινίζοντας Αλβανούς, οίτινες μεθ' όλας τας θρησκευτικάς αυτών διαφοράς διασώζουσιν ακμαίον τον εθνικόν αυτών πατριωτισμόν, και προς τους συμπολίτας των ορθοδόξους χριστιανούς έδειξαν πάντοτε αδελφικήν αγάπην, και συνέζησαν εν πλήρει αρμονίᾳ μετ' αυτών. Ούτε δύναται να υπάρχῃ μεγαλητέρα ανεξιθρησκεία εκείνης, ήτις επικρατεί μεταξύ των Αλβανών, ουδέ μεταξύ των μάλλον πεπολιτισμένων εθνών. Ο Αλβανός αγαπών εξόχως την πατρίδα του αγαπά και τον ομόφυλόν του, και όταν ακόμη είναι αλλόθρησκος, διότι την θρησκείαν έχει εν δευτέρῳ λόγῳ, όταν πρόκειται περί της κοινής πατρίδος. Εν τοις ηρωικοίς άσμασι του λαού απαντώσι πολλά τοιαύτα παραδείγματα αμίμητα ανεξιθρησκείας και πατριωτισμού.

Εύχομαι η παρούσα αλβανολογική συγγραφή να καταστῇ κοινόν ανάγνωσμα πάσιν εν γένει τοις Αλβανοίς άνευ διακρίσεως πολιτικού φρονήματος ή θρησκευτικής δοξασίας, τοις δε σπουδάζουσιν εκ των φιλολόγων ανδρών αφορμή τελειοτέρων μελετών και εθνολογικών άλλων απόψεων.-

Εξ Αιγύπτου. Κατά μήνα Μάρτιον έτους σωτηρίου 1878.

ΕΥΘΥΜΙΟΣ ΜΗΤΚΟΣ.

-V-

Skicim i parathënies së "Bëletës Shqypëtare" të v. 1878

Σχεδίασμα προλόγου της «Αλβανικής Μέλισσας» του 1878



Σκοπός της «Αλβανικής Μελίσσης» ήτοι της παρούσης συλλογής είναι πρώτον να παραδώσω εις το δημόσιον και πριν εξαφανισθώσιν από τον πανδαμάτορα χρόνον, όσα προ χρόνων και μετά κόπου και δαπάνης έχω συλλέξει άσματα, παραμύθια και λοιπά αλβανικά, άτινα βεβαίως έχουσι αξίαν τινά, καθ' όσον από αυτά εμφαίνεται η καταγωγή ενός έθνους. δεύτερον και το κυριώτερον, ίνα δοθή μία προτροπή και ώθησις εις την καθόλου πατρίδα – προς τους Αλβανούς – Σκυπετάρους ίνα επιδοθώσιν εις την γραμμάτισιν και σπουδήν της μητρικής των γλώσσης, όπως διά του φυσικού τούτου και μόνου τελεσφόρου μέσου, ως απαραβάτου της φύσεως νόμου, κατορθώσωσιν και αυτοί, ως έπραξαν όλα τα έθνη του κόσμου, να εκπολιτισθώσι· και τρίτον, ίνα παρακινηθώσιν οι εντριβούντες περί τα τοιαύτα, να τακτοποιήσωσι την εν λόγῳ συλλογήν και καλλωπίσωσι, και ούτω να χρησιμεύσῃ αυτή προς όφελος του λαού. ενώ εμείς, ως άοκνοι μεν γεωπόνοι, άμοιροι δε γεωργικών γνώσεων, προσφέρομεν την ύλην άμορφον και άτεχνον.

Επειδή ο γράφων προς το δημόσιον πρέπει να είναι αμερόληπτος, ξένος, άπατρις, κοσμοπολίτης, διά τούτο λέγομεν ελευθέρως το φρόνημά μας, κινούμενοι υπό του πόθου προς την κοινήν πατρίδα, το πανελλήνιον, ότι «λαός δεν δύναται να εξέλθῃ της βαρβαρότητος, ειμή καλλιεργών την ιδικήν του γλώσσαν», λέγει ο Χέρδερ. Οι Αλβανοί λοιπόν, ως είναι σήμερον εν τῃ εσχάτῃ αμαθείᾳ (και θα είναι τοιούτοι μεχρισότου σπουδάσωσι την μητρικήν γλώσσαν των) διῃρημένοι θρησκευτικώς εις Μωαμεθανούς, Χριστιανούς ορθοδόξους και καθολικούς, μόνον διά της σπουδής της μητρικής των γλώσσης θα ηδύναντο να φωτισθώσι. Διότι τα Ελληνικά γράμματα διά τους Αλβανούς εν γένει είναι εν αυτόχρημα μονοπωλείον, προσιτόν εις τους βαθυπλούτους μόνον, όπερ είναι σύστημα των τυράννων και του Κοτζαμπασισμού, όπως δεσμεύωσι τους λαούς και τους διατηρώσιν αγραμμάτους και δούλους. Έπειτα πάσα ξένη γλώσσα πρέπει να διδάσκεται επιτοπίως εκεί όπου ομιλείται, ίνα συνηθίσῃ ο μαθητής να την ομιλῇ, είτε την Ελληνικήν, είτε Γαλλικήν, Ιταλικήν κλπ. «Καλά 'ν τα φαρδομάνικα μον' για τους δεσποτάδες». η δε μητρική γλώσσα είναι η πρώτη και κοινή τροφή, ήτις ζωογονεί όλον τον λαόν εν γένει, και ήτις του διευκολύνει την ταχείαν και κανονικήν εκμάθησιν και πάσης ξένης γλώσσης, ευρύνει το στάδιον των φώτων και της προόδου. Ένθα δεν υπάρχει συναγωνισμός και άμιλλα, λείπει και η πρόοδος. Τα έθνη της Δύσεως εκαλλιέργουν την Λατινικήν εν τῃ νηπιότητι αυτών, και ήσαν εισέτι βάρβαρα· εξαναγενίσθησαν δε άμα εκαλλιέργησαν τας ιδίας αυτών γλώσσας. Και η Ελλάς τῃ νουθεσίᾳ και προτροπή του αειμνήστου Κοραή, κατήργησε το παλαιόν σύστημα της αρχαίας Ελληνικής και εισήγαγεν εις τα σχολεία την χρήσιν της μητρικής

γλώσσης του τόπου, διά τον αυτόν λόγον. Όσον δε αφορά την μεγάλην της Ελλάδος ιδέαν του να εξελληνίσῃ διά των Ελληνικών γραμμάτων και ενώσῃ τους Αλβανούς, και το υπό τον πέπλον της απάτης διαδιδόμενον προς τους απλοϊκούς των Αλβανών, ότι δήθεν τα Αλβανικά γράμματα θα επιφέρωσι διαίρεσιν μεταξύ Γκραικών και Αλβανών, ο εγωισμός ούτος, και η κενή και άπρακτος ούτη πολιτική πορεία με σαθρά και ατελή μέτρα καταστρέφει την τε Αλβανίαν και την Ελλάδα, και ας φέρωμεν ως μόνον παράδειγμα την στάσιν του Βυζαντινού κράτους. Το κολοσσαίον τούτο κράτος δεν θα έπιπτε πτώσιν ολεθρίαν και ανεπανόρθωτον αν εκυβερνάτο υπό μιας πατρικής εκπολιτιστικής κυβερνήσεως εμπνευσμένης υπό πνεύματος ενώσεως, και δεν θα εκερματίζετο εις τόσα ετερογενή και ξένα στοιχεία. Όθεν όχι διά της βίας και της απάτης, αλλά διά του φωτισμού, και μόνου του φωτισμού κατορθούται και επιτυγχάνεται η συγκέντρωσις και η ένωσις. Οι Γερμανοί και οι Ιταλοί αφού πρώτον εξεπολιτίσθησαν ενόησαν έπειτα το κοινόν συμφέρον, και επραγματοποίησαν την ένωσιν. Αλλ' ούτε δυνάμεθα να εννοήσωμεν αν υπάρχει μεταξύ του κυρίως Αλβανικού λαού και της Ελλάδος σχέσις τις πλην της εν μέρει θρησκευτικής. ενώ απεναντίας κατά την σημερινήν ηθικήν και πολιτικήν κατάστασιν των δυο λαών υπάρχει πράγματι διαίρεσις και χωρισμός. και το λέγομεν τούτο ουχί άνευ λύπης, μη θέλοντες εξ άλλου να βαυκαλιζόμεθα με σχολαστικάς και κενάς ελπίδας, αφού ουδεμία τοιαύτη πρόνοια υπάρχει.

Προκειμένου δε περί εξελληνίσεως και συγχωνεύσεως των Αλβανών, και εγκαταλειπομένης της Αλβανίας, ως είναι σήμερον, άνευ εγχωρίων γραμμάτων και σχολείων, εν τοιαύτῃ περιπτώσει, αντί των Ελλήνων, θα σπεύσωσιν οι Σλάβοι με ισχυρώτερα και πρακτικώτερα μέσα και θα καταβροχθίσωσι πρώτον την Αλβανίαν, αλλ' έπειτα και αυτήν την Ελλάδα. Ενώ εκπαιδευόμενος ο Αλβανός διά της γλώσσης του εντός της σφαίρας του αρχαϊκού Σπαρτιατικού βίου του θα αποκτήσει πατριωτισμόν και αυτοσυνειδησίαν, θα είναι ικανός να υπερασπισθῇ την φύσει οχυράν και απόρθητον πατρίδα του [και τον ελληνοπελασγικόν εθνισμόν του D 566]· επομένως κατά φυσικούς, ιστορικούς, συγγενικούς και πολλούς άλλους λόγους, θα κλίνει μάλλον προς την Ελλάδα, ή προς τους Σλάβους, και Ιταλούς [θα έκλινε την καρδίαν του ουχί προς τους Σλαύους αλλά μάλλον προς την μητέραν Ελλάδα D 566]. Δεν θ' απαρνηθῇ ο υπέρ παν άλλο έθνος φιλότιμος Αλβανός την πανάρχαιον Πελασγικήν του γλώσσαν, αλλ' ουχ ήττον δεν θ' αφήσῃ την καταγωγήν του, τους ενδόξους προγόνους του Ηπειρώτας και Μακεδόνας, τον ήρωά του Σκανδέρ Βέην, και τέλος τους νέους δελφίνας της θαλάσσης ομογλώσσους του Υδραίους, Σπετσιώτας, Ψαριανούς [οι Ψαριανοί δεν είναι Αλβανοί αλλά Γραικοί D 566], ως και τους αετούς του Σουλίου. Όσον δ' αφορά τους Οθωμανούς και καθολικούς Αλβανούς, αυτοί διετήρησαν ακραιφνή τα πολυτιμώτερα φυλετικά χαρακτηριστικά των, ως έχομεν μυρία όσα παραδείγματα εις την νεωτέραν ιστορίαν· προς δε τους πατριώτας των χριστιανούς εχορήγησαν πάντοτε τας ευγενεστέρας προστασίας επί διαφόρων κατά καιρούς περιστάσεων, ζώντες εν αγάπῃ αδελφικῇ, και πλήρει αρμονίᾳ Οθωμανοί μετά χριστιανών, ούτε δύναται να υπάρχῃ μεγαλητέρα ανεξιθρησκεία της αλβανικής έστω ως εις τα μάλλον πολιτισμένα έθνη του κόσμου (2) [Ο Αλβανός αγαπών εξόχως την πατρίδα του, αγαπᾷ και τον πατριώτην του έστω και αλλόθρησκων. διότι την θρησκείαν έχει εν δευτέρῳ λόγῳ απέναντι της πατρίδος. Εις τα ηρωικά άσματα του παρόντος απαντώνται πολλά τοιαύτα παραδείγματα αμίμητα.] Δεν τους λανθάνει λοιπόν τους Αλβανούς ότι, μεμονωμένοι όντες και χωρισμένοι από την αδελφήν των ή κάλλιον μητέρα Ελλάδα, ενώ περιστοιχίζονται υπό μεγάλων και ισχυρών εχθρών δεν θα δυνηθώσιν επί τέλους ν' αποφύγωσι τον κίνδυνον της κακής απορροφήσεως. Καθ' ην ώραν γράφομεν συμπολεμούσι μετά των Μαυροβουνίων πλείστοι Αλβανοί και εκ των εντός του Μαυροβουνίου και των εκτός αυτού κατοίκων, και αίροντας τας λαμπρότερας νίκας, αλλ' οποίον άραγε θα είναι το μέλλον αυτών;

Η παρούσα λοιπόν συλλογή, ήτις είναι ……. ανάγνωσμα δι' όλους εν γένει τους Αλβανούς, Οθωμανούς και Χριστιανούς, διά δε τους ξένους εν μικρόν δείγμα διά φιλολογικάς ερεύνας, εύχομαι να γίνῃ αφορμή καλών και σπουδαίων επί του αντικειμένου τούτου σκέψεων εκ μέρους των αρμοδίων Γραικών τε και Αλβανών, και όσον ο καιρός είναι πάντοτε και μάλιστα την σήμερον πολύτιμος. Το καθ' ημάς ετολμήσαμεν να προτείνομεν τούτο μετά μεγάλου σεβασμού χάριν, καλώς εννοουμένης φιλοσοφίας.

Το δε περιεχόμενον της … πονηματίου, όπερ ένεκα απροόπτων περιστάσεων εβράδυνεν επί τοσούτον να εκδοθῇ, είναι

1. Μέρος της Ιστορίας «Δώρα Ιστριάς – η Αλβανική φυλή», μετεφρασμένον εις την Αλβανικήν, εκ του, εν τῃ Αλβανοϊταλικῇ διαλέκτῳ με λατινικά στοιχεία, «Φυλέτια Αρbηνόρε» του Δημητρίου Καμάρδα, εκδοθέντος εν Λιβόρνῳ τῳ 1867·
2. Αλβανικαί Παροιμίαι μεταφραζόμεναι εις το Γραικικόν·
3. Αλβ. αινίγματα μαζί με την μετάφρασιν·
4. Αλβ. κύρια ονόματα και επώνυμα·
5. Αλβ. άσματα, αλληγορικά, κωμικά, γαμήλια, ερωτικά και ηρωικά, εν οις προσετέθησαν και 2-3 Γραικικά, ως και τινα των εν Ελλάδι και Ιταλίᾳ Αλβανών·
6. Αλβ. παραμύθια·
7. Λεξικογραφία από της Αλβανικής εις την Γραικικήν, κάποτε και εις την Ελληνικήν, κυρίως διά τας ξένας λέξεις, εν μέρει δε και τινας Αλβανικάς μη κοινάς καθ' όλην την Αλβανίαν ένεκα διαλεκτικών διαφορών. Ενιαχού δε γίνεται και παραβολή λέξεων Αλβανικών και αρχαίων Ελληνικών.

Ως γραφικά στοιχεία μετεχειρίσθημεν τα του αξιοτίμου και μεγάλου πατριώτου Δημ. Καμάρδα, εκδοθέντα τῳ 1870, πλην των αναστρόφων φ, και ρ, άτινα ένεκα ανωτέρας ανάγκης αντικατεστήσαμην διά του b και d. Ἴδε το αλφάβητον εν αρχῇ του βιβλίου.

Qëllimi i "Bletës Shqiptare", ose i kësaj përmbledhjeje, është që, së pari, t'i dorëzoj publikut -para se të jenë zhdukur nga kalimi i kohës që mposht gjithçka- gjithë këngët, përrallat dhe krijimet e tjera shqiptare, aq sa munda të grumbulloj prej vitesh me mund e me harxhe, të cilat sigurisht e kanë një vlerë, ngaqë prej tyre duket origjina e një kombi. Së dyti, dhe kryesorja, t'iu jepet një nxitje dhe shtytje shqiptarëve në mbarë atdheun që t'i përkushtohen shkrimit dhe studimit të gjuhës së tyre amtare, me qëllim që, me anë të këtij mjeti të natyrshëm e të pazëvendësueshëm, sikurse ndodh me ligjet e natyrës, të munden edhe ata, siç bënë gjithë kombet e botës, të qytetërohen; dhe e treta, që të nxiten tërë ata që merren me kësi punësh, të sistemojnë dhe zbukurojnë përmbledhjen në fjalë, duke u kthyer ajo në dobi për popullin. Ndërsa ne, si bujq të papërtuar, por pa njohuri bujqësore, e ofrojmë lëndën të palëmuar e të papërpunuar.

Meqenëse ai që shkruan dhe i drejtohet publikut duhet të jetë i paanshëm, i largët, i paatdhe, kozmopolit, kjo është edhe arsyeja pse, të nxitur nga dashuria për atdhenë e përbashkët, pan-helenium-in (πανελλήνιον-in), e themi lirisht atë çka besojmë, që "një popull s'mund t'i shkëputet barbarisë, veçse duke selitur gjuhën e vet", thotë Herderi. Shqiptarët pra, të ndodhur sot në padituri të skajshme (dhe do të jenë të tillë derisa t'i kthejnë sytë kah gjuha e nënës) dhe të përndarë fetarisht në mohamedanë, të krishterë ortodoksë dhe katolikë, do të mundin të ndritohen vetëm me të mësuarit e gjuhës amtare. Sepse letrat greke për shqiptarët mbarë janë diçka e largët, e prekshme vetëm prej save e kanë xhepin plot, çka do të thotë se iu shërbejnë tiranëve e veglave të tyre, për t'i vënë popujt nën zgjedhë e për t'i mbajtur të paditur e robër. Përveç kësaj çdo gjuhë e huaj duhet të nxëhet në vendin ku flitet, që të mësohet nxënësi ta flasë, qoftë greqishten, qoftë frëngjishten, italishten etj. "Të mira rasot, por vetëm për priftërinjtë". Aq më shumë që gjuha amtare është ushqimi i parë dhe i përbashkët, i cili i jep jetë popullit mbarë, dhe që e lehtëson në të mësuarit e shpejtë e të rregullt të çdo gjuhe të huaj, zgjeron hapësirën e dritave e të mbrothësisë. Ku s'ka shpirt gare dhe sedër, aty mungon përparimi. Kombet e Oksidentit e patën selitur latinishten në motet e miturisë së tyre, dhe prapëseprapë qenë barbarë; arritën të rilinden kur iu vunë selitjes së gjuhëve të veta. Edhe Greqia, me këshillën dhe nxitjen e të paharruarit Korais, hoqi dorë nga sistemi i vjetër i [të mësuarit të] greqishtes së lashtë dhe futi në shkollat përdorimin e gjuhës amtare të vendit, për të njëjtën arsye. Sa i përket idesë së madhe të Greqisë, që të helenizojë me anë të letrave greke dhe të bashkojë shqiptarët, dhe idesë tjetër të përhapur ndër shqiptarët naivë nën vellon e mashtrimit, se gjoja letrat shqip kanë për të sjellë përçarje mes grekëve dhe shqiptarëve, ky egoizëm, dhe kjo vijë politike e pakuptimtë dhe e pafrytshme me veprime të mykura e gjysmake shkatërrron si Shqipërinë edhe Greqinë, dhe këtu le të sjellim si shembull të vetëm qëndrimin e shtetit bizantin. Ky shtet kolosal nuk do të pësonte rënien shkatërrimtare dhe të parimëkëmbshme nëse do të qeverisej prej një qeverie të karakterizuar prej kujdesi atëror dhe misioni kulturor në frymën e të qenit një trup o vetëm, dhe nuk do të copëtohej në aq elemente heterogjene dhe të huaja. Për rrjedhojë, jo nëpërmjet të dhunës e të mashtrimit, por me anë të dritësimit, dhe vetëm të dritësimit, bëhet i mundur dhe realizohet kompaktësimi dhe bashkimi. Gjermanët dhe italianët u kulturuan së pari e paskëtaj kuptuan interesin e përbashkët, dhe realizuan bashkimin. Por as mundemi të kuptojmë nëse ka ndonjë lidhje mes popullit mirëfilli shqiptar dhe Greqisë, përveç lidhjes së pjesshme fetare. Por, në të kundërt, gjendja e sotme morale dhe politike e të dy popujve karakterizohet vërtet nga përçarja dhe ndarja. Dhe e themi këtë jo pa keqardhje, pa dashur ndërkaq të ushqejmë shpresa skolastike dhe të kota, përderisa nuk ekziston asnjë kujdes i tillë.

Lidhur me helenizimin dhe asimilimin e shqiptarëve, dhe pas braktisjes së Shqipërisë, siç është sot, pa shkolla ku mësohet gjuha e vendit, në atë rast, në vend të grekëve, do të shpejtojnë sllavët me mjete më të fuqishme dhe më praktike dhe do të gëlltisin të parën Shqipërinë, e në vazhdim edhe vetë Greqinë. Ndërsa po të arsimohet shqiptari në gjuhën e vet dhe brenda sferës së jetës së tij parake prej spartani do të fitojë atdhetari dhe vetëndërgjegjësim, do të jetë në gjendje të mbrojë vendin e vet, kështjellë natyrale dhe të papushtueshme [dhe thelbin e tij helenopellazgjik]. Si pasojë, për arsye natyrore, historike, farefisnore etj., do të priret më tepër kah Greqia , sesa kah sllavët, dhe italianët [do të jepej me zemër jo aq te sllavët sesa te mëma Greqi]. Shqiptari, sedërlli më shumë se çdo tjetër komb, nuk ka për ta mohuar gjuhën e vet të stërlashtë pellazgjike, dhe për më tepër, nuk do të harrojë rrënjët e tij, stërgjyshërit e lavdishëm epirotas dhe maqedonas, heroin e vet Skënderbenë, e së fundi dragonjtë e rinj të detit, vëllezërit e tij të një gjuhe, nidriotët, speciotët, psariotët [psariotët nuk janë shqiptarë por grekë], si dhe shqipet e Sulit. Për sa u përket shqiptarëve otomanë dhe katolikë, ata kanë ruajtur të paprekura tiparet më të çmuara të racës së vet, siç dëshmohet prej një morie shembujsh të historisë së kohëve të reja; ndaj bashkatdhetarëve të vet të krishterë u treguan përherë mbrojtës fisnikë në raste e kohë të ndryshme, duke jetuar në dashuri vëllazërore, dhe në harmoni të plotë myslimanë e të krishterë, dhe as është e mundur të ketë diku tjetër tolerancë më të madhe fetare sesa ajo e shqiptarëve, madje as ndër kombet më të kulturuara të botës (2) [Shqiptari që e do aq shumë atdhenë, do edhe bashkatdhetarin e vet qoftë edhe të një feje tjetër, sepse fenë e ka të sërës së

dytë krahasuar me atdhenë. Ndër këngët heroike të këtij libri hasen shembuj të tillë të shumtë e të pakrahasueshëm.] Pra nuk i shpëton vëmendjes së shqiptarëve fakti se, duke qenë të izoluar dhe të ndarë prej motrës së vet a më mirë të themi Heladhës mëmë, të rrethuar prej armiqsh të mëdhenj e të fuqishëm nuk do të munden përfundimisht t'i shmangen rrezikut të thëthitjes së keqe. Tani që po shkruajmë, luftojnë në krah të malazezve shumë shqiptarë, banorë të krahinave brenda dhe jashtë Malit të Zi, të cilët kanë arritur fitore të shkëlqyera, por cila do të jetë vallë e ardhmja e tyre?

Pra kjo përmbledhje, që është … një libër për gjithë shqiptarët anembanë, myslimanë e të krishterë, ndërsa për të huajt shërben si një pasqyrë e vogël për kërkime filologjike, uroj të bëhet shkas për mendime dashamirëse e të rëndësishme në këtë lëmë, nga ana e të diturve grekë e shqiptarë, dhe për aq sa koha mbetet e çmuar, përherë e sidomos sot. Nga ana jonë morëm guximin ta paraqesim me respekt të madh [për lexuesin] dhe për hir të filozofisë në kuptimin e mirë të kësaj fjale.

Përmbajtja e kësaj … vepërze, shtypja e së cilës u vonua për shkak rrethanash të paparashikuara, është

1. Pjesë e Historisë "Dora d' Istria – raca shqiptare", përkthyer në shqip, marrë prej librit të Dhimitër Kamardës "Φυλέτια Αρβηνόρε", shkruar në dialektin shqiptaro-italian dhe me shkronja latine, botuar në Livorno më 1867;
2. Fjalë të urta shqiptare përkthyer në greqisht;
3. Gjëagjëza shqiptare së bashku me përkthimin;
4. Emra dhe mbiemra shqiptarë;
5. Këngë shqiptare, alegorike, komike, të dasmës, erotike dhe heroike, të cilave iu shtuan edhe 2-3 greke, si dhe disa të shqiptarëve të Greqisë dhe të Italisë;
6. Përralla shqiptare;
7. Fjalor nga shqipja në greqisht, ndonjëherë edhe në greqishten e vjetër, kryesisht për fjalët e huaja, pjesërisht edhe për disa fjalë shqipe që nuk hasen në mbarë Shqipërinë për shkak të dallimeve dialektore. Vende vende bëhet edhe krahasim fjalësh të shqipes dhe të greqishtes së lashtë.

Shkronjat që përdorëm i morëm prej të nderuarit e të madhit patriot Dhim. Kamarda, e që u botuan më 1870, me përjashtim të shkronjave anastrofe ϕ, dhe ρ, të cilat i zëvendësuam me b dhe d për arsye nevojash praktike. Shih alfabetin në fillim të librit.

-VI-

Pjesë nga një motërzim i parathënies së "Bëletës Shqypëtare" të v. 1878
Μέρος προσχεδιάσματος προλόγου της «Αλβανικής Μέλισσας» του 1878



Ενώ λοιπόν ο Αλβανός είναι αυτόχρημα Έλλην, και προς ενίσχυσιν και πραγματοποίησιν της ιδέας ή πραγματικότητος ταύτης δεν συντελεί άλλο, όσον η σπουδή και η εξάπλωσις της Αλβανικής γλώσσης, της οποίας η σπουδή και εξερεύνησις θα ωφελήσει και τον Ελληνισμόν ποικιλοτρόπως, και η οποία γλώσσα, γραφομένη και καλλιεργουμένη ου μόνον δεν θα αποξενώνεται πλέον, αλλά και θα πλησιάζει έτι μάλλον προς την Ελληνικήν. Προς τι αυτή η κενή και σάθρα ιδέα γραικών τινών και Αλβανών ημιμαθών, ότι δήθεν «η Αλβανική γλώσσα θα προκαλέσει διαίρεση», ενώ πράγματι περιμένεται ένωσις; Και «τι χρειάζεται η βάρβαρος αυτή γλώσσα, ενώ έχομεν την Γραικικήν»; Οι τοιούτοι επιπόλαιοι, ει μεν είναι Γραικοί, υποπίπτουν εις αντίφασιν. Διότι αυτοί οι ίδιοι, χάριν του συμφέροντός τους και κατά προτροπήν του αειμνήστου Κοραή (και έπραξαν ορθώς) εγκατέλιπον την αρχαίαν Ελληνικήν, και εισήγαγον εις τα σχολεία την μητρικήν των γλώσσαν, ως και οι Ιταλοί και λοιποί εις την Ευρώπη καταργήσαντες την Λατινικήν ανέλαβον την Ιταλικήν, σπουδάζοντες π.χ. τον Όμηρον και άλλους συγγραφείς διά της λαλουμένης γλώσσης του έκαστος. (1) Ει δε είναι Αλβανοί, γίνονται [D 573] αρνηταί της πατρίδος, ως περιφρονούντες την γλώσσαν των, και του ιδίου θεού του δοτήρος της γλώσσης αυτής, γίνονται λίαν ταπεινοί απέναντι των ξένων, οι τοιαύτα φρονούντες γίνονται και λίαν σκληροί, ως τύραννοι απέναντι των ομογενών τους, ως θέλοντες να έχωσι μονοπωλείον διά μόνα τα τέκνα των την παιδείαν, τον δε μικρόν λαόν, όλως αγράμματον και δούλον. Αλλά και υπό τοιαύτην έποψιν, η σκέψις αύτη δεν είναι ορθή· διότι όπου λείπει συναγωνισμός, εκεί πρόοδος δεν γίνεται, και όπου απέχουν οι πολλοί, οι ολίγοι καλώς έχοντες δεν δύνανται να διατηρηθώσι. Τέλος είναι ανάγκη και ανάγκη επείγουσα χάριν του πανελληνίου να γραμματισθή η Αλβανική, και εισαχθή εις τα Ελληνικά σχολεία, όπως δεσμευθή διά της γλώσσης ο Αλβανός και μπή φραγμός κατά των Σλάβων τας προπαγάνδας. Ταύτα λοιπόν ως προς την γλώσσαν.

(1) [Έπειτα ποίαν σχέσιν έχει η σημερινή εκπαίδευσις ενός ιδίου λαού με την φαντασιώδη ιδέαν της ενδεχομένης πολιτικής διαιρέσεως; Ούτε η Ελλάς δέχεται να έχει τοιαύτας προσβλητικάς (….) και παρά φύσιν αξιώσεις του να κόψωσι την γλώσσαν των Αλβανών, ούτε οι Αλβανοί δέχονται να ταπεινωθώσι ~~ως υποχείριοι~~ τόσον χαμερπώς επί οιοδήποτε λόγῳ και ανάγκῃ γενναίοι, υπερήφανοι και υπέρ παν άλλου έθνους φιλότιμοι. έχομεν πρόσφατον παρ…]

Kurse shqiptari është përnjëmend grek, dhe për fuqizimin dhe realizimin e kësaj ideje a të këtij realiteti asgjë tjetër nuk kontribuon më shumë sesa të mësuarit dhe përhapja e gjuhës shqipe, nxënia dhe studimi i së cilës do t'i sjellë dobi gjithfarëduarsh edhe vetë Helenizmës, dhe e cila gjuhë, e shkruar dhe e lëvruar, jo vetëm nuk ka për t'u tjetërsuar, por do t'i afrohet edhe më greqishtes. Nga na doli kjo ide e pabazë dhe boshe e disa grekëve dhe shqiptarëve gjysmanalfabetë, se gjoja 'gjuha shqipe do të sjellë përçarje', në një kohë që pritet bashkimi? E 'ç'na duhet kjo gjuhë barbare kur kemi greqishten'? Këta njerëz të cekët, nëse janë grekë, bien në kundërshti me veten. Sepse vetë ata, për hir të interesit të tyre dhe sipas këshillës së të paharruarit Korais braktisën greqishten e vjetër (dhe bënë mirë) dhe futën në shkolla gjuhën amtare, sikurse edhe italianët e të tjerë në Europë, që hoqën latinishten dhe futën italishten, duke studiuar p.sh. Homerin dhe të tjerë shkrimtarë, secili nëpërmjet gjuhës që flet". (1) Nëse janë shqiptarë, bëhen mohonjës të atdheut, sepse duke përçmuar gjuhën e tyre, si dhe vetë zotin që ua dha atë gjuhë, e ulin veten mjaft kundrejt të huajve, [shto që] ata të cilët mendojnë kështu bëhen edhe shumë të ashpër, si tiranë kundrejt bashkëkombasve të tyre, ngaqë duan ta kenë shkollimin monopol vetëm për të bijtë, ndërsa vegjëlinë ta lënë pa gramë e robinjë. Por edhe nga ky këndvështrim, një mendim i tillë nuk është i drejtë; sepse ku mungon fryma e garës, aty nuk ka mbrothësi, dhe aty ku shumica rri mënjanë, pakica e kamur nuk mund të mbahet gjatë. Në mbyllje, është nevojë dhe madje nevojë që nuk pret, për hir të pan-hellenium-it të shkruhet shqipja, dhe të futet në shkollat greke, me synim që shqiptari të obligohet nëpërmjet të gjuhës dhe t'i vihet gardh propagandës së sllavëve. Këto desha të them sa i takon gjuhës.

(1) [Pastaj çfarë lidhje ka shkollimi i sotëm i një populli të veçantë me idenë fantazmë të përçarjes së mundshme politike? As Greqia pranon të ketë pretendime të tilla ofendonjëse ... dhe monstruoze për ndalimin e gjuhës së shqiptarëve, as shqiptarët –burrërorë, krenarë dhe më sedërllinjtë ndër gjithë kombet- pranojnë të poshtërohen ~~si zhele~~ kaq shumë për çfarëdolloj arsyeje a nevoje. Nga kohët e fundit kemi shem…

-VII-

Skica apo fragmente letr/-e-ash të Mitkos, drejtuar një miku të vet, nga anët e Korçës, lidhur me regjistrimin e pajtimtarëve për botimin e "Bletës" - Σχέδια ή αποσπάσματα επιστολ-ής/-ών του Μήτκου προς φίλο του, καταγόμενο από την Κοριτσά, σχετικά με την εξασφάλιση συνδρομητών για την έκδοση της «Μέλισσας»



[……], ως δεν αγνοείτε, εκ νεαρής μου ηλικίας ανέλαβον και τόλμησον να εκδώσω διά του τύπου Αλβαν. Άσματα, κτλ. Τούτον προς όφελος της καθόλου πατρίδος, δηλ. Χριστιανών τε και Τούρκων, Αλβανών και Ελλήνων/Γραικών. Προς τον σκοπόν τούτον σκοπεύω να εξακολουθήσω μεταφράζων και άλλα συγγράμματα, αν ενθαρρυνθώ από το κοινό φρόνημα των Αλβανών εδώ κατά τας διαφόρους περιστάσεις … Απαιτούνται όμως έξοδα … καταναλώσεως των βιβλίων … και τους προσδωκομένους εξ αυτών καρπούς να επιτευχθή και τα έξοδά μου τουλάχιστον να απαντήσω ~~αφού τα χρηματικά μου μέσα ως γνωστόν είναι μικρά~~. Προς τον σκοπόν μου τούτον κρίνω εγώ ως καταλληλότερον διά εκείνα τα μέρη της Αλβανίας έχοντας το αίσθημα πατριωτισμού και την επιδεξιότητα ως μέσα του να διεκπεραιωθή το βιβλίο. Σας προσφέρω διά τους κόπους σας 20% δι' όσους συνδρομητάς θα μου κάμητε και Τούρκους και Χριστιανούς και Γραικούς και Αλβανούς. Η Αλβανική μου Μέλισσα, της οποίας Αγγελίαν έστειλον προς τον Κον Π. Ζωγρ. είναι υπό το πιεστήριον, αλλά εάν εντός 30 ή 40 ημερών μου στείλετε μερικά ονόματα συνδρομητών, προφθάνω να τα καταχωρίσω. Ο Κυρ. Π. μου έστειλεν ολίγα ονόματα μόνον, διότι ίσως οι άνθρωποι εξήλαβον το σύγγραμμα ως ανθελληνικόν, ενώ τουναντίον υπηρετεί μάλλον τον Ελληνισμόν, ~~ιδίως δε την πατρίδα καθόλου.~~

Αν λοιπόν εγκρίνητε την ιδέαν μου, και νομίζετε ότι δυνάμεθα έτι να ωφελήσωμεν και το έθνος και τον εαυτόν μας ή μέρος, παρακαλώ γράψετέ μου την απάντησιν. Υμείς οι δύο κάμαμεν την απόπειραν του να συστηθή το Λάσσον της πατρίδος. Και επετύχαμε. Ίσως πετύχομεν και εις τούτο, αν και η θεία Πρόνοια μας βοηθήσει.

……

Από φιλικόν θάρρος προ πολλού σας έγραψα 2 ή 3 επιστολάς μου, δι' ων σας παρακαλούσα να μου κάμητε την χάριν να μου συλλέξετε μερικούς συνδρομητάς … ελλ-αλβ. σύγγραμμα, κατά την αγγελίαν μου που σας έστειλα συγχρόνως, και με απορίαν μου δεν έλαβον ουδεμίαν σας απάντησιν. Αδυνατών να κατανοήσω το αίτιον της σιωπής σας, αν υποθέσω ότι θεωρείτε το σύγγραμμά μου ως ανθελληνικόν, όπερ δεν αληθεύει, διότι αυτό είναι υπέρ του Ελληνισμού μάλλον, πάλι έπρεπε κατά καθήκον φιλικόν, να με απαντήσετε.

Εγώ τουλάχιστον, θεωρών υμάς, πατριώτην και φίλον καλόν, ετόλμησα διά τελευταίαν φοράν να σας παρακαλέσω και διά της παρούσης μου όπως κάμνοντές μου την χάριν μου συλλέξετε μερικούς συνδρομητάς. Και μου στείλετε αμέσως τα ονόματα … υπό το πιεστήριον … επί αμοιβής …. // Το σύγγραμμα, φίλε, είναι υπέρ των Ελλήνων Χριστιανών και των Τούρκων Αλβανών ήτοι υπέρ εκάστ' ανθρώπου εν γένει. Διά τούτο εδώ εγράφησαν πλείστοι Γραικοί συνδρομηταί. // Δυστυχώς έλειπον, και δεν επρόφθασα να απευθυνθώ ούτε προς τον κ. Ζαρίφην,

ώντα εδώ, ίνα ζητήσω την υποστήριξίν του, και δι' αυτού την του Κυρ. Χρηστ. // Τούτο με ελύπησε παραπολύ. Αν υμείς είχετε καλήν διάθεσιν, ημπορούσατε να με συστήσητε…

[……], sikurse e dini, qysh në moshë të re iu vura punës dhe guxova të shpall me anë të shtypit Këngë Shqiptare, etj. Këtë [e bëra] në të mirë të atdheut mbarë, d.m.th. të të krishterëve e myslimanëve, shqiptarëve dhe helenëve/grekëve. Për këtë qëllim kam ndërmend të vazhdoj e të përkthej edhe libra të tjerë, nëse do të inkurajohem prej bindjes së përbashkët të shqiptarëve të këtushëm në rrethana të ndryshme … Veçse duhen harxhe … për shpërndarjen e librave … dhe të arrijmë të marrim frytet që pritnim prej tyre si dhe të mbuloj së paku shpenzimet e mia ~~përderisa mjetet e mia financiare janë siç dihet të vogla~~. Për realizimin e qëllimit tim gjykoj se ndër ato vende të Shqipërisë mjetet më të përshtatshme të shitjes së librit janë fryma e atdhetarisë dhe shkathtësia. Ju ofroj për mundin tuaj 20% kundrejt numrit të pajtimtarëve që do të më siguroni, edhe myslimanë edhe të krishterë, edhe grekë edhe shqiptarë. Bleta ime Shqypëtare, Njoftimin e së cilës ia dërgova z. P. Zogr., ndodhet ende në shtypëtore, por po të më dërgoni disa emra pajtimtarësh brenda 30 a 40 ditëve, arrij t'i përfshij [në libër]. Zoti P. më dërgoi vetëm pak emra, sepse me sa duket njerëzit e morën librin për antigrek, edhe pse, në të kundërt, ai i shërben më tepër Helenizmës, ~~e sidomos atdheut mbarë~~.

Pra nëse e gjeni me vend propozimin tim, dhe mendoni se mundemi ende të sjellim dobi si për kombin si për vete apo për një pjesë, lutem të më shkruani përgjigjen. Ne të dy bëmë përpjekjen e krijimit të Llasos së vendlindjes. Dhe ia dolëm mbanë. Mbase ia dalim mbanë edhe në këtë, me shpresë se do të na ndihë edhe Providenca hyjnore.

…….

Me kurajon e të qenit miq ju kam shkruar prej kohësh 2-3 letra, me të cilat lutesha të më bëni nderin e të më mblidhni disa pajtimtarë … librin gr.-shq., sipas Njoftimit tim që ju dërgova në të njëjtën kohë, dhe për çudinë time nuk mora as edhe një përgjigje. Meqë nuk mundem të kuptoj shkakun e heshtjes suaj, edhe sikur të supozoja se e konsideroni librin tim si antigrek, gjë që nuk është e vërtetë, ngaqë ai është pro Helenizmës, prapëseprapë duhej të më përgjigjeshit, si detyrim ndaj miqësisë sonë.

Unë së paku, duke ju konsideruar atdhetar dhe mik të mirë, mora për herë të fundit guximin dhe ju lutem me këtë letër të më bëni nderin të më gjeni disa pajtimtarë. Dhe më dërguat menjëherë emrat … në shtyp… me shpërblim … // Libri, o mik, është pro grekëve të krishterë dhe shqiptarëve myslimanë apo në të mirë të çdo njeriu përgjithësisht. Për këtë arsye këtu u shkruan pajtimtarë një shumicë grekësh. // Për fat të keq mungoja, dhe nuk arrita t'i drejtohesha as z. Zarífi, që ndodhet këtu, për të kërkuar mbështetjen e tij, dhe nëpërmjet tij atë [mbështetjen] të z. Krist.[aq] [Zografi] // Kjo më hidhëroi shumë. Nëse ju do të kishit dëshirën e mirë, mund të më rekomandoni

-VIII-

Όσα τετράδια της αλβαν. Συλλογής μου στέλλω κατά καιρούς προς τύπωσιν*. - Fletoret e Përmbledhjes sime shqiptare, që dërgoj kohë pas kohe për shtyposje*.

Meyeri ... kish të më shtyposnjë të mbeturat e 'Bëletës'.
(Letër e Th. Mitkos për De Radën, 7.10.1884)

*Transkriptimi greqisht dhe përkthimi shqip i dokumentit janë përfshirë për nevoja praktike në tekstin e punimit tonë. -*Η ελληνική μεταγραφή και η αλβανική μετάφραση συμπεριλαμβάνονται για πρακτικούς λόγους στο κυρίως κείμενο της εργασίας μας.

-IX-

Ballina e botimit të Vjenës
Εξώφυλλο της έκδοσης της Βιέννης

Bleta Shqypëtare
e
Thimi Mitkos
përshkroj me shkrojta shqype, e përitheu shqyp dhe e raôhill
Dr. Gjergj Pekmezi
Konsulli i Shqypërisë
Vjen-ë
1924.

Parathënia e botimit të Vjenës, përkthyer nga Dr J. Basho
Πρόλογος της έκδοσης της Βιέννης, σε μετάφραση του Dr J. Basho



Parathënje.

Qëllimi i „Bletës shqiptare"; d. m. th. i këtyre këndimeve albanologjike, është përgjithërisht, shpëtimi edhe dhënija brezave që vinë i fjalëvet edhe tekstevet shqipe, sa para vjetesh me shumë mundim e prishje mblodha, të cilat mbesoj se do kenë një vleftë, sepse në këto duket fisi, karakteri, adetet e zakonet e rasës shqiptare; veçanërisht, duha që t'u ipet një shkak e shtyrje bashkatdhetarëve shqiptarë për të kulturuar edhe studiuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë natyrale edhe të vetëm fitimprurëse të mundin edhe këta të civilizohen edhe të kenë njësoj vjeftë me vëllezrit e tjerë të tyre ellenofonë.

Lutem që të tjerë, më të zotrit se mua në këto punë, të pasurojnë këtë mbledhje edhe t'a shukurojnë, ashtu që të përdoret për dobinë morale të kombit. — „Një komp nuk munt me as një mënyrë tjetër të dalë pe barbarismës, përveç se dyke punuar gjuhën e vet" thotë Herôeri. Edhe Shqiptarët, si gjenden tani të ndarë në Mohamedanë edhe të Krështerë, këta prapë në Katolikë edhe Ortodoksë, dotë mundin të ndriten edhe të

11

Qëllimi i "Bletës shqiptare", d.m.th. i këtyre këndimeve albanologjike, është përgjithërisht, shpëtimi edhe dhënija brezave që vinë i fjalëvet edhe tekstevet shqipe, sa para vjetesh me shumë mundim e prishje mblodha, të cilat mbesoj se do kenë një vleftë, sepse në këto duket fisi, karakteri, adetet e zakonet e rasës shqiptare; veçanërisht, duha që t'u ipet një shkak e shtyrje bashkatdhetarëve shqiptarë për të kulturuar edhe studiuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë natyrale edhe të vetëm fitimprurëse të mundin edhe këta të civilizohen edhe të kenë njësoj vjeftë me vëllezrit e tjerë të tyre ellenofonë.

Lutem që të tjerë, më të zotrit se mua në këto punë, të pasurojnë këtë mbledhje edhe t'a zbukurojnë, ashtu që të përdoret për dobinë morale të kombit. – "Një komp nuk munt me as një mënyrë tjetër të dalë pe barbarismës, përveç se dyke punuar gjuhën e vet" thotë Herderi. Edhe Shqiptarët, si gjenden tani të ndarë në Mohamedanë edhe të Kështerë, këta prapë në Katolikë dhe Ortodoksë, dotë mundin të ndriten edhe të humbasin zgjyrën e padijës së tyre barbare vetëm dyke studiuar gjuhën e tyre amtare. Gjuha amtare është yshqimi i parë e i përbashktë q' i jep gjallësi popullit; sa për klaset më të lartra le të mbetet më e mbaruara edhe e provuara greqishte.

Kërkimi i cave të mbytin gjuhën shqipe edhe me përdorimin e shtrënguar të greqishtes t'a thëthinë fjesht rasën shqiptare ose t'a shuajnë edhe t'a bëjnë sikur ska qënë, është një gabim i tmerruar, shpikje e një mendje të shkurtër, politik' e kalbur edhe i çdo "idhee të madhe" mosmeritonjës. Si shëmbëll le të jetë politika kishatare e Patriarhatës të Stambollit edhe e qevërrisë të Athinës kontra Bullgarisë, e cila në vent të bashkimit solli çarje edhe në vent të bindjes edhe thëthitjes pruri mëni rase të papajtuar.

Qytetërimi grek, siç gjenden sot punrat, munt të hyjë vetëm në të paktë Shqiptarë, vetëm në mest t'atyre, të cilët kanë pak dituri. Por si munt të hyjë qytetërimi grek në shumicën e gjendjes shqiptare, në familjen e zanatçiut edhe të industrielit, në kasollen e bariut, në qoftë se nuk përhapen iderat greke me përdorimin e gjuhës së tyre shqiptare që flitet?

Apo duhet të presë njeriu gjersa tërë populli shqiptar të mësojë gjuhën e shkrimit të Athinës edhe pastaj të fillojë përhapjen e iderave greke? Gjer atëhere do kalojnë shumë shekuj. Si shëmbëll le të jenë fshatrat shqiptare rreth Athinës, ku aty edhe ne dyert të kryeqytetit grek, edhe pas pesëdhjet vjet mbretëri greke nuk mësuan bota gjer tani as një fjalë greqisht.

Për veç kësaj, në qoftë se lihet Shqipërija në padijën e saj, pa shkronja vendi edhe pa shkolla popullore, do të rendin atëhere Sllavët me vegla më të forta e më praktike për të gëlltitur rasën shqiptare. Ja ku malëzestë zbresin pe maleve të tyre skërka edhe lakuriqe për t'a pushtuar edhe sllavizuar Shqipërin' e veriut edhe Sërbët vrapojnë gjith' me atë qëllim nga lindja. As priftinjtë, propangandistët e Romës srrinë me duar të kryqëzuar, por me katihizme shqip, d.m.th të shkrojtur në gjuhë shqipe, me fjalë edhe predikime po tërheqin më shumë se gjysmën e popullit shqiptar në dogmën latine edhe në kombësinë italjane. Kur, në qoftë se Shqiptari mësoheshe në gjuhën e ti amtare pe mësonjësve edhe pe kleri me mendime greke edhe në qoftë se mbillshe ne ay idea greke me frazët e ti Shqipe që fliten, kishte për të zënë rrënjë ne ay patriotismi grek edhe dija e veftesëvet [veftes së vet=αυτοσυνείδησις] aqe shumë sa të ishte i zoti të mprojë atdheun e ti pe natyre të fortë e të mospushtueshme, edhe kombësin' e ti greke edhe do fshtet'te mendjen e zembrën e ti jo në Sllavët e në Italjanët po më tepër ne mëma Greqi, dyke sjellë ndër ment gjyshrit e ti Epirotët e Maqedonët, bashkë kombëtarët e ti në Greqi të lirë, luftëtarët e atdheut të ti të math Suljotët, Pecjotët, Hidrenjtë e të tjerë.

Po edhe Greqia duhet t'u sillet Shqiptarëve, si mëmë e vërtetë edhe e dashur, dyke u folur në gjuhën e tyre të foshnjërisë edhe shtëpijake edhe jo si njerkë ziliqare dyke u folur përnjergjesh edhe pa pregatitur në gjuhën e Ksenofonit edhe të Thukidhidhit, e cila është për të mësuarit edhe e cila, masi ata nuk e kuptojnë, u err mendjen e i bën të plokët, sa t'i përbuzin vëllezrit e tjerë, si të pagëdhendur, të poshtër, të humbur, si vëllezër, të cilët gjoja sjanë fisnikë edhe si të këtillë shëmtojnë fisnikërinë greke.

Greqia duheshe si mëmë e dashur të ngrohi pe Shqiptarëve jo vetëm bashkëfetarët e saj, po edhe Shqiptarët Mohamedanë edhe katolikë, të cilët me gjith ndryshimet e tyre fetare e përmbajnë patriotismin e tyre kombjar lartër edhe për bashkëqytetarët e tyre të kështerët ortodoksë dëftyen gjithmonë dashuri vëllazënore edhe rrojtnë gjithmonë në armoni të plotë më ta. Një liri feje më e madhe se ajo që mbretëron në mest të Shqiptarëve nuk munt të gjendet as në kombet më të qytetëruar. Shqiptari dyke dashur pa funt atdhenë e ti do edhe bashkatdhetar' e ti, edhe kur ay është tjatër feje, sepse fenë e ka në vent të dytë, kur puna është për atdhen' e përgjithëshme. Në këngat e popullit heroike gjenden shumë këshisoj shëmbëlla patriotizmi edhe lirije feje të papërgjajtura.

I lutem Zotit, që ky shkrim albanologjik t'u bëhet këndim i përbashktë gjithë Shqiptarëve pa ndryshim mendimi politik ose besim feje edhe filologëve që studiojnë, një shkak për këndime edhe mendime të tjera ethnologjike më të mbaruara.

Misir, në Mars 1878.

Eftim Mitko.

Shënimi hyrës i Gj. Pekmezit në botimin e Vjenës
Εισαγωγικό σημείωμα του Gj. Pekmezi στην έκδοση της Βιέννης

Shpjegim.

Më 1908 isha në një librari në Monaho (München) dyke kërkuar libra përmbi Shqypëri, e ndër të tjera papandehur e gjeta edhe „Bletën Shqyptare" të Thimi Mitkos, të cilën edhe e bleva me gëzim të math.

Kur e këndova dhe e njoha pak më mirë këtë veprë të bukur, të kisha sesi me njëherë do t'a përshkruanja, do t'a përkthenja shqyp e do t'a shtypnja. Pandaj q' atëhere, u mundova që të marë vesht ndonjë gjësent më shumë përmbi jetën e Thimi Mitkos, sikundër edhe desha t'a gjej fotografinë e ti, që t'a zbukuronja tani këtë librëzë të rallë e të çmuar. Po përveç kësaj pat Mitkua edhe një mbledhje tjetër të këtillë më të madhe, se këtë, të cilën sado q' u mundua që t'a shtypi, mjerisht, sa ishte gjallë nuk i erth për dore. Prej kësaj mbledhje të pashtypur i dërgoj tre përalla albanologut të përmendur Gustav Meyer-it, i cili përveç të tjerave i shtypi edhe këto në gramatikët shqype të ti të famshme.

5

Më 1908 isha në një librari në Monaho (München) dyke kërkuar libra përmbi Shqypëri, e ndër të tjera papandehur e gjeta edhe "Bletën Shqyptare" të Thimi Mitkos, të cilën edhe e bleva me gëzim të math.

Kur e këndova dhe e njoha pak më mirë këtë veprë të bukur, të kisha sesi menjëherë do t'a përshkruanja, do t'a përkthenja shqyp e do t'a shtypnja. Pandaj q' atëhere, u mundova që të marë vesht ndonjë gjësent më shumë përmbi jetën e Thimi Mitkos, sikundër edhe desha t'a gjej fotografinë e ti, që t'a zbukuronja tani këtë librëzë të rallë e të çmuar. Po përveç kësaj pat Mitkua edhe një mbledhje tjetër të këtillë më të madhe, se këtë, të cilën sado q'u mundua që t'a shtypi, mjerisht, sa ishte gjallë nuk i erth për dore. Prej kësaj mbledhje të pashtypur i dërgoj tre përalla albanologut të përmendur Gustav Meyer-it, i cili përveç të tjerave i shtypi edhe këto në gramatikët shqype të ti të famshme.

Gustav Meyer-i kishte letrëkëmbim me Mitkon; ky përktheu gjermanisht edhe dymbëdhjetë përalla të "Bletës Shqyptare" dhe i shtypi në "Archiv für Literaturgeschichte".

Mitkua ishte i njohur edhe me të tjerë albanologë të kohës së ti, të cilët ditnë t'a çmojn bukur mirë punën e diturinë të lartë të Mitkos ashtu, që sot me të drejtë emri i ti i pavdekur e zë vëndin e merituar ndër fjaluar enciklopedik të përbotshëm.

Mjerisht nuk e dimë hollë mënyrën e mbledhjes së lëndës së ti, po padyshim ky është një prej fort të rallëve Shqyptarë, që dinte fare mirë të çmojë e të mbarojë si duhet një punë aqë të lartër e të vjefshme, dinte të gjejë njerëzit që dinë të këndojnë e të rëfejnë përalla mirë, e prej mënyrës së punës dhe zellit të math duket qartas, se e donte me gjith zembrë si popullin ashtu edhe gjuhën e ti.

Mitkua ynë e dinte mirë, se poezija e popullit jeton në vesht të popullit, në buzët dhe në lahutën e këngëtarit të gjallë e se, kur do njeriu t'a përmbledhi e t'a shtypi këtë për të kënduar të tjerët, bukurija e saje atëherë mbetet vërevërte e thjeshtë, në qoftë, se këjo është përmbledhur ashtu si është, e jo ashtu si i pëlqen mblethsit, ajo duhet të jetë fare e xveshur, si natyra vet e me të tëra naivitetet e sajë.

N' atë kohë dyke mos pasur autori ynë edhe një alfabet të caktuar shqyp, e si toskë e shkrojti librin e ti me shkrojla gërqishte dhe shpjegimet sikundër edhe parathënjen gërqisht. Mbas parathënjes duket mirë qëllimi i Mitkos, se ka dashur dhe t'i zbuti grekët kundra Shqyptarëve e të na i afrojë këta.

Shtypja e Mitkos sado që mezi është shkruar me shkrojla gërqishte dhe me të tëra theksat e shenjat greke është fort e bukur dhe fare e qartë. Dyke pasur ky parasysh edhe gjuhësinë dhe dyke përshkruar djalekte e jo gjuhë literare për popull, e shënon edhe kvantitetin apo gjatësinë po kudo atje ku këjo me të vërtet është e jo vetëm atje ku i ka pëlqyer ati apo ndonjë tjetëri. Këtë e shënon miretvesht mbas mënyrës greke me cirkofleks apo e dyfishon zënëtoren e gjatë, po mbasi pashë, se mjerisht edhe Mitkua nuk është në këtë gjë fare konzekvent, e lashë pa shënuar dyke dashur t'ja lehtësojë punën shtypëshkronjësit dhe shumicës së këndonjësvet të dashur. Mitkua ka

shkruar me të vërtetë ç ka dëgjuar, pra edhe ky, si edhe shumë shkrimtarë të përmendur, nuk e ka zbukuruar gjuhën, as me ë-za apo gjë-za as me theksa apo shkrepca, si disa prej nesh, të vetëquajturit albanologë apo filologë, të cilët dyke mos ditur, se ku duhen ngulur këto, tërë jetën e tyre e shkojn dyke ngulur e shkulur, e me këtë mënyrë e mundojn si veften ashtu edhe të shkretin popull. Prandaj edhe mbas kaqë vjetëve që kur ka dal urdhëri i përdorimit të theksës në gjuhët literare apo zyrtare nuk duket edhe ky as gjëkundi të ketë zënë vent. Nuk mbesoj të ketë as pesë vetë në Shqypëri që t'a dinë t'a përdorin atë rregull të famshëm.

Mbasi ky libër, mjerisht, nuk gjindet më as ndëpër bibliotekat më të mëdhaja t' Evropës, përveç kësaj, sikundër thamë, është shtypur me shkrojla gërqishte, dhe gërqisht e mjaft keq, gjer sot ky thesar i bukur ishte i humbur për popullin tonë, pandajza i pamasë ishte gëzimi jem kur e gjeta këtë librë të rallë, se dyke e përshkruar e përkthyer shqyp do të mundet të këndohet prej popullit, do të pasurohet pak literatyra jonë e varfër, do t'i mos shkojë kot mundi i math Thimi Mitkos dhe më [në] funt do të ken parasysh ata që duan të shkojnë pas gjurmave të këti mbledhësit të famshëm një shëmbëll të bukur e të pëlqyer.

Unë i përshkrojta me shkrojla shqype këngët, përallat, fjalët e moçme, fjalët e errëta ett., e përktheva shqyp parathënjen, i përktheva shënimet istorike të trimave q' ukëndohen këto kënga, që përmban këjo libër e ndreqa më mirë radhuan e këngave dhe të lëndës përgjithërisht, që të gjejë syri një kënaqësi dhe këndonjësi lehtësi.

Por dyke pasur parasysh sado shumicën e këndonjësvet Shqyptarë e shtrentësinë e madhe të sotshme të shtypit, lashë pa shtypur katër fletë me disa këndime istorike të Dorës d' Itsrja të përkthyera e të stypura edhe më tjetër vent prej Dhimitri Kamardës: Faqe 1-3. "Filia shqypëtare nga këngat e llauzit". Një pjesë e istorisë "Dora de Istria" që u shpall ndë ditëtoret "Epitheorisis ton dhio kosmon" në Paris, qe e nkëthyer, thuaj se, mbë të gjitha gjuhërat e Evropës, edhe zoti Kamarda e nkëtheu shqyp me shkronja italishte mbë 1867. Faqe 3-7, "Shqypërija para zapëtimit të turkut". Faqe 7-8. "Istorija e Vasilit Janosë dhe e Mahmut beut Vlorës. E lashë dhe këngën e parë të këngave shqype trimërishte, e cila nuk është këngë popullore, po është një vjershë e Z. K. Dorrës edhe ishte e shtypur prej K. Dh. Kamardës "Vdekja e Skanderbegut", Faqe 100, kënga e Veli Gegës Dervenagajt të Ali Pashës është gërqisht e u përkthye shqyp prej zotit Dr. Bashos. Faqe 149-150 mbet e pa shtypur edhe një vjershë e de Radës.Gjithashtu e lashë pa shtypur dhe fjalurthin e vogël, i cili nuk përmban fjalë që kanë nevojë për shpjegim.

Në mërgim kaqe munda kaqe bëra, po kam shpresë, se edhe me këtë veprë të vogël, do t'ua fitojë zembrat zyrtarëve dhe bashkëatdhetarëvet kompetent edhe për thesarin (aznën) shumë më të math e më të bukur të pambledhur që ron ndër popull dhe është me aq rëndësi për popullin mbarë. Kam shpresë, se që sot e tutje do të përkujdesen këta që të gjejn ca më parë njerzë të zotë që t'a mbledhin e të mos lënë të humbi një pasuri aq e madhe, një gjë aq e çmuar për gjithmonë për popullin tonë të varfër.

Përkthimet prej gërqishtes janë bërë me përkrahjen e ndihmën e posaçme të mikut tem të dashur Z. Dr. J. Bashos, për të cilën punë të shkëlqyer po i falem nderit edhe këtu prej thelbit të zembrës.

Pekmezi Vjen-ë, 15.VIII.1923

Thimi Mitko (1820-1890)